

JERONIM DE RADA

VEPRA HISTORIKO-FILOLOGJIKE
KURUAR NGA PROF. JUP KASTRATI

in memoriam



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE
PËR ARBËRESHËT

JERONIM DE RADA

VEPRA HISTORIKE
DHE FILOLOGJIKE

Përkthyer prej italishtes, pajisur me një studim hyrës
dhe me shënime e komente plotësuese nga

Prof. dr. Jup Kastrati

Tiranë, 2020

Recensues: Prof. dr. Emil Lafe

Prof. dr. Klara Kodra

Redaktorë shkencorë: Prof. as. dr. Bashkim Gjergji

Dr. Vilma Proko

Dr. Manjola Tërshana

Redaktor përkthimi: Dr. Elda Katorri

Redaktor gjuhësor: Dr. Vilma Proko

Korrektor letrar e teknik: Enkelejda Misha

Përgatitja grafike: Klevina Zhuri

© Copyright QSPA, për këtë botim

ISBN 978-9928-4664-0-2

AKADENIA E SHKENCAVE E RPS TE SHQIPRISE
Korpusi "Trashëgimi ynë kulturor"
Monumente të gjuhës shqipe

JERONIM DE RADA

VEPRA HISTORIKE DHE FILOLOGJIKE

Punuar nga
JUP KASIRATI

Shkodër, 30 shtator 1977

TREGUESI I LËNDËS

HYRJE 17

PARATHËNIE 23

JUP KASTRATI, *Mendimi politik e patriotik në veprat historike e filologjike të Jeronim De Radës*

KREU I

VEPRA HISTORIKE E GJUHËSORE (1833–1903) 31

- 1) Shënim (1834) 31
- 2) Sqarime (1843) 33
- 3) Identiteti i pellazgëve me shqiptarët (1846) 34
- 4) Nga gramatika shqipe e Kamil De Radës (1847) 42
- 5) Lashtësi e kombit shqiptar dhe afëri e tij me helenët dhe latinët (1864) 44
- 6) Ardhja jonë e shkretë në Itali [Emigrimi i shqiptarëve në Itali] (1866) 78
- 7) Alfabeti shqip (1866) 82
- 8) Shqipëria përballë Europës (1880) 84
- 9) Alfabet kombëtar (1883) 95
- 10) Shënime gramatikore për këngën e Ibrahimit nga Peja (1883) 97
- 11) Arbëreshët e Kalabrisë (1884) 99
- 12) Kolegji arbëresh I, II, III (1884) 102
- 13) Shënime gramatikore (1884) 108
- 14) Tri fjalët shqipe (1884) 110
- 15) Fjalori i Rapsodive: Parathënie (1884) 111
- 16) Vërejtje (vëzhgime) gjuhësore (1885) 114
- 17) Arbëreshët e Greqisë (1885) 116
- 18) Pellazgë e helenë (1885) 118
- 19) Kolegji arbëresh në Shën Adrian (1886) 122
- 20) Hyjnizime etnografike (1886) 124
- 21) Përparime në klasifikimin e gjuhës shqipe (1886) 127

22) Gjurmë të vendbanimeve tona të lashta (1887)	128
23) Kolegji i Shën Adrianit (1887)	132
24) Mësime për gjuhën shqipe (1891)	135
25) Katedra e shqipes në Shën Mitër Koronë (1892)	139
26) Konferenca mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe dhe të gramatikës së saj (1893)	143
27) Alfabet kombëtar (1897)	177
28) Pellazgo-Shqiptarët (1897)	180
29) Por është e nevojshme një pjesëmarrje e gjerë në rimëkëmbjen kombëtare (1898)	183
30) Shqiptarë dhe grekë (1899)	186
31) Tipare të gjuhës shqipe dhe përmendore të saj në periudhën parahistorike (1899)	191
32) Ligjëratë e mbajtur me rastin e hapjes së shkollës shqipe në Kolegjin e Shën Adrianit (1902)	200

KREU II

VEPRA HISTORIKE-LETRARE (1836–1900) 203

1) Këngët e Milosaut: Shënime (1836)	203
2) Shënime për Këngët e Milosaos (1847)	205
3) Tregime të Shqipërisë pas vitit 1460: Parathënie (1848)	207
4) Rapsodi e një poeme shqiptare: Parathënie (1865)	209
5) Botuesit (1866)	216
6) Ritmi i poezisë së lashtë shqipe (1866)	218
7) Vëzhgime folkloristike I (1866)	221
8) Vëzhgime folkloristike II (1866)	223
9) Skënderbeu i pafat: Parathënie (1870)	224
10) Shënime mbi “Poezinë shqipe” (1873)	226
11) Shënime mbi “Poezinë shqipe” (1877)	228
12) Shënime mbi “Poezinë shqipe” (1884)	231
13) Disa sqarime të shkurta (1877)	234
14) Rapsodi kombëtare: Parathënie (1883)	236
15) Kënga mbi Ibrahimin nga Peja (1883)	240
16) Nga legjenda e Salardit (1883)	243
17) Fjalë të urta shqipe (1883, 1884)	246
18) Gazetë botërore (1884)	248
19) Rima (1884)	249

20) Organi Kombëtar (1884)	250
21) Paragjykime të Shqipërisë së Veriut (1884)	252
22) Realja dhe idealja në pasqyrimin e botës (1884, 1885, 1886)	253
23) Rënia e Mbretërisë së Shqipërisë: Parathënie (1885)	261
24) Një gjykim (1886)	262
25) Një gazetë (1886)	263
26) Shtypi i Vjenës (1887)	264
27) Letërsi shqipe (1887)	266
28) Antologji shqipe: Parathënie (1896)	268
29) Seksioni i Dramës. Epitalami ritual i dasmave shqiptare (1896)	270
30) Ritmi i poezisë së lashtë shqipe (1896)	273
31) Parathënie për botimin e tretë të poezive shqipe (1900)	275

KREU III

PROFILE HISTORIKO-LETRARE (1833–1896) 289

1) Domeniko Belushi (1833/1838)	289
2) Jul Variboba (1838)	295
3) Françesk Avati (1838)	295
4) Françesk Buljari (1838)	296
5) Paskuale Baffi (1838)	296
6) Anxhelo Mashi (1838)	296
7) Agostin Toçi dhe Guljelm Toçi (1866)	297
8) Milo Shini (1866)	298
9) Kostantini e Garentina (1866)	299
10) Zhuzepe De Rada (1883)	300
11) Anastas Kullurioti (1883)	302
12) Dodë Gega (1884)	303
13) Leonard De Martino (1884)	305
14) Xhovani Emanuel Bidera (1884)	306
15) Peti Mitko I (1884)	306
16) Peti Mitko II (1884)	307
17) Vinçenco Dorsa (1884)	307
18) Prenkë Doçi nga Shkodra (1884)	308
19) Kostë Beluçi (Shala) (1884)	309
20) Louis Podhorszky (1885)	311
21) Jozefina Knorr (1885)	312
22) Xhuzepe Benniçi (1885)	312

23) Xhuzepe Muzaka (1885)	313
24) Ekstrakt nga libri i Jul Varibobës, Jeta e Shën Mërisë Virgjër (1885)	313
25) Jul Variboba (1885)	315
26) Thimi Mitko (1885)	315
27) Filip Shiroka (1885)	316
28) Prenkë Doçi (1885)	316
29) Vinçenco Dorsa (1885)	317
30) Gavril Dara (1885)	318
31) Anton de Somogyi I (1885)	319
32) Anton de Somogyi II (1885)	319
33) Mikelanxhelo Bilja I (1886)	320
34) Mikelanxhelo Bilja II (1886)	320
35) Domeniko Mauro (1886)	322
36) Pashko Vasa (1886), E. de Gubernatis, M. A. Canini (1886)	323
37) Françesko Baffa, Karmine Dramis (Dhërmiu), Akile Parapunja, Xhuzepe De Rada (1886)	323
38) Xhovanni Aragona (1886)	324
39) Bernard Bilota dhe Françesko Krispi nga Glaviano (1886)	325
40) Teodor Çedrarò (1886)	326
41) Mikele Kalvoza (1886)	327
42) Xhuzepe Sqirò (1886)	328
43) Herman Buholc (1887)	328
44) Françesko Tajani I (1887)	331
45) Françesko Tajani II	332
46) Ludvig Podhorszky (1887)	333
47) Jul Variboba (1896)	335
48) Luigj Lorekjo (1896)	337
49) Kostantini i vogël (1896)	338
50) Jozefina Knorr (1896)	339
51) Bernard Bilota (1896)	340
52) Anton Argondica (1896)	340
53) Toni Gulia (1896)	341
54) Alfons Kjinigò (1896)	342
56) Nikollë Naço (1896)	342
56) Kristina Xhentile Mandalà (1896)	343
57) Anton Santori (1896)	344
58) Thimi Mitko (1896)	346
59) Leonard De Martino (1896)	347
60) Rodrigo De Rada (1896)	348
61) Xhuzepe De Rada (1896)	349

KREU IV**VEPRA HISTORIKE, PUBLICISTIKE, POLITIKE (1873–1898) 351**

1) Autonomia e Shqipërisë (1873, 1877)	351
2) Flamuri i Shqipërisë (1877)	352
3) Protestë I (1878)	353
4) Protestë II (1878)	355
5) Jeta e Skënderbeut Zemërmadh (1878)	357
6) Vrasja e Mehmet Ali Pashës (1883)	363
7) Lidhja e malësorëve (1883)	369
8) Austria dhe Shqipëria (1883)	370
9) Lajme nga kombi ynë (1883)	372
10) Letër nga Janina (1883)	373
11) Ndarja e Europës (1883)	374
12) Dhëlpëritë e Greqisë (1884)	376
13) Na shkruajnë për këtë gjë nga Toskëria (1884)	378
14) Lajme nga Shqipëria (1884)	379
15) Ku e shtyjnë? (1884)	381
16) Programi i radikalëve ungarezë (1884)	384
17) Lajme të reja nga Shqipëria (1884)	386
18) Lajm i fundit fare (1884)	387
19) A duan, pra, të na i marrin dritën e syve? (1884)	388
20) Se erdh koha! (1884)	391
21) Lajm i lumtur! (1884)	393
22) Lajme të rënda nga Shqipëria oshëtijnë në Europë (1885)	395
23) Na shkruajnë nga Durrësi (1885)	397
24) Të abonuarit bashkëkombas të kolonive shqiptare të Italisë (1885)	398
25) Të abonuarit bashkëkombas (për vitin e parë) të kolonive shqiptare të Italisë	401
26) Por çështja është zbuluar (Po ranë perdet) (1885)	404
27) Drita (1885)	406
28) Nga Janina më 16 korrik 1885 (1885)	407
29) A janë zhdukur retë? (1885)	408
30) Puljet dhe Shqipëria (1885)	410
31) Turbullira (trazime) në Shqipëri (1885)	411
32) Të federuarit (të besëlidhurit) e Ballkanit (1885)	412
33) Ngushëllime në pikëllimet e tanishme (1885)	414
34) Shqipëria dhe të përkohshmet italiane (1885)	416

35) Inaugurimi i punishtes së vajit në Shën Mitër (1885)	418
36) Ditë e shënuar e gurit të bardhë (1885)	419
37) Gënjeshtër është e shtrembër (1886)	420
38) Lajm i pritur (1886)	422
39) Koha e zgjedhjeve (1886)	424
40) Letër nga Palermi (1886)	425
41) Nga Bukureshti (1886)	426
42) Kemi këtë letër nga Misiri (1886)	427
43) Retë e Lindjes (1886)	428
44) Fryn erë e mirë (1886)	430
45) Komiteti i Bukureshtit (1886)	432
46) Dy fjalë për komitetet antiklerike (1886)	434
47) Rruga mbretërore e hapët për Turqinë (1886, 1887)	435
48) Lajme të këtyre ditëve (1887)	440
49) Kujdesi i trishtuar i save jemi sot (1887)	442
50) Fatkeqësi (mjerime) shqiptare (1887)	444
51) Ç'i lypset Shqipërisë? (1887)	446
52) Disa shënime (1887)	453
53) Një memorandum (1887)	455
54) Murgu panhelen i Korçës (1887)	457
55) Na shkruajnë (1887)	458
56) Ne duam një shtet më vete dhe për vete! (1896)	459
57) Asnjë besim në grekun! (1897)	463

KREU V

VEPRA HISTORIKE-AUTOBIOGRAFIKE (1885–1902) 465

1) Autograf (1885)	465
2) Autobiologjia I, II, III, IV (1898, 1899)	475
3) Testamenti politik (1902)	532

KREU VI

EPISTULAR (1834–1902). NGA LETRAT E BOTUARA 543

1) Rafael Xagarezes (20 tetor 1834)	543
2) Mikel De Radës (20 shtator 1839)	546
3) Së Shenjtës Virgjëreshë të Papërlyer (8 dhjetor 1840)	547

4) Vinçenc Dorsës (1847)	549
5) Kalorësit Saverio Prato, komandant vullnetarësh në Venedik (2 qershor 1848)	551
6) Santori im (3 prill 1865)	554
7) Al signor D. Giovanni Stamile, S. Giacomo (Gjon Stamiles, 25 janar 1865)	557
8) Dhimitër Kamardës (21 qershor 1865)	566
9) Dhimitër Kamardës (25 qershor 1865)	568
10) Dhimitër Kamardës (22 janar 1866)	571
11) Dhimitër Kamardës (10 korrik 1866)	574
12) Dhimitër Kamardës (5 tetor 1866)	576
13) Zotni Bartolomeo Çeketit për studimet e tij mbi veprat e princeshës Elena Gjika (Dora d'Istria 10 shtator 1868)	579
14) Gjinnazi Garopoli në Koriljano Kalabro (25 tetor 1868)	581
15) Nxënësve të gjimnazit të Koriljanos në hapjen e shkollave (1 dhjetor 1868)	583
16) Lartësisë së Saj Princeshës Elena Gjika (1870)	587
17) Gustav Majerit (31 tetor 1883)	588
18) Gustav Majerit (1887)	590
19) Gustav Majerit (22 maj 1888)	592
20) Gustav Majerit	593
21) Çezar Kantusë	596
22) Zonjë ime shumë e mirë dhe e ndritur. Letër Baroneshës Jozefina Fon Knorr (28 Mars 1884)	601
23) Baroneshës Jozefina Fon Knorr (ditën e Pashkëve të Shenjta 1884)	603
24) Shumë i ndritshmi zotni i imi, Kalorësi Luigj De Simoni (20 shtator 1885)	604
25) Drejtorit të gazetës " <i>l'Adriatico</i> " të Venedikut (12 dhjetor 1885)	606
26) Anton De Somogyit (20 dhjetor 1885; 20 mars 1886)	609
27) Zotit Mark Anton Kaninit (20 janar 1886)	614
28) Thimi Mitkos (15 maj 1887)	616
29) Shkëlqesisë së Saj Princeshës Adele Pinjатели Strongoli (1891)	618
30) A G. C. Bugliarit. Letër Khan Krizostomo Buljarit (4 korrik 1893)	621
31) A G. C. Bugliarit. Letër Khan Krizostomo Buljarit (7 tetor 1894)	621
32) Thirrje shqiptarëve-pellazgë të Italisë dhe jashtë saj (gusht 1895)	622
33) Fjalim (përrurimtar) (20 shkurt 1897)	624
34) Fjalim (21 shkurt 1897)	625
35) Zef Sqiroit (30 korrik 1897)	626
36) Kontit Engjëll De Gubernatis, drejtor i revistës "Vita Italiana" ("Jeta italiane") (15 gusht 1897)	627

37) Anselm Lorekjos (15 janar 1898)	629
38) Zef Sqiroid (15 mars 1898)	630
39) I nderuari Zotni Komendator R. Kavacca (30 nëntor 1900)	631
40) Mikele Markianòit (13 prill 1901)	633
41) Anselmo Lorekios (31 janar 1902)	635
42) Anselmo Lorekios (5 prill 1902)	636
43) Donatelo Nives (Viktor Gaspër Gualtierit) (31 maj 1902)	637
44) Viktor Xh. Gualtierit	639
45) Mikele Markianòit (1 nëntor 1902)	640

KREU VII

VEPRA HISTORIKE DHE FILOLOGJIKE-TEKSTI

NË DIALEKTIN ARBËRESH, TRANSKRIPTUAR

NGA JUP KASTRATI (30 dhjetor 1977)

641

1) Zotni Bartolomeo Çeketit për studimet e tij mbi veprat e Princshës Elena Gjika (Dora d'Istria) (10 shtator 1868)	641
2) Buljëri e vëlezëris t'arbërit. Gjithë zotrave t'arbëresh (18 maj 1878)	643
3) Gjella e Skanderbekut zemër madhe (1878)?	645
4) Rapsodi Kombëtare: Parathënie (20 korrik 1883)	651
5) Vrejçja e Mehmet Ali Pashës (20 korrik 1883)	655
6) Vlem' e malsorëvet (20 korrik 1883)	660
7) Ljëpush nga Janina. Zotit N. N. (30 shtator 1883)	661
8) Lajme të kombes s'anë (30 shtator 1883)	662
9) Anastas Kolurioti (15 dhjetor 1883)	663
10) Proverbe t'arbëresh (15 dhjetor 1883; 15 janar 1884; 30 mars 1884; 20 nëntor 1885)	664
11) Austria e Shqipëria (30 shtator 1883)	666
12) Distaksitë e Europës (15 dhjetor 1883)	668
13) Ka përralez e Salardit (15 dhjetor 1883)	670
14) Zef De Rada (Xhusep' i Ràdhanjet) (20 dhjetor 1885)	673
15) Nijata të Greçies (15 janar 1884)	675
16) Na shkruanjën mbi këtë ka Toshkëria (15 janar 1884)	676
17) T'Arbrësht e Kalabries (15 janar 1884)	677
18) Laijme të Shqipërisë (28 shkurt 1884)	679
19) Dod Gega (28 shkurt 1884)	680
20) Kollegji i Arbrësh (28 shkurt 1884; 30 prill 1884; 30 korrik 1884)	682
21) Ku e shtinjën? (30 mars 1884)	688
22) Programi i radikalëve ungarezë (30 maj 1884)	690

23) Laijme të Shqipërisë (30 maj 1884)	692
24) Laijm' i ati-parthina (30 maj 1884)	693
25) Tri fialjë t'arbëresha <i>at, ëmë e sis</i> (30 maj 1884)	694
26) Poka duan të na diegën dritën e sivet? (30 qershor 1884)	695
27) Se erth ghera (30 qershor 1884)	697
28) Paragjykime të Shqipërisë Veriore (30 shtator 1884)	698
29) Laijm i ljumë (30 tetor 1884)	699
30) Laijm i randë nga Shqipëria kumbon nd'Europët. Dhiovasmi tek l' Intrasigéant di Parigi (10 prill 1885)	701
31) T'arbrësht t'Elladhes (10 prill 1885)	702
32) Po ranë sqepet (20 maj 1885)	703
33) Na shkruanjën ka Dirahji (20 maj 1885)	705
34) Drita (20 qershor 1885)	706
35) Ekstrakt nga libri i Jul Varibobës "Gjela e Shën Mërisë Virgjërë" (20 qershor 1885)	707
36) U lëfartin retë? (20 shkurt 1885)	708
37) Thimi Mitko (20 gusht 1885)	710
38) Kā Janina 16 të korrikut 1885 (20 gusht 1885)	710
39) Rënja e Mbretërisë së Shqipërisë: Parathënie (20 gusht 1885)	711
40) Pelasgë dhe helenë (20 shtator 1885)	712
41) Puljet dhe Shqipëria (20 shtator 1885)	715
42) Të federuarit e Ballkanit (20 tetor 1885)	716
43) Ngushëllime në mundimet e tashme (20 tetor 1885)	718
44) Shqipëria e ditaret e ljetire (20 nëntor 1885)	720
45) Inaugurimi i punishtes së vajit në Shën Mitër (20 nëntor 1885)	722
46) Ditë e shënùam (20 dhjetor 1885)	723
47) Programi i radikalëve të Francës. Letër Ant. De Somogyi-t (20 dhjetor 1885; 20 mars 1886)	724
48) E rremja ë çaljoge (20 janar 1886)	728
49) Laijm i pritur (20 janar 1886)	730
50) Kuvendi I Arbëresh Shën Trianë (20 shkurt 1886)	731
51) Letër nga Palermi (20 mars 1886)	733
52) Nga Bukureshti (20 mars 1886)	733
53) Gjon Aragona (20 prill 1886)	734
54) Vaitime (20 prill 1886)	735
55) Kemi kët ljëpush nga Miziri (20 prill 1886)	736
56) Retë e Apoljesë (15 tetor 1886)	737
57) Hyjnizime etnografike (15 tetor 1886)	739
58) Dy fjalë mbi komitetet antiklerike (15 nëntor 1886)	742

59) Frinë ajër i mirë (15 nëntor 1886)	743
60) Udhë e madhe e gapt Turqisë (15 nëntor 1886; 15 mars 1887)	745
61) Laijme këso-ditëshim (15 mars 1887)	748
62) Kardasgji e save jemi sot (15 mars 1887)	749
63) Psùame shqipe (15 prill 1887)	750
64) Ç'i ljpset Shqipërisë? (15 prill 1887; 15 gusht 1887; 15 nëntor 1887)	752
65) Letër Eftim Mitkos. Katundër e vëlâ Zoti Mitkua (15 maj 1887)	757
66) Mbeturina të seliva tona të lashta që vazhdojnë të qëndrojnë endë midis nesh (15 maj 1887; 15 nëntor 1887)	758
67) Murgu panhelen i Korçës. Na shkùanjën kâ Berati (15 gusht 1887)	761
68) Na shkùanjën ndë 20 të korrikut 1887 (15 gusht 1887)	762
69) Ludvig Podhorsky (15 nëntor 1887)	763

BIBLIOGRAFI E JERONIM DE RADËS (1831/32–1909), SHKODËR (shoqëruar edhe me origjinalin në anastatik)	765
--	------------

BIBLIOGRAFI PËR JERONIM DE RADËN (Botuar në periudhën 1903–1993)	789
---	------------

TREGUES I EMRAVE TË PERSONAVE, SHQIP, Kreu I-VI	823
--	------------

TREGUES I EMRAVE GJEOGRAFIKË, SHQIP, Kreu I-VI	831
---	------------

TREGUES I EMRAVE TË PERSONAVE, ARBËRISHT, Kreu VII	838
---	------------

TREGUES I EMRAVE GJEOGRAFIKË, ARBËRISHT, Kreu VII	840
--	------------

DOKUMENT ANEKS 1	843
-------------------------	------------

DOKUMENT ANEKS 2	847
-------------------------	------------

DOKUMENT ANEKS 3	849
-------------------------	------------

DOKUMENT ANEKS 4	901
-------------------------	------------

HYRJE

Kolana “*Thesaurus*”, një projekt që zë fill në këtë vit të parë të themelimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, mëton të realizojë ruajtjen e trashëgimisë të Universit Arbëresh të shkruar ndër shekuj. Përzgjedhja e emrit “*Thesaurus*”, në këtë rast, i referohet kuptimit masiv të përdorimit të këtij termi në zanafillat e tij, midis viteve 1260 dhe 1266, nga Brunetto Latini në *Li livres dou trésor* në Itali, por po aq edhe në Francë, në Spanjë, ku me këtë titull emërtoheshin vepra me karakter enciklopedik, të organizuara sipas kriteresh jo domosdoshmërisht homogjene, por me pretendimin e shterimit, të gjerësisë e të plotësisë së tyre.

Kolana zë fill me botimin e veprës dorëshkrim “*Vepra historike-filologjike të De Radës*”, e hartuar nga Prof. Jup Kastrati (1924–2003) me një punë shumëvjeçare, së cilës është vështirë t’i caktohet data e fillimit. Është një rast fatlum që botimet e kolanës “*Thesaurus*” të hapen me një vepër kushtuar Jeronim De Radës. Emri i tij njihet nga i madh e i vogël në mbarë Botën Shqiptare. Jeronim De Rada është kthyer tashmë në një emblemë të letrave shqipe të krijuara përtej detit, në një simbol të shpirtit dhe të qëndresës së fisit shqiptar. De Rada ishte ai që ringriti *Fiamurin e Arbërit* që më 1883, ishte ai që çeli rrugë të reja në jetën mendore të popullit shqiptar dhe i dha letërsisë shqipe e kulturës shqiptare aq vepra të çmuara sa askush tjetër, duke kryer një heroizëm intelektual dhe njerëzor në një kohë vendimtare për zhvillimet e mëtejshme të historisë sonë.

Dorëshkrimi i librit “*Vepra historike filologjike të De Radës*” ishte i gatshëm dhe iu vu në dispozicion QSPA-së nga ana e familjes së autorit. Kjo vepër, ku përfshihet edhe letërkëmbimi i De Radës me

tematikë historike e filologjike, përmbledhur, renditur, përkthyer nga italishtja përkatësisht transkriptuar nga arbërishtja nga i ndjeri Prof. Jup Kastrati (kapitulli VII), është një punë jete e tij. De Rada e kishte bërë për vete J. Kastratin që në moshën rinore. Interesi studimor ndaj letërsisë shqipe/arbëreshe e në veçanti ndaj De Radës, rezulton të ketë qenë një projekt jetësor i tij, i sendërtuar dhe kurorëzuar gjatë gjithë veprimtarisë së dendur hulumtuese me një numër të konsiderueshëm veprash, monografish e studimesh të thelluara për arbëreshët e kulturën e tyre. Po nga arkivi familjar i Jup Kastratit, dalin dokumente që dëshmojnë fillimet e mbledhjes së informacioneve nga Prof. Kastrati. Më i hershmi dokument, një dosje në format A3 (dokumenti *aneks 1* në fund të veprës), shkruar me dorë “*Për gjuhën. Dorëshkrimi i parë, Shkodër, janar 1940. 16 vjeç, nxënës i klasës së katërt gjimnaz, shkolla e mesme, sistemi i ulët*”, ku, midis shënimesh të tjera janë edhe informacionet e para mbi De Radën; dokumenti i dytë (dokumenti *aneks 2* në fund të veprës), daton në korrik 1949 (asokohe 25 vjeç) me titullin “*Shënime për letërsinë shqipe dhe për letërsinë arbëreshe*”, një fletore prej 41 faqesh, e shkruar me shkrim të dendur dore. Kjo vepër që po botohet sot është rezultante e këtij rrugëtimi të Kastratit. Në kohën që Prof. Kastrati përgatiste vëllimin që po paraqesim sot, i porositur nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sipas shkresave nr.755, datë 01.08.1975 dhe nr.755/1 datë 23.09.1975 (dokumenti *aneks 3*) dëshmohet se (citojmë): “Jup Kastrati i ngarkuar nga Akademia e Shkencave me hartimin e dy vëllimeve të shkrimeve filologjike historike të De Radës për serinë që po përgatit ajo Akademi në Korpusin ‘*Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar*’”, shkrimet e De Radës gjendeshin të shpërndara andej-këtej nëpër biblioteka e arkiva kryesisht jashtë vendit, të cilat ishin gati të paarrtshme për lexuesin e interesuar. Ideja e Prof. Kastratit për të përgatitur këtë vëllim tematik me shkrime të karakterit historik filologjik e publicistik të De Radës kishte synimin për t’i bërë ato të shfrytëzueshme nga rrethet e gjera të interesuarish, pedagogë të shkollave të larta, studiues e studentë. Si gjithë arbëreshët, De Rada ka qenë një autor dygjuhësh që synonte të njihej përveç nga gjindja e vet arbëreshe, nga publiku italian dhe europian. Përveç kësaj pjesa më madhe janë në italisht, ndërsa një pjesë tjetër arbërisht, çka e vështirësonte njohjen e tyre. Na duhet

të ndërmendim edhe një fakt të njohur tashmë, që gjuha e De Radës ishte një lloj *mélange* e italishtes dhe e arbërishtes, e cila krijonte një vështirësi unikale në të kuptuarin e në të përkthyerin e saj, gjë e cila nënvizohet nga të tre profesorët Kolë Ashta, Luigj Franja dhe Fadil Podgorica në rolin e recensentëve të veprës në fjalë (dokumenti *aneks 3* në fund të veprës). Lënda e vëllimit është edhe fryt i interesimit këmbëngulës e sistematik të përgatitësit, që ka gjurmuar *deradiana* kudo ku ka mundur, në Shqipëri dhe në Itali, për gati 30 vjet (1949–1977). Për kriteret dhe dimensionet e botimit të kësaj vepre, për gjurmimin e bibliografisë së De Radës dhe mbi të, për çështjen e riprodhimit me dorë të të gjithë dokumenteve, librave e artikujve në origjinal e më pas të përkthyer nga ai, për çështje si transkriptimi, transliterimi apo përkthimi i veprave të arbëreshëve, për projektet e tij për paraqitjen në *Opera Omnia* të De Radës etj., na jepen të dhëna shteruese të disa projekteve të paraqitura nga vetë autori Kastrati në letër prej 18 faqesh të daktilografuara (dokumenti *aneks 3* në fund të veprës) që i dërgon Kryetarit të Akademisë së Shkencave të asaj kohe, Prof. Aleks Budës, e cila daton më 20 qershor 1979 me titullin “Përgatitja për botim e veprave historike, filologjike dhe publicistike të Jeronim De Radës”.

Më 1977 Prof. Kastrati dorëzon për botim në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë variantin e parë të këtij punimi të vëllimshëm. Dorëshkrimi mbetet për plot dhjetë vjet në zyrat e këtij institucioni, pa e parë dritën e botimit. Më 28.06.1986, pra 9 vjet pas dorëzimit të variantit të parë të veprës, Prof. Kastrati merr nga Akademia e Shkencave një letër të nënshkruar nga Prof. A. Buda (dokumenti *aneks 4* në fund të veprës), me të cilën i lihet të kuptojë rikonsiderimin e mundësisë së botimit të kësaj vepre. Këtu ndërpritet dokumentimi i ecursisë së mosbotimit të këtij punimi. Pas kësaj periudhe të gjatë, Prof. Kastrati e rimerr në shtëpi dorëshkrimin. Familjarët e Prof. Kastratit ia kaluan të drejtat e botimit të kësaj vepre vetëm për këtë botim të parë, Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Dorëshkrimi u dorëzua pranë zyrave të QSPA-së, siç ishte lënë nga autori. Në këtë kuadër, le të sqarojmë edhe kriterin dhe procedurën që u ndoq për gatitjen për botim nga ana e grupit përgatitor të këtij Institucioni.

Së pari: titulli i veprës “*Jeronim De Rada, Vepra historike filologjike*” është ai që rezulton në dorëshkrimin të cilin QSPA mori në dorë. Më pas, në dokumente të tjera të pasqyruara në fund të këtij botimi, rezulton edhe si: “*Vepra historike filologjike e publicistike të De Radës*”. Grupi përgatitor mori për bazë titullin që gjendej në dorëshkrim. Për këtë arsye, faqja e parë e dorëshkrimit, ku rezulton edhe titulli i parë i sipërmendur, është vendosur e skanuar në hyrje të kësaj vepre.

Së dyti: kriteri i vendosur paraprakisht dhe i miratuar nga Këshilli Koordinues i Institucionit, organ autonom, ishte që të respektohej *ad litteram* dorëshkrimi, pa prekur apo ndërhyrë në asnjë pikë të tij. Duke marrë në konsideratë vullnetin e mirë të Institucionit për ta paraqitur veprën në mënyrën më cilësore të mundshme dhe, njëkohësisht, duke respektuar parimet bazë të gatitjes për botim të një vepre të kësaj fare, në bashkëpunim me studiues, kolegë të QSPA-së e bashkëpunëtorë të jashtëm, ecuria e mëtejshme përshkoi këto pika:

- rishikimi i gjithë tekstit të përkthyer nga italishtja në shqip; ka pasur plotësim të përkthimit në: disa shprehje latine të cilat ishin lënë pa përkthyer nga autori; të disa faqeve të papërkthyer të cilat nuk gjendeshin as në këtë dorëshkrim të Kastratit, por as në arkivin e tij personal që ruhet nga familjarët;
- rishikimi i bibliografisë së gjithëmbarshme. Në këtë rast, sërishmi familjarët vunë në dispozicion dokumentin origjinal të bibliografisë së De Radës të hartuar nga Kastrati deri në vitin 1962, e cila nuk u gjet në dorëshkrim. Për këtë arsye, si dhe për të pasqyruar besnikërisht punën e bërë nga autori Prof. Kastrati, kjo bibliografi e vendosur në fund të veprës, paraqitet në mënyrë anastatike, nga njëra anë e skanuar dhe në faqen përbri e shkruar në word në kompjuter;
- në rishikimin bërë tekstit nga redaktorët gjuhësorë, është ruajtur gjuha e përdorur nga Prof. Kastrati në periudhat përkatëse të hartimit; e cila mbart edhe gjurmë të strukturës gege;
- kapitulli në arbërisht (kapitulli VII), është lënë *telle quelle* siç është i transkriptuar në dorëshkrimin origjinal;
- hartimi i treguesve të emrave gjeografikë dhe emrave të personave të të gjithë tekstit, është kryer nga QSPA-ja, e cila vendosi të përfshijë vetëm ata realë, duke lënë jashtë të gjithë emrat dhe vendet mitologjike dhe biblike.

- **Perëndi greke dhe romake:** Kronosi, Urani, Jovi, Jupiteri, Hera, Junona, Mira, Teti (Thetis), Jea (Zea, Gea), Athena (Athina), Afrodite (Afërdita), Venusit, Demetra, Sibila, Apolloni, Ifesti (Hefesti), Saturni, Poseidoni (Posidhon), Baku, Hermesi, Nemesa, Tartari, Lycina, Venera, Jani, Diana (Dia, Dhia), Merkuri, Vesta, Nekmentia, Vullkani, Titanët, Io, Perseu, Juno, Lucina, Cereri (*Çereres*), Tritolemi, Aristéo, Atlasi, Angerona, Lari, Angerona, Elici, Marsi, Ana Perena (Anna Perenna), Erebi, Minerva, Ares, Mnemozina.
- **Personazhe mitikë të mitologjisë greko-romake:** Odisea (Odhise, Uliksi), Abari, Herkuli, Akili (Aqilé), Peleu, Patrokli, Andromaka, Jasoni, Paridi, Romi, Ariana, Eneu, Rezi – mbret i Trakës, Dardani, Antenori, Remi, Romuli, Numa Pompilis, Aria, Abari. Agamemnoni, Amfiloku, Alkmeoni, Eumolpi, Atmes, Prokusti, Adonisi, Lino, Jalemo, Thespi, Pellazgu, Sem, Kam, Jafet, Edipi, Antigoni, Sita, Kasandra.
- **Personazhe biblikë:** Shën Baldasari, Shën Gjoni, Adami, Abrahami, Maria, Satanai, Moisiu, Davidi, Solomoni, Jozuhi, Gedeoni, Noe.
- **Për të shmangur pasaktësi të mundshme historike QSPA vendosi të mos përfshijë në treguesin e emrave personazhe të ndryshëm nga Revolucioni Grek, sa herë që ata janë përmendur vetëm me mbiemër, pa emrin përkatës:** Zavella (Xhavella), Macry, Odisea, Miauli (Miaouli), Tombasi (Tombazi), Karaiskaki (Karaiscaki, Karaiskaji), Kondurioti (Condurioti), Bulgari, Bubulina (Bobolina), Botzari, Maurokordato, Mavromati, Nikokël, Niçeta, Misuli, Makri, Odiseu, Gura, Macry.
- **Personazhe të paidentifikuar, bashkëkohës të De Radës:** Palemoni (me gjasa studiues); ministrat e qeverisë burbone të Napolit: Ministri Januci, Ministri Skura, Ministri Mançini, Ministri Koppino, Ministri Bozzelli-Poerio, Ministri Boceli, Ministri Karreto, Konti i Aquila-s, Buskaljoni, Koeli, Kancio, Gesler, zonja Agata, Sulejman pasha, Tanuçi, gra të paidentifikuara nga ngulimet arbëreshë si Zibia, Rita apo Tortoshëlja, Ahmedi – luftëtar që vritet në betejën mes forcave shkodrane dhe atyre të Pasvan Oglusë; Konti dhe zonja Le Fèvre, *Çirili dhe Pagani, Forieli, Deahu, E. Paskualigo, Irneba, Seguer, Lutcenbaher, Zavarrone, Bovio, Fumeli*, Hasan Aga, prifti Pjetër, bej Vlora, Zulopi, Hajredin

begu dhe Riza begu, Prifti Miçeli dhe prift Luigji, Baroni Dramis, Meletoi, prift Salomon inga Vikarico, Vitaliano, Vëllezërit Kiodi të Moisiut, Euxhenio gjyqtar në Kozenca, Kuçi gjyqtar në Kozenca, Vulgari (Bulgari), Kalorës De Simone, Vesel Pasha, Haes-el Pashës, vëllezërit Korradi, Alberti i Markjanonjëvet, Kristina e Mandalojt, Mauro, Mancini, De Lauzières, baroni Bellelli, markezi Vulkano, poetesha Guacci, gjenerali Lubrano, Zagarese, Ferriolo, Valentini, dukë i Mignano-s, Mingiani, profesor Gjilji, gjeneral de Liguori, gjeneral Filaxhierin, markeze Linjola, konti Riçiard, gjenerali Buzaka, maresalli Leka, kryegjykatësi Bizantis, toger Çiard, dado Adriana, Regjina, Angjelika, Setembrini, kozentinët Salfi, Stumbon dhe Milonen, kavalieri D. Nikolla, markezi Spiriti, D. Salvatore, baroni Pasalakua, duka Marota, baron Beleli, konti dhe zonjushat Lë Fevrë, kont Avati, Princi di Strongoli Pinjатели, baron Marsiko, peshkop Da Leçe, profesor Dorotea, profesor Mazi, banditi Mikariëlji, Bokkaçiami dhe vëllezërit Bandiera, Xhioberti, D. Plaçido, Pepe, Beteli, Kryedjakoni Kanjaci, Xupeta, La Çiçilia, kapiteni Sale, Buskaljoni, kolonel Koeli, Kancio, Komonduros, Konsulli grek Kamaço, Jankopilo, Kieperti, Komendator R. Kavacca, D. Antonio, diplomati grek Kamaço.

- **Toponimia nga mitologjia greko-romake:** Lumi Flegetonti (Phlegethon, lumi Koçiti (Cocytus), fushat Elizej, Phthias;
- **Toponimia biblike:** Iskarioti, Babeli; si dhe termi i pidentifikueshëm: Rresh.

Me falënderimin për grupin përgatitor të veprës për botim, veçan tyre, kemi detyrimin të shprehim mirënjohjen tonë për gatishmërinë dhe shpejtësinë me të cilën iu përgjigjën thirrjes për ndihmë nga ana e Qendrës, *për të saktësuar përkthimin e disa termave dhe frazave në shqip nga italishtja e De Radës, edhe profesorit arbëresh nga Spezzano Albanese, z. Francesco S. Marchianò* e të tjerëve kolegë e miq arbëreshë që parapëlqyen të mos citohen këtu. Pastë rrugëtim të mbarë Kolana *Thesaurus!*

PROF. DIANA KASTRATI
Drejtoreshë Ekzekutive e QSPA

PARATHËNIE

Në këtë libër kam mbledhur e sistemuar disa punime historiko-filologjike e publicistike te Jeronim De Radës. Duke u marrë për vite të tëra me shqyrtimin e jetës, të krijimtarisë letrare dhe të veprimtarisë së tij shkencore, kam mbledhur mjaft artikuj e studime të ndryshme diturake, që nuk njihen sa duhet në masën e gjerë të lexuesve. Këto i kam gjetur në biblioteka e arkiva tona e të arbëreshëve të Italisë, kryesisht në Kalabri. U përkasin gjurmimeve të mia të periudhës 1949-1978. Materialet janë të shpërndara në organe të ndryshme, revista e gazeta e disa broshura e libra botuar kryesisht në gjuhën italiane, por edhe në të folurën arbëreshe të Maqit dhe të Shën Mitër Koronës. Sipas përmbajtjes së tyre e pashë të arsyeshme që t'i klasifikoj në pesë kapituj.

Kreu I: Vepra historiko-gjuhësore (1834–902).

Në punimet e këtij kapitulli janë ndihmesat e Arbëreshit të madh për gjuhën e gjuhësinë shqiptare. Në studimet Deradiane në shqip është e para herë që kjo dukuri e poetit të shquar bëhet e njohur në këto përmasa; ndaj, në libër, zë edhe vendin më të gjerë. Aty spikasin pikëpamjet e De Radës lidhur me prejardhjen pellazgjike të shqiptarëve, me zanafillën e gjuhës shqipe dhe me marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje. Këto dalin në pah në veprat e tij: *Identiteti i pellazgëve me shqiptarët* (1846), *Lashtësi e kombit shqiptar dhe afëri e tij me helenët e latinët* (1846), *Pellazgë e Helenë* (1885), *Gjurma të vendbanimeve tona të lashta që rrojnë ende* (1887), *Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe* (1893), *Pellazgo-Shqiptarët* (1897), *Shqiptarë dhe Grekë* (1899), *Tipare të gjuhës shqipe dhe përmendore të saj ne periudhën parahistorike* (1899) etj. Ndër këto punime, autori përpiqet të argumentojë, me konceptet dhe ekuacionet e tij, lashtësinë

e kombit tonë, duke folur për gjuhën shqipe.

Në disa punime të tjera dalin në pah ndihmesat e tij gramatikore, në fonetikë, morfologji si dhe diskutimet e tij për çështjet e alfabetit. Përmendim, për ilustrim, studimet: *Nga Gramatika shqipe e Kamil De Radës* (1847), *Vërejtje gramatikore* (1866), *Shënime gramatikore* (1883, 1884), *Dukuri gramatikore të gjuhës shqipe* (1885), *Sqarime* (1834), *Alfabeti shqip* (1866), *Alfabeti kombëtar* (1883, 1897) etj. Toponimia historike, leksikologjia, leksikografia, dialektologjia, gjuha letrare e kombëtare shqipe e njësuar janë disa nga disiplinat linguistike që ka prekur De Rada: *Tri fjalë shqipe* (1884), *Fjalori i Rapsodive* (1884), *Vërejtje gjuhësore* (1885), *Përparime në klasifikimin e gjuhës shqipe* (1886), *Mësime për gjuhën shqipe* (1891) etj.

Plot interes janë të dhënat e De Radës për shkollën shqipe ndër arbëreshët: *Kolegji arbëresh* (I, II, III) (1884), *Kolegji arbëresh në Shën Adrian* (1886), *Kolegji i Shën Adrianit* (1887), *Katedra e shqipes në Shën Mitër Korne* (1893), *Ligjëratë [e mbajtur] me rastin e hapjes së shkollës shqipe në Kolegjin e Shën Adrianit* (1902) etj.

Për historinë e kolonive shqiptare kanë njoftime të çmueshme punimet: *“Arbëreshët e Kalabrisë”* (1884), *“Arbëreshët e Greqisë”* (1885) etj. Të dhëna me vlera na dëshmon De Rada edhe në artikullin: *Ardhja jonë e trishtuar në Itali (Emigrimi i Shqiptarëve në Itali)* (1866). Por ky punim nuk më duket të jetë i dijetarit tonë të madh. Në kreun e parë të veprave historike gjuhësore ka edhe studime të tjera të dobishme për gjuhën shqipe, si p. sh. *“Shqipëria përballë Europës”* (1880), *“Por është e nevojshme një pjesëmarrje e gjerë në rimëkëmbjen kombëtare”* (1898) etj.

Nuk pretendoj të kem sosur problemin e gjuhës amtare dhe të gjuhësisë shqiptare ndër veprat e De Radës. *Kreun e parë: Vepra historiko-gjuhësore* e konsideroj si një hyrje apo përpjekje në këtë drejtim. De Rada ka bashkëpunuar me disa organe të shtypit periodik të kohës, kryesisht italisht, por edhe frëngjisht e gjermanisht. Unë nuk kam pasur mundësi t’i shoh të gjitha, prandaj, duhen bërë gjurmime sistematike ndër bibliotekat e Italisë për t’i gjetur e për t’i sjellë në Shqipëri: *“Omnibus”* (1836), *“Viaggiatore”* (1840), *“Lucifero”* (1843), *“Athinà-Minerva”* (1845), *“Calabria letteraria”* (1847), *“La rivista Europea”* (1870–1872), *“Il vero”* (1878), *“L’avenir”* (1880), *“L’Adriatico”* (1885), *“Il*

Corriere di Roma” (1881), “*La vita italiana*” (1896) etj. Punime të De Radës gjenden edhe ndër përmbledhës studimesh, si p.sh. “*Passeggiate intorno Napoli*” (1844), ose “*Passeggiate per Napoli e contorni*” (1844), “*Quaranta secoli*” (1846), “*Stati Europei*” (1892) etj. Unë kam vjelë: “*L’Albanese d’Italia*” (1848, jo të plotë, por vetëm disa numra), “*Fiamuri Arbërit*” (1883–1887), “*La Nazione Albanese*” (1897–1903).

Kreu II: Vepra historiko-letrare (1836–1900).

Ky kapitull përmban parathëniet e veprave kryesore të De Radës: “*Milosao*” (1836), “*Rrëfime të Arbërit*” (1848) ose “*Historitë e Shqipërisë pas vitit 1460*” apo “*Katër histori të Shqipërisë*”, “*Rapsodi të një poeme arbëreshe*” (1866), “*Skënderbeu i pafat*” (1870), “*Sa liri dhe mirëqenieska në shtetin me përfaqësi*” (1882), “*Rapsodi kombëtare*” (1883), “*Rënia e Mbretërisë së Shqipërisë*” (1885), “*Antologji shqipe*” (1887), “*Parathënie për botimin e tretë të poezive shqipe*” (1900). Përmes parathënieve, lexuesi, përveç të tjerash, njihet me gjenezën e poemave të tij; me motive që e kanë shtyrë Autorin t’i shkruajë ato, me tematikën dhe problematikën e gjerë të tyre, me burimet dhe ndikimet eventuale të folklorit.

Poeti na shfaqet edhe si kritik letrar i vetvetes. Është një lloj metode e autoobservacionit psikologjik. Lexuesit i jepet mundësia të ndjekë evolucionin gradual të rritjes së Poetit si artist i fjalës dhe i mendimit, por edhe i filozofisë dhe i mesazheve të tij. Kreu i dytë ndryan nëvetvete edhe disa dukuri të De Radës si estet: “*Realja dhe idealja në pasqyrimin e botës*” (1884, 1885, 1886), “*Ritmi i poezisë së lashtë shqipe*” (1886), “*Letërsi shqipe*” (1887), “*Rima*” (1884).

Punën e madhe të arbëreshit të shquar për traditat popullore e pasqyrojnë veprat: “*Rapsodi të një poeme arbëreshe*” (1866), “*Vëzhgime folkloristike*” (1866), “*Rapsodi kombëtare*” (1883), “*Fjalë të urta shqipe*” (1883, 1884), “*Epitalami ritual i dasmave shqiptare (Vallja rituale në dasmat arbëreshe)*” (1896), “*Himni i tryezës së nuses*” (1896), “*Këngë mbi Ibrahimin nga Peja*” (1883), “*Nga legjenda e Salardit*” (1883). Të gjitha këto pasqyrojnë përpjekjet e dijetarit arbëresh për mbledhjen, sistemimin, botimin dhe studimin e folklorit shqiptar. Ato shprehin meritat e De Radës si dhe rolin që kanë luajtur botimet e tij folkloristike në botën e huaj për afirmimin e kombit

tonë. Në kreun e dytë ka edhe elemente etnografike: “*Paragjykime të Shqipërisë së Veriut*” (1884).

Me shumë interes për studiuesin deradian janë shënimet në poemën madhore epike “*Skënderbeu i pafat*” (1873, 1877, 1884) si dhe “*Disa sqarime të shkurtra*” (1877). Për ne, sot, kanë vlerë të veçantë disa recensione të huaja të favorshme: “*Organ kombëtar*” (1884), “*Një gjykim*” (1886), “*Një gazetë*” (1886), “*Shtypi*” i Vjenës. Ne këtë mënyrë na bëhen të ditura veprat historike të De Radës.

Kreu III: Profile historiko-letrare (1833–1896).

Në këtë kapitull kemi përfshirë 50 artikuj të shkurtër. Mund të klasifikohen në katër grupe:

Grupi I: Përfshin profile dijetarësh, shkrimtarësh, intelektualësh, folkloristësh arbëreshë të Italisë: Domenik Belushi, Jul Variboda, Françesk Avati, Francesk Buljari, Paskuale Bafa, Anxhelo Mashi, Agostin Toçi, Zef De Rada, Leonard De Martino, Xhovani Emanuel Bidera, Vincenzo Dorsa, Kostë Beluçi-Shala, Xhuzepe Bonniçi, Xhuzepe Muzaka, Gavril Dara, Mikelanxhelo Bilja, Françesko Baffa, Karmine Dramis Dhërmiu, Akile Parapunja, Bernard Bilota, Françesko Krispi, Teodor Çedraro, Mikele Kalvozo, Zef Skiró, Luigj Lorekjo, Anton Argondica, Alfons Kjinigó, Kristina Xhentile Mandalà, Anton Santori, Rodrigo De Rada.

Grupi II: Përfshin profile shkrimtarësh dhe patriotësh shqiptarë: Peti Mitko, Prenkë Doçi, Filip Shiroka, Pashko Vasa, Nikollë Naço, Toni Gulia.

Grupi III: Përmban profile studiuesish e albanologësh të huaj: Dora d’Istria, Ludvig Podhorszky, Jozefina Knorr, F. A. Stier, Anton de Somogy, Anxhelo de Gubernatis, Mark Anton Kanini, Xhovani Aragona, Herman Buholc, Françesko Tajani.

Ne kreun e tretë ka ta dhëna me interes edhe për personazhe të folkloristikës: Milo Shini, Kostandini e Garentina, Kostandini i Vogël, - për ndonjë person shqiptar enigmatik: Dodë Gega, si dhe për ndonjë publicist patriot të arbëreshëve të Greqisë: Anastas Kullurioti.

Me disa nga portretet e te lartpërmendurve, De Rada hyn në radhën e kritikëve të parë të historisë së letërsisë shqiptare. Sado

të shkurtër, artikujt e tij janë me vlerë të posaçme, sepse na sjellin indikacione bibliografike dhe informacione letrare e publicistike të kohës. Punimet janë të ngjeshura. Stili është konçiz.

Kreu IV: Vepra historike, publicistike, politike (1873–1898).

Jeronim De Rada ndër të tjetra, ka meritën e madhe të njihet në historinë e fletorizmit shqiptar edhe si pionier i shtypit tonë kombëtar, në të cilin punoi pa u lodhur në dy periudha kohore: me 1848 “*Shqiptari i Italisë!*” dhe më 1883–1887 “*Fiamuri Arbërit*”. De Rada u paraprin brezave të ardhshëm të gazetarisë shqiptare me fjalën e fuqishme të argumentuar, me ngarkesa të mëdha ideore, për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve. De Rada ishte dhe mbetet një organizator dhe redaktor i shquar i shtypit periodik shqiptar. Ai ishte dhe mbetet një mësues për artin e të shkruarit, të hartuarit të mendimit politiko-shoqëror. Si poet i madh që ishte, De Rada ka ditur që të shkruajë me frymëzim artikuj, shënime, që sot i përfshijmë në grupin e gjinive të publicistikës, me karakter analitik. Revista e tij “*Fiamuri Arbërit*” lëvroi me sukses pothuajse të gjitha gjinitë letrare dhe publicistike, duke filluar te kryeartikulli e duke shkuar deri te skica, që nga kritika e recensimi e deri te studimi e monografia.

Në veprat historike, publicistike, politike (1873–1898), De Rada hartoi artikuj me karakter kombëtar, si “*Autonomia e Shqipërisë*” (1873–1877), “*Flamuri i Shqipërisë*” (1877), “*Jeta e Skënderbeut zemërmadh*” (1878), “*Vrasja e Mehmet Ali Pashës*” (1883), “*Austria e Shqipëria*” (1883), “*Ndarjet e Europës*” (1883), “*Dhelpëritë (dinakëritë) e Greqisë*” (1884), “*Shqipëria dhe të përkohshmet italiane*” (1885), “*Udha e madhe e hapur për Turqinë*” (1886), “*Ç’i lipset Shqipërisë?*” (1887), “*Një memorandum*” (1887), “*Ne duam një shtet më vete e për vete*” (1896), “*Asnjë besim në grekun (Mos ha kini besën grekut)*” (1897), “*E ardhmja e Shqipërisë*” (1897) etj.

Revista botoi artikuj me karakter informativ: “*Lidhja e malësorëve*” (1883), “*Lajme nga Kombi ynë*” (1883), “*Letër nga Janina*” (1884), “*Lajme nga Shqipëria*” (1884), “*Lajme të reja nga Shqipëria*” (1884), “*Programi i gazetarëve ungarezë*” (1884), “*Lajm shumë i ri*” (1884), “*Lajm i lumtur*” (1884), “*Lajme të rënda nga Shqipëria ushtojnë në Europë*” (1885), “*Na shkruajnë nga Durrësi*”

(1885), “*Nga Janina*” (1885), “*Turbullira (trazime) në Shqipëri*” (1885), “*Lajm i pritur*” (1886), “*Letër nga Palermi*” (1886), “*Nga Bukureshti*” (1886), “*Kemi këtë letër nga Misiri*” (1886), “*Komiteti i Bukureshtit*” (1886), “*Dy tatë nga komitetet anti klerikale*” (1886), “*Lajme të këtyre ditëve*” (1887), “*Murgu (kallogjeri) panhelen i Korçës*” (1887), “*Na shkruajnë*” (1887), etj.

De Rada botoi artikuj të mprehtë me karakter politik në favor të çështjes nacionale: “*Protestë I, II*” (1878), “*Ku e shtynjë?*” (1884), “*Duan, pra, të na marrin dritën e syve*” (1884), “*Se erdh koha!*” (1884), “*Por çështja është zbuluar (Po ranë perdet!)*” (1885), “*Pujlet dhe Shqipëria*” (1885), “*Të federuarit (të besëlidhurit) e Ballkanit*” (1885), “*Ngushëllime në pikëllimet e tanishme*” (1885), “*Ditë e shënuar*” (1885), “*Koha e zgjedhjeve*” (1886), “*Retë e lindjes*” (1886), “*Fryn erë e mirë*” (1886), “*Kujdesi plot trishtim i të gjithëve sa jemi tashti*” (1887), “*Fatkeqësi Shqiptare*” (1887), “*Qëndrim i paligjshëm i Turqisë*” (1897), “*Duan të na e heqin atë që me të drejtë, na takon ose t’u lutemi që të na e falin (të na e dhurojnë dhe të presim)*” (1898) etj.

E përkohshmja “*Fiamuri Arbërit*” ka qenë një tribunë e vërtetë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare për vitet 1883–1887. Organi është i mbushur me burime, njoftime e indikacione për tematikën dhe jehonën e punimeve në faqet e saj. Në të kanë zënë vend artikuj të rëndësishëm politikë, shoqërorë, letrarë, kulturorë.

Kreu V: Epistular (1834–1902).

Nga letrat e botuara, dërguar ose drejtuar disa personaliteteve shkencore, letrare kulturore dhe politike të kohës, epistulari i De Radës është shumë i pasur: Gjykohet që ai ngërthen mbi tri mijë letra. Nga këto, afro një mijë, i ka sjellë në Tiranë, në Institutin e Shkencave, më 1952, Kahreman Ylli, ndërsa një mijë të tjera i kemi sjellë ne në Akademinë e Shkencave, më 1981, së bashku me Dh. S. Shuteriqin dhe A. Xhikun. Janë letra që i kanë dërguar De Radës të tjerët. Kurse letrat që u ka drejtuar De Rada shkrimtarëve, dijetarëve, publicistëve, intelektualëve të ndryshëm, arbëreshë, shqiptarë, italianë etj., nuk i kemi në dorë. Ato janë të shpërndara e ruhen ndër shtëpitë e trashëgimtarëve me të cilët pati marrëdhënie Poeti i madh. Adresat se ku gjenden i kemi hetuar e zbuluar gjatë një periudhe të

gjatë prej një gjysmë shekulli që po merremi me studimin e De Radës. Korrespondencën e tij me Nikolla Tomazeun e ka përshkruar dhe bërë të njohur Emilia Xhilpi. Një pjesë e mirë e materialeve epistulare të De Radës gjendet në Bibliotekën Qytetare të Kozencës, në Bibliotekën Kombëtare të Firences, në Arkivin e Shtetit të Venedikut, në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës, në Bibliotekën e Gracit. Jemi në dijeni se dy arka me dorëshkrime dhe me korrespondencën e De Radës janë marrë në shtëpinë e Poetit, fill mbas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, nga albanologu e bizantinologu Xhuzepe Skiro - junior që vdiq më 1985, së bashku me ish-ministrin Ernest Koliqi. Ku kanë përfunduar? Në Romë apo në Firence? Kuptimplotë është fakti që në fondin e Tomazeut, në Bibliotekën Kombëtare të Firences, gjenden letrat origjinale që ky dijetar i pat dërguar De Radës në Maq! Është detyrë e shkencëtarëve tanë që të bëjnë hetime e gjurmime për gjetjen e zbulimin e letrave të De Radës, të cilat janë të shpërndara si "*Fletët e Sibilës*" në mbarë Europën. Ato duhen mbledhur, depozituar e sistemuar pranë Arkivit të Shtetit në Tiranë, sepse janë pjesë e trashëgimisë së popullit shqiptar e të kulturës sonë kombëtare, pasuri e paçmueshme e traditave të shquara të njërit nga mendimtarët më të përmendur të së kaluarës sonë pozitive. Një botë e tërë arbëreshe e qindvjetit të nëntëmbëdhjetë dallohet në këtë thesar kolosal të kulturës sonë shpirtërore. Një panoramë e gjallë e lëvizjes mendore intelektuale, letrare, diturake del në pah përmes këtij epistulari me vlerë të jashtëzakonshme. Këto letra hedhin dritë mbi veprimtarinë letrare e atdhetare të De Radës në të mirë të çështjes shqiptare. Veç kësaj, ato sjellin të dhëna me interes për historiografinë e Rilindjes Kombëtare.

Mekërkimet e mia sistematike kam arritur të gjej letra të poetit dërguar të tjerëve. Nga këto, 18 letra u janë dërguar arbëreshëve të mirënjohur: Mikel De Radës, Anton Santorit, Gjon Stamiles, Dhimitër Kamardës, Xhan Krizoston Buljarit, Zef Skiroit-senior, Anselmo Lorekjos, Mikele Markianòit. Dy letra i janë drejtuar atdhetarit shqiptar Zef Jubanit. 16 letra u janë dërguar studiuesve dhe albanologëve të huaj: Rafael Zagarezes, Saverio Pratos, Bartolomeo Çeketit, Elena Gjikës, Jozefina Knorrit, Gustav Megerit, Çezar Kantuit, L. G. de Simonit, Anton de Somoggiut, Anton Kaninit, Adele Pinjateli Strongolit, Anxhelo de Gubernatis, R. Kavacas, Viktor Gualtierit. Disa letra të De Radës u

janë adresuar *Gjinnazit Garopoli në Korigjiano Kalabros*, nxënësve të *Gjinnazit të Koriljanos*, drejtorit të gazetës “*L’Adriatico*” të Venedikut. Tri letra: Proklamate: *Thirrje të Shqiptarëve të shpërndarë të Italisë dhe jashtë*. Dy janë: *fjalime përurimtare*.

Në mes letrave të ardhura De Radës dhe atyre që ka dërguar Poeti ka një shpërpjesëtim të theksuar. Shumë më tepër janë ato që ka marrë Poeti se sa ato që ka dërguar. Dijetari ynë i madh arbëresh nuk ka ruajtur kopje, sepse ai nuk ka punuar me makinë daktilografike.

Me veprat e sotme historiko-filologjike plotësohet edhe më mirë personaliteti poliedrik i De Radës: poet, dramaturg, estet, publicist, kritik letrar, historian, gjuhëtar, editor.

Jup Kastrati
Shkodër, më 8 janar 2003

KREU I

VEPRA HISTORIKE DHE GJUHËSORE (1833–1903)

1. SHËNIM¹

Duke menduar të caktoj një alfabet për gjuhën e këtyre këngëve, u mbështeta në shkrimin (alfabetin) italian, sepse ishin në mes të Italisë viset, ndër të cilat unë doja ta bëja të njohur këtë poezi. Por, duke ditur se shqipja, ndoshta, shumë e vjetër në mes të gjuhëve të Europës dhe e lindur, si të thuash, njëkohësisht me ndjenjat, kishte më tepër se italishtja elemente të gjithënduershme, e drejtova vëmendjen nga gjuha greke, që, siç beson Malte-Brun, dhe bashkatdhetari im mendjendrituri [Gjon] Squirò, e pat burimin në gjuhën tonë. Duke qenë se shkronjat *c, d, g, j, z*, të cilat marrin pjesë ndër fjalët shqipe, nuk kishin shkronja (shenja) përkatëse në alfabetin grek, shpresoja t'i gjeja duke analizuar shkrimet e vjetra të gjuhës greke; do të kisha gjetur për shkronjat e mësipërme tinguj disi më të fortë duke futur në përdorim shkronja korresponduese (për bashkëtingëllore) të buta *κ, δ, γ, χ, ξ*, por me theksa e shenja të tjera të zanoreve e të diftongjeve, megjithëqë shqiptimin e tyre nuk e njohim mirë. Një idé e tillë që të zbuloj, me tingujt e së folmes së Epirit [gjuhës shqipe të Shqipërisë së Jugut], harmoninë e vërtetë të gjuhës helenike, u pat lënë mbas dore për shkak të dyshimeve mbi qenien e një harmonie të tillë; këto dyshime morën hov nga shpirti im i padurueshëm dhe nga një gjendje aspak e qetë. Unë hartova, pra, një alfabet të tretë me shkronja italiane dhe një si shtojcë me shkronja greke, të cilin, pastaj, e kam përdorë,

¹ *Avvertimento* (1834), *Poesie Albanese del secolo XV, Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari, da tipi di Guttemberg*, Napoli, 1836, p. XI–XII.

në mënyrë të qëndrueshme, si diçka të plotë dhe që nuk sjell ndonjë të metë aq të dukshme. Unë po e vë në krye të këngëve, me qëllim që leximi i këtyre t'u vijë më i lehtë arbëreshëve të Italisë.

A, b, c, d, e, f, g, h, i, j, l, m, n, o, p, r, s, t, v, u, x, z.

Shtesë zanoresh: *y* ose *υ*, difton një tingull hundor që ka të bëjë me parimin: *drapyr* (= drapër).

Shtesë bashkëtingëlloresh: *κ, δ, χ, ϑ, ξ*. Përveç *λ*-së, që ka tingullin *gli*-së (lipisiare = ljpisiare, e dhimbëshme, zemërdhimbëshme, e mëshirshme), kemi edhe *γ* që ka atë të *sc* (jtuaara = shtuara, në këmbë, drejtë, qíri në kambë), *γγ* e *γγ* si *γγ* e *λbyr* = gjelbër, *γγarγγul* = gargull (shm. garguj, zool. : shtura, bregca) *γγίetur* = gjetur.

Shtesë theksash: *i* rëndi shënon gjysmëzanoret ose të shurdhëtat (japòc = shapëk, shapkë, kapelë), *i* mprehti shpreh tonin e mprehtë të një zanoreje së thjeshtë (*stafidhe* = stafidhe, rrush i thatë).

2. SQARIME 2

Serafina lindi në Artë nga Andrea Topia, princ i Epirit, kur Murati II shtroi atë vend. Shih Marin Barlecin.

Nga këngët që mbetën prej saj, [kuptojmë] se ajo nuk e kishte ndër mend të punonte një kuadër të goditur e të lidhur rreth një fakti të vetëm, siç kishte bërë Homeri; por, duke ngritur këngën popullore, në të cilën tregimi, frymëzimi dhe paraqitja gjinden të lidhura, ajo e kishte zhvilluar atë për të përfytyruar vijat e veçanta dhe të dalluara të ngjarjeve kryesore të një veprimi të hapët, që zhvillohet rreth vetvetes.

I kam shkruar këto këngë me shkronja që i përgjigjen shqiptimit të njerëzve të vendit tim, e, sigurisht, nuk e mohoj se ai shqiptim mund të jetë ndryshe, sadopak, nga ai i moçmi i Serafinës. Ja alfabeti:

a, b, c, k, x xift (= qift, gjeraqinë, kaçubet), *d, ð* ðee (= dhee, dhé, tokë), *e, f, g, ç* reçje (= réhje, kodra), *h, i, j, l, m, n, o, p, r, s, t, ð* ðieel (= thieel, i kthjelltë), *v, u, v* muneç (= mënez, man i bardhë), *x, z, ç* çogke (= zoge, zog). Përveç [këtyrë], ka tinguj që shprehen nga bashkimi i më shumë shenjave *glò* (= ljë), *vaglò* (= valjë, vaj), *γχ γχii* (= gjii, gjí), *γγ γγésciur* (= gjëshur, i thurur, brez, rryp), *gk gkoogl* (= gooljë, gōljë, gjuhë). [Shkronja] *q* gjindet vetëm në fjalën *quegli* (= kueljë, kuaj) nga latinishtja *equus* (= kalë); [zanorja] *ù* (= è) është e shurdhët *buuçikéscòme* (= buuzëqeshëme, büzëqeshëme, me buzë të qeshur).

1843

² Schiarimenti (1843), *Canti di Serafina Thopia, principessa di Zadrina nel secolo XV*, dallo stabilimento-tipografico di Domenico Capasso, Napoli, 1843, p. 67.

3. IDENTITETI I PELLAZGËVE ME SHQIPTARËT³

Një provë e madhe e identitetit të pellazgëve me shqiptarët nxirret nga emrat e hyjnive të politeizmit, që, sipas Herodotit, ishin emra pellazgë. Pellazgët që prej kohëve të hershme, sipas historive e përmendoreve të lashta, kishin një besim (fe), që hyjnizonte fuqitë e natyrës. Ata ishin dega më e lashtë e helenëve, që, të gjithë, ndër kohë të vona të Homerit, adhuronin atë forcë të natyrës të fytyrëzuar ndër hyjni mitike, emrat e të cilave s'kishin të bënin fare me gjuhën e helenëve jonikë, që fliste Homeri, por e kanë tërë kuptimin e tyre në gjuhën e shqiptarëve, që banojnë, gjithnjë, ndër ato vende, për të cilat tregon Herodoti se ishin pjesë e pellazgëve, që nuk u shkri me grekët e tërhequr rreth lisave të qëmoçëm të Dodonës.

Dhe, së pari, *Zea*, *Jovi*, rrjedh nga shqipja *Zea* (zë), shpirt, fillim; kurse *Hera*, *Junona*, e lindur në lumin Imbrasi, korrespondon me shqipen *hera*, koha, mbasi ishte bazë e atij kultit, që shpirti i botës duke bashkëjetuar me kohën në *zbrazëti* (*Imbrasi*), sajonte botën. Por nënë e lashtë e të gjitha hyjnive ishte, pastaj, *Mira*, siç vëren Gëtja në pjesën e fundit të “Faustit”, dhe *mira* në shqipen don të thotë *e mirë*, kurse e mira është burim i hyjnive njerëzore. Dhe ajo kishte falëtore të veçuara nga hierarkia e perëndive, dhe tek grekët që identifikuar me Fatën, i cili nuk kishte asnjë fuqi mbi vullnetin e Jovit për të gjykuar njerëzit.

Gjithashtu shqiptarët e quajnë detin *Det*, jetën, botën *Jetë*, tokën *Dhé* dhe, prej këtyre tri objekteve të kultit pellazg, helenët formuan tri hyjnitë: *Teti* i detit, *Jea* e botës, *Edé* (*Edhé*), ose *Plutoni*, perëndi e Tokës. *Nemesa*, hyjnesha e hakmarrjes, është një fjalë shqipe, *nëmësa* (nëma), që don të thotë mallkim dhe ata, që e bëjnë si të ardhur nga greqishtja *nemo* (shpërndaj), nuk e njohën për hyjni, dhe hakmarrjen ndëshkuese të saj e quajtën Parashikim. Hyjnia që asistonte në lindjen e njeriut, quhej *Lycina*, nga radikalet (rrënjët)

³ *Identità de' Pelasgi e degli Albanesi* (1846). Quaranti secoli racconti su e due sicilie del pelasgo Matnceer. Publicati da Emmanuele Bidera, italo-greco, Napoli, all Insegna di Aldo Manuzio, p. 9-10; 113-118.

shqipe *lleghen* (mehen, lindin), *leghenia* (lehonja, lindja), *gliogona* (ljegona, ljhona, lehona).

Së fundi, ata më të vonët, për të shpjeguar emrin e Venerës *Afrodite*, trilluan një përrallë pa kurrfarë kuptimi dhe pak e përshtatshme, në formën e saj, me të menduarit e madhërishëm, që është bazë e politeizmit. Po *afër-ditë* në shqipen don të thotë *e afërme e ditës*, *e afërt me ditën*, *afër ditës*; ose kështu shënohej ylli i Venerës, që lindte, - thotë Homeri, - nga deti; ose me këtë emër donin të shënonin afërsinë e bukurisë me dritën, të dashurisë që i gjallëron shpirtërat, me Diellin, që e shpirtëzon materien. Ndërsa, nga ana tjetër, *Athena*, (Minerva latine), hyjnesha e dijes, rrjedh nga fjala shqipe *e thëna*, fjalë, verbum, o shfaqje e diturisë.

Është për t'u shënuar se feja e Atlantidëve, d.m.th. e asaj ane perëndimore të Afrikës, e lagur nga oqeani deri ndër kohët e Muhametit, qe identifikuar me fenë Uranike greke. Dhe, tash, del pyetja: Ata, a e patën nga grekët, apo ua dhanë këtyre?

Do të mund ta vazhdonim këtë zbulim, që e provon plotësisht hipoteza e Malte-Brun-it, se shqiptarët paskan qenë helenët e vjetër, pellazgët, dega më e parë e atyre helenëve të rinj, që lulëzuan me aq madhështi më pastaj, por qëllimi i shprehur deri këtu, është, tashmë, i tepërt për një shënim.

Këta pellazgë ishin shpërndarë në fise (tribu) të gjera edhe në Azi e në Ishujt, o kryesisht në Itali. Dhe, sot, nga përmendore etruske del e qartë afëria e të folurit të anasëve [fiset e vjetra që gjetën ardhacakët kur ngulën në atë vend] të Italisë me shqiptarët, afëri që është e madhe, më fort se sa në rrënjët e në shtesat, në trajtat e foljeve. Dhe, ndoshta, nuk është një guxim i tepruar të mendojmë që hyjnitë Hesperide [të Italisë – J.K.], *Jani* e *Diana*, që paraqiteshin me dy anë (faqe) kanë dalë nga shqipja *di anë* (dy anë), ashtu sikurse emri *Ghenna*, që Ovidi në *Fastet* e tij thotë se iu pat dhënë Dianës nga anasit, është emri shqip *i Hënës*.

Mbasi u pa se emrat e atyre hyjnive, që helenët patën nga pellazgë, ishin fjalë me kuptim shqip, ne u vumë në një udhë të re dhe të drejtë, të përçaruar për të gjetur të qëmoçmit në shqiptarët e sotëm, tashmë trashëgimtarë të asaj toke që ata e kishin më parë, dhe, mbas shumë kohe, jemi të sigurtë se e kemi grisur tisin që errësonte kohën mitike e atë të Heronjve.

Tash, duke ecur pas dritës, me të cilën hapëm rrugën, do të kërkojmë të dimë ç'vend kanë mbajtur pellazgët në krahinat e ndryshme, ku

qëndruan dikur; në ç'kohë lulëzoi, më tepër, kultura e tyre, cili qe karakteri i asaj kulture dhe sa ndikoi mbi qytetërimin europian?

1) E gjithë Helenia, në kohën e Herodotit, ishte ndarë në dy popuj, jonik e dorik. Kjo ishte një degë e popullit të lashtë pellazg, tretur, - siç thotë ai historian, - në Heleninë, se banonte, pothuaj, në të gjithë Peloponezin, në shumë ishuj, se kishte fise (tribu) në Azi dhe se Sparta ishte qytet kryesor dhe shumë i fortë i saj. Helenët Jonë, pastaj, ishin të shpërndarë ndër ishujt e Arkipelagut, ndër bregdetet e Azisë, në Atikë, Beoti, Sicili, Kersones dhe e quanin si të parë ndër vete Athinën, që kish qenë banuar, më parë, nga pellazgët e Samotrakias; sepse, përveç këtyre dy popujve, dorik e jonik, banonte, në atë kohë, në veri të këtyre dhe, andej-këndej, në mes një popull, quajtur vërtet pellazg, që fliste një gjuhë, për të cilën Herodoti, që i pati parë qytetet e tyre, e quan të huaj. Ky popull *pellazgësh jo të përzier*, - thotë ai, - banonte atëherë në Ftiotidë, në Epir e në Itali, kishte qytete në Peloponez, në Traki, në disa ishuj si Sicilia, Kreta, Lemnosi etj., një fis i të cilëve ishin frigët, që nga Maqedonia ishin shpërngulur në Azi. Për këta tregohej se ishin zënë me egjiptianët në çështje krahasimi, se cili ishte më i vjetër, për sa i përket secilit prej këtyre dy popujve, dhe se prandaj Psametiku, mbret i Egjiptit, si kish bërë të ushqehej një fëmijë nga një dhë, larg njerëzve, dhe si, mbas dy vjetësh e kish bërë të vinte tek ai dhe e kish futur brenda dhinë, kish ndër fëmijën që bërtiti, sapo e pa, *bek*. Dhe, si u gjet se *bek* është fjalë frigje që tregon bukën, që është shqipja jone *bukë* /buk/, Psametiku paskësh deklaruar se frigjët janë më të lashtë, si ata që kishin një gjuhë më të afërt me zanafillat e njeriut. Por prej *pellazgëve jo të përzier*, që ishin gjithnjë, siç e thamë, në veri të Greqisë e që kishin tempullin në Dodonë, grekët e mëvonshëm njihnin se kishin pasur kultin [e Dodonës] dhe ritet e shenjta. Herodoti tregon edhe se Sibila e lashtë ishte nisur që prej andej me gjërat e shenjta në një shportë dhe kishte përshkuar mbarë Greqinë, deri sa u vendos në Delos, ku lindi *Apolloni*, emri i të cilit në shqip shpjegohet me fjalën *diell*. Kështu ata, dikur, kishin qenë mësues hyjnish për Greqinë që, nga ana tjetër, ajo vetë përbëhej nga një degë e atyre, e Helenëve *Dorë*.

2) Nga të tilla histori e tradita ishte shumë e lehtë të merret vesh se pellazgët kishin pasur një kulturë të plotë, para se të lulëzonte Helenia, e cila u lind në kohën kur ata ishin në rënie; dhe këtu, si gjetiu, njerëzimi u tregua, ashtu siç është vetë, si një zog simbolik, që rilind i veshur me

ngjyra të reja prej hirit të vet të djegur. Pastaj nuk është i vështirë caktimi në kohë i shkallës më të lartë të pushtetit pellazg e që ne besojmë se ka qenë shtatë ose tetë shekuj para Homerit. Kështu që, në kohë të Homerit feja pellazge kishte veshur imazhet trupore; dhe këto ishin bërë, tashmë, të plota e të përkryera mbas shartimit të tyre me idhujtarinë egjiptiane e fenikase: madje shumë nga këto përfytyrime të shenjta nuk kishin më kuptim për shumicën, por qëndronin paksa në dijen e priftërinjve e të poetëve. Kështu Homeri, në librin XI të Odisesë, e shpjegon mitin e përbindëshit *Nekmuntia*, që godet njeriun me një paralizë të tillë, sa të mos jetë në gjendje të lëvizë; prandaj ajo ishte një fjalë pellazge (*Nëkmuntia*, nuk mundja në shqipe, *pafuqi*) e pakuftueshme për grekët dhe që shënonte pafuqishmërinë që e ngujon vullnetin e njeriut. Nga ana tjetër, në ato kohë të vona, populli pellazg i Peloponezit, i Ishujve dhe i Azisë ishte shndërruar në Doriko-Helen. Dhe, pak më vonë, Herodoti përmendte si një përrallë të lashtë e absurde një gojëdhënë popullore të pellazgëve jo të përzier, d.m.th., se pellazgu Abari na iu paskësh sjellë anembanë botës, i pajisur me një kosë. E, kështu, nën hieroglifin e këtij emri ishte përfshirë një mendim i thellë dhe një histori. *Ha-bari* në pellazgo-shqipen donte të thotë *që ushqehet me barishte*; me fjalë të tjera, është njeriu që, duke u ushqyer me barishte, u lëshuar i pari, i armatosur me një kosë, për të përshkuar tokën-mëmë. Sa i afërt është një tip i tillë [si Abari] me atë që haset, pastaj, në Saturnin e Laciumit [dhe i afërt] me kuptimet e pellazgëve që vëzhgonin e nderonin natyrën, dhe *ishin të caktuar që të endeshin*, siç shprehet Nienuhr! Sa i shpie ai [mit] mendjet nga ato kohë të lashta të tokës virgjëreshë dhe të jetës së parë bujqësore! Dhe ç'afërsi e plotë mes fjalëve *Abari* (abarë) e *Abaresi* (Abarezë), *Albanezë* o *Arbëreshë*, siç quhemi ne duke ulur zërin, në atë mënyrë që fjalën latine *palatio* e shqiptojmë *pëlcas*!

Por, qyshkur populli helen i ka dhënë gjuhën Homerit? Si kur e vendos mes pellazgëve, që këta Homeri t'i quante anasit e vet?

Tash këtu lypet të kujtojmë që tërë lashtësia greke, nga Homeri deri te Straboni, tregon se, në një kohë të largët, licët, egjiptianët, fenikasit e tjerë, të prirë nga Kadmi, Kodri, Danai etj., erdhën e prej tyre u vendosën në Heleni popujt tebanë, korintas, athenas e të tjerë. Kështu shkrimi fenikas qe përdorur për gjuhën e të gjithë këtyre popujve, e cila qe një e vetme, por e ndarë në dialekte; ata sollën eremitët e, pastaj, hyjnitë e Vullkanit, Bakut, Herkulit e tjerë. Mbasi u vendosën, i lëvizën

që të shpërngulen nga vendbanimet vetë anasët pellazgë, të cilët, pak nga pak, braktisën krahinat më jugore të atij vendi, duke u shpërndarë nëpër ishujt o në Azi, nën emrin Jonë, Dorë e Eolë; së fundi, këta të huaj zhvilluan një veprimtari pa masë për ta asimiluar për vete popullin, në mes të të cilit u vendosën; ndërsa pellazgët vendas nuk kujdeseshin për të tërhequr me vete ndonjë fis (tribu) të huaj.

Këta fenikas, egjiptianë e tjerë, qenë, pastaj, helenët e ndritur të gjuhës së artë, që qëndron ende.

Ata, të parën herë, arritën të fuqishëm në numër e në mjete fitoreje dhe, si i zbuar me forcë pellazgët në vendin e *braktisur* (në shqipen *Elënia*, e lëna), u vendosën dhe qenë thirrë *helenë*. Por kjo luftë, e përfytyruar në përleshjen mes titanëve e Zeusit (Jovit), nuk qe fituar ndryshe, veçse me ndihmën e *Herkulit*, që është vërtet kyçi që hap shkollën mitike e heroike. Ai është quajtur një grek që punoi pa u lodhur e me durim për të shpërrur nga njerëzimi një pjesë të madhe të të këqijave. Ai themeloi lojërat, nëpërmjet të së cilave qenë hyjnizuar, pothuaj, aftësitë shpirtërore e trupore të njeriut, dhe bijtë e tij, të përhapur në Heleni, në Itali, në Azi të Vogël e deri në Iberi (Spanjë), zotëruan, pastaj, mes popujve Dorikë e Helenë. Por, disa mijëra vjet para atij greku, një Herkul tjetër kishte tempuj në Egjipt e në Tir, siç e zbuloi Herodoti, dhe aty simbolizonte forcën fitimtare trupore e morale. Duke i vërejtur mirë të gjitha këto, shihet se emri i Herkulit ka qenë vëll i një sekti reformator, që i ardhur me tirët në Tebë, u përhap që andej nëpër Heleni dhe gjatë. Tërë kultura helenike, shndërrimi i pellazgëve të Peloponezitetit e të Azisë së Vogël në pellazgë helenë, duke se u detyrohet, sidomos, heraklidëve, që u përhapën aty si një gjak i ri dhe i dhanë jetën e vet atij trupi të lashtë. Ky, nga ana tjetër, mbeti gjithnjë i dalluar përkundrajt origjinës dhe fizionomisë së helenëve të vërtetë. Në këtë mënyrë, Herkuli e shojtë jetën e Hidrës, që përtërihej gjithnjë dhe Jovit Greqia i ndenji e qetë. Atëherë, *pellazgët jo të përzier* qëndruan mënjanë, si të huaj; ndërkaq Helenia përhapte aq shkëlqim diturie, ndjenje e arti mbi një trung të dyfishtë, nëse mund të shprehemi kështu.

Nuk duam këtu të vemë, në fillim, shfaqjet e një afërie ende më të lashtë mes pellazgëve e helenëve, e cila është simbolizuar në farefisninë e hyjnive të reja me Titanët. Edhe sikur të mos duam ta shtiem në një origjinë shumë të vjetër e të përbashkët një të tretën e fjalëve pellazgo-

shqiptare që hynë në gjuhën helene, prapëseprapë, duke sjellë vështrimin tek afria e bashkëlidhja e mëvonshme e dy popujve, te depërtimi i shpejtë: familjet helene ndër qytetet pellazge e anasjelltas, e, pastaj, te sundimi i heraklidëve mbi dorët, - të gjitha këto na çojnë në përfundim që ta hyjnizojmë [atë origjinë mitike]. Qoftë ndër gabimet [e fjalëve] *Io e Perseo*, qoftë ndër emrat *More e Atlant (at-lash, at i lashtë, i vjetër, baba-gjysh në shqipet)*, duhet të shohim, si të jetë e mundur, në njërin apo në tjetrin emër, gjurmët e pashlyeshme të një vendimi të përbashkët (në Afrikë) të të dy popujve; heraklidët, gjithnjë e më tepër, do të duken si një pemë bamirëse e lindur në tokën e vet; por që nuk mundi të sjellë të gjitha frutet e mira e të shëndetshme që ata që mendonin më mirë, pritnin prej asaj [peme]. Dhe fjalët aq të thella e aq topitëse, që Homeri vë në gojën e Herkullit në Eliz, do të ishin, atëherë, një ankim i poetit të lartë qytetar, që e shihte atë vepër të madhe e vëllazërore të kapërcyer, siç ndodh, nga padrejtësia e nga mashtrimi.

3) Ai [Herodoti] është i sigurtë që në mendjen e Homerit është pasqyruar gjallërisht tërë koha, në të cilën ai jetoi e në të cilën mënyra e re e të menduarit e helenëve ndërronte në mënyrë të dukshme dhe në të gjithë jetën pellazge. Dhe ai [Homeri] që mund të mos e donte, qoftë për origjinën e vet (joniko-aziatike), qoftë për ndjenjat fisnike krenare të lindura në shpirtin e vet, e pikëzon [atë kohë e shoqëri] me një dashuri të veçantë, dhe dy figurat e tablove të veta i zgjodhi mes miteve pellazge: njëri është *Odhise* udhëtari (në shqipen *Udhise* udhëtar); dhe tjetri është *Aqilé*, të cilit i jep vetëm epitetin *këmbëshpejti*, dhe të cilin e bën si të fuqishëm, në vrullin e forcës së vet krejt e ndryshme nga forca e ngurtë dhe e palëvizshmja e Herkullit, i fuqishëm për të vrapuar mbi kallinj të pjekur, pa i përkulur, e që, së fundi, kishte tempuj në Epirin pellazgjik me titullin e *të shpejtit*, kurse tjetra (fjalë) ka në emrin e vet hieroglifin e këtij virtyti, *Aqilé*, (në shqipen *Aqë i ljë*, aq i lehtë, i fuqishëm nga trupi). Kështu në poemat e tij (e Homerit) është endë përfytyrimi i të jetuarit pellazg, që, ndoshta, më i zhveshur nga elemente helene, vazhdoi, pastaj, në pellazgët dorë e ndër ligjet themelore të spartanëve, të cilat Likurgu i themeloi aq mirë mbi bazën e zakoneve e të të menduarit të popullit të vet. Dhe, atëherë, ai të menduar qe vënë para popullit më qartë ndër këngët e tija [të Homerit], të sjella në Europë prej atij ligjvënësi.

Por i fuqishëm në thjeshtësinë primitive të tij, u ngrit më fort se

askund në Itali, në të cilën pellazgët banonin në Krestone e në gjithë vendin ngjitur me Tirrenët, kur Herodoti udhëtoi ndër ato vise, dhe aty ishin strehuar [pellazgët] në kohë shumë të lashta, kur Laciumi i bëri strehë Saturnit të mundur, që atje e la kosën e vet. Atje gjenia e tyre i formoi të gjithë popujt përreth, dhe, nga të gjithë këta, u formua një i vetëm, Roma. E deri në gjuhën italike, e afërt me shqipen e sotme, nëpërmjet asaj pjese të pandërrueshme të çdo gjuhe, që është si farka ku hidhen fjalët, duket fondi i harruar pellazg, shumë më fort se sa ç'mund të gjendet në atë të helenëve, të cilët, duke u shpërngulur, kishin, tashmë, një kulturë të njohur e gati të plotë. Le të vlejë për të gjitha krahasimi i një kohe foljeje:

Italisht:

Io voleva

Tu volevi

Ei voleva

Noi volevamo

Voi volevate

Essi volevano

Shqip:

U doja

Ti doje

Ai dojë

Na dojmë

Ju dojitë

Ata dojinë

Këtu, po të vërejmë qoftë përemrat, qoftë mbaresat e vetave e, sidomos ato bashkëtingëllore që janë të pandryshueshme në të gjitha foljet te rrokja e fundit e numrit shumë, shihet qartë se është një mënyrë e përbashkët për të dy gjuhët; këto dy gjuhë janë të ngjashme edhe në këtë pikë, se e formojnëpësoren me foljen *me qenë*, dhe pjesoren e shkuar dhe ia ngjitin përemrat kundrinorë foljes që i mban, etj. ; dhe këto dy gjëra janë të pamundshme në gjuhën greke. Përveç atyre fjalëve shqipe, që në greqishten nuk pranohen pa i modifikuar, të paprekura gjenden në latinishte, dhe pa iu prishur mbaresat, si për shembull: *Glisëndër, Kasëndër, Antipatër*, në helenisht *Lisandros, Kassandros, Antipatros*, qëndrojnë në latinishte *Lisander, Cassander, Antipater* e deri fjala latine *Tyrreni*, me të cilën Pellazgët thirrën Lidët të porsaarritur (në gjuhën shqipe fjala *t'arrëni*, d.m.th. të ardhurit e rinj), ndër shkrimet greke gjindet i shndërruar në [formën] *Tarsini*.

Në Laciun, pra, e pastaj në Romë, kultura pellazgeu zhvillua e shkëputur nga Helenia dhe me tri tiparet kryesore, që ajo i kishte

mbajtur në Spartë e që pëlqeheshin në tablotë e Homerit, e janë këto: ndjenja e lartë aristokratike, një mënyrë e matur stoike në të ushqyer dhe, së fundi, dinjiteti më i madh i grave në krahasim me gjendjen që kishin tek helenët.

I pari nga tiparet për mënyrën e drejtimin të qytetit, mori format e një shteti monarkik, i frenuar nga fisnikët, dhe pa mospranimin tërësisht të vegjëlisë. Kjo aristokraci, e zbutur në Spartë nge Heraklidët, u mbajt në Romë, gjithnjë, duke luftuar me idetë popullore helenike, që ngadhënjëjnë edhe rreth vetes në kolonitë helenike të Tarantit, Napolit etj. Dhe, mbasi kishte fituar tashmë shpirti i atyre kolonive, Hanibal Afrikani, një tjetër pinjoll i republikës së Tiros, për ta ndezur zjarrin (afshin) demokratik, tashmë, të shuar, la mbas vetes në Lacium, siç thotë Tit Livi, plagën vdekjeprurëse të ndarjes së vegjëlisë nga patriciati (aristokracia), gjë nga e cila, pastaj, shpirti helen qe superior edhe në Itali me Qezarin e pathyeshëm. Por shumë më parë ishte shuar karakteristika e dytë e rëndësishme e pellazgëve, sipas së cilës të mirat, që s'kishin të bënin me njeriun vetë, nuk çmoheshin, por vlerësoheshin kur vendoseshin në mes të tokës, në mënyrë që kurora që vihej në mes të palestrës, t'i jepej si çmim atij më trimit. Dhe heronjtë e Homerit, mbretërit spartanë dhe konsujt e Romës, përbuzës aq të mëdhenj të pasurive, nuk e kishin për turp të fitonin për të përvetësuar plaçkat e të tjerëve. Kështu që atje hajnia (cubënia) ishte një poshtërsi, dhe pasuria – një stoli tek helenët, bij të tregtarëve fenikas. Vetëm nga kultura pellazge jetoi gjithnjë dhe mbeti gjendja e përmirësuar e grave, që në Heleni mbaheshin të mbyllura ndër gjerdekë (dhoma martese) dhe të veçuara nga jeta, kurse në Romë e në Spartë ishin, sikurse Andromaka e qëmoçme, zonja të Lareve të shtëpisë dhe të gatshme për të ndihmuar burrat me këshillë e dashuri.

Edhe në Epir e Maqedoni jeta i paraqiste, në ato kohë, këto tri aspekte, që qëndrojnë pa u tundur edhe sot ndër shqiptarët dhe shfaqen në gjendjen e grave, që në ditën e martesës marrin kurorën, *kezën*, si mbretëreshë e një familjeje e të jetës heroike të palikarëve si dhenë karakterin aristokratik të këngëve popullore të tyre dhe të të gjitha veprave të mendjes, sikurse edhe të tjerave.

4. NGA GRAMATIKA SHQIPE E KAMIL DE RADËS⁴

Gjuha shqipe ka, rreth, 40 tinguj të qartë, përveç larmive të lehta të disa zanoreve, siç duken, posaçërisht, në këngë.

Duke dashur të ngulisin alfabetin e gjuhës shqipe ndër këto kohë të ndryshme nga ato, kur nevoja bëri që shkronjat e pakta latine të adoptohen, së bashku, për gjuhët teutonike e keltike, mendoj se lypset tashti të paraqesim çdo tingull me një shenj të veçantë e të dalluar. Në krahinën e Vllahisë është përhapur më 1844 një alfabet shqip, i punuar me shumë mendjemprehtësi, i një tipi të posaçëm e krejtësisht të ri. Por është e vështirë, hë për hë, që ai të fitojë, sepse Shqipëria nuk është endë një komb i bashkuar dhe i pavarur. Por, meqenëse kultura e saj është duke u ndihmuar nga bijtë e saj, të përhapur ndër krahina të veçuara e të largëta, vlen, tash për tash, t'u përmbahemi, për sa u takon shkronjave, alfabeteve greke e latine. I pari është i përgjithshëm e i lehtë në Orient, ku shqiptarët kanë viset e lindjes dhe ku do të themelohet atdheu i tyre; i dyti është i përhapur ndër kombet e kulturuar të Jugut dhe të Perëndimit të Europës, dhe është ai që më tepër na përshtatet në të mërguarve në Itali. Unë e kam adoptuar [alfabetin latin], duke e plotësuar, ku ka qenë e pamjaftueshme, në mënyrat që vazhdojnë:

shenjat zanore	<i>a, e, i, o, u, y,</i>
bashkëtingëllore grykore	<i>g, c, k, h (x), j</i>
dhëmbore	<i>d, t, th (Θ), z</i>
buzore	<i>v, b, p, f</i>
gjysmëzanore	<i>l, m, n, r</i>

⁴ *Dalla Grammatica Albanese di Camillo De Rada (1847). Poesie Albanese del secolo XV, prima parte. Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari*, Seconda edizione, Stamperia del Fibreno, Napoli, 1847, p. 7-8.

fishkulluese	s, x
e aspiruar	h

Me [shkronjën] *h*, të vendosur pas bashkëtingëlloreve *c, d, l, s, z* mundemi, në një mënyrë të thjeshtë konvencionale, të dëftojmë përdorimin e këtyre shkronjave për tingujt e tjerë:

ch do të përfaqësojë atë tingull që ka italishtja në *ch, che*;

dh atë që ka greqishtja *δ* ose *d* e ëmbël;

lh atë që ka italishtja në *gl* të ëmbël te *gli*;

sh atë që ka anglishtja te *sh* ose italishtja *scte scevro* [= i pa.];

zh atë që ka greqishtja *ξ* ose *s* [e italishtes] në mes dy zanoresh.

Përveç këtyre tingujve të thjeshtë, ka edhe të tjerë në gjuhën tonë, që mund të shprehen vetëm me shumë bashkëtingëllore, si me *gk* tingulli [i fjalës] *gkii* [= gjí], *ngk* ai i *ngkien* [= ngjyen], *gch* ai i *deegch* [= degë], *ngch* ai i *ngchét* [= nget], e me *sg* ai i frëngjishtes *j* në *gcrasgd* [= grazhd].

Zanoret, pastaj, me përjashtim të asaj të fundit, që është, gjithherë, e shurdhët, kanë secila tri shkallë të qarta kohe. Zanorja *o*, për shembull, ka:

- dy kohë në [fjalën] *boor* (= borë);

- dy kohë e gjysmë në *bôra* (= bóra);

- një kohë të vetme në *monosàke* (= manushaqe).

Zanorja e fundit *o* ngrihet ose ulet, me fuqi, nën theksat e mprehtë dhe të rëndë, si në *lhòt* (= ljot, lòt), *lhòttesh* (= lòtësh).

E ky shkallëzim kohe i tingujve është, siç do ta shohim, i një rëndësie të dorë së parë në pasurinë e gjuhës, sepse mbi fondin hyjnor të harmonisë shpjegohet, thuhet, metrikisht fuqia e saj shprehëse, e tjera.

5. LASHTËSI E KOMBIT SHQIPTAR DHE AFËRI E TIJ ME HELENËT DHE LATINËT⁵

Tash që gjurmimet mbi kombin tonë, në Itali, nënë për në, po kryhen me interes prej profesorëve më të shquar për mprehtësi e njohuri gjuhësore, dhe prej nesh, që jemi krenarë për rilindjen e gjuhën e kombit tonë, për përparimin e të cilave po bashkëpunojmë, dua të nxjerr në pah disa idé që i kam parashtruar në librin e pestë të *Konsideratave* të mia, të cilat prisja që të zgjeroheshin nga studimet e mia të marra në tërësi.

Do të thosha se ato [ide] janë disa shenja, të cilat ka kohë që m'u shfaqën dhe tërhoqën vëmendjen time, për të renë [që sillnin], duke ndriçuar fillimet e besimit heleno-latin dhe duke treguar origjinën [e tyre] në popullin tonë, e shpjeguar [kjo] me anë të gjuhës sonë e me të tjera gjurmë të saja, qoftë në emrat e vendeve e të qyteteve të helenëve e të latinëve, qoftë në mitet e tyre. Nga këto shenja dhe nga këto gjurmë, që pajtohen me historinë e me të dhëna të tjera, më duket se merr dritë dhe ekzistenca e kombit tonë dhe marrëdhëniet e tij të afërisë dhe të përpjekurit me helenët e me latinët dhe, ndoshta, edhe me të tjerë.

I.

Që nga studimet /e para/ të rinisë sime, dy fjalë të huaja për gjuhën greke, që i ndeshja në këngët e Homerit, *Iperborei* (njerëz që jetojnë në mes të borërave) dhe *Emathia* (treva apo krahina e gjerë në veri të Greqisë), ishin për mua, thuajse, dy rreze që përfundonin në një popull, ndoshta, më i hershëm, që mund të ketë folur gjuhën tonë; *Emathia* është fjalë që don me thanë *e madhe*, nga e cila rrjedh edhe lumi *Emathio* (= i madh); dhe, nga [fjala] jonë *boor* (= bōr, borë),

⁵ *Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli Elleni e i Latini*, Stamperia dell'Industria Largo S. Barcellino, 1864, p. 21.

popujt e veriut u quajtën *të përborëm* (= njerëz me borë); dhe, prandaj, *Emathia* dhe *Iperborei*, në trajtën e emrave të përveçëm, mund të kenë kaluar te helenët.

Në atë moshë, me një kënaqësi prej nxënësi [shkolle], vërenim identitetin kaq të qartë në mes të [fjalës] *Teti*, hyjnesha helenike e detit, dhe fjalës shqipe *deti*. Përkimet e tjera të gjuhës sonë, në të cilat ndesheshim në atë kohë, në mënyrë të vazhdueshme, duke lexuar klasikët e Greqisë, kishin arritur të ngulitnin në mendjet tona ndjenjën e padalluar dhe tradicionale të afërisë në mes të helenëve dhe të epirotëve.

Por që më 1843, në Napoli, që unë ua vura mendjen, me një farë dashurie, përkimeve të tilla.

Lexoja te Herodoti, se pellazgët e vendosur në veri të Greqisë, e nga të cilët ai kishte gjetur koloni [të themeluara] edhe në Itali, kishin dërguar në Azi fisin e frigëve. Dhe, mbasi këta kishin rrahur mendimet me egjiptianët në lidhje me lashtësinë se njëri është më i vjetër se tjetri, për të cilën të dy popujt krenoheshin, Psametiku, mbreti i Egjiptit, mbasi rriti një fëmijë nga një dhë dhe larg njerëzve dhe, mbas dy vjetësh, mbasi e bëri të vijë dhe e futi /brenda/ dhinë, e pat dëgjuar fëmijën, porsa e pa, duke bërëtitur *bek*, që, në gjuhën frige, *bek* donte të thotë *bukë*, dhe Psametiku i urtë vendosi [e tha] se frigët ishin më të vjetër dhe gjuha e tyre iu afronte origjinës së gjërave. Unë, atëherë, mbeta i prekur nga afrimi dhe, thuajse, nga identiteti i fjalës shqipe *buk(ë)* me fjalën pellazge *bek* dhe, aq më tepër, se prej vetë Herodotit që thënë se pellazgët u patën dhënë helenëve mitet dhe hyjnitë e tyre, nga të cilët, ndonjëri, me siguri, ishte shqiptar.

Mbasi i rrahja këto gjëra, me vetvete, duke pasur mendime të ndryshme, ia kumtoja, atëherë, mikut tim të vjetër, Emanuel Biderës, që kishte në shpirt fantazinë e veprës [me titull] "*Matneer*" [Matnër, mat në erë], dhe pata shumë nxitje për hetime të mëtejshme, nga të cilat, rezultatet e para, me titull *Identitete të shqiptarëve me pellazgët*, i qita në dritë, më në fund, në një shënim të veprës së tij *Shëtitje për rreth Napolit*.

Më vonë, munda t'i zgjeroj dhe t'i përcaktoj më mirë hyjnitë e mia në këtë vështrim. Dhe, duke i nxjerrë, tash, në dritë të diellit, që rrjedh nga njohuritë më të mëdhaja të atij që i shqyrton, dua të ravizoj disa gjëra të një shkalle më të lartë, të cilat shoqërohen, që në fillim, me hetimet e kulteve fetare.

II.

Është për t'u vënë re se feja, të cilën mendja e ka të madhe dhe të palëvizshme në *kohë*, në *substancë* etj., (të cilat i mëson, thuhet, veçmas nga fenomenet trupore), nuk zë vend në nocionin e Zotit, as ky [nocioni] nuk zë vend në atë me të njëjtën shpejtësi. Ky nuk ia dha ato *vetes* bashkë me *dukjet*, bashkë me *mënyrat e përherëshme* të dukjeve që, më vonë, bëhen të vetë njeriut; por mbeti përmbi veprën e tij dhe i zgjidhur e i këputur prej saj; sepse, po të ishte Ai brenda botës dhe i lidhur me të, do ta njihnim që më parë, sikurse *unin* që gjendet i fshehur në trupin e secilit njeri, me të cilin flasim.

Por, përkundrazi, njohja e Zotit erdhi nga koha e lashtë së bashku me fjalën njerëzore dhe u përhap në të gjitha anët, mbasi që lajmëruar dhe qysh se ndërgegjija e parandjen në ligjin e gjallë që i flet dhe arsyeja beson ta zbulojë në rendin e botës etj. Ai na është i ditur, dhe nuk na hiqet nga sytë për gjithë jetën, si dielli që, mbasi u lind në atë anë, menjëherë gjendet gjithkrah, përrreth nesh, me dritën e atij dhe na përfshin. Ashtu si fenomenet, nocionet dhe ligjet gërshetohen me qenien tonë mendore dhe bëhen një me të, Zoti na është shfaqur neve si Zot i shtëpisë dhe i veçuar nga ajo.

Parandjenja e ndërgegjes dhe pamjet e veçanta të arsyes nuk do ta kuptonin Zotin me aq besim sa për ta bërë njeriun kundrejt tij të devotshëm deri në fli. Dhe për të bërë që Atij t'i ngriheshin altarë me një shpresë të vërtetë, Ai duhej që, gjatë kohës, ta kishte shfaqur veten dhe të vazhdonte, si rrjedhim i të dukurit, shfaqjen e tij vepruese mbi fatet njerëzore. Ndonëse nuk është një ngjarje historike, por një fakt i qëndrueshëm e gjithnjë i sotëm në jetë, u desh që feja të mbështetej në Verbin Hyjnor, dhe të mos ketë pasur kurrnjë tjetër.

Ka ndodhur që, kur, nga vesi ose nga marria, mbaroi komunikimi i shenjtë me Atin, brezat e pastajmë nuk u qetësuan më nga fjala e të vdekurve, që qenë dëshmitarë të Verbit të hershëm. Dhe, atëherë, mendja nuk mundi të rrijë pa e kërkuar vetë të vërtetën, për ta ngritur edhe një herë fenë, që i mungonte besimit ekzistues, mbasi i duhet të gërmojë, gjithnjë, në vise, në të cilat nuk shtrihen as jeta dhe as mjetet e saja, ose ndalohet pezull, ose bind në rast dyshimi, ose kthehet te komunikimi i lashtë, duke ngritur, përsëri, me shtyllat e përmbysura një tempull të ri, në të cilin mblidhet populli.

Një shembull shumë i gjerë i një besimi të bërë rishtas është politei-

zmi, ashtu siç gjendet në përmendoret, që kanë arritur deri tek ne. Pra, ai mund të përgjasohet, tashti, me ato rrënoja gjeologjike të mbivëna dhe që mbulojnë rrënoja të tjera të fundosura në kohë më të lashta. Dhe ai besim, në qoftë se, nga njëra anë, na jep masën e asaj që mund të arrijë mendja hetuese në këtë drejtim, që nga kohët e largëta, mbasi pat rënë e vërteta e parë, është, nga ana tjetër, një shembull i dobësisë që ka në vetvete për të bërë që të besohet plotësisht.

Në mitologjinë e helenëve ka një shartim të të dy ideve themelore, sikurse në historinë e tyre duket veprimi i përzier i dy racave, gjë që, po nuk u pat parasysh ose kapet në mënyrë shumë të mjegullt, nuk arrihet lehtë në shpjegimin e kontradiktave të shumta dhe të përpjekjeve të brendshme. Në dritën e këtyre ideve besoj se do të parashtroj, dora-dorës, zbulimet që dalin në mes vështirësish.

III.

1. Dihet se në majën e Olimpinit helenik gjendej *Zea* (latinisht Jupiter); dhe *Zeas* i që dhënë për bashkëshorte *Hera* (Junona).

Tashti, *Zea* dhe *Hera* janë fjalë shqipe: *Zea*, *Zena*, shpirt, fillim dhe *Hera*, ora, koha, gjë që na bën të mendojmë *Zean*, fillimin dhe shpirtin e botës, bashkuar me Herën, në krijim.

Zea pellazg, pra, nuk mund të ishte biri i *Kronosit* (koha), dhe as i *Saturnit*. Ai ishte *Zea*, *Fillimi*, dhe i martuar me Kohën për krijimin, i vërteti *Pater hominumque Deumque* (= Ëti i njerëzve dhe i zotave).

2. *Zea*, në besimin homerik, kishte dy vëllezër pjesëmarrës me të në mbretërinë e tij, njëri *Adhë* (Plutoni, zoti i dheut) e tjetri *Posidoni* (Neptuni), zoti i detit.

Adhë është qartë emër yni, mbasi quajmë *dhë* tokën; dhe fjala *dhë* (tokë), që gjendet në librat e lashtë të helenëve, duket se u ka ardhur nga të parët tanë, dhe se, më vonë, qe braktisur. Por *Posidoni* nuk ka emër që i përgjigjet në gjuhën shqipe. Ndoshta nuk mund ta kishte, mbasi emri i *Posidonit* dhe i *Hermesit* (Mercurit), nga dëshmia e Herodotit, nuk ishin hyjni pellazgjike, por të prura në kultin helenik nga Libia dhe Fenikia. Në besimin e vjetër helenik, grumbulli i ujërave ishte, përkundrazi, i shenjtë ndaj *Oqeanit*, shtrirja mesdhetare e të cilit qe nderuar me anën e një hyjneshe, bij e tij, e quajtur *Teti*. Që të dy këta janë emra shqiptarë, *Deti*, te ne, do të thotë *det*, dhe *Ui* don me thanë *ujë*, /kurse/ *Ujana* (Oqeani) difton plotëninë, shumësinë e ujërave.

3. Helenët *Zeas* i dhanë për atë *Kronosin* (kohën), dhe *Kronosit*

/i dhan/ *Uranosin* (Qiellin). Urani, sikurse *Adhê*, është, njëheri, fjalë helenike dhe shqipe. Ndër ne *vrenii* don të thotë *errësirë nga retë*, kurse *vreghet* don të thotë vrehet, vranësohet.

Bashkëshorte e *Uranosit* ishte *Jéa* (Cibele), e cila tek helenët i përgjigjej *Jêsë* (dheut, tokës), ndërse në gjuhën tonë *Jëtës* (botës); Sa përputhje që ka!

Por le të vështrojmë pak më thellë në mitologjinë helenike dhe ta ndajmë shpirtin e saj nga hyjnitë titanike, të cilat i përdori si lëndë për ndërtesën e vet.

Njeriut të ardhur në kërkim të një farë shpjegimi të jetës e të fateve të saj, iu përfytyrua *amëshimi* dhe *pambarimi*, që rrethonin, nga çdo anë, *qenien e tij të vdekshme* dhe *me mbarim (me fund) të errët*. Pra, në një mënyrë të mjerueshme, e aty për aty, e ndjeu veten të zhdukur para atij amëshimi, që shoqëron forcat e natyrës, në mes të së cilave gjendet, dhe i shënoi me fjalën *të hyjnueshme*, të barabarta me [fjalën] *sunduese*. Ndërsa, duke lënë më një anë fuqinë, që kanë për të dëmtuar ose për të prurë dobi, vetë zgjatmëria e tyre përtej vdekjes së njeriut, në mënyrë të veçantë, do të ketë ushtruar një peshë të madhe mbi mendjen dhe zemrën e tij.

Në çfarëdo faze të njerëzimit që të mendohet ky reflektim i mendjes mbi gjithësinë, nuk besoj se mund të përfytyrohet pa njohjen tradicionale të Zeas. Por, ose pse e pati [këtë njohje], të rrjedhur nga lashtësia, ose pse e arriti me forcat e veta, për ta pajtuar, si fuqi botërore, me të tjerat të natyrës, iu desh t'i gjente tiparet me anën e vëzhgimit, dhe, pra, t'i nxirrte andej, ku duket, d.m.th. nga shpirti njerëzor. Mundi, kështu, të besonte në një *Zea* inteligjent dhe të vullnetshëm, siç është te njeriu, por të lidhur me botën dhe me qëllime të paracaktuara e veprues në rrjedhim të tyre. Prandaj *Zea* homerik përkulet, si shpirti i njeriut, nën një fat të pashmangshëm.

Në këtë Gjithësi pa ndërjegje e pa zgjidhje, – dhe si mund ta dijë njeriu këtë, – shpirti, toka, ujërat, eteri duken të gjerë e të pavdekshëm, duke ndjekur udhën e tyre të shënuar, ndonëse pa njohur atë që i pajton në mes të tyre. As edhe njeriu nuk mund të shohë në ta Hyun e vet, atë që ka në dorë fillimin dhe fundin e jetës së tij dhe fuqinë për ta bërë të pavdekshëm ose edhe të gëzuar, sidoqoftë lutja që i drejton. Por, [njeriu] i vendosur pranë fqinjëve kaq të fuqishëm, duhet të ketë

qëndresë të vazhdueshme; kështu që forcat armike të pushojnë, para se ta kenë shkatërruar, dhe [forcat] kundërshtare me ato të vijnë pastaj në çastin e duhur, si të nevojshme në atë ekuilibrim të amëshuar të botës, e ta gjejnë e ta mbajnë gjallë atë [njeriun]. Një shembull i dalluar i këtij lloji gjendet tek Iliada, aty ku Akili përfshihet nga valët e rrëmbyeshme të lumit Ksanto dhe nuk mposhtet, por i ruan forcat e veta, deri sa Vullkani, duke ia behur, e ndihmon dhe e shpëton. Kjo shpikje, ndoshta, ka ardhur edhe nga një farë miti kozmik, që përfytyron Jetën, e cila, nga egërsimi, gjithnjë më i madh i dimrit, gati, shuhet; por, pastaj, me kohë, duke ardhur ngrohtësitë dashamirëse, e gjallërojnë [jetën] përsëri.

Kështu që, duke e vështruar nga çdo skaj, politeizmi helenik, më tepër se një fe, është një sistem kozmogonik njerëzor, që filozofët grekë të shkollave të para e çuan në drejtime të ndryshme, në rrjedhimet më të largëta; por, në atë [politeizëm], disa përgjegjëse të aspiratave rrënjësore të shpirtit njerëzor, vizatohen në mënyrë të veçuar si thërmijat e një komunikimi të humbur në kohërat e mëparshme, megjithatë, e bartën godinën e zbrastë të reformës së mëvonshme, dhe, ndoshta, qenë ato që, nga mezi i Panteonit mitologjik, duke tërhequr ndaj vetes, i dhanë ndriçim Sokratit dhe Anaksagorës.

Tashti, në këtë Panteon mitologjik, u zhvillua një gjenezë, që njeriu e vështron në të gjithë krijimin; por që nuk u shoqërua me fenë titanike më të lashtë, dhe për të cilën nuk na tregojnë gjë [shenj] Hyjnitë më të vjetra, të përfshira në atë tempull. Në atë që unë e përshkruaj si reformë helenike, ideja fizike e eterit jetëdhënës, e kujtuar ose e nxjerrë nga vëzhgime të thella, mund të shëmbëllet nga *Uranosi* [qielli], ati i çdo jete; dhe të mendohet se nga *Kronosi* [koha], biri i Uranosit, lindi *Zea* [shpirti] - thujse lulja e fundit që stolis gjithçka. Ndërsa nuk ka shenja të një *Teogonie* të tillë në kultin e natyrës, mbeturinat e saj janë të qarta në gjuhën shqipe. Nuk pengon ndonjë gjë që kultit të *Zeas*, *Fillim*, dhe *jo i lindur nga të tjerë*, t'i shoqërohej nderimi i *Adhê-s* (Magna Parens, lt.) dhe *i Ujana-s* (lt. Aequor), veprimi i përputhur i këtyre rrethonte dhe mbante, këtu poshtë, jetën e gjithësisë të përhapur nga *Zea*, dhe Atij – fillim shpirtëror i botës, *jo Uranosi*, por *Vrenli* [kaos, substanca etere e errët], i pat dhënë elementet paraprake për t'i renditur e për të ndriçuar.

IV.

Kjo që na duket, sqarohet nga ajo që do të themi.

Feja helenike përfshinte dy hyjni, që nuk pajtoheshin me idenë e saj, *Nemesin* dhe *Tartarin*. Nemesi nuk e kishte emrin nga folja greke *nemo* (ndaj, përndaj), mbasi nuk simbolizonte ajo Hyjninë që i përgjigjej Rregullit.

Nemesi, hyjni titanike, që sundonte mbi ndëshkimet dhe përndiqte fajet, duke e pasur kryefjalën (moton) e misionit të vet nga emri shqiptar *Nemesa* (mallkimi që përndjek fajtorët), shfaqet edhe në politeizëm, si bija e Zenas, që merret me pafajësinë e njerëzve, duke presupozuar, kështu, një ligj dhe një autor.

Me [hyjninë] Nemes lidhet Tartari me *Elisin*, vend i lumtur ku qëndron pafajësia e të vdekurve, dhe me Erebin (rrënja e të cilit gjendet në shqipen érrur, të errësuar, nga i cili kemi *erbiir*, *ersiir*, errësirë), në terrin e ftohtë të të cilit qanin, në amëshim, njerëzit e mbrapshtë. Për sa i përket pavdekshmërisë së shpirtit, arsyeja vetëkrijuese e një kulti fetar, mundet vetëm për analogji të mendojë që shpirti i njeriut të mos vijë nga gjiri i botës, ku çdo element trupor përfshihet dhe qëndron; por ideja e shpirtit, që vijon qenien e tij dhe ndjenjat e individit, duke pushuar në Erebin dhe në Elise, është krejt e huaj për mitologjinë panteistike dhe ka ardhur nga qielli titanik i cinguar nga Kronosi.

...

Por, sidomos, një fjalë, e cila rrezaton nga ai Empir i largët, vetëm ajo është një përmendore (monument), që dëshmon se feja e grekëve ka qenë me origjinë shqiptare, dhe ka lindur me vetëdijen e së Vërtetës, tek e cila, më vonë, është kthyer mendja e krishterë, si në vendpushimin e vet. Kjo fjalë është *Athena*.

Athena, nga e cila i dhanë emrin Athinës themeluesit e saj pellazgë, ishte Hyjnesha e madhe e *Dijes* dhe e të *Folurit*, por emri i saj nuk kishte kuptim në gjuhën helenike, ashtu si nuk ka *Minerva* në atë latine. Sot e kësaj dite, ne shqiptarët *fjalën*, *ligjëratën* (bisedimin) e quajmë *ethëna*; pra ishte *Ethëna* jonë (Verbum), që hyjnzuan helenët.

Ka edhe më: Ajo, duke u zhvendosur në tempullin e ri të Jovit, nuk qe si tjetërkund, tashmë e transformuar, sepse nuk u shfaq në të, si do të kishte qenë e arsyeshme, *Fjala njerëzore e hyjnzuar*, por miti

e përfshiu, ashtu sikurse e mori si të lindur nga mendja e Zeas, nga vepra e zjarrit të brendshëm, *Ifestos* (Vullkani).

Ifestos, hyu i Zjarrit, është e qartë se e pati origjinën ndër të parët tanë, ndër të cilët *edhesta* është *zjarri i amëshuar*, dhe *dhésen* = të ndezurit. *Edhesta*, nga ndërrimi i *dh* në *f* e *v*, kaq të lehta në shqiptim, u bë *Ifestos* ndër grekë, dhe *Vesta* (që pati në kujdes edhe zjarrin) ndër latinë. Ndër të parët [*Ifesti*] mbeti simbol i Zjarrit, material i mbyllur në gji të dheut, përkundrazi, te populli latin, në të cilin feja ruajti më shumë thellësinë e saj dhe rregullat e shtrëngimet primitive, *Vesta*, bija e Jovit, e ruajtur nga Virgjëreshat shenjte, donte të tregonte, ndoshta, dashurinë e pastër shpirtërore.

Miti i *Athenës* që lind, pa nënë, nga mendja e Zeas prej veprës së të birit të tij *Ifestos*, a nuk u tërheq mendjen në mënyrë të pathyeshme drejt Ungjillit të krishterë të Verbit të lindur prej Atit nga Dashuria e tij?

...

Dhe një dritë të njëjtë lëshon, pastaj, në të dy krahët e konceptit tonë një Hyjni e Romës, tashmë pak e nderuar, si të gjitha hyjnitë e vjetruara të Qiellit të parë. Ky ishte një Jov tokësor, përkundra atij olimpik dhe me qëllime të këqija. Vetë emri i tij *Elicio* është ai që në gjuhën tonë don të thotë *ilhicu* (= i ligu, i ligu, e keqja), shënon, megjithatë, tunduesin e lashtë. Ja përfytyrimi që na dha Ovidi me qartësinë dhe saktësinë e plotë, që janë veçori të tija. – “Porsa e pau, iu pështjellua zemra Numës, gjaku i iku nga krejt gjoksi dhe flokët iu ngritën përpjetë . . . Zoti e pranoi lutjen, por e fshehu të vërtetën me dredhi të pakuptueshme (të largëta), dhe e tmerroi heroin me fytyrën e dyshimtë. *Këpute kokën*, - tha ai. Mbreti iu përgjigj: *Do të bindemi dhe do të këputet, shpejt, qepa në kopshtijet tona*. – *Merri*, - shtoi ai, - *nga njeriu*. – *Flokët*, - iu përgjigj mbreti. Ai kërkonte shpirtin. – *E një peshku*, - shtoi ky, etj.

Këtu Jovi *Elicio* (i keq, i lig) nuk është simbol i përpjekjes, siç e shohim në mes të pjesëve të Gjithësisë, që luftojnë në mes tyre dhe me tërbim të vazhdueshëm, para se të qetësohen në një harmoni të paqte; nuk është, tashmë, kontrasti i forcave të kundërta panteistike, që mund të qëndrojë i bashkuar, më në fund, me një njësi të thjeshtë e absolute; por është një mendje armike me atë tjetrën që i jep shpirt

dhe e tërheq botën, dhe ajo, po të vendosej pranë njeriut, duke e ledhatuar [këtë], do ta shtynte në gabime. Në të vërtetë, secili e ndjen përbrenda praninë e një një Zeas së errët që, sikurse hija e trupit, e shoqëron këtë nëpër lëvizjet e tij. Mbas çdo gabimi të madh që bën njeriu, ky ndalohet me shpirtin ndërduzash, si për të dëgjuar hapin e një Djalli të errët dhe largohet fitimtar.

Në pikturën e Jovit Elicio, të dhënë nga Ovidi, prapëseprapë nuk është forca e së Keqes që, duke u barazuar me atë të së Mirës, e ndajnë sundimin e botës, siç shfaqet në kultin persian. Kurse ajo fitore fatbardhë e gjumit njerëzor, e ushqyer me dritë, mbi këshillat dijekëqia (me sherrí) të Gjenuit të errët, na kthen te mënyra e krishterë e kuptimit të Botës, nga e cila Krijuesi qëndron i shkëputur, dhe në krijesën gjendet vesi, por gjithnjë i dobët dhe i lindur për t'u mundur.

V.

Pastaj, nuk janë vetëm Vesta dhe Jovi Elic; shumë hyjni të tjera, që adhuroheshin në Romë, mbartin gjurmët e origjinës shqiptare.

Një analogji e madhe gjendet ndërmjet dy hyjnive me dy fytyra të Italisë, *Diana e Jano*, dhe *dî-aan*, fjala jonë: dy anë. Mandej, në krejt Laciumin kishte altarë të kushtuar *Lucinës* (Juno), hyjneshë që u qëndronte pranë lindjeve dhe ardhjes së njeriut në jetë; dhe *lehnia*, në gjuhën shqipe, don me thanë *lindje, lhebona* (= ljhonë, lehonë). Pastaj, të gjithë, në idet e marsit [e trembëdhjetta a e pesëmbëdhjetta ditë e mojit, në kalendar të romakëvet], kur natyra përtërihet, dilnin me pleq e me fëmijë dhe, duke u sjellur nga perëndimi, duke pirë, i uronin ditë të shumta, aq sa gòta boshatiseshin; Anna Perenna-s: âna perendme është ana e perëndimit, perëndimi i njeriut, në gjuhën tonë, nga rodhi, ndoshta, ai kult.

Pani, zoti i bimësisë, edhe po të shikohet ndër tiparet e tij, duket qartë se nuk e ka emrin prej helenishtes *pan* (të gjithë), por prej shqipes *bân* (me bâ, me prodhue). Përveç kësaj, Ai nuk ishte një zot kaq i madhërishëm, sikurse Universi (Gjithësia); në asnjë pjesë kulturi i tij nuk diftonte *Të tërën* të palëvizshme. Pani, zot arkaik /helen, nga Arkadia/, ishte perëndia i përtëritjes (i breznive). Ata që e nderonin, zhvisheshin dhe vraponin nëpër rrugët e Romës dhe zonjat e rënda dilnin te pragjet e dyerve për t'u prekë prej hyut të tyre dhe për t'u bërë nëna. Këto të dhëna dhe emri i tij *Bân* (prodhon, bën), *Bâna*

(prodhim) lejojnë për të zbuluar Panin e lashtë, ose Natyrën që, me lëvizjen e përjetshme, i dërgon lakuriq qeniet në jetë.

Këtu është vendi të shënojmë se gjinden edhe shumë emra të dorës së dytë në mitologjinë klasike, vështrimi i të cilëve nuk është, tashti, në gjuhën tonë, o sepse kjo humbi nga vetja e saj një pjesë [të atyre emrave], o sepse helenët dhe latinët i nxorën nga gjiri i vet o prej tjetërkund. Megjithatë, si *tevábi* [si përcjellje e një njeriu të lartë] ndër zotat më të mëdhenj, nga të cilët mund të përmendet *Dielio* (Apolli) prej shqipes *diel* (= diell), do të kujtoj *Dhê-meter* (Cerere), nga shqipja *dhêmeter* = masë e tokës; mbasi nga kjo hyjni është kryesuar çdo lavrim arash. E, prej andej, ndoshta (rrjedhin) dy mitet e Tritolemos dhe të Aristeos. Mbasi Cereri e pat rritur e pjekur grurin, nën zjarrin e diellit të verës, për ta bërë pavdekshmërisht të ri, *të rii-te lhêmi* [= të rí te ljëmi, i ri në lëmë, në lêmë], mundi të fillojë mitin e Tritolemit të vet të dashur; ndërsa Aristéo, i cili prej mishëravet të një bualli të varrosur, rriti bletët, na bën të mendojmë tek fjala jonë *ares-dhêu* [= ânza e tokës, grenxa e tokës, grera e dheut]. Por këto [mite] janë gjithherë përkime. Edhe sikur të hidhen poshtë, nuk mund t'i rrxojnë fare të vërtetat e mësipërme.

Për të plotësuar, me sigurinë më të madhe, mund të kujtojmë, në mes të dhuratave të shpirtit të hyjnizuar, [fjalën] *Atrekia*, prej shqipes *edrekia* (= e dreqta, e drejta, drejtí, drejtësi); vetë *Afrodite* (Venera latine) mundi ta ketë emrin prej fjalëve tona *afër* (= afër) e *dite* (= ditë). Ose desh të shënojë, me këtë emër, hyllin e Venerës (që gjëndet), përherë, afër ditës, ose afërsinë e bukurisë që gjallëron shpirtërat, me dritën që shpirtëzon lëndën (materien).

VI.

Nuk janë, tashmë, një ose dy fjalë monumentale, por janë figurat, gati të gjitha, të atij Qielli të lashtë, që thirren me emra shqip të objekteve natyrore, të cilat drejtonin qiellin.

Ja, me një shikim syri:

Zena (Zoti i parë e më i madhi), është /fjala/ shqipe *zena* (fillim, shpirt).

Hera (Junone, bashkëshortja e Zeas), është fjala shqipe *hera* (koha, ora).

Adhê (Zoti i tokës) është shqipja *dhê* (tokë, dheu).

Athena (Hyjnesha e fjalës, e bisedës, e kuvendit) është shqipja

ethëna (= e thëna, lt. *verbum* = fjala, lt. *eloquio* = të folur, bisedë, fjalë, gojëtar, elokuencë).

Vesta e *Ifestos* (Zotat e zjarrit) janë shqip *edhesta* (= e dhenta, e ndezur, flaka).

Dielio (Zoti i diellit) është shqipja *Diel* (= dielli).

Elicio (Xhindi i së keqes) është shqipja *ilhigcu* (= i ljigu, i ligu, i keqi, djalli).

Urani (Zoti qiell), shqipja ka *vrenii* (= i vranët, vranësirë, lt. *aere nebuloso* = rë, mjegull, i errët, i vrantë, i turbullt).

Ja (Hyjnesha e botës) është shqip *Jet* (= në dialektin arbëresh don me thanë *botë*).

E, ndoshta, *Afrodite* (Venere) është prej shqipes *afër-dites* (= afër ditës).

E, prandaj, pranë /këtyre kemi/:

Pan (= Zot i tokës prodhuese) prej /fjalës/ shqip *Bân* (= prodhon) dhe *Bana* (= prodhim, natyrë).

Oqeani (=Zoti u jëravet që rrethojnë tokën) është shqip *ujana* (= masë ujërash, grumbullimi i ujëravet).

Teti (= bija e tij, hyjnesha e detit) është shqipja *deti*.

Nemesi (= hyjnesha hakmarrëse e fajevet) është shqip *nemese* (= nëma, nâma, mallkimi që ndjek mbretërit).

Erebi (= errësitat e ferrit) është shqipja *erbiir* (= erbír, errësirë, errsi, terr).

Atrekia (= Hyjnesha e së vërtetës, e vërtetësisë) është /fjala shqipe/ *edrekia* (= e dreqta, e drejta, drejtë, drejtësi).

Dêmeter (= Hyjnesha e aravet, e fushavet) është prej shqipes: *Dhemeter* (= masë toke, masë dheu).

E tjerë.

E, këtu, shpirti më është mbushur nga një ndjenjë gëzimi të lartë, duke ndjerë kahë më del përpara fryma e atdheut tim, përmes gërmadhash, që koha i ka grumbulluar sipri; kështu që në çdo zë, si për ta njohur, gjej shpërblimin e mundimeve të mia.

Dy mitet më fisnikë, që, së bashku me atë të fenikut Herkul lidhen me mitologjinë helenike, Akili dhe Odiseu, vijnë nga ajo botëe baballarëve tanë.

Akili është i biri i Tetit dhe i Peleut (*piilh* = píl], në shqip: pyllë, mal me pyje); Teti është deti i *pandryshueshëm*; Peleu është toka plot me bimë, prej së cilës bien (mbarojnë) flokët. [Akili] është një

gjysmëperëndi, i paraqitur në përfytyrimin e çdo luleje shumë të mirë e që mbaron dhe ik nga jeta. *Akilêa* ka të shkruar në emrin e vet fatin e tij të përkohshëm. Akile është fjala shqipe: *ak-i-ljee*, *aq i ljé*, *aq i lehtë*. Deri ndër kohët më të vona të mitologjisë pagane mbahet mend kjo martesë simbolike e detit me tokën pjellore. Euripidi, në fillim të veprës “*Andromaka*”, thotë: - “E, këtu, kufizohet krahina e Ftias me Tesalinë, ku, një ditë, Teti detare, e nxjerrë nga dendësia e të vdekurve, u martua me Peleun; e, nga martesja e kësaj Hyjneshe, tesalët e kanë emërtuar vendin *Tetideo*”. Këta emra vijnë nga shqipja *Teti* (= deti) e *dhê* (= dhé, tokë). Ndoshta, në atë mit pellazg desh të pasqyrohej jeta, të cilën, ujërat dhe toka e frytshme, e ushqejnë dhe e mbajnë, dhe e cila është, pra, *aq e lehtë*, dhe *aq e bukur e zotëruese*.

Gjithashtu, figura e Odiseut, që Homeri ua lëshon helenëve, duke e barazuar, gati, me Akilin, që është *pellazg hyjnor*, e pat, ndoshta, origjinën e vet nga pellazgët. Pa dashur të diskutoj në se shqipja *uudh* (= udh, udhë, rrugë) prej nga *lvjen/ Udhis* (= udhëtar) e, pastaj, *Ulisse* (= Uliksi), është burim dhe rrjedhim i */fjalës/ helenike Odhos* (= udhë, rrugë), po tërheq vëmendjen mbi një copë (pjesë) të Homerit. Uliksi, në shpellën e Ciklopit, i thotë këtij, kur e pyet: - “Emri im është Utis (= kurrkushi, askushi), kështu më thërrasin babai im dhe nëna ime si edhe të gjithë shokët e mi”. – Natën, pastaj, nga britmat e Polifemit të qorruar, vrapuan ciklopët e tjerë për ta pyetur; por, duke qenë se ai iu përgjigj që “*Utis* më ka plagosur”, ata u kthyen. Kështu, nga kjo mosmarrëveshje, heroit shpëtoi. Tash, duke e pranuar këtë fakt në formën siç na jepet, Odiseu, që pranon emrin e rrejtshëm Utis, kur asgjë s’mund të pandehte se do të ndodhte nga ciklopët, dhe me këtë dredhi shpëton vetveten, ka një koncept femënor dhe jashtë vendit, në mes të shpikjeve, gjithmonë, të rëndë dhe thellësisht natyrore të Homerit. Ndoshta, në rapsodinë e hershme ishte: “Emri im është *Udhis*; kështu më thërrasin babai im, nëna ime, etj.”. E *udhis*, që në atdheun tij donte me thanë *udhëtar*, ciklopëve helenë mund t’u ketë tingëlluar *udhis* (kurrkushi, askushi) dhe, atëherë, mosmarrëveshja e ardhur nga një fjalë homonime, por me vështrim të ndryshëm dy gjuhësh, hyn në familjen e shpikjeve të thjeshta dhe të vërteta të poetit zotërues.

Këto pamje shpërndajnë dritë edhe mbi moshën e atij [Homerit], i cili ka përpara vetes e i mban format njerëzore, tashmë, të dhëna miteve të fesë, megjithëqë e din domethënien dhe me përbuzje të zgjuar

i shkrin tiset dhe i mbulon kudo. Ai, qoftë për shpirtërat fisnikë, të lindur prej natyre, qoftë, ndoshta, për origjinën, duke e dashur së tepërmi jetën pellazgjike (e qe nderuar, pastaj, kaq fort nga një tjetër pellazg i pathyeshëm, Aleksandri), pat nxjerrë prej saj [jetës pellazge] dy figurat e poemave të tija dhe madhëroi, shpeshherë, kujtimet.

VII.

Këtyre gjurmëve të rëndësishme të gjuhës sonë, të ngulitura në fenë e grekëvet dhe të romakëve, dëshëroj t'u shtoj disa të tjera, që kanë mbetur nga gjeografia e lashtë dhe që i shoqërojnë ato [gjurmë].

Pella, kryeqyteti i Maqedonisë, më duket (se rrjedh) nga *pélha* (= pelja, pela). *Dirachium*, i vendosur me shtëpitë e veta mbi dy kodrina, është në mënyrë të qartë /i ardhur prej fjalës shqipe të dialektit arbëresh/ *di-rahje* (= dy kodra). Fjala jonë *gcremii* (= gremí, greminë, humnerë), *gcremisset* (= gremiset), ndoshta, i pat dhënë, në Itali, emrin e hershëm Kremias në Shën Luçido, dhe Krimesë ndër shkëmbinjtë e kënetës (moçalit) Meotide. E, atje ku Cezari tregon se si e kapi bregun, në Epir, thotë: “Të nesërmen preku brigjet e Keraunëve, ndërmjet shkrepash dhe visesh tjera të rrezikshme, dhe i përhapi ushtarët në atë vend që quhet Farzalia”, një shqiptar njeh mirë në /emrin/ e përbërë *Farzalia*, dy fjalët /shqipe/ *afër* (= afër), dhe *Zhali* (= zalli, bregu); kuptohet se nga vendasit u quajt, kështu, vendi afër detit.

Unë po hapja, një ditë, te gjeografi Ortelius, hartën topografike të tempe-s; por, aty ku prisja të shihja një luginë të mrekullueshme, mbeta i prekur, kur pashë shkropa tepër të mëdhenj, të vendosur njëri mbi tjetrin, nëpërmjet të cilëve Peneu rrëzohet në luginën e nënteshme. Ndërsa po mblidhja mendjen nga ai çast habitjeje, m'u kujtua fjala shqipe *tiimp* (= tímp, shkrep, shkëmb, karpë, krep, rragam), e, aty-për-aty më ra në mend se emri i lashtë *Têmpe* qe /i ardhur/ prej etërvet tanë, e [ky] i pështatet mirë vendit, në të cilin skena e tmerrshme e malevet, ka zotëruar, përherë, mbresat e bukura të luginës.

PJESA II

1.

Mbas kësaj, pyesim:

- Populli, që në trashëgojmë e prej të cilit qenë ato gjurmë, a qe, vallë, i njëkohshëm me atë helenik dhe latin? A qe i njëjtë ai me popullin maqedon dhe epirot, dhe që vazhdoi ndër shqiptarët e Perandorisë Bizantine, deri ndër né?

Përgjigje. Së pari, them se kjo që po bëj të ditur, është e lehtë: ato shenja të gjuhës shqipe janë të ngulitura ndër përmendoret e në fenë e Greqisë së lashtë e të Romës; populli shqiptar pati, ndoshta, lulëzimin e vet përpara asaj /fesë së Greqisë së vjetër e të Romës/, por, sigurisht, pastaj, bashkëjetoj me të. Ekzistojnë opinione të mbledhura përciptas nga nomenklatura historianësh të lashtë e nga përqasje jo aq të sakta shkrimtarësh të perandorisë së fundit, për të cilët shqiptarët janë, njëkohësisht, Kolkët, ndjekës të Jasonit, Nardët e Aspetët persianë, prej nga doli Akili i shpejtë, që adhurohej në Epir, Japigët e Italisë dhe Albanët e Kaukazit, Gegët dhe Avarët e ardhur nga Hunët, etj. Këto mendime, nga një anë, paraqesin një pështjellim, nga i cili është e çuditshme si mund të qetësohet një mendje njerëzore, dhe nga ana tjetër, lanë dy zbrazëti që s'mund të mbushen: I. Si mundet që të gjithë ata popuj të ndryshëm, në vendbanimet e reja, ta flitnin së bashku shqipen? II. Si mund të jetë e njëjtë kjo gjuhë edhe për gegërishten e albanishten e Kaukazit, edhe për nardishten e persishten etj.?

Po ai mendim i ndritur, që nxjerr të dhëna nga afërsitë kombëtare, nga homonime të shndërruara me emërtime tribush e krahinash të largëta, na shtyn të shprehim disa hipoteza. Rajonet pranë Greqisë, të mbajtura në lashtësi nga epirotët e nga maqedonasit, në të cilat nuk pati shpërngulje të mëpastajme popullsie të shumtë, kanë në qytetet e tyre një popull me një gjuhë të vetën, e shënuar, aty-këtu, në kujtimet e lashta klasike. Gjithashtu, ky popull, është gjë e ditur, prej kohësh të vjetra ka rrjedhur nga epirotët e nga maqedonasit. Kjo gjë vërtetohet nga opinioni i të huajve, të cilët, diku e qetësuan me emrin *popull epirotas*, diku ushtrinë e tij e quajtën

mbretërore maqedonase dhe diku e përfshinë, (siç kishin bërë me popuj të Lekës e të Pirros), me grekët në emrin e gjithmbarshëm grekë. E gjithë kjo na shtyn të pranojmë që, populli maqedonas e epirotas, është në popullin e sotëm të Shqipërisë, në mënyrë që (me gjithë vërshimet më të mëdha të vizigotëve, longobardëve, hunëve e vandalëve) Italia, mbas kaq ndryshime emrash të provincave të saj, duket, nga gjuha që i tingëllon njësoj që nga Alpet deri në det, se është një kombësi, bijë e fiseve latine të Hesperies.

Është diçka e veçantë që, pasiguria në këtë anë (në këtë çështje), të rridhte nga emri i Arvanites (Albanenses), i përdorur, nuk dihet se si, nga historianët e perandorisë bizantine. Emri ynë kombëtar, kaq i shndërruar nga të huajtë, është *Aberësh* (arbëresh); dhe na thërrasin *Apiresi* (arbëreshë), gati si *Apirezë*, banorë të Epirit o *Apiros* (apirozë), siç qe thënë për shtrirjen e saj. Edhe emri shqiptar, siç e quan veten populli ynë, humbet ndër kohët më të lashta. *Scheptaar* (skeptār), patjetër, është apelativi shqiptar, që Homeri e përkthen në *Keravni*; prej nga fjala shqipe *shcheptur* (shkeptur) dhe helenishtja *Keravnin* kanë kuptimin “me shkrepëtitë, me shkrepë, me vetue, me lëshue rrufë e vetëtima”; o sepse ishin apelative të shkrepitimave (vetëtimave), pothuajse të vazhdueshme, ndër malet e Himarës, të banuara prej tyre, o sepse ishin mbeturinë e perandorisë pellazgjike të Shkreptimës, përpara mbretërisë së Jovit (Zeusit).

Monografia e Engjëll Mashit nga Shën Sofia, titulluar *Kolonitë arbëreshe të mbretërisë*, sido që gjykohet për diturinë e tij, për sa i përket identitetit të shqiptarëve të epirotasvet, mua më kujton, në shumë faqe, atë inteligjencë instinktive, që tërhiqte, pa e ditur, Meropin, që e kishte bir. As unë nuk do ta mohoj atë që ai shënoi se *Loon* (lōn), është emër maqedonas i muajit korrik, të cilin ne e quajmë *Lonaar* (= lonār); dhe, nga fjala *cheti* (keti), e mbajtur nga Kurci, tregohet mënyra e rregullimit të flokëve, e veçantë për maqedonasit, (siç i bëri Leka, atë mëngjes, që luftoi me Darin) e që, edhe sot, mbetet në fjalën tonë *ksheti* (= gërsheti), rregullim i flokëve mbi zverk. Dhe do të kujtoj, gjithashtu, me të, se është përmendur edhe nga Plutarku, në *Jetën e Pirros*, se Akili kish pasur falëtores në Epir, si hy i atdheut dhe nën emrin vendës *Ispetos* ose *i shpejtë*, sepse *ishpét* është fjala jonë e sotme, që don të thotë *i shpejtë*.

Më duket, pastaj, se emri mbretëror Pirro i përgjigjet edhe ai emrit tonë *burrë* (njeri i fortë, lt. vir); dhe, vërtet, Ali /Pashë/ Tepelena, duke i folur Pouqueville-it (Pukëvilit) për këtë /Pirron/, e shqiptonte *Burrus*. Por më i rëndësishëm është një krahasim tjetër. Thuhej se në Trojën e Frigjes,

Ekuba, kur ishte shtatzënë me Paridin, ëndërronte se po lindte një pishtar që i vinte zjarrin qytetit. Nga ëndrra e keqe, e thirri Aleksandër. Ky emër zërthehet mirë me rasën gjinore të shqipes *lhichs-ander* (= ljiqs-ander, prej ëndrrës së ligë, të keqe). Këtë emër e mori për të birin e vet, Olimpia epirotase, mbasi që e pat ëndërruar, kur ishte shtatzënë, se edhe ajo do të lindte një dragua. Kështu emri shqiptar Aleksandër dëgjohet, - do të thosha, - në Frigjen e Epirit e në Maqedoni, që prej kohëve më të vjetra.

2.

Kulti i natyrës shndërrohej, ndër stërgjyshërit tanë, në idhulltari popullore. Helenët, duke ia përshtatur natyrës dhe duke përdorur emrat e saj, e vishnin atë me antropomorfizëm.

Në mes të këtyre dy popujve, transmetimi i fesë, fqinjësia, përzierja e vendbanimeve dhe e pronave, na bëjnë të mendojmë një lidhje shumë të madhe. Kjo afërsi gjindet edhe sot e kësaj dite, në shenjat e mbetura të gjuhët e dy [popujve], në historinë dhe ndër zakonet e doket e tyre.

Identiteti i qartë i fesë, i shënuar edhe në Laciun nga ndonjë emër shqiptar, a të çon në një largësi më të madhe mes këtij populli, stërgjysh për né, dhe atij latin? Apo, përkundrazi, përgjasimi i zakoneve e i dokeve, dhe fqinjësia më e madhe e organizmit të përbrendshëm të së dy gjuhëve, shqipe e latine, më fort se ato lidhje të përjashtme politike e fetare etj., të Greqisë e të Shqipërisë, dëshmojnë ndonjë afëri mes shqiptarëve e latinëve?

Përgjigje: Unë anoja, dikur, nga besimi se, kulti natyror i stërgjyshërve tanë, ishte veshur, pastaj, me idhuj nga popujt Tirë, Egjiptianë, e tjerë, që u shpërngulën në Greqi, por sot e shoh se ajo ngjarje e madhe nuk mund të përfshihet mes kufijsh kaq të ngushtë. Adhurimi i forcave të botës duket se ka qenë feja pellazge (e lashtë), dhe e veçantë për etërit tanë, që mundën ta shoqërojnë me kultin e Zeusit, Zot-krijues; por ajo ishte e përhapur në Hindi, dhe besoj mes popujve, nëpër të cilët shtegtoi Abrami, etj. Antropofomizmi i miteve është, pastaj, i njëkohshëm në Europë, në Greqi e në Romë, dhe në Azi, në Hindi, në fiset Filistine, Amalacite etj., për sa di unë; dhe duket se nuk lindi veçse nga vepra e piktorëve dhe e skulptorëve që, pak nga pak, shkaktuan kudo që adhurimi i neveritshëm i ikonave të zëvendësonte fenë e lashtë. Këtë [te të lashtët] as unë nuk do të dija ta përcaktoja kur dhe ku mbaroi më parë se të kuptohej prej popullit. Nuk do ta dija, gjithashtu, ta përcaktoja as gjetiu, pa përjashtuar, ndoshta, përmendoret më të lashta të Hindive. Këto gjurmë të fesë së

lashtë kanë mbetur kaq të qarta e kaq të plota në politeizmin helenik, i cili është i reflektuar, tashmë, në pasqyrën e ndritshme të gjuhës sonë.

Për sa u përket, pastaj, fqinjësisë dhe afërisë mes stërgjyshërve tanë e helenëve, nuk mund veçse të radhit një varg faktesh, të cilat më duken se, kur të jenë shqyrtuar plotësisht, do ta ndriçojnë si rreze që vijnë nga çdo anë këtë temë.

E gjithë Greqia, në kohën e Herodotit, ishte e ndarë në dy popujt dorik e jonik. Populli dorik, sipas atij historiografi, ishte një degë pellazge e shkrirë ndër helenë; dhe Sparta ishte qyteti kryesor i tij. Populli jonik, pastaj, që përbëhej prej helenësh të papërzierë, njihete si kryeqendër të tij Athinën, që kish qenë banuar, më përpara, nga pellazgët e Samotrakies, nga të cilët kishin mbetur aty disa. Herodoti nuk thotë se Dorët, në kohën e tij, ndryshonin nga Jonët, në të folur; as shkrimet e Pindarit dhe të tjerë dorikëve nuk janë vendimtare për të provuar se aty kishte ndonjë ndryshim.

Përveç këtyre dy popujve, dorik e jonik, banonte, atëherë, në veri po të këtyre dhe, aty-këtu, në mes të tyre, një popull, quajtur mirëfilli pellazg, që kish qenë zhvendosur nga vendbanimet e tija prej helenëve, që fliste një gjuhë më vete, dhe të cilin Herodoti, që vizitoi disa qytete të tilla të atij /populli/, e quajti të huaj (*bàrbaros*).

Ndër helenët kishte qytete që kishin qenë koloni të tirëve, të egjiptianëve, etj., të cilët, në kohën e Homerit ishin ripërtërirë mes helenëve dhe i kishin ndihmuar fuqimisht, jo vetëm civilizimit të tyre, por edhe fitores mbi pellazgë, po qe se na lejohet t'i japim një kuptim historik mitit që lufta e Jovit kundër Titanëve qe fituar me ndihmën e heroit Herkul. Ai është quajtur një helen që u mundua, vazhdimisht, të zhdukte nga njerëzit veset e të këqijat. Ai krijoi lojërat për të përsosur shpirtrat e trupat e njerëzve; dhe bijtë e tij sunduan, pastaj, mes popujve dorikë e helenë. Ndërkaq, mijëra vjet para atij Herkuli, një Herkul tjetër kishte tempuj në Egjipt e në Tir, siç i gjeti Herodoti në udhëtimin e tij, dhe aty simbolizonte forcën heroike trupore e morale; dhe, tanimë, as kuptimi i emrit të tij, i huaj për pellazgët, nuk deshifrohet në gjuhën tonë. Duket që emri i Herkullit të ketë qenë veli për një sekt reformator që, mbasi erdhi me fenikasit në Tebë, u përhap në Greqi e gjetkë. Madje ka gjasë që, mbas zhdukjes së besimeve të vjetra e në ndërprerjet e besimeve fetare, idetë morale të përhyjnizuara në panteizmin që po vendosej, e ruajtën dinjitetin njerëzor nga një rënie e plotë; siç duket se shënon legjenda e Herkullit, që mban Olimpin në vend të Atlasit, (*at-lhash*, àt i lashtë, baba i

vjetër, në shqipe). Lundëtarët e Mesdheut, qendër kryesore atëhere e çdo tregtie, duke kaluar vazhdimisht përpara malit Afrikan që, i mbuluar me borëra, mbetet brenda në qiell, e shënuan me emrin e *At-lhash* (at-ljash, at i lashtë); dhe, pastaj, përfytyrimi i tij material që marrë për të paraqitur (figuruar) besimin e lashtë në qiellin e hyjnive.

Nga kjo tërësi të dhënash, në se nga njëra anë mund të sqarohet vajtja e tribuneve fenikase e egjiptiane në ndërtesën, qoftë për *adhurimin e ikonave*, qoftë për Panteonin grek mbi *adhurimin* pellazg, nga ana tjetër, vërtetohet, plotësisht, bashkimi i popujve aziatikë e afrikanë në trungun helenik, duke e ndryshuar, gjithnjë, nga ai që ishte më parë, ndoshta shumë më i afërt me degën pellazge. Këtë gjë unë shtyhem ta besoj, qoftë për shkak të fakteve të jashtme të sipërpërmendura, që helenët i kanë mbajtur perënditë shqiptare dhe me emrat shqiptarë dhe që, brenda e jashtë, janë përfshirë, si këta si ata, në emrin e përgjithshëm grekë; dhe qoftë për begatinë e fjalëve të përbashkëta për të dy gjuhët epirotike e helenike, që i ka bërë shumë / vetë/ të marrin të parën për një dialekt të tjetres. Thonë se ky fenomen ka mundur të vërehet mbas kontaktit shumëvjeçar të dy popujve dhe vetëm nga kontakti. Por nuk besoj se është e vështirë për një shqiptar të dallojë me mjaft saktësi fjalët [e tjera të mëposhtme]. Dhe një punë të tillë e ndërmora edhe unë në *Fjalorin shqip*, që fillova të përpiloj në Kolonitë tona, mjaft vjet më parë. Prej këtyre fjalëve, disa gjenden në gjuhën tonë, të prejardhura nga Greqia e krishterë, disa qëndrojnë në dy gjuhët, qysh në kohën pagane, të tjerat janë tamam tonat. Nga këto, vetëm jehonat mbeten ndër përmendoret më të vjetra të gjuhës helenike. Këto [fjalët] do të mund të ishin një dëshmi, më e lashtë se shkrija dorike, më e lashtë se Homeri, përpara të cilit qëndronin si dy popuj vëllezër, dhe grindjen e të cilëve ai e paraqiste në përçarjet e Akilit pellazg dhe të Atridit helenik, për të treguar shkatërrimin e pashmangshëm për të dy, po të mos qëndronin të bashkuar. Dhe, ndoshta, përveç zemërimit shkatërrimtar të Jonëve e të Dorëve, pikëzuar aq tragjikisht nga Tuqididi, edhe çrregullimi i brendshëm i Athinës që shkaktuar nga popujt e ndryshëm që përfshiheshin aty. Dhe shkatërrimi i Ermëve, shkaktar i të cilit thuhet se ishte Alkipiadi, munda t'i ngjallë dyshim në qytet se familjet pellazge merrnin anën e Dorëve, nga urrejta që kishin për shkronjat fenikase. Edhe sot është gjithnjë kundërshtimi i këtyre dy racave, që mbahet në këmbë nga pretendimet qesharake të panhelenizmit, që e pengon kursin e qeverisë greke dhe e asgjëson veprimin e saj për tështrirë sundimin edhe më tepër. Mendoj se ky sundim nuk do të jetë i gjatë, në qoftë se populli pellazg shqiptar nuk do të

marrë pjesë, me një pjesëmarrje të barabartë, në shtet dhe në kujdesin që ky ka për përhapjen e plotë të gjuhës e të formave të tjera kombëtare.

Është e vërtetë, pastaj, që jeta helenike shumë e vetmuar merrte ide të Azisë Perëndimore, duke ndryshuar nga mënyra dorike e pellazge, me të cilën mënyra e të jetuarit të në shqiptarëve ka përgjasim deri më sot.

Kjo mënyrë, që formon, nga ana tjetër, sfondin e tablove homerike, dhe që, pastaj, Likurgu, ripërtëritës i Homerit, e përforconte me madhështi në Spartën dorike, mbështetej mbi tri ndjenjat themelore: 1) Në të menduarit aristokratik dhe në ligjet që i përgjigjeshin një të menduar të këfillë; 2) Në dinjitetin më të madh të grave, duke i krahasuar me kushtet e tyre tek helenët; 3) Nëpërkushmëninë stoike në të ngrënë.

I pari nga këto detyrime, në drejtimin e qytetarëve, mori formën e një shteti monarkik, i zbutur pak nga parësia dhe pa përfshirë tërë vegjëlinë. Në Trojë e, pastaj, në Laqedemoni (Spartë) ekziston një mënyrë e tillë jetese, ku populli nderon fisnikët nga ana e racës, ndërsa për drejtësinë dhe mbrojtjen e jashtme mbledhet nën flamurin e ndonjë familjeje të tij kryesore e plot lavdi. Kjo frymë e lirë dhe plot respekt, duket përsëri në ushtrinë e Lekës, kur ushtarët, bashkatdhetarë me të, mbeten pezull mes bindjes që duhej t'i bënin mbretit dhe nderimit ndaj parësisë që e kundërshtonin atë; dhe vazhdon në kohën e Skënderbeut, pikërisht sipas përfytyrimit që na ka mbetur ndër këngët kombëtare bashkëkohëse me atë hero.

Gjendja e grave, pastaj, aq në nderim në Trojën Frigje, nuk ka ndryshuar fare as sot në popullin tonë, në të cilin virgjëreshat, ditën e martesës, marrin *kezën* (diademën), si mbretëresha të një familjeje njerëzore. Me të drejtë që shënuar për këtë rast se helenët, ishin krejt të ndryshëm në këtë çartje. Ata i mbanin gratë të mbyllura, sipas mënyrës aziatike, ndër hareme, e të veçuara nga jeta.

Veçoria e tretë e karakterit pellazgo-shqiptar ishte kjo: Thonë se nuk ekzistonte aspak koprracia, e cila ishte tradicionale dhe e ndryshme, ndër ata tribute skitike, sipas dëshmisë së Herodotit, të cilit i ishte dashur nga jeta endacake, të qëndronte këtu në vendbanime të paluajtshme. Do të thoja: kushdo që vizitoi vise shqiptare, mundi të njihnte një mosinteresim të rrënjëve në karakterin kombëtar të trashëguar nga ata stërgjiyshër të largët, përkundrajt të mirave e begative të jetës. Do të duket e çuditshme, por unë e shoh deri në nderimin, me të cilin shikoheshin kusarët e plaçkitës të tjerë të armatosur, që vazhdojnë ndër palikarë të sotëm. Gjithashtu, tek ata vlerësohej shumë guximi, argjendit i jepej një

vlerë e pakët, ose më fort quhej si një çmim që vihej në mes për provat e më të fortëve. Heronjtë e Homerit, mbretërit e Spartës, aq mospërfillës ndaj pasurisë, nuk e kishin për turp të dilnin fitues për të përvetësuar plaçkat e të tjerëve, atje ku hajnia është, gjithmonë, një poshtërsi dhe pasuria një stoli, sidomos ndër popuj tregtues, që jetojnë me të ardhurat e pakta e të vazhdueshme të jetës së mundimshme.

3.

Këto tri tipare fisnore dallojnë, gjithashtu, dhe në mënyrë të pathyeshme, popullin roman.

Mbas fitores së Pal Emilit, shumë koloni latine u themeluan në Shqipëri. Ky fakt na shtyn të dyshojmë se mos shumë gjurmime të bëra drejt kohëve ë mëparshme, do të jenë ndalur, përkundrazi, këtej e tutje, pas vendosjes së atyre kolonive. Shumë nga ato shenja që duken si treguese të një gjaku (një fisnie) për të dy popujt, mund të kenë rrjedhur nga bashkëbanimi i mëpastajmë. Lypet, pra, vëmendje e hollë e edhe një farë dyshimi se mund të gënjehemi duke i hyznizuar (përhyjnuar).

Sigurisht Jovi, Elici, Anna Perenna, Pani, e tjerë, janë të kultit para kohës së Romës, dhe kanë ardhë nga kombi shqiptar. Nuk do të dija të thoja nëse veshja luftarake e bluzave, zakonet qytetare të vajtimeve pranë të vdekurve, të këngëve të dasmës, riti martesor e të tjera, rrjedhin nga një farë-e-fisni e largët për të dy popujt shqiptar e latin, apo nëse rrjedhin në kohën e fitores. Vërtet, ato doke e ato veshje duken edhe në jetën helenike dhe, pastaj, kënga jonë e dasmës ka një lloj idesh që e dallon shumë nga poezia latine, që ne e njohim.

Por, qoftë edhe sikur këto gjëra i ndryshojnë popujt fqinjë, gjatë zhvillimit të jetës së tyre, tri shenjat e karakterit, që unë i quajta pellazge, ishin shumë të dukshme në Romë. Nuk është e mundshme që banuesit e parë të saj të kenë qenë hajdutë të egjër. Jo, gjithnjë, grupe hajdutësh mund të ndaheshin për një kohë të gjatë në klasa shumë të pabarabarta, patricë e plebej. Ndoshta patricë fisnikë dhe plebej simpatizues të tyre, të shpëtuar nga luftat qytetare, gjetën strehë me ndonjë princ të tyre në Tevere, dhe aty rregulluan çdo gjë me një drejtësi tradicionale. Dhe mbretëria aristokratike e, pastaj, aristokracia e zbutur luftuan, që andej, gjithnjë me idetë helenike popullore, të cilat ngadhënjyen për rrethkolonive greke të Tarantit, Napolit e të tjera. Dhe, mbasi, tashmë, kish fituar fryma e tyre, Hanibal Afrikani, një tjetër pinjoll i republikës së Tirit, erdh e ringjalli zjarrin demokratik, tanimë, të shuar; dhe, pas vetes, la në Lacium përçarjen e pavdekshme të

plebenjve e të patricëve, për të cilën gjë, pastaj, shpirti helen u bë superior edhe në Itali me Cezarin e pathyeshëm.

Kjo aristokraci, nga e cila matronat kishin denjësi e nderim jashtë në qytet, e donte jetën e fushave, ku shuhen nxitjet e kopracisë së vrullshme, dhe ku ka paqë thjesht të plotë, të shëndetshme.

Dhe kjo mjafton për mënyrën e të menduarit të lashtë, e përbashkët në Dorët e në Romanët, dhe jo e rënë endë nga shpirtrat e shqiptarëve.

Këtij bashkim zemrash në çështje të fesë, të dokeve e të të menduarit, i shoqërohej një afëri, ndoshta, më mirë e shprehur dhe e shënuar ndër gjuhët e tyre. Shënova gjetiu identitetin e disa fjalëve që qëndrojnë në burimet më të para në të dy gjuhët, latine e shqipe. Latinishtja ka *dies*, *diurnus*, shqipja ka *dittë*, *ditty* (= ditë), *dighet* (= dihet, gdhihet, bëhet ditë); latinishtja ka *magnus*, *major*, *majestas*, shqipja ka *imadh* (= i madh), prej nga /vjen/ *Emathia* (= e madhja) dhe *Emathio* (= i madhi ose Mati?), e *madheshtii* (= mashështi); latinishtja ka *lavo* (= laj), *lavacrum* (= govatë, banjë), *liquor* (= shkrihem, tretim), *lacus* (= liqen, pellg, rezervuar uji; poetikisht: ujë, lumë, burim); shqipja ka *lhaagn* (= ljanj, lāj), *lhagchign* (= ljaminj, laj, lamje, banjë), *lhiegn* (= ljenj, lyej), *lhuzz'* (= ljuc', llucë, kënetë, pjesë deti e cekët me një àmull), *lhuum'* (= ljùm, lumë, lum); latinishtja ka *lilium* (= lil, zambak); shqipja ka *lhùlhe* (= ljulje, lule), *lulhyzhòn* (= luljèzon, lulëzon), e, kështu, edhe shumë të tjera. Por dyshoj në se, me qindra fjalësh të veçuara, munden të shënojnë jo vetëm një afërsi të largët, por edhe moshën e lënë, në të cilën, kultit latin, i mbetën, gjithashtu, emra shqip me hyjnizim të hershëm.

Gjithashtu, pastaj, më duket se duhet menduar për ndonjë ngjashmëri që ka gjuha latine me shqipen, në organizimin e brendshëm, dhe ndër pjesët e tyre substanciale.

Kanë disa afëri në zgjedhim të foljeve, të cilat është e pamundur të mos i njohësh.

Le të vlejë, për shembull, koha e pakryer e dëftores:

shqip	latinisht	italisht
<i>doja</i> (= doja)	<i>volebam</i>	<i>voleva</i>
<i>doje</i> (= doje)	<i>volebas</i>	<i>volevi</i>
<i>doj'</i> (= donte)	<i>volebat</i>	<i>voleva</i>
shumës: <i>dojim'</i> (= donim)	<i>volebamus</i>	<i>volevamo</i>
<i>dojit</i> (= donit)	<i>volebatis</i>	<i>volevate</i>
<i>dojin'</i> (= donin)	<i>volebant</i>	<i>volevano</i>

E kryera e thjeshtë ka gjurmën helenike në njëjës, në shumës kthen

në trajtat italice:

shqip	latinisht	italisht
dështa (= desha)	volui	volli
dëshe (= deshe)	voluisti	volesti
dësh (= desh)	voluit	volle
shumës: <i>dëshitim'</i> (= deshëm)	voluimus	volemmo
<i>dështit'</i> (= deshët)	voluistis	voleste
<i>deshitin'</i> (= deshën)	voluerunt	vollerono

Urdhërorja, pastaj, është kaq energjike (e gjallë, e fortë, e fuqishme) dhe e shkurtër në shqip sa edhe në latinisht:

shqip	latinisht	italisht
thúaj (= thúaj)	dic	dici
thëft të theet (= le të thotë)	dicito dicat	dica
shumës: thonni (= thoni)	dicite	dite
t'theen (= le të thonë)	dicunto	dicano

Është për t'u shënuar, ndër shembujt e parë, që /bashkëtingëllorja/ vlatine është zëvendësuar në shqip, në mënyrë të qëndrueshme, prej /bashkëtingëllores/ *j*, dhe /bashkëtingëllorja/ *b* prej *j*, ose (gjë që është e përgjithshme, e përbashkët, e zakonshme) prej /bashkëtingëllores/ *v*. E kjo nxirret, edhe më qartë, nga përemrat, në të cilët, gjithashtu, afëria e shqipes është më e madhe me latinishten se me helenishten, siç /duket/ nga pasqyra krahasuese që pason:

shqip	helenisht	latinisht
njëjës, emërore: u (= unë)	egô	egô, it. io
gjimore: t'mêje (= i mua)	emû, mû	mei, it. di me
dhanore: mua, më (= mua, më)	emoi, moi	mihi, mi, it. a me, mi
kallëzore: mua, më (= mua, më)	emè, mè	me, it. me, mi
shumës, emërore: na (= ne)	imeis (dual: nê)	nos, it. noi
gjimore: t'neesh (= i në)	imôn	nostrum, it. di noi
dhanore: neve, na (= neve)	imin	nobis, it. a noi, ne
kallëzore: nee, na (= né)	imas	nos, it. noi, ne
rrjedhore: nêshi (= nesh)		

njëjës, emërore: ti (= ti)	si	tu, it. tu
gjinore: t'ëndët (= i tý)	son	tui, it. di te
dhanore: tîj, të (= tyj, të)	soi	tibi, it. a te, ti
kallëzore: tîj, të (= tyj, të)	se	te, it. te, ti
shumës: ju (= ju)	ymeis	vos, it. voi
gjinore: t'jûve (= i jú)	ymên	vestrum, it. di voi
dhanore: juve, ju (= juve, ju)	ymin	vobis, it. a voi, vi
kallëzore: juu, ju (= juve, ju)	ymas	vos, it. voi, vi
rrjedhore: jûsh (= jush)		

Filiacioni (birënia) i tri gjuhëve më duket se shfaqet prej saj, në të njëjtën masë, në dukurinë (pamjen) e mbiemrave përemërorë, që shkurtimisht po i shënojmë:

shqip

njëjës, emërore: immi, immia, t'imt (= imi, imja, timt)

gjinore: t'immit, s'immes (= timit, simes)

kallëzore: t'immin, t'immen (= timin, timen)

helenisht

emòs, emì, emòn

emòu, emîs, emôu

emôi, emî, emô

emòn, emîn, emòn

latinisht

meus, mea, meum, it. il mio

mei, meae, mei, it. del mio

meo, meae, meo, it. al mio

meum, meam, meum, it. il mio

shqip

emërore: itti, jottia, t'ëndët (= yti, jotja, tëndët)

gjinore: të t'ëndit, t's'attes (= të tëndit, të sates)

dhanore: t'ëndit, s'attes (= tëndit, sates)

kallëzore: t'ëndin, t'enden (= tëndin, tënden)

helenisht

emërore: sos, sî, son

gjinore: sou, sîs, sou

dhanore: sê, sî, sê

kallëzore: son, sîn, son

latinisht

tuus, tua, tuum, it. il tuo

tui, tuae, tui, it. del tuo

tuo, tuae, tuo

tuum, tuam, tuum

Për mashkulloren (**shqip**)

emërore: i tiij, e tij, të tîjt (= i tij, e tij, të tîjt)

gjinore: i, e, të tîjit, etj. (= i, e, të tîjit, etj.)

Për femëroren (**shqip**)

emërore: i sai, e sai, t'sai (= i saj, e saj, të saj)
 gjinore: i, e t'sait, etj. (= i, e të saj, etj.)

latinisht

emërore: suus, sua, sulm, it. il suo
 gjinore: sui, suae, sui, etj.

shqip

inni, jôna, t'anët, etj. (= yni, jona, tanët, etj.)
 iji, júaja, t'àjët (= yji, juaja, tajët)

helenisht

nôiteros, a, on
 sfôiteros, a, on

latinisht

noter, tra, trum
 vester, ra, on

E, pa u shtrîrë përtej, vlen të shënojmë, këtu, si *t*-ja, që në latinishten është *tuus*, dhe *s*-ja që në helenishten është *sos*, mbështesin pronorin e vetës së dytë. Sikurse *s*-ja e latinishtes *suus*, janë edhe dy shkronjat themelore të këtyre mbiemrave shqip. Por, në këtë gjuhë, shkronja të tilla përhapen në to me ligje të njohura e më të lashta, për të cilën /gjë/*t*-ja shënon, në përgjithësi, pronën e mashkullorit, e *s*-ja të femërores.

4.

Në të vërtetë, kujtesa e një farë-e-fisnie të etërvet të Hesperies dhe të Epirit ishte e lindur në Latium; e atë, poeti Virgjili, i shtrënguar nga kufizimet e tregimit të tij, ia ngulit popullit trojan, i mërguar ndër dy gadishujt. Por ka arsye të forta për të besuar, përkundrazi, që kjo afëri të ngjitet, përsëri, ndër kohë më të lashta që një popull fare-e-fis kishte banuar prej fillimit, në të dy brigjet e Adriatikut, ku, mbeturina e shpërndara, ruheshin në kohën e Herodotit; e prej këtyre qe e mundur t'i epej emri atij gji deti, pothuajse nga (fjala shqipe) *atëria* (adria), vendi i etërve, selia e të parëve.

I njëjti parim i Romës, i zhdukur nga terri e i prapësuar, me qëllim, ndër mitet, prej popujsh që e banuan më vonë e që ishin më të mëdhenj në numër e të ndryshëm në gjuhë nga themeluesit e parë, mund t'i detyrohet popullit pellazg. *Romi*, në gjuhën tonë, don të thotë *rrojme*, jetojmë; /duket/ sikur të mërguarit, nga vështirësitë e një jete endacake dhe të mbledhur atje, kishin

dashur, me fjalën e pavdekshme *ròmi* (= rrojme, jetojmë), të shënojnë ndjenjën e pushimit e të lirisë, në të cilën merrnin frymë. *Ròmi* e *rîmi*, rrojme e rrimë, qenë dy mendimet e para, të personifikuara, gjithashtu, në Romolin e në Remin; pastaj, dëshiri i dytë *rîmi*(= rrijmë) ia lëshoi vendin nevojës për të jetuar, qoftë edhe duke sulmuar, prej nga ndodhi që Remi vdiq nga dora e Romolit, vëllai i tij, dhe Roma pati emrin e saj të vetëm nga Jeta. Dhe miti tjetër, porsa i përfytyruar në largësinë e kohërave, *Egjeria*, që këshillon dhe frymëzon Numën e urtë, ka një shpjegim të natyrshëm dhe të pranueshëm me gjuhën tonë. *Egkëria* (= egjëria) në shqip, don të thotë fisni, gjini (më tepër për grua), gjak (më tepër për burrë), martesë, kurorë. Tani, është e lehtë që, mbas shkuljes dhe nguljes, në Romë, të Sabinëvet, dhe mbas përzierjes së tyre me banorët e parë, nuk u këshilluan me hyjni tjetër /= zotmbrojtës, dalëszot/, veçse me gjërinë, me të afërmit, e gjakut, që, tashmë, i lidhte. Kështu, mbreti Sabin, u jepte të kuptonte pellazgëve, dhe në gjuhën e tyre të vetën, që *egjëria* (farë-e-fisnia, gjaku, gjëria) e jo tjetër ia frymëzonte punën.

5.

Por ajo që, në radhë të parë, i afron dhe i bën të së njëjtës familje tri gjuhët: shqipen, helenishten e latinishten, është lakimi, sipas rasave, i emrave, përemrave e mbiemrave, prej nga sjellin, pothuajse, shenjat e botës së lashtë.

Le të më lejohet të them se si, nga praktika e gjatë dhe e madhe e gjuhës sime, mund të vërej tri gjëra:

- 1^a) Ekziston një sasi e veçantë fjalësh të përbashkëta për të dy gjuhët helenike e shqipe; një e dhjeta, pothuaj, e këtyre, por të burimit më të parë, janë të shpërndara në shqipen e në latinishten; kurse një sasi e madhe fjalësh italiane, që u fut në gjuhën tonë, në kolonitë tona, e kanë të qartë, në vete, vulën e huaj.
- 2^a) Për sa i përket formimit të zgjedhimeve, për përemrat e për ndërtimin e frazës, shqipja ka, ndoshta, më tepër përngjasim me latinishten.
- 3^a) Ka shenjat (tingujt) zanorë e bashkëtingëllorë të helenishtes e të latinishtes, njëheri; dhe qëndron mes tyre për nga format e dy lakimeve e për përemrat pronorë të përbashkët.

PJESA III

1.

Kështu, ai popull i etërve tanë, me të cilin bashkëjetesa (përveç lidhjeve të ngushta) me botën helenike e latine është e dukshme, a është ai popull pellazg aq në zë?

Unë u ndala në këtë opinion, lidhur me sa Herodoti na la të shkruar, se hyjnitë mitologjike kishin ardhur prej pellazgëve; se ata qëndronin, në kohën e tij, fqinjë të helenëve dhe me gjuhë të veçantë; se ishin shkrirë me helenët, duke formuar Dorët. Meqenëse ato hyjni ishin emra shqip, meqenëse gjuha shqipe, ndonëse e ndryshme nga helenishtja, ka bashkë me këtë një numër kaq të madh fjalësh, dhe përfshin krejt alfabetin. Ka një aftësi të njëjtë të kontraktohet e të zgjerohet, dhe, nga ana tjetër, meqenëse pastaj, doket, zakonet, shpirtrat, që qenë të Dorasvet, fryjnë, gjithnjë, ndër shtëpitë tona, mua më duket se shqiptarët zbresin prej atyre, në vendin e të cilëve, menjëherë, pas Herodotit, nuk gjejmë tjetër veçse epirotë e maqedonë, mbasandaj shqiptarë, të emërtuar, tashmë. Njimend, në gjuhën e tyre këtu mbajnë, vazhdimisht (edhe sot e kësaj dite), fjalën *pelak* (= plak, i moçëm), që atyreve ua ngjiten, ndoshta, më të rinjtë në moshë; e *pellazgë* u quajtën me fjalën e vet atyre. Asgjëmangut, po ia lë, me kënaqësi, opinionin tim kritikës së dijetarëve në gjuhësi dhe të atyre në çështjet e antikitetit. E, me qëllim që vetëm të ndihmoj gjykimet, do të zbuloj, ndër të tjera, disa shënime të gjuhës shqipe që, në mënyrë të veçantë, përvijojnë fizionominë /e saj/, e do të mund ta bëjnë që të njihet dhe të renditet.

1^a) Para së gjithash, alfabeti i saj /i gjuhës shqipe/ është shumë i pasur në bashkëtingëllore, duke pasur:

grykoret latine (*c, ch, g, ngch*) dhe heleniket (*k, gk, ngk, j, x*);

pastaj, të përbashkëta ndër të dyja, *x*; dhe të sajën të veçantë *gch*; dhëmboret latine (*d, t, z*) dhe heleniket (*dh, th, zh*);

buzoret *b, v, p, f*;

të lëngëtat *m, n, l*, dhe *lh* që i përgjegj italikes (italishtes) *gl* të *gli*; fishkullueset *s, sh* (që është italikja = italishtja *sc* të /fjala/ *scevro* = pa) e *sg* që tingëllon sikurse *g* galike = franceze.

Dhe, pastaj, zanore *a, e, i, o, u, y*. Tingulli i kësaj të fundit /*y* = *ë*/ nuk e di në se ekziston fare në ndonjë shëmbëllesë alfabetike të helenëve e nën *y*-në latine.

Këto zanore kanë, secila, tri shkallëzime të qarta; *a*-ja, për shembull, ka dy kohë në /fjalën/ *daardh* (= dārdh, dardhë), një kohë e gjysmë në /fjalën/ *dārdhie* (= i, e një dardhe), një kohë të vetme në /fjalën/ *myzha* (= mëza, pela). Përveç kësaj, ato, ndryshe, bashkëzanojnë nën theksat e mprehtë e të rëndë, kështu që, në tërësinë e gjuhës, japin mbi 40 tinguj zanorë të dalluar, të cilëve u duhet shtuar *e*-ja e shurdhët (e pazëshme), që gjendet me kaq shumicë në gjuhën frënge, e aftë për t'u shtrirë në gjysmëzanore [ndërmjetëse].

Do të thoja se gjuha jonë, e paralindur në mes të dy motrave, ka vetëm kjo sa ato të dyja së bashku.

2^a) Kjo shumicë tingujsh, e gërshtuar në njëmijë mënyra, nxjerr dukuritë e gjërave me emra prej larmie të ndryshme, ndër të cilët, thjeshtësia më e madhe, për sa u takon rasave dhe numrave, vë një rregull të përpiktë që e lehtëson të nxënit.

Së pari, të gjithë [emrat] klasifikohen në dy ndarje të mëdha, në femërorë dhe në mashkullorë. Dhe, në të dyja, rrallëherë ndonjë ndërrim shkronjash, por, zakonisht, një shtesë kohe *o*, në të vërtetë, rrokjesh, përcakton shumësinë e objekteve, dhe i shoqëron, pothuajse, në rritjen e tyre; si, p. sh. *lhuum* (= ljuum, ljūm, lumë, lum-i), *lhúmera* (= ljúmera, lumenj). Ndonjëherë, një ndërrim emri ndjek ndryshimin e dukurisë së objektit; p. sh. *iil* (= īl, yll-i), kaq i përshtatshëm për të përfytyruar pamjen e lehtë dhe të përkohshme të një ylli të vetëm, shndërrohet në *ilhizh* (= ijliz, yje), kur duhet të paraqesë drita të shumta që xixëllojnë nga një natë e gjerë (e plotë).

Emrat femërorë mund të mblidhen (të bashkohen) në një lakim të vetëm, nga i cili, në njëjës, gjinorja bën të ndryshojë, si të pazëshmen, ashtu edhe zanoren fundore në *ie*, e ku është e nevojshme, qoftë

për këtë, qoftë për eufoni, /të shkruhet/ në *je*: nga *lbuzz'* (= ljucc', llucë, kënetë, moçal), bëhet *ljuzzie* (= ljuccie, lluce, kënete, moçali); nga *hjee* (= hjé, hije) /bëhet/ *hjêje* (= hjeje, hijeje). Në klasën tjetër të mashkullorëve, ka dy lakime, në të cilët të gjithë ndahen me të njëjtën thjeshtësi. Dhe një ligj, i barabartë për të dy klasat, rregullon zhvillimin e shumësit ndër rasat e tij.

Por ajo që i bën shqipes një vend të veçantë, në lidhje me gjuhët e lashta të lakueshme helenike e latine, është që emrat e saj nga gjendja e pacaktuar (e pashquar), siç i kemi parë, kalojnë në gjendje të caktuar (të shquar), duke iu ngjitur atyre në fund *a* për femërorët, e *i* dhe *u* për të dy lakimet e mashkullorëve: nga *lhúcc'* (= ljúc, llucë, kënetë, moçal), bëhet kështu *lhúzza* (= ljucca, lluca, kënetë); nga *drápyr'* (= drapër) – *drápyri* (= drapëri); nga *shtògch* (= shtog) – *shtògcu* (= shtogu).

Dhe këta emra, kështu të ndryshuar, u japin vend dy renditjeve të tjera lakimesh më të përcaktuara e të thjeshta.

Kjo gjë nuk duket se e lidh dhe e ndryshon gjuhën shqipe me një kohë të moçme, por në të edhe çdo emër, në sasinë e vet të pafund, përcaktohet me forma të tjera nga ato të emrave mashkullore e femërore dhe *ûjyt'* (= ujëtë, uji), *vâlht'* (= valj't, vajtë, vaji), janë asnjësisht e tij të caktuar (të shquar); dhe i tillë është çdo veprim o cilësi në gjendjen e tij absolute, si *te dhiovassurit'* (= të dhiovasurit, të lexuarit), *te bardhyt'* (= të bardhëtë, të bardhyt' (= të bardhëtë, të bardhët, bardhësia).

Po shpjgohemi: *ghècur'* (= hekur), për shembull, në qoftë se don të dëftojë një hekur, të çfarëdo trajte e mase, është mashkullor, dhe kalon në gjendjen e tij të caktuar si ata që përngjasojnë me të; kështu kemi *ghècuri* (= hekuri), por, në se don të tregojë këtë metal në qenien e tij të përgjithshme absolute, është asnjësisht i caktuar, duke i shtuar në fund /mbaresën/ -t: *t'ghècurt* (= hekurat).

Për sa i takim pasurisë së thjeshtë dhe larmisë, emrat asnjësisht në gjuhën [shqipe] nuk janë ashtu si i ka latinishtja e greqishtja, nuk janë as si mbeturina e ndonjë gjuhe tjetër, të cilat i mbledhi një gjuhë e mëvonshme ose bashkëkohore, por asnjësisht mbajnë një trajtë të veten të veçanti për të shprehur idenë [gramatikore] në gjininë e emrit, gjë që u zhvillua gjatë gjithë jetës së gjuhës.

3^a) Nën këtë vështrim, është e denjë të kundrohet ajo që ndodh kur lidhet emri me mbiemrin në shqip, ku, në rasë se emri paraprin, ai lakohet e mbiemri e shoqëron i palakueshëm, si *trime i baardh* (= trim

i bārdh, djalosh i bardhë), *t'trimt baardh* (= t'trimt bārdh, të trimit të bardhë, të djaloshit të bardhë); në atë mënyrë, do të thoshja, që cilësia e përgjithshme është zbatuar, nga mendimi, pa e kufizuar atë, në vetë emrin. Në qoftë se mbiemri i paraprin emrit, gati, si të thuash duke marrë trajtat e këtij, mbiemri lakohet, kurse mbiemri mbetet i pandërrueshëm; kështu: *i bārdhi trim'* (= i bardhi trim, i bardhi djalosh), *ty bārdhit' trim'* (= të bardhit trim, të bardhit djalosh).

Në mes të mbeturinave të kësaj gjuhe, rrin, pastaj, në tri trajta të lakueshme, *un-*i i pavetje, që u mungon /gjuhëve/ greke dhe latine: *Vetthêa* (= uni), *vettmêa* (= uni im), *vettjúa* (= uni yt o juaj). Përveç mbaresës së veçantë, saktëson në të pronën e vetjeve të treta. Ndërsa rregulla (formula) e pronës, e lakmueshme, përcakton së bashku, në mënyrë të qartë, gjininë prej kujt është zotëruar dhe atë që e zotëron; kështu /kemi/:

për mashkulloren:

emërore: i tiij (= i tīj); lt. *suus*; e tiij (= e tīj), lt. *sua*; ty tiij (= të tīj), lt. *suum*;

gjinore: ty t'tijit (= të tijit), lt. *sui*; ty t'tijes (= të tijes);

dhanore: ty t'ijit (= të tijit), lt. *suo*; ty t'ijes (= të tijes), lt. *suae*;

kallëzore: ty t'ijin (= të tijin), lt. *suum*; t'ijen (= të tijen), lt. *suam*, etj. *për femëroren:*

emërore: i sai (= i saj), lt. *suus*; e sâja (= e saja), t'sait (= të saj), lt. *suum*;

gjinore: ty t'sait (= të saj), lt. *sui*; t'sajes (= të sajës), lt. *suae*;

dhanore: t'sait (= të saj), lt. *suo*; t'sajes (= të sajës), lt. *suae*;

kallëzore: t'sain (= të saja), lt. *suum*, t'sajen (= të sajën), lt. *suam*; t'sait (= të saj), lt. *suum*.

Këto gjurma të hershme /të kohë së parë/, të shënuara në alfabet, ndër emra, etj., duken se u mungojnë zgjedhimeve të foljeve; o, sepse ne i përdorëm duke i quajtur të lashta trajtat e ngjashme me ato të gjuhëve helenike e latine, o sepse kështu është në fakt.

Vërtet, gjuha shqipe ka pasur kohë të thjeshta në /diatezat/ veprorë e asnjësore /mesore/; të tjerat i ka të përbëra nga folja *me pasë* dhe nga pjesorja e shkruar, sikurse gjuhët romane; e, sikurse këto, i sajton të gjitha kohët nga folja /e diatezës/ pësore.

Megjithatë, unë nuk besoj se ajo pat hequr dorë ndonjëherë nga

trajtat e saja të thjeshta për t'i ndryshuar këto, qoftë pas kolonizimit romak, qoftë në kohën e zbrërthimit (përthyerjes) të gjuhëve moderne, sepse, po të njësohej me gjuhët e reja, shqipes do t'i duhej të ndiqte më tepër italishten, me të cilën pati marrëdhënie të qëndrueshme; ndërkaq, zgjedhimi i saj /i gjuhës shqipe/ është i njëjtë me atë të frëngjishtes. Vlejnë pak shembuj. Ajo ka më se të kryerën të pacaktuar, /kohë/ e cila i mungon italishtes:

Shqip:

u cam passur paar (= u kam pasur p̄ar, unë kam pasë parë);
ti chee passur paar (= ti kē pasur p̄ar, ti ke pasë parë);

frëngjisht:

je ai eu vu;
tu as eu vu;

e /diatezat/ pësore, më se të kryerën, më se të kryerën e tejshkuar, të caktuar, dhe më se të kryerën e plotë e sajojnë duke bashkuar, me pjesoren, /foljet/ ndihmëtare *me pasë* e *me qenë*, të bashkuara si në frëngjisht:

shqip, /koha/ më se e kryer:

u cam kyyn paar (= u kam qëen paar, u kam qën p̄ar; unë kam qenë parë);
ti chee kyyn paar, etj. (= ti kee qëen paar, ti kē qën p̄ar; ti ke qenë parë), etj. ;

frëngjisht:

j'ai été vu,
tu as été vu, etj. ;

shqip, koha më se e kryer e tejshkuar:

u patta kyyn paar (= u patta qëen paar, u pata qën p̄ar; unë pata qenë parë);
ti patte kyyn paar, etj. (= ti patte qëen âar, ti pate qën p̄ar; ti pate qenë parë), etj;

frëngjisht:

j'eus éte vu,
tu eus éte vu, etj.

Vështrimi (kuptimi) i këtyre dy kohëve nuk është, në të vërtetë, i njëjtë ndër të dy gjuhët:

shqip, /koha/ më se e kryer e plotë:

u chèschia kyyn paar (= u këshia qëen paar, u keshja qën pār; unë kisha pārë);

ti chescie kyyn pār (= ti keshie qëen paar, ti keshje qën pār; ti kishe qenë parë), etj.

Përveç kësaj [shqipja dhe frëngjishtja] ruajnë mbaresa të ndryshme për të tashmen e dëftores, të cilave u përgjigjen trajta të ndryshme për të kryerën e thjeshtë; prej këndej dalin shtatë zgjedhime. Dhe në to nuk ka shenja të fizionomisë thujse monotone të gjuhëve romane, prej të cilave gjuha jonë dallohet nga një varg foljesh, krejt të veçanta për të, që shprehin veprimin e bërë dhe të pësuar, njëherit, prej kryefjalës; p. sh. *shighem* (= shihem), *shighe* (= shihe), *shighet* (= shihet). [Këto] forma të shqipes u përgjigjen formave të mesme të foljeve të gjuhës greke, por në vetvete ato kanë edhe të gjitha trajtat e veproses.

Ndoshta këto trajta të përbëra të foljeve shqipe, në thjeshtësinë e tyre, harmonizohen me lakimet, që pamë aq të çkoqitura në krahasim me heleniket e latinet. Ndoshta, thjeshtësia e përdorur me vend i përshtatet më mirë botës së lashtë, në të cilën italianët mendjehollë gjejnë po shenjat e gjuhës së tyre.

2.

Mbas këtyre pikëpamjeve [të parashtruara më sipër], nuk është për t'u çuditur në se duket që kanë emra shqip rastisjet [që rrjedhin] nga përputhja e sigurtë e me vend e tingujve të kësaj gjuhe të konsumuar me të gjithë botën e ideve [të saj]. Ne ruajmë tepricat [që kanë mbetur nga e kaluara] dhe besojmë se dallojmë aty gjurmët e një kulture të veçantë, që nuk ka humbur në të, gjatë shekujve e shkatërrimeve, dhe e pranojmë me lehtësi konceptin e trashëguar se ajo ka qenë e folur nga pellazgët, kur rezonancat e saj përhapen nga tempulli e nga selitë e tyre, meqenëse nga feja e pellazgëve të Samotrakies, ne i kujtojmë

endë sot ato pak perëndi. *Kabirët*, në atë kult (adhurim) të errët e të thellë, thuhet se përpinin (hanin), si Saturni latin dhe Kronosi helenik, bijtë e vet; e *Ha-biir* (= ha bir), në shqipe, shpjegohet (don të thotë) *ha-bir*. Ishte, pastaj, Mira që njehej (konsiderohej) nënë e lashtë e të gjithë perëndive. Në gjuhën tonë e *Mira* don me thanë *E mira*. Tani kjo, le të më lejohet digresioni, është rrënjosur në tërë qenien, në tërë jetën, nga e cila drejtohen të gjitha aspiratat e natyrës, qenie e jetë që për njerëzit ndjehen si dhurata, e që dihet se do të shkojnë duke ndërruar deri sa të sosen; kështu në vetëdijen e tyre, është thellësisht e rrënjosur ideja e *diçkaje* të përtej natyrës së dukshme e të pranishme. Zotin, që duket autor (krijues) i një jete së tij dhe i pushtetshëm për t'ia dhënë, përgjithnjë, njerëzimi e adhuron dhe i lutet. Ndaj e mira, fryt e shpresë njëherit e *Jetës*, e lidh me Zotin dhe mbetet burim feje. Mira, ndoshta, e përkthyer në Dea Bona të Romës, kish lindur, pra, perënditë; dhe falëtorja e saj ishte e veçuar dhe e ndarë nga Panteoni; dhe kështu u donte.

Por, për këtë gjë, të jetë ajo që duhet [thënë]. Për çdo shqiptar, që vëzhgon në gjuhën e vet dhe ndjen flladin e brendshëm të saj, dhe, pastaj, shikon me admirim doket e stërgjyshërve, - sikurse janë bartja e grave me ngarkesa në shpinë në mënyrën e së resë së Abrahamit, xhoka e grave të martuara, si goditjen (ndreqjen, rregullimin) e flokëve, që, ndër gratë, është endë e njëjtë me mënyrën e gdhendjes në statujat greke, - ka një vetëdije të pamposhtur për prejardhjen e fisit të vet nga çdo popull fisnik, i lashtë, që qëndron në të i pandryshuar nga kohët. Dhe, sa më fort i sheh të errëta e të largëta origjinat, aq më fort bindet se mund t'u përkasë atyre origjinave çdo rezonancë e gjuhës së tij, e cila vjen qoftë nga kohë të lashta, qoftë nga vende të ndryshme. Kështu /Zef/ Krispi mundi të besojë, dhe jo të bindë të tjerët, se fjalët *mane tecel fares* të sallës së Baldasarit, interpretuar nga Danjeli si *i matur qe në kandar dhe s'peshove asgjë*, ishin fjalët shqipe *mân' ti keel fare* (mát e ti nuk çon (sjell) gjë). Dhe, ndoshta, më karakteristike (të veçanta) se këto, do të duken afërsitë e tri foljeve shqipe, *shim*, *cam* (= kam) e *jap* me tre kryeparët e njerëzimit *Sem*, *Kam* e *Jafet*: *Shim* (vendimi) që shëndon tendencën (prirjen) e popullit semitik për tregti; *Kam* që duket folja e Kamitëve, dhënë krejt pas jetës tokësore dhe të devotshëm ndaj Mamonës; dhe *Jap* (dhuroj), shenjë e bijve heroikë të Japetit. Por, sado të çuditshme që mund të duken të tilla përngjasime, ka që mendojnë se, në atë kohë të hieroglifëve, shënoheshin me fjalë të

shkurtra, po me kuptim të gjerë, jo epërsia e ndonjë pronësie në individë e në kombe, por edhe historitë e popujve. Këto tri folje tregojnë për tri fakte kryesore të shoqërisë njerëzore, të cilat nuk duhet të lireshin në heshtje, por, përkundrazi, të ngriheshin e të lidheshin me të tjera jehona (rezonanca) shumë më të qarta e të plota, që janë, pikërisht, të kësaj gjuhe të kohës së parë.

3.

Duke u dhënë fund vërejtjeve dhe hamendjeve rreth qenies së kombit tonë, le të më lejohet të prek një ndjenjë të errët, që është ngjallur në shpirtin tim dhe që u përket çështjeve më të spikatura të fatit tonë: “Gjurma, pra e gabimit të parë, e shënuar ndër emrat e perëndive të politeizmit helenik, gjendet e mbështetur në gjuhën tonë, sikur, pothuaj, në një puhi të lehtë që, përmes shekujve, e ka ruajtur, si një zë të domosdoshëm për ndriçimin e ardhshëm të jetës në të vërtetën e në fenë. Dhe mund të mendohet se janë themeltare, këtu, qëllimet e asaj diturie që, nga gjëra shumë të vogla, nxjerr gjërat e mëdha”.

Dhe aq më fort mua më duket kjo, sa më tepër që mund të lidhet me një fakt kryesor (kapital) në historinë kristiane: dua të them me ndalimin që i është bërë apostullit Pal që të fillojë në Azi misionin e tij në mes të popujve, duke iu dhënë, përkundrazi, urdhri që të kalonte në Europë, por në fisin (tribunë) tonë më të ndritur, Maqedoninë. Nëse, në rendin fizik, vëzhgimet e fenomeneve më të rastësishme në dukje, na kanë shpënë e na shpien, vazhdimisht, në zbulime të rëndësishme, mundet fare mirë, të ngrihet kjo e ajo ngjarje, në një sferë më të ngritur, të cilat duket se presin një shpjegime për të ardhmen.

Dhe kjo e godet edhe më fort mendjen, kur të mendojmë se dy më të mëdhenjtë ruajtës e përhapës të fesë pellazge, në kohën kur gjithë bota e braktiste, qenë dy shqiptarë, Diokleciani i Tivarit, që e luftoi krishterimin me dhunën më të fortë të armës romane, dhe Juliani i Prizrenit që, i fundit, u përpoq ta koklavisë e ta zhdukë, me çdo mjet dinak të artit pagan. Të dy duket sikur mbronin reliket e pasurisë së shenjtë të stërgjyshërve të tyre, dhe të vetëdijshtëm që e bënë këtë me ndërgjegje, në kohën kur bashkatdhetarët e tyre, në një numër më të madh, ishin lidhur me zemër me fetë e reja, të cilët [bashkatdhetarët], pastaj, të gjithë, nën Skënderbeun e tyre, dhe në kohën që ato fe ishin

venitur kudo për rreth, dhanë për to jetën e pasuritë dhe mbrojtën tokën krishtere me shkatërrimin e vetvetes.

Sigurisht që një sakrificë kaq e madhe ka, së paku, një vlerë për fatet tona. Dhe, me që në gjuhën tonë e në vuajtjet tona, qëndron fshehur një visar i dyfishtë, shumë më i vlershëm se çdo kulturë mondane artesh, dhe meqenëse fatet njerëzore vijnë prej së larti, ne kemi pse të besojmë në to. Edhe Zoti, pa veprën tonë, është kujdesur për ne kur, në mes të së tjerëve, banuam të varfër e të vetëm dhe pa altarët (ndihmat) e tij, dhe na e ka ruajtur nderin, /që ishte/ kaq i lehtë për t'u humbur në mungesë të atdheut o në mërgim. Prandaj nuk mund të njehen (të konsiderohen) si të pathemel shpresat tona, që në ripërtëritjen e shpirtit, e cila bëhet nën sytë tanë, ndaj dashurisë për gjithë atë që sjell në vete ndonjë drejtësi, ne do të kemi ndihmat e atij që do të dalë i pari nga një gjendje vuajtjesh të njëjlojta, dhe provon, tashmë, hërin e një jete më të drejtë, mbasi çështja e nevojave dhe e ndihmave ka nisur që nga fillimi në gjirin e botës, dhe ka mbetur e lidhur me të ardhshmen e pambarim.

6. ARDHJA JONË E SHKRETË NË ITALI (EMIGRIMI I SHQIPTARËVE NË ITALI)

Mbas vdekjes së Skënderbeut, i biri i tij, Gjoni, u çua e ndau në një anë gratë, fëmijtë e burrat e vjetër që nuk ishin të zott për armë; bashkoi, çka gjet, lundër e barkë tregëtie ndër limane shqiptare të Vlorës, të Portës (Portice), të Myzeqesë, të Durrësit, të Buenës, të Ulqinit e të Tivarit. Ndërsa ishin duke udhëtuar për t'u kapë në liman të Tivarit, ku ishin të mbledhura tok, të tëra anijet, bashkë me katër galé venedike, iu desh Gjonit, me shokë të vet, të hyjë në një luftë.

Shkaku i këtyre të zezave që, pse u nda Ana e Malit, që është një pjesë e Shqipërisë, prej Shkodrës, duke qenë se të dyja këto krahina janë të shkëputura prej një lumi të madh, që quhet Buena, lum plot peshq e ngjala, me të cilat vendi bën tregëti. Duke parë se hovi i ushtrisë turke, së cilës i kishte prirë veziri, Isuf Pasha, ishte gati kah shtronte mbarë Shqipërinë e kah shkelte, prandaj, edhe atë krah andej lumit (Buenë), Anamalasit, duke drashtë më fort për shtëpia të veta, që ishin aty ngjet, u mblodhën në kuvend, e, duke u ndarë prej shkodranëve, i dërguan letër Isuf Pashës, duke i thënë se ata donin të zbrapseshin e t'i binin në dorë (t'i dorëzoheshin), po që se ai nuk i bënte ndonjë gjë të keqe Anës së Malit. Ua dëgjoi fjalën Pasha dhe këta u kthyen ndër vende të veta.

Mbet, atëherë, ana tjetër, dua të them krahina e Shkodrës, e cila, për të gjallë, nuk i lëshoi armët; por, sa të mos i binte në dorë Isuf Pashës e të rrinin raje e tij, ndau të nisej; edhe me armë në dorë e çoi në vend fjalën e vet. Gratë e fëmijët i nisën e i bënë bashkë me çetën tjetër, që ishte me Gjonin e me do princa shqiptarë.

Kreshnikët e Shqipërisë, që ishin në krye të ushtrisë, quheshin: Kolë Mark Shini, Elí Maliziu e Marku i Matës. Ky i fundit zotëronte mbi pesëdhjetë katunde të Matës; ata dy tjerët ishin shtëpia të para në Shkodër. Në ushtri ishin edhe shumë gra, veshur si ushtarë, e që shoqëronin, me armë në dorë, burrat e tyre, e, pastaj, bashkë me ushtarë tjerë, hynë ndër barka.

Tivari, qytet bregdetar i Shqipërisë, ka afër një mal të lartë e të gjatë; në

rranzë të këtij mali, në anë prej detit, gjindet kështjella e Tivarit. Deri këtu kishte mbërrijtë ushtria turke, nën komandë të Isuf Pashës, duke marrë mbrapa shqiptarët (duke i ndjekur shqiptarët); këtu kishte rrethuar Gjonin me shokë të vet; ua kishte prë rrugën e s'linte të afrohej gjinden, që u kishte ardhur në ndihmë. Ndërkaq u erdh lajmi shqiptarëve, se barkat për ta ishin kaparue e mbledhur në liman të Pastroviqit, në tokë të Dalmacisë, që ishte nën sundim të venedikasve, e se aty prisnin gati për t'u nisë. Si i ranë në erë shqiptarët kësaj fjale, dualën prej kështjellës me armë në dorë, mësynë ushtrinë, i dhanë zjarr kështjellës, kaluan për mjedis të turqëve, duke bërë kërdrinë mbi ta, e u nisën të shkojnë kahë Pastroviqi. Ndërmjet Tivarit e këtij limani, në një vend ku flitet serbokroatisht, kalon një lum, që dikohet prej maleve të Perasit të Malit të Zi, mbushë /gati për herë/ me borë. Kjo ikje ka ndodhur në fillimet e pranverës. Duke mos pasë pra, për doresh as lundër, as farë mjeti me se ta kalojnë lumin, që aso kohe ishte breg më breg, e, në anë tjetër, duke dashur të bëjnë një të sjellur tepër të gjatë, d.m.th. të shkapërcejnë malet e Kotorrit, të bijnë nëpër Kroaci e Slavoni, duke e vënë vehten në rrezik të ndeshin kund edhe në armik, e pleqëruan dhe e caktuan [që ta kalojnë lumin, njashtu, zhyt e mby]. I ranë, pra, më not ujit, si të dëshpëruar; por humbën njerëz shumë shqiptarë. Çka mundi të shpëtojë, vajti në Pastroviq, ku u bashkua me ushtarë, që kishin ardhë përpara; u venduan me ta ndër barka dhe u nisën.

Gratë, pleqtë e fëmijët e kaluan më të parët detin; fill pas tyre doli edhe Gjoni me ushtarë e kështu u kapën te brigjet e Sicilisë. Kur bënë t'i njehin barkët e njerëzit e nisur, e panë, atëherë, se gjind shumë u kishin mbetur rrugës, diku prej sëmundjes, dike prej urije, sepse ishin nisur për ngut; vërtetuan edhe se shumë anije nuk ishin me të tjera: stuhia e detit i kishte pasë shpërndarë e kurrë më nuk u muar gjë vesh për to. Qanë sa qanë rreziqet (gjendjen), që i kishin gjetur e, pastaj, mbasi u këshillua Gjoni me krerë, mori rrugën për në Palermo, ku, aso kohe, gjindej mbret Ferdinandi. Para tij shqiptarët bënë vaj e i dëftuan se sa ngusht kishin ra, duke iu lutur t'ua ngjiste dorën e t'u ipte leje të zbarkonin të gjithë njerëzit.

Por mbreti, mbasi i njohu se kush ishin, nuk deshi kurresit t'i lërë që të dilnin në mbretëri të tija, duke drashtë mos t'i vinte ndonjë ngatrrësë prej turqëve; megjithatë, u ndihmoi me bukë. U dha urdhër, pra, të largoheshin prej andej, përndryshe, u tha se do t'i mbyste në fund të detit barkat e tyre. E shpalli këtë urdhër nëpër mbretëri të vet edhe çoi gjinden, andej e këndeje, për të pritur mos të guxonte kush të zbarkonte (të zhgarkonte) kund ndër limane të tija.

Me zemër të plasur, atëherë, u drejtuan kahë deti i Napolit; e,

mbasi e pleqëruan punën me shoqi shoqin, burrërisht, si shqiptarë, e vendosën të zhgarkojnë, me ditë ç'me ditë, në liman të Salernit; prej andej të shkonin në Napoli e, pastaj, (së fundi) në Romë.

Mbasi lanë përmbropa gratë e gjinden e papunë, të tjerët u vunë në rresht, si ushtarë, me flamur të Jeruzalemit e me ngjyrë të paqës, për të mos ngritë kend peshë, edhe u nisën. Zëvendësi i mbretit u bëri ballë e s'deshi një herë t'i lërë të hyjnë në qytet; por këta i thanë që mos të gabonte t'u bënte gjë, se kishin urdhrin e mbretit, Ferdinandit, që u jepte leje të zënë vend aty për ndonjë ditë. Përfaqësuesi ua lypi ta shohë dorën e mbretit, por, mbasi këta nuk kishin gjë me vehte, u shtrëngua t'i presë me forcë, aq sa shqiptarëve iu desh, atëherë, të qëndrojnë e t'i çelin shteg vehtes. Kështu, pra, në vend që të zhgarkojnë në Salerno, hynë brendë në Napoli, ku populli napoletan i priti bujarisht, duke i përshëndetur si miq e mbrojtës të fesë; u shënoi Kastelnovon, ku mund të zinin vend sa për një herë.

Gjoni, mbasi la aty me ta Kolë Mark Shinin në këmbë të vet, me porosi që ta njihnin të tërë si të ishte ai vetë, mori me vehte disa krerë e pak ushtarë e u nis të shkojë te Papa i shenjtë, mbërriti në Fondi, pushoi një ditë e, të nesërmen, mori rrugën për Romë.

I ra Papës ndër këmbë, e, me lot për faqe, i tha se ai ishte një i pafat që, për dymbëdhjetë vjet rresht, kishte bërë luftë për fé e se, para tij, gjyshi e i ati, Skënderbeu me të vëllezër, të helmatisur prej turqve, kishin dhënë jetën e gjënë e vet për t'i dalë zot kishës, e se, tash, ai kishte rënë fort poshtë e ishte i salvuar prej armiqësh të krishterimit, dëmtuar me robë (njerëz të vet), për detë, i mërguar e i panjohur në dhé të huaj, pa iu dhimtë njeriu të gjallë; madje as mbreti, Ferdinandi, nuk kishte dashë ta lerë që të zinte vend në tokë të vet; kështu ishte duke rënë ndër këmbë të mëkëmbësit të Krishtit për t'i lypë ndihmë.

Shenjtë atë papë i tha që të kthente tek të vet, në Napoli, t'i mirrte me të mirë e t'i sundonte me dashuri; sa për tjetër, t'ia linte atij, se ai do t'i ndreqte të gjitha punët. Edhe njëmend, papa i çon letër Ferdinandit e mbretit të Francës që ta emëronin Gjonin si mbret të shqiptarëve edhe t'u jepnin ndihmë njerëzve të tij.

Gjoni, me një shpresë të madhe në zemër të vet, u kthye e zuri vend në Kastelново, ku ndërtoi katër pyrgje, duke vënë në secilin shytin (stemën, emblemën) e shtëpisë së vet, sa për shenj, për t'u dijtë, kurdoherë, se ai e kishte ndërtuar atë godinë prej guri, mbasi Kastelnovi kishte qenë ndërtësë e vjetër dhe e ultë. Ndërtoi edhe një kishë të vogël, por fort të

hijshme, për kujtim të emrit të vet, ku deshi ta varrosnin, e shihet edhe sot e kësaj dite monumenti i tij mermeri për bukuri, rrethuar me shtylla guri të ardhur, e me pesë kandila, që rrijnë ndezë pa pushim. Në mur është fytyra e tij, pikturë greke, mbuluar me një pëlhurë, punë dore fort e çmueshme. Çelësin e kësaj kishe e mban kapelani grek i Napolit, i cili e ka në kujdes rojen e këtij vendi.

Për dhetë vjet ndenj Gjoni në Kastelnovo, pa pasë farë shqetësimi; por, për rrezik, lindën disa ngatërresa e hidhërime ndërmjet mbretërve dhe të vetëve. Shqiptarët, pa ndërruar kurrgjë, u mbajtën gjithmonë një; veç qenë shpërndarë, me familje të veta, nëpër mbretëri të Napolit e nëpër Sicilie. Mbas kësaj pune, mbreti i Spanjës i çoi ndihmë Ferdinandit, e, të dy së bashku, u vunë ta ndjekin për ta qitë jashtë prej mbretërisë së vet Gjonin me gjithë shqiptarë. Por, çka, se shqiptarët e qitun cekën të qëndrojnë me forcë e mos të luajnë gjurmën; u shtrënguan në Avelino, u dërguan shokëve për rreth, edhe e bën do luftë në Avelino e në Arianë.

U zmbropsën, pastaj, në Trebisacje, për të bashkuar gjinden, që ishte e shpërndarë nëpër Kalabri, edhe sa për një herë, zunë vend aty për do ditë. Porse, në anë prej Koriljanit, iu vu në shpinë Ferdinandit e ua behi pa pritë pa kujtuar. Gjoni, si u gjet në mjedis të dy zjarreve, dha shenjën për paqë, duke lypur, veç, që ta çonin punën te papa për ta pleqëruar ai bashkë me mbretër të tjerë të krishterë, e duke u dhënë fjalën se do t'i rrinte (do t'i përmbahej) vendimit të tyre. Edhe e lanë luftën. Pleqësia e papës ia qiti Ferdinandit e mbretit të Spanjës t'u paguante shqiptarëve shpenzimet e t'u lëshonte vende për banim, njashtu si të binin në gòdi ata vetë me shoqishoqin; Gjonit t'i lëshonin Shën Pjetrin në Galatinë me do vende të tjera; posë kësaj, t'u jepnin shqiptarëve barate e çlirime të dhetash e pagesash për doganë të hekurit; t'u ndihmonin me të holla, veçse shqiptarët do t'u shpërndanin andej e këndeje nëpër mbretëri të Napolit e të Sicilies (sikurse janë sot për sot); të bëheshin njësoj si vendasit e tjerë, as mos guxonin të themelojnë kund qytet, pa leje e pëlqim të Spanjës. . .”.

1866

Privilegjet (báratet), që qenë caktuar për kombin shqiptar, hynë për të bërë pjesë në mbretërinë e Napolit, janë këto që pasojnë të dhëna nga Alfonsi Lipariotëve, e të përsëritura në Pragmatikën e Karlit të Pestë në përkrahje të shqiptarëve që erdhën nga Kosova në mbretërinë e tij.

7. ALFABETI SHQIP⁶

Zanoret janë *a, e, i, o, u, y* [= ë], (si në *flyy* = flëë, flē, *myy* = mëë, më), *ú* [= ë] e pazëshme (si në *laja*, *dërδútín* = derdhëtin, derdhnin).

Bashkëtingëllore.

Buzore: e butë *b*; e fortë *p*; të aspiruara *f, v*.

Grykore të buta *g, x* [= ks], *j*; e fortë *c* [= k]; e aspiruar *ç* [= hj]; e butë (e shkriptë) *k*.

Të lëngëta (të buta) *l, m, n, r*; e butë (e shkriptë) *lh* [= lj] (si në *ðélhpyr* = dhéljpër, dhelpër).

Dhëmbore e hollë (e butë) *d*; e fortë *tz* [= c]; të buta (të shkripta) *ç* [= z], *ð* [= dh]; e aspiruar *Θ* [= th].

Fishkullore: e hollë (e butë) *s*; të ëmbla *sh* (si në *shpon* = çpon; *shcon* = shkon, kalon), *sg* [= zh] e ngjashme me *j* të frëngjishtes (si në *gcrasgd* = grazhd).

E aspiruar *h*.

1866

2.

⁶ *Alfabeto Nazionale, Rapsodie d' un poema albanese*, Tipografia di Federico Bencini, 1866, p. 16.

Zotni Kamarda, në *Gramatologjinë* e tij, punuar me aftësi, në faqen 299 shkruan: “De Rada dëshëron t’ia ngjesë vetjes së tretë të së pakryereve rrokjen *-neiose -nej*, si *klânej* për *klāj* [= qante]; ndonëse në veten e parë njëjës uniformohet në /dialektin/ arbëresh, si *mbâja*, etj. Por thjeshtësimi në mbaresën *-nej*, mund ta bëjë që të ngatërrohet [njeriu] në theksim me pësoren e shumë foljeve”. Tani unë, duke mbajtur mbaresën *-nej*, ndoqa, thjeshtësisht, përdorimin e /së folmeve/ arbëreshe /të Italisë/ siedhe prirjen e gjuhës /shqipe/. Në kolonitë arbëreshe të Italisë së Jugut, të cilat i kanë vënë gardh gjer më sot ndër në çdo depërtimi të jashtëm që mund t’u prishte gjuhën, ka dy dialekte, jo të lindura në Itali, por të bartura nga Shqipëria. Ndër foljet që mbarojnë me *-një*, njeri nga këto dialekte ka *-nej* e tjetri *-jë*; prandaj *puthinjë* [= puth, e tashme] diku ka *puthënej* e diku *puthëjë* [= puthte; e pakryer]. Këto dy trajta, sikurse ato dialekte, janë të përhapura edhe ndër rapsoditë e kësaj poeme, që është e njëkohshme me Skënderbeun dhe është përmendore e shqipes së pastër. Kështu, në vargun e sipërshtënuar, [foljet] éjulënej dhe *klanej* [= qante] nuk do të mund t’i zëvendësojmë [me format] éjulëjdhe *klaaj* [= klāj, qante], sepse do të humbte krejt metri [masa e vargut]. Në të gjithë dialektet, pastaj ndër folje me mbaresë tjetër, gati gjithkund është braktisur fundorja *-nej*; kështu *mbiel* [= mbjell] bën *mbilëj* [= mbillte], *thërrës* [= thërras] bën *thërritej* [= thërriste], e, në të rrallë, dëgjohet *mbilënej* [= mbillte], *thërritënej* [= thërriste]. Në qoftë se nuk do të merrnim trajtën e të së pakryerës [*puthënej*] dhe atë të së pakryerës së lidhore, atëherë lënia jashtë e këtyre dy të pakryerave do të shkaktonte që përdorimi i trajtave *mbilia*, *mbilie* [= mbillja, mbillje] do të ngatërronte vetën e parë me të dytën. E, në mjaft raste, kjo trajtë e cunguar ngatërron veten e tretë të së pakryerës me të dytën e urdhërores, si në *klaaj* [= klāj, qaj ti, dhe qante], *shtiiij* [= shtij ti, dhe shtynte]. Përkundrazi fundorja *-nej*, për të cilën miku im kaf rigë se do të ngatërronte të pakryerën e veprorës me atë të vetëvetores, nuk është e mundur në asnjë folje; për shembull veprorja ka /trajtën/ *lhanej* [= ljanej, lante], vetëvetorja ka *lhaghej* [= ljaghej, lahej]; veprorja ka /trajtën/ *puthënej* [= puthte], kurse vetëvetorja bën *puthej* [= puthej], etj.

8. SHQIPËRIA PËRBALLË EUROPËS⁷

Ishte kambana e vdekjes që urdhëronte mërgimin trashëgimtar. Kështu, mbasi u varros ai në Lezhë, etërit tanë çanë detin me vela të ndemë nga Italia, në mbretërinë e Napolit, të cilët qenë pritur prej mbretit të Aragonës. Por këta, për të mos tërhequr Turkun afër [për të mos e qasur Turkun pranë], patën frikë t'i presin; përkundrazi – tregon Kronisti – populli i Napolit, kur i pau se po shkonin tek ai me flamurin e Jeruzalemit të shpalosur mbi qiçin e anijes së kapitenit të parë, u hapi atyre portin, duke i brohitur (duke i thirrur) kampionë të fesë e shokë heroj “të Princit të Kalorësve të Mesjetës”, siç e quan Bajroni Zotninë e atyre. Qeveria frigacake, nga Napoli i shpërndau, pastaj, nëpër krahina, duke i detyruar të mos bënin qytete; por ku ngulnin plang, vendi që i rrethonte tregonte për ta nderimin e mikpritjen e përzemërt të vetën. Sot jemi endë, ndoshta, 100.000 frymë si numër; kemi një Kolegj, themeluar, më 1736, prej shqiptarësh, me nxitjen e ndihmën e Selisë së Shenjtë, të cilin, deri sa nuk qe grabitur autonomia kombëtare, e bekonin banorët italianë të krahinave për rreth. Aty, së pari, Jul Variboba i kolonisë së Mbuzatit nisi sundimin e vet për gjuhën e vendlindjes, ndërsa shoku i tij, Gjon Françesk Avati nga Maki, bënte të parën mbledhje të këngëve popullore, që gjyshërit tanë kishin shellë me vete prej Shqipërisë e prej Moresë. Variboba ishte bir i kryepriftit të katundit të vet, e nëna e tij e kishte emrin Vasha Kanadë. Botoi Jetën Nënës së Zotit, në vargje shqipe të rimuara e me masa të ndryshme, në vitin 1762, në Romë. Ai libër është një pasqyrë besnike e kolonive tona në kohën e tij, të varfëra e të papërlyera; e fytyra e Virgjreshës së shenjtë lartësohet (del) në mes të asaj jete të pagëdhendur, por plot dashuri, si ideja e fisnikërisë së trashëguar të gjakut shqiptar, që i është varfëruar. Realiteti është kaq i gjallë, që bie,

⁷ *L'Albania in faccia all'Europa*, L'Avvenire, Francesco Tripepidi Carlo, Corigliano Calabro, nr. 25, 26, 27 agosto 1880.

ngandonjëherë, në grotesk; por prania e Hyjneshës shumë të pastër i lë groteskut tërë pafajsinë e patëkeq. Është mëkat që rima e ka detyruar të përdorë shumë fjalë italiane. Frymëzimet e tija të devotshme, qysh prej kohës së tij, u bënë popullore, por i sollën dëm traditës atdhetare e rreptësisë së fesë.

Shumë interesante, jo vetëm për Shqipërinë, por për Europën e kulturuar, është poezia kombëtare popullore, e bajtur në shekullin XV nga Mëmëdheu në Itali e që mbet gjallë si një jehonë e Mesjetës lindore.

“Përsosmëria shumë e lartë e kësaj poezie, e cila i përkiste një kombi që, atëherë, ishte bërë mburojë e Europës së kërcënuar nga Turqit, e bëri të shkojë e të përhapet kudo që mund të kuptohej. Ushtimat e saja përsëriten ende si në këngët e popullit sllavo-ilirik, që është në kufi me Shqipërinë, ashtu edhe në idilet popullore italiane të Kalabrisë sonë; e kënga popullore greke, siç paraqitet e mbledhur nga Fauriel, është, pjesërisht, një tepricë e shembëllesave dhe e krijimeve të poetit tonë, mbeturinë e grisur, me të vërtetë, e në të cilën nuk duken më qëllimet poetike.

“Por vlera e dobishme që ka për ne, është pikturimi i jetesës së vjetër shqiptare, në të cilën, së bashku me thjeshtësinë e rreptësinë pellazge, përzihej edhe një refleks i madhështisë bizantine; është shpirti i kombit, që fryn brenda, i krishterë e me shpresë [me besim]. Në kolonitë e Italisë shtëpitë tona, të cilat janë larg ndikimit të jetës fisnike të qytetit, marrin çdo edukatë nga ato këngë popullore fisnike. Pastaj, për të gjithë, [poezia popullore] është monumenti më i vjetër i gjuhës sonë, e një model i madh stili të thjeshtë e të fuqishëm; sepse, në qoftë se, aty-këtu, vihen ré fjalë italiane, përveç që nuk fyejnë anën formale sintaktike të gjuhës, qëndrojnë si shenje të lidhjes në zanafillë të popujve e, pastaj, të lidhjeve të çdo lloji që bashkuan, në mënyrë të qëndrueshme, të dy popujt.

Mbasi që ato rapsodi qenë mbledhë, besnikërisht, nga tradita gojore, e botuar me anën e shtypshkronjës së Bençinit në Firence, *Guida* e Torinos shprehu me këto fjalë ndjenjën që nxitën për qark: “Gjuha shqipe nuk mund të mos ketë gjurmët e diturisë së lartë, përse mund të gjykojmë nga krijimet sublime poetike, që soditëm, duke lexuar *Rapsodi të një poeme arbëreshe*, mbledhur në kolonitë e krahinës së Napolit. Është një puhì misterioze, një aromë e këndëshme hyjnore poezie lindore e të ré, me të cilën italianët nuk kanë asgjë që

të mund të krahasohet, nga gjithë sa, prej shumë kohësh, ka dalë prej fantazisë e prej zemrës së poetëve tanë, etj.” Edhe para botimit Bençini, princesha rumune Dora d’Istria, me zanafillë shqiptare, në *Revue des deux Mondes* i kishte dhuruar publikut, në një studim të gjerë të kolonive të Italisë, një dhe një tjetër nga më fisniket e atyre poezive. Po ashtu, ajo e para kishte shtruar çështjen shqiptare, duke u bërë qendër, në të cilën u vërtitën, dhe u bashkuan [ndjenjat] e dashurisë për atdheun e përbashkët, të bijve të shpërndarë të Shqipërisë.

Tash së mbrami, u duk në *Ausland* të Vjenës nga Baronesha Gjyzepina Knorr një artikull i shkruar për këto rapsodi; dhe e riprodhuan shpejt *Posta* e Napolit dhe *Vero*-ja e Kozencës. Është një studim mendoj /i shkruar me shumë/ mençuri dhe me dashuri. Ajo Zonjë e ndritur ia kishte bërë të njohura, më parë, Gjermanisë nëpërmjet përkthimeve të përziera me poezitë e veta gjeniale /të hartuara me mjeshtri të rrallë/ e të thella. Edhe artikulli i *Ausland*-it është i paraprirë nga lajme të shkurta, por të sakta, rreth emigrimit tonë në mbretërinë e Napolit e të Siciliasë.

Kjo poemë tërhoqi, me të vërtetë, vëmendjen e Europës së qytetëruar mbi fatin tonë të ri, të bajtur pa ankim. Dëshën të na njohin për së afërmi. U hulumtua burimi ynë; u muar parasysh pjesa e ideve botërore që mbanim në shpirt, e, para së gjithash, gjuha që flisnim.

Përsa i përket gjinisë sonë, vëzhguesve të parë iu duk, menjëherë, sikur të kishin përpara gërmadhat e një lashtësie madhështore të nderueshme dhe që thënë se kombi shqiptar në Europën e tanishme është një përmendore e botës së vjetër.

Njimend, duke u nisur prej kohëve historike më afër nesh, gjejmë se shqiptarët, qoftë në vendimet mbretërore, qoftë në letrat e papëve, mbaheshin për Epirotë e për Maqedonë. Ndër kohët e veta, Halkondila, që ka jetuar në oborrin e Bizancit, (nënshtetas të të cilit ishin Ilirianët dhe Dakët) e që mundi të dëgjojë njerëz të atyre provincave, sipas rastit, që mblidheshin në dhomat perandorake, la të shkruar: “Treballet, Mizët, Ilirët, Kroatët, Polonezët, Sarmatët kam mundur të di se flasin të njëjtën gjuhë [sllave]. Por do të thoja, me siguri, se Shqiptarët janë të lidhur me Maqedonët e jo me tjetër fis të tokës së banuar”. E Meletoi, në Gjeografinë e vet, thotë: “Shqipëria është pjesa perëndimore e Maqedonisë”. Kjo, dikur, në kohët parahistorike kishte emrin Emathia; *emathia*, emër emfatik shqiptar, don të thotë: “*E madhja, e gjera*”.

Tashti, me kërkimet e Fallmerayer-it, që zbuluar se emri i shqiptarëve

ndonjë vëzhguesi i ngeli “si kafsha kur vihet në dyshim”, ai emër është i treguar nga një kod aleksandrin i shekullit II i erës sonë, si emër i përveçëm i një fisi që banon në mes të Ilirisë dhe të Epirit”. Por, tashmë, kurrnjë gjurmë – thotë Thungmann-i (në veprën e tij “*Gjurmime historike mbi popujt lindorë të Europës*”) – “as shumë e vogël nuk gjindet /që të flasin/ për emigrime shqiptarësh në selitë që zënë; përkundrazi: ata duket se kanë qenë banorët e hershëm të vendit të vet”.

Mbas vëzhgdimesh të kujdesshme të filologëve të ditur, sot është bërë e qartë se Aleksandri, bir i një Maqedoni e i një Epirotoje, dhe se Pirroja, mbret e prîs i Epirotëve, kanë folur shqip, siç ishte, prej kohësh, në ndërjegjen tonë kombëtare, e siç e dinin edhe popujt bashkëfqinj. Për Aleksandrin e vë në dukje edhe Kuint Kurci, kur tregon se, i fyer prej prijsave helenë, që e kishin ndjekur në Azi, iu drejtua në gjuhën e vet maqedonasve të tij, duke i nxitur që t’i ndëshkonin. E Plutarku, në *Jetën e Pirros*, thotë se në Epir ishte një tempull, kushtuar Akilit, me emrin kombëtar *aspeto*, që aludon (shkrep, çek) te homerishtja *më i shpejtë*; por kjo fjalë jeton ende sot në gjuhën shqipe: *ishpët* don të thotë: *i shkathhtë, i shpejtë*. Kombi shqiptar, pra, është ai që të vjetrit e njohën si banues të Epirit e të Maqedonisë, e veprimi i të cilit pat aq fuqi të madhe mbi botën e vjetër, dhe i cili [komb], ashtu i vetëm, përmes mundimesh të çdo lloji, qëndron ende me tiparet e tij të hershme përballë kohës.

Mbasi Rusia u armiqësua, Qeveria greke shtini në punë artin e të ngatërruarit, duke shpresuar *ta elenizojë*, e shpejt prej miqsh të vet, e në atë Paris, që krenohet se është seli e dritës europiane, u tha se “Komb shqiptar nuk ka”. Kjo natyrë ngatërrtare e Qeverisë helene nuk difton, për të, shumë urti, edhe sikur të mos i interesojë tepër drejtësia e morali; ndërsa duar e zemra shqiptare kanë themeluar mbretërinë helenike”. “Ishin kleftët e prisat shqiptarë, që i përkitinin ritit ortodoks, që i jepnin Greqisë së re herojt më trima të luftës së pavarësisë. Boçarët, Karaiskaqët, Xhavellat, Gurajt, Miaulët, Konduriotët, Tombazët, Vulgarët e shumë luftëtarë të tjerë ishin shqiptarë që rrokën çështjen e Greqisë, të prirë nga shpirti i tyre luftarak – lakmues për aventura e për luftim – e përveç këtij nga besimi që e kishin të përbashkët me Grekët”. Por, nëqoftëse se Helenëve u lejohet të jenë mosmirënjohës, ata mund t’i dëmtojë shumë shestimi (plani i tyre) për të shkatërruar emrin shqiptar

kudo ose me çdo mjet që ata kanë mundësi; ndërsa mbretëria helene një të tretën e banorëve të vet e ka popullsi shqiptare. “Shqiptarët janë, sot, të shpërndarë në të gjitha pjesët e Elladhës e të Peloponezitet; banojnë në Etoli, në Akarnani, në Laokoni, edhe në Meseni. Në Atikë, në Megaridhe, në Agrolidhe e në Becia janë në numër më të madh se Helenët. Pastaj janë të banuar vetëm nga Shqiptarë ishujt e Hidrës, Specias, Poros dhe, edhe, të Salaminës”. E, me siguri, është plagë e thellë në shpirtat e këtyre vepra për t’i shpërndarë (për t’i zhdukur) nga faqja e dheut, për të cilën gjë përpigjet vetë qeveria.

E, pra, Helenë dhe Shqiptarë kishin motit të jetës seli e fate të përbashkëta e, endë, sot ai bashkim është si i vetmi shpëtim i vërtetë dhe i qëndrueshëm për të dy.

Origjina e lartë, edhe nëqoftëse, rastësisht, mbron vetinë e mirë të një fisi që nuk e ka fatin e mirë të popujve të tjerë, nuk është, gjithashtu, një titull i fuqishëm për të siguruar simpatinë efektive të popujve që ka përreth. Ajo, për të cilën interesohet sot bota, është pjesa e historisë së kohës së parë që, gati si gjurmë e kujtimeve të ngjarjeve njerëzore të shënuara, mbetet, asgjamangut, mbresë në gjuhën tonë.

E, para së gjithash, tashmë, është sqaruar se emrat e hyjnive të politeizmit helen, të huaj për gjuhën greke, janë fjalë shqipe të fuqive të natyrës, të cilave ato hyjni u qëndronin në krye. Do të çekim pak shembuj; *Zhëa* e *Zhëna* *lëzja* e *zëna* në shqip kanë kuptimin: *shpirt* dhe *fillim*: *dëti* don të thotë *dët-i*; *i dhesti* ka vështrimin *zjarri* i *ndezur*; *athëna* d.m.th. *fjala*; *dieli* = *dielli*; *bàna* = *prodhimi* etj. E këto fjalë kanë mbetur emra të *Zeas*, *Zeusit* (Jupiterit), të *Thetis*, hyjnesha e detit, *Ifesto*, zoti i zjarrit, *Athëna*, hyjnesha e gojtarisë, e ligjërimit (e elokuencës), *Dielio*, perëndia i dritës, *Diana*, hyjnesha e të lindurit, etj. Ata [emra], nga njera anë, dëshmojnë për kultin që ka ekzistuar më parë të Zotit e të natyrës, e, nga ana tjetër, vinë si kumbime të një populli që ndonja njëmijë vjet përpara andropoformizmit mitologjik, që i fuqishëm në tokë, e nga i cili Helenët muarën besimin e emrat e shenjtë.

I prekur nga ky fakt, Hahni i ndritur kërkoi përmes të dhënash të tjera, të cilat kishin mbetur, të gjente ndër kombet e lashtësisë shumë të hershme atë komb të cilit i përkiste gjuha, me anë të së cilës shpjegohet tashti miti i perëndive të Elladhës. Me këtë, si me trungun e vet, do t’u lidhte familja shqiptare, me të cilën vazhdon ajo gjuhë.

E në librin e vet monumental (*Studime shqiptare*, botuar në Jena, më 1853/1854) konkudonte: “Me arsye mund të nxiret përfundimi se Shqiptarët përbëjnë bërthamën e kombit të Tirrenëve e të Pelasgëve, tepricat e të cilëve jetuan në Itali e në Traki deri në kohët historike”.

Gjurmimet e Hahn-it, pastaj, qenë shtyrë prej L. Benloew-it, i Universitetit të Francës, deri atje ku rrenimet e asaj bote të vjetër mund të shikohen endë brenda në jetën e tanishme. Ndër librat e vet të përmendur (të shquar) *Greqia përpara Grekëve* dhe *Analizë e gjuhës shqipe*, të botuar me radhë më 1877 e 1879, ky dijetar shumë i thellë e me njohuri të gjera mudi të shënojë krahinat e banuara nga folësit e shqipes, dhe, bashkë me këtë, të ngulisë formimin e kësaj gjuhe origjinale, në një kohë përpara ndarjes së gjuhëve aziatike.

Para së gjithash, ai pyet: “Pelazgët e, ndër ta, Tirrenët, Licët, Kaukonët e Dardanët, ndërtues të mëdhej ledhesh, ndërtues të mëdhenj pyrgjesh, a nuk ishin ata stërgjyshërit e malësorëve të Epirit, që, edhe sot, shpërngulen grumbuj-grumbuj, për në Greqi e për në Azi të Vogël, duke shitur me pagesë forcën e krahut të vet për të lartësuar ato mure, më pak o më shumë vigane, po më pak të qëndrueshme se ato të kohës së lashtë, por që u përngjasin atyre në papërsosmërinë e ecjes përpara të artit?”.

Duke marrë parasysh, pastaj, hyjnitë pellazge [nga pikëpamja e ngjashmërisë së tyre], ai [Benloew] zë në gojë fjalën *Dhëmetër* (Cerere), një statujë të shtrirë për tokë, që adhurohej në Dodonën pelazge; dhe kujton se si priftërinjtë e Delfit, në shekullin VIII para Krishtit, e këshillonin Likurgun të ndërtojë, për forcim të kushtetutës së ré, dhënë Spartës, një falëtoze *Zhea Ellanio-s* dhe *Athene Ellania-s*. *Dëmeter* është fjalë shqipe, që don të thotë *masë e tokës*. Vendosja e shembëllesës përputhej, kështu, me emrin, për të shpjeguar mitin e Hyjneshës së bujqësisë, me qenë se kjo ka në themel masën e ndarjen e arave.

Edhe *i ljëën*, *e ljeen* /= *i ljënë*, *e ljenë*/, ndër disa dialekte *i ljaan*, *e ljaan* /= *i ljanë*, *e ljanë*/, janë fjalë shqipe, që donë të thonë *i dalur jashtë përdorimi*, *i vjetëruar*. E në na shkon, shpejt, nëpër mend se orakulli i Zotit e këshillonte Likurgun të përtërinte *Kultin* e lashtë /hyjnderimin e vjetër/, *Athenën* e vjetër ose fjalën e jetës; gjë të cilën ai edhe e bëri.

Këtyre dhe qindra rezonancave të tjera fetare Benloew u shton emrat shqiptarë të vendeve, të cilët ishin të qartë në kohën e lashtësisë, e shumë larg ndërmjet tyre, e vë, me siguri (me bindje), tezën e guximshme “se

banorët e Greqisë, para ardhjes së Helenëve, kishin qenë stërgjyshërit e Shqiptarëve, që, në atë kohë të largët, kishin mbuluar truallin e vendeve, që shtrihen nga Adriatiku e deri në Halys”.

Pastaj, duke ardhur te caktimi i atyre fiseve, Straboni, pas Homerit, ve Pellazgë, Lelegë e Kaukonë në të njëjtën vijë. Në shikimin e parë, Pellazgët e Lelegatët duken si dy popuj që e ndanin, në mënyrë të pabarabartë, Greqinë, ishujt e brigjet e Azisë së Vogël. Ai, përkundrazi, i mendonte Lelegët si banorët e hershëm të të gjithë vendit, kurse Pellazgët e Greko-Pellazgët - të lindur nga shkrirja e Grekërve me vendasit. Shkrirja e dy racave, në të cilat elementi helen pat fituar zotërimin, bëri të lindë një poezi e një art, për të cilët banorët e vjetër, të shtyrë ndër male, qëndruan të huaj qysh prej fillimit. Por, përse u takon Pellazgëve, janë ata tek të cilët gjaku Leleg zotëroi në atë shkrirje; e Homeri na ka treguar se Pellazgët, Lelegët e Licët, aleatë të Trojanëve e të Dardanëve, /ishin/ të gjithë të përfshirë në të njëjtin rreshtim dhe ishin barabar armiq të Helenëve. Të gjithë këta popuj kanë folur një gjuhë të ndryshme nga gjuha greke, por në të cilën kishin mundur të depërtojnë mjaft fjalë greke. Helenët, nga ana tjetër, e njihnin këtë gjuhë me përpikmëri /tamam/ si Grekët e sotëm që çuditën duke dëgjuar Shqiptarët për rrethe.

Kjo teori vetëm shpjegon çastet historike të botës helene: e, në-çoftëse dijetarë të shquar, si Benloew, duke u shoqëruar me Shqiptarë të mësuar /të arsimuar/, do të vizitonin /o të shikonin/ viset ku ishin selitë e Pellazgëve, e do të gjenin, gjithënjë, shumë vende të banuara nga Shqiptarët, parashikimi i tij do të kishte një provë materiale të pakundërshtueshme e të qëndrueshme.

Por ai gjen diçka shumë të pëlqyeshme në këtë që, disa trajta gramatikore, disa fjalë qenësisht shqipe, u shartuan me të folmet e njerëzve, të cilët më vonë hynë në atë ambient të një vendi që ai (Benloew) ka caktuar. Janë shenja gjuhësore të cilat bëjnë që të dallohen në mes tyre, disa gjuhë nga ato të tjera të afërta ose të një gjinie. Vllahishtja – vë në dukje ai – është e vetmja nga gjuhët neolatine, siç është bullgarishtja, një nga gjuhët sllave, që e venë nyjen shquese pas emrit, ashtu sikurse shqipja, e cila, për këtë arsye, dallohet në dy lakime, në të pashquarin dhe në të shquarin. E, me të drejtë, ai nxjerr përfundimin se prej Shqiptarëve u ka mbetë gjuhëve rumune dhe bullgare, që erdhën në vendin e tyre, për të cilat ky shenj ishte i huaj në fillim.

Përse i përket elementit leksikor, do të shënoj dy o tri vërejtje të qarta

e me rëndësi kryesore për vërtetimin e mendimit të gjuhëtarit të madh frëng. Rumunët e Italianët, së bashku, kanë *tata* (im àt); tani, rrënja e kësaj fjale duket qartë se është shqipe *at* (babë). Italianëve, pastaj edhe Helenëve, u ka mbetë /së bashku me fjalën/ *at*(babë) edhe rrënja tjetër shqipe ëëm (= ëmë, nënë), e cila është vazhduesja jonë *m'ëëm* (= nëna ime), e rregulluar në *mëma* e tyre. Rumunët ruajnë edhe *sis*sa e Italianëve *zizza* (= cicë); por edhe këto janë prej rrënjës shqipe *sis* (sisë, cicë e qumësht), prej nga vjen folja *drosissèen* (me dhanë qumësht); por *sis* te ne tregon vetëm qumështin e gruas ndryshe nga *kjumshti* që tregon çdo *tambël* tjetër; për mënyrën e njeriut që jep frymën e fundit, thomi *vëdes*, kurse *possovissèn* difton vdekjen e shpirtrave tjerë të gjallë.

Gjithmonë e më tepër, duke iu sqaruar përpara rruga, sa më thellë merrte parasysh gjuhën, të përdorur si pishtar të vetin, Benloew arrinte rezultate tjera të reja e të gëzueshme për gjuhësinë në përgjithësi. Ajo çka më përpara ishte pranuar nga më të shumtit, do me thënë se shqipja ishte e familjes ariane, prej tij është kufizuar në kuptimin se, të përbashkëta me këtë, ka, me siguri, ndryshimet fonetike që ndër emrat, shenojnë rasiat e numrat e ndër foljet – vetat; porse ndryshon për nga rrënjët e njerës palë e të tjetrës, që endë e kanë të plotë kuptimin e parë, siç i ruajnë gjuhët turanike, me të cilat më duket se afrojnë gjithë ato fjalë të përbëra në mënyrë të ndryshme me fjalë të plota.

E, nga ana tjetër, ai vë në dukje shenja të qarta e të qenësishme, që janë të veçanta për gjuhët semitike, siç janë, p.sh. nyjet e prapashitesuara (prapavënëse) për emrat, e ndërrimi i zanores themelore që, shpërndamas, ndër emra shënon ndërrimin e numrit e, në shumë klasë foljesh, tregon ndryshimin e kohëve e të vetave. E, duke u nisur edhe prej fondit njërrrokësh, nga i cili kjo gjuhë zhvillohet, e fjalët e sipërshtënuara të së cilës *at / ëëm* - japin fillimet, e ndryshme të të folurit njerëzor, ai ia nënshtronte, më 17 maj 1878, Akademisë frënge tezën e tij se gjuha shqipe ishte në stadin e tranzicionit. Më përpara, kishte shprehur bindjen e vet se Shqiptarët, bashkë me Baskët, janë banorët më të vjetër të Europës. Për sa u takon fjalëve *at / ëëm*, kemi një *t*, që lidhet me *a*-në e theksuar; *T*-ja [te fjala *at*] shpreh diçka të fortë e burrërore; kurse tingulli *m* [në fjalën *ëëm*] i ndjekur nga një *ë* e gjatë shpreh diçka të butë femërore.

2.

E, sot, Aeropagu europian është ftuar të dekretojë në se duhet të jetojnë më /shqiptarët/ apo në se duhet të zhduken. Pyetja që shtrohet, është kjo: Nëqoftëse Greqia – thonte Krispi në parlamentin italian – ka përfaqësuar e, në mënyrë, të shkëlqyer popujt që ka fqinj e farë-e-fis, është e drejta e saj që t'i asimilojë (t'i përnjisojë, t'i bëjë për vete) dhe t'i thithë (t'i përpijë). Ne nuk e kemi mendjen të vemë në dukje sa i pavend është ky gjykim i marrë për një njeri, që u maskua me parimin e së drejtës së kombësive, e që, për fat të keq /është shqiptar dhe bile/, edhe shtëpinë e vet e ka të vendosur në kolonitë arbëreshe; vetëm na shqetëson mendimi se njerëz të tillë, që flasin edhe me fjalët që kanë dëgjuar rreth e rrotull, duan /të veprojnë/, kështu, gjithmonë, sipas dëshmimeve të atij, të cilin e besojnë të fuqishëm, përsa u përket pushtetit dhe të hollave. Dhe ja, në fakt, Franca dhe Italia e, madje, deri Qeveria angleze tregojnë se venë çdo politikë të jashtme në ekzekutimin e pjesëve më absurde e të interpretuara keq të Traktatit të Berlinit.

Njimend, artikujt e këtij traktati nuk patën një qëllim të vetëm, kryesor ose të haptë, prandaj nxjerrja në vetvete e qëllimeve të ndryshme, që një shtet ose një tjetër, mund të tentojë, do t'i përçajë këto dhe do t'i zbulojë armiq.

Ajo çka u duk, atëherë, se duket prej të gjithëve, forcimi i Turakisë, cenohet sot haptas prej Fuqive që, pa mundur të nxjerrin me të vërtetë të drejtën prej atij traktati, i lypin vende jo greke për t'ia dhuruar Greqisë. Nga ana tjetër, fiset e vendosura në Ballkan, të cilat iu shkëputën Turakisë, duke u lënë të pabashkuara e pa dinjitetin e duhur për sundimin e plotë të vendit të tyre, tashti diskutojnë proteksimin e perandorive fqinje. Sa për krahinat që i kanë mbetur Portës së Lartë, në vend që t'i ndërtonin, për t'u dhënë atyre paqë, në zhvillim të lirë autonom, bashkuar nën një perandori të vetme, të cilën ta mbanin për të mirat që do të kishin, siç është në Austri, ose sikurse në Angli, u ndanë [krahinat e Shqipërisë] sipas vullnetit të Ruisë. E, duke mos u barazuar, iu dhanë privilegjet më të pabesat [Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë, Greqisë], për demoralizim dhe fyerje ndaj të tjerëve [shqiptarëve]. Së fundi, mbi Kombësinë më të plotë e më fisnike ndër to, që i mbet besnike detyrës, u nxitën dëshira të këqija fqinjësh. E sot duan ta venë Turkinë në mes dy udhësh: ose ta shohin atë të gjakosur prej pushtuesve, arësyeja e të cilëve është lëshimi /i tokave/ që u është bërë asish që nuk kishin mbi të ndonjë tagër, ose ajo vetë do ta cenojë në besnikërinë e në të drejtën e saj. Dhe, në të dyja

rastet, do të përfatitet rrënimi i saj dhe do të sheshohet fusha për luftën e kombeve.

Qoftë vetëm ajo që, tashmë, u duket syve të shumicës, e shtypur prej oligarkisë së koalicionit, do me thënë se punët e reja lëvizin në mbështetje të skenave që janë afër mbylljes, është gjithmonë e vërtetë që as këshilla të ngushta, as të rënda e morale nuk i vënë në gódi, sot, shtetet europiane.

3.

Përsa i përket punës sonë (çështjes sonë), diç se Shqipëria, me qëllim që të vëhet nën tutelë popujsh të qytetëruar, Europës i paraqitet si barbare me zakone dhe e paaftë përsa i takon lavrimin të gjuhës. Këtë e thonë pikërisht ata që favorizojnë Greqinë /e grekërit/, të cilëve u bëjnë jehonë mediokritetet servile që e gjykojnë qytetërimin luksin e jashtëm barbarik e për të cilët virtyti i thjeshtë e gjykimi burrëror nuk vlejnë asgjë. Është fatkeqësi e jona që nuk njihet Atdheu ynë, as nuk njihemi ne vetë; por, në qoftë se lejohet të argumentojnë nga vendi i zënë me dinjitet e nga veorat e bëra prej shqiptarëve, në Turki e në Greqi, deri më sot, e nga vendosmëria e urtë dhe atdhetare, që i ka mbledhur nën flamurin e lavdishëm të etërve, shihet mirë se ata nuk janë bij të prishur të pellazgëve hyjnorë. E, ata të pakët, shkrimet e të cilëve mërrijtën deri tek ne, Vasa Efendi, Konstandin Kristoforidhi, Panajot Kupitori nga Hidra e Thimi Mitko, për njohuri të ndryshme, për gjykim të drejtë e për dashuri të fortë ndaj Mëmëdheut, qëndrojnë në nivel të kulturës së Perëndimit.

Por një Kolegj kombëtar, autonom deri më 1860, solli ndër në një lulëzim të pasur intelektual. Ka nga Ngulimet (kolonitë) njerëz politikë, gazetarë, letrarë, juristë, me të cilët Italia nderohet (krenohet); e shumë nga ata që kanë lindur ndër këto ngulime, zënë vende të larta në shtet, në ushtri, në arsim (në shkollë) të mbretërisë. Këtu, përveç studimeve serioze e shkencore për filologjinë shqiptare, etj., si *Gramatologjia* e arbëreshit sicilian Kamarda e *Gramatika* e Zef De Radës, që tërhoqën vëmendjen e dijetarëve të huaj mbi tërë kombin, u lartësua, së pari, e me sukses (në vepra poetike, sot, të njohura në Europë e që paraqesin kohën, në të cilën Shqipëria ishte e lirë dhe e bashkuar) hovi e fuqia e gjuhës amtare, të cilën At Fra Anton Santori i kolonisë së Shën Katerinës e sillte, pastaj, në prozë në veprën e vet *Sofia e Kominiatëve*. Ky poet gjenial do t'i lërë Shqipërisë, për ditët më të mira që e presin, dy

përmendore, të cilat nuk do të vdesin, që ngjarje shumë të trishtueshme (të këqija) nuk e lejuan t'i qiste në dritë: një dramë për ekskursionin mizor të Fumelit në krahinën arbëreshe, ku ai është lindur, e një roman në prozë. Protagoniste e këtij romani është një bijë princëresh shqiptarë që, nga një stuhi deti, hidhet në Kalabri, mbushur me koloni të bashkatdhetarëve të vet, jeta e së cilës e, bashkë me të, edhe ajo e italianëve për rreth, është dhënë prej tij /d.m.th. prej Santorit/ me vërtetësi karakteresh e me frymëzim të paparë ndër romane.

E, në qoftë se, për së shpejti, siç është mendimi, do të themelohet nga aksione të bankierëve shqiptarë e filoshqiptarë, e para gazetë shqiptare filoshqiptarë, e para gazetë shqiptare (që, në botim të dyfishtë italisht-shqip e shqip-helenisht, për të kënaqur tregun e gjerë, të botohej në Shkodër o edhe në Trieste e Venedik), shpejt, për nevojat e punëve të tashme, do të hapet përdorimi i saj që këtu mbet në heshtje, por që ishte e përgatitur prej kohësh. Në anën tjetër, prej këtyre kolonive do të njihen, me sot e me nesër, vepra letrare, të cilat, për origjinalitet e fuqi jete, të shprehur mirë, do të krahasohen me gjithçka është shkruar nga Helenia motër mbas rilindjes /së vitit 1821/. “Kështu, bota e kulturuar të bindet për atë çka në parandjenim, qysh prej shumë kohësh, se Greqia do të mund të ringjallet vetëm nga dega e birënisë së parë, dega pellazge, në të cilën qëndron burrëria e plotë, avantazhi i numrit [të popullatës] pastërtia e gjuhës dhe e meta e një kulture së hollë e të moçme, gjithmonë e dëmshme për lirinë origjinale të mendjeve të larta”.

gusht 1880

9. ALFABET KOMBËTAR⁸

Sipas këshillit të filologëve të ditur, duke hequr ndonjë shkronjë greke, përdorur prej nesh, më përpara, e duke pranuar pak shenja artificiale, i jemi përmbajtur më tepër alfabetit italik dhe përdorimit të tij, me qëllim që, më së pari, të pasqyrojmë krejt pjesën fonetike të shqipes së folur të Kolonive /arbëreshe/.

Zanore: *a*, *e*, *ē* (*mēn* = mën; *mēē* = mëë, më); *ë* e shurdhët (*e* pazëshme), *e* aftë të tingëllojë në *e* dhe në *ē* (*vachēt* = vakët, i vokët), si e pasqyruar me anën e apostrofit, edhe gati të zhdukur; *i*, *o*, *u*.

Bashkëtingëllore: *b*; *c* grykore /*c* = *k*/, përpara zanoreve *a*, *o*, *u* ose për bashkëtingëlloren *h*, kur i prapashtesohet asaj: *caa* (= kaa, ka: folje “me pasë”); *chē?* (= kë?); *c* gjuhore gjithmonë /*c* = *ç*/, me përjashtim të rasteve të sipërshënuara (*cē?* = çē?; *ciaan* = çiaan, çan, nga folja “me çà”; *vic* = viç); *kj* qellëzore /*kj* = *q*/, tingëllon si *x* e greqishtes përpara *ε* /*ε* = *e*/ (*kjift* = qift, sqifter; *pikj* = piq, nga folja “me pjekë”);

- *d* e fortë (*dii* = di; unë di); *dh* e ëmbël (*dhii* = dhi); *f*;

- *g*; sikur *c* /*c* = *k*/ grykore përpara zanoreve *a*, *o*, *u* ose për bashkëtingëlloren *h* që i prapashtesohet asaj (*igool* = i gōl, i hollë; *cràgh* = krah); *g* gjuhore gjithëmonë, me përjashtim të rasteve të sipërshënuara (*giavidhe* = xhavidhe, guackë deti; *giig* = xhixhë, pjesë, pjesëzë, xixë zjarri); *gj* qellzore, krahaso me italishten *veggia* /*ve* = *vegim*/ (*gij* = gjí; *giègj* = dëgjo); *gc* grykore, e përforcuar përpara zanoreve *a*, *o*, *u*, ose për shkronjën *h* të prapashtesuar (grupit bashk. *geh*, *gcuur* = guur, gur-i; *gchrasgd* = grazhd); *h* grykore e aspiruar; krahasoje me *ha* /të së folmes/ puljeze /të italishtes/ (*vettèhee* = vetëhé, úni; *ivapft* = i varfër); *j*.

- *l*; *lj* e njëjtë me italishten *gl* te /nyja/ *gli* (*ljèe* = ljë; lënë, nga folja

⁸ *Alfabeto nazionale*, La Bandiera dell' Albania, anno 1, nr. 1, p. 1, Corigliano Calabro, 20 luglio 1883.

“me lanë”; *dilj* = dil, nga folja “me dalë”); *m, n, ñ* e barabartë me italishten *gn* te /fjala/ *degno* /= i denjë/ (ñē = një; *bēñ* = bënj, bëj); *p, q, r, s, š*, që tingëllon si në italishten *sc* te /fjala/ *scena* (= skena) (*vaš* = vash, vashë, vajzë; *šcon* = shkon, kalon).

- *t;th* që tingëllon sikurse /shkronja/ *v* e greqishtes (*thòm* = them; *gìth* = gjithë); *v; x; z* e njëjtë me /shkronjën/ *z* të italishtes, në *orazione* /= lutje, uratë, ligjëratë/ (*ziap* = ciap, cjaq i madh); *zh* e njëjtë me /shkronjën/ *z* të italishtes në /fjalët/ *zero* /= xero, kurrgjë, asgjë/, *zelo* /= zëll-i/ (*zhēē* = xëë, xe, nga folja “me xanë, me mësue”); *sz* që tingëllon si /shkronja/ *s* e frëngjishtes në mes dy zanoresh (*szēē* = zëë, zë, nga foma *lja* “me zanë fill, me fillue, me nisë”);

χ e greqishtes (*χee* = hjee, hjé; hije, hijeshi; *ràχje* = kodër).

20 korrik 1883

10. SHËNIME GRAMATIKORE PËR KËNGËN E IBRAHIMIT NGA PEJA⁹

1) Në këtë këngë zanorja *a* zëvendëson tingullin *ē* të së folmes së përgjithshme:
gjaam /= gjām, gjamël/ për *gjēēm* /= gjëëm, gjëm, gjëmël, *mē baam* /= me bāmē
/ për *me bēēm* /= me bēmē; bërël/. Në Kantonin e Shën Mitër Koronës, Koloni
e Vakkariccos, ruhet kjo trajtë dialektore, që mund të shënojë prejardhjen.

2) *Ńatto* /= njato/ në vend të *atto* /= ato/; por për shkak solecizmi të bashkuar,
duke qenë femërore, me fjalën *burra* të gjinisë mashkullore, qortò: *attaburra*
/= ata burra/. Kështu te strofa e katërt: *tē p̄arvet t'oon* /= të parëvet tanël/
përemri *t'ona* i gjinisë femërore rrin për pronorin e gjinisë mashkullore *t'aan*.
Për saktësi morfologjike, po japim një pasqyrë të dy përemrave, përemrin e
vetes së tretën, pronarin përemëror të së parës.

Mashkullore, njejës: *Ai*, gjinore: *tē attij*, dhanore: *attij*, kallëzore: *attē*;
shumës: *attà*, gjinore: *tē attireve*, dhanore: *attireve*, kallëzore: *attà*, rrjedhore:
attireši; femërore njejës: *Ajò*, gjinore: *tē assai*, dhanore: *assai*, kallëzore: *attē*;
shumës: *attò*, gjinore: *tē attireve*, dhanore: *attireši*, kallëzore: *attò*, rrjedhore:
attireši; asnjanesi: *attà*. [Transkriptimi: mashkullore, njejës: *ai*, gjinore: *tē*
atij, dhanore: *atij*; kallëzore; *atē*; shumës: *ata*, gjinore: *tē atireve*, dhanore:
atireve, kallëzore: *ata*, rrjedhore: *atireshi*; femërore, njejës: *ajo*, gjinore: *tē*
asaj, dhanore: *asaj*; kallëzore: *atē*; shumës: *ato*, gjinore: *tē atireve*, dhanore:
atireshi, kallëzore: *ato*, rrjedhore: *atireshi*; asnjanes: *ata* (latinisht: illud)].

- Njejës, mashkullore: *Diâlji ün* /= djali ynël/ (latinisht: per qui nobis est), *tē*
dialjit t'ēēn /= të djalit tënël/, etj. ; shumës: *diëljmet t'aan*, etj.

Njejës, femërore: *vaša jon* /= vasha jonël/ (latinisht: puella quae est nobis),
gjinore e dhanore: *tē vašēs s'aan* /= të vashës sonël/, kallëzore: *vašen t'ēēn* /=
vashën tënë, vashën tonël/; shumës: *vašat t'ōna* /= vashat tonal/, etj.

Asnjanes, emërore e kallëzore: *mišt t'aan* /= misht tanël/.

3) *Tē madh šëndët*, shihet se është shkruar mbiemri mashkullor i bashkuar
me emrin femëror. Është e qartë se masa e vargut nuk përputhet këtu me

⁹ *Note grammaticali*, Canto sopra Ibraim da Ipech, Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30
settembre 1883.

- ndërtimin, sepse në strofën e dytë me fjalën *marrë* /= marrë, turp/ është lidhur, rregullisht, femërorja *të madhe* /= të madhe/.
- 4) Në Shqipëri, ndoshta gjithkrah, përemri *cē* (latinisht: qui = i cili, që) i kolonive arbëreshe zëvendësohet me *ci* /= ç*i*, q*i*/.
- 5) *Vet* /= vetë, vetëm/, pothuajse e gjithë *Škqipëria* /= Shqipëria/, e përdor edhe në vështrimin e përemrit pronor të vetes së tretë.
Kështu, këtu kemi špia *vet* /= shtëpia e *vet*/, *gjinavet vet* /= gji*vet* të *vet*/, *me gjacht vet* /= me gjak të *vet*/ në vend që të thuhet špit të *tire* /= shtëpitë e *tyre*/, *me gjacht të tire* /= me gjak të *tyre*/. Nga fjala *vet* /= vetëm e *vet* /= i *vet*/, ndoshta, i vetmi fond është trajta e dialektit arbëresh *vettëhee* /= vetëhé, unë *vet*, qenja e *vet*/, që, ndërsa është i *vet*, është edhe *vetë*, *vetëm*.
- 6) *Ngasin* [= ngasín] vjen nga folja *ngas*, šchëndressin [= shkëndresin] nga nga folja *shkëndressin* [= shkëndresin], fitojnë]; me anën e një ndërrimi fonetik të zëvendësojnë *e*-në karakteristike të së tashmes të diftores me *i*-në e së pakryerës së diftores, në vetën e tretë shumës. Drejt rrin *ngassën* (= ngasën), šchëndressëñën (= shkëndresëñjën), e pastaj *nghissin* (= ngisin), šchëndrissnën (= shkëndrissnëñj).
- 7) *Tui dihat* nuk ka trajtë shqipe, e Jubani duket se nuk diti ta deshifrojë. Duket se rrin në vend të *tue u dihet* /= tue u di*het*/ ose *u diht* (= ndërsa është duke u zbardhur); këtë kuptim mbajta në përkthim.
- 8) *Pevetš* /= pevetsh/ rrin në vend të fjalës sonë *pieš* /= pyes/.
- 9) *Škqipëria* [= Shqipëria] e përdor, përgjithësisht, në vend të së kryerës së thjeshtë, trajtën e përbërë të foljes *cam* /= kam/ dhe të pjesores, duke i dhënë kuptimin e së kaluarës së përbërë italishtes; p. sh. në vend të: *na rriti* /= na rriti/ thonë *na caa rritur* /= na ka rritur/. Ndër Kolonitë e Italisë koha e shkuar pasqyrohet me trajtën e thjeshtë; ka fuqi, kështu, koha e përbërë, por paraqet diçka të kaluar: *cam rritur* /= kam rritur/ duhet: që unë të kem rritur.
- 10) *T'amëlj* /= të amëll, te né *t'ëmbëlj* /= të ëmbëll/, don të thotë: *e ëmbël*, / kurse/ në Shqipërinë e Veriut shënon *tamlin* /= qumështin/, të cilin në Kolonitë e quajnë me emrin e vet të veçantë *chjumšt* /= qumsht/.
- 11) Këtu pronori femëror *t'ona* /= tona/ shihet i lidhur, rregullisht, me emrin femëror *szëmrat* /= zëmrat/.
- 12) Rregullisht dhe në mënyrë të prerë ndër Kolonitë tona nga *pëštòn* /= pështon/ nxiret *pëštuar* /= pështuar, i shpëtuar, i gjallë në jetë/, në vend të: *i pë-štiiir* /= i pështirë/ të tekstit do t'u donte t'i përmbahej trajtës *pëštiin* /= pështin, pshtyj/.
- 13) *mbësõn* /= mbësonj/ i përgjegj, mirëfilli, italishtes: *mësoj*; për fjalën *nxâ* (zë), *dëgjoj*, kemi foljen *zhëë* /= xë/ në dialektin arbëresh.

11. ARBËRESHËT E KALABRISE¹⁰

[Përshtatje nga dialekti arbëresh në shqipen e sotme]

Shqiptarët, pasi turqit i muarën qytetet, arritën në Itali; qenë shpërndarë këndeje e andej nëpër gjithë mbretërinë napoletane, por, më të shumët, vanë në Sicili e në Kalabri.

Në Kalabrinë e parë ata janë të ndarë në katër kantone, të gjitha në rrëzë të maleve që e rrethojnë atë, me Specanën në mes, me Falkunaren e me Farneten tutje mbi dy detet që u rrinë kundruall. Toka ndër ta është e ndarë në shumë duar.

Gjashtë katundet e Shën Mitrit, Shën Sofisë, Maqes, Strigarit, Vakari-cit dhe Mbuzatit, që nga Bezënjana deri në Kurljanë, bregut të Kratit e përpjetë malevet që prekin Akrin, kanë toka ku bëhen kështenjat, ullinjte, vreshtat, mënat, qershitë, portokallet, lëng rrushi e, pastaj, më të ëmbëlat frute, me dushqe e me luadhe për dhi e dhen e qé.

Gjithë ata fshatra kanë, ndoshta, pamjen më të bukur ndër katundet e Kalabrisë, sepse, me përjashtim të Shën Sofisë, që shikon malet e veriut dhe të perëndimit, si në një rreth përtej Kratit, themeluar mbi kodrat, pesë të tjerët, kanë përballë, nga Veriu, bashkë me fushat e malet, edhe detin Jon. Pastaj, të gjithë kanë ajër e ujëra të mirë.

Njerëzit janë të fuqishëm e të zgjuar, e, ndoshta, për këtë pak arsyetojnë. E u duk në vitin që erdhën francezët në Kalabri, kur ndër këto katunde rronin vëllezërisht të lumtur, me gjithë të mirat, pa frymë të huaji, - sepse, deri atëhere, binte, çdo mbrëmje, kambana pas Ave Maries e çdo italian donte të dalë nga shtëpitë e veta – po atëherë fryma e huaj u shturi e i përçau ndër vrasje dhe ndër shtëpi

¹⁰ *Gli Albanesi di Calabria, T'arëbrest e Calabries*, Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën i red).

të djegura. E, andaj, u shkretuan më shumë se të gjithë Mbuzati e Maqja. Prandaj mund t'i këndohen edhe vjershat që Eni shkroi për të parët e tyre:

“... *stolidum genus Aecidarum,*
Bellipotenties sunt magi' quam sapienti potentis”
 (“... *budalla është fisi i Aecidarëve,*
më shumë janë të fuqishëm se sa të urtë e të aftë”).

Këto katunde u themeluan, pasi iku i biri i Skënderbeut nga dheu i tij. pastaj, kur shkuan ca mot, e grekët, që nuk u kishin dhënë ndihmë arbëreshëve ndër luftat e para, humbën Morenë, nuk u mbeti tjetër, atje, veçse feja e krishterë dhe Korona shqiptare, së bashku me qytetin vëlla Modonen, të rrethuara dhe të ndihmuara prej anijevet të Karlit V. Këtu, mandej, erdhën, në ndihmë kalorësit e Rodit, e, së bashku, të gjithë luftuan kundër të tërë fuqisë së Sulltan Sulejmanit, derisa u zhdukën, meqënëse ishin pak; ata që shpëtuan gjallë, erdhën mbi anijet e Spanjës dhe u shpërndanë në shekullin XVI nëpër katundet arbëreshe, që ishin në Itali. E, andej, zotër të shtëpive të larta qëndruan në Shën Mitër, në Makje dhe në Strigari. E, meqënëse me ta ishin përzierë edhe spanjollë, shumë emra, ndër né, janë me prejardhje nga spanjishtja; kështu kemi: Liopësërat (Lopez), Kurtizërat (Kortëz), Psarra Ljarà (Pisarra-Larà) e, ndoshta, edhe të Radhanjet (De Rada) e të tjerë.

Kur erdhën në Itali, arbëreshët e Mbuzatit dhe të Vakaricit qenë dërguar te pronat e Dukës së Kurljanës; ata të Shën Mitrit, të Maqjes e të Strigarit te Badia e Vasilianëravet; Shën Sofia, më tutje, qe mbledhur te pronat e Princit të Berzënjës, ku ishte zonjë e bija e Skënderbeut.

Ata nuk patën vetëm tokë për të punuar, por Koronët, që erdhën më vonë, kishin edhe 70 dukatë në vit për familjet prej Karlit V, nga minierat e hekurit; e të gjithë bashkë kishin privilegjet që kishin edhe ata të Liparit, aq sa mund të paraqiteshin të armatosur edhe përpara mbretit.

Kur Kolegji arbëresh kaloi në Shën Mitër, këto katunde dërguan shumë nga bijtë e tyre, sepse nuk shpenzonin shumë dhe se ishin afër; e u bë ndër ta dritë e madhe; aq sa, motit, çdo shtëpi e pasur qe në

dorë të një zotërie që dinte, pak a shumë, latinishten dhe greqishten.

Arbëreshët e ardhur në Itali, jo vetëm se mbajtën gjuhën që kishin, por as edhe zakonet e tyre nuk i ndryshuan; e, në mes të italianëve, njihen lehtësisht se janë të ardhur nga një dhé tjetër mjaft i ndryshëm nga ai ku gjindeshin.

Martesa dhe vdekja, ndër arbëreshët, nuk bëhen si ndër italianët; lodrat e burrave janë rolja, lufta, gjuajtja e shenjtit dhe vrapimi me kuaj. Gratë lozin shkopecingël dhe cikadjarëza, e cila është bërë me dy drunj, njeri më i shkurtër për t'u futur në dhe, tjetri më i gjatë mbështetet sipër të parit e sillet nga tre o katër vetë; lozin, gjithashtu, për të fshehur një unazë.

Ndër dasma, pastaj, e ndër gëzimet e mëdha, gra e burra zënë vallen e këndojnë këngët e moçme, që kanë lindur në mëmëdheun e tyre. Bashkë këta fshatra kanë më se dhjetëmijë vetë.

15 janar 1884

12. KOLEGJI ARBËRESH I, II, III (1884)

[Përshtatje nga dialekti arbëresh në shqipen e sotme]

Kolegji arbëresh, që sot ndodhet te manastiri i Shën Trianit (= San Adriano), përtej Shën Mitrit (= San Demetrio) nga perëndimi, që hapur, të parën herë, në Koloninë e Shën Benediktit (= San Benedetto).

Dy benediktinë të shenjtë, vëllezër, nga shtëpia bujare e Rodhotà-ravet (= Rodotà), qenë dërguar për shkollë në Romë. Atje mbetën bashkë; sepse njeri, Pompili, mbasi u rrit, shkoi bibliotekar në Vatikan; tjetri, gjithëherë aty, duke kuvenduar me krerët e kishës, mendoi e pati bindje t'ua hapë, në atë qytet, një kolegji arbëreshëve të braktisur, të cilët ishin të shpërndarë në dhë të huaj tash sa mot.

Thuhet se ky me emrin Ilumtur [= Felice], para se t'i paraqitte Papa Klementit XII lutjen në përkrahje për njerëzit e vet, çdo mëngjez, e për nëntë ditë e net, lutjen, ashtu na e kishte shkruar, e vente nën kupën e kungatës, kur thonte meshë e ia porositte zotit tonë. E Papa pranoi atë lutje, siç ia paraqiti. E këshilluan ta hapin /kolegjin/ në Shën Benedikt, ku të dy vëllezërit kishin shtëpi për konvikt, e familja Korsini, nga e cila ish Papa, kishte pasuri për ta pajisur. Desh Papa edhe më, që të mbledhë katundet arbëreshe nga të gjitha viset nën një peshkopatë të tyre, në gjirin e së cilës të mbanin të qetë fenë që kishin sjellë në tokën italiane. Po qeveria e Napolit, që i kishte strehuar me mërzi dhe i kishte shpërndarë, nuk u desh që arbëreshët të njiheshin për komb.

Atëherë, atij zotërisë arbëresh, që e bëri peshkop, Papa i ngriti brenda kolegjit, që ishte i kishës, fron zotërimi mbi shkollën e i vuri në duar të truamit (= nikoqiratën) e priftërisë dhe të krezmimit të ritit grek.

Kështu, në vitin 1736, u hap kolegji, si derë e madhe drite të re e të ngrohtë (të bukur) për të gjitha shtëpiat arbëreshe, nga të cilat, ato që patën mundësi, menjëherë, dërguan bijtë e tyre që të kthenin o priftër, o këshilltarë. Ata që niseshin për jetë kishtare, gjenin atje shkollë dhe

mensë falas; shokët që i priste jeta, paguanin jo më shumë se njëzet dukatë (85 frënga) në vit; por, si klerikët me rrobe priftërinjsh në kishë, ashtu edhe të tjerët me petka të vendit, mësonin në të njëjtën shkollë, rrinin së bashku në klasë.

Kujtimi i mëmëdheut të braktisur tek të huajtë, që po i mirrnin fenë dita me ditë, shihet i ngritur në faqen e parë të Bulës, që themeloi atë shkollë. E ky kujtim jehoi thellë e hareshëm tek zemrat e djelmëvet, që u mbloodhën atje. Këtu zu fill ndër ta e u mbush prej të parëvet, që duallën prej andej, dëshiri për të mbledhur këngët /popullore shqipe/, që, të sjella nga dheu i prindërvet, kujtoheshin endë; sepse ndër to pasqyrohej jeta e hieshme arbëreshe e rrëfehej fatkeqësia e trimavet të pafat, disa nga të cilët ishin endë filiza të njomë nën diellin. E andej ne mundëm t'ia paraqitnim, përsëri, kombit tonë, gati si një stemë bujarie. E, pikërisht, në këtë vit filloi të shkruhet gjuha shqipe; e ndër vargje të marra hua u dëgjua – o më mirë të thomi – u pa jeta hyjnore dhe plot helm e zonjës Shën Mëri, të cilën ne do ta nxjerrim, shpejt, në dritë e plot shpresë, në mënyrë që edhe ajo të pranohet me hìr.

Ishte ky agimi i ri i ditës sonë, megjithëse pak i largët.¹¹

Dy qëllime kishte ajo shkollë: 1) Të mësuarit e misterit të botës, e cila u bë re për të krishterët; si janë ndihmuar ata të tërheqin rretin me të mira të dobishme nga uji, e mbi ato, si janë ftuar te buka e te peshku i përshkuar nëpër zjarr, që iu shtron jeta e përjetëshme pjesëmarrësve. Teologjia, liturgjia, historia e kishës, nëpërmjet të doktrinës së etërvet të shenjtë, mbi të gjithë të Greqisë, qenë mbështetje, pra, me fat të mirë për nxënësit.

2) Pas këtyre, u shpiegoheshin përpara vetitë e bukura të herojvet të tokës së Greqisë dhe të Romës, zotër (prisa) që ndryshuan botën me bëmat e tyre të pasura e të mëdha. Në këtë mënyrë, duke mësuar gjuhën, të rinjtë rriteshin shpirtërisht dhe mendërisht me ata shembuj si pasqyrë.

Kjo e kthyer e mendimevet të jetës kah ditët e kaluara, duket se edhe shkonte në harmoni e në ujdi me kombin tonë, që ishte shpërndarë brigjeve dhe nënshtruar të huajve të ashpër dhe të rëndë, e prandaj, gjithmonë, me fat të keq gjer në kohën kur jeton.

Nxënës të këtij kolegji në atë kohë, lanë të shkruar, se, një ndër ta, Xhan Françesk Avati nga Makja, - me sa duket, mbas një vit studimesh, - dërguar në Romë për ta gëzuar Papën, lexoi përpara tij dhe i përktheu

¹¹ *Collegi i Arbres*, (Il collegio Albanese), Anno I, Nr. 5, Corigliano Calabro, 30 febbraio 1884.

italisht pjesë nga Homeri dhe nga Pindari. E, vazhdimisht, pastaj dualën prej andej njerëz të ditur në atë gjuhë, edhe nën dy peshkopët kryetarë që ndoqën, të zgjedhur si i pari, prej shtëpish të mira, Nikolla de Markis nga Ungëra dhe Françesk Arqopulli nga Shën Mitëri. Kaq sa vetë Selia e Shenjtë desh dhe u përpoq, në kohën e tyre, që të lulëzojë ai kolegji, i cili ishte një tjetër e mirë për kombin tonë të vobegët. Mbretëria e Napolit bëri çmos dhe e mbylli manastirin bazilian shumë të pasur të Trinisë së Shenjtë të Miletit, në Kalabri, por nga prona e kallogjerëvet, që Papa i la asaj ndërduar, bëri marrëveshje që katër mijë dukatë nga kamata mbretërore t'ua kalonte fshatravet arbëreshe, me qëllim që të hapnin edhe ata shkolla për fëmijët. Por kjo [mbretëri e Napolit] vonoi t'i japë; e, duke gënjer, me atë kamatë paguante krrerët e oficeravet të Gardës Mbretërore Maqedone, një Regjiment arbëresh, që rrinte në Napoli, në mbrojtje të saj. Në vend të Arqopullit, pati peshkopatën e arbëreshëvet Françesk Bulja (Buljari) nga Shën Sofia. Atëherë u ndodh ministër i mbretërisë Tanuçi, njeri me vullnet të mirë, që ishte i rrethuar prej bujarësh (fisnikësh) të urtë e ndjekës, sikurse ai vetë, i mendimevet, që ngriheshin prej gjithë anësh, do të thoshnja, drejt qiellit të ri. Kish kërkuar ai që të hapej një konkurs për të zgjedhur katër mësues për katedrat e gjuhës greke, që po ngriheshin prej atij vetë; dhe kish marrë vesh që të zgjedhurit kishin qenë katër djelm të Kolegjit arbëresh, ndër të cilët njeri italian, Veteri, nga Kozenca. Nga kjo, u bë dashmirës i këtij kolegji. Kështu, Buljari e Paskal Bafi, njëri ndër katër profesorët e zgjedhur, edhe ky [Bafi] i lindur në Shën Sofia, e që nga mezi i të tjerëvet, për arsye të zgjuarësisë së tij, kish qenë emëruar bibliotekar i Bibliotekës së re të Borbonëve të Napolit, - u këshillua njeri me tjetrin dhe u kujdesuan që të shpërblehej dhurata e Papës nga pronat e Bazilianëve të Miletit, të cilën ua kishte dhënë arbëreshëve. Veçse jo për fshatrat tona, e të cilavet ishte, por e lypën dhe deshën për kolegjin dhe për shkollat, që ai kishte brenda, e Buljari zotëronte; e, mbase, prandaj e patën më lehtë; sepse, në mbarim të shekullit të tetëmbëdhjetë, kjo dhuratë që ndërruar me Badinë e Shën Trianit (= Shën Adrianit), në të cilin manastir Buljari, si përzuri kallogjerët, i çoi tek Shën Benediktinët djelmët e shtëpiavet shqiptare.

Buljari pati qenë i lëvdur për pasuri, me anë të së cilës ai pati mundësinë ta përgatitë këtë shkollë të kombit të vet. Por lavdia e tij më e madhe ka të bëjë, sidomos, me dobinë e atyre që pritnin nga kjo pasuri [lidhur me shkollën] dhe nga gjerësia e ideve dhe e aspiratave të reja, me të cilat ai ishte i pajisur. Porse nuk që, në të vërtetë, shumë e drejtë ajo punë e tyre, me të cilën varfëruan katundet për të ngopur shkollën, sepse ajo

kish qenë themeluar për dobinë e kolonivet. Edhe pse ka qenë gjithmonë zakon t'i jepet më parë administratorit nga pasuria e çdo ndërmarrjeje, - qoftë edhe sikur të mbeten pak o aspak në dobi të të zotëve të shtëpisë së administruar - nuk mund të shfajësohet ai peshkop e ai njeri i shquar nga kjo e metë drejtësie.

Më mirë se përpara u duk, tashti së voni, si në dritë të diellit, se atje “ku ka kufoma, atje ka edhe shqiponja”. Mirëfilli Belushi, që zuri këmbën e Buljarit, mundi të lërë, pas vdekjes, shtatë mijë dukatë nga ajo begati në arkën e shtetit; edhe, për sa kohë jetoi, pati aty të hollat e nevojshme, me të cilat mbajti shkollat e reja, që pat hapur Buljari: atë të Filozofisë dhe të së Drejtës qytetare, të Matematikës dhe të Fizikës; porse, i rritur ai në Shën Benedikt me fjalët e pleqëve, dhe në mes të të tjerëve që kanë qenë aty, ai ishte bërë shumë i ndershëm dhe dashurues i Krishtit të varfër. Por, pastaj, u pa, përherë e më tepër, që, për shumicën e kryesisë së shkollës, pasi humbën sysh djelmët dhe Arbëria, tryeza e Shën Trianit (= Shën Adrianit) mbeti si ai djathi i përrallës, në të cilin u mbyll miu me qëllim që të mos e shkulinin s'andejmi, deri që mbaroi lëvozhga e përjashtme, duke rënë, së bashku me të tjerat, gjithë katedrat e shkollës, me anë të së cilavet Buljari kishte plotësuar edukimin shkencor të bashkatdhetarëve të tij.

Nga ana tjetër, në shenj shpërblimi për dhuratën, siç dukej ajo, qeveria që jepte, deshi dhe pati mundësi të kishte, pastaj, dorën e vet brenda kolegjit, që më përpara ishte vetëm i arbëreshëve dhe i kurnjë njeriu tjetër. E sot rri qartë përpara syve tanë si na e ka prishur ajo dora e huaj. Në të vërtetë, ky qe një faj shumë i madh.

E, pastaj, prej vetë duarve të Buljarit, të zgjëruarit e dijevet, që ai i deshi aq fort, ra përpara se të bulonin pemët /d.m.th. përpara se të piqeshin frutat/; sepse ai dhe shkolla e tij qenë rrahur, vazhdimisht, prej erërash së jashtme; deri sa e mbytën /Buljarin/ me pushkë dhe me thikë disa njerëz të këqij të Mbretërisë, - siç thuhej, - pikërisht ashtu sikurse tetë vjet më parë kishin varë në trekëmbësh, në Napoli, Paskal Bafën.¹²

Koha, kur e drejtoi kolegjin Peshkop Belushi nga Frashënit, shkoi si ditë fatbardhë e atij kolegji. Ndoshta gjuha greke nuk u mësua si më përpara, por latinishtja po; dhe hynë, atëherë, e u lexuan, me dëshir, librat kryesorë të letërsisë italiane. E, mbi të gjitha, krenaria e mbajtjes së qenësisë /shqiptare, arbëreshe/, e ushqyer prej shembujsh

¹² *Cuvendi i Arbëres nd'Italiet* (Collegio albanese in Italia), Anno I, Nr. 7, Corigliano Calabro, 30 aprile 1884.

/së mirë/ të Romës dhe të Greqisë, u dha nxënësve guxim plot besim, që, mbasi të dilnin prej andej, të mbeteshin në shesh të dijes, me bijtë më të zgjedhur të kombevet të huaja.

Në vitin 1833 vdiq Peshkopi Belushi. Por disiplina e të mësuarit, e vënë ndër vitet e para të drejtimit të Belushit, prej dorës së hekurt të Mikelangjelo Rusanit nga Akuaformoza, pati jetë në kolegji edhe disa vjet; e ajo, me zjarrin aq të ndezur të lëvdatës /= të lavdisë/, mbajti më këmbë nderin e madh të shkollës sonë.

Peshkopi që e zëvendësoi, Gabriel De Markis, i urtë e shumë i mirë, ishte tepër plak; dhe e mundi lagështia dhe të ftohtit e dimërave në atë manastir aq sa u pat mbledhur ai në shtëpi dhe ia la derën hapër Qeverisë së Mbretërisë. Kjo me papën zgjodhi peshkopë italianë si drejtorë shkollë. Thomi se këta kanë qenë të mirë; por, meqenëse ata rrinin larg, priftërinjtë arbëreshë, të cilëvet u patën besuar administrimin e shkollës, nuk patën, pastaj, kujdes që t'ia ngrenin dhe t'i bënin nderin e duhur; teksa ata e dinin që sherbëtorët e qeverisë mbretërore, që i rrinin afër, i mbanin sytë sipër. Kështu, Kolegji ynë i bukur, që kishte qenë i pavarur, përfundoi sikurse një shtëpi, ku në vend të prindërve të saj zotërojnë të huajtë. E, kur ajo, që pat qenë, gjithëherë, vatër lirie, mori flakë përjashta, në mënyrë të pakujdesshme këtë, duke qenë marrur më sysh dhe duke mos qenë e ndihmuar, o memzi prej papës, humbi edhe qetësinë e brendshme, që i lypej. E qëndroi si një anije pa u kapur pas bregut, ku të mblidhej përpara, e rrahur prej erërash dhe prej qetësisë që e ndrydhëte.

E ky varfërim u bë edhe më keq gjatë kohës së bashkimit të Italisë. Në na duan keq, o mirë, siç thonë, e dinë ata; ajo që duket qartë përpara, është se, me përjashtim të Garibaldit, që arbëreshët i njohu për së afërmi në shesh të betejës dhe i desh mirë, nga ministrat e mbretërisë së re, dikush nuk u kujdesua fare /për arbëreshët/, dikush u përpoq që t'i zhgatërronte /këta/.

Në vitin 1860, Ministri Skura, një arbëresh nga Vakarici, deshi dhe pati besim ta kthente kolegjin ndër statutet e tij themelore dhe tek e drejta autonome e vitit të parë. Por, si vdiq ai, shpejt, Mbretëria s'e la më t'i dalë duarësh. Ministri Mançini, o se nuk kuptoi Dekretin e Garibaldit, o se bëri sikur s'e kuptoi, nuk e la të mëkëmbej, duke prapsur mendimin e Këshillit të Shtetit, ku ishin aq njerëz të zot e më të aftë se ai; duke shtyrë edhe Dekretin e mbretit, që kishte qenë me të aq dorëhapët. Ky njeri, disa vjet më parë, duke shkëlur (duke marrë) nëpër këmbë ca vendime të ligjës së mëparëshme, u muar arbëreshëvet

të Italisë kishën greke të Napolit dhe ua dha grekëvet të huaj. Qeveria greke i vari në qafë, atëherë, kryqin e Jezu Krishtit.

Prandaj Peshkopata, nga e cila pritej aqë shumë ndër ne, e përunjur përpara atyre zotërinjve, duket se nuk solli asgjë në esencën vet. E, pastaj, gjithçka është aty brenda, s'është e vetja. Vitin e shkuar, Ministri Januci i dërgoi komisionit administrativ të Kolegjit lutjen e një italiani, me të cilën kërkonte që t'i rritnin atje të birin, pa pagesë. Peshkopi i pari dhe të tjerët me të u përgjigjën që "Bula themelore e Kolegjit urdhëronte që të mos rritek atje brenda ndonjë që nuk ishte e pagëzuar në ritin grek, edhe arbëresh në qoftë ky, jo më italian; ndërsa pranimet pa pagesë ishin për ata që ftoheshin për t'u bërë priftërinj për fshatrat e vogla të ritit grek. Për këtë arsye, ajo Bulë vendosi edhe që, në rasë se aty brenda, më vonë, do t'u rritte ndonjë, pa paguar, i arbëreshi, që do të zbulohet se ishte pagëzuar në ritin latin e s'mund të bëhej prift grek, do të jepte, përnjëherë, detyrimin e të gjitha vitevet, për sa kohë kishte ndenjtur aty brendë. Përveç kësaj, sot për sot shkolla, që memzi mbahej, nuk u siguronte ushqimin, as edhe atë që ne arsye u takonte. Ministri, me krenarinë e shtetit ndër krahë, urdhëroi që ta pranonin italianin brenda dhe t'ia njihnin të drejtën.

Gjenden, po, edhe në Itali njerëz të drejtë e të mirë; e Mbreti vetë nuk di gjë nga këto padrejtësi dhe qëndron, vazhdimisht, larg kësaj vramjeje; por në qeverinë e Përfaqësivët, të shumtën e herës, zotërimi është në dorën e disa njerëzvet gjysmakë me karakter të dobët. Qysh para këtyre të dyve, u desh që italianët të ndanin me arbëreshët kolegjin e këtyre të vetëm; e, pastaj, profesorëve aty brenda nuk u dhanë diploma, do me thënë si të dinin, si të mos dinin, e njëjta gjë ishte. E luftuam me ta!

Të gjitha këto gjëra, ku synonin? Mos, vallë, tek shuarja e shkollës, që kish veç dritë për në? Zoti ynë e di dhe ka në gji të tij këdo që i ndihmoi kësaj pune kundër mëmës sonë të nëmur. Ja, siç pandehej, erdhi koha që ai [kolegj] pa të holla duhej të lante borxhe të mëdha e pa pasur njeri që t'ia jepte, sepse dora e huaj i tërhiqte për vete, prej kah do të vinin ndihmat, (dhe miq e armiq sot e mallkojnë) duhet të shesë nga pasuria o, këtë vit, të mbyllet.¹³

28 shkurt 1884;

30 prill 1884;

30 korrik 1884.

¹³ *Cuvendi i Arbres*, (Il collegio albanese), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno I, Nr. 70, Corigliano Calabro, 30 luglio 1884.

13. SHËNIME GRAMATIKORE¹⁴

Duke pasë përdorur, pothuajse, të gjithë shkrimtarët, në gjuhën shqipe një shenj të vetëm, qoftë për zanoren e pazëshme, shprehur prej nesh me *ë*, e paaftë të qëndrojë në fillim të fjalës, qoftë për zanoren e pasqyruar me *ē*, posaçërisht prej nesh, dhe e aftë për të gjithë theksat e gjuhës sonë, kjo gjë ka shkaktuar e do të shkaktojë, për të gjatë kohë, atë ngatërresë që do të shpinte në leximin e frëngjishtes mungesa e rregullave që shënojnë *e*-në e shurdhët, por që e dallojnë nga *e*-ja zanore. Për këtë arsye, i shkëlqyeri Gustav Meyeri e pat quajtur këtë tonën, *zanore të pasigurtë* (të pasaktë, të dyshimtë). Për të shmangur disa rregulla të tjera, e, në të vërtetë, nuk do të dinim se sa, parapëlqyem dy shenja të ndryshëm.

Nga zanorja e shurdhët (e pazëshme) besoj se mund të shënojmë dy gjendje të para. Para së gjithash, tek ne, ajo pasqyron ndalesën, që shkon duke u zhdukur, të një toni, në të cilin, ndoshta, përherë, mbarojnë emrat e pacaktuar (të pashquar) dhe rrënjët e foljevet, që mbarojnë me bashkëtingëllore. Këtij toni që pothuajse është me rëndësi në shqiptim, të pakët janë ata që i venë ndonjë shenj ndër botime.

Tani, 1^a), sipas emrave dhe foljeve të sipërthëna, që marrin prapashtesa, ai ton që shkon duke u zhdukur, merr pak qëndresë e mbet, do të thojë, në vend të zanores tematike, si të foljet e greqishtes: *ljægch* [= lag, lag] ose *liægch'* [= liag, ti lag] kthehet në *ljægchëmi* [= ljagëmi, lajmë], *ljægchëna* [= ljagëna, lante]; *mott* [= mot, kohë] ose *mott'* [= mot, kohë] në *mottëra* [= motna, kohëra]; përveç kësaj, kthehet, si, b. fj., ndër emrat zvogëlues mashkullorë, në një zanore tjetër, që shenon shumësin: *i mërúam'* [= merúam, i mjeruar, i brengosur, i shkretë, i

¹⁴ *Shënime gjuhësore (Note grammaticali)*, Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. VII. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën. i red.).

pikëlluar], *të mēruáamisz* [= të merúamiz, të mjeruar, të brengosur, të shkretë, të pikëlluar]. Unë kam dashur ta shënoj, gjithmonë, në mes të temës dhe të mbaresës: *ljumëra* [= lumenj], *ezzëmi* [= ecëmi, ecim]; të tjerë e heqin këtë ë: *ljúmra* [= lumenj], *ezzmi* [= ecmi, ecim]. Por, në shqiptim, shprehja e saj është gjithkund një, dhe të shkruarit ndryshe nuk don të thotë larmi dialektare.

Në vend të 2^{-të}, përveç lirisë poetike që, këtu e atje, shtrin në ë atë të pazëshme fundore të rrënjëve dhe të rrënjëtorëve: *mòttē* [= motë, kohë], *ljagchē* [= ljagë, lag], mundet ajo, në trup e në fund të fjalëve, veçanërisht njërrokëshe, për shkak të ndeshjes së theksave, të vijë e të zëvendësohet nga *ē* ose edhe ta zëvendësojë atë. Të tilla zëvendësime nuk janë të paarsyeshme, sikurse në lirinë e një frymëzimi të lartë; ato, së bashku me kontraksionin, ndihmojnë, si disonanca, në paraqitjen e gjallë të pikëllimeve të shpirtit dhe të ndjenjave të ndryshme të botës së jashtëme. Dëshëroj, në mënyrë të thjeshtë, të kujtoj ligjin fonetik, për të cilin fjalët njërrokëshe marrin zanoren e shurdhët ë, në qoftë se ndiqen nga një fjalë, rrokja e parë e së cilës është e theksuar ose e gjatë; dhe, në se, përkundrazi, zanorja ē: cë viën të jeet [= çë vjen të jët, që vjen për të qenë], *vettēm ndē në šòch* [= vetëm ndë një shok, vetëm në se një shok], *jetten cē ja caa* [= jeten çë ja kã, botën që ia ka].

Një organizim i tillë fonetik i gjuhës, megjithëse është marrë parasysh, porse ka mbetur i panjoftuar deri më sot, nuk ka ende një bazë të qëndrueshme ndër veprat e botuara, përsa u takon studimeve të këtilla.

Por, duke e ngulë mendjen në të [=organizmin fonetik], ku materia pothuajse shuhet në lidhjen me shpirtin e që paraqitet e përhapur edhe në gjuhë tjera, dhe vetvetiu i vjen në ndihmë magjisteri i pashuar, gjersa s'kap më syri që duket në larmitë e endjes së degëve, të cilat, si shtresë e parë e jetës, mveshin Tokën.

15 janar 1884

14. TRI FJALËT SHQIPE¹⁵

Rumunët dhe italianët kanë *tata* (= àt, baba); kanë, pastaj, rumunët *sis* (= sisa) e italianët *cicca* (= cica). Nga këto dy fjalë, rrënja e shfaqur është dy fjalë shqipe: *àt* (= àt, baba) e *sìs* (= qumështë gruaje e sisë), prej nga *drosissën* (= me dhanë gji, me dhanë qumështë).

Italianët kanë, pastaj, *mamma mia* (= nëna ime, mëma ime), që duhet të ketë ardhur nga fjala jonë ëm o âm (= ëmë ose amë).

Duket, pra, fare qartas, që dy fjalët *ât* (= àt) dhe *ëm* (= ëmë) – në të parën e të cilave *t*-ja e fortë mbyll *a*-në e theksuar shenon zotërimin burror, e në të dytën *m*-ja e butë, së cilës i mbështetet *ë*-ja e gjatë dhe e përulur, reflekton lëshimin (dorëzimin, shtrirjen) e ëmbël të gruas – ato dy fjalë që do të thoshja se janë të parat e gjuhës njerëzore, dhe *sis(ë)* së bashku me to, do të kenë kaluar nga etërit tanë pellazgë tek italianët e parë.

Edhe në ato fjalë të para shihet, pra, mbresa (gjurma), ligja që nga njëjisi i kthen në shumës femërorë dhe pjesën më të madhe të mashkullorëve.

30 maj 1884

¹⁵ *Trii fjalj t'abërësa AT, EEM, e SIS (Tre paroli albanesi AT, EEM, SIS), Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. VII. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën. i red.).*

15. FJALORI I RAPSODIVE¹⁶

Parathënie

Qëllimi i parë i këtij fjalori është të lehtësojë spjegimin e Rapsodive në veçanti e njohjen e gjuhës shqipe, trajtat e herëshme të së cilës, më mirë se gjetiu, ruhen në ngulimet tona.

Prandaj në të për foljet do të shënojmë diftoren veprorë të re të tashme e të shkuar, pjesoren e urdhëroren që, në përgjithësi përmban (= ka) rrënjën, duke vërejtur se prej veprorës nxiret vetëvetorja duke i shtuar temës, në të tashmen e diftores e të lidhores, rrokjen *ghem* /= *hem* e në disa *nem*, në kohët e shkuara të gjitha duke vënë përpara *u* ndoshta e barabartë me *unë*.

Sa për emrat, duam të shënojmë se në trajtën e pashquar ata klasifikohen në dy lakime: mashkullori e femërori. Emrat femërorë shquhen, duke i shtuar prapa temës që mbaron në bashkëtingëllore, një *a*; e, në qoftë se mbaron me zanore, duke e ndrruar këtë në *ia*: *dëlje*, *dëlja* [= dele, delja], por, në qoftë se zanorja është e dyfishuar, duke këmbyer thjesht të dytën në *a*: *foljee*, *foljêa* [= çerdhe, çerdhja; folé, foleja]. Për sa u takon mashkullorëve, ata që mbarojnë në zanore të dyfishuara o në bashkëtingëllore grykore *ch*, *gh*, *gch* caktohet [= shquhet] duke u vënë prapa *u*: *plach*, *plakku* [= plak, plaku], *caa*, *câu* [= kâ, kau]; pastaj, ata që mbarojnë ndryshe, shquhen duke shtuar mbrapa *i*: *dimër*, *dimëri*. Shumësi i dy lakimeve të shquara bëhet me prapashtesën e përbashkët *t*; *trima-t*, *vasha-t*. Në fund, emrat që tregojnë universalitet (të përgjithshmen) o totalitet (tërësinë), shquhen duke i shtuar mbrapa në njëjës *t* temës: *ghecur*, *ghecurt* [= hekur,

¹⁶ *Lexicon delle Rapsodie*, Prefazione, Biblioteca Nazionale: Rapsodie e Lexicon, 30 ottobre 1884.

hekurt], hekuri në përgjithësi; e ky është asnjësi ynë. Pas këtyre ligjeve e njohjes së rasave, lakohet me lehtësi çdo emër, i shquar o i pashquar, mjaft që të dihet shumësi. E, me qenë se ky ndrron në shumë mënyrë, sidomos në mashkullorët, për çdo emër o mbiemër të pashquar (të pacaktuar) shenojmë në fjalët trajtën e shumësit.

Për të veçuar, pastaj, elementin vendas nga huazimet, ia kisha lënë në dorë Mikel De Radës, bir i tim vëllai, (që kishte marrë për sipër e kryer punën e pagdhendur të fjalorit) krahasimet me greqishten. Ai vdiq shpejt, fill mbrapa, njëzet vjeç, në prill, e, atëherë, im bir, i sëmurë, mori përsipër veprën e mbetur, duke krahasuar me latinishten e greqishten deri te shkronja *n*. por, mbas shtatë muajsh, e la edhe ai këtë botë; e mundimeve të tjera të mia iu shtua nevoja për të përfunduar punën e marrë përsipër prej tyre. Shtina (futa) në punë dy dorëshkrime të helenistëve të zotë, Stanislao Jeno e Lukë Toçi, e ndonjë punim që mund të njoh të filologëve të shquar Teofil Stier, Gustav Meyer e Dhimitër Kamarda.

Këtë e them përpara, kështu që, mbasi jam i ri në studimet gjuhësore, mos të fryj me paditurinë time zbrazëtirën (boshllëkun) e ulët të ndonjë Rabule të Filologjisë.

Duke parashikuar, pra, m'u duk se latinishtja kishte fjalë prehistorike identike me shqipen; o pse ishte shqiptar shartimi frig me popullin latin, o pse tirrenët (*të rrënit* = të ardhurit e rinj), ndikimi i të cilëve mbi Lacion që i madh, ishin prej rrace shqiptare: Kujtoj tonën *túnd* e *shkund* e vargun e Virgilit: *Hinc atque hinc tundittur Heroos*. Fjalë të tjera latine mbeten të lidhura me gjuhën tonë nga pushtimi i Romës, që mundi Teutën; të tjera, në fund, e sidomos në ngulimet (kolonitë) e Napolit e të Sicilias, nga tregëtia (moderne) e kohës së re me italianët. Do t'i shënojmë të parat me *cfr.*; të dytat me *lat.*, të tretat me *it.*

Në të njëjtën mënyrë, me që helenët zunë (pushtuan) vendin e pelazgëve, e dy popujt mbetën të përzierë, siç janë ende, shkëmbyenshumë fjalë *ab antico* (qysh motit, qysh heret, në lashtësi); shumë (fjalë), pastaj, gjuha shqipe i mori nga greqishtja më e lëruar (më e punuar), e kjo, në kohët e fundit, prej asaj. Ato që na duken të kohës së vjetër, do t'i shënojmë me *cfr.*, me *gr.* të dytat. E, gjithë këto janë në përdorim të shkencës, që do të nxjerrë jashtë e do të pranojë, siç e thotë arsyeja e drejtë.

3. Rrallëherë ndeshen shembuj fjalësh nga gjuhë e tjera pa përjashtuar edhe sllavishten. Disa duan që të gjejnë shumë huazime sllave në shqipen. Nga njëra anë, këto fjalë mbetën të lidhura me sllavishten, të cilat u vunë përsipër porsì një shtresë e vjetër në shqipen dhe këto mund të bëhen si péri i Arianës, sipas teorisë së Benloew-it të ndritur, që thotë se toka në lindje të Adriatikut deri te lumi Alys në Azi, në kohët e vjetra, ishte e banuar prej stërgjyshërve të shqiptarëve. Nga ana tjetër, ato fjalë sllave kaluan jo para shumë kohe në Shqipëri e, sidomos, ndër rrethet e caktuara kufitare, duke zëvendësuar fjalët amtare. E, shpeshherë, është diçka qesharake studimi i atyre gjuhëtarëve që kërkojnë t'i kapin të tilla pamje të kota, që vijnë nga një det i trazuar.

4. Në fund, do të shënojmë me fjalët që do të ndeshim në gjuhë të tjera, por të shtrembëruara në trup të fjalës o të ndryshuara (për) nga kuptimi. Po marr një shembull prej Miklosich-it: fjala jonë *giapii*, *giapier* (= gjapí, xhapî, gjapier, xhapier) – jo hardhucë, që në shqip thirret *gàrdhëlj* (= që shqip i thonë *gàrdhëlj*) – gjëndet (ndeshet) në *giaba* (gjapa, xhapa), serbisht *šava friuliano* e *sapo* spanjole, që përkundra donë të thonë bretkocë; (fjala) jonë *ljocëch* (ljoçëk), lloj gogle (koklute) që lén (lind) mbë kërcejt e bisqeve të lisave (gjëndet) në fjalën serbe *lokme*.

16. VËREJTJE (VËZHGIME) GJUHËSORE¹⁷

Si mbetëm vetëm, mezi mundëm të paraqisnim një skicë të asaj që kishim në mend të bënim; as jemi në gjendje të nxjerrim ndonjë ligj të qëndrueshëm nga paradigmat që paraqitëm.

Duke krahasuar me gjuhën gjermane (sipas Gramatikës së Stier-it, nëse nuk e kundërshtuam me të keq), duket si në gjuhën shqipe, sikurse në atë:

- 1) Fjalët e përbëra ndjekin sasinë (kuantitetin) e pjesëve të tyre;
- 2) Kanë zgjedhime të dobëta e të forta;
- 3) Mbaresat e gjinore, dhanore e rrjedhores njëjës aty janë identike (të njëjta);
- 4) Mbiemrat përdoren në trajtën ndërfoljore të palakueshme, kur janë kallëzues të fjalisë o atribute të emrit që paraprin.

Dhe kjo për gjuhësinë.

Përsa i përket zhvillimit të saj gjatë shekujve, nga fjalori duket se shqipja ka shumë më tepër fjalë të përbashkëta me gjuhën e helenëve, nga të cilat një pjesë, megjithëse e pakët, Greqia e nxori prej saj, hem në kohë të lashtë, hem ndër kohë të afërta me ne. Por aty kemi diçka krejt ndryshe. Shihet qartë, nëpërmjet emrave shqiptarë të hyjnive të Greqisë, se adhurimi pellazg i forcave të natyrës ka qenë baza e politeizmit të tij. Ata emra dëshmojnë për vërtetësinë historike të udhëtimit simbolik, për të cilin flet Herodoti, të Sibilës, që nga pellazgët erdh me gjera të shenjta në një kanistër, dhe, duke kaluar nëpër Greqi, u ndal në Delos. Dy të dhëna këto që, të bashkuara me banimin e përbashkët të dy popujve qysh nga koha më e parë deri në kohën tonë në një vend, nga një anë e përforcojnë traditën e invazionit helenik në

¹⁷ *Vëzhgime gjuhësore*, (Osservazioni linguistiche), Anno II, Nr. 3, Corigliano Calabro, 20 giugno 1885.

vendin e pellazgëve që, në një numër shumë të madh, u përmblohdhën në veri; dhe, nga ana tjetër, tregojnë kulturën e lartë të atyre anasëve (banorëve të parë) që, me të drejtë, u quajtën *pellazgë të hyjnueshëm* nga Homeri.

Shumë fjalë të tjera tingëllojnë, pastaj, që prej asaj kohe të largët, para se të vinin helenët, si fjalë të një gjendjeje fqinjësie dhe afërsie të pellazgëve e të italeve, që dihej dhe për të cilën gjë Virgjili mundi të thotë:

“*Cognatae gentes olim populosque propinquos*” (gjind dikur të njohur e popuj të afërt).

Për këtë fakt, përveç shumë provash gjuhësore, ne shënuam, aty-këtu, dhe mbetën dëshmitarë, një e një tjetër hyjni me emër shqiptar, që, po aq sa emri *bora*, vjen tek ne si një jehonë e një lashtësie të largët sa s’mund të vërehet.

Vëllezërit Arvalë, që kujdeseshin në Romë për fenë e *arave*, në pranverë i bënë fli hyjneshës Dia. Se kush ishte kjo, askush s’e ka thënë. Por ne jemi të bindur se emri Dia paraqet *dhinë* ushqyese e Zeusit (Jovit); dhe me emrin shqip dhia, ashtu sikurse në kohë stuhie, si Eliqit (djallit) ata i bënë në pranverë fli dhisë që të mos dëmtonte bimësinë e re, me të cilën ushqehet jeta njerëzore. Revista *Mélusine* thotë: “C’est ainsi que on les voit immoler une truie et une jeune brébis à la Dea Dia, quand leur bois sacré éprouve quelque dommage” (“Kështu i shohin duke sakrifikuar ndonjë dosë a ndonjë qengj për Perëndeshë Dianën (Dea Dia), kur pylli i tyre i shenjtë pësonte ndonjë dëm” – shën. i red. B.Gj.). Duhet të shënojmë se në fli nuk kish vend dhia.

Por edhe sikur të mos pranohet tërësia e gjithë kaq provave, aty ka diçka që mjafton për t’i dhënë gjuhës shqipe një vend shumë të largët nga ne në gjuhët e formuara. Dhe, duke bërë gjithnjë e më tepër dritë kjo, do të veniten kundërshtimet ndaj kësaj të vërtete.

20 qershor 1885

17. ARBËRESHËT E GREQISË¹⁸

(Përshtatje në gjuhën e sotme nga dialekti arbëresh)

Rrypina e ngushticës së Korintit tërhoqi atje, së bashku me shumë nga kombet e tjera, edhe shqiptarët e kolonive tona, që kishin shkuar atje dikush për të nxjerrë dhé, dikush si murator, dikush për të ngarkuar vagona o për të bërë tjetër gjë. Disa kaluan nga një vend në një tjetër e, pothuaj, të gjithë vajtën në Athinë. Nga ata që janë kthyer prej andej, mësuam që në Atikë flasin shqip, që në një pjesë të madhe të Greqisë ndër fshatra të vegjël banojnë shqiptarë, kurse ndër qytete banojnë helenë. Dhe këtë e la të shkruar edhe Hahni o sepse i kishte parë, o sepse ia kishin thënë.

Tregojnë, gjithashtu, ata që qëndruan në Korfuz, se nga dy brigjet që janë pranë luginës, e cila arrin deri në ranishten ku është ngritur qyteti, njëra është plot me helenë, ndërsa tjetra ka shqiptarë.

Këta bashkatdhetarë që zënë kaqë hapësirë të Heladhës, nuk vërshuan këtu kur ra Skënderbeu; gjithë ata fisnikë shqiptarë ikën në vende të largëta nga Turqia, sepse Greqia vetë ishte atëherë nën turkun, e pushtuar nga Muhameti II, ndër ata muaj që Skënderbeu qëndroi në Itali. Po historitë e Mesjetës, a nuk shërbejnë për të kujtuar përhapjen e popullit tonë tutje nëpër Heladhë, e deri në Hidër e Poros? Por në kohën e Skënderbeut, qytetet Koronë, Modonë e Napoli të Moresë, ishin pothuajse shqiptare, siç dëshmojnë rapsoditë, që kanë lindur aty. Mjaft familje arbëreshe, që erdhën prej andej qëndrojnë në mes nesh.

Kjo përzierje popujsh, që gjeti njerëz të shkuar prej këndeje atje, ishte qysh prej kohëve të Platonit, i cili flet për këtë gjë. Dhe tash

¹⁸ *T'Arbrëshet T'Elladhes* (Gli Albanesi della Grecia), Anno II, Nr. I, Corigliano Calabro, 10 aprile 1885.

duket qartë se kjo gjendje mbeti edhe mbas ardhjes së helenëve, që zunë vendbanimet e mbajtura prej pellazgëve qëmoti, gjë për të cilën flasin deri gurët e asaj kohe. Dhe, meqenëse mandej shkrimtarët nuk i shënuan qartë popujt grekë sipas këtij ndryshimi racash, kemi një pështjellim të madh në mendjet tona. Në këtë mënyrë s'kemi gjë tjetër veçse emra fisesh që luftonin mes tyre ose bënëin paqë e marrëveshje, në vend që [shkrimtarët] të njihnin shkakun e thellë të ndasive dhe të aleancave, që do të kish qenë drita sqaruese e asaj bote. Shkaku ishte, ndoshta, te popullsia e ndryshme, në të cilën e jona - sikurse e pandeh Benloew - ishte vendasem ndër ishujt e Egjeut e në brigjet e Azisë.

10 prill 1885

18. PELLAZGË E HELENË¹⁹

(Përshtatja në gjuhën e sotme nga dialekti arbëresh)

Nga gjuha helenike kemi shkrime e përmendore që prej 3000 vjetësh e më parë, dhe në të gjitha këto [greqishtja] qëndron, para nesh, si jehonë e dashur e një kombi fisnik, e mbajtur në një radhë qytetarësh të ditur [të organizuar e me kulturë].

Përkundrazi, dëshmia më e lashtë e gjuhës shqipe, e njohur gjer tashti, na erdhi katërqind vjet më parë me rapsoditë e me gjuhën e familjeve që, të emigruara në Itali, - meqë atje, deri dje, nuk përziheshin me të huajtë – në të gjitha krahinat, në të cilat u përhapën, e ruajtën në forma identike. Nga kjo, sot, e ndiejmë, pak o aspak, se janë të ndryshme ato të gjuhës së atyre të të mbeturve në vendin që qe yni. Por në tërësinë e gjuhës shqipe ndihet një, nuk di çka, që është ruajtur qysh prej kohërave para përmendoreve të gjuhës helenike dhe që, nëpër to, u përshkua dhe aty mbetet. Janë emra sendesh: *borë, det, dhé, nëmë, dyllë, yll, shi*. Janë emra vendesh: *Pela, Kumatë, Gash, Shkëmbi, Timpë, Tezali*, krahaso: *Thesalia*; *Afër zalli, Farsalia* afër bregdetit, *Gramí*(hone), krahaso: *Krimea*. Janë emrat antropofornikë të fesë helenike: *Zea, Hera, Athena, Ifestia, Dhêmetra, Ha-biri, Afrodite, Deti, Urani, Oqeani*. Këta emra këta që qëndrojnë tek ne si apelativë të forcave të natyrës që ato perëndi simbolizonin. Helenët i kishin marrë së jashtmi, në kohë të hershme, pa i kuptuar ose duke ua pasë harruar domethënien.

Këto fjalë, qysh prej banorëve më të lashtë të Greqisë, kaluan në gjuhën helenike; pra nuk i përkitën asaj. Dhe, sot, ato shqiptohen e tingëllojnë shqip në shtëpitë tona.

¹⁹ *Pelasgi ed Elleni*, Anno II, Nr. 5, Cosenza, 20 settembre 1885.

Herodoti, një prej shkrimtarëve më të vjetër helenë, e la të shkruar se, në kohët e tij, Greqia ishte e banuar nga dy kombe. Njëri ishte vendosur atje që prej lashtësisë e ky ishte populli *pellazg* = plak; kurse tjetri, d.m.th. populli helen, erdhi më vonë aty, dhe shtyu drejt veriut banorët që nuk iu nënshtruan. Histmani thotë se një numër i madh i banorëve që qëndruan, ndejtën në të njëjtat zona të përbashkëta dhe u shkruan me ta. Nga sa i kish dëgjuar Herodoti, pellazgë flisnin një gjuhë të ndryshme nga ajo e helenëve. [Dijetari i lashtë tregon] se gra helene athinase, të grabitura nga pellazgët e Lemnosit, u mësuan, pastaj, të bijve gjuhën e vet për t'i vënë kundra bashkëshortëve. Kështu, ato, duke qenë krenare, por të fyera, sepse ishin të lindur në shtëpi më të mëdha, më luksoze se në atdheun e tyre, ishin zonja e pellazgëve.

Ai thotë edhe se perënditë e Olimpinit helenik, me përjashtim të Poseidonit dhe nuk di cilit tjetër, kishin prejardhje nga kultu pellazg. “Pra, - (thashë unë kur e lexova këtë) – shqiptarët janë pellazgët e Greqisë, dhe duket se si, në shpirtin e etërve tanë, ka qenë, me tërë thjeshtësinë e pastërtinë e vet, besimi në zotin e botës nëpërmjet të kultit të krijësive të tija”.

Edhe, sot, këta dy popuj, - ashtu siç duhet të kenë qenë në kontakt me njëri-tjetrin dhe heshtazi të kenë huajtur ata emra e kush e di sa të tjerë, gjenden diku afër, diku ngjitur ndër fshatra të shpërndara. Dhe, ndërkaq, gjuha e njerit është, për nga të lindurit, e ndryshme nga ajo e tjetrit.

Dhe ndryshimi i emrave epirotë, maqedonë, shqiptarë, etj., janë pëlhuara merimangash, të cilat i gris fladi më i lehtë. Fjala pellazg nuk qe emër populli, por shënoi ata që ishin ndër ato vende para helenëve, sepse çdo fis i një populli, deri sa më i forti i tyre nuk i pat mbërthyer në një dorë, ruajtje, gjithmonë dhe vetëm, emrin e vet të mirëfilltë. Sot thirret Arbëri tërë lugina e Vijosës, deri aty ku, dikur, ndoshta, Epiri bashkohej me *Ilirinë greke*, e, ne, të shpërngulurit nga ajo trevë, e mbajtën emrin *Arbërësh* = *Apirezi*. Kështu shqiptarë quhen deri më sot ata që helenët e latinët i emërtonin Keravnii, që vjen nga fjala *shkëpten*, d.m.th. vetëtimë.

Pak kohë më parë, Gustav Meyer shkroi, në Itali, se shqiptarët janë një degë e ilirëve: Por, më poshtë nga kodrat e Eugones, a nuk gjenden varre të këtyre? Nga niset ai për t'i zëvendësuar pellazgët me ilirët? Ç'material kemi ne nga gjuha e atyre ilirëve për ta krahasuar me shqipen, që të zhdukim mandej pellazgët, prej gjuhës së të cilëve kemi

gjurmë [të mjafta], të cilat Herodoti i gjeti edhe në Italinë e Poshtme?

Fjalët shqipe që i gjejmë sot në fenë e Lacios edhe me vështrimin që i përdorim ne, na bëjnë të argumentojmë se në Italinë e Poshtme, sikurse në Greqi, jetuan stërgjyshër tanë. Dhe, pastaj, gramatika jonë sa shumë nuk përputhet me atë të italianëve! E dimë fare mirë, pastaj, se latinët e shkelën dhe e kolonizuan Ilirinë greke dhe sunduan Epirin. Dhe prandaj, endë tingëllojnë ndër né fjalë të gjuhës së tyre. Por, sigurisht, ata erdhën këtu me fenë e tyre të lashtë. A mund të na thotë, tash, ndokush se *Vesta, Jovi, Elici, Diana, Pani, Angerona, Dhia, Lari*, etj. me kuptimin që patën dhe kanë, dihen prej sllavëve?

Por le t'i lëmë fjalët, me të cilat humbim kohë, sepse etërit tanë nuk lanë shkrime të gjuhës së tyre. Ata nuk mund të na linin, sepse fati desh qysh nga kohët prehistorike që ata të mos jetonin kurrë në qytetet e tyre. Populli helen, duke qenë më i zhvilluar e i qytetëruar, mbas fitores në vendin e tyre dhe duke pasur gjithë të mirat e jetës, u duk se vetëm ai ishte bujar e i ditur.

Populli i lashtë vendas [pellazg], që nuk u bashkua me helenët, u përfshi në shtetet e këtyre, u shpërnda nëpër fshatra dhe u rrinte pranë ndër bëmat e ndër fatet e tyre; kështuqë lejonte të delshin në pah vetëm helenët.

Erdh, pastaj, vërtet koha, në të cilën një fis pellazgësh, i mbledhur në kufirin verior të Heladhës, fisi i maqedonasve, ia nisi dyluftimit dhe doli fitues kundër fitimtarëve të stërgjyshërve të tij. Ky fis u udhëhoq nga Filipi dhe nga i biri i tij [Aleksandri]. Por ky i ri, që ishte princ dhe e ndiente veten prijës të njerëzve, i nxitur nga ideja për t'u bërë zot i Tokës, pa u menduar për asgjë, filloi, menjëherë, luftën me Azinë. Përdori, përkohësisht, gjuhën e helenëve, sepse në shkollën e këtyre ai ishte edukuar, dhe i desh edhe si shokë me vete, kudo që vajti. Jo për këtë gjë, ata [helenët] mbetën me një pikëllim të zi në zemër, por sepse këtyre iu duk se shkuan si këmbësorë të maqedonëve. Së fundi, maqedonët e shtynë përtej atdheun e këtyre njerëzve të largët, që e shihnin tashti nën këmbët e latinëve. Dhe, mbasi ajo dritë, e pashoqe në botë, qe shuar, ndasitë e prijësve maqedonë filluan të vlonin.

Porse helenët sollën të njëjtin fat, por jo fisnik, për të dy popujt; në të cilin, pak nga pak, qitën në harresë dhe shuan çdo cmir, të cilin e sjell gjithnjë, mirëqenia. Të tjerët i quanin të gjithë së bashku grekë, e pastaj romej, maqedonë, epirotë.

Deri sa nuk di prej sa larg ia behën të huaj të tjerë për t'ua marrë atyre hem tokat, hem fetë e gjyshërve, edhe fatkeqësia në anën vjetër, i pat katandisur të kishin dëshira të përbashkëta, ku edhe fjalët i huajtën njeri nga tjetri. Heladhën dhe Shqipërinë, ndër ditët tona, po i shohim të ngritura së bashku me mundim për një bashkim, në të cilin fronti i shkëlqyeshëm i Greqisë së lashtë, i ringjallur, të mbështetet në forcën e të dy popujve. Porse ato Europa u mundua, ndoshta, t'i ndajë, sepse, kur vonë ajo ua ngjiti dorën atyre, u shfajsua duke u vënë përpara detyrimin që kish me Heleninë, prej nga i kish ardhur kaq dritë mendore; dhe, si e mënjanoi Shqipërinë, nga gjoksi i së cilës ishte ndezur e mbajtur gjallë zjarri, e rrumbullakosi Heladhën ndër kufinj që e dinte se ajo i kishte pasur. Nga ky fakt lindi faji në shpirtin e helenëve, të cilët e patën kështu se u shpërblyen vetëm ata. Dhe pleqëruan mes tyre të helenizonin shqiptarët dhe sidomos ata që i kishin mbetur prej jashtë; me qëllim që kur, pastaj, të mund t'i tregonin si pjesë për vete, t'i kërkonin Europës që t'ua epte si pjesë që u përkiste.

Duke marrë qëllimin e keq të helenëve e të Malit të Zi, me marrëveshjen e tyre, pas së cilës serbët e bullgarët u mbështetën pors i sllavë nga ana e kombësisë, me qëllim që këtë marrëveshje ta përdornin në dalinë e tyre planin, po shihet qartë se ata kërkojnë për t'i shkëputur pjesë Shqipërisë së mjerë, të cilën e duan ta bëjnë si dhuratë Hyjneshës së Heshtur. Dhe themeluan shkollën që duhet ta bindë “se ajo është e një gjaku me to, prandaj të mos i vijë rëndë të hyjnë për të shërbyer në shtëpitë e tyre”.

Por Zoti, që nga vdekja nxjerr jetën, e hapte bash sot kohën e saj në ditët e botës. Prej kudo ku ishte i shpërndarë, si komb, i shtyrë, njëherit, nga një këshillë i natyrshme, ia nisi të lëvrojë gjuhën e vet, që është jeta e futur si gjak në një komb. Ai, do të thoshit, na mbajti në mërgim të gjatë e paqësor në që kemi qëndruar deri në këtë çast, dhe i dha popullit osman të veçuarit e të shestuarit në gjuhën kombësinë tonë, që iu duk sikur kish shkatërruar çdo nder krenar tonin, kur as Leka, as Skënderbeu nuk e kishin mundur ta sjellin ndër mend një ide të tillë. Le të bekojmë Atin ndër qiej, që të mos na largojnë prej nesh faje të reja dritën e vonë që tejduket edhe në mes resh.

19. KOLEGJI ARBËRESH NË SHËN ADRIAN20

(Përshtatje në gjuhën e sotme nga dialekti arbëresh)

Mbasi që gjeni i së keqes nuk pati mundur ta shtynte mëmëdheun tonë, të rrethuar nga pusitë, në një kryengritje, ku do të mbeteshin bijtë e saj o të vvarë o të plagosur o të çuar, pastaj, të lidhur duarsh ndër fqinjët e saj, një sihariq po përhapet në Itali, ku ne “të dalurit nga një vuajtje e madhe” gjetëm strehim. Mbasi mëmëdheu ynë nuk fliste, [kombet e afërta] besuan se do të heshtëte përgjithmonë dhe Heladha, meqë popullsitë qëndrojnë të përziera e fqinje në një vend kaq të madh, filloi t’i ndalonte para kohe shkollat kombëtare, dhe ta merrte e t’i jepte gjuhën e vet, me qëllim që Shqipëria të mbetej e pagdhundur për Greqinë, në padituri dhe si shërbyese. Prandaj ne nxorëm në dritë një të përkohshme shqipe. Më përpara disa zotërinj [bujarë] të huaj e shumë të shquar, na gërganë e na thanë se ne po e ndanim fatin e Shqipërisë nga ai i Heladhës, duke i bërë që të dyja të dobëta. Ata nuk e dinë se sot, të veçuarit nga Greqia na bën që të jemi gjallë, kurse bashkimi do t’i jepte fund qenies sonë. Për këtë arsye, si rrjedhim, ata kërkojnë që ne ta tërheqim *Fiamurin e Arbërit (Shqipërisë)*, duke e ulur për tokë përgjithmonë.

Na është lejuar t’i kapërcejmë gjëra të tilla, meqë i përkasin të shkuarës, nga momenti që aktualisht mendimet tona janë kthyer përtej Shkollës tonë, për të cilën as Turqia, as Heladha nuk mund të na ndihin, por që pret të rregullohet. Ministria e Arsimit, e cila e njeh këtë shkollë dhe e di se ishte nder për Italinë, në mënyrë që ajo të futet në rrugë të mbarë e të ngrihet me shkëlqimin që pati nën Mbretin e

²⁰ *Cuventi i Arbërësh Shen Triaan*, (*Collegio Albanese in S. Adriano*), Anno III, Nr. 10, Cosenza, 20 febbraio 1886.

Napolit, zgjodhi dhe dërgoi si përfaqësues të vullnetit të saj një Zotëri, të një familjeje të mirë, të matur e dashuror të dijes e të qytetërimit. Uduk sikur dhe shpresojmë të jetë kjo ora në të cilën të përmbushet vullneti që e frymëzoi themelimin e këtij institucioni e të jetë ajo fanar drite për Kolonitë, dritë e cila të përhapet edhe në Shqipëri. Kësodore, nga të gjitha anët, po ndizet dëshira që në atë shkollë të kemi sërishmi Kishën sipas riteve të të parëve tanë, si dhe një kopsht, i cili na mungon sot, në gjuhën pellazge të cilën flasim ne. Lungro më e para, një koloni e kultivuar e më e rëndësishmja e Kalabrisë, por edhe të tjerat do ta ndjekin pas shpejt, ia parashtroi duke iu lutur këto nevoja Komisarit të sapoardhur. Nga ana tjetër, për ç'arsye Kolegji duhet të jetë nën varësinë e Ministrisë së Kulteve (fesë) përveçse për arsyen e fesë sonë, mbrojtja e së cilës i qe besuar po këtij Kolegji?

Nga ana tjetër, një Kolegji arbëresh, ku shqipja të mos mësohet, është diçka e zbrazët, sot që dera e vendit, ku lamë shtëpitë, na është hapur, ndihet nevoja që ta studiojmë. Pastaj është nder i madh për atë Itali që të japë, prandaj, kyçin pellazg për hulumtimet në botën parahistorike, që nga të gjitha anët sot dëshirohet dhe përbën përpjekje për ta hapur. Dhe kur katedra e saj të jetë themeluar, e dimë që familje shqiptare të përtej detit do të dërgojnë bijtë e vet për t'i edukuar aty. Le të zhduken pra në mes tonë keqkuptimet dialektore dhe pengesat për bashkimin vëllazëror; le të bëjmë që Shqipëria të lidhet me ndjenjë mirënjohjeje e me tregti me tokën latine, meqë ishte ajo që na priti në fatkeqësi dhe na ushquu e na veshi si të vetët. Qe një kohë kur nga Epiri Andromaka, atje tej në bregdetin e Jonit, plot lot vështronte njerëzit e një gjaku të saj të përbashkët me Pallas Athenën të nisur në det për të ardhur në këto brigje, dhe atyre u uronte fatbardhësi, dhe lutej që ajo (fatbardhësi) të ishte e përbashkët për të dy anët.

20. HYJNIZIME ETNOGRAFIKE

(Përshtatje në gjuhën e sotme nga dialekti arbëresh)

Në vitin 1829 erdh nga Shqipëria në ngulimet tona një njeri që kish qenë në shërbim të Ali Tepelenës dhe hodhi në shtëpinë time vallen e trimave, që s'ishte tjetër veçse një kërcim. Atë valle unë e kisha parë më se një herë duke u hedhur nga pleqtë tanë – dhe ta dish se ka edhe të tjerë njerëz të shtyrë në moshë, ndër ngulime të tjera tona, që kanë qenë pranë në të tilla valle – dhe ishte ajo në masën koraike (trokark). Në këtë valle, këmba e djathtë mbështetet me forcë në tokë, dora e djathtë shtrihej poshtë afër kofshës, thua se do të mbështesë heshtën në tokë; ndërkohë, dora e majtë çonte rrylin para ballit, sikur ta mbulonte ballin me mburojë.

Ky ishte në kohën e lashtë këcimi me prejardhje nga Shqipëria, i cili, duke e pasë marrë emrin nga Pirroja, i biri i Akilit, që quajtur *vallja pirrike* (valle burrash). Kërcimi, që u mbeti salëve në Romë nga shokët e Eneut frigj, të cilët e kërcyen të parët në Itali, siç e la të shkruar Palemoni “këcimi me armë”, kërcimi i salëve ishte krejtë i njëjtë me vallen pirrike (burrënore). Kjo është një gjurmë e vogël, po e vërtetë e unitetit (e njësisë), ndoshta, të atyre fiseve të shtyrë drejt vendeve të largëta.

Po le të kalojmë më tej. Salët e Romës nuk e mbanin në dorë mburojën e vogël qytetare, por peltën (mburojën) sferike trakase. Kush qenë trakasit, kur asnjë nga popujt që banojnë në Ballkan, nuk dinë se kanë në vetvete ndonjë gjë që mund t'i përkasë popullit trakas, që të ketë mbetur prej tij. Duket se ai nuk ka lënë asnjë gjurmë të veten, si të mos kish qenë fare. Por s'dihet që ndonjë popull i zhbimë aty pas ardhjes së Krishtit, të jetë shfarosur si bishët; pra ai që farefis me popujt të tjerë të së njëjtës kombësi, që ende flet gjuhën e lashtë. Nëse sllavët e Ballkanit nuk kanë si të lidhen me atë kombësi, atëherë është

e ditur dhe e qartë se Trakia ishte e huaj për Heladhën. Dhe ne do të donim që në kërcimin me armë të lindur në Epir, dhe i përbashkët tek shokët e Eneut me peltën trakase, të ndiqnim një fill të hollë sa të duash, por që s'është këputur, dhe lidh, ndoshta, me një farë farefisnie trojanët, trakasit e shqiptarët, që nga vise të ndryshme morën emra të ndryshëm po ashtu, si maqedonë, epirotë, thesprotë, ilirë, etj. Në sa *pelta* do të ketë qenë *peta* që ne e kemi gjithnjë edhe sot. Janë, pothuajse, 400 vjet që mburoja erdh duke u lënë mënjanë nga ushtritë. Kur u mërguam, në punë e sipër nuk përdoret më, vese i ka mbetur emri. Në dasmat qytetare, të enjten që vjen para së dielës së martesës, në shtëpinë e dhëndrrit gatujmë me miell, sheqer e vezë petën, një mburojë në formë sferike, e lartë më tepër se dhjetë centimetër, më e gjerë se një shoshë, dhe e stolisur sipër me rilieve që paraqesin qeniet e jetës; dhe të shëmbëlltyrës së të cilës, siç na njofton Homeri, ishte mburoja e Akilit pellazg. Dhe prej këndeje kuptohet se në shtëpinë e dhëndrrit, i cili quhej “qiparis, për t’u mbështetur hardhija”, gatuhej *peta* (pelta trakasa), simbol i strehimit për mbrojtje që nusja do të gjente aty në shtëpinë e burrit.

Po të shkojmë më tej për Rezin, mbret i Trakisë, që vajti për të ndihmuar Trojën, na flet farefisnia e saj me shokët e Eneut; edhe kuajt e tij me nam na kujtojnë atë që qe lavdi i Shqipërisë në të gjithë popujt e saj, me fjalë të tjera, dua të them se të parët tanë janë ushtruar (stërvitur) me kuajt të pashoq.

II.

Nuk është për t’u çuditur nëse duke ndjekur gjurmën e brezave të zhdukur me kohën, – e nga se do t’ua ndiejmë atyre më fjalën? – do të na duhet të shkojmë pas, - siç do të thoshte ndokush, - fyzash ashtu si i merr era.

Por ka mbetur një fjalë e Pirros, e cila, si thëngjill i pashuar, ndriçon gjuhën e atij mbreti, gjuhë që qe shqipja.

Ndër fragmentet e Enit kemi se ai mbret dërgoi t’u thonte romakëve:

Ferro vitam utrique,

Vos ne velit an me regnare Hera; quidve ferat Sors

virtute experiamur. . .

Dikush e përktheu vargun e dytë /kështu/: “Në shenjoftë Junona

që ju ose unë të sundoj". Por, duke e pasë përkthyer keq, i thanë sepse Junona nuk ishte hyu udhëheqës, as i betejave, as i të dy kombeve luftëtare. Për ta ndrequr këtë, mbasi Hera për ta ishte fjalë latine, e lidhën me subjektin tjetër *Sors*, gati si Hyjnia fat, vese këtu humbiste bukuria dhe të qenit e dy ideve të ndara.

Por domethënia del e qartë duke dalluar në /fjalën/ hera një fjalë shqipe, që përdorej ndër fjalët e huaja. Hera, për ne, është çdo shfaqje vepruese e kohës; dhe në këtë kuptim përdoret edhe sot nëpër gojët tona. Dhe ai varg duhet përkthyer /kështu/: "Qoftë për ju, qoftë për mua, sjellte mbretërimin Koha", sepse Eni atë fjalë ka dashur ta ruajë së bashku me krenarinë aq të madhe të shpirtit shqiptar, dhe për nder të *Burrit* të famshëm, ashtu sikurse emrin në gjuhën e tij dhe ndryshe nga latinët, edhe për faktin vjetër, sepse fjala shqipe *Hera* përmban më fort se *tempus*-in e latinëve, jetën që ishte, - si të thuash, - në gjakun e atij poeti, i lindur në kolonitë e Kalabrisë.

15 tetor 1886

21. PËRPARIME NË KLASIFIKIMIN E GJUHËS SHQIPE²¹

Gjuhëtari i madh Podhorsky më shkruante: “Ju kam dërguar një dorëshkrim mjaft të vëllimshëm në lidhje me farefisninë e shqipes me gjuhën keltike (armorikane, galeze dhe kornikën e shuar tash 150 vjetë); por ajo që do t’ju çudisë më tepër është farefisnia me gjuhën egjiptiane, me të cilën ka, bashkë me gjuhën kelte, të njëjtin formim leksikologjik, nga i cili kam zbuluar hollësitë. – 19 tetor 1886.

Duke e pasë kryer fatbardhësisht Fjalorin etimologjik neoegjiptian, kam ndërmarrë, me sukses, jo për herë të parë, analizën e Fjalorit arab, gjë që asnjë dijetar nuk e ka shprishur. Kështu enigma e fjalëve me dy e tri rrënjë është bërë një dogmë, me gjithë absurditetin ilogjik. Janë bashkuar parashtesat foljore me vetë rrënjën. E kam kryer detyrën time, dhe do të nisem, po që e mundur, pa brerje ndërgjegjeje dhe pa keqardhje. – 30 nëntor 1884.

Këto fjalët e fundit na kanë hidhëruar, duke na u kujtuar sikur të jenë bërë për të, vargjet e Poemës së lexuar në inaugurimin e trupores së Berliozit, një tjetër hungarez i lënë më një anë dhe i harruar nga Atdheu.

Po, ditët tuaja qenë ditë të pafarë.

Po, donin për ty përbuzje të zgjatura dhe hije,

Ku shpirtrat e errët mbajnë prekursorët:

Por lufta nxiste lart dëshirat tuaja dhe ëndrrat tuaja,

Dhe në të gjitha luftimet, në pushimet e shkurtra

Vuajtja dhe guximi në shpirtin tënd ishin motër e vëlla.

15 nëntor 1886

²¹ *Progressi nella classificazione della lingua Albanese*, Anno III, Nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886.

22. GJURMË TË VENDBANIMEVE TONA TË LASHTA QËVAZHDOJNË TË QËNDROJNË ENDE MIDIS NESH²²

(Përshtatur në gjuhën e sotme shqipe nga dialekti arbëresh)

Dhe kështu, gjithnjë e më tepër bëhet dritë mbi atë që nuk dinim. “Nga cilat treva erdhëm ne? Ku lindën Rapsoditë? Cilit prej kombeve të vjetër i përkasim?”

I. Gjejmë edhe në Shqipërinë e Poshtme se, me të tjerat, këndohet Rapsodia e dytë e librit të parë të *Bëmave të herojve*.

S’ëmës vanë e i thanë:

“Ta zū gjarpëri t’ët bijë!

Nd’ e zū gjarpëri, u shëroftë,
ndë e zū trimi, u trashëgoftë”.

Dhe, në këngën e botuar te *Bleta Shqiptare*, në faqen 58, numri II, ndiehet jehona e Rapsodive: “Vjen marsi, mirë se vjen”.

II. Koha në të cilën kemi ardhur këtu në Itali, është e njohur: Kur patëm zënë ato brigje, prej nga u mërguam, fjalë o përmendore tjetër të lashtësisë nuk përmenden drejtpërdrejt deri tashti. Vetëm mundemi, në bazë të arsyes, të mbështetemi në besimin se, si qëndrojnë sot punët, të tilla duhet të kenë qenë edhe ndër kohë të largëta. Padyshim, në atë mënyrë siç ishin të zëna ato brigje deti në kohën e Strabonit, janë edhe sot.

“Këto janë pra kombet e vendosura mes Istrit dhe maleve të Sllovenisë e popullit trak, - siç e la të shkruar ai në librin e shtatë të Gjeografisë së vet. Nga këto male kanë mbetur shpati jugor dhe fushat përposhtë deri ndër detra, ku është Heladha dhe ata popuj të

²² *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora, Anno III, Nr. 7, Cosenza 15 novembre 1887.*

huaj që i rrinë përreth. Hekateu prej Miletit shkroi se, në Peloponez, para helenëve, kishin zënë vend të huajt, bile përpara se mbarë Greqia të ishte banuar ndër kohë të qëmoçme prej të huajve. Ndër të tjera, Atika ishte pushtuar nga trakasit që kishin ardhur me Eumolpin. Që atëherë e deri më sot, trakasit, epirotët e sllavët rrethojnë Greqinë e, edhe tashti, prej saj kanë ndonjë pjesë. Thesprotët, Kasiopejtë, Anfilokët, Mollosët, Atamanët, fise epirotike [shqiptare], zënë skajet e sipërme të Akarnanisë e të Etolisë.

“Fiset epirotike, - siç tregon Teoponpi, - janë katërmbëdhjetë, dhe ndër to më të famshmit qenë Karnët, Mollosët, prej të cilëve ishte familja e Eacidëve, gjithashtu, për shkak të Orakullit të Dodonës. Tuqididi tregon se, si u kthye Anfiloku nga Troja, mbasi Argosi, vendlindja e tij, filloi ta shikojë me sy të keq, iu desh të strehohej tek i vëllai Alkmeoni, që kish zënë vend që prej kohësh në Akarnani, ku u ndal, dhe, si vdiq ai, erdh në fronin e tij, dhe e ndërtoi Anfilokinë.

“Anfilokezët janë tani një popull epirotik[shqiptar], dhe, me të, të gjithë ata që banojnë më lart nëpër malet deri aty ku bashkohen me sllavët: Mollosë, atamanë, etinkë, tinfej, orestiej, parorë, atintanë. Në mes këtyre, qëndrojnë, andej-këndeje, të përzierë bashkë katunde (sllave), të cilat kaluan këndeje, në trevën e maleve që vështron nga jugu, sepse tokat malore përkëtej, nga Durrësi e Apollonia deri ndër Akrokeraunë, janë të mbajtura prej fiseve epirotike të Vilionëve, Taulantëve, Parthenëve (*Albanë*) e Frigasve.

“Ata që nisen nga Apollonia (Vlora) e nga Durrësi, vijnë e përpiqen (takohen) njëheri në udhën Egnatia, e hapur nga romakët. Kjo rrugë, në pjesën e parë, e ka marrë emrin nga Kandavia, mal sllav, dhe pastaj përshkon Pilonën, ku ajo ndan tokën sllave të Maqedonisë dhe kalon nëpër Herakle, Edesë, Pela deri në Selanik. Kështu, atij që i takon të ecë nëpër këtë rrugë, i mbesin në të majtë malet sllave, ndërsa në të djathtë fiset epirote deri në gjiun e Artës, qytet epirot shumë fisnik në kohën e vet, kur Pirroja kishte aty fronin e vet. Më tej, në të djathtë të atij që hyn në gjiun, janë disa fshatra helene të Akarnanisë.

“Si të kalohet Arta, vendi, që është në midis, ndërmjet së djathtës së Egnaties dhe të së majtës së Peloponezit, përmban fiset e Maqedonisë e të Peonisë deri në Strimon. Mbas atij lumi, deri në Em dhe deri në grykë të detit më të madh, shtrihet Trakia. Vetëm gjatë atij, brigjet e detit kanë aty qytete helene.

“Territori i lingistëve, i palagonëve, i orestiadëve dhe i emëve ka pasur edhe emrin Maqedoni e Sipërme; dhe ka nga ata që tërë vendin deri në Korkirë e quajnë Maqedoni, për arsye se *të gjithë së bashku flasin të njëjtën gjuhë, vishen njësoj e mbajnë flokë në një mënyrë; Edhe ndër zakone janë të ngjashëm dhe të një familjeje*”.

Këto gjëra Straboni ua la të shkruara trashëgim pasardhësve. Dhe asgjë s’duket se ka ndryshuar nga ajo gjendje. Vendi, si në kohën e vet të lashtë, është i populluar nga shqiptarë. Këta mbajnë, gjithnjë, Atikën. As nuk mund të zhguleshin krejtësisht nga Greqia, të cilën e shkelën helenët. Dhe nga Peloponezi zënë endë këtu gjysmën. Një është gjuha e të gjithë atyre bashkë [gjuha e vendit epirot është e përbashkët]. Një pjesë prej nesh ikëm (u larguam) s’andemi para katërqind vjetësh. Disa të tjerë nuk e lanë kurrë Greqinë [mbetën atje]. Këta bënë për vete më tepër fjalë greke; ne, përkitej huazuam fjalë italiane, sipas Hyjnisë së Fatit.

Por, për këtë ndryshim kombësie, mes Epirit e Heladhës, kemi dëshmitar Virgjinin (*Eneide*, libri III). Eneu thotë aty se si arritën në Leukadë: “Këtu, të lodhur, u ndalëm dhe erdhëm në qytetin e ngushtë.

Kremtojmë ne

Lojrat trojane në bregdetin aziatik.

Kënaqen mes tyre me gjithë ato qytete argolike

kaq fort të përhapura, duke u përshkuar përmes

armiqve.

(Përkthim i Princit Pinjатели).

Por thonë: “Megjithatë, nuk përmbahet tërë Shqipëria në trevën që shtrihet prej Vlorës deri në Artë, sepse nga Vlora shtrihet, në anën vjetër, drejt Veriut deri në Mal të Zi. Në këtë trevë ishte Iliria. E, prandaj, pikërisht për këtë, një gjuhë e vetme flitet nga Mali i Zi deri në Artë dhe më përtej. Populli ilirik është ai që shtrihet deri në kufinj të Heladhës. Dhe kjo është Shqipëria që na rri sot përpara”.

G. Meyer mundohet ta përforcojë këtë opinion, nëpërmjet fjalëve latine të përhapura, gjithkund, në gjuhën shqipe, të cilat - thotë ai - kanë mbetur, së pari, prej latinëve, kur Roma e mbajti nën vete të skllavëruar Ilirinë për një kohë të gjatë. Por ky sendergjim arsyetimesh nuk ka ndonjë bazë më të fortë se sa tjetri, që ata janë të një gjaku me shqiptarët e Kaukazit, sepse gjoja të dy paskan të njëjtin emër. Vetë

Straboni nuk gjeti ndër ato treva të tjera, veçse tre popuj: Keltët, Sllavët, Trakasit. Ilirët nuk përbënin një komb, por qenë fise kombesh të tjera, që e morën emrin nga vendi o ndryshe. Ai nuk flet për gjuhën e tyre, gjë për të cilën ai i dallon banorët e Epirit nga popujt që i rrethonin, dhe që ishin të ndryshëm me gjuhë edhe nga helenët. Njihej atëhere vetëm kjo që Iliria e Sipërme ishte e zënë nga sllavët, kurse Iliria e Poshtme mbahej nga popujt që qëndrojnë endë aty dhe, duke u shtrirë nga jugu, bashkohen me helenët; e ajo kishte emrin Iliria greke. E nga që, pastaj, - siç shënoi dhe nxori në dritë Benlevi – helenët, që pellazgët e lashtë i gjetën aty dhe me të cilët u përzien, qenë quajtur, më vonë, së bashku, grekë. Ky fat na ngatërron, sepse ne jemi kaq të huaj e të ndryshëm njëri nga tjetri.

Këto gjëra mund të vijnë në kontradiktë njëra me tjetrën nga mungesa e dëshmimeve, por jo nga arsyeja, sepse janë pikërisht kështu siç paraqiten.

Të bëjmë vetëm këtë pyetje: Kush e ku qenë, në kohën më të parë, ata që banonin atje si të huaj për sllavin dhe helenin, për të cilët Straboni diti e dalloj gjithë ato fise të emëruara në mënyra të ndryshme, e pastaj dalloj emrin e trevës, në të cilën qëndronin, por jo më tjetër, mbasi që deri dje nuk u qe dhënë atyre ndonjë emër kombëtar.

Edhe për këtë unë kam në vetëvete një *besim të patundur* që kombi i përbashkët me atë fis është ai i vendosuri, që së lashti në ato treva, mbi të cilat erdhën e u vunë pastaj helenët dhe u ngulën aty. Ky fis, me emrin e nxjerrë nga fjala *plake* gjuhës së vet, u quajt pellazg, si atje ku qëndruan të bashkuar e vetëm, ashtu edhe aty ku ishin të ndarë nga njëri tjetri, për shkak të vendosjes së të huajve në mes tyre.

Mbasi pata lexuar tek Herodoti, më 1841, që hyjnitë e helenikë patën lindur nga populli pellazg, gjë të cilën ai e pa dhe e gjeti, siç e pamë në trevat ku në kohën e Strabonit banonin shqiptarët, dhe, mbasi pata vërejtur që emrat e atyre perëndive ishin fjalë shqipe, me të cilat shënojmë edhe sot pjesët e natyrës të fytyrëzuara në ato perëndi, njoha poshtë, nën dritën e kthjelltë, që ata pellazgë, *autoktonë* të Greqisë, jemi ne, përballë të huajve, që erdhën pastaj.

15 maj 1887;
15 nëntor 1887

23. KOLEGJI I SHËN ADRIANIT²³

Po e pezullojmë vazhdimin e artikullit të së përkohëshmes *Presse* të Vjenës, për shkak të një lajmi, që s'mund të lihet pa u përmendur.

Së shpejti, do të dalë një broshurë që përpiqet e lufton për aneksionimin e Kolegjit italo-grek të Shën-Adrianit me Institutin Peculo dhe për vënien e të dyve bashkë nën një administratë të vetme, duke i përdorur për dobi të të gjithë kalabrezëve. Ndihet nevoja që, njerëz bujarë të Ngulimeve (Kolonive), të ndihmojnë me oferta, sado të vogla, për të përballuar shpenzimet e shtypit. Por të pakët janë ata që e ndiejnë rëndësinë e kësaj pune.

Para së gjithash, shënojmë se kjo ndihmë për shtypin do të përdoret për të paguar ata që do të bashkëpunojnë në mbrojtjen (me shkrime) të broshurës, e cila nuk ndihet si do të jetë.

Tani del çështja në se Instituti Peculo, vend bamirësie për kala-brezët, a do të vejë më mirë, duke iu ndërruar administrata, dhe në se i ka të dhënat e duhura që kërkohen nga ligji i ri mbi vendet e përshpirtëshme, dhe, po për këtë gjë, në se do të veprohet sipas Dekretit mbretëror, a do të jetë kjo një vepër e mirë qytetarie. Po ç'ka të bëjë këtu Kolegji arbëresh?

Ky qe themeluar prej Selisë së Shenjtë për arbëreshët e krahinës së Napolit, me cilësinë si Seminar Papnor, caktuar për mbajtjen e ritit grek në Ngulimet e tjera dhe për kulturën përkatëse të vetë atyre. Këtij qëllimi i qëndroi edhe më pas. Kjo autonomi e tij nuk qe refuzuar nga Parlamenti kombëtar që, duke administruar pasuritë kishtarë të shtetit, nuk mendoi as nuk i preku pronat e tij.

Përkundrazi, meqë mbas vitit 1850, (duke mos qenë aty peshkopi grek kryetar i përhershëm i seminarit për vulat e themelimit) qeveria borbonike ua kish lënë kryesinë e administrimit fetar peshkopëve italianë, diktator Garibaldi, me Ligjin e 26 tetorit 1860, urdhëroi të

²³ *Il collegio albanese S. Adriano*, Seminario Corsini, Tipografia economica, Catania, 1891.

mernte fund shpërdorimi, “që Instituti t’u kthehej drejtuesve natyrorë të tyre, në bazë të ligjit të themelimit të tij; dhe, për sa kohë që do të mungonte peshkopi, urdhëroi që t’ia zinte vendin (ta zëvendësonte) një komision prej tre priftërinjsh të rritit grek”. Por, me emërimin pastaj të peshkopit Buljari më 1876, dhe ai e mori vetë ky kryesinë e Kolegjit, konsulta e mori parasysh të drejtën e tij dhe ngritjen e komisionit për shërbim të përkohshëm; kështu, me dekret mbretëror atij i qe ngarkuar Kolegji, si drejtues natyror që ishte.

Ministri Mançini, me të vërtetë, duke mos iu përmbajtur dekretit, e emëroi Buljarin kryetar jo të Kolegjit, por të Komisionit. Tani, ministra të tjerë e kanë prishur Komisionin, dhe e kanë vënë, përkohësisht, veten në vendin e peshkopit.

Duke marrë parasysh gjithë këto fakte, që parashtruar deri tashti, del e nevojshme kërkesa për ta vënë [Kolegjin], një herë e mirë, nën administrimin e caktuar me dekret mbretëror. Po cili nga bijtë e lindur nga familje arbëreshe do të ngrejë dorën tradhtarë që të përmbysë strumbullarët e patundur deri tani, që për ne e mbajnë me pronat që i janë dhënë për përkrahjen e edukimit mendor e moral dhe të riteve fetare të popullsisë arbëreshe?

Është mbyllur edhe rruga, nëpërmjet të së cilës Shteti dhe Provinca të vinte e të paditte administrimin e Kolegjit, si Vepër e përshpirtshme, që e ka humbur drejtimin. Dhe, mbasi që Klementi XII e pat themeluar, Qeveria e Napolit nuk pranoi që ai të hapej në krahinat e saj, për arsye se ndër ato nuk mund të ngrihej ndonjë *Vepër e përshpirtshme*, veçse duke paralajmëruar, më parë, mbretin. Selia e Shenjtë, së cilës iu drejtua, u përgjegj se ajo nuk ishte Vepër e përshpirtshme, por një Seminar papnor i hapur prej tij në tokë krishtere për arbëreshët e shpërngulur dhe, për këto, Këshilli mbretëror i dha të drejtë.

U shfaq, atëhere, ideja për ta ngritur në Napoli, ku ndihma e Qeverisë do t’i vlente shumë; dhe kështu, më 1813 Jakin Murati, me të njëjtin qëllim, vendosi, me dekret mbretëror, që ai Kolegj, transferuar në Katanzaro, të ngrihej e të bëhej licé i të tria Kalabrive. Por peshkopët kryetarë dhe Kolonitë, duke parë që nderurat dhe dhuratat nuk po bëheshin në dobi të tyre, e refuzuan, për të dyja herët, transferimin. Tani, më pak se asnjëherë tjetër, nuk do të ishte e nevojshme dhe e ligjshme që ai të ndërrohet në një institut qeveritar.

Ajo që sot shumë mendojnë se është me dobi dhe besojnë se mund të zbatohet, pa u sjellë ndonjë dëm atyre që kanë të drejtë lidhur me Institutin,

është që ky institut të vihet në një shkallë me institutet qeveritare, gjë që do të garantonte, në një farë mënyre, aftësinë profesionale të mësuesve. Dhe, për fat, në krye të qeverisjes së Krahinës e të shkollave qëndrojnë dy burra të shquar, të cilëve u vjen keq për gjendjen tonë, na duan fort, dhe mendojnë si e si ta lartësojnë përsëris Institutin, pa e cenuar arsyetimin tonë, duke u përputhur me shpirtin e lartë e bamirës të Komisarit mbretëror që të kujdeset për katër punë. Dhe jemi në dijeni të një ideje të mirë të atyre [burrave] për ta shpejtësuar, sa më tepër, sigurimin e kredive të çdo lloji, që mund të ketë Instituti dhe që, me një veprim bankar të mbështetur mbi ato, të sigurojë mjetet me të cilat të pajisë lokalën, dhe të përkujdeset për orenditë e shkollave. Mbetet, pastaj, si e paditur mënyra se si do të përballohen gjërat e rënda të paparashikuara të mësuesisë; dhe ne besojmë se do ta shpiem përpara këtë.

Por vullneti i Qeverisë, e vendosur që ta rimëkëmbë dhe t'i japë një dinjitet më të madh Kolegjit, mund ta bëjë që, pa pritur më, të rivendoset disiplina, vigjilenca ndaj mësuesisë, rivendosja e shkollës për liturgji e këngë morale për ritin grek të kolonive (Ngulimeve arbëreshe), e mbështetur nga vepra plotësuese e një ati shpirtëror, dhe themelimi i një Katedre “shqipeje të krahasuar”, rëndësia e së cilës, sot, ndihet fort dhe nga çdo anë. Për këto rindërtime mjaftojnë, tashmë, të ardhurat që ka tani Manastiri (Badia) i Shën Adrianit.

Është llogaritur që ato i kalojnë 32 mijë lirat; dhe, le ta zëmë se 12 deri 14 mijë lira të shkojnë për shpenzime erariale (të thesarit publik), të rojës, etj., mbeten të vetë Konviktit arbëresh 18 deri 20 mijë lir. Prej këtyre, nja tetë o nëntë mijë mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e drejtimit të përmvendshëm dhe për dituritë (doktrinën) e sipërpërmendura për nevojat e Kolonivet (Ngulimevet arbëreshe). Pjesa tjetër, rreth 9000 lira, të ndara për secilin nga nxënësit që u përkasin atyre (Kolonive arbëreshe), do të përdoren për mbajtjen (të ushqyerit) e tyre. Ky dallim i të ardhurave të vetë Kolegjit nga ato që merren prej festave të përbashkëta për të gjithë nxënësit, të ruajtura edhe nga mbajtja e barazisë së tyre, do t'u vlejë Kolonive në dobi të edukimit gjysmëfalas, për të cilin kanë të drejtë, në bazë të vullnetit të themeluesit.

(vazhdon)

15 maj 1887

15 gusht 1887

24. MËSIMET PËR GJUHËN SHQIPE²⁴

(Nga vjetërsia, pesë rreshtat e para të tekstit origjinal janë të prishur – J.K.).

Parathënie

Hapja e shkollës sonë të gjuhës shqipe na mbush shpirtërisht së bashku, o bashkatdhetarët, si me ngazëllim ashtu edhe me besim. Italia, qysh nga shekujt XV e XVI na priti ne, që u mërguam nga vendi i të parëve në shekullin XVII, pastaj, ndihmonte themelimin e këtij Kolegji, e Paladit të kombësisë sonë; e ia ngjiti dorën e iu bë krah, pastaj; e shpërblyer nga besimi e devocioni, me të cilët njerëzit e rinj, miq të një gjaku, iu bënë shokë në të gjitha ngjarjet. Por ajo që na sjell e njëjta dorë, duket se na afron drejt atij Fati, për të cilin, ndoshta, Zoti na ka ruajtur të paprishur gjatë një mërgimi prej katër shekujsh, për të qenë, pra, prisat e rinj për Mëmëdhenë në rilindjen e vet intelektuale e morale, që të jetë bazë për rimëkëmbjen e fateve të tija. Shqiptarët, ndërkaq, të cilët banimi për një kohë kaq të gjatë me ta i ka pajtuar me turqit e njësuar me ta (përsa i përket fatit), lidhur me fatin, tashmë, ndiejnë dhimbë për përtëritjen që bëhet në Perandorinë Osmane. Sulltani, i cili sot e ka të përbërë nga shqiptarë rojen e vet, për arsye se ndër fushat ballkanike e, sidomos, në Plevnë, ata mbrojtën, kryelartë e të pathyeshëm, flamurin e tij, përveç që ka në mend të realizojë sa më shpejt një hekurudhë, që të përshkojë bregun shqiptar, duke prekur Vlorën e Durrësin desh që Komundet shqiptare të Perandorisë të hapin për vete shkolla në gjuhë amtare. Ky fakt, i cili njehet si përgatitje për autonominë administrative, që u përket atyre e që shkon duke u pjekur në mbledhjet e Divanit; e ajo nuk do të mund të mbështetet veçse mbi themelin e kulturës së vendlindjes. Tashti,

²⁴ *Lezioni di lingua Albanese*, Corigliano Calabro, Tip. del Popolano, 1891, p. 8.

ndërsa fati sillet kështu. . . zemërmirë në Lindje, Italia, për t'i lehtësuar vështirësinë më të rëndësishme që mund ta vonojë mungesën e mësuesve të asaj gjuhe, desh të themelojë një shkollë të asaj vetë, në Kolegjin e Kolonive arbëreshe, që nuk u ndanë kurrë nga zemra e Mëmëdheut. Kështu, nga Fuqitë e Mëdha, që udhëheqin qytetërimin, . . . Italia, më parë, për të uruar ringjalljen e gjuhës shqipe, sepse fjalë të kësaj, që vinë nga kohë parahistorike e ngadhnjimtare. . . e që ende jetojnë në anë të ndryshme të vendit, [themeloi një Kolegj]. E, më tej, duke na nderuar, si bij të ushqyer me mendimin e saj, me ajrin e saj e me qumështin e tokës së saj, ka deklaruar se është e kënaqur, në qoftë se nga edukata që na jepet neve në këtë strehë paqeje e përdëllimi, duan të gëzojnë vëllezërit tanë që banojnë në Turki. *Kaq, në të vërtetë, o lule të breznisë sonë nuk më shkonte në mendje, / ndër vitet e shumta që kanë kaluar, në të cilët, si njeri që, në ëndërr, shkon mbi anije nëpër det i vetëm e nuk di ku, / unë vazhdoja, pa qëllim të sigurtë, të kujdesesha për gjuhën tonë, vetëm nga dashuria e shkëlqimit të natyrshëm që unë shikoja, o sepse ajo kishte lindur me mua në shpirtin tim. E, pra, anijes sime i frynte era nga jashtë, - siç po shkon duke e vërtetuar koha (jeta), - pse gjuha shqipe, e nxjerrë në pah dhe e mëkëmbur, u duhet, tashti, atyre që e flasin për t'u dalluar nga të tjerët dhe për t'u mbrojtur me vendosmëri se shquhen prej njerëzve jo miq, mes të cilëve gjenden.*

1.

Po, “kjo është një ditë që na e ka bërë Zoti; të gëzohemi e të galdojmë në të”. Njimend, këto nuk janë ngjarje shumë të mëdha, por, gjithmonë, lindja kaq e gëzueshme e njeriut e të kndellurit e tij, që mbush me shpresa, janë vogëlsi dhe dobësi, e i lihen së panjohurës (e braktisen në panjohuri). E kështu është për ne. Ndoshta, më tepër se njerëzit e tjerë, ne kaluam e jemi duke kaluar fatkeqësi, por duhet të ngushëllohem, sepse i kemi kaluar pa pësuar prishje në fuqinë e trupave e të shpirtërave. Ndërmjet njerëzve, ku fati na pat hedhur, në çdo kohë, natyra e çiltërt dhe e vërtetë, që i shmanget servilizmit të ngushtë, dhe burrëria, mikpritja e pa të keq, na siguruan nderimin e dashur të fqinjëve e na i lehtëson vështirësitë. Askund nuk na përbuzin. Nuk ka shumë vjet e, Livingstoni i përmendur, duke udhëtuar në Afrikë, gjet përsëri fushën e një arabi në zë, shfrytëzues, prej të cilit e dinte që urrehej e i cili, me qëllim të keq, kishte thirrë pranë vetes

një grumbull njerëzish. Livingstoni kishte pakë të armatosur e ishte në mendim për pusitë e parashikuara. Ndenji me dyshim, duke mos i rënë për shtat të ndërronte rrugë. Pastaj u këshillua me vete e në ag të ditës, “pasi i bëri të vetët të vishnin rrobën e nderuar të shqiptarëve”, - janë fjalë të tija, - u drejtua nga vendi i pa besë i arabit, që, pasi e kishte lëshue zemra, e priti me fytyrë të gëzuar e i dha gjithçka. Të më lejohet, prandaj, të kujtoj me ca kënaqësi fjalën e urtë të të parëve tanë: *Fryn era lisat, e, duke era, i rrit lisat*, e të ngushëllohem duke menduar se, nga rrënimet e largëta historike, Akili dhe Aleksandri u ndanë në shenj prej këtij popull rrezikzi, duke shkëlqyer ndër prisat e njerëzve të të gjitha kohëve.

Dhe nuk është e paarsyeshme të pranohet në gjuhën e një race kaq burrërore, një fuqi e përshtatshme me atë forcë të brendshme të shpirtërave, mbasi “me gjuhë njeriu shfaq, gjithmonë, veten dhe kuptimet e brendshme të veta”. Nuk dihet, deri më sot, a ka qenë shkruar ajo ndonjë herë në kohët historike. Filipi u ngrit për të marrë shpagim mbi helenët, të thyer prej të parëve të tij, kurse i biri i tij, Leka, u ngrit për të pushtuar Azinë si dhe fronin e njerëzve të lindur në kohën e vet. [Këta të dy] e përdorën atë gjuhë pa u kujtuar. Dy a tri fjalë të saja janë të ruajtura në kujtimet e ngjarjeve të tyre më në shenj. Periudha e Skënderbeut ndahet në kohë lavdie dhe fatkeqësie. Në këtë të fundit njofti, - kisha për të thënë, - shkëlqimi i këngës së vetvetishmes popullore, e cila reflektonte ato ngjarje. Atëherë, ndoshta, nuk patën kohën për t’ia vënë mendjen jo aq shkëlqimit të saj se sa brendish magjepsëse të këngës së pavdekshme [popullore].

Kundrimin të gjuhës, në të cilën ishte shprehur kënga popullore, iu la të rejave të këtij shekulli. Duket se një frymë hyjnore kalon, sot, nëpër majet e pemës sonë kombëtare; e, në të gjitha brigjet ku jemi shpërndarë, mendimet synojnë në rindërtimin e gjuhës së vendlindjes, sipas vetëdijes që shkon duke u përhapur se, duke mos pasur ne qytete, e duke u gjetur të shpërndarë në vise që janë larg njeri nga tjetri, vetëm gjuha amtare është endë vaji që mban gjallë të ndezur jetën tonë kombëtare. Unë jam i lumtur që mund t’ju lajmëroj se forcave kolektive të Komiteteve shqiptare të Kostantinopolit e të Bukureshtit, tashti, u shtohen ato të një Rrethi, që është hapur në Palermo për traditat e atdheut, dhe për besimin në të ardhmen, të Kolonive të Sicilisë. E kam shumë arsye të shpresoj se, shpejt, do të bëhet, gjithashtu, në Napoli prej

atdhetarësh të shquar të Kolonive arbëreshe të steresë. Në vetëvete, studime të tilla do të jenë të shpërbyera, pa dyshim, nga zbulime të pashpresuara e të çmuara në shumë pikëpamje, në atë mënyrë, me të cilën, gjithmonë, një sasi e madhe sendesh me vlerë të shumëfishtë shpërblen mëndin e bërë për të nxjerrë prej varrit (në dritë) qytetet e mëdha që qenë në kohën e vjetër. Për sa i përket gjuhës, në veçanti, është bërë e qartë, qysh tashti, se në fondin e saj leksikor qëndrojnë gjurmë të qarta qytetërimi të gjerë (të madh) e të nderuar historik, i cili arrin te mitet e politeizmit elenik e këtu mbaron; ndërsa në organizmin e vet, ajo vë në dukje se është shkëputur, para së tjerash, prej trungut të vetëm që kanë pasur gjuhët e pasqyron atë qytetërim parahistorik të popullit nga i cili u fol [ajo gjuhë].

Për të njohur e për të ngritur vlerën e brendshme të strukturës organike e të simbolizmit të fuqishëm të fjalëve, prej të cilave përbëhet gjuha shqipe, do të drejtohet, me parapëlqim, vëmendja jonë bashkarisht. Ndërkaq, për të ju frymëzuar në shpirt qëndresë e dashuri për fatin e atdheut, dua të vë në dukje, me sa kam mundësi, jéhet (jehonët) e shekullit të parë të lavdishëm, që na përkiti (që na takoi), mbasi “noblesse oblige”, dhe është plotësisht e vërtetë, se *kush ka të kaluarën, do të ketë edhe të ardhmen*.

2.

Gjuha helene pat libra e përmendore gati trimijë vjet më parë, në të cilat ajo na rri përpara si një zë i dashur i një kombi fisnik e të lumtur, që mbështetet në ndër shtresa qytetare të ditura.

Edhe në gjuhën latine gjenden sprovë të vjetra (*metrum saturnium*, *Ligjet e dymbëdhjetë rasave*, etj.). Në të vërtetë, në to nuk pasqyrohet veçse një shpirt i thjeshtë, i drejtë e i përshpirtshëm, që nuk ka ende dituri e ushtrim në krijimet e fjalës. Edhe pas atyre përmendoreve të vjetra, lavrimi i gjuhës latine, për gati katër shekuj, qe bërë në Romë më të shumtën prej të huajsh e pas artit të huaj. Vetë shkrimtarët e mëdhenj që, pastaj, brenda një kohe, pothuaj prej një shekulli, e lartësuan në atë madhëri të bindshme (të mrekullueshme) e kaq të aftëtë fenomeneve të botës së jashtme, vinin, në pjesën më të madhe, nga bashkitë italiane.

Drejtimi për të bërë më tepër se për të thënë, që i largoi romakët prej letërsisë, është i përbashkët, gjithnjë, tek shqiptarët; dhe kujdesja i mban ende në një jetë të ashpër e të fuqishme për studimet e lira.

25. KATEDRA E SHQIPES NË SHËN MITËR KORONË²⁵

Në fillim të prillit /1892/, Prefekti i Kozencës i bënte të njohur Kryetarit të Bashkisë së Shën Mitrit: “Që Ministria Mbretërore e Arsimit, *me qëllim që të mbahet i gjallë, në Kolonitë e shumta arbëreshe, përdorimi i gjuhës së tyre amtare*, kishte vendosur që të epeshin mësimet e gjuhës shqipe në Kolonitë e Shën Mitrit, duke pasur parasysh se kjo Koloni është qendër e gati katër mijë banorësh; që Ministria e ngarkonte prefektin të thërriste Jeronim De Radën, njohës të gjuhëvet klasike dhe të shqipes, që ky ta merrte përsipër këtë mësim për llogari të Shtetit”.

1.

Kemi, pra, një shkollë tonën, tashmë, të hapur, mësimet e së cilës, me anën e shtypshkrimit, do të arrijnë në shtëpitë e bashkatdhetarëve tanë të shpërndarë kudo. Fat më i lumtur se ky, ndoshta, nuk ishte për rrethanat tona të tashme. Do të mbetet si një fakt historik, efektet e të cilit na humbasin në pamjen e së ardhmes.

Së pari, ajo do të shpëtojë jetën fisnike shqiptare, duke ia ruajtur gjuhën, që është shpirti hyjnor i saj. Lexojmë te Virgjili se Eneu, kur po ikte nga Troja, e paska tërhequr nga tempulli dhe na e paska marrë me vete, si ruajtëse të fatevet të kombit, statujën e Palladës. Perëndeshës Athena (Athina) ia kishin vënë emrin “Fitimtarja”. Athena (Minerva latine) mori pranë grekërvet emrin e saj shqiptar “*Athëna*” (Fjala), “*e thëna*”, dhe ishte Perëndesha e të folurit. Kështu, në mithin e dijes së lashtë, sipas së cilës Eneu nga atdheu në flakë tërhiqte jashtë dhe merrte me vete Athenën (të folmen e vendit të lindjes), është i mbuluar si me hije fakti i vazhdueshëm në historinë e botës, se mburojë dhe

²⁵ *La Cattedra di Albanese in S. Demetrio Corone*, Tip. Dell Avanguardia Macchia Albanese, Cosenza, 3 luglio 1892.

mbrojtje e vetë qenies së çdo populli është gjuha amtare. Është e drejtë që ne ta dimë, se dora Perëndisë, nga një katedër, destinuar në fillim për një a dy klasë mësimi të një instituti, duke parë sukseset, e bëri një shkollë të përgjithshme për Kolonitë tona në Itali, e cila, e vetmja nga kombësitë e tjera, na deshi mirë. Është kjo Katedër, që, duke u bekuar prej tij [Perëndisë], e pranuar me dashuri e për nevojë të mbarë Atdheut, do të bëhet, ndoshta, një shkollë e madhe kombëtare.

Në rend të dytë, dobia e mësimi, që po nis sot për ne, do t'i vlejë –duke shpresuar kështu në të mirët e Italisë – gjithashtu, edhe shkencës së Europës së qytetëruar. Dy gjëra ka në gjirin e saj kjo gjuhë e pellazgëvet, të cilat i ruajti të paprekura gjatë kohëve:

1. Ruajti gjurmët e qarta të një feje shumë të lashtë njerëzore dhe para prishjes së saj në adhurimin e kotë të Natyrës, edhe më përtej ndër idhujt e kësaj.
2. Ruajti tingujt e një gjuhe parahistorike prej rrënjash, gati, të gjitha njërrokëshe, të gjitha me kuptim, gjuhë e cila qe kristalizuar, - do të thosha, - që në fazën e parë të fleksionit, përkundrazi, fleksimi, sikurse ndër gjuhët klasike, e ka errësuar kuptimin e fjalës ose e ka zgjeruar në një mënyrë analoge, kur fjala është zgjeruar prej mbaresave.

Këto dy gjëra do të jenë lëndë e kundërimit tonë të kujdesshëm.

Ka më shumë se gjysëm shekulli, disa shqiptarë me zemër të pathyer, megjithëse të shpërndarë nëpër vise të ndryshme dhe të panjohur në mes njëri-tjetrit, bënë një studim spontan dhe fisnik për lavrimin e gjuhës amtare. Kjo do të dukej si një reaksion fatal përpara përpjekjeve të fqinjëve të këqinj, që, duke i parë /shqiptarët/ të shpërndarë e pa Atdhe, filluan të komplotojnë që t'ua humbnin gjuhën, për t'i përpirë. Qe, sigurisht, një dashuri për Atdheun e shkretë, që i bëri /shqiptarët/ t'i drejtonin mendimet nga gjuha e vet; dhe duket se po fryn një erë hyjnore nëpër majat e lisit tonë kombëtar dhe nëpër të gjitha brigjet, ku na kanë shpërndarë shtrëngatat e ku po mblidhen shpirtërat për rindërtimin e Atdheut.

2.

Po, si u mund Atdheu, edhe gjuha shkoi duke u varfëruar dhe duke u prishur. Pastaj, as nga shkrimtarët tanë, që shkruanin në dy alfabetë, grek e latin, se këta dy alfabetë të vetëm ishin të përhapur, nuk u dhanë

shkronja të mjaftueshme për pasurinë e fonetikës së saj, më të mira se sa ato [të fonetikës së mëparshme]. Për të gjetur shkronjat e duhura (e nevojshme), kriteret individuale mbetën të lira dhe ndryshuan kaq shumë sa që çdo libër i ri doli në dritë me një alfabet, trajtuar sipas kushteve të vendit, edhe kur numri i madh i shtypshkronjave, që ishin krijuar, mund të ndihmonte në zgjedhjen e autorëve.

Për këto shkaqe, vështirësia e leximit dhe e kuptimit të fjalëve të ndryshuara ose të prishura kanë dëmtuar, vazhdimisht, dhe në pjesën më të madhe të dobisë së tyre, ato botime edhe kanë dëmtuar, sidomos, jetën e gjatë të organevet periodike, që kanë dalë për t'i bashkuar shpirtërat e vëllezërvet.

Këto përpjekje vlejten edhe për të zgjuar ndjenjën atdhetare dhe për të pasuruar fjalorin e gjuhës me fjalë të dala jashtë përdorimit në një krahinë, por që gjinden ndër krahina të tjera dhe të nxjerra në dritë nëpërmjet të atyre librave. Ndërkaq, prirja për njësimin e alfabetit është në udhë të mbarë të shprehur besnikërisht në çdo tingull të vendosur të gjuhës. Bashkë me këtë, si u kërkuar, për një kohë të gjatë, lloje të ndryshme të këtij alfabeti, mendjet po kthehen te shkronjat më të njohura e të pranuar nga shkrimtarët e parë e më të mëdhenj të shqipes. [Po marrin] shenja të helenistes, por të plotësuar me ato latine dhe anasjelltas; kurse për shkronjat e pakta që mungojnë, po marrin nga alfabetet e tjerë të huaj, që, nga përdorimi i shkencës dhe i shumë albanologëve, - do të thoja, - janë bërë më të përdorshme.

Edhe larmitë dialektore, nëpërmjet stukimeve të këtyre viteve të fundit, të veçuara nga barbarizmat dhe nga deformimet, mbeten një pasuri forcash për gjuhën. Prandaj do të jetë një punë e lehtë për t'i grumbulluar rreth së folmes, gati të njëtrajtëshme të Kolonivet të Kalabrisë, të Bazilikatës dhe të Siqelisë, që qe ajo /d.m.th., e folmja/ e shokëve të Skënderbeut, e pranuar, tashmë, si më e plota dhe më e pasura dhe e destinuar të bëhet gjuha kombëtare.

3.

Me vetëdijen e këtyre avantazheve dhe të njohjes praktike të gjuhës amtare, e ndjej veten (në gjendje) t'u premtoj të pranishmëvet, në mësimet e mia, se do të mund të arrijnë ta mësojnë plotësisht mirë këtë gjuhë për përdorimin e zakonshëm. Këndej edhe ne do të kemi

kulturën tonë të pavarur, siç e kanë të gjithë /popujt/, veç nesh, e mungesa e së cilës na ka poshtëruar e na ka ulur në mes të popujve.

Në vitin 1884, revista “Melusine” e Parisit e mbyllte një gjykim të saj interesant me Rapsoditë Kombëtare me këtë shënim rreth mbledhësit të tyre: “As mosha, as fatkeqësia, as mungesa e mjeteve materiale, as banesa e thjeshtë, ku u desh të mbyllet jeta e tij, s’kanë mundur t’ia pakësojnë këmbënguljen, energjinë në punë. Ne shpresojmë që, me anën e vetëmohimit të tij të vazhdueshëm dhe me anën e atdhetarizmit të pathyeshëm, sidomos me anën e mbështetjes morale e materiale të bashkëatdhetarëve të tij, Ai do të mundet të bëjë edhe më shumë për diturinë, që e dashuron, dhe për popullin, të cilit i përket e që e përfaqëson me fisnikëri”.

Po, dhe deri sa të jem në “Tokën e të gjallëvet”, qëndromëni për rreth dhe ndihmomëni të gjithë ju, që e çmoni emrin shqiptar. Kështu do të tregohemi të denjë për të mirën që na bëri Italia dhe për përkrahjen e Europës, që gjithnjë ka besuar e beson në vlerat morale e intelektuale të popullit tonë.

Maqë arbëreshe, 3 korrik 1892

26. KONFERENCA MBI VJETËRSINË E GJUHËS SHQIPE DHE TË GRAMATIKËS SË SAJ²⁶

Gjuha u thirr *tokë e shenjtë*,
pse në të shkon e vendoset mendimi.

Max Müller

10 prill 1892

Më lejoni, para së gjithash, që unë ta falënderoj dhe ta bekoj Zotin tonë. Etërit tanë, shokë të Skënderbeut, në luftën kundër turqëvet, mbas vdekjes së këtij mbrojtësi të mëmëdheut, erdhën dhe u strehuan në Itali. Këtu zunë vend, pa qytet, nën kupën e qiellit, shatorre e atit, në besë të të cilit ata kishin lëshuar vetëveten dhe shpërtërat e tyre. E Zoti na muar si bij të vet. Në tokën e huaj ne, shpejt, patëm banesa të këndëshme, të shëndetëshme dhe me tokë të begatëshme, e, pastaj, një shkollë tonën, që u bë fisnike dhe e shquar për qetësi, që është aq e mbarë për studime. Vendi na priti e na desh; e në Orën e tij të mirë mendoj edhe për ne, shokët të fatit të tij, dhe për ruajtjen e qenies sonë origjinale. E, ja se u themelua prej sunduesve të këtij vendi dhe me të holla të tyre një Katedër e gjuhës shqipe, e u çel në një nga Ngulimet (Kolonitë) tona më të shquara, në ndihmë edhe për të tjerët. Kështu u çfaq në dritën e diellit, si në fshehtësinë e mendimit hyjnor. Ne, bijt e atyre martirëve të fesë shenjtë e të lirisë njerëzore, u shkëputëm përmes rrënojash e u vendosëm në tokën mike, duke pritur Orën, në të cilën, në vend të atyre kalorësive, të ishim ne vetë prisat e rinj të

²⁶ *Conferenze su l'antichità della lingua Albanese e grammatical della medesima*, Tip. Di Francesco Mormile, Napoli, 1893, p. 39.

mëmëdheut në rilindjen intelektuale dhe morale, që duhet të jetë bazë e përtëritjes së fatit të tij.

Ndërsa, njëkohësisht, ata, që mbetën në tokën e stërgjyshërve pa u shkëputur kurrë prej zemrave tona, e që bashkëjetesa prej katër shekujsh i kishte pajtuar me turqit dhe i kishte njësuar me fatet e tyre, e ndijnë veten të ngjallur për përtëritjen e gëzueshme që po kryhet në Perandorinë Osmane. *Sulltani*, i cili mban, - sikur thonë, - rojen rreth vetes të përbërë prej shqiptarësh, - prandaj ndër fushata ballkanike e, sidomos, në Plevna, ata mbajtën të pamposhtur flamurin e tij, - jo vetëm se ka mendimin për të futur në veprim, sa më shpejt që të jetë e mundur, një hekurudhë që të kalojë nëpër bregdetin shqiptar, duke prekur Vlorën e Durrësin, por bile autorizoi edhe komunet shqiptare të Perandorisë të çelin shkolla në gjuhën e tyre. Ky fakt mbahet si një hyrje drejt autonomisë administrative që u përket atyre, e që shkon duke u pjekur ndër mendimet e Portës.

Po, kjo është dita që ka qitur për ne Zoti. Të gëzohemi e të galdohemi në të.

Këto nuk janë, sigurisht, ngjarje me rëndësi të madhe, por, gjithmonë, lindja aq e gëzueshme e njeriut dhe të shëndoshurit e tij që e mbush të ardhëshmen, rrjedhin prej vogëlsisë dhe dobësisë, dhe lëshohen në të panjohurën. E kështu është për ne. Ndoshta, më tepër se të gjithë njerëzit e tjerë, ne kaluam e po kalojmë nëpër nështrasha të vështira; por duhet të na ngushëllojë fakti, se i kemi shkapërcyer pa pësuar dobësim në fuqinë e trupavet e të shpirtëravet². Në mes njerëzish, ku fati na hodhi, në çdo kohë, natyra jonë, që i shmanget servilizmit të ulët, trimëria burrërore, mikpritja me zemër dhe me durim, fituan nderimin e dashur të të afërmëve tanë për ne dhe na i zbutën vështirësitë. Kurrkund (në asnjë vend) nuk tregohet përbuzje për ne. Nuk ka shumë vjet, kur i përmenduri (i shquari) Livingstone, duke udhëtuar nëpër Afrikë, u gjet në fushën (në kampin) e një arabi të famshëm zezak, me të cilin ai e dinte se ishte në armiqësi, e që, me mendim të keq, kishte thirrë rreth vetes një grusht shokësh si veten. Livingstoni mbante pakë njerëz të armatosur, dhe, i shqetësuar për pusitë që parashihte (parashikonte), mbet ndërdyzash, mbasi as nuk e interesonte të ndërrojë rrugë. Pastaj mendoi me vete, e, teksa zbardhi drita, “duke ua mveshë të vetëvet petkun e nderueshëm të

shqiptarëvet” (janë fjalët e tija) u turr kahë qendra e të pabesit arab, i cili, lëshuar zemre, e priti tërë gëzim në fytyrë dhe i lejoi çka deshi. Prandaj kemi të drejtë të kujtojmë me një farë kënaqësie proverbin (fjalën e urtë) tonë popullor *Fryn era lisash, e, duke fryrë, i rrit era lisat*, e të ngushëllohemi duke menduar se prej rrenojave historike, duke shkëlqyer mes prisave më në shenj të të tëra kohërave, Akili e Aleksandri dolën prej këti fisi fatzi.

E nuk është gjë e paarsyeshme të pranosh, në një gjuhë të një rrace kaq burrërore, një fuqi të barabartë me fuqinë e brendshme të shpirtërave, mbasi, “me anën e gjuhës, njeriu paraqet, gjithmonë, vetveten dhe ndjesitë e brendshme të tij”. Deri tashti nuk dihet në se kjo gjuhë qe shkruar, ndonjëherë, ndër kohëra parahistorike. Filipi dhe i biri i tij, Aleksandri, që s’kishin tjetër mendim veçse i pari të hakmerrej kundër helenëve, pushtues të stërgjyshërve të tij, e i dyti të pushtonte Azinë e, me të, fronin e të gjithë njerëzimit të asaj kohe, përdorën këtë gjuhë pa ia vënë mendjen.

Vetëm dy tri fjalë të kësaj gjuhe janë ruajtur ndër kujtimet e vjetareve të tyre. Dhe koha e Skënderbeut, e kapur vetëm nga kujdesi për rrezikun që i kërcënohej jetës shqiptare, nuk kishte sesi, në atë kohë, të kishte një mendim (kujdes) të veçantë për gjuhën që ishte lidhur tok me fatet e kombit.

Por paska qenë thënë që, vetëm në këtë shekull plot mendime lëvizëse, herë në njërin anë e herë në tjetrën, në këtë shekull përtëritjeje për kombet kristiane, të studiohet kjo gjuhë.

Me të vërtetë duket se një frymë hyjnore po përshkohet, sot, nëpër majet e pemës sonë kombëtare, e, nga çdo anë, ku janë shpërndarë mendjet, po sillen drejt përtëritjes së të folurit tonë; pse, përherë e më tepër, po përhapet bindja se ne, duke mos qenë në gjendje të ndërtojnë një qytet e, duke u gjetur të shpërndarë ndër vise të largëta njeri prej tjetrit, është e vetmja gjuha, vaji, që mban gjallë jetën tonë kombëtare. Forcave kolektive të Komiteteve shqiptare të Stambollit dhe të Bukureshtit, në vjetin e kaluar, iu shtua edhe një Rreth, që është çelur në Palermo, me degë ndër Koloni arbëreshe të Sicilisë, e që paraqet dashuri për emrin e vet dhe për traditat kombëtare dhe besimin në të ardhshmen. Qysh tash, për të, është themeluar një arkiv shqiptar. Mundëm të kemi të katërtin vëllim, që përmban një novelë

poetike të Xhuzepe Sqiroit, *Mili e Hajdhia*, e vulosur me freski të tokës shqiptare e për të cilën shkon mirë përshëndetja e Lamartine-it: “*Poezia ka ardhë nga brigjet tuaja, dhe atje duhet të kthejë*”. Edhe në Athinë, në vjetin 1881, u krijua një komitet për lëvrimin e gjuhës shqipe, kryesuar nga koloneli Dhimitër Boçari; por, ndoshta, në këtë kohë, panhelenizmi i çmendur, me gjithë simpatitë, sikur flitet që Mbretëresha Ollga paska për shqiptarët, do ta ketë mbyllur.

Në vetëvete, të tilla studime do të shpërblehen prej zbulimesh të papritura dhe të çmueshme nga çdo anë. Në këtë mënyrë, një pasuri e madhe objektesh, me vlerë të ndryshme, shpërblen mundin e bërë në zbulimin e qyteteve të mëdhaja, që qenë në kohën e vjetër. Fondi leksikor i saj është dëshmitar parahistorik i lindjes së gjuhës njerëzore, e Gramatika e saj hedh një dritë të pamenduar (të pamendueshme) e të çuditshme mbi procesin e të të folurit; dy fakte që lodhin mendjen, sot për sot, të mbarë botës shkencore. Gjithashtu i rëndësishëm është fakti, se kjo gjuhë përmban emrat e zanafillës të idhujvet fetarë në botën heleno-latine. E këta janë në këtë gjuhë emra të zakonshëm fenomenesh natyrorë, që paraqiten nga ata idhuj, çels i fundit i atij kulti, që mbajti, për sa shekuj, të lidhur mbas vetes pjesën më fisnike të Europës dhe që u fytyrzua në sfondin e njëj feje primitive, që qe i yni.

Për të frymëzuar në ju gjymtyrët e Shqipërisë, të vendosura në Itali, dashurinë për fatin e atdheut, unë po dua të vë në dukje ato jehe të njëj kohe sonë të lumnueshme, mbi të cilën u vendos epoka e shkëlqyeshme e helenëve, mbasi “është detyrë fisnike” dhe është e vërtetë se, kush ka të kaluarën, do të ketë edhe të ardhmen. Kështudo të nxjerrim në dritë mënyrën e përdorimit të gjuhës së folur në atë kohë dhe si ka mbetur në gojën tonë. E si shtojcë të drejtë ne do të paraqesim disa pjesë poetike, me të cilat, si thonë një fjale, lajmërohet ardhja e saj në këtë botë.

KONFERENCA I_{a27}

Gjuha helenike ka pasur libra e përmendore gati trimijë vjet më parë. Për hir të këtyre, ajo na del përpara si zëri i dashur i një kombi fisnik e të lumtur, i mbështetur ndër shtresa qytetare të ditura.

Edhe nga gjuha latine na kanë mbetur disa shembuj të vjetër *metrum saturnium*, ligjet e XII tabelave, etj. Ndër ta nuk pasqyrohet veçse një frymë e thjeshtë, e drejtë dhe e përsëritëse që, për vjet me radhë, nuk ka pasur as shkencë, as ushtrim përta i përket krijimit të fjalës. Edhe mbas këtyre përmendoreve të para, lëvrimi i gjuhës latine, për gati katër shekuj, që në Romë, për më tepër, nën kujdesin e të huajvet dhe në gjurmën e artit të huaj. Vetë shkrimtarët e huaj të mëvonshëm, që brenda një shekulli e ngritën këtë gjuhë në dinjitetin e mrekullueshëm dhe e bënë në gjendje të pasqyrojë fenomenet e botës së jashtme dhe fuqinë e shpirtërave të mëdhej, vetë këta shkrimtarë erdhën, në pjesën më të madhe, prej krahinash italice.

Ajo prirje për të bërë më tepër se për të thënë, që i shkëputi aq tepër romakët nga letërsia, shihet gjithënjë ndër shqiptarët, e i mban këta në një jetë të ashpër e të fortë, sikur ajo e banorëvet të parë të Romës me të njëjtën mospërfillje për studimet letrare. Ne nuk dimë për ndonjë vepër në gjuhën shqipe, përveç rapsodive tradicionale, që kemi marrë zakon t'ia atribuojmë shekullit të pesëmbëdhjetë, pse, pikërisht në atë kohë, duke braktisur atdheun, ne i sollëm me vete; e pse pjesa më e madhe e tyre na kujton po atë kohë, që është për ne e lumtur dhe e mjerë. Natyrisht, mandej, gjejmë, aty-këtu, të vulosura reminishenca biblike, në sa që kënga e dasmës, pa tjetër dramatike, që paraqitet në mënyrë tradicionale në dasmat fisnike, të jep përshtypjen se kujton, në embrion, operën e Tespit. Epitalami i Katulit është për këtë një përfytyrim mjaft i zbetë, për arsye të përsëritjeve të tija.

²⁷ Po aty.

E vetmja përmendore që na mbetet, ndoshta, nga poema e Mesjetës Lindore, janë ato rapsodi, jo më pak të këndshme dhe me një ndjenjë të ëmbël, siç i gjejmë ndër poezitë e popujve të ndryshëm të asaj kohe; as nuk janë, sikur këto, të ardhura nga trajta e mendime të përparëshme, që qenë pasuri e përbashkët; ato janë nga një familje e shquar dhe e re, për nga fizionomia; kështu që qëndrojnë në një rën anë në mes të poezive të kombeve të tjera, sikurse gratë tona, me ato veshjet e tyre kombëtare, paraqiten të huaja për botën moderne. E as asaj kënge, sikurse thamë për kostumet, nuk mund t'ia gjejmë një burim të sigurtë. Ta zëmë se po këto poezi ndijnë jehun e një poezie lindore, që ka ekzistuar më parë, një poezi e vetvetishme në jetën e lirë dhe në pushimin e kohës së gjatë bizantine; me gjithë këtë, gjithmonë, nuk sjellin vulën e lindjes së tyre, pak a shumë të largët. Dhe as prej këtyre poezive nuk mund të argumentohet kundër opinionit të Gustav Meyer-it të Universitetit të Gracit, që na identifikon me ilirët, e vë dukjen e tyre (pamjen e tyre, dukurinë e tyre) ndër kohëra të reja (moderne), i mbushur mendjeje, ndoshta, prej kësaj se quhet sot Shqipëri ajo krahinë që qe, dikur, selia e ilirëve të Jugut. Nuk e di, pastaj, në se ai Profesor i ndritur kujton se /mos, vallë, pandeh se/ ilirët janë një degë e trungut sllav. Sigurisht, siç duket nga studimet e tija, ai nuk ka mundur të nxjerrë gjurmë të vërteta fjalësh e trajtash të përbashkëta për të dyja gjuhët, sllave e shqiptare, përpos atyre që kanë mundur t'ia huazojnë njëra tjetrës, për arsye afërsie gjeografike. Në anë tjetër, e kemi nga historia, se Iliria e vjetër ishte ndarë në grekë e sllavë; e, sot, është krejtësisht e ditur (shumë e njohur) se emri gjenerik (i përgjithshëm) grek e përfshin gjithnjë në vete, qysh nga kohët e para, së toku dy kombe shumë të ndryshëm: shqiptarët dhe helenët. E se Iliria qe banuar tamam (pikërisht, bash) nga shqiptarët, nxirret nga fakti se këta e banojnë, gjithnjë. Për më tepër, tradita e vazhdueshme siell se ata ilirë ishin nga fisi Frigas, të sjellur në këtë vend prej Dardanit dhe Antenorit, shumë të ndryshëm dhe kundërshtarë të helenëve. E vetë fjala *ilir* rrjedh prej *Ilio*, e Ilio prej *ili* (ylli në gjuhën shqipe). Tashti, nga shenimet e shumta të poetëve të mëdhej të vjetërsisë, duket se ylli i Venerës ndriste mbi fatet e Trojës dhe përbënte emblemën e fisit. Kështu nga *ili* (ylli) mund të dilte emri i tij Ilio, e ky mund t'u përsëriste në Iliri, që në shqip don me thënë hylli i ri /Illyria/.

Ky digresion, natyrisht, nuk përforcon vjetërsinë e këtyre poezive kombëtare, i vetmi libër i sjellur nga mëmëdheu.

Për këtë trashëgim letrar, sot për sot, është vërtetuar vetëm se lënda substanciale e këtyre krijimeve i përket epokës kristiane dhe kohës fare të re të Skënderbeut. Gjuha e kujtimet historike të ndriçuara nga fjalë, që kanë rrjedhë po prej kësaj gjuhe, kujtimet e sjellura ndër libra latinë dhe helenikë, dhe krejt fondi i politeizmit heleniko-latin, që përmban emra shqiptarë të vulosur ndër mite shumë të largëta e që i shpjegojnë këto, janë një libër i madh për ne, janë harta e vjetër fetare e Europës, që u përpunua më vonë prej kombevet të mëdhej, trashëgimtarë e sundues.

Mos të braktisim traditën iliake.

Vallja që u mbet në Romë Salëve nga shokët e Enesë, që qenë të parët që kërcyen në Itali, siç na la të shkruar Palemoni, (kërcimi në armë) ishte vallja e gjyshave tanë *burriae* që të huajët e përkthyen *Pirrica* (pirrike) e ia çuan origjinën (zanafillën, prejardhjen) te Pirroja, biri i Akilit. Përkundrazi, ai emër dhe emri i kësaj valleje lidhen me fjalën shqipe *burrë* (lt. vir). Kësaj të dhëne historike i jep dritë të plotë dhe të papritur një varg tjetër. Salët, në kërcimin Frigis, nuk kapnin mburojën (it. l'ancile) romake, por "*pelten*" trakase vëzake (vezake). Po kush qenë trakasit, mbasi asnjë prej racave që banojnë në Ballkan, nuk din se ka në vete ndonjë gjë nga gjurma që mund të na kenë mbetur prej këtij populli? Duket se nuk la shenj mbas vetes, si të mos kishte qenë (si të mos kishte jetuar). Për më tepër, për asnjë fis nuk dihet, mbas ardhjes së Jezu Krishtit, që të ketë qenë zhbi (që të ketë qenë shfarosë, zhdukur) në këtë vend ose të ketë mbetur gjallë në qenien e tij, por e padalluar. Është e ditur (e njohur) nga mija provash historike, se Trakia ishte e huaj për Heladhën; e sllavët që erdhën e pushtuan më vonë, nuk kanë si të kapen për të. Përkundrazi, ajo është aleate e trojanëvet. E ne, në kërcimin e armatosur, që pat emrin e vet nga gjuha e Epirit e që qe e përbashkët me shokët e Enesë që sollën peltën trakase, dallojmë një fije të hollë sa të duash, por që nuk është e këputur e që lidh, ndoshta, në një bashkëfisi të largët frigasit, që Herodoti i quan pellazgë, trakasit e shqiptarët që, gjatë kohëve e ndër krahina, muarën emra të ndryshëm, sikur maqedonas, tesal, tesprot, molos, ilir, e tjerë.

E *pelta* duhet të ketë qenë *peta* që ne, gjithnjë, e kemi. Ka, gati, 400 vjetë, qysh se mburoja nisi të lihet pas dore në ushtri; por, që nga mërgimi ynë, as që kujtohet, nga bota zejtare, por qëndron si një emër historik, që, vetëm tashti, për nevojë, po e vemë në dukje. Në martesën shqiptare, ditën e enjte para së diellës së kurorëzimit, përgatisin në shtëpinë e dhëndrit, me miell, vezë e sheqer *petën rituale*, një si mburojë në trajtë vezake, e lartë më se 10 cm., më e gjerë se një *shoshë* e madhe, dhe e zbukuruar, për sipri, me rilieve, që përfytyrojnë qenie të natyrës në atë mënyrë si te Homeri, siç e gjejmë të stolitur me pikëzime mburojën e Akilit pellazg. Në shtëpinë e dhëndrit, sipas këngës dasmore, “qiparis tek i cili mbështetet hardhija”, përgatitet *peta* (*pelta* trakase), simbol i strehimit (i mburojës, i mbrojtjes), që duhet të gjejë gruaja në shtëpinë e burrit.

Traditat e Trojës, që mbushnin zemrën e popullit grek, ndoshta pse rrenimi i atij qyteti shenonte fitoren përfundimtare të helenëvet mbi pellazgë, fitore e arritur, sikur ngjan, me ndihmën e pellazgëvet tjerë, armiq të fisit (ose të gjakut) të vet. Ato tradita të Trojës vazhdojnë për një kohë të gjatë, duke vënë në dukje se fisi Iliak vazhdoi nën emrin *Aberësh* (Apiresi – në Epiresi), i cili emër shkoi duke u shndërruar në fjalën *Albanezi* ndër gjuhët e huaja.

Eneu, në poemën e Virgjilit (Lib. III), thotë për arritjen e tij në Leukade: “Te ky breg u ndalëm të lodhur dhe zbritëm brenda qytetit të vogël . . . dhe bëmë, pastaj, të gëzueshme dhe krenare, me lojra Iliake, bregdetin e Acios. Ishim të gëzuar se kishim dalë gjallë nga qytetet argolike dhe kishim çelur shtegun për ikje në mes të armiqëvet”. Pse Acio, më parë tokë e Epirit, jo vetëm se ishte e huaj dhe e ndarë nga helenët, por ishte edhe breg i një krahine mike: Téukrit u lëshuan në pushim dhe ndër lojëra të gëzueshme të mëmëdheut. E, mandej, duke shkuar më tutje, gjetën njerëz, bashkatdhetarë të tyre. Emrat e lumenjve e të brigjeve, ishin një jehonë e atyre lumenjve dhe brigjeve të Ilios; gjetën Andromakën trojane që kishte mbërritë aty para pak kohësh e me një grusht njerëzish me vete, dhe aty ishte mbretëreshë si në atdheun e vet, e cila ua lehtësoi vuajtjet duke i furnizuar anijet me ushqime; së fundi, gjetën Helenin nga mbretërit e Trojës, i cili pasi i hodhi sërishmi në det, duke profetizuar, i kishte premtuar Eneut bashkimin e ardhshëm, jo të fisit të vet, por të Epirit me Italinë, të dy

të banuar nga pasardhësit e Dardanit. Më pas, brenda në Itali, Eneu i bashkohet fatit me një popull pellazg, me arkadët, jo helenas; e u nënshtrohet këshillave të Orakullit të Kumes, të themeluar aty nga Pellazgët e emigruar prej Eubesë.

Por është shì (mu, bash) në Romë, ku u vu për fije fati i trojanëvet, që bashkëfshnia e saj / e Romës/ me gjyshat tanë, la kujtimet e veta më të ndritshme. Vetë fillimi i Romës, kaq fort i mbështjellur në errësirë dhe me qëllim i hedhur ndër mite nga ato fise, që më të shumët në numër dhe të ndryshëm në gjuhë prej pasardhësave të Eneut që e ndërtuan [Romën] dhe e banuan më vonë, mban shenjat e gjirisë (fisit) tonë. *Rròmi* në të folmen tonë don me thënë *jetojmë (rrojme)*, thua se të ikurit nga robëria, të mbledhur aty, donin të shprehnin me atë fjalë të pavdekshme *rròmi* ndjenjën e pushimit dhe të lirisë që ndjenin në vendin ku u strehuan. *Rròmi* e *Rrimi* (jetojmë dhe vendohemi, vendosemi) qenë dy idetë e para të personifikuara (barabar) në Romolin dhe Remin. Mandej dëshira e dytë *rrimi* (të qëndrojmë këtu, të rrijmë) i lëshoi vendin nevojës së jetesës edhe duke mësuar popujt fqinj. Prej këndeje rrjedh që Remi vdiq nga Romuli, dhe Roma nxuar emrin nga jeta.

“Në krahinën e parë të Italisë, - thotë Plini, - është vendosur qyteti i përmendur i Romës, misteri fetar i së cilës nuk lejon të diftojë emrin *e kundërt*. “As nuk është jashtë vendit të kujtojmë këtu të paraqiturit e *Angeronës* me një vel ndër sy dhe me vulë në gojë. Angerona, hyjni armike, e kishte tempullin e vet jashtë Romës; dhe është e qartë, se, po të marrim rrënjët e dy fjalëve Roma e Angerona nga folja jonë *rrò* (jetò), na del një kontrast mitik i këtyre dy hyjnive mbi fatin e amëshuar o të vdekshëm të këtij qyteti: Roma dhe *rròmi* (të jetojmë), si me thënë *e vazhdueshme, e amëshuar*; ndërsa Angerona prej fjalës sonë àng (nuk) *errònë* (= do të jetosh) është fjala e kundërt: *Nuk do të jetosh* (angë rronë).

E, me një herë, më vonë, ndërsa qëndronte e vetme, gjithnjë, në qytet gjuha e frigasve themelues, erdhën e u përzien sabinët; e, më vonë (pastaj), për mes tyre, Numa hypi në fronin e Romolit. Prej asaj kohe një fjalë, stemë e familjes sonë, ka mbetur si vulë e vazhdueshme e bashkimit të të dy popujve. Miti, porsa i përvijuar në largësinë e kohëve, i Egerisë, që këshillon dhe frymëzon Numën e urtë, ka një shpjegim të natyrshëm vetëm në gjuhën tonë. Pse *gjëria* në shqipet don

me thënë *afnitet*. E është gjë e lehtë të kuptohet se, mbas të ngulurit të sabinëvet në Romë dhe përzierjes së tyre me banuesit e parë, Numa, duke u vënë dhe duke u përpjekë të bashkojë të dy fiset në një njësi të vazhdueshme, s'kishte hyjni tjetër, prej të cilit të merrte këshille, vetëm prej “afnitetit, bashkëgjinisë, të një gjërie”, që, tashmë, lidhte këto dy fise. Kështu, mbreti Sabin u epte të kuptojë frigasve në gjuhën e vet se ishte vetë Egeria (afniteti, gjinia, gjëria) që e frymëzonte për këtë punë.

Ndoshta te e njëjta origjinë e largët lidhet edhe kulti i Janos dhe i Dianës (*dī āna*, në shqip: në dy faqe, *dy ana*) dhe kulti i Larëve, për të cilët Ovidi, ndër *Fastet*, tregon me aq bukuri legjendën plot kuptim. Por kurrkush nuk mundet të mohojë se kulti i hyjneshës *Dhija* (Dhia) e ai i Jovit *Elisio* ka ardhë nga etërit tanë e ka zënë vend në Romë me sa duket nga *Eneidët*, banues të parë. Elicio ishte Jovi i nëndheshëm, hyjni me mendime të këqia, të zeza, krejt të kundërt nga Jovi i Olympit. Ja përfytyrimi që na ka lënë Ovidi, me atë përpikëmeri të plotë, që është natyrë e stilit të tij: “Porsa e pa, zemra e Hyjnisë [Nume] u trazua, gjaku i iku nga parzmi; flokët iu çuan përpjetë të ngrirë. . . Zoti ia pranoi lutjen, por ia fshehu të vërtetën me shprehje të errëta dhe e frigësoi mbretin me atë fytyrë të dyshimtë. Ai tha: “*Preja kokën. E mbreti i përgjegji: Do të dëgjojmë, e do t'i pritet qepës së zhgulur prej veglave tona (prej mjeshtërisë sonë).*”

– *Kapi*, - ai shtoi, - të njeriut. . . “*Flokët*” – shtoi Hyjnia (Numa). Ai kërkoi shpirtin: të një *peshku*, përgjegji mbreti”.

Këtu ne kemi parasysht krejt figurën e Satanës, po me atë emër, me të cilin e thirrën gjyshat tanë, *Iljigu*, Jovi i Keq; rrënja: *ljig* = lig, keq, e *ljiga* = e liga, e keqja, i *ljigu* = i ligu, i keqi, siç e thomi edhe ne sot në gjuhën tonë.

Një dritë të këtyllë sjell gjuha shqipe edhe mbi një tjetër hyjni, ndoshta të një kulti më të lënë mbas dore (më të braktisur), por që u përket Frigasve të Italisë. Vëllezërit Arvalë, që përkujdeseshin në Romë për fenë e fushave (*arva*), në pranverë i bënin flije hyjneshës Dia. Çka ishte kjo, kurrkush s'e ka thënë. Pra *Dhia*, Dia, është emri shqip i shtazës *dhija*. Pa u ndalur këtu të flasim për nderin e madh që i përket këtij frymori ndër kohë të vjetra si ushqyese e Jovit, kujtdo që ka dijeni për jetën familjare të romakëve të vjetër, do t'i mbushet mendja

se Hyjnesha Dia s'mundet me qenë tjetër veçse *Dhija* jonë. Sikurse Stuhisë, sikur Elicit (Hyjnija i së Keqes), ata i bënë në pranverë flije edhe Dhisë, që ta kishin për vete, t'u sillte të mbarën; kështu që ajo të ruante prodhimin e ri, me të cilin mbahej jeta njerëzore. Revista *Mélusine* e Parisit thotë: "C'est ainsi que on les voit immoler une truie et une jeune brebis à la Dea Dia quand leur bois sacré éprouve quelque dommage". Të vihet re se në flije nuk u mbytnin dhë.

Po e mbyllim këtë kuadër bashkëfisi në mes të trakasve, epirasve dhe frigasve, stërgjysha të romakëve, e cila bashkëgjë u dinte në lidhje me festën e Anna Perenna. Ovidi, në librin e Fasteve, la për kujtesën e njerëzvet, se në Ídet e Marsit, kur natyra përtëritet, dilnin nga Roma familjet me pleq e me fëmijë e, të ulura ndër brigje, me fytyrë kahë perëndimi, duke pirë, i uronin vehtes ditë të panjehura nj'aq sa ishin gotat që shprazeshin për nderë të hyjnisë Anna Perenna: *Ana e Perendëme* për shqiptarët është *ana e perëndimit*, nga e cila, të sjellur, stërgjyshat e tyre, të lindur në gjirin e kultit të Natyrës, kërkonin që Dielli i tyre të merrinte sa më vonë.

Ky kuadër, sikur po e vemë në dukje, është shlyer nga mija vjetësh, që i kanë kaluar sipri; por jemi të bindur se, sikur të ndriçohenanë të tjera të tija, do të zhduken edhe kundërshtimet, që mund t'i bëhen së vërtetës së kësaj përmbajtjeje.

KONFERENCA II^{a28}

Ara, tek e cila kemi arritë, është plot me të korrat tona. Hyjnitë e qiellës helenike-latine simbolizonin, e dinë të gjithë, forcat e fenomenet e natyrës. Tashti, emrat e atyre hyjnive janë, gati të gjitha, fjalë shqipe, të lidhura me objektet e natyrshme, që janë të përfytyruara prej atyre fjalëve. Nga kulti i thjeshtë i natyrës, për të cilën bëjnë fjalë ata emra e deri te simbolizmi antropoformik i tij, kaloi një kohë e panjohur; e njeriu nuk e din se sa e gjatë ka qenë. Gjithashtu, një kohë e pamatur, deri tashti, ndan qytetërimin parahistorik të kombit, në gjuhën e të cilit janë të vulosura gjurmat e atij kulti, nga periudha historike, në të cilën simbolizmi andropoformik gjindet së bashku me helenët dhe latinët. Por të shqyrtosh tempullin e politeizmit helenik, kemi mundësi vetëm ne, pse në shtëpiat tona kumbojnë, gjithënjë, emrat e zotave dhe të hyjneshave, që janë mbledhur aty, kumbojnë sikur ishin në zanafille (në origjinë) nëpërmjet emrash, që janë të lidhur me fenomenet e botës.

Prej këtij ekskursioni ne do të sjellim një përmbajtje të dyfishtë, d.m.th., duke ndriçuar një pamje të gjerë të botës parahistorike dhe duke e bërë këtë ndriçim në dritën e të vetmit pishtar që ka mbetur, të gjuhës shqipe.

Ai, i cili shënoi, i pari disa emra, që kanë ardhur si të huaj në kujtimet klasike e që ishin shqipe edhe mbanin kuptimin e parë të fjalës, qe Engjëll Mashi nga Shën Sofia, në librin e tij “*Kolonitë italo-greke të Mbretërisë*”. Emrat *bora*, burim i qartë i fjalës *Borea* dhe *Iperborei*, etj., dhe tjetri *deti*, që vihet në lidhje me *Teti*, hyjnesha e detit, dhe, duke shtuar pranë këtyre edhe emra të tjerë që vetëm na ranë në mend kur ishim të rinj ndër shkolla, si *Diellios* homerik – përçues i Diellit, që është Dielli ynë, shihet qartë se e kanë zanafillën (prejardhjen) prej gjuhës shqipe.

²⁸ Po aty.

Këta shembuj të paraqitur vlejten për t'i sjellë mendjet e studjuesvet kahë një thesar i varrosur. U bënë shqyrtime në fenë e helenëvet, në botën e gjysëm-zotavet të tyre, në emrat e vjetër të krahinës që ata zenin. E, nga të tëra anët, na dolën emra të një vështrimi nga një botë me një qytetërim më të vrazhdë se ajo e helenëvet, të cilën helenët e kishin mbyllur mbas vetes. Kujtimet më të vjetra të këtyre janë, me gjithë këtë, dëshmi se prej asaj bote të mëparëshme, të quajtur pellazgjike, mbeturinat e së cilës qëndronin, gjithënjë, në mes të Greqisë, i kishte ardhur kësaj / botës helenike/ kulti i hyjnivet, natyrisht po me ata emra të huaj e me kuptim (vështrim) të panjohur. Kur u muar vesh, se emrat e sipërtreguar i përkisnin gjuhës së sotme shqipe, e se shqiptarët vazhdojnë ta banojnë Greqinë bashkërisht me helenët, e se këto fjalë jepnin kuptimin e funksionit të atyre idhujvet, u zhduk habia e parë dhe u kuptua veprimi i padukshëm i kohëravet të kaluara në kohërat e mëvonëshme, përse i përket përhapjes së dritës në mes të njerëzvet edhe përmes popujvet të pakujdesshëm, por që ndoshta *manent in dilectione ejus* (mbetet në dashurinë e tyre).

Duke studiuar fenë e helenëvet, del i qartë shartimi i njëj peme së re në një pemë tjetër më të vjetër, sikurse në histori mund të shihet veprimi herë konvergjent, herë divergjent i dy racave. E, po të mos merret parasysh kjo gjë, o të kuptohet errtas, nuk mund të arrihet, lehtësisht, në kuptimin e luftavet dhe të kontradiktave të brendshme. Feja pellazge muji me qenë vetëm sfondi i pavetëdijshëm i politeizmit antropoformik, tempull i ri, i ngritur, mbi shtyllat e një tempulli të vjetër, për të mbajtur besimin e popujve dhe për t'i mbështjellë brenda vetes. Fjala jonë *zea* (shpirti, fryma) e *zena* (filli, fillimi, nisja) janë prototipet e kallëzores së greqishtes të /fjalës/ *Zeus* (Jovi) *zea* e *zêna*; e *Hera* (Junona) është *Ora*, në gjuhën shqipe *Hêra*, e lindur nga bregu i lumit *Imbrasi*, emër shqip i fjalës i zbrazët.

Këto dy fjalë sillnin me vete kujtimin e Zotit, hartuesit të parë dhe të Herës (Ora), shoqe e tij, në krijimin e rruzullimit. Por, mbasi u zhdukën besimet e vjetra, *Zea* arriti që të nxirrej në panteonin e paskajshëm nga përfytyrimi tokësor, në mënyrë që shpirti i njeriut të duket sa më i shkëlqyeshëm. Dhe mund t'u nxirte me ato veçori që i përkasin këtij shpirti, që vetë nuk krijon, por rregullon qenëjet, sipas ligjeve *intelectae* të atyre qenieve. E qe ngadhnjimitar kundër

Titanëve një Zêa me zgjuarësi dhe vullnet, por i lidhur me qëllimet e paracaktuara të qenies. Kështu Jovi homerik përkulet, si shpirti i njeriut, nga fati i pamëshirshëm.

Në këtë mënyrë kjozatorët (shpjeguesat) helenë gjetën emrin *Hêra* të ngjashëm me *Aria* (= ajër) dhe këtë ia dhanë për grua *Zêas*: interpretim i pranuar me ëndje nga ata, të cilët, duke identifikuar *Zeus* me *Dieus-Dies*, panë, në këtë emër, të parafytyruar ditën.

Por shënimet, që i përkasin *Herës* (*Orës*), në kultin titanik, janë: 1) Ajo çonte rininë kahë martesë; 2) Ajo qitte në dritë pjellën, prandaj quhej *Junona Lucina* në Lacium, o po të duash *Ljehënia* që, në gjuhën tonë, don me thanë lindje; 3) Homeri e kujton mitin si një gjë të largët, sipas të cilit *Zêa*, për ta ndëshkuar Herën, për një faj të bërë, e nguli atë në ajri me dy kudhra ndër këmbë. *Ky mit dhe këto karaktere, ngjajnë dhe e shënojnë kohën që rrjedh përher.*

Në vend të reformës panteistike, që ndoqi besimin e vjetër, ne po sjellim përrallën e të larit të gruas së Jovit për çdo vjetë në një gurrë (burim), që kishte cilësinë ta kthejë virgjër hyjneshën. Ndoshta kjo gjë ka rrjedhë nga fakti se ajri, për çdo vjetë, laget nga shirat e dimrit dhe, në këtë mënyrë, i kthehet pastërtia.

Besojmë se është i mjaftë ky shënim, se kanë ekzistuar dy periudha fetare në Europën mesdhetare: kulti titanik primordial dhe ai që erdh mbrapa, d.m.th. kulti i Jovit rregullues. E do të përpiqemi t'i sqarojmë dhe t'i vemë në dukje në dallimin e tyre gjenuin, duke i hequr pengesat, që i përsien njerin me tjetrin.

1.

Dihej për një botë të dalur nga *khaosi*, lëndë e parë, e trazuar, jetëdhënëse. Khaosi është si një emër, që nuk gjen shpjegim të mundshëm në asnjë gjuhë; edhe, ndoshta, i pamjaftueshëm do të duket edhe ky shpjegim (mendim) që po paraqes. Mos të jetë, ndoshta, fjala khaos (helenikisht *haos*) e njëjtë, si në vështrim, ashtu edhe në tingëllim, me fjalën *gja* të Shqipërisë së Veriut, e prishur vetëm nga mbaresa greke -ose që, në gjuhën tonë, ka vështrim: *diçka* edhe *qenëje*?

Është për t'u vënë në dukje se prej khaosit nuk lindi *Zea*, që më vonë u bë zot i tij, por lindën forcat dhe trajtat e natyrës. Të bijt e Khaosit ishin Erebi, Oqeani, Rea, Urani, Jee, Aidhê, Fati, Nèmesi.

- 1) *Erebi* (banesa e errësirës) është fjalë shqipe: *erbiir* = errësirë; rrënja: *èrr* (errson).
- 2) Kështu është *Oqeani*, rrënja: *ûj*, *ûjana* (shumësi uji, shumicë uji).
- 3) *Rea* është fjala shqipe *rêja*; as nuk mund të ketë shpjegim tjetër të pranueshëm.
- 4) Në besimin e vjetër nuk ishte *Uranòs* (me vështrimin qiell), por *Vrëni*, *vrëni*, që për shqiptarët do të thotë *ajr i mugët, i errët dhe i lagështitur*; rrënja *vrëi*, e rrjedhur nga *erebi* i *Gjâsë* (i gjësë); e, nga ajo, në gjirin e tokës u prodhuan përbindëshat e tmershëm dhe trajtat e tjera titanike, mbeturinat e së cilave, gjithënjë, qëndrojnë. Kjo gjë është vërtetuar nga shkenca dhe e gjejmë ndër traditat biblike *tenebrae erant super faciem abyssi*. E *Jëta*, jo *Jèa*, u dha fund me kohë këtyre forcave të shregulluara.
- 5) Ajo fjalë që për helenët kumboi *Jèa* dhe e shpjeguan *Tokë*, është identike me fjalën pellazgo-shqiptare *Jëta*, që do të thotë *Bota*, e cila, më vonë, mundi të quhet *Nënë e kohës*, që shoqërohet me periudha kohe të njëpasnjëshme të rregulluara.
- 6) *Fati*, i lindur nga *Gjâ*-ja, lidhet edhe ai me *Zêa*-n át; dhe emri i tij vetë e tregon. Fjala *Fao* (greqisht), shq. *thom*, them; latinisht *Fari*, *fatum*, shqip *fjas* (= flas), *fjaalj* (= fjalë) kanë kuptimin e fjalës *Verbum* të pandryshueshëm, që mban e sundon rrozullimin. Ovidi e shprehu këtë gjë me qartësi ndër *Fast*-et e tija, kur thotë: “Fati (ose Verbum) u dha drejtimin forcave të natyrës”.
- 7) Të njëjtën gjë mund të themi edhe për hyjneshën titanike *Nëmesi*, mallkim (nâmë, nëmë), që është caktuar të ndëshkojë ata që, të mirat e Krijesës, i sjellin në dëm të qenëjevet, të cilat janë thirrë në jetë për të gëzuar. Thanë për këtë fjalë se rrjedh nga helenishtja *nemo* (shpërndaj). Në këtë mënyrë, ajo duhet të paraqiste Provaninë hyjnore. Por *Nëmesi*, që ndiqte fajtorët, ishte, përkundrazi, hakmarrësja e amëshuar e ligjës së Jovit dhe kishte marrë emrin nga kombi ynë, që thërret *Nëmes* – *mallkimin* (nâmën, nëmën); rrënja: *nëm* = mallkoj.
- 8) Fakti i të përpimunit të bijve të vet (i cili, më tepër se kohës, e cila nuk është tjetër veçse një koncept i shpirtit e së cilës i atribuohet reforma helenike) u përket forcave të errta të lëndëve të simbolizuara ndër Kabirët e errët të tempullit pellazgjik të

Samotrakies; e gjithmonë shpjegohet me emrin shqiptar *Ha-biir* (= që han birët e vet).

Gjithashtu Flegetonti, Koçiti, lumej zjarri, dhe Elizët, banesë e lumtur e shpirtëravet të pafaj, që e kishin vendin në botën e nëndheshme, janë jehe të fjalëve shqipe (*Flaga* është emri i flakës, *Kúkj*, ngjyra e kuqe, *I ljuum* = njeriu i lumtur, *i ljiind* = i pafajshmi), e shprehin besimin e njëj bote së përtejme, botës së të vdekurve, veçori e besimit titanik.

2.

Por nuk duam të themi me këtë se, nën sundimin e mëvonshëm të Jovit, - sundimi i ndarë ndër zotat më të mëdhenj, banues të Olimpiti, dhe të kryetarëve fetarë më të vegjël të jetës tokësore, - shkoi duke u shlyer gjurma pellazgjike, e cila në tempullin e ri (të ndërtuar me pjesët e copëtuara të komunikimit primitiv, që mbajti edhe ai ndërtesën boshe të pjesës së fundit) ruajti emrat e origjinës për idhujt e ri.

Zeus, që në ditët tona kërkohet ta unjisojmë me fjalën ditë, ishte gjithëmonë hyu kryesor, *Pater hominumque deumque*. Vëllau i tij ishte *Adhê*, sundimtar i mbretërisë së nëndheshme të të vdekurvet, e Neptuni – zot i detëravet. Tashti, *dhee* (= dhé-u) është emri shqip i tokës. *Is adhen* (= nën tokë) thonin helenët; *ndën dheen* (= nën dhenë, nën dheun) thonë shqiptarët.

Se Zeusi paska pasur një vëlla të tretë, Poseidonin, hyun e ujravet dhe si ai bir i Kohës, është e qartë se kjo është shtesë e huaj, e futur nga reforma panteistike. Nuk ka fjalë që i përgjegj këtij emri në gjuhën shqipe, as për Poseidonin, e as për Neptunin, siç e quajtën latinët, as për Plutin, emër që muar më vonë fjala *Adhê*. Herodoti bjen si të sigurtë faktin, se hyjnitë Posidoni dhe Hermes (Merkuri) jo nga pellazgët, por nga Libia erdhën te Helenët.

Është për t'u shënuar përkimi, me anë të të cilit u kërkua të përfytyrohet Të qenunit (ekzistenca) me anën e kultit politeistik; e duhet vënë në dukje, se prej kësaj përpjekjeje del e qartë që nuk ka pasur një fé, por një ndërtesë kozmogonike. *Rea* prej Hesiodit njihet për bijë e Uranit e të *Jee-së*, Tokë.

Urani për helenët, emri i Qiellit, është birë i Erebit e burrë i Jeas (Toka); prej këtij lindi Kronos (Koha). Kjo gjë është e qartë dhe e pranuar prej arsyes. Rêja është e bija e qiellit dhe e tokës dhe të maturit

e kohës nxiret nga rendi i Rruzullimit. Por mitologët tregojnë se Jea, e hidhëruar me Uranin, pse ky mbante ndër veriga Qind-duershat, bijt e tyre të përbashkët, armatosi me një drapër Kronosin, dhe me të copëtoi babën e vet dhe mbretëroi në këmbë të tij, duke i dhënë fund, kështu, epokës së hyjnive titanike, kryetar i të cilëve ishte Urani.

Koha e në ç'mënyrë i dha fund Uranit (Qiellës)? Në ç'mënyrë dhe kur e krijoi Zotin?

Shkëmbimi i fjalës *Vrenii* për Uranin, - *Vrenii* = errësiat e traditës pellazgjike e që u zhgattrua nga Koha, - është një provë se paganizmi pat një farë qëndrueshmërie të vazhdueshme, i përket nxjerrjes së lëndës mitologjike nga kujtimet titanike.

1) Përkundrazi, emri i një Hyjneshe së madhe, që lëshon rrezet nga Empireu i largët e që na përket neve, do të mjaftonte së bashku me fjalët *Deti*, *Dielli*, *Iperborei*, *Habiri*, me futë ndër mendjet më rigorozë konceptin, se në fenë e helenëve ka shkuar duke u shkri një kult më i vjetër, që i përkiste kombit të madh e të vjetër pellazgjik, i cili jeton ende ndër ne. *Athena* (Minerva e Latium-it), prej së cilës i dhanë emrin Athinës, themeluesit e saj pellazgjikë, ishte *Hyjnesha e Fjalës* dhe e *Dijes*, e *athëna*, ku pjesëza *a* tregon gjininë e emrit, në gjuhën tonë, ka kuptimin *fjala në idé*, ndërsa fjali quajmë *fjalën e shprehur*. Është për t'u vënë re se *Athena*, duke kaluar nga kulti titanik në Olimp, nuk u ndryshua në atë mënyrë sikur u ndryshuan fjalët *Zea* dhe *Hera*, ose, edhe po të jetë ndryshuar, është vetë ajo që vlen të dëshmohet se në Njerinë, prej të cilit e nxuarën, është parafytyrimi i Hyjnisë. Nuk lindi prej bashkimit të *Zeas* me *Heran*, por *Verbi i amëshuar* (fjala e përjetëshme), lindur nga áti, ishte shfaqur me anën e *zjarrit të dashurisë* (ifestos).

2) *Ifestos* (Vullkani, Hefesti) ishte birë i zjarrit e burrë i *Veneras*, *Hyjnesha e Bukurisë*. *Ifestos* dhe *Vesta* për shqiptimin e tyre të lehtë kanë shndrruar *dh* në *f* e *v* e janë një me fjalën tonë *e-dhesta* (= flaka e ndezur), rrënja *dhez*, ndez. Për helenët pat shqiptimin *Ifestos* e në Romë, ndoshta, e sjellur nga Frigët qëndroi *Vesta* (= flaka shenjte e amëshuar).

3) *Afrodites* (*Venus* e latinëve), *Hyjnesha e Bukurisë*, (për lindjen e së cilës helenët kishin një legjendë të turpëshme), më duket se i gjet (i përngjason, i gjason) fjalës sonë *Afërditës* = që është pranë ditës, që i prin ditës; o, ndoshta, pse me këtë emër kanë dashur të quajnë Hyllin e *Veneres* ose *Fuqinë magnetike shpirtërore të Bukurisë*, që i hap Ditën *Jetës*.

4) *Ares* (Marti), hyu i armëve, për të cilën fjalë nuk mund të gjindet çelësi në ndonjë fjalë helenike, rrjedh nga gjuha shqipe. Për në *jâri* është trim, dashnori, miku i gruas. Në këngën e dasmës, krushqit thërrasin nga jashtë nusen:

*Gàpe shpéit e m'u buthtò,
se më t'ert h jâri mbë deer.*

(Hape shpejt e m'u shfaq,
se të erdh dashnori në derë).

Ares, në Iliadë, paraqet zakonisht Jarin shqiptar.

Dhe jo më me pak qartësi, në ciklin e Hyjnive më të vegjël, gjejmë te gjuha shqipe shpjegimin e të qenunit të tyre.

5) *Deti* është fjalë shqipe; helenëve u mungon germa *d*; kështu, duke e zëvendësuar me shkronjën *t*, parafytyrimin të *Detit*, të Hyjnizuar, i lanë emrin e vjetër pellazgjik, duke ndryshuar vetëm germën e parë; e, kështu, kemi *Teti*.

6) Fjala *Dhêmeter* (Hyjnesha e Bujqësisë) ka në gjuhën shqipe vështrimin e plotë. *Dhê-meter*, fjalë e përbërë: *dhee* = dhë-u, tokë-a e *meter* = masë-a, merr kuptim të plotë. Benloew na ven në dijeni për një statujë të Dhêmetrës në Dodonë, “*qui couche à terre*” (“që fle në tokë”), pozicion që karakterizon këtë mit. Prej këndeje çdo lavrim nxiret nga masa e ndarja e tokës dhe, nëpërmjet të kësaj, qëndron në këmbë.

Shënim

Tregohet se Kronosi, i dëbuar nga qielli, qe strehuar në Itali, ku pat një kult të vetin të shenjtë, duke simbolizuar punën e njeriut mbi vegjetacionin tokësor; e quajtën në gjuhën e vendit *Saturno* nga *Satum* (= me mbjellë). Në botën pellazgjike, sipas Herodotit, gjejmë një fac simile në Abari, *i pari ndër njerëz, i cili, pajisur me një kosë, ngau Tokën (shkeli Tokën)*. E ky emër ka një jehonë në gjuhën tonë nga bota parahistorike. *Ha-bari* për ne ka kuptim, ai ushqehet me barë dhe përfytyron njerëzimin, i cili, duke u ushqyer me fryte, me një kosë në dorë, filloi të shfrytëzojë tokën.

7) Për bri hyjneshës së të korrave qëndron *Pâni*, hyjnia i parë i *postfoetantes*. Helenët kujtuan se vjen nga fjala *Pan* [gjithëçkafja]. Dhe

atyre iu besua, sikurse ndodh për sendet, të cilave njeriu nuk u jep rëndësi. Gjithashtu, ishte fare e qartë se ai nuk ka qenë një hyjni aq e madhnueshme sa të paraqitte rruzullimin dhe as nuk kishte farë cilësie të madhërisë së palëkundshme të tij [Panit]. Por, për ne, është e qartë se emri i zanafillës që *Bâna* (bëra). Në gjuhën shqipe *Bâna* don me thanë të bamunit, të bërit, prodhimi; rrënja: ban (me bâ; bën, bërë). E bana ishte pikërisht zoti i prodhimit tokësor, që hjedh një mbas një qeniet në jetë. Fetarët e këtij kulti, ndër festat e Luperkaleve në Romë, ngitnin (vraponin) rrugë më rrugë; e zonjat romake dilnin nëpër dyer për të qenë të prekura nga hyjnia, me qëllim që bëheshin nëna.

Sot gjuha jonë ka shumë kordha, që kanë shkuar duke u dobësuar ndër këto shtegëtime. Shumë fjalë i ka qitur jashtë përdorimit, por, me gjithë këtë, reflekton aq shumë nga ajo botë që i prin botës klasike, sa që mund ta marrin me mend për gjithë atë sasi fjalësh, që mbante në gjirin e vet.

KONFERENCA III²⁹

Duke zbritur prej Hyjnivet ndër Gjysmë-hyjnité, ne ndeshemi, pikë më së pari, ndër dy heroj, në Akilin e në Agamemnonin, të cilët, bashkë me Herkulin, patën namin më të madh në botën e vjetër. Herkuli nuk është një emër i shpjgueshëm me anën e gjuhës shqipe. Legjenda e këtij të birit të Jovit nga gojëdhënat u përkiste emigrimeve aziatike në Greqi, prandaj është e huaj për autoktonët. Mijëra vjetësh më përpara Herkulit teban, një Herkul tjetër kishte tempuj në Egjipt e në Tiri, siç e gjet Herodoti në udhëtimin e tij dhe shëmbëllente fuqinë heroike, si trupore ashtu shpirtërore. Ai krijoi në Greqi lojrat që kishin për qëllim të përsosnin shpirtërat e trupat e njerëzvet, duke u përpjekur, vazhdimisht, të dëbonin prej njerëzimit veset e të këqijat. Në revolucionin e madh dhe të vazhdueshëm, të gjatë, në të cilin mbretëria e Jovit zëvendësoi kultin e dikurshëm titanik, tregohet se Herkuli mbante mbi supe qiellin në vend të malit Atlas. Këtij mali, majet e të cilit me borë të përjetëshme futen (hyjnë) në thellësitë e qiellit, i ka mbetur emri pellazgjik *at ljash* = át i vjetër, i lashtë, i moçëm, pse ky qëndronte përpara syve të stërgjyshave tanë si përfytyrimi i besimit të parë kundrejt qiellit; e, mbasi u zhduk ky përfytyrim, Herkuli, simbol i Ligjës morale, e mbajti vetë qiellin për disa kohë.

Por dy heronjtë homerikë janë, pa tjetër, konceptione (botëkuptime) të popullit, prej të cilit ne rrjedhim.

Akili gjën në gjuhën shqipe shpjgimin e simbolit të tij: *Aq-i-ljee* /= Aq i lje: Aqilén/, që në gjuhën tonë don me thanë *Aq i lehtë*, është *Ahjilea* e miteve, për të cilin Homeri thotë se mund të kalonte sipër njëj are plot me kallëza, pa i përkulur, dhe e thërret, vazhdimisht, me epitelin këmbëshpejti.

Engjëll Mashi nga Shën Sofia që i pari që vuri ré se Plutarku, në “Jetën e Pirros”, kishte shkruar: “Se në Epir Akili kishte një tempull të vjetër si

²⁹ Po aty.

Hy i Atmes (i Atdheut) e nën emrin autokton (zanafillës, vendas) *Aspetos* (= i shpejtë), fjalë që lidhet me shqipen *i shpëti* (= i shpejti, i shkathti)". Ai ishte ideali i lules së jetës njerëzore, që zhduket me një herë, të cilën ujrut dhe toka e mbajnë, e ushqejnë dhe e rrisin me bukuri e me fuqi. Prandaj ai lindi nga hyjnesha *Teti* (Deti i pandryshueshëm, i përhershëm) dhe nga kreshniku Peleu, që rrjedh nga fjala jonë *pülj* (= pyllë), lartësi e ngritur me pemët e saja plot gjetth që vyshken. Deri ndër kohëra më të vona ka qëndruar kujtimi i kësaj bashkëshortësije simbolike. Euripidi, në fillim të "Andromakës", thotë: "E këtu kufizohet toka e Ftijes me Thesalinë, ku, një ditë, Teti detare, e nxjerrë jashtë nga vizitat e vazhdueshme të të gjallëve, u bashkua me Pelenë. E, prej këtij bashkimi të kësaj Hyjneshe, thesalët e kanë quajtur vendin *Tetideo*". Kjo është një kompozitë dy fjalësh për gjuhën e tyre që, për ne, mbesin të njëjtat: *Deti* dhe *Dheu*.

E këto nuk janë stërhollimet tona. Homeri, poemat e të cilit ne i kemi në gjuhën helene, sigurisht e dinte vështrimin kombëtar të këtyre dy emrave Teti dhe Peleu e se kishin po atë kuptim që kanë për ne *Deti* e *Malet*, e mbushura në pyje. Në librin XVI të Iliadës, ai ven në gojën e Patroklit këto fjalë për Akilin:

"Mizuer: As Áti ty Peleu, as Nëna
Tetis nuk të qe, por *deti i zi* dhe ija
e njëj *shkëmbi* të polli".

Kështu edhe fisit pellazgjik i përket miti i Uliksit, që paraqet jetën e njeriut të rrahur gjatë shtegëtimit të tij, i cili, duke kaluar me anën e forcës së zemrës së tij dhe të ndihmës hyjnore, i jep fund shtegëtimit të vështirë, i dërmuar nga udhëtimi. Uliksi, të cilin Helenët e bëjnë të vetin, është një krijim i huaj për ta, që nuk ka mundur, në asnjë mënyrë, të mbulohet nga ata që kanë mbledhur e kanë shpërndarë poemat e Homerit. Ai, më tepër se një tip i veçantë shtegëtari, ne na duket si një tip special i fisit pellazgjik të dërmuar nga fati, që nuk pat kurrë një vend të caktuar prehjeje dhe strehimi.

Pa dashur këtu me shoshitë në se fjala shqipe *uudh* (= udhë, rrugë) është përpara apo e njëkohëshme me fjalën homonime *odhòs* të helenëvet, e se emri i kreshnikut endacak (të arratisur) rrjedh prej nesh, *Udissë* (që ka mbetur i paprekur *ab origine* për latinët në Ulixes) është i konfirmuar nga vetë vargjet e Homerit. Uliksi, në shpellën e Polifemit, atij që i kërkoi emrin, i përgjegji kështu: "*Utis* më thërrasin mua, nëna dhe baba im)". Mandej ra nata, në të cilën edhe Odiseu ia shkimi Ciklopit të vetmin sy që kishte në ballë, e, kur ky filloi me bërtitë

në kupë të qiellit, ia rrane (ia behën) ciklopët tjetër dhe e pyetën se çka kishte, Polifemi përgjegji: “*Utis*, që për grekët don me thanë *kurrkushi* më ka plagosur”. E ata largoheshin prej andej, duke menduar se donte me u tallë. Tashti, edhe duke pranuar se Odiseu ishte shumë i zgjuar dhe se me qëllim e kishte çpikur këtë emër për të shpëtuar veten, ne na duket mendim krejt femënor e jashta vendit kjo çpikje e Homerit, sikur mos të kishte një bazë të veten. Përkundrazi, në rapsodinë primitive, duhet të ketë qenë: emri *im* është *Udhisse*; kështu më thërrasin nëna dhe baba”. E *Udhissë*, që në gjuhën e tij atërore kishte vështrimin udhëtar, s’është çudi që për ciklopët helenë pat kuptimin *udhisis = kurrkushi*, e, atëhere, kjo mosmarrëveshje, e rrjedhur nga një fjalë me tingull të barabartë, por me kuptim të ndryshëm ndër dy gjuhë të ndryshme, hynë në familjen e çpikjeve të thjeshta e gjeniale të këtij poeti sovran.

Ky interpretim vërtetohet nga fakti se Ulisiti i qe ngjitur ky emër nga gjyshi prej nëne Autoliku, i lindur në Parnasin e banuar nga pellazgët. Në Odisenë (Libri XVI, vargu 493 e vazhdim) lexojmë: “Autoliku, atëherë, u suall e tha: O dhëndërr im, o bijë, vini këtë emër që unë po ju them. Mbasi unë rrjedh prej burrash e prej grash, që janë endur mbi këtë tokë, që ushqen gjithë frymorët, këtij t’ia ngjitni emrin e përshtatshëm Ulises (endacak). Kur të rritet, ai do të vijë në shtëpinë amënore, në Parnas. . .”.

Një gjë është e vërtetë, që pluskon mbi atë periudhë legjendare të vdekur, se ai (Ulisiti) qe birë i njëj nëne shqiptare, e se prej saj e mësoi gjuhën.

Këtyre dy tipave të pavdekshëm të asaj jete aristokratike besoj se do të vijë dita t’u shtohet figura e *Perseut*, për të cilin poeti Algeu shkroi vargje aq fuqimisht origjinale dhe të ëmbla. *Përzéu* (i përzanuni, i dëbuari) rrjedh nga folja jonë *përzé* (me dëbue, me përzanë); dhe ky është emri ideokratik i fatit të tij. Është e treta figurë e gjysmë-hyut që, i dëbuar (i përzanun) nga hidhërimi ziliqar i njerëzvet, por i prirë prej *Fatit atëror*, mbron trimërisht në Andromedën pafajninë që e ka për zemër Jovi, e, mbasi then *Gorgonen Nekmantia*, që ka fuqi me i ngri frymorët, hyn në lavdi e në pushim.

Nekmantia (fjalë shqipe *Nëkmëntia* dhe, në ndonjë dialekt, *Nekmuntia*= Pafuqishmëria) i binte në të përrallës që e bën njeriun të palëvizshëm. (Cfr. Ankimin e vajtueshëm të Herkulit te Homeri, Odiseja, libri XI).

Disa kanë thënë se, pa e provuar, unë kam identifikuar pellazgjit me kombin, prej të cilit kam nderin të rrjedh. Por unë besoj se, çdo argumentimi, - e kështu mendojnë edhe shumë të tjerë - i prin dëshmia e intuitës në mënyrë të qartë. Fjalët e gjuhës pellazgjike, që kanë mbetur ndër përmendoret (monumentet) e lashtësisë klasike, janë fjalë të gjuhës shqipe, që kanë po atë vështrim të dikurshëm. Viset (vendet), që historia më e vjetër i shënon si banesa pellazgjike, shumë prej të cilave kishin emra që janë fjalë shqipe, janë, gjithënjë, në pjesën më të madhe, të zëna (të xanuna) nga kombi ynë. Por, për të na u mbushur mendja, plotësisht, gjë që është e pamundur, do t'u donte që ne të përfshinim, me një shikim të vetëm, stërgjyshat e vdekur dhe stërnipat që tashti jetojnë; e, vetëm në këtë mënyrë, do të mundnim me e vërtetue identitetin e gjuhës.

E, pra, ne kemi prova të padiskutueshme se i njëjti popull mëshehet (fshihet) nën dy emra të ndryshëm. Në Atenë, në kohën e Tukididit, endë qëndronte, pranë Akropolit, një lagje e quajtur *Pelazgia*, e banuar nga pellazgjit. Sot kjo lagje mban emrin e dikurshëm *Plakia* (= plaka: në gjuhën shqipe) e është e banuar nga shqiptarët, që qëndrojnë, gjithënjë, te këmbët e Akropolit, edhe kanë tjetër veshje, tjetër gjuhë e tjera zakone, krejt të ndryshme nga helenët, me të cilët banojnë së bashku në të njëjtin qytet.

Përsa i përket ndenjes së lashtë të krejt fisit tonë, për të cilin Louis Benloew, në librin e tij "*Greqia përpara grekëve*", ka diktuar gjurmë aq të mëdha, ne do të kënaqemi këtu, duke sjellur pak shembuj, por të qartë.

Straboni, që jetoi gati njëmijetëqind vjet më parë, tregon në Librin VII të Gjeografisë së tij, se si, në kohën e tij, vërshimi i ujit në drejtim të jugut, prej maleve të vendosura në mes të Istriës e Skjavisë, si edhe rrafshultat, që janë nën këto male deri në Heladhë, ishin banuar nga barbarët (= të huajtë); e se Ekateu i Milezit kish lënë të shkruar, se në Peloponez, përpara helenëve, jetonin po ata barbarë, e, për më tepër se në mbarë Greqinë, po ata kishin banuar qysh në kohërat më të vjetra, e, në mes tjerash, vetë Atika ishte zënë nga trakasit, të ardhur me Eumolpin.

"Në kohën e tij – shkruan Tuqididi – fiset epirotase zinin (okuponin) pjesët e epërme të Akarnanisë dhe të Etolisë, e se, mbasi Anfiloku ish kthyer nga Troja, për arsye se Argoja, vendi i tij, filloi me e kqyrë me sy të keq, u detyrua, së bashku me të vëllanë, Alkmeonin, të strehohet në Akarnani. Mandej, si i zu vendin e tij si mbret, themeloi Anfilokinë.

Anfilokasit ishin fis epirotas e, me ta, gjithë ata tjerët që bashkë-jetonin, pak më sipër, nëpër male, deri në kufi me sllavë: Tesprotasë, Kasiopej, Mollosas, Atamanë, Palagonë, Etnej, Istiej, Oreste, Parorë, Atintanë. Në mes të këtyre fiseve, aty këtu, gjindeshin të shpërndarë dhe të përzierë fise sllave, që kishin kaluar në këtë anë, në atë zonë malesh, që shikon me fytyrë kahë jugu. Njëkohësisht vendet malore, që nga Durrësi e Apollonia e deri në Akraçeron, mbaheshin nga fise epirotase të Vlionëve, Taulantëve, Partenëve e Frigëve”.

Ke përshtypjen se je në udhëtim, së bashku me të, nëpër Shqipërinë e sotme, e kufizuar me fise sllave e katunde sllave, të cilat, ai gjeograf i përmendur, i gjet, në kohët e vet, brenda atdheut tonë.

E ai vazhdon: “Ata që vehen në udhëtim prej Apollonisë e Durrësit, ndeshen, me një herë, në rrugën *Egnatia*, të çelur nga romakët. Me të vërtetë, për atë që kalon nëpër këtë rrugë, i qëndrojnë kahë majtas malet sllave, nga e djathta fiset epiteze deri te gjiu i Artës, qytet epirez shumë në zâ në atë kohën e tij, kur Pirrua kishte këtu fronin e vet. *Via Egnatia* kalon sipër këtyre, duke u përshkuar nëpër Pela, dhe arrin në Selanik. Ai që, nga deti, hyn në gjiun e Artës nga e djathta në Akarnani, gjen disa *katunde helene*; e krahina, që qëndron kahë e majta e Peloponezit dhe kahë e djathta e rrugës *Egnatia*, përmban fise të Maqedonisë e të Peonisë deri në Strimon. Mbas këtij lumi deri në *Emo* e te gryka e Detit të Madh shtrihet Trakia. Vetëm gjatë brigjeve detare gjinden *qytete helene*.”

“Toka e Lingistëve dhe e Palagonëve, e ka marrë emrin *Maqedonia e Epërme* prej Orestejetve dhe prej Emëve; e ka asish që, krejt këtë zonë, deri në Korçirë, e thërrasin Maqedoni, për arsye se, *të gjithë, së bashku, flasin të njëjtën gjuhë, veshen dhe mbajnë flokët njësoj dhe, përta u përket zakoneve, janë të ngjashëm dhe të një familjeje*”.

Gjuha që flasin, është shqipja; petku i të gjithëve është toga e bardhë heroike, që i zbret prej belit deri te gjunjët. Do të duket e tepërme, por ne duam me kujtue disa emra vendesh e tjera, që aty kanë mbetur, që nga kohërat parahistorike, e janë fjalë të shqipes së sotme.

Dyrrachium, në qoftë se me të vërtetë mbështetet mbi dy kodrina, sigurisht e nxuar erin nga fjala: *dy* e *rahje* (= kodër, në dialektin arbëresh).

Kur Cezari tregon zbarkimin e tij në Epir, thotë: “Ditën e nesërme ne prekëm brigjet e Cerauneve, tërë shkëmb, dhe të tjera vende të rrezikshme dhe e shtrimë ushtrinë në atë krahinë që quhet Farsalia”.

Për né, Farsalia është një emër i përbërë nga fjalët *afër* dhe *zali* (= bregu); emër i ngjitur nga banorët asaj krahine që ishte *afër bregut*.

Prej Maqedonisë, krahina më e shtrirë (më e nderë), kishte emrin *Emathia*, fjalë e paprekur shqipe, që don me thanë *E madhja*; e Pella, kryeqytet i kësaj zone, e pasur për kuaj, rrjedh nga fjala shqipe *pela*. Engjëll Mashi, para të gjithë të tjerëve, vërejt se maqedonasit thirrëshin *loon* muajin e korrikut, që ne e quajmë *lonaar*, e se fjala *kêti*, me të cilën Quintus Curtius përcaktonte si një mënyrë kombëtare, me të cilën Aleksandri i rregulloi flokët, në mëngjezin e luftës së Granikut, është *kësheti* /= gërsheti/ shqiptar, emër i gërshetimit të flokëve gungalec mbas kreje.

Duke shkuar më poshtë, Tezalia u quajt kështu prej stërgjyshërve tanë, mbasi ishte krejt *bregore*, shqip *te zali* (= te bregu).

Fjalë të tilla ne gjejmë deri në Greqi brenda, në mes të helenëve. Unë, një ditë, çela te gjeografi Ortelius hartën topografike të Tempes; por, aty ku unë prisja të shoh një rrafshultë të mrekullueshme, mbeta i prekur, porsa vura re shkëmbinj, njerin mbi tjetrin e, në mes të këtyre, Peneun, që lëshohet rrëmbyeshëm terposhtë në luginë. Kështu, prej kësaj pamjeje madhështore të këtyre shkëmbinjve të pamasë, e gjeta arsyen, pse stërgjyshat tanë e quajtën këtë vend Tempe (*timpë* = shkëmbore në gjuhën e tyre).

Këtu duket ishin vendosur selitë e zanave e prej këtij /mali/ quheshin *Peonie Tracie* (Treyssae). Herodoti tregon se banesat më të volitëshme të pellazgëve - (e ky emër nuk ishte i një kombi, por i autoktonëve origjinarë, mbasi në atë kohë ishte në fuqi ndarja ndër fise) - ishin vendosur në Pind, Olimp, Elikonë, Parnas, që endë sot banohej, në pjesën më të madhe, nga shqiptarë. E këtu shpirti më mbushet me një gëzim të thellë, duke ndjerë, kahë frynë, në gjithë këtë udhëtim, fryma e atdheut tim përmes rrenojash (gërmadhash), që koha ka hedhur e grumbulluar sipër.

Edhe emri *Shkeptâri*, që na japin neve, është apelativi i lashtë, të cilin Homeri e përktheu në *kjeravni*. Fjala *shkeptur* e shqipes dhe *kjeravnein* e helenishtes donë me thanë, të dyja së bashku, me vetue (me shkrepitë), fjalë që ka mundur të rrjedhë o nga malet e Himarës së tmerëshme për shkrepitima të quajtura *kjeravni*, nga të huajtë, të cilat male i banuam dhe i banojmë edhe sot e kësaj dite; ose kanë mundur të na mbesin nga perandoria pellazge e Shkreptëtimës.

KONFERENCA IV³⁰

Në fund të fundit, njeriu pyet veten:

1) Në cilën kohë Jeta niste t'i përshtatej mendësisë idhujtare, rendi e hovi i së cilës nuk u merrnin më nga *Zea* titanik, por forcat dytenike të natyrës përbënin fatin e verbët që i jep shpirt dhe e lëviz [jetën]?

2) Mos qe, ndoshta, kulti fetar i fenomeneve të natyrës një shkëputje e parë nga komunikimi primitiv dhe fondi i vetëvetishëm i idhujtarisë?

Përsa i përket ardhjes së politeizmit antropomorfik, ai duhej të jetë zhvilluar ndër periudha të gjata parahistorike. Idhujtaria ishte vendosur në Mezopotami në kohën e Patriarkëvet e, në Azinë e Vogël e në Greqi në epokën e luftës trojane, megjithëse flitet se ishte në fuqi shumë më përpara në Indi, etj.

Por, që kjo idhujtari të ketë pasur djepin e vet ndër fise pellazgo-epireze, është në kundërshtim të plotë me traditat historike, që na ka sjellë historiani i lashtë Herodoti. Ky, mbasi ia atribuon kombit pellazg mitet e fesë natyrore, thotë: “Se zotat, në fenë pellazge, nuk ishin konkretizuar ndër trupore, por shumë më vonë trupore të këtyre hyjnive u qenë sjellë pellazgëve nga Egjipti”. (V. *Libri II i Historive të tija*). Nuk dihet nëse, në origjinën e tij, ai kult të ketë qenë një shmangie nga Zoti Át e jo më si adhurim i *Zeaskrijues*, i cili adhurim s'u shtri mbarë botës sikur të ishte shfaqje e Tij [=e Zeas]; Po kështu shpjegohet kuptimi i emrit *Zea* në gjuhën tonë, e cila i përket po asaj kohe, kur u zhvillua ajo fé primitive. Nuk është e mundur që kulti i kotë *i diellit, i hënës, i tokës, i shpirtit të gjallë*, i punëve rregulluese të këtij rruzulli, të cilin e ka nën sundim, t'i ishte dhënë njeriut që prej zanafillës për pushim të tij.

³⁰ Po aty.

Dhe është, sot për sot, me rëndësi të madhe e mbi çdo hulumentim tjetër kërkimi që i pat dhënë një shtytje kaq të përgjithshme e kaq të qëndrueshme shkëputjes së kreatyrës nga krijuesi i saj; dhe këtij t'i gjunjëzohej ajo e përulur para dukurive të pakuptueshme që e rrethojnë (njerinë).

Një gazetë e Francës, në vitet e para të perandorisë së Napoleonit III, kërkonte, përsëri, me entuziazëm, që hyjnitë e vjetra të zenin vend në Olymp. E sot, mbasi u zhdukën këta idhuj, ashtu siç mendohej një herë e përgjithëmonë e, në vend të tyre, u përhap, në të gjithë njerëzimin një doktrinë tjetër dritëdhënëse, ka njerëz që dalin e kërkojnë kthimin e tyre, e ky kthim pritet me dëshirë prej shumë njerëzve. Tashti, në qoftë se *hulumtimet* e një qytetërimi parahistorik, që ka lënë gjurmë në gjuhën e Atdheut tonë dhe në qoftë se analiza e magjistarit të hyjnueshëm të kësaj gjuhe shumë të vjetër, nga e cila analizë jemi drejtuar, [këto hulumtime] kanë për qëllim kryesor t'ia kthejnë kombit shqiptar ndjenjën e fisnikërisë së tij, përpara se t'i jepet çelësi i shtëpiave të tij dhe pavarësia. Le të jetë si kurorëzim i këtij misioni tim, afër perëndimit, një fjalë që të përtërijë në mendjen e saj dinjitetin e bijës ndaj Zotit e, që prej kohe, e devotshme ndaj tij dhe, me anën e tij dhe të birit të hyjnueshëm të tij, nëpërmjet frazimeve e stuhive, pati fatin të dalë fitues mbi rrënojat. Kjo fjalë të qëndrojë si rreze dielli që nuk e lagin ujërat re erërat nuk e lëvizin.

Janë disa që pohojnë, - e nuk e dijnë - se Krijuesi vuri dy ligjë, njera prej të cilave, për kah pesha dhe për kah masa, përçon botën e jashtme, kurse tjetra – sipas dëshirave - ven në lëvizje vullnetin e njerëzve si don vetë. Prej këndeje nxjerrin [përfundimin], se nuk ekziston liri vetjake në njeriun e se ka sipër njeriut diçka që drejton forcat e rruzullit kah mirëqenia, për të cilën njeriu jeton.

Por këto doktrina rrenimqare pehliuanash kurrë nuk kanë mundur t'ua mbushen mendjen njerëzvet që t'i nënshtrohen fatit dhe as epërsia e pasurisë nuk mund të përulë fuqinë e trupit e të shpirtit. Kështu, gjithmonë, adhurimi i shtetit ka qenë efekt i paqëndrueshëm i një sundimi të dobët dhe koprracia me kuptim të zakonshëm, është quajtur, gjithherë, prodhim i vogëlsisë shpirtërore.

Njeriu, që shtie ose nxjerr diellin e shiun prej dhomave të veta, nuk mundi kurrsesi, në një gjendje normale të pranojë t'u gjunjëzohet

atyre forcave të pamatura e më të forta se ai²⁷. Qe e pamundur për njerinë që t'i mbajë ato forca si zotëruese mbi të, si të kishin fuqi në vetvete për t'i dhënë atij jetë të pandashme e të lumtur. Ai synoi gjithnjë t'i përdorte si desh vetë, kur kishte nevojë.

Por, në se kundrejt botës që e rrethon njerinë, nuk është ndonjë shenjë që të tregojë se ai ka diçka tjetër, përveç vetëvetes, atëherë nuk ka as gjurmë për të kuptuar atë që ai sheh dhe di, as nuk dallon ndër ato /aspekte/ ndonjë paralelizëm me vetëdijen e detyrave, në të cilën identifikohet *Ligji i Zotit që kthen shpirtërat!* Kjo vetëdije, duke u hyjnizuar, ia nënshton, vazhdimisht, zbatimit të atyre detyrave veprimin e forcave të përbotshme, ashtu sikurse *Fati* [u nënshtrohet] atyre të urdhëruara nga *Áti*, që e ka ndër qiej, kështu që të ndeshkoinë moskujdesin dhe të shpërblejnë përmbushjen /e tyre/. Njeriu e ka pak a shumë të qartë, në fund të shpirtit të vet se vetëm është zot i këtij planeti, por vepra e njeriut mbetet vazhdimisht zotëruese. Nga gjuha pellazgjike që na ka mbetur, kemi tri fjalë me trajtë të huaj ndër foljet e saj, *thom*, *kam* e *jam*, të vetmet, ndër të gjitha, që në veten e parë të pohores /= diftores/ sosin më *-m* (shkronjë që në të folmet e kthen idenë në kryefjalë): *thom*, *kam*, *jam*, që nuk përvetësohen veçse nga njeriu dhe që shënojnë tri tiparet e pamohueshme të dinjitetit të tij gjysmëhyjnor dhe më të fortë se jeta e shkurtë e tij.

“Vetëm njeriu paraqet idenë e fjalës së Zotit, që shfaqet në realitetin e sendeve, dhe i jep formën e vet në të folur; vetëm ai e përdor, pastaj, atë në një botë të tërë, për qeniet thuajse të shpirtëzuara: *vetë thom*.”

“Vetëm ai, ndër të gjallët, vepron sipas vullnetit dhe sipas shkallës, duke përdorur aftësinë krijuese dhe e ndjen se është e tija ajo që bën dhe që *ka* sikurse zoti.

“Nga aftësia për ta vështruar atë dhe nga mundësia që ka për ta lidhur botën me vetveten me anën e fjalës, nga zotërimi i gjërave që i kthen e i përdor si do vetë, dëshmon se e zotëron vërtet atë /botën/, ndryshe nga imagjinimi në ëndrra, dhe munda të thotë: *U jam* (= unë jam).

Mbas kësaj, ne kuptojmë se nga *Verbum* i Zotit njeriu merr vetëm shfaqjet e jashtme; se vepra e tij (e njeriut) është një mënyrë e thjeshtë përdorimi, sipas nevojave të shtytjeve që vëren ndër objektet dhe mbasi të ketë vdekur, ia le përgjithëmonë ndërtesat e tij kohës se po i njëjti kuptim i *qenies* nuk vjen nga një fuqi e natyrshme, por për hër të të tjerëve dhe në fund i kthehet në *shpresë*. Dhe mendjen e vet

e ka krahasuar, shpesh, me imazhet e reflektuara ndër pasqyra, pa jetë; sepse /vetëm/ kjo i mbetet personit që vdiq dhe në pasqyrë ka të projektuar hijen e vet e asgjë prej vetes.

Dhe gazi e vaji, me burime të panjohura tek ai, shënojnë e vijëzojnë kontrastin e përhershëm të dy anëve të natyrshme në vetëvete.

Pra, shtytja për të mos besuar në se ai ka të bëjë me hyjnitë, do të ketë rrjedhur nga pjesa që iu caktua nga ana (pjesa) e dobët e natyrës së tij. I është dashur të jetë i tillë tani që forcat e vërteta të përjashtme e kanë pushtuar jetën; dhe, në heshtjen e botës së vetmuar, që erdhi pastaj, u zhduk (u përmyt) çdo bindje ndaj Zotit: Siç e lanë, brez mbas brezi me gojë, kjo ndodhi kur përmytja ua rrëmbeu njerëzve sipërfaqen e tokës dhe çdo herë që njerëzit gjysmakë qenë goditur nga vegime, të hapura si nëpërmjet vetëtimës, për horizonte të reja të dyshimta të natyrës. Të dy hyjnitë e Sumirëvet, siç duket nga mbishkrimet e më se 4000 vjetëve para Krishtit, do të thoja, të mbetura pas përmytjes, ishin *Shpirti i Ujërave dhe ai i ferrit* (avisit).

Dhe kalimi, i shfaqur para syve tanë i atyre që kanë humbur besimin *në qenien e vet të shkretë*, duke e mbajtur veten si të paditur për gjithçka që mos *të preket e të shihet*, ai kalim është një pamje nënshtrimi ndaj zbulimeve të vazhdueshme e të mrekullueshme, brenda organizmit të botës. Efekti përfundimtar i këtij [veprimi] do të sjellë, padyshim, afrimin tek në të *Shpirtit Krijues*, ashtu si, tashti, udhëtimin e caktuar i dritës, që vjen nga yjet më të largëta të kupës qiellore dhe hyn në botën ku jetojmë, dëshmi që nga fillimi i kohëve të pamata për shfaqjen e Tij në krijim e për amëshimin e tij.

Por tjetër është aftësia e tanishme e njohjes së atyre. Njohja në një mënyrë sa më të plotë e sistemit planetar dhe e forcave që e lëvizin dhe e përtërijnë këtu, mbetet pothuajse e vetmja gjë përpara nesh dhe veprimi i tyre është e vetmja fjalë që dëgjojmë jashtë.

“Njohja e natyrës – shkruante Humbolti dhe nuk kishte prova për këtë – duhet të ketë si synim, gjithnjë, të vërtetën dhe të bukurën, duhet të përdoret aty për të pasuruar mendjen, për të zgjeruar horizontin e ideve dhe për të ushqyer e gjallëruar fantazinë”. Po a qëndron këtu vallë qëllimi i jetës së njerëzve? Apo, përkundrazi, qartësia e mendjes dhe fantazia profetike vlejnë për diçka që qëndron jashtë tyre? Të gjithë e kuptojnë se jeta nuk qëndron në përsosmërinë e tyre të përkryer, por në të pasurit prej tyre përfitim dhe perfeksionimin e

frytit të vet, që është të vënit e dorës së vet në dorën e atij që e desh në këtë planet të përgatitur për të dhe (e deshti) në të dhënit shpirt pranë tij dhe në *hirin*, i cili pastaj e mbulon.

Së fundi, mund të thuhet një fjalë e sinqertë. Shfaqjet e njëpasnjëshme të trevave, të botës së pafund kanë përlur, gjithmonë, shumë shtresa njerëzore, por qëndruan nën fjalën që do të pritnim prej saj, sepse bota as prej elementeve, prej të cilave përbëhet, as prej dukurive që i shfaq jashtë, nuk ka kurrnjë përgjegje për nevojën që ka për nevojën e njohjes së natyrës dhe vullnetit të krijuesit të saj, në të cilën njohje qëndron përgjigja pse që ndritur jeta e njeriut dhe ku drejtohet ai. E, pra, vetëm ajo jetë është jona dhe na është lënë në dorë për ta ruajtur. Ç'na shërben në të dimë nga rrjedh fryrja e erërave? Ç'i vlen njeriut që vete drejt varrit, të kalojë nëpër një panoramë të pamatur, kur nuk njih *dëshmitë e zotit dhe testamentin (dhjatën) e tij?* (*testimonia domini et testamentum ejus?*). Me të drejtë që thënë se për të njohur jetën e njeriut, zotëruesit të tokës, na shpie pamja e harmonishme e botës, të cilën mund ta arrijmë me anën e aftësive tona vetjake duke pasur bashkë me ne e pranë nesh ujërat, zjarrin me dritën e vet, bukën e të folmen e shokëve dhe, në sfond, larg, qiellin më të largët (empir) plot me yje të panjohura, që tregojnë një diçka të përtejme të panjohur dhe që të mbushin me përjetësi. Ndaj, nga shpirti plot me diturinë e fuqinë e pasosur të një dashurie të pafund, vetvetisht, del lutja: *Pater noster qui es in coelis!* (= Áti ynë që je në qiej!) ashtu sikur fytyra e njeriut që, më parë, kish një bukuri mahnitëse, e copëtuar gjithkund nga hekuri, me zorrë të ndyta të dala përjashta në diell dhe me sy të shuar, të ngjall neveri e lemeri dhe ashtu sikur anatomisti s'do t'ia dijë aty as për shpirtin që në të fliste, po kështu edhe autopsia e madhërisë së lartë e ndihmëse të Gjithësisë (Kozmosit), i rri, me forcat e pranishme, të ndara e të shumta në veprimtarinë e tyre, si një tis (vel) Zotit të lumtur e të fundosur ndër humnera (avise), dhe i lë dorën vepruese gati si zotëruese të gjithësisë.

Kjo është ashtu siç thuhet ndër né, dhe s'ka të bëjë me mosnjohjen ose poshtërimin e vegimit të madh të krijimit, i qartë ndër ditët tona. Zbulimet që bëhen njeri pas tjetrit ndër shekuj, janë përsëritja nga Fati i parë dhe të drejtuara për të nxjerrë para njerëzve dëshmi të reja e të vazhdueshme për Zotin dhe për t'i bërë gjithnjë më të afërt me të. Por kjo nuk e përjashton faktin që dukuria e papritur, e paraqitur në forma të ndryshme e të pakufizuara të botës, të ndodhë gjithnjë

duke i habitur njerëzit e thjeshtë dhe të përhapë ndër ta ndjenjën e inferioritetit. Gjithnjë, në të tilla epoka, shumë /njerëz/ i braktisën besimet e vjetra, dhe u mbështetën në *pozitivën*, ose në atë që e dinë se u sjell ndonjë forcë, me të cilën të mbrojnë veten dhe pasurinë e vet, dhe, gjithashtu, të kenë si shokë fati frymorë të ndryshëm, të cilëve, sikurse atij, u zbardh dita dhe, sikurse atë, strofuj e çerdhe e mbulojnë kur është natë: me një heshtim më të madh për të mos prishur bisedët që burrë e grua bëjnë ndërmjet tyre, atje ku ata rrinë bashkë.

Kjo gjendje e ulët është shtrati natyral i idhujtarisë. U pranuan për Zot, Dielli (*Diellios*), Hëna (*Diana*), Gruri (*Dagon e Cerere*), Vera (*Lico*), Pasuria e tufave (*Actanoth*), Era e natyrës (*Beelfegor*), etj.

Idhujtaria solli deri sot plot pasoja (rrjedhime), që, përsa i përket vlerës praktikeve të zbulimeve botërore, jemi dakord të pranojmë se ato zbulime i çuan njerëzit në përfitimin e të mirave që sjell gjiri i tokës. Dhe njeriut të vdekshëm, të lindur nga ndonjë kafshë e vdekshme, iu desh të luftonte për jetën dhe të ketë si qëllim të vërtetë të jetës së vet ripërtëritjen e species (llojit, farës). Dhe ka njerëz me kokë të mjegulluar që arsyetojnë gjithënjë duke u mbështetur mbi pohime të njerëzve të tjerë, që i mbajnë si të autoritëshëm dhe bërtasin se ky /njeri/ është *Gjeniu i shekullit* dhe se ai nuk është tjetër veçse djalli, kundërshtar i Krishtit të Zotit, “të cilit duhet t’i bindemi dhe të jemi të denjë për të”.

Në kaq, kjo shtytje e verbër drejt thesarit që thuhet se është i fshehur në botë, ka kaluar tashti e gjithmonë, ashtu siç thotë fjala popullore, nëpër një *grumbull thëngjish të shuar*, ose le të themi se në lidhje me faktorët më të mëdhenj të të mirave, që janë: dielli, shirat, mjegullat, erërat, të diturit e sotëm nuk mund të bëjnë asgjë më tepër nga ç’kanë bërë njerëzit e pagëdhendur të kohëve të kaluara; ose le të themi se nuk është i mundshëm një prodhim i atillë që të plotësojë lakmitë për të pasur e për t’u kënaqur në një masë të pakufizueshme; ose le të themi se natyra, që zëvendëson me anë të makinave punën e njeriut, ia heq këtij aftësinë e natyrshme të përdorimit të vetvetes dhe turma të papunësh i ngre si valë deti të gjerë kundër atyre që veprojnë *me art (me mjeshtri) e me shkencë*, dhe këta kanë, në vend të atyre, këtë fakt: Bota e qytetëruar, e, sidomos në Europë, është në gjendje të mjerueshme dhe e pushtuar nga frika për një të ardhme të zezë. Nga qytetet tona vërshojnë turma të uriturish ndër vise të largëta. Dhe disa nga ata mbesin të helmuar, ngaqë shohin se pasuria e qytetit, e bërë publike, u është lënë në dorë

ta mbarështrojnë dhe ta gëzojnë ato parti që përbëjnë *shumicën*; dhe ato, duke qenë në numër më shumë, besojnë se, duke i kthyer krejtësisht shtetet në shushunja të qyteteve, kanë arsye të venë duart e tyre të ndyra në trashëgiminë, e cila nuk u është lënë këtyre nga brezat e mëparshëm dhe në frytin e përpjekjeve të tanishme të fqinjve. Është era e qelbur e skëterrës së vdekur që e shoqëron shejtanin (djallin), të kthyer në engjell drite, dhe i rrënqeth të gjallët.

Por ravgimi i mendimeve e i përpjekjeve do të përplasat mirëfilli dhe shpejt në gurin e palëvizshëm të natyrës hyjnore të shpirtërave. Vënia mendjen kësaj fjalës sime të vërtetë. Ai duhet të shohë, mes nesh, çdo mesditë, grupe grash që vijnë të ngarkuara me kërthia (me dru, me shkarpa) e që, pas pak, shkojnë, përsëri, në pyll për t'u rikthyer në mbrëmje. Nga ato që mbeten në shtëpi, dikush shkon ndër ullinj, dikush ndër të mbjella, dikush lan papushim teshat (petkat, rrobat) dhe rregullon dhomat. Dhe, me të njëjtin kujdes, punojnë burrat, kush në parmendë, kush në shatë, kush vete pas tufave (grigjeve), përpiqen për të jetuar. Një kujdes, pra, kanë dhe ky është i përbashkët për të gjithë. Dhe, sikur kjo sipërfaqe të ishte tërë jeta e njeriut, bota do të ishte një dhomë e pamatur, ku një gjen i keq mbyll e mban njerëz të pikëlluar që e kuptojnë, por s'dijnë të gjejnë në vetvete fajin e ndëshkimit.

Po jeta është një kandil që e ka dritën e vet si éteri nga lart, dhe pothuajse nuk kujtohet për këtë. Nga ata burra dhe nga ato gra të shkriira nga andrallat e jetës, ju lutem të mendoni sa të paktë janë ata e ato që e ndezin zjarrin, gatuajnë gjellët, sigurojnë veshjen duke menduar vetëm për vetvete se do të kenë, pastaj, qetësi. Ajo që vjen me ujë nga burimi (nga gurra), më së pari, i jep motërzës që e pret në prag; burri rrushtë, fiqtë, mollët më të mira që i ka mbledhur në bashtë (në kopshtë, në bahçe), i ruan si diçka të gëzueshme për t'ua çuar bijve e gruas. Një tjetër sofrën (tryezën), që do ta shtrojë, në mbrëmje, mendon se do ta përgatisë për atë zot (për atë hy) të familjes. Duket qartë se ata mblidhen në shtëpi, në vatrën e prindërve. Në këtë botë reale, që e kemi nëpër këmbë, është ndjenja për shoqishoqin që e mban punën e të gjithëve përballë botës së rreme, të imagjinuar për të mbrapshtit, botën e luftës për jetën. Dhe Zoti, në atë bërje të plotë të vetën, sepse është plot dashuri e drejtësi, i ka dhënë secilit shëndetin e trupit.

Është, pra, dhe qëndron përpara njerëzve, një Mirë (Fata) më e madhe se kujdesi që i jep të mira trupit, dhe aty është fytyra e Zotit,

e vulosur në shpirtra. Dhe cilësia e tyre që qëndron në mirësinë e në pafajsinë, është baza e përjetshme e përherëshme e shoqërisë njerëzore dhe, njëherit, burimi i çdo gëzimi hyjnor. Shkëlqimi, që ajo cilësi përhap edhe jashtë ndër fytyra, është thelbi i çdo të bukure që njeriu e vren në format e njerëzvet e në botën, shfaqje e burimit të çdo dashurie, të çdo të vërtete. Latinët i quajtën të ndershme rrezet e asaj cilësie të shpërndara në veprimet, në gjuhën, në sjelljen; etërit tanë e thirrën *hjee* = hjë, hijeshi) ose hije e bukur e pemës njerëzore. Dhe nga ajo bukuri, nga brenda e shpërndarë ka jashta në njeriun, ndizet bashkimi i pashuar kurrë, i shpirtërave të rinj bashkëkohës, dashuria, miqësia, me rrëmbimet e të cilave, nuk mund të krahasohet asnjë gjë, edhe sepse afrohet me ëndjet, nga të cilat shoqërohet gëzimi i të miravet. Bekuar qoftë pra kjo, nga që e gëzon jetën dhe këtë ta përdorë dhe të mos e bëjë në asgjë. Vetëm se një të tillë sferë të ulët (të mëvonshme), - mbretëri e lashtë e hyjnive Satirë të vegjël, Faunë, Najadë – dhe e sjellur tek ne nga Gjeni i shekullit, *i mungon Dielli*, - siç u shpreh në mënyrë të shkëlqyer një zonjë e frymëzuar, stoli e tanishme e Austrisë së saj, - i mungon Dielli asaj dhe imazhit që ia jep Arti. Dashuria qiellore, që mbush me besimin në jetën e përherëshme, është banuesi i fundit i Parajsës tokësore, engjulli që i ka përjashtuar prej andej të gjithë ata që i kthejnë shpinën për të kapur mollët e prishura dhe të ushqyera me lym. Jo, nuk është e mundur që bota e pafund dhe plot me urtësinë e tij të jetë ngarkuar me detyrën e përherëshme për të mbajtur derra e mëza (kuaj) të vdekshëm, dhe për ripërtëritjen e tyre të përherëshme.

*

* *

Ne nuk kemi vënë filiza të një peme të thyer nga erërat për mbarësisë e kësaj sferë të ulët (të mëvonshme). Dhe as që i dëshirojmë! Etërit tuaj lëshoheshin, aty, në një tokë tjetër, jashtë shtëpive dhe pasurive që kishin aty, dhe jashtë ajrit fuqিদhënës që vinte nga qielli i tyre, për të mos u shkëputur nga dinjiteti stërgjyshor, dhe nga Zoti. Të mos i mbajmë si të zvetënuar shpirtërat e tyre të lartë, për të cilën gjë

popujt, që jetonin me ta, qenë admiruar e shikuar me aq simpati; të mos mallkojmë sakrificën e tyre, edhe nëse të jetuarit e vështirë që kaluan ata, na bën kaq të lavdëruar për shëndet e fuqi. Më të mirët e të dy kombeve më fisnikë të botës, dolën nga një shtrat jo i ndryshëm nga juaji; dhe, duke marrë, do të thoshja, bukë e ujë të tokës dhe duke jetuar të kënaqur me këto, mbetën si shembull për të gjitha kombet e qytetëruara. Përmbi hallakatjen e shpirtvegjëlve, imazhet (parafytyrat) e të mëdhenjve të Greqisë e të Romës, të vendosura, si në një galeri të përherëshme, në librin e Plutarkut duken, gjithnjë, si gjysmëperëndi. Por stërgjyshërit tanë, të cilët ia dhanë shpirtin e tyre bijve të vet të vërtetë dhe mbetën në mes tuaj, u jepnin bekim edhe më të madh. Áti i qiejve, në se do t'i qëndrojmë të drejtë e të mirë, do të marrë në dorën e vet dorën tonë përmes fateve. Ja: kështu ka bërë deri tani; dhe, mbas katër shekuj provash të vështira, të paprekur jemi endë nën hijen e yllit të dalur përsëri, që prej së largu mbi fatet tona.

1893

27. ALFABET KOMBËTAR³¹

Gjuha dhe tingujt e saj kanë lindur bashkë me kombin që e flet. Të shprehurit e saj, i ngulitur (fiksuar) ndër shënja, zhvillohet gjatë kohës nga aftësia e secilit. Ai është gjithënjë artificial dhe është, pak a shumë, i përsosur, në qoftë se shënjat e shkruara janë pak a shumë në gjendje për të pasqyruar tingujt e fjalës. Në këtë përkim besnik qëndron cilësia e lartë e çdo alfabeti.

Nuk e di se në ndërgjegjen e cilave kombe qëndron zhvillimi historik i alfabetit të gjuthës së tyre, ose nga cilat shkrime më të vjetra popujsh të tjerë të ketë dalë ky alfabet ose të ketë marrë nga alfabetet e mëparëshme, pak a shumë të plota ose të shuara. Dhe, gjatë analizës, me sa duket, nuk mbizotëron shumë mendimi, se ato alfabete fiksojnë (ngulisin), në një mënyrë të plotë, zanoret e gjuhëve, të cilat i përdornin. Gjuhët romane e filluan rrugën e tyre me gërma latine, që nuk mjaftonin. Do të shënojmë nga italishtja vetëm shkronjën *d*, që shëmbëllen në *duro* (= i fortë, i ashpër) si *dia* (= dhia), tingulli i ndryshëm nga *d* në fjalën *odore* (= erë); dhe shkronjat *s* dhe *z* në fjalët *veste* (= rrobe grash, fustan) dhe *ozio* (= përtësë) me fjalët e njëllotja (identike, të barabarta) në *svoglio* (= i zgjuar nga gjumi) dhe *zero* (= xero, kurrgjë). Nga kjo kuptohet që, për të paraqitur me një shkronjë disa tinguj, rrjedhin pasiguri dhe pasaktësi në shqiptim. Për t'iu shmangur kësaj, duhet të ngulitet me rregulla gramatikore ndryshimi i një shkronje të vetme p. sh. në frëngjisht shkronja *s* në fjalën *sein* (= kraharor) dhe në *raison* (= arsye).

Kur u fillua të shkruhet shqip, - e së pari e bëri Propaganda Fide në Itali – u përdorën gërmat latine të pamjaftueshme edhe më parë për italishten; dhe aqë më tepër të pamjaftueshme për shqipen, që ia

³¹ *Alfabeto Nazionale, La Nazione Albanese*, anno 1, nr. 6, p. 1, Pallagorio (Catanzaro), 31 marzo 1897.

kalon aqë shumë italishtes me tinguj; shqiptimi i çuditshëm e bëri të pakuptueshme /gjuhën/. Për t'iu shmangur pasaktësisë në paraqitjen e tyre, [të tingujve me anën e gërmave] dy albanologët e shkëlqyer Hahn-i dhe Stier-i me kapitenin Xylander, duke u marrë me gjuhën shqipe, përdorën alfabetin grek, duke e plotësuar me gërma të italishtes. Në të njëjtën kohë, botohej “Milosao” me gërma latine, duke përdorur pak gërma greke e pak të tjera konvencionale.

Më pastaj, grupe gërmash latine erdhën duke i zëvendësuar gërmat greke, duke besuar se, me anën e tyre, do të mund t'i zëvendësonin plotësisht, p.sh. shkronjës θ grupin e formave *th*, shkronjës χ grupin e formave *ch*; dhe u quajt një fakt shkencor ajo që ishte një miratim i gjurmës latine të qytetërimit evropian. Shumë kohë humbi, në këtë përpjekje, Dhimitër Kamarda. Unë, nga ana ime, ndër botimet e mia të pastajme, iu përmbajta, duke shikuar ta përmirësoj, alfabetit të preferuar në “Milosaon”, si më i kuptueshëm për Italinë, ku jetojmë, dhe për shoqërinë evropiane.

Ndërkaq, në çerekun e fundit të këtij shekulli, u përhap në Mëmë-dheun një alfabet i përzier³ me gërma sllave, ndoshta me latine e greke, të cilat u përdorën herë ato, herë këto, për të pasqyruar tingujt e gjuhës amtare: dhe, mbas gjithë këtyre, ngeli se ngeli e meta e alfabetit të Propaganda Fides: pasiguria e kuptimit të shkronjavet, të çaluarit e metrit dhe të theksit me kaq larmi dhe të hequrit e fazave të së shurdhëtës. Ndër të tjera, shkronja *q* latine, si ka humbur tingullin e vet, në na shëmbëllen herë me *c*, herë me *kj*; dhe *z* herë tingëllon *zh*, si në fjalën *zhèé* (= xe, me xanë, me mësue), herë tingëllon me *z* helenike, si në fjalën *zée* (= zë, fillo, nis) pa e humbur tingullin e vetë italishtes *ozio*(ocio, përtaci). Duket se përdorimi i këtij alfabeti, më tepër se të dy alfabetet e preferuar të Kristoforidhit, rrjedh prej përdorimit të tij nga Lidhja e Prizrenit. Naimi dhe Sami Frashëri më propozonin nga Konstantinopoli këtë alfabet, duke më premtuar se do t'i jepnin ndihmë të madhe revistës sime *Fiamuri Arbërit*. Po unë do të isha gati të vuaja të gjitha torturat, para se të prishja fytyrën hyjnore të gjuhës amtare. Nuk ishte ndonjë sëmundje foshnjore zgjedhja e shkronjave të mia, por, siç e thashë edhe përpara, ose nuk isha i kënaqur me to, ose për gjendjen e keqe të tipografive, me të cilat më jepej mundësia të punoja, u detyrova të ndryshoja pesë a gjashtë herë alfabetin. E vërteta është

se unë nuk do t'ia kisha filluar një alfabeti, që do t'ia merrte frymën e lirë e të fuqishme të jetës, dhe, si një shtrat i Prokustit, do ta gjymtonte gjuhën dhe do ta zhatërronte shpirtin muzikor të saj.

Desh Zoti kështu për të më diftue që përpjekjet (mundimet) e mia ishin prej tij dhe në të mbështeteshin. Mendja ime qëndroi, së pari, në ato gërma, që mund të shprehnin gjuhën shqipe në formën e saj më të plotë e kjo m'u shfaq mua më tepër se ndonjë tjetri. E kjo, pastaj, bëri që të jepte pëlqimin e saj *Shoqëria Kombëtare* me pjesën më të madhe të anëtarëve largpamës. Është një alfabet i përpiluar në mënyrë që të pasqyrojë aq shënja sa janë tingujt e të folurit; dhe, megjithëse ato shkronja janë marrë nga gjuhë të ndryshme, në përgjithësi të njohura, ka këtë të mirë që i përdor sipas kuptimit që kanë gjetkë, në mënyrë që të jetë e thjeshtë dhe e lehtë për t'i mësuar.

Po të kthehet edhe një herë sot shkolla e Konstantinopolit, duke na kujtuar njësinë (unitetin), të propozojë Alfabetaren e saj kaq të gjymtë dhe të parashikojë *mosmarrëveshje*, po të vazhdojë alfabeti tjetër, përveç çudisë (habisë) dhe shqetësimit shpirtëror që lindin tek unë, nuk i ka hije as urtësisë, as patriotizmit të njohur kudo, të të atestuarëve të asaj shkolle.

Në Gjermani vazhdon, edhe sot e kësaj dite, alfabeti gotik e latin, pa sjellur ndonjë përçarje të madhe në punën fisnike të përbashkët. S'jam ndonjë që nuk e kuptoj *simbolin e bashkimit* që përmbahet në alfabetin e saj, dhe ajo është e lirë t'i qëndrojë edhe besnike; por të mos jetë alfabeti, si ndër gra mendjelehta, një arsye që të na prishë njerin me tjetrin.

Kur kombi ynë, i braktisur, do të kthehet, edhe një herë, të marrë frymë lirisht, - në qoftë se kjo është thënë nga Fati, - në gjirin e jetës së tij më të mirë të lashtë, ai vetë [d.m.th. populli], pavarësisht nga rrethanat e jashtëme, do të mbajë nga të dy, atë alfabet që do të shprehë, më së miri, frymëzimin e jetës së tij të plotë.

31 mars 1897

28. PELLAZGO-SHQIPTARËT³²

Thanë se para se ta provoja (dëshmoja), unë i identifikova Pellazgët me kombin, të cilit jam kaq i nderuar t'i përkas. Kjo është.

Por në çdo arsyetim besoj (dhe shumë më besojnë) se dëshmia e intuitës shkon përpara në dritë të plotë. Fjalët e gjuhës pellazge që mbijetojnë në përmendoret e antikitetit klasik janë fjalë të gjuhës shqipe që rezistojnë duke mbartur kuptimin që kishin në to. Vendet që historia më e lashtë i përcakton si vendbanimet e pellazgëve dhe shumë prej të cilave u vunë emra që janë fjalë shqipe, janë akoma në pjesën më të madhe të zëna nga kombi ynë.

Mungon, për plotësinë e bindjes, ajo çka njeriu nuk do ta ketë kurrë; të qenit në gjendje të kuptojë me një vështrim paraardhësit e vdekur dhe fëmijët që ende jetojnë dhe të dallojë njehsimin e identitetit të tyre gjuhësor.

E megjithatë ekziston një provë tjetër e pakundërshtueshme se ato janë një popull i vetëm nën dy emra të ndryshëm.

Në Athinë, në kohën e Tuqiditit, mbeti nën Akropol një lagje e quajtur *Pellazgi* dhe që banohej nga pellazgët. Sot kjo lagje ruan emrin antik *Plakia* (e lashta në shqip), dhe është e banuar nga shqiptarë të cilët megjithatë mbeten nën Akropoli dhe kanë një veshje tjetër, një gjuhë tjetër, zakone të tjera të ndryshme nga helenët që jetojnë bashkë me ta në po atë qytet.

Për sa i përket banesave antike të mbarë rracës sonë, prej të cilave Luis Benloew, në librin e tij *La Grèce avant les Grecs (Greqia përpara grekërve)*, tregoi gjurmë kaq të larmishme, ne do të mjaftohemi vetëm me disa tregues por të qartë.

³² *I Pelasgo-Albanesi, La Nazione Albanese*, anno 1, nr. 11, p. 4, Pallagorio (Catanzaro), 15 giugno 1897.

Straboni rrëfen në librin e VII të gjeografisë së tij, se si në kohën e tij shpati jugor i maleve i vendosur midis Istros dhe Skiavonisë dhe fushat poshtë tyre deri në Heladë, ishin të banuara nga barbarë; Hekateu i Miletit kishte përcjellë në kujtesën e pasardhësve të vet se në Peloponez, para Helenëve, banonin ata barbarë, se madje, e gjithë Greqia, në kohërat antike, ishte e banuar po nga ata dhe, ndër të tjera, Atika ishte e pushtuar nga trakët, të cilët erdhën me Eumolpus-in.

“Se në kohën e tij, fiset Epirote pushtuan rrjedhat e sipërme të Akarnanisë dhe Etolisë, - shkruante Thukiditi, se Amfilokut, me t’u kthyer nga Troja, meqë Argosi, atdheu i tij, filloi ta shihte me sy të keq, iu desh të strehohej tek i vëllai Alkmeoni; i strehuar në Akarnani, ai pasi pasoi të vëllanë në fron, themeloi Amfilokinë. Se Amfilokët ishin njerëz Epirotë, dhe bashkë me ta, të gjithë ata që jetonin mbi male, deri atje ku bashkoheshin me Sllavët: Thesprotë, Kasiopë, Molosë, Atamanë, Palagonë, Etne, Istie, Krete, Parorë, Atintanë. Se mes tyre, *kishte aty-këtu popuj të përzier sllavë* të cilët kishin këtej, në pllajën e maleve që sheh nga jugu. Po kështu, tokat malore nga Durrësi në Apolloni e deri në Akroçerauni, mbahen nga fiset Epirote të vlonëve, taulantëve, parthenias, dhe frigjëve.

Dhe njeriu ndjehet sikur po udhëton me të nëpër Shqipërinë e sotme, në kufi me popuj sllavë që ai gjeograf i madh, i gjeti, në kohën e tij, brenda saj.

Dhe Straboni vazhdon:

“Ata që lëvizin nga Apollonia dhe nga Durrësi mbërrijnë në një kthesë ku ndeshen në rrugën *Egnatia*, të hapur nga Romakët. Tani, ata që ecin përgjatë kësaj rruge lenë në të majtë malet sllave, drejt janë fiset epirote deri në Gjirin e Artës, një qytet shumë fisnik i Epirit të asaj kohe, atëherë kur Pirro kishte atje pallatin e tij. *Egnatia*, duke kaluar nëpër Pella, arrin në Selanik dhe atyre që hyjnë në Gjirin e Artës drejt e në Akarnani nga deti, u paraqiten *disa vendbanime helene* dhe rajoni në të majtë të Peloponezit, duke vazhduar drejt përgjatë Egnatias, përmban fiset e Maqedonisë dhe Peonit, deri në Strimon. Pas atij lumi, deri në Emo dhe grykat e Detit të Madh (sot, Deti i Zi) shtrihet Traka. *Vetëm përgjatë brigjeve të detit ka qytete helene.*

“Territori i lingistëve, i palagonëve, i kresteive dhe i emëve është quajtur edhe *Maqedonia sovrane* dhe ka disa që të gjithë vendin,

deri në Korfuz, e quajnë *Maqedoni*, për shkak se të gjithë së bashku flasin të njëjtën gjuhë, vishen dhe i mbajnë flokët po njësoj, ndërsa në zakone janë të ngjashëm e prej një familjeje.

Gjuha që ata flasin sot është shqipja; veshja e zakonshme është toga (fustanella) e bardhë heroike, e cila zbret nga rripi në gju.

Ndoshta është e tepërt, por ne duam të evokojmë disa emra të vendeve që ekzistonin atje që prej kohërave parahistorike dhe sot janë fjalë aktuale shqiptare.

Aty ku Çezari rrëfen zbarkimin e tij në Epir dhe thotë: - “të nesërmen prekëm brigjet çerauni, në ishuj dhe vende të tjera të rrezikshme dhe u shfaqëm atë rrugë që mban emrin Farsalia”.

Për ne Farsalia është një fjalë shqipe, i përbërë nga *afër*(afër) dhe *zali* (zalli): emër i imponuar nga vendasit për vendin buzë zallit.

Sa i përket Maqedonisë, krahinës më të madhe, ajo ka emrin Emathia, fjalë e paprekur shqipe që do të thotë *e madhe*; dhe *Pella*, kryeqyteti i atij rajoni që ushqen kuajt, është emri i *pelës* në gjuhën tonë.

Dhe duke zbritur më poshtë, *Thesalia* u quajt kështu nga paraardhësit tanë, në të cilën *te zali* do të thotë në breg.

Dhe jehona të tilla pasqyrohen edhe brenda Greqisë dhe midis Helenëve.

Na duket se vendet e Muzave na përkisnin neve, dhe ata vetë quheshin *Poenie Tracie*(Treysae). Herodoti na thotë se ato vendbanime që erdhën pas atyre të pellazgëve, dhe ky emër nuk ishte i kombit, por i vendasve autoktonë, ku në ato kohëra mbizotëronin ndarjet në fise, qenë më pas Pindi, Olimpi, Helikoni dhe Parnasi, të cilat edhe tani banoheshin, në pjesën më të madhe, nga shqiptarët.

Dhe këtu shpirti më mbushet me një gëzim të thellë, duke ndërë, pas një udhëtimi kaq të gjatë, se atdheu im merr frymë sërish kudo përmes rrënojave që koha ia ka hedhur kapicë përsipër.

15 qershor 1897

29. POR ËSHTË E NEVOJSHME NJË PJESEMARRJE E GJERË NË RIMËKËMBJEN KOMBËTARE³³

Përpyekjeve tona për të rimëkëmbur Shqipërinë nuk u mjafton aspak dëshira, as brohoritjet për vetë këtë. Rimëkëmbja mund t'i vijë vetëm nga dy arritje (suksese): ripërtëritja e tërë jetës së saj dhe paqa (qetësia) e kësaj, si të jetë zonjë e veprës dhe e pasurisë së vet. Tash ajo [rimëkëmbje] arrihet me kthimin në ritet, doket, kostumet etj. të saj, që formojnë (sajojnë) veshjen e jashtme dhe me pasqyrimin në gjuhën e vet, pa u prishur nëndialektet, të gjithshkaje që është trashëgimi e qenies së përmbrëndshme të vërtetë të saj. Paqa (qetësia) në shtëpitë (familjet) e saj do të jetë drejtuar mirë nga veprime të bëra me urti e me nder.

Fatbardhësisht të dy këto gjëra paraqiten mirë; dhe simpatia e kombeve europiane i shoqëron dhe i përkrah. Nga njera anë, përmendore artistike, gramatika, fjalorë, etj., o në përpilim o të nxjerra në dritë, dhe, pastaj, njëherit me ta edhe katër gazeta që, së bashku nga vise të ndryshme, shënojnë, pothuajse, një fakt: ringjalljen morale të kombit.

Nga ana tjetër, vazhdon, bashkë me ato përpjekje, burrëria (virtyti) e të lindurve në vendin, shqiptar, me fitore aq të shkëlqyeshme ndaj armiqve të perandorisë turke, me të cilën fatet dhe besimi leal na kanë lidhur si dhe urimi që aty, më së pari, e shoqëron aktin heroik të tyre: “Që të mbeten të dalluara nga fiset e ndryshme që përbëjnë perandorinë dhe që të shporren nga qytetet e tyre dhe të zhduken shkollat e huaja, që janë bërë shkatërruese të vetë ndjenjës kombëtare”.

Në të vërtetë, helenët, bullgarët, serbët, malazezët s'kanë asgjë ç't'i mësojnë Shqipërisë o që të jetë edhe e krahasueshme me mendimin e

³³ *Ma uòpo è di largo concorso alla restaurazione nazionale, La Nazione albanese, Pallagorio (Catanzaro), Anno II, Nr. 15, 15 agosto 1898, p. 3.*

me shpirtrat (frymën) që përmbahen ndër librat që kjo i ka nga gjuha e vet.

Megjithatë, këto fatmirësi i kundërshton dhe i shqetëson mendimi se në kulturën intelektuale, e shiguruar kudo për të drejtuar punën politike, nuk merr pjesë, do të thojë, që tani mëmëdheu, as Greqia, ku ka një numër më të madh pellazgësh të shpërndarë.

Vetë lëvizja në kolonitë e shpërndara në vise të tjera mbështetet në përpjekje të individëve të rrallë, të cilëve u mungon përkrahja kombëtare; Këshilltarët dhe nxitësit e shpirtrave kombëtarë janë të mërguarit nga mëmëdheu në qytete të largëta (Bukuresht, Bruksel) dhe trashëgimtarët e shpërngulur të saj, në Itali.

Kjo është gjendja e punëve që na rri parasysh dhe që *plaçkitësit e poshtë* (që dësherojnë të përpijnë qenien tonë me qëllim që t'u mbetet në dorë atyre vendi ynë i bukur) i mban shpresa, ndoshta, se do të kthehen, brenda pak kohe, “në ato të paka zjarre të rreme që nuk janë ndezur sot për shpëtimin tonë”.

Ndërkaq, unë kam një besim të patundur në zemrën time që shpëtimi ynë është në dorën e Zotit dhe se qëndresa e dëshirave dhe e ndërmarrjeje është e madhe ndër njerëzit e popullit tonë dhe se ajo nuk do të lërë që ata, të cilët e ndihmojnë Atdheun e vet me të holla, të pushojnë së ndihmuari për shkak të fondeve. Dhe, aq më tepër, ma forcon arsyetimin (bindjen) time prania e fateve shumë më të lumtura nga të kaluarat që edhe ato vlejten të përftojnë këtë shpresë kaq të madhe që kam sot.

Ndërkaq shkëlqimi që, qoftë nga librat tanë, qoftë nga rruga e çelur prej nesh e që ka dalë aq në pah, do t'i kthejë nga Greqia në gjirin e atdheut vëllezërit tanë shqiptarë, të gënjyer, tashmë, nga Sinonët Helenë.

Turqisë nuk ia dimë ende gjendjen e brendshme, prandaj vazhdojmë ta këshillojmë që të presë me durim dhe përsërisim se nuk i vlen të bashkohet me të tjerë për t'u shtrirë ndër né nga çmimi i vazhdueshëm i Shqipërisë efektive kundra asaj [Turqisë], së cilës duket se i vinë në ndihmë botimet tona. Në fund, çkado që të bëhet tek ne, duhet të marrë shkas, krejtësisht, nga dashuria për farefisërinë tonë dhe jo nga shpresa feminare për krijime fantastike dhe për kënaqësi nga hakmarrje të mbrapshta. Ngritja pa mendim, sot, kundra të metave të qeverisë turke do të kishte për pasojë veprën e ligë të të zgjedhurve

të vegjëlisë sonë, autorë të vëllavrasjeve të tanishme të Italisë. Veprimi ynë duhet të jetë shumë i matur, leal, dhe të mos i ndruhet dritës: dhe na fyen, gjithnjë, thumbimi (pickimi) *i grezëve të të tjerë këso dore*, që, ndoshta, nuk e mbulojnë (helmatisin) njeriun.

Po, çkado që të ndodhë me fatin tonë të ardhshëm në këto mbretëri, Rilindja (Ringjallja) jonë është e thënë që të arrihet vetëm nëpërmjet duarve tona. Vendqendrimet tona, o të gjitha viset ku janë përhapur, varen nga qeveri me gjak të huaj (tjetër), dhe që s'kanë arsye që të përpiqen për të mirën tonë, dhe as që interesohen për ndonjë gjë. Të mbash, sot, gazeta e libra që të na nderojnë dhe që t'i bëjnë popullit tonë vend mes kombeve të dalluara, është punë që varet nga pjesëmarrja e gjithë kombit.

E vërteta është ajo që këshillon *Albania* e Brukselit, “që komunet (bashkësitë) shqiptare të themelojnë shkolla shqipe më vete”, është punë e ftohtë, qoftë për parashikim, qoftë për pavendosmëri, qoftë për pafuqi.

Ato ne i zëvendësojmë, tash për tash, *me praktikimin që na vjen për dore të shtypit, pa tjetër, të dobishëm e të denjë*, praktikë me të cilën jemi të rysur e që kushton, përgjithësisht, pak lira vjetore. Është e sigurtë që, tek ne, bashkitë së paku dha famullitarët me të hollat që u vijnë atyre nga atdheu, të blejnë botimet patriotike dhe t'i venë, pastaj, në dorë të popullit, me të cilin janë të lidhur. Edhe eprorët e çdo qyteti e kanë për detyrë të marrin pjesë sa të kenë mundësi në ngritjen e jetës së popullit të vet, që i nderon e i adhuron.

Por përhapja, nëpërmjet abonimesh fisnike, në Turqi të cilat do t'i quaja beteja të jetës pellazge (shqiptare), është jashtëzakonisht e nevojshme dhe si i vetmi mjet i Fatit të lartë që shpresojmë ta kemi të nevojshme për një kohë sa më të gjatë.

15 gusht 1898

30. SHQIPTARË DHE GREKË³⁴

Tek “*Fiamuri Arbërit*”, viti III, n. 3, 20 shkurt 1886 lexohet:

Vuajtje e madhe qe, në këto raste, për shpirtin tim mbrojtja që iu bë Greqisë nga njerëz të shquar, dhe mospajtimi që ata patën për mbrojtjen tonë.

Dhe më lejoni të shpalos të gjithë arsyen e atdheut tim të mjerë, përpara Europës, se si pata nderin t’ia sqaroja kujtdo që e kishte me shumë merak dhe në çdo aspekt nderimin tim.

Çezar Kantu më shkroi:

“E marr gjithmonë “*Fiamurin tuaj shqiptar*”, por, ju rrëfej se nuk më pëlqen deklamimi jua i vazhdueshëm kundër Greqisë. Që nga viti 1829 ne e mendonim Epirin - Janinën të shkrirë me Greqinë, ndërkohë që nuk di se si ta imagjinoj të ndarë në një Shtet të izoluar. Por a nuk do të ishte më e udhës një federatë ballkanike? Më tregoni si e shihni Ju të ardhmen e vendit të etërve tuaj, natyrisht, të shkëputur prej turqve”.

Ja përgjigjja ime:

I ndritshmi Zotëri i imi,

Meqë e lexova në Opinionin e Firences letrën tuaj drejtuar prof. Billias, vendosa t’ju paraqes çështjen e Shqipërisë së braktisur nga të gjithë; se edhe në historinë e vet ajo qe mohuar dhe dënuar. Tani me letrën tuaj ajo më entuziazmon dhe më shpejton.

Pikë së pari, kombi shqiptar, sido që të jetë i përzier me atë helen, është i huaj dhe i ndryshëm nga ai dhe gjuha e tij, sipas asaj që tashmë dihet, është larg nga helenishtja më tepër se ç’është dhe nga latinishtja, çka tregon se nuk ka pothuajse asnjë ngjashmëri racore mes të dyjave.

³⁴ *Albanesi e Greci, La Nazione Albanese*, Anno, III, Nr. 11, Pallagorio (Catanzaro), 15 giugno 1899, p. 1.

Prandaj nuk pati një Federatë ballkanike ku “trashëgimtarët e Botzarit dhe Maurokordatos” (se si Ajo, me mënyrën e vet të shkurtër dhe të skalitur, përcakton Shqiptarët dhe Helenët) të formonin, ashtu si suedezët dhe norvegjezët, një shtet të vetëm; mua më duket se pak pasi të qe formuar do t’i qe nënshtruar sllavëve federalë, ose zotërve të tyre që qëndrojnë pas.

Por këtë bashkim prej të barabartësh Helenët nuk e duan, ato pretendojnë të rivendosin Perandorinë Bizantine e cila për ta tingëllon si Perandoria Greke.

Sa i përket Shqipërisë, ata e kanë paracaktuar që të jetë ajo subjekti i egër me të cilin ato të shartojnë gjuhën dhe sundimin e tyre, dhe kështu të kenë një pozitë mbizotëruese në Lidhje.

Rreth vitit 1883, Mavromati, konsulli grek në Maltë, u përpoq të demonstronte (në shumë numra të gazetës *Akropoli* të Athinës): “Se Shqipëria e Veriut dhe ajo e Mesme, Epiri dhe Maqedonia, nuk kishin as 700.000 shqiptarë, interpretim që hoqi detyrimin të konsiderohej pothuajse si një komb që gëzonte të drejta”. Dhe disa vjet më parë, kur me nismën e Buskaljonit, një dorë vullnetarësh italianë u ofruan të mbështesin, së bashku me Helenët, Federatën Ballkanike, sapo kolonel Koeli shprehu dëshirën e Buskaljonit dhe të Kancios që Shqipëria të figuronte midis atyre shteteve, Komonduros u turbullua i gjithi dhe hoqi dorë nga bisedimet.

Ndërkohë Shqipëria as nuk ka menduar dhe as mendon për Federatën, cilatdo qofshin ato.

Përkundrazi, tashmë shpirtrat e saj tani janë shumë të ndërsyer nga tradhtia arrogante e Helenisë, e cila kryeneçësisht punon për ta humbur. Në nr. 3, viti II i “*Fiamurit*” janë të rrjeshtuara fazat e të dy popujve dhe pozicioni i tyre përkatës aktual dhe se si Helenia ka përfituar nga keqkuptimi, se këtu në Europë, besohet se shqiptarët dhe helenët janë popull grek që flasin dialekte të ndryshme. Nëse burrat e mëdhenj të Greqisë antike, ishin të gjithë helenë, apo pjesa më e madhe e tyre ishin pellazgë, koha ende nuk e zbulon, por ajo që dihet mirë është se Rilindja helene zuri fill nga një pellazg, Aliu nga Tepelena dhe se heronjtë më trima të Heladës: Botzari, Zavella, Macry, Odisea, Miauli, Tombasi, Karaiskaki, Kondurioti, Bulgari, Bubulina, etj. ishin pellazgë, por me dashje helenët heshtën për kombësinë e tyre dhe përfituan nga bëmat dhe lavdia e tyre.

Them me dashje sepse që nga viti 1850 një gazetë greke e Vjenës, *Imera*, e përgëzonte faktin se shumë fshatra në Greqi kishin arritur ta ndalnin përdorimin e gjuhës shqipe. Pastaj unë në broshurën: *Lashtësia e Kombit Shqiptar*, (që mundi të botohej vetëm pas vitit 1860) vura në dukje këtë mburrje të pakuptimtë, duke paralajmëruar suksesin e rremë të Panhelenizmit.

Në të vërtetë atyre më pas u shkoi gjithçka mirë: për shkak të neglizhencës së Portës së Lartë dhe dyshimeve që patën Feneriotët në lidhje me Shqipërinë, u hapën si në Epir ashtu edhe në Maqedoni shkolla greke për shqiptarët, me paratë e Zapas dhe Zografit falë zemërgjërësisë së të cilëve nderi i kaloi emrit grek ndërsa ata s'ishin veçse dy shqiptarë naivë. Dhe duke mos reshtur së punuari, me ndihmën e Themeluesve të Klerit Ortodoks dhe të Lozhave Masonike, u arrit të helenizoheshin më shumë vende në ato provinca turke. Ky ishte shkaku i parë i reagimit të ndjenjës kombëtare që u shfaq në zemërimin e Ibrahim bej Dragrotit në Tepelenë dhe në Komitetin Shqiptar për kultivimin e gjuhës kombëtare, themeluar në Konstandinopojë nën presidencën e Sami bej Frashërit, dhe më vonë në Lidhjen e Prizrenit.

Kjo kishte rrezikuar fatet e thurura nga Mbretëria Greke, kur lëshimi i Ulqinit që e ashpërsoi atë kundër Portës, u dha helenëve mundësinë të bëheshin këshilltari djall dhe nxitësi i kryengritjes së Gjakovës dhe Prizrenit. Se si më pas ato i tradhëtuan dhe ndërsa Krerët e Lidhjes u degdisën në fortesat e Perandorisë, ata fituan pjesën më të madhe të vendeve shqiptare në Thesali dhe Epir, Ju do ta lexoni në broshurën e Z. Kanini që unë po jua përcjell bashkë me këtë letër.

Të inkurajuar nga sukcesi, me t'u shpërndarë Lidhja, Mbretëria Greke vazhdoi me zjarr, çka dukej urrejtje ndaj racës tonë, punën për zhdukjen e gjuhës së saj. Një shqiptar i shquar, shtetas grek, A. Kolurioti, shkoi në Gjirokastrë për të përhapur abecedarin e tij të gjuhës shqipe, por Konsulli grek (me emrin Kamaço nëse nuk gaboj) e burgosi dhe e ktheu në Korfuz, mes duartrokitjeve të shtypit helen dhe favorizimeve të qeverisë që e promovuan atë në Konsullatën e Korçës.

Pastaj Shqipëria pati mendimin që të themelonte një revistë të sajën, duke ma besuar mua drejtimin e saj, shfaqja e të cilës pati një efekt kërcënues në të gjithë komplotin panhelenik. Duke mos mundur edhe pas intrigave të gjata ta ulnin këtë *Flamur të Shqipërisë*, u vu përpara fantazmës së një Lidhje Ballkanike, nismë e Trikupit siç thuhej, dhe

emisarët që erdhën tek ne nga Korfuzi kërkuan “që të nxisnin një kryengritje në Shqipëri në mënyrë që, kur Turku të mposhtej, ajo të mos aneksohej nga Greqia, por të bënte pjesë, si e barabartë mes të barabartëve, në Federatën Ballkanike”

Morën përgjigjen: - “Çfarë/Nëse Greqia dhe Shtetet e Ballkanit të pavarura do të bashkoheshin, më vonë Shqipëria do ta pleqëronte këtë me veten”

Pak më vonë patëm në shkëmbim numrat e parë të gazetës *Federata Lindore* dhe Leonida Bulgari më deklaroi se ndonëse nuk mund t’i kundërshtonte ambiciet e Greqisë, ai, meqë kishte lindur maqedonas, i kishte fort për zemër sidomos Maqedoninë dhe Shqipërinë. Edhe ky arsyetim i gazetës nuk më bindte, dhe as nuk luajta nga qëndrimi im; kështu u ndërpre çdo marrëdhënie mes nesh.

Prandaj ndodhi që, në funksion të *Flamurit* të ngritur të *Shqipërisë*, në Bukuresh u krijua një Komitet prej 300 bashkatdhetarëve tanë, me qëllimin për të kultivuar dhe ngritur lart gjuhën shqipe. Ky fakt i rëndë i shtangu shpresat e Helenisë dhe ishte ai që e çoi atë të merrte këto vendime të rrezikshme. Më dërguan nga Firenze një numër të *Federatës Lindore* në të cilën, pas themelimit të Komitetit, dha thirrjen e alarmit: “Mbaruan, thuhej aty, fatet e larta të helenizmit ku të merrte hov krijimi (fiks kështu!) i një gjuhe shqipe”.

Këtu, nuk qe më vetëm balli i Bullgarit, pa maskë, por fytyra e Mbretërisë Greke e zhytur në paudhësi.

E dëshpëruar për ta pasur vasale Shqipërinë për “*dhesmòn Abnicon*”, kurdisi planin e pamëshirshëm, i cili tashmë u shfaq qartë, që të binte në ujdin me fqinjët sllavë për ta copëtuar atë. Apo mos jemi ne që duam gjë prej saj? Jo, por kur ajo deshi dhe thirri të tjerët që të kërkonin kompensim në vendin shqiptar, për të ruajtur ekuilibrin pas zgjerimit, siç thonë ata të Bullgarisë dhe dëshirat e tyre gjetën përkrahje në atë pjesë të shtypit evropian që “mban temjanicën përpara Bishës”, Shqipëria rroku armët kundër armikut të saj, dhe për sa kohë që kjo luftë nuk pushon, dhe as nuk mendon më për Epirin dhe Maqedoninë, ajo nuk do t’i ulë ato.

Tani *Fiamuri shqiptar*, zotëria im i nderuar, nuk mund të ishte pa të meta dhe pa maturi askund tjetër përveç në fushë shqiptare. Dhe pse duhet ta lërë atë, dhe më kot ta pushojë?

Prej një kohe të gjatë ata e shohin Greqinë si një forcë dhe një civilizim që duhet t’u imponohet fqinjëve: ne që ndiejmë gabimin e

këtij mendimi dhe dëmtimin prej tij, themi se në të vërtetë Shqipëria mban në trojet e veta më shumë se dy milionë Shqiptarë, dhe (përveç atyre që ende figurojnë gati gjysma e popullsisë së Greqisë) kanë shumë ishuj të Arkipelagut të mbushur plot me shqiptarë, koloni në Azi, Itali dhe gjetkë; se raca shqiptare për nga virtyti i mendjeve dhe trupave, për nga thjeshtësia dhe besnikëria qëndron më lart se ajo helene, e cila flet një gjuhë që i ndrituri Bucholtz e quan *të vyer*, frytet e së cilës, janë pastruar, do të thosha, kohët e fundit, ajo është më shumë se kushdo tjetër në gjendje të gjykojë dhe të krahasohet me ato të nevelenikës. Unë besoj se fati i saj sot është i lidhur me Perandorinë Osmane – që tashmë ka hyrë në orbitën e Fatit të Austrisë dhe të Gjermanisë që prej shumë kohësh u bënte ballë forcave të tyre, dhe e nevojshme për dinjitetin dhe paqen e Anglisë -: besimplotë se ai Sulltani, ashtu si edhe Fuqitë e tij mike janë të vendosura që t'i rikthejnë prosperitetin dhe virtytin e tij antik këtij bastioni të fuqishëm dhe të *status kuosë* lindore.

Ndërkohë, le të përhapet çiltërsia dhe harmonia jonë në vendin amë nga një vend i lënë jashtë pasioneve, dhe të ndihmojë zhvillimin vendas dhe historik të kulturës së tij.

Ne e dimë që flamuri i atdheut tonë së shpejti do të na bjerë nga duart, por Zoti, i cili e ka mbajtur për këto raste baltën tonë të mjerë, do të jetë Ai që do ta ngrëjë në vendin tonë të tjerë më të lumtur. Dhe i mbetet gjithmonë atij mënyra e veprimtimit sipas planeve të kota të njerëzve të vdekshëm.

Pas këtyre fakteve të cilat, të bashkërenditura, shpjegojnë njëri-tjetrin, Ju s'do të mund të kini veç mirëkuptim.

Juaji, gjithnjë me nderim e devotshmëri

Jeronim De Rada
15 qershor 1899

31. TIPARE TË GJUHËS SHQIPE DHE PËRMENDORE TË SAJ NË PERIUHDHËN PARAHISTORIKE³⁵

1.

Më 1891, Qeveria e Italisë themelonte (ngrente) në Kolegjin e Shën Adrianit një Katedër të gjuhës shqipe, me qëllim të përcaktuar për të mbajtur gjuhën kombëtare tek ngulimet e shumta epirotase (shqip-tare) të mbretërisë. Dhënien e mësimit ma besonte mua që, që prej gjysmë shekulli, e lëvronja këtë gjuhë. Njëkohësisht më ngarkonte me drejtimin e shkollave të Kolegjit. Por peshkopi, që ishte kryetar i Kolegjit, e kundërshtoi vënien time si drejtor, se Kolegji kishte natyrë kishtarë që e vinte nën vartësinë e Peshkopit, dhe, si mbaroi viti, arriti ta tërhiqte drejtimin laik dhe ta mbyllte shkollën kombëtare.

Një vit pas, Italia e ringrente Katedrën, duke e shpërngulur në Sh. Mitër, ku bën pjesë edhe vendlindja ime, porse aty nuk kish mundësi që shkolla të kishte dëgjues jashtë komunes, kështu që mësuesit, për t'iu përgjegjur qëllimit të shtetit, iu desh të shtypte leksionet e t'i përhapte nëpër Ngulimet (Kolonitë) e shpërndara në trevat e Napolit. Kjo gjë pat suksese të papritura: Në Ngulime (Koloni) dy kongrese, të përshëndetura deri nga Madhëria e tij Mbreti dhe në të cilat u vendos një Alfabet; edhe në Mëmëdheun ndodhi një zgjim i pamposhtur i ndjenjës kombëtare, në të cilin u thye përpjekja helenike e pakuptim për ta pushtuar /Shqipërinë/.

Sa për mua, ajo shkollë më duket, tash, sikur më është dhënë nga provania /dhe nga dora e Zotit/ nëse vlerat e saj qëndrojnë në orët që unë mund t'i kthej në shkencë, kur kjo [shkollë] ishte e drejtuar, sidomos, në njohjen e vërtetë të tiparit kryesor të familjes njerëzore dhe në njohjen e tiparit të gjuhëve të saj.

³⁵ *Caratteri della lingua Albanese e suoi monumenti nell'età preistorica, La Nazione Albanese, anno 3, nr. 19, 20, 1899.*

Gjuha shqipe qëndron veçan për kushtin origjinal të saj, e qëndrueshme edhe sot, pa qenë e përzier thellë, së paku me të paraformuarat sanskrite, helenike, latine e të tjera të prejardhura prej tyre. Gjatë zhvillimit të tyre nëpër shekujt, ato kanë shkëmbyer bile mes tyre ndonjë fjalë e ndonjë tjetër, të cilat pra, gjithnjë si të huaja, mbesin si gjurma grupesh ushtarake kalimtare. Qëndron në shqipen një një natyrë e dukshme, e qartë, e veçantë, përkundrejt gjuhëve të formuara më përpara. Unë nuk e di, pastaj, në se ndonjë nga gjuhët e tjera të botës të ketë pak apo shumë farefisni me të.

Por, për të dyja rastet, ky parashtrim mund të bëhet i nevojshëm për të tërhequr vëmendjen e sa njerëzve me epërsi doktrinare e intelektuale, të cilëve po marr guxim t'u paraqitem.

2.

Funksioni i fuqisë së gjuhës shqipe qëndron, përgjithësisht, në njërrrokshet, nga të cilat formohet (sajohet ajo): *ha, pi, rrò, ec, at, et, l= babël, ju, u* (= unë), *ku*, etj.

Njërrrokshet përbëhen, në përgjithësi, nga dy bashkëtingëllore e nga një zanore: *kjo*, sipas theksimit të zakonshëm dhe të shpeshtë ka dy more: *jam, thòm, kam, dilj* (= dil), *hip, hiir* (= hīr, hyrë), *mish, huund* (= hūnd, hundë), *vet* (= vetëm), *kjet* (= qetë), *veç* (= veçmas), *pàs*.

- 1) Nga foljet shqipe, rrënjët paraqesin urdhëroren: *ec* (= mbaj)², *xè* (= ze, mëso), *xhesh* (= zvesh), *vesh* (= mvesh); dhe nga emrat, rrënjët paraqesin thirroren: *moi trim* (= o djalosh; o trim); *moi vàsh* (= o vashë).

Ky fakt (mbas kaq fjalëve njërrrokshë që pasqyrojnë anët e shumta të gjithësisë) më bën të formoj mendimin se njeriut gjuha i ka qenë komunikuar si shfaqje e asaj që ajo paraqet dhe se puna e funksioneve të saja, që ajo merr në ligjëratë, s'është tjetër veçse paraqitja (prania) e thjeshtë e cilësive të ndryshme në shpirtin njerëzor, të pasqyruara në të folurit me të cilin qe pajisur, me epërsi përkundrejt kafshëve që e dëgjojnë. Këto fjalë mbeten, - si të thuash, - burimi (amë) për komunikimin monosilabik. Njeriu nuk mundi, në udhëtimin e vet, ta krijojë, por ta shtrembërojë, siç bën për vetë cilësitë e shpirtit të vet.

- 2) Unë besoj me bindje se ajo që është, ka qenë; gjithnjë fëmijët dëgjojnë dhe fjalët e dëguara i përsërisin. Por, nëse ka gjasë që

në kombin tonë fjalët e tij të qëndrueshme, plot kuptim, kanë qenë shokë që në lindjen e tij [kombit tonë] në jetë, morfologjia, me të cilën u kthyen në fjalë, nuk ka si të ngrihet në ndonjë stad imitimi, së paku të atyre gjuhëve klasike. Atë edhe nga pikëpamja e funksionimit të saj në ligjëratë shumë të fuqishme.

Me këto rrënjë, që pasqyrojnë idetë dhe që mbesin gati të kristalizuara, të qarta dhe të dalluara përherë ndër fjalë, me anë prapashtesash, me shndërrime tingujsh ndër rrokje dhe me brendashtesa të ndonjë parafjale, ka vend të flitet për sintaksën. Emrat e saj lakohen në një trajtë të dyfishtë, d.m.th. në dy mënyra, në të shquarën dhe në të pashquarën: *-búk* (= bukë), gjindore: *búkie* (= i, e buke), etj. Emri dhe mbiemri i shquar lakohen përmes shtatë rasash: Emërore: *búk-a*; gjindore: *së búk-ës*; dhanore: *búk-ës*; kallëzore: *búk-ën*; vendore: *ndë búk't*; thirrore: *moi búk-a*; rrjedhore: *prei búk-ës*.

- 3) Foljet e shqipes, sikurse në helenisht, ndahen në tri klasa: veprorë: *ljidhinj* (= lidh); mesorë: *ljidh-em* (= lidhem); pësorë: *jam ljidh-ur*. Çdo folje, pastaj, zgjedhohet në pesë mënyra: diftorë: *ljidh-énj* (= lidh); urdhërore: *ljidh* (= lidh); lidhore: *të ljidh-inj* (= të lidh); dëshirore: *ljidh-ështa* (= lidhsha); paskajore (lloji i së cilës është i zakonshëm, i rëndomët me pjesoren): *ljidh-ur* (= lidhur; me lidhë dhe lidhur). Prej dy zgjedhimeve të shqipes, njeri shumë i hapët, zhvillohet krejtësisht ndër dy numrat e ndër vetjet me anë prapashtesash përemërore; tjetri, më i ngushtë, e i dalluar ndër klasë, ndryshon, aty-këtu, vetjet e numrat me ndryshimin herë të zanores, herë të bashkëtingëllores së rrënjës: *Mirr* (= merr ti); *marr* (= unë marr); *mèrr* (= ai merr); *môra* (= unë mora); *muar* (= ai muar; mori); *ngkà* (= ngà, ec ti); *ngkàs* (= unë ngas); *ngkàu* (= ai ngau).

Ky fenomen ze vend, aty-këtu, edhe ndër emra, duke ndryshuar nga njëjisi në shumë nëpërmjet të ndryshimit të zanores ose të bashkëtingëllores themelore; nga thës nxiret *thàs* (= thasë); nga *dàsh* – *dèsh*; e kështu nga *zògk* (= zòg) – *zògj*.

- 4) Gjuha shqipe ka, barabar si helenishtja dhe latinishtja, emra të së tri gjinive: mashkullore, femërore dhe asnjane: *burr-i* (lt. vir); *gkrúa-ja* (= grúa-ja), *miel-t* (= miell-të, miell-i), *új-t* (= ujtë, uj-i). Asnjane sit i është dhënë shprehja e mendimeve të gjithëmbarrëshme, ndërsa në

gjuhët klasike shpesh duket e kundërta. Mbiemrave, në trajtën e parë të tyre absolute, u janë dhënë, sipas gjinive që u përkasin, tri paravënese të përgjithshme *i* (m), *e* (f), *të* (asnjanëse), për të marrë gjininë e emrave, me të cilët janë bashkuar që t'i caktojnë: *trim i búkur* (pulcher, lt.) (= djalosh i bukur); *vash e búkur* (= vajzë e bukur, vashë e bukur); *gjak të búkur* (= gjak i bukur); ose edhe prej vetes e veçse i zëvendësojnë duke i theksuar ato ndër nyjet *il, lo, la* të italishtes, të cilat, ndoshta, paravënëset tona na çojnë në një kohë shumë të largët: *i së môtërës* (lt. qui sororis), *e së môtërës* (lt. quae sororis); *të së bukurës* (lt. quod sororis) (est):

- 5) Përsa i përket anës fonetike, kjo gjuhë është shumë e veçantë dhe fisnike. Kur, gjatë zgjedhimit, lakimit ose tjetër, fjalët, shenja të mendimeve (ideve), shndrohen në pjesë të ligjëratës, kanë ndërruar, për shkak të shtesave, masën e vet (sasinë), zanorja /e përbërë/ prej dy moresh e gjysmë zbret në një more e gjysmë: *door* (= dōr, dorë); *deer* (= dēr, derë), kalojnë në *dōra* (= dora) e *dēra*; *ljaan* (= ljan, làn, lanë), në *ljânja* (= laja). E më përtej, me anë shtesash së reja, kjo gjatësi duket nën theksin e rëndë: *dòrie* (= prej dore), *dèrie* (= prej dere), *ljàita* (= lava). Duke ndjekur rrokjet, vërejmë se nga theksi i mprehtë shndrohen në të rëndë: *málj* (= mal-i) në *màlji* (= i, e një mali); *ljòp* (= lopë) në *ljòppa* (= lopa); *rrónj* (= jetoj) në *rròva* (= jetova); e ato rrokje, mbi të cilat bie theksi i rëndë, bien ndër zanore të thjeshta: *gjàrpër – gjarpërave* (= gjarpinjve). Dhe krejt kjo ngjet mbasi gjuha, duke shprehur kuptimet e saja të përgjithshme dhe nga ndryshimi i vazhdueshëm i tingujve të fjalëve njërrrokëshe, në këtë kompleks ndryshimesh ajo ndryshon përherë edhe idetë; p. sh. *késh* (= kishte), *ish* (= ishte), *kjésh* (= qesh), *gjésh* (= ngjesh brumin, brumos, gatuj brumin); *ljésh* (= lesh-i), *désh* (= desh, deshti), *préshe* (= presht, pras, purri), *shésh* (= shesh-i), *vèsh* (= vesh-i).

Këto fenomene ndërtohen në mënyrë ritmike, të pakrahasueshme, duke ua kaluar gjuhëve klasike, veçanërisht në poezi; dhe, së bashku, flasin (dëshmojnë) në favor të qëndrueshmërisë së shtatë zanoreve dhe të tridhjetetri bashkëtingëlloreve të saj. Për këtë arsye, qysh prej fillimit ajo është aq e pasur, sa që nuk humb.

3.

Këto tipare të gjuhës shqipe vlejten në lashtësinë më të largët për ta parë pastaj se sa i moçëm është populli që e flet atë gjuhë. /Këto veçori të gjuhës shqipe vlejten në kohën më të lashtë për ta bërë ta shikojnë popullin që e flet si më të vjetrin/. Helenët dhe latinët e quajtën atë popull në mënyrë të barabartë *Pelasga*, sikurse ky e thirriveten *Pëlaka* (= e moçme, në shqip).

Por, për të marrë këtë titull, e ndihmoi edhe qenia e tij si krijues i politezimit helen e latin. As unë nuk mund ta dij, as nuk kam si ta parashikoj kohën, në të cilën simbolet antropomorfë të fuqive të natyrës u kthyen ndër idhuj të pakuptueshëm të fesë pagane. Përkundrazi, ajo që rrin edhe tash në mënyrë të pakundërshtueshme, është se gati të gjitha hyjnitë e idolatrisë kanë emra shqiptarë, emrat e të cilit shpjegojnë edhe më mirë kuptimet e simboleve, dhe me anën e ideoltarisë, ndoshta, zëvendësojnë një fé që do ta kenë pasur të parët tanë, fé kjo “adhuruese e lashtë e zotit dhe, pranë tij, nderuese e llojeve të fuqishme të krijimit të tij të përjetshëm”.

Do të thomi pak shembuj të posaçëm:

- 1) Helenishtja *Zeús*, Pater hominumque deumque, ka për rasë kallëzore të veten *zéa*, *zéna*, dy fjalë tonat, që për né duan të thonë: *zë* = shpirt, *zéna* = fillim, nisje.
- 2) *Hêra* (latinisht *Iuno*) është fjalë shqipe, që ka vështrimin: *Hêra* (Ora), bashkëshorte e amëshuar e Zotit, që me atë shoqe krijoi botën; dhe, ku pat nevojë, e ndaloi duke ia lidhur kudhën në këmbë.
- 3) *Jovi Elicio* na përket, edhe në mënyrë më të shkëlqyeshme. Ishte Zeja, shpirti i nëntokës, kundruall Zeasit, Olimpikut. Për të Ovidi shkruan kështu: “Nga shikimi i saj zemra i turbullohet Hyjnisë [Numa], gjaku ik prej krahërorit, flokët i çohen përpjetë. Ai ishte përballë Zotit të së keqes”. Emri i tij *Elicio* rrjedh prej gjuhës së etërve tanë, në të cilën *ljik* (= i lik) është rrënja e fjalës *e lliga* (= e liga), *i lligu* (= i ligu). *Elicio* është Satani i fesë së parë të paganëve, dhe prania e tij në të paraqet dy fakte: se, që prej zanafillës, ishte për fenë idhujtare Demoni i zi, vënë përkundrejt Zotit; dhe se, prej katragjyshërve tanë, që thirrë *i lligu* (= i ligu).
- 4) *Adhê* (Plutoni), ai që rrin poshtë, në Ferr, rrjedh prej fjalës shqipe *Dhee* (= dhé, tokë); *eis adhen* helenik është *nën-dheen* (= nën-dhé, nëntokë), që ka rrjedhur nga shqipja.

- 5) *Athéna* (Minerva latina), e dalur prej kokës së *Zêa*-s përmes (nëpërmjet) të një së rëni të Ifestos (Vullkan), është një simbol shqiptar i të lindurit të gjuhës në jetë. Ndër né shqiptarët, *e-thëna*, *athëna*, tregon *verbum* të latinishtes, fjalën që ka buruar prej mendjes së njeriut në jetë nëpërmjet zjarrit të shpirtit; *i-dhësti* në shqip don me thënë *i ndezur*.
- 6) *Diellios* (Apollo), përçues i diellit. Emri i Diellit është i njëjti emër i shqipes Dielli: *Diellios* = Diell, *Dieli* = Dielli.

Nën Empirin, Toka është banuar në mënyrë të njënjëshme prej zotash shqiptarë (hyjnish shqiptare):

- 1) *Dêti* është emri shqip i fjalës *deti*. Helenëve u mungon shkronja *d*, kështuqë, duke e zëvendësuar me *t*, në përfytyrim të detit të hyjnizuar, e shndrruan emrin pellazg në *Teti(s)*.
- 2) *Dhêmeter* (Cerere latina) për ne shqiptarët don me thënë *masë toke*, prej *dhee* (= dhe) e *meter*, dhe na tregon punën e kësaj Hyjnie. Çdo agrikulturë nisët nga matja dhe ndarja e tokës. Benloew na ven në dijeni për një trupore të Dêmeter-s në Dodonë “qui couche à terre”. Ky pozicion – shton ai – karakterizon mitin e saj.
- 3) *Oqeani* është drejtpërsëdrejti *Ujâna* jonë, sasia e ujnavet; rrënja: *uu* (= ujë-i). Ta kujtojmë martesën e Oqeanit me Tetin në ngushticën e Gibilterrës.
- 4) Saturni i Lacios ka, gjithashtu, një vështrim të njëjtë me fjalën shqipe *Habâri*. *Abâri* i botës pellazge, qe, sipas Herodotit, *i pari i njerëzvet, që, pajisur me një kosë, përshkoi Tokën*. *Habâri*, për né /shqiptarët/, shënon *njeriun që ushqehet me barë*; dhe përfytyron njerëzimin që, duke u ushqyer me bimë, pat pushtuar Tokën.
- 5) I dalluar në kultin tokësor është edhe *Pana*, zoti i *postfoetantes*. Helenët e kujtuan këtë emër sikur rrjedh nga emri *Pana* (Të gjithë). E, pra, është e qartë se ai nuk është një Hyjni kaq madhështore sa të paraqesë *Rruzullimin* (Gjithësinë), e ne ju vemë në dijeni, se emri i tij ze fillë prej fjalës sonë *Bana* (= prodhim) (rrënja: ban). E *Pana* ishte, pikërisht, *Zoti i prodhimit të tokës* që, herë pas here, edukon qenjet e jetës. Lëvruesit e tij, ndër të kremtet e Luperkaleve në Romë, ngitnin nëpër rrugica, e zonjat e shtëpive dilnin nëpër praqe dyersh për t’u ndeshë (për t’u takuar ose për të qenë të paprekura) me atë Hyjni të tyre që të bëheshin nëna.
- 6) *Nemesi*, dënuesi i mbretërvet, është emër shqip, *nëmez* – *nëma* (mallkim, nâma) e kështu edhe fjala *Kabiri* nga *Ha-biir* (ha, o birë, o djalë).

4.

Koha heroike u përket atyre njerëzve të barabartë mes tyre në Europë. Dy figurat e mëdha prisash janë te Homeri, shenji i të cilit për ata është dhënë gjithnjë me anën e frazës “hyjni pellazgjike” ose “pellazgë hyjnorë”, prej të cilit poema, i kemi në gjuhën helene greke. Ato figura janë *Akili* dhe *Uliksi*, që kanë emra shqiptarë, që na shpjegojnë plotësisht mitin.

I pari paraqet “*Lulen (ajkën) e jetës njerëzore*”, fitues i të gjithave dhe i shpejtë (fitimtar në çdo gjë dhe ikës): *Aqileu* (Aq-i-le(h)të; *Akj-i-ljee*: Aq-i-lé = kaq i lehtë, kaq i shpejtë: *Akillêa*. Homeri e përshkruan (e shënon) gjithmonë (gjithnjë) me epitetin: *më i shpejti*, këmbëshpejti dhe se *do të kalonte mbi kollëza pa i përkulur*. Plutarku, në Jetën e Pirros, rrëfen (na kallëzon) se Akili kishte në Epir një falëtoare të vjetër si hyjni vendase dhe nën emrin vendas *Aspetos*, i njëjtë me fjalën shqipe të sotme *i shpejtë* [Akili, në Epir, ndër kohë të lashta, ka pasur emrin e Zotit “mbrojtës i Atdheut” dhe është quajtur prej vendasvet *Aspetos*, fjalë që është e barabartë me gjuhën shqipe të tashme: *i shpejtë*].

Tjetri, *Odiseu*, heroi që paraqet udhëtimin plot vuajtje të njeriut nëpër Tokën, e pat emrin nga rrënja shqipe *uudh* (= ùdh, udhë), emër që mbeti, që në fillim (që prej zanafillës), në *Udhisse*, *Udhise*, *Uliks*, qëndroi i paprekur ndër latinë dhe dëshmon për gabimin e helenëve, për të cilët ai emër s’pati asnjëherë kuptim.

Ai popull, farefis dhe i njëkohës me popullin e ardhur nga Troja e nga Frigjia, themelonte Romën.

Eneu, në poemën e Virgjilit (libri III) thotë për arritjen e tij në Acio, tokë (vend) e parë e Epirit: “Ta bëjmë të gëzuar e krenare për *trojanët* bregdetin e Acios. E jemi të lumtur që kemi dalë jashtë nga qytetet argolike dhe që kemi çelur shtegun për të ikur përmjedis armiqve”. Dhe, duke vazhduar më tej, gjen bashkëvendasit e vet: Andromakën që kish arritur pak më parë, që aty është mbretëreshë si në atdheun e vet, dhe Helenën që ish ndalur po aty dhe që, duke u nisur, i uron:

*Cognatas gentes olim populosque propinquos,
Aspiro Esperiam, quibus idem Dardanus auctor,
atque idem casus, unam faciemus utramque”.*

Në Itali pasardhësit e Eneut themeluan, pastaj, Romën dhe i dhanë një emër të nxjerrë nga gjuha e tyre. *Rromi* në të folmen (në gjuhën) tonë don të thotë *rrojme*, *jetojmë*, gati sikur ata të mbledhurit këtu të

kishin dashur me fjalën e pavdekshme *rromi* të shënonin ndjenjën e qetësisë (të pushimit), që i frymëzonte në atë vend (strehim). *Rromi e Rrimi* (rrojmë e rrimë, pushojmë) qenë dy idetë (mendimet) e para të personifikuara edhe në Romulin e Remin; pastaj, dëshira e dytë, *rrimi* të rrimë, ia lëshoi vendin nevojës për të jetuar.

Këtë fakt e vërteton fjaltoja, shyti armik i *Angeronës*, vendosur jashtë atij qyteti: Roma nga *rromi* (rrojmë, jetojmë, mund të thoshte *jetë e përherëshme*); por Angerona, nga /gjuha/ jonë *ang* (= nuk) e *rrom* (= do të rrosh), është fjalë e kundërt: Nuk do të rrosh, nuk do të jesh. [Angerona, për të mos e shqiptuar, u paraqitte prej të tjerëve m enjë vulë në gojë.]

Dhe, duke u ndalur në ndonjë gjurmë vjetër gjuhësore, ndër njëqind në atë në të parën epokë tonën shumë të tjerë, Troja i ishte kushtuar yllit Afërditë (Venerë) e, madje, pat emrin Ilicio, që vjen nga fjala shqipe *ylli*, dhe mbretëria e themeluar në Ballkan nga Antenori, i ikur nga Troja me teukrët e frigjët e tij, pati emrin nga gjuha jonë: *Ili rii, Yll i ri, Ilirik*.

Emri klasik i qiellit të epërm, *Empirit*, përbëhet nga dy fjalë shqip: *mbi* e *re* (= përmbi re). Nga *Atëria*, trevë e stërgjyshërve (rrënja: át, babë) vjen *Adria, Adriatik*. Të tilla fjalë të lashta *Borea, Iperborei* lindën (rrodhën) mbi rrënjën shqipe (*bora*). Dhe, në qoftë se do të mbështeten te fuqia e vetë kësaj gjuhe monosilabike dhe te qenia e fesë greko-latine, si kult i parë i natyrës, i shprehur në të, dhe në qoftë se këto njohuri të një lashtësie shumë të largët na bëjnë që t'u besojmë, atëherë emri i malësive të Hindisë *Imalaja, Imalla*, mbeti nga kombi ynë, me rrënjën e ruajtur gjer më sot në shqipen *mal*.

*
* *
*

Le të më lejohet, mbas një paraqitjeje kaq madhështore, të theksoj një sukses të vazhdueshëm në vjetë historike, që nga njerëz të këtij populli lindën ata prisra ndër epoka të ndryshme dhe njëheri të shquar mes bashkëkohësve të tyre.

- 1) Leka i Madh, me më pak se 60.000 bashkatdhetarë të tij, shkallmoi (shpartalloi) Perandorinë Persiane, që mundi t'i verë përballë një milion /njerëz/.
- 2) Pirroja ua kaloi romakëve në një kohë kur këta kishin fuqi të madhe.

- 3) Në këtë perandori kaq të gjerë, themeluar nga romakët me anën e Çezar Augustit, janë dy shqiptarë, Diokleciani nga Tivari e Guljelm Apostati nga Prizreni, shquhen për rreptësi e krenari, ndër më të mëdhenjtë e më të famshmit që patën sunduar aty.
- 4) Dhe Skënderbeu, që ne na hapi dyert për në Italinë mikpritëse, shpallur në shekullin XV Hero, jo vetëm i vendit të vet, por i Europës kristiane, s'do ta ketë, ndoshta, në botë ndonjë shok që të mund të matej me të: me 14 ose 15.000 shqiptarë mundi në 23 beteja më tepër se 100.000 pushtuesit osmanë.

Është e vërtetë se aty nuk pat vend sikurse në Athinë e mandej në Romë, asnjë periudhë shtetërore të qetë, në të cilën poetë, oratorë e filozofë të drejtonin në garë zemrat e mendjet e kombit drejt idealeve fisnike. Ky fakt që vënë nga kombet e zhvilluara europiane dhe sot është bërë për ta i zakonshëm; por për mendjet e njerëzve që sikurse Dielli për Tokën, Fjala e Birit të Zotit; për nga ndjenjat e zemrës njerëzit e *ndershëm* u ngritën nga Rapsoditë kombëtare, ashtu sikurse jeta e moçme helene [u ngrit] prej Homerit.

Këto ishin, tashmë, të lashta që i përkasin Atdheut tonë shekullin XV, kur i sollëm në Itali. Si u bënë të njohura botërisht këtu, sot mund të krahasohen me këngën popullore të kombeve europiane dhe të lavdërohen.

Kjo letërsi në gjuhën e vet amtare, e filluar për nevojat e kohëve të reja, e ve, ndoshta, mbi letërsinë e shteteve që, deri dje, - duke parashënuar shpartallimin e Perandorisë Osmane, me të cilën fatet dhe pjesërisht feja e bëjnë, tani, të qëndrojnë - shpresuan ta ndajnë pjesë-pjesë dhe, mbasi ta zhdukin, ta përvetësojnë. Por Perandoria Osmane, në dritën e bërë, në të cilën përputhen këshillet e Europës, është duke e ndihmuar e duke i dhënë shkolla e administrata të veta, për ta pasur për veta, për ta pasur, ndoshta, në vend ashtu si [Shqipërinë] Perandoria Austriake ka Hungarinë.

Dhe me këto shpresa e mban, para së gjithash, bindja gjithnjë e më e madhe e Europës së qytetëruar, që në gjuhën shqipe të jenë ruajtur mundësi të reja për njohjen e botës dhe nga ajo [Europa] shënohet me gisht Italia, e banuar që prej kohësh nga pellazgë e që endë mban një tepriçë prej 200.000 shqiptarësh të saj, si më e përshtatshmja për të themeluar me dobi një Katedër të asaj gjuhe, pranë atyre të sanskritishtes, etj., me të cilën gjë nderohet.

32. LIGJËRATË E MBAJTUR ME RASTIN E HAPJES SË SHKOLLËS SHQIPE NË KOLEGJIN E SHËN ADRIANIT³⁶

Rihapja e një shkolle në Kolegjin tonë na mbush, o djelmosha bashk-atdhetarë, me një kënaqësi e me besim në të ardhshmen. Italia, ndër shekujt XV e XVI, na priti ne që ikëm nga vendi i stërgjyshërve; pastaj, në shekullin XVII ngrente këtu një kolegji për ruajtjen e kombësisë sonë dhe i erdhi në ndihmë pothuaj gjithnjë kësaj (kombësie), e kënaqur nga devocioni, me të cilin populli fqinj mikpritës iu bë pastaj shok ndër të gjitha ngjarjet.

Por ajo, që po jep koha e tashmem duket se na afron drejt Fatit, në të cilin, ndofta, zoti na ka ruajtur të paprekur gjatë një mërgimi prej katër shekujsh, d.m.th që të jemi udhëheqës në ringjalljen mendore e morale, për rimëkëmbje të fateve të saj [Shqipërisë]. Lërimi i gjuhës së saj, që prej këtu, nëpërmjet shtypit, do të arrijë familjet e shpërndara të bashkëkombasve, do ta shpëtojë jetën fisnike shqiptare, duke ia ruajtur gjuhën që, për të [shqiptarin], është shpirti i dhënë nga zoti.

Tek Virgjili lexojmë se Eneu, duke ikur nga Troja, mori nga faltorja dhe e mbajti me vete si rojtëse të fateve të qytetasve, tempullin e Palladës [Athenës]. I është dhënë ky emërtim (epitet) fitimtar Hyjneshës Athena (Minerva) që kishte mbajtur në faltoren e Menikut emrin e vet Athena, që në shqipen don të thotë *fjalë [e thëna], gjuhë*. Dhe ajo ishte këtu hyjnesha *Verbum*. Kështu, në mitin e urtësisë së lashtë, sipas të cilit Eneu nga atdheu në flakë e nxirrte jashtë bashkë me vete (e shpëtonte) Athinën, gjuhën kombëtare, në atë mit është mbuluar fati i vazhdueshëm në Jetën tokësore, sepse mbrojtëse përkrahëse për vetë ekzistencën e çdo populli, është gjuha, me të cilën ai lind.

³⁶ *Prolusione all'apertura della Scuola Albanese nel Collegio di Sant' Adriano*, La Nazione Albanese, VI, 21, 3-4, Pallagorio (Catanzaro), 15 novembre 1902.

Prandaj ngritjen e Katedrës së re mund ta konsiderojmë, në radhë të parë, si një fakt historik, me anë të së cilës katedër Italia, midis Fuqive të Mëdha që drejtojnë qytetërimin europian, përkrah e para ringjalljen e popullit pellazg, duke qenë se asaj i donte më fort, sepse në gjirin e saj Ajo ruan koloni të veçanta të po atij [popullit shqiptar], duke i ushqyer me mendimin e vet, me ajrin e vet dhe me qumështin e tokave të saja.

Dhe është me arsye, mbas gjithë kësaj, që ne të na jetë besuar nga dora e zotit, që kjo katedër, e pritur me gjithë zemër nga i tërë Atdheu, të bëjë që kjo të kthehet, ndofta, në shkollë të gjerë kombëtare për nevojën e jetës së gjatë e të lumtur të Shqipërisë, së cilës i vjen për mbarë. Shqiptarët, që kanë bashkuar, për një kohë të gjatë, aradhet e tyre me turqit dhe që i njëjti fat i ka bërë një, qëndrojnë, sot, në vijën e parë në Perandorinë Osmane. Atë [Perandorinë] sulltani e mban të përbërë nga shqiptarë si gardë (roje) të vetes së tij, dhe, mbasi ndër fushatat ballkanike, e sidomos në Plevnë, ata e mbrojtën pa u thyer flamurin e tij, u lejoi bashkësive shqiptare që të hapnin shkolla në gjuhën kombëtare: Ky fakt që konsiderohet si prelud (paralajmërim) për autonominë administrative (vetadministrimin), që këtyre u përket, dhe kjo gjë shkon gjithnjë duke u pjekur ndër mbledhjet e Divanit, si të ishte ajo një strumbullar për shpëtimin e vetë Turqisë. “Për mendimin tim, - shkruante e ndritura baronesha gjermane zonja Gjyzevina Knorr, - Turqia-Shqipëria si Austria-Hungaria. Kjo gjë do të ishte ringjallja e Turqisë. I rrituri pranë kryqit do të bëhej ylli i Marisë, që u dha shumë përkrahja të pafeve, edhe ata bij të Adamit. Besoj me Ju se Shqipëria, e bashkuar me Turqinë, do ta mbante për të mirë të të gjithëve *statu-quo-në*”.

Tashti ai kusht i ri, që ne na uron e famshmja zonjë, nuk do të mund të qëndrojë veçse mbi themelin e kulturës kombëtare (të lindur në vend): dhe gjuha shqipe, këtu e ringjallur dhe e ruajtur, shërben për të ringjallur ata që e flasin. Në të vërtetë, gjithnjë lindja e njeriut dhe shërimi i tij, që të mbush me shpresa për të ardhshmen, i përkasin moshës së vogëlisë dhe paaftësisë dhe humbin në të panjohurën. Dhe kështu qoftë edhe për ne. Ne kaluam dhe jemi duke kaluar nëpër ndeshtrasha (aventura), më fort se njerëzit e tjerë, por duhet të ndjejmë kënaqësi që i kemi kapërcyer pa pasë pësuar ndonjë dëmtim në fuqinë e shpirtëravet dhe të trupavet.

Ndër popujt, në të cilët fatkeqësitë na ndoqën në çdo kohë, natyra jonë e papërkulshme ndaj servilizmit dhe e sinqertë (e çiltërt), trimëria, mikpritja jonë plot durim, fituan respektin plot dashuri të fqinjve, dhe na i lehtësuan vështirësitë e jetës. Që ndër kohët e hershme të Romës, Eni i lashtë i cilësonte etërit tanë me emërtimin krenar “*Aecidarum genus belli potentis*”, dhe nuk ka shumë vjet që i famshmi Livingston, duke udhëtuar në Afrikë, takon kampin (sheshin) e një arabi të përmendur, zezak, i cili e dinte që urrehej prej tij dhe që me qëllim të keq kishte mbledhur, rreth vehtes, një grusht njerëzish të vet. Livingstoni kishte pak njerëz të armatosur, dhe, i shqetësuar nga pusitë e parashikuara, mbeti, përsëri, në dyshim, duke mos qenë i sigurtë se mund t’i shmangej atij. Pastaj mendoi, rishmëzi, me vete dhe, në të zbardhur të ditës, “si bëri (- janë fjalët e tij -) që t’u vishnin të tijve (d.m.th. njerëzvet të vet) petkun e nderuar të shqiptarëve /kostumin kombëtar të shqiptarëve– J.K./, u nis drejt vendit të rrezikshëm, ku qëndronte ai arabi, i cili, i prekur në zemër, e priti i gëzuar në fytyrë dhe i dha ç’desh”.

Prandaj, me të drejtë, përmendim fjalën e urtë, të vendlindjes: “I rreth era lisat, dhe, duke i rrahur, i rrit lisat era”, dhe ndjejmë kënaqësi duke menduar se mbi gërmadhat historike të saj, prisat e njerëzve të të gjitha kohëve, Akili e Leka u ngritën me shkëlqim prej këtij populli fatkeq.

Në të vërtetë nuk më vinte fort në mend, kur unë isha si njeri i vetmuar, i panjohur, që në ëndërr shkon nëpër det, kur pa qenë i sigurtë në përfundim, kujdesesha për gjuhën time, vetëm nga dashuria për shkëlqimin e natyrshëm që unë vëreja në të, dhe nga që ajo kishte lindur në mua me shpirtin tim. E, pra, anija ime rrihej nga jashtë prej ere, që i frymëzonte ndjenjën e përbashkët për lëvrimin e gjuhës amtare. Ishte një dashuri e fakire për brezninë e vendlindjes që e drejtonte mendjen e vet nga gjuha e tij, derisa të duket që flladi hyjnor të kalojë nëpër majat e pemës sonë kombëtare, kështu që nga të gjitha viset shpirtërat tonë të drejtohen te rindërtimi i Atdheut.

15 nëntor 1902

KREU II

VEPRA HISTORIKO-LETRARE (1836–1900)

1. “KËNGËT E MILOSAUT”: SHËNIME³⁷

Botimi I (1836)

F. 37, Kënga X, “Vallja e natës së Pashkëve”, v. 1:

“Me të trokitur mesnata që paraprin Pashkët, gratë shqiptare ngrihen, shuajnë zjarret për t’i ndezur ato me thëngjijtë e zjarrit të shenjtë që ndizet në agim; dhe, me të zbratur ujin nga urnat, shkojnë tufa-tufa në shatërvan për t’i mbushur ato sërish. Dhe meqenëse enët e tyre janë plot, duke u kapur dorë për dore, vendosen në një varg të gjatë, dhe duke kënduar e vallëzuar përshkojnë fshatin”.

F. 61, Kënga XVII, v. 32:

“Festa e Shën Mërisë së Konstandinopojës në shqip thuhet *Meso-sporite*, sepse festohet në nëntor në mes të kohës së mbjelljes së grurit”.

F. 79, Kënga XXIII, v. 26:

“Është një besim prej të marri e vulgut shqiptar se ata që, kur vdesin i kanë sytë e hapur, thërrasin të tjerë familjarë pranë vetes dhe se i fundit prej tyre që shikimi i tij ka hasur bëhet viktimi e fatit”.

³⁷ *Poesie Albanesi del secolo XV*, Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari, Guttenberg, Napoli, 1836.

F. 83, Kënga XXVI, v. 9:

“*Keza* është diadema që vendoset në kokën e virgjëreshës shqiptare në ditën e dasmës të cilën ajo më pas e mban gjithmonë, si nënë e familjes, bashkëshorte e burrit dhe zonjë e shtëpisë”.

F. 93, Kënga XXIX, v. 4:

“Shqiptarët e ndajnë vitin veçse në dy stinë të barabarta: njërës i thonë *dimër*, që fillon në tetor dhe mbaron me mars, tjetrës *verë*, të cilës i takojnë gjashtë muajt e mbetur”.

1836

2. SHËNIME PËR “KËNGËT E MILOSAUT”³⁸

Botimi II (1847)

Kënga IV, v. 12:

Ndër ç’ka mbetur tjetër nga jeta antike, në kolonitë shqiptare të Italisë, janë edhe ushtrimet gjimnastikore, me të cilat rinia forcohet dhe bëhet e bukur; dhe ndër të gjitha e para dhe më e përdorura është loja e diskut.

Kënga e së bijës së Kallogresë dhe e Shkodraneve (f. 23).

Tek shqiptarët, të kënduarit nuk shoqërohet nga instrumenti, as nuk bëhet kurrë vetëm, dhe pothuajse gjithmonë në ajër të hapur. Ata këndojnë lavdet dhe ndjenjat e dashurisë ose përbuzjes ndaj atij që është shënjestër, në fusha, nëse është ditë, dhe nëse është natë edhe në rrugët e qytetit.

Kënga e shokëve të Milosaos (f. 25).

Buljari quhen manjatët shqiptarë, e ardhur mbase nga fjala homerike *buglii*, asamble konsultative e të Urtëve.

Kënga IX, v. 3:

Kori, aspekt themelor i tragjedisë së Thespit, shfaqet me fizionominë e tij primitive në Vallet Shqiptare. Në çdo gëzim publik, të gjitha vashat e qytetit të rrethuara nga të afërmit e farefisit, të veshura si për festë, zbresin në rrugë, kapen për dore me njëra-tjetrën, dhe duke endur vallen që ato e quajnë Vala, ia marrin një kënge të shoqëruar me ritmin e hapave.

³⁸ *Poesie Albanesi*, Canti di Milosao, Prima parte, Fibreno, Napoli, 1847.

Kënga XII, v. 28:

Çdo afërsi midis burrit dhe gruas, të cilët nuk janë lidhur në martesë, është jashtëzakonisht e pahijshme ndër shqiptarë.

Vallja e Pashkëve (f. 49), v. 3:

Mëngjesin e Pashkëve, në fshatrat greke, ndizet përpara kishës një zjarr i madh, ku çdo familje merr pak një thëngjill dhe rindez oxhakun e shuar një natë më parë.

Kënga XXI, v. 32:

Mesosporite është festa e Shën Mërisë së Kostandinopojës e cila festohet më 21 Nëntor në mes të kohës së mbjelljes.

Kënga XXV, v. 11:

Për sa kohë që të rejat shqiptare janë të virgjëra, ata i mbajnë flokët të lidhur gërshet mbi qafë me një fjongo të bardhë. Më pas, ditën e dasmës, i zbukurojnë ato me *kezën*, e cila është diadema martesore.

Kënga XXV, v. 20:

Këto janë vargjet e “epitalamit kombëtar”.

3. TREGIME TË SHQIPËRISË PAS VITIT 1460³⁹

Parathënie

Në gjysmën e dytë të shekullit XV, pasi osmanët shtypën Kostandinopojën, shumë fisnikë të Shqipërisë, pasi u syrgjynosën në Itali me familjet e tyre, themeluan kolonitë që populloheshin nga më shumë se njëqind mijë njerëz, kanë ruajtur zakonet, gjuhën dhe besimin e etërve të tyre.

Jeta e tyre duke lulëzuar sërish, larg çdo turpi dhe në paqen mikpritëse që patën në këto lagje, është gjithsesi e mbushur me ide të thjeshta dhe të rrepta pellazge, të patrazuara ndonjëherë nga mendimet e njerëzve fqinjë. Gjuha që ata flasin, e pasur me tinguj si greqishtja, dhe aq e bollshme me forcë të lindur, është në formën gramatikore të shtrirë si ato Japetike dhe Semitike së bashku. Por zbukurimi i tyre më i madh mbeti besimi që i mbajti kaq të fortë për katërqind vjet në të menduarit dhe të qenit i tyre dhe kombëtar: besimi që atdheu i tyre, i lënduar nga kaq shumë plagë për nderin e Kishës së Krishterë, duhet të rimëkëmbej dhe të ishte dëshmitar i pavdekshëm “që Zoti është i mirë dhe mëshirimet e tij *janë* të përjetshme”.

Në të vërtetë duke parë Italinë, e cila vuante bashkë me ta dhe tani, me qetësinë e një mbretëreshe që u zgjua nga një gjumë i gjatë, hyn në ditë të reja duke kujtuar të vjetrat, atyre në zemër u kumbon se tashmë edhe për ta po afron një e tillë ringjallje. Dhe me mendje të ngazëllyer, duke vështruar, tashmë janë të vetëdijshëm se kultura e gjuhës së tyre filloi mes tyre jo nga një mendim njerëzor, por nga një frymëzimi më i lartë: si t’u përkiste pikërisht atyre, që, ashtu porsi etërit e vet, që e

³⁹ *Storie d’Albania dopo il 1460: Prefazione*, Stamperia del Fibreno, 1848.

udhëhoqën Shqipërinë në betejat e lavdishme të lirisë në shekullin XV, ashtu edhe ata do ta çojnë atë në rizbulimin e mënyrës së lashtë fisnike dhe të krishterë të të jetuarit.

Dhe po, punën e tyre do ta bëjë më të frytshme qielli, i cili nuk lë mendime të shenjta dhe të larta pa fryte në jetë; ai që i ka provuar në sprovat ndaj të cilave i nënshtroi kjo tokë mikpritëse, i ka ngritur ata sot në liri dhe s'ka më të huaj, që siç kanë bërë më parë, tëshpinin këshilla të padrejta atje në Shqipëri, për ta dobësuar dhe korruptuar atë me lëvizje të verbëra dhe të përgjakshme.

Sepse që këtej e tutje do të jemi gati ne që, duke e dashur, do t'i tregojmë asaj të vërtetën dhe virtytin, do t'ia ripërtërijmë madhështinë. Deri në një stinë jo të largët, në të cilën Greqia u shfaq e tëra dhe shkëlqyeshëm, por nga dega e saj e parë e lindur nga dega e Pellazgut, (pasi në të është plotësia e vlerës, përparësia e numrit, virgjëria e gjuhës dhe ceni i një kulture të hollë të mëparshme gjithmonë i dëmshëm për lirinë origjinale të mendjeve) kurora e saj bujare dhe e hershme t'u kthehet njerëzve.

4. RAPSODI E NJË POEME SHQIPTARE⁴⁰

Parathënie

Kush e kthen shikimin drejt Lindjes dhe me mendjen e tij dëshiron të vrapojë pas zhvillimit dhe veprimtarisë së llojit njerëzor, intelektit të tij i paraqitet fakti, se në atë tokë pjellore dhe bimësi të harlisur, u shfaqën njerëzit e parë dhe qytetërimi i parë. Dhe nëse historinë dhe traditat që kanë mbërritur deri tek ne doni të studioni, shihni se si atjepopujt u shpërndarë mbi tokë duke ndjekur në lëvizjen e tyre rrugën e diellit nga lindja në perëndim: mund të vërehet se kishte shumë qytete dhe popuj tregtarë, të pasur dhe të fuqishëm, tanimë të shkatërruar dhe duke vazhduar në vazhdimësinë e kohërave, vini re popullin grek, gjeografikisht më i afërti me ne, të lirë, të pavarur, duke prekur kulmin në politikë dhe disiplinat civile, mandej, pak nga pak, në fund të rrënohet derisa mjerisht iu nënshtroa shpatës turke (skimitarit turk) dhe qytetërimi i atij populli u shkri në atë romak, i cili rridhte lirshëm brenda tij ndërsa ngadhënjente sundues ndër popuj të huaj, për të humbur pastaj madhështinë dhe liritë e tij nga pushtimi i barbarëve. Për këtë arsye sapo këta popujt u brutalizuan dhe robëruan, lirinë dhe të mirat morale e materiale humbën.

Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve edhe në lindje, dhe pikërisht në Galile, lind një Diell i ri, më i madh dhe më i fuqishëm, i cili, më i lartë se nevojat tokësore, ngjall në shpirtin e njeriut parimet dhe ndjenjat që e kthejnë atë tek dinjteti i tij, tek liria e tij, tek dashuria për të ngjashmit dhe i hap një rrugë të re, të qartë dhe të sigurt për një të ardhme më të mirë.

⁴⁰ *Raspodie d'un poema albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Tipografia di Poderigo Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866.

Kjo flakë e gjallë eklipsohet dhe zhduket nga lindja për të ardhur në perëndim. Këtu frytet e transformimit të ri shoqëror përftohen fillimisht nga Italia jonë, paçka se, në vendin e saj primitiv, pema bëhet më e egër. Këtu në perëndim pushoi, hodhi rrënjë, u kacavjerr, dhe u rrit dhe shtriu degët e saj, të cilat u gjuhëzuan dhe u kthyen drejt lindjes sikur të donte të kthente mbrapsht ato që kishte marrë më parë atje.

Tashmë kanë kaluar rreth katër shekuj dhe midis maleve të Shqipërisë një popull i vogël në numër por bujar dhe krenar, i gjallëruar nga koncepti i ri, bëri përpjekje papara për të fituar lirinë dhe pavarësinë. Por, sikur të mos kishte ardhur ende koha, që drita të kalonte gradualisht nga perëndimi në lindje pa lënë boshllëqe të ndërmjetme, hordhia islamike i bëri zap ata pak njerëz, por të cilëve nuk ia mposhti virtytin e shpirtit i cili edhe pas kaq shekujsh mbetet ende i pandotur nga fryma e fëlliqur, dhe ka besimin se do të vijë ditë e dëshiruar kur të shohë tokën e saj të zbrazur nga shtypësi barbar. Epoka e një lavdie të tillë vjen nga historia e shënuar me emrin e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut.

Prandaj ai është një fakt historik shumë i dukshëm që populli shqiptar, pasi njeriu iu shmang skllavërisë morale dhe iu dha dinjiteti i tij nga Krishti, ishte i pari, i cili i gjallëruar nga ajo ide sublime paraqet fizionominë e një populli, që ngre flamurin e lirisë dhe pavarësisë nga i huaji.

Italia, Helvetia, Spanja me guelfët dhe gibelinët, me dëbimin e gjermanit të përfaqësuar në Gesler, me nënshtrimin e maurëve nuk lanë të njejtën gjurmë.

Atje mes maleve të Shqipërisë ai popull i gjithi i një mendjeje kishte një ide të vetme, një qëllim të vetëm, domethënë t'i shpëtonin sundimi të huaj, dhe të ishin të lirë në besim, në vepra dhe aspirata.

E as nuk mund të qe ndryshe. Ne nuk duam të hetojmë origjinën pellazge të shqiptarëve dhe nga kjo nxjerrim përfundimin e epërsisë mbi popujt e tjerë në doza të caktuara dhe ndër të tjera të qenit më vrapues drejt të lirive. Por, nisur nga gjendja aktuale, duke e shqyrtuar atë, ky është argumentimi i asaj çka duhet të ketë qenë në kohën e Aleksandrit, Pirros dhe Skënderbeut. Kjo dëshmohet duke parë se si ai, kur turku vërshoi duke pushtuar rrugët e tij, emigroi masivisht,

duke braktisur tokën amtare dhe pasuritë e veta, në vend që të jetonte në skllavëri.

Pra, nëse shikoni pasardhësit e këtij populli ndër ata që qëndruan zemërthyer në tokën e tyre amtare, ose ndër ata që erdhën të jetonin midis njerëzve më të qytetëruar, do t'i shihni të ruajnë për shekuj me radhë të gjitha veset dhe virtytet e një populli primitiv. Mes popujve të ndryshëm ata ruanin zakonet, ritet dhe veshjet; natyrën e hekurt dhe të guximshme; po e njëjta gjuhë e Orakullit të Dodonës dhe që i afrohet më shumë origjinës së parë, vetëm e folur, pa fjalor, pa gramatikë, pa shkrim dhe akoma e pavdekshme, përveç disa ndryshimeve të vogla dhe të pandjeshme.

Nuk u ka ndodhur ndryshe as atyre që kanë mbetur në tokat amtare. Gulçojnë atje dhe përbetohen për të shkundur zgjedhën e urryer. Këtu, ndërsa përpiqen për lirinë dhe pavarësinë e atdheut birësues, ndiejnë gjakun t'u vlojë, duke menduar për vëllezërit që ende rënkojnë nën thundrën e pushtimit, dhe presin me padurim ditën kur mund t'i ndihmojnë të çlirohen prej saj.

Në të vërtetë duket se i Plotfuqishmi në udhëtimin e njerëzimit këtë element të forcës së një populli primitiv dhe të virgjër kishte dashur ta ruante në mënyrë që të gjallëronte dhe inkurajonte, në fitimin e të drejtave të tyre njerëzore, shpirtat më civilë, të cilët të joshur nga marifetet e tiranisë dhe të një jete plot kënaqësi të siguruara me paudhësi, harrojnë dinjitetin, lirinë dhe pavarësinë e tyre.

Shqiptarët, një popull semitik i shpërndarë në vitin 1900 p.K. në kohën e Hykshos (*Hyckshos*), të cilët shkuan në Greqi, Itali dhe në vende të tjera të Mesdheut, në shekullin e XV të epokës sonë, duke u arratisur nga Shqipëria erdhën në një numër të madh në Italinë e Jugut. Këtu iu dha strehë dhe privilegje nga mbretërit e asaj kohe, por u shpërndanë nëpër vende dhe qytete të ndryshme. Ata u vendosën kryesisht në Kalabri Çitra (*Calabria Citra*) si një tokë afër vendit të tyre të lindjes, ndoshta me shpresën që të mundeshin një ditë më lehtë në atdheun e tyre të ktheheshin. Dhe këtu zjarri i lirisë ushqej nga i ati tek i biri, me lënien trashëgimi të Këngëve Kombëtare. Tani mes këtyre këngëve kombëtare të shqiptarëve, na rastisi që të shquajmë një poemë e cila rrëfen kohët e shkuara të një populli, fatkeqësitë e pësuarra dhe shpresat që ushqen ai. Dhe megjithëse kjo poemë e

shtrirë në këngët kombëtare mund të themi, tani që po e sheh dritën për botim, se ka qenë disi punë e një populli primitiv, megjithëse shihet e realizuar me një art krejtësisht të ri, i cili në tërësi përbën, sipas konceptit dhe strukturës, një veçanti në republikën e letrave, që nuk është larg vetë natyrës së shqiptarëve, domethënë larg natyrës së një populli që gjithçka e mbështet në të gjithë forcat e tij.

Në fakt, poema nxjerr në pah njerëz luftëtarë dhe fatkeq, të cilët janë të vetëdijshëm për rilindjen e tyre. Por si të ndërtojme një poemë duke folur për një popull pa unitetin e veprimit dhe pa figurën e një personazhi kryesor? E megjithatë, kjo vështirësi serioze zgjidhet në një mënyrë shumë të thjeshtë, duke e ndarë punën në tre pjesë, të cilat janë, gjendja primitive, lufta, fatkeqësia dhe shpresa. Në pjesën e parë, me këngë të ndryshme, pasqyrohet gjendja e shqiptarëve siç ishin në gjendje të lirë, zakonet e tyre, shpirti i pavarur. Dhe këtu lipset të theksohet se ai popull nuk shihet nën ato tre aspekte për një përshkrim të thjeshtë, i cili do të kishte qenë i ftohtë dhe i mërzitshëm, por ka këngë në të cilat, ndërkohë që poezia qëndron në lartësinë e saj, vihen në skenë zakone dhe individë që në fakt kanë ekzistuar realisht, dhe prej të cilëve ne, për shkak të distancës në kohë, nuk ruajmë informacion tjetër, dhe që historikisht nuk do të dinim si t'i përcaktonim.

Në fazën e dytë të poezisë zgjohet pak a shumë urrejtja dhe përbuzja ndaj turkut pushtues, tregohet gjendja e luftës, flitet për fitoret. Këtu nis të paraqitet një personazh kryesor historik në tre faza të ndryshme, në fitore, në dasma, në vdekje. Ai që i dha emrin e tij kohës së vet, ai që e mbushi Europën me bëmat e tij, i cili gjithmonë e mposhti të pabesin, me pak fjalë, atij të cilit i detyrohemi krenarinë më të madhe të shqiptarëve, dhe që në vetvete të mund të formojë heroin e një poeme e madhe: ky është Skënderbeu.

Sidoqoftë, individi harrohet, dhe kombi mbetet. Poeti, për të mos e lënë individin të përthithë madhështinë dhe peripecitë e kombit, e përmend atë, e vë në dukje, e përshkruan, por në të njëjtën kohë nuk e ndërton atë si heroin kryesor, duke qenë se qëllimi i tij i vetëm është populli.

Dhe pse u zgjodhën saktësisht tri kohët e fitoreve, të martesave, të vdekjes së Skënderbeut? Pikërisht për të mos devijuar nga ai koncept që është pikësynimi kryesor, domethënë kombi. Në fakt, fitoret

tregojnë atë kohë kur liria mbështetet dhe blihet me çmimin e gjakut të qytetarëve; dasmat tregojnë dëshirën e përbashkët për të vazhduar në të, të mbledhur rreth një qendre të përbashkët në pasardhësit e Skënderbeut; vdekja, shpresa e humbur, liria e shuar pasi në këtë mënyrë, kur flitet për individin, as shprehja dhe as ngjarjet kombëtare nuk mungojnë.

Pjesa e tretë duket një elegji e bukur dhe e ndjerë, si ajo që përmban vajtimet, dëshirat dhe aspiratat në lidhje me tokën amë, dhe besimin për të rifituar atdheun, dhe pavarësinë.

Larmia e këngëve, lidhja e pakët mes tyre, ku secila duket se qëndron më vete, dhe ku asnjë individ nuk zë vendin e parë, çka do të kishte errësuar konceptin primitiv të të folurit për një popull, ju dëshmon në gjithë lakuriqësinë e vet për natyrën shqiptare, sot jo ndryshe nga e kaluara, jo shërbëtore, por krenare, e pavarur edhe mes vedi. Pra poema që i serviret publikut ofron një risi të vetën, imagjinatën, larminë, unitetin, historinë e dhimbshme dhe mallëngjyese të një populli të vogël, por të lavdishëm, të ashpër, por këmbëngulës në qëllime, mbështetës i fortë i lirisë së vet, i mundur nga numri por jo nga vlera, i mbushur me shpresë për një të ardhme sigurisht më të mirë dhe jo të largët.

Pra, kjo është kanavaca e poemës shqipe, të cilën së bashku me bashkëqytetarin tim Jeronim De Rada duam ta sjellim në dritë: dhe të dy menduam se po bënim diçka që do t'u pëlqente bashkëqytetarëve tanë shqiptarë, duke botuar lavdinë e tyre, dhe letërsisë në përgjithësi, duke botuar një vepër të panjohur të një populli të shquar sidomos për ndjenjat dhe fatkeqësitë e tij.

Gjuha shqipe është tradicionale; cilësia e të qenit një popull i shpërndarë i ka shtrirë efektet e saj deri edhe në gjuhë. Ne nuk kemi asnjë kujtesë antike të shkrimit shqip, dhe as nuk duket se ky mund të ketë kaluar nëpër të gjitha fazat e shkrimeve të tjera, që janë shenja të pastra figurative, figurative simbolike të përziera me shenja fonetike, ose hieroglifë dhe më në fund fonetike. Sepse asnjë dokument historik apo grafik nuk ka mbërritur deri tek ne. Qytetërimi jo i përparuar mes këtij populli na e konfirmon këtë supozim. Por këtu ne nuk duhet të shqyrtojmë nëse gjuha ishte zbuluar, dhe për këtë arsye më e përsosur pasi është më afër burimit të saj. Shqiptarët si të gjithë popujt e tjerë e njohin origjinën e tyre nga tre prejardhjet që kanë udhëheqësit e tyre *Sem, Kam e Jafet*.

Në tryezën e Baldasarit, siç thonë librat e shenjtë, u lexuan të tre fjalët *mane*, *techel*, *fare*, të cilat janë fjalë shqipe, që edhe sot shprehin atë që atëherë u interpretua, por personazhet e atyre tre zërave ishin kaldeo-hebraikë.

Shqiptarët, semitë, siç pohojnë të gjithë shkrimtarët, emigrantë në Greqi, ose sundimtarë apo nënshtetas të racës japetike, nuk e humbën krejt hegjemoninë e tyre dhe e ruajtën fort dhe të plotë formën dhe pamjen e gjuhës amtare.

Grekët, shkrimi i të cilëve buron nga alfabeti semitik dhe pikërisht nga ai kaldeo-hebraikë, në gjuhën letrare përcollën fizionominë e vet eklektike, e cila e preku qytetërimin në çdo gjë të tijën. Nuk ndodhi kështu për shqiptarët.

Prandaj, shpesh herë brenda vetes kam menduar, pse vallë kishte ngjarë, dhe vazhdonte ende ky fenomen tepër i rrallë, që ofron vetëm populli shqiptar, i cili nuk mund të asimilohet me të tjerët. Shpërndarë rreth vitit 1900 p.K. ai e sheh veten duke vrapuar përgjatë brigjeve të Mesdheut, duke u vendosur kryesisht në Shqipëri dhe më pas duke vazhduar emigrimin në vende të tjera; për më shumë se 4000 vjet duruan në gjuhën e vet, pa ia cënuar detet fonetikën, thjesht një gjuhë e folur, pavarësisht faktit se mes popujve të civilizuar bashkëjetoj, ashtu si grekët e lashtë dhe italianët në artin e letërsisë, dhe në çdo manifestim tjetër shumë të përparuar intelektual.

Ky fakt është me të vërtetë i denjë për të tërhequr vëmendjen e të diturve, që me të tilla gjëra merren. Sepse mua më duket se gjuha shqipe nuk ishte më pak e lashtë sesa *sanskritishtja* dhe se nuk mund të radhitet ndër dialektet e kategorisë ilire.

Dhe duke iu rikthyer kësaj teme, unë do të them se alfabeti grek nuk mund të shprehë plotësisht shqiptimin në shqip pa lipsur që të shtohen shenja të veçanta.

Dhe në të vërtetë shqiptarët i kanë ende të gjitha lakimet dhe tingujt e gjuhëve primitive, të cilat nuk kanë ndjekur përparimin e kohërave. Në të gjeni aspirime (thithje ajri) të buta dhe të forta, pothuajse si *ain*-i i hebrejve, e nëse ndoshta nuk i kanë të katër aspirimet e gjuhës së tyre, tre janë të sigurta, duke e konsideruar *a*-në si zanoren e aspiruar më të ëmbël në të gjitha gjuhët; është *d*-ja e butë dhe *d*-ja fortë; *z*-ja e thjeshtë dhe ajo hebraike *t'ade*; *e*-ja e shurdhët e ngjashme me atë

të frëngjishtes; *th*-ja e ngjashme me atë të greqishtes Θ, ose *th*-ja e anglishtes; *chi*, *gli*, *glio*, që tingëllojnë si (*chiesa*-kisha), *gli* (nyje) *loglio* (*lolium*) në italisht, ose *καλ* dhe *κυριε* në greqisht; tingulli i zgjatur i zanoreve pothuajse si nota muzikore; e në fund theksi i fjalëve, e kështu me radhë.

Grekët në të tashmen përdorin shkronjat e alfabetit të tyre për të shkruar shqip, duke qenë kjo veçse njëra nga mënyrat e përdorura për t'i asimiluar këta njerëz dhe për të fshirë edhe hijen më të vogël të dallimit midis tyre, por për këtë gjë ata duhet t'i shtojnë shenja të tjera shkronjave të tyre për të treguar tingullin, që duhet të përftohet, dhe me gjithë këtë qëllimi nuk është arritur. Do të përmend këtu si provë shembullin e *birrit*, greqishtja e shkruan *πιριτ*, dhe të gjithë e dinë se *π*-ja greke nuk korrespondon me tingullin *b* të latinishtes apo *β* të greqishtes; dhe siç vërehet në pikën më lart, çfarë nuk ekziston në alfabetin grek, pa të keq mund t'i shtojmë një shkronjë tjetër krejt të re.

Pra, shqipja nuk ka asnjë alfabet të vetin, me aq sa dimë, apo të jetë përdorur në shkrimet antike dhe aktet publike.

Mes nesh italo-grekëve, libri më i vjetër që unë njoh, është ai që kam ruajtur, domethënë një fjalor shqip-latinisht i shtypur në Romë në vitin 1635. Gjithashtu kam nga shekulli i kaluar një urdhëresë ushtarake, paçka se i mungojnë faqe, i shtypur në shqip-italisht, për regjimentin mbretëror Maqedonas, i cili shërbente në mbretërinë antike të Napolit, si edhe Varibobën, gjithashtu i shekullit të kaluar, i cili botoi disa poezi të shenjta. Këto vepra janë me shkronja latine, përjashto këtu disa shkronja ose shenja të shtuara sipas gjykimit, dhe vullnetit arbitrar të shkrimtarit, siç është bërë nga të gjithë ata që në shekullin tonë kanë botuar ndonjë shkrimtar shqiptar.

Z. Girolamo de Rada është jashtëzakonisht i aftë në gjuhën tonë, dhe kryesori, ose më saktë i vetmi, mbledhës i këtyre këngëve popullore, po punon qëllimisht për ta reduktuar alfabetin e shqipes në kufijtë e parimeve filologjike të pranuara botërisht.

5. BOTUESIT⁴¹

Kjo tablo e vjetër dhe e qashtër e jetës sonë, nëse s’do të kish tjetër veçse një rëndësi poetike, sot nuk do të duhej ta nxirrnim në dritë sepse do ta ekspozonim ndaj mosvëmendjes. Por kjo tashmë ka shumë mundësi politike, gjë e cila nuk na lejon, pasi kemi zbuluar pothuajse të gjitha pjesët e saj, ta vonojmë shfaqjen e saj. Asgjë nuk mund ta shquajë sot Shqipërinë për besimin dhe virtytin e pleqve tanë, më tepër se kjo poemë bashkëkohëse e Skënderbeut, dhe që përmban historitë e kalorësve shqiptarë, dëshmorë me peshë të Krishtit dhe të lirisë. Kur burrat që kishin luftuar për dashuri bujare, binin nën një ndëshkim armiqësor, dhe toka mbetej pa to dhe e rraskapitur, atëherë ndonjë shok i po atyre aspiratave ngrihet zakonisht për të ruajtur, do të thojë, nga rrënimi, imazhet e atyre dhe idenë duke ia besuar ato këngës ose historisë. Dhe kështu ato bëhen shembull për brezat e ardhshëm, që rriten dhe zbulojnë të njëjtat fakte ndërkohë që njerëzve, ndër të cilët jam, ata u tregojnë armiqtë e tyre, pengesat e jashtme dhe të brendshme që i bënin të padobishme lëvizjet e mëdha antike. Ndoshta është ligj i botës shpirtërore, ai që i bën monumentet e pavdekshme të mendimit të rimarrin jetë, duke lidhur mes tyre epoka.

Një bashkatdhetar i yni i ndjerë që mblodhi nga goja e popullit një pjesë të këngëve të kësaj poeme, Anxhelo Bazili, thoshte “ata vijnë për të mbushur kohën që rrjedh nga Dante dhe Petrarka e deri tek Ariosto”. Por një mendim i sigurt nuk mund të jepet për këtë poemë, pavarësisht faktit se ajo është e plotë dhe e qartë si me frazat dhe me rendin e saj të rivendosur në qenien e parë. Të nderuarit tanë bashkatdhetarë, të cilët u përpoqën t’i bashkonin, u nxitën sigurisht

⁴¹ *Gli Editori, Rapsodie d un poema albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Tipografia Di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866, p. 15.

vetëm nga mendimi që aty të nxirrnin mësimin e tyre më të vjetër dhe origjinal, por përtej ndryshime fare të lehta në veprat elokumente që i janë besuar këngës dhe kujtesës, a është ndjekur vallë çdo gjurmë që mund të mbetet në çdo koloni të Italisë dhe në Shqipëri? Apo nuk ka pasur harrim të vargjeve, këputje, madje edhe këngësh të tëra, të përziera me rapsodi popullore që zor se janë të ndashme?

Pastaj, atij që i mblidhte, tundimi për të shtuar ndonjë varg, për të mbushur disa boshëllëqe a iu shua përgjithnjë? Edhe ne, nëse nuk pranonam asnjë mësim që nuk bindte ndërgjegjen, duke i dhënë një rend mbetjeve të shpërndara të këngës, pak të ndihur nga fati artistik, thjesht ndoqëm rrjedhën që na u duk se kishin ngjarjet që e ai përmbante: dhe kështu besojmë se kemi dhënë një version të afërt me atë që realisht i përkiste.

Por ne nuk dyshojmë që në botimet e tjera që do të vijnë, disa këngë do të rishfaqen më të pastra, të tjerave do t'u gjenden pjesët e gjymtuara, ose të tjera nga të huajt do të zbulohen; dhe më e plotë, mbase më afër rrjedhës origjinale, do të shfaqet në të gjithë përsosmërinë e tij të vërtetë ky monument fisnik i Mesjetës lindore.

6. RITMI I POEZISË SË LASHTË SHQIPE ⁴²

Në tre poezitë *Ngazëllimi*, *Himni* dhe *Banketi*, gjenden të përshtatura tri melodi të gjeniut të atyre vargjeve njëmbëdhjetërrrokëshe shqiptare, por që ndryshojnë nga motivet e tetërrrokëshit që është metri i këngëve të kësaj poeme.

Në poezinë e lashtë shqiptare, për vargjet njëmbëdhjetërrrokëshe dhe për ato tetërrrokëshe ka dy ritme të ndryshme, por në të dyja, masa e rrokjes gërshetohet sipas mënyrës amtare me fuqinë e thekseve. Rrëfimi epik, shtysa e pasionit gjithashtu, janë shprehur në vargje me tetë rrokje me disa ritme elegante itifalike (p.sh. χιῶν shiu rêshit, binte shiu nga retë), të përbëra nga këmbë të lidhura në mënyrë të ndryshme, në një periudhë me shumë vargje, një harmoni e lirë dhe e gjerë e përshtatshme për tema të larta dhe serioze. Le të shërbejë si shembull metri i shtatë vargjeve të fundit të këngës XIII të këtij libri:

Dilj k̄a p̄gjeret Duk̄esha
 T̄e shigh Duken e t̄'e njigh̄e;
 E z̄uljes ç̄e i b̄eri z̄em̄era
 M'̄i kumb̄uan shpiit e ljarta,
 Gr̄ushteshit ç̄e m̄e i dha kr̄eut
 U p̄r̄p̄oq̄etin p̄gjerit
 U p̄r̄p̄ooq̄e mb̄i vetheen.

- - - vv v - v
 - - - vv v -
 v - vv - v - vv
 - v - v - v - v
 - vvv - vv - v
 - v - vv - vv
 - v - v - - -

⁴² *Rapsodie d un poema albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Tipografia di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866, p. 54-55.

Këto tetërrokësha në përgjithësi shoqërohen nga një këngë silabike, notat e së cilës përsëriten në çdo varg, që ngjajnë porsì një rrotullim Valsi. Dhe motivet, megjithëse shumë të larmishme, që janë ose të ngazëllyer, ose të lumtur, ose të vendosur, ose të guximshëm, pothuajse gjithmonë nuk ka asnjë lidhje tjetër me veprimin e poezisë, përveç asaj të vënies së dëgjuesit në një ndjenjë të ngjashme me temën e saj, në mënyrë që ai të mbetet i prekur nga ajo. Të tilla melodi monotone cytin improvizuesit.

Ritmi i njëmbëdhjetërrokëshave, vazhdimisht të përshtatshëm për këngët e dashurisë ose trishtimit, i pasqyron këto hije të shpirtit me një plotësi më të madhe dhe ariet që u përshtaten atyre, me notat e tyre të gjata dhe të thella, të shpien në një botë të largët, të pafund dhe të dehin me melankoli; arie të cilave u afrohen ato të këngëve të dasmës. Arsyeja që njëmbëdhjetërrokëshat janë në thelb lirikë, është se në to, përveç rimave asonante, ka një kthim monotone të thekseve dhe masave të ngjashme. Le të japim një shembull:

Frini ajëra bini shìra; e (këtu mbrënda - v - v - v - vv - v - v	
Na mbaìtur fati) mos u gaptë jeta,	v - vv - v - v - v - v
Të futuroonj e ljumlah kë pata!	v - v - - v - vvv - v

Spirate venti, riversatevi piogge; e (qua dentro
Tenendoci chiusi, ma e lei il Fato) non aprasi il mondo,
A volarne fuori la felicità ch'io m'ebbi!

Për masën e vargjeve shqipe, është jothemelore ligji harmonik që rrok tërë gjuhën dhe të përmendur prej meje në *Parimet e Estetikës* time (bot. në Napoli më 1863). Vërej për shembull se zanorja e shurdhët, e cila ndjek në përgjithësi shumë emra dhe mbiemra që duket se përfundojnë me bashkëtingëllore, shndërrohen në shumës në gjysmë zanoren ú (= ë), si *lhuum* (= ljuum) lumi, *lhûm-ra* (= ljumlah-ëra); dhe po kështu te foljet prapashtesa, ose rrokja, a -aja fundore (e zëshme ose e shurdhët qoftë) nuk humbet kur zgjedhohet, por shndërrohet në të njëjtën ú (= ë), ose në gjegjësen e saj të plotë y (= ë): Ashtu si *diegch* (= dieg) djeg, *lhagch-ign* (= ljustag-inj) banjo, *diegch-úmi* (= dieg-ëmi) digjemi, *diègch-yn'* (= dièg-ën) digjen, *lhagch-úmi* (= ljustag-ëmi) lagim etj; kështu *dògk-ia* (= dòq-a) e dogja, *dogk-útim* (= doq-ëtim) dogjem.

Tani më lejoni të shpreh angazhimin tim që në Kolonitë tona të bëhet një mbledhja e shumë elegjive dhe epigramave njëmbëdhjetërrrokëshe, lule të vyera që do të japin imazhin e njëmendtë (të qashtë) të të gjithë mendimit kombëtar.

Por mbase asgjë, në këtë zhanër, nuk do të ishte e krahasueshme me punën e dalluar të njohjes dhe ndalimit, para se të humbin, të asaj çka mbetet nga këngët shqiptare. Unë nuk e di nëse jehonat e muzikës frigiane, apo dorike, apo lidiane jehojnë ende në të. Mund të ndodhë edhe që notat e saj, duke u futur në muzikën e sotme, të bëhen shkas për risi joshëse. E sigurt është që kënga bashkë me gjuhën është shprehja e lindur e aspiratave të një populli, dhe atyre që me më shumë këmbëngulje qëndrojnë bashkë me të në udhët e jetës duke pasur të dyja fuqitë natyrore për ta rimëkëmbur ose për ta kthyer në kohë më të mira të lashtësisë. Kështu që, edhe për artin në përgjithësi, dhe për ne si komb është një moment i shkëlqyer shpëtimi i asaj çka mbetet nga muzika pellazge që vazhdon ende mes nesh.

7. VËZHGIME FOLKLORISTIKE⁴³

I.

Ailhi Jalhimonò janë zërat e vajtimit shqiptar për atë që ka humbur në mënyrë të pakthyeshme. Mbase jam i gabuar, ose dëgjohen në to gjurmët e mbetura të dy vajtuesve të antikitetit të miteve: Jalemo! Ahi Lino! Në kohërat e largëta të Greqisë, Lino dhe Jalimo mbaheshin, si Adonisi, për burra që Zotat i kishin për zemër e megjithatë të mundur nga fati tek të cilët njerëzimi vinte vit pas viti për të vajtuar veten. Lino-ja i trishtë këndohej gjatë vjeljes së rrushit, Jalemo festohej pas të korrurave të grurit. Tani Lhymi në shqip do të thotë *oborr* (aja) *dhemokër* (palmento). Zbulova se mitet kryesore të kultit heleno-latin kanë një shpjegim të vetin në gjuhën shqipe (*V. Antikiteti i kombit shqiptar*, etj., në Napoli 1864); dhe këta dy emra, dy pishtarë të tjerë të asaj gjuhe, ndriçojnë atë botë të largët nga një tjetër anë. Sa gjasa ka që, me t'u prerë të korrat dhe me t'u futur në oborr, mendjet e atyre brezave që ishin, vetvetiu të ktheheshin me keqardhje te ajo shpresë e gjelbër dhe më pas pasuri e artë e tokës që shuhej në oborr (te lhymi)? Dhe kështu një trishtim i pashmangshëm, i cili megjithëse përtërihej çdo vjeshtë, duhej të shoqëronte të korrat dhe zhdukjen e rrushit në mokër (te linò); Homeri, i cili qe dëshmitar, midis figurave të mburojës së Akilit, vë: "Vasha dhe rioshë të brishtë që mbanin mbi kokë rrushin e ëmbël. Në mesin e tyre, një djalosh i binte gjithë mirënjohje çiftelisë, duke kënduar me zë të ngrohtë që të kënaq shpirtin Linòin". Prandaj vajtimet e Jalemit dhe Linos fillimisht përkonin me "ah medet, varrin e jetës". Dhe është diçka e jashtëzakonshme që kombi, në gjuhën e

⁴³ *Rapsodie D Un Poema Albanese, Racolte Nelle Colonie Del Napoletano*, Tipografia di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, Nr. 24, Firenze, 1866, p. 37-38.

të cilit ruhet kuptimi i atyre fjalëve, ende i mban ato si shprehje të vajtimit të tij *abilhi! Jalhimo nò!*

Kjo mbase kuptohet pak në kohën e sotme, e cila mezi e mban mend hyjninë. Por ndoshta një ditë do të kuptohet edhe moskokëçarja e tanishme, se si jemi dhe nga kush jemi ngritur në këtë botë hyjnore që na mban, dhe nëse Ata temben, Ai duke na njohur na vuri aty për të përmbushur qëllimet e tij; dhe do të duket tej mase i pakuptimtë zemërimi i shumë njerëzve, kundër atyre që, me t'i ndërprerë kurat kalimtare, tërhiqen nga plani për të njohur duke soditur dhe adhuruar atë Zot. Duket në shikim të parë se qetësia e botës në rende që duken të përjetshme, ishte ajo e mendimeve, të cilat nuk besonin në asgjë tjetër veçse në atë që është streha jonë e ndjeshme.

Por kjo qetësi ishte që në kohrat e hershme, kur vajtimet Jalemo dhe Lino shoqëroheshin me kultin e duarve, lustrimet (purifikimet) me ujë dhe kripën e shenjtë, dhe miklimi shëlbyes për sakrificën e jetëve njerëzore ose shoqëruesve të tjerë të njeriut, domethënë të qengjave dhe demave të vegjël pa cene. Në atë idhujtari të përvuajtur pasqyrohet ndjenja e thellë e Zotit dhe e natyrës, e cila si një tufë rrezesh drite mbante lidhur njerëzimin me Parimin e botës së përtejme, si të qe pothuajse një bashkim i lumtur, për të cilin ajo kishte në gjuhë shenjë mbretërore dhe as që e dinte fare se si qe shkëputur prej saj. Ndërsa indiferenca sipërfaqësore e sotme më duket se rrjedh nga një burim më i afërt. Qëkurse u tha mes njerëzve dhe u dëgjua, se ata ishin bij të Zotit të lindur në një pjesë të universit të tij, dhe besimi i parë, i cili i mbajti të shumët të qashtë dhe të pacen, u pasua nga besimi që patën tek mirësia e të Atit, dhe këtë besim i krishterë me të cilin është abuzuar, mendja e ligë e njerëzimit më vonë e shndërroi në harresë sqimatore. Tanimë kjo është një histori që përsëritet në jetën e njerëzve.

8. VËZHGIME FOLKLORISTIKE ⁴⁴

II.

Të katër këngët që vijojnë mbeten rituale në dasmën shqiptare, të cilat ende e ruajnë dukjen e një feste publike. Në mbrëmjen e së enjtes që paraprin të dielën e dasmës, shtëpia e dhëndrit mbushet me qytetarë dhe qytetare dhe dy kore grash që kalojnë pranë vajzës që po përgatit brumin e tortës së dasmës (*peta*), ia marrin një kënge nga e cila mundëm të kishim vetëm katër vargje. Ndoshta ajo i referohej shkarazi kuptimit të fshehur të asaj torte të mbrujtur me miell, vezë dhe sheqer, duke u dhënë sipërfaqeve me basoreliev pemë, gjarpërinj dhe katërkëmbësh, me diellin dhe hënën në krye; ndoshta i gjithë rituali vinte nga bota pagane. Dhe në fund, shumë të vjetër e konsiderojmë poezinë e mëposhtme të dasmës, e cila qëndron para nesh si një monument i mbijetuar, në Athinën pellazge, prej ku Thespi e mori idenë e dramës. Por duke qenë se këto poezi ambientohen vazhdimisht në jetën reale të shqiptarëve, mund t'i konsiderojmë ata si një pjesë përbërëse edhe të historisë së bukur mes djalit të Zonjës Agata dhe vajzës së Pietro Shtrorit dhe këtu t'i shpalosim.

*Se ti vashëza gadhiare
Sā gadhiare aqë dëljirë,
Çë m'gjëshën ata brumë,
Gjëshe fort e ngüre shumë.*

1866

⁴⁴ *Rapsodie d un poema albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Libro II, Tipografia di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866, p. 53.

9. “SKËNDERBEU I PAFAT”⁴⁵

Parathënie

I nisa këto poezi në rininë time të hershme, në vitin 1837, duke futur aty ndjenjat e shpirtit tim, të cilat më lindnin në atë kohë dhe më pas më lindën në Napoli, ku një bukuri e rrallë, më ngriti drejt vetes nga bota e poshtme. Dhe kështu ata pastaj, nën tingullin e erërave që frynin mbi Europë, u rritën pothuajse në vetmi dhe nën rrezet që binte nga lart; të cilën unë që nga fëmijëria e ndoqa me thjeshtësi dhe deti fort i trazuar i pasioneve nuk më fundosi.

Brendia dhe forma e veprës u prodhuan në këto kushte të shpirtit dhe të kohës. Ata nuk ofrojnë, si epopeja antike, një fabul simbolike që përmban ndonjë mendim të lartë, dhe me qartësi rrëfen të vërtetat e njerëzve dhe të gjërave, por fenomene dhe veprime të cilat, duke u lartësuar, nga çdo varg zemra ime është rrëmbyer, janë aty, si statuja homogjene në galeri të njëpasnjëshme, të vendosura aty për të ilustruar disa aspekte të botës. Në këtë mënyrë, dhe ndoshta e lindur në të njëjtën kontekst, tragjedia Athinase tashmë, në përmasa më të mëdha, i kishte mirëpritur dhe përfaqësuar çastet kulminante të jetës njerëzore.

Pastaj gjatë punës, me qëllim që ata që sot synojnë kryesisht të zbulojnë nga fenomenet e jetës ndonjë shenjë të sigurt të Fjalës së thellë që ajo përmban, unë, duke qenë se nuk e di nëse pak apo shumë vëmendje ndaj ndjenjës heroike buron brenda tablove dhe lidhjes së tyre të jashtme, e peshoja me më shumë kujdes se si mund ta njihja dhe ta shfaqja në figurat e krijuara dhe në rendin në të cilin i vendosja ato, atë të vërtetë të Jetës, e cila, përpos asaj që gëlon mbi tokë, prek

⁴⁵ *Scanderbeg sventurato: Prefazione* (1870). *Poesie albanesi*, volume II, *Skanderbegu i pafaan*, Tipografia Albanese, Corigliano Calabro, 1872, p. 5-8

thellë shpirtrat e njeriut. Por, për të shquar dhe njohur atë fjalë të shenjtë të botës unë nuk mjaftoja i vetëm dhe e shpreha aq sa munda atë që m'u shfaq, ose më mirë që m'u dhurua.

Realisht vetëm, pa atdheun tim, dhe i privuar, ndërsa mbi veprën e gjatë, nga mbështetja që të gjithë të tjerët marrin nga bashkëqytetarët, unë nuk kisha as dritë për të kërkuar por u ngushëllova në besimin e të Njeriut Zot që deshi të gozhdëzuar në kryqin e tij tërë popullin tonë: dhe shumë herë në Të, të cilit çdo njeri qetësohet kur i drejtohet, më ndriçoi dhe më ngushëlloi.

Dhe, nëse ndodhi që, në vitin 1836, nga dashuria për atdheun emri im u mor e u lartësua si i pari dhe i vetmi Shqiptar dhe më nxorri në dritë të diellit, ku, pothuajse në një palestër të përbashkët, sot pasardhësit e ndryshëm dëshmojnë virtytin e tyre: tani që mbaroi poema e gjatë që e lartëson gjuhën, traditën tonë, mos pandehni se kam përmbushur çdo qëllim të artit, ndiej se nga ai Besim në Zot më buron një gëzim i sinqertë, sepse tani më duket, dhe nga anë të ndryshme shfaqen ato shenja, se vepra ime ka për qëllim të ndihmojë rimëkëmjen e kulturës dhe pasurisë sonë.

dhjetor 1870

10. SHËNIME MBI “POEZINË SHQIPE”⁴⁶

SKËNDERBEU I PAFAT HISTORI TË SHEKULLIT XV

Volumi IV, Libri III (1873)

F. 35, Kënga e parë:

- a) Këto tre vargje janë ç’ka mbetur nga një këngë e humbur popullore.
 b) Izolimi i Shqipërisë së ndarë nga turqit nuk është i dëshirueshëm sot për ata që e duan atë; sot, kur idetë zvetënohen, të gjithë bëjnë plane për të dobëtit. Perandoria Turke e themeluar në një formë federale dhe e përshkuar nga një frymë vëllazërore e krishterë, është e vetmja zgjidhje e qëndrueshme për çështjen e Lindjes, dhe që është në të mirë të të gjitha kombësive të përfshira në perandori.

F. 53, Kënga e dytë:

- c) Deri më tani poezia popullore shqiptare ka vetëm dy lloje vargjesh të krahasueshme në një farë mënyre me njëmbëdhjetërrrokëshat dhe tetërrrokëshat italianë. Atyre në poezi u mvishen nota të shumëfishta: dhe për poezitë solemne, si ato të Valles, të Korit dhe të Banketit të dasmës, mbeten tradicionale disa nota të vetat: në tërësi ata të sjellin ndërmend atë çka ishin variacionet dorike, frigiane etj.

d) Drini është lumi më i madh i Shqipërisë; ai rrjedh nga Zadrime dhe derdhet në Adriatik.

e) Buljari quhen manjatët shqiptarë, fjalë që rrjedh mbase nga periudha e Homerit *buglii*, asamble konsultative e të Urtëve.

⁴⁶ *Poesie albanesi*, volume III, Libro II *Skanderbegu i pafaan*, Tipografia Albanese, Corigliano Calabro, 1873.

F. 101, Kënga e katërt:

Harpitë ishin në kohët e lashta simbol i Egoizmit ku kulti i gjërave të fundme, pasuria, bukuria sensuale, fuqia e të tjera, virtyte të cilat njeriu i përfton vetë, ndër kolegë të vet, gjëra të tilla, shndërrohen, duke u zbehur, në instrumente të kota të një ferri idhull, dhe nga i cili të gjitha zemrat shkëputen përpara se edhe ato të kthehen në bark të Tokës.

Pag. 143, Kënga e pestë:

Qyteti Koeprili në Maqedoni, i vendosur në lumin Vardar, Aksi antik i Homerit. Koeprili qe atdheu i dy vezirëve të mëdhenj shqiptarë Mehmet dhe Ahmet Koeprili.

F. 151, Kënga e gjashtë:

Qyteti i Pejës në Shqipërinë e Veriut, i vendosur mbi një degë të Drinit të Bardhë, njëmbëdhjetë legë detare nga Prizreni, atdheu i Xhuliano apostatit, dhe njëzet nga Shkodra.

Faqja 175, Kënga e shtatë:

k) Ishte kjo shenja se ajo agjëronte për martesë.

1) *Shengjeza*, konstelacioni i lirës.

11. SHËNIME MBI “POEZINË SHQIPE”⁴⁷

SKËNDERBEU I PAFAT HISTORI TË SHEKULLIT XV

Volumi IV, Libri V (1877)

F. 32, Historia I:

Mes shqiptarëve është zakon që, në prag të Shën Gjonit, të dashuruarit të kalojnë disa lule gjembi mbi flakën e një qiriu dhe t’i ekspozojnë ato ndaj freskut të natës. Nëse dora teksa i kalonte qe e rëndë, dhe në mëngjes ata nuk kishin lulëzuar, shënojnë vdekjen e dashurisë.

F. 66, Historia II:

Këto vargje janë marrë nga Epitalamusi kombëtar i shqiptarëve:

/ F. 62: / - Gapu, mëlj, e bënu údh / të më shkónj këjò thelëz / kí petrit e krághërëgjënt. / Sgardhamént se pèxheret / mbí dét, te zoti madh / i presën. . .”.

(Hapu mal dhe bëhu udhë; që të kalojë kjo thëllëzë dhe kjo shqiponjë me krahët e argjendtë: Ndërsa i hap krejt ballkonet mbi det në pallatin e të madhit Zotit, ku t’i presin).

F. 66, Historia II:

Ishte nata e 14 tetorit 1837, kur autori, në moshë të re, i përndjekur, i strehuar në pyll - dhe atje i befasuar nga shiu i stuhishëm me rrufe dhe bubullima, pa të shfaqej rastësisht në qiell meteorin madhështor të vijëzuar në këto faqe me vërtetësi.

⁴⁷ *Poesie albanesi*, volume V, *Skanderbegu i pafaan*, Tipografia Francesco Mormile, Napoli, 1877.

F. 114, Historia III:

Ende në atë kohë kishte vërshuar në Itali i tërë vrulli i letërsisë dhe shkencës pagane; por studimi i gjerë i vetë atyre, i gërshetuar me spektaklin e neglizhencës së Klerit (i cili pak më vonë i dha kaq shumë shkas Reformës), tashmë kishte shtyrë shumë mendje italiane drejt të menduarit të lirë.

F. 138, Historia IV:

Emri i lashtë Evagrio i lumit Maritza është fjalë shqipe: Ui-egcher (ujë-egri).

1877

F. 138, Historia IV:

Shqiponja në një sfond të kuq, e cila do të thosha se erdhi nga i njëjti qiell me ata të Romës, ishte flamuri i Shqipërisë. Dhe ai njeri që shikon tek Aleksandri dhe Pirro fëmijët e këtij (flamurit), ose më vonë tek Skënderbeu i pathyeshëm, tek Koprili dhe tek Ali Tepelena, dhe tek ai më afër nesh Mehmet Ali i Egjiptit, dhe tek Miaouli, Botzari, Odisea, Karaiscaki dhe tek Sulejman Pashai, sot një frenues i arrogancës së Rusisë, ose që shikon në lavdinë më të paqtë të Princeshës Dora D'Istria nga dy botë e nderuar, dhe madje edhe tek Akil Toreli, i cili në rininë e tij ulej midis princërve të skenës italiane, do të thotë (duke patur parasysh gjithashtu që pothuajse të gjithëve jashtë atdheut iu desh të mposhtnin më parë fatin) që ai flamur fisnik i Shqipërisë i rri mirë për shtat.

F. 156, Historia V:

Që nga viti 1873, në një shënim në librin e tretë të kësaj poeme, unë thoja se Shqipëria tashmë nuk ka strehë tjetër për kombësinë e saj përveçse të qëndrojë e bashkuar me Perandorinë Osmane. Autonomia pa mbështetje vëllazërore do ta ekspozonte atë ndaj lakmisë së aneksimit të provincave, e cila gjithnjë e më shumë pushton dhe rrënon shtetet e mëdha. Tani sllavët fqinjë do ta gllabëronin në të mirë të vullneteve (vendeve) të largëta dominuese. Sa për grekët që kishin fituar me ndihmën e shqiptarëve të ishujve, të Sulit dhe të provincave të tjera, në vend që të kultivonin gjuhën e tyre amtare dhe shpirtërore dhe të lidheshin me me ta, nga zilia dhe Panelinizmi i zbrazët zunë të

mohonin traditat fisnike pellazge dhe t'ia bjerrnin gjuhën kështu që tani një humnerë është hapur midis dy popujve.

Kështu, duke e vendosur veten nën flamurin osman në luftën e tanishme, shqiptarët jo vetëm zgjodhën për vete vendin e rrezikut dhe të nderit, siç atyre u kishte hije, por peshuan me kujdes shëndetin e tyre. Dhe sido që të jetë fundi i kësaj lufte, ne kemi besim se i drejti Zot do t'i lërë dheut amë atë liri dhe qenie më të mirë, ku të na mundësohet edhe ne të mund të gjejmë ngushëllim para se dheu i huaj të na tresë.

1877

12. SHËNIME MBI “POEZINË SHQIPE”⁴⁸

SKËNDERBEU I PAFAT HISTORI TË SHEKULLIT XV

Volumi VI, Libri V (1884)

F. 36, Historia I:

- a) Kjo është një fjalë e urtë shqiptare që përshkruan shkallët e fisnikërisë në shpirtra. Sipas preferencës që kanë ato, dhe studimit gjithashtu, për gjërat e pavlera ose ato të brishtat dhe njerëzoret.
- b) *ljeen* në shqip do të thotë *i marrë*. Këtu kuptimi i pikëlluar i fjalëve që ajo martirizon i drejton të afërmit të saj qëndron në aluzionin se, romakët duke i quajtur helenë banorët e Cezaresë i dhanë, me përbuzje, atij emir kuptimin që ai kishte në gjuhën shqipe. Nuk e di më tej nëse Cezareja ishte e banuar nga helenë të vërtetë apo nga maqedonas.

F. 74, Historia II:

Vlejnë për t'u përmendur dy fjalë shqipe *ree* dhe *hjee* me një simbolikë të qartë primitive: *Rae* (*ree*) do të thoshte *re* dhe *mendim*, njëra ngrihej nga kazani i tokës dhe tjetra nga zemra vlonte; ndërsa *hje* (*xee*) do të thotë hija që projektojnë trupat dhe dinjiteti që shpirti reflekton mbi veprimet edhe pamjen.

⁴⁸ *Poesie albanesi*, volume VI, *Skanderbegu i pafaan*, Tipografia Francesco Mormile, Napoli, 1884.

F. 102, Historia III:

Në këtë pseudo-testament të Amuratit na bëhet me dije që të caktojme dy krerët e rrjetit inteligjent ku shtrihen *Shtetet Përfaqësuese* të ditëve të sotme: Njëri ka të bëjë me Sovranitetin që i jepet popullit sipas një modeli, në mënyrë që ai t'ia delegojë atëindividëve të veçantë, dhe t'i bëjë ato të gjithëpushtetshëm mbi njerëzit dhe vetë pasuritë e tyre ç'ka sjell si pasojë që pas të vetmes ditë në të cilën kombet janë të lira, ditën e delegimit, jo të vullnetit të tij, por të pozitës së vet pa rezerva, domethënë të zgjedhë së kë dëshiron të ketë mbi krye: këta pjesa më e madhe e të cilëve ishin aventurierë atë ditë u bënë *kombi sovran* dhe sundojnë pa kontroll kombin e vërtetë që ka mbetur *nihil*. Tjetri nën ndjenjën e *bonum est nos sic esse* (ajo çka është e mirë për ne), që në të tilla kombe të sajuara, e nxit vullnetin e nënshtetasve për të shuar *respektin ndaj vetes* i cili i ve fre skllavërisë, dhe *besimin në Zot*, për të cilin njeriu nuk kujdeset.

Sot klerikët deklarojnë se merimanga e këtij rrjeti të zymtë është Sekti i Masonëve, që pasuan themeluesit e Babelit, dhe ku gjallon Satanai.

F. 154, Historia IV:

f) Në konceptin e shqiptarëve është e lidhur me aristokracinë; mirësia kështu bijtë e fisnikëve të *ljeer së mirësh të lindur nga të Mirët*.

g) *Deti* që në shqip do të thotë det është helenja *Teti*, Hyjnesha e oqeanëve e martuar me Peleun (*piilj mal i egër* në shqip). Deri në kohët e mëvona të mitologjisë pagane mbetet kujtimi i kësaj martese simbolike të detit me tokën e frytshme. Nga e cila, Akili, i adhuruar, sipas Plutarkut, nga bashkëkombasit e tij Epirotë, me emrin Aspetos, që është fjala shqipe i *shpet* (i shpejtë), dhe në mitin e të cilit – e zbërthyer edhe nga fjala shqipe *aki-ljee* (po i lehtë), Akili homerik “i cili me ç’thuhet ka vrapuar mes një fushe me kallinj gruri pa i përkulur ato” – pasqyrohet, dhe shfaqet, Jeta, të cilën toka dhe ujërat e ushqejnë, dhe është kaq e lehtë por megjithatë hyjnore.

h) Emri i Afërditës (Venusit) shpjegohet shkëlqyeshëm nga fjalët tona àfer (vicino) dhe *dit* (*giorno*), qoftë për të treguar edhe vetëm yllin Venus që shkëlqen mes dritës së diellit.

1) Euripidi në fillim të Andromakës thotë: Këtu territori i Phthias kufizohet me Thesalinë; ku një ditë detarja Teti u bashkua me Peleun,

dhe nga dasma e asaj Hyjneshe Thesalianët e kanë quajtur vendin Tetidheo: “kështu nga fjalët shqiptare Teti (deti) dhe dhe (toka)”. Në librin XVI të Iliadës Patrokli i thotë Akilit:

As baba për ju Peleu dhe as nënë.
Teti ishte, por *deti* i zi dhe ai i qeti,
Ajo lindi shkëmbin, etj.

1884

13. DISA SQARIME TË SHKURTRA ⁴⁹

Pas mendimeve të ndryshme të shprehura për librat e parë të *Skënderbeut*, e shoh të udhës të jap disa sqarime të shkurtër.

I) Formën e Këngëve unë thjesht e mora nga rapsoditë që sollëm me vete nga vendi amë¹ që janë në vetvete pjesë e fondit të përbashkët popullor, prej nga ka lindur çdo poezi heroike spontane e kombeve europiane. Aspekti më i dallueshëm i tyre qëndron në faktin se rrëfimi, veprimi dhe frymëzimi pasojnë njëri-tjetrit dhe shkrihen së bashku siç vihet re në jetë. Poezitë homerike (forma e fundit e të cilave iu dha nga Soloni mbeti një model i shkëlqyeshëm për epikën, kudo që u provua ajo më pas), kanë lindur, sipas traditës, në të njëjtin terren dhe po atyre mënyrave; prandaj nga ato mundën pastaj të shquheshin dhe të formuloheshin qartë tragjedia por dhe lirika e helenëve. Edhe në kohërat e vona Greke, kur njerëzit donin të ktheheshin në realitetin e gjallë, si në idilët sicilianë, u ribashkua përsëri në Këngë rrëfimi me shfaqjen dramatike.

II) Sa i përket përmbajtjes, unë doja, në formën që i dhashë, atdheun tim të portretizoj, jetën që bën dhe dëshiron në shtëpitë e tij. Dhe sepse në to *realja* (e vërteta) nuk kufizohet në streha paqësore të mbrojtura nga të këqijat, siç pretendonte Teokriti për shtëpitë rurale; as nuk shqetësohet gjithmonë dhe vetëm për fitimet, ndjenjat dhe detyrimet që mund të lindin prej tyre, por është depërtuar dhe vënë para sprovave të fuqishme nga besimet e krishtera dhe rrymat e tjera të pafundme: jeta që është thith ajrin nga çdo anë e botës në të cilën ndodhemi. Ajo që e diferencon përfaqësimin e vetë asaj, do të shihet, për shembull, po të krahasojmë historinë e Këngës IV të këtij Libri me

⁴⁹ *Poesie albanesi*, volume V, Libro IV, Skanderbegu i pafaan, Tipografia Francesco Mormile, Napoli, 1877, p. 5-10.

ndonjë eklog të Teokritit, ose me Arminiusin dhe Dorotean moderne të Gëtes, poet fisnik realist².

III) Për shkak të pamundësisë së mënyrës për t'i bashkuar pjesët në një të tërë të madhe, për të cilën jam akuzuar, unë e shpreha në parathënien e poemës se çfarë uniteti më siguronte ajo t'u jepja grupeve të ndryshme të Basorelievit tim: Ndërsa një jetë, së cilës dhimbjet e pashtershme ia prishën gjithnjë qetësinë, as më dha e as mbase nuk do të më japë më tepër fuqi, se sa fakti që ta rrokja me një shikim riprodhimin e njëpasnjëshëm të figurave.

Nga ana tjetër, për çdo shpirt poetik dhe krijues është e ditur se, në vepra të tilla që lipsin forcë e mund të madh, trillimet e gjalla dhe me efekt, të krijuara më parë, i jepen më pas mendjes për t'i nxjerrë në dritë të renditura në mënyrë që nga njëra të reflektohen butësisht e në mënyrë harmonike tek tjetra; dhe asnjëherë akti krijues nuk e ndjek fiks planin e paramenduar e të stërholluar të mendjes e as nuk i bindet asaj. As shembulli i poezive epike që imitojnë rendin homerik nuk është i vlefshëm sepse në to figurat ose nuk janë të pajisura me plotësinë e jetës, ose nëse janë të gjalla dhe flasin, ato shpeshputen dhe pothuajse edukohen jashtë pëlhurës që i përmban ato. Prandaj, rendi artistik dhe harmonia e së tërës duhet të kërkohet tek pikturat individuale: sepse në to qëndron absolutisht vërtetësia dhe fisnikëria e rrëfimit, e vërteta dhe idealet shëruese të personazheve dhe kuptimi simbolik i gjërave.

IV) Edhe për ndonjë cen të përkthimit unë kërkoj dhe shpresoj të më falni.

Pata, pikë së pari, nevojë që ta bëja vetë; as nuk kishta ndonjë mjet tjetër përveç gjuhës italiane që të mund të isha i kuptueshëm në nivel universal. Nuk mund ta mposhtja arsyen e shpirtit tim, i cili donte të paraqiste me anë të këtij mjeti (gjuhës) rendin dhe energjinë, me të cilat bota u mbryjt tek ai. Por gjuha jonë me origjinë të lashtë mundet lehtësisht që për shkak të rasave, të tkurrjeve që ka, etj. të pasqyrojë çdo rend të kundërt të ideve dhe të japë ritmin e gjendjeve të ndryshme të shpirtit aty ku ajo italiania nuk i vete fort për shtat.

Kjo gjuhë për mua nuk ishte ajo amtare, dhe atje ku nuk e dija tërë fuqinë e saj, qofsha i justifikuar sepse më është dashur ta mësoj në libra, ashtu si gjuhën latine dhe atë greke.

14. RAPSODI KOMBËTARE

Parathënie

Sapo u largova nga Kolegji i Shën Adrianit, në korrik të vitit 1833, mora një letër nga Rafaele Valentini (i cili më vonë në moshë shumë të thyer qe kryetari i pushtetit ekzekutiv të Kryengritësve të Kalabrisë në vitin 1848), dhe më kërkoi këngët popullore të kolonive tona. Pastaj shkova në Shën Kozma tek gjyshja ime nga ana e nënës dhe atje një grua tejet e moshuar, Tortòscëglia (shqip: Tortoshëlja) më recitoi të parat, ndër të trera ato të Dedi Skurës, Miloshinos, Rada Vanit. Pastaj u ngjita në Shën Mitër, tek kushërira jonë Oricia, prej derës Strigari, mbi nëntëdhjetë e kusur vjet e prandaj e pakujtesë e cila më mësoi këngën “*Zbarkoi Turku, po ku u ul?*” dhe shumë të tjera boll gjysmake.

Në atë kohë shkoja të dëgjoja gratë e fshatit tim nga të cilat mësova rreth njëzet. Dhe nga ato biseda me vajzuket dhe nga thjeshtësia e diktimit të atyre këngëve, zuri fill historia dhe më pas rrëfimi, ashtu siç është, i trillimit të *Milosaos*. Përmbledhjen e dërgova në Kozenca.

Kur në vitin 1845 Dhimitër Kamarda më takoi në Napoli dhe më tregoi një dorëshkrim prej nja pesëmbëdhjetë këngësh, të gjetur në Kolegjin shqiptar të Palermos, nga i cili, ai i kuptonte pak prej tyre sepse nuk ishin në dialekt sicilian: sapo i pashë njoha menjëherë gjuhën e fshatrave tanë: Ishin fisnikë dhe të lindur, mund të thuhet, të gjithë në More: “*Doli e bukura tek dera*”, “*Nga qyteti i Napolit*”, “*Rrezes së trishtuar*”, etj. I transkriptova dhe i bashkova me të tjerat. Një vit më vonë njoha Herman Kestnerin nga Hanoveri, i cili mblidhte këngë popullore nga njerëz të ndryshëm, dhe deshi edhe të miat. Fryma e guximshme dhe freskia e re e tyre iu duk se i vinte (çmonte) mbi të tjerat që kishte njohur dhe ai më ndihmoi në planin e kahershëm për t’i nxjerrë në dritë, në mënyrë që të mund ta shihnin [dritën].

Pesë vjet më parë, Luigi Petrasi nga Qana më kishte dërguar tre, me të vërtetë të fisme. Dhe një vit më vonë, erdhi në Napoli Anxhelo Bazile nga Pllatëni dhe më solli tre të tjera, atë të Pjetër Shtrërit, atë të dasmës dhe atë të besimit të madh të Kostandinit të madh, dhe të plota, ashtu siç unë nuk i kisha. Kështu që i porosita dhe i përktheva në italisht. Pastaj rrodhën ngjarje të tjera të trazuara dhe m'i vonuan. Prandaj kur u largova nga Napoli me një zemër të çjerrë, grisa dhe hodha tutje bashkë me të tjerat, pa e kuptuar, edhe atë dorëshkrim; humbi.

Pasi u ktheva në atdhe, siç më këshilluana, kërkova ndër dokumentet nga ku e kisha nxjerrë atë libër, por fragmente të vyera kishin humbur, dhe njëra prej tyre "*Këndova dhe zgjova Zotin tim*" nuk ishte më. Për të më mbeti vetëm shpresa se një kopje të saj do ta kishte Kestneri, së cilit ia kishte dhënë. Kështu që e pashë të nevojshme që të shkoja në Shën Sofi, dhe nga një grua e vjetër që e thërrisnin Zibia, dëgjova pesë a gjashtë reja, këngë të cilat nuk e di nëse edhe njerëzit e tjerë i kishin: "*Vej i biri i Fugh'jes*", "*Ngritën një pavijon*", "*Të gjithë vala i nxorri jashtë*", "*Po bie shi dhe borë*", etj. Pastaj një grua nga Perçile, me emrin Rita, më mësoi versionin e përmirësuar të këngës së bukur dhe krenare "*Kur të lindje vashëz*".

Dhe në fund, mora një përmbledhje nga At Antonio Santori nga Kolonitë përtej Kratit, por m'u desh t'i shkoja në mend për të dalluar disa shtesa, me ndihmën e të tjera kopjeve që kisha dhe nga disa copëza që më kujtohej se nëna ime ia këndonte vëllezërve në djep. Kështu nga mëndesha plakë që na rriti jetimë më vonë, më kujtonte atë që fillon kështu: "*E pleqëroi plaku me malin*".

Por duhet të ketë ende shumë të tjera në fshatrat tanë; dhe unë i lutem bashkëpunëtorëve të kësaj reviste t'i nxjerrin ata nga aty ku janë harruar; në mënyrë që puna ime të furnizohet nga duart e tyre: sepse kjo është një trashëgimi e shkëlqyer e të gjithëve ne.

Në 1866, i rregulluam ato që kishim me Nikollë Janon nga Shën Dhimitri, Nikolla Tomazeo na ndihmoi që t'i botonim në Firence. Si të tjerët, të cilëve iu drejtuam më kot, ai nuk na njihte. Por ai kishte, ndër shumë të tjerë, edhe më të lëvduar të kohës së tij, fatin, do të thosha unë, që do të mbështeste me duart e tij gjithçka që do t'i shërbente nderit të Italisë. Dhe pasi ai vdiq, mbeti një si vend i hapur për shumë veta që fryjnë turpshëm tek besimet e jetës dhe në frymën pastruese të krijimeve të shpirtit; dhe duket se ato, meqë nuk është më gjykatësi i

ashpër, vijojnë të mburren me arrogancë për asgjë tjetër veç vetvetes. Ai Zotëria me ta marrë vesh për frymën e re që po përhapej nga rapsoditë shqiptare, u kujdes edhe për lustrimin e përkthimit, për t'u hapur rrugën atyre që të shkonin kudo të bekuara.

Sepse sot ata janë me të vërtetë një shembull shërues për artin poetik europian: sot që mendimet, imazhet dhe ndjenjat, qofshin ato të kota, të nxjerra apo të mbledhura nga kudo që shiheshin, kuptohen në vepra inerte, të cilat në art zunë vendin e imazhit të jetës. Si rrjedhojë, atyre u mungon Njeriu që dëshiron, flet dhe vepron sipas prirjes që ka e cila ndryshon tek gjithsecili; dhe prandaj atyre u mungon arsyeja e ekzistencës së vet. Këto të tjerat tonat: Përfaqësime “të përshtatura si duhet” (lat. *moratae recte*) të burrave dhe grave që kishin jetuar dikur dhe të cilëve ne u përshkruajmë shpirtat aristokratikë në veprime, në akte dhe në ligjërim, ata të bëjnë për vete po, dhe nga bashkimi i tyre marrim shembull dhe u ngjajnë atyre. Nga kjo pikëpamje, shpirtat e njërit apo tjetrit poet që krijuan ato imazhe, si ato ngjallnin ndjenja të larta dhe plot jetë rinore, na i lanë ne në poezi të pavdekshme ato shpirta që ende mbeten si Dielli për kombin shqiptar. Dhe nga ato këngë këtu në Itali, ku jemi shpërndarë, janë edukuar mjaft mirë shtëpitë tona të zhvendosura dhe të largëta nga qytetet e ndihen më të bekuara e të fisme.

Nga ana tjetër, ato rapsodi të Zotërinjve, qyteti dhe emri i të cilëve, ashtu si ato të Homerit, nuk njihen më, për ne mbeten si një pikturë në të cilën pasqyrohen jeta dhe fatet tona. Dhe duke i lexuar ato, e shohim ende veten, me dëshirë madje, në vendin e Musakit nga Delvinjo:

“Por nëse më shihni të kthehem në atdheun tim të rrënuar, mos u habitni sepse asnjëri prej jush, begatimin në dhë të huaj, në vend të këtyre shkëmbinjve tanë, nuk do ta dëshironte për vete dhe unë, që kam lindur në Delvinjo bashkë me ju, nga fati ynë i lagur me gjak fisniku nuk do të vuaj nëpër botë”.

Kjo gjë lindi në kohën që ishte edhe koha e artë e etërve tanë, që u ngritën për t'i bërë ballë hordhive të Fuqisë turke, për t'i sprapsur që të mos pushtonin dhe vinin në zgjedhë botën e krishterë dhe për këtë arsye sytë u kthyen të gjithë drejt Shqipërisë.

Dhe për faktin se ato ngjallnin frymën e guximit të lartë të heronjve dhe dinjitetin e shtëpive ku kishin lindur, u pritën me dashuri nga

fqinjët dhe ata që ishin larg; dhe më në fund në Itali të pritur së bashku me ata kalorës, të plagosur nga fati.

Në këngën popullore të Ilirisë dhe të Kalabrisë, jehona e atyre shpikjeve mund të dëgjohet edhe sot. Por në Greqi, këngët popullore që Faurieli dhe të tjerët kanë mbledhur deri më tani, pavarësisht nëse ishin me origjinë të përzier ose të çfarëdolloj origjine, janë, në pjesën më të madhe, më shumë sesa imitime, disa përkthime të varfra dhe të papërpunuara të atyre tonave. Dhe nga ato, mua më duket se shpikjet e kalasë së Atlasit, të Mandrikarlos që u ndeshën në Doralice dhe të Anxhelikës në një vend të izoluar me murgun e vjetër, kanë kaluar edhe në poezinë e kultivuar të Italisë. Këngët: *Ajri në majën e një mali, I kisha vënë unë kampet/bivaket (posta in italiano antico = accampamento militare o bivacco), Ishin në tryezë, U nisën për udhë nëntë të rinj.*

Të gjitha i korrigjova dhe i ndava në tre libra. Së pari historia e dashurisë së madhe shqiptare, e cila i meriton lavdet që morën këto Rapsodi nga Udhërrëfyeti i Torinos dhe të tjerët gjithashtu. Ndërsa, nëse e konsiderojmë si një simbol të Jetës - e cila lind si një lule mes mollëve (frutave) që gjen në tokë, dhe duke vjelur herë pas here nga Bota bëhet e përsosur në njohuri dhe dëshira, madje edhe midis mundimeve dhe gëzimeve duket pothuajse si perëndeshë; dhe është po ajo që pastaj përkulet dhe poshtërohet në kujdesin e atyre që i lindën në shtëpi të cilët më pas do t'i zënë vendin dhe madje edhe më shumë se ajo josh vëmendja e bashkëkohësve - asnjë gjuhë kurrë nuk lartësoi një përfaqësim të asaj Jete aq të qartë, të gjallë dhe të plotë, sa ç'bëri kjo e jona. E veçuar do të ndjekë historinë e fateve të popullit tonë, e ndarë më dysh, aq sa më duket vepra e dy duarve sepse në njërin, skëlqen dita e Skënderbeut, në tjetrën vijon beteja e zgjatur në More deri në rënien e Koronës nga ku Karli i V mori në anijet e veta dhe i solli në këto brigje shqiptarë e tjerë dhe të fundit. Në fund do të radhis ato këngë, të cilat mendoj se kanë lindur në gjirin e Jetës, e cila tekta kalon shëh gjithçka që është e qëndrueshme në Univers dhe e nxjerr në pah me anë të fjalëve të urta ose simboleve, të cilat pastaj një popull i huazon nga tjetri.

15. KËNGA MBI IBRAHIMIN NGA PEJA⁵⁰

Njëqind vjet pas arratisjes tonë nga mëmëdheu, Ibraimi nga Peja, Pasha i Shkodrës, me 20.000 të rinj nga Shkodra shkatërrouan të famshmin Pasavan Oglù i cili po i mësynte mbi krye me 60.000 ushtarë. Thurja e lavdeve ndaj heroit u këndua në Shqipëri asokohe: dhe ne, në përpjekjen për të nxjerrë në pah shpirtin e vëllezërve tanë dhe për të rindërtuar gjuhën e tyre të barbarizuar, po ju sjellim, të marra nga vepra e Jubanit, disa strofa të këngës antike, duke e shoqëruar atë me shënimeve gramatikore.

Zëri i lajmëtarëve përplaset në jehonën
e fushave dhe maleve, dhe u bën thirrje
burrave të fortë të vendit të bëhen gati
me armë, ata trima, të cilët për të madhin shpëtim
nxituan, u kthye me shenja të arta
në shtëpitë e tyre në çdo kohë, si dritë nga lart.

Të gjithë nxitojnë, teksa dita po zbardh për veteranët
armët shkëlqejnë nga çeliku rrezëllyes;
pushkët, shoqe besnike të Shqiptarit
shihen në duart e çunakëve që ende se kanë cikur
moshën burrërore. Të gjithë lëvizin si një dallgë e vrullshme
aty ku e zeza është më e kobshme dhe e zymtë.

Atdheu gjendet i rrethuar nga vështirësitë,
armiku i hedh atij zinxhirë të rëndë

⁵⁰ *Canto sopra Ibraim da Ipech, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. IV.

për ta mbështjellë nga sot e tutje.
 Por ata mbeten ende tek ai,
 që mendon ta poshtërojë, dhe ta shpjerë në turp e
 në çnderim: Kështu mendon ai, dhe kështu më kot bën plane!
 Dhe a do të donim ne të prisnim . . . ?
 ne ndalim vdekjen e Jetës,
 që atyre t'u ndihë vrapimin:
 Apo duam t'u lëmë pas turpin
 (etërve tanë dhe të rrimë veten duke pyetur)
 se sa vlerë kanë patur ato, se sa forcë?
 Vallë ne duam të rrimë duke folur, e të japim këshilla
 se ç'farë është për t'u bërë e për t'u zgjidhur.

Jo, jo: kjo tokë është nëna që na ushqeu,
 me qumështin e gjirit të saj ne u ushqyem;
 ajo është e reja e virgjër që për të dashurinë e mëkoi
 në shpirtrat tanë, e së cilës i thithëm butësinë e ngrohtë.
 Kush do të mundet, prej atyre që e duan me pastërtinë
 e një biri apo burri, të mos e shpëtojë me gjakun e tij?
 Nga britmat e mprehta që shpejtësia e erës Boreane i solli
 në pllajën e Lamës së Spahisë, nga fushat pluhuri që ngrihet
 si një re, lajmërojnë marshimin mbi armikun: dhe
 janë njëzet mijë shqiptarë nga Shkodra, si vetëtima. Ibrahim
 Mahmud Begoli si një luan u prin bashkë me çelikut;
 Dhe zëri dhe vlera e tij spikasin në mes të të pabesëve.

Kush është ai që dëshmon kaq shumë modesti në veshje
 dhe në sjellje ndaj shokëve të tij,
 që aq shumë terror frymëzon me shtatin e tij gjigand
 dhe vështrimin e shndritshëm? Ky është heroi
 më i dallueshmi që
 gjithmonë u shqua për trimëri.

Ripërtërihu o Pasvan, me radhët e ushtarëve të tu.
 Sa për boshnjakët, romeliotët dhe aziatikët
 janë tre herë më të shumtë në numër

nga ç'pandehja unë, ata do të sjellin çrregullime mes tyre;
dhe kështu qe: Ushtria jote u mund dhe u shpartallua,
u largua nga fusha dhe u ngjit në male.

Gjaku rrjedh me shkulme; rrjedha është e ndalur
nga kufomat e Jeniçerëve që patën merita
në dy, tre konflikte. Boshnjakët mbështesin luftën
dhe fëmijët e Karamanisë, por s'bëjnë gjë tjetër veçse
të rrisin rrisin masakrën e tyre. Ahmedi shuhet
ndër Osmanllinj, më i miri pas Pasvanit të tij.

Frika e panikut përhapet; ndalet tërbimi i betejës.
Pasvani i kërcënuar nga të tijtë, u paraprin me arratisjen, atyre që
Që më lehtë e morë udhën: Ejani o Pasvan, të
mësoni se çfarë janë luftëtarët, dhe t'i
dëshmoni Sovranit tonë, fundin tënd, ashtu
siç dinë të vdesin Shqiptarët, dhe se si dinë të luftojnë.

Flamuj të panjohur, rrinë ngatërruar mes atyre të fituesve:
janë trofetë e fitores. Fama e vlerës
tonë kudo ajo u shfaq. Kufomat mbetën
në fushën e betejës. Ngushëllohuni,
dhe këndonin o shqiptarët e mi,
se Zoti ishte me ne dhe na priu.

Ejani, o fëmijët e mi, o se bashkëshortë të dashur;
ejani që t'ju shtrëngo
me dashuri në gji, ndëkohë që pa ju të gjithë do të kishim
rënë në skllavëri; do të kishim humbur nderin tonë, dhe do të
kishim mbetur të braktisur. Ejani të shlodheni në gjirin tim
dhe mësojuni fëmijëve tuaj, sa të mirë jeni dhe si luftoni.

16. NGA LEGJENDA E SALARDIT⁵¹

Dëgjova se ai donte të botonte një pjesë me poezi, në të cilën shohim të parafrazuar, për kënaqësinë e popullit tonë, një sipërmarrje të hijshme dhe fisnike të marrë nga *Mbretërit e Francës*. Sepse asaj poezie, në frymën e saj të pastër, të shenjtë dhe në pasqyrimin, si të qe një pasqyrë, të ndershmërisë dhe besimit fisnik, ndaj Zotit, të nënshtruar dhe të gatshëm, të shpirtrave që jetuan në këto shtëpi tonat, asgjë nuk i ngjan atyre që lanë poetët më me emër të cilët jetuan më parë këtu në Kolonitë tona, ku është e qartë se ajo u zhvillua. As nuk mendoj se vetë poezia antike franceze, të ketë një tablo që për nga bukuria e thjeshtë e lakuriqe, të jetë më tërheqëse. Nga cili vend dhe nga cila kohë qe ai që e kompozoi unë nuk kam se nga ta di, as nëse duke kaluar gojë më gojë dhe shpirtra e grupeve të këngëve, ajo u rrit si në ide ashtu edhe në bukuri. Vetëm se gratë që po e këndonin më thanë se kishte ardhur nga Shën Sofia; ata as nuk e dinin të gjithën. Por i ngjan atyre të Costa Šaljas nga Shën Mitri.

Ditën që bënte shumë e nxehtë
dhe duke luftuar herë ngadalë e herë shpejt,
pasi duke u plakur forcën njeriut humbet,
mjeshtri u lodh duke punuar:
maja e shpatës e ktheu nga toka,
madje edhe mendja po i vinte vërdallllë.
Sepse, duke nisur që në mëngjes
kishin luajtur shumë gjatë.
Shkoi djali cirak e u hodh në shtrat;

⁵¹ *Ca përralesz e Salardit*, (Dalla leggenda di Salardo), *Fiamuri Arbërit* 1/3, 1883, p. 5-7.

mjeshtri i vuri mënjanë ato shpata,
 pastaj u shtri, dhe ra në gjumë.
 Por vini vesh atë që më pas i ngjau.
 Ai flinte dhe gërhiste me trishtim;
 i riu nuk mund të gjente prehje.
 E shihte që ora e gjumit po i shkonte
 as i solli freski të ëmbël qenies së tij;
 aq sa më në fund u ngrit nga shtrati,
 mjeshtri mjekrën ia preu.
 Mjeshtri, pasi gjumi e lëshoi,
 preku mjekrën dhe nuk e gjeti;
 mbërtheu shpatën që sjell vaj
 dhe drejt vendit ku është nxënësi, u nis me ngut.
 Nën gjumë ai po merrte frymë lehtë
 zambak i virgjër në huret e tij,
 teh shpate e magjepsur, e krishterë.
 Mjeshtrit i ra dhe iu davarit qëllimi,
 e ktheu shpatën në millin e saj;
 dhe u largua nga dhoma me dhimbje;
 babain e tij shkoi të takoi.
 - Zotëri kur djalin tënd më dhë të edukoj
 se do të kalonin në personin tim
 pjesët e Francës ju thatë:
 Tani Ai jetën, duke qenë se nderin,
 ai ma mori; dhe e gjithë Franca
 pret nga drejtësia që ta varë në trekëmbësh;
 në mënyrë që jo çdo njeriut të rritur me vonë në shtëpi
 prindërve t'u bëhet gjarpër.
 Mbreti u ngrys, por një betim
 kishte bërë, ai mbret dhe i krishterë;
 lejoi që djali i tij edhe pse ishte Zot
 lejoi që, i kapur, të çohet në vdekje,
 Nxorri gjithashtu dekret tëv ri,
 që për tre ditë anjeri të mos e shihte.
 Ushtarët pastaj u paralajmëruan
 të nisnin udhën të lehtë dhe të heshtur:

- Nëse Udhëngatërruesi nuk është duke fjetur
askush të mos i afrohet;
ç'vlerë ka ai përballë një komandanti
aq sa një milingonë që zvarritet përtokë.
Në gjumë e gjetën,
lehtë e lidhën dhe duke e mbajtur,
teksa e shtrëngonin më pas e zgjuan.
Nëna në shtëpi nuk është,
dhe as nuk di gjë:
Kishte një detyrim për atë djalë;
atë mbrëmje ai shkoi ta shlyente.
Dhe

Në rrugë u ndesh me trupën
që djalin i ri po ma sillnin për ta vrarë.
Nga larg i rrethuar nga trazira
atë po e zhvishnin nga rrobat mbretërore.
Mbretëresha: Një gabim shumë i madh është ky
Që të vdesë ky adoleshent sot ”.
Por teksa ajo i afrohej
i përlotur ai asaj iu lut:
- Mos më braktisni ju Zonja mëmë,
sepse mbreti im atë më ka dënuar
që unë të varem përpara se të ngryset dita;
dhe sonte nga mua asgjë më nuk do të mbetet,
Zonja ku djali e njoftoi
i ra të fikët dhe nga kali i saj ra . . .

15 dhjetor 1883

17. FJALË TË URTA SHQIPE⁵²

1. Dardha e ka bishtin prapa.
2. Kush ka gjizë dhe keca, del në gjyq dhe i japin të drejtë.
3. Fëmijës që nuk qan, nuk i jep nëna qumësht.
4. Aty ku del gangrena i vihet zjarri.
5. Kush e bën të keqen, e qan atë.
6. Dielli ngroh ata që shohin.
7. Dyqanxhiu shet atë që ka.
8. Prika e largët mbetet rrugës.
9. Peshku qelbet nga koka.
10. Qeni që leh nuk të kafshon.
11. Fjala e mirë zbut dhe gurin.
12. Gjuha kocka s'ka, por kocka thyen.
13. Djalli nuk ka lesh dhe shet batanije.
14. Nëse bëhesh dele, të ha ujku.
15. Dhi dhe mulli i ha ai që i sheh me sy.
16. Burri që mbledh me karrocë dhe gruaja që shpërndan me lugë, kanë të njejtin rezultat.
17. I rrit lisat era, i fryn lisat në fruta era.
18. Ku kërcen dhia, kërcen edhe keci.
19. Më mirë kokë miu, se sa bisht luani.⁵³
20. Më e afërt është kojshia, se sa farefisnia.
21. Pula që ecën kthehet me gushën plot.
22. E di qeni se ku fle lepuri.

⁵² *Proverbe t'arbëres*, (Proverbi albanesi), *Fiamuri Arbërit*, Corigliano Calabro, 15 dicembre, 15 gennaio 1883, 30 marzo 1884.

⁵³ *Po aty*, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. VII. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën. i red.). p. VIII.

23. Mos e prekni qenin që fle se ngrihet dhe ju kafshon.
24. Ec e gjej kallëzat e grurit në dëborë.
25. Kur mullixhinjtë grinden, shikoni miellin.
26. Njeriu nuk duhet të hajë të gjithë atë ka, as të thotë të gjithë atë që di.
27. Mali me malin nuk puqen por njerëzit mes tyre takohen.
28. Çdo prush ka tymin e vet.
29. Në ditën e Kandelorës, ashtu si fati, nga del delli andej thekon dëbora.⁵⁴
30. Kush i gjen cene gomarit e blen atë.
31. Mishi nuk ndahet nga thoi.
32. Çfarë të bësh do të gjesh.
33. Njëra dorë lan tjetrën dhe të dy lajnë fytyrën.
34. Kush i hap varrin tjetrit, bie vetë brenda.
35. Kush pyet gjen kudo.
36. Jo çdo mizë bën mjaltë.
37. Sa më larg të jenë preshtë, aq më shumë fryhen.
38. Jeta e njerëzve, një qiri, zbëhet nën dritën që ka në gji.
39. - Ik mal, se sëpata po vjen.
Mal Për sa kohë që pyka ndarëse nuk hyn.
40. Jo të gjithë ata që nxjerrin tingull janë arra.⁵⁵
41. Ai që lë rrugën e vjetër për të renë, e di se cilën e lë, por nuk di se çfarë gjen.
42. Pështyma që hedh lart do të bjerë në fytyrë.
43. Vetëm luga e di se çfarë tenxherja ka brenda.

15 dhjetor 1883

15 janar 1884; 30 mars 1884

20 nëntor 1885

⁵⁴ *Po aty, Proverbi, Nr. 6*, 30 marzo, 1884, p. VIII.

⁵⁵ *Po aty, Anno II, Nr. 7, Cosenza*, 20 novembre, 1885, p. VIII.

18. GAZETË BOTËRORE

Ne jemi të lumtur t'ju bëjmë me dije se *Fiamuri* ynë, i sapolindur, duket se do të bëhet një gazetë botërore. Është e kërkuar në Francë, Gjermani, Austri, 12 kopje të tij gjenden tashmë në Amerikë, 3 në Azi, 12 në Rumani, 35 në Turqi, 11 në Greqi, 50 në Egjipt. Ky vlerësim është sidomos falë Bibliotekës së tij, siç shpresohej aq mirë në këngët kombëtare.

Këto kanë qenë objekt i studimeve të Princeshës Elena Gjika, i përkthimeve të shkëlqyera në vargje gjermane nga znj. Xhuzepina, Baronesha Knorr, përpos versioneve poetike italiane të Akile Torelit, Demetrio De Gracias, Ruxhiero Ruxhierit, të cilat rishfaqen në një dritë më të mirë tek *Fiamuri*, ato shpërndahen nëpër Europën e kulturuar, në përkthime fatlume, si ato të fundit fare në gjuhën frënge dhe atë magjare, nga filologu i madh Podhorsky i Akademisë Hungareze: i cili, duke i shkruar poetit sicilian T. Kanixaros, e pyeti nëse botimi i *Fiamurit* vazhdonte ende: “Sa i lumtur do të jem (shtoi) të kthehem në burimet e gjalla të poezisë popullore shqiptare”. As nuk mund të heshtim ndaj mendimit pohues të G. Tomazeut, i cili shkroi nga Firence në datën 3 të këtij muaji:

“...Dhe kjo tani shpaloset në një mënyrë të admirueshme me gazetën. Çfarë stili i thjeshtë dhe i thellë i Këngëve popullore! Çfarë thesari i poezisë dhe traditave! Çfarë dëshirash delikate dhe të ndershme! Kur e lexon duket sikur je në një botë ndryshe nga kjo e jona dhe ndoshta është shumë ndryshe që të fuqishmit ta kuptojnë atë. Edhe në këtë drejtim, Zoti De Rada ka mjaft merita për Shqipërinë dhe Europën.

15 janar 1884

19. R I M A⁵⁶

Rima, e cila në gjuhën tonë nuk përshtatet, sjell gjithmonë shtrembërimë në Gramatikë; dhe kjo i ndodhi Varibobës, dhe deri diku edhe Kostas nga Shalja, një poet popullor. Po kështu bëri që autori i këtij ditirambi fisnik të vendoste *e bårdhe e piotte* në vend të *e baardh e piott'*, dhe në shumës *gjérdhe* si zëvendësues i *gcardhe*. Nuk mund të thuhet se sa shumë kjo gjë e dëmton njohjen e vërtetë të gjuhës sonë. Në të mbiemrat e gjinisë femërore që tregojnë një gjendje e *bhaard*, (natyra e të cilave është bardhësia), dhe *caljther* (bojëqielli), *epiòt* (e plotë) etj. nuk dallojnë nga mbiemrat e gjinisë mashkullore *ibaardh*, *i piot* përveç *e-së* që zëvendësohet me *i-në*. Një rast tjetër është ai i fjalëve që tregojnë shndërrim, të cilat nuk paraprihen kurrë nga nyjet *e* dhe *i*, por ku shtesa e *e-së* fundore bën që gjinina femërore të përftohet nga gjinia mashkullore, *bardhulôre* që shkon drejt të bardhës, nga *barduloor* objekt që zbardhohet.

Sërish këtu rima e vendosi poetin përballë një udhëkryqi ose një kontradikte duke zëvendësuar a *bën* (bën), me *bëën* (bëri), ose duke ndryshuar *hëën* (hëna), në *hën* që nuk është fjalë shqipe.

30 maj 1884

⁵⁶ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania) Anno I, nr 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. IV.

20. ORGANI KOMBËTAR

Një nga periodiket më të njohura europiane, Revista *Mèlusine* në Paris, në numrin e saj të 5 qershorit, e ka nderuar *Fiamurin* me artikullin e mëposhtëm:

“Në një koloni shqiptare në Itali shfaqet Gazeta e Z. De Rada. Ajo është organi kombëtar jo vetëm i kolonive shqiptare të Italisë, por edhe i vetë Shqipërisë, sot ende një provincë turke. Pikërisht nga kjo provincë dhe tokat fqinje të vendosura në bregun lindor të Adriatikut vijnë këta kolonë, paraardhësit e të cilëve e braktisën atë pas pushtimeve turke.

“Sot kolonitë shqiptare të Italisë numurojnë 70.000 banorë sipas disave, ndërsa sipas disa të tjerëve 100.000, prandaj ata janë një nga elementët etnografikë të huaj më të rëndësishëm që gjenden në Itali”.

“Ju mund të pyesni veten pas kësaj hyrje, se në ç’aspekt gazeta e një kolonie shqiptare i intereson francezes *Mèlusine*? Ne përgjigjemi: për shkak të materialeve të Folklorit (dashuria për popullin) që përmban. Tetë faqet e fundit të Gazetës, e cila numëron vetëm 16, kanë një përbërje të veçantë dhe i kushtohen *Bibliotekës Shqiptare*, domethënë Folklorit, Rapsodive dhe veçanërisht këngëve popullore. Kjo është pjesa që na intereson kryesisht . . .

“Deri tani ne kemi vetëm 6 numrat e parë, domethënë pjesën e parë dhe fillimin e pjesës së dytë të Rapsodive, gjithsej 40 fragmente. Për të dhënë ndonjë ide të kësaj poezie, na lipset të kujtojmë leximin e bërë para disa vitesh të përmbledhjes së lartpërmendur”.

“Një origjinalitet befasues, një forcë shprehëse që njeriu nuk mund ta gjejë më veçse mes popujve me një jetë epike ose që të paktën tradicionalisht e ruajnë poezinë që i ngjan epopesë, u japin këtyre

këngëve një karakter të tyrin dhe u japin atyre një ngjyrë dhe një shije të veçantë.

“Nëse hedhim një sy në formën dhe sfondin e këtyre prodhimeve poetike, ne vërejmë se vargu ka dy metra të ndryshëm që përkojnë deri në një farë pike, siç thotë z. De Rada, me njëmbëdhjetë- dhe tetërrrokëshat italianë.

“Si në pothuajse të gjitha këngët epike popullore, ndarja në strofa nuk ekziston dhe pikë; ashtu si edhe në këngët serbe, vërehet mungesa e rimës; çdo varg që formon një fjali të plotë e përjashton kalimin e kuptimit nga një varg në tjetrin; përkundrazi palilogjia është e shpeshtë. Epiteti që gjatë gëlon, si për shembull tek Iliada dhe tek këngët serbe, këtu është shumë i rrallë (le të themi se e njëjta gjë vihet re edhe në këngën e Rolandos).

(vazhdon)

30 maj 1884

21. PARAGJYKIME TË SHQIPËRISË SË VERIUT⁵⁷

1. Ata besojnë se ka njerëz që lexojnë në kockat që pulat kanë në gjoks atë që duhet të ndodhë.
2. Nëse janë duke qëlluar dhe një grua kalon pranë e ata duhet të ndalojnë, thonë se nuk do ta godasin shënjestrën, sepse u është prerë rruga.
3. Nëse ata po shkojnë diku dhe një lepur, ose dhelpër, i pret rrugën, thonë se është një shenjë e kobshme dhe se atyre nuk do t'u vijë asnjë e keqe.
4. Kur kali është duke ngrënë elbin në thesin që e ka të lidhur në krye dhe shtrihet me shpinë drejt mullarit me kokën nga dera, thonë se do të vdesë i zoti i shtëpisë.
5. Thonë se është keq edhe kur kuis qeni, dhe nga lloji i kuisjes se tij mund të kuptohet nëse do të vdesë dikush i shtëpisë, apo i mëhallës.

30 shtator 1884

⁵⁷ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr 11 , Corigliano Calabro, 30 settembre 1884, p. V.

22. REALJA DHE IDEALJA NË PASQYRIMIN E BOTËS⁵⁸

I.

Ajo që në Greqi quhej Ideale (*Ajo që duhet të jetë*), e cila shfaqej në jetën përreth ose në imazhin e së cilës ne ngrihemi, në të vërtetë nuk ishte aspak diçka e huaj për shpirtin: në kuptimin që frutat nuk janë të ndryshme nga trupat që ushqehen me to.

Ne demonstruam diku tjetër se cilësitë e shpirttravenjerëzore si “Drejtësia”, “Afeksioni”, “Përunjësia” e të tjera si këto, përhapin një aureolë hijeshije mbi faktet, thëniet dhe tërë personin. Dhe tashmë kjo gjë nuk bie në kontrast. Dhe po kështu të gjithë shohim se në qytete këto janë cilësi që lidhin shpirtat bashkëkohorë me njëri-tjetrin. Sepse nëse ato (vlerat) shkëlqejnë jashtë nga brenda, edhe tek fëmijë të shtëpive të huaja, ne na heqin orë nga tonat dhe na lidhin me ta: dhe kur i shohim ata të perëndojnë mes reve ose të zhduken, ata na zgjidhin nga laku pothuajse i konsumuar.

E më tutje në paraqitjet e jetës ato që na tërheqin në zona më të pastra dhe më të shëndetshme, duke na bërë ta harrojmë fatin e rëndë, janë Ndershmëria, Mirësia, Mirënjohja ndaj Zotit etj., të cilat shfaqen në faktet dhe thëniet e zotërinjve fisnikë dhe të njerëzve: Akili, Edipi, Neoptolemi, Antigona, Sita.

II.

Tani rritja e këtyre cilësive që na zbukurojnë edhe nga jashtë, na bën t’i afrohem Idealit të jetës njerëzore; dhe këtë rritje e gjejmë ku më shumë e ku më pak, brenda shtëpive. Dhe nga e pakta apo e shumta e asaj çka shohim tek një njeri apo tek tjetri, ndryshojnë, në qytetet e të gjitha kombeve, kushtet e familjeve.

⁵⁸ *Il reale e l'ideale nelle rappresentazioni del mondo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno I, nr. 11, Corigliano Calabre, 30 settembre 1884, p. I.

Ekziston para ne të gjithëve një shtresë dhe është më e ulta, ku Jeta i ka këmbët. Në këtë kat, kjo ka të mirat e gjërave që ha dhe pi, ngrohet dhe strehohet etj. dhe të gjitha i përdor me një ndjenjë të hareshme, ashtu siç është e hareshme martesë me të cilën lidhet, duke u ripërtërirë pambarimisht. Ata, për të cilët vlera e jetës gjendet në kënaqësinë e fitimeve që sjell ose në llamburitjen e arit nga kudo nxirret, dhe bashkë me ta pastaj turma të cilën varfëria e shndërron në vuajtje e mundime që nuk i lë më të ngrenë sytë drejt botës - dhe sytë iu dhanë për të parë madhësitë dhe për të pasur besim - këta të bashkuar e mbushin këtë kat. Edhe këtu Ndershmëria, dhe Mirësia, dhe Modestia deri më sot – të bashkuara kështu ilustrohen dhe pozojnë së bashku pa frikë dhe dyshim, afër në një fole; por ata janë ende pa krahë dhe lëkundën vazhdimisht nga fryn era e të Mirave. Ky kat i një realiteti të vërtetë, përmban, do të thosha, ato që kanë mbetur në gjysmë të rrugës drejt përsosmërisë njerëzore; sepse edhe mendjet atje janë pa shumë njohuri që do t'i ndriçonin ato. Edhe Jeta në mes të të Mirave që ka përreth saj shfaqet si e mësuar me botën, si në çifligun e vet, megjithatë gjithmonë me zemrën e rrëmbyer nuk e di nga çfarë tjetër, dhe të konsumueshme me ato gjëra të dobishme dhe të trishtueshme në fund të saj.

Në këtë qiell të argjilës njerëzore, në Greqinë e lashtë (Helas) dhe në Lacio kryesonte Hyu i Nimfave, i barinjve Satirë, i Çereres bërë me grurë dhe Baku këmbë përmbi këmbë sipër një fuçje.

Por në mes të këtij populli me qafë të përkulur (*incurvicervicum*) ka nga ata që kishin një vend pushimi të shtruar nga pleqtë e tyre; dhe shumicës prej tyre mendja iu qartësua lehtësisht nga dituria dhe shpirti iu edukua nga imazhi i Zotërinjve të pasqyruar në libra ose piktura të tjera; dhe se ata të Ndershmit gjithashtu i gjejmë të nderuar ose të gjallë në grumbullimet e sojit të tyre. Fjalët muzikore të mençurisë, të tilla si jehona e të përjetshmes, u kumbojnë vazhdimisht këtyre në gji; vlerësimi që ata gjejnë te shokët, dhe pastaj besimi, modestia dhe të tjerët të Ndershëm, kaq të lulëzuar në epokën e re, ndezin tek ata një dashuri në të cilën i përmyt gëzimi për të dashur njëri-tjetrin, gati sa nuk buron nuk di nga cilat male që prekin qiellin. Dhe në vetvete janë të ndërgjegjshëm “se njeriu nuk jeton vetëm me bukë”. Këto janë Bujarët (*Bùgliari*) e qyteteve të të gjitha kombeve; dhe më shumë shkëlqen dinjiteti i Idealit të përafërt, aq më shumë nderohet ai nga bashkëqytetarët. Për shkak të turmave që janë përreth tyre, për shkak të tregtisë së thënieve dhe veprave, në atë përsosmërinë e idealit

të tyre të përbashkët ata ndihen si në një botë më të mirë dhe të gëzuar nga erërat të largëta, ata nderohen.

Në Heladë dhe Lacio besohej se kjo Aristokraci e njerëzve kishte perëndi të pavdekshme në pallatin e qiellit ose në majat e maleve, që mendonin për të “Atin e Universit, Fjalën fituese, Diellin, Afërditën, Hënën e virgjër dhe bijat e Mnemozinës së zërave që të mbushin me lumturi qiellore.

Kjo gjendje e lartë është po aq e vërtetë dhe reale sa edhe ajo tjetra më e ulët. Dy motra, të dala do të thonim nga ato dy gjendje, qëndruan një ditë para Zotit Krisht, i cili i tha plebejes: Marta, Marta lodhesh për shumë gjëra; e megjithatë vetëm njëjërën e ke të nevojshme: Maria motra jote ka zgjedhur pjesën më të mirë, e cila nuk do t’i merret”.

III ⁵⁹

Në këto gjendje të argjilës njerëzore që qëndrojnë para nesh, shfaqet qartë një rritje e Shpirtit në cilësitë e tij dhe tek disa një përafrim pothuajse drejt qenies së përsosur (*idealit*). Duke qenë se kishin dhe ndoshta kanë ende nga ata që, të mbledhur nga dhimbjet kalimtare, jetojnë në një kujdes në të cilin kumbon shërimi hyjnor i së Mirës pa kufij. Dhe të jetuarit mirë të njeriut konsiston në arritjen e qenies së përsosur, të cilën Jeta na e mëson gjithmonë sipas nevojës, sepse në atë mënyrë është e shëndetshme.

Mandej cilësitë e shpirtit, të shndërruara në fakte, bëhen morali i njeriut dhe sipas asaj që duken nga jashtë e zbukurojnë. Kështu Bukuria dhe i ashtuquajturi Virtyt janë e njëjta gjë tek njeriu. Asgjë tjetër përveç paraqitjes së këtyre cilësive nuk përbën Bukurinë e Botës. Sepse, në këtë, cilësitë e shkëlqyera të Zotit krijues që pasqyrohen përbrenda, shfaqen kudo në Jetë - në pastërtinë e kthjellët të qiellit, në lulet e reja ku shohim pothuajse një ripërtëritje të përjetshme, në jehonën e zërave që na shoqërojnë dhe të atyre të Natyrës, të cilat i përgjigjen pothuajse me keqardhje fatit tonë jetim - ato janë, do të thosha, manifestime të bukura që na rrëmbejnë shikimin. Të diturit, që deri më sot nuk e vranë mendjen për këtë ekzistencë, e ndanë Moralën nga e Bukura në Jetë; kur u përpoqën t’i themelonin ato jashtë cilësive të lindura të shpirtit, vunë mbi to themele ëndrra të përvuajtura që u rrëzuan aty afër.

⁵⁹ Po aty, Anno I, nr. 12, Corigliano Calabre, 30 ottobre 1884, p. III.

IV.

Se, që një rritje dhe përmirësim i tillë bëhet përmes mësimave të prindërve, të gjithë e pohojnë. Dhe po për këtë qëllim janë edhe Shkollat gjithashtu të cilat prindërit, që ose nuk e dinë ose nuk mund t'i mbushin, vendosin mësues që t'i përfaqësojnë ata.

Megjithëse është një fjalë e urtë e të gjithë popujve që thotë se më shumë se sa fjala, është shembulli i ndershëm i burrave afër nesh që e ushqen dhe e ndërton shpirtin. Ne shohim që nga ushqimi dhe pijet trupi përfton elemente të ngjashme me ato të asaj çka ai kushton dhe përjetojmë ashtu si edhe shpirti përmes mënyrave të tij hyjnore - syri dhe dëgjimindjesitë e botës i prekin e i filtrojnë – ushqehet dhe rritet i vërtetë, dashamirës dhe i përkorë brenda vetes me llojet e drejtësisë, etj., që shfaqet qartë te burrat e gjallë, ose që reflektojnë në to imazhe të frymëmarrjes së gjallë, ose që rrezatojnë nga shfaqjet e botës.

Prandaj është Arti që ekspozon në qytete imazhe burrash të afruar me idealin e tyre dhe që shkëlqejnë nga hijeshija e tij, ndihmon në rritjen e cilësisë së shpirtit. Dhe këtu lind çdo çmim i këtij Arti. Dhe kur shpirti rri mbi trup, aq shumë lart zanateve që paketojnë ushqime dhe rroba të shëndetshme për Jetën, është nderuar gjithmonë Arti që ushqen dhe e mban Entellekinë⁶⁰ hyjnore, e cila duke qëndruar e mbështetur në këmbë, merr frymë në Botë. Pra, që nga kohërat e hershme të atij Arti e pikturoi ballin të rrethuar me kurorë karthjesh të pavdekshme.

V⁶¹

Buka e epërsisë së kombeve, që në kohën e tyre sundonin mbi të tjerët, ishin të Ndershmit që ushqenin shpirtat e tyre në mënyrën që në çdo qytet të jenë ata buka e të Virtytshmeve që aty nderohen. Prandaj në popujt e Greqisë dhe të Romës, të cilët e kishin shpirtin, por shpejt e zëvendësuan atë, përfaqësimi artistik i botës qëndronte para shtëpive si një pasqyrë në të cilën pasqyroheshin heronjtë që mishëronin idealin. Duhej që varësia nga vetja, liria e atdheut dhe më pas lavdia të ishin gjithmonë përpara adoleshentëve, që me to të ushqeheshin dhe të rriteshin të ndritshëm për nga fisnikëria; duke vazhduar kështu jetesën

⁶⁰ Vjen nga *entelechia* (greq.), koncept filozofik aristotelian, *concetto filosofico aristotelico* në origjinal. (Shën. i red.).

⁶¹ *E me-kjena te gjela e tech te gjarat e saj* (L'ideale nella vita e nelle rappresentazioni di questa), *Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania)*, Anno II, nr 1, Corigliano Calabro, 10 aprile 1885, p. VI.

e shkëlqyer e krenare të baballarëve të tyre. Kështu që ndërtesat, pikturat, statujat, këngët duhet t'i bënë jehonë diçkaje të pavdekshme dhe bukurisë që përmes saj rrezatonte; dhe nga e cila ka depërtuar dhe ka kaluar balta e dheut, të mos harrohej pas gjërave të vdekshme që trupi i vdekshëm formon dhe i le të bien.

Le të kujtojmë se si në Festën e madhe të Heladës, gëzimi i ditëve të Kuvendit kombëtar vinte nga admirimi i shpalosjes së forcës dhe bukurisë së trupave të atdheut të tyre të ri; nga dëgjimi i rapsodive të Homerit dhe historive të Herodotit - pamje të ndërgjegjshme dhe të kthjellëta të Fateve të Jetës; dhe nga të ndjekurit me mendje derisa t'u humbiste nga sytëfati i rëndë i fëmijëve të Hyjnive të Olimp, të cilët, në tragjedinë athinase, fisnike mbi të gjithë të tjerat, i panë të kalonin të egër e të pamposhtur duke marrë me vete zemrat e prindërve të tyre. Dhe nga gjërat që kanë parë e kanë dëgjuar shpirtat e tyre u mbushën me frymëzim hyjnor dhe të lumtur: dhe në këtë të sigurtë portretizoheshin në shtëpitë e tyre, Perëndi të vërteta të saj.

Në rrëfimet që sot u ofrohen popujve europianë - të cilët më kot e mbajnë në gji fjalën e thellë të Zotit, -përmbajnë mund të thuhet litarin e Vdekjes: Veshja e trupave të pallateve, qerre që i largojnë shpejt nga orët e jetës së tyre dhe i shpërqëndrojnë në vizione të larmishme, ushqim e pije, dhe pastaj shtretër të butë ku të bien në harresë. Çfarë ëndrrash! dhe më pas mëngjese që i davaritin ato përgjithmonë. Është e vërtetë që së shpejti edhe Helada - Roma zgjati më gjatë - ra në fundin ku Europa i ka këmbët, domethënë në kultin e të Mirave që i sjellin dobi trupit. Emigruan prej saj fëmijët e familjeve, ushtarë apo shërbëtorë në Azinë e pasur që paraardhësit e tyre i kishin vënë në këmbë; dhe të përulur prisnin nga duar të pasura që ishin atje. Por kjo dekadencë ishte me shumë dhimbje për ata që kishin lindur në periudhën e bukur antike. Dhe në teatër përkrah jetës së lartë, të përfaqësuar në tragjedi, që e pranishme edhe ajo e varfra e të Varfërve, që i merr nderin njeriut. Ata që e shfaqën ishin, ashtu si poetët e tragjedisë, plot me ndjenja dhe vlerësim për cilësitë që shërojnë dhe nderojnë shpirtin; dhe merita e komedisë së Aristofanit qëndron në idenë e atyre cilësive, që del në pah nga mungesa e tyre, siç del në pah nga hija objekti që e projekton atë. Ato nuk i ushqenin shpirtat me pamjen e të Ndershmëve, por vinin në dukje plagët e kobshme të mbetura në atë Jetë që vyshkej nga zhdukja e atyre.

Pjesa e jashtme tërheqëse e këtyre dy Jetëve - njëra që ofron në vetvete idealin njerëzor dhe tjetra që është pa cilësitë e lindura të njeriut, madje përtej të zakonshmes në shtresën e ulët shoqërore - ishte imazhi i qetë dhe real të vetë atyre në pasqyrën e fjalës. Sepse duke ngjyrosur të vërtetën, Arti quhet poetik.

VI⁶²

Ndoshta në botën e komedisë tiparet e burrave portretizohen më të larmishme dhe të dallueshme, sepse sa më shumë që njeriu të ketë cene të vetat aq më shumë mbetet, le të themi, si i prerë me sëpatë (i vrazhdë): kështu ne hasim ata që, pa kurrëfarë droje, imitojnë lehtësisht një të deformuar apo tjetin, por për të imituar cilësitë e bukura nuk munden. Prandaj Falstafi na mbetet më i skalitur në mendje sesa Romedo, Tersiti më shumë sesa Diomedi. Sepse qasja ndaj idealit na afron me blerjen e kësaj apo asaj vlere që shoqërohet gjithmonë nga të tjera, ndërsa e mira lipset që të jetë edhe e drejtë, etj; dhe për shkak të këtij bashkimi ku të Ndershmit mblidhen, nuk është e lehtë për çdo njeri të dallojë të ngjashmit e Apollonit nga ato të Adonisit dhe Antinudit; dhe vazhdimisht shohim që mjeshtrat e disiplinave që nuk kanë lidhje me poezinë, vetëm tek maska e njohin karakterin.

Por edhe imazhi i Jetës së poshtme, që shumica prej njerëzve bëjnë së bashku, nëse shfaqet para nesh me besnikëri, drejt vetes na tërheq mendja dhe zemra që e kuptojnë atë me ëndje, qoftë për shkak të pasqyrës së kthjellët në të cilën pasqyrohet (si në fjalimet e pastorëve të Teokritit), qoftë për shkak të së Mirës që ajo gjithashtu përmban në vetvete, dhe kështu Vdekja shkëput prej nesh me pikëllim, fatlumë e fatziun sëbashku.

Pasqyra, që nga kohrat antike mbeti më e pastër nga kënaqësitë e shqisave, është në Eklog; por në Elegji kënaqësia, që buron prej tyre, shoqërohet me një reflektim më të madh. Në kohën e sotme duket se ajo botë sensuale po reduktohet në Pornografi.

Në pallate (brenda të cilëve fisnikëria krenare e shpirttrave, fyente më shumë se gjithçka tjetër krenarinë e Zotërve të tyre, dhe ku jeta shtangej pothuajse si në burg, shpirti poetik u ndal në imazhin e

⁶² E Kjéna ej e mekjena tech të gjârat e jettës (Il reale e l'ideale nelle rappresentazioni del Mondo), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr 8, Cosenza, 20 dicembre 1885.

fushave nga ku kënaqësitë buronin në çdo anë; fushat e largëta të lëna në harresë nga shtëpitë që Fisnikëria e qytetit trazon. Por në të vërtetë do të donim që fushat të ishin një port i bukur, jo të zhuritura nga i nxehti, as nga shirat që i lajnë ato në ditë të vështira, të shfrytëzuara dhe të trishtuara. Dhe ndjejmë se jeta e fshatit, në të cilën Eklogu na përfaqëson, tanimë nuk është ajo e vërteta në të cilën ndodhemi. Dhe as njeriu më nuk e mendon se zhveshja e botës së jashtme nga ashpërsitë e saj, siç do ta lipste Jeta, është Ideali i kësaj; dhe as ajo çka ne shohim në të janë realiteti dhe ideali të marra së bashku.

Por gjithmonë ujërat e freskëta dhe hijet në verën e ndezur, fryma e zjarrit në ditët me borë apo të tilla stimuj, për të qenë burime gëzimi, nuk kanë dhe as nuk sjellin gëzimin, që sjellin fytyrat e Drejtësisë dhe Dashurisë fisnike, që ngadhëjnë mbi fatin e u sjellin shtëpive lumturi dhe respekt. Dhe kur bukuria e pavdekshme dhe gëzimi që buron prej saj e ndriçojnë jetën më shumë sesa kënaqësitë e shqisave, si Epika ashtu edhe Tragjedia, dëshmitarë të së cilave jemi, qëndrojnë më lart se përfaqësimet e tyre.

VII⁶³

Ndoshta Ideali i çdo fytyre të botës së jashtme do të ishte, ajo diçka që, nga ato, si një fjalë e heshtur, venitet dhe vjen të ngjishet vetë në mendje: Fjalë që jehojnë aty-këtu nga pamjet e Natyrës të kujtuara më shumë në Elegji, sesa në pikturat e Eklogut pothuajse aspak inteligjente.

Ndërkohë që këtu poshtë gjenden e qeshura dhe lotët që vijnë nga thellësitë e jetës, dielli dhe shiu nga thellësitë e botës: erërat që vijnë nga copra qiejsh të panjohur, deti gjëmëmadh dhe zëra të tjerë të së përjetshmes së dëshiruar e rrethojnë realisht jetën e përlulur dhe të prirur për të mbijetuar, e lartësuar në të Ndershmin e saj. Shpirti që, i rrëmbyer nga ato zëra, i ndjek dhe pothuajse i shkëputur nga vetja përhumbet në to në ekstazë, kështu Dashuria që bukuritë e shenjta ndezin dhe shpien në qiej, është një fe që nga altari i Jetës tokësore shkon tek Zoti nga i cili buron çdo bukuri, çdo e përjetshme dhe e pafund. Dhe prandaj në krijimet e mendjes dhe në dashuri, njerëzit e harrojnë veten e tyre si të qenë para Parajsës: dhe për këtë arsye Artistët

⁶³ *Il reale e l'ideale nelle rappresentazioni del Mondo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr 9, Cosenza, 20 gennaio 1886, p. VII.

e vërtetë ndjehen si të qenë fëmijë të Zotit. Dhe pastaj ajo bukuri në Jetë dhe ato zëra të së përjetshmes na bëjnë të zbulojnë atë çka është hyjnore përtej botës, dhe na bëjnë ta ndjejmë aromën e kopshteve të magjepsur aty afër: ky është përmbushja qiellore e poezisë njerëzore. Por kjo transparencë është tipike e Jetës së krishterë: në kohërat antike ai iu shfaq vetëm Sofokliut dhe Pindaros në disa raste.

(vazhdon)

**30 shtator 1884, 30 tetor 1884,
10 prill 1885, 20 dhjetor 1885,
20 janar 1886**

23. RËNIA E MBRETËRISË SË SHQIPËRISË⁶⁴

Parathënie

Në mungesë të Varibobës, shumë mbështetës të *Fiamurit* donin të zëvendësonin *Milosaon*, aq të dashur për Jetën e re që përfaqëson. Por, autori nuk pranoi dhe kërkoi vendin për akordet heroike që ai thotë se ka mundur t'i nxjerrë nga telat, të këputura aty-këtu, të gjuhës sonë. Dhe ia kaloi Komitetit pjesën e parë ose, do të thosha, Portën e madhe të *Skënderbeut të pafat*; në të cilën ai shfaqte tablo të një jete madhështore dhe të dhimbjeve të mëdha. Por për shkak të saj, kanavaca ishte shumë e madhe; kështu që njëra pjesë ose tjetra i shkëputeshin vështrimit, ajo u nda më vonë: dhe pesë piktura në vetvete mirëpresin në gjirin e tyre të gjithë atë jetë fisnike që një Zonjë e madhe e jona e përshëndeti si “Agimin e Ditës së Shqipërisë”. Ajo Jetë ka gjithashtu, në fizionominë familjare, diçka ndryshe nga poezia e huaj: duke qenë se në të, ashtu si edhe në *Rapsoditë kombëtare*, epopeja është shkrirë me dramën: dhe harmonia e bukuria e botës që imitohet në vetvete bën gjithashtu që ta duash atë.

Për këtë propilë të Skënderbeut, autori thotë se e ka ilustruar ashtu siç donte dhe ai kurrë nuk do t'i rikthehet më, siç nuk do t'i kthehet më as *Milosaos*; meqenëse e ndjen se nuk ka ç't'u shtojë më shumë. Dhe ne i besojmë pas këtyre lëvdatave të pakursyerandaj kësaj peme të gjuhës Shqipe, me lule dhe fruta të ëmbla, secila “ngrihet e shquhet e lartë në qiell”: ne kemi besim se tani që kjo u pa, do të thoja, vlerësohet e pastër, do të duhet të mbajnë frymën edhe ata që prisnin që kombi ynë, siç i ka lënë gjithmonë ata që vinin tek ai të flisnin në vend të tij, kështu që atij nuk do t'i duhej më të fliste në fund në çastin kur ato do ta mbysin.

20 gusht 1885

⁶⁴ *La caduta della Reggia d' Albania: Prefazioni, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 4, Corigliano Calabro, 1885.

24. NJË GJYKIM

Një gëzim të vërtetë patëm këto ditë nga një botim i ri i Herrigut, (*Arkivi për Studimin e Gjuhëve Moderne*), i cili botohet në Berlin dhe ku filologu i famshëm H. Buchholtz vazhdon të na nderojë duke treguar artikujt që përmbahen në Vitin II të *Fiamurit*, deri në numrin VII. Është mirë të shënohet ky paragraf i përmbledhjes së tij të thukët: “Gjysma e dytë e tre numrave të parë përmban Fjalorin Shqip të Rapsodive Kombëtare, i cili filloi të botohej pak më parë (Viti I, numri 12): *një suplement tejet i vyer*”.

Po me të njejtën simpati dhe gjykim të përshtatshëm qe shumë i qartë Profesori i Universitetit të Napolit, Xhustiniano Nikoluçi, i cili u shpreh në lidhje me përpjekjet tona: “Ato i përshtaten më së miri duke gjykuar Epiriotët, pra Shqiptarët, Pellazgët e lashtë të Greqisë dhe Italisë. Nuk duket, nga kaq shumë fakte të mbledhura deri më tani, se mund të ketë më shumë dyshime. Lipset, për të përfunduar historinë e kësaj rrace fisnike, të studiohen mbishkrimet euganeane dhe mesape, të cilat deri më tani kanë mbetur të pashpjegueshme për studiuesit tanë. Nëse do të mund të shpjegoheshin ndonjëherë për shqipen, do të hiqej një vello mbi historinë antike të Greqisë dhe Italisë dhe Pellazgët do të rimerrnin atë vend të lartë që meritojnë në historinë e qytetërimit botëror”.

20 prill 1886

25. NJË GAZETË

Doli në dritë në Firenze një gazetë e drejtuar nga e nderuara Zonjushë Biçe Miralja dhe e redaktuar nga zonja fisnike në shoqëri. Ashtu si *Vjollca* (Mammola), nga e cila mori emrin, është ëmbëlsisht aromatike dhe qëndron, mund të thuhet, veçmas dhe jashtë stinës në të cilën shumë lule të larmishme ngatërrojnë shikimet. Gjërat ju thuhën në mënyrë të ndjeshme; dhe prirjet njerëzore dhe natyra e jashtme vërehen dhe portretizohen me besnikëri. Mjaft dobi do t'u sillte lexueseve të Kalabrisë, të cilave do t'u këshillohej të bëheshin anëtare.

30 maj 1886

26. SHTYPI I VJENËS

5 janar 1887

Dëshmi për të kujtuar familjen Sina në Shqipëri, të cilës ajo i përket dhe midis të cilave është nderuar gjithmonë, jepen nga dy këngë popullore të botuara nga Jeronim De Rada, Homeri Shqiptar, në revistën e tij “*Fiamuri Arbërit*”. Kjo revistë, një shenjë e përparimit të kulturës në atë vend malor kaq larg nesh dhe historia e të cilit fillon në kohë shumë të lashta parahistorike, apo ndoshta dhe në ato të miteve, ka gjetur një interpretues të aftë dhe të mirë te Podhorszky, anëtar i Akademisë Mbretërore Hungareze, etimolog i palodhur që jeton në Paris dhe kontribuon në redaktimin e kësaj reviste të parë shqiptare.

Kush ka parë qytetin e egër romantik midis S. Maria di Leuco dhe portit të Vlorës (Avlona), kaq i rëndësishëm në kohën e romakëve për lundrimin nga Brindisi në Korfuz (Corcira); kush e sheh nga deti këtë fshat me malet me dëborë të Himarës (Chimara) sheh brigjet e thepisura mbushur me një mrekulli sublime të egër, që rrjedhin përmes një porti të madh, por të shkretë, të përbërë nga ishujt Sazan (Lesene) dhe Kepi i Gjuhëzës (Capo Linguetta), siç ndodh për një udhëtim në vaborin Lloyd nga Trieste ose Fiume për në Korfuz dhe Levante; ata që kanë gjuajtur derra të egër në plazhet jo-mikpritëse të Butrintit, Sarandës (Santi Quaranta) deri në Prevezë, ose pelikanët në brigjet moçalore, siç bëjnë veçanërisht anglezët në udhëtimet e tyre me jahte në ato ujëra; kush ka parë një të parë fshati të endej me pelice prej gëzofi deleje dhe me *opinga* (*opanghi* - këpucë shumë primitive) dhe i ka dhuruar atij një pako me pluhur (për armë zjarri) “*ad captandam benevolentiam*” (për të fituar pëlqimin e tij): Këtu mos prisni të gjejmë se ku, nga një revistë, redaksia e së cilës nënkupton studiues të shquar,

diçka lexohet në tavernat ose bujtinat e kohës nga një mësues shkolle, ose një prift apo kryetar fshati, ose të lexohet në masë nga pirës të heshtur të rakisë. Meqenëse vetëm Shqipëria, pak e përfaqësuar në komeditë dhe tragjeditë e Gadishullit të Ballkanit dhe shqiptarëve në përgjithësi asnjë rol nuk u është dhënë aty, ishte edukimi i njerëzve nga revistat dhe lexues pa ndonjë nevojë të ndjeshme: por nevoja është e shkurtër në kohët e fundit për shkak të rregullimit të kufijve të saj sidomos me Malin e Zi dhe Greqinë etj.

Besnike e tezës së vjetër se “Kush ka të kaluar, ka të ardhme”, gazetaria, përpos çështjeve të ditës, duhet të merret edhe me historinë e vendit dhe kërkues të zellshëm marrin mundimin të rrëmojnë në ato pak kronika që kanë mbetur ende pa u gllabëruar nga mola për të shkruar të kaluarën e lavdishme të një vendi. Subjekte të shkëlqyera për kujtime të tilla janë këngët popullore dhe rapsoditë kronike, që kanë në pjesën më të madhe një bazë historike të pa shtrembëruar, karakterizojnë mënyrën e të menduarit dhe të bërit e stërgjyshërve dhe ruhen për traditë.

(vazhdon)

15 prill 1887

27. LETËRSI SHQIPE ⁶⁵

Jeta e Zojës së Bekuar nga Jul Variboba doli në 1762 dhe *Këngët e Milosaos* nga Jeronim De Rada u botuan në vitin 1836 dhe botimi i IV i të cilit është mbaruar.

Ndoqën pastaj *Këngëtorja shqipe* nga At Antonio Santori (1839); *Hyjnitë pellazge* (1841) dhe *Këngët e Serafinës* (1843) nga J. De Rada; *Hulumtime dhe mendime* e Vinçenc Dorsës (1847); *Katër historitë* e Anmaria Kominiates; *Nata e Krishtlindjes, Adine, Videlaide* nga J. De Rada (1848); *I burgosuri politik* i At Antonio Santorit (1850); i *Krishteri i shenjtëruar* po nga i njëjti autor (1854); *Gramatologjia* me Shtojcën e rëndësishme të Dhimitër Kamardës (1854, 1866); *Përmbledhja e Rapsodive Kombëtare* nga J. De Rada dhe Nikolo Jenò de'Kornei (1866); *Kombësia shqiptare* e Dora d'Istrias, përkthyer në shqip nga Dhimitër Kamarda (1867); Homazh me poezi nga shqiptarët e Kolonive dhe të Atdheut Princeshës së tyre Elena Gjika Dora d'Istria (1870); *Gramatika shqiptare* nga J. De Rada (1870); Pesë libra të *Skënderbeut* nga J. De Rada (1872-1884);

Harpa e një italo-shqiptari (1881); *Rapsoditë popullore të Kolonive të Sicilisë* të Zef Skiroit (1887). Në fund, revista *Fiamuri Arbërit* ku një dorë e zgjedhur patriotësh nga Mëmëdheu dhe vendi i mërgimit sollën gurin e tyre; dhe e cila u pasua në Palermo nga revista *Arbëri i ri* /Shqipëria e Re/ për dy të shquarit, të lartpërmendurit Skiroi dhe Françesk Peta.

Ky lulëzim i gjuhës shqipe tërhoqi simpatitë, në kombet e civilizuar, të njerëzve të që shkëlqenin në shkencë dhe në kultin e ringjalljes së popujve. Maks Myler (Max-Müller), në një letër nga Oksfordi, parashikoi “ku ajo duhet të hedhë dritë mbi shumë të panjohura”.

⁶⁵ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 7, Cosenza 15 novembre 1887, p. II.

Teofil Stieri përktheu Anmari Kominiaten në vargje gjermane; dhe së fundmi ka botuar një broshurë të zgjuar mbi emrat shqip të ngjyrave; Louis Benloew i Akademisë Franceze bëri një analizë shumë korrekte të saj e duke i hamendësuar, shënonte edhe vendet e lashta në Europë dhe Azi të njerëzve që e flasin atë (shqipen); Hermann Buchholtz nga Berlini e quajti atë të vyer dhe në Shkallën e tij, që e vendos atë ndër poetët më mendjendritur të shekullit, ai ka mirëpritur disa nga rapsoditë tona të përkthyer nga ai vetë. Dhe të tjera poezi i përktheu e fismja Baronesha Knorr dhe i radhiti mes poezive të saj me një kuptim shumë të thellë. Gjuhëtari i famshëm L. Podhorszky, përktheu edhe ai në hungarisht *Milosaun* dhe këngën e *Janosh Huniadit*.

Thimi Mitko botoi në Aleksandri të Egjiptit në vitin 1877 *Bletën* e tij *Shqiptare* dhe mëkonte tek bashkatdhetarët e tij dashurinë për gjuhën e tyre: *Bleta* u dogj në sheshin e Athinës.

15 nëntor 1887

28. ANTOLOGJI SHQIPE ⁶⁶

Parathënie

Këto ese të gjuhës nuk po i paraqesim në mbështetje të rregullave dhe strukturës së saj, të cilat zakonisht i kemi mbështetur me shembuj në gramatikë, as për të nxjerrë në pah dialektet, mbi të cilat studimet e mia janë shumë të parëndësishme: por, siç deklaroam tek *Manifesti i Shkollës* (Konferencat f. 8), “për të treguar se si paraqitet ajo në rishfaqjen e saj në botë”.

Kultura e shumë gjuhëve duket se ka filluar nga Poezia, aq sa vetë krijimi i gjuhës (siç mendja ime është e bindur dhe ku pati disa eksperimente në art) dukej se merrte jetë nga një frymëzim poetik. Ndërsa, përdorimi i gjuhës në prozë është një punë e ftohtë dhe e vështirë e mendjes, e cila synon dhe zgjedh prej saj atë që mbetet e përhapur në brezat njerëzorë, gjendjen aktuale të saj besnike dhe autentike.

Prandaj, le të fillojmë duke ndjekur shembullin e dhënë në gjuhë të tjera, esetë e prozës, dëshmitare të sinqerta të gjendjes në të cilën gjuha shqipe, në përhapjen e saj të gjerë, zgjat pak a shumë e varfëruar në fjalë, por vazhdimisht e unifikuar në Morfologji dhe Sintaksë. Dhe ne u japim vendin e parë Përrâlesvet (*Përrallave*) që vijnë nga një kohë më e largët, dhe mbajnë me vete gjurmë të lavdishme të shpirtit të pavdekshëm të njerëzve nëpër gojën e të cilëve kumbojnë, ndërsa tek ne kalojnë.

Aty-këtu kam nënvizuar me shkronja të pjerrëta fjalë nga gjuhë të tjera që kanë hyrë në dialektet tona. Ndër fjalët italiane, që janë të përbashkëta për kolonitë tona dhe për shqipëtarët, do të dallojmë

⁶⁶ *Antologia Albanese: Prefazione, Appendice alla Grammatica*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 19-22.

ato që kanë hyrë para eksodit tonë nga atdheu; pastaj sipas përhapjes me bollëk të tyre në shkrimet e kohërave të mëvonshme do të mund të kuptojnë nëse sot ky është progres apo regres i dyndjes së huaj.

Lejomëni në fund të theksoj se produktet e gjuhës shqipe të mbledhura këtu, nëse konsiderohen si ese të një letërsie të sapolindur, nuk ofrohen si provë ambiciose e një mendjeje të indoktrinuara; por ato janë vërshime spontane të shpirtit të ndryshëm nga bota e ndryshme që i mbush ato me veten e saj. Originaliteti dhe një larmi befasuese përbëjnë karakterin e tyre thelbësor, ndërsa ato shfaqin të sinqerta, jo sipas modelit, natyrën e veçantë të njerëzve të cilit i përkasin.

Në të njëjtën kohë, nuk mund të mos rrëfej kënaqësinë e brendshme për faktin se më në fund mund t'i paraqesim Europës së kulturuar këtë pasqyrë *virtyti të lindur* të kombit tim, për t'u bërë e njohur dhe e të krahasohet madje me atë që mund të jetë e Neo-Helenëve, e pasqyruar në prodhimet e tyre të shkëlqyera letrare.

Gjithkush e njeh idenë djallëzore dhe intrigën e pandërprerë të mbretërisë helene, për të marrë për vete Shqipërinë, për t'ia zhdukur dhe shfarosur gjuhën; intrigat që shpien në vullnetin për ta fshirë, në ditët e sotme, prejardhjen tonë nga Pellazgët hyjnorë, në dobi të tyre, Helenëve.

Vullneti fajtor dhe i neveritshëm nga kudo që ta shikosh këtë çështje, se Ajo (Shqipëria) është një nga kombet më të magjepsur të Zotit, siç duket, në atë kohë; se Ajo ishte në krah të Heladës dhe fitoi luftërat e lirisë për të, e hoqi atë nga varësia e huaj, e është e armatosur mirë, siç thonë ata, nga madhëria e saj Mbretëresha e Helenëve; vullneti i një pafytyrësie që të bën për të vjellë: siç do të duket nga ky monument i epërsisë së mundshme të shqiptarëve, të cilët deri më tani, përballë helenëve, dëgjojnë dhe mund të thonë vetëm: "*Est Deus in nobis*" (Zoti është me ne).

29. SEKSIONI I DRAMËS⁶⁷

Epitalami ritual i dasmave shqiptare

Vemë përpara çdo eseje tjetër poezinë e martesës bashkëkohase me qytetërimin parahistorik të racës sonë. Është një veprim që zhvillohet nën tingujt e këngës së koreve, dhe që çon në rrëmbimin e nuses, një ritual për Himeneune Spartës dhe Romës, i cili ose kishte popullin italik të përbashkët me ne, ose ishte importuar në të nga Pellazgët e Trojës, së bashku me vallen e Pirros që kish marrë emrin nga fjala jonë *būrr* (vir), valle burrërore. Kjo dramë epitalamike e shnërron dasmën në një festë të qytetit.

Ceremonia e dasmës

Nusja me një fustan të stolisur ulet në ndenjese dhe ndërsa i krehin flokët, gratë e ndara në dy kore, i këndojnë Asaj me radhë. Toni i këngës është i mbrujtur me melankoli.

Ndërkohë, që flokët e nuses bëhen gërshet dhe lidhen në qafën e saj ku vendoset *keza* prej kadifeje e qëndisur në ar ose argjend që u fshih zverkun dhe më gjerë, majën, kulmin e kokës dhe mbetet një simbol i statusit bashkëshortor.

⁶⁷ *Antologia Albanese: Prefazione, Appendice alla Grammatica*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 71.

*
* *

Unë mendoj, dhe këtë e thashë edhe diku tjetër, se nga ky rit parahistorik lindi tragjedia athinase. Jo se kjo i përmbahej brendisë së kësaj poezie mahnitëse e cila në pjesën e parë ndoshta i referohej më shumë Epitalamusit të Katulos (i cili, si tani mes nesh, për Psalmin “*Adstitit regina a dexteris tuis in vestitu deaureato*”) dhe festës së qytetit që zhvillohej me rastin e dasmës së manjatëve. Shpirti muzikor i tragjedisë athinase, tradita historike ku Athina fillimisht ishte e banuar nga Pellazgët, të cilët ende pushtojnë zotërimet e saj, fakti se mbeten ende mes nesh qëndruar ajo çka është ruajtur më së miri nga Pellazgët, një dialog i tillë koral që Thespis e shtriu në raste të larta, mua më bindën.

*
* *

Ai tregon për kohën kur pritët që të mblidhen të gjithë të afërmit, të ftuar sipas zakonisht nga nusja për të dërguar tufa me lule.

*
* *

Duket qartë se metafora e pemës së mollës është një simbol i pastërtisë së virgjër, e paprekur nga ndikimet e turbullta, që trazojnë jetën rreth nesh.

*
* *

Në këtë vjen dhëndri bashkë me krushqit dhe një lumë të madh burrash dhe grash. Dera e shtëpisë së nuses mbetet e mbyllur para tyre.

*
* *

Ndërkohë, me të dëgjuar të shtënë e një pushke që qëllon jashtë, shokët e dhëndrit godasin me forcë derën.

*
* *

Pastaj dera hapet; Krushqit përshëndesin nusen, e marrin për dore duke e ngritur nga ndenjësja.

*
* *

Nusja del nga shtëpia e kapur për dore nga dy djem të rinj të fisit të saj, dhe mbërrin në Kishë në krye të kortezhit; dhëndri, që është mes krushqve, i bie pas.

Pastaj kur hyjnë në kishë, këngët pushojnë dhe rifillojnë përsëri pasi nusja kapet dorë për dore me dhëndrin.

30. RITMI I POEZISË SË LASHTË SHQIPE⁶⁸

Në tre poezitë *Ngazëllimi*, *Himni* dhe *Banketi*, gjenden të përshtatura tre melodi të gjeniut të atyre vargjeve njëmbëdhjetërokëshe shqiptare, por që ndryshojnë nga motivet e tetërokëshit, që është metri i këngëve të kësaj poeme.

Në poezinë shqipe, kanë për vargjet njëmbëdhjetërokëshe dhe për ato tetërokëshe dy lloj melodish. Sa i përket ritmit, në të dyja masa e rrokjes gërshetohet sipas mënyrës amtare me fuqinë e thekseve. Rrëfimi epik, shtysa e pasionit gjithashtu, janë shprehur në vargje me tetë rrokje, të cilat, konstante për nga këmbët [metrike] të lidhura në mënyrë të ndryshme, japin në një periudhë të bollshme me vargje, një harmoni të lirë dhe të gjerë të përshtatshme për tema të larta dhe me peshë.

Këto tetërokësha në përgjithësi shoqërohen nga një këngë silabike, notat e së cilës përsëriten në çdo varg e ngjajnë porsì një rrotullim valsì. Kjo këngë, pikërisht nga Rapsoditë, është me motive shumë të larmishme: ose e ngazëllyer dhe e lumtur, ose e rëndë dhe e guximshme, pothuajse gjithmonë nuk ka asnjë lidhje tjetër me veprimin e poezisë, përveç asaj të ngjalljes tek dëgjuesi i një ndjenjë të ngjashme me temën e saj. Të tilla melodi monotone cytin improvizuesit.

Motivet e njëmbëdhjetërokëshave, të përshtatur për këngët e dashurisë ose trishtimit, i pasqyrojnë këto hije të shpirtit me një plotësi më të madhe. Kështu ariet që u përshtaten atyre, me notat e tyre të gjata dhe të thella, të transportojnë në një botë të largët, të pafund dhe të dehin me melankoli: sepse trishtime shoqërohet gjithnjë me jehonat e pafundësisë: arie të cilave u afrohen ato të këngëve të dasmës. Arsyeja që njëmbëdhjetërokëshat janë në thelb lirikë, është

⁶⁸ *Antologia Albanese: Prefazione, Appendice alla Grammatica*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 71.

se në to, përveç rimave asonante, ka një kthim monoton të thekseve dhe masave të ngjashme.

Tani më lejoni të shpreh angazhimin tim që në Kolonitë tona të bëhet një mbledhje e shumë elegjive dhe epigramave njëmbëdhjetërrrokëshe, lule të vyera që do të japin imazhin e të qashtë të të gjithë mendimit kombëtar.

Por mbase asgjë në këtë zhanër nuk do të ishte e krahasueshme me punën e dalluar të njohjes dhe ndalimit, para se të humbin, të asaj që mbetet nga këngët kombëtare. Unë nuk e di nëse jehonat e muzikës frigiane, apo dorike, apo lidiane, jehon ende në to. Mund të ndodhë edhe që notat e saj, duke u futur në muzikën e sotme, të bëhen shkas për risi joshëse. E sigurt është që kënga bashkë me gjuhën është shprehja e lindur e aspiratave të një populli, dhe atyre që me më shumë këmbëngulje qëndrojnë bashkë me të në udhët e jetës; duke pasur të dyja fuqitë natyrore për ta rimëkëmbur ose për ta kthyer në kohët më të mira të lashtësisë. Kështu qëedhe për artin në përgjithësi, edhe për ne si komb, është një moment i shkëlqyer shpëtimi i mbetjeve të muzikës pellazge që vazhdon ende mes nesh.

31. PARATHËNIE PËR BOTIMIN E TRETË TË POEZIVE SHQIPE

Dy rrugë kemi përpara tani që shihen si ato që të shpien drejt Ringjalljes së Shqipërisë.

1. Nëse komunitetet me origjinë shqiptare do të reduktoheshin në një shtet që përfshin vetëm këto komunitete të pavarura, e që do t'ua mbante të shkëputur jetët e tyre nga vendi i lindjes, sepse vetëm bashkimi do të mund t'u garantonte atyre kohëzgjatjen e kësaj të mire që përbën *eudaimoninë* (lumturia – shën. B.Gj.) e qytetit.
2. Ose, nëse komuniteteve me origjinë shqiptare, që pajtohen në heshtje me kushtet e jashtme aktuale, u mbeten mjetet që i mbajnë ata dhe zhvillojnë qenien e tyre të dallueshme nga ajo e ndonjë familje tjetër njerëzore në pushim, (mjetet) e zotërimit paqësor të pasurive të tyre, besimeve, zakoneve dhe botës së përtejme në gjuhë të ndryshme që u dha Zoti, e çoi secilin popull në një Fat të ndryshëm Zoti Atë.

I.

Por u kundërshtua nga opinionet dhe nga faktet që bashkëjetesa e lirë në vetvete të siguronte për Shtetet dhe madje edhe për Familjet eudaimoninë. Nuk është e papërshtatshme që për shkak të vendit që ata zënë veçmas në Tokë, bashkëjetesa mbetet pothuajse e lidhur me dallimin e njerëzve nga prejardhja; vetëm kombësia mbetet e lidhur me bashkëjetesën, ajo ka kundër saj shembullin e shqiptarëve. Koloni të shumta të tyre qëndrojnë që nga kohëra që nuk mbahen mend në Europë bashkuar me të huajt, dhe në vendin e tyre ata bëjnë sipas vullnetit të të huajve, madje edhe brezi i atyre i mbështetur nga gjaku, të ndryshëm për nga gjuha, dhe i mbushur me jetën krenare të paraardhësve është qëndrestar ndaj prishmërive që zgjasin.

Duhet shtuar gjithashtu se fati në të cilin na kanë lënë ngjarje të pashmangshme i kundërvihet fuqisë që ne të bëjmë një Shtet rreth të cilit të mund të mblihdemi dhe ndoshta biem dakord që ta lejojmë atë gjë. Pikë së pari duhet që të shpërbëhet dhe të shkrihet Perandoria Osmane, shembja e së cilës nuk është një Luftë pasuese, e flamuri i saj është Vdekja.

Tani nxitjet kryengritëse në Lindje mbështeten në univers nga rebelët me premtime për kompensime në vendin tonë, për t'u ndarë atëherë kur jeta e të *Sëmurit të Madh* të pushojë.

Kur u ngrit në Itali Flamuri i Shqipërisë (*Fiamuri Arbërit*) dhe 300 intelektualë të Mëmëdheut themeluan në Bukuresht Komitetin me emrin *Dituri* (shqipja flitet në të gjithë Rumaninë) Helenët dërguan emisarë në Shqipëri dhe nga Korfuzi ata erdhën edhe tek ne, të cilët synonin, nismë e Trikupit siç thuhej, - “një Konfederatë Ballkanike ku Shqipëria duhet të pranohej e lirë dhe e barabartë kur të rebeloheshin ndaj Turqve dhe prej tyre të shkëputej” – Ata morën përgjigjen: - “Që Greqia dhe Shtetet e Ballkanit të pavarura do të bashkoheshin, e kuptoi Shqipëria se duhet të shihte nga vetja” - Ishte ajo një ofertë prej mashtrimi helen që kërcënonte jetën e Shqipërisë, të cilën Perandoria Turke, ende aq e fuqishme, ishte e sigurt se do ta pushtonte.

Dhe ky besim qëndron ende sot prapa këshillave që nxisin shpagimin e dhunshëm të Atdheut. Sidomos po qenë të huaj të zhvendosur, të cilët hiqen si shokë të atyre që as nuk i njohin dhe as nuk i duan; të paaftë në zanat çka i bën edhe sot arrogantë mes të afërmve dhe të largtëve, ata duan të ushqehen me përgatitje të armatosura ose konflikte të armatosura, që t'i lartësojnë ato para kultit të marrë të burrave bashkëkohës. Dhe pastaj Qeveria Greke i mbështet ata me paratë e saj.

Rreth vitit 1883, Mavromati, konsulli grek në Maltë, u përpoq të demonstronte në gazetën “Akropoli” të Athinës: “Se Shqipëria e Veriut dhe ajo e Mesme, Epiri dhe Maqedonia nuk kishin as 700.000 shqiptarë, interpretim që hoqi detyrimin të konsiderohej pothuajse si një komb që gëzonte të drejta”. Gjendje historike që do t'i heqë prejardhjes sonë, do të thosha unë, të ndërjet pak luanë mes tufave të panumërta delesh dhe dhish dhe të autorizojë Greqinë, e dëshpëruar, që të ketë përsëri shërbëtoren e saj, Shqipërinë që *δεσμὸν εθνικόν* (organizata politike nacional(ist)e që veproi në Greqi në vitet ‘80 të

shek. XIX), të hyjë në planin e pamëshirshëm, i cili ishte tashmë i qartë, për të bërë marrëveshje me sllavët fqinjë për ta copëtuar atë.

II.

Prandaj, kur u pa se erdhi Ora që të vëzhgonte dhe të mblidhte në këshilla të shprehura me gjuhën e vet Kombin Shqiptar, lipset që t'i lëmë të gjitha dritat të bien para së gjithash mbi keqkuptimin që për 4 mijë vjet e ka identifikuar atë me Greqinë, e t'i presin Fatet e veta.

Herodoti na la të shkruar se në kohën e tij Greqia ishte e banuar nga dy kombe, një që atje ishte shumë e vjetër, *pelasga* (*pëlàka* - e vjetra - në shqip); tjetri Greqia që erdhi dhe shtyu drejt veriut ata që nuk iu dorëzuan asaj me përkushtim (*Arbëria* e tanishme). Se një numër i madh i atyre që mbetën, ose qëndruan pranë helenëve, ose u bashkuan me ta në vende të përbashkëta. Që flisnin një gjuhë të ndryshme nga ajo e Helenëve siç dëgjova. Kjo përzierje njerëzish ish që nga koha e Platonit dhe përmendet tek Fedoni: “E madhe, thotë ai, o Çebet, është Greqia, ku ka edhe njerëz me vlerë, *dhe shumë pasardhës të barbarëve*”.

Helenët, zotër pra të hegemonisë së dy popujve, i përfaqësuan ata në kohërat e lashta dhe vetë folën për të dy. E pasi ia atribuuan vetes fatin duke u konsideruan të lumtur thellësisht në jetë, nxorrën në pah imazhe të rëndësishme të saj, të cilat nga gjuha e tyre mbeten monumente deri më tani të pashoq.

Por nuk na mbetet veç të argumentojmë nëse, midis burrave të mëdhenj të Greqisë janë dhe ata që kanë lindur Pellazgë; prejardhja pellazge në kohën e lulëzimit të Helenizmit ishte pothuajse e fshirë, dhe nëse nuk ishte krejt e panjohur në fakt kjo ishte për shkak të vetë vendit të rrëgjuar, siç kujton Herodoti, më shumë drejt veriut.

Arbëri ynë (Epiri i Lashtë), Makjeljea (Maqedonia), malet Shkeplari (Keravni) patën gjithmonë banorë trima; fitimtar ndaj Latinëve në kohën e Pirros; patën më të lartin midis njerëzve dhe të pamposhturin Aleksandrin e Madh.

Pushtimi i Turqisë, duke e shpërbërë Perandorinë Bizantine, zhbëri shtypjen e neveritshme të elementit Pellazg. Pastaj, të varur nga vetja, pati ajo rajonet jugore të Europës të banuara nga helenë dhe pellazgë, por të dallueshme dhe të ndara nga njëra-tjetra në provinca të veta që kishin mbetur që nga kohërat të hershme.

Dhe kur Greqia e fryrë dhe e ndihmuar nga Europa e krishterë u bë një mbretëri e lirë në kohët e reja, mund të shihej qartësisht se heronjtë e saj që e çliruan ishin bashkëjetues me të me prejardhje Pellazge. Kryengritja e nisur nga Ali di Tepelena u mbështet nga afër dhe u fitua mandej nga shqiptarë të pamposhtur si, Botzari, Miauli, Zavella, Karaiskakji, Macry, Odiseu, Tombasi, Condurioti, Bobolina, etj. Lavdia e tyre ngriti peshë shpirtrat e bashkatdhetarëve të shpërndarë nëpër brigje, në ndjesinë e të qenurit tashmë një familje e ndarë dhe më e lëvizshme se ajo e fqinjëve; e megjithatë gjuha e saj mbijetoi, përmes peripecive të fatit të mbrapshtë, si dritë që do ta udhëhiqte drejt Fateve të reja.

Tani unë e kam në zemrën time një Besim të palëkundur sa i përket kombit tonë se ai nuk është i paracaktuar për t'i ripërtërirë Grekëve Perandorinë Bizantine, por që i shkëputur prej tyre një herë e mirë, të thotë fjalën e vet pranë Fateve të Zotit!

III.

Dhe kjo gjendje e jashtëzakonshme, që ekzistenca e Shqipërisë t'i zerë diellin e saj Greqisë dhe ta kundërshtojë atë në planin që ajo ka për të rënë në ujdi me sllavët fqinjë për copëtimin e saj, mua më duket plot rreziqe rruga e çlirimit nga Turku me armë. Hakmarrja e saj, jo dhe aq e keqe për vlerësimin kryesisht për shkak të luftës, do të ishte gjithmonë e pasigurt.

Nga ana tjetër, sot më duket se Perandoria Turke, e kërcënuar nga rebelët, ka nevojë për mbështetjen e popujve të ndryshëm të bregdetit të saj; dhe ndër këta popuj më trimi dhe i parapëlqyeri i tij, shqiptari, a duhet të jetë besnik i palëkundur ndaj tij së bashku me strehën e tij të sigurt në Perandorinë e jetës së pushtetshme?

Shto këtu, se aty ku mbretëria e re e Shqipërisë do të lindte, me fat dhe e pavarur, do të mbeteshin jashtë saj shumë pjesë të tjera të kombit të lëna pas nga ngjarjet në Greqi, Itali, Ballkan dhe të tjera brigje; nëse eudaimonia që i urojmë do t'i përmbushet nga lartësimi i qenies së saj për shkak të kulturës morale dhe intelektuale, e lirë dhe e përhapur kudo, nga kjo do të kishte përfituar e gjithë Jeta shqiptare; dhe është ideali i saj tek unë, dukshëm i mbështjellë në dëmtimet e saj.

Dhe unë jam i lumtur të jap ndihmesën time në këtë ringritje, të autorizuar nga autonomia që Mëmëdheu ka në zemër dhe Sulltani i

premtion; nga ndjenja e vetvetes, autori kryesor i fateve njerëzore, i cili pushton deri në Heladë kantonet shqiptare; nga bashkimi i Kolonive Italiane të dominuara nga mendimi, kaq mrekullisht dhe me një jehonë kaq të gjerë të lëshuar nga i shquari miku im Kavalier Anselmo Lorekio, se ringjallja kombëtare varet nga kultura e shpirtrave, bashkërendues, të lindur në të gjitha vendet, e cila, ashtu si drita, nuk i prish as ata larg, e as ata afër.

Dhe është serioz dhe nuk ka lindur nga rrethana tokësore vizioni i një Fati që i ka rrëmbyer fitoret turke mbi 200.000 ushtarë shqiptarë të Birit të Zotit, që do të strehoheshin në Itali në këtë kohë. Për të cilën gjithashtu është e shëndetshme në univers njohja e një Gjuhe, gjithmonë faqja më e vjetër e botës europiane; dhe pastaj është libri njerëzor që përmban dhe ruan devijimin e hershëm të kultit fetar, nga Zoti, Ati i padukshëm, në shoqërinë e formave të ndritshmetë krijimeve të tij ekzistuese, që shfaqen në fenë idhujtare dhe quhen me emrat që u shkojnë për shtat atyre në pellazgjishtë.

Përtej këtij thesari të varrosur brenda saj, Gjuha shqipe mbetet dëshmitare e lidhjes së hershme midis njeriut dhe Zotit, që është konstante.

Lejomëni të evokoj këtë meritë të Fjalës në kohën kur, në luftërat midis hajdutëve dhe arrogantëve, ndoshta do të ndodhë përfitimi vëllazëror i saj dhe vlerësimi i pushuar nga qëndrimi (vendi, bota) që na rrethon. E në mes të të cilave drita e Ditës sonë, siç profetizoi dhe një Grua e lartë në kulturën shpirtërore të racës sonë, të cilën e uron edhe Nikolo Tomaseo prej tre çerek shekulli në fjalinë me të cilën, në një letër që më drejtohej mua: “Dita e shenjtë për Moisiun udhëheqës të një populli”.

Pas këtij emigrimi bujar, Fati hyjnor u shfaq menjëherë në dhuratën që bëri Papa Klementi XII, pasardhës nga një Zonjë prej dere shqiptare; dhuratë e Kolegjit Corsini të Shën Adrianit dhe çifligut të tij: ku kishte një shkollë të larmishme të shkencave klasike në gjimnaze apo lice, të pasuruar nga doktrina universitare matematikore dhe filozofike dhe dega e studimeve kishtarë për ritin grek.

Ky Kolegj *sui generis*, i cili pati në një formë të veçantë në Mbretërinë e Napolit dhe në të cilin emigrantët shqiptarë për 200 vjet u arsimuan për qëndrueshmërinë e qenies së tyre kombëtare, sot janë

përballë dy fateve që atyre, të pavetëdijshtëm, duhet t'u vijnë nga bashkimi me Italinë, gjithnjë e më shumë e lumtur për t'i bërë ato familjarë të saj. E para, që Katedra e gjuhës shqipe që ishte vendosur në atë Kolegj për dhjetë vitesh, të transferohet në Kolegjin Oriental të Napolit, tjetra, që vetë Kolegji Korsini të jetë i hapur për studentët e Mëmëdheut dhe të bëhet ndërkombëtar për Italinë dhe Turqinë.

Dhe për përkushtimin e palëkundur vetëm ndaj idealeve të larta dhe të lavdishme, nga komisari i shquar Skalabrini, Inspektor i Përgjithshëm i Shkollave në Lindje, ajo i ka vendosur me vendosmëri pjesët e saj në Europë, për çka lipset të bien dakord gjithsesi.

IV.

Në vetvete, pra, përtej çdo fati të jashtëm, kombi Pellazg është shumë i denjë për Fatin që i shpaloset, pas, le të themi, shlyerjes së fajit për devijimit të tij të hershëm nga adhurimi i Atit që kemi në qiell, dhe ndoshta për vazhdimësinë krenare të parapëlqimit të gjuhës së tyre ndaj asaj të Zotit, të cilët preferojnë emrat e tyre të vdekshëm.

Dhe dinjiteti i saj bëhet i pashlyeshëm në lidhjen e origjinës midis njeriut dhe Zotit: çmimi i gjithë jetës njerëzore është në gjenerimin e Fjalës së tij nga hyjnorja, e pafund, dhe jashtë të cilës kanë mbetur të egrit që i shërbejnë Jetës. Dhe vlera krahasuese e fjalëve për prejardhjet njerëzore mbetet në teprinë dhe besnikërinë e jashtëzakonshme të tingujve dhe pasqyrimeve të përjetshme të universit tokësor që vetë ato ofrojnë.

V.

Të ndalem për të soditur këto fatet është një privilegj edhe i imi, që për treçerek shekulli i kam përfaqësuar ata në pafuqinë e tyre dhe fuqinë hyjnore; në Orën kur lipset e nevojshme që përsosmëria e gjuhës dhe thesari i depozituar në gjirin e saj pas rinovimit, le të urojmë e shpresojnë që të jenë faktorë të rikompozimit kombëtar.

Pas botimeve të cilave u drejtohem, le të jetë e qartë edhe për vëllezërit tanë të shpërndarë në të gjithë Heleninë se virtyti i mundshëm i gjuhës pellazge është më i lartë se ai i gjuhës helene dhe se produktet letrare të Heladës së sotme janë tepër inferiore krahasuar me ato të bashkëkohësëve të Arbërit, që grekët synojnë t'i fshijnë.

Gjuha pellazge ka një notë të rrallë që nuk e ndan me klasikët dhe ato të Europës së sotme të civilizuar. Se zhvillimi i ligjërimin në të duhet të shoqërohet me zhvillimin fonetik të fjalëve që ato paraqesin. Për shembull, le të themi emrin femëror *aar*, të korrrat.

Emërore dhe kallëzore njejës na jep *aar*; gjinore dhe dhanore së *àrie, arie*, të korrrat.

Emërore dhe kallëzore âra, ara, dhanore ârave, *arave*; rrjedhore âraschi, prej arave.

Po ashtu të foljeve:

Bénj, bëj, *bèsha*, që të bëj, *bènur*, bërë, *bêra*, bëra; *bèen*, bënë.

Po ajo, sintetike si ato klasiket, ka në krahasim me to dy lloje zgjedhimesh: të shquarën dhe të pashquarën.

Emërore *trim*, giovine; *trimi*, il giovine; gjinore të *trimi*, di giovine; të *trimi-t*, del giovine.

Emërore *vash*, fanciulla; *vasha*, la fanciulla; gjnore së *vashie*, di fanciulla; së *vash-es*, della fanciulla.

Emërore *gjak*, sangue; *gjakët*, il sangue; ginore të *gjaku*, di sangue; të *gjak-ut*, del sangue.

Do të zbulojmë se emri i tij neutral nuk ka kuptim për ne, si greqishtja dhe latinishtja, por përfaqëson ide universale. Dhe njësoj me gjuhën helene dhe atë latine ka tre klasa foljesh: aktive, pasive dhe neutrale.

Pastaj ai ka tepër përparësi ndaj të folurave njerëzore: - dhe e nevojshme na qe transferimi i Katedrës së Kolegjit Oriental ku ajo mund të krahasohet me gjuhë shumë të lashta siç është gjuha arabe, kineze, etiopiane, indiane, etj. - për pasurinë e rastit të tingujve: 34 bashkëtingëllore dhe gjashtë zanore, secila e moduluar nga katër tone; plus ë-në e shurdhët. Për secilën gjuhë muzika e saj, me Zotin autor, është e shprehur nga Njeriu që e përfiton atë me shenja arbitrare konvencionale.

Sa i përket gjuhës shqipe, ashtu si edhe tingujt, fjalët nga një burim i panjohur, lindin, që nga kohët e lashta, njërrrokëshe pjesa më e madhe, domethënëse dhe me dy bashkëtingëllore e një zanore në mes; dhe qartësia e saj e madhe buron nga ky parim fonetik i paprekshëm. Ndryshimi më i vogël i shkronjave themelore, duke hequr tingujt e ndryshëm, e prish gjuhën. Pa mendoni nëse është i mundur ndonjë zëvendësim në zërat e radhitur më poshtë të cilat shpërthejnë pothuajse

nga një organ i vetëm: *Gèsh*, i zhveshur; *gjésh*, mbrun; *jesch*, unë isha; *kjésh*, qesh; *késh*, unë kisha. Për të kompletuar alfabetin e saj qenë të pamjaftueshëm dy alfabetet helene dhe latine të marra së bashku dhe ajo përdor disa shenja arbitrare që ende i lipsen për të shprehur me shenja të veçanta dhe të ndryshme të gjitha zërat e gjuhës.

Kushtëzimet që patën të parët tanë nga ngjarjet historike, që më pas mbetën të trashëguara tek ne, na pajisën me dy alfabete, greqishten e Konstandinopojës dhe Latinishten e Komitetit të Lungros në Itali, të dyja në proces përmirësimi; aty shpaloset e sigurtë për të ardhmen e saj shumë fisnike kultura e re e pellazge.

Lejomëni të shpreh pa fre ndjenjën krenare kur u shfaq në botën e kulturuar Letërsia pellazge, dhe u bashkua me ato të sotmet shumë të vlerësuara dhe ato të lashtat të pashoqe.

Ndodhi që atë verë (1844), shkoi nga Franca në banjot e Iskias poeti de Lamartine. Ai ishte në kulmin e karrierës së tij të shkëlqyer dhe të lëvduar. I këshilluar nga ankthi për të mësuar nëse kisha unë një arsye të vërtetë për ndjenjën e krenarisë për veten time, me anë të një marinari, kur ai kaloi në Iskia, unë i dërgova një kopje të *Milosaos* me këngët e botuara të *Serafinës*. U fol, në rrethin e të njohurve të mi, për këtë guxim - ai i kish pritur letrarët e Napolit me mirësjelljen e një njeriu që nuk i njehej - dhe shumë nga familjarët e mi pritnin që mendjemadhësia ime të mirrte dënimin e merituar. - U kisha zënë shtratin nga lëngime të shpirtit, kur mbas pesë ditësh, marinari u kthye me këtë letrë:

“Zotni,

Jam i lumtur për këtë shenjë vëllazërie poetike dhe politike mes jush e meje. Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja e aty duhet të kthehet. Unë nuk kam pasur asnjë meritë tjetër veçse që e kam parandjerë dhe që kam shprehur dëshirat e para për lirinë dhe ringjalljen e Shqipërisë. Ju më shpërblyet së tepërmi. Më vjen keq për shkakun që më pengon të ju shoh dhe ju lutem të pranoni falënderimet dhe përgëzimet e mia.

Iskia, 8 shtator 1844.

Lamartine

Pasi u ktheva nga Iskia e vizitova atë në *Hôtel des Étrangers* në rivierën e Kiajas dhe ai më tha fjalë që do ta bënin krenare çdo zemër. Pastaj disa ditë më vonë, ndërsa po dilja nga vila me dy shokë, Ai na kaloi pranë me karrocë me familjen e Kontit Le Fèvre; duke hequr kapelën, e nderova; dhe ndërsa karroca ngjitej në përprjetën e rrugës, pashë Zonjushat Le Fèvre të ngriheshin në karrocë dhe të flisnin për mua duke m'i ngulitur sytë nga pas.

Gëzimi i madh ma dehte shpirtin; dhe as kisha vend tjetër ku ta blatoja, veçse në këmbët e Statujës, shpirtin e heshtur të së cilës adhurorja e që ishte i lidhur me timin me zamkë të pavdekshme.

Dhe unë besoj se mund t'u referohem këtyre provave dhe atyre të tjerave, të mijave bashkë me ato të Grekërve të nivelit të lartë që bashkëpunuan me mua, duke lënë që të bjerë mbi ta drita, adoptimi i Mëmëdheut, duke sjellë disa vlerësime të kritikëve më të lartë nga Italia, Franca dhe Gjermania, që i nderuan ata me shumë simpati, si pasqyra të virtytit të lindur të prejardhjes së tyre.

Dhe i pari, duke përdorur autoritetin e tij, Nikolla Tomazeu, për të më ngushëlluar për përkushtimin e jetës sime ndaj atdheut, më shkroi në 1873:

“... Deti që shihet mes kodrave në distancë është një kujtesë e rinisë sime të hershme, por nuk më kishte ndodhur kurrë të ndjeja “Borën që zbret mbi alga e mbulon krahët e rosave të egra që fluturojnë mbi ujë; unë kurrë nuk kam menduar për ujërat e detit, të cilat herë pas here përtërihen gjithashtu . . . Dita i buzëqesh detit dhe kodrave si një vallëzim. Kemi në Psalmet kodrat që gëzohen si qengja të cilat mbase i linin në hije vallëzimet e Hireve dhe të Nimfave në dritën e hënës tek Horaci. Dhe rrëfej se më pëlqen më pak te Dante “*Trivia nei plenilunii sereni ridere tra le ninfe eterne che dipingono il ciel per tutti i seni*” [Trivia në netët me hënë të qetë të plotë rri duke qeshur mes nimfave të përjetshme që pikturojnë qiellin në të gjitha pjesët (gjinjtë)], meqenëse imazhi i pikturës këtu ka shumë art dhe ajo e “gjinjve” është reduktuese. I butë ylli i Afërditës që shkëlqen përmes pjergullës që bën hije në një dritare. E vërtetë vërejtja se si vajza e mësoi orën në dritën e hënës që binte mespërmes dhomës, etj.

Fraza të vlefshme më duken “këngë e harresës”, më të mira se vera e *harresës së Horacit*; “Buzëqeshje e fishkur”, të cilën ai e pikturon dhe

ngjyra e buzës është lëngimi i shpirtit dhe të kujton puthjen e *fytyrës së dëshiruar*, por me një drojë më delikate; “Gjendje të lumtura” në një kuptim më të larmishëm, por jo më pak të përshtatshme se ato të Virgjilit “*Felices olivae*”. Ora e Mirë “që e bën zemrën të hovë përpjetë” ka një thjeshtësi elegante. Dhe kështu “Lule që ngazëlleen nga gurgullima e ujërave”, “Lule që presin Pashkën”, “Toka ku erërat dhe fjalët njerëzore nuk rrinë pa bëzajtur”, “Koha nuk foli më për të, si dikush që është në varr. Krahasimi i një të rioshi në një gjendje të lumtur “që ashtu porsi hëna u bë i madh e bukur”, më shumë se ylli i Çezarit “*velut inter ignes luna minores*”, (si hëna mes yjeve të vegjël) etj.

Më pëlqejnë mua ato përmendje zakonesh: të shkuarit e vajzave për shkarpa, të tjerrurit në shtëpi, qepja e këmishave dhe të pjekurit e bukës. Ai lumi Voda (ujë për Sllavët) më kujton jo vetëm emrat e shumtë që kanë lumenjtë në të gjitha gjuhët, që nuk kanë kuptim tjetër në përgjithësi përveç atij të ujit, por vëllazërinë dhe përzierjen e fiseve epiriote me ato sllave.

Të dy popujt bien dakord në kultin e mëshirës prej biri dhe asaj vëllazërore . . . Diku tjetër kujtojmë me dashuri familjen dhe atdheun, vëllezërit, shatërvenet dhe vendin tonë, i cili evokohet me më shumë ngrohtësi nga vargu i Virgjilit: *Hic inter flumina nota et fontes sacro* (Je një plak me fat mes lumenjsh dhe burimesh të shenjta). Një i ri sodit me një shpirt adhures bukurinë madhështore të së jëmës dhe titulli i *Zonjës Mëmë* është edhe ai në atë komb, mes të qenit patriarkal dhe luftëtar, një dokument historik.

Nga disa prekje, dashuria e druajtur dhe leja që u jepet mendimeve, e ngjashme me një ëndërr të shkurtër, me zbardhjen e ditës tretet. Ëndërron dashnori që kali të lëshohet dhe të hyjë në mes të një turme grash, të gjitha të shpërndara, dhe ajo Njëra duke shtrënguar frenat e mbledhura nga toka, dhe me pushtetin e syrit njerëzor, ta zbusë kalin dhe të presë atë, meit në fytyrë, e t’i fshijë me shami gjoksit e djersitur, teksa skuqet nga frika se mos e shohin . . .

. . . Dy zemra kuptohen si “dy gojë që së bashku hapen për të qeshur”. Më e thellë se tek Dorotea e lëvduar e Gëtes, vajza e cila, duke shkuar për të mbushur ujë, në gjysmë të rrugës kthehet, dhe hedh sërish sytë nga qyteti, drejt shtëpive ku ajo lindi, etj. Për dashurinë e humbur, por që mbetet në zemër: “Ajo do të shikojë detin, dallëndyshet do të

fluturojnë në ajër; dhe ajo do të nisë të këndojë me një zë të avashtë këngët që unë i këndoja në kohën kur ne fort e donim njëri-tjetrin”.

Të tjerët thonë se këngët e tij janë paksa të parregullta. Ajo që flet për pëllumbin e pavdekshëm të Anakreontit, më lë të kuptoj se nuk përshkohen me spango retorike lëvizjet e lira të shpendëve fluturues. Një fill tjetër tani po shoh që në vitin 1836 e shtrëngonte atë dhe prap shoh se si për maturi e vendosmëri bashkë zemra i bëhet udhërrëfyes. Në zemrën e tij është e përkorë ambicia e së mirës, pasi ajo gufon nga dashuria për Jetën e Përjetshme.

Urime dhe nderime të përzemërta.

N. Tomazeu

Firence, 30 korrik 1873.

Vendi im nuk do të jetë më pak mirënjohës ndaj simpatisë me të cilën Gjermania po dëshmon ringjalljen e tij adventureske.

I famshmi Herman Bucholtz në “Revistën e Shtypit të Huaj” në Berlin po bëhej zëdhënës i përshtypjes së madhe që po bënte tragjedia shqiptare *Sofonizba*, e cila e shfaqur në Napoli në viti 1892, kishte prekur kombin e saj më tepër se sa ç’ishin përpjekur më parë t’u tregonin brezave të ardhshëm atë figurë heroike të asaj gruaje të kohërave klasike.

Ne bëjmë mirë të sjellim disa pikëpamje të marra nga ai gjykim i famshëm i botuar në Napoli në 1894 në Tipografinë e Anxhelis Belisarios.

Bucholtz i ndritur shkruan:

“Jeronim De Rada, i shkëlqyeri, kampion i Shqiptarëve, pajtuesi dhe bashkuesi i kombit të tij, këngët heroike të të cilit që nga *Milosao* e deri tek *Shkënderbeu*, për më shumë se gjysmë shekulli e kanë lartësuar popullin e tij dhe janë ngazëllimi i filologëve, i cili mblodhi *Këngët popullore* të vendlindjes së vet, dhe që dhjetë vjet më parë diti të pajtonte zemrat e njerëzve të tij të shpërndarë duke nxjerrë në dritë një revistë politiko-letrare në gjuhën shqipe dhe për të cilën kemi folur disa herë në këtë periodik, jeton në provincën e Kozencës. Ka pak kohë që ka marrë detyrën e lavdishme, që i bën nder Ministrisë Italiane të Arsimit Publik, të kujdeset, me shpenzimet e Qeverisë, për studimin e gjuhës shqipe mes bashkatdhetarëve të tij të Napoli.

Dhe tani në moshën 78-vjeçare ai na jep një *Sofonizba* në të cilën edhe bëhet shqiptar. Në dedikimin kushtuar Zonjës së Oborrit të

Mbretëreshës Margeritë, Princesha Adele Pinjateli, Strongoli, thotë se si donte t'i tregonte Italisë, mikpritëse e sjellshme e popullit të saj, dhe Europës, në gjuhën e saj dhe të përkthyer prej saj, çfarë mund të bëjë Shqipëria, e cila nuk meriton të ofendohet.

Ideja për të shndërruar në një subjekt tragjedi historinë e vyer të vajzës së Hasdrubalit, të rrëfyer nga Livio, Dioni, Kasio, Apiano, Diodori, Zonara, nuk është e re. Xhan Gjergj Trisini, gramatikani i madh i cili pati fat të vakët me poezinë e tij *Italia e çliruar nga Gotët*, me *Sofonizban* e tij e dëshmoi vetën poet të talentuar.

Kritiku më pas vazhdon me analizën e dramës së kryer në botimin e bërë nga Taso prej së cilës riprodhon vëzhgimet e bëra anash që prekin paksa bukurinë por edhe vulgaritetin e saj; dhe duke ekspozuar me kujdes kanavacën ai vazhdon: *tani tek i madhi Alfier!*

Sofonizba e tij, e gjitha në njëmbëdhjetërokësha, pa vargje lirike dhe pa kor, kalon në fushën e Shipionit në Afrikë. Shihen ushtarë romakë dhe numidianë, nga ana tjetër numri i personazheve është i kufizuar tek Sofonizba, Sifaçe, Masinisa dhe Shipio. . .”

Vazhdon të shpalosë kanavacën e Dramës dhe përfundon:

“Gjuha është e bukur, fisnike, gjithmonë në përputhje madje edhe me pozitën e tragjedisë klasike. Por në vetvete tragjedia të lë të ftohtë. Bujaria nënshtruese e Shipionit është e pabesueshme dhe të mërzit. Nuk është e qartë pse Sifaçe dhe Sofonizba nuk duan të shpëtojnë veten ndërkohë që munden.

Është e çuditshme që ky Shipioni tejet bujar i Alfierit t'i ketë pëlqyer aq shumë Xhebelit tonë saqë në Sofonizban e tij e ekzagjeron edhe më tepër dhe për ta bërë këtë ai as që pati ndonjë ngurrim për të përmbysur traditën historike etj.

Po De Rada si e bën? Me cilin nga tre pararendësit ngjan më shumë? Sipas titullit “Dramë Historike”, kujdeset për traditën historike dhe e ruan atë. Por kjo nuk do të mjaftonte për shpalosjen e së tërës, dhe për këtë arsye ai trillon si poet.

Në frymëzimin e tij ai e braktisi që në fillim njësinë e vendit dhe të kohës nga e cila pararendësi i dytë dhe i tretë tashmë ishin larguar gradualisht. Ka një ndryshim skenash siç i ka Shekspiri, imazhe madhështore si këto dhe si Eskili i lashtë, një kënaqësi për shijen e kohës sonë, një atraksion i madh për jehonën e aspiratave më të bukura dhe më të spikatura të Italisë dhe Europës”.

Kritiku i shquar vazhdon dhe analizon veprimin, rifillon:

“I gjithë veprimi i De Radës është aq i vërtetë, aq prekës, aq patetik dhe i devotshëm, sa i asnjërit prej pararendësve të tij.

Nuk është një akumulim i ngjarjeve si në të parën, nuk ka virtyte të rreme dhe mburrje të trilluara si në të dytën.

Historia e dhimbshme është kjo: Sofonizba dashuron Masinisën, Princ i Masilëve dhe kushëriri i saj dhe është e dashuruar prej tij, e ai, për të qenë i denjë për të, shkon në Spanjë për të mbrojtur Kartagjenën. Ndërkohë, Mbreti i vjetër i Numidias, Sifaçe, përfiton nga mungesa e tij për të pushtuar Masilian dhe për t’ia siguruar vetes atë, i kërkon dorën Sofonizbas, nga Kartagjena, duke i premtuar Kartagjenës mbështetjen e forcave të tij. Hasdrubali, babai i saj, i dobët dhe i rremë, e pranon propozimin duke e bërë zap popullin e cytur nga një skllav grek dhe vendos për fatin e vajzës së tij.

Edhe nëna e kundërshton fuqishëm refuzimin e saj. Në fund, e mashtruar, Sofonizba dorëzohet, kundër vullnetit të saj, megjithëse dyshon për dëmin që po i shkaktohet Masinisës dhe e vetëdijshme për fajin e një politike të pandershme. Ndërsa ia kursen vuajtjen burrit të saj ajo është e pafuqishme të harrojë. Dhe kur nga fushat e luftës, një grua fisnike spanjolle e martuar me Masivën që i kishte mbijetuar masakrave, dërgohet para saj, ajo duke e pritur me mirësjellje, e tjer në mashtrime dhe i tregon për dashurinë e përhershme të Masinisës; rindizet sërish e gjitha.

Dhe pasi Sifaçe që e kishte torturuar atë me xhelozitë të padrejta, në turbullim e sipër, i vuri flakën kampit të Romakëve dhe u zu rob, atëherë Masinisa ende gjallë dhe i bashkuar me Romakët, i pushton sërish ata dhe pretendon se Sifaçe, tani një skllav, nuk ekziston më për të. Ajo e kundërshton në emër të nderit të saj e thotë se nuk dëshiron të jetë e lumtur ndërsa Kartagjena vuan dhe i lutet që ta dërgojë tek e ëma. Ia merr pëlqimin, por gjatë rrugës i rrëmbehet Kartagjenasve nga Romakët dhe më kot vëllai i Masinisës që aty nuk ishte, i kërkoi Shipios që t’ia kthente mbrapsht por ai e mbajti skllave si shpërblim për triumfin e tij.

Ajo kishte marrë nga gruaja e Masivës një unazë me helm gjarpri, dhe si mbesa, dora vetë e Hanibalit, duke marrë vathët që më pas dhuron, i heq një të gërvishur fytyrës dhe le që në të depërtojë helmi bashkë me vdekjen.

Kudo ajo është e pastër, fisnike, e madhe dhe e matur. Dhe nëse si heroinë tragjike nuk është e pafaj, ajo është fajtores vetëm se i është nënshtruar shumë lehtë martesës me Sifaçen. Është e kulturuar, lexohet në librin e një filozofi grek. Ajo u ofron *Vedantasvemundësinë* që të bisedojnë me të në gjuhën masile të cilën e kishte mësuar nga Masinisa

...

Sa i përket formës, gjuha e pastër mbërrin në zemër për mrekulli. Kemi fjalën e fuqishme, pasurinë e imazheve në një mënyrë orientale. Për shembull, nëna e Sofonizbës akuzon Masinisën duke i thënë: “i ke prerë krifën familjes sonë”. Me pak fjalë, gjuha është e mrekullueshme, fisnike, e lashtë. Ekspertët do të gjejnë ngjashmëri me gjuhënlatine, me këngët shqipe të autorit, aty ku ato janë pjesërisht dramatike; dhe vërtetohet se origjinali shqip është shkruar në vargje”.

31 gusht 1900;
15 shtator 1900;
15 tetor 1900

KREU III

PROFILE HISTORIKO-LETRARE (1833–1896)

1. DOMENIKO BELUSHI (DOMENICO BELLUSCI)

Ja, ndodhi ajo që, vetëm duke e menduar, na frikësonte! Ai që qe tempull i pamjes hyjnore e fëner i të mirëve në Oqeanin e një jete të pasigurtë, është venitur si respekt në përjetësi. Këto rudina, trevat arbëreshe, nxënësit e rinj të këtij monastiri, kanë mbetur si anija e zhgatërruar nga mbytja mbi rërën e pashpirtë, si salë në të cilën flaka është shuar në shalldan (pishtar).

O Zot! Po, unë pashë kufomën të shtrirë mbi arkivol aq të stolisur me veshjet pontifikale, të drejtë e të papërkulur, që vajtonin kambanët, kujtoj për shpresën që u shua, e mbeta i pikëlluar e parafola: “Vetëm ty, o shpirti i qiellnave, ne mund të të bëjmë sakrificën e kësaj therorie kaq të madhe njerëzore”.

I madh është boshllëku, e jeta është e shkurtër, në mënyrë që breznia e tashme mund ta shohin të mbushur. Prift i lartë, ai ofrohej si anije për njerzërit e shpërndarë të Epirit, i vetmi që bekonte veprat e të mërguarve e që jepte shpresë që të vdekurve të tyre t’u hapej një parajsë.

E, pra, në këtë shkretëtirë të qetë, i pavërejtur, pranë varrit paqësor, e para bijve të rinj të një populli në mërgim, unë ndjej se po më shkëputet nga zemra një zë ngushëllues.

Jo vetëm unë, i ngritur gati si një Panteon, duhet t’i vë parasysh madhështinë e monumenteve (përmendoreve), fisnikërinë e zakoneve, fitore dhe lavdi kombëtare e t’iu nxis për nderin e atdheut /të të

parëvet/: Jú, arbëreshë, nuk ju mbesin veçse disa rite dhe zakone dhe një të folur primitiv, tepriçë kujtimesh të lehta të kombësisë e të historisë së vet.

Por, në këtë shkretëtirë të qetë, pranë varrit misterios të një ipeshkëvi (peshkopi) të virtytshëm, e para të rinjve, bij të një populli të mërguar, unë nuk shoh veçse lavdinë e vuajtjes, të qëndresës e të besimit, që juve, o vëllezër, nuk qe e mundur t'iu hiqej. Tituj, pasuri e atdhë, në ikjen tonë, /kur ne u mërguam/, mbetën përtej detit; të gjitha fisnikëritë u shkrinë në këtë fatkeqësi, sikurse fytyrat në varre; e të barabartë për fat, ne i gjetëm në fushën e kryqit, në të cilën, një provë e zemrës dhe jo tjetër, është jeta. E, pra, në këtë gjendje nuk gjej poshtërim, por krenari, si Mesia, që, për të hyjnizuar njeriun, lartësohej në të ndjesia e madhërisë e jo ajo e qejfit; ja, pra, kurrë krishtërimi nuk ka vijuar dobësinë, por fëmijët e tij qenë shenjuar për fitoren e botës, sikurse lisat e pishat e lartësuara në alpet kundër stuhisë.

I.

Unë nuk mundem të përmbaj përballimin, kur, duke tërhequr syrin prej kufomës së stolisur me kurorë, kujtohem për ditën që nëna e porsatëlindurit e çoi në krah, e admiroi dhe u gëzua, pse i kishte dhënë tokës një njeri, e më shkon mendja se nëpër çfarë ambicjesh të holla dhe shtëpish të thjeshta ai rritej, afër vllájve të trandafilëve, histori e thjeshtësisë e bashkuar me ngritjen! Prej një fare të vogël sinopi përhapet në ajrë e, në mes të familjes së degëzuar, ka hijen e vet dhe degëzat e veta, mbi të cilat vijnë e pushojnë zogjtë; rinia, e kufizuar në shtëpitë atërore dhe në shkollat, qëndron e përvujtë dhe e fshehur, pastaj gjëndet zotëruese e vetme e tokës, e vrojtueshme prej vetëvetes mbi hirin e breznisë së kaluar; e ka, gjithmonë, një ndryshim të pluhurit në jetën e pavdekshme, prej fëmijës, i zbrazët në fjalë, si të paarsyeshmit, tek njeriu që mbushë qytetin e vet me mendimet e veta edhe e ndikon me dëshirat; e kjo /ndodh/ pse kemi besim e lartësojmë shikimet në atë bashkim virtyti e lavdie, për të cilin është gjithësia, ndërgjegja intime e që shenjtëron natyrën njerëzore dhe e bën mbretëreshë të kësaj bote.

Më se 9 vjet, jetuar jo ndërmjet shfaqjeve dhe harmonive që tundin thellësinë e shpirtit dhe ndezin atë afsh të pasionuar, që është si rrezja e një bote tjetër, por të njohura porsa për dashurinë pa halle të botës

së jashtme, Belushi, si ky, i thjeshtë, i lirë, i qetë, i mbyllur (i vetëmuar), vjen këtu me gëzimin e pakufizuar të së resë.

Në ngjashmëri me lulëzimin e tokës, që ka favoret e pranverës ose të jetës së njeriut që ndezet në gjirin e nënës, e cila është fshehtësi dashurie, ai, i caktuar për t'u bërë një ditë ngushëllues dhe ndriçues i një populli të vuajtur, u rrit në flladin e asaj lavdie që këtu na paraqitet një dhe e panjolllosur me thjeshtësi e kënaqësi që në botë nuk ka kurrë. Ecën bota e madhe si e shpërndarë në njëmijë rrugë, në të cilat ecën gjinde e pambarim e kush nget përpara në njerën, thërret kundra atij që përparon në tjetrën, dhe bëjnë kundërshtime dhe fyerje derisa lavdërimi u zhduket të gjithëve si iluzione; por në këtë tërheqje të kthjelltë talentet fisnike e intelekti pa rival gjejnë, përherë, kaq admirim që është balsam për plagët e zemrës, duke mos qenë veçse një karrierë dhe një cak për të gjithë ata që grumbullohen prej vendesh së ndryshme e prej fatesh së ndryshme. Ky strehim zanash të Greqisë, i mbjellur në Kalabrinë e pyllëzuar, si një përmendore (monument) i kohës heroike, duket se ruan shenjat e rilindjes së virtyteve të moçme. Këtu gjejmë që, në gjuhën tonë dhe në zakonet tona, jetojnë ende në njëqind fshatra të tjerë të largët; këtu jeta, pastaj, që është një pritje, nuk është e tërbulluar prej mendimesh për zgjedhjen e veprimeve; këtu shpirti i pastërt pushon te një mik i ri, e prej dashurisë formohet një botë ëndjesh ose konsumohet në zotin për lotët dhe për ekstazin, e si prej gostisë së gëzueshme në lozhet e vështira, dërgon prej xhamave të mureve një shikim mbi ledhin e bardhë rrethues, gati si në sfondin e skenës.

Shpirti im është i mbushur plot në këtë vend sa s'mund të harrojë ndërmjet objekteve të ndryshme që do t'i kalojnë deri sa do të jetojë në këtë botë. Po deri kur do të na tërhjekin këto ledhatime? Yjtë kërkojnë natë, lulet kujtojnë venitjen e shpejtë të jetës, e rinia që mbi arkivolin e një njeriu mendon tërheqjet e kënaqësitë, bën të kujtojë pjesën hyjnore jo të mundur në shpirtërat krejtësisht prej fajit, e që çohet prej fundit të rrënimeve të shkaktuara prej saj; por këto kujtime të përvetësuar prej lotësh nuk paraqesin një simbol të kësaj qetësie të qëndrueshme, të asaj fuqije, mbi të cilën qëndron gjithësia me dukuritë e saj të ndryshme. E këtë simbol të admirueshëm, shpirti i njeriut e dëshiron, pa pushim, për ta arritë, si përsosmëri e natyrës së vet. O kolegë, që edhe pak vjet iu kanë mbetur këtu për të dalë së bashku me rininë, tashmë, të përfunduar, që, lagur me lot, jeni ndrydhur në këtë

kufomë sikur në varrin e mjeshtrit hyjnor, e puthur keni dorën e atij që shpërndan mendime të larta të kësaj moshës suaj e që, me adhurim e dashuri, besoni që qëndron, tash, në zotin e alltareve tuaj, deh!, lartësoni shikimin si një synim e premtim, në kohën që, si patriark në kishën e vëllezërve, tregoi atë besim e virtyt informues, për të cilin Krishti kishte parafolur për të: *Jo, ai nuk është një kallam i lëvizshëm prej erës në shkretëtirë.*

Në këtë kohë, ne, larg prej vendeve e vetëm në pamje të horizontit, që në qetësinë e saj rrin e gatshme si për t'i shtuar hovin e lëvizjes së familjes frymore, shohim me ngjyra të mekuna dhe të pamjaftueshme turbullimet dhe rreziqet e gjindjes njerëzore. Megjithatë, për të mos ju dekurajuar në vështirësitë e ardhshme, le të ju vlejë për të jua paraqitur këtë mendim, që, kundra nesh, në këtë tokë, nuk ka gjë së cilës mos të mundemi t'i përballojmë me fuqitë tona, e deri sa gjëndet në mundjen e vdekjes një lavdi hyjnore, e cila në amëshimin e gjithësisë ndjek shpirtin e pavdekshëm dhe e shoqëron me lavditë e tjera për atje ku Zoti synon. Në këtë vështrim në procesionet e shenjta përdorin të krishterët vendosjen e pikturës së virgjreshës e të martirëve të fesë mbi shpinën e një arkivoli të stolisur lehtë. Një erë e fuqishme ishte fryrë prej Zotit mbi faqen e tokës, kur ai qe caktuar për t'u djegur në pishtar. Rrugët e qytetit të trishtueshme prej zisë, detrat të kërcënuar nga anijet, ky vend, i mbushur me gëzimin rijnor, mbetur bosh nga nxënësit, e Peshkopi i fortë, që pruri në fillim fisin e Epirit në këto heshtina, si në një ishull të vetëm, kish ikur një natë të stuhishme prej atdheut të vet. As aty nuk gjente besim në të vetët, as në miqtë, duke qenë tërë bota një fushë e gjerë lufte; e, pas disa ditësh, e nuk e di se me çfarë syri shikohej prej tij, u gjet i copëtuar me thika, duke derdhur gjakun, të cilin e piu dyshemeja e një hambari, ku ishte fshehur. Kufoma e tij e gjakosur, hedhur në një arkivol, zhdedhur nga ritet priftërore, shëmtuar nga copëtimet, qe bajtur në dritë të hënës në kishë e, prej duarësh të panjohura, u mbulua në varr. Prej çfarë idesh të fuqishme nuk është objekt drama e njeriut, në mënyrë që zhgattrimi i tij mos të mbytet në një oqean mëshire e mrekullie, frige dhe dhimbjeje. Zogu grabitqar lartësohet mbi erën, në mes ajrinave, në re shikimi i tij i mprehtë ecën prej detit drejt, drejt kahë malet e zbret dhe han prenë e vet, struket në çerdhe, ku vrullit të stuhisë, i qetë i len puplat e flenë për t'u zgjuar atëherë, kur, mbasi të jetë kaltërsuar qielli, hijet do të jenë të shpërndara mbi tokën e bukur.

Por njeriu nuk paraqet një fushim të thjeshtë dhe një veprim të thjeshtë. Mendimet e tija, dëshirat e tija, faktet e tija, gëzimet e tija, komunikojnë me tjetrin në jetë dhe pas vdekjes dhe zhdukja e tij është si një gjamë e krijimit. Alltaret u duken se u zbehën në të gjitha fshatrat; arbëreshët, shumë priftërinj e famullitarë, viktima të shkreta, ikën për t'u bashkuar me ipeshkvin (peshkopin) martir, sepse u friguan të mos shkriheshin me italianët e të mos zhgatroheshin. Gjendje e mjerë e një populli, mbushur me kujtime heroike që, i hedhur si gjyle në fushë, nuk është zot i rrugës së vet e i sunduesve të vet kombëtarë, por mbahet vetëm nga lutjet e veta e nga favorët e të tjerëve!

Por Zoti kishte vendosur ndryshe për bijtë e këtyre etërve, që përballuan lumin e pamasë të barbarëve e me sakrificën e fateve të tyre larguan çfarosjen prej Europës besnike.

Ipeshkëvia, që është si kurora e popullit të Skënderbeut, u kthye për të shndritur në mes të saj që të përhapë shpirtin shenjt mbi famullitarë dhe priftërinj. Për gjendje4n e veçantë të çështjeve, e cila veshi me drejtësi e shpirtmadhësi popullore aktet e *Zotruesit absolut*, që zgjedhë një i ri prej Frashinetit me nam të madh, tepricë e Kolegjit mbas Avatasve dhe Varibobëve, Baffëve dhe të Masheve. Shumë prej tyre, që kishin qenë nxënës të këtij institucioni, kishin dëgjuar të mësonin histori e filozofi në mënyrat e veta të veçanta, të reja, të sigurta, origjinale, të qëndrueshme për t'u shtypë në mendjet, si shenjë fuqije intelektuale mbi vështirësitë e pakapërcyeshme. Ishte folë, pastaj, për një teatër më të gjerë, e atje në Napoli, në mes interesash së panumërta, atëhere të rebeluar dhe të ndezur prej stuhive të shtetit, e ngjashme me anijen që nuk mbytet në detë, por lartësohet mbi tallazet, ai, për hirë të kulturës së tij të mrekullueshme, kishte shndritë ndërmjet më fisnikëve të atij kryeqyteti e ishte bërë mik i Çirilit e Paganit, e shok i tyre në burg, prej ku qe nxjerrë, pse tepër i ri, e, pastaj, qe nderuar prej mbretërve legjitimë. Ai dukej i rrethuar prej një aureole lavdije e fati në ndriçimin e në gëzimin e një dite, në të cilën barka e Israelit i kthehej Padiljonit e Zoti përtërinte aleancën me popullin e vet, me ritin e shenjtë të Etërve në krye. Ah! këto shtylla këtu do të kenë marrë pjesë në ekzaltimin e përbotshëm, e hymni madhështor o *Mbret qiellor* do të ketë shkrirë qiellin e tokës.

Ndër i madh dhe i pakrahasueshëm është, tashti, ky që më takon: të çohem e të flas përpara arkivolit të tij. Natyra bën që të lindin lulet

mbi pluhurin e njeriut për të shpërndarë tmeret e me bukuri të reja të mbulojë vendin. Por, a do të mundem unë të bëj që të burojnë gëzime për të zhdukur shtangimin e rënjes së tij? Të zbresish këtë shpirt të madh, siç ka bërë vdekja, e t'jua paraqes juve në atë dritën më të bukur që e pat në jetë e në lavdinë që tash ai gëzon, mundte vetëm një mendje e tij, që për të ardhmen do të jetë përherë për ne e heshtur.

Mendje e efektshme, që me përulje dinjitoze e të përvujtë në kryq, mundte vetëm të shpërndajë turbullimet e shpirtërave tanë, e ne, të penduar, hidhnim mosbesimet që ai i Madh nuk kishte. E tejdukej nga sjellja e rreptë, e përbërë jo prej pasqyrimin të shpirtit, por prej lartësisë së vetëvetishme, të atillë që Zoti i Ungjillit don për të gjetur kënaqësi në veprën e vet. Dhe asnjë ide e egoizmit, e bashkuar me këtë pamje, nuk e zvogëlonte madhësitinë, që, për ta parë e për ta dëgjuar, ndryshonte shpirtërat në një vis sublim e të paiterësë.

II.

Arsyeja i dha një trajtë, një materie e një ngjashmëri kufomës dhe arkës: orët e jetës, herë të gëzueshme, herë të dhimbshme, rrjedhin ndërmjet këtyre dy kufijve, përtej të cilëve është qetësi dhe heshti. E sa ka dashë Provania, që si njeriu që para se të lindë nuk duhet dhe as që mendohet, kështu mbasi vdes, marrin fund dhimbjet dhe vajtimet, pse jeta mban vetëm sundimin e ditës dhe të natës. Ja që mbeten në një zbrazëti, si mbesin jetimat në vitet më të rinj, që vetë atdheu duket se nuk ka për ta festat e tija dhe ditët me diell. Dhe, megjithëkëtë, ndikimet e të dalluarve të mëdhej jetojnë edhe përtej varrit. Nuk qe kurrë në këtë institucion lavdia e ndier dhe e dëshiruar si tash dhe askush nuk pat kaq dashuri për Atdheun, e kjo fatkeqësi (si stuhia për bimët) qe dërguar për të na kalitur në durim. Arbëreshë të të gjitha anëve, që endë ruani kujtimin e vëllazërisë së trimërisë, që duani ritet e tempullit, që flitni të njëjtën gjuhë dhe shpresoni bashkimin, qëndresë e guxim! Rreth këtij arkivoli, i përbashkët si logu i kuvendeve, ne të zhdukim mosmarrëveshjet dhe ashpërsitë, të lusim që të vijë mbretëria e qiejve, ku është forca heroike e zemrës, ku është kënaqësia e thjeshtë e ndjesisë dhe bollëku i drithit e i vajit.

2. JUL VARIBOBA (GIULIO VARIBOBA)

Jul Variboba, /qe/ poet i shenjtë origjinal, prej Mbuzatit. Vjershat e tij shqip, të shtypura (të botuara) në Romë, mbetën të panjohura. Autori kishte kënduar për të devotshmet e Mbuzatit, e nuk deshi tjetër lumturi veçse t'i shihte këngët e veta të shpërndara ndër gjashtë fshatrat greke të Mbuzatit, të Vakkariccos, të Strigarit, të Makjes, të Shën Mitrit e të Shën Sofisë; kështuqë poezitë e tija, duke mos qenë të përkthyer, për t'i lexuar të huajtë, deri tashti nuk janë tjetër veçse këngë popullore.

1833/1838

3. FRANÇESK AVATI (FRANCESCO AVATI)

Françesk Saverio Avati prej Makjes, /qe/ nxënës, për kohën dhe për zulmën (lavdinë) e vet, në mes të të parëvet të Kolegjit grek. Anxhelo Xavarrone flet për të. Vdiq plak në Urbino më 1800. Në mes nesh mbetën (ne kemi) prej tij disa letra dhe një dorëshkrim rinor, plot me erudicion kishtar e të arsyeshëm.

1833/1838

4. FRANÇESK BULJARI (FRANCESCO BUGLIARI)

Françesk Buljari prej Shën Sofisë, i ngritur në peshkop, shpejtoi lejen (konçesionin) e abacisë së Shën Adrianit, e, mbasi e mori, në manastirin me këtë emër, të vendosur në një pyllë me dy të treta të milit prej Shën Mitrit, barti (transportoi) Kolegjin, që e kishte banesën në Shën Benedetto Ulano. Më 1806 qe mbytë (qe vrarë), në shtëpinë e tij, prej një çete bâkëqijsh.

1833/1838

5. PASKUALE BAFI (PASQUALE BAFFI)

Paskuale Bafi në moshën 22-vjeçare doli prej Kolegjit me tre të rinj të tjerë, për të qëndruar (për të zënë vend) mbi katër katedra letërsie, të hapura nën drejtimin e Saverio Matteit. E qe, pastaj, njeriu që pat talentin e Maxxokkit e shpirtin e Sokratit.

1833/1838

6. ANXHELO MASHI (ANGELO MASCI)

Anxhelo Mashi, lindur sikurse Baffi në Shën Sofia, qe për të një mik i denjë. Vdiq në Napoli, këshilltar i shtetit. Prej tij mbeti një vepër shumë e vyer mbi kombin shqiptar.

1833/1838

7. AGOSTIN TOÇI DHE GULJELM TOÇI⁶⁹ (AGOSTINO TOCCI E GUGLIELMO TOCCI)

Ndoshta asnjë popull, për të ruajtur fenë e vet dhe nderin e vet, nuk u zhgul kaq fort, sa populli ynë, prej tokës ku lindi; dhe për kurrnjë nuk qe paraqitur nisja e zotave të shtëpisë atërore me poezi të tilla të ngjashme. Por kush ishte zotni Andrea që bëri gati anijet? Nga cili port i ngrehën velat? Gjithëçka është e panjohur (asgjë nuk dimë).

Guljelm Toçi nga Strigari, në një libër të ri që qiti në dritë dashurinë e tij për atdheun /e të parëvet/ dhe shumë kujtime tona të fshehura, (e që, tash, po përgatit përkthimin dhe botimin e poetit Variboba) më tregoi (më dha) një dorëshkrim, që e kishte gjetur në letrat e shtëpisë së tij /të zotit Flamin Toçi nga Shën Kozmo/, e në të cilën tregohet për ardhjen tonë të shkretë në Itali. Është shkruar me dorë prej fisnikut Agostin Toçi, që ka jetuar në fund të shekullit XVII. Është mirë që të njihet në atdheun /e të parëvet/ tanë.

1866

⁶⁹ *Rapsodie d un poema albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Tipografia di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866, p. 97.

8. MILO SHINI ⁷⁰

Milo Shini, në opinionin popullor, është heroi i dytë kombëtar pas Skënderbeut. Me të vërtetë, ai është kavalieri (kalorësi) ideal shqiptar: me shpirt të thjeshtë, i pamundur (i pathyeshëm), e mbi të cilin i gjithë nderi mund të rrijë i paluejtshëm, i qëndrueshëm, në fé të Zotit dhe në të ndershmit e atdheut të vet. Poeti duket se nuk ka bërë tjetër veçse ka imituar prej realitetit ose vetëm ka krijuar një gjendje (situatë) hyjnore për të vënë në dukje heroin e ri, që, mbasi është ngritur prej tryeze, e, mbasi ka mundur /ka fituar mbi/ një ushtri të tërë, mbetet i plagosur nga i vëllai, që nuk e din sherrin e që lufton për të ruajtë turqit. Atij i ka dhënë ujë, gjithashtu, dhimbja e vdekjes së tij, nga zulma (lavdia), nga kënaqësia e kthimit të të vëllait në shtëpi dhe nga parrizi që e pret.

Në librin e tretë mbyll historinë tonë të fundit e të madhe Pjetër Shini; por këtë familje gjysmëperëndish hesht Barleci.

1866

⁷⁰ *Rapsodie d un poema albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Tipografia di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866, p. 66.

9. KOSTANTINI E GARENTINA⁷¹

Skena e tmerit që rritet dhe e heshtjes, e bashkuar me anën dramatike të shkëlqyer dhe me besimin dhe nderin kristian; e, pastaj, ndjenja e thellë e jetës kanë bërë që kjo këngë (nga e cila njoh tri përkthime të bukura poetike, të Rafale Lopez, të Luixhi Petrassit e të Anxhelo Baziles) të mbahet nga shumë vetë si mbretëreshë e të tjeravet. E çfarë poezie tjetër, në të vërtetë, mund të jetë më e lumtur se ajo e idesë së djaloshit Kostantin, që, i thirrur nga vendet e të vdekurve për një mision të kobshëm, hyn në qytet me kalë e takon fëmijë të shkathët të motrës së vet, që lozin duke ndjekur dallandyshtet, e, pastaj, duke u afruar te vallja e zonjavet, thotë me vete: “Vasha, të bukura jini, /porse hijeshi për mua s’kini”? Ka në përmbledhjen e Forielit një përpunim të kësaj legjende në gjuhën helene; dhe askund një e tillë, e ngjashme me këtë, s’mund të jetë bërë në sllavisht e, prej nga, ndoshta e nxuar Bürgeri Eleonorën e tij. Kjo përshkoi gjithë Europën e, megjithatë, sa e vogël është, lidhur me jetën e qartë dhe të lakuriqtë, përkundrejt origjinalit shqip.

1866

⁷¹ Po aty, p. 32.

10. XHUZEPE DE RADA (GIUSEPPE DE RADA)⁷²

Dje vdiq, pas një lëngimi të gjatë, që e duroi vazhdimisht në këmbë, Xhuzepe i Radhanjet, i biri i drejtorit të *Fiamurit /të Arbërit/*. Djalosh i tipit më të mirë shqiptar, kishte ndër buljarët tanë, shumë në kujdes fatet e Shqipërisë së pafat.

Kish lindur në Maqë, një fshat i vogël, katër kilometra larg prej Shën Mitrit, në janar të vitit 1852.

Gjatë vjetëve 1868–1869, në Kolegjin e Kurljanës (Koriljanos), ku rritej (edukohej) nga i ati, hartoi Gramatikën shqipe, e cila, kushtuar Zonjës Elena Gjika, që ishte fener i Shqipërisë së saj, qe shtypur në Firenze, më 1871. E, shpejt, mbasi u njoh në Europë, tërhoq vështrimet e më të ndriturvet për urtësi (sllavisti Miklosich, Meyer i Universitetit të Gratz-it, e mjaft të tjerë). E ajo gramatikë, ndonëse jo e përsosur, sepse ai nuk e kishte përfunduar së botuari, është e vetmja që përmban ligje të sigurta e të paluajtshme të gjuhës shqipe; prandaj, me arsye të madhe, Louis Benloew i Institutit të Francës, e mbështeste mbi të *Analizën* e tij mbi gjuhën shqipe (Paris, 1879). Pastaj ai /d.m.th. Xhuzepe/ la edhe shkrime të tjera.

Nga studimet suall në jetën e përjashtme një drejtësi e një mirësi të bardhë e të nderuar ndaj besës së shenjtë të prindërvet, aq sa kurrë nuk u tha se pat ai ndonjë armik, e sot që e buarëm (e humbëm), na bën të kujtojmë vjershën popullore: “Kushdo që e njohu, e deshti mirë; të gjithë dëshironin që t’i jepnin kënaqësi”.

Në vitin 1879, u martua me një zonjë shtëpie strigariote (nga Shën Kozmo), motra e Guljelm Toçit, që qe deputet te kuvendi (parlamenti)

⁷² *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883, p. I.

i Italisë. E pati nga ajo dy djelm, prej të cilëve më i madhi, dy vjeç, vdiq këtë muaj, tetë ditë më parë se prindi, e mbas tij e tërhoq edhe atë. Fshati, që e pati bir, e qau në mënyrë të pangushëllueshme. Kolegji arbëresh dërgoi, nga ana e vet, dy klasë për ta përfaqësuar në shoqërimin e kortezhit funeral, të cilit iu bashkua, gjatë rrugës për në Shën Mitër, i gjithë kleri i kësaj komune. Nderime të tjera, gjaku ynë i shpërndarë në Itali dhe i shkretë për vuajtjet (dhimbjet, helmet) e reja në Shqipëri, nuk pat nga t'i bënte.

Maqë, më 20 të Shën Mërtirit (nëntor) 1883

11. ANASTAS KULLURIOTI⁷³

Në “Bashkimi”, fletore greke e Aleksandrisë së Egjiptit, lexojmë:
 “I njohuri në Athinë, si mik i shqiptarëvet, për më tepër si apostull i shënuar /i përmendur/ i arbëreshëvet /të Greqisë/, Anastas Kullurioti, mbasi pat shkuar në Shqipëri të Jugut që të ndezte atje dëshirin për gjuhën shqipe, një ëndërr e zbrazët që ia ka marrë mendtë, qe zënë prej konsullit grek, që është në Gjirokastër, e cili e dorëzoi ashtu me një herë në duar të grekëvet, që ishin ngritur kundër tij e që gjindeshin të shpërndarë nga çdo anë; e, në mes të rojevet të veta, e dërgoi në Korfuz”.

Mbi këtë lajm as që duhet tjetër fjalë, sepse edhe ai më truthati, në se ka ndonjë në mes të shqiptarëvet, e kupton se çdo të thotë lidhje e jonë me grekët. Porse ne donim që Europa t’i vinte mendjen kësaj furie të tërbuar të grekëvet, përsa i takon zgjimit të ndërgjegjes kombëtare të shqipëtarëvet. Ky idhnim i përngjet zemrimit të judejvet kundër fesë së ré të Jezu Krishtit; e pastë edhe fatin e atij hidhërimi: ata, kudo që gjindeshin, pak a shumë, nëpër katunde, të huaj, mbasi e dëgjonin, ngriheshin të egërsuar për ta shuar në gjak të apostujvet; derisa e drejta e botës njerëzore, e mishëruar te më i buti i perandorëve romakë, ua pat shkelë atyre mizorëve në gji pabesinë deri sa u dha fund (= i mbyti).

15 dhjetor 1883

⁷³ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883, p. III.

12. DODË GEGA⁷⁴

Nga Mirdita që edhe Dodë Gega.

Kishte lindur në Orosh e, si më të shumtët, jetonte ndër pasuri bejlerësh, që i mirrte me qirà. Kështu shkoi, pastaj, në dhé të Gjakovës si rojtar lopësh, ku u lidh me malësorë hajdutë, e u njoh si njeri i fortë nga trupi e nga mendja. Atje, shërbëtorët e zotërivet turq ia hodhën sytë sipër dhe e përkëdhelën.

Ndodhi që, një ditë, në Pukë, nëntë orë larg nga Shkodra, erdh një ushtar i ri elbasanas, Ibrahim Zaka, që e mbante kryet gjithmonë të përkulur poshtë mbi gjoks. Kur dilnin të bënin ushtrime, kapterri i thonte: Ngreje kryet, por ai s'e bënte dot; deri që kapterri i vuri një picigû (drû të mprehtë me majuc) nën mjekër e te gropa e fytit, në mes të të qeshurave të turqëvet. Por, mbasi sosi (mbaroi) ushtrimi, ai vajti në kalà e u mbyll brenda e ua mbylli /derën/ të gjithëve, e u zhgrehu /armët/ atyre (i qëllonte me armë ata) që qaseshin ta hapnin. Shtatë vetë vrau ndër shokët, sa që asnjë më nuk guxoi të shfaqje ngaha ai arrinte me sy.

Agjëroi dy ditë; të tretën natë, i ndihmuar prej shokësh shqiptarë, doli. Shpëtoi, iku në Orosh, duke u strehuar në shtëpinë e Kapidanavet të Mirditës. Mbas disa ditësh, sipas urdhërit që erdh prej Stambollit, sundimtari ua kërkoi atyre të shtëpisë, o të gjallë o të vdekur. Ata u përgjegjën “se prindërit e tyre nuk i kishin gënjer kurrë mysafirët e tyre dhe ata nuk do ta njollosnin nderin e prindërvet të tyre as për një botë të tërë”. Ndodhej, atëherë, i kthyer në Orosh Dodë Gega, me të cilin qeveritari bëri lidhje dhe i premtoi se do ta bënte kapterr.

Ky iu afrua Ibrahim Zakës e thuhet se e magjepsi me fjalë. E, duke ua kaluar miqëve, me ditë e me javë, e duke i treguar ai letra të

⁷⁴ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 5, Corigliano Calabro, 30 febbraio 1884, p. V.

sundimtarit, me të cilat i premtonte falje, një mëngjez e nisi dhe e solli me vete në Shkodër. Këtu e hodhën në burg e, pastaj, e dërguan në Podgoricë, e atje e vranë.

Dodë Gegën e bënë kapterr. Shtëpisë së Kapidanavet të Mirditës i erdhi kaq keq sa që disa /të asaj shtëpie/ vanë e i vranë atij nuk dij se cilin, axhën apo të vëllanë. Gjak për gjak, si është zakoni.

Pas kësaj, Sulltani dërgoi në shtëpi Bibë Dodën, një djalë nga kapidanat që, atëhere, studionte në Stamboll, me qëllim që ai t'u printe mirditasvet në luftën kundër Malit të Zi. Por atje u mblohdën pleqtë e fisevet e bënë këshillë: pastaj u përgjegjën "që Porta e Lartë, kur hoqi nga gjiri i Mirditës një mysafir dhe e vrau, /me këtë veprim/ dhunoi paktin e Dukagjinit Leshzi; prandaj edhe ata ishin të zgjidhur nga ai pakt, që ua bënte një detyrë ta përkrahnin në luftë.

Atëherë një ushtri turke, nga Shkodra u ngjit në Mirditë, me pararojë Dodë Gegën, rrethuar prej hajdutësh nga malet e Gjakovës, nga e cila, të afërit e miqtë shkonin duke akuzuar kapidanat /e Mirditës/ që, të porositur nga Franca, donin të zgjidhnin (të prishnin) Lidhjen e Prizrendit, dhe, o sepse ishin të krishterë, o sepse ishin kushërinj me Vlladikën, punonin që t'i jipnin Malit të Zi vise të Shqipërisë. Prandaj Mirdita u mpî e ndrujtur (hezitoi me dyshim) dhe shumë vetë nuk u nisën (nuk shkuan, nuk u vunë për rrugë) me flamurin e Kapidanavet, të cilët qenë thyer, dhe ra në fushë të betejës zoti Gjon. Dodë Gega shkoi përpara e u dogji atyre pallatin. Pas këtyre veprimeve që emëruar bajraktar; e, si kudo çdo njeri i lik (i keq) i përkrahur (i ndihmuar) nga fuqia e zotërisë ndaj të cilit është shërbëtor, edhe ai /d.m.th. Dodë Gega/ muar kreni të padurueshme (u bë arrogant i padurueshëm) nga mbështetja që kishte prej qeverisë turke, aq sa një hije e keqe pat rënë edhe mbi fatin e malësorëvet të Shkodrës.

Pastaj, në vjeshtën e këtij viti, i biri i Kapidan Gjonit, si hyri në /moshën/ pesëmbëdhjetëvjeçare, i doli përpara në treg të Oroshit e me pushkë ia dogj gjoksin.

13. LEONARD DE MARTINO (LEONARDO DE MARTINO)⁷⁵

Leonard de Martino, arbëresh, lindi në Greçi di Pulje, që, duke folur me gjuhën e prindërvet, zgjoi Shqipërinë e Sipërme, e tek i cili mbështeten aq shpresë tonat.

Ky, që është edhe një poet fisnik italian, frymëzoi ndjenjën kombëtare në Institutin fetar qytetëruës, përgatitur me anën e stigmatineve nga prefektët apostolikë Át Xhiampiero da Bergamo e nga Át Mariano da Palmanova, në Shqipëri, atdheu i tyre i adoptuar. Sot është në Shkodër një Strehë (kuvend) dhe një shkollë, në lokalin e të cilave mbahen, me kujdes hyjnor (me provani), qytetarët me një kolektiv që, në pakë ditë, arrinë 12.000 lireta, e ku mblidhen përmbi 300 vajza shqiptare, katolike, ortodokse e myslimane. E shumë thanë se janë ditare (gazeta) të shpirtit shqiptar, prej kahë ato i dërguan Princeshës Dora D'Istria një pendë, punim ku s'shkon më i bukur, në filigranë, e për të cilën, në përgjigjen e ëmbël, thuhet "que soit employée à défendre l'honneur et les droits de l'Albanie, ma patrie vénérée" (= se do të përdoret për të mbrojtur nderin dhe të drejtat e Shqipërisë, atdheut tim të nderuar). At Leonard, që, tashti, është famullitar i Troshanit në Mirditë, si mbrojtës i një drejtimi të tillë të shpirtëravet, për t'iu dhënë guxim dhe për t'ua zgjeruar mendjet, hartonte një dramë të shenjtë baritore, plot me vërtetësi dhe natyrësi që qe, e para dramë shqiptare, shfaqur nga nxënësit e shkollave popullore në kishën e françeskanëve në Shkodër, natën e krishtlindjevet më 1880.

30 mars 1884

⁷⁵ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 6, Corigliano Calabro, 30 marzo 1884, p. VII.

14. XHOVANI EMANUEL BIDERA⁷⁶ (GIOVANNI EMANUELE BIDHERA)

Xhovani Emanuel Bidera, fisnik për nga lindja dhe për nga ndjenjat, mbajti lart, në Napoli, emrin shqiptar, nga viti 1836 deri më 1848. E madhe qe lumturia ndër 90 ditët e tij të kolerës dhe të *Shëtitjeve* të tij *përreth Napolit*, kuadro (piktura, figura, pamje) shumë të bukura në miniaturë (në pikturim ose në përshkrim), nxjerrë prej së vërtetës. Shkroi librete për muzikë, në mes të së cilave *Xhemma* për Donixxettin, si edhe një libër të arsyetuar deklamimi. Vdiq para se të përfundonte pëlhurën e gjerë /të veprës/ së vet *Mattneer* (= Mat në erë).

30 prill 1884

15. PETI MITKO I⁷⁷

Këto shkolla u themeluan, në Korçë, me përpjekjet individuale të Peti Mitkos. Fatkeqësisht, turku nuk lejon të studiohet gjuha amtare, shqipja, sepse kështu do edhe politika e kishës greke e Konstantinopolit që, gjithashtu, veproi, së pari, me rumunët e me bullgarët. Këto shkolla kanë një fond prej 12.000 lire stërlinash, me interesin e të së cilave mbahen, dhe që me nxitjet e Peti Mitkos, qe mbledhur /ky fond/, në mes të tregtarëve korçarë në Egjipt. Dihet se, i pari që dërgoi pjesën e vet, qe Doktor Mihail Gjoka.

30 qershor 1884

⁷⁶ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 7, Corigliano Calabro, 30 aprile 1884, p. VIII.

⁷⁷ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 9, Corigliano Calabro, 30 giugno 1884, p. VIII

16. PETI MITKO II⁷⁸

Kur Peti Mitkos, promotori i shkollave /shqipe/ në Korçë, iu desh të marrë rrugën e mërgimit, doli në popull një këngë, në të cilën pasqyrohet bashkimi i shpirtëravet (që u ndoq, gjithashtu, edhe në Itali) në mes të popullit shqiptar, dhe të buljarëvet (fisnikëvet) të tij, që ndjehen si degë të së njëjtës pemë. Plot ëmbëlsi dhe mirënjohësi e patëkeq (e thjeshtë), përfundon me këto dy vargje:

“Zoti Peti të qëndrosh,
Dhespotnë mos e dëgjosh,
O Peti, të ruat Norka⁷⁹,
Shpëtoi nga nizami Korça”.

30 korrik 1884

17. VINÇENCO DORSA (VINCENZO DORSA)⁸⁰

Vinçenc Dorsa, shumë i ri, më 1844 tërhoq mbi vete vëmendjen e dijetarëvet me njohuritë (dijenitë) e tij historike mbi shqiptarët e mbretërisë së Napolit. I la, pastaj, dhuratë publikut studime, përherë e më të mira (më të kujdesshme), dhe të matura (të urta) në lëndë /të atilla/, të lënë pas dore, ndër né; dhe sot është, ndoshta, këtu i vetmi lavrues i folklorit. Në librin e tij të fundit *Tradita greke-latine ndër vendet e Kalabrisë*, ai çekë (zë në gojë) kërkime të reja që, nga jeta kalabreze, do të përhapen në atë të ngulimeve arbëreshe.

30 shtator 1884

⁷⁸ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 10, Corigliano Calabro, 30 luglio 1884, p. VII.

⁷⁹ Norka/ishite bija jonë, Eleonora, të cilën e deshte si fëminë e tij, sepse ky (xhaxhai ynë) nuk pati fëmijë. Vdiq në Selanik. (Thimi Mitko).

⁸⁰ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 11, Corigliano Calabro, 30 settembre 1884, p. VII.

18. PRENKË DOÇINGA SHKODRA⁸¹

Po i botojmë këto vargje të një atdhetari të ndritur nga Shkodra, mërguar në Athinë që prej vitit 1874, për t'iu përgjigjur, para së gjithash, nevojës që të bashkohemi në gjuhë, /e cila është/ detyrë e parë e *Fiamurit /të Arbërit/*. Dhe pritëm për t'i vënë për bri, jo gjithaq si shkrim dashurie, por si adhurim i vërtetë, të cilëve, me ndjesi të thjeshta e të natyrëshme, ata u rrinë në krah si bij të një kombi.

30 shtator 1884

⁸¹ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 11, Corigliano Calabro, 30 settembre 1884, p. VIII.

19. KOSTË BELUÇI (SHALA) (COSTA BELLUCCI)

Përpara se të lëmë fushën e këngës popullore, po u paraqesim lexuesvet të *Fiamurit /të Arbërit/* një poezi të një njeriu të popullit, dhe të cilën fshati, ku lindi, e bëri të vetën.

Është një satirë shumë e këndëshme, dhe fytyrat (figurat) e njerëzvet të vërtetë, që ajo përmban, u shfaqën, gjithënjë, me dëshir atyreve që i njohën në jetë. Çdo imitim i realitetit fshataresk ka pjesën e çmimit në besnikërinë e pikturavet (portretevet).

Ajo, jo vetëm që është një përmendore e gjuhës, që flitet sot në kantonin (krahinën) e Shën Mitrit, por jep edhe një idë të plotë mbi gjendjen e lirë dhe të lumtur shoqërore – nën monarkinë absolute–të kolonivet (ngulimevet) tona /arbëreshe/, dhe në të cilat, si dikur në Athinë, fjalët e holla e me kripë të Aristofanit derdheshin pa bujë mbi shokët e jetës.

Me të vërtetë shpirti i vjershëtorit shfaqet në këtë jo me hidhërim, po, përkundrazi, me dashuri kundrejt njerëzvet, të cilëve u zbulon të metat, duke mundur kritika e tij, nga kjo anë, të pasqyrojë atë që ushtronin në Romë sherbëtorët e shtëpisë mbi të zotërit e tyre, ditën kur ishin të lirë.

Hartuesi se një rrobaqepës nga Shën Mitri, që vdiq pas vitit 1860, dhe shërbeu si ruajtës i pyjeve të bashkisë. Po në fëmëni bëri mësimet e para në Kolegjin arbëresh, si nxënës i jashtëm dhe, për këtë arsye, gjejmë në poezitë e tij të ndryshme shumë përngjasime, marrë nga shkrimtarë klasikë (imituar prej klasikëve). Në një këngë thotë:

*Unë nga moti jam i shkuar,
Bakun t'lidhur dua ndër duar.*

E kështu lindi në të ai mendim melankolik, - përherë i mbytur nga puna e dorës – i cili shfaqet, këtu e aty, ndër vjershat e tij, dhe jep një kuptim përbuzjeje të gjithmbarëshme pikturës së vërtetë (kuadrit real) që ne po paraqesim. Ndoshta kjo ndjenjë, e bashkuar me karakterin (natyrën, tiparin) e tij, ndikoi për ta mbajtur, gjithëmonë, një njeri të mirë (= vlejti ta shquajë, gjithëmonë, si njeri të mirë).

Kështu, ai, me vargje të bukura dhe të çuditëshme, jehona e jashtme e të cilave tingëllon bashkë me idenë e pakufizuar, ndal çdo njeri që e dëgjon, ku në vajtimin përmbi zonjë Luiza Lopec, lindur në Samengo, thotë:

*Atje është një madhe shpi,
Hyjm' t'gjith', pleq e t'ri,
Nuk e dimë se ku është
Shkojmë e nuk kthejmë më.*

Shënim:

Le të më falin lexuesit se nga ky grup pikturash (kuadrosh) të Kosta Shalës kam hequr tri a katër. Liria e tepërt e këtyre vjershave nuk na e lejonte një gjë të tillë.

20. LOUIS PODHORSZKY⁸²

Nga gjuhëtari dhe filologu i famshëm Louis Podhorszky i Akademisë Hungareze, morëm një studim të jashtëzakonshëm të tij mbi identitetin e prapashtesave shqiptaro-latine dhe finlandeze që do t'i bëjmë të njohura tek *Fiamuri*. Duke botuar letrën e shkurtër që e shoqëron, e dimë se do t'i bëjmë të lumtur bashkatdhetarët tanë:

Mjeshtri im i nderuar,

Më duhej të prisja rihapjen e Bibliotekës *Sainte-Geneviève* për të kopjuar studimet e mia. Autori i *Etruskëve*, komentatori i Festit tha se prapashtesat foljore latine ndryshonin - kryekëput - nga prapashtesat greke dhe ai shpjegoi arsyen pse latinët u shkrinë me një racë parahistorike, prej së cilës patën zgjedhimin. Vetëm se ai tha që nuk njihnte asnjë racë tjetër, prapashtesat e së cilës ishin të ngjashme me ato të gjuhës latine. Sapo kam provuar që prapashtesat e shqipes nuk janë vetëm analoge por identike, jo të vdekura por të gjalla.

I devotshmi juaj me zemër,

Ludvig Podhorszky

Paris 3 janar 1885

10 prill 1885

⁸² *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 1, Corigliano Calabro, 10 aprile 1885, p. VIII.

21. JOZEFINA KNORR (JÓSEFINA KNORR)⁸³

Në mes të lojrave të lehta fëminore, që sot pranohen për poezi e nga kjo e zbresin dinjitetin, duam të bëjmë të ditur një libër shumë të ri, me këngë magjepëse dhe me ndjenja të thella, botuar në Vjenë. Janë të llojit të poezisë kalimtare të Goethes, por shpesh me ndjesi më të gjalla e të freskëta të jetës që simbolizon. Zonja fisnike, të së cilës janë /këto vargje/, do t'ia falë admirimit tim tekstin me gabime, duke zëvendësuar gjuhën e saj të pasur e të fuqishme me timen, kaq të varfër e të lindur dje.

20 maj 1885

22. XHUZEPE BENIÇI (GIUSEPPE BENNICI)⁸⁴

Për Beniçin na erdh njoftimi më 1881, me rastin e humbjes së pikëllueshme të bashkëshortes së tij të re, Xhoakina Mazi, për të cilën mund të thuhet me Homerin se “kjo u ngjason, në mënyrë të mrekullueshme, hyjneshave të pavdekshme”. Mbi arkivolin e saj, muza pellazge (shqiptare) zgjidhi vajtimin, ndoshta për herë të parë, së bashku me muzën italiane, për komendator Pjetër Kjarën.

20 maj 1885

⁸³ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 2, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885, p. V.

⁸⁴ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 2, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885, p. VIII.

23. XHUZEPE MUZAKA(GIUSEPPE MUSACHIA)⁸⁵

I shkëlqyer, tash për tash, i Horës së Arbëreshëvet është edhe ai vetë, Papas Xhuzeppe Muzaka, hartues poezish elegante greqisht, dhe një nga helenistët e parë të Italisë.

20 maj 1885

24. EKSTRAKT NGA LIBRI I JUL VARIBOBËS JETA E SHËN MËRISË VIRGJËR⁸⁶

Kavalier (Kalorës) Guljelm Toçi nga Shën Kozmo, që kishte ndër mend ta përkthente në italisht *Jetën e Shën Mërisë Virgjër të Varibobës* e, së bashku me të, të na jepte edhe biografinë e autorit, nga e cila ajo rrëfenjë ndriçohet, endë s'e hartoi veprën e vet, i zënë, siç është gjithmonë, me punë që i ngrej në popullsitë e këtyre anëve tona të mjera.

Por, me qenë se një njeri shumë i urtë e i nderuar, Gustav Meyer, ndezi dëshirin për ta njohur atë *Jetë*, mbasi e pat emërtuar këtë “vepër klasike, të zgjedhur, të gjuhës shqipe”, ne duam të paraqesim disa pjesë të saja, e t'i përkthejmë ne vetë.

Në të vërtetë, një nga shkrimtarët tanë, të cilin të gjithë e njohin, na pat këshilluar ta linim atë *Jetë* me shpirtëra të ulët të një fati të poshtër e, pothuajse, pa ndjesi atdhetare, ta linim në kohën kur Shqipëria, zot i vetëvetes, don, në qetësinë e saj, të ngulet në parafytyrën e dlirtë të shtetit të nëmur (të palumtur) të shtëpiavet më të mjera arbëreshe, në

⁸⁵ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 2, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885, p. VIII.

⁸⁶ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 3, Corigliano Calabro, 20 giugno 1885, p. II.

dhë të huaj. Padyshim – duke lënë më një anë vështrimin, ne shohim, në ato fate (shorte), gjërat e shenjta, që ne nderojmë, të vëna, gati, si në ndyrësi – ajo *Jetë* nuk u vlen fare as dëshiravet, as nevojavet të ditës së sotme. Shqipërisë i lypsen sot që t'i paraqiten përpara, si në pasqyrën e Rapsodivet, histori dhe bëma (gjeste) heroike të etërvet /të kohës/ kur rrinim bashkë nën flamurin e vet, ose fatkeqësi ku i mbështuall të copëtuarit (shpërndarja). E Variboba, si ai që nuk diti, nuk e ndjeu atë fisnikëri (aristokraci), atë fatkeqësi. Sot ne duhet të tregojmë që kombi ynë nuk e pret gjuhën nga buza (nga goja) e dadove të huaja, por e mban nga nëna e vet, që është një nga më të parat e fisit njerëzor. E Ai /Variboba/, si i huaj /duke qenë arbëresh/, u ndihmua, gjithmonë, nga gjuha italiane.

Prandaj ne, duke filluar që nga ky numër, po zbulojmë një pjesë të atij kuadri, prej nga duket se i pat bërë përshtypje aq të madhe atij Zotërie të nderuar /Gustav Meyerit/, o e vërteta tokësore, e brendshme e një bote që jetoi (kaloi), e vërtetë e qartë, të cilën sot duan ta sodisin pa mundim (pa përtesë), o ndonjë tjetër, nuk e dimë se çfarë e tërhoq (e lidhi) në atë që i pëlqeu.

20 qershor 1885

25. JUL VARIBOBA⁸⁷

Nuk duam ta shtyjmë më përtej dhunimin e pafalshëm nga budallallëku o nga thjeshtësia e qëllimit, i cili fyu (lëndoi) shumë shpirtëra të mërzhitur e të ashpër, në mes të pajtimtarëve /të së përkohshmes *Fiamuri Arbërit*/. Tash nuk duhet tjetër për të gjykuar në se përmbajtja e forma e një poezie së tillë e meriton përcaktimin “*klasike mbi çdo tjetër*” sipas autoritetit estetik të të shkëlqyerit Gustav Meyer.

20 gusht 1885

26. THIMI MITKO⁸⁸

Tjetër nuk mundemi, për Abramidhin dhe për Komitetin bashkëkom-bëtar fisnik, veçse t’u vemë nën sytë e tyre, si ngushëllim, mirënjohjen e mbarë atdheut, të cilit i bën jehonë ky hymën që fluturoi nga shpirti i Toskërisë.

Po vemë këtu gjykimin e A. Somogyit, miku i Deahut, që i dha statutin Hungarisë, më 1848: “Lajmi i Bukureshtit na mëson të gjithëve sa mundet të japë edhe një numër i vogël njerëzish, të bashkuar me shpirt nga ndjesia atdhetare. Dhurata e Anastas Abramidhit është një fakt historik, dhe një shembull i gjallë, që nuk mund të mbetet pa efekt mbi bashkatdhetarët pellazgë (shqiptarë). Më kot helenët janë tërbuar (janë bërë tym) kundër këtyre herojve të shkëlqyer të kombit të vet, zbukuruar (stolisur) me kaq mundime dhe sakrifica. Tashmë opinioni i mbarë Europës është ngritur në favor të shqiptarëve”.

20 gusht 1885

⁸⁷ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 4, Corigliano Calabro, 20 agosto 1885, p. V.

⁸⁸ *Eutimio Mitko, Inno ad Abramidhi, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 4, Corigliano Calabro, 20 agosto 1885, p. II.

27. FILIP SHIROKA⁸⁹

Kur Fuqitë e Europës ndërhyjnë për copëtimin e parë të Shqipërisë, një djalosh shkodran, Karolipo Shifip /anagram i poetit Filip Shiroka/ hartoi hymnin e luftës italisht, (shih: *Harpa e një arbëreshi, italo-shqiptar*, Venedik, 1881), i cili paraqet një parafytyro të vrullit të sotëm të Shqipërisë.

20 tetor 1885

28. PRENKË DOÇI⁹⁰

Prenkë Doçi është një nga karakteret më të spikatura, më të shquara shqiptare. Administroi, vazhdimisht, famullitë e Oroshit e të Spaçit; qe, pastaj, për pesë vjet, famullitar i Kalivarit në Mirditë. Kur ishte këtu, Dodë Gega e të gjithë krerët e Mirditës ia mbushën mendjen, e nxitën që të merrte mbrojtjen e privilegjeve të vendit dhe të së drejtës së Prenkë Bibë Dodës për të qenë kryetar i pesë Bajrakëve që formojnë Mirditën. Dodë Gega, si agjent i Qeverisë /osmane/, e ndërroi shpejt mveshjen, e mori me vete disa krerë që besonin në dashurinë e Portës së Lartë për Lidhjen Shqiptare. Por mbarë populli, duke qenë përkrah Doçit dhe i mbështetur nga jashtë, kërkoi që Princi, i cili ishte mbajtë qysh më 1876 në Konstantinopël, të mund të kthente në atdhe. Në shënimin mbi Dodë Gegën përshkruam se si ky kthim pat qenë me pasoja. Kur turqit më 1877 mësynë Mirditën, Doçi qe burgosur në Guci; por miq të fortë ia mërritën ta lirojnë po në atë verë. I arratisur, ndëj pesë vjet në Amerikë, e, pastaj, në Athinë një kohë të mirë, që i mjaftoi për të njohur pabesitë e grekëvet. Sot gjindet në Hindi me cilësinë e sekretarit të delegatit apostolik në Bombay.

20 nëntor 1885

⁸⁹ *Filip Shiroka* (Karolipo Scifip), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 6, Corigliano Calabro, 20 ottobre 1885, p. III.

⁹⁰ *Primo Dochi*, *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 7, Corigliano Calabro, 20 novembre 1885, p. VII.

29. VINÇENCO DORSA

Lajmi i fundit dhe përdhimtues, është ai i vdekjes së Vinçenc Dorsës, profesor në liceun e Kozencës dhe i njohur në Itali e jashtë për studimet e tija filologjike. Nuk di se ç'fat, më tërhoq, në fillim të nëntorit, në Kozencë, dhe e gjeta të sëmurë që prej pak ditësh më parë, dhe të shqetësuar për shkak të një kolle të pashkulshme. Mua nuk më dukej se kishte aq zor në gjoks sa ç'dronte ai; dhe aq më kish gabuar mendja sa, në një vizitë të dytë, duke pasë gjetur bashkë me të një mjek të mirë, bashkëkombas yni, zotni Oracio Martini nga Lungro, një prej përkrahësve të *Fiamurit /të Arbërit/*, asgjë që m'u dha nga Zoti që ta parandieja fatin e mikut. Kështu e lashë, pa menduar fare për vdekjen (mbarimin) e tij, që ndodhi shpejt nga sëmundje zemre, mbas nisjes sime.

30 dhjetor 1885

30. GAVRIL DARA (GABRIELE DARA)

Në *Xhiornale di Sicilia* (Të përkohëshmen e Sicilisë) lexojmë: Më 19 të nëntorit të shkuar “les trois ressuscitateurs hereux des leurs vaillants compatriotes” (tre të ringjallurit e lumtur të bashkëpatriotëve të tyre të lavdëruar) në Xhirxhenti vdiq Gavril Dara. Ai qe, për disa vjet, drejtor i së përkohëshmes *Reforma*, dhe tregoi se ishte një publicist shumë i aftë, gjithnjë i ngritur në formën e në konceptet (mendimet).

I pajisur me një fuqi të madhe mendore dhe krijuese, zotëronte një kulturë të gjerë, sa të të çudiste se si një peshë (sasi, mori) kaq e madhe njohurish mund të përmbliidhej në një mendje.

E studioi me dashuri gjuhën greke, duke i pasë mësuar elementet e para dhe shijuar bukuritë klasike të saj, nën drejtimin e të famshmit Emzot Krispi, që Europa e kulturuar e përshëndeti njëzëri si princ i helenistëve.

Nder e mburrje e letërsisë shqiptare, lëvroi me entuziazëm atë gjuhë të lashtë, së cilës i dha paraqitje letrare me shkrimet e tij origjinale dhe me zbulimet e këngëve shumë të vjetra popullore, të nxjerra prej tij nga harresa, dhe të ilustruara.

Një poemë e tij në gjuhë shqipe ishte gati, tashmë, për shtyp; por vdekja, pothuaj e papritur, në moshë endë të kërthnestë 59-vjeçare, e shoqti, për një çast, dëshirën e zjarrtë të albanologëve, dhe atë çka pritnin njerëzit e letërsisë.

Gavril Dara lindi në Palac Adriano, nga një familje e lashtë dhe në zë, në të cilën, për një radhë të gjatë brezash, janë lëvruar dhe admiruar shkencat, letërsia dhe artet.

U ngarkua me detyrat më të larta administrative e politike; qe këshilltar e deputet krahinor i Xhirxhentit, prefekt i mbretërisë, avokat nga më të mirët, këshilltar jurist i ditur.

30 dhjetor 1885

31. ANTONIO DE SOMOGYI I (ANTONIO DE SOMOGYI)⁹¹

Antonie de Somogyi na kishte nisur programin e fundit të Radikalëve të Francës duke na kërkuar mendim. Nuk mundëm t'i përgjigjeshim veçse vonë kur letra zbuloi se Ai ishte larguar prej kësaj jete. Për të evokuar për pak kohë kujtimin e një njeriu kaq kërkues dhe shumë dashamirës ndaj nesh, dhe për shkak të përmbajtjes serioze të vetë letrës ne deshëm ta botonim.

20 dhjetor 1885

32. ANTON DE SOMOGYI II

Jemi shumë të hidhëruar (të pikëlluar) nga humbjet tona të rënda të vjeshtës që po mbaron.

Nuk jeton më për *Fiamurin le Arbërit*, Zoti bujar, kryetari i radikalëve hungarezë (magjarë), Anton de Somogyi. Lajmi i papritur po na vjen nga Parisi me anë të letrës së të ndritshmit Podhorszky, /mis/ i Akademisë së Hungarisë (Magjarisë), letër të cilën po e riprodhojmë edhe për ngushëllimet e tija plot simpati për *Fiamurin le Arbërit* dhe për ne.

- 17 dhjetor 1885: Kam marrë *Fiamurin e Arbërit* si një balsam për plagët e mija të pashërueshme. Ne humbasim me Zotin Anton De Somogyi një karakter nga të Plutarkut, një Solon dhe Cincinat që atdheu i tij nuk diti ta vlerësojë fare. Unë kurrë nuk e kam parë, megjithëse e kisha njohur, pas 1848, me anën e miqëve të përbashkët. Do të dëshirojsha të ju bëj “një dhuratë të Dianës” d.m.th. të një miku të ri në personen e “Miltonit Katalan” Jasint Verdager, nga i cili posa lexova *Atlantiden*. Do të ju jap disa pjesë si sprovë se ai është i denjë që të plotësojë triadën De Rada, Mistral, Verdager.

30 dhjetor 1885

⁹¹ *Antonio De Somogyi, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 8, Corigliano Calabro, 20 dicembre 1885, p. I.

33. MIKELANXHELO BILJAI (MICHELANGELO BILLIA)

E ndejmë për detyrë t’u bëjmë të njohur anëtarëve të Shoqatës sonë një vepër të profesor Mikelanxhelo Biljas mbi *Rregullat e programit e shkollave*. Me një qartësi të veçantë mendjeje e me dituri diskuton veprimin e shtetit, përvetësues i së drejtës së etërvet të familjevet dhe të fakultetevet (cilësive, vetive) të doktrinës; e si ky veprim, për shtetet e drejta, nuk ka asnjë përfitim, veçse si burim i parë i ushtrimit të mendjeve që na rri përpara. (Torino, libreria G. B. Paravia).

20 janar 1886

34. MIKELANXHELO BILJAI

Ne i bëmë homazh drejtësisë dhe pavarësisë së mendjes dhe shpirtit të Prof. Mikelanxhelo Biljas. Sot studimi i tij i kostant për një zgjidhje të qëndrueshme në Lindje të Europës, që shtrin të mirën në mënyrë të barabartë në kombet që e banojnë atë, duke e sjellë profesorin në fushën tonë, por me pikëpamje që janë të pafavorshme për ne për sa i përket “kriterëve” për gjendjen e brendshme dhe të jashtme të provincave (për të cilat ne duam paqe dhe vetëkontroll) dhe mbi mjetet për t’i përfutur ato: kam nderin t’ia paraqes këto dy kërkesa mençurisë dhe mirëbesimit tuaj:

1. Është e volitshme dhe e arsyeshme që *Fiamuri*, “fati i të cilit është shkëlqejë mbi Shqipërinë dhe të pajtojë”, të mendojë dhe të punojë për të përmbysur Perandorinë pjesë e së cilës është, ruajtja dhe transformimi i brendshëm paqësor i së cilës dëshirohet dhe garantoet nga fuqitë e mëdha me anë të një marrëveshje të bërë kohët e fundit në

dobi të paqes europiane? Unë besoj se atëherë Revista, përveç se do të shuhej si një flakë e mekur (iluzion i çastit) në derën e dheut amë, do të shihej si e mbrytur me qëllime të këqija që synojnë të përkeqësojnë ndarjen fetare dhe fisnore që mundon vendin.

2. A është vallë e drejtë të na bëni me faj ne (autoritetin e të cilëve Jue rrisni për shkak të dashamirësisë së madhe) për distancimin e Shqipërisë nga një Federatë ballkanike e pasaktë, inekzistente, kur dje Ristic e këshilloi Serbinë, një anëtare e saj e ardhshme, të pushtonte vendin malor të Shqipërisë, duke pasur parasysh trazirat bullgare? dhe kur Helenia zgjat dorën e saj, të gjatë dhe të pabesë prej kohësh, pa u tërhequr tashmë? - Nuk tërhiqet nga pretendimet e saj mbi Epirin dhe Maqedoninë, nuk i dhuron shkolla në gjuhën kombëtare popullsisë shqiptare me të cilën është e mbushur plot, por po ato njerëz mes helenëve që “na duan vëllezër” deklarojnë se e shohin gjuhën shqipe si *rrezik që nxit përçarje* brenda Bashkimit, ku do të dëgjojnë pa u fyer gjuhën sllave të anëtarëve të tjerë të Federatës! – Ia lemë shpirtit tuaj fisnik të gjykojë.

15 tetor 1886

35. DOMENIKO MAURO (DOMENICO MAURO)

Është botuar, gjithashtu, tani shpejt, një përmbledhje postume /vepër që shtypet pas vdekjes së autorit/ me poezi të bukura të Biaxhio Miraljas. Për mua është shumë interesant ky libër, në të cilin ai “drejtohet e shikon me habi”, në vajtje-ardhjet që bën ndër qytetet njerëzore, vendin e jetesës më të mirë, në të cilin vështronim, së bashku, në rinë. Duke qenë ai, përherë, besnik në dashuritë e veta, në fund të librit i drejtohet bashkatdhetarit tim – kujtimi i të cilit më ndalon, tashmë, që ta evokoj në *Fiamurin le Arbërit/* - Domeniko Mauron; dhe e thërret:

*Shpirt grek,
shpirt i pathyeshëm, që rrjedh prej gjaku pellazg
(shqiptar) shumë të pastër, atëherë kur Skënderbegu
kërkoj trevat italiane, erdhën etërit tuaj mbi
malet e zez të atdheut tim, Kalabria e shenjtë, etj.*

Kështu, e veja dhe vajzat e tij shumë fisnike, duke njohur dashurinë që ai më solli aq herë, më dërguan librin e tij të fundit, shënimi i parë i të cilit është shpresa e paqës ndër fushat e vetmuara. (Roma, Karlo Verdezi e Sh.).

20 janar 1886

36. PASHKO VASA, ANGELO DE GUBERNATIS, M. A. CANINI⁹²

Shih disertacionin e shkëlqyer të Vaso Pashës, sot sundimtar (gubernator) i Libanit, botuar gjermanisht në Berlin, më 1879; gjithashtu relacionin e Anxhelo De Gubernatis, dhe Letrat e fundit të profesor Mark Anton Kaninit, mbi Çështjen Ballkanike, nxjerrë nga gazeta “*L’Adriatico*”, botimi i dytë i së cilës përmban një shtojcë, gjithashtu, shumë interesante “*Mbi Epirin e mbi Shqipërinë*”, çmimi 60 qindarka. Për atë që do të vihet, siç thuhet, në korrent me një nga çështjet më komplekse (të ndërlukuara) e më të rënda europiane, letrat e profesor Kaninit janë një mësim i mirë.

20 janar 1886

37. FRANÇESKO BAFFA, KARMINE DRAMIS (DHËRMIU), AKILE PARAPUNJA, XHUZEPE DE RADA

Kemi në dorë një vëllim me letra dhe me sprova të tjera në gjuhën shqipe, me tipare të veçanta të hartuesvet, të bashkuar më 1878 për të lavruar gjuhën amtare, shqipen. Ishin që të katërt djelmosha të rinj e të nderuar (të ndritur). Françesko Baffa nga Shën Mitri, Karmine Dramis (Dhërmiu) nga Mbuzati, Akile Parapunja nga Perçile e Xhuzepe De Rada nga Makja; po, më 1884, vdiqën të gjithë së bashku, e nga e njëjta sëmundje, që iu ngjit njeri-tjetrit nga miqësia që kishin.

20 prill 1886

⁹² *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 9, Cosenza, 20 gennaio 1886, p. II.

38. XHOVANNI D'ARAGONA (GIOVANNI D'ARAGONA)⁹³

Prej aq visesh të ndryshme sytë janë prirur mbi Pastërin në Paris, për të cilin u tha se gjeti mjekimin e të kafshuarit të qenit të tërbuar. Por vijnë lajme se nuk i shëron të gjithë.

Në Kalabri dihet, qysh kahë mot, se në Karpancano zotni Xhovanni d'Aragona shëron cilindo që i çojnë, pas kafshimit të qenit të tërbuar. E, unë vetë, jam dëshmitar.

Në vitin 1881 u tërbua në Shën Mitër një qen i Don Marçel Lopsit. Iku e shkoi në Maqë; atje u suall e zuri dy fëmijë që bridhnin në udhë; njerit i thonë Zep (Zef) Bëljushi, tetë vjeç ishte atëhere; tjetrin /e quajnë/ Lixhë (Luixhi) Frontera, gjashtë vjetsh. Nga britmat e atyre e të grave prej dyersh, qeni bishtnoi gjatë brigjeve nga Apoljea, që sosin te lumi i Math; e kush u gjend në katund, e ndoqë udhëve të ndryshme të asaj brinje. E panë se, mbasi arriti te lumi – kish një metër ujë e pak më tepër – ngau bregut lart një çikëz, pastaj u suall prap brinjës përpjetë. Tek po ngarendte, në udhën që të çon për në Strigar, ndeshi në të mjerin tim bir, i cili zhgrehu më të (e qëllloi, e gjuajti me armë zjarri); dhe ra në vend pa piskatë fare.

Prindërit i prunë dy djelmnt në Karpancano; ndenjtën disa ditë, e paguan vetëm mjekimet, fuqia e të cilavet, qysh në javën e parë, bëri që të sëmuret të përmjerrin (të urinojnë) gjak. Të dy, sot, janë gjallë.

Ne nuk dimë se si edhe, - e pas kaq fjalësh që fliten mbi këtë nevojë, - asnjë nuk ia thotë prefektit të Kozencës /formulën/ e reçetës, që dihet se e kanë në Karpancano.

20 prill 1886

⁹³ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 9, Cosenza, 20 gennaio 1886, p. II.

39. BERNARD BILOTA DHE FRANÇESKO KRISPI NGA GLAVIANO ⁹⁴ (BERNARDO BILOTTA, FRANCESCO KRISPI)

Në heshtjen e kujdesjeve për fatet që na gatiten (thuren, enden) pa hiri, duam të kthejmë (të prehemi, të çlodhemi) ndër provë të reja, që na vijnë për lavrimin e gjuhës sonë aq fisnike dhe të hijshme. E këto nga dialekte të ndryshme (të folme të ndryshme), na shkëlqejnë si fënerë të vendeve, prej nga ikën (emigruan) kjo apo ajo koloni e gjindve tanë.

Njera është e të nderuarit /Bernard/ Bilota nga Frashërita, /që ka qenë/, gjithmonë, me në në kujdes për rilindjen e Shqipërisë; dhe është një vajtim për vdekjen e Akile Parapunjës nga Perçili, një pinjuell ky i zemrës së Shqipërisë e nuk di se ç'fatkeqësi e tërhequr në dhjatën e botës.

Tjetra është e njëj të riu, Françesko Krispi nga Glaviano, që hyn për së pari herë në luadhën e trimavet të Shqipërisë. Ai e përshëndeti bukur *Fiamurin le Arbërit*; por mendimet që na u kthyen në helm (në zì), na bënë që të ndjekim, me të, përkundrazi varrimin e zotit Gavril Dara, bashkëqytetarit të tij, dritën e të cilit kombi ynë i varfër e humbi tani shpejt. Sikurse Bilota, edhe ky djalë i ri këndon, sipas ndjesive dhe sipas vetëdijes së thjeshtë, e pashqetësuar nga kotësia e dukurisë së gjërave, duke u mbajtur, kështu, ata bashkë me hekurin arbëresh (= duke mbajtur ata, kështu, karakterin, tiparin shqiptar).

20 prill 1886

⁹⁴ *Vaitiime*, (Nenie), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 12, Cosenza, 20 aprile 1886, p. II.

40. TEODOR ÇEDRARO (TEODORO CEDRARO)

Mbi shembullin e mbetur të mikut tim Vinçenco Dorsa në librin e tij *Tradita greko-latine në Kalabri*, profesor Teodor Çedraro lexoi në Shoqërinë filomatike (= Akademinë e dashurisë ndaj shkencës) të Mormannos *Gjurmimet e tij mbi një mijë fjalë e fraza të dialektit lukano-kalabrez*. Siç e thekson edhe titulli, fusha e gjurmimeve të tija s'është ngushtuar (kufizuar) vetëm në rrethin e gjuhësisë, por është shtrirë mjaft përtej; dhe është e pamohueshme, madje, domosdoshmëria e këtyre studimeve për të sqaruar shumë ngatërresa dhe errësi që gjinden ndër tregimet (kallëzimet) e historisë njerëzore. Dhe mjaft të dhëna të dobishme jep, në librin e tij, prifti Çedraro; kaq sa na vjen keq që lavdërimi që do të mund t'i mveshim ne, autoriteti i tij i madh nuk mund të përfitojë gjë nga ato pak që dijmë në këto lëndë.

Vetëm do t'i bëjmë një vërejtje se mendimi që ka ai që, gjithçka, t'ua mbështesë grekëve si edhe latinëve, sikur e kufizon sadopak, madje edhe e përdhunon prejardhjen e lindur në mjaft fjalë. Po sjellim pak shembuj: në qoftë se *jôja* = keklishtë, llapë, llafe, është nxjerrë drejtpërdrejt nga helenishtja *jôî* = britmë, thirrje, e prej latinishtes *clanculum* = fshehtas, në mënyrë të fshehtë, fjala *kjangulu* = i shkretë, si mundet, ndoshta, të ketë rrjedhë, përkundrazi, prej /foljes/ *chiangere*, tjetër është për *catanfaru*, që e bën të ardhur prej helenishtes *kanafora*, në vend të fjalës *cadaver* = kufomë, në të cilën përmbahet i plotë /kuptimi i fjalës/ sonë kalabreze *catàfaru*; e *nutria* = zemërim, që e sjell nga helenishtja *myo* sikur rrin, gjoja, më afër /fjalës/ së pazë që ndryshon!

20 prill 1886

41. MIKELE KALVOZA (MICHELE CALVOSA)

Zotni Mikele Kalvoza, një nga bashkëpunëtorët e *Fiamurit /të Arbërit/*, ka qitë në dritë, tash shpejt, një vëllim me poezi e me prozë, që dallohen për thjeshtësi, e që merituan një letër përkëdhelëse nga Shkëlqesia e tij Ministri Koppino. Me sadisfaksion, dhe për nder të saj, po e zbukurojmë këtë faqe të *Fiamurit /të Arbërit/* me gjykimin dhe me lavdërimin, me të cilat i epte guxim princesha Dora d'Istria:

Firence, më 17 gusht 1886

Zotni,

Kam lexuar me shumë kënaqësi vëllimin e këndshëm *Në trishtim*, që ju keni pasur mirësinë të ma dërgoni.

Novela në prozë më ka interesuar (më ka tërhequr) po aq sa edhe poezitë, frymëzuar nga ndjesi kaq fisnike.

Pranoni, ju lutem, Zotni, së bashku me falënderimet e mia, shprehjen e konsideratës sime më të lartë.

Dora d'Istria
15 tetor 1886

42. XHUZEPE SQUIRO' (GIUSEPPE SCHIRÒ)

Xhuzepe Sqirò nga Hora e t'Arbreshvet është duke botuar një vëllim, që përmban më se 25 këngë shqipe, të cilat kanë të bëjnë me kohët e *Skënderbeut*, dhe pesë pjesë lirike të gjata për periudha më të lashta, e, me siguri, më të hershme se kristianizmi. Të gjitha këto dëshmojnë, vërtetojnë se poezia popullore shqipe nuk është më e ulët se ajo e ndonjë populli tjetër.

Botimi do të jetë i pastër dhe elegant dhe do të bëhet krejtësisht për pajtimtarët. Vëllimi do të përmbajë listën e shokëve dhe do të kushtojë 5 lira.

15 nëntor 1886

43. HERMAN BUHOLC (HERMANN BUCHHOLTZ)

Jemi të gëzuar që po përkthejmë, për lexuesit tanë, një sprovë nga libri poetik, botuar tash shpejt, i dashamirësit tonë, zotni Herman Buholc. Në këtë libër vërejtja e hollë prej filologu, në vend që ta dëmtojë ndjenjën e virgjërtë e të gjallë të natyrës, i dhuron, do të thojë, gjeniut fjalën e lindur të fenomeneve, në të cilat shikon me vemendje. Do të kthejmë më vonë /mbi këtë çështje/.⁹⁵

⁹⁵ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. II

*

* *

Dhamë prova të tjera të risive prekëse të librit të Buholcit (shih: *Fiamuri Arbërit*, viti II, nr. 2) plot me figura simbolike, të vërteta dhe të gjalla, me fjalën e vet të qartë, aq sa piktura flakëron. Gëzohemi, si për lumturinë tonë, për brohoritjet që Gjermania lavdëron këtë mik të shqiptarëve shumë fisnik.

Nga gazeta *Voss* e Berlinit, e datës 29 dhjetor 1886, /po përkthejmë këtë gjykim/:

“Një dukuri me rëndësi të posaçme në fushën e letërsisë lirike më të re na shfaqet përpara në librin e Këngëve të Herman Buholcit /me titull/ *Shkalla* (Botues Paolo Shleter, 1886). Përmbajtja e librit, duke lënë më një anë tri poezi kushtimi në fillim dhe tri të tjera si mbyllje në fund, ndahet në Prelude, Këngë dhe Kuvende të kombeve: Pjesa e parë, Çelja; pjesa e dytë: *Urdhëri i ditës*.

Autori jeton në afërsinë tonë në Friedenau (*Lugina e Paqës*) dhe është i njohur shumë, e tepër i lavdëruar edhe për botimin e një *Gramatikeitalisht* (Hanover, 1882). Meritat e tij, lidhur me letërsinë klasike italiane, qenë vënë në dukje prej zotni E. Paskualigo, i cili, në organin *Fanfula della Domenika* (Romë, 21 nëntor 1886), u flet bashkatdhetarëve për librin e sipërshtënuar të këngëve.

Buholci difton njohurinë e tij shumë të pasur që ka për gjuhët e huaja, në librin e tretë të këngëve të tija, titulluar “Dieta (pehrizi) e kombevet”, ku ai, pasi ka karakterizuar, në një mënyrë poetike, një varg tipa racash, bën që të dëgjohen zërat e këtyre kombeve, nën titullin e dytë “Urdhëri i ditës”. Këtu autori sjell këngë me prejardhje të ndryshme, si dhe poezi të princave të shumtë në mes të poetëve të huaj (Homeri, Dante, Irneba, Hafizi, Seguer, Moore, Petëf e të tjerë), me shënime mbi origjinën e tyre, dhe në përkthim të lirë. Kjo përmbledhje zgjon, në veçantinë si edhe në larminë e saj, një interes të përgjithshëm, posaçërisht filologjik.

Ndër preludet dhe ndër këngët, pjesa më e vëllimshme e Veprës, që trajton një sasi të madhe e të pafund temash, ndeshim gjithkrah zërin e brendshëm të shpirtit, siç shënon edhe Paskualigo, dhe një gjeni poetik që zgjon simpatinë tonë të gjallë. Duam të shënojmë vetëm këngët për

fëmijët, në faqen 37 e vazhdim, dhe ato që kremtojnë lumturinë e nënavet ndër fëmijët-famull (deri sa t'i merren flokët), në faqen 55-57, dhe të të martuarvet në mes të tyre, në faqen 64-66, dhe të zonjës së shtëpisë e të kopshtit. Këto, me freskinë dhe me origjinalitetin e tyre, do të pushtojnë shumë zemra. Epigramet, të shpërndara dëndur, këtu e atje, në pjesën më të madhe kanë një shije klasike.

Larmisë së temave u përgjegj një pasuri shumë e bukur formash poetike dhe metrash. Në se autori, me guxim prej trimi ndërmerr që të bëjë të bashkëtingëllojnë parimet e vargjeve në rima në mes tyre (në vend të fundoreve), madje të fusë me alternime simetrike artistike, rimat në fillim, në mes dhe në mbarim të vargjeve (shih faqet 163-165), ai parashtron probleme të reja të artit metrik; dhe libri i tij i këngëve me këtë, me të cilën do t'u bëjë rrugë (do t'u çelë udhë) të tjerëve, ia shton mjaft mirë rëndësinë /vetëvetes/. Edhe përsa i përket sintaksës, në mënyrën se si i lidh fjalët, dhe në pikëpamje të formimit të tyre, nuk mungojnë risitë që japin të kuptojnë /se kemi të bëjmë me një/ gjuhëtar.

Por kur ne e kemi përvetësuar këtë gjë të rrallë, të jashtëzakonshme që, sipas asaj që kemi thënë, u është ngjitur këtyre poezive, efekti i përshkruar më sipër, i përmbajtjes gjithë nerv, hyn në të drejtën e saj të plotë.⁹⁶

15 nëntor 1886;
15 prill 1887

⁹⁶ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 4, Cosenza, 15 aprile, 1887, p. III.

44. FRANÇESKO TAJANI I (FRANCESCO TAJANI)

Historitë shqiptare, të hartuara prej Françesk Tajanit nga Vietri sul Mare.

Në mes të mija veprave të ditës që botohen, të vlefshme të gjitha për çështjet e tanishme, kjo që flet për një popull sa të lashtë aq edhe të lodhur nga fati i trishtueshëm, i njohur keq, sepse i shpërndarë në vise të largta, ndërsa prek për së afërmi çështjen rektuese të Lindjes, është caktuar të mbushë një boshllëk të madh. Filologë të ditur gjermanë, anglezë, francezë, italianë, etj. kanë folur e shkruar mbi gjuhën *shqipe*, por asnjë nuk i ka mbledhur endë ngjarjet e shqiptarëve të të gjitha kohëve e të të gjitha vendeve. Prandaj *Historitë/shqiptare*, që, me anë të shtypshkronjës sonë, po i botojmë, përveç të tjerash, kanë edhe meritën epërparësisë.

E gjithë vepra është e ndarë në katër pjesë ose epoka, secila e pajisur nga një ilustrim, do të paraprihet nga një shënim historik-filologjik mbi zanafillën e mbi njësinë e popullit shqiptar, do të ndiqet nga një parashtrim i zakoneve të krahasuara.

Epoka I: Shqiptarët në Azi. Epoka II: Arbëreshët në Greqi. Epoka III: Vazhdim i arbëreshëve në Greqi. Epoka IV: Arbëreshët në Itali. Çmimi 8 lira.

15 mars 1887

45. FRANÇESKO TAJANI II⁹⁷

Nga pushtimi romak ka rrjedhë, me sa duket, që, një numër i madh fjalësh latine, të duken në dialektet e Shqipërisë së Veriut. Por Roma zotëroi edhe mbi Epirin e Greqisë shqiptare, dhe është e pamohueshme që, nga sundimi i saj i gjatë, fjalë latine, por jo të shumta, të mos jenë përhapur në të gjithë gjuhën tonë. Këto fjalë italike, që shumë tingëllojnë brenda të gjitha brigjeve, e kanë prejardhjen, përkundrazi, pjesa më e madhe nga përzjerja, do të thoja, e të dy popujve, për faktin se, që nga shekulli X e deri te XVI, Mbretëria e Napolit e, pastaj, Venediku patën sundim të gjerë mbi bregdetin që, nga Iliria, shtrihet përtej Selanikut, dhe ushtroheshin tregëti të gjalla. Nga kjo bashkëjetesë, provat e nderuara u duken, disa për të parën herë, disa të mbledhura më një, në librin e ri *Historitë shqiptare* të Françesko Tajanit.

Zotni Tajani derdh shumë dritë dhe të re mbi historinë e shqiptarëve të Kaukazit, por nuk munda të ketë /të dhëna/ për kalimin e tyre ndër krahinat që qëndrojnë (gjinden) përtej Adriatikut, as për farë-e-fisninë e njëjtë gjuhësore të tyre me shqiptarët. U besoi autorëve mjaft të lehtë, /që janë/ ndalur në emra të ngjashëm, megjithëse të falsifikuar. Tashmë deri emri ynë, që e bëjnë të huajtë në *albanesi* (= shqiptarë), është, përkundrazi, *abëresh* gati (pothuajse) *apiresi* = *epiresi*.

15 nëntor 1887

⁹⁷ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 7, Cosenza, 15 novembre 1887, p. V.

46. LUDVIG PODHORSKY ⁹⁸

Na ka takuar të lexojmë në *Revistën e Lindjes*, që botohet në Budapest, disa njoftime rreth Ludvig Podhorskyt, i cili me ndriçimet (punimet e ndritura) që na jep dhe me dashamirësinë e madhe, na ngushëllon e na mban në kohë demoralizimi. Dhe e kemi për detyrë t'ia bëjmë të njohura, së paku disa prej tyre, Shqipërisë, e cila nuk e harron mirënjohjen e tij. Ajo revistë thotë:

“Të gjitha gjuhët e Lindjes! Dhe a mund të ketë njeri që t'i ketë mësuar të gjitha ato o pothuajse të gjitha? Ç'mund të thotë mbi gjuhët kryesore të Azisë e të Europës, sepse ai i njeh thellë?

Po, ky njeri ekziston. Ne e njohëm në Paris. Atje e gjetëm të zhytur mes gjithë aq fletorësh të dorës së tij mbi gjuhë të panumrueshme, ato të inkasve, të anamitëve, të malezëve, të jivasve (të Javës), të egjiptishtes së lashtë, pa përmendur gjuhët më familjare, si arabishtja, persishtja, baskishtja, shqipja, bretonishtja; po them familjare, sepse e dëgjova duke i folur. Në një dhomë të vogël, kaluan horizonte të natyrshme pa brigje në kohë e në hapësirë. Zotëruesi i këtyre gjuhëve, Ludvig Podhorsky, anëtar i Akademisë së Shkencave të Hungarisë, brenda një ore, që iku, ah!, tepër shpejt, duke biseduar, na bëri të asistojmë në kalimin e njerëzimit nëpër rajone (treva) e kohë më të lashta, dhe në formimin e gjuhëve të popujve. Me një ligjërim të ndritur, Ai, duke na treguar farefisninë e atyre gjuhëve, na paraqiti si erdhën /këto gjuhë/, njëra pas tjetrës, nga një vend në tjetrin të botës (të njerëzimit), dhe gërshetimin e fiseve të saj /d.m.th. të botës/.

⁹⁸ Ludvig Podhorsky, *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 7, Cosenza, 15 novembre 1887, p. VIII.

Një rast fatlum më solli lajmin që ai Zotni, që u shmang prej syve të mi prej kaq kohësh, kishte kthyer në Hungarinë e vet, për t'u lehtësuar pak nga studimet e tija të rënda; dhe se ishte, zakonisht, mik (mysafir) i zotit Lutcenbaher në vilën e tij në Zeb.

Kur ne e vizituam, /pamë/ se kishte marrë letra nga arkiduka Xhuzepe, që e pyeste për disa sqarime mbi gjuhën e ciganëve (Cinganëve, magjypëve?), së cilës Lartësia e tij i ka kushtuar një studim të gjatë".
(Vazhdon)

15 nëntor 1887

47. JUL VARIBOBA⁹⁹

Jul Variboba, bir i kryepriiftit, *pro tempore* (sipas rrethanave), i Mbuzatit dhe i Vasha Kanadë-së, qe një prej nxënësve të parë të kolegjit arbëresh të Shën Benedeto Ulanos; dhe reminishenca klasike, sidomos nga Ovidi, ndjekin njera - tjetrën në poemën e tij. Kuadri që ai paraqet, është i një realiteti të pashoq, por fatesh të ulta dhe që nuk njohin atdhe /d.m.th. me mungesë ndjesish atdhedashurie/. Ai vetë, poet i lindur, nuk ka një mendim as në fé, as në tjetër që ta ngrejë mbi popullin, që e rrethon dhe që e nderon shtëpinë e tij, në të cilën ai kënaqet sa të mbledhë të folmen e përmbytur nga gjuha e Italisë, ku, pa shkollë, rrinte e mërguar që prej tre shekujsh. E popullariteti i tij që i erdh nga shkrirja me vegjëlinë dhe nga hyrja e rimave dhe e metrit, që atëhere ishin të modës në Itali, e dëmtoi plotësisht traditën poetike. Çdo vit, në kohën e Pashkëve, një nga fshatet e këtij dhe të atij kantoni arbëresh, mveshur me kostumin e hershëm kombëtar, vizitonte banesat e afërta të bashkatdhetarëve, duke kënduar Rapsoditë e vendit të vet të humbur e të përbashkët. Këto vizita, të quajtura Rusalle, të përbujtura me javë ndër shtëpiat vëllazërore, mbanin gjallë atdhedashurinë. Tash, vendin e kujtimeve të larta e të lashta e zunë këngët e reja monotone të tija, me ide kristiane të varfëruara e deri të përlyera, si prej atij që nuk i kupton. Kështuqë, para pak kohe, kritikui i mënçur dhe i hollë, Albert Stratigò nga Lungro, na e afroi me priiftin matuf prej Apriljanos, *Tonnu Pantu*. Nuk duam të zgjasim më tej dhunimin, të pafalshëm nga mosgëdhenja ose nga thjeshtësia e qëllimit, i cili fyen shumë shpirtëra ngurrues dhe të rëndë, në mënyrë të rreptë. Nuk duhet, pra, tjetër për të gjykuar në se

⁹⁹ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 59.

përmbajtja dhe trajta e një poezie të tillë meriton të quhet *klasike mbi çdo tjetër*, sipas autoritetit estetik të të shkëlqyeshmit Gustav Meyer. Po e përfundojmë këtë shënim me një anekdotë karakteristike. Njeri prej nxënësve të parë të Kolegjit arbëresh që një i ri nga Makja ime, Xhan Françesku i Kontëvet Avati, për zgjuarësinë e jashtëzakonshme të të cilit flet, veçanërisht, Zavarrone, në historinë e tij të themelimit të Kolegjit. Në na ka arritur, e shkruar me dorën e tij, mbledhja e parë shumë e çmueshme e Rapsodive popullore, që i sollëm nga atdheut /i të parëvet tanë/. Mbasi i zuri vendin Rodotà-it në kryesinë e Kolegjit, peshkopi Arqiopulli i Shën Mitrit ngarkoi Avatin në Katedrën humanitare /e shkencave shoqërore/; dhe i dha, gjithashtu, zyrën e Rektorit. Por, pas ndonjë viti, ndryshoi shtesim Peshkopi, që ishte, gjithashtu, i afërt me të, e veptoi, mësheftazi, për të vënë, në vend të tij, në Rektorat, Varibobën. Ditën e parë të nëntorit, Avati, që e dinte, shkoi në vendin e vet për të pritur nxënësit. Pas një jave, kur e pau se po vinte Variboba, e priti në krye të shkallës dhe e pyeti me fjalën e Krishtit /drejtuar/ Judës: *Amice ad quid venisti?* (O mik, për çka vini?). Dhe zbriti përposhtë shkallës drejt banesës së një mushkatari, me të cilin, në mëngjezin e ditës së nesërme, u nis fill për në Romë. Prej andej kaloi në një katedër të Kolegjit Urbino. Atje vdiq pas /vitet/ 1800.

1896

48. LUIXHI LOREKJO (LUIGI LORECCHIO)¹⁰⁰

Më kënaq shumë ky përkthim prej italishtes, qoftë sepse është bërë në një kanton arbëresh, i cili duke qenë i largët nga të tjerët, na tregon qëndresën konservatore (ruajtëse) të gjuhës, në një mërgim kaq të gjatë, brez pas brezit; qoftë sepse i përket një zotnie të zgjedhur, nga familje, tashmë, prîse për autonominë kombëtare që po agon; qoftë sepse ai /d.m.th. shqipërimi/ rrin si gur krahasimi në mes të poezisë së lashtë me flatra dhe të zhdërvjelltë dhe që ka gjurmën e shekullit, në lëndën e saj të përkulshme të gjuhëve, thelbësisht, ritmike, dhe të hapit të ngadalshëm, që e bën të rëndë ecjen e strofave dhe të tresheve, të menduara dhe të shtërnguara ndër rima. Dhe, në mes të kaq frymëzimeve të lira shqiptare, të kapura pas çastit të vet, Kënga e Dantes na jep, pothuajse, një vazhdimësi mbresash, që e ndalojnë mendjen dhe, prej sosh, reflektojnë ndjenjën.

1896

¹⁰⁰ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 70.

49. KONSTANTINI I VOGËL¹⁰¹

Është diçka e denjë që, krahas sprovave të tjera, të vihet një përmendore e paimitueshme e artit poetik kombëtar në kohën e perandorisë së butë bizantine. Është rapsodia e *Konstantinit të vogël*, e cila barazohet mirë me tjetrën, megjithëse /është/ mjaft e ndryshme, të *Konstantinit e Garentinës*. Ndër dasmat bujare ngrihen të ftuarit prej tryezës /së gostisë/ martesore dhe vendosen, burrat ndër ana e gratë në mes, në *Valle*, së cilës i shtohen, jashtë, të rinjtë e mbarë fshatit. Këta, duke kërcyer sipas ritmit të këngës, sillen rreth banesave dhe i përhirojnë shtëpiat qytetare dhe kujtojnë fatin e Konstantinit të ri, /që është një rapsodi/ e ruajtur kaq e plotë dhe rituale ndër dasmat.

1896

¹⁰¹ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 50.

50. JOZEFINA KNORR¹⁰²

Po e mbyllim seksionin lirik me disa përkthime nga gjuha gjermane. Të tre kuadrot origjinalë, që ne po i paraqesim, përbëjnë një larmi në mes vegimeve tona. /Shqipja/ është shumë karakteristike dhe origjinale dhe, në një farë mase, dëfton aftësinë e gjuhës, me të cilën përpiqet kjo të shprehë brendinë e çmueshme.

*

* *

Mos të më merret për kotësi se shtova përkthimin e një odeje tjetër, që më erdhi përpara. Çdo njeri, “që nuk din prej nga vjen e ku shkon”, e bën në asgjë punën e vet; vetëm lavdia e ngushëllon këtë. Tashti, fjala “kaq grua e qartë”, ndaj dashurisë që e kemi të përbashkët të gjithë për atdheun e braktisur, na gjallëron e na shtyn përpara dhe na jep një kënaqësi të denjë.

1896

¹⁰² *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 47/49

51. BERNARDO BILOTA (BERNARDO BILOTTA)¹⁰³

Po vemë këtë paraqitje besnike të një fakti të vërtetë, si jehonë e përjetëshme e qenies së rëndë, por e mbuluar prej një veli (tisi) të jetës së njeriut. Mund të thuhet se zotni /Bernard/ Bilotën, studimet e të cilit synojnë, gjithmonë, të qesin në pah (në dritë) atdheun e mjeruar /të të parëvet tanë/, qielli e nderon me dhurata notash *sui generis* (të veçanta, të posaçme) në harmoni poetike, që më është dhënë të paraqes.

1896

52. ANTON ARGONDICA (ANTONIO ARGONTIZZA)¹⁰⁴

Autor i këtij vajtimi kaq të natyrshëm dhe të mirë përsa i takon gjuhës, është Anton Argondica, nga Mbuzati. Ky, në bashkëveprim me profesor Anxhelo Ferrarin nga Frashineto, me Doktor Agostin Ribekon nga Specano arbëreshe, me kavaljer Luixhi Laudan dhe me Xherardo Konfortin nga Greçi di Pulja, qe anëtar i Komitetit, promotor i Kongresit gjuhësor shqiptar, ideja mëmë e të cilit dhe zhvillimet e tij të para i atribuohen atdhetarit të shquar kavalier (kalorës) Lauda, hartues (autor) i një kënge të re e të bukur, në formë marshi, italisht.

1896

¹⁰³ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada Appendice alla gramatica, Stabilimento Tipo- Stereotipo del Cav. A. Morano, Via. S. Sebastiano 47, Napoli, 1896, p. 44*

¹⁰⁴ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 43.*

53. TONI GULIA (TONY GULIA)¹⁰⁵

Duam të fillojmë ne nga vrasja e Mehmet Ali Pashës, sepse nga ajo, më tepër se s nga të goditurat e duarve të fshehta, që i lëvizën /gjërat tona/ gjithëkah dhe i rrëzuan udhës, ngaha edhe po venë, duket qartë shkaku i fatkeqësisë sonë. Për këtë arsye, pastaj, Fuqitë e Mëdha të Europës u ngurtëzuan në zemër mbi fatin e Shqipërisë. E, doemos, se nga ajo e keqe, po të mos ia kishin pasë rrëfyer me të rreme, do të ishte pasë ndezur më shpejt ndër ta dashamirësia dhe admirimi për atë *besë*, së cilës në Shqipëri, kudo që të shfaqet, pleq e të rinj i flijojnë dashurinë e atdheut, gjërinë dhe vetëhenë. Pse është një histori e dëlirtë, si rapsodi e Homerit, tek e cila pasqyrohet kthjelltë shpirti shqiptar. /Ajo është/ e shkruar nga një bujar, që ishte me gjithë shtëpinë e tij në Lidhjen e Prizrendit, dhe mori pjesë në atë zí, deri që e pau, gati, për së afërmi /se si u shua ajo/.

Ky kuadër homerik, kaq i vërtetë dhe i dalluar (i spikatur) për tiparet e moçme të Hoshit të Nurit dhe të Abdullah Pashës, ka për autor Toni Gulian, i biri i Prenkës, aso kohe myselim (= nënkryetar) në Gjakovë, i cili ka qenë dëshmitar i kësaj kërddie (kasaphaneje, katastrofe). Mbas ndonjë viti. . ., duke përfituar nga një armëpushim. . ., u strehua në Itali; dhe prej Rome, im bir, Rodrigoja, e solli në shtëpinë time, për strehim, ku qe mik i nderuar për katërmëdhjetë muaj. Në Gjakovë kishte gruan dhe katër fëmijë të vegjël. Kur qe ndër në, e ndryshoi dialektin e lindjes me të folmen e ngulimeve (kolonive arbëreshe). Vitin që kaloi /1895/, muarëm vesh se u gjindte në Londër. . .

1883, 1896

¹⁰⁵ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada Appendice alla gramatica, Stabilimento Tipo- Stereotipo del Cav. A. Morano, Via. S Sebastiano 47, Napoli, 1896, p. 12.*

54. ALFONS KJINIGO' (ALFONSO KJINIGÒ)¹⁰⁶

Kjo *përrallë* – që duket si shëmbëllesë e një njeriu të mërzitur, nëpunës i zotërisë – që mbledhur, së bashku me të tjera, nga Alfons Kjinigò, vendlindjen e tij. Në të shihet se si qëndresa e një vullneti të urtë e të virtytshëm lehtëson rrugët e jetës së lavdërueshme. Qe nxënës i Kolegjit arbëresh në Shën Adriano. E njoha në Napoli më 1885, e qeshë, për dy javë, mysafir i këtij studenti e i të vëllaut të tij, Françeskut, dy bij të mirë të Shqipërisë. Më ndenj, pastaj, për krah, si redaktor i *Fiamurit / të Arbërit*; sot është sekretar i prefekturës së Bolonjës.

1896

55. NIKOLLË NAÇO¹⁰⁷

Nikollë Naçoja, një burrë shqiptar me karakter të fuqishëm, na paraqet, më së miri në kohën tonë, reaksionin e Shqipërisë, veprimet këmbëngulëse të Shqiptarëve kundër dëmtimeve të jashtëzakonëshme të helenëve, kundër qëllimeve të këqia pushtuese të grekëve. Mbas ngjarjes në Mansurah (Egjipt), ku konsulli grek e kishte fyer (përdhnuar) nipin e tij 16-vjeçar, ai mori armën në dorë, me të cilën i doli para dhe e vrau (e mbyti) brenda në karrocë, në shesh, në mes të rrugës. Pastaj Nikollë Naçoja kaloi në Bukuresht, ku themeloi gazetën e përditshme *Shqiptari*, që vjen mbas së përkohëshmes sonë, *Fiamuri Arbërit*.

1896

¹⁰⁶ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 12

¹⁰⁷ *Antologia albanese*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 32

56. KRISTINA XHENTILE MANDALÀ¹⁰⁸ (CRISTINA GENTILE MANDALÀ)

Por prej Sicilie kemi një letër të rëndësishme, e cila, përveç se bërë emrin e një djali të ri me shpresa të shndritshme që i dha *Fiamurit /të Arbërit/* - në të njëjtën kohë, ajo letër është një sprovë e shkëlqyeshme e një mendjeje të ndritur (të ditur), si përsa i takon shprehjes së lehtë ashtu edhe përsa u përket vargjevet krejt të përkryera (të përshtatshme) për zonjat tona bujare.

*
* *

Nuk e di se çfarë fati e përndjek fisin (popullin) tonë! Ndoshta kohëve dhe individëve cilësitë (vetitë e pajisjet) e larta u janë dhuruar për t'u mbrojtë kundër fatkeqësive. Kjo zonjë e re, e martuar /duket/ tash së voni, në moshën 18-vjeçare, me një inxhinier të shquar, Gjergj Mandalà, ka mbetur e vejë, në majin që shkoi. "Po – më shkruante ajo, mbasi unë e mora lajmin e fatkeqësisë – është shumë e vërtetë se unë nuk kam më burrë. Kam humbur engjëllin mbrojtës (kujdestar), që, ditë e natë, vegonte (rrinte zgjuar) mbi mua, që më kushtonte të gjitha përkujdesjet e tij, të gjitha mendimet e tij, gjithë vetëveten e tij. I mirë, i ditur, i dashur, i plotë – ai ishte gëzimi im, krenaria ime, e ardhmja e ime. Pa pritë pa kujtuar, ai m'u zhduk e, nga gjithë ai thesar virtyti dhe dashurie, nuk më ka mbetur gjë tjetër veçse kujtimi dhe emri i tij, që ma la të pastër (të papërlyer dhe të pashlyeshëm).

1896

¹⁰⁸ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 34

57. ANTON SANTORI (ANTONIO SANTORI)¹⁰⁹

At Françesk Anton Santori lindi në Koloninë /arbëreshe/ të Picciljias (Shën Katerina), më 1819. Në moshën 16-vjeçare, me shumë pak njohuri, u strehua në një monastir /murgjërish/ Fretërish të Reformatëvet /një degë e Urdhërit të Shën Françeskut/, ku mendja e tij e shkëlqyer plotësoi mungesën e studimeve të rregullta. Rreth vitit 1839, qe botuar në Napoli një *Këngëtore shqipe* e tij, e shkurtë, por me ndjesi të nxjerra nga natyra e gjallë; u bë, kështu, i njohur në Kalabri. Urdhëri i Reformatëve, duke e nderuar, e emëroi dy herë, nëse nuk gaboj, Definitor. Në kaq, ai ndiqte lavrimin e gjuhës amtare në romanin e gjerë e gjenial *Sofia e Kominiatëve*. Kahë viti 1858 iu besua themelimi i një kuvendi (monastiri) në Lattarako, ku, mbasi solli, së bashku me dy laikë (punëtorë) dhe me tetë ose nëntë dukatë, mundi të radisë (të furnizojë), brenda, pothuajse, dy vjetësh, shtëpinë e re, sipas një vizatimi të tij të bukur e të veçantë. Por kryengritja që ndodhi, jo vetëm që ia zhgatroi veprën, por edhe ia zgjidhi e ia mbylli fatet. I lënduar nga cmira (zilia) e shokëve e nga çrregullimi i jashtëm mosmirënjohës e i palirshëm, braktisi jetën prej murgu e u tërhoq në fshatin e lindjes. E aty jetoi, pastaj, duke dhënë mësim e duke ndërtuar, me duart e veta, vegje (vegla për të tjerë, makina tjerrëse), me tre a katër boshta, të çpikura prej tij, që i shiste me çmim të ulët (për pak dhetshe). Gjatë këtyre provave, qe botuar në Kozencë romani i tij në gjuhën italisht *Bija e mallkuar*, vepër e veçantë në formë dhe me vërtetësi të tmershme; e, bashkë me vepra të tjera, ai shkroi, hartoi, edhe këtë dramë, *Emira*, në veprimin e së cilës qe dëshmitar. Sot drejton famullinë e varfër të Shën Jakut, e cila, duke pasur për peshkop Parlatoren, meçenat i klerit të mësuar, ka punuar për ta bërë këtë vend të çfarëdoshëm strehë pushimi, 1887.

¹⁰⁹ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 82.

Nuk dua të hesht, sepse prej të nderuarit zotni Mikele Markjanò nga Makja, tash profesor në Kolegjin e Barit, qe ndjerë më mirë, në mes të të gjithë atyre që unë di, veçoria e kësaj poezie të rrallë, të jashtëzakonshme. Në lidhje me tragjedinë e Picciljies, ai shkruante: Santori, mbas kaq shekujsh, thërret “në jetë artin grek, imitues i përsosur i shpirtit dhe i frymës së ëmbël të Idileve të Teokritit e të Elogeve të Virgjilit”.

Autori vdiq në varfëri e në hidhërimë ditën e 7 shtatorit 1894.

1896

58. THIMI MITKO¹¹⁰

Thimi Mitkoja nga Korça ka qenë guri themeltar i rindërtimit të atdheut të vet. Lindi nga një shtëpi, në të cilën, dashuria e vërtetë ndaj kombit të vet të robëruar ishte tradicionale. Iu vu tregëtisë e jashtë bëri çmos për të zbatuar atë që tha Kornel Nepoti për Themistokliun: “I gjykonte sendet e tanishme në mënyrë të drejtë dhe me parashikim dhe i lidhte me ato që do të vijnë”. Kurrë nuk i largoi sytë prej fatit të Shqipërisë së vet. Në “*Bletën shqiptare*” është – kisha për të thënë unë – në embrion ajo që ruan gjithnjë atdheu im /i të parëvet/ nga qenia e tij bujare (fisnike) e prej nga merr zemër e ripërtëritet. Mitkoja i dha kombit të vet një vepër madhështore, sa që nuk mund t’ia dhurojnë një gjë kësisoji as ngulimet (kolonitë) arbëreshe të Italisë, me gjithë kolegjet e tyre të Shën Adrianos dhe të Palermos /d.m.th. me gjithë zhvillimin e tyre kulturor nëpërmjet të këtyre institucioneve shkollore arsimore/. Një gjë të tillë e gjejmë sot vetëm te Anselmo Lorekjo, në ngulimet (kolonitë arbëreshe) të Kalabrisë së Mesme, që janë dorëjashtë, deri tashti, me ato dy Kolegje /d.m.th. që nuk kanë të bëjnë fare me to/. Ky zotni, që është nga një familje plotësisht atdhetare, qëndron në fushë (në betejë) me hovin e tij /djaloshtar/ dhe me një fuqi gjithënjë më të madhe për mbrojtjen e popullit shqiptar. Dhe Zoti e dhashtë që të tërheqë mbi kombin shqiptar simpatinë e Italisë dhe vemendjen e Europës.

1896

¹¹⁰ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 29-30.

59. LEONARDO DE MARTINO¹¹¹

Ishte detyrë e jona që të botonim në vazhdim disa skena të dramës baritore të At Leonard De Martinos nga Greçi di Pulja, misionar apostolik në Shqipërinë e Veriut. Sigurisht, i shkëlqyeri De Martino ka, më shumë se të gjithë né, merita të mëdha për ringjalljen e shpirtëravet në Shkodër e në krahinën e saj, ku ai rrin. Por, tash, ai shkruan në dialektin e atij vendi e me alfabetin e propagandës /Fide/: Së pari, nuk i ka mbetur nga shqipja veçse pyka e pashkatrrueshme morfologjike e sintaksore; alfabeti, pastaj, që e ka hequr krejtësisht zanoren e shurdhët ë dhe ritmin e lindur, mbledh një grumbull bashkëtingëlloresh me zanore të pasigurta, të vështira për t'u lexuar. E, duke qenë se mungon përkthimi përbri, edhe për né ka dalë, aty-këtu, i pakuptueshëm.

1896

¹¹¹ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 74.

60. RODRIGO DE RADA¹¹²

Është me dyshim – shkruan Horaci – në se komedia i përket prozës apo poezisë; dhe në këtë dyanëshmëri unë po vë në mes të njerës dhe të tjetrës këtë dialog të një djaloshi 14-vjeçar. /Rodrigo De Rada/.

Sepse do të ishte një poezi fine (e hollë, elegante) – sikur e quan i nderuari Bovio përpyjekjen e tij dramatike “Krishti në Festë” të Purim-it. Është një kuadër i shkollës së padëshërueshme dhe i shikuar keq. Skena që nxirret prej këtij Aristofani të vogël të “artit të vogël prej Bovios” është plotë jetë, vërtetësi, shpirt dhe gjykim, pajë (apo cilësi) këto që u mungojnë bisedave të Purim-it. Ky filozof nuk na ka prek. Si mësues i shumë nxënësve, ai ka meritën se të mëson dhe të edukon me shembullin e vet kuptimin e saktë (apo drejtimin e vërtetë).

Shkruar në Koriljano Kalabro, në dhjetor 1872.

Botuar më 1896.

¹¹² *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada Appendice alla gramatica, Stabilimento Tipo- Stereotipo del Cav. A. Morano, Via. S. Sebastiano 47, Napoli, 1896, p. 35.*

61. XHUZEPE DE RADA¹¹³

Nuk kemi letra nga ngulimet (kolonitë arbëreshe) që t'i vemë, këtu, së bashku me mendimet e tyre parashikuese dhe me një thirrje dashurie për nënën tonë të pikëlluar nga të gjitha anët. Kam pranë vetes një përmendore afekti ndaj gjuhës amtare nga katër të rinj të vdekur – e kush e di se nga cili fat vdiqën njeri mbas tjetrit, nga e njëjta sëmundje: F. Baffa prej Shën Mitrit, Dramis nga Mbuzati, Akile Parapunja prej Perçiles dhe Xhuzepe De Rada nga Makja. Por kjo tërësi letrash në gjuhën shqipe është caktuar të dalë në dritë, kur (në qoftë se do të vijë dita për né) atdheut /të të parëvet tanë/ të ripërtëritur do t'i duhet të rishikojë këto kujtime e kujdese të thjeshta shkrimi të të rinjve të vet. Do të më lejohet vetëm sa për të sjellë një letër, me anë të së cilës ky djaloshi i fundit, ndër këta katër, do të jetë i dashur për kombin e vet. Me këtë letër ai i jepte nënës së vet lajmin e një fatkeqësie e të një sëmundjeje së pashërueshme, që qe shkaku, ndoshta, i venitjes së jetës së tij të njomë, i shuarjes së parakohshme të tij, në lulen e rinisë së vet.

¹¹³ *Antologia albanese, tradotta fedelmente in italiano da G. De Rada*, Tipografia A. Morano, Napoli, 1896, p. 33.

*
* *

Të një kohe së lashtë dhe, gjithashtu, të panjohura si datë janë të ashtuquajturat *vargje (vjersha)* njëmbëdhjetë rrokëshe që këndohen prej dy vjetësh. Janë porsì shigjeta të hedhura nga larg ndaj pikës që i drejtohen. Jo më pak të çmueshme se sa *Rapsoditë kombëtare*, me të cilat barazohen për nga origjinaliteti, ato na japin, në trajtë të paimitueshme, shprehjen e një dashurie të zjarrtë, të thjeshtë e të pastër në vërtetësinë e saj. Djali im, Xhuzepe, bëri mbledhjen e parë, por jo aq të plotë e të begatë, sepse ra i sëmurë dhe, për këtë arsye, i braktisi këto kujdesje fisnike. Nga kjo /përmbledhje këngësh/ kemi nxjerrë disa prova, porsì stoli (zbukurime) të çmueshme për *Antologjinë* tonë.

*
* *

Le të themi se *pietatis causa* është një imitim i vargjeve popullore të bëra nga Xhuzepe de Rada, e cila mund të thuhet se është vajtimi i jetës së tij të re. Ai e kompozoi atë në shtator të vitit 1883; vdiq më datë 19 të nëntorit pasardhës.

*
* *

Revista e Periodikëve, që botohet në Berlin, u ndal t'i merrte në konsideratë këto vargje shqipe, disa ese që u shfaqën tek *Fiamuri*. Ajo thotë se janë disa strofa popullore me dy apo tre vargje njëmbëdhjetë-rrokëshe që ngjajnë pothuajse me Këngët e mbrëmjes që tingëllojnë për t'u dëgjuar edhe nga distanca, që vijnë pak a shumë si rrufetë që lëshohen nga një kodër, ndërsa dy njerëz i përgjigjen njëri-tjetrit. Shembull: *I ëmbli koriandër, i lumtur, ai që do të të shijojë, etj.* Këtu, më tepër se sa në mendime, magjepsja qëndron në gjuhën dhe tingullin që i shpreh ato, etj.

KREU IV

VEPRA HISTORIKE, PUBLICISTIKE, POLITIKE (1873–1898)

1. AUTONOMIA E SHQIPËRISË¹¹⁴

Që më 1873, në një shënim në librin III të kësaj poeme, unë thosha se Shqipëria, tashmë, nuk mund ta ruante kombësinë e vet, veçse duke qëndruar e bashkuar me perandorinë osmane. Autonomia, pa një përkrahje vëllazërore, do ta shtynte të lakmonte që të shtonte (aneksonte) për vete provinca, gjë që, gjithnjë e më tepër, pushton e çorodit shtetet e mëdha. Tani sllavët fqinjë do ta përpinin si shpërblim dëshirash sundimi të dikurshme; kurse, përsa u përket grekërve që i patën mundur me ndihmën e shqiptarëve të ishullit, të Sulit e të tjera provincave, në vend që t'ua lëvronin gjuhën dhe traditat dhe t'i bënin për vete, nëpërmjet panhelenizmit ziliqar e të zbrazët, u përpoqën t'ua mohojnë traditat fisnike pellazge dhe t'ua bdarin gjuhën; ndaj një humnerë është hapur, tashmë, mes dy popujve. Kështu që, duke u vënë, në luftën e tanishme, nën flamurin osman, shqiptarët jo vetëm e zgjodhën për vete vendin e rrezikut e të nderit, siç ishte i denjë për ta, por punuan (vepruan) me mend për shpëtimin e vet. Dhe, sido që të jetë përfundimi i kësaj lufte, ne besojmë që Zoti i drejtë do t'ia lerë mëmëdheut tonë atë liri dhe një jetë më të mirë, tek e cila të mund të mbështetemi edhe ne para se toka e huaj të na hajë.

1877

¹¹⁴ *Poesie albanesi*, volume V, *Skanderbegu i pafaan*, Tipografia Francesco Mormile, Napoli, 1877.

2. FLAMURI I SHQIPËRISË¹¹⁵

Shqipoja në pëlhurë (fushë) të kuqe, e ardhur, pothuaj, nga i njëjti qiell me atë të Romës, ishte flamuri i Shqipërisë.

Dhe, o pse ndokush i quan Lekën e Pirron bij të kësaj, o, më pastaj, Skënderbeun e pathyeshëm, Qypriun e Ali Tepelenën, e, më pranë nesh, Mehmet Aliun e Egjiptit e Mijaulin, Boçarin, Odiseun, Karaiskaqin e Sulejman Pashën, sot frenues i prepotencës (kapadaillëkut) së Rusisë, o pse synon të arrijë lavdinë më të qetë (pa bujë) të princeshës Dora d'Istria, e nderuar nga dy botë, si dhe atë të Akil Torelit që, në rini, qëndroi krahas princërve të skenës italiane, don të thotë (duke marrë parasysh edhe se pothuaj të gjithë jashtë atdheut arritën ta mposhtim fatin) se ai flamur fisnik i përshtatet më së miri Shqipërisë.

1877

¹¹⁵ Po aty.

3. P R O T E S T Ë

Komiteti Shqiptar në Itali po përpiqet t'i përgjigjet sa më shpejt thirrjes që i bëhet duke botuar këtë:

P r o t e s t ë

Duke ditur, tashmë, se qeveria e Athinës paskesh deklaruar se don ta radhitë Epirin në provincat helenike, dhe disa nga grekët që banojnë në mes nesh o të ardhur tani paskeshin shpallur deri aneksimin e vendit tonë me të vetin, ne shqiptarët e vërtetë dhe bij të shqiptarëve të vërtetë protestojmë e deklarojmë me plot që përpara Zotit e njerëzve, se Epiri i Lashtë, o Shqipëria e Poshtme, Epiri i Ri, o Shqipëria e Mesme,

Shqipëria e Sipërme, o Gegëria,

Të cilat kanë bërë pjesë në mbretërinë e Egjiptit të lashtë e të lavdishëm dhe të Shqipërisë, janë të gjithë, me të njëjtin titull, pronë e shqiptarëve, që e kanë zotëruar në çdo kohë pa qenë në gjendje ndonjë njeri të kujtojë se e ka pasur në dorë kush tjetër;

Dhe betohemi mbi gjoksin e etërve tanë dhe mbi shpatën e pathyeshme të Mbretit tonë – Herojt Skënderbe, se ne dhe bijtë tanë do të dinë t'i mbrojmë jo me më pak xhelozë se të parët tanë, dhe do t'i ruajmë aq sa do të rrahë vetëm një zemër shqiptare, në kujtimin e asaj shpate e të atij gjaku!

Prandaj i bëjmë thirrje Princit tonë shumë të dashur Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe të gjithë bashkatdhetarëve tanë që gjinden të shpërndarë në tokën bujare të Italisë, në perandorinë e hapët osmane, në Livadi e në ishuj, që të bashkojnë zërin e tyre me tonin në këtë protestë, që ne ua drejtojmë të gjitha autoriteteve e fuqive të mëdha, duke iu lutur që të mbrojnë tërësinë e Atdheut tonë të dashur kundër

lakmive (pangopësive) të qeverisë së Athinës që, duke u përpjekur që të na japë lirinë me aneksimin, kërkon të na rrëmbejë gjënë më të mirë të një populli, *kombësinë e tij. E ç'do të na vlente të ishim të lirë, po të mos ishim më shqiptarë?*

Ua dërgojmë, pra, Komitetit tonë Qendror dhe komiteteve që janë përjashta që t'i bëjnë publicitet sa më të gjerë Protestës së tanishme, si nëpërmjet shtypit lokal, ashtu edhe me anë gazetash.

Nga malet shqiptare, sot, më 12 shkurt 1878, krerët e fiseve (tribuve) të Shqipërisë së Sipërme, të Mesme e të Poshtme.

(vazhdojnë nënshkrimet)

12 shkurt 1878

4. P R O T E S T Ë 2

Komiteti Qendror i mbrojtjes së të drejtave të kombësisë shqiptare. Të gjithë atdhetarëve shqiptarë.

Ne, sapo kemi bërë të përhapet, përmes shtypit e komiteteve lokale, protestën tuaj kundër pretendimeve (synimeve) të qeverisë helenike ndaj Shqipërisë së Poshtme e Epirit, pjesë e pandarë e vendit tonë, sikurse Shqipëria e Mesme e Shqipëria e Epërme. Një dokument i tillë, i dalë nga vullneti i të gjithë juve, i nënshkruar nga krerët e parësia juaj, është një dëshmi e lidhjes suaj të flaktë me atdheun tonë e . . . të pandashëm (një).

Por, ndërsa përpjekjet për të shkelur Shqipërinë e Jugut shmangeshin nga refuzimi i krerëve tuaj për t'u bashkuar me vullnetarë grekë e nga rezistenca e banorëve të Epirit, një tjetër shkelje e huaj ndodhi vërtet në Shqipërinë e Veriut.

Dihet që shqiptarët, përsa mund të puthitej me detyrimin e tyre ndaj Portës së Lartë, kanë mbajtur një asnjanesi të plotë në luftën mes turqëve e malazezëve.

Si pasojë, ju duhet ta shikoni me surprizë Malin e Zi – i futur në luftë vetëm me qëllim që të çlirojë vëllezërit e vet të Hercegovinës, siç e kishte deklaruar plot bujë princi i tyre – të hidhej, përkundrazi, ndër limane e ndër rrethe të Veriut të Shqipërisë së Epërme. Duke pandehur se ky pushtim ishte bërë për qëllime ushtarake, ne kishim shpresuar se ai s'do të kishte vend më me pushimin e luftës dhe nuk do të cënonte aspak të drejtat tona kombëtare. Mjerisht, qeveria malazeze është tërhequr nga dëshira për të mbajtur gjithnjë territorin e pushtuar si edhe disa fise autonome, që ai nuk ka pasur fuqi t'i pushtojë dhe të cilat, jo më sikurse territorin, askush nuk kish të drejtë t'i përdorte sipas interesit të vet. Ajo /qeveria malazeze/, madje, ka

filluar t'i trajtojë shqiptarët sikur të ishin bërë, tashmë, nënshjetas të saj. Krerë malazezë nuk pushojnë të përdorin gjithfarë përdhunimesh e plaçkitjesh në vendin tonë, dhe, ditë për ditë, ata bëjnë shpërdorime mbas shpërdorimesh.

Një sjellje (qëndrim) këso dore agresive e dhunuese dhe që nuk mund të përlligjet as nga më i vogli provokim nga ana jonë, ngjall tek ne një zemërim të thellë e të përgjithshëm. Përpyekje të përgjakshme ka rrezik që të ndodhin mes trapave malazeze dhe popullsisë të shkelura dhe, në mbarë Shqipërinë, tashmë, po ngrihet kushtrimi: Duhet t'u vemi në ndihmë vëllezërve të trazuar e të zhveshur!

Komiteti Qendror e ndjen si një nevojë shumë të ngutshme të pengojë (të shmangë) një luftë mes dy popujve që, mjerisht, patën rast të masin forcën dhe trimërinë e tyre, dhe të shporrë, kështu, rreziqe të reja për paqën e Lindjes. Komiteti do të përdorë të gjitha përpjekjet e tija për të mbrojtur përpara opinionit publik dhe diplomacisë europiane të drejtat e kombësisë shqiptare në Shqipërinë e Epërme, siç e ka bërë po për të njëjtën arsye në Epir. Ai do të bëjë përçapjet më të forta tek Porta e Lartë e tek kabinetet e fuqive të mëdha që ta bindin qeverinë malazeze për të hequr dorë nga ndërmarja e padrejtë dhe e rrezikshme e saj. Asgjëmangut, Komiteti beson, njëkohësisht, se duhen këshilluar (nxitur) krerët e parësia, si edhe të gjithë atdhetarët e mirë shqiptarë, që të bëjnë ç'është e mundshme për të frenuar mospërmbajtjen, nga ana tjetër mjaft e ligjshme, e vëllezërve të tyre dhe t'u kallë besimin në drejtësinë e dashamirësinë e lartë të Madhërisë së tij Sulltanit dhe të sovranëve të tjerë të Europës, të cilët, asgjë tjetër nuk kanë, sigurisht, më fort për zemër, se sa paqën e lumtërinë e të gjithë popujve të Lindjes. Ne dëshërojmë tani, pa nxituar, të jetojmë në paqë me të gjithë fqinjët tanë të Malit të Zi e të Greqisë, të Serbisë e të Bullgarisë. Ne nuk kërkojmë, nuk duam, asgjë prej tyre; por jemi, plotësisht, të vendosur për ta mbajtur gjithë atë që është jona! Le t'u lihet, pra, shqiptarëve toka shqiptare!

Pera-Konstantinopol, 18/30 maj 1878.

(Vazhdojnë nënshkrimet)

18/30 maj 1878

5. JETA E SKËNDERBEUT ZEMËRMADH

Gjon Kastrioti, pasi lidhi aleancë me dy princër të tjerë shqiptarë, luftoi kundër Amuratit. I mundur nga ky i fundit, ai bëri paqe dhe për të respektuar traktatet iu desh t'i jepte zotit të madh (Sulltanit) katër djemtë e tij: Reposhin, Stanishin, Kostandinin dhe Gjergjin.

Gjoni kish marrë për grua Vojsavën, të bijën e Princit të Maqedonisë dhe Bullgarisë, një zonjë shumë e shquar dhe e bukur, nga e cila kish pasur katër djemtë e lartpërmendur si dhe katër vajza: Marien, Vitën, Angjelinën dhe Mamicën.

Amurati, meqë i kishte parë fëmijët e Princit të Shqipërisë dhe meqë i ishin dukur të rinj, të pashëm dhe të fortë, mendoi se një ditë ata mund ta nderonin perandorinë e tij dhe prandaj vendosi t'i trajtojë ata si fëmijët e vet. Megjithatë, disa prej tyre ishin tashmë të rritur dhe, meqë ai nuk mundi t'i thyente lehtë, siç dëshironte vetë, zgjodhi t'i helmonte.

Kështu që, disa më herët, të tjerët më vonë, ai helmoi tre (nga katër vëllezërit) më të mëdhenjtë, duke mbajtur me vete Gjergjin, i cili asokohe ishte vetëm tetë ose nëntë vjeç. Këtij, më vonë, në mënyrë që të mos ruante asnjë kujtim të prindërve të tij dhe atdheun të vet, ai madje i ndryshoi edhe emrin, duke e quajtur *Skënderbe*, i cili në gjuhën turke tingëllon: "*Zoti Aleksandër*".

Ndërkohë Skënderbeu po rritej i pashëm, i ngjeshur, i fortë dhe bujar (me zemër të madhe). Që në moshë të njomë s'bënte gje tjetër veçse stërvitej në kalërim, në përdorimin e shpatës, në hedhjen e shtizave dhe ushtave. Ai nuk kishte shok tjetër veç shpatës; çdo ditë bëhej gjithnjë e më i fortë, aq sa në perandorinë e Amuratit nuk gjendej askush tjetër që të mund të matej me të, në ndershmëri, në kalërim, në goditjet në shënjestër dhe në përdorimin e shpatës. Por Skënderbeu, përpos se dinte se si të luftonte dhe të ishte i shkathët në çdo luftë apo nismë

luftarake, ishte i ditur edhe në gjuhën turke, arabe, greke, sllave, latine dhe italiane.

Amurati, si e pa aq të përkushtuar dhe mbi të gjitha trim në luftë, e vuri në krye të një ushtrie të madhe.

Kishte kaluar pak kohë që kur e mori vesh se ishte emëruar komandant, kur mbretëria e Kilikisë u ngrit kundër Sulltanit, i cili pasi mblodhi një ushtri të madhe, dërgoi edhe Skënderbeun me krerët e tjerë për të luftuar kundër asaj mbretërie dhe për ta kthyer atë sërish nën flamurin e tij.

I riu shqiptar u soll aq mirë dhe sypatrembur në këtë luftë, sa që udhëheqësit e tjerë bashkë me shpurat e tyre, me t'u kthyer i referuan Amuratin sa më tej vijon: “Nuk ishin shpatat e ushtarëve tanë që mundën Mbretin e Azisë, e cila i kishte kthyer armët kundër jush, por trimëria dhe madhështia e Skënderbeut”. Skënderbeu ishte vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç atëherë. Pas disfatës së kilikianëve, një mbretëri tjetër e Azisë, e cila jo shumë kohë më parë ishte vënë nën zgjedhë nga Sulltani, u rebelua kundër tij. Amurati, pasi i dorëzoi heroit shqiptar një ushtri të madhe kalorësish dhe këmbësorësh, e dërgoi atë kundër asaj mbretërie. Në këtë luftë Skënderbeu rriti nderin që kishte fituar në ekspeditën e Kilikisë, duke mundur armikun dhe duke u kthyer tek Amurati plot me plaçkë (fjalë për fjalë: monedha ari) dhe të burgosur.

Sulltani, duke e parë aq të fortë dhe të guximshëm, e vuri në krye të të gjithë gjeneralëve të tjerë dhe mendoi ta dërgonte kundër disa mbretërve të Azisë, të cilët nuk donin të njihnin autoritetin e tij mbi ta.

Gjergji shkoi atje dhe jo vetëm që mundi ata kundër të cilëve u dërgua, por ai nguli flamurin e gjysmëhënës në shumë mbretëri të tjera; më pas kur u kthye, Amurati e mirëpriti me të gjitha nderimet dhe i dorëzoi shumë monedha ari.

JETA E SKËNDERBEUT ZEMËRMADH (vijon)

Një ditë të bukur një tartar erdhi në oborrin e Sulltanit nga Adrianopoja dhe sfidoi një e nga një çdo turk që të ndeshej me të në një dyluftim trup me trup.

Turqit dëgjuan sfidën e shpallur për duel, por askush nuk kishte guximin të dilte përpara; tani *zoti i madh*, me qëllim që të gjente dikë që do të dilte të matej me tartarin (përndryshe ky do të qe një turp i rëndë për perandorinë e tij) premtoi shumë monedha ari dhe një mijë gjëra të tjera, por askush nuk u avit në mejdan.

Sapo Skënderbeu mësoi se një tartar kishte patur guximin të sfidojë më të fortin, në oborrin turk, nuk mundi më të rezistonte dhe, me të dalë para Sulltanit, i kërkoi leje që të mund të matej me tartarin, i cili po mbillte terror në të gjithë perandorinë. Amurati, duke e parë Skënderbeun kaq të ri, në fakt atëherë sapo kish filluar t'i dërsinte mjekra, pati droje ta linte dhe i tha:

- Skënderbe, biri im, hiqe nga mendja këtë mendim, sepse duke të humbur ty, do të kem humbur krahun tim të djathtë. Por pas shumë këmbënguljesh, pavarësisht se e donte me shpirt, më në fund e la të shkojë. Ai desh të merrte pjesë personalisht në duelin e veçantë, në mënyrë që të vëzhgonte nga afër aftësitë e të riut shqiptar.

Tartari teksa e pa Skënderbekun kaq të njomë, duke qeshur e qortoi ashpër duke iu drejtuar kështu:

- Djalosh, pse don t'i pikëllosh, me vdekjen tënde, babanë dhe nënën? Shko tutje, sprapsu! Nuk je burrë që të meritosh hakmarrjen e shpatës sime.

Skënderbeut këto fjalë nuk i tingëlluan mirë dhe i hidhëruan shpirtin. Ai e pa kundërshtarin me një fytyrë të zemëruar dhe iu përgjigj:

- Zemërlepur, pse flet duke u mbajtur me kaq të madh? Dil përpara dhe kjo shpatë do të tatregojë se kush jam!

Tartari plot zemërim, zhveshi shpatën, u sul kundër Skënderbeut, por heroi i ri teksa e priti goditjen, e plagosi shpejt në qafë dhe e shtriu pa frymë përdhe. Thirrjet e atyre që ishin të pranishëm u ngritën

në kupë të qiellit dhe Amurati, duke e pritur me gëzim të madh, e shpërbleu me monedha floriri dhe dhurata nga të gjitha llojet.

Pas këtyre ngjarjeve, Sulltani dhe Skënderbeu bashkë me manjatët e tjerë të perandorisë shkuan në Burs ose Prusi, një vend i Bitinisë, ku takuan dy persë të rinj, i pari me emrin Jaja dhe tjetri Zampa.

Këto sfiduan më të fortin midis turqve, në mënyrë që ai të luftonte kundër njërit prej tyre, mbi kalë dhe me ushta. Skënderbeu menjëherë u hodh mbi kalë dhe pyeti kush dëshironte të matej i pari me të. Atëherë doli përpara Jaja, i cili kur lëshoi ushtën, ajo e goditi kundërshtarin në helmetë, por u bë cikë e thërrime. Heroi ynë e gjuajti ushtën e tij, të cilës Jaja, duke u përkulur me shkathtësi, arriti t'i shpëtonte. Pastaj nxorën shpatën nga milli dhe luftuan si dy luanë; Zampa e priti, pasi e kuptoi që Jaja, i vetëm, nuk do të mund ta përkulte krahun e armikut, edhe ai u vërsul kundër Skënderbeut. Ky i fundit, e vuri re menjëherë, u hodh mbi të më shpejt se rrufeja dhe i theu kraharonin duke e hedhur nga kali, pastaj iu kthye Jajas dhe, pasi shkëmbyen disa goditje me njëri-tjetrin, e goditi në shpatull dhe e shqeu deri në ijë. Më vonë, pasi i zbriti gjokut, shkoi tek sulltani i cili e priti plot me gëzim dhe i tha, duke u ngashëryer nga mallëngjimi:

- Skënderbe, biri im, ti je nderi i perandorisë sime, dhe që nga sot unë do të të mbaj si bir dhe kështu do të të quaj.

Skënderbeu, në fakt, nuk u tregua krenar dhe i fortë vetëm në duelet tek për tek, por edhe në çdo lloj lufte tjetër. Ai ishte i pari që hidhej kundër armiqve në betejë, ashtu siç ishte i pari që ishte në gjendje të ngulte flamujtë në barrierat rrethuese të mureve të tyre. Nuk kishte asnjë prijës tjetër që t'i donte ushtarët e tij më shumë se ai, dhe as ushtarë që e donin prijësin e tyre aq sa e donin ata të tyrin.

Ky kur merrte dhurata nga Sulltani, ua shpërndante të gjitha ushtarëve të tij dhe nuk mbante asgjë për vete. Pikërisht atëherë Skënderbeut i vjen një lajm i hidhur, që e lajmëronte për vdekjen e të atit. Dhimbja e Skënderbeut nuk mund të rrëfëhet, kjo edhe ngaqë ai duhej ta fshihte dhimbjen e humbjes së babait të tij, përndryshe Amuratit, i cili e donte shumë si bir dhe i cili e kishte porositur të mos njihte kërrkënd tjetër si baba, do t'i kishte ardhur keq.

Ndërkohë, shqiptarët menduan, sipas fjalës së dhënë, që Amurati do ta dërgonte Skënderbeun të mbretëronte në vend të babait të tij Gjonit. Por u mashtruan sepse Sulltani në të gjitha qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë dërgoi ushtarë turq dhe Vojsavës, e veja e Kastriotit, iu desh të strehohej në Maqedoni tek një bijë e saj shumë të pasur.

Një ditë i shkrepri në mendje Amuratit që të helmonte edhe Skënderbeun, siç kishte bërë me vëllezërit e tij, por duke qenë se atë e donin në të gjithë mbretërinë si edhe turqit më fisnikë, u druajt ta bënte këtë, kështu që e thirri mënjanë e i tha: - “Mos u mërzit nëse nuk po të dërgoj në mbretërinë e të parëve të tu; e bëj për të mirën e asaj mbretërie dhe jo sepse dua të zgjeroj kufijtë e perandorisë sime, por meqenëse të dua si tim bir, më vjen keq të të kem larg vetes”.

Disa fisnikë turq e vunë në shënjestër, dhe pikërisht ngaqë shihej me sy të mirë nga Amurati, ata filluan të përhapnin shpifje kundër tij, domethënë, që Skënderbeu po përpiquej ta dëbonte atë nga fronti për t’u bërë vetë sovran i turqve . . . kjo që arsyeja pse kishte zënë miqësi me të gjithë ushtrinë. Amurati atëherë, shumë i plakur dhe disi i matufepsur, u zinte besë gjithçkaje dhe i besoi të gjitha ato çka ishin thënë për Skënderbeun. Ndërkohë, ai mendonte me vete se si t’ia shuante fitilin e jetës. Por qielli, i cili gjithmonë e kishte mbrojtur, e largoi nga mbikëqyrja e kujdesshme e Amuratit, siç tregohet më poshtë.

Në atë kohë princi i Serbisë u rebelua kundër Amuratit dhe ky i fundit, duke mos pasur asnjë udhëheqës tjetër të fortë dhe të aftë si Skënderbeu, vendosi të dërgonte atë. Skënderbeu, i pajisur me një ushtri të madhe, porsa u përlesh në betejë me Princin e Serbisë, e mundi atë, duke ia shpërndarë ushtrinë nëpër fusha; pra, pasi pushtoi shumë qytete, plot laçkë e plaçkë u kthye te “*zoti i madh*”.

Amurati, i cili tashmë e kishte vendosur fundin e Skënderbekut sa më shpejt të ishte e mundur, kishte frikë ta bënte këtë haptas dhe, në mënyrë që askush të mos dyshonte, filloi të dërgonte shpallje në të gjitha vendet e pushtuara prej tij, për të ftuar të gjithë ata që dëshironin të garonin në qytet, qoftë mbi kalë e qoftë më këmbë, në gara dhe luftime. Sulltani e bëri këtë, pasi e dinte që Skënderbeu do të nxitonte i pari për t’u matur dhe për të garuar me të tjerët, por ai shpresonte që mes shumë personave që do të mbërrinin aty, do të dilte dikush më i fortë se ai që ta vriste. Megjithatë, Skënderbeu i mundi të tërë dhe në të gjitha llojet e luftimeve.

Në vitin 1440 Papa Eugjeni IV, duke parë se turqit po e zgjeronin gjithnjë e më tepër perandorinë e tyre, bëri aleancë me princin e Hungarisë dhe me shumë princër të tjerë të krishterë dhe veproi kundër Sulltanit, me dyzet mijë ushtarë. Atëherë Amurati dërgoi Skënderbeun me njëzet mijë ushtarë, që të bashkohej me Pashain e Maqedonisë dhe të lëvizte kundër të krishterëve. Sulltani i ndoqi me nëntëdhjetë mijë

ushtarë. Skënderbeu, i cili tashmë e dinte që Amurati po përpiquej ta hiqte qafe, mendoi të arratisej dhe të tërhiqej në tokat e të parëve të vet. Për këtë arsye ai i shkroi fshehtas Janoshit, Huniadit, Princit të Transilvanisë, për ta informuar rreth taktikave që duheshin ndjekur për të mundur turqit.

Kur radhët kundërshtare filluan të ndesheshin, Skënderbeu, pasi luftimi kish pak që kish nisur, i ktheu shpinën me njëzet mijë burrat e vet, duke e lënë vetëm Pashain, i cili luftoi trimërisht për një kohë të gjatë, më vonë, kur e kuptoi se shqiptari, i cili ishte një nga më të fuqishmit dhe më të guximshmit prej gjithë prijësave, ishte tërhequr, ia ktheu edhe ai shpinën armikut.

Atëherë të krishterët u hodhën kundër turqve dhe i shkuan ata në armë. Skënderbeu, kur pa se turqit disa ishin vrarë, disa ishin zhdukur, mori me vete një kancelar të *Zotit të Madh, Sulltanit*, dhe shkoi në fushimin e Huniadit, i cili e priti me shumë gëzim. Atje e kërcënoi kancelarin dhe e bëri të shkruante një letër nga ana e pashait të Krujës, të pajisur me vulën e Zotit të Madh, të cilën kancelarët e mbanin gjithmonë me vete.

Në atë letër, Pashait iu tha që të linte menjëherë Krujën në duart e Skënderbeut dhe të kthehej në Adrianopojë; arsyeja e dhënë ishte se, duke pasur parasysh aftësitë e këtij princi shumë krenar dhe ekspert të artit ushtarak, ai duhej të shkonte për të mbrojtur kufijtë, në mënyrë që hungarezët të mos depërtonin në Turqi. Pasi kancelari e shkroi letrën, Skënderbeu e ftoi të shkonte me të në Shqipëri, sepse do ta shpërblente me dhurata, pasuri dhe nderime, por ai nuk desh të shkonte dhe Skënderbeu urdhëroi ta vrisnin që të mos i raportonte gjithçka Amuratit. Prandaj Princ Skënderbeu, duke marrë me vete treqind kalorës që i qëndruan pranë dhe besnikë për aq kohë sa ishte në oborrin e Amuratit, u nis për në Krujë, ku, sapo mbërriti, i dorëzoi letrën Pashait që u nis menjëherë për në Adrianopojë. Me të vënë këmbën në Krujë, zboi menjëherë turqit nga çdo vend i mbretërisë së tij. Disa prej tyre i vrau ndërsa të tjerët, ata që u pagëzuan, i mbajti si ushtarë. Zor të tregohet me fjalë se ç'gëzim patën shqiptarët kur mësuuan se Skënderbeu qe kthyer. Njerëzit, si milingonat e lisit, vërshuan nga çdo fshat në Krujë për ta parë atë. Më vonë, të gjithë, pasi i shkulën flamujt turq nga kullat e tyre, ngritën flamujt e kuq të Skënderbeut me shqiponjën e pruar dykrenare.

6. VRASJA E MEHMET ALI PASHËS¹¹⁶

Duam të fillojmë nga vrasja e Mehmet Ali Pashës, sepse nga ajo, më tepër se nga të goditurat e duarve të fshehta, që i lëvizën /gjërat tona/ gjithkrah dhe i rrëzuan udhës, ngaha edhe po venë, duket qartë shkaku i fatkeqësisë sonë. Për këtë arsye, pastaj, Fuqitë e Mëdha të Europës u ngurtësuan në zemër mbi fatin e Shqipërisë. E, doemos, se nga ajo e keqe, po të mos ia kishin pasë rrëfyer me të rreme, do të ishte pasë nderur më shpejt ndër ta dashamirësia dhe admirimi për atë *besë*, së cilës, në Shqipëri, kudo që të shfaqet, pleq e të rinj i flijojnë dashurinë e atdheut, gjërin (= farë e fisin) dhe vetëhenë.

Pse është një histori e dëlirtë, si rapsodi e Homerit, tek e cila pasyrohet, kthjelltë, shpirti shqiptar. /Ajo është/ e shkruar nga një bujar, që ishte me gjithë shtëpinë e tij në Lidhjen e Prizrendit, dhe mori pjesë në atë zí, deri që e pau, gati, për së afërmi/, se si u shua ajo.

Ishte e mërkurë dhe krerët e bujarët e Gjakovës, muslimanë e të krishterë, dualën mbë udhë të Prizrendit, që prej Gjakovës është larg gjashtë orë të ecur; e prisnin Mehmet Ali Pashën, që kishte bërë telegram në mëngjez, se vinte për të ndarë një anë (= një pjesë) të Shqipërisë e për t'ia dhënë Malit të Zi, siç e donin Fuqitë kristiane.

Na vinte, kështu, një armik i dërguar prej armiqëve. Pritën deri në 11 të mbrëmjes, kur erdh një xhandar e tha:

- Pasha nuk vjen, se ia vranë, në Prizrend, telegrafistin, në kafe të Marashit.

Të gjithë u gëzuan dhe Hasan Aga u tha të krishterëve që ishin aty:

- Ju, të krishterët, jeni të kënaqur. Kishit gëzim, se po u vinte ky, pse është kaurr si ju.

¹¹⁶ *Vreittia Mehmet Aly Pasës* (Uccisione di Mehmet Aly Pascià), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 1, Corigliano Calabro, 20 luglio 1883, p. II.

U përgjegj zotni Pjetri, prifti i të krishterëve, që ishte me ta:

- Si të vijë, si të mos vijë, e mira ose e keqja që vjen për ju, vjen edhe për ne; pse ju dhe ne jemi shqiptarë e të një gjaku; ai vjen i huaj prej të huajsh.

- Po, si kujtoni ju? - përgjegji Hasan Aga, - as ai, as Franca s'kanë ç'na bëjnë më, pse ende jemi të gjallë.

Në mbrëmje, të gjithë u kthyen bashkë në qytet. Të shtunën erdhi Mehmet Ali Gjakova me nja pesëmbëdhjetë suvarí kaluar; e të djelën mbrëma dërgoi e thirri pater fra Pjetrin, që rrinte në Zym, ndaj Drinit, katër orë larg Gjakovës në udhë të Prizrendit. Më një gjymës ore natë, patër Pjetri vate në Gjakovë, në shtëpi të Prenkë Gulisë, muslim për të krishterët, e andej me Tonin e Prenkës, e me një sherbëtor, duallën për të vajtur në shtëpi të Abdullah Pashës, tek kish hequr Mehmet Aliu. Udhë ishte e zënë, gjithëkah, me pushkatarë të Gjakovës e të katundeve, që ishin të shpërndarë tuba-tuba.

Pallati i Abdullah Pashës ishte me katër ndërtesa, me kopështije në mes, e të rrethuar të gjitha me një mur, që i mbyllte brenda; e lumi Përroni, që shkonte për në mes të Gjakovës, lagte ndërtesën, tek rrinin pashallarët. Kur ata hynë brenda, gjetën në kuvend me Pashën të zotin e shtëpisë, Kadinë, Koronicën, Bajram Agën, Sulejman Agën, Shaqir Agën e të tjerë bujarë, të cilët ishin të gjithë krerë të Lidhjes, e përpiqeshin që ta bindnin Pashën të kthejë pa i vënë faj Shqipërisë, se populli ishte me Padishanë. Por, mbasi u buarën fjalët më kot, shumica u ngrenë e duallën. Atëherë pater Pjetri që thirrë brenda. Porse, pa i thënë ende ata mirë: kush je e si je, u mbushën shtëpitë me gjind nga jashtë, të cilët pyesnin:

- Pse erdh ky këtu?

Por doli Abdullah Pasha e u tha:

- Ç'është këtu gjithë kjo britmë?

Ata i thanë:

- E duam njerinë, e duam. Përse ka ardhur këtu?

Abdullah Pasha u përgjegj:

- Unë, për të gjallë tim, njerinë nuk e jap. Si kujtoni ju? S'më njihni mirë, se kush jam unë.

Bajram Aga, Shaqir Aga e Hasan Aga i qitën njerëzit përjashta derës, me të mirë. Sa duallën e u mbyll dera, bënë jashtë një pështjellim

e, pastaj, një batare pushkësh në dritare të dhomës, tek ishte Mehmet Aliu. Të gjithë gjakovarët zunë e zhgrehnin pushkë. Atëhere doli Mehmet Aliu prej dhomës në kopsht e tha:

- Hapnie derën! Ç’duan këta? Mua nuk më trembin me të lehura udhës!

Abdullah Pasha e muar për krahu e i tha:

- Hajde, vemi brenda, se ti nuk i njeh këta se si janë.

U foli edhe burrave:

- Deri sa ndër ju, këtu brenda, të mos jetë kush i plagosur a i vrarë, të mos ngreni pushkë.

Pastaj pleqtë e qytetit hynë në mes e dhanë besën deri kur të dilte dielli.

Më vonë u tha, se në pallat është edhe prifti me Tonin e Gulisë aty. Pasha me Abdullah Beun i thanë pater Pjetrit:

- Mos u tund!

Po Toni i tha fratit:

- Dalim.

Frati i tha:

- Jo. Më tha Pasha: “Rri këtu me ne!”.

Toni vate e foli me Hasan Agën, që i tha:

- Më vjen keq që gjendet këtu pater Pjetri, si edhe ti; por s’mund të dilni.

Pastaj u këshilluan bashkë, i ndërruan mveshjen fratit, i dhanë në një shami gunën e Maldurit, një njeri të Hasan Agës, duallën me këtë oficerin e kaluan pa u vënë ré përmes popullit, që rrethonte pallatin, ku ishin pashallarët.

Si u gdhi e hëna, qyteti hyri edhe një herë tjetër në mes e u zgjat besa deri të nesërmen, në orën pesë. Mehmet Aliu dërgoi Hasan Agën te Filjiesvishi, në Kosovë, me një që kishte sjellë mbas vehtes, i cili do të merrte udhën e hekurit për të vajtur në Stamboll. Me telegrafë, pastaj, lypi ushtarë në Prizrend. Hasan Aga u kthye e, si e porositi zemra e bujarëve, nuk hyri më në pallat te Abdullah Pashës, as nuk u përzie me shokët e Lidhjes; por shkoi në shtëpi të vet e nuk doli prej andej. Të martën, në orën tre, erdh në Gjakovë një batalion ushtarë. Pak para se të vinin, i dualën disa përpara, sepse batalioni kishte edhe shqiptarë, dhe i pyetën:

- A janë edhe shumë që vijnë?

Pararojet u përgjegjën:

- Nuk ka të tjerë.

- E ju, ç'do të bëni?

- Ne, vëlla me vëlla, nuk luftojmë, pse ky është kaurr.

Erdhën në kazermë, në fushë të Bajram Pashës. Kompani nga të Gjakovës e të Rekës, Malësia e pakët e Pejës hynë, pastaj, e u muarën pushkët, municionet e ç'pat me vehte një batalion, kaq sa ata ikën dhe u kthyen në Prizrend të çveshur.

Në kaq, Abdullah Pasha e Bajram Aga kishin dërguar njerëz nëpër katunde e nëpër miq e u erdhën bashkë me osmanllinj nja tridhjetë të krishterë të Fandës, djelm që qenë më të mirët.

Të martën nga mjesdita, Hoshi i Nurit i Novaseljës erdh në Gjakovë e shkoi nga pallati i Abdullah Beut. Bajram Aga ishte duke ndenjtur te dera. I thirri dhe i tha:

- Ku po shkon?

- Shkoj te kisha.

- Kisha nuk ka nevojë, por kam unë këtu nevojë.

- Bajram Aga, do të vete te kisha mos të na e vjedhin malësia.

Bajram Aga ia bëri:

- Po ke frigë, Hosh, të rrish këtu?

- Jo, Bajram Aga, unë s'u frigova kurrë; ti e di mirë, se shumë herë qeshë me ty.

E ndenji aty.

Pak më vonë, zunë luftën e u vranë shtatë o tetë, brenda e jashtë. Qyteti, i alarmuar, hyri në mes e u dha besa deri të enjtën, në orën pesë. Pastaj, meqenëse gjithë të mërkurrën dhanë e muarën, e, /meqenëse/ Mehmet Ali Pasha nuk hoqi dorë nga mendimi, me të cilin kishte ardhur, shpresa e pajtimit iku, brenda dhe jashtë. Atëherë, Mehmet Ali Pasha e Abdullah Beu pajtuan Bajram Agën e Shaqir Agën; e ata dy trima të Shqipërisë, që s'mund të shiheshin fare njeri me tjetrin, u puthën si vëllezër, në këtë orë të zezë. Kur mbrëmja e së mërkurës ra, Hoshi i Nures u mblodh e fjeti te Prenka, të cilin e donin mirë të gjithë. Atij i thanë që të mos kthehej më, se hapte vrasje në mes të vëllezërve.

- Jo, - u përgjigj Hoshi, - se unë i kam dhënë fjalën Bajram Agës edhe ai më ka besuar e më pret.

- Ç' do të thotë ai? S'është e thënë prej Zotit të vrasish e të vritesh pa të dëmtuar kush!

- Kjo, po, është një ditë e lindur nga tërbimi i mallkuar. Abdullah Pasha, prej se ka në shtëpi armikun, i duhet ta ruajë të paprekur nën strehë të vet, dhe nesër, ndoshta, do të vritet për të me shokët dhe me gjërinë, si e lyp ndera. Ashtu duhet të bëj edhe unë.

- Po bijt tuaj të vegjël e nusja e ré sonte s'dinë gjë; e në shtëpi do të mbeten pa asnjë.

Hoshi uli kryet mendueshëm e s'foli fare. Para se të gdhihej, ndërsa njerëzit e shtëpisë endë ishin fjetë, u ngrit dhe vajti te pallati.

Të enjtën, mbas orës pesë, filloi lufta e tmerrshme, që zgjati deri në orën njëmbëdhjetë, e cila kaloi gojë më gojë, përmes këngës popullore:

*“Krisi pushka te mejtepi,
kah lufton Abdullah Begu,
për një që i dërgoi Davleti,
dy asllana i kish me vete,
s'i ka Krajli, as s'i ka Mbreti:
Shaqir Agën e Bajram Rustemin.
Aferim prej njai mileti,
prej miletit të Fandës,
se ata ishin djelmt e nanës,
se ata ishin djelm daji,
lufton Fanda për zotëni.
Abdullah Pasha u kujtue:
- Ç'po ka Fanda që u shurdhue?
Se Hoshi i Nures u vorrue.
Hoshi i Nures po bërtet:
- Bini, shokë, të bâjmë gajret,
se na ka ardhë dita me dekë,
na ka ardhë një ditë e mbarë,
për me dekë me pashallarë”.*

Në orën njëmbëdhjetë, ata që ishin përjashta, hynë brenda, hodhën zjarrin dhe vranë Abdullah Pashën; i dogjën gjithë sarajet; vetëm

ndenji një kullë tri katesh, ku ishin Mehmet Ali Pasha, Bajram Aga, Shaqir Aga, i biri i Abdullah Pashës, një djalë shtatëmbëdhjetëvjeçar, e Hoshi i Nures, i plagosur, me ca pak të Fandes dhe myslimanë. Bënë luftë atë natë gjithë natën. Kah mëngjezi, i biri i Abdullah Pashës, i djegur prej etjes e i lodhur, sepse një ditë e një natë kishte luftuar pa ngrënë e pa pirë, u zgjat në dritare që të hidhej në Përrua për të shuar etjen; por Bajram Aga e kapi për krahu dhe e tërhoq që të mos e vrisnin; e, atëherë, një nga jashtë thirri:

- O, Bajram Aga, pa priti burrat! Shtiu, e vrau dhe ai ra përmbropa. Thuhet se, atë natë, Mehmet Ali Pasha i premtoi gjashtëmijë grosh atij që do t'i sillte një kotrovë me ujë; por asnjë nuk ia solli nga urrejtja, sepse ai, i mbështetur në fuqinë e atyre nga të cilët vinte, dhe jo në zemrën e vet, pat hyrë si gjarpër i zi për të tërbuar Shqipërinë.

Mbasi ra Bajram Aga, armiqtë hypën përmbi të tretin kat e i dhanë zjarrin; në mjesditë digjej krejt kulla. Kur dolën, ata që ishin brenda, i prishën e i vranë. E kështu i vranë me pushkë Shaqir Agën e Hoshin. Vetëm të birin e Abdullah Pashës e muar një në besë dhe e shpëtoi. Mehmet Aliut i prenë kryet e ia vunë në një hu dhe e lanë te fusha e Bajram Pashës, kurse kufomën ia hodhën nga dritarja në udhë.

20 korrik 1883

7. LIDHJA E MALËSORËVET¹¹⁷

Malësorët e Shkodrës u lidhën me besë, sepse nuk duan t'i dorëzohen Malit të Zi. Turqia, e cila – siç thonin – i kishte shtënë shqiptarët për të bërë këtë mbledhje, që këta të qëndronin me të, tashti dërgon ushtri e i vret për të mos u ndezur ata kundër vendimit të marrë në Kuvendin e Berlinit, që qe shkak i të gjitha të këqijave të saj. E gjaku zu të derdhet në çdo vend. Tani Europa sheh çka bëri e kë plagosi, kur, për të ndëshkuar të pafatin, e detyron Turqinë të paguajë dëmshpërblimet, jo me të holla o me gjë tjetër, që t'i dhëmbë, por me dhënien dhe prishjen e një populli, që është i huaj për të, i cili ishte nderi i të krishterëve të një moti. Këtij populli, Turqia i pat shkretuar, më përpara, çdo të mirë. Çdo gjë ia zhduku; dhe atë që i teproi, jetën, sot po ia merr për të ruajtur vetveten.

20 korrik 1883

¹¹⁷ *Vlem e Maljsórvet* (Lega de' montanari), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 1, Corigliano Calabro, 20 luglio 1883, p. II.

8. AUSTRIA DHE SHQIPËRIA¹¹⁸

Thuhet nga të gjitha anët se Shqipëria e Sipërme do të lidhet në një shtet nën hijen e Austrisë. Ne s' dimë, se ç' duan atje brenda dhe as për Shqipërinë e Poshtëme, e pse do të qëndrojnë e veçuar.

Ne donim dhe e thamë që, për të mirën e Shqipërisë dhe për paqën e Europës, ajo s' duhet të shkëputet nga Sulltani, i cili, por, duhet t' i japë asaj të drejtën që të rrojë më vete me zakonet e para, me ligjin (kanunin) e pleqësisë, sipas fiseve, dhe të mos japë më taksa të tjera, përveç atyre që dhanë etërit (prindërit e tyre). Kështu ai /Sulltani/ do ta mbante me vete dhe do të shlyente detyrimet, që kishte ndaj vendimeve të Kuvendit të Berlinit, përsa u takon kërkesave të tij për vetadministrimin e viseve, që ndodhen nën sundimin e tij.

Ndoshta turqit këta i donin, pse vlerësuan besën e shqiptarëve si edhe gjakun më të mirë të tyre, që lagën fushat e betejës në luftë me Rusinë. Por djalli u hyri në mes dhe i shpërndau, nga s' e pandehnin. Mali i Zi, prejse kishte qenë nën flamurin e Rosisë, lypi e paditi prej kësaj për plaçkë një pjesë të tokës së Shqipërisë së Sipërme. Grekët, nga se ishin të bijtë e helenëve, lypën fushat dhe portat (mbrojtjet) e Shqipërisë së Poshtëme; dhe Franca desh t' ua japë si dhuratë të hijes së etërve të tyre.

Të copëtuarit e Shqipërisë qe mirëfilli për gjithë Turqinë një plagë, aq sa, kur për shpëtimin e saj, u deklarua autonome e u bashkua në Lidhjen e Prizrendit me njerëzit e vet, u tha fqinjëve: "Po, eni e merrni!"; këta njëzëri u thirrën Fuqivet të Europës, e paditën Sulltanin, sikur ky, i mundur në betejë, nuk dëshironte të shlyente detyrimet e pagimit ndaj fitimtarëve, duke u shtirur se gjoja Shqipëria ishte shkëputur prej tij /prej Sulltanit/. E, prandaj, Fuqitë e Mëdha bënë një punë të pahijëshme. Ato e shtrinë për tokë dhe ua dhanë dy armiqëvet të saj që ta copëtonin një komb nga më të moçëmit në Europë, i cili s' bënte keq, po ishte i pafat. E, pastaj, me atë bujari, që të gjithë e dinë, ato bashkuan tërë mjetet e fuqisë së tyre kundër një vendi me pak shtëpi në një bregdet të hapët.

¹¹⁸ *Austria e Skjiperia* (L' Austria e l' Albania), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. I.

Prandaj, Porta e Lartë, e trembur shumë, u kthye kundër Shqipërisë, e u dha (dhuroi) grekëve atë që lakmonin. Unë thom se ajo s'mundi të bënte ndryshe, dhe nuk është për t'u fajësuar që i la; por, të sjellurit e armëvet të saj kundër popullit shqiptar, qe një punë armiqësore. Ali Begu i Gucisë i vuri përpara Sulltanit, bujarisht, gjendjen e njëmendët të dy pjesëve: “Deri tashti – i shkroi ai – të pata për prind; por, mbasi ti më lëshove Malit të Zi, vendosa të mos jem më yti. Unë e pata, mot e mot, nën vete Malin e Zi; tani e solli fati që ai më mori e ka edhe teshat e mia; por edhe t'i përulemi, unë dhe shtëpia, këtë s'më lejon as nderi, as jeta. Unë fëmijë s'kam. Dy vajzat i martova. Varrin e kam, tashmë, të hapur përpara. Mbetet që të vdes o nga sëmundja, o i vorruar nga shpata për nderin e vetes sime. Vetë madhëria jote e njeh, se nuk është e drejtë dhe mirë që shërbyesi ta urdhërojë të zotin. Kështu, pra, në rasë se sot, kur po më len e nuk do të më kesh më, kërkon të më marrish dhe të më përulish nën Malin e Zi, unë do ta shoh veten në mes dy armiqësh, që e kanë me mua (që sulen kundër meje)”. Kjo është gjendja e tanishme e malësorëvet, që, me jetën e tyre, mbrojnë shtëpinë dhe pasurinë e tyre, që të mos bijnë robër ndër duar të të huajve.

Unë s'besoj se të dërguarit që ecin nëpër Shqipëri janë [agjentë] nga Austria, së cilës nuk ia do puna sot që të mos e ketë më Turqinë (aleate) në krah të saj, por ta shohë në anën e huaj; prandaj as s'guxon t'i zemërojë Fuqitë [e Mëdha] mike, me të cilat u lidh për shpëtimin e përbashkët. Vetëm që, pastaj, Porta e Lartë tregon se i harroi të mirat e Shqipërisë së shkretë; e bujarët ia mban në burg, pse bënë lidhje që të mos binin nën zotërinj të rinj; e, tani, edhe po ua përgjak shtëpitë. Mund të ngjasë që ajo /Shqipëria/, sot o një ditë, t'ia ndenjë duart atij që do t'i vijë në ndihmë. Mund të ndodhë, prandaj, që nga sllavët e Austrisë t'i vijnë Shqipërisë së gjorë premtime e ata të ndërsehen mbi Turqinë, e cila është e shtrënguartë bashkohet me pahir me ta. Sllavët përpiqen – dhe Greqia e lehtë nga mendja shkon pas tyre – t'u presin krahët fisevet të Shqipërisë, që ende janë në grindje dhe luftojnë veç e veç në betejë. Sllavët e bëjnë këtë me qëllim që të bjerë Shqipëria, shtylla e fundit e Turqisë në Europë, dhe vendin e kësaj ta zërë sllavizmi, që do të vërshojë përmbi Apuljen deri te deti Adriatik.

9. LAJME NGA KOMBI YNË¹¹⁹

Vdiq, në Kajro, nga kolera Ligor (Grigor) Naçoja, një bujar nga Korça, qytet i ndritur i Shqipërisë së poshtëme, e la te dhiata (testamenti) 52.000 franga, me të cilat të ndihmohet puna e lëvrimin të gjuhës shqipe.

Në Mirditë, i biri i Kapidan Gjonit, që qe vëllau i princit Bibë Doda, vrau Dodë Gegën, që e kishte bërë të varfër dhe e kishte shti (e kishte futur) në grindje, jo vetëm në Orosh, prej nga ishte, por edhe në gjithë Mirditën. E kudo që e muarën vesh në Shqipëri, bekuan pinjollin e guximshëm të zotërisë së tyre, një djalosh pesëmbëdhjetëvjeçar, që e shndërroi nga një djalosh të pambrojtur në një njeri përjetësisht të trishtuar, për të cilin te numri tjetër /i së përkohëshmes *Fiamuri Arbërit*/ do të thomi ndonjë gjë.

Stanislao Markjanòi nga Shën Sofia botoi në Napoli, ku mban zyrën e ekonomatit kishtar, një libër që shtie (hedh) dritë të re mbi faktin “që Pellazgë u quajtën, dikur, motit, ata që, edhe sot e kësaj dite, janë e thuhën shqiptarë, nga të cilët dy fiset më të mëdha ishin, pastaj, epirotët e maqedonët”.

Duhet të gëzohemi ne, nga puna e përbashkët dhe e ndryshme, në dobi të mëmëdheut të dashur, prej këtyre zotërinjve të ndershëm.

30 shtator 1883

¹¹⁹ *Lajme te kombes s'aan* (Notizie patrie), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. VII.

10. LETËR NGA JANINA¹²⁰

Zotit N. N.

Me shumë gaz shoh punërat që ke bërë zotëria jote për të mirë të Shqipërisë e të gjuhës sonë. Zoti të bekoftë e i haptë fatin Shqipërisë së mjerë, që ka rënë në mes të armiqëve të mëdhenj.

Toskërinë grekët e kanë mbuluar me propagandë për të prishur mëndjen e djelmëvet e të vashavet me shkollën greqishte.

Mbas mashtrimeve të grekëve, - siç e kuptoj unë – Porta e Lartë, në Konstantinopël, ia ndaloi Shoqërisë anglo-amerikane botimin e shkrimeve në gjuhën shqipe. As nuk i jep leje atje Kristoforidhit që të botojë një Fjalor shqip, greqisht, italisht dhe turqisht, të cilin e ka gati që moti.

Në Dardanele gjenden të mërguar, si rob, dy zotërinj shqiptarë: Mustafa Vrioni dhe Pasha Vlora. Abdyl be Frashëri gjendet, që prej disa vjetsh, i burgosur në Prizrend. Edhe në Rodi gjenden disa të tjerë, të cilët i zuri qeveria, pa pritë pa kujtuar, i arrestoi nëpër shtëpiat e tyre, sepse ata donin të ngrinin krye së bashku me Gegërinë.

Është keq e gjora Shqipëri; por Zoti e shpëtoftë!

I falem Zotërisë sate.

30 shtator 1883

¹²⁰ *Ljëpus nga Jannina* (Lettera da Giannina), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. VI.

11. NDARJA E EUROPËS¹²¹

Ka shumë kohë që Europa prir të ndahet në dy fusha, o për të shpëtuar paqën, ose për t'u përgatitur përpara të paprituravet, pse [të dy palëve] u duket se do të ruajnë paqën duke ndaluar njera-tjetrën me fuqitë e veta. Secila pret, pastaj, që, me fuqinë e saj, të sundojë fatin, nëse krenia e madhe do ta shtyjë tjetrën t'i sulet për ta shkyer dhe për ta mbytur.

Dihet, tani, se Gjermania e Austria, dhe Italia pas, lidhën besë në mes tyre; po ashtu edhe Rusia e Franca kanë një qëllim të përbashkët.

Këtë verë, pastaj, u pa Spanja pranë flamurit të Gjermanisë; edhe Turqia dëshiron të mblidhet atje. Nga ana tjetër, në Kopenhagë bënë kuvend lidhjeje Rusia me Danimarkën; aty desh të ulej edhe Anglia. Në të vërtetë, më kot, sepse kjo doli qëkur, e është edhe e veçuar e larg lëkundjevet të Europës; e, pastaj, tek ai kuvend as që vajti Franca, e cila mund t'i shqetësonte ata që ishin jashtë. Kjo mbledhje e përbashkët nuk duhet të jetë bërë kundër lidhjes së Austrisë me Gjermaninë. Por më shpejt ato shtete duan – si e parandjen zemra jonë që ashtë e interesuar në këtë çështje – t'i dalin përpara përgatitjes së sistemimit të Lindjes, tek gjendet mëmëdheu ynë; sepse Austria dhe Gjermania, - me qëllim që ta kenë, një ditë apo një tjetër, në krah të tyre Turqinë, që është endë një shpatë e mprehtë, - duan ta shpëtojnë atë. E kemi besim se ajo do t'i kënaqë kombet që ka nën vete, të cilat, të lidhura me dëshirë të tyre, do ta bëjnë të fuqishme. Por Rusia do që të shkëputet [toka] prej aso kombesh, me të cilat pat themeluar perandorinë e saj; kështu që ajo /Turqia/ të bjerë e t'i humbë qenia e saj në Europë. Prandaj ajo pret që të begatojë sherbëtorët e saj – e

¹²¹ *Distaxut e Europës* (Le divisioni d'Europa), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883, p. III.

ja që i rri pas, me dukjen e prindërvet bujarë, Greqia, që troket, ka ca mot, te dyert e gjithë zotënvat të huaj [Fuqive të Mëdha] -; pastaj të krijojë shtete autonome, të cilat, ose do t'i qëndrojnë besnikë, ose, si të vegjël, do të jenë të pafuqishëm për t'i penguar udhën. Edhe Gladstoni, qoftë se nuk ka më besim te Turqia, qoftë sepse atij i duket se një federatë me popuj të ndryshëm, ngritur mbi gërmadhat e saja, duke mbajtur për vete Konstantinopulin, nuk do të jetë ndihmë për të përmbajtur lakminë e njerit ose të tjetrit, qoftë sepse shpirti i tij i krishterë i flet përbrenda, edhe ai /Gladstone/, ndoshta, don që ta zmbropsë Turqinë e pafë [muhamedane] nga Europa.

E ne do të dëshëronim që edhe Shqipëria të dilte më vete e të priste nën dorën e Zotit tonë.

15 dhjetor 1883

12. DHELPËRITË (DINAKËRITË) E GREQISË¹²²

Në qershor erdh në katundet tona Prenkë Gjoka, mirditas, nga Kaçinari, i dërguar, siç thonte ai, të mbledhë të holla për të blerë pushkë dhe barot për malësorët e Shkodrës, që luftonin për të mos qenë nën Malin e Zi. Qe pritur mirë dhe me ngrohësi. Por, si u afërua, tha drejt se udha e Shqipërisë i ish e prerë; vetëm një rrugë i mbetej: ajo e Malit të Zi. Tregoi se vinte i dërguar nga Komiteti i Korfuzit, se në Athinë kishte folur me Trikupin, i cili premtoi shumë për Shqipërinë e se edhe Rusia ia do të mirën.

Kuptuam gjithëçka; por, meqenëse pak më përpara na kishte ardhur një letër nga malësorët, me të cilën lypnin ndihmë, e ai, si i dërguar, u ofrua të vejë në fshat, hapëm një kërkesë për të blatur për mëmëdheun tonë. Këto ndihma do të dorëzoheshin, kur të gjëndej një njeri shumë i njohur, i cili të zotohej se do t'ua çonte malësorëvet ose do të blente për ta çdo gjë që lypnin. Me qëllim që t'ia kishim besën atij, i lëshuam në dorë letrën e malësorëvet, me të cilën do të çfaqej kudo.

Gjithkund nënshkruan te ajo notë. Por, ndërsa ai po shkonte fshattrash, e, ndërsa ne kërkonim se kush do t'i merrte të hollat për ata që po dhuroheshin, kryengritësit malësorë i lëshuan armët dhe u tërhoqën në shtëpiat e veta. Atëherë Prenkë Gjoka i lypi të hollat për Kuvendin e Korfuzit, që të mbante andej zjarrin të ndezur në Shqipëri. Por asnjë nuk i dha gjë, veç aq sa iu deshën të vejë në Romë.

Atje gjet ato gënjeshtër të vjetra, që më përpara tërbuan viset e Europës për dukatët e pak budallenjve. E, që andej, thonë se u pat shkruar mbretëritë se Shqipëria s'ka tjetër mbrojtje paqe veçse të

¹²² *Nijatta të Grecies* (Le insidie della Grecia), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. I. (Mbështetur në bibliografinë e hartuar, viti është 1884).

lidhet me Greqinë; se ajo, [duke qenë] ndër trungjet e turkut, s'mund ta thotë; por Prenkë Gjoka, mulosh i Kasiumit, i dërguar i Komitetit [Eterisë] të grekëvet, e thotë për të [këtë gjë]: E beson edhe ndonjë gazetë italiane; [Dhe e besojnë] të gjitha ato të Greqisë.

Përse Shqipëria i duhet dhuruar Greqisë?

15 janar 1884

13. NA SHKRUAJNË PËR KËTË GJË NGA TOSKËRIA¹²³

Pashë ndër gazetatat greke notën që shqiptarët e Gegërisë, të Matit dhe të Çamërisë dërguan, nëpër shtete të Europës, duke lypur bashkim me Greqinë, etj. E nderuara gazetë e Trishtes, *Imera*, nr. 465, të 10 nëntorit, thotë se “kjo shkresë, me një nënshkrim të vetëm, nuk duhet fort e vërtetë; sepse gjithë shqiptarët, myslimanë dhe katolikë, janë të ndarë fort me zemër prej grekërvet, për shkak të fanatizmit të fesë”. E, nga ana tjetër, ç’të mirë u bënë, ndonjëherë, grekët shqiptarëvet, që këta t’i lidhin zemrat e tyre me helenët? Ose më mirë të thomi: a kanë lënë ndonjë të keqe pa u bërë grekët shqiptarëvet? Vetëm Madhëria e saj Ollga, mbretëresha e Greqisë, e zuri mirë gjuhën shqipe për nder të shqiptarëvet. Unë doja të pyes: përse të mos ketë në Greqi një shkollë edhe për gjuhën shqipe, tek gjenden 4 ose 500.000 shqiptarë të vendit?

Një shqiptar nga Toskëria

15 janar 1884

¹²³ Po aty.

14. LAJME NGA SHQIPËRIA¹²⁴

Lexojmë në gazetat italiane shumë histori që bien ndesh me vetveten, të cilat ose s'kanë gjasa, ose nuk dimë mirë si t'i deshifrojmë ato.

1. Se në Malin e Zi janë duke u përgatitur 4000 mijë ushtarë për të marrë në zotërim Gucinë;
2. Që Mali i Zi po u shpërndan armë dhe municion shqiptarëve, që të shkojnë dhe me t'i marrë, ata t'i dhurojnë Gucinë;
3. Se dy fise shqiptare mësynë në Mal të Zi, zhveshën, vranë, dogjën;

Ne dimë vetëm se, të gjithë ata që ishin në kongresin e Berlinit për të kënaqur Rusinë, i dhuruan Malit të Zi, bashkë me Tivarin dhe Ulqinin, edhe Gucinë, një qytet sllav në malet e sipërme.

Por Aliu i Gucisë që kishte rol kyç në Lidhjen e Prizrenit, me poteren e ngritur mjeshtërisht se nga aty Mali i Zi do të vinte të pushtonte Gjakovën, Pejën, Rekën dhe rajone të tjera shqiptare, e nxiti Shqipërinë e Epërme myslimane të rrokte armët dhe t'i dilte zot vendit që të premtuar. Atëherë Porta e Lartë ra në ujdi me Malin e Zi që të ndërronte Gucinë me fshatra të krishtera shqiptare të maleve të Shkodrës. Por këta nuk deshën t'ia dinin për malazetët dhe vitin e kaluar hynë në luftë me vetë Sulltanin.

Me ç'duket qëndresa e shpirtrave të malësorëve i kishte bërë ata, paçka se të humbur, të fitonin kauzën dhe fuqitë e Europës mbase u dhanë të drejtë pasi Mali i Zi do të duhet të drejtohet sërish nga Gucia. Dhe kjo tani, sikur tërheqja të qe një lëshim dashamirës për shqiptarët e krishterë, mos vallë do të thotë se ata duhet të shkojnë vetë ta marrin Gucinë? Mos harroni se Mali i Zi vepron si Greqia, që mes nesh vëllai me vëllanë të vriten. Por në dashtë Zoti koha për këtë ka sosur.

¹²⁴ Lajme të Skjipëriis (Notizie dell'Albania), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 5, Corigliano Calabro, 30 febbraio 1884, p. I.

Tani, nëse ato gazeta të huaja nuk thonë gënjeshtër, shqiptarët që hynë në Mal të Zi duhet të kenë qenë ata që bashkë me malësorët e Gjakovës janë fqinjët e Gucisë. Për më tepër, pasi ende nuk i dimë fatet e reja në të cilat gjenden, edhe mund të gënjehemi.

28 shkurt 1884

15. KU E SHTYJNË?¹²⁵

Erdh, përsëri, ndër né Prenkë Gjoka, por jo më lajmëtar i Komitetit për të lidhur Shqipërinë me Greqinë. Mbasi që shtypi grek, me rastin e Kulluriotit, zbuloi drejt, paturpësisht dhe marrëzisht projektin për ta lidhur Shqipërinë pas qerres së vet, - ta thuash në gjuhën e saj – çdo shqiptari do t'i vijë turp t'i ndihmojë /Greqia/ në ngadhënjimin e kombit të vet. Pse njohëm në një jetë të gjatë e mund të thomi që, në rasë se venë dorë për të bërë keq për breznitë e tyre një shqiptar dhe një tjetër, ata nuk e dinë, por të gënjyer prej ndonjë pamjeje së mirë, që atyre iu duket se është më e pjekur ajo punë, ata venë dorë. Rrallë ngjet me ndonjë që, për t'i bërë nderë, duke pritur bukë e vdekje, plagos nënën tonë aq të helmuar. Unë dua të zë fill këtu me dy bujarë ndër më të mirët që kemi, Konstantin Cepën e Kristaq Zografën, e me fjalët e Kulluriotit tek *Anasqeva* e vet:

“E me dhimbje shohim se dy zotëri aq të drejtë ndaj atdheut të tyre qenë futur në thes prej ca gjysmë njerëzish që iu lëpijnë pjatat, e që patën kaq fuqi mbi ta sa, me gjënë që iu hodhën sipër, helmuan burimin e ëmbël e të shëndetshëm të veprave të tyre aq të mira”.

Sepse këta dy bujarë shqiptarë zemërmëdhenj, që hapën shkolla greke, si gjetkë edhe ndër fshatrat e Shqipërisë së Jugut, e patën bërë këtë punë për shkak të thesaritë ruajtur nëpër të gjithë njerëzit në gjuhën e moçme të grekëve; e me besim të patundur se bashkëvëllezërvet të tyre fshatarë do t'u ndriçohej endja dhe do t'u rritej shpirti duke pasur si pasqyrë atë jetë plot shkëlqim të grekëve të lashtë. Por do të shohin, dhe shpejt, se grekët e sotëm me ato shkolla nuk punojnë që shqiptarët të jetojnë mirë si tek pasqyra e etërve të tyre, por për t'u përzierë,

¹²⁵ *Cu e stinen?* (Dove lo spingono?), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 6, Corigliano Calabro, 30 marzo 1884, p. I.

pastaj, me ta vëllazërisht. Grekët ua qesin shqiptarëve atë formë të moçme që t'ua prishin mendjen dhe t'i poshtërojnë nën veten e tyre. Nëqoftëse kanë gjakun e prindërvet me zemër, ata të dy do të pendohen fort, ashtu sikurse tani janë penduar të gjithë fshatarët shqiptarë, që flijuan vetveten e tyre për të mirën e grekëve. Sepse sot, mendimi që Shqipëria dhe Greqia janë një komb, ka rënë gjithkund; e, kush e thotë me kokëfortësi, atij fjala i del nga shpirti i keq dhe i padijshëm.

Prandaj, tani, Prenkë Gjoka kërkoi tjetër gjë prej nesh. Ai na vuri në dijeni se /grekët/ do të ndihmonin Shqipërinë për të ngritur krye shpejt dhe për t'u lidhur me Federatën e madhe të Greqisë, Serbisë, Rumanisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë; në këtë Federatë do të jetë qetësia e saj /e Shqipërisë/ dhe e Europës. Për këtë punë, Anglia dhe ministrat e Italisë duan t'i japin dorë asaj për t'u ngritur dhe t'i hapin udhën.

Kjo zgjidhje çështjesh duket mirëfilli për së largu; na u duk edhe ne, në një kohë, limani i atyre kombeve dhe i kujdeseve të Europës. Por kush do ta ndërtojë sot atë liman, - nga i cili, ndoshta, do të turbullohet gjithë deti, - dhe do të strehohet i pari?

Ne thomi pak, jo shumë: Greqia, Rumania, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi, që janë më vete [të pavarura] dhe [i kanë] duart të zgjidhura, të lidhen në mes të tyre. Edhe Anglia e kushdo mund t'i vijë ndër krahë, nëqoftëse turku o ndonjë tjetër do t'i kundërshtonte. Dhe, atëherë, Shqipëria do t'u kujdesonte për vete, duke parë gjënë që ka përpara. Përndryshe, do ta donim të zbuluar gjarprin e zi që e këshillon ajo të ngrihet për një çështje që nuk ekziston, e të zerë (të fillojë) ajo – me pikëpamje të ndryshme mendimesh, pa të holla, pa armë, pa taktikë ushtarake dhe me pak duar, - luftën kundër Turqisë, që i ka me shumicë të gjitha këto e, për më tepër, ndihmëtarë të huaj.

Por vajtimi i saj për fatin e vet, siç na thonë, kumbon në Shqipëri:

Shqipëri me njëqind krahina,
në fund të botës e humbur!
Disa shtete pa respekt
i thonë Sulltanit: Ti jepe.
O Sulltan! mos ep pëlqimin.
Ne s'vemi me Malin e Zi,
as me Serb, as me Austrinë,

as me Turq, as me Greqinë;
i duam vetes autonominë.
Shumë turp për Shqipërinë,
të humbasë kombësinë,
pikërisht në këtë kohë,
kur Frëngu bëri Bullgarinë,
e harroi Shqipërinë,
vetëm se ka trimërinë.
O frëng, kujto Perëndinë,
se atje do bëjmë gjyqin.

30 mars 1884

16. PROGRAMI I RADIKALËVE UNGAREZË¹²⁶

Muarëm statutin, mbi të cilin, një Komitet atdhetarësh të Hungarisë, /e cila ka qenë/, gjithmonë, mikeshë e shqiptarëvet të shkretë, dëshëron të themelojë jetën politike. Dhe e kemi për nder këtë dhuratë; edhe për faktin që ai statut duket se bashkëzanon me librin tonë, në të cilin vendosëm (parashtruam) disa mendime të sinqerta mbi sundimin me përfaqësi, i cili, mbase, mund të jetë guri i rrokullisur mbi këmbët e baltës së statutit të ditës së sotme. Libri ynë, pra, /*Sa liri dhe mirëqenie ka në shtetin me përfaqësil*/ përputhet me idetë themelore të atyre zotërinjvet.

Vetëm një mendim po na ndanë.

Duket se ata nuk mund të shqiten, krejtësisht, nga gjendja e jetës që jetojmë; e, prandaj, duan që ajo të mbetet rend i përhershëm për rregullin e qytetit, ku /popullsia/ është mbledhur në mbrojtje, /si vend shpëtimi/. Pastaj, ky rregullim është i nevojshëm t'u besohet disave, në vend /që t'u besohet/ të gjithëve; e, në të vërtetë, këta disa janë gjëmbat e shoqërisë. Por ky rregullim është një gjë e jashtme dhe tranzitore, siç është gjë e jashtme të ndërtosh shtëpinë, për të ndenjur brenda i kujdesur (pa menduar më).

Ata që e hapën këtë kohën tonë, e deshën të pasqyruar si te jeta e Romës dhe e Heladhës së lashtë; e nuk menduan se ajo, mbasi e kishte kthyer teposhtë kujdesin e të jetuarit mbi skllëverit, kishte ngë ta prirte mendjen në shkallën e duhur; pastaj, e mbledhur në qytete të vetme e jo të mëdhej, ishte, gjithmonë, e gatshme për atë që e zëvendësonte. Por, edhe atje, të kthyerit, siç ishin të prirur kahë zotëria i qytetit, gati si ndaj thesarit të jetës, i mbajti të ndarë, deri sa u shuan në mes të tyre,

¹²⁶ *Programma dei radicali ungheresi, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr. 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. II.

me egërsi: të pasurit ose fisnikët, të cilëvet u frynte zemrën zotërimi dhe pasurimi me shumicë i të miravet; dhe të varfërit e plebejt, të cilët, meqenëse ishin më shumë në numër, e shikon qytetin me hidhërim, ndër ata zotërinj.

Shëndeti, që vetëm pas kaq të këqijash, u shfaqet sot njerëzvet, është pushimi i kujdesit që një ose shumë duan të kenë nga jetët e të tjerëvet. Sundimit (despotizmit) nuk duhet t'i jepet /mundësi/ që të bëhet fodull (madhështor) dhe i pasur. Punëtorëvet, kudo që të gjinden të shpërndarë, u duhet lënë fati ndër duar të tyre, sepse tjetër gjë më nuk rëndon, veçse dora e huaj, që na shtrihet mbi kohën tonë, e na merr nga prodhimi e nga punët tona. Nga ana tjetër, sepse lumturia dhe pasuria mvaren nga ligjë që nuk i bën njeriu, e ato asnjë nuk mund t'i themelojë (nuk mund t'i krijojë ose t'i vendosë) përgjithmonë (për tërë kohën) në shtëpinë e vet, sepse, nga duartë e atij që i pati, sot zgjidhen, kurse nesër hyjnë ndër dyer të tjera. Né, përkundrazi, në vend që të shqetësohemi e të varfërojmë pasurinë e njerit për t'ua ndarë atyre që nuk kanë, na duhet të prapsim (të paksojmë ose të zbutim) më shpejt grykësitë (lakmitë, ngopsitë, llupësitë) që ndjekin një ëndër; e t'ia lëmë dhimbshurisë (mëshirës) njerëzore dhe Këshillit fillestar që të mbarojë shortet (fatet). Ja, që kur se u zu jeta, shohim që punëtorët marrin ata të parët nga gjëja që bëjnë (nga vlera apo çmimi i punës së bërë), dhe i lënë të zotit të gjësë, o pak o shumë, sipas asaj që do të shesë. E, si njeri ashtu edhe tjetri, e kalojnë jetën së bashku, me zemër herë të vyshkur (të thatë), herë të hapët (të zgjëruar) nga flladet e botës.

Prandaj shoqëritë të punëtorëvet /u duhet/ të jenë më të këqia se të mira. Duke lënë më një anë zilitë, që janë në secilën, për të cilat Heziodi thotë: "Këngëtari e ka zili këngëtarin, farkatari – farkatarin", përse ta ngrejme këtë hije të dëmshme, që të rri, gjithëmonë, mbi shoqërinë? Prandaj, edhe pse shoqëritë punëtore nuk shikohen shtrëmbër në mes të tyre, duke qenë të shpërndara në fshatra të tutjeme (ndër vise të ndryshme), atje duhet t'i bëjnë zgjedhjet, e prej andej të zgjedhurit të shkojnë te vendi i Komitetit të përhershëm. Do të vijë, vazhdimisht, ngeja për të bërë këpucë, për të qepur tirq (çorape), etj. E, me lehtësi, atyre do t'u duket, pastaj, gjë e drejtë të jetojnë nga alltari (nga selia apo nga fronti), të cilin ia ofrojnë. E kjo është një e keqe shumë e madhe.

17. LAJME TË REJA NGA SHQIPËRIA¹²⁷

Gazeta të Greqisë përhapën lajmin e keq se Sulltani nuk do të lejojë më që *Fiamuri Arbërit* të hyjë në Shqipëri. Na e merr mendja se çka i pat kërkuar ai, tash së fundi, Qeverisë italiane, dhe kemi për t'i thënë në numrin e ardhshëm qëllimet e tij.

Gazeta të Napolit shkruajnë se Shqipëria, që është sot nën Turqinë, e Maqedonia bashkë me të, janë gati t'u lypin Fuqive të Europës që t'u jepet e drejta për të thënë (për të shprehur), me anë plebishiti, rendin politik, në të cilin duan të qeverisen, dhe me kë duan të bashkohen. Lajmi i këtij këshilli të marrë iu pat ardhë atyreve nga Eteritë.

Shqiptarët endë nuk u muarën vesh, njëzëri, për fatin që do të dëshërohej për veten e tyre. Por, nëqoftëse kjo është ora e zotërimit të atyre Fuqive mbi fatin e gjith kombeve të tjera dhe të secilës prej atyre, atëherë jo vetëm Shqipëria e sunduar prej Turqisë, por e tëra dhe prej gjithkah, d.m.th. të gjithë ata që me forcë qenë detyruar të lidhen me Greqinë, me Malin e Zi dhe me Serbinë, duhet të pyeteshin, por në shtëpiat e tyre të zbrazura (të boshatisura) prej të huajsh; dhe atje, vetë, duhet të pyeten vetëm për vetëm dhe të dëgjoen.

30 maj 1884

¹²⁷ *Lajme të Shqipërisë*, (Notizia dell'Albania), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. VIII.

18. LAJM I FUNDIT FARE¹²⁸

Athinë 10 qershor.

Pardje në Institutin Filologjik të Parnasit, u themelua në Greqi, Shoqata *Vëllezërit Shqiptarë*. Artikujt e parë të statutit të tij, dhe ku shfaqet qartë qëllimi dhe ai vetë, janë këto:

1. Shoqata synon të rrisë dhe ngrëjë lart gjuhën shqipe dhe ta zgjerojë përdorimin e saj në jetën tonë dhe në të njëjtën të zhvillojë dhe edukojë atë jetë në shpirtin dhe mendjen shqiptare, pavarësisht natyrës së fiseve apo fesë që ajo mund të merrte në vende të ndryshme.
2. Vetë shoqata do ta largojë nga vetja çdo qëllim tjetër që dikush mund të përpiqet ta fusë në punën e saj.

30 maj 1884

¹²⁸ *Notizia recentissima, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr. 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. VIII.

19. A DUAN, PRA, TË NA I MARRIN DRITËN E SYVE?¹²⁹

Ndalimi, që Porta Osmane i bëri së përkohëshmes shqiptare [*Fiamuri Arbërit*] që kjo të mos hyjë në Shqipëri, - në është i vërtetë ky lajm – tregon se turku këtë /d.m.th. Shqipërinë/ nuk e ka për pjesë të vetën, por, megjithëqë kanë shkuar 400 vjet, e mban ende si plaçkë e fitim, që e shkyen sipas dëshirit të vet.

Ajo e përkohëshme as nuk i fryu zjarrit, as nuk i këshilloi shqiptarët që të ngritnin krye kundër /turqve/, por desh që të ishin miq të dashur; por gojët [e këqia] greke, të cilat me gëzim lajmërojnë se si iu mbyll Shqipëria, më parë shpifnin se Pushteti turk fliste për të, me qëllim që të vononte dhe të shpërndante lirinë dhe të mirën e Shqipërisë nën hijen e Helenisë motër. Vërtetë në nuk i shihnim Shqipërisë tjetër shtrat të qetë për zhvillimin e saj, veçse të ndenjurit e saj së bashku me Turqinë, me të cilën e kanë lidhur fatet. Dhe urimi ynë i vazhdueshëm që që të tërheqë, edhe një herë, dhe të bashkojë me trupin e saj ato pjesë që i qenë shqitur (hequr) prej fqinjëve shpirtëzëzë, të ketë detin e të Parëve /Etërve = Adriatikun/ për mbështetje si edhe një shoqe dhe, mbas krahëve, zonjën e Helespontit.

Ky dëshir që edhe feneri ndriçues për *Fiamurin e Arbërit* deri në ditën e sotme.

Është e vërtetë se ne i thamë Portës Osmane që të mbante dorën dhe të mos i binte më Shqipërisë, të mos ndihmonte në shkyemjen (të gjerrunit) e saj, që është aq e dëshiruar nga armiqtë e të dy palëve, sepse prej këndej do të shkëputej gjalmi i besës vëllazërore, me të cilin ishin lidhur; dhe do t'i lente të dyja palët veçmas e të ndara ndër brigje të errëta dhe në mes të sa e sa vetëve që Turqinë e duan të humbur dhe

¹²⁹ *Voglionci dunque abbacinare? Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr. 9, Corigliano Calabro, 30 giugno 1884.

Shqipërinë të molisur dhe të lidhur me të. Të shikojë ajo [Turqia], sot, rreth vetes së saj, sa pak pjesë prej kombit të saj kanë tepruar nga ato ordhí që ndiqnin si valët e një lumi, kur zunë (pushtuan) Lindjen. Tani janë pak dhe në mes të të krishterëve. Endë gjinden njerëz nga ata që i thonë asaj: “Shqipëria është një gjarpër, të cilit po i preke diellin, do të bëhet i zhdërvjellët dhe do të të zërë; shkele, shkele (shtype, shtype), në kohën e ngrimjes (në dimër), tani që e ke në dorë!”. Dhe, nga ana tjetër, po ata njerëz i thonë Shqipërisë: “Shih si të mbajnë (të shtërngojnë) dhe çka bëjnë në ty! Bëhu me né, dhe kemi për të shti në duar tuaja thikën, me të cilën t’i shposh jetën qenit, që të ka futur ndër dhëmbë dhe nuk të lëshon më!”. Dhe, ja, pra, kemi arritur, sot, në atë pikë sa të besojmë “që dhelpra dinake tërheq pas vetes ujkun budallà”.

Por do të mund të thotë ajo se vetë libri, që më së pari deshëm t’ua vinim ndër duar djelmëvet të Shqipërisë, *Rapsoditë* e motit, kur ne ishim bashkë në brigjet e Adriatikut, vetë ai libër, që rrëfen luftat e etërvet të tyre me turkun dhe fatkeqësitë, do të vlejë për t’i shkëputur dhe për t’i shti, përsëri, shpatat ndër duartë e tyre. Por ato lufta, - e atje të një së kaluare të largët në mes të aq figurave të tjera të botës, - mbaruan jo më vepruese për bashkimin e dy kombeve, se nuk qe ca mot më parë historia e Thierryt mbi nënshttrimin e Britanisë së Madhe nga lordët Normanë. Né, arbëreshët e Italisë, që andej buarëm (humbëm) çdo gjë që kishim, tani i harruam; e të marrur mendsh prej së mirash e së këqijash te ku jemi, as s’e dimë Turqinë /as nuk e njohim atë/, jo më të kemi urrejtje për të, më fort të nderuar dhe të lënë në qenjen e tyre autonome, me përdorimin dhe besimin e bashkëjetesës dhe të shumë të fé dhe me martesë, u patën lidhur (shkuan duke u bashkuar); dhe, pastaj, i qenë për bri e në një fat /d.m.th. e ndihmuan/ deri tani vonë, si në luftat e maleve të Emit /të Ballkanit/.

Po, se ai libër, një pasqyrë e kthielltë e trimave dhe grave të arbëresha me hijeshinë e shtëpiavet që kishin, bijtë e sotëm të të cilëve u rritën të ngjashëm me farën atërore, ai libër dëshiron – sikurse edhe *Fiamuri Arbërit* në çdo pjesë të vet – t’i përtërijë këta shqiptarë, kudo qofshin, përsa i përket vetëdijes kombëtare, gjuhës dhe emrit, në një komb të vetëm dhe të dalluar. Po kjo, ç’i bën Turqisë? Do të helmojë, mbase, ndonjë Mavromat o Nikokël, të cilëvet, andej, ka për t’u rënë, nuk dij se prej çfarë duarsh, dhe kanë për të humbur pështymën, me të cilën

e ndërtnuan; por Turqisë, për të cilën është kusht jetik që të rregullohet si edhe Austria me një pajtim vëllazëror të kombeve që i bashkoi rreth vetes, të kënaqura secila për lumturinë dhe zemërgjerësinë e vet, - Turqisë ka për t'i pru (ka për t'i sjellë) fat dhe ka për t'i bërë nderë.

Nga ana tjetër, të huajtë që s'mund të dinë për atdheun tonë, sidomos me këtë të mbyllur që i bëhet sot së përkohëshmes shqipe, duket sheshit se e kanë më të hapur rrugën për të vajtur në Afrikë që të shohin dhe të njohin njerëzit e egjër të kontinentit se sa të njohin Shqipërinë, të cilën Europa e ka në gjirin e vet; të huajve kjo e përkohëshme u zbulon çka jemi dhe çka kemi. Prandaj shpresojmë të na duan mirë që ne ta meritojmë simpatinë e tyre. Ah! patën guxim sa të thonë që na mungonte gjuha dhe deshën të na jipnin, me forcë, të tyren disa krena thasësh bosha!

Kështuqë, o e shtyrë nga ata që e duan të keqen, ose vetë Turqia bën që t'ua mbyllë arsimin njerëzor dhe qytetërimin shqiptarëve të nëmur, në mënyrë që ata të jenë për të gjithëmonë zagarët e verbër (të paarsyeshëm), të cilët t'i ndërsejë mbi armiqtë e saj. Sot e gjen Europën rreth e përqark të neveritur, në mos tjetër, nga ajo egërsi barbare që, papandehur, përgjaku dikur pjesët e mira (brigjet e bukura) të Lindjes së saj. Dhe arsyeja jonë mbet e pacënuar përpara kombeve të Europës së krishterë, tek dera e së cilës ne ramë duke mbrojtur fenë që ajo mbajti, dhe u bë zonjë e botës, dhe brenda në trimëri me zemrat tona e tek këmbët e zotit tonë, prind që nuk vuri një vëlla nën tjetrin.

30 qershor 1884

20. SE ERDH KOHA!¹³⁰

Që të zhgrehen retë, që të përmythen shirat dhe të flokojnë borërat. Dielli është prapa. Dhe flladit të ngrohët i gëzohemi dhe përshëndesim stinën e re, që po afrohet.

“Kur fiqtë nxjerrin gjethët jashtë, ne thomi se jemi në verë”.

Mbasi që ndër brigjet e vetëmuara e të mbyllura, përtëritëm, këndeje, gjuhën e etërvet tanë, e na pyesnin: për ç’gjë? /e bëni këtë/ e s’dinim ç’t’u përgjigjeshim, u hap dita e pamë bujarë (fisnikë) të tjerë, Kostandin Kristoforidhin, Thimi Mitkon, Leonard De Martinon, Anastas Kulluriotin, Vëllezërit Frashëri me shokë, që bënin të njëjtën gjë, ndër vise të ndryshme e të largëta në mes të tyre. Ishte dora e Zotit tonë, që i lëviz gjërat njerëzore.

E pamë, shpejt dhe me një herë, në maje të malevet tona, krenët e Shqipërisë, ndonëse me idenë e tinë-zoti ndryshe në gji, që, të ardhur prej gjithë vendesh, prej gjithë anësh, i jepnin dorën njeri-tjetrit, besën vëllazërore, në një Lidhje bashkimi kombëtar, që nuk do të zgjidhet kurrë më (që nuk do të shuhet asnjëherë).

E kur qielli u mvrejt përsëri e na muar sytë, e neve na thonin: Ku është besa që dhatë? (Ku është lidhja që bëtë?), zemra shtangu në vend e palëvizur dhe priti. E, tash, erdh dita që prej këndeje valavitet në erë Flamuri i popullit tonë; e, përtej, në Heladhë, po pohohet, mbështetet dhe mbrohet, me guximin më të madh, Fati që na qe falur, përgatitur, nga zotynë, ndër qiej.

Izemëruar, i egërsuar nga prita, nga pusia e Helenisë mosmirënjohëse, që nuk e do Shqipërinë me të, por nën veten e saj, Anastas Kullurioti na u drejtua neve, e në nuk e dinim, viseve arbëreshe që janë aq të shumta

¹³⁰ *Perchè l'ora è venuta, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr. 9, Corigliano Calabro, 30 giugno 1884, p. IV.

në Heladhë, e u vuri atyre përpara mjerimin, fatkeqësinë e gjakut të tyre, të përhapur, të shpërndarë nëpër kombet e ndryshme. E u pa se të gjithë, me të bashkë, ia donin nderën dhe të mirën. E u formua një Komitet me njerëzit më të mirë, që ka për detyrë të përkujdeset për fatin e Atdheut dhe të popullit të tyre. /Kryetar i Komitetit u zgjodh koloneli i ushtërisë greke Dhimitër Boçari, kushëri i Mark Boçarit, heroi i Karpenicës; zëvendëskryesia iu dha nënkolonelit të xhenios, Jani Lekës, i biri i Dhimitrit që, më 1829, komandoi forcat greke në Athinë, e aty u bë martir, theror i lirisë. Paraqitës i Komitetit që emëruar i shkëlqyeri Anastas Kullurioti/.

Janë bujarë nga Athina, nga Atika, nga Hydra, nga Suli, nga Specia, nga Qefalonia, nga Argu, nga Idilia, nga Eleuzina, nga Kranidiu, e, bashkë me ta, zotërinj nga Janina e nga Gjirokastra.

Është kjo dita që bëri zotynë. Le të gëzohemi dhe të punojmë në këtë ditë, duke uruar perëndinë.

30 qershor 1884

21. LAJM I LUMTUR¹³¹

Duall ose është në të dalë në Stamboll një tjetër gazetë shqipe, *Drita*. Kjo ngjarje na ngushëllon në punën e rëndë për kthimin e vetëdijes kombëtare atdheut tonë, nga i cili, kur etërit tanë ikën, nuk e hoqën besimin që kishin se nuk do ta lëshonin kurrë as në një errësirë gjithënjë e më të keqe.

Kurse, tashmë, na lodhi mungesa e çdo gjëje, që nuk e lë gjuhën tonë të zhvillohet (e cila do të jetë për të mirën e të gjithë bijve të Mëmëdheut tonë), nuk e lë të lehojë dhe të tingëllojë në mes të tyre. Thonë se zhvillimin e gjuhës e pengon ndryshimi i alfabetit. Po dialektin, si ta ndërroj? Është i shpirtit tonë të brendshëm, është pak më i prishur (i konsumuar) nga dialektet e tjera, dhe me fat që, me anë të tij, të përtërihet gjuha e etërve /e të parëve tanë/. Sa për shkronjat, ato janë një shenj i jashtëm i tingujve të gjuhës, por jo të ngjitura (të lidhura) me të si tingujt me fjalën. Dhe, pse të hidhërohemi kaq fort? Të marrim (të mbajmë) sot atë që kemi nëpër duar. Të mërzhit, me siguri, napa (tisi) e shkronjavet që na hjek nga të pamit fytyrën dhe mendimin e Jetës, të cilën ulemi ta sodisim; por bijve të bujarëve tanë, që janë aq të shpejtë (të gatshëm) për të dhënë pa pengesë gjënë si edhe jetën për nderin e Shqipërisë, u lypim kujdesin (vemendjen) e një jave ose të dy javëve për të zbutur atë napë (tis) dialektore dhe alfabetike. Dhe pastaj, vera e zgjedhur, që është e mbuluar prej kësaj, në fenë e Zotit, ka për t'i dehur me një guxim plot shëndet, sepse është e ndritur nga hijeshia e shpirtëravet që flasin shqip.

Nga ana tjetër, me gëzimin tonë të madh, edhe *Drita* që botohet në Stamboll, dëfton se Shtëpia e Sulltanit nuk është, në të vërtetë, ajo re

¹³¹ *Lajm i Ljuum*, (Notizia felice), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr 12, Corigliano Calabro, 30 ottobre 1884, p. I.

që do t'i mbajë (t'i pengojë) diellin Shqipërisë, siç e bëjnë zyrtarët e saj të këqij të duket. Por, pse duhej të ishte? Shqiptarët sot, pa kurrkend për rreth, tek të cilët të mund të mbështesin besën e tyre të bardhë (të drejtë, të sinqertë), i janë drejtuar asaj Porte [të Lartë], me të cilën shumica e tyre është e një feje, dhe i rrinë të sjellur dhe të ngulur me zemër; dhe Ajo, gjithashtu, ka vetëm ata në krahë që e duan drejtë dhe të nderuar. Sot, siç shkruan vetë gazeta e *Eterisë së Apoljes* (= e Federatës së Ballkanit), në Kuvendin e Skiernevicës, u vendos që kombet të rrinë siç gjinden; e mbase, për disa vjet, ajo që atje u desh edhe të jetë. Prandaj, Shtëpia e Sulltanit e sheh vetë se hijeshia dhe shëndeti i saj rri (qëndron) në të qenit ajo dorëhapët, siç qe gjithëmonë, me skolitë e saj besimtarë ndër këto ditë qetësie, dorëhapët drite, bujarie dhe begatie. E zemra, pastaj, do t'i prehet, sepse, sot, mbetë vetëm Greqia ose ndonjë shoqe e saj me dëshira qensh (sepse, dihet: është dikush që i fryn) jo në ëndër, po zhgjandërr (kur zgjohet) bën dhe përsëri bën, ndër gazetatat e saj, dhjatën (testamentin) e Turqisë.

30 tetor 1884

22. LAJME TË RËNDA NGA SHQIPËRIA OSHËTIJNË (KUMBOJNË) NË EUROPË¹³²

Lexojmë në *Intransigèant* të Parisit:

Stamboll, 7 mars. – Një lëvizje e madhe vlon në Shqipëri, veçanërisht në Prizrend. Agjitorët, lypin heqjen e taksave (detyrimeve), lirim të burgosurve politikë dhe kthimin e të mërguarve politikë.

Ky agjitacion është i drejtuar prej Komiteteve irredentiste shqiptare të vendosura në Prizrend, Qerfoz (Korfuz) dhe Taranto.

Syra, 8 mars. – Me gjithë mungesën e lajmeve të sigurta, mbasi kryengritësit kanë këputur fijet e telegrafës, duket e sigurtë se trupat turke qenë zbrapsur mbas një luftimi në Lumë, etj.

Këta zëra (lajme) sot përputhen (përsëriten) në gazetatat e të gjitha gjuhëve. Na kishin shkruar që në dimër se Korça, e djegur pse ndënji veç, tash ishte bashkuar edhe me Lidhjen e Prizrendit. Para disa ditësh, muarëm vesh se Prizrendi ishte ndër duar të njërit nga shtëpia e Zulopit, kreu i shqiptarëve të Dibrës së Poshtëme.

Gjithë këto gjëra, mbasi i shoshitëm (shkoqitëm) në mendjen tonë, nuk mund të thomi me vetëdije endë se në gjirin e Shqipërisë lindi prej vetes ora që bijtë e saj të marrin shpatat ndër duar, apo që ato i kapën të nxitur prej të huajve që janë për rreth. Dimë vetëm këtë që shpatat u hoqën prej millit për të mbrojtur të drejtën.

- 1) Që të mos japin ata /shqiptarët/ më shumë se me marrëveshje të shprehura dhanë të parët (etërit) e tyre; e që haraçin ta ndajnë pleqtë e tyre shtëpi për shtëpi, siç qe zakoni, është kërkesë e drejtë.

¹³² *Notizie gravi dalla Shqipëria echeggiano in Europa, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 1, p. 1, Corigliano Calabro, 10 aprile 1885.

- 2) Që të mbajë Turqia më gjatë në burgje e në mërgim (internim) krerët (bujarët) e Shqipërisë, është faj i madh, duke ditur mirëfilli ajo se ata zotëri, po ashtu si i kishte pasur për krah në luftën me Rusinë, ajo i thirri për rreth saj kundër kombeve të afërta që mendonin ta çveshnin (ta shkatërronin). Dhe vetëm kur ata e panë atë /Turqinë/, ndonëse pa dëshirin e saj, se u pat dhënë atyre kombeve armike të saja, pjesë të gjërisë së tyre, që i qenë aq besnike, vetëm atëherë ata u shkëputën prej saj me zemër dhe me vepra. E t'i mbajë ajo /shqiptarët/ endë të shkretë, s'është më e drejtë.

Le të jetë tani, dëshërojmë, ora që Porta e Lartë Osmane me aq shtete të afërta dhe të largëta që i duan të keqen, e me të, ndër të pakët që nuk e lëshuan (braktisën) endë, shqiptarët e mjerë, duke i ikur gjakut, t'iu api këtyre, siç premtoi në Berlin, autonominë e shtëpiavet të tyre, t'i gëzojë ata duke iu kthyer zotërijtë e tyre. Këta do t'i bëjë të lumtur. Do të shpërndajë pritat e huaja të pangishme (të pangopura).

10 prill 1885

23. NA SHKRUAJNË NGA DURRËSI¹³³

Prenkë Gjoka i shkretë qe rrethuar e zënë në një shtëpi, te gryka e Buenës. Pati kohë ai brenda sa të zhdukte letrat që mund ta komprometonin, pse, si thonë, nuk i gjetën tjetër veçse një numër të *Fiamurit /të Arbërit/* që, në Shqipëri, është i ndaluar, si edhe veten e tij. Jo pse e kishin në sy atë, dhe e dhanë në duar të turqëvet, sepse ai s'ia ndalonte diellin ndonjë njeriu, por pse u duk që vinte emisar (spiun) i Trikupit, i bërë panhelen. E çuan në Stamboll, nëpër rrugën tokësore, duke drashtë (pasur frikë) se, po ta vënin në vapore, që ndalohen nëportet (limanet) e Heladhës, mundet që atje helenët t'ia mirrnin prej duarsh.

E, si rob i panhelenëvet, takoi, për fat edhe më të keq, Hajredin Begun nga Matja, një njeri i lik (i keq) ky, i cili, mbasi kishte vrarë me tradhëti, të kushëririn, Rizanë, një zotëri i ndritshëm, atë dhe gjithë shtëpinë e tij, kish ikur në Heladhë. Atje gjeti se kush t'ia përkëdhelë mbrapshtinë (shpirtin e tij të keq, paudhësinë), dhe e zgjodhi për rreth helenizmit fatbardhë. E, pas disa vitesh, prej atje ktheu aty ku nuk gënjeu njeri, sepse edhe në Heladhë nuk i fliste shqiptar me gojë. Kështu, mbasi e vunë një mbrëma në mes, e vranë mbë udhë.

20 maj 1885

¹³³ *Ci scrivono da Durazzo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 2, p. 3, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885.

24. TË ABONUARIT (PAJTIMTARËT) BASHKËKOMBAS TË KOLONIVE SHQIPTARE TË ITALISË

Të Sicilisë:

- 1) At Damiano Karnesi, Piana dei Greçi
- 2) Prof. Nikollë Kamarda, “ “ “
- 3) Kristina Xhentile di Xhuzepe, “ “
- 4) Françesko Madalò di Venanço, “
- 5) At Xhuzepe Musakji, “ “ “
- 6) Françesko Peta, “ “ “
- 7) Vinçenco Zolopi, Kryetar bashkie “ “ “
- 8) Kryepriifti i Pallatit Adriano
- 9) Kryetari i bashkisë së Pallatit Adriano
- 10) Shtëpia e Gjergj Skëndërbeut në Pallatin Adriano
- 11) Pietro Kriara Avokat në in Palermo (20 kopje) në Pallatin Adriano
- 12) Antonio Dara di Gabriele i Pallatit Adriano
- 13) Kavalier Gabriel Dara i Pallatit Adriano
- 14) At Filip Matranga, Prift grek në Mesina në Pallatin Adriano
- 15) Gaetano Petrota Matranga, Inspektor pyjor në Pallatin Adriano

Nga Kalabria 2^a:

- 1) Prifti Miçeli në Katanxaro, nga Vena
- 2) Gaetano del Xhudiçe nga Vena
- 3) Baroni Dramis nga Skandale
- 4) Prifti në S. Nikola del Alto
- 5) Kryetari i bashkisë në S. Nikola del Alto
- 6) Felice Mesina, Mësues i Zakonshëm në S. Nikola del Alto

- 7) Sindaco di S. Nicola del Alto
- 8) Felice Mesina Mësues i Zakonshëm i S. Nikola del Alto
- 9) Prifti i Karficit
- 10) Prifti i Karficit

Calabria Çitra

- 1) Antonio Argontixa, Kryeprift nga Mbusati
- 2) Françesko Kanadè nga Mbusati
- 3) Samuele Dramia nga Mbusati
- 4) Florindo Kanadè nga Vikarico
- 5) Ercole Elmo
- 6) Salomoni Prift nga Vikarico
- 7) Felice Skura, Sekretar
- 8) Kavalier Vinçenco Skura nga Vikarico
- 9) Çezare Toçi, Kryetar bashkie nga Vikarico
- 10) Francesco Toçi, Kryetar bashkie nga Vikarico
- 11) Prifti S. Markeze (18 kopje) nga Strigari
- 12) Mikele Makri nga Strigari
- 13) Vitaliano, Sekretar Pallati nga Strigari
- 14) Françesko Serembe nga Strigari
- 15) Kavalier Guljelm Toçi nga Strigari
- 16) Donato Toçi nga Strigari
- 17) Xhuzepe Toçi, Kryetar bashkie nga Strigari
- 18) Kozmo Toçi nga da Strigari
- 19) Xhovani Andrea Vinaçi nga Strigari
- 20) Pietro Barçi nga Makji
- 21) Mikele Kalvoza, Segretar në Trebisaçe, nga da Makji
- 22) Demetrio Gradilone, Prift nga Makji
- 23) Akil Markianò, Prokuror i Mbretit në Kozenca, nga Makji
- 24) Anxhelo Markianò, Rektor i Kolegjit Shqiptar, nga Makji
- 25) Kavalier Antonio Markianò, Profesor në atë Kolegjin Shqiptar, nga Makji
- 26) Kirstofor Markianò nga Makji
- 27) Mikele Markianò, Zëvendës Drejtor i Gjinnazit Paola, nga Makji
- 28) Prifti Vinçenco Ajelo nga Shën Dhimitër Korone

- 29) Doktor Stefano Bafa, nga Shën Dhimitër Korone
- 30) Vëllezërit Kiodi të Moisitut, nga Shën Dhimitër Korone
- 31) Xhuzepe Kiodi, Prift në Tiriolo nga Shën Dhimitër Korone
- 32) Salvatore Kiodi, Drejtor i Gjimnazit të barazuar të Kasanos
- 33) Vinçenco Kiodi, i deleguari shkollor i Rrethit të Shën Dhimitrit
- 34) Demetrio De Graça, Profesor në Liceun e Notos
- 35) Doktor Anxhelo Lamirata nga Shën Dhimitër Korone
- 36) Marçelo Lopez, Kryetar bashkie nga Shën Dhimitër Korone
- 37) Nikola Lopez, Prift nga Shën Dhimitër Korone
- 38) Françesko Makri nga Shën Dhimitër Korone
- 39) Salvatore Markianò nga Shën Dhimitër Korone
- 40) Xhuzepe Markianò, Prift grek nga Leçe
- 41) Çezare Marini, Pretor në Çiro nga Shën Dhimitër Korone
- 42) Françesko Marini, Zëvendës Pretor nga Shën Dhimitër Korone

(vazhdon)

20 maj 1885

25. TË ABONUARIT BASHKËKOMBAS (PËR VITIN E PARË) TË KOLONIVE SHQIPTARE TË ITALISË

- | | |
|---|--------------------|
| 1) Nestor Kadikamo | Sh. Dhimitër |
| 2) Rafael Lopez, prift | “ |
| 3) Rafael Mauro, i të 1000 nga Marsala | “ |
| 4) Komendator Demetrio Strigari, avokat në Napoli | “ |
| 5) Doktor Françesko Buljari | Sh. Sofi |
| 6) Federiko Ferrioli, Gjyqtar në Gjykatën e Xhirxhentit | “ |
| 7) Akil Ferrioli, prodhues cigaresh në Montevideo (30 kopje)“ | “ |
| 8) Xhovani Mashi | “ |
| 9) Prof. Vinçenc Pici | “ |
| 10) Stanislav Makiano, Zyrtar në Ekonomatin e Napolit | “ |
| 11) Xhovani Karaçolo, avokat në Kozenca Falkonara | “ |
| 12) Dr. Antonio Greko | S. Benedeto Ulano |
| 13) Carlo Masci | “ |
| 14) Virginia Karçi | S. Martino di Fin. |
| 15) Xhuzepe Karçi, avokat në Kozenca | “ |
| 16) Xhuzepe Pinola | “ |
| 17) Vinçenc Tuçi | “ |
| 18) Kavalier Karlo Facio | S. Jakopo |
| 19) At Antonio Santori | “ |
| 20) Tomazo Smeriljo | “ |
| 21) Xhovani Stamile, përfaqësues shkollor | “ |
| 22) Silvio Mayera | Çerxeto |
| 23) Luçano Petrasi | “ |
| 24) Françesko Saverio, prift në Melikji Kavalerico | “ |
| 25) Anxhelo Barone në Gucolino Çervicato | “ |
| 26) Alfonso Markiano | “ |
| 27) Xhusepe Arone, sekretar në Akua Form[osa] | “ |
| 28) Xhovani Batista ish Gjykatë i Mirë | “ |

- | | |
|---|------------------|
| 29) Anunçato Kapareli | “ |
| 30) Famullitar Xhovani Kapareli | “ |
| 31) Orazio Kapareli | “ |
| 32) Valentino de Mari | “ |
| 33) Euxhenio, gjyqtar i mirë në Kozenca | “ |
| 34) Ambroxho Frashini, kryeprift | Firmo |
| 35) Leticia Frashini | “ |
| 36) Çelestino Frashini | “ |
| 37) Antonio Barbati | Specano Albaneze |
| 38) Alesandro Çuçi | “ |
| 39) Mikelanxhelo Greko, Pretor i Kozencës | “ |
| 40) Vinçenco Maxhore Luçi | “ |
| 41) Paskua Skuilaçe | “ |
|
<i>Kalabria Çitra</i> | |
| 42) Tomazo Korteze, gjyqtar në Katanxaro | Lungro |
| 43) Kuçi, gjyqtar hetues në Kozenca | “ |
| 44) Kavalier Anxhelo Damis | “ |
| 45) Komendator Domeniko Damis, Gjeneral i Lartë, Komandant
në Ankona (4 kopje) | “ |
| 46) Nikollë De Marko, prift | “ |
| 47) Lorenc De Reris | “ |
| 48) Vinçenc Lekardito | “ |
| 49) Agostin Maida, kryebashkiak | “ |
| 50) Çezar Martini | “ |
| 51) Dr. Oracio Martini | “ |
| 52) Ferdinand Samengo, marrësi i kripës | “ |
| 53) Kavalier Xhuzepe Samengo, Kryetar i Gj.
së Krimeve të rënda | “ |
| 54) Arqipeshku Xhuzepe Skaljone Scaglione | “ |
| 55) Kapiten Vinçenc Stritigo | “ |
| 56) Domeniko Tamburi, avokat në Kastrovilari | S. Basile |
| 57) Kavelier Napoleon Tamburi | “ |
| 58) Bilota, Kryeprift BernardoFrashineto | “ |
| 59) Vinçenc Dorsa, profesor ne Liceun e Kozencës | “ |
| 60) Domeniko Arkuri, avokat në Kastrovilari | Perçile |
| 61) Antonio Parapunja, kryebashkiak | “ |
| 62) Vinçenc Pelikano | Çivita |

- | | |
|---|-------------|
| 63) Xhenaro Plako, avokat në Kastrovilari | “ |
| 64) Xhuzepe Plako Farm. | “ |
| 65) Doktor Anxhelo Bazile | Plataçi |
| 66) Vinçenc Belushi | “ |
| 67) Demetrio Kidikimo, Kryeprift | “ |
| 68) Karlo Paçe, Kryebashkiak | “ |
| 69) Akil Kamodeka e | Kastrorexho |
| 70) Batist Kamodeka | “ |
| 71) Pietro Kamodeka, Kryeprift | “ |
| 72) Pietro Solano | “ |

Basilikata

- | | |
|---|---------------|
| 73) Xhuzepe Osnati | Sh. Paolo |
| 74) Kavalier Aleksandër Smilari, Kryetar i Gjykatës
në Trani | “ |
| 75) Erminio Paçe | Sh. Kostandin |
| 76) Kavalier Agostino Skutari (Shkodra) | “ |
| 77) Xhuzepe Turiela | Barile |

Pulje

- | | |
|-------------------------------------|--------|
| 78) Xhorxho Maurea Senior (2 kopje) | Kieuti |
| 79) Dr. Xhovani Musakji | Ururi |
| 80) Prifti Xhakomo Pelegrino | “ |
| 81) Shoqëri punëtore e Kastelvekios | “ |
| 82) Emanuel Bosha | Greçi |
| 83) Karlo Luixhi Borsirà, prift | “ |
| 84) Doktor Rafael D'Apuco | “ |
| 85) Avokat Xhuzepe De Majo | “ |
| 86) Francesko De Martino | “ |
| 87) Françesko Lauda, kryeprift | “ |
| 88) Kavalier Luigji Lauda, abat | “ |
| 89) Françesko Lusi | |
| 90) Nikollë Strada | Abruci |
| 91) Kastandin Milo, prift | Badesa |

(vazhdon)

20 qershor 1885,
20 gusht 1885

26. POR ÇËSHTJA ËSHTË ZBULUAR¹³⁴ (PO RANË PERDET)

Konfederata Orientale, e përkohëshme që del në Athinë, më 21 janar sjell këtë lajm:

“Kemi dëgjuar me një çudi për të ardhur keq se në Bukuresht u formua një Komitet për lëvrimin e gjuhës shqipe, me pikësynim që të gjejë burimet (zanafillet) e saj dhe ta përgatisë të kulluar në veten e saj /ta zhvillojë me pastërtinë e saj të natyrshme/.

“Kjo e bëme /ky fakt/ na tregon me ç’mendim të mprehtë e parashikues shkrimtarët e Horës /së Arbëreshëvet/ e kanë pasë siguruar çështjen e helenizmit. Këta miq, këta ndihmëtarë (dalëzotës, mbrojtës) të Horës shohin, padyshim, më tej se ne, e, prandaj, me qëllim që ta ndanin, përgjithëmonë, Shqipërinë prej Greqisë, deshën që të nxirrej në dritë një gjuhë shqipe; sepse të lindurt e kësaj gjuhe nuk do të thotë tjetër veçse të ndarit (të veçuarit, shkëputja) e shqiptarëve prej nesh”.

Pastaj, mbasi kujton ajo e përkohëshme ngjarjet e vitit 1877, për të cilin thotë se helenët nuk ditën të rrëmbejnë (të shfrytëzojnë) rastin, por i lanë shqiptarët të vetëm në fat të zi, kalon me këto fjalë: “As gjithë ata milionë marrë hua, as hapja me nxitim e hekurudhave nuk u vlen gjë fateve të mëdha të helenizmit, duke u lënë kështu pas dore, siç po ndodh, populli shqiptar, i cili po ndahet nga ne në të gjitha drejtimet, dhe, më fort se të tjerët, shqiptarët ortodoksë, po të zinte rrënjë ky plan për një gjuhë të tyre më vete”.

Në radhë të parë, po thomi se nuk është e vërtetë se Greqia nuk diti të rrokë çastin e volitshëm; dhe, për të mos e mbuluar me turp, po heshtim.

¹³⁴ *Ma Son Caduti I Veli, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 2, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885.

I drejtohemi, pastaj, Bulgarit (Vulgaris), njeri me besim të sinqertë: ç'i intereson atij që Greqia të përpiqet ta ndrydhë gjuhën shqipe që në djep? Sepse, na duket, që nuk i mbetet tjetër veçse të magjepsë, me sytë e vet, ata (disa) prej nesh, që i ka në zemër, e gjithë sa përmban Shqipëria, e, pastaj ata që gjinden larg në Itali, në Egjipt, në Rumani, dhe ata që janë përhapur nëpër të gjithë Turqinë deri në Azi; t'i joshë, dhe me fjalën e vet t'ua ftohë në zemër shpirtin që u ndizet nga fjala e njerëzve të një gjaku sapo të lindur.

Po le të theksojmë atë që rrëfen ai vetë e jo më tepër: rrëfim që hedh dritë, /në mënyrë/ që Shqipëria të zbulojë tri gjëra në Greqinë:

- 1) Se Federatën e popujve të Ballkanit ajo e ka në zemër, jo sepse ua do të mirën të huajvet, por sepse pret që, duke i hedhur si një perde syvet Shqipërisë, kjo do të bëhet robëreshë, dhe asaj [Greqisë], e forcuar nga nënshtetasit e rinj, ajo Federatë t'i bëhet karro, ku të rrijë si mbretëreshë.
- 2) Për ta bërë ajo, pastaj, të veten Shqipërinë, kjo duhet të heqë dorë nga gjuha e saj e natyrshme, që i është ndrydhur brenda në shpirt; dhe t'i qëndrojë asaj jo vetëm rob, por edhe si një kafshë bartëse e dobishme.
- 3) Që, së fundi, vetëm Greqia nuk e di endë se gjuha shqipe nuk pritet që të lindet, sepse ekziston që prej kohëve më të para, dhe: “tani e ushqyer dhe e vaditur” në tokën e vet dhe në mes të të huajve sot:
“ajo ka lëshuar shtat dhe është bërë një vashë e re”.

Por Greqia, në të vërtetë, e di këtë, dhe shumë më tepër, sepse e ndjen me veshët e vet, dhe i tingëllon për rreth, nga çdo anë e vendit të vet. Ndoshta nuk di endë këtë, që, sot o nesër, krijimeve të asaj gjuhe, e vetja /d.m.th. gjuha e vet/, që është aktuale me të, nuk di ç'të bëjë tjetër, veçse t'i rrijë për bri me nder.

20 maj 1885

27. D R I T A¹³⁵

Muarëm nga Stambolli tre numra të *Dritës*, dhe i urojmë ditë të bukura e të gjatë përgjithëmonë. Ato që dihen sot nëpër kombet e shquara, Ajo do, e – bën shumë mirë – t’ua mësojë djelmëvet të Shqipërisë së shkretë, për kur kjo të ketë shkollat e saj. Tek ajo edhe ne me kënaqësi gjetëm aq fjalë, të cilat, në këtë veçimin tonë, i patëm harruar. E kujtojmë se si, disa kohë më parë, zotërijtë që shkruajnë *Dritën* na kishin thënë të kishim besim se gjuha, sikurse edhe ne vetë, rronte e shprishur (e shpërndarë) një pjesë këtu – një pjesë atje, e se një herë (një ditë) do të mblidhej. Por, si i harruam, na lypsej t’i përkthenim o frëngjisht, o helenisht (greqisht). I këshillojmë, pra, të mos marrin, të mos dredhin fort me trajtat e gjuhëvet të huaja, fjalë që ne s’i kemi, sepse fjala e dëshëruar do të rrjedhë vetë e me fizionominë e shtëpisë nga kroi i jetës.

Rreth alfabetit do të flasim më rëndë kur drejtuesit e *Dritës*, zotërinjtë e Komitetit të Bukureshtit dhe ne bashkë do të bijmë në gódi mbi shkronjat që të jenë jehonë e të gjithë tingujve të gjuhës dhe nga më të njohura në përgjithësi.

20 qershor 1885

¹³⁵ *Dritta*, (La Luce), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, nr. 3, Corigliano Calabro, 20 giugno 1885, p. I.

28. NGA JANINA MË 16 KORRIK 1885¹³⁶

Të shkruajta se Abdyl Beg Frashëri vdiq në burg. Se desh mirë Shqipërinë, pësoi të keqe; e këndej, të gjithë ata që e dinë, janë helmuar.

Për Komitetin e Korfuzit, beso se ai i shërbeu Greqisë, kurse Shqipërinë e gënjeu. Sa për shqiptarë, kanë mbledhur disa vrsasës, të papunë, pa bukë, që të quhet komitet shqiptar; por është e rreme. Gjithë mendimi i tyre është të mundin të ndajnë shqiptarët myslimanë e të krishterë, gegë e toskë.

Prap më shkruajnë nga Toskëria se nuk e kanë marrë fare *Fiamurin e Arbërit*. Dëgjova se i presin udhën në Korfuz ose në Janinë, me qëllim që ata të mos paguajnë dhe zotrote të lodhesh.

Shkruajnë, përsëri, nga Athina:

“Letra jote e sotme më bëri edhe këtë helm. Nuk e dija që je kaq plak: nuk jemi ne endë të mëkëmbur, as të bashkuar. Por mbahu fort dhe të jetosh gjallë sa të mundesh, deri që të lësh tjetërkënd në këmbë tënde. Se të jap unë sot një lajm shumë të mirë: *Porta e Lartë u dha leje krahinave shqiptare të hapin në gji të tyre shkolla me gjuhën amtare të Shqipërisë*”.

Ishte ky shenji i dëshirave tona.

20 gusht 1885

¹³⁶ *Da Giannina, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 4, Corigliano Calabri, 20 agosto 1885, p. I.

29. A JANË ZHDUKUR RETË?¹³⁷

U ndodhëm shumë afër asaj dite, kur gati ishte duke shpërthyer një betejë e ashpër dhe e përvajshme ndërmjet Anglisë dhe Ruisë; dhe, po qe se njera ose tjetra prej tyre, që janë mjaft krenare, do të zmbropset nga ajo përpjekje e plagosur thellë në zemër, s'ka dyshim se ajo që, tashti, duket se është paqe, ka për t'u zhdukur shpejt. Ndërsa ato sot nuk kanë dëshira pushtimi që t'i shtyjnë në ndeshje ndërmjet tyre, edhe zemërimi, pra, me kalimin e kohës, do t'u zbutet, ashtu sipas fyerjeve me fjalë.

Në të vërtetë, një rrëqethje përshkoi trupin e Europës. Ja që, tashmë, ka kohë që Anglia jep e merr në Egjypt, dhe kërkon të bëjë miq me vehte. Franca, kur pa se midis Anglisë dhe Ruisë cariste grindja u bë serioze, bëri paqe me Kinën, megjithëse kjo e fundit ishte mundur. Dhe, ndërkaq, ajo e mban endë atje ushtrinë, gati e përgatitur për çdo ngjarje të paparashikuar. Nga ana tjetër, Gjermania, që, përveç Francës që e urren, edhe qeveria angleze po e godet prej kohe (nuk desh t'ua mbyllë kufijtë e saj të arraturve politikë të huaj, kur të kishin turbulluar vendin e shteteve të tyre, dhe, pak më parë, ajo bëri të njohur një këshillë ekuivoke të Bismarkut) – Gjermania, pra, si kurrë ndonjëherë tjetër në të kaluarën, kremtoi ditëlindjen e Dukës së saj, qoftë për t'i dhënë kurajo, qoftë për mirënjohje, për shkak se mundi të arrijë të merreshin vesh ndërmjet tyre të tre perandorët.

Përse e bënin këtë aleancë dhe nuk deshën që Italia të ishte e pranishme? Askush nuk e tha këtë. Veçse, pas kësaj, Rusia i hodhi dorashkën Anglisë /e thirrinë dyluftim/, dhe ajo nuk e pranoi.

¹³⁷ *Si son dileguate le nubi?*, *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 4, Corigliano Calabri, 20 agosto 1885, p. III.

Të themi të vërtetën, dyzet vjet më parë Rusia nuk do t'i kishte dalë përpara me kaq fodullëkt Anglisë së Palmerstonit. Ishte koha kur dëshira dhe synimi i të gjithë njerëzve ishte të çlironin veten dhe pasurinë e tyre nga vullneti dhe sundimi i princërve. Dhe flamur i asaj dëshire dhe i atij synimi pa caqe ishte, atëhere, ai ministër / Palmerstoni/ bashkë me Anglinë e tij. Dhe kush mund ta ndalonte? Qysh atëhere, filloi çlirimi i popujve, njeri pas tjetrit. Por që të gjithë, në lirinë e dëshiruar, nuk mundën veçse të zgjedhin, në kohën e caktuar, jo përfaqësues të tyre besnikë të bindur, por disa *zëvendës*. Dhe, kështu, shpejt u zhduk lumturia që kishte nxjerrë krye së largu, lumturia e çdo populli që priste të ish zot i vendit të vet. Ato vende kaluan në duart e *zëvendësve*, dhe këta, siç ndodh gjithmonë dhe kudo, i keqpërdorën vendet, me që nuk ishin të tyre. Dhe të zotët e vërtetë të vendit, gjithnjë e më të mjeruar, qysh prej ditës që zëvendësat nisën të ndrrohen njeri pas tjetrit, nuk dinë nga cilët mbretër varen, nga ç'mbretër të një lloji dhe kapadailëku të ri, që janë zgjedhur për të qeverisur, pa përgjegjësi, njerëzit dhe pasuritë.

Por e gjithë e keqja nuk qëndron vetëm këtu. Ata *zëvendësa* janë të rrethuar, nga dita në ditë, prej turmash, përherë e më ambiciozë, që kërkojnë të gllabërojnë pasurinë e të tjerëve. Dhe kështu, kush ka familje dhe pasuri, rri me zemër të ndrojtur nga frika e së ardhmes. Pikërisht në duart e Anglisë dhe të Francës flamuri i sundimit të *zëvendësave* (*mëkëmbësave*) është i rrahur nga fortunat e jashtme dhe nga ato të brendëshmet; prandaj edhe nuk guxojnë, dhe endë nuk vendosin.

Kështu, në thellësi të oqeanit të shqetësuar, dhe ku dallgat ua heqin syve pamjen e, pastaj, e lënë të shihet mirë, qëndron koka e Meduzës, që llahtarit Europën.

20 gusht 1885

30. PULJET DHE SHQIPËRIA¹³⁸

Nuk di si të thom me fjalë mirënjohjen e zemrës sime dhe të të gjithë shqiptarëvet – kur të marrin vesh – ndaj zotni Kalorës De Simonit, kryetar i gjykatores tregtare të Barit dhe ndaj këtij qyteti për këshillin bujar (shpirtmadh, zemërmadh) që të lidhin Puljet, përsëri, tregëti me Shqipërinë, nga të cilat, /nga Puljet/ pjesa më e madhe, motit, flisnin gjuhën e saj e të një gjaku edhe janë. Ka kohë që, ndër gazeta, lexoja, me mallë, shkrime të urta e të drejta të atij bujari; e s’e pandehja kurrë se, një ditë, ai do t’i ngrinte Shqipërisë sonë, mbrojtjen e hapët mbi të gjitha.

Pse, prej gjithë anësh, vetëm ai (sipas një lajmi të ri që na erdh) bën të mbushë fatin e mirë të mëmëdheut tonë me një tjetër propozim të bukur. Presim që, nga brigjet e këtij /të atdheut/, të na jehojë dëshira e gatëshme, lidhur me ato që iu propozuan, jo vetëm për të shitur e për të blerë, me të gjitha vendet, por edhe për të huajtur, me shndrrime, njera me tjetrën, dhe me kënaqësi shpirtërash, si është zakon në mes të shtëpiave motër.

Dëgjoni lajmin e ri nga *Risorgimento delle Puglie* (= Përlindja e Puljevet), më 7 shtator:

“Pas atyre që botuam përpara, na erdh një letër tjetër nga Kalorës De Simone, dijetar dhe shumë punëtor për çështjet e mira të Italisë, e jemi të sigurtë, nga ana jonë, se e nderuara Odë e tregëtisë dhe i shkëlqyeri kryetar i Komisionit administrativ i Shkollës sonë mbretërore me Bankën model, me të ndërruarit e saj të shpejtë në Institut i lartë universitar, do të dijë ta kthejë në fakt konkret propozimin fort të bukur të Kalorës De Simone për një katedër të gjuhës shqipe. E, pa diskutuar rëndësinë e studimeve të gjuhës arabe dhe pa vënë në dyshim nevojën e një Sprove përhapjeje koloniale kah Afrika, né na duket shumë e dobishme që populli shqiptar të njihet më për së afërmi dhe të vëllazërohet me popullin italian.

20 shtator 1885

¹³⁸ *Le Puglie e l’Albania, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, nr. 5, Cosenza, 20 settembre 1885, p. I.

31. TURBULLIME (TRAZIME) NË SHQIPËRI¹³⁹

/Organi/ Débats, /nën titullin/ Turbullime në Shqipëri, 25 shtator, / shkruan/: Lexojmë në Korrespondencë politike të 22 shtatorit:

Mbas përpjekjeve që u bënë më 28 shkurt të këtij viti, ndërmjet popullsisë së Lumës dhe trupave /turke/, prisat e fiseve të ndryshme të Shqipërisë së Veriut kanë bërë mbledhje të shpeshta për formimin e një lidhjeje kundër futjes së projekteve të ligjeve të reja midis këtyre bajraqeve. Mareshali i ri Vesel Pasha, mbasi u bind se do të pëlçiste një kryengritje e armatosur nga ana e këtyre fiseve, shkoi me katër batalione në Gjakovë, ku arrijti më 4 shtator.

Mbasi blokoi qytetin, arrestoi një farë Sulejman Vokshi, dhe shumë udhëheqës të tjerë të Lidhjes [Shqiptare të Parë]. Popullsia, e dëshpëruar shumë, sulmoi trupat /turke/ dhe ra në një përpjekje (luftim) të përgjakshme. Nga njera palë dhe nga tjetra humbjet qenë të ndjeshme. Vesel Pasha u tërhoq, por duket sikur u rrethua nga shqiptarët, në rrugën e Prizrendit, dhe, kështu, iu desh të kërkojë ndihmë edhe katër batalione nga Prishtina.

Kryengritja shqiptare nuk ka të bëjë aspak me ngjarjet në Bullgari. – Vjenë, 25 shtator.

Gjendja në Shqipëri sa vete keqësohet. Lajmet zyrtare nga Konstantinopoli përgënjeshtrojnë zërat e përhapura që thonë se kryengritësit shqiptarë mundën trupat turke të komanduara prej Vesel Pashës.

20 shtator 1885

¹³⁹ *Debats, troubles en Albanie 25 septembre, Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 5, Cosenza, 20 settembre 1885, p. II.*

32. TË FEDERUARIT (TË BESËLIDHURIT) E BALLKANIT¹⁴⁰

Sot gjindemi para një gjëje të re në botë. Atje ku një shtet, duke u bashkuar me të afërmit e vet, bëhet i madh, tjetri që i rri pranë, që të mos qëndrojë më i vogël, do dhe këshillon të rrëmbejë kë mundet. Nesër, pastaj, një shtëpi, e cila do të shohë në qytetin e vet se fqinja, a me të bleme a me tjetër punë, u bëgat (u pasurua) mbi të, do të ndehet (do të zgjatet) të marrë ku të mundet; sepse ajo ka arsye të mos qëndrojë prapa. Dhe gazeta që quhen liberale nga të tjerët – në të vërtetë – u jepin të drejtë atyre. Se sot, qentë që rrethojnë trapezën e mallkuar të katundeve të nëmura, i lehin përherë Hënës së bukur të paluejtëshme, në të cilën qe e prëjtur (e vënë) jeta njerëzore. Po, ku vemi, pastaj, bashkë, po t'i japim arsye vjedhësit që t'i ndihmojë njeriut për të mos qëndruar si prapa tjetrit?

Por kjo – thonë ata – është një rrethanë e jashtëzakonshme. Në të vërtetë, kur u bashkua Italia dhe u bë e madhe, nuk ndodhi kështu, sepse asnjë nuk desh, as nuk lypi tjetër. Sot jemi në çaste të atilla që Turqia e huaj po mundohet të dalë nga Europa; e kombet që ajo mbajti nën vete, do t'i marrin përsëri vendin dhe asgjë më tepër.

E ne i pyesim: Po cilin vend? Ajo erdhi nga Azia. Vendet, mbi të cilat sundoi, janë ato të kombeve që ajo gjeti. Sepse ajo, tashti, nuk e shkretoi dhenë, por e ardhur aty me dy ose treqindmijë ushtarë, zgjodhi ndër tokat që mundi e ndenji zonjë e dymbëdhjetë a trembëdhjetë milionë burrash, pleqsh e fëmijësh. Ajo nuk e ka vendin aty /në Ballkan/.

Përse, vallë, ndehen duartë në gadishull të Ballkanit? Greqia, e para, do Shqipërinë e Jugut, Thesalinë e pjesë nga Maqedonia; Mali i Zi do Gegërinë e afërt të bregut të detit; vende të gjitha këto, ku jehon vetëm gjuha e Shqipërisë, me përjashtim këtu-atje si shtëpia e Zhapës nga Labova – (shtëpi) gomareshë kryeneçe dhe e mbledhur nëpër stallat e

¹⁴⁰ *I federati de'Balcani, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 6, Cosenza, 20 ottobre 1885, p. I.

Greqisë – që bëri të jehojë në ndonjë shkollë gjuha greke, megjithatë është e huaj për mëmat dhe etërit e asaj familjeje. Serbia, pastaj, do Serbinë e vjetër, të cilën *Ligja e Romës*, si ajo që nuk pa e që nuk di, marrë nga gazeta të shitura, ka përfshirë edhe Gjakovën, Rekën, Lumën; deri Mirditën e këllet brenda. Por Serbia e vjetër, më shumë se Maqedonia sot, është e mbushur me shqiptarë, pse në kohët e lashta, ajo ishte e kombit tonë. Serbianët erdhën dhe e zunë në Mesjetë; por, meqenëse u përzunë përsëri prej andej, ia patën lënë atij që i përkiste. Sot, serbët duan t'ia marrin si pjesë e shqerrë (e shkyeme, e grisur) e kombit të tyre, po me atë ligjë, me të cilën Longobardët mund t'i lypin Italisë Lombardinë.

Po ja, më të rarë atje dielli, ne shohim: Shtetet që u zgjidhën (u shkëputën) më parë prej Portës së Lartë Osmane, ngrihen jo që t'i ndenjin (zgjasin) dorën Shqipërisë për t'u ngritur edhe ajo motër, *por që ta bëjnë copa-copa dhe ta ndajnë*, në mes tyre, kombin e gjorë që, i fundit, qe mundur prej turqish, me të cilët e mban të lidhur besa shqiptare. Për ato shtete, kjo është e gjithë Çështja Lindore. E, megjithëse nuk duan të shohin, tani ato duken sikur luftojnë për pjesën që i duhet secilit /shtet/: pjesët ato i ndajtën tek e shenjta *Besëlidhje (Federatë) Ballkanike*.

E, tani, që vetë u zbuluan, shqiptarët e Gjakovës, të Lumës, të Dibrës, etj., ato shpata që i kishin rrëmbyer kundër Sulltanit për të mbrojtur zakonet e shtëpisë së tyre, ato shpata ia zgjatën, vëllazërisht, Haes-el Pashës, shqiptar edhe ai vetë, që t'i çojë kundër armiqëve të jetës shqiptare. E ky lajm përhapet ndër fusha e ndër male dhe pret që t'i jepen armët rinisë së saj të çdo krahine. Por ata vrasës nuk guxojnë të vijnë vetë njeri pas tjetrit në luftë me Shqipërinë. Kjo pret me padurim çastin e luftës deri që Sulltani, i patrembur, t'i presë ata bashkë, në flamurin e tij. Dhe, nëqoftëse është vendosur nga fati i tynë-zoti që Turqia, e shtrime poshtë nga fuqitë e huaja të tjera, të bjerrë zemrën (të humbasë guximin), atëherë vetë Shqipëria do t'i hapë udhë vehtes që të futet në Besëlidhje /në Federatën Ballkanike/ me të drejta të njëjta. Kjo Federatë do t'i mbledhë (do t'i bashkojë) të tëra shtetet. Shqipëria do t'i japë besën Portës së Lartë Osmane – atë besë që vetëm ajo e mban të panjolllosur -, megjithëse dikur pat qenë aq keq me të.

Dimë se këto gjëra shkojnë, sot, nëpër zemra të krishtera dhe myslimane, pa frikë (d.m.th. fliten gojë më gojë).

33. NGUSHËLLIME NË PIKËLLIMET E TANISHME¹⁴¹

Sot zjarri i dashurisë për gjuhën amtare është ndezur në Shqipëri, e, prej gjithë vendesh, na përshëndesin dhe e urojnë *Fiamurin /e Arbërit/*.

Në javën e fundit të korrikut, muarëm këtë letër nga Maqedonia:

“Ka shumë kohë që kur kam dishëruar të kisha të përkohëshmen tuaj *Fiamuri Arbërit*, por, për fat të keq, nuk jua kam gjetur udhën. Para 18 muajsh lexova një numër që ia dërgojshit Kristoforidhit në Stamboll, edhe më ka pëlqyer shumë. Tashti, ju lutem, më tregoni se me ç’mjet të paguaj 6¹/₂ franga, në mënyrë që të më vijë revista.

Të fala me shëndet gjithë punëtorëvet të kësaj pune të shenjtëruar.
Manastir, më 23 korrik 1885

Vëllai juaj i dashur

Gjergj D. Qiriazi

Një letër tjetër na erdh, pastaj, nga Sicilia, e cila, përveç se na sjell emërin që një djalë, me shpresa të zgjedhura (të shndritshme) i jep *Fiamurit /të Arbërit/*, është ajo vetë një provë e shkëlqyeshme, sa e një mendjeje të urtë aq edhe e një gjuhe të bukur e, nga të gjitha anët, e përsosur, në mes të zonjavet tona. Duam ta paraqesim këtë lule të gjuhës së Shqipërisë:

I ndritshmi Zotëri,

Duke marrë zemër nga e mira e Zotërisë sate, guxoj t’i shkruaj, përsëri, e bindur se do të më ndiejsh (do të më falish) guximin, për hër të gjuhës sonë, për të cilën vij t’i jap shqetësim.

Një kushëri i imi, Zef Sqiroi, djalë që ndodhet duke bërë studimet në Palermo, punon që t’i japë gjuhës shqipe pastërtinë e saj të vjetër.

¹⁴¹ *Conforti nei presenti travagli, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, nr. 6, Cosenza, 20 ottobre 1885, p. IV.

Më bëri të lexoj disa krijime të tija (valle, këngë e vjersha të tjera), që mua, për sa mund të gjykoj, më duken të mira. Po ju dërgoj disa gjëra, në mënyrë që zotëria juaj, që, për këto punë, kupton më tepër se të gjithë të tjerët, të më thotë si i duken, pse një fjalë e zotërisë sate mund të rritë, tek ai, zemrën (shpirtin) dhe vullnetin të ecë në rrugën e marrur. Ky djalë, megjithëse shumë i ri (nuk i ka endë të njëzet vjetat) ka botuar, në një gazetë, disa këngë italishte, që janë pëlqyer.

Mora librin e katërt të *Skënderbeut /të pafat/* dhe ju falënderoj shumë. Lexova vajtimin mbi të ndjerin tyt bir e nuk gjej fjalë që të ju thom si më shqori (më copëtoi) zemrën. Për këto lloje (farë) plagësh nuk ka shërim. Dhe unë e di fort mirë /këtë punë/, sepse, sapo kisha mbushur pesëmbëdhjetë vjeç, bora (humba) mëmën e, me të, të mirën nga çdo anë. Perëndia, që këto gjëra i urdhëron, nuk e dimë përse, na dhënte fuqi sa t'i durojmë në paqë. Ditë shumë pastë zotëria jote dhe familja e zotërisë sate”.

Nga poezitë e dërguara bashkë me këtë letër e prej nga ne parandjejmë se mund t'i thomi djaloshit të ri *Vos exemplaria graeca nocturna versate manu versate diurna* /= Tani ju zgjidhni me dorë, ditën dhe natën, shembujt grekë/ të poezive, pse kaq pak vend kemi, prandaj edhe kaq pak mund ta shfaqim (ta paraqesim). Edhe pse pak, nga ajo shkrepitin diçka e re, refleksi i një shpirti të lindur vëzhgues (vrojtues), populli ynë i gëzuar do t'i thotë me besë: “Macte virtyte, puer” /= Të lumtë për këtë virtyt, vetí, o djalosh!/.

20 tetor 1885

34. SHQIPËRIA DHE TË PËRKOHËSHMET ITALIANE¹⁴²

Me t'u bashkuar krahinat e Italisë, në pasqyrën e të përkohëshmeve të asaj pjese që mori në dorë frenat e këtij bashkimi, shfaqet dhe shkon gjithnjë duke u shfaqur një dëshirë, sapo e shprehur, që të vihet këmbë mbi bregdetin e Shqipërisë dhe një frikë se, shpejt, Austria do të zbresë ndër ato brigje dhe do t'ia zërë diellin Italisë [do ta pengojë Italinë që të shtrihet nga Lindja].

Porse nuk u treguan kurrë qeveritarëve të tyre një rrugë të drejtë, me anë të së cilës të mund të hynin në Shqipëri si miq të pranuar e si kunetër – sepse të tillë qenë në kohë të lashta – si, bie fjala, të zhvillojnë tregëti, kështu që njëra të ndihmonte për mbarëvajtjen (mbrothësinë) e tjetrës; dhe të mendojnë për nevojën që Shqipëria ka për shumë arsim e qytetërim, dhe, për këtë, mjaftonte të nxitej që Italia të lavronte në Ngulimet arbëreshe, që i ka të shumta në gjirin e vet, gjuhën e tyre. Dhe, ndoshta, ajo këto dy gjëra mund t'i shpinte përpara duke themeluar (duke ngritur) një shkollë të asaj gjuhe në Kolegjin arbëresh, që e kanë ato Ngulime, i hapur edhe për italianët. Dhe, për ta themeluar (për ta ngritur), ajo nuk do të kishte shpenzuar tjetër veçse fjalën.

Përkundrazi, ato të përkohëshme nuk e ngritën zërin jo vetëm për ta përkrahur emrin tonë përkëtej, por edhe kur ministra pa mend e patën dhënë atë Kolegj, që është yni, për ta konsumuar, si një copë buke, sipas qejfit të disa njerëzve që i shkojnë bisht prapa Principatit, edhe nëse e ditën, nuk shqiptuan asnjë fjalë. Përkundrazi, sa herë që u dukej se po shpërthente zjarri (po del tym) në Lindje, ata, njëzëri, u uronin sukses të plotë Greqisë, Sërbisë e Malit të Zi, që kërkonin duke kërcënuar në bashkujdi njeri me tjetrin, ta copëtonin Shqipërinë dhe

¹⁴² *Shqipëria e dittâret ljetire* (L'Albania e i giornali italiani), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 7, Cosenza, 20 novembre 1885, p. I.

t'i ndanin mes tyre copat. Do të thoshit "Italia është e një mendimi me ato, o sepse i patën premtuar edhe asaj diçka nga Shqipëria e mjerë; o sepse nga ajo Lidhje e Ballkanit, Austrisë i paraqitej e mbyllur udha për Adriatikun e poshtëm.

Po ata bëjnë që kjo të duket si e kurdisur me veprimin e atij që përpiket të ngrejë vetën mbi gërmadhat e fqinit, ashtu siç e vërtetuan se duan të Federuarit e Ballkanit; veprojnë në mënyrë që ajo të mbetet, pastaj, pa pasë bërë gjë, shenjë për urrejtjen e shëmtuar që, sot, Shqipëria, mbi të cilën bëhen plane si *in corpore vili*, tregon kundrejt Greqisë, në mendjen gënjeshtare të së cilës lindi ideja e parë e Federatës Ballkanike, të cilën ato të përkohëshme bënin të besohej se Italia e përkrahte.

Dhe zemrat tona do të helmoheshin shumë nga një qëndrim kaq armiqësor, po të mos shihnin që Mbreti i Italisë ka sot me vete këshilltarë të drejtë e fisnikë, të cilët munden të dalin nga rrymë të verbëta që e nxisin atmosferën dhe vazhdojnë ta ruajnë këtë frymë të shëndoshë besnikërie në traktatet. Dhe pastaj – si vallë nuk kuptohet? – Turqia në këmbë dhe e fuqishme me mjete do t'i qetësojë (do t'i fashitë) vetëm ajo frikën e dyshimet e Italisë, duke frenuar për shpëtimin e vet këdo që të mendojë, qoftë edhe për të shkelur dhe për të smadhuar në krahinat e saj. Turqisë do t'i përtërihen forcat nga përkrahja e Fuqive europiane, po t'i qëndrojnë besnike ujdisë që bënë, dhe për të bërë që ajo të lidhë me fatet e saj krahinat e Europës që u sundon. Atyre, mbasi t'u jetë kthyer, në bazë të pakteve të Berlinit, qeverisja e shtëpive dhe e qyteteve të veta, do të bëjë, më në fund, që ato t'i drejtojnë sytë nga Federata, që në Austri u sjell të mira të tilla popujve të ndryshëm që ajo përfshin.

Në çdo rast, Shqipëria, e struktur në vetvete dhe e mbledhur në degët e saj të shpërndara, do të jetë një shkëmb, në të cilin do të thyhen tallazet sllave, të cilat sot trazojnë Austrinë dhe e bëjnë që të venë pendë për t'u mbrojtur nga çdo anë që mund t'u duket se u vjen rreziku.

20 nëntor 1885

35. INAUGURIMI I PUNISHTES SË VAJIT NË SHËN MITËR¹⁴³

Në dhé të Shën Mitrit, aty ku Rekaniejli e Lumi i Madh përzihen nën Maqin, qe themeluar e bërë gati, në këtë verë, një punishtë për vajt e hollë, e sot, ndërsa po shkruajmë, bluan /guri i mullirit/ me fat të mirë; sepse, sot, është, ndoshta, e para dhe nga më të zgjedhurat, ndër ato pak punishte të tilla, që deri tani u hapën në Kalabrinë e parë; e, prandaj, qe vendosur në mes të gjashtë fshatrave të Ngulimeve arbëreshe, që e rrethojnë për së afërmi, të cilat do ta rritin, pastaj, në një të katërt kamatën e ullinjëve.

Kur, më 22 të nëntorit, ajo punishte u vu për rrugë /nisi punën/ qe si një e kremte e arbëreshëve, me bujarët e ftuar atje. Atë e pajisën, bashkë, gjashtë zotërinj shokë: Dy vëllezër Korradi nga Shën Remi në dhé të Genues; Udhis Pankari, përfaqësues në Shën Mitër i Bankës së madhe të Kozencës; Alberty i Markjanonjëvet nga Shën Mitri; Mikanton Palaci nga Strigari, e nga Maqi Rodrigo De Rada, i biri i drejtorit të *Fiamurit /të Arbërit/*. Ujët e sjell, dhe bluan ndër tri vaska.

Mbasi që u inaugurua rrjedha, u vu tryeza e gëzueshme për bujarët e ftuar dhe për punonjësit e punishtes. Tek ajo tryezë, bashkë me Guljelm Toçin nga Strigari, deputet i krahinës, e me Marçelin e Ljopsatëvevet, kryetar i Shën Mitrit, desh vend i nderuari drejtor i Bankës së madhe, Zef Forliu, ardhur, nergut, nga Kozenca, që të merrte pjesë në inaugurimin e një punishte, caktuar që të rritë begatinë e shumë katundeve, dhe së cilës, me pëlqim i kishte dhënë edhe zemër dhe e kishte përkrahur.

20 nëntor 1885

¹⁴³ *Inaugurazione dell'opeficio oleario in S. Demetrio, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, nr. 7, Cosenza, 20 novembre 1885, p. III.

36. DITË E SHËNUAR E GURIT TË BARDHË¹⁴⁴

Dje qe një ditë e shënuar për *Fiamurin e Arbërit*. Nëna jonë përtej detit, që gëzohet dhe e ndjek me dashuri të heshtur, dhe e përshëndeti dhe i ndëjti dorën me të birin e saj, të zgjedhurin Prenkë Bibë Dodën, princi i Mirditës, i nderuar nga vëllezërit e krishterë dhe muhamedanë të Shqipërisë, e cila na dërgoi këto pakë fjalë të mira:

16 shkurt 1886

“Prenkë Pasha, Princi i mirditasvet, e lut shumë të nderuarin zotni De Radën të pranojë 40 frangat, që ai ia dërgon me nderimet e veta të sinqerta, e të besojë se do ta ndihmojë, me sa do të jetë e mundur, në detyrën e tij të vështirë e atdhetare, që ka marrë përsipër”.

20 dhjetor 1885

¹⁴⁴ *Giorno segnato di bianca pietra, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania) Anno II, nr. 8, Cosenza, 20 dicembre 1885, p. I.

37. GËNJESHTRA ËSHTË E SHTREMBËR¹⁴⁵ (RRENA I KA KAMBËT E SHKURTA)

Stuhia e lindur nga Lindja, siç duket, u shua, pa lënë shkatërrime. Në Mal të Zi po futen në vrima me një mullë (me një lëmsh) pritjesh të largëta; vetëm Heladha s’di të gjejë paqë. Ata që i kanë mbetur miq, i thonë horas (në kor): “Mos thuaj më se don të shtrihesh ndër prona të tjerëve. Në këtë mënyrë, ti lëndon drejtësinë; dhe askush s’do të të ndihmojë”. – “Oh, pashë Zotin (përgjigjet Ajo), ne s’duam gjë prej të tjerëvet. Ne rrokim armët për të çliruar vëllezërit. Ne duam të kemi, përsëri, jo tjetër, veçse tërë tokën që patën dikur të parët tanë. Sepse, sot, njerëzit e përparimit mendojnë të gjithë se kjo është një drejtësi”.

Le ta lëmë opinionin e njerëzve të Përparimit, i cili po të tërhiqej nga pasuritë, po të bëhej arsye e pasurive/, Heladha vetë me gjysmën e Europës do t’i nënshtrohej, përsëri, racës latine.

Le të kërkojmë, vetëm, që të na thonë, me sinqeritet, atë që dëshirojmë të dimë prej tyre; dhe neni do të zgjidhet menjëherë.

- Ju doni edhe një pjesë tjetër të Epirit e të Maqedonisë, e pse? Se ato janë tokë të bashkëkombasve tuaj, o sepse në to kanë themeluar qytete e zotërojnë toka të bashkëkombasve të tu?

Se ato janë krahina ku rri kombi juaj, është një falsitet i çpifur nga njerëz pa fytyrë e se realiteti, tashmë, i shkatërroi. Tri pjesë të popullsisë në to përbëhen prej shqiptarësh e pak sllavësh, dhe vetëm një e katërta, nga mashtrimet e një dore të gjatë, ndodh që sot të duket helene. Thënje gënjeshtarësh dhe llafazanësh është ajo që helenët kasnecë vërrasin në të katër anët, që të ndihen (të dëgjohen) larg: “Se Shqipëria është një degë e Greqisë, se për shkak të gjuhës që në atë u

¹⁴⁵ *La bugia è storpia, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 9, Cosenza, 20 gennaio 1886, p. III.

prish – dhe duhet të ribëhet sipas mënyrës së parë – sot fizionomia helenike aty sapo dallohet”. Sot, një diell i fortë ka zhdukur (ka zhदारaritetë) terrin e këtij mashtrimi dhe aq më fort atë që të dy popujt urrehen dhe urryen, gjithnjë, njeri tjetrin.

Mbetet, pra, ajo që është e vërtetë, se, në ato Vilajete, shumë fshatra, me pronat e tyre, janë me popullsi helene.

Gjithashtu, nëse për këtë fakt Heladha, pas shpëtimit të atyre që e këshillojnë, don që t’i mbledhë ata nën flamurin e vet, do të ketë arsye; por të ketë mendjen, nga ana tjetër, se jo vetëm Shqipëria por sot dhe Porta /e Lartë, Turqia/ për të don t’i mbedhë më vete (t’i bashkojë) gjithë ata shqiptarë autoktonë të Greqisë, që helenët e ardhur aty i pushtuan, dhe plot një të tretën e së cilës [popullsi] ata e mbajnë gjithnjë.

Le të dinë të përgjigjen ata: Shqiptarët e Heladhës (Arëreshët e Greqisë) duhen fort aty dhe me të duan të rrinë; tjetër punë është me grekët nën Turqinë.

Ne duam të shohim shpejt, se mos edhe kjo është një gënjeshtër që u shtohet të tjeravet.

20 janar 1886

38. LAJM I PRITUR¹⁴⁶

Një grua nga Kolonia e Vakaricos, që u kthye nga Vlora, rrëfeu se Ymer Bej Vrioni kishte kthyer në shtëpi, i liruar me zotëritë e tjerë të Shqipërisë, që ishin mbajtur ndër kullat e Dardanelit.

Pra, javën që shkoi, na erdh nga Egjipti një lajm tjetër, që na mbushi me gëzim.

*

Dje pata letër nga Bukureshti, tek më shkruanjën se Abdul Bej Frashëri rron. Sulltani e fali edhe e ftoi në Stambollë. Ky shenj është i mirë dhe i mbarë për Shqipërinë, dhe jam fort i gëzuar. Shkruaje këtë lajm të bukur në revistën *Fiamuri li Arbërit!*

Gazetat e grekëvet shkrojtën me gënjeshtër aq herë se Abdul beu vdiq. Kështu, në mars të vitit 1885, gazeta “La Confederation d’Orient” tha se Shqipërinë, që nga Gjirokastra e deri ndër malet e Shkodrës, po e merr Serbia; pjesën deri te lumi Strimon, Selanikun edhe lumin Aliakmon – do t’i merrte Austria; kurse Greqia do të mirrte Epirin e poshtëm pas Gjirokastrës. Kjo, gjoja, ishte lidhë në Skervenics. Të gjithë panë sot ç’njeri i vërtetë është kush e shkruajti! Të rrejtur e të turpëruar qofshin ata gjithmonë.

¹⁴⁶ *Notizia aspettata, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 9, Cosenza, 20 gennaio 1886, p. III.

*

Mësuam me gëzim, në këtë muaj, se ajo zonja arbëreshe nga Sicilia, me mëndje të ndritur, bujare dhe e bukur, me një gjuhë fisnike shqiptare, Kristina Gjentile, ishte vajzë e bardhë, e më 14 të shkurtit u martua me Gjergj Mandalò-në, një djalë i një shtëpie së madhe të Horës së Arbëshëvevet.

20 janar 1886

39. KOHA E ZGJEDHJEVE

Nëse po dalim me propozimin tonë që të heshtim për kushtet politike të brendshme, na e këshillon dhe na shtërngon koha e zgjedhjeve, që sjell me vete të mirën dhe të keqen, dhe vjen edhe një herë me vazhdimin e keqkuptimeve, burim i çdo kobi. Dhe pyesim: Mos, vallë, është ndarja e vendit në përfaqësues të së djathtës e të së majtës që, sikurse në Francë bujaria dhe shteti i tretë i *fe, me* (?), hahen për zotërimin e pasurisë qytetare? Jo; sepse vendi ka nevojë që njerëzit e ngarkuar me mandat të tij, të vëzhgojnë mirë punët dhe t'i gjykojnë planet e ministrave të shtetit, për të ndalur o ndrequr, miratuar o çmiratuar (për të mos pranuar), e jo për të hequr (mposhtur) ata ministra, duke hapur një shesh ambiciesh, kullota e fundit e së cilës të jetë administrimi e përdorimi i pasurisë publike.

Nga kjo, i pari në vargun e gabimeve që vijnë njeri pas tjetrit si me krenari, është keqkuptimi që e identifikon atë që i është dhënë mandati me atë që lëshon mandatin, dhe pasuritë e atij ia kalon në dorën e këtij.

Dhe kjo është burim (pafundësi), sepse sot bota njerëzore u jep atyre nderin që i bën të krenohen, dhe, njëherit, pasurinë e vet, sikur *ata të ishin në vend të tyre*, dhe këtë gjë e bëjnë pa rezervë, mbasi e kanë në dorë të veprojnë si u do qejfi dhe pa u kontrolluar!

Dhe si ata harxhojnë kudo jetë e pasuri të të tjerëve, pa e vrarë mendjen fare, populli e sheh, e duket sikur s'di. Vetëm sot e vren, së largu, sikur dallgë të pandalshme në stuhi që vjen, gjithnjë, duke u shtuar, ia behin njerëz edhe më të pangopur (të shterruar), që i përvetësojnë ato dhe lënë në vend të atyre ty që s'ke kurrjë. Atyre që sot janë shtruar në tryezën e qytetarëve, do t'iu duket e vështirë, por jo e padrejtë që *ata që mbetën pa trashëgim deri tani*, t'i bëjnë të ngrihen nga sofra dhe të ulen ata (në atë tryezë). Dhe këta, me vetë logjikën e vet, do të pajtohen me faktin, se ata e mbajnë me të drejtë pasurinë publike, duke ua pasë marrë atyre që vegjelia ua kishte dhuruar, duke qenë atëhere ata *zëvendësuesit* (rol-luajtësit) e vegjëlisë.

Dhe nuk sjell asnjë dobi për këtë gjendje ndjenja e mjerimit, në të cilën bie, ditë për ditë, teposhtë, mbasi, me besimin që ka humbur në të vërtetën e në zotin, votimi i përjashtëm nuk e ndjek votën e brendshme, po disa njerëz të kotë i nxisin zgjedhësit që të tradhëtojnë vetveten.

Rrugë shpëtimi tjetër nuk mbetet veçse në rastin – provania nuk duhet më në këtë mes – në të cilin të zgjedhur të jenë njerëz me mendje të drejtë e të qartë, të cilët pozita shoqërore dhe qëndrimet e hijshme t’i detyrojnë të tjerët t’i nderojnë, dhe pasuria të shtyjë (të imponojë) që të kenë frikë nga lakmitë për grabi që dalin për fushë. Këta njerëz do të mund të kuptojnë dhe t’ia kthejnë vendit (popullit) zotërimin e vetvetes [t’i detyrojnë njerëzit ta zotërojnë veten] dhe të pasurive të tyre, dhe ta forcojnë besimin dhe virtytin që e pason. Sado pak që të jenë, nëpërmjet të së vërtetës dhe të së mirës mund të bëjnë për vete shumicën, sepse e vërteta dhe e mira janë pasuri e përbashkët e të gjithëve.

20 shkurt 1886

40. LETËR NGA PALERMI¹⁴⁷

Na shkruajnë nga Palermoja:

Të dielën që shkoi, u zgjodh, këtu, përfaqësues i qytetit, Pjetër Kjara, një ujar nga Palac Adriani. E njohin mirë dhe gëzohen ata që shkruajnë në *Fiamurin le Arbërit*. Pesë katundet tona, Pëllas Adriani (Palac Adriani), Qana (Hora e të Arbëreshëve), Shën Kristina, Mexojuzi e Kontesha qenë të gjithë për të, si i pati hije.

20 mars 1886

¹⁴⁷ *Lettera da Palermo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania) Anno III, nr. 11, Cosenza, 20 marzo 1886, p. I.

41. NGA BUKURESHTI

Na shkruajnë nga Bukureshti:

“Do të bëjnë ndihma për *Fiamurin /e Arbërit/*. Në maj, brenda në salonin ku u mblodh Komiteti për lëvrimin e gjuhës, Nikollë Naçua, një shqiptar, hoq revolverin përmbi nënkryetarin, Kostandin Eftimiun, por nuk e vrau; do ta shpëtojë zot ynë. Pastaj plagosi me thikë Thanas Mborien, në kofshë, po pak e pa dëm. Tani e kanë /futur/ në burg Nikollë Naçon”.

Kjo e zënë na ka mjeruar (na ka pikëlluar, na ka brengosur), e, për më tepër, sepse nuk dimë shkakun e ndarjes (grindjes). Mos, vallë, ajo që për arsye se dikush e don shumë e dikush e don pak gjërinë (fisni, popullin) e vet?

Njerëzit e lindur ndër shtëpiat arbëreshe të Heladhës ishin përpjekur që ta zhduknin atë Komitet. Kështu mësuam se A. Pashida, një arbëresh kashte, si zunë e tundeshin fletët e Ballkanit, nga Athina shkoi në Bukuresht; dhe dyshojmë se ata që e nderojnë në tryezën e tyre, e patën dërguar andaj.

Pastaj donim të dijmë nëse ky është Nikollë Naçua, i burgosur në Sirë, vitin që shkoi, nën akuzën se ai kish shti të nipin, çnderuar prej Konsullit të Heladhës në Mansurah, që ta priste në treg e ta vriste; gjë të cilën ai djalë e bëri.

(Shih: *Fiamurin e Arbërit*, viti I, nr. 6).

20 mars 1886

42. KEMI KËTË LETËR NGA MISIRI¹⁴⁸

“Për kolerë s’flasin gjë nga Shqipëria. Por në Brindisi, e nëpër gjithë bregun e detit të Italisë, përballë detit Adriatik, janë të sëmurë; e ata që vijnë s’andejmi, nuk i duam ndër shtëpitë tona. Edhe në Shqipëri, hë për hë, ka shumë kusarë; e unë i thom Zotërisë sate: Mos e dërgo tashti birin tënd, ku janë kaq ushtëri turqish andej, sepse ata plaçkisin më keq. Edhe shqiptarët, që janë gati e të ndezur të luftojnë me grekët, gjënden endë posi njerëz pa krye /në anarshi/. Rrëmbyen kaq katunde të krishterësh, Janinën, Përmetin, Kolonjën edhe Korçën, ndërsa ishin duke ndenjor të qetë”.

E, për tani, presim të përmbushish mendimin që të dërgosh, për kënde, birin tënd të dashur. Ky udhëtim i birit tënd do t’i sjellë Shqipërisë një përfitim të madh. Të gjitha dyert do t’i hapen me mikpritje, sepse ne na pëlqen politika e *Fiamurit /të Arbërit/*: “Përkrah Sulltanit, kundër të huajvet”. E ato sa shkruan, janë të drejta. Shqipëria e tërë është me Sulltanin kundër grekëvet. Disa të pakët, ndër të krishterët e Epirit, e kanë zemrën me Greqinë; por nuk guxojnë. Muhamedanët e Shqipërisë janë atdhetarët më të mirë”.

Beni-Sueff, 3 korrik 1886
Eftim Mitko

¹⁴⁸ *Abbiamo questa lettera dall’ Egitto, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 12, Cosenza, 20 aprile 1886.

43. RETË E LINDJES¹⁴⁹

Sukseset e fundit në Lindje zbuluan shkakun përse nuk dukeshin dhe nuk thuheshin pengesat që i viheshin paqës së dëshiruar në atë pjesë të Europës që ka nevojë për qetësi, dhe përse Europa nuk mund të ishte e qetë dhe e shkujdesur për shkak të gjendjes së pasigurtë atje.

U pa si drita e diellit se ishte vetë Rusia që nuk donte të lëshonte nga dora plaçkën që pat marrë nga Turqia, e cila i qe lënë ndër dhëmbë me paqën e Shën Stefanit, por që Europa ndërhyri dhe ia rrëmbeu. Dhe ja që ajo as vetë nuk rri, as të tjerët nuk i lë të qetë, gjersa ta marrë, përsëri, atë plaçkë nga duartë e kësaj. Dhe, siç më duket, sot ajo lakmon edhe diçka tjetër. Gazeta “Moskowskya Wedemosti” e 3 shtatorit e tha haptas: “Princi Aleksandër duhet ta mbajë fjalën e dhënë. Ai duhet të verë në duartë e Carit – siç premtoi kur e mori – kurorën e Bullgarisë, që vetë cari i madh i Ruisë ia dha”.

Në pritje të çastit, për t’i hequr Turqisë një copë më të madhe dhe kështu të smadhojë peradorinë e saj, Rusia pranoi tinëz që Rumelia të bashkohej me Bullgarinë. Veçse ato dy krahina, krenare dhe të kënaqura për bashkimin e tyre, ndryshe nga ç’priste Rusia, menduan dhe deshën të jenë më vete. Dhe, për këtë faj, ne pamë mbretin e tyre të lidhur të kapet rob prej sherbëtorëve të Ruisë dhe të “ekspozohet si në një panair”.

Europa, si një trumë zogjësh të trembur, deri tashti nuk ka bërë tjetër veçse zë në erë (zhurmë në ajr).

Turqia, e braktisur, rri si e mpitë.

Austria dron se mos, në çastin e nevojshëm, Gjermania nuk do t’i jetë në krah.

¹⁴⁹ *Le nubi dell’ Oriente, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 1, Cosenza, 15 ottobre 1886, p. II.

Dhe vetë ajo /Gjermania/ gjindet ndërmjet dy shpatave. Franca, që armatohet dhe përgatitet për të rifilluar dyluftimin, i sjell në buzë një fjalë që ia tharton grykën: “Ajo në Ballkan nuk ka çka kërkon”. E lë, pra, Rusinë të jetë arrogante, dhe aspak e shqetësuar të kalojë me Francën, nga e cila përkëdhelet. Nga qëndrimi i Francës, dikur, lufta e Krimesë humbi frutat e veta dhe tash pret të prishen paktet e Berlinit. E dielli i Gjermanisë duket sikur zbehet pranë saj, dhe ka për t’u penduar që atë e ka përkëdhelur vazhdimisht.

Kështu mua më duket se ajo u gënjye (gaboji), duke vënë, me hir të Ruisë, këmbën te zverku i anës së Polonisë, aneksuar Prusisë, sepse në këtë mënyrë ka forcuar sundimin e rivalës mbi pjesën më të madhe të atij kombi fatkeq; dhe ia la Francës të shpresojë ta ketë me vete në kryengritjen që aq tepër dëshiron. Ndërkaq, askush nuk don sot të bashkohet me kushtet e Francës, dhe, nëqoftëse Poznani, sikurse Krakovia, të thithte ajrin e lirë të stërgjyshërvet, pjesa tjetër e Polonisë do t’i rrinte Ruisë “si një armë e ré në një veshje të vjetër”.

Mbetet Anglia që, nëse lordët e saj do të merrnin në dorë drejtimin e vendit, do të mund të shuante turbullimet në Europë, që sot, sa vjen e më tepër, deh mendjet e njerëzvet, duke i dhënë Austrisë, si edhe Gjermanisë, një përkrahje të fortë e të vendosur. Pas kësaj, njerëzit e krishterë do të ngroheshin, rishtaz, nga feja e tyre e lashtë, me rastin e fitores së drejtësisë. Por në Angli ata që, edhe pa gjë, u premtojnë gjetkë gjithë të mirat kombeve që t’i zgjedhin përfaqësuesit e vetvetes, edhe në Angli venë duke pasur ndër duar shtetin, e pse figurojnë ata më tepër me dinakëri dhe me ambicie që ndjekin njëra-tjetrën, atje, si gjithkund, zotërimi është bërë i luejtshëm, vazhdimisht, sipas dëshirave. E, megjithatë, sot kjo duket se po u besohet lordëve, me zërin e të cilëve merr frymë Anglia plakë, ndër duar të të cilëve nuk çahen paktet. Gjermania mbahet, sepse nuk guxon t’i besojë. Por, në paralizimin e Fuqivët të Mëdha, kjo, përsa i takon pjesës së vet, paguan, sepse duket, që janë pikërisht këto që nuk e lënë Europën të prëhet (të rrijë) e qetë, me kujdeset e vetvetes. Europa e mjerë rri e brengosur vazhdimisht, sepse do të mbytet në gjak për të mbajtur dhe për të mbrojtur djelmte e saj në ushtri, “ushtri dhe burgim”. Sot kjo i flijoi (i bëri fli), thomi, Djallit të botës Aleksandrin e pafuqishëm.

44. FRYN ERË E MIRË¹⁵⁰

Kolegji arbëresh i Shën Mitrit u hap, i riorganizuar si gjimnaz dhe si licé. Presim t'i shtohet edhe tjetër gjë, mbasi të ardhurat e fondit të tij, po të mos humbasin rrugash, do të derdhen brenda.

Tashti bujarët e Shqipërisë, e, ndër ta, të parët që e marrin vesh, ndihmëtarët e *Fiamurit /të Arbërit/*, në kanë djelm për të mësuar, t'i dërgojnë në katundin e gjakut të tyre, më mirë se në shkollat me gjuhë të huaj të Greqisë dhe të Francës. Në kapakun e së përkohshmes sonë *Fiamuri / Arbërit/* mund të lexojnë programin dhe çdo gjë që atje mësohet e me çka lahet (paguhet) dhe se si të pagëzuarit në ritin grek do të pranohen me të njëjtën pagesë sa bijtë tanë.

Para se të dërgojnë bijtë e tyre, mund të vijnë nga Shqipëria, në fillimin e vitit të ri, një bujar dhe një tjetër, që të shohin me sytë e vet shëndetin e ajrit dhe të ujit, vetëminë e këndëshme të vendit dhe bollëkun e larëminë e të miravet (prodhimeve) që ka dheu këndeje, e, mbi të gjitha, hijeshinë e zakoneve shqiptare, që endë ruhen.

*

Kemi, pastaj, ndër duar një letër–dëshmi e nevojës dhe e dëshirit, tashmë të përgjithshëm, për lëvrimin e gjuhës sonë dhe për përparimin e kombit–letër e të nderuarit bej nga Korça, të cilën ia shkruan të shkëlqyeshmit Thimi Mitkos në Egjipt.

“Sadoqë nuk e njohim njëri-tjetrin me të parë, por me të dëgjuar, jam unë që, gjithnjë, po i drejtohem zotërisë tënde, që ke qenë, dhe je, mirëbërës i madh i kombit tonë. Me gaz të madh mora vesh nga

¹⁵⁰ *Friin ajer i miir*, (Spira buon vento), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania) Anno III, nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. V.

kushëriri yt, zoti Ligor Mitkua, sa i kishnje shkruar atij për mua, sikundër edhe unë kam mallë të madh që të çkëmbejmë kartëra “për punën e gjuhës sonë”.

Me helm të madh mësuam ngjarjen (atentatin kundër) zotit Anastas Avramidhi, prej Iskariotit Nikolla Naços; por zoti i botës e shpëtoi për të mirën e gjithë kombit. Le t’i lutemi zotit, natë e ditë, që t’i zgjatë jetën për atë që nisi rilindjen e Shqipërisë.

Ndofta edhe zotrote i shkrove ato që lypsen në këtë punë për ta shpejtuar që të mos lënë prapa punën që ka nisur.

Të përqafoj me mallë, vëllai yt,

Orhan Çerçiz

Korçë, 2 shtator 1886.

15 nëntor 1886

45. KOMITETI I BUKURESHTIT¹⁵¹

Pamë se i plagosuri nuk kishte qenë Avramidhi, por një shoku i tij. E, meqenëse jemi në dijeni për këtë ngjarje të vajtueshme, duam të thomi, haptas, mendimin tonë mbi aftësinë dhe mbi efikasitetin e një Komiteti të tillë, lulëzimi i të cilit, sikurse, zakonisht, ato të parlamenteve me shumë përfaqësues, mund edhe të mos jetë gjë. Për lëvrimin e një gjuhe janë mjete tepër të pafuqishme blerja e një shtypshkronje me këto apo ato shkronja dhe caktimi shokëve dhe të tjerëve i hartimit të një libri ose të një tjetri, pavarësisht nga mospajtimet e pashmangëshme, përveç rastit të dhënë disave që të mendojnë për përfitime vetjake ose për konceptet ndonëse feminare, përveç pamundësisë për të njohur përfaqësuesit e armiqëve të veprës, të cilët ndërhyjnë për ta turbulluar ose për ta asgjësuar. Janë nxitje të rralla për ngacmim të shpirtërave atdhetarë dhe për dashurinë e gjuhës së vet, futja në dorë e sa më shumë ekzemplarëve, që të jetë e mundur, veprash së botuara nga më të çmueshmet e me përmbajtje nga jeta kombëtare, dhe përhapja e këtyre veprave me çmim të pakët për shtëpiat qytetare; dhe, së bashku, gjetja e mjetit me shpërblime të këndëshme, si në shkollat ashtu edhe në qytetet dhe katundet e Shqipërisë, që të mësohet shqipja; dhe duhet ndër nxënësit durimi i nevojshëm për të kapërcyer vështirësitë dialektore, që u dalin përpara, vazhdimisht, e më të mëdhajat në lidhje me dialektin arbëresh, që është folur nga shokët e Skënderbeut dhe që është njohur, tanimë, si dialekti më i paprishur, më i plotë, i mjaftë dhe i caktuar për t'u bërë, përsëri, gjuha kombëtare. Mos, vallë, duhet më pak durim për të mësuar frëngjishten, greqishten, etj? Në rastin e Komitetit të Bukureshtit, le të jetë ai ose vetë Avramidhi, me anë

¹⁵¹ *Il Comitato di Bukarest, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania) Anno III, nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. VII.

të interesit të pronës së tij, që ka lënë prej 100.000 lirash, interes që do të ishte për dy vjet, do të kishte blerë disa qindra kopje nga *Rapsoditë e shekullit XV* dhe nga *Bleta shqiptare* e Mitkos, ose nga ndonjë vepër tjetër e dalluar dhe do t'i kishte shpërndarë me gjykim. Në këtë kohë, do të kishte filluar të rridhte një gjak i ri nëpër zemrat shqiptare në vend të shpresave, që andej rrinë varë edhe tashti, gati për të dalë “ëndërra të sëmurish”. Do të kishin pasur mundësi më mirë të fitonin veçorinë—dhe të shiteshin me një çmim të arsyeshëm—qoftë këto tekste shqipe, qoftë të tjerë, që djepi i kulturës europiane i ka për ndër. Këto fjalë, duke u përfshirë në fjalorin e vet, në morfologjinë e vet, do të ishin përkthyer në frëngjisht, në turqisht, etj. Dhe këto, pastaj, të jepen për t’u shtypë (për t’u botuar) në dhjetra mijra kopje me alfabetin latin të Kristoforidhit, duke iu shtuar – e do të jemi ne, me këtë rast, që t’i vemë në dukje—shkronjat, me të cilat ai është i mangët dhe i pamjaftueshëm për sa i takon plotënisë fonetike të gjuhës, e duke i shpërndarë me çmim të ulët, siç vepron Shoqëria Biblike, nëpër qytetet dhe fshatrat e të gjithë Shqipërisë. Dashuria dhe studimi i gjuhës amtare si dhe përpjekjet për zgjimin (qytetërim) kombëtar do të ndizeshin kështu dhe do të përhapeshin në çdo breg, ku rreh një zemër shqiptare. Në kaq, duke e ushqyer atë ndjenjë studim dhe qytetërim (përparim), gjenialiteti hyjnor pellazg, me zulmën (lavdinë) që e shquan atë në fushë të hapur, e ku vihen në dukje virtytet e tij, do t’i shumëfishonte krijimet intelektuale, duke i vënë ato në shërbim të interesave të Atdheut.

15 nëntor 1886

46. DY FJALË PËR KOMITETET ANTIKLERIKE¹⁵²

Nga erdhi zhgënjimi i madh midis atyre të shumtëve që ose kishin, ose kanë, ose janë duke pritur të marrin bukën nga Principata (it. *Sinjoria*) që e mban Italinë të bashkuar, dhe prej andej kujt më shumë t’i bërtasin “Jeni me Çezarin dhe jo me Zotin?”. Kjo gjë besoj se dihet. Nuk dihet vetëm se çfarë solli Ora në të vërtetë dhe ç’u shkaktoi atyre kaq shumë shqetësime.

Atëherë qytetet që më dëgjuan u shastisën nga habia. Vetëm nga kjo dhe nga vërshimi nga çdo cep i vendit në të njëjtën kohë me flamuj që valëvitëshin *Trimat e Mentanës, të Mbijetuarit nga betejat e atdheut* dhe Kompanitë e tjera të ngjashme (për të pasur ndoshta tjetërsend: njerëzit lebetiten duke menduar se Përmbytja “nën të cilën kraharorët dalin në sipërfaqe” nuk pakësohet dhe as nuk pushon në Italinë fatkeqe.

15 nëntor 1886

¹⁵² *Due parole su i Comitati anticlericali, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. IV.

47. RRUGA MBRETËRORE E HAPËT PËR TURQINË¹⁵³ (RRUGA E MADHE E HAPUR PËR TURQINË)

Duam t'i thomi Turqisë, këtë herë, pak fjalë, por të drejta (të sinqerta) dhe të dobishme.

Përse rri ajo, gjithmonë, si e marrur mendësh (e zhytun në mendime), thua se parandjen, nuk di se ç'fat, edhe mbasi në Berlin i premtuan se nuk do të lejojnë t'i marrin më nga ato që i mbetën? Sepse dron se ata që i bënë premtimet, mendonin më tepër për interesin e tyre se sa për të sajën. Ata e garantuan se asnjera prej atyre Fuqive (të Mëdha) nuk do t'i ndërte dorën që t'i rrëmbente ndonjë copë, për t'u bërë kështu më e madhe dhe më e fortë se shoqet. Tashmë, kanë ngjarë edhe raste të tilla, kur Fuqitë e Mëdha, për shkak të paqës që u lypset më tepër, jo vetëm që nuk vepruan, por as nuk e çanë fare kokën.

Ato, pastaj, asgjë nuk i premtuan për kohën, në se një o më shumë krahina do të bënin orvatje që të ndaheshin prej saj dhe të rrinin zonjë më vete. Do t'i duhej asaj /Turqisë/, që t'i shtërngonte, me fuqitë e veta, të qëndronin të lidhura me të. Punë kjo e vështirë, duke u gjetur në mes të atyre shteteve që nuk kanë tjetër mendim e dëshirë, veçse të zgjerojnë kufijtë dhe sundimin me krahinat që ka në zotërim Turqia. Dhe nga çdo anë, nxitën ato krahina për t'u shkëputur nga Turqia dhe për t'u bashkuar me ata [që i nxisin]. Të gjithë e dinë këtë qëllim të keq, që u duk fill pas Kuvendit; sepse u bë dhe bëhet, paturpësisht, në dritë të diellit. Por në atë Kuvend /Kongresi i Berlinit/ qenë edhe nga ata që ia deshën të mirën; dhe i bënë gati një detyrë, duke u dhënë prëhje disa krahinave që zotëron /duke u siguruar qetësi popujve që ka nën sundimin e vet/, duke i kthyer në jetën e të parëvet

¹⁵³ *La via regia aperta alla Turchia, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 2/ nr. 3, Cosenza, 15 novembre 1886/ 15 marzo 1887, p. II.

të tyre /duke respektuar zakonet dhe mënyrën e jetesës së të parëvet të tyre/, duke mbrojtur me ligje, edhe drakoniane, fenë, pasurinë dhe kombësinë e tyre nga kopracia, lakmia dhe fodullëku i nëpunësave dhe i administratorëve të dërguar nga Sulltani, që është gjithmonë i pafaj. Porta e Lartë asnjë populli, që është lidhur me fatin e saj, nuk ia ndaloj kurrë as përdorimin e gjuhës, as mënyrën e jetesës së tij; dhe mund të ishje i bindur se, duke u kthyer atyre kombeve paqën dhe begatinë, ato do t'i qëndronin /Turqisë/ të paluejtëshme. Por, deri më sot, fqinjët nuk e lanë Turqinë t'u japë atyre kombeve autonominë.

Pozita, pra, në të cilën gjindet, e këshillon t'i lypë shpëtimin e vetvetes, duke marrë zemër nga aq të mira që ajo ka.

Ne nuk mendojmë aspak t'i thomi Turqisë se e mira e vendeve është të kenë, siç ka sot, mbase, gjithë Europa, zëvendës [administratorë], që të punojnë për të mirën e tyre. Ata, më të shumtët, shpërdorjnë për dobi vetjake pasuritë e vendeve, në të cilat janë zgjedhur. Për ata, të krishterët janë ndarë në dy pjesë: një pjesë e madhe ha nga prodhimet e tjetrës, kurse vetë s'bën gjë; pjesa tjetër bën (prodhon) por dhe jep. Është turp, është faj i madh të duan njerëzit që “disa bëhen Uni i të gjithëve”.

Ne duam vetëm atë që do çdo komb: “Një shtet më vete dhe për vete, ku të mblidhen njerëzit e një gjaku, ashtu si në një shtëpi mblidhen njerëzit e një familjeje”; të përkujdeset vetë populli për vendin dhe pasuritë e veta; dhe për grindjet e çështjet gjyqësore të brendshme vendimin ta japë vetë në bazë të ligjeve të drejta e të siguruara nga përkrahja e Sulltanit. Secili komb në luftë të ketë flamurin e vet, bujarët (krerët) dhe gjuhën e vet, përveç kur ka çështje zyrtare me Portën e Lartë: pak prisja (funktionarë) të huaj t'i dërgohen, pak të jenë të vendit, për të mos e rënduar dhe të ndëshkohen rëndë të gjithë nëse abuzojnë [mbi ligjin që u është besuar].

Por do të thonë: Përkundrazi, këta të hapur dore [këto koncesione, kjo sjellje e butë e plot lëshime] do t'i shkëputë ato kombe nga Perandoria [Osmane], së cilës duket se duam t'ia kthejmë fuqinë. Vërtet i shkëput, por dimë se fuqia sundimit nuk i vjen nga të mbajturit e këtyre vendeve me forcë, por nga dashuria dhe nga mirënjohja që ato duhet të ndjejnë për të. Ata popuj, që i mund një zot /princ apo mbret/, nëqoftëse i do të lidhur pas qerres së vet, këtë e bën që t'i njohin krenarinë e tij [Turqisë], dhe jo për t'i fuqizuar. Dhe Roma, atyre popujve që i mundëte /kur

fitonte mbi to/, u hidhte imazhinndër këmbët e shtëpiavet të tyre, për të përmbushur kësodore vanitetin e fryrë të saj; pastaj ata i linte zotër të vendit dhe të pasurisë së tyre edhe me veten e tyre; veçse të ishin të lidhur me të [me Romën] për nevojat e përbashkëta.

Dhe ia mbanin besën mirë. E Roma, porsi një lum i madh që rritet vazhdimisht prej rrëkësh që bashkohen udhës me të, u duk, pastaj, si e vetmja në dhé.

Ky po është shtrati /i lumit = i Romës/, tek i cili janë prehur ose u bindën në paqë popujt më të urtë të Europës: Helvetët, suedezët, austriakët, gjermanët, anglezët. E këto lidhje treguan, shumë herë, se nuk i trëmb gjë. Dhe në këtë lidhje, ajo dëgjon, dhe jo dje a njëditëzaj, që duan të mblidhen Shtetet e Ballkanit; por ora atyre nuk u vjen, pse mvaren prej të huajvet që janë më të mëdhenj se ata; dhe u lypset unaza e ndërmjetme e bashkimit. [Turqia ka dëgjuar prej kohe se shtetet e Ballkanit duan të mblidhen për të formuar një federatë, por ora e tyre ende s'ka ardhur, sepse varen nga zotër më të mëdhenj se ata, dhe, njëkohësisht, u mungon hallka ndërmjetëse]. Asnjëri as s'do, as s'është i lejuar të dojë që ky apo ai shok të hypë mbi timonin e qerres /të bëhet princ apo mbret i shoqatës a i Federatës Ballkanike/. Prandaj paqa, tek e cila ne shohim që edhe Porta e Lartë mund të qetësohet, është tek të mbajturit më me ngadalë të frenave të kombevet që i binden. [Prandaj, nëqoftëse Porta e Lartë dëshëron të gjejë qetësi e paqe duhet t'u japë më tepër liri kombeve që i ka nën sundim]. Kështu ajo do të mbetet unazë qendrore dhe zonjë më vete, duke pasur mirënjohjen e tyre. Dhe tjetër lidhje /Federatë/ më të mirë se ajo e saj nuk do të kishte, pastaj, kurrkund; dhe, menjëherë, do t'u çduknin të gjitha zhurmat rreth nevojave të Lindjes. [Dhe një federatë tjetër më të mirë se ajo e saja nuk do të kishte dhe, në të njëjtën kohë, do të pushonin murmuritjet rreth nevojave të Lindjes].

Pasi u muar kombevet, mbi të cilat sundon, frytin e pasurisë së tyre, Porta e Lartë bëri një faj të madh, sepse desh t'u japë të gjithëve fenë që ajo kishte e ngaha e kishte tek zoti ynë.

Këtë s'mundi, në të vërtetë, ta bëjë veçse deri në gjysëm; dhe moti vate duke ia prapsur mëndjemadhësinë dhe dëshirin e kësaj pune. [Koha ia zbuti arrogancën dhe ia ndryshoi synimin]. Edhe këto janë dy fakte të lumtura të kohës së sotme. Pse lidhja /Konfederata/ nën zotërimin e saj,

me qenë se tek ajo, mbase, janë aq të krishterë sa edhe muhamedanë, do të qetësohet mbi atë gjë, e cila, e gërvishtur, e egërsion më tepër botën njerëzore, duam të thomi fenë, ku një brez beson të lidhë tek perëndia bijtë e vet. Pas kësaj, nevoja e parë e asaj Perandorie është të heqë dorë nga puna që të ndërrojë vetëdijen e brendëshme (fenë) e atyre popujve që kanë te perëndia. Sepse ligja e vetëmbrojtjes dhe e ruajtjes së kultit të çdonjerit, do t'i ndalojë të huajtë që e rrethojnë /d.m.th. fqinjët/ të gjejnë pretext nga gjendja e turbulltë e ndonjërës – të bashkuara me të nga origjina ose nga rite liturgjike – për t'u ardhur në ndihmë e për t'i marrë nën ta. E vetë Porta e Lartë nuk do ta ketë më atë dyshim që sot e zhyt në shqetësime, se mos një ditë, pa pritë pa kujtuar, gjysma e nënshtetasve të vet me fé të ndryshme nga e saja, të shkëputet dhe të bashkohet me kombe të krishtera, që të fillojnë, pastaj, luftën kundër saj. Le të jetë, pra, kjo Qerrja e Madhe /= Ylli Polar/ e qiellit, prej nga sytë të mos priren që të mos bjerrë (humbasë) udhën.

E mbështetur në këtë drejtësi apore, Lidhja /Federata/ e kombeve, që sot janë të lidhur me fatet e Turqisë, do të ecë përpara në jetë me një fat të lumtur të dyfishtë, që nuk e ka pasur kush. Duke qenë se kombet, që ajo përmbledh, janë të vegjël si kërthi /me pak njerëz/, si ata që paraqesin teprica breznish së lavdishme – njeri pas tjetrit të nderuar e pastaj të rënë nga gjendja e mëparëshme për t'ia lëshuar orën e vet fqinjit -, duke qenë, pra, gjithëherë, në nevojë që të mbahen tek fuqitë vëllazërore nën hijen e shtetit osman, në rast se ndonjëri komb do të donte të ndahej apo të veçohet, do të mbaronte ndër duartë e ndonjë vrasësi (ambiciozi). Dhe këtë e thomi në lidhje me stabilitetin e palëvizshëm të shtetit federativ, që ne e lusim /e dëshërojmë/ të vijë. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh se kjo federatë është e vendosur rreth *Detit të Madh*, që nga Tripoli në Afrikë, nëpërmes Misirit, hapet brigjeve më të shëndetëshme të Azisë deri në Stamboll, e prej këndeje brigjevet të Trakies, të Maqedonisë, të Shqipërisë deri në Tivar, e me ishujt më të bukur të dheut, thomi se, mbi gjithë shtetet e tjera të Europës, ajo pati pasuri grurësh, dushqesh (pemësh), kafshësh me lumenj e porte të përshtatshme për lundrim e transport, e me klimë të butë e të shëndetshme, nën diell të bukur. Duket edhe tani sikur në atë gjí gjenden ende gjurma të parajsësit të tokës së parë. [Edhe sot ato vise të bukura janë përfytyrimi i Parajsës tokësore të dikurshme]. E,

mbi gjithë këto gjëra, atje, pastaj, iu dhurua njeriut pema e pasur. Atje u lindën Moisiu, Davidi, Akili, Aleksandri, Sesostri, Nabukodonasori, Kiri (Çiri), Burri (Pirroja), Muhamedi, Skënderbeu, Muhamedi i Dytë, Mehmed Aliu. Atje, po, lindën Solomoni, Homeri, Pitagora, Aristoteli; dhe, po, atje, për gati dymijë vjet – qytete dhe dinastira të fuqishme bënë gjithë historinë e botës (njerëzimit).

Nga kjo, Sulltani le të frymëzohet të marrë zemër (guxim) e t'u ndihmojë [popujve], që të ringjallen në vetvete me të njohurat dhe me pasuritë që patën të parët e tyre [që të përtërihen me shpirtin dhe dritën e stërgjyshërve të tyre]. Dhe, atëhere, çdo komb, i përkrahur dhe i besuar kujdesit të bijve të vet, që do të ketë, do të marrë pjesë në Këshillin e Divanit, jo me zëvendës [me korubër] të kësaj, por me të dërguar të vet, me armët, që do t'u lihen, do të ushtrohen, nën udhëzimet e prisavet më të shquar, të ardhur nga fuqitë më luftarake europiane. Kjo përkrahje do të tërheqë mbi Portën e Lartë simpatinë e Europës së kulturuar; dhe pranë federatës, në fushën e betejës, ajo përkrahje “të jetë shpata e mprehtë” kundër atij që do të ngrëjë dorën për ta prekur Portën e Lartë.

15 mars 1887

48. LAJME TË KËTYRE DITËVE¹⁵⁴

Na shkruajnë nga Athina: Vdiq Kullurioti, i cili shumë shkruajti për gjuhën shqipe; e, për të ndezur dashurinë e kësaj ndër aq fshatra tona, që endë gjenden në Helladhë, bëri sa mundi. Kish pasë dashur të lidhte vëllazërisht, si dikur në kohërat e lashta, në një Greqi të përtëritur, helenët dhe shqiptarët; por ata faqezez ia mbyllën shpejt “*Zërin e Shqipërisë*” dhe ata vetë e lanë më një anë.

*

Letër, pastaj, e gëzueshme na erdh prej Manastirit të Maqedonisë. Turqia, në këto kohët e fundit, dha lejen zyrtare, me anë të së cilës lejohet që, nëpër shkollat e Shqipërisë, të futet detyrimisht gjuha shqipe dhe turqishte, jo greqishtja. Autorizoi për t’u përdorë edhe librat shqip që u shtypën në Bukuresht, të cilët u dërguan në Shqipëri. Kisha greke në Stamboll po shërben dhe përpiqet që të mos marrë udhë ky urdhër; porse atje janë edhe shumë shqiptarë të fuqishëm. E më duket se me hir të zotit na u shpërblyen mundimet, e arriti dita e bardhë për gjuhën tonë.

“Anastas Avramidhi Korçari dërgoi një dhjatë (testament) nga Bukureshti në Korçë, me anë të së cilës fali njëzetepesë mijë napolona për gjuhën tonë, edhe për të tjera punëra të njerëzishme. E Dhespoti helen (*i letë*) me disa korçarë të liq e tradhëtorë të vëllezërvet, u përgjegjën se nuk e duan gjuhën shqipe, pse Krishti ka folur helenisht”.

¹⁵⁴ *Notizie recenti, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 3, Cosenza, 15 marzo 1887, p. IV.

*

Përsëri nga i shkëlqyeshmi zoti Efthim Mitko në Misir na është dërguar kjo letër:

“Tashti që qeshë në Aleksandri e në Kajro, u ndalova me qëllim, nja dy a tri ditë më tepër; fola me disa myslimanë e të krishterë për të bërë edhe këtu, si në Bukuresht, një vëllazëri (= një shoqëri) për gjuhën e prindëvet; e m’u përgjegjën fort mirë, meqenëse u dha, pastaj, urdhëri i Derës së Lartë. Por shqiptarët e këtushëm gjenden, o vëlla, shumë të shpërndarë; e harxhi (shpenzimi), për të rëndur pas tyre, është më i madh, mbase, se ajo që njeriu mund të marrë mbi vete. Por, megjithatë, kam shpresë të bëhet një gjë e mirë edhe këtu”.

15 mars 1887

49. KUJDESI I TRISHTUAR I SAVE JEMI SOT¹⁵⁵ (KUJDESI PLOT TRISHTIM I GJITHË SA JEMI TANI)

Qëndrojnë me duar në dorëz të shpatës dhe presin se kush, më parë, po i turret (po i sulet) për ta shpallur fajtor për kërdrinë, në të cilën u nxitën të gjithë. Dhe unë e pranoj që Franca nuk don luftë sot; pranoj që Gjermanisë nuk i mungon asgjë që të armatohet; mendoj se edhe Rusia ka qenë fyer nga një shtet i krijuar prej saj, dhe, me qëllim që ky t'i bëhet i respektueshëm, ajo nuk ka më punë me askënd. Nga ka lindur, pra, shqetësimi i sotëm? Shkëndija e parë e zjarrit lindi nga që Rusia e zboi princin Aleksandër nga Bullgaria, kur nuk kish më ndonjë të drejtë në të. Dhe, në se qëndrimi i rreptë i Fuqivet, të mbledhura në atë pakt në Berlin, do ta kish frenuar arrogancën (fodullëkun), me të cilin ajo merrte nga ajo dhe të gjithë për Zotin, zjarri do të ishte shuar, që në ndriçimin e parë!

Është, plotësisht, e vërtetë se ajo mund të kish përgjegjur: Po ju si e latë dje atë burrë të mirë të cënojë atë traktat dhe, një mendjeje me Bullgarinë, e tërhoqet dhe e bashkuat (shtuat) edhe Rumelinë? Megjithatë, këtë shkak, atëhere, askush s'e kujtoi; vetëm përpara fodullëkut të Ruisë ata qëndruan jo të një mendjeje. Dhe tash që Gjermania deshi, përkundrazi, më fort miqësinë e Ruisë e paqën, se sa të shkojë pas qejfit të Bullgarisë, le të shohim sot ku po i shpien erërat atë paqë e atë miqësi.

Dhe do të donim që ajo të kishte mendjen, se jo Bullgaria, por përçmimi i besimit publik, në të cilën është mbështetur shoqëria njerëzore, është në lojë në këtë çështje. Dhe, atëhere, si do të shpëtonte me të gjithë prej ngatërresës së tanishme më i lehti.

¹⁵⁵ *La cura trista di quanti or siamo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 3, Cosenza, 15 marzo 1887.

Kurse, po të shikonte ajo shpatullat për mbështetje të së drejtës Austrisë, Turqisë e Anglisë, të cilat i fyen të parat cenimi i pakteve që Rusia bën, kjo ose do të tërhiqej duke u pajtuar, dhe të gjithë do të mund të merrshin, rishtas, lirisht frymë, o do të fillonte luftën dhe në atë do të ishte mirë që të ishte vetëm. Dhe, përkundrazi, po që se Franca do të hynte në luftë për ta ndihmuar, edhe ajo do të dilte besëthyesë së bashku me të, dhe do të tregonte se, tashmë, nuk donte, në të vërtetë, paqën, por priste rastin (kohën e përshtatshme). Dhe, atëhere, ardhte drita prej së larti e ndriçoftë këshilli i Zotit.

- Askujt më tepër se Shqipërisë s'duhet t'i interesojë që ajo të zgjidhet sipas drejtësisë, mbasi që Greqia ka premtim nga Franca dhe Mali i Zi nga Rusia se do t'i ndajnë si plaçkë në mes të tyre fiset (tributë) shqiptare; dhe të dyja janë armatosur për t'u ndenjtur përbri patronëve të tyre.

15 mars 1887

50. FATKEQËSI (MJERIME) SHQIPTARE¹⁵⁶

Pas grindjes që i ndau dy pjesësh shqiptarët e Bukureshtit, na ra ndër duar një letër e Nikollë Naços, për shkak të të cilit u tha se u bë ajo fatkeqësi. E, prej andej, pamë se të gjithë ata që ishin atje, donin bashkë të mirën e atdheut, por nuk di ç'djall, i cili ka aq vite që e keqpërdoron të nëmurën mëmën tonë, bën punë që të zbrazë vullnetin e mirë të perëndisë, në të cilin ajo ka besim. Në atë letër pasqyrohet aq thellë shpirti shqiptar, i rrjedhur prej nevojësh që e tërheqin nga të gjitha anët, sa na duket, - e duam të tregojmë një pjesë, - si shënim i përsosur i orës drejt së cilës shkojmë:

“... Po mësoni edhe për të ngjarat e këtushme të Shoqërisë. Me shumë zahmet (= mundim) çalltisa (= u përpoqa) deri sa ta sjell më udhë të mbarë që të kuptojnë nevojën e kombit tonë, edhe u mblodhën (u mbluadhën) më të shumët; por filo-grekët na vunë intriga për të na prishur, pse e dinë se gjuha jonë është vdekja e tyre. . .”.

“Greku e sheh që, në rast se shqiptarët do të zgjohen e do të shkruajnë gjuhën tonë, fiset tona arbëreshe, që gjenden të shpërndarë ndër ta, do të zgjohen prej gjumit; e, në numër, janë të shumët; më trimat i kanë me vete; të fortët, në dorë të shqiptarëve gjenden; edhe dyfeqet i kanë. Sot ata janë të strehuar në mbretërinë e Greqisë, nesër do të mblidhen në Shqipëri. Kush mund t’i mbajë? Prandaj ata /d.m.th. grekët/ kanë kuvenduar /kanë ra në godi, në ujdí, në marrëveshje/ me Serbinë, me Malin e Zi, etj. Këta /d.m.th. serbët/ të marrin Prizrendin, kurse Karadaku /Mali i Zi/ të marrë Shkodrën; ndërsa zotni greku të marrë Janinën. Ky është hesapi, /kjo është llogaria e bërë prej tyre/, këto janë nevojat dhe rreziqet; e Greqia ua bën udhën të tjerëvet. E, kështu, të gjithë bëhen gati të na hanë neve. E unë i lutem Zotit të mos bëhet luftë për dy vjet, sa të ngjallemi edhe ne; se, në u bëftë lufta tani, jemi të humbur ne dhe Turqia; por të përpiqemi që ta bëjmë gjuhën të shkruar, dhe në Filat /në viset arbëreshe të Greqisë/ të dërgojmë botime shqipe për t’u përdorur nëpër shkollat.

“... Në Shoqërinë /e Bukureshtit/ intrigat qenë bërë me qëllim që të sundonin /të urdhëronin/ pak njerëz; e, pastaj, me qenë se s’përgatitej

¹⁵⁶ *Psuame Shkijpe* (Fortune albanesi), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 4, Cosenza, 15 aprile 1887, p. VI.

gjë shpejt, duket se donin ta lënin punën prapa në heshtje, deri sa të vinte greku. Po unë më mirë të vdes se sa ta shoh kombin të ndarë e të humbur. Ja, shkuan dy vjet e gjysmë qëkurse u themelua Komiteti, dhe asnjë fletore (gazetë) nuk vajti në të mjerën mëmën tonë, që nga kjo pret gjithë të mirat, edhe nderin. E nga se? Nga se jemi të verbër, e verbëria na solli ndarjen; e ndarja u dha guxim maceve të lidhin luanin për ta hëngër (për ta ngrënë)? Unë vetë, nga që pashë se atje gënjehej Shqipëria, u zura me ta, deri sa rashë në burg.

Tani, unë me ca shokë, bëra një Komitet të ri, më 9 janar 1887, edhe vura njerëz të mëdhenj; edhe, me emër të Zotit, do të vemi përpara; e, shpejt, do të vete në Shqipëri me një fletore (gazetë) shqipe që të merren vesh me armiqtë e kombit tonë. Njëri nga kryetarët, V. A. Urequa, që është senator e që ngjalli gjuhën vllahe në Maqedoni, më thotë që të sjellim djelm dhe çupa shqiptare që të mësojnë shqip e vllahisht, për t'u kthyer, pastaj, me titullin e mësuesit në Shqipëri.

Kur të keni kohë të volitshme, dërgoni këtu një njeri, që të shohë të vërtetën e punëvet”.

II.

Ndërsa në Shqipëri duan e s'gjejnë udhën, nga të bijtë e shpërndarë nëpër viset e huaja vete duke iu përtëritur asaj jeta. Një tjetër gazetë, motër e kësaj të Kalabrisë, ka sot gjuha shqipe në Sicili. Kur pamë, në këtë organ, të rrëfyer me gojën e dliërë që ka vetë ajo, vasha zonjë Kristina e Mandalojt, njerën nga përrallat tona, kujtuam lëvdatën që na dha një i ditur polonez (një dijetar polonez), i Universitetit të Vjenës, Jan Hanusz, në të cilën thotë: “Tek përrallat arbëreshe gjenden po ato modele që ndeshim edhe gjetkë, por të paraqitura e një formë që nget (prek) zemrën vetvetiu”. Ky “*Arbëri i Ri*” na gëzoi vërtet. Ata që gjetiu thuhet se kanë pasuri, caktuar për ringjalljen e Atdheut tonë, përse nuk blejnë nga këto fletore (gazeta) për t'i shpërndarë atje, dhe të zgjojnë shpirtërat dhe mendjet e njerëzvet të mëmëdheut tonë? Për shkak të alfabetit? Po do të ishte për të qeshur, kur të gjithë né, përderisa mundëm të formojmë një Kongres bashkë, përdorim shkronjat *pro manibus*, siç bëjmë me një petk për stinën e tanishme.

U thomi, pastaj, dy zotnive të gazetavet: Bëni keq ju (ju veproni keq), duke ndryshuar dialektet e tjera dhe duke i njësuar me tuajin, si, p.sh., ndër artikujt e Serembes dhe të Kinigoit. Kështu bënte Kamarda; po me ç'tru? Në qoftë se këtë zakon ju do të mbanit edhe në gjuhën e Varibobës, kush do t'ua falte përdhunimin e marrë?

15 prill 1887

51. Ç'I LYPSET SHQIPËRISË¹⁵⁷

E para nevojë e saj është ajo e mbrojtjes së ligjit [organizimi gjyqësor për zbatimin e drejtësisë]. Atje /në Shqipëri/ sot dërgohen kadilerë të huaj, lakmues parash [ryshfexhinj], si gjithë njerëzit e rëndomët, për të cilët lumturia apo mjerimi i vendit s'është gjë fare [nuk mendojnë aspak për gjendjen e shkretë të vendit]. Ata gjithmonë, mbajnë lidhje me familjet më të pasura që munden, nga të cilat kanë përfitim në të holla dhe në kënaqësira të tjera. Prandaj, edhe shtëpiat më të mira [familjet më të shquara] janë të tërhequra [të shtyra] të vrasin dhe të marrin [të rrëmbejnë] nga të tjerët, jo aq për lakmi se sa për shpirtin e tyre koprac [për natyrën e tyre fodulle]. Familjet e ofenduar [e lënduara, e dëmtuara], pastaj, duke mos pasur shpresë në mbrojtjen e ligjëvet [të drejtësisë] mundohen të marrin hak me an të bijve të tyre të rinj. Për këtë arsye, u bë zakoni i moçëm të duan gjak për gjak, petk për petk, aq sa njerëzvet të largët (të huaj) vendi u duket si i egër, ndër pyjet e të cilit gjenden luanë të këqij.

Thonë se sot është zakoni i jetës shqiptare që secili nga né të bëjë, ligjin e vetvetes [d.m.th. se shqiptari e ka bërë zakoni vetëgjyqësorin]. Jo, kjo nuk është e vërtetë; por kjo është nevojë e domosdoshme për të, sepse i lypsen gjyqtarët [një gjendje e tillë është shkaktuar nga mungesa e drejtësisë]. Gjatë atyre muajve që Lidhja e Prizrendit mori ndër duar fatet e Atdheut, pasi vari nja katër o pesë kusarë, o ndryshe njerëz të liq (kriminelë), Shqipëria jonë u pa një vend qetësie për ndonjë vit. T'u kthehet, pra, bashkatdhetarëvet ligja [e drejta] për të gjykuar njerëzit e gjakut të tyre. Pleqët [kryetarët e familjeve], të

¹⁵⁷ *Di che è bisogno all' Albania?*, *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 4, Cosenza, 15 aprile 1887, p. I; *Po aty*, nr. 6, Cosenza, 15 agosto 1887, p. II; *Po aty*, nr. 7, Cosenza, 15 novembre, 1887, p. I.

zgjedhur me short, dhe që janë po të atij vendi ku është kryer faji, ata ta bëjnë gjyqin përpara syve të qytetarëve të mbledhur grumbull. Ata vetë, pastaj, të përkratur nga vullneti i mirë dhe i drejtë i Sulltanit [të japin vendimet], sepse vetëdija e së vërtetës dhe e së drejtës nuk është shuar kurrë në gjirin (shpirtin) e krijesës njerëzore; e, më shumë se gjetkë, në Shqipëri dhuna dhe padrejtësia më e ulët rëndojnë mbi frymët e popullit dhe e bëjnë jetën shumë të trishtuar. Pastaj të veprohet rreptësisht sipas ligjeve, duke i ndëshkuar me bjerrjen e pasurisë ose të jetës të gjithë ata që vrasin e vjedhin, si edhe gjyqtarët që abuzojnë dhe marrin rufshfete.

Por, derisa njerëzit t'i vihen kësaj pune burrash, populli duhet të jetë i qetë, të ketë gjithë vetëdijen dhe zotërimin e vetvetes në mes të një fryme bashkimi dhe vëllazërie të gjerë. Kjo u kërkua edhe në Prizrend, por pabesia e të huajve, duke e shfrytëzuar këtë qëllim të lartë, e vonoi plotësimin e kërkesës. Ne thomi se Shqipëria duhet të jetë e bashkuar brenda kufijve që ka pasur gjithmonë, në një pashallëk të vetëm të përfshijë Shqipërinë, Epirin dhe Maqedoninë, ku, në pjesën më të madhe, janë nga gjaku ynë dhe flasin gjuhën tonë. Nën një Bejlerbej, që Sulltani dërgon sipas dëshirës të vet, krerët e zgjedhur të së tri atyre krahinave të jenë shqiptarë; nën patronazhin e tyre ligji, drejtësia qytetare, të zbatohet qetë e pa pengesa, sepse erdh koha që Sulltani ose t'i bjerrë (t'i humbasë) ato krahina, duke u përpi nga fqinjët mizorë [të pabesë dhe lakmues] ose, që t'i shpëtojë, ashtu siç bëri Austria me Hungarinë, t'ia besojë Besës Shqiptare. Nga ana e vet, Shqipëria sot s'ka mbrojtje tjetër gjëkund [rrugë shpëtimi], përveç se tek Porta e Lartë. Në Këshillin e Divanit duhet të marrin pjesë bujarë të dërguar atje si përfaqësues nga ato krahina, me një numër të barabartë, sa të krishterë aq edhe muhamedanë, si edhe nga komunitetet e huaja që ndodhen atje. Haraçi, ashtu siç gjëndet sot, të ndahet këtu pjesë-pjesë për çdo krahinë. Pleqësitë, të mbledhura për këtë punë, ta ndajnë haraçin për çdo komune, dhe komunet për çdo shtëpi, sipas një norme të drejtë, të caktuar nga Divani. Kushtetuta ose organizimi për caktimin e haraçit, pastaj, duhet të jetë ligja e parë e këtij bashkimi për Shqipërinë. Një haraç i ri nuk duhet t'i vëhet popullit me asnjë mënyrë, pa marrë pëlqimin e dy të tretave të pleqëve të kombit (të krerëve ose të kryetarëve të familjeve). Sepse, shpejt, ndër shtetet e botës ajo lloj

begatie që ndryshon sistemimin e jetës, ose ajo lloj nderje (lavdie) që kumbon gjer në brigjet më të largëta për emulacione të çmendura, do të mbetet si ëndërr të sëmurish. Dhe, sot, Europa mendjelehtë vë pasurinë e saj në duartë e disa njerëzve të prishur [të shthurur e të liq], ndërsa të mirët janë të pakët. Prandaj dergjet nga varfëria dhe nga vuajtjet [katandisur si mos më keq]. Pastaj, me ç'arsye? S'është kryetari i shtëpisë (familjes) që bën e jep nga e tija, por ata [të shthururit dhe të liqtë] shpenzojnë nga pasuria e përbashkët, ashtu sipas qejfit të tyre. Pikërisht, ky është shënji i vërtetë i servilizmit të marrë.

Dua të arsyetoj, me pak fjalë, se për ç'arsye ne s'kemi besim se mund të dalë gjë e mirë nga Përfaqësia, sepse thomi se Shqipërisë i vjen më mirë [i përshtatet më tepër] që çdo fis i saj të ketënjë zot të vet [një sundimtar të dalë nga gjiri i tij], se sa të gjitha fiset të sundohen nga një sundimtar i vetëm, edhe sikur ky të jetë i zgjedhur në mes të tyre.

Përsa i takon tezës së parë, çdo zotërim, qoftë ai i mbretit apo i bujarëve, në rast se ata [mbreti dhe fisnikëria] nuk sundojnë kë mundin me armë [me forcë], ka qenë gjithherë dhe mbetet në dorën e përfaqësive të qyteteve, të zgjedhura që në fillim. Këto përfaqësi, a pleqësi, zbatojnë ligjin [drejtësinë] për të gjithë që andej. Ndryshimi është vetëm këtu se përfaqësuesit e sotëm mund të mos jenë ata që qenë dje; pikërisht, siç shohim të shkuemit e atyre që janë zgjedhur nga mbreti apo nga fisnikëria. Po, ç'është të dalë nga ky fat i përbashkët? Edhe pse u përzunë ata që qenë të liq, të nxjerrurit e tyre mb'anë nuk i shëron të këqijat që kanë mundur të bëjnë, sado që bota mund të marrë frymë lirisht e të ketë një farë kënaqësie, duke qenë e çliruar nga mëria dhe zilia e atyre që e kishin shkretuar. Ajo [bota] po i sheh të hedhur [të kallur tutje] ashtu siç hidhen bërsitë në rrugë të madhe.

E vërteta ndryshon në këto. Nëqoftëse Përfaqësuesi është një i vetëm, ai nuk mund të sillt keq [nuk ka mundësi të ushqehet vazhdimisht me urrejtje a të bëhet arrogant], ndaj një shumice që ai as nuk e njeh. Të emëruarit prej tij, veçanërisht ata që gjenden larg sysh të tij, shumë herë me kopracinë dhe kryelartësinë (kapadaillëkun) e tyre i bëjnë të vuajnë ata që kanë fatin e keq t'u jenë afër. Princi vetë këtë gjë as nuk e do, as nuk e di. Ajo që mund ta bëjë atë të keq, është frika, dhe kjo, gjithashtu, mund ta përmbajë, duke e parë ai veten të vetëmuar. Në rast se do të sundojë një aristokraci, pikësëpari ajo do të lëmojë (do të mbledhë)

hijeshinë e urdhërit të vet [para së gjithash, ajo do të ruajë sedrën e shtresës së vet]; dhe e ndjen veten të fyer, kur njeriu varet nga kuleta e huaj [e ndjen veten të ofenduar nga mvartësia materiale e të tjerëve]; dhe kështu, si rrjedhim, ajo do pak, ose nuk do fare nga vegjëlja [nga shtresa e ulët e popullit]. Megjithatë, ajo aristokraci, me përbuzje krenare, i rëndon ata që e rrethojnë, dhe përkrah njerëzit që lëvdojnë arrogancën e saj dhe i shërbejnë asaj. Por turma e përfaqësuesvet tanë i ka të gjitha ato të meta, dhe nuk e dij në ka ndonjë virtyt. Pjesa më e madhe e tyre, mbasi mbahet në konsideratë të pakët dhe është nevojtare, kur nis detyrën e vet, ka për synim të parë të përulet e të përkëdhelë shtëpiat më fisnike dhe të pasura, me të cilat ka afrim fisi, dhe tregon një dëshirë plot ankth për të mbushur arkën e shtetit, që i bën të kapardisen, dhe nga ku, më vonë, kanë për të nxjerrë fitime për vete. E, pastaj, gjithkund sundon rrena [gënjeshtra, mashtrimi], me të cilën ndihmohen që të mos bjerrin (të humbasin) vendin e tyre tek tryeza e shtruar.

E kaq mjafton nga përfaqësuesit.

Një nevojë tjetër është që fiset e Shqipërisë të jenë të lidhur nga gjaku dhe nga gjuha, me të cilat i ka bashkuar zoti, dhe jo nga fuqia e ndonjë zotërimi të një qytetari (bashkatdhetari) a të huaji. Kjo është një domosdoshmëri e caktuar nga vetë tiparet e përbashkëta që kanë si fis më vete. Në gjiun e mëmëdheut tonë, krenaria e shpirtëravet nuk do [nuk duron dot] që një shtëpi (familje) e vetme të sundojë mbi gjithë të tjerat; dhe feja e ndryshme nuk lejon që i krishteri të qëndrojë i qetë nën një princ muhamedan, ashtu sikurse muhamedanët nuk mund t'i nënshtrohen një zoti (sundimtari) të krishterë, kur si njëri dhe tjetri të mos jenë të dërguar të posaçëm nga Sulltani, të cilin e nderojnë së bashku. Prandaj le të rrijë (të mbetet) çdo fis i mbledhur (i bashkuar) nën bajrakun e bujarit të vet (nën drejtimin e një bajraktari të vet), të dëgjojë pleqët e vet. Veç kësaj, bashkimi i Shqipërisë, Epirit dhe i Maqedonisë, do të zgjonte mjaft shpirtin (vetëdijen) e kombit, do të bënte lidhjen tonë. E, me qenë se ajo /Shqipëria/ është e vetme në shesh të hapët, do të dëgjonte shpejt këshilla gjarpërinjsh për t'u ndarë nga Porta e Lartë Osmane, që sot ia mban jetën të veçantë [ia ruan personalitetin me karakteristikat dalluese si një komb më vete]. Dhe Turqia, pastaj, duke dyshuar në ndonjë kundërshtar të vetin, armik të ardhshëm, nuk do të qetësohej [nuk do të bindej me fjalën dhe me

botën që do t'i jepte Shqipëria], nga besa e saj, as nuk do të vazhdonte të dukej dhe të ishte dashamirëse, siç është sot me të.

Mbasi të kemi vënë këto përpara, një nevojë tjetër për Shqipërinë është përjashtimi i bijve të saj nga shërbimi ushtarak, nga e cila gjë nuk përfiton të mësojë as përdorimin e armëve, por kënaqet që është e zonja ajo vetë t'i dërgojë Sulltanit, për shumë muaj, bijtë e vet [lulen e rinisë], i cili i përdor si bashibuzukë, kur i lypen. Ndërsa nga kjo, ajo dhe bijtë e saj, në pamje dhe në fuqi, u përngajnë luanëve, por që, prej së largu, mund t'i plagosë edhe biri më i plogësht i një gruaje. Kush desh, në Kuvend të Berlinit, që të përsëritej ai privilegj, bëri t'i priste flokët (u duk sikur i preu krifën), që të mos fitonte më nga rregulli dhe disiplina ushtarake atë siguri krenare. Shqipëria, megjithëse e vogël në numër dhe e vetme, nën udhëheqjen e Aleksandrit dhe të Skënderbeut, i mundi të gjithë ata që i dolën përpara shpatës së saj;

Por, mbi të gjitha, Shqipërisë i lypset arsimit, që, pas disa ditësh, do ta çlirojë prej duarvet të huaja. Me qenë se patëm përdorur, për mot e mot, gjuhën e huaj në të shkruar, ne s'patëm dhjatë urtësie (trashëgim kulture) dhe vullneti të së parëvet tanë; dhe e patëm ndërë veten, gjithmonë, rob të së tjerëvet që na dhanë gjuhën e shkruar. E, për katërqind vjet, para se pushtimi i turqëvet të mblidhte shtëpiat tona në atë lidhje që habiti mbarë botën, etërit tanë, duke luftuar për italianët e Napolit, për grekët e Fanarit e deri për disa aventurierë francezë, përgjakeshin, vobegësoshin (varfëroheshin) dhe qëndronin, gjithmonë, skllëvër të fatit të të huajvet. Sot që ato helme (mënxyra) i lexojmë tek *Historitë e Tajani-t*, që i qiti në dritë, zemra na copëtohet nga që ata kërkonin, vazhdimisht, lumturinë, dhe e fitonin, po jo për veten e tyre, por për të huajtë. U mungonte atyre gjalmi i dhuruar i kombeve për lumturinë: përdorimi i gjuhës së vet, ashtu siç është për familjet dashuria në mes të pjesëtarëvet.

Më fatlumtur jemi ne sot, duke parë se po lind dashuria për gjuhën tonë, dhe po e lëvrojmë sipas hijeshisë që i ka falë natyra. Në Stambollë kemi sot një shtypshkronjë, nga e cila dalin, ditë për ditë, botime në gjuhën shqipe për shkollat fillore të djelmëvet tanë, që priten të çelen. Në gji të Shqipërisë ngrihet, përherë e më e madhe, vala që e shtyn tutje punën e huaj, e cila e lodhi (mërziti) me përpjekjet e saj për ta asimiluar. Ajo ka bujarë (krerë) të vet në Rumani, e, dëgjuam, edhe

në Athinë, që u lidhën me besë për ta përtëritur dhe për ta përdorur gjuhën tonë. Në Itali, ku u strehuan aq zotërinj shqiptarë, mbasi pafuqishmëria u ndryshku atyre shpatat ndër duar, - se prej kah u frymëzuan atje; nuk e dimë, - e vetme, jehoi, për së pari, gjuha jonë. E, tani, e shohim si të ndezurit e hollë të fillimit të një zjarri të madh. [Kjo na duket tashti si një shkëndijë e vogël e një zjarri të madh që, sapo, ka filluar]. U gjetën atje, e fill pas, këngë të lindura në gjë të mëmëdheut tonë, te moti që atje ishim të gjithë bashkë, të cilat pasqyrojnë epopenë e lartë të jetës fisnike dhe të lumtur, që donin të na e shuanin. [Këtu gjinden këngë të lindura në gjirin e mëmëdheut, në kohën kur banonim atje të bashkuar, një epike ku pasqyrohet lartësia e një jete fisnike e të lumtur, dhe që sot përpiqen ta shuajnë në shpirtin tonë]. E plot dashuri për atdheun çeli gjethet atje një poezi, nga e cila Europa u tërhoq, u pruar e i vuri ré gjërisë që ka atë gjuhë, e së cilës moti nuk ia grisi hijeshitë e orëve të lumtura. /Aty lindi një poezi plot atdhedashuri, për hër të së cilës Europa i kushtoi vëmendjen kombit me një gjuhë aq të shquar, dhe së cilës koha nuk ia prishi atë bukuri që kishte në kohët e saj të bardha/. Sot aty /në Itali/ kemi një të përkohëshme me uratën e zotit tynë, ajo ka vetëdijen se është *Flamur* i panjollë i shqiptarëve të çdo krahine. E deri në Egjipt, prej kah jehoi në veshët e Shqipërisë e para borë që thërriti bijt e saj të ngriheshin për nder të Atdheut, kjo e përkohëshme ka ndihmëtarët e vet.

Por, përmbi gjithë këto fate të reja, erdhi kujdesi i Sulltanit, i cili, me qëllim që t'i veçonte shqiptarët, zemrat e të cilëve rrahin njëzëri me të, nga armiqtë e tyre që i rrethojnë, desh një qytetërim të tyre që t'u zhvillonte cilësinë (veçorinë) e lindjes dhe gjuhën e tyre të posaçme; prandaj ka vendosur të hapë shkolla me këtë gjuhë ndër të gjitha viset e tyre.

Mbetet, por, që këto të dhëna, këto fuqi dhe vullnete të bashkërenditen, në mënyrë që të ndihmojnë njera tjetrën, e të përgatisin autonominë e dëshëruar të të menduarit dhe të të jetuarit të kombit tonë.

Kësaj pune, që të zehet, i lypset, përsëri, të dashurit mirë të Sulltanit të madh, për t'ua vënë detyrë krahinave shqiptare të mësuarit e gjuhës së tyre, derisa t'i dhurohet, si shpërblim dhe hakmarrje, ndër viset ku ka shkolla greke, me të hollat e caktuara këtyre. Ç'është ky fodullëk

i grekëvet që i detyrojnë shqiptarët të mësojnë gjuhën e tyre, të cilën asnjë nuk do që ta dijë!

Por asgjë nuk e pengon këtë bashkim fuqish të shpërndara, sa largësia pa rrugë komunikacioni, dhe të gjeturit, përgjithkrah, në mes të grekëvet, një pengesë e keqe që bën të na ndajë edhe më tepër, aq sa – veçanërisht për në që kemi detin ndërmjet – të mos shihemi me njeri tjetrin. U lypsen mësuesa shkollash viseve të Shqipërisë, e disa mund të shkonin prej këndej /nga arbëreshët e Italisë në Shqipëri/, por nuk dimë sa do të shpërbleheshin, ç'do të gjenin, e, prandaj, varem tërë dyshim. Mund të vijne nxënës edhe në Kolegjin tonë [arbëresh], këtu afër; por, siç po venë /po shkojnë/ ngjarjet e reja, jam ndërduzash për një këshill të tillë, dhe, për më tepër, sepse këtu kanë filluar të zotërojnë këshilla të huaja. Unë qeshë ftuar të shkoja vetë /në Shqipëri/, e të shihja e të njihja gjendjen, që nga Stambolli e deri në Shkodër, por pleqëria dhe të mosditurit se si do të jem i pritur, më mënuan (= më mbajtën në vend). Ishin, mbase, këto disa gjalmëra që nuk e di deri kur do të mbajnë të lidhur nye.

15 prill 1887;
15 gusht 1887;
15 nëntor 1887

52. DISA SHËNIME¹⁵⁸

Për t’u shënuar, ndër të tjera, /është/ përpjekja e lëndëve të gazetës / së përkohëshmes/ sonë për t’ia përhapur lajmet e saj, siç vepron e rëndësishmja *Revista e të përkohëshmeve*, që botohet në Berlin. Duam t’ua vemë në dukje lexuesve tanë disa shënime të saj në një artikull të tanishëm:

Fiamuri Arbërit (= Flamuri i Shqipërisë). Viti II, nr. 10.

Fletë tejet (shumë) e çmueshme dhe tërheqëse për të gjykuar mbi shqiptarët përkundrejt grekëve. Një “besojmë” (një kredo) e vërtetë e botuesit, është një letër e gjatë, drejtuar Çezar Kantusë, dhe shtypur nën tekstin; mbasi Kantu, në një letër drejtuar autorit, kish treguar se ai kish imagjinuar, që në moshë të re, se, shteti i tyre më i mirë i përbashkët, do të ishte një Greqi, në të cilën Shqipëria të ish shkrirë me të. Heronjtë e çlirimit të Greqisë, përgjigjet De Rada, qenë, në pjesën më të madhe, shqiptarë (Boçari, Xhavella, Makri, Odiseu, Miauli, Tombazi, Karaiskaqi, Kondurioti, Gura, Bobolina, Bulgari, etj.); ky komb /ekziston/ dhe gjuha e vetë atij flitet gjithënjë edhe sot në një pjesë të madhe të Greqisë së sotme; ndërkaq grekët i kundërvihen çdo zhvillimi të mësimin në këtë gjuhë, duke shprehur opinionin se do të sillte pasoja të rënda për helenizmin në se “krijimi” i një gjuhe shqipe të shkonte mbarë. A do të mund të dëshërohej kështu që veriu i vendlindjes, vendbanim kryesor i shqiptarëve, t’u hapej grekëve? Dhe, në se në ndonjë vend nuk njihen veprat e tija, duke lexuar këtë letër njeriu e ndjen veten të prekur nga madhështia e mendjes dhe e zemrës së këtij rithemeluesit të gjuhës poetike shqipe.

¹⁵⁸ *Disa shënime* (Alcune note), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 5, Cosenza, 15 maggio 1887, p. V.

Nga veprat postume të Xhuzepe De Radës, bir i Jeronimit:

Dhjetë strofa popullore–të tjera do të vijnë pas–prej dy o tri vargësh njëmbëdhjetërokëshe, që ato këngë mbrëmjeje të tingëllojnë sa të dëgjohen edhe së largu, si shigjeta të lëshuara, si të thuash, nga një bregore, në sa dy i përgjigjen njera-tjetrës. Aty njoftohet se disa nga ariet kombëtare që u përkasin atyre vargjeve janë për t’u vënë në nota nga një zotni gjerman, Emilion Reinhold, profesor muzike në Gjimnazin e Koriljanos, për t’u ruajtur, sikurse fjalët e tyre nëpërmjet shtypit janë shpëtuar nga shkatërrimi. Shembull: “Bajame e ëmbël! lum ai që do të të shijojë! unë i mjeri duhet të nisem e të të lë”. Mund të thuhet se, më tepër se ndër mendimet, magjepsja ndihet dhe qëndron në gjuhën e në tingëllimin, etj.

15 maj 1887

53. NJË MEMORANDUM¹⁵⁹

Gustav Meyer thotë për shqiptarët e sotëm, siç vërtetohet prej tij nga një memorandum: “Që bashkimi i Shqipërisë me Monarkinë Austro-Hungareze ishte konsideruar në mendjen e tyre si një gjendje kalimtare. Austria duhet t’u japë atyre /shqiptarëve/ të mirat e kulturës, e, kur të ketë krye punën e saj, duhet të shkojë /të largohet nga Shqipëria/. Është e vështirë, pra, që misioni ynë duhet të konsistojë në bërjen /përgatitjen/ e mësuesve të shkollave të përkohëshme për kombet e huaja, derisa këto dalin jashtë tutelës”. (Shih: “*Arbëri i Ri*”, viti I, nr. 2).

Kush janë këta që i lypin /ndihmë/ Austrisë e ku? E me çfarë vizatimi (projekti) Profesori i Gracit merr përsipër vendet e kësaj, e, me një paganizëm dorështrënguet, i lejon ata?

Disa gazeta të Parisit, kur doli *Fiamuri Arbërit*, lajmëronte Italinë që të lakmonte Shqipërinë, e, për ta tërhequr këtë, të themelonte nëpër Ngulimet /Kolonitë/ tona /arbëreshe/ një gazetë shqip. Por né nuk dinim gjë për ambiciet e Italisë, as kjo nuk e ndihmoi kurrë organin në fjalë, që qe vetëm i mëmëdheut dhe i Ngulimevet /Kolonivet arbëreshe/; as, pastaj, për një botë të tërë, ne do të kemi qenë, me dobi për të tjetërkënd, të pabesë ndaj kombit për të cilin jemi bij.

Është e vërtetë se Shqipëria, kur qe ngusht, nuk iu drejtua as Austrisë, as Italisë, as kurrkujt tjetër, armët e të cilavet t’ia ndërronin samarin; madje as popullit të tij të shumtë që ka mbetur nën Greqinë, dhe të cilit çarllatanizmi grek ia ka bërë shpirtin budalla. Ajo /d.m.th. Shqipëria/ u drejtohet e u kërkon /ndihmë/ bijvet të vet, që janë të shpërndarë nëpër Rumani, nëpër Egjipt, etj., që të ngrejë krye; e, më tepër (mbi të gjitha, kryesisht) ka besim e shpreson ndër Ngulimet /

¹⁵⁹ *Një memorandum* (Un memorandum), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, nr. 6, Cosenza, 15 agosto 1887, p. II.

arbëreshe/ e asaj të Italisë. Këto kanë bërë dy Kolegje që iu dhuruan atyre nga Papa, kryetar i fesë së tyre; e ai i Shën Adrianit, në veçanti, i hapur, me këtë caktim (shënim): “*në të cilin do të mësojnë (do të rriten) djelm dhe të rinj prej Epirit, por edhe nga mbretëri të parashikuara për tokët përkëtej Farit të lindjes*” (*in quo pueri et adolescentes ex Epiro, at que in regni praedicti terris citra Pharum orti, alantur*).

Tani që asnjëri nuk i mbetet për të parë, e qoftë edhe në Itali, kurrnjë fener ndriçues që rrezaton prej së largu njëj popullsie të pikëlluar? Çfarë kanë për të parë, në qoftë se mbledhin ndër shkollat tona bijtë e Nënës sonë të paharrueshme, e cila nuk ka shkolla? O do të kenë “syrin e keq për atë që Italia do të jetë e mirë” me né, të cilët i ushqen toka e saj, qielli i saj dhe mendimi i saj, e, së bashku me të të ndihmojë ndër këto Kolegje mësimin e Katedrës shqipe të krahasuar, mbrojtëse e një populli, të cilin ajo e strehoi me mundime të mëdha dhe s’e pat ndarë, pastaj, kurrë nga fatet e veta? Ajo nuk bën gjë tjetër veçse t’i japë ndershmërisht një dorë miqësore Zotit të madh, që don ta ngrejë mbi themelet e gjuhës kombëtare Shqipërinë e vet, që e kanë mëri, sepse i është besnike. Nuk bën tjetër veçse t’i nxjerrë në pah vetes, në mënyrë fisnike, nderin për të rindërtuar – dhe ajo mundet vetëm – gjuhën shqipe, që është një nga më të moçmet gjuhë europiane. Kjo është e mirë dhe e denjë për të.

15 gusht 1887

54. MURGU (MUNGARI, KALLOGJERI) PANHELEN I KORÇËS¹⁶⁰

Na shkruajnë nga Berati

Është njollosur me turp emri i Abramidhit (Avramidhit) (vate i çnderuar emri i tij); e nuk gjëndet njeri që në skëterr (ferr) të dojë ta ketë pranë. Kallogjerin, që i futi kalamiten, e njoha unë, pse këtu punoi peshkop, para se të shkojë atje. Nuk ka, ndoshta, njeri tjetër më antipatik dhe më të neveritshëm se sa që kjo shëmtimë (ky njeri i shëmtuet). Fanatik dhe rob, në shërbim të pabesësië (të tradhëtisë) së helenëve, me qënë se e pat braktisur e shnderuar Abramidhin (Avramidhin), kish pasë varur në qafë kryqin e shëlbuesit (kryqin e Shën Salvatorit). Dhe ky, që të mos bëhesh monedhë e djallit, ia preu udhët; ndërsa djalli deshi ta mashtrojë e ta tërheqë prej apostullatit të tij të paqës e të dhëmbshurisë, mes vëllezërve të bashkuar, në kishën e vet; kështuqë futi grindjen, dhe, mbasi i ktheu kundra nënës së vet të shkretë disa faqezezë (njerëz të pandershëm), të cilët u bënë tradhëtarë në dorë të tij, i bleu me pará (me të holla) qeveria helene. Dhe ai pati fatin që e bëri (e krijoi) vetë. Pse, mos është e rreme ajo që rrëfëhet (tregohet, kallëzohet), e këndeje e dëgjoj nga çdo anë (nga vise të ndryshme), ai, mbas jo shumë vitesh nga mkati i bërë kundër Shqipërisë dhe zotit Krisht, që zënë (rrëmbyer) nga disa kusarë (hajdutë), të cilët, mbasi e varfëruan (e grabitën) më parë, pastaj e vranë dhe e prenë thela-thela.

15 gusht 1887

¹⁶⁰ *Il monaco panelleno di Corcia, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, nr. 6, Cosenza, 15 agosto 1887, p. VII.

55. NA SHKRUAJNË¹⁶¹

më 20 korrik 1887

Në Bukuresht u përsërit me të madhe mbledhja e shqipëtarëve me emër të ri “Dituria”. Naçua mbeti jashtë pa shokë. Po kështu, edhe Avramidhias nuk do të dijë. Ky është njeri i pakulturë e i trashë sa nuk njih të mirat e revistës *Fiamuri Arbërit*. Shkolla në Korçë u hap pa atë. Tani duan të marrin në dorë edhe pasurinë e shkollës së madhe që është atje; e për këtë vajtën e u ankuan në Konstantinopël, tek po gjykohet. Në qoftë se shtijnë në dorë shkollën e madhe, atëhere gjuha jonë ze vend këtej. U hapën shkolla edhe në Ohër, në Starovë e në Rresh. Pse nuk vjen edhe ndonjë mësues nga ata tuajt që të themelojnë shkolla, sidomos në Berat e në Kavajë, afër Durrësit? Po le të kemi durim dorë për dorë.

15 gusht 1887

¹⁶¹ *Na sheruanjën ndë në oo të Corricut 87* (Ci scrivono a 20 di Luglio 87), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania) Anno III, nr. 6, Cosenza, 15 agosto 1887, p. I.

56. NE DUAM NJË SHTET MË VETE E PËR VETE

Më fajësojnë se unë për jetë po shkëputem nga e ardhmja dhe se nuk po kujdesem /për fatin/ e sotëm të popullit tonë. Por fati i të parëve mbeti i varrosur me ta; për të sotmen jam në kujdes sikurse edhe të tjerët; as nuk më shpëton ajo që, kush të mundë Turkinë, do të shkelë mbi ata, të cilët e mbrojtën më tepër; kështu Plevnën e ndoq humbja e tokës shqiptare nga Tivari në Shkodër. Për këtë arsye (prandaj), po të vazhdojmë ta mbështesim qenien tonë tek Turkia, duhet që kjo të jetë e fortë. Dhe, mbas ngjarjeve të Armenisë, të Kretës dhe të Maqedonisë, ndërjegjia ma ven si detyrë urdhëruese që t'i parashtroj atë që shpirtit tim – i cili në të don të mirën e kombit të vet – i duket si limani i vetëm i shpëtimit të përbashkët.

Ka sot shtete që nuk kanë mendim dhe lakmi tjetër veçse të shtohen në shtrirje dhe në sundim me vendet e Turkisë; dhe u fryjnë, nga të gjitha anët, atyre krahinave për t'i detyruar që të shkëputen dhe t'u jepen atyre. Të gjithë e dinë se ky qëllim mendjekeq u shfaq fill pas Kongresit të Berlinit, sepse veproi dhe vepron, haptas, me pafytyrësi. Prandaj dikush, në atë Kongres, i desh të mirën, dhe ia vunë detyrë që t'u jepte qetësi popujve të ndryshëm, që sundon, duke i kthyer në jetën e të parëve të tyre me ligjë, qofshin këto drakoniane, duke iu mbrojtur besën, pasurinë dhe kombësinë nga lakmia dhe nga kotësitë krenare të të dërguarve tek ata për të zënë vendin e Sulltanit, /që, duke qenë Turkia një shtet i pafuqishëm, i dobët, është/ gjithnjë i padëmshëm (d.m.th. nga dobësia e tij si shtet nuk arrin t'i bëjë dëm kujt).

Gjendja, pra, në të cilën është, e këshillon t'ia kërkojë shpëtimin vetëvetes, duke marrë zemër nga të gjitha ato pasuri që ka.

Nuk na shkon ndër mend t'i thomi se, qenia më e mirë e qyteteve, është në pasuri, siç e ka sot e gjithë Europa, të Zëvendësve që veprojnë për

to. Prej këtyre, shumica mendon për vete dhe me pasurinë e porositesve edhe popujt e krishterë për to janë të ndarë në dy pjesë: njera me numër më të lartë ushqehet me prodhimin e tjetrës dhe nuk prodhon, /kurse/ tjetra bën dhe jep. Turp tepër i madh, faj tepër i madh, kur njerëzit duan “që disa bashkëkohës të tyre të bëhen *Uni* i të gjithëve”.

Ne duam atë të vetmën gjë që don çdo komb: një shtet më vehte e për vehte, ku të mblidhen njerëzit e një gjaku si familjet në shtëpinë e vet, duke pasur kujdesin e vendit të vet dhe të të ardhuravet të tija dhe që, për ngjarjet dhe bashkëujditë në tokët e tij, gjykimi t’i mbesë atij, sipas ligjeve të drejta e të qëndrueshme, nga mbështetja e Sulltanit. Secili /komb/ në luftë me flamurin e vet, me bujarët dhe me gjuhën e vet, përveçse në marrëdhëniet /zyrtare/ me Portën e Lartë. Të dërgohen pak prisja të huaj dhe pak të jenë të tij, për të mos iu rënduar, dhe të gjithë të dënohen, në mënyrë të pamëshirëshme, në qoftë se i shmangen detyrës /rrugës së drejtë/.

Por do të thonë: kjo gjerësi (kjo shtrirje) do t’i shkëpusë nga Perandoria, së cilës duket se po duam t’ia kthejmë forcën. Po, i shkëputë, por dijmë se forca nuk i vjen Sundimit duke i mbajtur ato me detyrim, të lidhura pas tij, por nga dëshiri i tyre që t’i duan të mirën. Roma, çdo popull që nënshtronte, e linte zot të vendit të vet, por duke e pasur nën sundim të saj, vetëm që të ishte i bashkuar me të, në rasë nevojë të përbashkët. Dhe, po, ia mbanin besën. Dhe si lum i madh, që rritet, vazhdimisht, nga lumenj të tjerë /të vegjël/, që e arrijnë gjatë rrugës, u duk, pastaj, /Roma/ si e vetme në sipërfaqen e tokës.

Qetësia (pushimi), në të cilën shohim se mund të gjejë paqën Porta Osmane, qëndron në lirimin e frenave të popujve që i binden, duke mbetur ajo vargova dhe sunduese e tyre, mirënjohëse dhe të nënshtruara. Dhe Federatë tjetër, me fat më të mirë se kjo, nuk do të ketë kund, dhe, njëheri, do të shuhet shamata për rreth nevojave të Lindjes.

Një faj i rëndë i Turakisë /qe kjo/ se desh t’u epte të gjithave besimin (fenë) që ajo kishte, dhe nga e kishte, në Zotin.

Këtë vepër, në të vërtetë, nuk mundi ta kryente, veçse për gjymës, dhe ka ardhë koha që ia ka kufizuar krenarinë dhe qëllimin për të. Dy fakte që mbesin si dy lumturi të kohës së sotme.

Sepse Konfederata nën Sundimin e saj, - mbasi janë po aq të krishterët sa /edhe/ muhamedanët, do të kishte mënjanuar atë që e preku

nga fyerjet, - e ashpëron më tepër dheun njerëzor, duam të thomi, fenë, tek e cila një brez beson të lidhë në Zotin bijtë e tij. Mbas kësaj, nevojë e parë e asaj Perandorie është që të heqë dorë nga përpjekjet që të ndërrojë me mjetet e saja ndërgjegjen e brendshme që kanë për Zotin-At popujt që i dorëzuan vehten e tyre.

Kurse (ndërsa), duke qenë i mbrojtur edhe i ruajtur kult i vet për secilën dhe kështu, të mbajtura së bashku në paqë, do t'i ndalojë fuqitë fqinje që të marrin shkas nga gjendja e paqetë dhe e ndrydhur e ndonjerës – e lidhur me të nga origjina ose nga ritet liturgjike – për t'i ardhur në ndihmë dhe për ta tërhequr ndaj vehtes. Dhe Porta e Lartë, edhe ajo vetë, do të lartësohet, duke pushuar dyshimi që sot e mban në një kujdes plot travajë, ndoshta jo në ndonjë ditë të papritur, pjesa e shtetasve të saj, me besim (me fé) të ndryshëm ndaj të shkëputet dhe të gjejë strehim ndër popuj të krishterë, që mund të hyjnë në luftë, ndonjëherë, me të.

Të jetë, pra, ky ylli polar i qiellit të saj, tek i cili do t'i drejtohen sytë për të mos humbur rrugën.

E mbështetur në këtë barazi (urtësi) atërore, Federata e krahinave, që sot janë të lidhura me fatet e Turakisë, do të përparojë në jetë, e përkrahur nga një fat i mirë i dyfishtë, që s'e ka kush tjetër. Qyshse kombet, që ajo do të përfshijë në të, janë me pak njerëz, sikur ato që teprojnë nga mbeturinat e popujve të lavdishëm – njëra dhe tjetra sundimtare e nderuar e vendit dhe, pastaj, e zbritur nga shkalla për t'i lënë kohën e saj fqinjës – dhe, pra, me nevojë të vazhdueshme që të mbështetet tek forcat shoqe, nën hijen e Shtetit Osman. Ndërsa secilës, të shkëputur dhe të izoluar, çfardo ambiciozi do t'i vente dorë mbi të. Dhe kjo, përse i përket qëndrimit të palëvizur të Shtetit Federativ, që ne kërkojmë dhe urojmë të jetë kështu. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se si ajo Konfederatë gjindet e vendosur për rreth “Detit të Madh”, që nga Tripoli në Afrikë, nëpër Egjipt, shtrihet tek brigjet më të shëndetëshme të Azisë, duke u rrotulluar deri në Stamboll dhe, prej andej, nëpër brigjet e Trakisë, të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, deri në Tivar, me ishujt më të bukur që ka toka, thomi se, përmbi shtetet e tjera të Europës, asaj i mbetet pasuria e drithërave, e bimëve (e pemëve, e drujve), e grigjeve, në mes lumejsh dhe limanesh, përçues pasurish (begatish, të mirash), e ajr të shëndetshëm, në dritën e diellnave mirënjohës. Edhe sot duket se si në gjirin e atij vendi të na mbetet e përfytyruar gjurma e parrizit të

hershëm të tokës. Pastaj aty, mbi të gjitha këto sende, është e pajisur, në mënyrë të pasur, bima Njeri. Këtu kanë lindur Moisiu, Davidi, Sezostri, Semiramide, Nabukadonozari, Kiri, Aleksandri, Pirroja, Muhamedi, Skënderbeu, Muhamedi II, Mehmed Aliu; këtu /kanë lindur/ Solomoni, Homeri, Pitagora, Aristoteli dhe këtu, për rreth trimijë vjet, qytete dhe dinasti të fuqishme bënë të gjithë historinë e njerëzimit”.

1896

57. ASNJË BESIM NË GREKUN!

Ajo që kërkohet nga mendje të çrregulluara dhe ndër sheshe të qyteteve, copëtimi dhe fundi i Perandorisë Otomane, do të thotë sot copëtim dhe fund i Shqipërisë. Vazhdojnë të konspirojnë, duke përfituar nga lufta ruso-turke për t'i hequr nga një gërshërë secili rreth saj: Greqia, Mali i Zi, Serbia kanë futur në dorë që prej asaj kohe qytete e krahina të Shqipërisë.

Perandoria otomane europiane është e përbërë sot nga pak turq, bile nga hordhitë pushtuese dhe nga popuj të pushtuar.

Vënia në kundërshtim e të krishterëve me turqit bazohet në vetë intrigën *triviale* të gënjeshtreve. Sot për Krishtin as punohet, po as mendohet më; dhe besimi në Mohamedin tani nuk është i dëmshëm as për të largëtit, as për të afërmit; dhe llafazanët dhe ata që fshehen nën këtë besim, nuk kanë njohur kurrë as Krishtin, as Zotin, të pazotë si ç'janë për t'u ngritur në atmosferën e tyre. Nuk ka më të krishterë e mohamedanë, si grekë e turq, po janë në fushë fisi *pellazgjik (shqiptar) dhe fisi helenik me rreth e përqark bushtra të thara që ndihmojnë*.

Sot është bërë e qartë që një erë pellazgjike qe mbyllur në Greqi nga vërshimi helenik, vërshim i cili erdhi mbi shtresën e pavdekshme prehistorike. Kjo përzierje e dy popujve që edhe sot e kësaj dite e gjejnë aty udhëtarët, ekzistonte që në kohët e Platonit, që e përmend. “*E madhe, (tha ai) është Greqia, në të cilën ndodhen edhe njerëz me vlerë të madhe dhe me një prejardhje barbarësh*”, etj. (Fedoni, Kap. XXIV).

Po pjesa e kombit shqiptar, e mbetur jashtë shtypjes helenike, errësoi, nën Filipin dhe të birin e tij Aleksandrin, çdo lavdi të helenëve dhe, ndoshta, koha do ta sqarojë ndonjëherë, nëse pak apo shumë nga burrat e mëdhenj të Eladhës qenë nga fisi prehistorik i bashkuar me fatet e saj.

Ajo që tashti është e qartë për historinë, është se në ditët tona çlirimi i Greqisë nga pushtimi turk qe bërë dhe qe fituar nga burra të vlefshëm të fisit origjinal, nga shqiptarët si Ali Tepelena, Boçari, Xhavella, Olliseu, Miaulis, Kondhurioti, Karaiskaqi, etj. ; kështu helenët që në krye u dhanë atyre emrin e gjyshërve, u rilindën në mbretëri.

Po pak i është njohur Europës Perëndimore se si pastaj heleni u shpërbleu me zili të zezë atyre shokëve të vet të luftës, të pajisur më mirë nga natyra.

Shpërblimi i parë dhe kujdesi që i shqetësonte, që të mbysin gjuhën e tyre.

“Polingenesi” i Athinës, më 1884, shkruante nga Epiri:

“Në javën e kaluar erdhi në Gjirokastrë albanofili Athanas Kullurioti, Athinas, i cili pat ndërmend të themelojë, brenda në Athinë, një Komitet për lëvrimin e gjuhës shqipe, dhe këtu ka vënë në shitje në abecedar shqip. Ai filloi të flasë për komb si dhe të përhapë idë shumë të pamenduara. Cilido u habit për një gjë të tillë që nga qendra e shpresave tona, nga Athina, (ku pak vjet përpara kishin djegur në shesh “Bletën shqiptare” të Thimi Mitkos) kish ardhur këtu një njeri që emërohet grek, përhapës i atyre ideve, të cilat ne i luftojmë me të gjitha fuqitë tona që mos të zënë rrënjë në Epir”.

Konfederata e Lindjes, e botuar në Athinë më 1885, shkruan:

“Kemi dëgjuar me habi e keqardhje se në Bukuresht është themeluar një Komitet për lërimin e gjuhës shqipe / . . . / lindja e kësaj gjuhe nuk tregon tjetër veç shkëputjen e shqiptarëve nga ne / . . . / as tërë ata miliona që kemi marrë hua për të ndërtuar me nxitim hekurudha, nuk vlejnë më për fatet e larta të Eladhës, në qoftë se ndër shqiptarë do të zinte rrënjë ky plan për një gjuhë më vete”.

Pra, që kur u ndaluan shkollat në gjuhën shqipe, asnjë libër shqip nuk u duk në mbretëri për 70 vjet.

E, meqenëse nuk vleu asnjë masë dhe bijtë e Shqipërisë, të shpërndarë në Turqi e nëpër çdo anë të detit, vunë në pah gjuhën e tyre dhe u botuan prodhime letrare të tilla, sa në tre e katër vjet kur të shtypen e të dalin në dritë, Helenia, nuk do të mundë më ç’t’u vërë përballë dhe duke menduar se do ta ndihmonin shtetet ballkanike për copëtimin e Shqipërisë, filloi luftën e çmendur.

Meqenëse ajo ka shtruar çështjen: o njërin ose tjetrin nga të dy fiset, nuk i ngel tjetër fisit pellazgjik, veçse t’i mbështetet Turqisë. Dhe është për të uruar për një organizim të Perandorisë Otomane ndër ato krahina që lakmohen nga të tjerët; që nga Nili në Arabi deri në Tivar t’u venë përballë një Federatë paqësore dhe të fuqishme atyre shteteve tradhëtare që duan ta përmbysin.

15 mars 1897

KREU V**VEPRA HISTORIKE-AUTOBIOGRAFIKE (1885–1902)****A U T O G R A F**
(1885)**A U T O G R A F**¹⁶²

/Poeti Jeronim De Rada i shkruan M. Marchianò-it, në Paola/

Maki, prill 1885

I dashuri kushëriri im Mikel,
Po të mos njëfshit ngushticat (vështirësitë), në të cilat gjindem, dhe si,
pa zbardhë dita e deri me dy orë natë, merrem, çdo ditë, gjithënjë me
punë pa rëndësi, nuk do të dinit me saktësi këtë sakrificë që bëj për
dashurinë që kam për ju e më detyron.

Ju e dini se prej çfarë shtëpie unë rrjedh nga ana e babait. Shtëpia ku
unë banoj, ishte e Markianò-ive të parë dhe u trashëguua nga nëna ime.
Xhaxha i babait saj qe Françesk Avati, mbledhësi i parë i *Rapsodive*
Shqiptare, i cili vdiq rreth vitit 1800 në Urbino, kur ishte aty profesor
universiteti (d.m.th., kur mbante katedrën e Urbino-s – J.K.).

Isha fëmijë në kohën kur cubënia, porsa e shuar, i linte familjet e
pakta të fshatit të zatetura nga urrejte të mëdha.

¹⁶² Michele Marchianò, *Un Autografo del Poeta Albanese Girolamo de Rada intorno la sua vita*,
Trani Tipografica Editrice Vecchi e C, 1909.

Babai im ishte profesor në Kolegjin arbëresh, ndërsa gjyshi im, deri në vitin 1823, herë i ndjekur si partizan i Muratit (d.m.th., i ndjekur si muratist), herë i burgosur, qe dërguar, me urdhër, në Kozencë, dhe unë vetëm me nënën rritesha kënetave të lira, në grindje të vazhdueshme me fëmijtë e cubave armiq, dhe i mundja (ua kaloja).

Kur u bëra shtatë vjeç, babai më mori me vehte në Kolegjë, por mbyllja këtu më sëmuri dhe, për tre dimëra, u ktheva i sëmure në shtëpi, për t'u rrahur, përsëri, e në sulme me gurë, e, për këtë arsye, nënat e shkreta britnin vazhdimisht. Por edhe në Kolegjë nuk mësoja gjë, mbasi nuk dija asnjë fjalë italisht. E si të xeja (të mësoja) ato që nuk kuptoja? Mbas tri vjetësh, kur fillova të kuptoj "*Selectae Veteris Testamenti*" ("Pjesë të zgjedhura të Dhjatës së Vjetër"), u rihabilitova në një farë mënyre.

Në vitin 1825 vdiq, duke lindur, nëna ime në moshë shumë të re. Babai im u detyrua të linte Kolegjin, për t'u marrë me drejtimin e shtëpisë, dhe unë, kështu, solla shtratin tim të vogël në dhomën e përbashkët. Këtu edhe në orët e *argëtimit* (të rikrijimit), ose kur isha në pendesë (i ndëshkuar), ose qaja, ose lexoja çdo libër që mund të kuptoja prej Mbretërve të Francës dhe deri tek përpjekjetpër të kuptuar Tasson. Këtë e desha kaq shumë sa që, pas një viti, po të më thonte kush vetëm një varg, unë isha në gjendje t'i tregoja (copën) së cilës i përkiste vargu dhe koka më ishte mbushë me trimëritë e luftëtarëve të tij. Së bashku me këtë, për të përdorë atë pak latinishte që dija, fillova me lexue, në meshën e mëngjezit, pjesën historike të Ungjillit, gjithmonë i dhënë mbas Jozuhit, Gedeonit, Davidit, etj. U shtova librat e asketikëve italianë, deri sa kur mbërrita moshën trembëdhjetëvjeçare, gjendja e trishtuar shpirtërore si jetimi, jetimllëku melankolik e hiri i veçantë i Zotit shkaktuan një ndryshim të madh në shpirtin tim. Urrejtja të metat e mia, rashë në gjunj para Zotit me lutje dhe agjërime (krezhëm), dhe, mbas pesë muajsh, mbasi bëra një rrëfim të përgjithshëm, fillova t'u bëj shokëve të mij konferenca fetare dhe ua ndryshova mendet. Në muajin e majit, Eprorët e mi vinin, gjatë *argëtimit*, me ndëgjue mbas derës së kameratës (klasës), ku kush këndonte psalmet, kush thonte rruzaren, kush dëgjonte leximin e librave të shenjtë; vetëm rallë (pak ditë) e hanim mishin në mensë. Por, duke u marrë tërësisht me punët e fesë, lashë mbas dore latinishten dhe greqishten në shkollë. Edhe në dy muajt e gjysë të pushimeve verore u largova prej të luturit. Në vitin e ri shkollor, më çuan te

mesatarët, gati më çuan pa asnjërin nga shokët e mi. Këtu u prita me mjaft ftohtësi, dhe i prekur në sedër nga fyemjet e një shoku të klasës, dhe i fyer botërisht në klasë nga mësuesi, fillova të nxë (të mësoj) pa u lodhur lëndat shkollore, saqë arrita të bëhem i pari i shoqërisë (kryetari i grupit të kameratës, i dhomës apo i sallës së fjetjes e të studimit). Në kohën e Pashkëve u barazova në shkollë me Seremben dhe me Mauron, që ishin katër ose pesë vjet më të mëdhej se unë; dhe ishin ndër *të mëdhejtë* (në kameratën e të mëdhejve).

Porse unë, përmbi të gjitha, përfitova nga një miqësi e pastërt, e ëmbël dhe e zjarrtë, që dashuritë e mëvonëshme që më rrëmbyen përjashta, nuk mund e arritën (nuk vlenë tjetër). Me mikun tim, ndër orët e lira, në shëtitje, veç, lexonim klasikët italianë, atë çka mund të gjenim nga Stael e Chateaubriand, e sidomos veprat e Ciceronit *De Officiis* e *De Amicitia*, dhe ishim të lumtur dhe princa të kameratës. Për më tepër, unë edhe krijoja, duke u provuar në çdo gjini proze e poezie; ndërsa miku im, më i vogël në moshë, nuk mundi të bënte po kështu.

Këto qenë dy bekimet që solla me vehte nga Kolegja (Konvikti): ndjesia e pashlyer për Zotin dhe parfumi i një dashurie qiellore.

Pas vjetësh që qëndruam bashkë, familja e dërgoi në Kozencë në studion e Luigi Grekos, i afërm i tyre; unë shkova te mesatarët. Për këtë arsye, për tri vjet me radhë, mbasi nuk u kujdesa për të sunduar mbi shokët nuk desha /tjetër/ veçse të njoh dhe të hartoj. Nxuna/mësova/latinishten, mesatarisht greqishten, mitologjinë klasike dhe, jashtëzakonisht, matematikën. Dhe, ndërsa mërrita me nxjerrë rrënjën katrore me 23 numra, hartoja dy poemtha të vogla italisht, njerin me rimë treshe (strofë treshe), kurse tjetrin në vargje të lira, për të cilat do të flas më vonë. Kështu, i përgatitur (me këtë kulturë), dola në moshën 18-vjeçare nga Kolegji. Vjetin e ardhshëm, mblodha *Rapsoditë Kombëtare*, dhe dashurova një nimfë (nymfë) fshatare. Prej këtyre dy burimeve, vitin pas, lindi *Milosao*.

Mbetshi me shëndet (të jeni shëndosh) dhe do të keni dhe të tjera. Kushëriri juaj,

Jeronimi

Mbasi u largova nga Kolegji, doli numri i parë me thirrjen në shërbimin ushtarak, dhe na u desht me vu një *zëvendësues* (bedel). Nga shpenzimet e bëra, dhe dëshira që të pushoj një vjetë në fshat,

vetëm mbas një vjeti im atë lejoi që pas një viti të shkoj në Napoli. Atë vit e kalova duke studiuar, duke u marrë me jetën fshatare dhe me dashurinë e parë. Në *Fiamurin* kam treguar si mblodha shumë rapsodi dhe si hartova *Milosaun*.

Mbasi shkova në Napoli, në nëntor të vitit 1834, duke mos ditur të flas mirë italisht (duke ditur të flas pak italisht), për një ndrojtje që nuk mund ta mposhtëshe, nuk vlefta gjë nër shkollë, dhe kjo e shtoi (e ndihmoi) kundërshtimin tim ndaj fakultetit të drejtësisë (ndaj ligjit ose së drejtës), por nuk munda të qetësohem ta flej mendjen për të mos u bërë asgjë. Në mars të vitit 1835, u paraqita te Torelli, i cili prej tri vjetësh botonte *Omnibus*-in. Për gazetën e tij i ofrova tri poezi të mia shqip; atij i thaçë se i kisha mblledhë nga populli. Ai u ngrit më këmbë dhe më shtrëngoi për gjoks: Edhe ai vetë ishte arbëresh. Të nesërmen në mëngjez, në një artikull të vogël njëzet rreshtash, flitej për takimin tonë si për ndonjë ngjarje me rëndësi dhe në tre numra radhazi u botuan poezitë, të përkthyer në prozë. Dhe unë fillova të shijoj lavdinë.

Në qershor po të këtij vjeti, më njoftoi Emanuel Bidera, arbëresh prej Sicilie, mjeshtër recitimi dhe libretist, që më desh, pastaj, si babë. Atij i recitova disa idile të *Milosaos* dhe e shihja se i ndritnin sytë nga gëzimi; filloi të më bënte të njohur ndër rrethet e miqëve të tij si një që po ngrihet në qiellin e poezisë, dhe deshi (kërkoj) që të dërgoja në shtyp (për botim) poemën e vogël. Të hollat për botim m'i dërgoi im at, ndërsa miku i vjetër më gjeti botuesin (shtypshkruesin) dhe, së bashku me mua, qortonte bocat. Për librin folën me dashamirësi dy ose tri fletore (të përditshme) dhe u gjetën dakord (dhe përfunduan njëzëri) se ishte një poezi me fytyrë (paraqitje) të re.

Porsa ishte botuar libri, u përhap kolera, prandaj në nëntor, lashë Napolin dhe u ktheva në fshat, ku fillova përsëri, dashuritë dhe poezinë arbëreshe. Çdo javë shiheshim me Domeniko Maurin dhe s'mbaronim kurrë së foluri për artin. Për çdo muaj i çoja të lexonte disa përkthime këngësh heroike, që unë i hartoja gjatë pushimit, dhe gjithmonë nën tingullin monoton të kitarrës ose të fyejvet kombëtarë, që u binte im vëlla, deri sa më lodhej frymëzimi.

Se si unë u ngatërrova në lëvizjet politike të vjetit 1837 (e prandaj m'u desh të fshihem në shtëpi gjatë gjithë vjetit 1838) dhe se si u shkrova me gradën e kapitenit në *Italinë e Re*, mendoj se e kam rreshtue në shënimin

nekrologjik për Mauron. Ndër ato dy vjetë, që janë më të plotat e jetës sime, hartova *Vantisanën*, *Agatën e Pravatës*, *Adinen*, *Imotoen*, *Maria Kominiaten*, *Natën e Krishtlindjeve*, *Videlaiden*, *Miloshinin*.

Njëkohësisht, interesohesha edhe për punimet bujqësore (në lavrimin) e tokave të babait. Dhe nga kjo, mbas dhjetë vjetësh qëndrimi në Napoli, munda të mos e trazoj çerdhen time të lindjes dhe të nxjerr nga bujqësia atë që më duhej për jetesë.

Mbasi ktheva, kahë fundi i vjetit 1838 në Napoli, hyra si/praktikant/ i ri në studion e Rafael Konfortit. Merresha vesh me Benedikt Musolinon, kolonel i *Italisë së Re*, dhe u përpoqa ta fryj stilin tim, të cilin Mauro, me një kritikë urrejtëse, e krahasonte me ngamjen e një kali. Më dëmtoi edhe Lamartine, që e mora si model. Për mënyrën e re të /të hartuarit apo të të shkruarit/, të shkëputura nga mendime të bashkangjitura (nga idé aksesore), është si shembull poema *Serafina*, botuar në vjetin 1843.

Në vjetin 1840, më burgosën, për arsye politike, ndërsa babain tim e vunë nën mbikqyrjen e policisë. Kur dola nga burgu, e pashë se m'u pré karriera ligjore (e së drejtës, e drejtësisë) dhe m'u pakësuan edhe ndihmat nga familja /në fjalë/. Por Zoti më hapi shtëpinë e Dukës Spiriti, ku hyra si mësues i birit të tij të vetëm. M'u duk se gjeta paqë, dhe u dhashë i gjithi mbas shqipes (iu kushtova krejtësisht gjuhës shqipe), duke e konsideruar këtë si një mision.

Do të ju përmend edhe një herë, mëshirën që pat për mua, nëna e Zotit, dhe nuk do ta shpie më në baltën njerëzore atë fuqi qiellore.

Mbasi u bëra edukator tek Duka Spiriti, pushova së ecuri prej mëngjezit e deri në mbrëmje, kështu ndryshuan edhe orët e punës dhe cilësitë e ushqimit; kur pasdreke nuk shoqëroja familjen në teatër, shkruaja (hartoja [me zorë] një tragjedi të sforcuar, i shtyrë nga dëshiri i zjarrtë për t'u bërë, me të shpejtë, i përmendur; përkundrazi humba shëndetin. Mbas dy javësh, një mëngjez pështyra gjak (qita gjak për goje). Megjithëse mora gjak disa herë, në fillim të mojit tjetër, ky fenomen i trishtueshëm rifilloi, duke m'u përsëritur në mëngjez; megjithatë nuk e ndërpreva punën, porse pasdreke bija në shtrat me ethe dhe dhëmbje në shpatull, së bashku me të kisha pagjumësi dhe djerse.

Së fundi, u trondita shumë për humbjen e shëndetit tim aq të mirë. Në mëngjezin e ditës së tetë, kahë ora gjashtë, kambanat e Napolit

filluan të binin për festë, ndërsa në një kantinë, nën dhomën time, gjajdexhitë vixhjanëz luanin për festën e Zonjës së Papërlyer. Duke pasur të njëjtin besim, u çova nga shtrati dhe shkrova në vargje shqip, një lutje, të cilën, mbasi e laga me lot, e vura në krye të këngëve të mia.

Të nesërmen s'u pa asnjë shenj gjaku, as kurrë mbrapa; edhe ethet më kaluan dalëngadalë. Në prill shkuam për pushime në Portici. Në mëngjez (në agim), pa lindë dielli, dilja në ato fusha plot ajr të pastër, pastaj në orën 10 ecnim me kuaj për më tepër se dy orë, së bashku me nxënësin tim. Në mbrëmje, shetitnim që të tre së bashku me Dukën, i cili më donte si djalin e vet. Në gusht shkuam për banjo në Kastelamare, prej nga ktheva i ri plot shëndet.

Në atë kohë, meqenëse shpirti im qe ushqyer jo me tjetër veçse me dashuri, më mori një dashuri e pafat për një vajzë bujare, që shpejt pat të njëjtat ndjenja si unë. Dhe jeta ime u mbyll në këtë dashuri. Më doli nga zemra *Italia e Re*, për përfaqësuesit e së cilës përbuzja më ishte shtuar gjithnjë më tepër, ndërsa u ndeza nga ideja e zjarhtë për ta paraqitur të pavdekshme (për ta përjetësuar) atë hyjneshën time, në poemën që mendova, atëhere, të bëj për Atdheun tim (e vendosa, e caktova për mëmëdheun tim). Për shtatë vjet, kënga ime jehoi vetëm për dashuri; dhe shpresova se deri tragjedia do ta ndezte flakë përjashta dashurinë time, duke tërhequr përmbi mua sytë e qytetit; por fati kishte vendosë krejt ndryshe. Shenjat e flakës së vjetër të dashurisë do t'i shikoni të qarta, ndër të tjera, në këngën e parafundit të librit II, në këngën II dhe III dhe në këngën IV të /librit/ V të *Skanderbekut / të pafanë /*. Në këngët e *Serafnës* nxora, së pari, në dritë (më 1843), rezultatin tim të parë të përpjekjes sime të dyfishtë, për të rindërtuar (për ta përtërirë) gjuhën shqipe, dhe për ta ngritë, me atë vegël muzikore (me atë instrument) me pakë tela, këngë nga të cilat shkriheshin (të bashkoheshin) epika, dramatika në harmoni lirike.

Por, kur e pata në dorë librin e shtypur (të botuar), as unë vetë nuk munda ta pëlqej (ta miratoj).

Suksesi gjysmak nuk më frigësoi. M'u duk se më ngjau edhe mua si Jupanges në autorin e *Kapokabanas* të Kalderonit, porse pashë se po më ikte lavdia, për të cilën kisha kaq nevojë; sepse / duke mos qenë/ i pasur, po i një pozite të vogël, po e ndjeja vehten të ndrydhur nga lartësia e dashurisë sime. Kur, në vitin 1845, erdh në Napoli Lamartine, tek i cili shkoi për vizitë aristokracia letrare e qytetit, thuhet

se, para fytyrave të panjohura, qëndroi si i shqetësuar; përkundrazi mua më priti me një nderim jo të zakonshëm (jo të rëndomët), porse as kjo pritje nuk ma ngriti moralin. U muar vesh se kur po kthente / Lamartine/ nga Bregu i Krijës, në karrocë, së bashku me të bijat e Le Fèvre, më ndeshën mua që po vija nga Vila Mbretërore, dhe, ndërsa kuajt ecnin, dy femrat e reja ishin ngritur dhe shikonin mbrapa për të më parë dhe për të më njohur. Por, për këtë dallim, nuk u krenova, edhe sikur t'ia dilja ta përdorja për t'i tërhequr; përkundrazi, ajo u bë farë e re frymëzimesh që fluturonin tej ishullit, në të cilën më mbante në vuajtje Kalipsoja ime.

Në kushte të tilla shpirtërore, ripunova dhe botova *Milosaun*, dhe, prapa, *Katër historitë e shekullit XVI*, që u pëlqyen shumë në Napoli, ndërsa po ia mërrishin lëvizjet politike të vitit 1848, që më gjetën në pararojën e liberalëve.

Ose përse ma këshillonin natyra ime dhe mënyra ime e të menduarit, ose pse, sidoqoftë, e kisha njëfarë pozite, fakti është se unë qëndrova i veçuar nga ato që kërkonin punë (zyre). Por mbasi P. S. Mancini e Acch. De Lauzières, nuk mundën të merren vesht për të themeluar ne të tre së bashku një gazetë, që shkroi pas vitit 1852 në Pays të Francës, unë i vetëm fillova të botoj *Shqiptarin e Italisë (Arbëreshin e Italisë)*, me pak më tepër se dyqind pajtimtarë në provincë dhe me rreth treqind kopje, që dhuroheshin në Napoli.

Kishte pak kohë që gazeta ishte themeluar, dhe vala e revolucionit, për të përdorë një frazë popullore, gjithnjë ngrihej. Partitë politike merreshin vesht për të kërkuar heqje njerëzish prej pune e vendet e mbetuna bosh. Ishin njerëz nën mbrojtjen e *Klubit Kushtetues*, i mbushur me avokatë e gjyqtarë liberalë, të kryesuar nga baroni Bellelli, armik i përbetuar (shumë i egër) i dinastisë, për arsye se Princi i Sirakuzës, nip i Borbonëve, i kishte shnderuar motrën, bashkëshorte e Markezit Vulkano, i cili, një mëngjez, u gjet i varur në dritaren e pallatit të vet, fakt që ende ishte i gjallë në mendjen e qytetit. Këtyre u dhanë zyre, u krijuan vende të reja, porse gjithmonë vala e fundit ishte më e fryrë se ajo para saj. Revolucionit kalonte (ngitte, ngarendte) me furi nëpër rrugë, deri sa në mojin e prillit, një kryetar gjykate, njëfarë Anton Saliceti, i propozuar për ministër nga ana e Klubit, porse i refuzuar prej Mbretit, u vu në krye të të pakënaqurve, duke e shpallë vehten si Robespierri i Borbonëve.

I ligështuar nga britmat nëpër rruga dhe nëpër teatro, që kërkonin Kushtetutën, Ministri Bozzelli-Poerio paraqiti dorëheqjen. Pa asnjë qeveri, çdo ditë mbylleshin dyqanet, e i gjithë qyteti ishte i tmerruar. Atëhere poetesha Guacci, e sëmurë, çoi e më thirri, duke më nxitur (duke më shtytur me arsye, duke më këshilluar) që të kujdeseshim për atdheun. Mbas kuvendimit, u paraqita tek Gjeneral i Rojes Kombëtare, Roberto Pepe, i mërguar në vitin 1820, dhe që ishte kthyer një vit më parë si nderi i Italisë, dhe e luta që, po t'ia propozonin, të pranonte të bëhej ministër. Nuk më njipte, por, mbasi më ndëgjoi, pat besim te unë më deshti. Punova deri në orën dy të asaj dite të zezë (të flaktë, të vështirë), me kundërshtime të vazhdueshme, për të hapë rrugën për një Ministri të rreptë dhe të drejtë. I ligështuar, këtheva në shtëpi në orën e drekës.

Nga ora 7 e mbasdrekes, duke ecur nëpër dhomë, në valë të mendimeve, ndëgjova sikur një zë nga brenda, më tha: Po, përse kohë (përderisa) ke në gazetë një forcë tënden, përse e kërkon këtë gjetiu (tjetërkund)?

Brenda një gjysmë ore, shkrova një artikull të fortë kundër idhullit të *Speranzonëvet* (Liberalëvet). Paditja Salicetin si njeri që kishte dalë, duke u ngrehë rrëshqanthi, nga gjyqtaria, në një atmosferë të papërshtatshme për të, si njeri i pakuptimtë në politikë dhe paurtësi. Vija në dukje, gjithashtu, se si ky, pak kohë përpara, i kishte kushtuar përkthimin e vet të *Jobit*, Del Carretto-s, një nga ministrat më të rrejtur të Borbonëvet (ministër shumë i rrejtur i Borbonëvet).

Para se të vinte mbrëmja, doli Gazeta me artikullin. Tridhjetë numra ua dërgova si dhuratë po kaq kafeve të qytetit. Nga ora një e natës, nuk mund të hyje më në to. Në njëorën nga këto, në Toledo, duke kaluar, unë pashë, hypur mbi një bankë, poetin Regaldi, që po deklamonte artikullin tim. Në orën katër të natës, familja e Dukës, që u largua nga një mbledhje aristokratësh liberalë, më solli përgëzimet. Të nesërmen në mëngjez, artikulli, i rishtypurishte afishuar nëpër qoshet e Napolit. Saliceti u zhduk, i nisur jashtë shtetit, prej kahë, me anën e gazetave, kërkoi pensionin si gjyqtar i larguar nga detyra në mënyrë të paligjshme. Po atë ditë, historiani Troya u ngarkua për formimin e Qeverisë së re.

Mbasi ra edhe flamuri i Salicetit, *Partitë politike* të të gjithë mbretërisë, mbasi u mblodhën (mbasi bënë një këshillë, mbasi u këshilluan)

në Këshillë, i shpërndanë njerëzit e tyre nëpër krahinat, duke filluar një punë përgatitore për zgjedhjen e deputetëve. Kështu që, në javën e dytë të mojit të majit (Parlamenti duhej të çelej më 14 maj), qyteti u mbush me letrarë dhe avoketër të furishëm, që përfaqësonin popullin. Në mbrëmjen e datës 14, këta deputetë u mblodhën në Monteoliveto, dhe, pa pasë paraqitur ndonjë mandat, e pa bërë betimin, filluan t'i dërgojnë mesazhe fyese Mbretit, dhe, mbasi ky i fundit nuk i pranonte ndryshimet që kërkonin për t'i bërë Kushtetutës, në mbrëmje nisën të ndërtohen barrikada, të cilat, vazhdimisht gjatë natës, u pushtuan nga ndonjë çetë rojesh kombëtare, dhe nga aventurierë italianë dhe të huaj.

Në orën 8 të mëngjezit të datës 15, pashë (takova) deputetin D. Cesare Marini, i cili më tregoi çdo gjë që kishte ndodhë, një natë më parë, në Parlament. Ai kishte pasur një besim naiv edhe mendonte se ishte vënë në jetë marrëveshja, ndërsa çuditëj se çfarë kuptimi kishin barrikatat e ngritura për të mos e lejuar mbretin të shkojë në Parlament (në Dhomën e deputetëve). Mbas orës nëntë, dualëm së bashku, mbasi donte të më marrë me vehte, sepse donte që të isha (të gjindesha) në bisedimet në Monteoliveto. Por, mbasi bëmë pak hapa jashtë shtëpisë ndëgjuam një të shtënë pushke nga ana e Pallatit Mbretëror e një duartrokitje e Toledos, nga ballkonet e mbushur me të armatosur. Më vonë, mora vesht se kapiteni i Sviceranëvet, i quajhuri Sales, kur mbërriti koha, në të cilën Mbreti duhej të dilte, shkoi te pengesa e parë e pyeti: “A thua, vallë, doni të pengoni që të fillojë liria kushtetuese në mbretëri?”. Por, ndërsa ai fliste, një plumb, i shprazur nga pallati Ricciardi, e kishte plagosur në zemër. Ajo e shtjerë pushke që ishte vendosur [të bëhej] që më parë, u ndoq nga duartrokitjet e Toledos dhe batalioni i Kalorësit të rënë iu përgjegj me një breshëri plumbash mbi njerëzit e dritareve e të pengesave. Lufta vazhdoi gjatë Toledos prej orës 10 deri në orën 6 pasdreke, kur rrugaçat, me flamuj të bardhë, përshkuan rrugët e qytetit, duke bërëtitur: “Rroftë Mbreti!”, kurse në orën 7, nga raketat ndezëse mori zjarr pallati Ricciardi, selia e Komitetit kryengritës. Deputetët, që në drekë kishin shpallë Kushtetutën, qenë shoqëruar nëpër shtëpiat e tyre nga rojet e sigurimit; njëkohësisht u shpall shtetrrëthimi. Atë ditë, me vërtetësi dhe pasion lirie të vërtetë, shkrova për ngjarjet që po ndodhnin, dhe, mbasi pata shtypë, gjatë natës, një shtojcë të gazetës “*Shqiptari li Italisë*” (Arbëreshi i Italisë), vendosa, në mëngjez herët,

ndonjë kopje ndër kafe. Përpara orës 8 të mëngjesit, Gazetau përhap si vetëtima. Me qindra kopje dërgoheshin në provinca (nëpër krahina të ndryshme), ku u qetësuan shpirtërat. Deri në mbrëmje të asaj dite, ishin shitë 3. 200 kopje, fakt ky i padëgjuar deri në atë kohë për qytetin e Napolit. Në mëngjezin e 18 majit, një oficer i Komandës së vendit, më mori dhe më shoqëroi për në Kështjellë, ku Gjenerali plak Lubrano më njoftoi arrestin për shkelje të shtetrrrethimit. Mbas ndonjë ore, munda t'i dërgoj një pusulle Mareshal /Dhimitër/ Lekës, shqiptar prej Mirdite, i cili kishte komanduar dhe fituar me datën 15. Mbasi u kthye i dërguari me një rresht letër për Lubranon, unë u lirova.

Ndërkaq, Mbreti, i mposhtur nga britmat që e quanin si Neroni i ringjallur, dërgonte në shtëpitë e tyre autorët e 15 majit. Shumica të prekur, shkuan së bashku në Kalabri, të cilën e tronditën krejt, të mbështetur, siç ishin, nga një grup sicilianësh. Kështu që iu desh të luftojë, përsëri, dhe fitoi e shtypi përsëri (ndrydhi në mënyrë mizore, mizorisht). Në qershor unë pezullova botimin e Gazetës, duke deklaruar “se nuk mund të mbështetja një lëvizje të çmendur dhe të mbrapshtë, as dhe nuk mund të goditja njerëz të mij të dashur, që komandonin në mes të kryengritësve”. Në mes tyre, ishin miku im i Kolegjit, Zagarese, miku im i shkollës Mauro, burri i motrës sime (kunati), Ferriolo, dhe Valentini që kishte mbrojtë, në një gjyq të rëndësishëm vëllaun tim. Më në fund, universiteti i Penniferi-vet (pendtarëvet), siç i quante Borboni njerëzit e pendës /letrarët/, kaluan nën flamurin e Savoia-s (kaluan nën të përmendurit, të shquarit, Savoia).

Atëhere Mareshal Leka më ofroi (propozoi) drejtimin e gazetës *L'Araldo* (Lajmëtari); në anë tjetër, Nunziante, në atë kohë sekretar i mbretit, pastaj dukë i Mignano-s, më njoftoi, me anën e drejtorit të Kryporevet të Lungros, Mingiani, se mbreti dëshëronte të më shihte. Ishim tërheqë në Vomero, dhe unë, duke ardhur mbrëmjeve, në shtëpi në qytet, e kisha zakon të frekuentoj, deri në orën 10 të mbrëmjes, rrethet /e partisë/ mbretërore dhe nuhata reaksionin, që po përgatitej nën hijen e Kontit të Aquila-s. Dhe, me qenë se unë këtë e urreja, e urreja si shërbyes i të tjerëve, dhe, tashmë, rrufeja e dashurisë kishte zharitë çdo dëshirë temin për jetë, kështuqë, në kohën kur mbreti vinte nga Kazerta, unë nuk ndodhesha aty (nuk u gjeta aty). Lekës i thashë se prindi plak më donte në shtëpi. Këtu i strehova në nëntor, prej kahë endë mund të thom: *Odī profanum vulgus et arceo* (E urrej turmën e paditur dhe i shmangem asaj). (Shën. i përkth.).

AUTOBIOLOGJIA

PERIUDHA I, II, III, IV (1898, 1899)

PERIUDHA E PARË

Linda, më 29 nëndor 1814, në Maqë, koloni e vogël epirote e Kalabrisë, e vendosur mbi një kodrinë të hapët, përballë detit Jon. Nëna ime, prej shtëpisë Braile, atëhere trashëgimtare e dy familjeve të vjetra, Avati e Sqiljizi, kishte lindë në koloninë e afërt Strigari. Stërgjyshërit e tim eti rridhnin, ndofta, nga një farë Pjetër Anton Rada prej Shqipërisë, për të cilin, në Arkivin e Venedikut të vitit 1300 ndodhet një kontratë për shitblerje me Dogjen. Një farë Pjetër Antoni është i pari i shtëpisë Rada, të cilin e gjejmë në librat e pagëzimit të Maqit, emër që nuk zhduket në të tash katër shekuj dhe që e sollën deri në ditët tona dy vetë, në të cilët përfunduan dy degë të së njëjtës familje. E, më në fund, Kapela e Radavet, që ka datën 1640, i kushtohet Shën Antonit, në Kishën tonë amtare.

Të saj qenë, me pak ndërprerje kohe, për tre shekuj, Famullitarët e katundit, deri tek im at dhe deri tek im vëlla; pra, me të drejtë, mund ta quaj veten prej fisit levitik. Edhe fusha e shytit të shtëpisë sonë është e bardhë si e Guelfëve.

Deri shtatë vjeç, larg syve të tim eti, u enda nëpër fshat, duke marrë me vete katundarë të vegjël, jetima hajdutësh, në lodra palikarësh. Vetëm një ngjarje e asaj moshe, e që tashti më duket fillimi i aq fatkeqësirave të ndryshme të mia, më mbetet në mend. Gjyshi im, bri të cilit rrija gjithmonë, një ditë kur ai ishte i lirë, po çonte, një herë, në një vend të thurur, jashtë katundit, pelën e vet të bardhë plakë të tij. Kur arrita te vendi, mbasi gjyshi çeli derën e gardhit, unë, që isha përbri tij, meqenëse u vonova t'i ngjitesha asaj pëllëmbë gardhi, mbi të cilën

mbështetej derëza e kopshtit, pela e futi në gojë kokën time dhe, pa e dëmtuar fare me dhëmbë, më nxori të paprekur brenda gardhit. Nëna jonë plakë, Andriana, thonte se unë *kisha lindur me këmishë* (me fat).

Në prill të 1822, hyra në kolegjin arbëresh të Shën Adrianit, ku im at jepte mësim në klasën e parë të liceut. Natën unë flija me të; por në dhomën e studimit, meqenëse gati të gjithë ishin më të mëdhej se unë, kishin mundësi dhe shtinin të tjerët të më zhigatnin. Rrija i brengosur edhe për arsye se isha i fundit i klasës, mbasi që italisht nuk kuptoja asnjë fjalë dhe nuk munda të nxë (të mësoj) kurrë atë që nuk kuptoja.

Në gusht, i sëmure, shkova në shtëpi, ku ethet më mbajtën gjithë dimrit. Në mars të 1823, u ktheva përsëri në kolegji. E prapë ndeja kot e pa përfituar gjë, kështuqë, në fund të vitit, Imzot Belushi, peshkop, kryetar i institutit, këshilloi tem at të më çonte në bujqësia. E ma tha nëna ime në pushimet e vjeshtës; e plot gëzim u kallëzova fëmijëve katundarë, miqëve të mij, duke u dhënë fjalën se do të bëhesha përsëri shok i tyre. Por im at kishte kërkuar të më lënin në shkollë edhe një vjetë, sa për të më provuar.

Kështu, më 1824, mbasi u ktheva në shkollë, në orët e pushimit, më ra të ulem afër një djali prej Kozence, i shtëpisë Orlandi, bir i një avokati me emër e, që si italian, e kishin lënë më një anë, veç grumbullit të shokëve. Ai fjalosej me gjithë qejf me mua, që tashti e kuptoja një farë soj italishten, dhe e dëgjoja me vërejtje, kur më tregonte të bëmat *e hajdutëve* në Sile, ose për festat e qytetit. Ai më dha të lexoj *Jetën e Ezopit e Mbretërit e Francës*. E pastaj, i ndihmuar fsheftazi prej tij për të hyrë në gjimnaz, fillova ta marr veten në bisedime me shokë e të marr zemër. Ndërkaq, atë vit, më vdiq gjyshi im. Më 1821, ai kishte ngulë, në Maqë, flamurin tringjyrësh; e, si ai që kishte marrë anën e francezëve në Dhjetëvjeçarin, i qe vënë syri, në mënyrë të veçantë nga reaksioni, e armiqtë e tij i uronin dënimin me vdekje. Dësh fati që, një kozentinas me pushtet, D. Diego, prej shtëpisë shumë fisnike, Tarsia, të kishte djemtë e tij për mësim në kolegjin arbëresh, dhe dy më të mëdhenjtë nxënës të babait tim; e ai bashkëpunoi që gjyshit tim, çdo dënim, t'i ndërrohej me banim të detyrueshëm në Kozenca. Mirëpo, ajri i rëndë e i lagësht i atij qyteti, e mundi trupin e tij të fortë si hekuri, brenda dy vjetësh, banimi. Dhe, mbasi erdhi në shtëpi, i sëmure, me leje, vdiq 59 vjeç; unë as e pashë, as e qava.

Përkundrazi, në vitin e ri shkollor përfitova shumë në shkollë. Në orët e studimit unë rrija në dhomë të tim eti. Prej Shën Mitrit vinte e pushonte Dhimitër Lopez, që ishte kushëri i babait tim. Ky ishte një djalosh me

mendje të jashtëzakonshme, që mbasi kishte kryer studimet e liceut, ndiqte aty, si i jashtëm, mësimet universitare të matematikës së lartë dhe të së drejtës së natyrës, me të cilat, së bashku me shkencat morale dhe teologjike, plotësoheshin atëhere planet mësimore të institutit tonë. Ai më shpjegonte, sikurse vitin e kaluar Gaspër Orlandi, copat e dyshimta në latinishten time; e me shembull nuk më linte të ndërpres studimin; e, duke nxënë (mësuar) vazhdimisht, më shtoej besimi në veten time. Mbasi gjeta librin *Jeruzalemi i çliruar*, që u bë gjë e shenjtë për atë moshën time, në orët e pushimit e të mësimit të greqishtes, rrija gjithnjë me të në dorë, me gjithë që nuk e kuptoja krejt; por aq sa keqkuptoja trimëritë e atyre burrave, ajo ishte bota ime. E pastaj, gati mësheftazi, lexoja shumë libra të tjerë italishtose të përkthyer në italisht, libra që përpara ishin të ndaluar në mënyrë të shtrënguet në atë kolegji mësimesh të rrepta. Vetëm dy a tri vjet përpara, dy mendje të rralla, Rafael Lopez prej Shën Mitrit e Fr. Saverio Kapareli nga Akuamorfoza, i kishin dhënë një shtytje drejt një kulture më të gjerë. Përfitova edhe në latinisht nga leximi i vazhdueshëm, në kohën e meshës së mëngjezit, prej pjesëve tregimtare të Biblës. Kur, nga mbarimi i tetorit të vitit 1825, vdiq, në lindje e sipër, shumë e re, nëna ime, tim eti iu desh të linte mësimin e, i papërvojë, të marrë përsipër drejtimin e shtëpisë së shkretuar.

Kur u ktheva në kolegji, në nëndor, për fatkeqësinë që më ndodhi, shokët më pritën me një nderim më të madh. Çova shtratin tim të vogël në dhomën tjetër e mbi të, në orët e qetësisë e, nga ndonjë herë, në kohë të studimit, shkrihesha në vaj. E përsëri, më tepër se mësimet, më tërhiqnin me forcë leximet e tjera, gjithmonë e më të ndryshme. Gjeta një vëllim të Ariostos e *Pastor Fido*, një histori të përgjithshme të Ehardit, një mitologji të ilustruar në disa vëllime e pastaj Kalorësi i varfën, Argenide të Barklejos, etj.; por më bënë përshtypje më të madhe librat asketikë dhe shkrimet e shenjta.

Në vitin e mëpastajmë, librat asketikë zunë vendin e Tasos e të leximeve të tjera. Duke menduar tashti, këtë detyrë (ia mvesh)hirit hyjnor, nëpërmjet leximeve, të cilat, në atë institut, bëheshin mëngjez e mbrëmje në dhomën e bukës, për jetët e shenjtënve të kishës. U dogja nga dëshira të isha me ta; agjërimeve të kishës ortodokse u shtova lutje e mundime të jetës. Lashë leximin e çdo libri që nuk ishte i shenjtë, duke pëlqyer gjithnjë librat doracakë (përmbledhës) të historisë fetare.

I bindur për të vërtetën, në të cilën isha kthyer, për pashkë, mbasi bëra kungimin e shenjtë, pas një rrëfimi të përgjithshëm, që çuditi rrëfyesin e jashtëzakonshëm, D. Karmine Dramis nga Mbuzati, (që për të u tha

profesorëve në kohën e pushimeve), ia nisa duke u folur këtij dhe atij, nga shokët e mij, për Zotin, si krijuesin dhe dhënësin e vetëm të gjërave të gjithësisë, dhe i ndryshova në mënyrë të tillë që, në gjysmën e verës, në orët pushimit, vinin, herë pas here, profesorët më të prigjuar te dera e fjetores së të vegjëlve, në të cilën, të shpërndarë në grupe, nëpër shtretër, djemtë, disa recitonin psalmet, disa lexonin libra të përshpirtshëm, e disa përsëritnin rruzaren. Të çudit fakti se unë, shpirti i asaj bote të çuditshme, nuk isha veçse 13 vjeç. Dhe është e denjë, për më tepër, të shenohet një tjetër sukses, i cili zuri vend në mënyrë të qëndrueshme në mendjen time.

Librat e shenjtë, duke më tërheqë së tepërmi, më hanin kohën, kur unë duhet të nxëjshe mësimet e mia, e shpesh mungoja në shkollë. Dhe ngjau shumë herë, në atë verë, që ra kumbona e shkollës, kur unë nuk u kisha hedhë ende një sy mësimëve përmendsh, e të mësuarit përmendsh mekanikisht më mungonte, atëherë në shkollë unë lutesha, i lutesha Zonjës që të më shpëtonte nga të pyeturit dhe nuk më bie ndërmend që, në ato raste, të jem ngritë të thoshja mësimin e të jem turpëruar. Kështu, pra, e ndjeja veten të çliruar, duke u ngushëlluar me atë mendim, se, pas vdekjes së nënës sime, kur u nisa nga shtëpia fillkat për në kolegji, dhe isha i mbytur në vaj, një grua aty më kishte thënë: “Eh, djalë, ngushëllohu, atje do të gjesh Zonjën në vend të nënës sate”.

Por do të thom edhe më.

Në mes shokëve më besnikë të lidhur me mua, ishte një djalosh prej Shën Mitrit, Anton Kjodi, që, nga mbarimi i qershorit, u detyrua të linte kolegjin prej një dhëmbje koke që s’ia pushonte gjë. Në shtator, në kohë të provimeve, muarëm vesh që ai kishte vdekë nga sëmundja e vet; pastaj, pa e menduar më, siç ngjet nga ngurtësia e fëmijëve, për shkak të ngurtësisë së tyre, u ndamë për pushimet e vjeshtës. Nga mezi i tetorit, u dukën borërat mbi malet e Polinos; e, në një mëngjez, kur bënte shumë të ftohtë, në shtëpi time ishim mbledhë rreth e rrotull zjarrit; im at thonte Ufficen, unë lexoja dhe vëllezërit e mi të vegjël luanin në një kënd të vatrës. Kur, u hap dera dhe hyri një grua e lartë, e shkuar nga mosha, e veshur në të zeza. Im at, që e njohu, u ngrit për ta pritë:

- Jo, D. Mikel, nuk do të rrij, por lermëni të njoh djalin tuaj, Jeronimin. Kur më treguan asaj, m’u hodh përsipër e më mbuloi me të puthura e me lot: “Antonin e pashë sonte në ëndërr e më dërgon që të të falënderoj, sepse ti je shkaktar që ai tash është në qiell”. Unë e ndoqa me sytë plot trishtim, kur ajo pasi zbriti në oborr, ku e priste një sherbëtores, hypi mbi një gomar e iku.

Im at e kishte kundërshtuar dëshirën time që zgjati për t’u mbyllur

në ndonjë manastir deri sa unë, mbasi të kisha mbaruar studimet, të mundesha, me mendje të arsimuar, të vendosja për jetën time.

E di sa e lehtë është edhe për dijen e pakët që të interpretohen këto gjëra në mënyrë të natyrëshme. Trazimet që u bien mendjeve të paafta zbulimet e sotme të kaq forcave të Materies, të cilat e kanë larguar çdo vëmendje nga prania e *Qenies shpirtërore* dhe të padukëshme, kanë bërë që të pëlqehet, siç thotë njeriu, shërbëtori në vend të zotërisë. Para nesh kemi në amëshim një botë të pafund, të pandryshueshme, dhe disa qenje të cilat shkojnë tutje e kurrkush nuk sheh se ku. A janë këto ëndrra që zhduken? Që të jenë hije të ngritura pa qëllim, kjo nuk zë rrënjë në mendje e në zemra: një krijues i plotfuqishëm “sendesh të kota që duken njerëz”, është ëndrra e marrëzisë. Edhe në jetën, nga jemi duke kaluar, duken disa lloje që na japin zemër e na shtyjnë në atë rrugë që duhet të jetë drejt së mirës; sepse toka e palëvizëshme, nga po kalojmë këtu poshtë, qe edhe ajo vetë plot me të mira për të na zbutë tmerin, që *nuk e njohim*. Te vetë njeriu, ajo që “është” e ajo që “bën”, qëndron e mbyllur tek ai e nuk shihet; e vëmendja për dukjen e asaj që “është” e *bën*, te njeriu u prin dhe u rrin sipër të gjitha kujdesjeve të tjera që e pasojnë. E ky është simboli i plazmimit të gjithësisë, në të cilën nuk mund të ketë gjurmim e zbulim në lëndën trupore që i pështatet asaj të qenjes shpirtërore dhe privilegji i njerëzve dhe i kombeve qëndron në njohjen e krijuesit të botës dhe të qëllimeve të tija. Por biseda shkon larg.

Që nga ky vit, prej një banje në det të paanë, për shkak të një regjimi të përsosur, m’u përtri shëndeti, m’u zgjerua mendja dhe m’u forcua shpirti me besim.

Pastaj në shtëpi, pa pasë më kohë, pa pasë më vend ku të strukesha për t’u lutë, devocioni im shkoi duke u vakur. Në Kolegj më dërguan te ata të moshës së mesme, duke mos pasë me vete asnjërin prej shokëve. Në muajin e parë ndenja si i huaj, duke ju ruajtur talljeve të shokëve lidhur për vitin e kaluar, të cilit e ndjejsa se i kisha kthyer shpinën. Vetëm nëpër rrugët e shetitjes edhe mbas pak, me një djalosh italian, me moshë më të vogël se unë, edhe ai pa shokë, sepse *i ri*, afroheshim e çkëmbejim llafin aty ku e kishim lënë. Ai ishte nga Rende, në Rrethin e Kozencës, prej shtëpisë Xagareze, i lindur nga një bijë e Baronit të Shën Donatit, me shpirt të pastër, të pafajshëm, të drejtë, sikurse dilet nga shtëpiat e thjeshta. E miqësia më zbuti venitjen e besimit munguar ndaj Jezu Krishtit.

Ndodhi, pra, që një ditë të pushimeve të Krishtlindjeve, i ulur afër mangallit me tre a katër shokë konviktorë, i kërkova njerit prej tyre një

thikë për të qëruar një portokall; njeri prej tyre, që ishte dy vjet më i madh se unë, shumë i përpikët në mësimet përmendsh – studionim në të njëjtën klasë – ja priti prej vendit të tij: “Mos ja jep!” Por, ai të cilit ja kisha kërkuar, ma dha thikën, veçse fyerja e atij shoku më preku shumë; mbas kësaj ngjarjeje, një dëshirë e madhe më hyri në zemër: të vihesh në krye të fjetores sime. Ndodhi, pra, që në atë vit, nuk mbaj mend çfarë ngatërrese, na ndau në dy palë: njera, ajo e italianëve dhe e arbëreshëve të ritit latin, kurse tjetra e arbëreshëve të ritit grek. Në mbrëmjen e pashkëve, në dhomën e boshatisur nga bankat e mësimit, u kacafitëm me grushta. Në njerën dhe në tjetrën anë ishim dy djelmosha më se 16 vjeç. Fitoi ana jonë e ngriti trofeun e saj mbi shtratin tim. Të hënën u bëmë përsëri shokë, e tryeza e paqës, ku ata të ritit latin na thërritën, u shtrua mbi shtratin e Xagarezes. Qysh prej kësaj kohe dalloheshin me emrat e *Orestit* e të *Piladit*.

Kënaqësia ishte e madhe, si e ndjej sot vetë, por atëhere nuk më rrëmbeu shumë, gati sikur mos ta kuptoja. Unë isha i lumtur nga miqësia dhe pastaj spektator i pangopur, simpatik për kohën më të nderueshme që pat jeta pranë popujve të ndryshëm, orë që na kanë mbetur të përshkruara prej artit të fjalës. Më tërhiqnin, sidomos, tragjeditë e Sofokliut e të Euripidit; dhe, mbasi i lagsha me lot personazhet e dashuritë e tyre, largohesha nga to, i pastruar për miqësinë, i pavetëdijsëm për shpirtin hyjnor që gjindej në të. Tash, më duket, që mëngjezi i kësaj dite të lumtur, thellohej në gjinin e vitit të kaluar: ose perëndia, që unë kisha kërkuar me të vërtetë, më hapi pothuajse, një qiell tokësor, ose shpirti im, i shenjtëruar dhe i pastruar, pse kishte pasë ndër mend gjithnjë perëndinë, ishte bërë i ndijshëm në ndjenjat më fisnike, të cilat mbështeten mbi drejtësinë, mbi mirësinë e mbi turpin e shpirtave; mbasi, njeriu, më parë çmon, pastaj dashuron.

Ndër orët e lirshme, gjatë shtive, në hije pemësh o drizash, vetëm, lexonim ndonjë klasik o të përkthyer prej gjuhësh të tjera; me kureshtje *Orlandin e Tërbuar*, me më përfitim *Korinën* e Zonjës Stael; dhe, në vitin e pasëm, më pëlqente të lexoj Ciceronin: *De officis*, traktatin e tij të miqësisë, dhe *Jetën* e shkruar nga Middleton. Ndër këto dy vjetë, unë kërkoja të formoj stilin, duke marrë për model Petrarkën, gjuha e të cilit më dukej e mahnitëshme. Nga ai studim nuk më mbet, besoj, veçse gjurma e errësirës, e cila, pastaj, më dëmtoi shpesh ndër konceptet e mia.

Në nëndor të vitit 1831, i prirë nga emri i mirë që kisha fituar, më kaluan te mesatarët. I mbetur pa kundërshtar në klasë, i ndarë prej

shokut, - Domeniko Mauro, Aleksandër Serembe, në vend të vetëmisë së Shën Adrianit, kishin pëlqyer shkollat e qytetit – e ndjeva veten më të lirë për çdo mësim. Nuk kishte kurrfarë libri të ri, që të hynte në konvikt, e të mos ma jepte për lexim çdo sallë studimi. Gjithëmonë unë vazhdoja, përtej masës, e pa mësues, në lidhje me formimin e stilit, duke imituar, në mënyrë të ngatrrueshme, më të mirët, dhe i pyesja mësuesit e stilistikës të çdo vendi mbi qenësinë e së Bukurës, që ata nuk e dinin, dhe mbi rregullat e paraqitjes, të cilat unë nuk dija t'i kuptoj qartë nga mësimet e tyre. Kam dëgjuar të thonë, se mendja, kur është drejtuar nga leximet e shumta, dhe në kundërshtim mes tyre, dobësohet. Ndoshta kjo ngjet, kur mendja kërkon të zbatojë diçka edhe ndalet; ndërsa mua më mbette në mend, ajo që më pëlqente, tjetra kalonte pa u kthyer më.

Ndërkaq, mendoj se më ka vlejte shumë të mësuarit përmendsh, që kam bërë atë vit, të disa pjesëve shumë të bukura të Tasos, të Ariostos, të Iliadës së përkthyer nga Monti, të një libri të Gjeorgjikeve, të Olimpiadës së Metastazios, të Varreve të Foskolos, etj. Në vitin tjetër, munda të kem në dorë “Korsarin” e Bajronit, që, bashkë me Alfierin, ishte çuar në qiell. Mua më bëri një përshtypje të veçantë për novitetin dhe madhësinë e figuravet; por më dukej se ishte i shkollës së Lukanit, që nuk di të nxjerrë të gjalla, nga veprimet dhe nga të thënat, tiparet e njerëzve, porse përpiqet t'i hartojë, duke i përshkruar e duke i grumbulluar veçoritë.

Në të njëjtin vit, më 1832, tashmë në sallën e studimit të të mëdhejvet, iu vura punës për të hartuar një poemth me katër këngë *Odiseu*, një temë shqiptare, duke përdorur rimën treshe; nuk e mbaj mend, në se i frymëzuar prej Dantes apo prej Basvilianës së Montit. Asnjë nxënës i kolegjit nuk ka qenë orvatë, më përpara, për t'ia hyrë një veprë së tillë. Për këtë arsye, ajo moshë e jona, në të cilën libra tjerë, veç atyre shkollorë, mbushën kolegjin, qe koha e lulëzimit më të madh të tij. Mbasi dola vitin tjetër (në marsin e të cilit vdiq peshkop Belushi), unë e laçë shoqërinë, rregulluar, thujajse, si akademi, ku çdo të shtunë, secili lexonte ndonjë punim të vetin. Këtu i bëri provat e para shoku im fatkeq Engëll Bazile nga Plataçi, autor i veprës *Ines de Castro*, botuar në Napoli, më 1848.

Ajo që do të përbëjë, ndoshta, një veçori të mendjes sime, qe pasioni që m'u zhvillua për matematikë, një dëshirë jo më pak e zjarrtë se sa për letërsi. Vazhdimisht, për dy vjet, letrat e mia, nga një anë, rrinin të shkruara në vargje, nga ana tjetër, të mbuluara me figura gjeometrike

dhe shifra algebrike. Arrita të nxjerr me mend rrënjën katrore të 24 numrave. Ishte profesor në kolegji Gaetano Çerri nga Marturano, që kishte pasë dhënë mësim në Nunciata të Napolit e, mbas vitit 1821, që i detyruar ta lëjë katedrën. E mbaj mend se në klasën tonë, mbas kursit të *Gjeometrisë plane* të Euklidit dhe të asaj të ngurtë, paraqitur nga Flauti, ai na dha në dorë *leksionet konike* të Karavelit, mik i tij, të cilat u lidhnin me kurset e mëparëshme të të njëjtit, e që ne nuk i dinim; prandaj nuk mundëm më të kuptoheshim. Mbas gjithë këtyre, në nëndor të vitit 1832, plaku i nderuar, pothuajse i dëshpëruar, më thirri në dërrasë të zezë dhe, mbasi e shpjegoi në të gjerë dhe qartë, si mjeshër që ishte, fjalinë, e desh që ta përsëris edhe unë vetë; dhe atë gjë e bëra me disa pasaktësi të vogla, ndërsa ai qortonte. E, pastaj, e shkrova pastër në sallën e studimit dhe ua kalova shokëve.

Kështu, mandej, radhaz, studiuam lëndën deri në fund. Mbas gati pesë vjetësh, ishin zhdukë, nga kujtesa ime, të gjitha së bashku, ato njohuri. Ndoshta, mbasi u ushqye arësyeja e mendjes sime, nuk kishin më se çka të bënin në të.

Në korrik të vitit 1833, e laçë kolegjin, i mburrur me të kaluarën e pa kurrfarë pikësynimi e mendimi për të ardhmen. Në mënyrë që t'u përtrija prej lodhjes së kaluar edhe t'u jepja si me një ugur mbas jetës bujqësore, babai im desh që, një vit, të rrija për pushim në shtëpi, e t'u kujdesja për punët e familjes. Në shtator, më erdhi prej Kozencës letra e avokatit të përmendur Rafael Valentini, i cili, pastaj, shumë plak, që kryetar i pushtetit ekzekutiv të kryengritësve të Kalabrisë, më 1848; ai më kërkonte këngët popullore të kolonive tona. Atëhere shkova në Shën Kozmo te nënëdaja e këtu, një plakë, me emrin Tortoshëlja, më recitoi të parat këngë, ndërmjet të së cilave ato të Dedë Skurës, Milo Shinit e Radavanit. Në Shën Mitër pata pjesët e shumë këngëve nga Oricia, gjyshja nëndëdhëtvjeçare e Dhimitër Strigarit.

Pastaj, vazhdoja të dëgjoj gratë e fshatit tim, prej së cilave mësova shumë këngë të tjera. Mbledhjen e dërgova në Kozencë. Por, nga shoqëria me vajzat dhe nga thjeshtësia e shqiptimit të atyre këngëve, lindi historia e, pastaj, parashtrimi i *Legjendës së Milosaos*.

Një mëngjez, u ndala me një shok të kolegjit te dera e hambarit të tij, brenda të cilit gratë zgjidhnin misrin. Vura re një vajzë të re, rreth 23 vjeç, që aty u duk e kënaqur me mua. Binte në sy si fytyrë e si sjellje dhe m'u ngul në zemër. Më vonë munda ta shoh shpesh, sepse ishte e bija e çobanit të grigjës sonë; dhe, pastaj, duke u ndihmuar grave, ndër punët

e tokës, ajo ishte gjithmonë në mes të tyre. Ishim të ndruajtur dhe, vetëm për vetëm, nuk ishim kurrë, sepse, ndër ne, çdo takim ndërmjet dy sekseve, ta humb stimën; megjithatë fryti i këndshëm i çdo dite sonë, ishte që të shihemi rishtazi. Këtu zuri fill studimi im i gjuhës amëtare. Për dy orë e gjysëm, çdo mbrëmje, ndërsa ndihmoja në studimin e latinishtes vëllaun tim Kamilin, duke e ushtruar në ligjëratën e Ciceronit *pro Milone*, unë përpiqeshe t’ja përshtatja shqipës masat e vargjeve greke e latine, e nuk kisha ndonjë përfundim. Gjithmonë mbetja pezull nga thjeshtësia e idesë dhe e trajtës së këngëve tona kombëtare.

Mbas katër muaj provash, në mëngjezin e Ujit të Bekuar të vitit 1834, hartova me mend, duke luajtur djathin, idilin “*Ish e djela menat*” (Ishte e dielle mëngjez), duke vënë një ngjarje timen të atij mëngjezi. E u takova në artin grek “që reflekton të vërtetën, në të cilën e rëndomta me idealen shkojnë bashkë”.

Qysh prej atëhere, erdha në të njëjtën mënyrëz, duke vizatuar tjera çaste të këndshme të asaj dashurie të parë, duke imituar sa munda thjeshtësinë e Rapsodive; e me këto populli mblodhi e bëri të veta shumë aso këso këngësh. Mbyll serinë kuadri “*Pra që dieli i ra te shtrati*” (Mbas dielli i ra te shtrati), që e hartova në rrugë për Napoli, më 24 nëndor 1834, e, sikurse të parën, me mend në karrocë. Ato, të bashkuara, përbënë, pastaj, *këngët e Milosaos*.

Më 1 dhjetor 1834, isha në Napoli, në shtëpinë e një florentini, D. Xhovani Rastrelit, nëpunës në Bamirësinë e arësyeshme, i cili më pranoi në pension në familjen e vet dhe më dha dorë në jetën qytetare. Aty unë bëra shok djalin e vetëm të Paskuale Rosit nga Tesano (me të cilin ishte i një fisi gruaja e Rastrelit, zonja Rozina Travulo), dhe, nga ai, më deshën mirë.

Duhet thënë, para së gjithash, se Napoli, ndjenja e njerëzisë më zemërçelët, më la mbresa të pakënaqëshme, me të parën, për lirinë e tepruar në marrëdhëniet në mes dy sekseve. I lindur në shtëpi, ku ishte turp të uleshe në të njëjtin kuvend vasha e re dhe i fejuari i saj, më lëndoi që një djalë e një vashë të qëndronin bashkë në tryezë e të dishëroheshin me shikime. Ishte, ndoshta, një paragjykim që rrjedh prej të prapambeturish, i cili, por, më mbajti, për vjet, si të huaj në atë qytet: As nuk pushova kurrë, pastaj, të besoj se “dashuria është një lulezë e butë që do hijen”.

I zoti i shtëpisë më porositi të shkoj te shkolla e së drejtës e profesor Gjiljit, e, mbas Pashkëve, më bëri të më pranonin në atë të gjuhës italiane të markezit Bas. Puoti. Këtë e braktisa shpejt, i lodhur duke e kaluar jetën në qëmtim frazash të *bëmave të Eneut*. Por, me qenë se nuk munda të

dashurohesha pas studimeve të drejtësisë, për të mos e brengosë babain tim, merrja pjesë i heshtur, i panjohur; e, ndërmjet nxënësve fjalamanë, krenarë, rrija i pakënaqur nga pàdija ime. Por qyteti, për të cilin u tha, “Napoli i bukur, të shoh, të puthi”, më qëndronte magjepës në qiellin e tij të përjetshëm dhe të pakrahasueshëm, në festën e tij të përhershme, plot muzikë, dhe edukues i madh, me bibliotekat e veta, me muzeun dhe me monumentet historike. Në gji të këtij qyteti, unë nuk dija nga t’ia mbaj më përpara. Për t’u zhytë në letërsinë moderne, më dha dorë ajo pak frëngjishte që m’u mësua, brenda dy muajve, nga leksionet e bujarit, mikut tim. Lexova më përpara Shekspirin, Shilerin, korrespondencën e këtij me Gëten në “Revistën Gjermanike”, Kalderonin, vizatuesin e kalorësve të pakrahasueshëm dhe Teatrin frëng. Përshtypja që më bëri Shekspiri, përsa i takon stilit, nuk më doli kurrë nga mendja; ndjenjat e tij kaq të fuqishme, më dukej se ai i shprehte, thujse me germa, mbasi t’i kishte bluar me vete e; nga, në teatrin e Athinës, e japin jehun e vet të menjëherëshëm, të lindur, me një stil të thjeshtë dhe të rreptë (të ashpër).

Leximet e shumta, ndonëse pa metodë, si përherë, e tronditën shpirtin tim që nga thellësia e tij. Kaq mendime të një bote kristiane, e, që, bile, dukej se kishin pak njohuri për krishtin, dhe filosofismi francez i shekullit XVIII, vepruan aq shumë kundër besimit tim të plogshhtë, që, edhe duke mos mundur ta dobësojnë, më trishtuan. Nuk do të dija të thoshja turbullimin, me të cilin një mëngjez, mbasi lexova në një dramë të Vernerit, britmën e dëshpëruar “Krishti ka vdekur përgjithmonë”, u ngrita dhe dola nga biblioteka, i kapërthyer nga një stuhi mendimesh. Pak zinin tek unë fjalët e këtyre qenjeve të vdekëshme tokësore, por e njëjta pakujdesi imja dhe shoqëria që më rrinte për rreth, që besonte në mënyrë mekanike, ishin për mua ujë i ftohtë për jetën time të brendshme.

Napoli nuk tallej me besimin e vet të shenjtë; por qëndronte i zënë dhe i turbulluar nga çështjet e ditës. Unë shikoja, duke hyrë në kishat e tij, njerëz të pushtuar dhe, pas tyre, dyert që mbylleshin nga jashtë, prej erës së madhe. Hynin vazhdimisht dhe, të kapërthyer, të gjithë, nga brenga e madhe, që e bren jetën nga jashtë. I shikoja të gjunjëzuar në një skaj, në të cilin shiu, i përzier me breshër, dhe tërshërët e egra e të rritura ndër praqet e dritareve, rrihnin së bashku xhamat e dritares; prej nga zbriste poshtë një dritë e zbehtë, e cila, dukjen, jashtë dhe në pjesën e sipërme, e kishte më të bardhë. Ky ndriçim i paktë dhe drita e kandileve, bënin që të dukej përmbi elter kryqi dhe, në muret anësore,

figura martirësh, gati të zhdukur ndër shpella të errta; sepse koha që ata e shihnin veten ditën bijt e krijuesit të botës, ajo kohë ndërrohej në mbrëmje dhe mbytej në terrin e natës.

Shpirti im ishte i prekur, por me çfarë forcash ngrihej, as unë vetë nuk e dija: më dukej se nuk kisha ç'të bëj më; dhe, së bashku me popullin tjetër, unë hyja ndër kishat e vjetra, për të njohur aty, të skalitur, lutjen e princave të artit dhe të pikturës; dhe, pastaj, meloditë e organonit, duke dalë nga bota dhe për të gjetur paqë tek këmbët e Martirit të pavdekshëm të Besimit në Zotin, mbrojtës të virtytit. Dhe më forcohej mendimi, se do të ishte e dobishme për mua, që të zhgarkohesha nga kjobarrë.

Në janar të 1836, shkova një mëngjes te zyra e “*Omnibus*”-it, gazetë letrare, e para që u pat themeluar në Napoli. Gjeta drejtorin Vinçenc Torelin, vetëm në studio, dhe i thashë kështu: “Kam disa këngë popullore me karakter të rëndomët, të cilat kishin për të qenë ndoshta si diçka e ré në gazetën tuaj. Mos mendoni se është nga paurtia e guximshme që po i paraqes pa kurrfarë rekomandimi të rastit; sepse nuk qe e mundur ta kisha unë, unë, si arbëresh i panjohur”. Duke dëgjuar, ai u ngrit i përmalluar dhe, mbasi më shtërngoi dorën, më tha: “Gjaku ynë i shprishët!” (Gjaku ynë i humbur, i shpërndarë). Ishte edhe ai arbëresh nga Barile në Bazilikatë. “*Omnibus*” doli duke lajmëruar vizitën time dhe duke botuar poezitë, të cilat u dukën shumë origjinale; dhe, më vonë, gjithmonë, qe e hapur (gazeta) për provat e mia.

Ky sukses më nxiti përsëri në studime letrare. Fillova të përpunoj *Odisenë*, të cilën e kisha përpiluar në Kolegj në rima treshe, dhe po e perifraroja në vargje të zgjidhura. Në këtë kohë, ndodhi që shokët më tërhoqën në shkollën e deklamimit të Emanuel Biderës, arbëresh ky prej Sicilisë, shumë i njohur në Napoli, dhe libretist i *Gemma di Virgy*. Por këtu, gjatë dy muajve, duke më penguar turpi, në vend që të deklamoja, unë recitoja me një monotoni të pagjallëri tingëllimin e Petrarkës: “Më çoi mendimi im nga ajo anë ku ishte ajo që unë kërkoj, etj”.

Aq sa profesori, mbasi tërhoqi më një anë shokun dhe farefisnin tim Dhimitër Strigarin, nxënësin e tij të zgjedhur dhe sot avokat i dalluar i Napolit, ia bëri të njohur hidhërimin e tij për paaftësinë time. Por e meta, sikurse më del sot në pah, pjesërisht ishte në vetë tingëllimin e pashije dhe të pafuqishëm për të ndezur tjetër gjë veç disa zjarre të kota në mendjet e Rektorëve. Në të diellin e ardhshme, mbasi u ngrita, nga ana ime, lexoja dhe, me dashurinë që e kisha krijuar, një copë të përpunimit tim në vargje të zgjidhura, nga *Odiseja*.

Profesori, mbasi iu afrua bashkënxënësit Luigj Tercit nga Paterno, e pyeti nëse ato vargje ishin të Bajronit. –“Jo, iu përgjigj miku im, janë të tijat”. Plaku i nderuar, atëhere zuri vend para meje, dhe, duke më vështruar me vëmendje, mbasi i nisi nxënësit, më mbajti pranë vehtes; dhe, dolëm së bashku. E, mbasi i dëftova për ushtrimet e mia në gjuhën tonë, dhe, mbasi dëgjoi ndonjë ode të *Milosaos*, nuk la arësytim pa më bërë për të më bindë që t’i qitja në dritë. Dhe më gjeti, ai vetë shtypshkruesin, ndërsa unë bëra të më sillnin të hollat nga shtëpia për shtyp. U botua, në gusht të 1836, ajo këngë që ia kushtova mareshalit të Fushës së Mbretit, Dhimitër Lekës, arbëresh edhe ky, por prej Atdheut-nënë, dhe që kishte mbetë në Mbretërinë e Napolit, mbasi u shpërnda regjimenti mbretëror maqedon, në të cilin kishte milituar së bashku me Mark Boçarin.

Në atë muaj, kolera kishte pushtuar Napolin dhe, duke u zhgrehë me furë mbrapa, në tetor ika përsëri për në shtëpi, duke marrë me vete kopjet e poemës, që u vlerësuan në mënyrë shumë të favorëshme.

Përpara se të kaloj përtej, do të bëj një shënim të spikatur të karakterit tim. Në atë verë, do të ipja provimet, në Universitetin e Napolit, për pustullën në Letërsi, duke depozituar në sekretari gjashtë dukatë. Mora 12 pikë në të gjitha lëndët, pra Diplomën (Laurën e lirë). Eh mirë, i kënaqur me vetëveten, nuk u kujdesova më për të tërheqë depozitën, as për të nxjerrë pustullën.

Mbasi u ktheva, pra, në vendin tim, ia nisa provës për të ngritur gjuhën tonë për të paraqitë mënyrën e jetës së lartë ndër krijime, mundësisht, të vërteta dhe me pasione fisnike. E kam çekë në historinë e *Adines*, të hartuar në shtëpinë Rosi, në Tesano, afër Kozencës.

I vazhdova përpjekjet, më 1837, me *Nata e Kshnellave, Frozina, Vantizana*. Por gjuha ishte, për mua, një vegël me më shumë tela të shprishur, dhe kjo gjë u diktonte krijimevet të mia një gjendje lakuriq të pakalueshme, megjithatë, aty-këtu, kishte edhe parafytyrime të reja, të nxjerra nga natyra. Nga Napoli ishte riatdhesuar, në Shën Dhimitër, Domeniko Mauro; dhe, mbasi e lamë çdo rivalitet, çdo të enjte ndanim rrugën duke dhënë detyrën e javës. Në atë vit, ai përpiloi poemën e vet *Enriku*.

Në kaq, kolera, duke pushtuar krahinat, ishte shoqëruar me dyshime helmi, të ngjallura dhe të ngarkuara Qeverisë, nga sektarë, që ia kishin nisë punës për të ndërruar rendin e shtetit. U besua tek ata që kishin nevojë të ndërroheshin fatet e tek të dëmtuarit e çdo qyteti e

kështjelli. Erdh tek në mjeku Paskuale Rosi, karbonar plak (i vjetër), që më njihte se isha ushqyer me shembuj të Greqisë e të Romës dhe e dinte që Babai im kishte dalë nga e njëjta shkollë. Ai përfshiu mungesën e përvojës sime në një konspiracion drejt një ideali të turbullt, ndonëse gjithënjë të lakmuar. U nis me besën që i dhashë, dhe i forcuar në veten time nga një besim i patundur, se Qeveria vepronte për të skllavëruar duke prishur. Dhe këtë e besova për shumë vjet, e deri sa nuk qeshë bindur, se njeriu shkon duke u dridhur tek vrasja me të pabesë, dhe nuk është e mundur një grumbullim i gjerë mbrapshtish kundër njerëzve të panjohur; por që është e lehtë për Djallin, t'ia bëjë t'i besojë atij, që ka pak kujdes. Gjithashtu, më kishte hyrë kotësia, nga relacionet e ndryshme që më dilnin para, dhe nga mendimi që po bëhesha udhëheqës njerëzish dhe që po formoja një sundim të tashëm (të sotëm).

Mbas fillimit të qershorit, më erdhi një letër ekspres prej Kozenca, që më urdhëronte të merresha vesh me të përbetuarit e Specanos Arbëreshe e të Kastrovilarit, bashkë edhe me ata të Akrit e të Longobukos; të njihja forcat që dispononim; t'ua referoja dhe, ndërkaq, t'i rreshtoja e t'i përgatitja. Shkrova (një letër) për Akri dhe shkova vetë në Specano. Mbasi mëngjezin pasues ishte e dielle, zbritëm në Kameratë. Këtu u grumbulluan nga Kastrovilari dhe Kasano shtatë ose tetë studentë, të diplomuar, të plogshhtë, nga të cilët asnjeri s'm'u duk se mund të kishte edhë një njeri të vetëm. Njeri prej këtyre kishte pru një kitarë dhe i binte. I prekur, nga muzgu, ia hypa edhe një herë kalit dhe nuk ia dolën miqtë e Specanos të më ndalin atje; por, nga mbrëmja vonë, ia beha në shtëpi, i dëftova çdo gjë tem eti dhe ia shpreha vendimin tim për t'u shkruar që ata të mos kishin më shpresë tek unë. Pregatita relacionin dhe korrierin për të mërkuren në mëngjez; kur, ja, në mbrëmjen e së martës, përkundrazi, arriti nga Kozenca një lajmëtar me urdhërin e Komitetit të Napolit: "Të binim në Kozencë, më 22 qershor, ditë e caktuar për revolucionin e të gjitha krahinave". Nuk munda, pra, më të tërhiqesha, pa humbur nderin, megjithëse e kisha të qartë përfshirjen e njerëzvet që po përgatisnin lëvizje bandash, të cilat, në se ishin e ku ishin, edhe ata vetë nuk e dinin.

Menjëherë u dërgova të interesuarve qarkoren. Nga Specano na u kthye me lajmin se katër nga ata më me influencë të cilët kishin ardhë prej Kameratë dhe të cilët ishin ndalë, atë mbrëmje, në kafené, kishin vdekur atë natë prej kolerës zhgjetuese, së cilës do t'i ketë hapur rrugë malarja e Kameratës dhe gosta e ditës. Në kaq, u tha se qenë helmuar

dhe kafexhiu, një italian i shkretë, mbas dy javëve, qe mbytë me thika. Prej Akrit, Tomazo Parvolo, kryetar i të pakënaqurve të Akrit e të Longobukos, më përgjegji se njerëzit, në atë stinë, ishin përhapë për korrje. Prej 300 të shkruarve në listë, vetëm 50 do të mblidheshin me në te lumi Mokone.

Më 19 qershor, dërgova një njeri në Tesano tek Paskuale Rosi, me qëllim që të dinte si ishin punët e të më këshillonte. Por korrieri nuk u kthye, kështuqë, në mbrëmjen e 21, mbasi mora bekimin e tim eti, u nisa me nja dhetë vetë të armatosur. Mbasi ia mbërritëm, në orën 5 të natës, në të djathtë të Mokones, u ndalua dhe, simbas marrëveshjes me Akirin, qitëm njëherë me pushkë; dhe, mbasi ndenjëm pak, e përsëritëm dy herë. Por kurrkush s'u përgjegji; askush nuk ishte. Vazhduam përtej, me kujdes, deri në Krati, ku, tashmë, duke zbardhë drita dhe duke u tërheqë, hymë në një kasolle trapaxhinjsh, në atë kohë e braktisur, sepse lumi kishte pak ujë. Prej këndej dërgova një lajmëtar drejt Kozencës. S'kaloi shumë kohë dhe njohëm, në rrugë, njerinë që po kthente nga Tesano dhe po sillte këshillin që të shpëtonte veten. Ktheu, gjithashtu, edhe lajmëtari, që pat shkuar në Kozencë, ku e kishte gjetë çdo gjë në qetësi.

U pat marrë vesh, pastaj, se në të njëjtën ditë, pak larg prej nesh, nga e mëngjërta e kratit, rrinte Xhovani Moshiari me njëzet bashkatdhetarë të vet në Shën Benedetos. Pra vetëm dy arbëreshë kishin dalur në fushën e rrezikut.

Në perëndim të diellit, grupi im u kthye në fshat, duke marrë rrugën nga *Montagna della Noce* dhe nga malet e Akrit. Nga ora 2 e mëngjezit, hyra në shtëpi dhe *multa in corde volutans* rashë në gjumë.

Mbas një jave, u përhap lajmi se Gjenerali de Liguori kishte qenë në Kozencë me *Alter Ego*, dhe filluan nga të gjitha anët t'i dërgonin paditjet, si nga keqbërës si nga lakmues të bukës së Qeverisë. Unë, natën, nuk shkoja më në shtëpi; ditën, në qoftë se për së largu do t'u dukshin xhandarët, çdo grua e fshatit ishte për mua roje që të më lajmëronte. Në fillim të gushtit u shpall në piacë dënimi me vdekje dhe ekzekutimi i njëmbëdhjetë individëve nga shtëpitë e Kozencës, fajtorë për konspirim kundër shtetit. Shumë i turbulluar, babai im më gjeti në vendbanimin në *Via delle Agrene*, që po lexoja në *Vade-mecum*-in tim, të asaj stine, Letërsinë e Frederik Shlegelit; dhe më lajmëroi për këtë ngjarje shumë të rëndë. Nga një ëndërr që kisha parë dy net më parë, edhe pa i besuar plotësisht, unë isha, thuajse, i qetë, dhe e ngushëllova në një farë mënyre. Atë ëndërr, pastaj e mora dhe e riprodhova besnikërisht në Librin e 11 të *Serafinës* sime.

Sepse, në fakt, qe providenciale zgjidhja e rrezikut tim.

1. Në korrik, në trazirat e para, ndërsa ishin të mbledhur, në Shën Mitër, krenët në preturë, dikush propozoi të referohej, si masë sigurimi nga ana e zyrës, për lëvizjen kriminale që ishte zhvilluar në fraksionin e Makit, por kundërshtoi, megjithëse armik i tim eti, D. Salvator Marini, njeri me rëndësi, i cili kishte pasë qenë, për dhetë vjet, kryegjykatës në Monteleone, dhe që kish autoritet më tepër se të gjithë. Ai vuri në dukje se unë isha i matur, por, njëkohësisht, edhe kokëkrisur, me një natyrë që u nënshtrohej pasioneve. Po të nxirresha jashtë ligjit, siç mund të nxirresha, ndoshta, dhe i nxitur nga njerëz të dëshpëruar, që kishin po këtë fat, dhe që s'i përmbante gjë, unë mund të përtërija në komunë krimet e cubave. Dhe, për më tepër, deri sa mos të bënte ankesë kush pranë autoritetit për këtë fakt, heshtja nuk do të thoshte faj. Këto konsiderata i pranoi gjykatësi De Simoni, mik i familjes sonë, dhe nuk u bë gjë.
2. Nga Akri u ngrit një padi kundër Tomazo Parvolos, si kryetar i të përbetuarve (komplotistëve), dhe unë isha shenuar aty si bashkëfajtor kryesor. Por në prefekturë, D. Gjenaro Bafa, shqiptar me origjinë e kunat i Parvolos, ishte mësuar që për krishtlindje e pashkë të bënte dhurata, dhe denoncimi nuk vajti në prefekturë, por, si iu paraqit zotëri Bafës, u la mbanë.
3. Së fundi, një denoncim kësisoji në Specano iu drejtua prefekturës së vendit. Aty emërtoheshin pjesëmarrësit në banketa revolucionare të Kameratës, dhe përmendeshin ligjëratat e tyre. Kryegjykatësi Bizantis e kishte dhënë të vetmen vajzë që kishte në familjen e Frashinëvet të Firmos, të cilët ishin të lidhur me një dashuri të madhe me mua që në kolegji; dhe, nga e cila, ai kishte marrë *Këngët e Milosaos*. E mori, pra, dhe e dogji letër-ankesën. I tha, pastaj, mikut tim Akil Frashinit: “Nuk ishte mirë për mua të filloja procesin kundër të vdekurish; as që do të veproja kurrë kundër Jeronim de Radës”.

Në këto ngjarje, unë nuk mora pjesë fare. Një dorë e jashtme i zhvilloi, pa dijeninë time; dhe vetëm hija e saj u ndal duke u pasqyruar paksa në pellgun e zemrës, por duke ia ndrydhur çdo frigë. Ditën qëndroja jashtë, vetëm të dielave merrja pjesë në mënyrë mekanike në meshë. Kolera ishte përhapur, përsëri, atë vit në provincë; dhe i mbyllëm të dy daljet e Makjit me roje që i kisha në zotërim. Deri në orën tre të natës, ndriçuar nga zjarre të mëdhej, në çdo vend, aty afër, dhe në dritë

ndër sheshe vallëzonin burra të rinj me gra të reja. Mbasi merrnin fund dëfrimet, unë humbisja nëpër kopshtet o në pyjet që rrethojnë vendin, dhe më zinte gjumi mbi armët, nën vështrimin e yjevet. Në netët me shi, futesha në ndonjë kasolle vreshtash o në ndonjë kashtore për buaj, por gjithnjë duke ndërruar vend. Tashti, o pse zjarret shkatërronin mikrobet e murtajes, o pse ngritja e shpirtitave i shpërndante, - gjëra që i pohojnë mjekët, - Makji mbeti i paprekur nga kolera, ndërsa dy fshatrat fqinjë, Shën Mitri e Shën Kozmo, në mes të të cilëve gjindet, u shkatërruan. Mbas gjashtë muajsh, natën e Krishtlindjeve, mbasi ngjarjet e kaluara as që ndiheshin më, ktheva në shtëpi dhe fjeta në shtrat. Megjithatë, atë vit nuk pata guxim të shkoja prapë në Napoli.

Dy vjetët që qëndrova në vendlindje, më forcuan shumë shpirtin dhe trupin. E kaloja kohën, pothuaj, gjithnjë me ushtrime fushore dhe pa pasur kujdes për t'u marrë me rregullimin e administrimit të shtëpisë, kënaqesha me punën e lirë në ajr të hapët dhe pa kokëçarje. E shtëpia kishte pasur nevojë gjithmonë për babën tim që e mori vonë në dorë nga ana praktike dhe për të zhvilluar një veprimtari të gjallë ekonomike meqë e mposhte vazhdimisht kujdesi i kishës që i ishte ngarkuar që prej ndonjë viti; dhe të Makjit të vet, që fqinjët, duke qenë i vogël dhe i varfër, kishin dashur gjithnjë ta nënshtonin. Lexonte e shkruante si përherë, dhe kënaqej që studimi e kompozimi ishte për të një shmangie e vazhdueshme nga jeta. Në atë vit pushimi pa mendime, me orë e me orë, im vëlla, Kamili, duke nxjerrë nga zumaret kombëtare arie shqiptare, na ngrente – si të thuash – shpirtin në qiell; me ato, ai i qetë, shikonte (shënonte) me konture të qarta fytyrat e jetës që i kalonin përpara. Dhe të asaj kohe janë vegimet e lira: *Anmaria Kominiate, D. Agata, Diana, Nasta, Videlaide*. Ato nuk ishin kurrë simbol i ndonjë ideje të paramejtuar, por përfytyrime të thjeshta gjërash, dhe as shqueshin për thellësi pasionesh.

Në verën e vitit 1838 vdiq, mbas dy vjetësh martese, gruaja e ré e vëllait tim, Kostantinit, dhe na u desh t'ia kthenim pajën babait të saj D. Xhovani Bafës, kryepriift i Shën Mitrit. Pak fryt dhanë edhe tokët e grigjët, dhe ky u harxhua për të mbuluar shpenzimet e paparashikuara për kohët e kaluara të djalërisë sime. Dhe mua nuk më vinte keq, edhe pse pakësoheshin mjetet e kthimit tim në kryeqytet, cak, siç më dukej, i jetës sime.

PERIUDHA E DYTË

Në nëntor të vitit 1838 u nisa, përsëri, për në Napoli. Kisha një re-komandim të Rafael Anastazios për Benedikt Musolinon, përfaqësues i Maxinit në qarkun e Napolit. Ky, ndoshta, edhe i paralajmëruar, më doli përpara, i shoqëruar prej dy shokëve të mij të banimit, Akile Frashinit e Dhimitër Strigarit. Kështu që s’pata nevojë t’i dorëzoj letrën, që mbeti në fund të baulës. Pas ndonjë jave, shkova te Zef Epiani, nëpunës pranë Ministrisë së Ekleziastikëve, i cili më paraqiti te Rafael Konforti, që më priti në zyrën e studios së vet.

Ky ishte një avokat penalist i zoti, në moshën ndërmjet 30 e 40 vjetësh, me një mendje të hollë e me një farë kulture letrare, që, ndër ato kohëra, ishte një gjë e rrallë në rrethin e tij. Ky, brenda pak kohe, më dalloi prej të tjerëve dhe tregoi besim të plotë tek unë. Në atë dimër, shpirtin tim e kishin pushtuar dy fantazma: lëvdata, që iu thur poezisë që kish gufuar nga thellësitë e shpirtit tim; dhe revolucioni, mbas të cilit m’u dukte se qëndronte një e ardhme lumturish të pafund.

Shpejt i njoha ambicien e pashpirt e marrëzinë e Maxinit e të shokëve të tij. Në këtë kohë, unë isha i magjepsur nga vegimi i lirisë greke e romake, as që ishte e mundur të mos më dukej arbitrare dhe shtypëse çdo monarki absolute. E shpirti im ishte aq i dhënë mbas Kushtetutës sa që, në një mëngjez të prillit të atij viti, Emanuel Bidera, që ma donte, gjithmonë, të mirën, më qortoi seriozisht, ndërsa isha në Kartolerinë e Fabrisit: “Po ti, De Rada, - m’u drejtua – që pate një Zot, që të flet në shpirt, si bashkohesh me njerëz, të cilët nuk kanë me çfarë të rrojnë e përgatisin kryengritje për të shti (për të futur) në dorë atë gjë që thonë se është e popullit?” E të tillë e përfytyrojnë (është bërë e qartë tashmë) pasardhësit dinakë të mbretërve, të cilëve shteti tash ua ka zënë vendin. Si *përfaqësues*, gjoja, por për t’i pasur e për t’i vënë në veprime të njëjtat gjëra e, më në fund, për t’ua dorëzuar për shfrytëzim pasardhësve të vet. Pajtohej me këtë përfundim edhe eksperimenti që

unë bëja, qysh atëhere, me politikanë *Shpresë-mëdhenj*, të cilët nuk kanë ditur kurrë se ç'është atdheu.

Ndër këto dy vjetë, deri në tetor 1840, përveç detyrimeve të mia, e drejtova shpirtin lirisht e pa kurrfarë kujdesi e gjithëmonë aty ku kam dashur. Dhe kurrë ndonjëherë tjetër mendimi i Zotit nuk u pat larguar kaq shumë nga unë si gjatë kësaj gjendjes sime të brendshme e të jashtme; dhe asnjëherë tjetër, shpirti im nuk qe i pafuqishëm për t'u ngritur deri në lartësinë e krijimeve poetike gjeniale. Ndërmora, në atë kohë, botimin e veprës sime, *Serafina Topia*; e bashkëpunoja, krahas me këtë, në redaktimin e së përkohëshmes *Viagjatore* (Udhëtari), e përkohëshme kjo e themeluar prej Domenik Mauros. Mirresha, gjithashtu, edhe me *dosjet* që më kalonte Konforti. Përveç mëngjezeve, e shihja gati çdo mbrëmje në Molo. Dhe shëtitnim së bashku, duke biseduar me interesim të thellë për gjendjen politike të Europës, e, sidomos, për luftën e Spanjës. Fletët e *Serafinës*, të cilat nxënësit ia patën shpënë Malpikas, poet dhe improvizator i ditës, i bënë këtij një përshtypje të çuditëshme. "*Janë*, - tha, - *parashtrime të realitetit të gjallë, por jo poezi, sepse nuk ka në to asnjë gjurmë klasicizmi*". Me vështirësi të madhe kisha marrë prej Revizorit Kanonik shënimin *Të shtypet*, për çdo fletë. Por, kur ia çova, dhe e lexoi veprën për të thënë *Të botohet*, nuk desh, "*sepse*, - tha, - *këtu është një qiri i ndezur për Jezu Krishtin e një tjetër për Djallin*". Dyshonte, ndoshta, për *Lirinë*; e as nuk qe gjë që t'ia ndërronte mendjen, megjithëse ai ishte një burrë i moçëm dhe i mirë. Mua më shkaktoi një dëm prej 70 dukatësh.

Mbas pak kohe, e ndaloi botimin edhe *il Viagjatore* (Udhëtari) e Domenik Mauros. Bashkë me ne, edhe Vinçenc Padule nga Akri, botohte vjeshat e para të vetat, me një stil të bukur. Të tre ishim shumë të rinj, e mosha jonë e re i jepte edhe vulën e vet së përkohëshmes; punë kjo që ishte me dobi. Ajo u përhap në të gjithë krahinën e Kozencës dhe e lexonin ndër shumë kafenë të Napolit. Por kursimet studenteske, me të cilat mbahej, mbaruan përpara se të bëhej vjelja e pajtimeve dhe, kështu, ajo pati një jetë të shkurtër.

Në Napoli, ndër ato kohëra, ishte në rendin e ditës filozofia e Kondijakut. Prej saj më largonte besimi i krishterë dhe mendjeqartësia ime e natyrshme; nga ana tjetër, me qenë se studimet e mia metafizike kishin qenë të pakta, unë, për çështjet boshe, që përsëriteshin, tërhiqesha i mërzhitur. Me një mendjelehtësi me të vërtetë fodulle, të gjithë ata që simpatizojnë filozofinë e Kondijakut, nuk marrin parasysh, thujse fare, traditën historike dhe, nga evolucioni i pandërprerë, nëpër të cilin kalojnë

speciet, krijojnë konceptet për mosqenien dhe, e flejnë mendjen. Pra, nuk e ndjejnë përshtypjen e keqe, që duhet të shoqëronte atë anë të jetës njerëzore që shpenzohet gjithkund pas punëve, të cilat i merr mbrapa gjithëmonë. Tashti, sipas tyre, pushojnë e humbasin me frytin e tyre, por njerëzimi si valët e pandërgjegjshme të detit, ndjek aty vetveten pa pasur ndërgjegjen e ndonjë fati të vet. E të neverit në gjithë këtë mjerim që në vend të fjalës hyjnore që e zbukuron dhe e lartëson në madhësinë e një planeti të artit të pakufishëm njerëzish të vënë në shërbim të tij e ndalojnë fjalët e marra të një mediokriteti mendjemadh që synojnë ta bëjnë të qetësohet në fatin e shtazëve të tjera, të cilat e shoqërojnë atë, por, tashmë për përdorim e kullosë të jetës së saj mbretërore. E kjo, duke i mbajtur krah mishit vdekjeprurës, me gjithë pamjen e botës hyjnore të pambarim, ndjek udhëtimin e vet me mendime të kota e të habitura, drejt varrit, që do ta mbyllte (e mbyll, e mbulon).

Por do të flas për fatet e mia.

Toka e Makjes, nga veriu, kufizohet me feudin e Dukës së Koriljanos, në lagjen *Koste mançine*, marrë me qirà, atëherë, prej zotëruesvet të Akrit. Kishte filluar korrja e elbit, e qetë e bashkëvendasve të mij, që nuk kishin qenë të ruajtura mirë, hynë në pjesën e tokave të Dukës; kur, ja, pesë njerëz të armatosur, nga rojtarët e qiramarrësit e feudalit, i sekuestruan e po i dërgonin kahë Koriljano. Nganë shpejt të zotët e qevet për t'ua marrë. E, mbas fjalëve që u bënë, vëllau im, Kamili, nëntëmbëdhjetë vjeçar, ngau prej një toke tonën afër atij grumbulli kundër asaj çete. Teksa e panë se erdh, u ndez një grindje për që, ndërsa tjetri vëlla, më i madh në moshë, që kishte dalë për gjah në *Koste mançine*, u hodh aty edhe ai me vrap. Dhe mbërriti aty, kur rojtarët kishin pasë shprazë armët e veta dhe e kishin plagosur vëllanë e tij me saçme në gjoks e ndër krahë. Atëherë shprazi edhe ai armën e vet e qilloi njerin prej kundërshtarëve në fytyrë dhe e verboi. Pushoi të kacafytyrit, duke marrë me vete bashkëvendasit e mij qetë e tyre e secila anë u largua me të plagosurin e vet.

Dy ditë më vonë, togeri i xhandarmërisë, Çiardi, që gjindej në Akri, zbriti me një sasi të armatosurish dhe pushtoi shtëpinë tonë. Por, mbasi e gjetën bosh, përveç dados Andriana, që ishte aty për roje, e motrës sime dymbëdhjetëvjeçare, bastisën shtëpinë e, duke sharë e duke kërcënuar, u larguan së andejmi.

Fill pas, vëllezërit e mij u fshehën, por në korrik Kamili, që u padit për gjymtimin e bërë, ra në duar të forcës /dmth., të organeve/ dhe u dërgua në Qendrorin e Kozencës. Të më lejohet këtu të kujtoj një

ngjarje, që karakterizon vëllanë tim, Kamilin, i cili pat, pastaj, një jetë shumë të vështirë, si edhe shtresën e ulët të popullit kalabrez. Në të ashtuquajturat *Kampreze* të burgut të madh, sundonte si në shtëpi të vet një i burgosur kokëkrisur, që kishte bërë njëmijë e një të zeza, kur kishte qenë i lirë dhe të cilit, çdo i burgosur i ri, ishte i detyruar t'i paguante një farë shume në të holla, në donte që të mos i binte në qafë. Por im vëlla nuk pranoi t'i japë asgjë. Dhe, prandaj, ai dhe shokët e tij iu lëshuan në shpinë për ta paguar. Pa mbyllur java, i dolën përpara ndërsa po hante bukë dhe e provokuan. Ai nuk u foli, por, ashtu siç ishte duke prerë bukën, u sul dhe e plagosi me thikë në gjoks kryetarin e keqbërësve që, i gjakosur, ua mbathi këmbëve, përgjatë rruginës [së burgut] mes brohoritjeve të të burgosurve të tjerë për atë që e kishte plagosur. Atë mbrëmje, fitimtarin e shpallën kryetar të *Kamprezës*.

Mbasi më patën shkruar për arrestimin e tij, Konforti u interesua pranë vjehrrës, e veja e juristit nër zâ Rafaeli, dhe kjo e fundit pranë prokurorit të Përgjithshëm të Kozencës, Deziato Janigro, për një rekomandim. Deziato Janigro kishte qenë, dikur, në studion e të shoqit të saj dhe, që andej, pastaj, kishte filluar karrierën e tij në Magjistraturë. Më parë se të ndodhnin këto, Inspektori i Përgjithshëm i Fanterisë, Mareshali Leka, mbas kërkesës sime, e kishte transferuar togerin Çiardi, si fajtor për veprime arbitrare në Kotrone, ku edhe vdiq nga malarja.

Kahë mbarimi i korrikut, erdhi në Napoli Rafael Mauro, vëllau i Domenikos. Shkova ta shoh e të marr vesh prej tij ndonjë lajm për njerëzit e mij, sepse gjatë atij muaji nuk më kishin shkruar. Kur e pyeta, ai m'u përgjegj me vargun e rapsodivet: "*Në qoftë se do ta thom, ti do të mërzitesh*". "Të gjithë e dinë që vëllau yt do të dënohet me njëzet vjet; që me çifligarët e Akrit është bashkuar kundra jush edhe Marko Madalene da Rende, që në Kozencë bën ç'të dojë. Vëllau yt, Kostandini, ra nga kali në rrugën e Koriljanos, ku lëngon i sëmurë në shtëpinë e Akuilas me një vajzë të së cilit do të martohej. Yt atë, nga të gjitha shqetësimet, e ka humbur, pothuaj fare, dritën e syve; dhe xhaxhai yt, prifti i Shën Kozmos, jep e merr i kapur nga të gjithë".

I mërzitur, zbrita atë mbrëmje në Postë – duke qenë se atë ditë ishte e enjte – dhe gjeta një letër të Kamilos, i cili më pyeste nëse Regjinën e kishin zënë dhimbjet e lindjes dhe nëse kishte shpresë për ndonjë falje, sepse avokati Valentini (i cili kishte hequr dorë nga gjyqi prej kohësh, dhe kishte pranuar të mirrte përsipër mbrojtjen e tij vetëm për hër të miqësisë që e lidhte me mua) i kishte lënë të kalonin të *pesë ditët* pa kërkuar pafajsinë.

Kjo letër më turbulloi pa masë dhe u ngjita një vrap tek Konforti, i cili banonte atje afër, në *Shën Maria la Nova*. Por, megjithëse ai më dha shumë premtime, - e ndoshta kishte mundësi edhe t'i mbante ato premtime – brengën që kisha në shpirt, nuk ma lehtësoi. U ktheva në shtëpi kahë ora njëzetekatër, kërkova një kandil dhe u vura të studioj; por çdo libër që hapja, m'u dukte sikur nuk kuptoja kurrgjë. Derisa, më në fund, vura dorën mbi një ekzemplar të *Dhjatës së Re* (botim i Euterpias), sikur të doja të këshillohesha me të. E, në fletën ku e hapja, m'u paraqitën këto fjalë:

“E filloi një shtërgatë e madhe, e cila valët e detit i hidhte përmbi barkë.

Ndërsa ai po flinte i qetë mbi barkë, ato e zgjuan dhe i thanë: Mësues, a nuk e sheh se ne po mbarojmë?

Atë, duke u ngritur, e mbuloi një valë e madhe ere; atëhere ai i tha detit: ndal, hesht. Menjëherë pushoi era dhe deti ra në fashë. E u bë qetësi e madhe”.

Nuk munda ta vijoj më leximin: dy pika lotësh m'u derdhën mbi libër e ma lanë mendjen pa turbullime. Kaloi e premtja pa u menduar e pa kujdes. Të shtunën paradreke, nuk m'u durua dhe u ktheva në Postë, sadoqë e dija që në Kalabri posta vinte vetëm të enjten dhe të hënën. Por kishte disa muaj që vinte, çdo të shtunë, edhe një korrier qeveritar. U ktheva, pra, në Postë, si pa dashë (vetëvetiu) dhe pyeta. - “Po, - m'u përgjegjën, - ka ardhur për ju një letër, të cilën e ka sjellur korrieri “për hatër”. E hapja letrën dhe lexova: “*Dje, mbas mbrojtjes së Dr. Rafaele Valentinit, që e la gojëhapur tërë auditorin, gjyqi liroi tënd vëlla. Sot ndodhet në shtëpinë time; nesër do të nisët me xhaxhanë tuaj për në Makje*”.

1 gusht 1840

Miku yt Rozario Anastazio

Sikur ma kish thënë zëmra. Dhe, tani, mendja më rrinte te ky mendim: “Zoti e ka përshtatur botën për njeriun dhe njeriu që e sheh këtë botë dhe që dëgjon urdhërat e Zotit, është si të ishte biri i tij”.

Si e mora veten nga ky lajm i mirë, iu vura leximit të dy proceseve, që më dha Konforti; dhe, mbasi vura atje ato gjëra që mendoja se do t'i ndihmonin të pandehurit, i dërgova në shtyp. Kisha vendosur, aso kohe, të mirresha me Drejtësi.

Por para se çështjet të shkonin në gjyq, kur një natë, andej nga ora dymbëdhjetë, disa drita fenerësh ma prishën gjumin. Banonim në një dhomë të gjerë me katër shtretër: dy vëllezërit Rafaele dhe Gabriele Xagareze, Gjuzepe Konsolle, që u bë, më vonë, Këshilltar i Gjyqit të Lartë në Katancaro, dhe unë. Ishte zoti Markez Kançelier i Xhuntës së Shtetit dhe sekretari i Prefekturës së Policisë, me një turmë policësh me drita dhe me armë. Pyetën për mua dhe unë u ngrita menjëherë. Më pyetën nëse e njihja një farë Benedetto Musolino. “E nga është ky?” – u gjegja unë, gjoja sikur nuk e njihja. Po nuk folën më asnjë fjalë; shtuan vetëm se Ministri kishte pak punë me mua. M’u desh t’i mbyllja shkrimet në baule dhe të shkoja me ta në Prefekturë. Nga të dy anët e shkallëve qenë rrjeshta me xhandarë, kështu që i thashë i habitur: “*Venerunt ad me cum fustibus et lanternis*” (Erdhën tek unë me shkopinj, dhe me llamba).

Në Prefekturë u shtriva në një kanapé dhe vijova gjumin e ndërprerë, as s’kuptova, as s’ma mori mendja rëndësinë që i jepej arrestimit tim. Atë vit, kishin vënë dorë mbi *Italinë e Re*. Vëllezërit Musolino, Rafaele Anastazio dhe Setembrini qenë kapur e futur në burgun e S. Maria Aparentes. Prej Akrit i ishte dërguar Qeverisë një grumbull me letra të kapura me anë të të cilave unë i jepja lajme tim eti mbi aleancën katërpalëshe, etj. etj. Kisha filluar të bëhesha i njohur, aso kohe, në qarqet e kryeqytetit; dhe kishin, ndoshta, arsye të shpresonin se në letrat e mia do të gjenin ndonjë fill drite që u nevojitej (u duhej).

Në mëngjez më morën në pyetje. U kontrolluan letrat, të cilat Inkuizitori Markeze, mbasi i lexonte, i hidhte të gjitha për dhé. Kur nxori nga të fundit e pashë në dorë letrën e Anastazit, që kishte brenda rekomandimin për Musolinon, pashë se mbarova, dhe, as nuk më ndihmoi tjetër, veç nëna e Zotit, që i lutesha për ndihmë me besim. Dhe ja, ndodhi që, ndërsa Inkuizitori përshkonte me sy letrën e Anastazios, në fund të së cilës ai kishte vënë emrin, por jo mbiemrin, letra tjetër e bashkangjitur me të shkau e ra poshtë mbi pirgun e atyre që dergjeshin për dhé. Ai më pyeti se kush ishte ky Rafael Mauro, për të cilin bëhej fjalë në letër, unë iu përgjegja pa të keq. Dhe, ose nga që ndoshta kujtoi se ishte fjala për një Mauro dei Kazali, të cilin e kishte kumbar dhe që qe arratisur në Zvicër, dhe e mbante në dijeni mbi veprimtarinë e të mësuarve italianë të atjeshëm – ose nga që ishte i lodhur dhe punë të tjera, më të rëndësishme, e thirrnin gjetiu, nuk u ul ta mirrte letrën e rënë, por përshkoi me sy edhe ato pak letra që i kishin mbetur dhe më nxori jashtë.

Më kthyen në burg kur ishte mezi i ditës; shërbyesja më kishte sjellur drekën, të cilën ma kishin dërguar shokët. Kjo vazhdoi tërë kohën që qëndrova në Prefekturë. Mbas tri ditësh, erdhi të më takojë vëllau i Konfortit dhe më solli 10 pjastra, që ia dhuronin autorit të kujtimeve dy klientë të tij të liruar. Kur kisha hyrë në burg, kisha patur me vete vetëm gjashtë karlina.

Mbas një jave, më çuan në Shën Maria Aparente, ma vunë shtratin bashkë me Kozentinët Salfi, Stumbon dhe Milonen, që kishin qenë të përzierë në kryengritjen e dështuar të vitit 1839, në katër dhoma të ndara, nëpërmjet një rrugine, nga oborri. Mbas disa ditësh, erdhi atje edhe një farë Rugjero Kolonelo, një kalorës që zbriti i brohoritur në *lampione*. Ai, nuk e di ngase, tregoi se kishte një farë nderimi për mua. Nëpërmjet tij i dhashë një pjastër Kryetarit-Kamorra, Kopola di Salernos, që ishte një mik i tij i vjetër, si shpërblim për shërbimet që do të na bënte në të ardhmen si gjellëbërës i të burgosurve.

Ai qe një muaj shumë i qetë; dhe unë, në atë vend, që ngrihej mbi zhurmën e qytetit, mbi detin e hapur në të gjitha drejtimet, me një besim të madh s' di se ku, harrohesha mbas përfytyrimit të fundit tragjik të Astirit dhe të Gonetës, si dhe mbas peripecive të Gjon Huniadit në burgun e Belgradit. Por ka një demon armik në jetën e çdo njeriu, që nuk e le kurrë të qetë me veprën e tij djallëzore: menjëherë, porsa dielli arrinte në kupë të qiellës, kisha përshtypjen se më ngulej në kokë një gozhdë, që më shkaktonte një vuajtje kaq të madhe sa që shtrihesha e përpëlitesha në shtrat, pa gjetur dot shërim.

Mbas një muaji, më liruan prej burgut; por dhëmbja e kokës nuk pushoi veçse ngadalë jashtë. Si punë e parë, shkova në studion e Konfortit për të rifilluar profesionin tim legal. Mirëpo, mbas tri ditësh, ndërsa bëheshin gati që të shkonim së bashku në gjyq, hyri në studio një Inspektor i Policisë, i cili pyeti nëse unë ndodhesha atje. Kur i thashë se po, u largua. Por, pastaj, u kthye përsëri të hënën e javës tjetër; të gjithë, sa qenë të pranishëm, u tronditën. Atë mbrëmje shkova te Konforti, të cilin e gjeta vetëm me zonjën e tij, dhe i thashë: "D. Rafaele, me sa duket nuk paskam më të drejtë të përfitoj nga mirësia juaj. Klientët tuaj mund të mendojnë, për faj tim, që nuk shihen me sy të mirë nga qeveria dhe t'u largohen. Pra, më lejoni të largohem, ndonëse nga Ju unë nuk do të ndahem kurrë. Xhandarët më kanë detyruar të gënjej dy herë deri tash; kurse sot po më pengojnë në karrierën time". Vura re se D. Angjelika, bashkëshortja e tij hirëplote, u trondit shumë nga këto fjalë.

II.

Nuk kisha, vërtet, ku të vija kryet. Matteo de Augustinis, një nga liberalët e parë të Napolit, i cili ishte duke botuar disa komente për Kodin civil për të hapur në nëntor një shkollë, kur mori vesh si i kisha unë punët, më propozoi dhe nguli këmbë që ta hapnim shkollën bashkë: Ai, si mësues i së Drejtës civile, unë si mësues i Kodit penal. Por nuk munda të pranoj, sepse nga ligjet penale dija vetëm nenet që më nevojiteshin në praktikë; nga ana tjetër, nuk kisha pasur kurrë rast t'i flisja, në gjuhën italishte, një grumbull dëgjuesish dhe këto dy të meta ia dija vetes.

Por Zoti kishte vendosur të më falte pak qetësi mua dhe, anijes së jetës sime, pak erë për të ardhmen. Ndërkaq, unë isha shumë i sëmurë. Përveç rrugës pak të gjatë në pishën e diellit, më lodhnin edhe shkallët që ngjitja; dhe një mëngjez, vura re ca shënja gjaku në pështymë. Por pata kujdes që të mos e bëj fjalë me njeri e, veçanërisht, me tim atë: lirimi im i kishte ngushëlluar disa dhe më 10 tetor mora rrogën e muajit. Në gjysmën e parë të tetorit, erdhi në Napoli Çezare Marini, një bashkatdhetari im, vëllai i D. Salvatores, një nga personat e nderuar të Shën Mitrit, që më kishte dhënë një ndihmë të madhe më 1837. Ky, duke qenë avokat primar i Kalabrisë, kryente në Kozenca punët e Kavalierit D. Nikolla te Markezi Spiriti që, pjesën më të madhe të pasurisë, e kishte në Kalabri. Ky i fundit, i qe lutur t'i gjente një mësues privat për të birin e tij të vetëm njëmbëdhjetëvjeçar. Marini kish dëgjuar të flitej për mua dhe më njihte e, më propozoi. Kishte marrë përsipër, gjithashtu, të më takonte dhe të bisedonte me mua. Pranova dhe shkova te ai zotni dhe u morëm vesh. Kështu, më 1 nëntor 1840, u ula në tryezën e tij duke qenë aty të pranishëm i biri dhe e shoqja, e bija e Baronit Pasalakua, një grua kaluar të dyzetat. Më 1839, u kishte vdekur në kolegjin e jezuitëve një djalë 14 vjeç; një vajzë e rritur, që ishte fëmija e tyre e parë, ndodhej në kolegjin mbretëror të S. Marçelinës. Atë mbrëmje kuvertat, çarçafet, dysheqet etj., të shtratit tim, i ndava me shërbëtorët dhe shërbëtoret e shtëpisë së re.

Krejt i çkujdesur tani për të ardhmen, iu kushtova i tëri kujdesjeve për nxënësin tim dhe përsosjes së vetes sime; dhe, pothuaj, si i dehur nga dëshira për punë, nuk çaja kokën për sëmundjen. Ngrihesha në mëngjes në orën gjashtë – si më ishte bërë zakon gjatë kohës së gjatë që kisha qenë në Kolegj – dhe shkruaja derisa të zgjohej familja. Pastaj filloja mësimet, të cilat i vazhdoja deri në orën 10.30', që ishte koha e sillës; si kalonte një gjysëm ore, rifilloja mësimin; dhe kjo më dëmtonte.

Nuk kisha studjuar kurrë menjëherë pas buke, por mirrja një sy gjumë. Aty nga ora dy dilnim shëtitje me karrocë dhe ktheheshim, kur zinte të ngrysej, për të ngrënë darkën. Po kur ngriheshim nga tryeza, në rast se nuk shkonim në teatër, duke qenë i lirë, unë kthehesha, përsëri, në studimet e mia, që zgjatnin deri natën vonë. Ky çrregullim jo i zakonshëm për mua, duke mos ecur më vazhdimisht, të ushqyerit në orë të ndryshme dhe me ushqime të tjera, ma prishnin dita-ditës shëndetin. Herë pas here pështyja gjak; mbasi studioja për një kohë të gjatë, bija në shtrat si i mposhtur nga ethet; dhe natën bëhesha qull në djersë. Mjeku që më vizitonte, më mori gjak tri herë gjatë muajit; aq sa, nga dobësia e madhe, m'u shpif një kollë, që s'mbahej; pastaj, nga mbrëmja filluan të më zinin ethet që më zhytën thellë në trishtim.

Në këtë gjendje më gjeti nata e së kremtes të së Papërlyemes. Qull në djersë dhe me kokën e rëndë, me dhimbje në shpinë, më mposhti natën vonë një gjumë i lehtë si me përçartje, nga i cili më përmendën, mbas pak, kambanat që binin për festë nga të gjitha anët e Napolit. Një vit më parë, në mos u gabofsha, Pio IX kishte shpallur të *Xanunit e Papërlyem (L'immacolata Concezione)*. Bashkë me kambanat, Vigjanet u binin gajdeve, përpara një grazhdi në bodrumin përposh dhomës sime të fjetjes. Nuk e di se si, por, si i goditur nga një mendim i zbetë, ndeza dritën, u veshja, shkrova dhe blatova në këmbët e Mbretëreshës së Krishterëve një lutje për shëndetin tim. Meqë lutja në ritme shqiptare doli mirë, më qetësoi shpirtin dhe zura ta përkthej prozën italisht në qetësi të madhe, ashtu siç mbeti më pas si kushtim i poezisë sime shqipe që erdh pas Milosaos. E lashë mbi tryezë origjinalin, që të mos u shkyente ashtu i hapur siç ishte prej lotësh. Mbasi dola vetë prej dhomë, ose ata që e ndreqën dhomën, e fshinë, ose era që hyri nga dritarja e hapur, e qiti jashtë; dhe unë nuk qesh i zoti ta rishkruaj shqipe /dmth., unë mbeta pa të e nuk dija më ta përsërit/. Por, sidoqoftë, e ndjeja veten të gëzuar dhe krejt e sinqerisht të çkujdesur, pse, qysh atë ditë, nuk pashë më asnjë shenjë gjaku; ashtu edhe ethet e të djersitunat pushuan gjatë javës. Shpirti që e kujton, është edhe sot i prekur e është dëshmitar i suksesit. E njëjta lutje më ka mbetë shenj i nderëve hyjnore.

Në mars kaluam në vilën Amoretta, dhe këtu rrezet e para të diellit më goditnin në mëngjes nëpër ullishtet e kopshteve që mbanin erë luleportokalli. Pastaj, dy orë para mesditës, bridhja në kalë me nxënësin tim deri rrëzë Vezuvit; mbasi ktheheshim, uleshim në tryezë për të

ngrenë bukë. Mësimet në atë vend pushimi qenë pakësuar në katër orë ditën. Në mbrëmje zbritnim në Portiçi e deri në Granatelo unë, nxënësi dhe ati i tij, i cili, si më foli, e dëgjova nga afër, më deshi më tepër se çdo të huaj tjetër. Shplodheshim pak diku në ndonjë kafene, pastaj ktheheshim në shtëpi me gjysëm ore natë. Nga Portiçi, më vonë, në verë, kaluam në Kastelamare, në banjat, në ujërat termale, dhe në shëtitjet mbi gomarë për Kuizizanë. Kur kthyem, përsëri, në Portiçi, në shtator, m'u hapën damarët hemorroidalë; dhe shëndeti më mori për të mbarë si kurrë herë tjetër. Të gjitha këtyre iu shtua ajo që është për njerëzit si një shenjë e Parajsit: ndjeva se kisha pirë në burimin e Hirit, një privilegj ky i rrallë për njerëzit.

Provimet që dha djali në nëntor, e mbushën me gëzim familjen e tij, që ishte mbledhur, atëhere, e gjitha në shtëpi në Napoli. Edhe unë kisha përfituar, duke përvetësuar aty shijen e rregullit dhe të ekonomisë, që atëherë përgjithësisht nuk njihej prej shtëpive arbëreshe. Vitin tjetër, shkrova, me një ankth të ethshëm, tragjedinë *Numidet*. Por as orët e papërshtatshme të vetmet që kisha të lira, as leximet e Tit Livit dhe të Plutarkut, nuk kishin frymëzime për të më dhënë.

Nevoja për nam u bë për mua, si një makth i vërtetë, një vit më vonë, kur dashuria për një vajzë të virgjërt nga derë e madhe, depërtoi në jetën time që, siç më dukej, nuk ishte aspak e pasur; ajo vajzë zëvendësoi për mua deri edhe veprimin e Zotit. Ajo ka qenë re për mua që, e përqaftuar, s'ta përmbush dot dëshirën; mbas pamjes së bardhësisë së saj, kridheshin parreshtur dhe, ndoshta, pa e ditur (= mbas pamjes së bardhësisë së saj, u drejtova pa u shpëputur më kurrë, edhe ku unë nuk e dija aspak)¹⁶³.

Në kohën e krezhmëve, mbasi mblodha disa shokë, u lexova atyre "*Numidet*", por nuk vura re që të prekeshin. I ligështuar, i ndrydhur nga një afsh përvëlues, që nër mua shkoi duke shkrire gjithçka dhe që ma kishte shndërruar frymëzimin në një dëshirë kapitëse. Por, megjithatë, kulti për një krijesë njerëzore, nëse më bëri që të shmangem nga aspiratat e rinisë sime të parë dhe më ngatërroi me botën që më rrethonte, më liroi, gjithashtu, edhe nga një varg të metash. Nxitesha me shpresa të vagëllyera (të papërcaktuara) për një punë të madhe

¹⁶³ *Skënderbeu i pafat*, libri V, Botimi Mormile, Napoli, 1873.

dhe të pastër. Shpirti i Hyjneshës sime nginjej (mbushej) me idealet e mia dhe shpirti im me çfarë i pëlqente asaj: fenomen ky i zakonshëm në një miqësi me të vërtetë fisnike. Duke pasë humbur shpresën për nâmin që mund të fitohet nga teatri, u mora me studime të tjera. Po atë vit, botova, në gazetën “*Luçifero*”, *Hyjnizimet pellazgjike*, të cilat u riprodhuan, më vonë, në botime të tjera dhe prej të cilave ishte vënë në dukje se vetëm gjuha shqipe ishte në bazë të politeizmit helenoromak dhe se ajo ishte e vetmja në gjendje për ta shpjeguar atë. Profesor Dorotea i Universitetit të Napolit e pranoi i pari tezën time dhe më njohu mua zbulimin e identifikimit të pellazgëve me shqiptarët, zbulim ky që, më vonë, u pranua edhe nga shkenca europiane.

Rifillova, më vonë, botimin e *Serafinës*, në të cilën hidhja fazat e ndryshme të figurës që më shkëlqente ditën dhe më linte pa gjumë natën. Por stilit lakuriq, aktiv të *Milosaos*, të spërkatur me figura të freskëta, të *Serafina* e ripunuar, i vihej përballë një tepri figurash e mendimesh, që i përmbyste aksionet dhe personazhet. Mbas saj, në këtë botë të pafund ishte (gjindej), siç thashë, një dëshirë e pafuqishme, ashtu si mund të jetë në një jetë që është rob e vështrimeve, e zërit dhe bilë edhe e heshtjes së një Zonje. Kishte, gjithashtu, si shtytje e model poezinë frënge të asaj kohe, edhe faktin se në krijimin e saj më shoqëronte jehona e pianos, që vinte së largu, nga dhomat e brendëshme, me variacionet e saja monotone.

E pengonte, gjithashtu, krijimtarinë përpjekja e palodhur dhe këmbëngulëse për restaurimin e gjuhës shqipe, së cilës i qe këputur më se një tel, dëshira e flaktë që ta edukojta atë në paraqitjen e jetës më të mirë. Dhe fryt historik i këtyre shtatë vjetëve, qe restaurimi nga unë i gjuhës amtare dhe i fisnikërisë së popullit që e flet, vepër kjo që atdheut tim i vleu më shumë se çfarëdo vepër tjetër arti. Nga ana tjetër, edhe stili i *Serafimas*, i rënduar nga teprica e aksesoreve, nuk u prit keq nga publiku që, tani, ishte mësuar. Ajo u bë shkak, për më tepër, i një vizite të Alesandro Poerios së ri, vëllaut të Karlos, kthyer atë kohë nga Parisi, ku kishte ndenjtur për një kohë të gjatë, dhe i cili humbi jetën e tij heroike, më 1848, në rrethimin e Venedikut. Profesor Mazi, që u bë më vonë Kryetar i Administratës Qendrore për Studimet në Itali, në një artikull të tij, nuk e mbaj mend se në cilën revistë, e krahasonte këngën e dytë me tabllotë e mahnitëshme të Biblës.

IV.

Këtu e ndjej të nevojshme ta kthej tregimin në ngjarjet e jashtme të jetës sime, në ngjarjet prej të cilave më shkëputi takimi, do të thoja, me Zanën, e cila më bëri, më vonë, që të jem i lidhur shpirtërisht me Onestët. Dhe kaq e thellë ishte, gjatë atyre viteve, shkëputja ime nga gjithçka, sa që më vonë e mora vesh vdekjen, në lindje e sipër, të D. Anxhelika Konfortit dhe s'munda, kështu, t'i bëja të shoqit dhe nënës së saj një vizitë ngushëllimi për atë lule të pafat (fatzezë).

Im vëlla, Kamilua, si doli nga burgu, veshi petkun e priftit; dhe, si u shugurua prift, erdhi në Napoli për t'u pajisur me arsimin shkencor. Por, për fat të mirë, një ditë, një farë imzot Engjëll Antonio Skoti, Delegat apostolik për Kolonitë greke të krahinës së Napolit, duke kaluar për të kontrolluar përgatitjen arsimore, e pa këtë prift të ri dhe desh të bisedonte me të, meqenëse i nevojitej për Kishën greke të Leçes. U morën vesh dhe Kamilua, mbas një jave, u emërua famullitar dhe u nis për në Pulje.

Kavalieri Spiriti kish për xhaxha një farë Duka Marota, shumë plak dhe nuk di nëse ishte beqar apo i vé, pa fëmijë. Ai, vetëm për disa merita që kishte kundrejt Francës, qe përjashtuar nga masat e marrura për zhdukjen e feudeve, të Xhuzepe Bonapartit. Vdiq në atë kohë dhe e la *Feudin* që të ndahej në mes të *vasalëve*; por, në të njëjtën kohë, e bëri nipin e tij, Spiriti, trashëgimtar të titullit të Dukës dhe, ndoshta, të 100.000 dukateve të investuara në ndërtesat e tij, që i kishte në Napoli dhe në të ardhurat e Librit të Madh. Kavalieri Spiriti, me gjithë familjen e tij, veronte gjashtë muaj në vit, në Portiçi dhe në Kastelamare, kështu që, të shumtën, një ose dy herë në javë, unë e shikoja Napolin, dhe orët e paka që qëndroja atje, nuk ishin të miat.

Këtu dua të tregoj se si, gjatë atyre çasteve të këndëshme, u kujtova në një ditë feste edhe për Zotin, për shkak të një ngjarjeje të çuditëshme që e jetova në ndërgjegjen time, pothuaj si një skandal.

Në Portiçi, për festën e Shën Mikelit, zhvillohej çdo vit, dhe besoj se zhvillohet endë sot, një procesion solemn. Në mes të procesionit qëndronte, në vend të Shën Mikelit, një djalosh i veshur si luftëtar romak, që tërhiqte, të spërdredhur në këmbë, një përbindësh të vogël prej druri e me dy brirë, e që përfytyronte djallin. Kur qëndronin, Dhiaku e tymoste këtë maskara me temjanicë. Por vdekja e Jezu Krishtit nuk qe një Komedi! Një gjë është e vërtetë: derisa të krishterët e dinë që nuk mund të presin nga priftërinjtë e tyre – ashtu si nga shenjtorët qëmoti – që t'u shërojnë të sëmurin në shtëpi, që t'i japin dritë të verbërit, që

t’i kthejnë jetën të vdekurit, të gjitha ato marrëzira, atëhere, zbulojnë arsyen e thellë të Pazotësisë (Impotencës). Le të supozojmë se priftërinjtë janë interpretuesit e doktrinës ungjillore. Kisha rrallë na paraqet shenjat e virtytit të Fjalës hyjnore, që u komunikohet vetëm atyre, tek të cilët Besimi, Dashuria, Pafajësia e shtojnë numrin e vëllezërve të të Birit të Zotit.

Në atë strehim (azil) paqeje, mezi më erdhi jehona e revolucionit të Regjos, që dështoi mbas atij të Riminit dhe të Bolonjës. Ndërkaq komitetet e fshehta, o sepse njerëzit e krahinave ishin gënjer nga relacione njerëzish pa gjykim, o sepse agjentët e policisë luanin me ta, o sepse, përkundra, ishin të detyruar të vepronin nga kush i mbante, në mos qoftë ato Komitete, që luftonin nga një vend i ngurtë mezi po pritnin që të dilnin nga varfëria e tyre – nuk e njihnin lodhjen për të bërë përpjekje të reja revolucionesh. Dëgjoni tani se ç’do t’ju them unë me të vërtetë.

Një mëngjez, së bashku me Dukën, erdhëm nga Portiçi në Imakolatela për të pritur kunatin e tij, Baronin Pasalakua, që vinte nga Kalabria. Po me atë vapor, erdhi edhe Xhovani Moshiari, për të cilin kam folur në librin e parë të kësaj Jete. Ndërsa zbarkonin valixhet, u hoqëm mënjanë me këtë, dhe unë e pyeta për gjendjen e njerëzvet në Kozentino. “Italianët, - m’u përgjegj, - kanë rënë në gjumë të thellë; ndërmjet shqiptarëve, përkundrazi, ka disa njerëz liberalë e të vendosur”. Nuk kaluan as pesëmbëdhjetë ditë dhe më erdhi një ftesë nga Komiteti Kushtetues i Napolit, të cilit i caktova orën e mbledhjes. Atje, në shtëpinë e avokatit Avelino – që s’kishte pasur kurrë sukses në ndërmarrjet e tij – gjeta një rreth të ngushtë personash, pjesërisht të panjohur për mua. Kërkuan që unë të nisesha e të vihesha në krye të një lëvizjeje të përgatitur në Kalabria Çitra; atdheu nuk do të më linte pa ma shpërblyer këtë sakrificë. U parashtrova atyre, miqësisht, ato që më kishte thënë Moshiari, u kujtova fatin e vitit 1837; u thashë, gjithashtu, se atje nuk njihja njeri, që ta donte Italinë deri në atë pikë sa që të vinte në rrezik jetën dhe pasurinë e tij. Ata më thanë se “Abrucet dhe Molizeja ishin gati për të ngritur krye, dhe se diversioni në Kalabri do të kishte qenë një ndihmë vendimtare”. “E po mirë, - u thashë unë, - ky diversion, atëhere, do të jetë i lehtë dhe i rëndësishëm vetëm mbas një kryengritjeje të vërtetë në Sanio. Nuk kam ndër mend të ekspozoj veten dhe bashkatdhetarët e mij në një aksion që mund të dështojë”. Kur u largova, m’u dukën të menduar.

Ç’është e vërteta, nuk e di në se, edhe sikur të mos kishin qenë vështirësi kaq të mëdha, unë do të mund të bëja gjësendi; kurrë nuk kam shkuar në mendjen e të tjerëve. Dhe, ndoshta, vetëm atëhere munda të thom për fatin tim me aq vërtetësi:

*Fryni erëra, bini shira, e, né, këtu brenda,
duke na mbajtur Fati të bashkuar, mua dhe ata, u haptë bota
që të fluturojë Lumturia që unë pata.*

Por s'kishin kaluar as pesëmbëdhjetë ditë dhe, pranë një ujëshitësi në Toledo, takova Domenico Mauron, i cili, mbasi më dha dorën, - "Çfarë do, - më pyeti, - t'i them babait tënd nga ana jote? Sepse nesër do të nisem për në Kalabri. Jemi në vigjiljen e një revolucionit të vërtetë dhe duhet të ndodhem atje". Desha t'i ndërroj mendjen; i fola për ato që më kishte thënë Moshiari. "Moshiari ka vajtur vetë atje qysh të shtunën", - ma ktheu Mauro. Ishte një djalë trim, por pa spërvojë në marifetet e gënjeshtërs. "Veç kësaj, ka më se një vit që jam bashkuar me ta, u kam dhënë fjalën dhe nuk mund ta humbas nderin tim duke u tërhequr tani, përpara rrezikut të aksionit".

U nis së bashku me pesë a gjashtë studenta. Mbas një jave, arbëreshë nga Shën Benedetto dhe nga Mandamenti i Çerxetos, gjithësejt një pesëdhjetë veta, hynë një mëngjez në Kozenca që të nxitnin popullin të ngrinte krye; qenë të gjithë djelmosha të zotë, të bashkuar jo nga gjësëndi tjetër, por vetëm nga një aksion trimërie (provë trimërie) dhe të nisur drejt një vendi ku u kishin thënë se i pritnin shokët. Në vend të tyre, përkundrazi, i pritnin ushtarë në këmbë dhe në kuaj, që, me t'u ndeshur me ta, hapën zjarr kundër tyre me një farë rregulli. Aty u vra komandanti i xhandërmarisë, i biri i filozofit të shquar Galupi, si dhe shumë ushtarë e kryengritës. Ndërsa nëpër rrugë zhvilloheshin luftime, qyteti mbylli dyer e dritare dhe askush nuk e nxori kokën jashtë; kështu që arbëreshët, ndër të cilët të paktë ishin ata që dinin të mbushnin pushkën me një farë shkathësie, të ligështuar, u tërhoqën dhe u strehuan ndër malet e të parëve, pa u ndjekur më nga ushtarët. Mauro u arrestua më vonë dhe u dërgua në Kozenca së bashku me Françesk Petrasin, nga Çerxeto, një djalosh i dashur ky, i cili kishte qenë, së bashku me të vëllanë e tij, Luixhin, një nga shokët e mi të dhomës në Shën Adriano. Vëllai i tij më i madh u dënua me burgim të rëndë së bashku me Rafaele Kamodokan nga Kastorexhio, që kish dalë para pak vjete gjithashtu nga ky kolexh: që të dy të akuzuar se ishin vënë në krye të arbëreshëve kryengritës.

Moshiari, që kishte dhe harxhoi shumë të holla dhe që kurrë nuk ka pasur zjarr në gjak, duke blerë dëshmitarë e magjistratë, mundi ta ndreqë punën e tij fare mirë, duke u dënuar vetëm *me banim* të detyruar në Napoli.

Por as, për Molizen dhe Abrucin nuk u dëgjua më mbrapa.

PERIUDHA E TRETË

I.

Mua më mbeti kënaqësia se me mpreftësi qëndrova i pafaj. E kisha të njohur thënien e apostullit Shën Gjon: është më i fuqishëm ai që mbretëron tek në se sa princi i kësaj bote. Në rregull: E kisha marrë vesh që më parë, kotësinë e përbetimeve dhe, pra, s'kisha për t'u ngatërruar nëse doja që të mos prishja qëllimin për të cilin u linda. Ndërsa ngjarjet e atyre ditëve ishin për mua ngasje për punë të rrezikshme.

Vashës së zemrës sime, prindërit i përgatitnin një martesë që i përshtatej shkallës së saj: mua më dukej se, mbas kësaj, jeta ime nuk kishte më asnjë kuptim. E shikoja që kishte rënë në një melankoli të thellë dhe besoja se nga shkaku që do ta ndanin nga unë, sepse vitet, gjatë të cilëve ajo qe djegur si një qiri i ndezur në zbrazëtirë, nuk e kishin kredhur në trishtim.

Rreth asaj kohe, kaloi nga Napoli Otoni I, mbret i Greqisë, që shkonte në Bavierë. E shoqëronte i biri i Miaulisit, të cilit iu paraqita për të marrë vesh prej tij ndonjë lajm për të jatin, heroin shqiptar, princin e kryengritjes helenike. Ishte një djalosh shtatmesatar, thatim, me flokë dhe mustaqe të zeza pis, me sjellje të përsosur. U gëzua, mund të them, kur pa sprovat e mia të para për të ringjallur gjuhën tonë amtare. Më këshilloi të shkoja në Greqi, duke më thënë që, kur të kthehej nga Baviera, do të më mirrte me vete në fregatën mbretërore. Kjo më gëzoi, por, gjatë qëndrimit të tij në Monako, marrëveshjet për martesë dështuan dhe mua s'kish më njeri në botë që të mund të më shkëpuste prej saj. Në jetën time të brendëshme të atyre viteve të çkujdesura, hedhin blana drite fazat e saj, e Zanës tokësore, që reflektohen si në një pasqyrë, në vjershat e asaj kohe, bijat e fatit tim.

II.

Ndodhi që, atë verë, të shkonte nga Franca në banjat e Iskjas, poeti Lamartine. Ai ishte në kulm të karrierës së vet të shkëlqyer e të brohoritur. I shtyrë nga padurimi për të ditur në se ndjenja krenare që kisha për veten time, ngrihej mbi ndonjë bazë të shëndoshë, kur Ai kaloi nga Iskia, i dërgova, me anë të një marinari, një kopje të *Milosaos* me *Këngët* e botuara të *Serafinës*. U fol, në rrethin e miqvet të mij, për këtë guxim (thuhej se i kish pritur letrarët e Napolit me mirësjelljen e një njeriu që nuk i njeh) dhe shumë nga familjarët e mij pritnin që mendjemadhësia ime të mirrte dënimin e merituar. Unë kisha zënë shtratin nga dhëmbjet e shpirtit, kur, mbas pesë ditësh, marinari u kthye me këtë letër:

“Zotni,

Jam i lumtur për këtë shenjë vëllazërie poetike dhe politike mes jush e meje. Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja e aty duhet të kthehet. Unë nuk kam pasur asnjë meritë tjetër veçse që e kam parandjerë dhe që kam shprehur dëshirat e para për lirinë dhe ringjalljen e Shqipërisë. Ju më shpërblyet së tepërmi. Më vjen keq për shkakun që më pengon të ju shoh dhe ju lutem të pranoni falënderimet dhe përgëzimet e mia.

Iskia, 8 shtator 1844.

Lamartine”.

Kur u kthye nga Iskia, i bëra një vizitë në *Hotel des Etrangers* (Hotelin e të Huajvet), në bregdetin e Kiajas; më tha fjalë që do të ngjallnin një ndjenjë krenarie në zemrën e cilitdo. Pastaj, disa ditë më vonë, ndërsa po largohesha nga Vila bashkë me dy miq të mij, Ai na kaloi pranë me familjen e Kontit Lë Fevrë, në karrocë; hoqa kapelen dhe e përshëndeta; dhe, ndërsa karroca ngjitej në të përpjetën e rrugës, vura re (pashë) se Zonjushet Lë Fevrë që u ngritën në karrocë, e kthyen kokën nga unë dhe më shikuan, duke m’i ngulur sytë.

Gëzimi i madh ma dehte shpirtin; dhe as kisha vend tjetër ku ta blatoja, veçse në këmbët e Statujës, shpirtin e heshtur të së cilës adhuroja e që ishte i lidhur me timin me zamkë të pavdekëshme.

E në atë stinë e në mes kënaqësisë së tillë ndodhi që të kthehej nga një udhëtim i shkurtër në Greqi, bashkatdhetari im Tomazo Paçe nga Shën Kostantino. Ai pohonte në Arkivin e Madh të Napolit, që drejtohej, aso kohe, nga arbëreshi Mikele Bafi. Ky ishte i biri i të famëshmit Paskuale Bafi nga Shën Sofia, *njeri i pakrabasueshëm*, siç e quan historiani

Bota, duke folur për vdekjen e tij më 1799, i cili, si shumë arbëreshë të tjerë të ndershëm, kishte qenë riabilituar nga Ferdinandi II. Tomazo Paçe njëhte greqishten e re dhe, në të përkohëshmen e Athinës *Minerva*, botoi një përmbledhje të hymnizimeve të mia pellazgjike mbi sfondin e *Politeizmit*. Kur u kthye ai prej Greqisë, mori një letër nga Bukureshti në gjuhën greqishte, në të cilën qenë edhe këto fjalë: “Kur morën vesh se në ngulimet arbëreshe të Italisë lavrohet gjuha amtare, zemrat e shqiptarëve u ngritën peshë”. Këto ngjarje dhe kjo letër i orientuan, përfundimisht, mendimet e mia drejt krijimeve poetike për të nxjerrë në pah jetën dhe gjuhën e një Kombi kaq fisnik dhe më fatkeq nga të gjithë.

Kështu që mendova, në radhë të parë, për një përmbledhje të plotë të këngëve tona popullore; dhe, menjëherë, mbasi nxënësi im dha një varg tjetër provimesh përpara Profesorëve të Kolegjit të Shën Marçelinos dhe familja e tij mbeti shumë e kënaqur, nga ky sukses, i fola Dukës për nevojën që ndjeja për t’i kaluar pushimet e tetorit në shtëpinë time, për t’u ripërtëritur me shëndet dhe për të parë tim atë, pas shtatë vjetësh, që isha ndarë prej tij.

U nisa, duke e pasur mendjen, vazhdimisht, te atdheu im i dashur, ku dashuria e të gjithëve, qetësia e gëzueshme dhe ternimi i erërave malore me puih e detit, që dukej në largësi, më bënë ta marr veten, pothuaj, menjëherë. Takova, mbas pak, gjyshen nga ana e nënës, në shtëpinë e Brailes, dhe më kujtohet se donte të dinte nga unë si ishte ndërtuar Parajsa dhe Ferri. Këtu mblodha disa këngë të bukura kombëtare nga një grua plakë, Tortoshëlja, të cilën gjyshja ime, që ishte një grua shumë e përshtirshme, e thirrte hera-herës e i dhuronte ndonjë send. Shkova më vonë në Shën Sofia, ku ime motër Leticia, që ishte martuar atje, që prej katër muajsh, më dha mundësi, nëpërmjet plakash të tjera të atij vendi, ta pasuroj përmbledhjen e Rapsodive të mia me këngë të tjera të bukura.

Në fillim të nëntorit, mora, përsëri, udhën për në Napoli, ku më shpinte zemra, dhe, për të shkuar atje, preferova të udhëtoj nëpër det. Në gjysëm të rrugës nga Paola, u ndala në mbrëmje në Kavalerico, në shtëpinë e D. Luixhi Melikjit, i vjehri i Çintia Feriolit, e motra e kumatit tim në Shën Sofia. Kishte mbetur e vé prej pak kohësh. Të shoqin e saj e kisha pasur shok klase në Shën Adriano. Mbas darke, me që bënte të ftohtë, u mblodhëm rreth vatrës, ku zuri vend, pranë s’ëmës, një vashë e re, e bija e të zotit të shtëpisë, flokëverdhe, nja 22 a 23 vjeçe, e hijëshme, me trup të hedhur, e heshtur dhe e matur; mund

të thuhet as foli, as ndjeu. Në tryezë nuk kishte qenë, sepse te ne një gruaje nuk i ka hije të shtrohet në tryezë me të huaj. Mbas pak, u ngrit, dhe, e ndjekur nga sherbëtorja, hyri në dhomat e brendëshme, nuk u kthye më. Të nesërmen në mëngjez, i zoti i shtëpisë më kishte përgatitur shtatë trima të armatosur, që më pritshin te dera për të më shoqëruar sepse malet qenë mbushur me banditë. U nisëm nëpërmes mjegullës, që kishte pështjellur gështenjat dhe më lart lisat. Përpara kalit tim ecte një plak, i ati i njerit prej banditëve (Mikariëlji).

Këtu u zgjata disi shumë, por kjo për arsye se e bija e të zotit të shtëpisë, për të cilën unë atëhere nuk pata ndonjë mendim, ishte paracaktuar nga Zoti (fatet e padukshme e tepër të buta të të cilit lidhin jetën njerëzore) si shoqe e urtë e udhëtimit tim të vështirë mbi këtë dhé.

Në shpatin që zbret në Paola, nën një diell të ngrohtë e gazmor dhe me detin përpara syve, i falënderova dhe i shpërbleva ata që më shoqëronin dhe zbrita i lumtur drejt vendit, ku ndalej vapori që do të më shpinte në Napoli. U nisëm ndaj mbrëmjes dhe, para mezit të natës, na zuri një shqotë në Gjirin e Salernos, kështu që atyre të vaporet iu desh të zhgarkonin shumë gjëra e të ndaleshim. Me merak se do të vonohesha për të shkuar atje ku më pritnin dhe duke mos e ndjerë veten mirë nga që më *kishte zënë deti*, nuk e ndjeva, pothuaj fare, rrezikun që na kanosej.

Kur zbrita në qytet, pashë në vashën virgjër si të ishte këputur ndonjë fill lakun që na lidhte, aty-këtu, në shumë vende. Bardhësia e madhe e saj më shtynte të mendoja se do të kish qenë në dhomat e një magjistareje tjetër.

III.

Më largoi nga këto mendime, letra që mora të nesërmen nga Domenico Mauro, i cili më ftonte të takohesha me të në Shën Maria Aparente, ku e kishin shpërngulur që nga burgjet e Kozencës. E gjeta në një qeli tjetër, jo në atë ku kisha qenë dikur dhe unë vetë: në fund të një dhome të madhe, ku kishte njerëz që qëndronin në këmbë dhe të tjerë që rrinin ulur; ne u hoqëm mënjane, pranë derës. Mbasi i dhashë letrat që i dërgonin njerëzit e tij, ai më tha shqip këto fjalë: “Do të kisha dashur të isha takuar me ty, para se të niseshe për Kalabri; kisha disa lajme që do t’i ngrinin atje zemrat peshë. Këtu me ne është Bokkaçiampi, shok i vëllezërve Bandiera, i cili, për hir të demarshëve të Qeverisë frënge, do të dalë së shpejti nga burgu. Ai ka 700 të rinj të *Legjionit të huaj*

të Afrikës; dhe, menjëherë, porsa të ketë në Kalabri zotërinj, të cilët t'i premtojnë se nuk do ta lënë vetëm, është gati të zbarkojë me ta në bregun që do t'i caktohet". – "Unë qeshë i sëmurë, iu përgjigja, dhe nuk pashë askënd; por këtu brenda juve ju kanë kurdisur një kurth. Në kohën e vrasjes së vëllezërve Bandiera, Palmerstoni, kur e pyetën në parlament, deklaroi se ata i kishte dorëzuar në Qeverinë e Napolit një farë Bokkaçiami, i cili spiunonte, për llogari të Austrisë, të mërguarit italianë". – "Po nuk është e mundur, më tha ai; këtë e thonë disa gazeta të ndyra, që paguhen qëllimisht për ta diskredituar". – "E përse, atëhere, i thashë unë, nuk pësoi edhe ai fatin e shokëve të tij?" – "Sepse, m'u përgjegj, nuk u kap në përleshjen me milicinë e qytetit". – "Kish qenë lajmëruar më parë; nga ana tjetër, shokët e tij nuk kanë zënë kurrë armë me dorë. Pastaj, të pyes, si vjen ky njeri në një vend armik, pa e ftuar kush dhe pa pasur njeri që ta presë?" – "I dashur Xhirolamo (ma ktheu ai), e ke gabim; ai është njeri serioz, me pikëpamje të gjëra, veç ta njohësh". – "Jo, nuk dua ta njoh. Po le ta lëmë këtë bisedë; vetëm vini re një send: derisa ai paska pasur një legjion të huaj, përse erdhi këtu tek ne me dhjetë të ngordhur? Ku i ka lënë trupat që ta presin? Kush ia ushqen?" – Këto pyetje sikur e bënë të mendohej mikun tim. Unë, ndërkaq, u largova, duke menduar me veten time: "Që, ndoshta, udhëtimit tim mund t'i japin një kuptim politik ata që merakosen për këtë gjë dhe që Bokkaçiamin e kishin futur atje që ta zbulonte".

Dhe, me të vërtetë, mbas pak kohe, e hoqën që andej dhe, se ç'u bë më tej me të, këtë nuk e mori vesh njeri. Mauron e shpunë në një burg më të keq; dhe vigjilenca e policisë ndaj meje u bë më e madhe. Një ditë, afër Krishtlindjeve, takova vëllanë e Benedeto Musolinos, që kishte dalë nga burgu, i cili më porositi të jem shumë i matur, sepse isha një nga të dhjetë njerëzit e dyshimtë të lagjes Montekalvario. Ai e dinte mirë këtë gjë, sepse, aso kohe, ishte mjek pranë Komisarariatit të Policisë të asaj lagjeje.

Ndërkaq, unë isha izoluar dhe duke i kthyer kurrizin vulgut, që nuk ka zot tjetër veç Dobisë për veten, isha struktur në idealin e Atdheut tim dhe të gruas. Shmangia e një ngushëllim kanë qenë për mua, në këtë kohë, dy mbledhje fisnike që zhvilloheshin nga ora 7 deri në 9 të mbrëmjes, njëra, të premtën, në shtëpinë e Akile De Lakoxierës, dhe tjetra, të shtunën, në shtëpinë e Kav. De Çezares, i pari lindte nga një ish kolonel i ushtrisë së Muratit, nëpunës në Ministrinë e Punëve të Jashtëme. Ishim njohur në zyrën e *Omnibus*-it të Vincenzo Torelit;

kishte botuar një libër të bukur me vjersha të lehta dhe e mbante hapur salonin e tij për letrarë të njohur dhe për të rinj të aristokracisë. Kalorës Gjuzepe De Çezare, një liberal i vjetër që kishte shpëtuar i '99, mbledhte në salonin e vet ç'kish mbetur, endë, nga liberalizmi i 1820. Unë, shumë i ri ndërmjet pleqësh, isha njohur me të me anën enjë farë Napoleone Kazili, mjek asistent në Spitalin e të Pashërueshmëve, i cili, më 1839, më kishte dhënë mësimë private në osteologji, si mua ashtu edhe Dhimitër Strigarit, Akila Frashinit dhe Xhiuzepe Masaritit, i cili mbajti, më pas, temianicën përpara Xhiobertit – që të katër anëtarë të *Italisë së Re*. – Që të gjithë ata zotërinj qenë volterianë, por njerëz të drejtë dhe dashamirës ndaj meje, pikërisht për hir të sinqeritetit tim fetar, që ishte i kundërt me besimin e tyre. Më shihnin të shtunave me kënaqësi, dhe dëgjonin nga unë lajmet politike që u sillja.

Kati i parë i pallatit, ku banoja unë, ishte pronë e familjes *del Poco*, që përbëhej nga nëna plakë, nga një prift, D. Luigji, kapelan i Mbretit, dhe nga vëllau i tij, Ferdinandi, funksionar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ky, në konfliktin e mademeve të sqfurit të Sicilisë me Anglinë, kishte qenë dërguar nga Napoli në Francë dhe bëri që ajo të ndërmjetësonte në këtë çështje. Si u paquan punët, ai qe kthyer në vendin e vet dhe i jepte Dukës gazetën e Francës që i vinin në Ministri – *Débat, Constitutionel, National* – të cilat unë mund t'i lexoja dhe që më shtinin dashurinë për Qeverinë parlamentare. Që andej, nxirrja lajme, pothuaj të sakta, të cilat i komentoja, sipas zemrës sime dhe sipas dëshirave të auditorit, që më priste dhe ishte i lumtur.

E përmenda këtë ngjarje të jashtëme dhe të parëndësishme, sepse u lidh, një herë, me kushtet më intime të qënies sime.

Ndërkaq, mora disa letra nga Kamilua, prej Leçes, që më njoftonin se si, nga një sëmundje e rëndë në krahëror, mjekët e kishin këshilluar të shpërngulej në ndonjë spital të përshtatshëm të Napolit, ku nuk do t'i mungonte, gjithashtu, edhe konsulta e mjekëve të dëgjuar. Me ndërmjetësinë e Gjuzepe Epifanit, - të cilit unë nuk munda kurrë t'i provoj mirënjohjen time – dhe duke ndërhyrë, gjithashtu, edhe imzot Engjëll Antonio Skoti, nxori udhëtimin nga Qeveria si edhe 20 dukata në muaj, që i jepeshin për të përballuar shpenzimet e nevojshme në Spitalin e Paqës, që ishte themeluar për priftërinjtë nga Shën Kamilo de Lelis. Me të arritur, vajta ta takoj dhe e gjeta në shtrat, të dobësuar dhe të kredhur në një trishtim të thellë. I premtova se do ta ndihmoja. Dhe po atë javë, të shtunën, shkova e u takova në

shtëpinë e Kav. De Çezares, një mikun tim që ishte asistent në Spitalin e të Pashërueshmëve, duke iu lutur që të kalonte në Spitalin e Paqës dhe, mbasi ta vizitonte me kujdes, tim vëlla, të më thonte se si ishte me shëndet dhe të më jepte ndonjë këshillë. Të shtunën tjetër, mbasi hyra në salonin e De Çezares, Kazili, që ishte atje, u ngrit në këmbë dhe – “I dashuri De Rada, - më tha, - shpura në Spitalin e Paqës, dy mjekët e parë të Spitalit të të Pashërueshmëve dhe, mbas vizitës, më vjen keq të ju thom se vetëm Zoti – tek i cili ti beson kaq shumë, - do të mund ta shëronte vëllanë tënd”. – Dhe tek Ai unë shpresoj endë”.

Të dielën në mëngjes u hodha një vrap në Spitalin e Paqës dhe e gjeta Kamilon shumë të mërzhitur. – “Erdhën, - më tha, - dy mjekët të parë të Spitalit të të Pashërueshmëve, të shoqëruar nga një asistent, që të njihite; më vizituan imtësisht për një kohë të gjatë dhe arritën në përfundimin se vuaja nga një tuberkuloz në një fazë shumë të përparuar”. Dhe, në atë e sipër, më tregoi një kupëz, që e mbante në krye të shtratit, plot me ballgame, duke më lutur që të mos i shkruaja gjë për këtë babait.

Në vetvete ngjarjet e jetës sime nuk kanë absolutisht asnjë vleftë për njeri, dhe, nga ana tjetër, unë nuk kam as ndonjë arsye që të mburrem me to. Por në atë mënyrë që unë i dhashë veprimin dhe kamjen (bërjen dhe pasjen) lartësimin të gjuhës amtare, rrejtësës së Atdheut shqiptar, po ashtu po parashtroj ndodhitë e jetës sime për stimen (për vlerën) e pashoqe që përmbajnë, aty-këtu, dëshmi të sakta të *Mbretërisë së qiejve*, brenda së cilës u zhvillua veprimi im. Në veri të vendit ku shëtitnim në Kolegjialit e Shën Adrianit, ka qëndruar dhe qëndron një Kishëz fshati “*Kònez e Dhumnikut Gjëljt*” me një fugure (fytyrë) të shenjtes Marie. Pra, një mbremje të gushtit të vitit 1827, duke kaluar andej pari, u shkëputa prej shokëve e, i shkrirë në devocion (*shih për këtë Periudhën e parë të kësaj Autobiologjie*) i u luta, me thjeshtësi, në këtë mënyrë: “Në qoftë se bota më shmangë e më heq nga ti, më tërhiq ti e bën që të mos të humbas (që të mos birem). Njeri nuk e din dhe nuk mundet kurrë të thotë në se atëherë ishte ndokush që më dëgjonte ose më prigjonte; megjithatë do të ishin *dëshmitarë të pohimit* dy Lumturi: Njera, në qoftë se ndër rreziqet e tepërta, një fuqi e paparë e thirrur në ndihmë më tërhoq pastaj vazhdimisht në lirim, e, ndoshta, ky veprim i jashtëm qe shenj i qartë për fatet e mia. Dëshmia tjetër do të ishte një ndër të *Kthyemet* e mija prej të shmangunave kaqë të harruara; por kjo nuk është për kohën e tashme; Orët (kohët) e mëvonëshme mbesin në *mosqenien*, edhe pse nuk paralajmërojnë,

vdekja e tre bijve të ndritshëm e të nënës së tyre të dashur, që më lidhëshin me botën, jetën e detyruar në shkreti, prej së cilës nuk kam asgjë në qoftë se nuk ia lypi Atit të qiejvet e jetën e gjatë të shëndoshë e, gati të ruajtur për fatet që endë nuk janë dhënë.

Duke vazhduar, pra, mbas disa orësh, laçë vëllanë tem pa kurrfarë shprese e, duke këthyer në shtëpi, u ndalova të shoh Meshën në Kishën e Sakramentistëve. Aty, ndoshta, para dhjetë vjetëve, ishte bërë murgeshë një prej të rejave fisnike të Napolit, e tradhëtuar nga dashnori, që pasi shkoi në Romë, e nuk i ktheu më. Ishte ndër këngëtarët dilektante më të përmendura të qytetit; e murgeshat, shoqe të saja, mbasi që ishte bërë murgeshë, e kishin pru (kishin sjellë) në koro një pianofortë, që, duke ia akorduar zërin e saj, që ishte bërë më i këndshëm në atë mjerim, tërhiqte të largët e të afërm në Kishë. Kjo punë, duke marrë, dalë ngadalë, pamjen e një teatri, e detyroi Kardinalin që ta largojë pianofortën prej korit. Por unë, që kisha banimin e parë në Viko de' Venti në Foria, shkoja aty të shoh Meshën, ndër ditët e diela, si edhe ta dëgjoj murgeshën, që më lartësonte mbi vete. Atë mëngjez, shkova kur kishin mbaruar funksionet e hyra në Kishë, në një kapelë anash, ku kishin pasë vendosur një pikturë të ré, aq të madhe sa zinte krejt njerin krah të saj. Përfytyronte të ngjallurit e Lazrit; e, duke parë Madalenën ndër këmbë të Jezusit, rashë edhe unë në gjunj e, i mundur prej një vaji, që më merrte frymën, - kurrkush nuk ishte në atë kohë në Kapelë – përsërita fjalët e saj, drejtuar Birit të Zotit: “Po të kishi qenë këtu, vëllau im nuk do të kishte vdekur”. Nga ky ngashërim u çova (u ngrita), duke besuar në një të prekur të Hirit (Gracies). Nuk pata mundësi të shkoja të enjten të shikoja vëllanë, por, tek shkelja të shtunën në shtëpinë e De Çezares, Kazili, që po më priste, u ngrit, më doli përpara dhe më tha me një frymë: “Kush do ta kishte besuar? Për Zotin, kam parë, dje, vëllanë tuaj, duke më kaluar përpara, më këmbë, me një bastun nyje-nyje në dorë, në rrugën di Portiçi!”. – Unë iu përgjegja: “Po unë shpresoja, që Zoti, në të cilin besoj, do të ma kishte shëruar”. Unë po tregoj ngjarje, gjithëmonë të vërteta, duke ditur se unë i flas një brezi shumë mendjemadh e që ka për citat fjalën e Pilatit: “Cila është e vërteta?”.

Kamilua, mbasi u shërua, u kthye në Leçe; më 1855 u bë famullitar në Makje, duke zënë vendin e atit (babait) tonë, që aso kohe vdiq; dhe jetoi deri më 1883.

IV.

Vitin tjetër erdhi nga Sicilia në Napoli, si famullitar i Kishës greke të Fiorentinëve, Dhimitër Kamarda, shqiptar i vërtetë në zemër e në mendime. Ai vinte e më takonte, vazhdimisht, në Vilë në orët e shëtitjes, dhe bisedonim bashkë rreth ringjalljes intelektuale e morale të kombit tonë, më i shkreti nga të gjitha vendet e botës. Kamarda kishte sjellë nga Sicilia një dorëshkrim shumë të vyer me këngë shqiptare, dhe disa letra të Xhian Françesko Avatit, lindur në Makje në shekullin XVIII, dhe vdekur në Urbino si katedratik.

Nga Urbino qenë nisur edhe shumë letra të tij, që ruhen në Maqë, në shtëpinë e nanëgjyshes sime. Në vizitën që bëra në Shën Kozmo, e për të cilën fola në Periudhën II të Jetës sime, pashë edhe një libër të tij, që ishte gjetur në bibliotekën e D. Fluminio Toçit. Përbëhej nga dy tema: nga Legjenda e fluturimit të Konizmës së Zonjës së Këshillës së Mirë nga Shkodra e Shqipërisë në Gjenecan, dhe nga një letër-shoqërimi për një pako me këngë të lashta shqiptare, të *mbledhura nga goja* e popullit, të cilat ai ia dërgonte Rektorit të P. P. Olivetani të Palermos. Ky lajm më bëri të sigurohem që dorëshkrimi me shkrimin dhe në dialektin e Avatit, ishte Koleksioni i tij që na kishte ardhur nga Palermo nëpërmjet Kamardës.

Bashkëkohës me Avatin qe poeti Jul Variboba nga Mbusati; që të dy, ndonëse me një divergjencë të dukëshme drejtimi, shënojnë të dy një moment të rëndësishëm në fatin e kombit tonë, që pasqyrohet në veprat e tyre.

Poezitë e Varibobës, të lehta, të rimuara, që e paraqesin me besnikëri jetën reale, patën më fat se sa poezitë tradicionale, për ruajtjen e të cilave Avati bashkëpunoi. Dhe kjo sepse subjektet fetare, të zbukuruara nga rima, depërtuan dhe mbisunduan në rrethin e grave, duke bërë që të liheshin mbas dore këngët e lashta të trimërisë, të frymëzuara nga zakonet, nga ngjarjet, nga ndjenjat kombëtare dhe që shoqëroheshin nga Rusalet, koret rituale të këngëve. Mbas ca kohe, edhe këto vjersha u lanë mbas dore, pa e tërhequr dot popullin drejt Perëndisë, si ato që ishin jehona të defit tingëllues priftëror, të xhveshur nga çdo vajim shpirtëror. Në ditët tona ai pati një kundërshtar, përse i përket lehtësisë së stilit, te Kosta Beluçi nga *Shialja* e Shën Mitrit, në fotografinë e mallëngjimit që tërhoqi në këtë fshat të vogël aktoren Adelaide Buratti. Gjuha, si e njerit ashtu dhe e tjetrit, është e mbushur me huazime italiane; dhe rima që (ashtu si tërë poezinë njerëzore) e ftoh fantazinë, te Variboba

ndihmohet nga fjalë italiane, ndërsa te Kosta nga Shialja shtrembëron, që të rrjedhë, vetë fjalën. Për Varibobën dhe për familjen e tij, nuk kam ditur kurrë asgjë. Avai ishte nga një familje fisnike. Në krahinën tonë ka një rrugë me emrin *Konte Avati*; në Kishën e famullisë, në të majtë të altarit të madh, ndodhet Kapela e Avatëve, me një stemë, e cila ka një helmetë sipër saj, e lisiin me luanin që ka çuar këmbën në fushë bojë qielli. Gjatë pushtimit frëng, ndërmjet cubave opozitarë, ka qenë edhe një Mikele Avati nga Makja, një nga më të tmerrshmit syresh. Në Napoli, në Trininë e Spanjollëve, gjatë kohës që banoja në shtëpinë e Spiritit, një Konte Avati banonte në pallatin përballë dhe kishte një vajzë, për të cilën thuhej se ishte nga më të bukurat e Napolit.

Ky largim nga studimet, që kishte për shkak Kamardën dhe ngjarjet politike të shtetit roman, më ndihmoi që të mos e ndjej ose më mirë të thom, që ta zbus vuajtjen që më shkaktoi një ngjarje, të cilën do ta tregoj tani.

Një natë të Karnavaleve, ndërsa ndodhesha në San Karlo me familjen e Zonjës, në palkun e tyre të radhës së parë, na u afrua një maskë nga platea, që, si u kthye nga virgjëresha e re, i tha: “Po ju, Zonjushe, nuk ju gjejmë kurrë atje ku ju lëmë”. Fytyra e vashës u skuq e u bë flakë; nuk tha asnjë fjalë. Pasi kishim dalur dhe, meqenëse ajo u shty prej turmës ca hapa përpara, në treme e arrita dhe i thashë i qetë: “Pra kini ditur të gënjeni”. Ajo, e turbulluar, u largua bashkë me njerëzit e saj dhe u ngjit në karrocë.

Nuk e mora vesh kurrë se cili që njeriu që fshihej mbas maskës dhe as që desha ta dij ndonjëherë; shpirtërat tanë qenë ndarë tani në një mënyrë të pandreqëshme, ndonëse secili kishte mbetur thellë i plagosur. Atë e pllakosi brenga e vetmisë, mbas më se gjashtë vjetësh që e kishte lënë zemrën e saj të ndiqte një re, që kishte lindur për t’u zhdukur në ajrin e dytë (boshatisun). Kurse mua, kjo zgjidhje që bënte pjesë në parashikimet e mia të përditëshme dhe që më çlironte, si të thuash, nga një njollë – mendimi që tek Ajo unë dashuroja jo njeriun, por pasurinë (50.000 dukatë pajë), gjë kjo që më brengoste thellë – kjo zgjidhje më dukej si e dërguar nga provania rojtare e shpirtit tim të ndershëm. Që të harroj, u dhashë pas ngjarjeve politike të Italisë mikpritëse dhe pas misionit tim. Por kur, mbas 40 vjetësh, fati na bëri që të takohemi përsëri, ajo e vé dhe pa fëmijë, unë i lënë shkretë nga dy djemët, të cilët m’i kishin zili të gjithë, ndjemë që të dy se në zemrat tona të heshtura, plaga nuk ishte shëruar.

V.

Vetëm atëherë e pashë marrinë, - që ndoshta s'e ka shoqen ose është më e dënueshme, - nëqoftëse tek unë mendimet më të kota ose ndinji-met më kalimtare kishin errësuar pa-reshtur fytyrën e Atit që na ka në botën e vet, ashtu si nata mbyll bashkë me ditën dritën e jetëve.

Jo si ngushëllim, por për qetësim të çdo vdekje të qenies sime, unë pranoja aso kohe së jashtëmi mburrjen e bashkëkohasve të mij. U përkujdesa për një botim të dytë të *Milosaos*, të cilit nuk iu kursyen lëvdatat dhe miratimet dhe, në botimin e saj të ri dhe të shkëlqyeshëm, botova njerin pas tjetrit *Katër historitë e Shekullit XV: Anna Maria Kominiate, Adhine, Nata e Krishtlindjes, Vidhelaidhe*.

Milosaos, mbas 1841, i kisha shtuar, në çastet e lumtura, disa krijime të thjeshta homogjene, që e lidhnin artistikisht thurjen, dhe që, ndonëse të pakta, mjaftonin për të kënaqur mua dhe të tjerët. Kurse shtojcat, që iu bënë skeletit të *Katër historive* më 1845 dhe 1846, paraqitnin interes jo për shkak të gërshetimit, por nga se bota që paraqitej ishte e plotë. Pasioni që lëngonte gjatë atyre viteve në shpirtin tim, i nxitur edhe nga stili që ishte atëherë i modës, më shtynte të ndalesha më tepër në paraqitjen e njeriut dhe të natyrës, në dëm të ritmit të shpejtë të veprimit. Dhe prandaj u shquan për një kumbim mendimesh, figurash dhe ndjenjash karakteristike për Shekspirin, ndonëse u mungonte drama e këtij poeti të madh, si e ndriçuar nga dielli i mesditës. Le të më lejohet të citoj këtu një strofë: “A– E lanë vetëm të rrethuar nga drita që luante brenda velave të tejdukshme: ashtu si në mal një Zanë pa njerëz me vete, dhe gjithënjë vetëm me fërshëllimën e erës nëpër kullat e njerëzve, që duket krejt e padëmëshme”.

“Dhe, mbasi dielli kaloi mezin e qiellit, pa ngritur nga faqja e detit hijet nga toka me pemë, pika shiu të përziëra me erën e perëndimit, që donte ta shkulte velën e anijes, i lagën gërshetat” etj.

Dua të kujtoj se si në atë kohë më erdhi, i rekomanduar nga Kamilua, i biri i një Gjykatësi që kishte vdekur; dhe se si, duke mos pasur me se ta ndihmoja, i dhurova dorëshkrimin e *Odisesë*, një poemth me rimë të alteruar /strofë treshe, danteske/, me përmbajtje kombëtare, që e kisha shkruar kur isha në Kolegjin e Shën Adrianos. Ai mundi ta botojë, duke ia kushtuar të shoqes së Ministrit të Punëve të Brendëshme S. *Anxhelo*, e cila rridhte, siç thonin, nga ca Princa Shqiptarë, dhe mburrej për këtë. Kushtimi nënshkruhej nga *Saverio de' Marchesi Pirro*, të cilit kjo Zonjë fisnike i dhuroi 250 dukatë. Kam një copë (ksombël) të veprës së botuar.

PERIUDHA E KATËRT

AUTOBIOLOGJIA

Libri IV

I.

Ishim, sikur thashë, në vitin e reformave të Papës Pio XI (1848), agim, si dukej, i Italisë; e kjo hynte gati ndër ditët e saja të lumtura. Gjatë kohës që shpirti im po shërohej, unë ëndërroja së tepërmi ditët e shpresuara të lirisë. Ndoshta ato reforma, për të cilat ndjeja duke m'u qetësuar shpirti, do të mund t'i jepnin Italisë mbarësinë e brendshme sidhe qetësinë; s'qe e mirë, pastaj, t'u jepej qeverimi i vendit Doktrinarëve, që, si Këshilltarë, do të kishin mundur t'i sillnin vendit njohuri praktike. Por *partitë politike*, siç quheshin, nuk u kënaqshin me një gjë, që nuk u epte atë çka prisnin. Dhe, prandaj shpejt, me gëzim të madh, përshëndetën Karlo Alberton, që i fali Piemontit *Kushtetutën e Francës*, e tërhiqte nga Pio IX për vete simpatinë botërore.

Kushtetuta, edhe për mua, përpara se ta shihja për së afërmi, ishte e mrekullueshme. Gojëtaria e Odilon Barrot, Berryer, Lamartine, e ajo më e reja dhe aq e skalitur e Ledru Rolin kishin prishë botën time, vlera e së cilës më dukej, tashmë, ndër ligjëratat madhështore. Ditën e janarit, sapo pashë *Demostratën* në Toledo, që qe vendimtare për fatet tona, u bashkova me të. Ishte e pakët në numër, e mbështillej rreth një flamuri tringjyrësh; thuhej se ishte e filluar prej bijve të familjeve të nalta, Statela, Çirela, Duka di Madaloni, etj. Duke përparuar, mori formën e një shkulmi të madh, duke ju shtuar, gjithnjë e pa pushim, njerëz të klasës qytetare, dhe duartrokitej nga balkonët. Në sheshin e

Merkatelos ishte bërë aq e madhe, sa ju desh kavalerisë që e përcillte, ta shpërndajë.

Qyteti ndej nën ankth, por të nesërmen (frika) u zhduk me lajmin se do të kishte kushtetutë. E, më 27 janar, kjo u shpall me një kremtim të papërshtkrueshëm të qytetarëve që po derdheshin në Toledo. Nga tarraca e shtëpisë sonë në Trinità de' Spanjoli ja dëgjoja jehonën, e shpirti, që më dukej se ishte mbushur me kënaqësi, luste Atin e qiellit me psalmin: *Eulogé hé psyhé mou tōu Kýriou* (Benedic, anima mea, dominem) (Zot, beko shpirtin tim!). Ishte një ditë e kthjellët dhe jo e ftohtë. Pas orën 9 të mëngjezit dola e, duke u futur në Toledo, Akile de Lauzières, i pari që pashë në atë varg të ngjeshur e të pambarim koçish tërë brohorì, më ftoi për të hyrë në tilbury, ku po rrinte vetëm; e vazhduam tatëpjetë duke shkuar drejt Pallatit mbretëror. Këtu prej tarracës mbi kafenenë Europa, Stanislaò Mançini, që qe më vonë ministër i Italisë, na thirri të ngjitem tek ai.

Atje sipër, të mbledhur në një dhomë të vjetër, vendosëm të tre të themelohmë një Gazetë politike, dhe për secilin caktuam lëndën për numrin e parë. Por, si u mblodhëm në ditën e caktuar për leximin e artikujve, filloi mosmarrëveshja për titullin e Gazetës, për të cilën Lauzières donte që të ishte *Il Riscatto* kurse Mançini, përkundrazi, *Il Riscatto d'Italia*, aq sa të ziheshin mbi arësytimin e të dy kërkesave. Unë nuk fola asnjë fjalë, sikur të isha vënë në dijeni që të hahesha me De Lauzière-in, për zgjedhjen e titullit, që e themelonte (organin) me të hollat e veta. Puna nuk eci përpara, e u largova, pa u turbulluar, nga mbledhja pa përfundim. Da Lauzières e nxori vetë *Il Riscatto*; e Mançini qe pranuar bashkëpunëtor në (gazetën) "*Costituzionale*", themeluar prej Barone Beleti-t.

Kështu, në atë ditë plot dalldì, Anxhelo Bazile, një arbëresh nga Plataçi, mbasi pushoi vrapimi i karrocave, u end aty, në krye të dy radhë studentësh të armatosur me shkopinj, duke sjellë flamurin tringjyrësh në qytet poshtë e duke detyruar vegjëlinë kundërshtare që ta përshëndeste. Djalosh, sapo tridhjetepesëvjeçar dhe kryeprift i vendit të tij, i ndezur nga një dashuri e pashuar për një grua të martuar, qe larguar nga famullia prej ipeshkëvit që e dinte këtë punë (edhe për ta shpëtuar nga rreziku i vdekjes). Ishte në Napoli që prej dy muajsh, gjatë të cilëve ishte i zënë me qortimin e bocave të një tragjedie të vet *Ines de Castro*, me të cilën më kishte nderuar, duke ma kushtuar. Ka në të më shumë frymëzim se sa në teatrin e Alfierit dhe, në fisnikërinë e stilit, nuk i lë gjë mangut. Tani, në atë ditë, në krye të

asaj djalërie, së cilës i qëndronte në krye, me veshjen e madhnueshme të priftit ortodoks, shoku im i Kolegjit tërhiqte, nga vetja, deri në mbrëmje, shikimet nëpër rrugat, që përshkonin. U tha atë ditë për të, se kishte bërë një nga ato tepritë e veta, që shkatërruan karrierën e tij. Ishte në Napoli një prift i çuditshëm në jetë, më i dashuri në popull, D. Plaçido Beker. I falej vazhdimisht Jezusit të vjetër. Banova në Pendino, një dimër, e dëgjoja nga mjesnata ndjekësit e tij të të dy sekseve që të udhëhequr prej tij, silleshin nëpër Napoli poshtë, duke kënduar lutje të përshpirtëshme. Populli i thjeshtë e mbante për shenjt, e thuhej, se tek ai rrëfehej edhe Nëna Mbretëreshë; ishte, në anën tjetër, Dita e Ujit të bekuar të studentëve që dëgjonin duke thënë për të se u këshillonte bigotizmin fanatik rrugaçëve e se spiunonte për llogari të policisë. Po çka është e vërteta, ndër dymbëdhjetë vjetët që ndenjta në Napoli, nuk u dëgjua që t'u kishte sjellë ndonjë shqetësim të tjerëve, për të cilën mund të mirrej nëpër gojë.

Në mbrëmje, pra, informatorët u gjinden në strofullin e vet. Plaku i cflitur banonte në dhomën përdhese ku më tregoi, njëherë, shtratin e tij të varur në tavan. Thuhej që Bazile e kishte zënë për gryke, duke e detyruar që t'u besonte për Kushtetutën, por nuk pati frymë ta bëjë, mbasi i rra të pakët prej frikës, dhe e lanë ashtu pa ndjenja. Shëtitja mbaroi me ndezjen e llampave, dhe shkova e gjeta Bazilen, me gjysmë ore natë, në kafenenë *di Buono*, për t'i kumtuar se, në javën e ardhshme, e prisnin në shtëpi të Markeze Linjola, me cilësinë e edukatorit të fëmijëve të tij, zyrë që ja kisha siguruar unë. E gjeta duke ndenjtur në mes të një shumice të madhe njerëzish, zbutur prej djerse e i përkëdhelur me gota të mbushura me rum akulloreje e që i vinin njera pas tjetrës, e që ai i kapërdinte pa u përmbajtur, pa ja vënë mendjen, pa u kujtuar, pothuajse, fare.

Dy ditë mbrapa, kur më pruri kamerierja kafen në mëngjez, më tha: “Ai greku prievite që vjen te ju, ka shkuar me studentë dhe ka vrarë D. Plaçidon; por J. Krishti nuk i paguan të shtunat”. Ky lajm më shqetësoi mendjen, por nuk më preku në zemër. Më padisin, e, ndoshta, me arsye, se jam zemërgur.

Dua të përmend një anekdotë tjetër karakteristike të kohës. Në mbrëmje të Festës së betimit shkova te Paolo Poerio, Drejtor i Policisë, për t'i kërkuar katër bileta hyrjeje për familjen Spiriti. Zyra ishte e mbushur me njerëz në këmbë, e me vështirësi të madhe munda të hap rrugën deri te ai që ishte ndenjtur para një tryeze, e përsëriste fjalët: “Po s'ka më!”. Sa më pa: “De Radë, - tha, - ke filluar të bëhesh i padukshëm!”.

– “Kam ardhur sot për një lutje, - i thashë, - më nevojiten, për nesër, katër bileta palkoje”. Mbasi i nxori prej sirtarit të tryezës, kur ai m’u ngrit për të m’i dorëzuar, të gjithë ata që ishin rreth tavolinës, u lëshuan mbi kasetë; e tryeza u përmbys, duke rënë sipër saj një a dy nga të panjerëzishmit; po të mos e mbante një roje policie që i rrinte pranë, do të kishte rënë në kokërr të shpinës për tokë me gjithë karrigë. Besonin se ishin në mbretërinë e pushtuar prej tyre. *Partitë politike*, vetëm ata që kishin përhapur fjalët nëpër rruga, pretendonin se koha e re do të sillte gjithë të mirat në shkretëtirën e tyre të kaluar, të tashme e të ardhshme. E unë mendova të themelohet një Gazetë që të ndante nevojët e atdheut nga ata që kërkonin prej tij një shpërblim, *Liberalët të së tjerëve*.

Mjetet e mia ishin shumë të pakëta, por më bënte guximtar e drejta. Kontraktova, ndër ato ditë, me Shtypshkruesin Trani, që botonte *Ines de Castro* të mikut tim; dhe, me letër të keqe e me shkronja të vjetra, doli *l’Albanese d’Italia*. Pat pakë lexues në Napoli, por nja njëqindesëdhjetë pajtimtarë në krahinën e Kozencës, ku kujtimi që kishte mbetur prej meje ndër kolegjalët e Sh. Adrianos, botimet e njëpasnjëshme në gjuhën shqipe të pëlqyera (të mirëpritura), pjesëmarrja e guximshme në kryengritjen e tentuar në Kozenca, më 22 qershor 1837, bënë që të pritej me ëndje. Vazhdova ta botoj vetëm, me të vetmin bashkëpunëtor Nikola Kastanja, student abrucez, babai i të cilit kishte qenë një nga deputetët në Parlamentin e vitit 1820. Sikurse unë, ky djaloç ja epte mundin e vet atdheut pa asnjë mendim shpërblimi. Por nuk mund të më ndihmonte sipas dëshirës së vet. E pengonin studimet, dhe e ngadalësonte një rast i jashtëzakonshëm. Kishte pasë strehuar në banesën e vet Silvio Spaventën, ardhur nga Abruci, dhe me të ndante shtratin e vet të vogël prej studenti. Tash që bënte kohë e nxehtë, pësonte shumë, e shpesh gëzonte, pak gjumë në mëngjez, duke më lënë mua vetëm të drejtoja betejën.

Ish-kolegëve të mi, unë u këshilloja atë çka m’u dukte e ndershme; ata, përkundrazi, pritnin që t’u shpërblenin; e shpejt m’u larguan. Në një mbledhje, që patëm së bashku, të gjithë u ngritën në kor kundër meje; e qe ndonjë, që më tha: “Ti bën si spartanët, sepse e ke një nëpunësi”. “Atij që është i drejtë me të gjithë, - përgjegjja unë, - i shes veprën time, e me vleftën e saj unë jetoj”. Nga mbarimi i shkurtit, Boceli, Ministër i punëve të brendshme, emëroi intendent të Kozencës kalabrezin Barone Markizio, njeri me mendime të drejta; e, sipas porosisë që kishte, i këtheu për në Kalabri që t’i hiqte qafe.

Me gjithë këtë, agjitacioni qëndroi, i mbajtur prej njerëzve më të këqij të krahinave të tjera, të cilëve ju shtuan aventurierë të ardhur prej së jashtmi. E shpallja e Republikës në Francë i ndezi, përsëri, zjarret.

II.

Pas një jave, mora vesh në shtypëshkronjë se Bazile, duke qenë i sëmurë rëndë, kishte dalë prej shtëpisë së Markeze Linjola. Të nesërmen shkova vetë te Markezi, e mora vesh se e kishin zënë ethet me shenja të kuqe në trup, i ishte dashur ta transferojë në Paçe. Pas ndonjë dite që shkova ta shoh, vërtetova se, duke i rënë sëmundja, i ishte mbledhë në kofshë një i thatë. Sa më pa, filloi të qajë me të madhe; kishte një kopje të *Ines* të hapur e të mbështetur në mur, pas jestekut. U mundova ta ngushëlloj, dhe folëm shumë për kushtet politike të kohës. Më kujtohet se, kur i përmenda për kundërshtimin që i bënte qeverisë kolegu e bashkatdhetari ynë Domenico Mauro, përsëriti dy herë: “Krye hekuri!”.

Pas gati një muaji që e kishin transferuar nga Paçe në atë ditë të të pashëruarve, si i infektuar prej një sëmundjeje shkatërruese nervore, e pashë në spitalin e ri me ballë të vrërët e që, në qetësi, mbyllte buzët përgjysëm. Ktheva përsëri në muajin e qershorit, në kohën, kur një sherbëtor, tuberkuloz edhe ai vetë, po i binte prej së jashtmi disa portokalla. Më tha se mjekët ja kishin ndaluar; por rrudhi vetullat me një mënyrë plot përbuzje kundër mjekëve. Nuk kishte ndryshuar gati aspak në fytyrë. Hypi në dritare e, duke u mbajtur për hekurash, thirri: “O! kish të mund të m’i ulte kush ato male, që të mund të shihja ty, Plataçi im! Me të pamit tënd e me ajrin tënd, që do ta thithja, do të shërohesha!”. Nuk dëgjova më tjetër, as nuk e pashë më. Vdiq në korrik; librat, dhe ato pak plaçka të tija, u mbetën priftërinjve për shpenzime varrimi.

III.

Tash në Napoli, pas ngjarjeve në Francë, të pakënaqurit filluan ta shohin Kushtetutën të pamjaftueshme e u mblodhën rreth një farë Aurelio Saliçeti, krye i pafuqishëm dhe i mbrapshtë. Ky, si Magjistrat i Gran Kortës e frekuentues i klubit, kishte arritur deri në Ministri; por, o pse nuk kuptonte, o pse tradhëtonte, për paraqitjet e veta të marra, që zbuar; e, nga se ishte i helmuar për së tepërmi kundër Mbretit, u bë idhull i sheshit. E mungesa e edukatës së tij ishte kaq fort e ndihmuar prej demonstratave që shkonin duke u shtuar e duke kërkuar Kushtetutën, që vinte duke u

përhapur, sa që u premtonte të uriturve të çështjes publike, se shpejt do të bëhej Robespierre i Ferdinandit II. Në një mbrëmje të atyre netëve, ndërsa dëgjonin muzikën në sheshin e Sh. Françeskut, Mbreti dhe familja mbretërore u dukën në ballkonin e pallatit mbretëror; por, të pritur nga një fishkullimë e përhapur ndër shumë anë e nga fjalë të ulëta, hynë përsëri brendë menjëherë. Roja mbylli hyrjet; e, në mëngjezin tjetër, u dyfishua. Natën kështjellat u përforcuan.

Qyteti ishte i pushtuar prej frige; pjesa më e madhe e dyqaneve mbetën mbyllë; Ministria e budallenjve kishte dhënë dorëheqjen që prej disa ditësh e nuk mund të formohej një ministri e ré. Në orën 7 paradite mora një pusullë prej poeteshës Xhuzepina Guaçi, që sapo e kisha njohur e që lexonte shqipen; kishte dëshirë për të më parë. E gjeta të bërë më simpatike prej melankolisë, shkaktuar prej një sëmundjeje të lehtë të gjoksit. “A mos do ta humbim, - më tha, - Kushtetutën, për punë të atyre që nuk kanë menduar për të?”. E aty, të dëshpëruar të dy, vendosëm, sipas këshillit të saj, që të shkoj unë te Gabriele Pepe për ta lutur që të pranojë formimin e ministrisë, që thonte ajo, se i ishte ofruar prej Mbretit. Gabriele Pepes, deputet në parlamentin e vitit 1820, i ishte dashur, pastaj, të mërgojë prej mbretërisë, dhe në Firence i ishte dashur, për njerin e Italisë, të bëjë me Lamartinin një dyluftim, që kishte dalë me dobi. Pas dhënjes së Kushtetutës, ishte kthyer; e Gjenerali i Rojës kombëtare, Princi di Strongoli Pinjateli, e kishte emëruar kolonel të asaj arme, sepse ishte uthitur me besën dhe fisnikërinë e shpirtit të tij. Shkova me ngurrim, duke mos e njohur, e edhe Guaçi nuk e njihte fare. Ishte duke dalur prej shtëpisë në uniformë, i naltë me shtat e me pamje burri. Më priti në këmbë e, mbasi më dëgjoi, më kundërshtoi, duke thënë se nuk ishte i thirrur prej Mbretit, e, edhe sikur të bindej kudo që të ishte, nuk njihte kend që ta thirrte në anën e vet. Ai kishte ardhë në Napoli, para pak kohësh, dhe e kishte gjetur shumë të pështjelluar. Unë i parashtrova se si mund të çlirohej prej këtyre dy vështirësish, dhe, mbasi m’i pëlqeu, dola për të parë Gjeneral Lekën, që më nderonte e konsideratën e vet plot dashuri, dhe për ta pyetur në se mundte ai t’ja kujtonte Mbretit Gabriele Pepen. Ngava me të shpejtë në rrugën Karminelo a Kiaja, dhe, Mareshalit shumë të egërsuar me Saliçetin, i fola për Pepen. Ai, meqenëse prej shumë kohësh Mbreti nuk këshillohej me të, më dha një biletë për Gjeneral Filaxhierin. E tash as këtë nuk e gjeta në shtëpi, pse, pak përpara, ishte thirrur në pallat. Ishte një ditë shumë e nxehtë prilli; e shkoja duke kujtuar vargjet e përmendura të Tasos:

“Pothuaj, pas një gjoje të gjatë e të mundëshme, këthehen të zymtë e ngashërues zagarët”, etj.

Në drekë u njoftova atyre të shtëpisë për mossuksesin tim, që i brengosi shumë. Mbasi u çova prej tryezës, nuk më qe e mundur që të bëja pushimin e shkurtë të zakonshëm. Duke shëtitur nëpër dhomë, me një stuhi të madhe mendimesh, ndjeva sikur të më thoshin nga brenda: “Çfarë ndihme u kërkon njerëzve që kanë kundërshtuar një kukull, që nxit kotësinë e keqe kundër Zotit, ndërsa ke në dorë një Gazetë që flet për Të?”. Menjëherë u vura në punë e shtrova një artikull të shkurtë e plot vërtetësi.

Aty ja paraqita Saliçetin popullit që ta përbuzte për atë mosmirënjohje të ditur të njetij me të cilën i kishte përgjegjur presidentit N., i cili nga sekretar i vogël e kishte ngritur lart në zyrat e magjistraturës, se ka shtie në punë për ngritjet në karrierë një kushtesë servile të një përkthimi të psalmeve të bërë prej tij; që ia ka bërë Karretos, atëherë ministër i policisë; me pa edukatë të paturpshme prej tradhëtari, duke përdorë si mjet Kushtetutën, plagoste shpirtin e atij, të kujt na kishte dhuruar, dhe kishte çdo fuqi për ta hequr përsëri. Gazeta do të dilte atë mbrëmje; zevëndësova *akuzën* me kryeartikullin. E, brenda njëzetekatër orësh, një sherbëtor i shtypëshkronjës, shpërndante tridhetë kopjet e para nëpër kafet më të njohura të qytetit. Në treçerek natë dola vetëm nëpër rruga për të parë efektet. Kishte shpërthyer një zjarr. Në kafe të Napolit, në Toledo, plot me klientë në këmbë, poeti Regaldi, që kishte ardhë te ne prej disa muajsh, hypur mbi një bankë, lexonte me zë të naltë Gazetën. Rreth orës dhetë, kur ktheu familja e Dukës prej shtëpisë së Këshilltarit të Hetuesisë, Kalorës de Çezare, - ku kishte pasë kaluar mbrëmjen në një shoqëri shumë të madhe, - më kallëzuan se “*L’Albanese*” e kishin shpënë e u lexua me kaq duartrokitje sa që dukej se nuk ngopeshin me të. Por, më përtej, ishte Zoti në krah tem. Si agoi dita e re, u pa artikulli i riprodhuar në formate të ndryshme, afishuar ndër skaje të rrugave. Nga Gazeta filluan, pastaj, numrat të thuhën me zë të lartë nëpër rrugë, si “*il Lampo*”, organ i lajmeve *sensacionale*. Zbulova të vërtetën e gjykimit hyjnor: “Të korrat janë pjekur, por mungojnë korrtarët”. E vërteta dhe drejtësia gjinden në fund të shpirtërave njerëzorë, e këta zotërinj të botës së Tokëujshme përbëjnë madhërinë e qenjes. Kush i shpall dhe i ngreh si flamuj të jetës ato, ai ka përkrah papritmas e ngushëllues mbarë një popull. Vetë bota pagane ja mbështetëte rrjedhën e këtyre forcave

jo misterit hyjnor, por trimërisë së njeriut. Prandaj proverbi: *Audaces fortuna juvat, timidosque reppelit*.

Atë ditë në mëngjez, ndesha ndër shkalla bashkatdhetarin tim, me trup të shkurtë, Françesko Mashì prej Shën Sofisë, që banonte në një dhomëz, pak nën dritaren time. Atij i vinte, nganjëherë natën, Saliçeti. Porsa më pa, më tha: “Jeronim, edhe ti nuk flet të vërtetën. Saliçeti as s’ka përkthyer dhe as nuk i ka kushtuar psalme Ministrìt të policisë, dhe ka për të ngritur padí kundër teje duke u ankuar për shpifjen që i është bërë”. U turbullova shumë; unë nuk e kisha parë librin, por kisha dëgjuar të flitet; e, përgjithësisht, më bëjnë të rrënqethem avoketët pedantë (formalistë). Po zbritja atëherë me nxënësin prej vilës, e desh fati që të ndeshem me Biachio Gambóa, përkthyesin e Kalderon de la Barka, njeri me rëndësi, e që Parlamenti i vjetit 1820 e kishte dërguar këtë si ambasador në Spanjë. Ky, sa më pa, erdhi tek unë e më përshëndeti duke më përgëzuar. Por unë i fola për vështirësinë e ré. “Ai nuk ia kushtoi psalmet, - shtoi ky, - por Govi; kam një ksombal ne dispozicionin tuaj”. Kthjem, së bashku, në qytet. Pas një gjysmë ore që kisha mbërritur në shtëpi, erdhi sherbëtori i tij me libër; e unë, duke qeshë, ia dëftova prej dritares mikut tim, i cili qe, më vonë, *Shkurtabiqi misterioz* i kungares napoletan E. Saliçeti, pastaj, natën u zhduk *erupit evasit*; e prej tokës papnore protestoi në gazetën “*La Nazione*”, në se nuk gaboje, kundër qeverisë që donte t’i hjekë rrogën e gjykatësit.

IV.

Mbasi u qetësua sheshi kryesor, e mbas një bisedimi të gjatë të kotë, mbi premtimin që Kushtetuta t’i zhvillojë tri Fuqitë, historiani Troja mori përsipër Kryesinë e Ministrisë, ndërsa atë të Faljes dhe të Drejtësisë e mori Rafaele Konforti, ish Kryetari im. Me atë nuk shiheshim më; as nuk e pashë përtej; dhe as këta nuk patën mundësi të forcojnë asnjë përpjekje qeverimi. Të pushuarit prej pune në shpresë të të zhdukurit të Saliçetit, u shpërndanë si një tharm (majà) i keq nëpër Krahina. E u fillua, nga të gjitha anët, me gënjeshtër të fliqtë, të egërconin shpirtrat me shumicë në Kalabri. Në ndërkohë, në Kozencë, Baron Marsiko nuk ia dilte të qetësojë të gjithë të pakënaqurit. Parlamentarizmi *nuk i kishte bërë ende të përbashkëta pasuritë e privatëve*, dhe as Shteti kushtetues nuk kishte përforcuar ende në kre të vendit, që i ishte urdhëruar. Intendenti, njeri fisnik, nuk dinte edhe ai ku të mirrte për

të dhënë; u çuan, pra, me lehtësi, shpirtrat kundër, o pse për nevojë, o pse deshën ta ndalojnë. E prîjës ndër ta ishte Domeniko Mauro, prej familjeje pasanike, me shpirt të naltë, i cili e ndjente vehten të fyer, se ishte lënë pas dore me qëllim. E ishte edhe njeri që u vinte veshin shumë Njerëzve të parëndësi, liberalëve të së nesërme, shokëve të klubit që ishin ndër të zgjedhur të tij; këta do të ndanin së bashku përbuzjen e tij. Ai, përveç pasionit të hollë, zotëronte edhe talentin demagogjik; e një mori njerëzish mblidhej, vazhdimisht, pranë tij.

Ndër ato javë dyshimi, Beteli më kërkoi, me anën e një letre, duke më paraqitur gjysmën e pajtimtarëve, shkrijen e “*Albanese*”-s në “*Costituzionale*”, për të cilin po delte një kundërshtar i fortë “*Tempo*”, organ i Trojas. Unë i përgjegja me thjeshtësi: “Nuk dua të hiqet prej meje Flamuri kombëtar; as nuk mundja të urdhëroj natyrën time të egër, që t’u bindej opinioneve e qëllimeve të komiteteve e, përgjithësisht, të të tjerëve”. Dhe mbeti e pavarur Gazeta ime e, bashkë me këtë, mbeti e pavarur edhe fletorja “*Omnibus*”, pronë e bashkatdhetarit dhe mikut tim Vinçenc Toreli prej Barile në Bazilikatë. Nuk më kujtohet me saktësi a qe përpara apo mbrapa këtyre ndodhjeve – përsa u takon datave, nuk kam siguri; më mungojnë numrat e “*L’Albanese-s*” e mendja ime, e kapur, gjithmonë, mbas ngjarjeve, nuk shikonte, as pak as shumë, data ose rrethana të tjera (e kërkoj të falur për pasaktësinë nga kjo anë) – që m’u dërgua “*l’Apostolato*” i Françesko Krispit nga Kolonia jonë e Palaco Adrianos. I çova, atëherë, të gjitha numrat e “*Albanese-s*”; e shkëmbimi vazhdoi derisa fortunat e mërritura i zhytën, përnjëherë, të dy Periodikët.

Ndërsa, pak kohë pas këtyre ngjarjeve të sipërtreguara, u bë e qartë lakmia e Sicilisë për autonominë e vet administrative, ajo u bë, papritmas, ankthi i këshilltarit tim të vjetër Emanuel Bidera, i lindur edhe ai në Palaco Adriano. E, pra, mua më dukej një gjë e drejtë. Për kujtim të jetës helenike, me të cilën më kishin mbushur klasikët, unë, në zemër, isha Federalist. Jo, gjithaq, përsa u përket formave të Shtetit – mbi të cilat, pastaj, kuptova që mos të mbështetem tepër – i mbrojta me shpirt të pastërt e, gjithmonë, çka pranonte vendi. Në çështjen siciliane, pretendimi që më dukej se vinte prej Napolit, për të sunduar ishullin, më epte të kuptoj se rridhte prej vullnetit të mbrapshtë. Prandaj nuk e bëra objekt diskutimesh, duke iu shmangur, me vendim të prerë, çdo ndërhyrjeje sonë, duke egërsuar kundërshtimet civile në Itali, që na kishte miq aqë të dashur.

Përkundrazi, Gazeta të tjera, edhe pa pasë prirje për Sicilinë, i epnin arsye, vetëm pse (ishin) lajmet e para fatlumtura të kryengritësve që ringjallnin thirrjet e atyre që shpresonin si edhe të të pakënaqurve, o pse (ishin) lakmues, o pse ishin armiq ata i epnin zemër për luftë duke i dhënë të drejta. Në kaq, ndodhi që një ditë, bile, u pa i varur në traun e një dritareje të pallatit të tij, nën sheshin e Merkatelos, i biri i markezit Vulcano.

U tha, se gruaja e tij, motra e Baron BeELIT, kishte kurvëruar me të vëllanë e Mbretit, Princin e Sirakuzës; e, me të vërtetë, mbreti, mbas këtij fakti tragjik, e largoi këtë prej shtëpisë mbretërore dhe e internoi në Firence të vejën me katër fëmijë të vet. Por turpi nuk u shlye më prej shpirtit fisnik të BeELIT; e “*Costituzionale*” e tij, që ishte shumë e përhapur në Napoli, helmatoste çdo veprim të Oborrit mbretëror.

Kaq ishte çrregullimi i shpirtave, sa që dukej sikur nuk mund të mendohej më për ndalesë; u fillua të flitet qartas e, ndër anë të ndryshme, se “Statuti është një shtirje që kalon, nga përfundimi në të cilin u prish Kushtetuta e 1820-ës, se treguesit janë te zyrat e shtetit qëndrojnë të mbahen nga shërbyesit e vjetër, e në përbuzjen e shfaqur për të gjithë ata, që kishin sjellur ngjarjet e reja, me humbjen e vetvetes; të përzanun prej zyrove, pse nuk kishin më atë që, fëmijërisht, i kishin dhënë atdheut. As nuk u shihte asnjë e mirë e ardhur vendit prej kushtetutës, mbas sa e sa muajve, por një qëndrim i saj prej mumje që shikon ndrrimin e maskave të veta minesterialë që bën tirani. Këto insinuacione mbretëronin në Kalabri, ku indiferentëve dhe njerëzve paqedashës që më nderonin dhe u kundërvinin atyre vlerësimet e kundërta të “*Albanese-s*” besnike, pati ndonjë që u përgjegji, “se një dashuri aristokratike e kishte zvetënuar dhe poshtëruar shpirtin tim”. Më kujtohet se deri Luixhi Petrasi, miku im i shkollës në S. Adriano e gjithmonë, pastaj, mik i devotshëm, e përfundonte një letër të veten me këto fjalë: “Por në qoftë se “*Albanese*” nuk është me né, poshtë “*Albanese*”!”.

Në një ndër ato ditë, gjeta në postë letra të një Ati Domenikan prej Kastrovilari, Rafael Orioli, që e kisha për zemër e më vinte në dijeni: “Se Krahina, mbasi kishte marrë njoftim për lodrat tradhtare të Borbone-it, ishte njësuar e gjitha për një kryengritje të ardhshme me zjarr të gjerë; se i kisha bërë të qarta (të njohura) radhët reaksionare në Gazetë; e se populli do të qëndruake pas meje”. Mbasi i përgjegja siç duhej mungarit, gjeta rastin të shoh në shtëpi të tij Karlo Poerion, drejtor i Punëve të

brendshme. Ai nuk u turbullua për këto lajme; më tha se si këto, ashtu edhe të tjera, kishte marrë prej Intendentit Marsiko, e ju dukte si mos të kishte ku të mbështesë dorën. Nuk mund të rëndonte vendin me mjete të padrejta duke mbajtur gjithë ata të papunë, dhe as nuk mund t'u gjente këtyre vende duke përjashtuar njerëz që i kishin dhënë shtetit punën e jetës së vet, e që nuk kishin fajtorë për kurrëgjë. E këtu gjeti rastin të më kallëzojë për Muzolinon, kryetar i “*Giovine Italia*”, që kishte qenë tek ai për të bërë kërkesë të panjerëzishme; e, në një të fjalosur, që provokoi ai me Komisararin e Policisë Merenda, ky kishte nxjerrë prej raftave (dollapeve) e i kishte dorëzuar Poerios një tubë letrash, që pastaj mbaroi krejt: “*sed parce sepultis*” (në respekt të të vdekurve). Unë shtova se, me siguri, sot kurrkush më nuk i kërkon Zotit: “*Adveniat regnum tuum*” (Ardhtë mbretëria jote), por në të keqen e përhapur, pushteti i është dhënë për ta shti në punë atë për dobinë e popullit. E ajo që kërkohet tani shpejt, është që të ndalohen që kryekëcyerit ta bëjnë fajtor vendin ndaj Mbretit; arrestoni, në Kështjell, ndër më të parët, Mauron, e tufa e tij do të shpërndahet. – “Jo, De Radë, (më ndërpreu) unë nuk do të vë dorë kurrë mbi shokët e mi që kanë aspirata fisnike. Unë nuk i kam mjetet; po shkoj të jap dorëheqjen”. E, me të vërtetë, këtë e bëri po atë ditë.

Duke menduar, tash që po shkruaj, mbi sukseset e mëpastajme, jam i shtërnguar ta shikoj nga një pikëpamje tjetër, butësinë e patëkeqe të një njeriu, për të përcaktuar dinakërinë e të cilit Çezar Marini kishte thënë: “Ka dyzet vjetët e djallit, është bashkëthirrësi e kundërshtari i Borbonëve, stigmatizuar si besëthyes; jehona e bujshme e mosbindjes së sicilianëve; lufta që ndodhi befas në Venedik për tërësinë e Italisë, së cilës Mbreti nuk i dërgonte trupat e veta, bënin të humbiste dita ditës, besimi se dinastia do të zgjaste. Ministrat nuk e përfaqësonin më Mbretin; dhe, në përgjithësi, më ambiciozët në mes të nëpunësve mendonin të gjenin ndonjë strehim te Muratistët, Unionistët etj., sundimtarë të së ardhshmes”.

V.

Në këtë gjendje shpirtërore u bënë zgjedhjet për parlament; dhe hapja u dekretua për 15 maj.

Në mbrëmjen e datës 13 (e shtunë), anija e Kalabrisë shkarkoi, bashkë me deputetë, një numër – siç u fol – prej 90 djemsh të rinj, të gjithë me pupël të zezë në kapelë; e një roje kësi soji ju desh të përcjellë

edhe deputetët e krahinave të tjera. Dhe shumë të rinj të shteteve të tjera të Italisë ishin shpërndarë prej kohe nëpër pijetoret e Kryeqytetit. Të djelën deputetët u bashkuan në Monteoliveto në mbledhje përgatitore e filluan komunikimet e veta me Ministrinë mbi qëllimet e veta për të shndërruar Kushtetutën; nuk mundën të bien në marrëveshje me Mbretin. Rreth orës 24, Ministria dha dorëheqjen dhe, mbas një ore, rruga e Toledos filloi të përfocohet me ledhe. Kryetar i asaj mbledhjeje së parë qe Kryedjakoni Kanjaci, me origjinë shqiptare prej Pulje, që, mbasi u kujtua për pështjellimin e mendimeve, të nesërmen dha dorëheqjen.

Rreth orës dy të natës, nëpërmjet ministrave të rinj, ju bë e ditur mbledhjes pëlqimi i Mbretit se po *shpallej* Kushtetuta, lajm ky që i kënaqi më të shumtit, të cilët u larguan. Por ata që mbetën, dhe populli përjashta, kërkuar, përsëri, me anën e një lajmi të ri një betim se do të shpallej dhe të modifikohet Kushtetuta. Natën vazhduan përfocimet nëpër rruga me mburoje drësh, dheu e gurësh, duke u zënë me këtë punë edhe Roje kombëtare, që, kur shkoi komandanti Gabriele Pepe te ato për t'i tërhequr, filluan të humbin respektin. Në kaq, edhe në mesazhin e fundit Mbreti pranoi që të bëhej betimi për shpalljen e një Kushtetute, me kusht që të shpartalloheshin barrikatadat; por, atëhere, as këtë nuk e deshën.

Përfaqësuesit e Mbledhjes, në atë natë marrëzie, ishin njerëz gjysmakë dhe me kërkesa të neveritshme, Petruçeli dela Gatina, Xupeta, La Çiçilia e tjerë të tillë. Në vetvete dukej sikur ishte zhdukur mirëkuptimi prej atyre orëve të mbrapshta. Në zbatimin e sinqertë dhe mirëbërës për popullin të Kushtetutës, zbatim të cilin të gjithë e prisnin e që shkonte duke u vendosur në Piemont, qëndronte, në mënyrë të nënkuptueshme, shpallja e vërtetë dhe besnike e saj. Por, sa për *modifikime e për shpallje*, po të ndryshonin duke u betuar, do të bëhej bé për diçka të paqenë, kur të mos besohej se, me një betim, do t'i shtohet një gjëje të pakufishme e drejta për vendime (rezolucione), që do të vinin, edhe sikur të ishin prapsepër të pabesë. Prej Mbretit qe thirrur dhe pyetur, atë natë, Mareshali Leka, e ky e këshilloi që t'i përmbahej Kushtetutës, për të cilën ishte bërë betimi më 10 shkurt; dhe asaj t'i qëndronte besnik dhe, pastaj, të kishte besim në Zotin. Këshillë i denjë për mendjen e drejtë shqiptare, sikurse qe i denjë për shpirtin e pamposhtur, në të ardhmen, drejtimi i betejës që ju ngarkua (besua) atij.

Porsa agoi drita në mëngjezin e së hënës, dëgjova duke u rënë burijave, e, si brofa (kërceva) nga shtrati, pashë një barrikadë të madhe në qoshen e rrugës Sh. Xhakomo, mbrojtur prej ushtarësh të Gardës. Nga ora shtatë, u ula në shtëpinë e mikut tim Fr. Mazi, e prej deputetit Çezare Marini, nga Sh. Dhimitri, xhaxhai i tij, mora vesh fill e për për *pourparters* e ditës së përparëshme. Ai ishte i kënaqur për prishjen e mosmarrëveshjes, e kishte besim për këtë; dhe desh që unë të shkoja me të në Dhomë për të qenë i pranishëm e për të lajmëruar në Gazetë, për luftën që *do të niste ai kundër të çmendurve*. Kështu, nga ora nëndë, së bashku shkuam nëpër rrugën Lungo Teatro Nuovo. Por, teksa shkuam pak më përtej teatrit, dëgjuam, prej së largu, një batore armësh e prap disa të tjera më afër. Nuk m'u dukte, pra, e arsyeshme të qëndroja më tepër në Dhomë, dhe as nuk dija se çfarë vendi tjetër më i mirë më kishte mbetur. Mbasi lashë Deputetin Marini, u ula nëpër Monte Kalvario në Toledo, ku më kaloi përpara Xhuzepe Samengo (arbëresh nga Lungro, sot Këshilltar i Hetuesisë në Romë), që po zbriste i armatosur me një pushkë, e më tha se ajo ishte e fundit që qe e mundur të sigurohej. Në fund të Toledos bëhej luftë gjithnjë; ballkonet, mbi Largo dela Karità, ishin plot me studentë të armatosur; ndër këta – shumë kalabrezë; mua, si i paarmë, nuk më mbeti tjetër veç të largohem prej vendit të betejës.

Në shtëpi mora vesh prej një kapiteni që kishte dhënë dorëheqjen, Beluçit, dëshmitar me sy, se, duke ju afruar kapiteni Sales i Sviceranëve barrikadës S. Brixhida, e, duke urdhëruar që t'i hapej rruga Mbretit për të shkuar në Parlament, e qëlluan me armë prej pallatit Çirela, dhe ra prej kalit. Në atë goditje, shpërtheu një të rrahur shuplakësh prej të gjitha ballkoneve të Toledos, e, mbas pak minutash, zviceranët, me një shprazje armësh të rregullt, hapën luftimet. Mbasi u ngrit forcimi lart flamuri i luftës, e mbasi u erdhën në ndihmë zviceranëvet trupat e marinës, filloi Kastel Nuovo të mitralojë ato që ishin kundruall ndër ballkone, ndërsa kryengritësit, të mbrojtur prej dyshekëve, që i mbanin pezull ndër to (ballkonet), shtinin kundër trupave. Këto, të bashkuar mirë e duke qëlluar në shenj papushim në paftat që mbyllnin portat e mëdha, i shpartalluan; e ushtarët, duke kërcyer brenda, dikë zunë rob e dikë mbytën nga pushtuesit që u gjetën aty ndër parrakllëqet (hekurat e ballkonevet). Ndërkaq, topat shpërthenin barrikadat që ishin gati pa asnjë njeri, por të mbrojtura nga të shtënat që vinin prej pallateve sipri.

Të burgosurit ishin çuar në Darsena. Kështu u luftua deri në mbrëmje, kur, me anën e fishekzareve ndezëse, ju dha zjarr pallatit Riçiardit, ku rrinte Komiteti drejtues i Kryengritjes: zjarri vazhdoi gjithë natën. Një britmë e papërshkrueshme e vegjëlisë përkrahëse e Mbretit, që ishte mbledhur para mbrëmjes në Toledo me flamur të bardhë, brohoriti për fitoren e Mbretit. Disa nga kryengritësit, që nuk mundën të mëshehen, u rruan e u transformuan që të mos njiheshin. Trupat fushuan gjithnatën ndër rrethe. Të nesërmen në mëngjez që shpallur shtetrrëthimi prej Ministrisë Kariati, që botoi një manifest qetësues, por i sigurtë në forcat e veta. Megjithkëtë, as dyqanet nuk u çelën, as nuk u shihte ndonjë civil. Kryengritësit e shpëtuar iknin ndër Krahina, ku erdhën edhe ata që kishin qenë burgosur në Darsena, e që kishin qenë liruar. Rugët përshkoheshin nga rrugaçë. Duke pasur shpresë në Zotin e në gjuhën e huaj, desha të shoh qytetin. Aty sillej një karrocë e madhe të vdekurish, e ndër lagjet përposhtë hidhej valle sipas krizmave të lodrave, si nëpër rruga ashtu edhe nëpër kopshte të hapura; nuk shiheshin më fletë të shtypura, që dje qenë aqë të shpeshta e shurdhuese. Kur u ktheva në dhomën time, nuk munda të qetësohesha duke menduar se fyerja e një sektit merrej si fyerje e vendit liberal; e thura një tregim të gjallë, plot vërtetësi e dritë, por të hapët në fytyrë të fituesve, të cilëve nuk u bindesha (nuk i dëgjoja). Po, e rrëfej, Gruaja aristokrate ishte në krye të vendit dhe Hyjneshë e zemrës sime të pafrikë, ndër ato mendime të ngritura. Në orën një të natës, relacioni ishte radhitur në shtyp për një Shtojcë të “*Albanese d’Italia*”. Duhej që të shpërndareshin kopjet natën, pse, nga ora 8 e paradites, isha i thirrur në Komandën e Piacës, e i mbajtur si shkelës i Shtetrrëthimit, në një dhomë ngjitur me kabinetin e komandantit Lubrano. Mbas gati tri orësh, munda të paguaj një ushtar e t’i shkruaj Lekës, të cilit i kisha dërguar në mëngjez fletën e, pas një bilete që ai dërgoi t’ju drejtonte Lobranos, m’u dha leje të dal. Lirimi im që një mjet shpëtimi për Gazetën, që u përhap si një ujë i ftohtë mbi gënjeshttrat e nxehta të dërguara nëpër Krahina. Për këto, deri në orën dhjetë të ditës së enjte, u dërguan 3200 (kësombëlla) të Shtojcës; vetë Shtetrrëthimi u dobësua, dyqanet u çelën përsëri. E ruaj gjithnjë letrën e Kavaljer De Çezare, prijësi i liberalëve të Napolit, atëherë intendent në Bari, rreshtat e parë të së cilës tingëllojnë (kështu): “I dashur De Radë, ju jeni i vetmi atdhetar i vërtetë, ju vetëm e keni shpëtuar mbretërinë”.

Erdhi Gjeneral Pepe e më la, pranë rojes së portës, biletën e tij të vizitës. Në jetë ka disa çaste që e hyjnizojnë njeriun.

Nuk më kish mëri shumë-kush, për mua prekeshin shumë njerëz të drejtë. Vizitova Xhuzepina Guaçin mbas një zhgrehje gjaku, që e kishte dobësuar shumë. Sa më pa, më tha: “De Rada, e keni plagosur në zemër atdheun. Jo atdheun besnik, po ndoshta atë jo besnik!”. “Shikoni, (i thashë), Napoli ka vrojtuar, pa u shqetësuar fare, prej pallateve të veta, duke mos marrë pjesë aspak në veprën tradhëtare e të çmendur. Kam punuar për t’i hequr reaksionit pretekstin e kryengritjeve të krahinave, zjarre të kota, që ju e dinit se mund të shuheshin lehtas”.

VI.

E ngjarjet më dhanë shpejt të drejtë. Kalabrezët e shpëtuar – e qenë gati të gjithë – prej kërdisë së Napolit, lënë të pandëshkuar, gjetën ndër vise të veta ku u strehuan konspiracionin që më ishte paralajmëruar prej mungarit Domenikan, dhe një vëllazërim me emisarët (të deleguarit) e Siqelisë, që nuk ishte prekur dhe, për një arësye të veçantë, në gjendje kryengritjeje. Mbasi ranë në gódi (në ujdí) partitë këndeje e andej Faro-s, e mbasi arriti në Kozencë Konti Riçiardí, nuk di se me çfarë lajmesh të reja, u formua aty një qeveri e përkohëshme, e cila, e ndihmuar prej trupave të zhbarkuara prej Siqelisë, shpejt ju imponua vendit. Turbullimi do të ketë qenë shumë i madh, përderisa Rafaele Valentini, shtatëdhjetëvjeç, kaloi, nga një njeri i qetë, i dhënë pas studimeve, u lidh me Revolucionin si *Kryetar i Fuqisë* ekzekutive të Revolucionit. Atëherë dërgoi qeveria Gjeneralin Buzaka me 6000 vetë për në Kozencë, ndërkaq Nunciante drejtohej me anije, për në Pico. Në mes të këtyre dyshimeve, në një intervistë që pata me Mareshal Lekën, i parashtrova vendimin që kisha marrë për ta mbyllur gazetën dhe për të kthyer te babai im, mbasë dhjetë vjeç mungese; ndërsa do të më ishte dashur, pastaj, o të mos thom të vërtetën, që Zoti ma kishte ngulur në shpirt, o të plagosja ndër bashkatdhetarët, edhe shokët, edhe kushërinjtë e mi, kush i rekrutuar ndër çeta, kush në ushtri me vullnet të vetin. “Ju bëni (veproni) keq, - më tha ai; - mos e leni Napolin; ju do të merreni me drejtimin e “*Araldo-s*” (që ishte organi i ushtrisë). Por unë nuk pranova në asnjë mënyrë, duke më këshilluar ndërgjegja të mos pranoja shërbime që të më tregonin si të arratisur

nga fusha liberale, e të më epnin një padron, të cilin, ndoshta, më ishte dashur ta ndihmoj në të keq, ose që braktisesha me poshtërim prej tij. Edhe atë ditë, një i quajtur Minxhiani, ish-drejtor i Krypores së Lungros, e i njohur prej meje ndër mbrëmjet e Kavalier De Çezare, erdhi e më tha që Mbreti dëshëronte të më njohë, dhe se ai do të më çonte në pallat, ku adjutanti i fushës Alesandro Nunciante do të më kishte paraqitur te madhëria e tij. Nuk e pranova, megjithëse ishte një nderim i madh; por, pastaj, ndjeva një pendim, sepse ishte opiniononi që Ferdinandi s'ishte dokushdo; dhe do të kisha dëshëruar ta dëgjoj dhe ta njoh. Më pengonte nga gjithë ato këmbime, siç do të shihet shpejt, rruga që më kishte shndërruar në një Kampeador të kombësisë sime.

Pak më vonë, në Kampoteneze, ku qëndronte Domeniko Mauro në krye të çetave, porsa mbërrijtën ushtarët e parë të Mbretit, qe zanë befaz dhe mbytë bashkë me Fr. Saverio Toçi prej Shpen Kozmos, vëllau më i vogël i Mauros, Vinçenci, shoku im i rinisë, trim dhe i njerëzishëm si kurrkush (ku s'shkon më). Çeta, e ngacmuar prej ushtarëve, qe shpërndarë, e siqelianët e mundur në Specano qenë vënë në të ikur.

I ktheu, atëherë, në Napoli, krenaria vegjëlisë, e ne shkuam, para kohe, të verojmë në Vomero; por zbrisja të flej, për natë, në Trinità de' Spanjoli, gati, si të thuash, si roje e pallatit.

Të shumtën e mbrëmjeve i kaloja te Markeze Vulkanos, vjehri i Beletit, të cilit i kisha qenë paraqitur prej familjes Rastreli. Ishte një bashkëbisedim rojalistësh të drejtë (përkrahësish të mbretit), që kishin besim në mua. Një mbrëmje, bija më e vogla e markezit, më lajmëroi për qëllimet hakmarrëse të princit Luixhi Borbone, kryetari i reaksionit monarkik që po formohej, e ngulmonte duke më këshilluar që të mos e leja Napolin. Përkundrazi, tregimet e saj caktonin përherë e më tepër si vend ndalëse, Makjen time të bukur, gjashtëqind banorësh, pa gjyqtar, pa kryetar bashkie, pa xhandarë, ku kisha lindur i lirë, pa më urdhëruar kush.

TESTAMENTI POLITIK

(1902)

JERONIM DE RADA

I.

Kombi shqiptar, i shpërndarë dhe i tretur (i dobësuar) ndër brigje të ndryshme, nuk pret më të mblidhet në një vend të vetëm e në shkëlqimin e vet. Por, me përjashtim të /territorit/ të *bujarëvet* të vet /arbëreshë/, që banojnë të strehuar, këtu, në Itali, dhe të atyre që kanë mbetur në trojet e vjetra, të përzjerë me helenët, që erdhën mbas tyre, mbetet ende një vend, krejtësisht shqiptar, ashtu si në lashtësi; ka qenë, dikur, djep dhe fushë veprimi e Pirros, e Filipit të Maqedonisë, e Lekës së Madh dhe e Skënderbeut; munda, bashkë me ta, Perandoritë e fuqishme bashkëkohëse.

Ky vend është ende i gjallë, e sot, i nënështruar nga turku, pret që bijtë e tij të bëhen, përsëri, të lumtur, duke qenë zot të vetëvetes. Jo se mundimi i vetëvetes është, me të vërtetë, lumturi për njerëzit; sepse ai, për çdo gjë, është edhe rrugë për zhgatërrim. Lumturia e kombevet është vetëm /atëherë/ kur janë të qetë dhe kur e mëkëmbin veten krejtësisht, duke u mbështetur në atë pushtet që kanë për të vendosur dhe për të bërë.

Edhe pak e mbushen tetëdhjetë vjet qëkurse kujdesi, për ta rindërtuar atdheun të pavdekshëm, shkon duke u përhapur në mendjen e në zemrën e ajkës së shqiptarëve, të cilët, nga afër e nga larg, shikojnë mosmarrëveshjet dhe fatkeqësitë e popullit të vet, që, gjithkund, është i nënështruar nga të tjerët. Atyre u është dashur të punojnë që ta njohin për ta zbuluar se cili është në të vërtetë. Kjo vënje në pah (qitje në dritë) nuk do të mund të pengonte popuj të tjerë; e përpjekja /për të ndaluar të tjerët që ta njohin vetëveten/ do të ishte një vetëmburrje e kotë.

Shihni! Çdo komb, në vetëvete, është i ndarë e i ndryshëm nga popujt e afërm dhe të largët, ashtu sikurse çdo fytyrë burri o gruaje që lindi në tokë, - e pshin nuk e dijmë – është e ndryshme në amëshim njëra nga tjetra. Por, duke marrë parasysh jehun, me të cilin gjuhët e ndryshme që ndryshojnë nga jashtë, pasqyrojnë, në mënyrë të ndryshme, dukuritë e botës dhe vegimet në të të shpirtëravet njerëzorë, themi se ato janë pasqyra të jetës së plotë pranë prehërit të Atit e pranë grigjeve të heshtura që i ndëgjojnë dhe që e kanë për zot. As kombet e mësuara nga bashkësia e gjakut, as gjuhët me anën e të cilave këto nijfen, nuk janë bërë prej vetë njerëzvet, ndër kohë të ndryshme. Ato i krijoi Zoti bashkë me njerëzit nga hiçi, ashtu siç bëri e lindën nga balta pemët me bisqe e me fryte të ndryshme, njëra më e këndëshme se tjetra.

E dijmë se kjo doktrinë kundërshtohet prej pedantëve të shkencës, por ajo vetëm sqaron e përlligj faktin se gjuhët janë të gjitha të lidhura me një sintaksë të vetme, e pashkëputshme me formën e vetme të racës njerëzore, dhe /faktin/ tjetër se fëmijët, që dalin në dritë nga mosqënia, kuptojnë shpejt, - dhe as nuk e dijnë si – vështrimin, të cilin e ka fjala, e po kaq me lehtësi marrin vesh edhe njerën, edhe tjetrën. E të gjitha kombet, jo pse të lindura me gjuhë të ndryshme, janë kundërshtare njera me tjetrën, por shpejt, - nuk e di me çfarë kënaqësie – flasin në mes të tyre, e duket se larmitë e kombeve e të gjuhëve të tyre janë bekuar për të gjallëruar sa të jetë jeta.

II.

Në të vërtetë, në tokë, asgjë tjetër s'i plagos e s'i vyshk shpirtërat e popujvet, - që janë të ndarë, ndërmjet vetes, këtu në jetë – më tepër se rreziku që, me anë të gjuhës, t'u prishet atyre lidhja e gjakut dhe e gjinisë (e farë-e-fisnisë). E duket nga të gjitha anët, pastaj, se si bota është gati ta ndihmojë, për përpjekjet e sotme, që ta rindërtojë, në cilësinë e vet, kombin shqiptar, pa e bërë, pra, të humbasë paqën.

Nga ato përpjekje doli zbulimi botëror “se me emra të gjuhës shqipe qenë shënuar, në Europë, Idhujt e natyrës e Herojt e traditës më të lashtë klasike”. E, sot, është e qartë se, të paktën, prej katërmijë vjetësh, folësit e kësaj gjuhe, të quajtur, pastaj, nga Homeri me emrin *Pelazgë* Hyjnorë, banuan qytete, që qenë të shkëlqyeshme për doktrinë e për fuqi”.

Bashkë me cilësinë, që atij populli nuk mundi t'i prishet nga ngjarje të një kohe kaq të gjatë, qe vërejtur, në këtë periudhë të lumtur, edhe nëpërmjet të zbulimit të Rapsodivet e të folklorit të tij të pakrahasueshëm,

në të cilat pasqyrohet e del nga të gjitha anët, në zakonet, në njohuritë, në kujtimet historike e në hìret, natyra e lindur hyjnore pelazgjike. Të përmbytura nga pushtimi turk në shekullin XV të krishterimit dhe të ruajtura në Itali, ato qenë botuar dhe shtuar te *Fiamuri Arbërit*, pemë e hijshme e asaj stine.

Vetë aftësia e madhe e gjuhës, që i mvesh ato, paraqet në vetvete, madhështinë e kombit, të cilit i përkasin. E pajisur me fleksion e tinguj, që shprehin, me pasuri të madhe, fazat e shpirtit, ndër gjymtyrët e tjera të origjinës së vet hyjnore, ruan, në vetëvete, tri fjalë që dëftojnë gjendjen e lumtur, me të cilën u krijua njeriu në tokë: *jam, thom, kam*, që të tria në trajtën njëjës, /dhe një gjendje/ e ndryshme nga ajo e fjalëve të tjera të vetë asaj.

Qe, ndoshta, ajo cilësi, e pasqyruar, jo më pak besnikërisht, në poezitë, që ai popull prodhoi, në rilindjen e vet, e që qenë pritë me shumë simpati në letërsinë e kombeve të mëdha europiane.

Për këtë përputhje (bashkëprijje, konvergjencë) – do të thoshja – nderimi dhe pëlqimi të përgjithshëm, në rilindjen e bukur të popullit pellazg, ky u drejtua, njëj mendjeje, me shpresën për bashkimin e ardhshëm vëllazëror, të përruar; e nga të gjitha vendet, ku ai gjindej i shpërndarë, hidhte lule mbi flamurin e vet, të lartësuar në kolonitë e veta në Itali.

Prej Beni Suefit, në Egjipt, na shkruanin:

“Presim të mbushësh mendimin të dërgosh birin tënd të dashur për këtejna. Këjo udhë e birit tënd do t’i sjellë të madh fitim Shqipërisë, te ku gjithë dyertë do t’i hapen me hirë. Përse politika e *Flàmurit /të Arbërit/* na pëlqen: *Përkrabësi me Sulltanin kundër të huajvet*. E ato që ti shkruan, janë të dreqëta. Shqipëria e tërë janë me Sulltanin kundër Elenëvet. Ndo pak, ndëpër të kërshterët e Epirit, kanë zëmbren me Elladhën, po nuk guxonjën. *Muhamedanët e Shqipërisë janë më të mirët patriotëra*”. – Eftim Mitko.

Pastaj, në atë *Fiamur /të Arbërit/* munda të botoj: “Mëmëdheu përtej detit, që ka gjithnjë emra shqiptarë – *Adriatik* prej /fjalës shqipel *Atërisë* (selí e gjyshërvet) e *Jonio* nga /shqipja/ *jonë* (i ynë) – nëna që gëzohet për *Fiamurin* dhe e ndjek me dashuri të heshtur, dje e përhëndeti dhe i dha dorën, me anë të birit të vet të zgjedhur, Prenkë Bibë Doda, princi i Mirditës, i nderuar nga vëllezërit e krishterë dhe muhamedanë të Shqipërisë, e cila na dërgoi (na çoi) këto pak fjalë të mira:

“(16 shkurt 1886). Prenkë Pasha, Princ i Mirditasve, e lut shumë të nderuarin (zotni) De Radën të pranojë 40 frangat, që ai ia dërgon me nderimet e veta të sinqerta, e të besojë se do ta ndihmojë, me sa do të jetë e mundur, në detyrën e tij të vështirë e atdhetare, që ka marrë përsipër”.

E, shumë kohë më parë, më ishte bërë e njohur hyrja e shqiptarëve, që banojnë në Greqi, në përpjekjet e kulturës së mëmëdheut.

“Kalonte nëpër Napol Otoni I, mbret i Greqisë, që shkonte në Bavierë. E shoqëronte i biri i Misulisit, të cilit iu paraqita për të parë në të se çfarë kishte /të trashëguar/ nga i ati, heroi shqiptar, prisi i kryengritjes greke / për çlirimin kombëtar/. U gëzua, do të thoja, duke parë sprovat e para të përpjekjeve të mira për të ringjallur gjuhën tonë amtare. Më këshilloi të shkoja në Greqi, duke më thënë që, mbasi të kthehej nga Baviera, do të më mirrte me vete në fregatën (në anijen) mbretërore. Por vonesa e tij në Mynhen, zhduku praktikat e martesës së hyjneshës sime, e askush më në botë nuk mund të më shkëpuste nga qëndrimi i saj /d.m.th. marrëveshjet për martesë me hyjneshën time dështuan dhe mua s’kishte njeri në botë që të mund të më shkëpuste nga ndenja me të/”

Bashkimi i zemrave shqiptare, të shpërndara gjithkund, u ndoq nga dëshira e përbashkët për autonominë e vendit të vet, dëshirë e imponuar atyre prej drejtësisë e prej dashurisë së pathyeshme për pavarësinë e vetëvetes. Dhe, këtë, e shoqëroi vullneti i ndershëm i Portës Osmane, /e cila ishte/ rysun, tashmë, se, edhe për të, liman shpëtimi mbeste bashkimi besnik i krahinave të Shqipërisë, e se kundër gërgasave të poshtër, të krijuar nga Greqia e gjorë, nga Mali i Zi e nga shtete të tjera, autonomia e Shqipërisë nuk mund ta ndante e ta prishte Perandorinë, sikur nuk mundi zotërimi i shtëpiave /të mëdha/, nënshtetase të saja, të lira gjithëmonë, që donin të bënin, brenda në to, /veprime/ të huaja /për politikën turke/. E duke pasur besim, mbas bashkëjetesës gati 500 vjetëshe, Turquia e para, kundërshtarë e vendosur ndaj vullnetit të pafuqishëm e të poshtër /kundër dëshirës së mbrapshtë e vullnetit të keq/ të disa Fuqive /të Mëdha/, u deklaronte atyre, se “për të zmadhuar tokën e tashme të Malit të Zi, nuk duhet veçse t’i jepen krahina, brenda të cilave banorët janë të së njëjtës rracë, e, në shumicën më të madhe, të së njëjtës fé me malazetët, ajo e gjykon (e shikon) si një padrejtësi bashkimin (aneksimin) Malit të Zi të tokave të banuara nga shqiptarët myslimanë e katolikë”.

Ndërkaq, u jepte qyteteve shqiptare të Perandorisë shkolla qytetëruese me katedra të gjuhës së tyre, ndërsa Italia, edhe në mënyrë të çiltërt dashamirëse për Shqipërinë e strehuar në gjiun e vet, mbështetur në flakën kombëtare /të tyre/ të përhapur këtu, dhuronte dy shkolla në gjuhën shqipe, duke e themeluar njerën, me anën e Ministrit të shquar, të nderuarit Boselli, në Kolegjin që është në Kolonitë në Shën Adriano, e tjetrën në Napoli në Institutin Mbretëror Lindor, sipas dëshirës (kërkesës) së Kongresit të fundit gjuhësor ndërkombëtar, /mbajtur/ në Romë.

E njohim, së fundi, gati si një bekim të provanishëm për këto studime tona të padëmshme, që Europa e krishterë e ka bërë të vetën çështjen, për të cilën ata janë të devotshme, duke i pranuar arsyet.

Jam i gëzuar se mund të sjell për këtë fakt, si dëshmi të pakundërshueshme, një letër, me të cilën i përmenduri (i njohuri, i famshmi) ministër anglez Gladstone, më nderonte, në kohën e Kongresit të Berlinit:

“26 korrik 1880.

10 Dom. . . street.

Zotëri,

Unë jam ngarkuar prej zotit Gladstone që të ju shpreh falënderimet e tij më të shquara, për letrën tuaj të 17 vazhduesit, dhe për të ju thënë që ju mund të rrini të sigurtë se, bashkë me kolegët e vet, ai dëshiron për Shqipërinë atë drejtësi e sigurim të drejtash civile, që tashti mungojnë, në mënyrë kaq të vajtueshme, në vendet e sunduara nga turqit, me përjashtim /të atyre viseve/ ku janë siguruar, me anë institucionesh, të bazuara *me autonomi* reale dhe lokale.

Unë jam, zotëri,

shërbëtori juaj shumë i detyruar

I. A. Godley

Zotëri,

Jeronim De Radës”.

III.

Por djalli (demoni) armiqësor (i rrezikshëm), që prej më se katërmijë vjetësh, pengon popullin pellazg të bashkohet në një shtet, përpiket tashti, me anë të një rruge tjetër të poshtër e të rrejshme, të çojë huq veprën që do ta shpinte në bashkim.

Helenët e sllavët e Ballkanit, duke u shtirë tepër të merakosur për mirëqenien e ardhshme të Shqipërisë, e se, gjoja, duan ta përshpejtojnë, thonë se ajo qëndron vetëm në sundimin e vetëvetes; e, me qenë se Turcia as nuk mundet, as nuk don ta lëshojë zotërimin e vet në vendosjen e në rregullimin, brenda ndër shtëpitë /e mëdha/ shqiptare, prandaj është e nevojshme të çojnë krye e të thejnë zgjedhën e keqe; të rregullojnë (të ndreqin), përsëri, veten në liri, të cilën, brezi i tashëm njerëzor, e quan burim të çdo të mire.

Nuk është këtu rasti të diskutohet vlera e kësaj farë lirie, /që i është/ dhënë një bërthame, e cila e zëvendëson atë, për të qeverisur çdo pasuri e punë të vendit të vet /dmth., për të pasur në dorë çdo pasuri e veprim/. Vetëm mendojmë se, ata që i nxisin shqiptarët në revolucion kundër Turakisë, absolutisht nuk e bëjnë sepse janë të krishterë, dhe as nga dashuria e madhe që ata të huaj kanë për kombin tonë që të duan ta shohin zot të vetvetes. Qenë e janë gënjeshtarë të poshtër, lakmiqarë të drejtësisë krenare të pinjovje të shtëpive të Epirit, e, në mënyrë shumë të ulët, dishrakë për tokën e lumtur që ata kanë (që zotërojnë), e, për t'i zhbî (për t'i zhdukë), i shtyjnë drejt flamurit të vdekjes.

Sllavët e helenët e dijnë mirë se Shqipëria është sot pa armë, me pak /njerëz/ të vet, në vendin e vet e që nuk njihen njeri me tjetrin, madje pa ndonjë gjë që ta duan të gjithë bashkë; kështu ata janë pa mjete, pa vendime të marra njëzëri. E dijnë, pastaj, se turku, sadoqë është dobësuar nga kohët që erdhën, duke e dëmtuar në lufta të vazhdueshme, i ka të gjitha këto brigje. E presin që Epiri të ngadhënjejë mbi të. Jo vetëm presin, por, për ta ndihmuar, edhe i japin këshilla, që janë armiqësore ndaj Turakisë, me qëllim që shqiptarët, të bashkuar, të konspirojnë, e mbasi që ata i patën ndërsy (i patën cytë) kundër turkut. Ndërsa, mezi ç'presin kohën që ta shporrin prej syve të vet Shqipërinë, duke i pushtuar, siç shpresojnë, malet dhe brigjet kaq të shëndetshme e të plleshme.

Le të më lejohet që unë të qes në dritë – do të thoja – rruzullin e gjerë, të vjetër, të cilin e ka ndjekur një prishje kaq e madhe e jetës njerëzore dmth., pastaj jeta njerëzore u prish kaq shumë. Afër perëndimit të jetës dhe me mendjen plot shkëlqim të ditës, në të cilën jetova, po ju lë të vërtetat që i kam nxjerrë, si në testament, për farë e fisin tim (për gjërinë time, për popullin tim), që të gjejë aty paqën e vet.

IV.

Libri i jetës që na rri i hapur përpara, ka në vetëvete një qenie të dyfishtë të amëshuar (eternale, të përjetëshme): njera është vetë jeta, në të cilën kombet e njerëzve lindën me një pritje pa breg, megjithëse shohin, nga ditët e saja, ku do të kalojnë. Rrinë me një besim të vendosur (të ngulur) nga se lindin me kuptim, me drejtësi, me dashuri; cilësi të shtrira (të ndera, të vendosura), që thënë, nga një i përparshëm, i vjetër; e, për to, janë ndihma për t'i përmbajtur në familje e në jetesë të përbashkët të lumtura (e për banime të lumtura). Besimi i tyre mbahet, vazhdimisht, nga të përmbajturit (përkatësia) e jetesës tokësore botës së pambarim; e ndërtojnë me gurë banesat e veta, për të gjatë kohë. As nuk dijnë kurrë se ka gjë të pahijshme: - “Që vetëvetes, kaq të vegjël e të vdekshëm, t'i mbesë për jetesë (për qëndrim, për banim) një botë kaq e madhe e pa zhgatrim në amësim; as që atyre t'u veket, në orët e nevojës, dora e shpirtit të vjetër, Mbretëreshë”. Ndërkaq, atij besimi (ose ndaj feje), Ungjilli i ka premtuar *të afruarit e mbretërisë së Zotit*, që jeton (ushqehet, lëviz) brenda asaj jete. Në atë, shpirtërat e mëdhej dhe të prujtë (që kanë turp), parandjejnë në dashurinë e burrit me gruan kënaqësinë (lumturinë) e Parajsës; për këtë kanë dijeni të gjithë popujt e tokës, të ndarë ndër brigje.

Aspekti tjetër i botës, në gjiun e së cilës gjindemi, është fakti se do t'i lëmë të mirat, me të cilat jetojnë të gjithë ata që lindin në tokë, duke i përdorë lirisht prodhimet e viseve ku lejnë. Brezat e njerëzve prodhojnë edhe vetë një pjesë të madhe të gjërave të nevojshme që u duhen: mbjellin, korrin, bluajnë grurin, pjekin bukën, që u nevojitet. Aty me njeriun kullosin bagëtitë e ndryshme, të panumërta që, këtu e atje, e ndihmojnë të nxjerrë ushqimet nga balta e tokës, e i dhuron edhe nga mishi i vet, që ta bëjë të jetojë. Ai e dëgjon të flasë për vete dhe e bën zot të vetëvetes. E njeriut, megjithëse nuk i hiqet kurrë nga mendja ideja se të gjitha sendet qenë krijuar me kohë e, qëndrojnë atje, prej nga ai i merr, i mbetet në zemër një besim i padukshëm “se Toka është feudi i tij”.

Këto dy aspekte të jetës, të ndriçuara nga i njëjti diell e të lidhura bashkë me dashurinë e pakufishme të një vullneti të vetëm, janë të vendosura, qysh *nga origjina*, për të mbrojtë fatet e njeriut. Njeriu le të dëshirojë e të ketë çfarë i nevojitet, por duke pasur parasysh, gjithmonë, se nuk i përkasin atij as vetvetja, as pasuritë, të cilat, vazhdimisht, njeri i lën e tjetri i merr. E njeriut i është bërë nderi i madh, meqenëse Zoti i qëndron pranë, i rrit cilësitë e vulosura, ç'me

lindjen e shpirtit të tij, dhe e bën të mvarur nga ai Perendi, që ia dha ato cilësi. Në të tëra brigjet e botës, për të gjitha kohët që mbahen mend, nga të cilat kanë mbetur kujtime, ndër shtëpiat e njerëzve qenë ngritur kisha, e njerëzit patën e kanë besim, në të vërtetën e në lutje (në falje, në uratë).

Misteri i Fateve të tija qëndron, pastaj, në atë që, për shkak të vdekjes e të Demonit armik, - dihet prej të gjithë njerëzimit – jetesa në tokë që bërë palestër hyjnizimi, e cila ishte e denjë vetëm që njeriu ta fitonte për vete e të ishte për të kurorë fitoreje. E, kështu, Erebi tërheq nga vetëvetja ata që janë varfanjakë (meskinë), por ata që janë shumë të fortë e të zgjuar, nëpërmjet fatkeqësive, dhimbjeve dhe fajeve, mund të dëftojnë cilësitë e tyre hyjnore në krahe /në hìret e Perëndisë/ që t'i çojnë në prehërin e Atit, që i njeh përsëri dhe i mban për bij të denjë që të mbretërojnë me Birin e vetëm. Kjo është, vazhdimisht, e vërtetë dhe e pranishme.

Por na qëndron, bashkë, përpara, ç'prej kohës së parë, gjendja e popujve në rruzullim, që, të pafuqishëm, durojnë ardhjen e mbretërisë së Zotit, që nuk shihet kurrë prej tyre, e që, duke qenë e prishur prej rrjedhës së këndshme të të mirave, me të cilat jetojnë, e nga sundimi i tyre që ato mbajnë në vetëvete, u lëshohen, krejtësisht, në dorë të tyre. Njerëzit jetojnë të pavetëdijshëm në këtë botë, prej nga dolën, e nuk dijnë edhe pse ta çojnë përpara prodhimin, më tepër se sa u duhet shijeve të tyre e mbajtjes gjallë të jetës, para se kjo të bjerë në terrin e mosqenies. Ata nuk pyesin, asnjëherë, pse Dielli e Hëna, të krijuara për njerëzit e tokës, qëndrojnë larg; as kësaj Tokës nuk i qe thënë si gjindet e bashkuar me hyjt e botës. Asnjë njeri nuk di, sot, me të vërtetë tjetër veçse për dorën që bën e jep. E munda njerëzor (në shqip është *bëna, bana*, përkthyer në greqishten *pana*) gjindet i vendosur ndërmjet zotave të vet dmth., djersa që derdhet, është një ndër perënditë e tij. Pastaj u vendosën në tokë, prej së cilës hëngrën, pinë e fjetën, pa menduar. E zgjohen, gjithmonë, me vetëdije se aty çdo gjë është bërë për ta gëzuar jetën (për të jetuar mirë), që është qëllimi e thesari i Djallit të largët, ku e drejta e parë është të qenit e njeriut e të nxjerrunit nga gjithkund, e sido: e para e drejtë që, ndoshta, në mendjen e tyre zgjidh nga faji mashtrimin, vjedhjen e tiraninë që të ndihmojnë mirëqenien individuale. Me siguri, të qenët i drejtë, dashamirësia e feja, faktorët (bâtorët) e sferës më të lartë, nuk kanë mbështetësen që shihen, në rruzullim.

V.

Kështu, cila nga kombet njerëzore ka pasuruar, deri tashti, vetëveten me tokë të huaja, mbahet fatlume, si ajo që shkonte për të qëndruar në fronin e jetës. Fakti se historia e njerëzve ka qenë që nga zanafilla histori luftash, të nxitura, gjithmonë, prej lakmisë së fitimeve më të mëdha e prej kotësisë së ulët /prej zbratësisë së thatë, boshe/ për të ndrydhë mbi fqinjët, dëshmon se tek ata mbizotëron, sidomos, kulti i të mirave tokësore.

Ndoshta gabohem, por besoj se një përhapje pa frê /jashtë mase/ e prishjes së njerëzvet ka qenë në kohë, që endë mbahen mend /kujtohen/, dalur qysh nga përmytja e Noesë dhe e Romës, aq madhështore e ulkonjë grabitqare, nga e cila, tashti, nuk tepron më asgjë, veçse jehona e asaj që qe dikur, mbeturinë gjuhësore, tash e boshatisur nga përmbajtja. Italia e sotme ka mbetë si relik i dikurshëm, që nuk e ka më atë përmbajtjen e përparëshme. Me fjalë të tjera: Nga lavdia e Romës së dikurshme, sot, s'ka mbetë gjë tjetër, veçse italishtja, trashëguar si një tepricë gjuhësore, por e boshatisur nga përmbajtja e përparëshme.

Ndërkaq, as Agapi (dashmirësi vëllazërore), i përhapur si shpërthim i shpirtit të Atit në bijtë e vet tokësorë e që përbën mbretërinë e tij në amëshim, nuk është kryer, pasi që fjala e tij u ndie në botë. Kisha katolike e ortodokse marrin pjesë (asistojnë) në vazhdimin e devijimit (shmangies) së mbrapshtë, e, endë, bashkë me to, *historia e njerëzvet është histori luftash*. Nga ana tjetër, fatkeqësisht, tjetër karakter, nga pafuqishmëria e tanishme e tyre, është fenomeni "se në to fara njerëzore në mjerimet e saja thërret Zotin At me fjalë gjuhësh të huaja, që nuk kupton. E, që të gjejë atë që për jetën e saj është Zotëri e Zot, i bëhet pengesë moskuptimi i fjalëve, me të cilat kërkon (ose lyp); e lutja është boshatisur (është shprazur) nga padituria (nga injoranca); as s'mbet më rrugë për premtimin: *quaerite et intervenietis; petite et accipietis* (kërkoni e do të gjeni; lypni e do të merrni).

E më tutje, mbrapa, është përhapur të marrakosurit. Për shkak të prisave të këqij të popullit, që koten, do të thoshje, që pandehin se zënë vendin e Krishtit, sot është bërë e ligjeshme deri zhdukja e personalitetit të kombeve, duke ua mbytur gjuhën që i dallon dhe duke ua zhbi ekzistencën (duke ua shqymë qenien e tyre).

Ne kemi parasysh tradhëtinë e çmendur të Greqisë me shoqe, që konspirojnë për thithjen përfundimtare të popullit pellazg.

VI.

Por me zhdukjen e prîsave nga sytë e masave, sfera më e lartë e kësaj Jete nuk pushon zhvillimin pas tyre, valët e së cilës do ta kthejnë te Ati, të vlerësuar nga vuajtjet e vdekjes në kryq, në të cilin i vendosi Biri i vetëm për dashurinë e shenjtorëve në varfëri, në botën e vet të pakufishme. E vëmendja, prej kaq vjetësh, që unë i vura jetës së vdekshme, pas shikimit të qartë në misterin e saj, është ngulitur në mua, me një besim të patrandur, në fitoren përfundimtare të çdo drejtësie, nga të cilat një është kryesore: rilindja (përtëritja) autonome e vendit tonë, e përhëndetur prej bijve të vet të të gjitha brigjeve. Edhe në muajin e kaluar, i patën shkruar, nga Vlora, Anselm Lorekios, kalorësit tonë që mban lart, përballë Shqipërisë, flamurin e saj, se *Shqipëria duhet të jetë e shqiptarëve*.

“Pashë Djallin të binte poshtë nga qiejtë si një vetëtimë”.

E, për mua, insinuata e meskinëve (varfanjakë), që na nxisin për luftë me Turkinë, është zekth që më ngacmon e më shtyn kahë bashkimi i pashkëputshëm me të, gati si liman shpëtimi për né e për të. Ajo nuk na desh keq. Na e la vendin që e gjet tek né. As nuk pat në mendje, kurrë, shuarjen e kombësisë sonë, të drejtësisë dhe të burrërisë luftarake, e cila, e zgjeruar (e zmadhuar), do të thoja, gjithnjë e më tepër, është sot e lumtur se ka lidhë një pjesë me veten, në besimin në Zotin, sipas mësimave të një biri të vet, Muhamedit. Sot, vetëm Turcia është e lidhur me shqiptarët në zemër, siç dëshërojmë të jetë për institucionet. Askush, në të vërtetë, nuk mohon se oficerët të perandorisë shkretajnë (dëmtojnë, dhunojnë) shtëpitë e shqiptarëve të mjerë; e ua bëjnë atyre një nevojë të domosdoshme për t’u bërë zot të vetëvetes; por, megjithatë, pa i shkëputur nga fati e nga administrimi i Perandorisë së Konstantinopojës, bashkimi me të, që prej katërqind vjetësh, tashmë, është bërë për ta gjendje normale.

Vura në dukje gjetiu (tjetërkund) rrezikun që do të kishte për jetën e Shqipërisë revolucioni, që i këshillojnë kundër turqve. Nga ana tjetër, shikimit të mprehtë osman nuk do t’i ikë (nuk do t’i shpëtojë) shpresa e fshehtë e keqdashësve, që ia çmojnë një çështje nderi mohimin e pacilësuar të kërkesave të Shqipërisë; shpresë që ajo, Turcia, sadoqë fitimtare, e dalë nga dyluftimi e këputur (e lodhur, e dërmuar, e molisur) e pa i pasur më shqiptarët për krah, e rrethuar nga mbretëritë e krishtera që dyshojnë në të, do të marrë pjesë (do të asistojë) në shkatërrimin e vet, që do t’i vijë pas. Ndërsa, bashkimi vëllazëror e pa përzierje me ta, mbrojtja e tanishme e vetes së saj, është

vendosur mbi mirëqenien reciproke, - si ajo e Skocisë me Anglinë, e Austrisë me Hungarinë – do të mund t'i dhurojë, përsëri, Perandorisë së Konstantinopolit, parësinë e lumtur ndër shtete, për të cilën, tash, veçoritë gjeografike e natyrore i bëhen krah (e përkrahin).

Për këtë dukuri përfundimtare, ndoshta, është përgatitje hyjnore zgjimi i ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Shqiptarët kanë nevojë të bashkohen në studimin e gjuhës së vet amtare, në soditjen vepruese e imituese të lavdive të kaluara, duke i respektuar megjithatë të drejtat feudale në fuqi, në katër *vilajete*, të cilat, të njësuara e të bashkërenditura, do të ripërtërijnë vendin, me të cilin Leka i Madh nisi pushtimin e Azisë.

E Zoti kërkon, me siguri, sakrificën që bëri, për vete, për Atdheun e pamundur e për Fenë e krishterë, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, hero i pakrahasueshëm. Ai bekim raftë mbi shtëpinë e baballarëve të vet, rihapja e të cilave qoftë për bujarët shqiptarë, një çelje e lavdisë dhe e fatit të vjetër të tyre.

Kjo, pra, duhet të jetë zgjidhja e fateve tona në Lindje, që duhet të mbesë si ëndërr e dëshirave tona. Sot fryn, nga shumë anë, një erë e mirë mbi Atdheun tonë të pikëlluar. Restaurimi autonom i tij i imponohet Europës, i pjekur nga nevoja që ka për paqën e vet. Mbretërit e saj, të mbledhur në Berlin, pranë fronit të një Shën Konstantini të ri të të krishterëve, i bënë të ditur Portës Osmane, se ishte nevojë e tyre që Shqipëria të shpallej autonome, dhe Shqipërisë i parashtruan detyrën të mbetej një gjymtyrë besnike e Perandorisë Osmane. E, kështu, gjithçka të qëndrojë e përmirësuar në *statu quo* (në gjendjen që është).

E, sidomos, do t'i vlejë një paqeje të tillë të uruar, përhapja e afërt e fjalës së Zotit në Turki, e, pastaj, edhe më tutje. Kjo shtrirje shpirtin tim e paraqet në sferën e lartë, eprore, të jetës. Është ai Verb dielli të largët, në dritën e të cilit zhytet e zhduket çdo dritë zjarri, që të ketë ardhur, duke u nderur ndër kohë. Ai vetëm është pjesë fisnike e botës. Ai vetëm ndriçon ditët tona. Aty, kush dëgjon atë Verb, ai beson dhe bën. Sa kërkon këtu, merr gjithmonë. Për këtë fakt të pakundërshtueshëm, dëshmitare është jeta ime shumë e gjatë, sipas rrëfimeve të shumta të botuara në shtyp. Dhe as nuk më mbetet e nuk qe gjë më e madhe se E vërteta, ose gjë që unë nuk pres më nga sa është, përveç pushimit e një perëndimi të afërt. Por ajo pranë e përhershme e virtytit hyjnor të atij Verbi e bën fitimtar në amëshim. Nga shpirti nxjerr parandjenjën se përhapja e tij në Turki do të ketë fillim me kthimin në fenë e stërgjyshërvet të shqiptarëve, sot vëllezër me turqit, për shkak të martesave e të pikësynimit të dëshiravet.

KREU VI

EPISTULAR (1834–1902). NGA LETRAT E BOTUARA

1. RAFAEL XAGAREZES¹⁶⁴

Sot, në perëndim të diellit, po shëtisja me Antonin dhe Engjëllin kundrejt mureve të Shën Adrianit; rrinim në heshtje, duke menduar se, mbas pak ditësh, nuk do të takoheshim më në atë rrugë, dhe dëgjuam, me një melodi mallëngjyese, si ideja e amshimit në njeriun kalimtar, të këndohej një nga ato, që ne i quajmë *vargje*, të cilat shprehin, gjithnjë, një ndjenjë të vetme e të zjarrtë. Po ta përshkruaj që ti të shohësh shijen e këtij populli:

*“Mos më harro, o djalosh, në udhëtimin tënd,
Sepse, sa të desha, as vetë s’e dij;
Mos më harro, kështu që të mundesh, kur të kthehesh,
Të më gjesh të bukur e të ré, siç më le”.*

Zëri e kujtimet e dimrit të kaluar më zhgrehën në vaj. Unë e ndjenja se jeta ishte bërë më e pasur e kishte nevojë të zbrazej në dikë. Kudo që kaloja, bëheshin lutje, që nisja ime për Napoli t’i sillte dobi vendit. Kush i zatet këta njerëz të pakënaqur dhe u heq fuqinë dhe i bën të jetojnë me shpresë në të tjerët? Këto mendime më trulllosin: unë e lë veten në dorë të fatit, pa u menduar, sikur ai që hidhet në jetë vetëm

¹⁶⁴ *Poesie Albanesi del secolo XV. Canti di Milosao, Figlio del despota di Scutari*, da Tipi di Guttemberg, 1836, p. V.

për shestime të forta. Oh, sa më ka ndërruar ky vit! Në korrik të vitit 1833, duke e pasur kokën plot me numra e shpresa, dola nga kolegji. Toka më buzëqeshte ngado që unë e vështroja; derdhja në këngën e dytë të veprës *Kruetani i mërguar*, me vargjet që ndjekin, ndjenjat me të cilat më mbushte atdheu im:

“Unë po shtrihesha, edhe një herë, në shtrat, / të cilin dadoja ma kishte mbushur, / e gëzueshme që po më shihte rishtas; dhe ishin të gëzuara / vatrat (shtëpiat), për të korrat. E zhytur / në mendime të thella, e hutuar, shkëlqente hëna / dhe dukej tamam si ditë e gjallë, rreth lumenjve, / që të rrethojnë, o Maqë; / nëpër kallëza, / zihatja e lehtë e bujqve (të vatrës) e mbushte / ajrin e qetë dhe fushat e larueshme. E lodhur, / vasha flinte, duke ëndërruar agimin / dhe shoqet kah mbushnin boskat / për vjelësit, ndërsa ajo në fundin / e errët të tremes, dorë për dore, kapet / me të birin bujar të zotit të arës. / Dhe prej vetë atij vendi, / heret, si ta kishte zgjuar Xagareze, / do ta thirrte (në shtëpi) dhe, në fladin jashtëzakonisht / të melodishëm të natës; i rrëmbyer, do të shikonte pas nga Maqi, e mbështjellur nga kodrat e djegura / dhe nga pyjet që merrnin avullim dhe / më dukej se kurrë s’do të mirrte fund jeta / dhe dukuria ime këtu në tokë”. /

Në ato ditë të bukura më lindi në zemër kënga, që fillon: *Ljis jeta kish ndërruar*. Trajtat e saja tepër të gjalla dhe të zhveshura nga çdo pikëllim më bindën, se unë isha mjaft i qetë për të shkruar, plot gazmend, sipas poetit të Teos. Ecja nëpër pyje, nëpër brigje të lumenjve dhe nëpër vërria me tronditje të ëmbla; unë iu ngjitja kodrinave dhe një mendim lavdie më dehte. Shpesh, ndër ditët e kthjellta të asaj vjeshte, rrija në bregun lindor të fshatit; veriu (tramondana) lëkundte përposhtë meje degët e zbardhemëta të ullijve dhe e gjithë sipërfaqja e kaltërt e detit po shkumbëzonte; ajo anë e tokës, e braktisur në tronditje e në fishkullim, më sillte ndër mend rrëmujën e sa brezave njerëzore. Po ende nuk kishte filluar të acarohet dimri, kur të endurit tim ishte më i lirë të bariste. Unë ndjeja, si thellësisht e kisha shprehur, atë që këndoi Italinë: se dashuria, kur është një pasion, të çon gjithnjë në mallëngjim.

Do të kishte qenë pa vlerë sikur të bashkoja këngët popullore shqipe, mbasi do të bëhej një përmbledhje, e cila, tash, është plotësuar dhe vënë në vargje italiane nga miku im fisnik Engjëll Bazile, dhe, meqë m’u dukën disa shumë të këndshme, ua mësova të rinjve

fshatarë. U përpoqa të hartoj ndonjë në mënyrën e atyre, dhe nuk më dolën fort keq, ndërsa, secilën këngë të re, që këndohej për të parën herë në mbrëmje, gratë dilnin ta dëgjonin ndër dritare. Kjo më nxiti dhe më lindi idejapër romanin tim dyfish lirik. Unë në të derdha shumë ëmbëlsi e mallëngjim, sidomos vërtetësi, duke pasë përshkruar në të, në pjesën më të madhe, ngjarje krejt të mia: as kam lexuar ndonjë gjë aso dore. Është lehtë, veç, që të gjendet një shembull i tillë, meqenëse këto vise shohin pak libra. Tash po e shoh, se ky vit më ka kaluar kot, si kalorësve endacakë në kështjellën e Atlantit, s'kam bërë asgjë për të ardhshmen, që të ndiej më tepër kënaqësi për të. Në fund të muajit, këto vise do të më mbyllën përgjithmonë. Ndoshta, kur të kthehem, do të dëgjoj, gjatë të vjelave dhe gjatë të korrave, këngët e rinisë sime të parë, dhe, duke e ndjerë veten, gati si të huaj, do të them me vetvete: A nuk janë këta të rinjtë, a nuk janë këto gratë, me të cilat kam ndenjur, aq herë në tryezë, në fushë dhe kam festuar të kremtet? A nuk është kjo fytyra ime ajo e mëparëshmja?

Po i jap fund, lum miku se pak më vlejné këto ëndërrime; vetëm të lutem, eja shpejt të më takosh e të më gëzosh. Lamtumirë!

Miku yt
Jeronim De Rada
Maqë, 20 tetor 1834

2. MIKEL DE RADËS¹⁶⁵

Ju ndjeni për mua kaq dhimbje të madhe, saqë edhe unë vuaj, ashtu sikur unë të mos kisha fuqinë e duhur t'i bëj ballë, jo vetëm vetmisë, por edhe të këqiave më të mëdha.

Në qoftë se u veni vesh fjalëve të botës, nuk mund të kuptoni ndjesitë e mia. Ju lutem kujtohuni si u mbështeta në të gjitha vështirësitë e jetës time në prërdinë dhe në fatin tim.

Edhe mua, në këtë heshtje, më paraqiten, në një mënyrë të errët, të gjitha ato mendime që lakmia për të mirën m'i ndriçonte më parë; megjithatë, unë i vlerësoj dhe përpiqem, vazhdimisht, për t'ua zbutur atë vrazhdësi që vjen nga lodhja.

Dhe, në pak ditë, krewa (përveç legjendës së Huniadit për librin IV të Epopesë), edhe shtesat për këngën e Milosaos dhe, pothuajse as që duket në paraqitjen e kthjellët të vet pikëllimi i shpirtit tim.

Ashtu siç është tash, më pëlqen; porsa zgjohem në mëngjez, duke parë se si po më ikën një ditë shumë e kthjellët pa bërë gjë, ngushëllohem me këto këngë, duke e lënë pas kohën kur nuk kam për të ekzistuar më në asnjë vend të botës.

Dje u shqetësova shumë, mbasi nuk kisha lajme për tim vëlla; e marr me mend që do të jetë shqetësuar nga largimi juaj; qëndrojini afër me këshilla dhe kësodore nga kjo fatkeqësi do të fitojë shprehi për punë dhe do të tregohet i matur e i vendosur.

Me shëndet jam krejt mirë.

Ju kërkoj bekimin dhe mbetem

Biri juaj shumë i ndigjueshëm:

Jeronimi

Napoli, më 20 shtator 1839

¹⁶⁵ *Poesie albanese*, volume I, *Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari*, terza edizione, Tipografia Albanese, Corigliano Calabro, 1873.

3. SË SHENJTËS VIRGJËRESHË TË PAPËRLYER¹⁶⁶

Napoli, më 8 dhjetor 1840

Agoi festa jote o Virgjëreshë e Papërlyer; dhe në këmbët tuaja çdo familje dergj shqetësimet e saj, në mënyrë që Toka t'i hapet diellit e zhveshur dhe e plotë. Ti shkon e lumtur; sepse vetëm nëse lutjet janë të pakta, shpirti yt mbetet i pakënaqur.

Dhe ti i përket edhe meshës së ritit tonë, aty ku gjendet e shkretë në mes të Italisë: eh! nëse e doni tokën e krishterë, më ktheni shëndetin.

Kur isha adoleshent, më goditën dielli dhe shiu; por dashamirësia e një miku që më mbajti me vete, më ruajti nga ethet dhe varrin ma shtyu tutje.

Dhe po i njejtë besim që më vonë ai ndaj atdheut. Ndonjëherë mes grurit të gjelbërt, tek i cili mbërrinte nga larg jehona e kishave të tua, u ula nën një dardhë të egër dhe më rrëmbeu gjumi. Kalonin andej vashëza që me këngën e tyre ma çonin shpirtin peshë, por jo përtej gjumit; më lozonjarja prej tyre më hodhi "velin" e saj e me të më mbështolli, dhe ashtu buzagaz më qortoi për përtacinë që gjendej në gjymtyrë aq të reja: saqë ata dhe unë e shihnim njëri-tjetrin në çdo ditë dhe në gëzime të reja, porsori orët e qiellit (parajsës).

Por unë dola nga ajo kohë, si nga një zhytje në det që të freskon për disa orë dhe ta shton shëndetin; dhe ndoqa diturinë dhe të vërtetën e pavdekshme në vende të largëta ku ti, o Shenjte, ishe udhërrëfyesja ime e vetme dhe e mëshirshme.

Dhe shpejt rruga ime u la me gjakun e njerëzve që kishin jetuar bashkë me mua: por mua në ëndërr m'u shfaq e mëdyshur një fytyrë e

¹⁶⁶ *Alla Ss. Vergine Immacolata Poesie albanese*, volume I, *Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari*, terza edizione, Tipografia Albanese, Corigliano Calabro 1873, p. 3.

dashur, e cila në zemrën time nuk u shua kurrë dhe më tha: pse druaje kaq shumë se mos ishe ti i padenjë? a nuk ishe i ruajtur mes të njëmijëve?

Pas asaj nate, i shkëputur nga njerëzit, e pashë veten të ruajtur nga stuhitë çdo ditë dhe u mora (argëtova) me veten time, pothuajse si një perëndi që pushton botën.

Sepse çeli në zemrën time një këngë e qetë dhe besimplotë në Kishën e së Mirës së Përjetshme e cila më premtoi njohjen e Dritës që mbush jetën.

Por, megjithatë, gjithmonë më rikthehet një mendim, që paraardhësit tanë dëshmorë të asaj Kisha, e humbën veten mjerisht dhe ne na lanë pa një atdhe dhe pa pasuri.

Dhe tashmë jeta ime e re është plagosur në një tokë të huaj, dhe bashkë me të janë plagosur kaq shumë shpresa që unë kisha siç i kishin edhe ata kalorës; dhe se si flamuri yt i bën të lindin sapa në ajër ai shpaloset.

Por edhe besimi që njeriu ka tek ti, ai besim i cili kur ndjehet i zhgënjyer bie, por herë të tjera shfaqet gjithmonë me lutje të reja dhe në çdo ditë, tashmë ai është dëshmi e mirësisë tënde të pashtershme: Dhe kështu nga varri ku jam unë ngrihem dhe lutem me zemrën mbushur plot me jetë të amëshueme.

Ai nuk mund të ngrejë dorën e njeriut: por ajri që Ati dërgon dhe i afrohet qiellit ripërtërin çdo gjë vit pas viti, ndërsa gëzimi që largon dashuritë tokësore nga unë është ai me të cilin hiri yt më mbysh.

Një gëzim si ky i sotmi përhapet në atdheun tim të mirëpritur para imazhit tënd, e shenjta Virgjëreshë; ndërsa babai im i lumtur parfumos altarët dhe nuk di asgjë: ai për të cilit vetëm emri im i gjallë është një pasuri kaq e madhe!”

4. VINÇENC DORSËS¹⁶⁷

Kam lexuar me kënaqësi të madhe “*Letrat e tua romane*, sepse më kanë bindur plotësisht për gjithë mbështetjen e madhe që mund t’u sjellë mendja juaj e mprehtë ngulimeve tona. Çka, në të vërtetë, më ka goditur fort në to, është mënyra e drejtë me të cilën hulumtoni në lashtësinë e madhe latine. Gjykimit tuaj të qartë të mendjes suaj të mprehtë e konsekuente s’i shpëton as letërsia, as doket, as feja; me fjalën tuaj, ndihet se Italia jeton ende në historinë e Romës, tek e cila popujt e mundur ishin mësuar të shikonin vetëm forcën fitimtare. I keni përvijuar me siguri të plotë edhe kufijtë e trevave pellazge. Gjithashtu keni prekur edhe fjalën *Vesta* në të gjitha vështrimet, ia keni zbuluar kuptimin e vërtetë në heksametrin e Ovidit *Nec tu aliud Vestam quam vivam intellige flammam*, por vetëm s’ju kujtua fjala shqipe *Dhesta* (gjithnjë e ndezur), nga e cila rrodh *Vesta* latine dhe *Ifestos* (Hefesti) helen. Por, tashti, si një tis i dobët, ajo magji e kështjellës së Atlantit, ajo asgjë që ndërvihej mes nesh e popullit pellazg, ka rënë dhe është zhdukur. Dhe, tash, nga Frashinetoja (vendlindja e Dorsës), ku njihen aq shumë gjuha e kultura helenike, pritet më fort se nga ngulimet e tjera, vënia në pah (qitja në dritë) e lashtësisë së popullit tonë.

Nuk dua ta përfundoj këtë letër, pa ju dhënë një sihariq.

Kur, vitin e kaluar, Tomazo Paçe qe në Athinë, botoi në gazetën *Minerva* disa mendime të veta mbi kombin (popullin) pellazg, mbi lëvizjen mendore të ngulimeve të Siqelisë dhe mbi bukurinë e fatet e gjuhës shqipe. Kështu, dje ai mori një pliko (pako) me libra shqip, nga Bukureshti në Vllahi, dhe një letër nga një zotëri shqiptar, Qiriako Danjeli, në të cilën i thuhej: “Lajmi se në Itali lëvrohet gjuha jonë,

¹⁶⁷ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

na ka bërë zemrën të gufojë nga gëzimi, këtu në Shqipëri”. Ndaj i kërkonte, nga një kopje të të gjitha gjërave të botuara tek ne, që t’i çoheshin (dërgoheshin) në Brailov (Brëillë). Bëjeni të ditur, për këtë, Santorin, me qëllim që t’i bëjë një rishikim të mirë dramës së vet, dhe ta përgatisë për ta nxjerrë në dritë. Unë besoj se e keni lexuar *Këngëtoren* e tij të vogël dhe, sikurse dhe unë, keni vërejtur në të vulën (tiparet) e një poeti të thjeshtë e të fuqishëm: fjala buron e gjallë dhe me një mënyrë të re nga shpirti i tij; përfytyrimet e tija janë marrë nga jeta shqiptare, me më tepër vërtetësi, se sa ato të Gesnerit nga jeta zvicerane; dhe, nëse nuk e ka figurën hyjnore të Laurës dhe trillimin e shumëllojshëm, të pastër e të stërhollët të këngëtorit të saj, prapëseprapë ka një dashuri më të trishtë (të zymtë) e më të vërtetësishme.

Jeronim De Rada

Napoli, 1847

5. KALORËSIT SAVERIO PRATO, KOMANDANT VULLNETARËSH NË VENEDIK¹⁶⁸

Mbasi iu përgjegja letrës suaj të fundit, që e lexova, pastaj, të riprodhuar, më 22 mars, nuk pata më lajme prej jush, kështuqë nuk di çka të mendoj.

Megjithatë, të vetmet gjëra që e gëzojnë janë lajmet e reja, që vijnë nga bijtë e tij luftëtarë në Lombardi dhe që nuk vlejnë më pak për trimëri se sa të tjerëtqë flasin gjuhën e vet dhe lindin nga sundimtarët (dukët) e vjetër të botës.

Me të vërtetë, është i madh dhe i bukur ky grumbullim i të rinjve të të njëjtit komb, por me atdhe të ndarë, në një fushë ku jepen provat se kush po e nderon më tepër të vetin.

Homeri e Aleksandri, shumë të mëdhej në mes të njerëzve të të gjitha kohëve, u jepnin ushtrive të tyre formën e një të tillë fushimi, duke i ndarë ndër kompani, sipas qyteteve dhe sipas fiseve. Unë e adhuroj ndjesinë e këtyre shpirtërave hyjnorë, ndjesi e përbashkët e të gjithë popujve pellazgë, nga të cilët lindën, në mënyrë të vetvetishme, bashkësitë italiane, sa të lira aq edhe të devotshme për Romën, edhe ajo e vetme.

Dhe unë jam i bindur plotësisht që në rast se një ligj i menduar mirë do t'i jepet Italisë bujqësore, që është e denjë për lirinë më fisnike, një pavarësi partish që lulëzojnë vetvetiu e njëheri që i bashkon me mënyra dashamirëse që koha nuk do t'i zhdukte, ai (ligj) do t'i sigurojë brenda pak kohe atë begati që kanë Zvicra dhe Amerika, por me një botë më të madhe shpirtërore. Kanë në gjak, në gjuhë, në tradita një lidhje të shenjtë, që i lidh ata që marrin pjesë.

¹⁶⁸ *Fiamuri Arbërit* (L'Albanese d'Italia), nr. 27, dt. 3 qershor, 1848.

Dhe mua më kujtohet se kur, në Kolegjin Arbëresh, na ra në dorë, në të rinjve, *Udhëtimet* e Pukëvililit dhe *Historia* e tij e *Ringjalljes së Greqisë*, ajo që na ndezi ne, nuk qe atdhedashuri, as entuziazëm, por diçka e shenjtë që na rrëmbente, ashtu siç ngjallet, në një shpellë luanësh të vegjël, kur, para tyre, kalon një tufë (kopé) armike.

E, megjithatë, ne të mërguarve na ndan një det i pamatur dhe një kohë e gjatë dhe shumë ndryshime qeverish prej trojeve të lashta të të parëve aq sa, kur unë, për të parën herë, i veshja, me gjuhën amtare ndjenjat rinore, vetë bashkatdhetarëve të mi kjo iu duk një gjë e huaj dhe krejt e kotë.

Por, çfarë mendimi tjetër mund të zinte vend më tepër në zemrën time se sa ideja se jam shqiptar, se kam dashur më tepër se çdo gjë mëmëdheun, se e kam për zemër dhe të shenjtë, para së gjithash, gjuhën që ishte shprehje e shpirtit tim dhe pa shikuar madhërinë e pashoqe të saj, edhe para se ta gjeja të ngulitur në shpirtin e saj kuptimin e botës së vjetër fetare.

Edhe sikur të më vendosnin në çfarëdo vendi të botës, në mes të popullit tim që ka mbetur vetëm, prehet shpirti im, ashtu sikurse, dikur Uliksi, nuk donte tjetër të mirë veçse atë që të jetonte në Itakë pranë vatrës familjare për atë pak kohë të jetës që i kishte mbetur.

Ju do të ma falni dufin që kam. Prania e rilindjes italiane, ringjallur në mënyrë të mrekullueshme, ma bën mua më të dashur mëmëdheun e të parëve të mi, bir i të cilit unë jam, e për të cilin endë nuk ka arritur dita e tij e madhe. Ajo (Shqipëria) – kështu më thotë mendja ime parashikuese – do të dëgjojë, në këtë tokë të stërgjyshërve tonë, kushtrimin e parë të ringjalljes. E, kur Italisë nuk do t'i cënohet liria e saj nga lidhjet e jashtme, që do të mund cilësinë për t'i dhënë unitet, (i cili do të ishte, gjithënjë, artificial dhe i barabartë me shermashekun që shtrëngon e lidh degët e një peme); kur Italia, e bashkuar, siç janë bijtë e së njëjtës shtëpi nga virtyti, nga populli, nga gëzimi i drejtë i ndarjes së trashëgimisë, të ketë, vetëm ndaj të huajve, një emër të vetëm, një vullnet të vetëm, një mbrojtje të vetme, atëhere, në gji të saj, edhe jeta jonë do të shpalosë lulet e vjetra të vendlindjes, të cilat do ta zbukurojnë edhe këtë kopsht të Italisë, që erërat e stuhitë nuk kanë mundur ta rrëzojnë (ta rrahin) kurrë, sepse këtu e ka selinë e vet jeta.

Bijve të saj trima u takon (u përket) që, sikurse kanë bërë në të

kaluarën, ta nderojnë, endë gjithnjë, në fushën e luftës, ku, me vëllezërit e tjerë, janë duke mbrojtur nënë e përbashkët; kështuqë Napoli të ndrisë përtej dritës që pat nën normanët, dhe mos të imitojë kurrë ata të poshtër që përulën veten për të pasur lidhje me më të mëdhenjtë (për t'ua bërë qejfin atyre), por të kenë, në aleancën dhe në drejtësinë e zemrës, një të drejtë për dashurinë dhe për nderimin e të barabartëve dhe të vëllezërve. Oh! kur do të jetë ajo ditë që ju të ktheheni, mbasi ta lironi Italinë, në të cilën balli i saj ka për të qenë i gëzueshëm, duke lënë më një anë grindjet (hasmëritë, mëritë, urrejtjet), kujtimin e zisë së saj (të fatkeqësisë e të gjaqeve të saj), dhe mosbesimin që e ndan dhe e turpëron, duke shkrirë gjithçka, çdo gjë, në ndjesinë e denjë dashamirëse, bujare, të një nëne që ka lindur heronj.

Ajo ditë do të më duket si dita e parë e lirisë së saj të vërtetë; liri që nuk do të mund ta ndajë prej shokësh, ngase do ta gjejë veten të madhe dhe Zonjë. Dhe ajo ditë, po, do të vijë, ashtu siç e shpresoni ju; por lamtumirë! mirë u pafshim!

Miku juaj shumë i dashur,
Jeronim De Rada
Napoli, më 2 qershor 1848

6. SANTORI IM¹⁶⁹

Mbrëmë i mora dy këngët popullore që më dërguat: *Shkoi një trim nga një rrugë dhe Ajo zonjë e reja e Gjikës*. Kjo e fundit, për përmbledhjen time, sot, është një dhuratë e çmueshme, sot që një bijë e Gjikajve shqiptarë, lindur në Princat rumunë, Dora d'Istria (Princesha Koltcof Masalski), po tërheq mbi vete shikimet plot simpati të Europës së kulturuar. E kanë quajtur Stael-i Veriut, e barazojnë me Korinën.

Për çka kam lexuar unë prej shkrimeve të saja (ashtu sikur figura e parë romantike, që më tronditi krejt shpirtin tim në moshën katërmbëdhjetëvjeçare, qe Korina), tek Elena Gjika më duket si tipar dallues i veçantë një arsytim prej burri, kështu që ajo veçohet nga vetë natyra e seksit të vet që sundohet, gjithnjë, nga burri, dhe e lirë i përmbahet dijes ashtu, sikur i përmbahej zotit të vet Shën Terezja, me të cilën ka një ngjasim në shpirtin e ëmbël dhe të kthjelltë dhe në vëzhgimin praktik të pasosur. Madje, për nga harmonia aq e plotë e përsosmërive dhe e bukurisë së trupit me vetitë e jashtëzakonshme që vërehen në të, mua kjo më sjell ndër mend një tjetër grua, shqiptare edhe ajo, që e lindur në Egjipt, bëri për vete, më parë Çezarin dhe pas tij Antonin, porse kjo ndryshon nga Kleopatra, ngase ajo mbretëreshë, duke mos dyshuar aspak në pavdekësinë e shpirtit, e drejtoi mendjen në edukimin e vetvetes pothuaj si një lule kalimtare që të merr sytë me ndriçimin e saj dhe që pastaj s'i qëndroi stuhisë (epsheve), nga e cila gjë u shkatërrua (mbaroi) mbretëria e të parëve të saj.

Përkundrazi, kjo Princeshë trime (heroike) dhe me cipë duke mos u larguar nga Krishti, mund të thuhet se është agimi i popullit të vet.

¹⁶⁹ *Rapsodie d'un poëma albanese, raccolte nelle colonie del Napoletano*, Girolamo De Rada, Tipografia Di Federico Bencini, Via dei Pandolfini, nr. 24, Firenze, 1866, p. 79-80.

Gjyshërit e saj, Gjikajt, fisnikë, të dalur nga Shqipëria dhe të ngritur në rangun e princërve të rumunëve në vitin 1658, duke sunduar për afro dy shekuj brumosën (formuan) shpirtërat dhe fatin e principatave, duke i bërë të aftë për të siguruar shtetin e tanishëm dhe, ndofta, edhe një tjetër më të madh, ashtu sikur Qyprilitë, bashkatdhetarë me ta, rimëkëmbnin nga ajo kohë fatet e Perandorisë Osmane që ishte në tatëpjetë. Dhe Porta (Perandoria Osmane) do ta vinte në udhë të mbarë zgjidhjen e çështjes Lindore, nëse, për ta rimëkëmbur pa e shkëputur nga vetja Shqipërinë trime, duke ua besuar sundimin shqiptarëve, si kësaj familjeje me tradita besnikërie që duke i qëndruar, vazhdimisht, besnike Turqisë, e deshi aq fort vendin që i ishte besuar, sepse një prej princërve Gjikaj, Gregori VII, përballoi hidhërimin e Sulltanit të poshtëruar dhe donte më tepër të vdiste se sa ta braktiste në duar të Austrisë Bukovinën, duke ia shkëputur, kështu, Rumanisë.

Dhe, për tash, atdhetarët shqiptarë, nuk shohin ndonjë zgjidhje më të mirë se sa kjo: t'i krijojnë vendit të vet një stabilitet të kënaqshëm.

Ishte, Revolucioni, i këshilluar nga të jashtmit, dhe marrëveshja që synonte ta nxirrte në vete, do ta linin (Shqipërinë) pa mbrojtje kundrejt Turqisë e aleatëve të saj. Dhe, tani, dihet se, duke përdorur në përgjithësi njerëz që nuk kanë gjë mbas shpirtit, që përzihen aty me qëllim që të përfitojnë, më vonë, në kurriz të të tjerëve, shfrytëzon, në mënyrë të turpshme, vetveten.

Kjo masë dashamirëse do t'i jepte, njëkohësisht, fund rrezikut që Turqia, nesër ose pasnesër, të shihte të drejtuar kundër saj këto shpata (armë) të trimave që e mbështetnin atë, por që, megjithëse pak, ia shkëputën Greqinë (dmth., e çliruan Greqinë), me Boçarin, Miaulin, Xhavellën, Tombazin, Makrin, Gurën, Niçetën.

Por le të ngjasë ashtu siç është shkruar atje lart. Le të marrim zemër nga figurat e mëdha të këtyre bashkatdhetarëve tanë, dhe mos të braktisim vendin që Perëndia, së bashku, na ka caktuar për rimëkëmbjen e Atdheut tonë të shpërndarë.

Për pjesën tjetër (tepricën), mbani, ju lutem, qetësinë, që ju sjell çdo ditë; Në vitet që na mbeten (mbesin), mbas kaq viteve që kaluan dhe që duhet të ishin më të mirë, nuk ka hije për ne që të kërkojmë ndonjë gjë tjetër. Edhe për ju, janë dy arsye që të siguroni një paqe në trazirat e tanishme. E para, se deri tashti, një dorë, gati si nga jashtë,

i ka mbajtur në mes kaq britmash kundërshtare këto ngulime tuaja, të cilat, megjithëse janë krejt njerëzore, në to duken shenjat e lirisë që njeriu përdori në kërkimin e Zotit, kaq fort e tërheq atë. E dyta, se ju, duke u larguar nga shekulli (nga bota), jeni çliruar edhe nga ato që duken të mirat e tij, dhe që tash kërcënon t'ua heqë. Fyerjet që i drejtohen Krishtit, pastaj, tani nuk e prekin më siç e preknin kur ishte në kryq, dhe popullit të ri, që e rrethon, duke e sharë, i ngelet një boshllëk nga pakënaqësia. Por nuk jeni vetëm ju në hall; krejt Italia është në këtë gjendje. Edhe Principata e tij është në vështirësi. Ndërkaq, revolucioni i ka aneksuar, së bashku me provincat, duke i shpërndarë nëpër ushtritë gjithë oficerat e përgatitur ndër sekte dhe që punojnë për t'u shërbyer atyre, duke krijuar kështu parazitë të panumërt për shtetin, që po e përpijnë gjatë rrugës. Por, dhashtë Zoti, që ai, duke pasë përkrahjen e vendit, që po pëson gjithë këtë të keqe, ta kuptojë situatën. Kjo shpresë ne na mban.

J. de Rada

7. AL SIGNORD GIOVANNI STAMILE, S. GIACOMO¹⁷⁰

Zotnisë

D. Gjon Stamile

Shën Jak (Kalabri)

I dashur Gjoni im,

Mbasi nuk mundem të braktis ato dëshira të para që më kanë drejtuar në rrugën që po vazhdoj, do të them, si do ti, çfarë duhet të keni parasysh në zgjedhjet e afërme për t'ia mbyllur plagët Italisë; në këtë mënyrë, ndofta, mendja ime do të parashikojë që edhe njëherë tjetër, ta humbas fjalën time, mbasi fati i Kasandrës përsërite vazhdimisht ndër njerëzit që janë të paaftë të shmangin, po t'i parashikojnë urdhërat e Zotit.

Tash, dy baza shpëtimi kemi: njëra, që Italia është e bashkuar, në pjesën më të madhe, dhe të gjithë njerëzit, tani të shpërndarë, sikur të bashkohen ose të lidhen së toku, me siguri bëhet e lumtur dhe e sigurtë; tjetra është, se e ka në dorë vetë të bëjë ligjet e saj; kështu që dëshira e saj mbetet burim jete.

Nuk e di se sa i kanë pasur parasyshkëto dy të mira që ekzistojnë më parë, ata që e qeverisën pas bashkimit. Por më parë e pamë se, nëse Italia e ndjente në vetvete dhe Europa e pranonte se tani është mirë ta pranojë, si të thuash, këtë gjendje të qetë shpëtimi, dhe që marrëveshja me Francën vinte, pothuajse, për t'ia imponuar këtë pushim shpëtimi, Qeveria ua paraqiste Dhomave si të mbështjellur me tisë, që e shtrembëronin, dhe ato qëndronin si të shtangur e të

¹⁷⁰ *La Lettera politica a G. Stamile, Saggio politico del De Rada in forma epistolare sulla situazione politica dell'Italia postunitaria*, Tipografia dell'Indipendenza, Cosenza, 1865.

huitar. – Po, o zotërinj (thonte deputeti La Porta), për të inauguruar politikën e Qeverisë, ju duhet të vinit t’ua thoshnit Dhomave dhe kjo të miratohej prej tyre, por nuk patët guxim.

Këto fjalë paraqesin qartë qëndrimin e të dy palëve. Gabimi i Qeverisë nuk qëndron në politikën e re, të inauguruar (të përuruar); porse, duke ia paraqitur atë, për miratim, njërës Dhomë, ngjarjet e mëparshme të të cilës e hidhnin poshtë krejtësisht; dhe këtë nëse e pranon nga keqkuptimi, është shenjë e një respekti të paktë, dhe nuk tregon se ka aftësi për të sjellë ndonjë rezultat.

Qeveria, po ta kishte shkrirë Dhomën në kohën e duhur, dhe po t’i kishte thënë vendit: - Ne jemi një mbretëri prej më shumë se njëzet milionë frymësh; ambiciet prej shteti të madh, jo vetëm do të na venin në vartësi të miqve të fuqishëm, po që tani e bëjnë të pasigurtë madhështinë e fituar. Ndërkohë, propozime të tilla, duke na shtrënguar të lëndojmë qytetarët dhe të nderojmë, ndërkaq, disa nga ata që uji i turbullt, duke lëvizur i ka nxjerrë sipër, do të bënin që vendi, i dëshpëruar, të mendojë e të thotë: Kjo Itali e re po na varfëron e po na i largon prej sysh (zhduk) edhe ato “që për të ishin gjëra të hijshme sidomos në jetë, Zot, dituri, nder, pasuri. Por le të hedhim sytë nga kohët e para! Për të mos rënë, pra edhe një herë me turp, atë që na është dhënë, dhe e kemi, ta rregullojmë, në mënyrë që çdo familjeje t’i vijë paqa e begatia me dritën e mendimeve fisnike, dhe tërë mbretërisë – drejtësia, dhe le të nderohet e të çmohet prej të huajve. Këto vepra të mëdha po u mbesin bijve tanë. – Po t’i kishte folur kështu, vendit, zëri i sorrave që, duke shurdhuar, pushtojnë ajrin, do të kishte gjetur mbështetje dhe përkrahje nga atdheu, që do t’i vinte pas. Dhe ai, pastaj, me një përkrahje më të madhe se sa ajo që i vjen nga këshilla e ndihma të zotit mik të huaj, do të zente rrugën e mbarë pa u shqetësuar se ka marrë një drejtim që është mbështetur në vepra e premtime që sjellin pengesa.

Por, mbasi pati frikë nga hijet e zbrazëta, kombi po detyrohet tash të mbështetet në besnikërinë e vet, dhe, duke u ndalur në marrëveshjen me Francën, të kujdeset për shpëtimin e vet, duke u siguruar me këtë, pavarësisht në të ardhmen.

Miku im, mua nuk më rrëshqet nga sytë që Perandoria, e fyer në idetë e saja të supremacisë dhe prej rusëve copëtuesia të Polonisë dhe

prej gjermanëve vepruesë në veri jashtë rrethit të aksionit (të veprimt), mendoi të bëjë akt fuqie, me njohjen Italisë, provincat (krahinat) e Papës: E se ky traktat të synojë, sa vetë Perandorisë, t'i tregojnë si aleat që ai të jetë i revolucionit, i drashtun (i pasur frigë) prej të gjithëve e, më tepër, /prej/ Austrisë, të cilën e ven në mburoje (megjithëse siguron se nuk ka qëllimin, pse e sheh të rrethuar me aleatë): që, me vendosmëri, godet Papën, duke tërhequr Qeverinë italiane duke ia përkëdhelur ambicjen e eksituar kundër një Princi kaq të ulët. Tashmë, ky i vendosur mirë në radhën e vet, atje ku hesht Austria, nuk ankohet; por qet një qarkore që, duke anuluar Konkordatin akatolik të perandorisë së parë, qet jashtë Kisha të riun, i cili, në të vërtetë, duket se i bën apel Argjipeshkvit (Peshkopit) të Parisit¹⁷¹.

Ky është kuptimi intim (i ngushtë) i akteve (veprimeve) që shohim të gërshetuara: dhe Italia, të kuptohemi, do të kujdeset, gjerësisht, për shpëtimin e vet, sipas fuqisë së vet. Dhe dy gjërat do t'i arrijë me vënjen e dëshirave të shtrirjes, sikurse ka premtuar, tashmë, Konvencioni¹⁷².

Duke ndenj në marrëveshjet, ose t'i ketë Perandoria ose jo forcat e veta në Romë, mbretëria e Italisë është jashtë dhe mundet që të mos ketë mendime dhe halle (derte), por të qëndrojë me Perandorinë, as duke mos fituar, as duke mos humbur. Dhe kjo do të jetë një përtëritje e dinjitetit të saj (për dinjitetin e saj).

Për sa i takon (për sa i përket) shërimit, Ajo ka, tashti, dy plagë, të gjera dhe të thella: Ka Klerin e vet në gjirin e vet, të ndarë nga çështja kombëtare me turbullim të rëndë ndërgjegjeje (të vetëdijeve): Ka mbaruar (ka sosur) çdo pasuri të vet për mbështetje të armëve dhe të armatave dhe për pagesa të partizanëve që duhet të përmbushin fatet e saj.

Pas revolucionit, tri vepra të bashkuara qenë paraqitë prej qeverisë kundër kishës:

¹⁷¹ Të vjetrit që kanë Romën për kryeqytet, vrasin mendjen se si do të jetë perandoria, pas dy vjetësh. Por, në qoftë se qëndrojnë fuqitë, siç janë, që tash të bashkuara i shkaktojnë vonesa. Ajo nuk do t'i thotë Italisë të turbullojë Papën, e do ta ruajë, në të përkohshëm, për llogari të vet; në qoftë se del prej rrethit të karboneve, që i shtërngon, do të bëjë që të bijë në rrugë Papati dhe ndonjë tjetër dhe do ta tërhejë, shpejt, Italinë ose në rrënimin e vet ose së bashku me shtete të tjerë, do ta radhisë, pastaj, në një provincë (krahinë) të vetën: Dëshira të parashikuara ose të dëshiruara prej të çmendurve.

¹⁷² Lavdërojnë taksat e parapaguara: Por, duke ofruar zbritjen prej 6 për 100, krahinat e frymëzuara dhanë pak të holla, të mbledhura për të bërë rruga, etj., e kështu edhe ndonjë Bashki. Të pasurit parapaguan kështu për fitim. Populli që nuk pat për të parapaguar, do t'i paguajë, mandej, ai vetë fitimet e të pasurve mbi Qeverinë!

- 1^a) Heqja e të Dhetave dhe detyrimi (domosdoshmëria, nevoja) i klerit të ulët të varej nga duart e Shtetit.
- 2^a) Manifestimi (i të shikuarit me sy të shtrembtë) i keqdashjes në braktisjen, kështu, në vështirësi dhe në kujdesin e paktë të Fjalës së shenjtë, që ai beson se e ruan, duke e dëgjuar pak e duke e lënë të rrjedhë çdo fjalë tjetër që do të ishte pak e nderuar ose kundërshtare dhe duke prishur ditët që për Atë ishin festive.
- 3^a) Shpronësimin e klerit të lartë, të kishave dhe të urdhërave fetare, duke shpërndarë, shumë o pak, plaçkat atyre sekteve që nuk besonin në Krishtin.

Duke lënë më një anë që, një Shtet, endë pa shokë të fortë, bënte vepër të dëmshme duke tentuar këto gjëra, kur dhunonte krahinat e Papës dhe nënkuptonte të zbritur në Ipeshkv (në Peshkop), nënshtetas të Principatës: këta, në vetvete, nuk ishin të sentimentit (ndjesisë) të Italisë së krishterë, ku feja është themeli i qetësisë i të gjitha familjeve dhe që forcohet kundër ernave që e kundërshtojnë. Vlen, si provë, e kësaj që, ndoshta, nuk është ndërmjet atyreve që e përqeshin, për t'iu bërë qefin padronëve (për t'i përkëdhelur zotërinjtë), që t'ia japë (edhe kur nuk lindi si grua e keqe) bijën e vet të huajit, që, duke mos e dashur për grua në kishë, e merr në shtëpi.

Por ngulin këmbë që vështirësitë e tanishme të kenë rrjedhur për shkak se kleri, i privilegjuar prej mbretërisë të rrëzuara të devotshme ndaj tij ëndron armik natyral i lirisë politike dhe i barazisë qytetare. Edhe po të ishte prej klerit të lartë edhe ndonjë urdhëri tjetër fetar, kleri i ultë, famullitarë dhe priftër të mbajtur prej degëve të tyre, nuk kishin kurrgjë të përbashkët me të privilegjuarit e shekullit. Në anë tjetër, duke i numëruar Ipeshkvijtë (Peshkopët), Kanonikët (Priftërinjtë) e Murgjit, të pasur e të fuqishëm, do të shohim se janë kapkët përballë (kundrejt) aq Dukësh të Milicive, Magjistratësh, Administratorësh, Aristokratësh, etj., që humbën të gjithë namin dhe të mirat (fatet) për të rejat tona, të cilët ndërkaq, duke lënë të bjerë zinxhiri, mbi të cilin mbaheshin, u shpërndanë dhe, tash, nuk e preokupojnë (nuk e shqetësojnë) Shtetin. Nëse kleri, pra, rrin i rregulluar dhe konstant (i qëndrueshëm) kundër Qeverisë, kjo, absolutisht, nuk ka humbur.

E shtirë, po ashtu, është edhe pala tjetër (edhe lloji tjetër, fara tjetër shtihet kinse, gjoja) që i është bindur një motto-je urdhëri, të ardhur

nga Roma, mbas marrjes së Markevet, e që qëndron armike ndaj Italisë. Nuk do të bëj asnjë vërejtje për mbi marrjen e këtyre krahinave (rreth pushtimit të këtyre provincave), ku faktit të dedikimeve (përfundimeve?) i depërtonte invadimi, pasi veprimi parlamentar mbeti dorëjashtë. Përkundrazi, e paditën (e akuzuan) Perandorinë që, mbasi e këshilluan, dha ndihma, duke gënjyer (duke rrejtur), si thonë, me Papën, me pikësynim që të kenë, kështu, Italinë të mvarur e shoqe. Në të vërtetë, armiqtë e saj e padisin, po ashtu, për kalimin ndër venat (ndër dejt, ndër gjymtyrët) e Qeverisë italiane, mëri ogurzezë kundër Krishtit, për referimin (për hatrin, për dashuni pos tjerëve) që supozohej për flamurin e Oktavian Augustit: flamur krenar i forcës dhe i mashtrimit! Por në lidhje me këtë, do të thom se, për atë që është ekspert (mjeshër) i njerëzvet, është e qartë se pasja ose humbja (të pasurit ose të humburit) e një krahine Papës, nuk prek, sot, më shumë priftërinjtë dhe murgjit se sa shekullarët; ose i prek të gjithë së bashku, në qoftë se i fiton ose humb për fakte (për veprime) imorale dhe të padrejta.

Por ndër klerin kishte shumë korrupcion (shumë prishje), ndarje e çuditshme e miradinave (fatesh), përtacë në monastire, edhe ndonjë gjë tjetër. Dhe unë e kuptoj se idetë e reformës mund të lindnin në një atdhe të ngritur me mendimin që të pushojnë veset dhe të këqijat. Por vepra e tij duhej të ishte e mbushur me mëshirë, në mënyrë që Këshillet e të parëve të Krishtërit të bënin në kohë për të ringjallë Klerin në frymën e Zotit, shpirt i së vërtetës, i drejtësisë e i mirësisë. Në qoftë se ishin Peshkopë që kishin shumë, e priftërinj që nuk kishin kurrëgjë, prej çkahit do të frymëzoheshin për të qenë të bashkuar, veçse prej Ungjillit që u kujton njerëzve “jo vetëm prej buke jeton njeriu, por prej çdo fjale që vjen prej Zotit?”. E në qoftë se atdheu do të tregonte nderim mbi të gjitha për këtë Fjalë të së vërtetës dhe të virtytit, dhe klerikët e pasur mos të ishin kaq të lidhur me pasuritë tokësore e po të linin (po të lëshin) që kleri të ishte në skam, i lidhur me këtë fjalë, jetë e botës, do të mendonte pak, e pak do të dëshironte vdekjen me pasuri. Tash, në fund, Italia mendonte, në ndërgjegjen e vet, për këtë ringjallje të krishterë.

Përkundrazi, ata që nuk ndejtën përfaqësues të Tij, por të francezitet 89 (që interpretohet barazues i miradive, kështu që, duke i marrë atij që ka, e duke i dhënë atij që mbeti pa gjë, të bëjë që, qoftë edhe

për një ditë të vetme, të rrijnë në bashkësi, në një mensë, pa asnjë administrator të kënaqur), ata që, në qoftë se bota ka në vetëvete fjalën e Zotit, tashmë nuk e urrejnë, por ndjejnë vetëm dobitë e jetës tokësore. E, në shumicë, hynë në parlament, për të premtuar se premtuan për t'iu dhënë përsëri shanse në vuajtjet politike. Ajo që u dëgjua më vonë, provoi se kishin ndër mend për ta bërë rishtas me aftësitë e qytetarëve punëtorë. E të çudit fakti që, ndërmjet çthurjes së një pjese kaq të madhe të kombit, që gati është i tëri (që, pothuajse, është i tëri), njerëz të habitur e bosha venë, për planet (për qëllimet) e tyre të pamatura, sikur t'i kishin siguruar vetes vullnetin dhe kuletat e të gjithëve, duke u quajtur bij të vetëm të vërtetë të Italisë e që do të bëjnë të renë *me të drejta të reja*: e, në të vërtetë ata e kanë për nënë, vetëm që t'i thithin qumështin.

Këta që i kanë bërë të humbë besimin e bukur se lumturia dhe stolia të lulëzonin më tepër edhe një herë, tash që janë në defiçit, venë dorë në kisha e monastire, e jo për t'ua kthyer në rregull themeluesve të shenjtë, që i ndrydhin e i dënojnë për vepra të këqija arsimtarësh të dobët. Së shpejti, do t'i dëbojnë edhe këta prej kishave: në kaq, edhe ne jemi në të njëjtin kryq. Ata që shpërdoruan, në këta katër vjet, të ardhurat e kishave dhe të monastireve, kanë coptuar prodhimet e punës sonë: dhe, vetëm sa për të larë gojën, na kanë premtuar përparim për të ardhmen.

Për tani, për neve të jugut, rrugë e tregëti, ndoshta, më pak se sa kishim; hekurudhat sa me thënë; po kështu edhe për arsimin popullor;

Këshillat krahinore të hapura vetëm për të autorizuar shpenzime *ad libitum* /sipas qejfit/, dhe të bëjnë plane;

Bashkitë, për veprim qeveritar, të penguara për të kultivuar veprat e tyre: janë të gjitha, siç ishin më parë, por të varfëruara;

Familjet, qysh nga vdekja e ndonjë pjestari të tyre, të xhveshura prej një pjese të kamjeve të tyre, që, tashmë, ka mbaruar t'i nevojitet të vdekurit; pastaj të hollat, të nxjerra prej tyre, me një mijë mënyra, deri për të bërë kurorën e mbretit;

Taksa e konsumit, e nxjerrë si turrjelë, që, duke poshtëruar çmimin e bagëtisë, pa e zbritur atë të mishërave, bën që qytetarët të vuajnë, dhe i shtërngon padronët (të zotërit) e kafshëve;

Drejtesia, përveç mishmashit të taksave gjakpirëse, sepse ushtrohen jashtë mandatit, bën që të humbasin, ndoshta, një e dhjeta e punës së

krejt popullit, prej endacakëve pa mjeshtri e që janë të liruar prej të menduarit e prej të thënit e që vijnë prej çdo bande, prishin besimet dhe zakonet;

Në fund, duka (shembllësa) e Qeverisë, që shkon duke u ngjasue Oborreve Feudale, në të cilat kishte një post, qoftë edhe atë të berberit, ishte i majm dhe i nderuar, jashtë qëndronte mundimi i thithur dhe i vështirë;

E populli ynë, sipas zakonisht të tij, u përkulej të gjithëve, sikurse fletët erës që kalon.

E aq për të kënaqur gabzherret e zyreve të krijuara për nevojat e të afërmevet, të cilët, mbasi e kishin shtrydhë kështu, atdheunnë pranë të Mbretit që, për t'i lehtësuar, i falte prej listës së vet qytetare (të limituar prej pak njerëzish), të rritur si pasanikë e zotërinj për t'u bërë më pas kopracë e të pacipë. Tash na është bërë e qartë, si dielli që mbush sytë, se është kopraci çdo liberalizëm, duke u nisur prej perandorisë së parë e deri më sot, që i bëhet thirrje 89-^{ës}, e që kur, në çdo shtet, të jenë të pakta nëpunësitë, që do të shuajnë dashuritë e dhimbshme për atdheun, të cilat, po ashtu, e trazojnë, e këta do të mbesin kudo në qetësinë dinjitoze, të thjeshtë dhe të lumtur.

Në lidhje me këtë, dëshëroj të them një koncept timin, të rrjedhur nga zhvillimi i ngjarjeve.

Prej kësaj ndonjë filozof u ndalua në idenë që jeta dhe lumturia e saj të jetë e gjitha ajo çka mund të ketë njerëzimi: vulgu i të diturve dhe i të paditurve shkon duke u çuar në rrjedhimet e veta praktike. E, tashmë, opinioni që sigurimi i sa më shumë të mirave të jetë urtësia e vërtetë dhe leverdia njerëzore, bëhet kryesorja, dhe shoqërohet, pothuajse, po prej një budallallëku për besimet e vjetra morale. Kjo ide është e njëjtë me fjalën e thënë gruas në fillim të botës prej gjarpërit plak: *Dii estis*, fjalë kundër së cilës fryjnë Zoti dhe Krishti i tij. Tashti, një shumicë njerëzish, të munduar prej vuajtjesh, (megjithëse nuk mund të thuhet që të jetë kjo një korrupsion i veçantë i italianëve), të ardhur për të mëkëmbur atdheun, ata shpresuan se do ta nxirrnin nga rrjedhimet, e, ndërsa rregullonin jetën e tyre në kushte të reja, bënë të britej (të thirrej) prej njëqind gazetash, se ishin ata në veprën e hapjes së madhërisë dhe të lulëzimit qytetar. Por, sikurse në të ngrënit e mollës prej Evës, parajsa u kthye në shkretëtirë të panjohur, kështu, jashtë tryezës (gostisë) së

tyre, Italia është ndryshuar në çerdhe, çka ka tepruar prej bollëkut e lumturisë: sikur barte ligjën e botës, ku mendimi i disave nuk bjen një korrije kaq të pasur sa që të ngopte dëshirat e të gjithëve.

I dashur Stamile, në sytë e mij është e shpejtë, jo vetëm këtu, por për të gjithë Europën, kjo arritje që njerëzit do të kenë për t'u ngjeshur rreth flamurit të Krishtit, simbol i dinjitetit shpirtëror, të cilit sot i bëjnë luftë të bashkuar (përveç ndonjë krenarie të jashtëzakonëshme e sahanlëpirsave të sofrave të tyre) *les hommes d'argent* /njerëzit e pasur/, përçarësit dhe keqbërësit.

E, pastaj, sigurisht, në qoftë se shteti kushtetues, me dinastitë që i mbështeten, mendojnë të stabilizohen për një kohë të gjatë ju duhet që të mos e keni syrin, mandej, te fatet e individëve. E këta, nëqoftëse nuk kanë humbur intelektin, në zgjedhjet e reja do të synojnë të shkëputen para detyrimesh të tilla që mbrojnë lirinë e saj fëmijënore; e, duke vënë në duart e shtetit një pakicë të të hollave të saj, do të parashikojnë me këtë ekonomi për pushtimin e vet, e do të ndalojnë lëvizjen e madhe politike, e mbështetur prej lëvizjeve që ndiqen me qeveritë për të kullotur në hallet e tjetrit.

Qe e kotë të kishe shpresuar efekte të tilla të Dhomës që *po vdiste*: janë fituar në të ekonomitë në ushtri, por, për të pakësuar nëpunësitë, për të hequr pensionet politike, dukej se nuk kishte dorë të fortë. Oh! në të vërtetë, kjo vetë, në shumicë, përbëhej prej të tillëve, që gati të gjithë, të djathtë e të majtë, dhelpëra dhe ujç (megjithëse refuzuesa të një shpërblimi të haptë dhe të ndershëm) jetonin, ose për vete ose për të vetët, prej tributeve të kombit. E kjo thuhet pa i njohur mirë (pa i mirënjohur) të shumtit e deputetëve të mirë dhe superiorë (eporë). Tash mbetet që vendi të marrë masa për lumturinë e vet dhe të principatës, duke u deklaruar për çështjet që vijojnë:

- 1) Shoqëria është e lirë nëqoftëse është e mbrojtur prej një rrjete eprorësh ose, përkundrazi, nëqoftëse është e mbrojtur thjeshtë në veprim, në mënyrë që të dojë atë që lejohet.
- 2) Burokracia a ka qenë, vallë ndonjëherë, e fuqishme që të mbajë një shtet? A mbahej (a qëndronte) pa ndihmën e qytetarëve dhe pa iu bërë atyre e neveritshme?
- 3) Një shtet a është, vallë, më i fuqishëm, kur mbështetet në shumicën dërmuese të qytetarëve (në një numër të madh

qytetarësh), apo kur mbështetet mbi një grusht partizanësh të tij ose njerëzish të shitur.

- 4) *Në çështjen e shkurtimit në kuadrin e nëpunësve, qeveria vallë do të ketë përpara syve interesat e atyre, të cilëve u ka krijuar komoditete, apo vullnetin e shtetasve, që janë të detyruar të mbajnë mbi kurriz njerëz që shtetasve nuk u sjellin asnjë dobi?*
- 5) *Kombi a ka vallë ndër mend të shpërblejë meritat politike të patriotëve dhe cilat merita? . . .).*
- 6) A i lejohet përparimit të preferojë fuqinë pagane? E kjo, është e mirë në thelbapo ekspozon fituesit e sotëm drejt shkatërrimeve të së ardhmes. Italia a do të ketë, vallë, pavarësinë e saj dhe nderimin nga të huajt, duke respektuar të drejtat e të tjerëve, duke vepruar brenda vendit, në mënyrë që të mbretërojë, me të vërtetë, urtësia dhe qetësia, konsiderata miqësore dhe e barabartë për gjithë të huajt, apo duke vazhduar të armatoset (pa arritur kurrë që të bëhet shteti më i fortë ndër të tjerët), do të kërkojë të gllabërojë vendet e të tjerëve, dhe, për t'ia arritur këtij qëllimi, do të vazhdojë, si e varur, nga një padron i fortë shumë aventurier?
- 7) A vlejnë më shumë fitimet mbi Papën, duke turbulluar fenë e duke lënë vendin në një botë të errët ndërmjet arkivolit dhe djepit? A më tepër me të tilla fitime, apo me ndershmërinë, me dëshirën e mirë, me nderimin për Krishtin, që përfshijnë në vetëvete, do të lulëzojnë fatet e shtetit të ri?

Në qoftë se kombi do të shqiptohet, sipas ndërgjegjes së vet (krejt e kundërt me të shtirurit e gazetave që, si frat Gjinepri i ndezur rreth mangallit, çirren e pëllasin vetëm përpërparim, qytetërim elektrikizmi dhe hekurudhash, për perandori), në qoftë se nuk do të heshte dhe as nuk do të gënjente, le të jetë shenjë që fati i Italisë është në pamje të limanit (dmth., ka mundësi që anija Itali të arrijë në liman); përkundrazi, e ardhmja i qëndron mbi kokë e mbarsur plot me re të zeza dhe rreziqe). Lamtumirë!

25 janar 1865

Shumë i dashuri juaj
Jeronim De Rada

8. DHIMITËR KAMARDËS¹⁷³

21 qershor 1865

Shumë i dashur im Kamardë,

Po ju përgjigjem menjëherë, mbasi nuk më kanë mbërritur endë të gjashtë kopjet e librit tuaj dhe as ndonjë letër para suajës, bashkë me tjetrën drejtuar Zot. Jenos (De Koronej). Mora vetëm një kopje, dërguar në emrin tim, dhe jam duke e lexuar copa-copa, mbasi jam zhytur në punë fushore dhe në përgatitjen e dorëshkrimit të këngëve kombëtare dhe të arsimimit të tre bijve të mi, etj. Dhe ja, tash, mbresa e çiltër që kam për të.

Libri është i çmueshëm për njëmijë shfaqjet (aspektet, dukuritë) që tregojnë mendjemprehtësi të veçantë. Por, shpesh, ju pushton (zotëron) ideja e gabuar se, gjoja (pra), shqipja është, thuajse, një dialekt helenik, dhe /kjo/ ju shpie në dy të meta: 1) të shihen marrëdhënie ku nuk ka o ka me fjalë joshqipe, por të marra prej nesh andej-kënde; 2) të pranoni si forma të rregullta foljesh solecizmat dhe shtrembërimet (gjuhësore). Për shembull Ju e ndërtoni (sajoni) në bazë të së tashmes e të së shkuarës pohore të foljes *me puthë* duke e zgjedhuar jo siç duhet.

Në radhë të parë, *puthë* është vetja e dytë e urdhërores, e dalluar qartë nga e para e pohores *puthinj*; dhe kjo zgjedhohet:

<i>puthinj</i>	<i>putha</i>
<i>puthën</i>	<i>puthe</i>
<i>puthën</i>	<i>puthi</i>
<i>puthëmi</i>	<i>puthëtim</i>
<i>puthëni</i>	<i>puthëtit</i>
<i>puthënjën</i>	<i>puthitin</i>

¹⁷³ *Shejzat* (Le Pleiadi), VIII, Nr. 7-10 Roma, 1964, f. 372-395.

Ky fat do të jetë ai i gjenisë krijuese që do të vijë, siç e uroni; ndërsa e di që është ajo e Ngulimeve tona, përzier me gegë e epirotë (toskë), ose shqipe e vërtetë, shtrembëruar, paturpësisht, nga Da Lecce e nga përkthyesi i Ungjijve; për të tjerët nuk di.

Ju veç, gjithnjë, jeni i pari shqiptar që sillni dritë në skajet më të hershme të gjuhës, dhe ju jemi mirënjohës për këtë. Të shoqëruarit e Shën Kozmos janë përfshirë në gjashtë kopjet e mia. Lamtumirë.

Shumë i dashur miku yt,
Jerolim De Rada

P. S.

Jepjani letrën e përfshirë këtu brenda zonjës princeshë Dora d'Istries.
Njëzet ditë pas korrjes, do të ju dërgoj *një ose dy përralla e letër*.

9. DHIMITËR KAMARDËS¹⁷⁴

25 qershor 1865

Shumë i dashuri im Kamardë

Të gjashtë kopjet që më keni dërguar mua, kishin ngelur në Koriljano, nga refuzimi i korrierëve këmbësorë për t'i sjellë; sepse janë dymbëdhjetë milja rrugë, sadoqë unë pata folë (ngulmuar); megjithatë, është gjë që mund të ndreqet. Për të tri të dërguarat Stamiles, nuk di ende kurr gjë, por do të interesohem për t'ju njoftuar për to. Shpresoj se, përveç të gjashtave, të nxjerr edhe dy të tjera.

Duke u kthyer, tash, në argumentin që ju pëlqen, ju them se unë kam disa ide fikse, që janë si fener (dritë) i gjykimeve të mia.

Një nga këto është se, kur vërej që gjuha ka forma të ndryshme, të sakta e të rregullta në zgjedhime e lakime (siç i ka shqipja ndër ne) dhe e shoh të njëjtën gjuhë të shkruar o të folur, jo më me ato forma, por me disa që i ka humbur, e me pak të mbetura i zëvendëson të gjitha e i përziën (konfondon), mendoj se në këto është përdhosur (prishur). Shpresoj, pastaj, se bota nuk do të më pandehë si pretencioz mua që, prej 30 vjetësh, merrem me gjuhën time, nëse nuk kam marrë parasysh shumë Da Leçen e peshkopin e Korfuzit; as sepse u linda shqiptar, e mblodha këngë të lashta, sa të mund ta quaj veten më pak të ditur në gjuhën time, se sa ç'është Hahni.

Më është ngulitur, gjithashtu, ideja që të mos besoj se mëmëdheu e flet, gjithnjë, më mirë se Ngulimet (kolonitë arbëreshe – J.K.) gjuhën e vet, dhe se duhet ta ruajë më mirë hem karakterin, hem fenë, etj. Mëmëdheu ynë mbeti nën të huajt që e shkelën dhe e prishën; ne u

¹⁷⁴ Po aty.

strehuam në vende të veçuara, dhe shpëtuam. Pastaj mëmëdheu nuk na flet, tashmë, ai ne; por, për të, njerëz të huaj, na bëjnë të flasim fjalët e tija. Së fundi, Homeri që themeloi kulturën greke, kishte lindur në një nga Ngulimet (kolonitë). Dhe kjo do të ngjasë edhe për Shqipërinë, dhe ju vetë /Kamardë/ filluat ta bëni.

Kam edhe një ide të tretë, që më është ngulitur, se tek gjuhëtarët e gramatikanët nuk është mirë të mbështetemi, por ta deshifrojmë një gjuhë. Kështu, ndër 24 Ngulimet (Kolonitë) e Kalabrisë është ligj i qëndrueshëm të vihet *t*-ja në vetën e parë shumës të së shkuarës së foljeve që mbarojnë me *-nje*, qoftë kur kanë theksat ('*ed*') në rrokjen e parafundit, qoftë kur kanë theksin cirkonfleks mbi të parafundit.

Si: <i>dërdhinje</i> ,	e shkuar <i>derdha</i> ,	shumës <i>derdhtim</i> =	<i>derdhëm</i>
<i>púthinje</i> ,	“ <i>putha</i> ,	“ <i>puthtim</i> =	<i>puthëm</i>
<i>dëthinje</i> ,	“ <i>dëthita</i> ,	“ <i>dëthitim</i> =	<i>thëthitë</i>
<i>shtinje</i> ,	“ <i>shtita</i> ,	“ <i>shtitim</i> =	<i>shtimë</i>

por nuk e kanë në të njëjtën vetë, foljet që sosin në *nje*, të paraprirë nga zanore e theksuar:

çjonj (çonj = gjej), e shkuar çjova (çova = gjeta), shumës çjuam = gjetëm;

rrëmpenj(rrëmbej, marr), e shkuar *rrëmpeva* (= rrëmbeva),
shumës *rrëmpiem* (= rrëmbyem)

Dhe të tilla ndërrime shtrihen me një rregull të përpiktë në zgjedhimet e tjera, në ato me mbaresë në *eghë*:

dieg (= djeg), e shkuar *dogja*, shumës *dogjëtím* (= dogjëm).

Ato që mbarojnë (që sosin) në *asë*:

Shkasë (= shkas, shqas, përshqas, zdryp), e shkuar *shkava*,
shumës *shkámë* (= shkamë, shqitëm).

fjas (= flas) paraqet një anomali (parregullsi), nëse e bën të shkuarën e rregullt *fjava*(= fola), në shumës bën *fjámí* (= folëm), pa *t*;

nëse merr *folja* (= fola) (pothuajse nga *foljinjë*) nga *foljëtín* me *t* (= folën).

Kam hartuar një gramatikë të vogël dhe nga pasqyra e zgjedhimit, ku janë shënuar rregullisht këto gjëra, i rrok me një të hedhur syri.

Por, po të doni, zireni sikur nuk është thënë asgjë për këtë: ju më urdhëruat që të ju thoja përshtypjen që më pat bërë punimi juaj i ditur; dhe e thashë me çiltërti. Pastaj u shtriva shumë, sepse m'u duk se jú, ju kujtohem vetëm si një *shqiptar* dhe jo ai *shqiptari* që prej më se 30 vjetësh përpiqet ta ngrejë gjuhën tonë për të shprehur konceptet e qytetërimit të sotëm; duke folur me guxim, nuk besoj të kem folur me mendjelehtësi për këtë çështje.

Këngët kombëtare do të shikohen në Firenze në bocat e tyre shpre-soj nga një shqiptar; dhe vetë radhitjet e tyre, edhe do të më dërgohen; kështuqë do të kem mundësi t'i qortoj, duke iu kushtuar vëmendjen e duhur.

Ju përqafoj, shërbyesi juaj shumë i dashur,
Jeronim De Rada

10. DHIMITËR KAMARDËS¹⁷⁵

I dashur im Kamardë

Kam marrë me shumë kënaqësi shkrimet tuaja. Po ju shti (fus), këtu brenda, një çek 3. 50 d., çmim i pesë kopjeve të librit tuaj; e gjashta m'u kthye duke më kërkuar të falur; ia kam dërguar dikujt tjetër, shpresoj ta ketë pranuar: shkurt, është varfëri e madhe, nga e cila prej 5 kopjeve nuk mora endë çmimin, po do ta marr më vonë.

Droja se mos nuk ju ka arritur *përrallëza*. Do të ju dërgoj një varg (seri) (që jam duke i dëgjuar në këtë krishtlindje), nëse do të kem mundësi t'i kopjoj.

Për botimin e këngëve, unë po çmendem. Më erdhën bocat e librit të parë e të një pjese të të dytit; dhe mbas një pritjeje prej dy muajsh, m'i dërguan pardje bocat, mbasi një bashkatdhetar ynë që i pat, i kish kaluar në shtypshkronjë. Më duket si rrëmbimi i Lekës. Siç keni mundur t'i shikoni, janë me të vërtetë të bukura. Sa për mua, e përsëris, mendoj se në poezinë e sotme ato do të duken ashtu siç u duk Skënderbeu mes princërve bashkëkohës me të. Ju më nxitni që të kthej mbi /çështje/ të gjuhësisë. Por ajo që vëreni *në të mëje*, meriton një sqarim. *Të*-ja nuk është aspak një nyje në vështrimin e ngushtë të fjalës, që ju ia vishni. Kemi /fjalën/ të *motërën*, të *motërat*, etj., ku *të*-ja do të jetë një nyje e vërtetë, por në gjindoren ajo është thjesht një fjalë e formuar që shënon një marrëdhënie. Ne mund të thomi *ljulje dimëri* (lule dimri) e jo kurrë *ljulje të dimëri* (lule të dimri), sikur *të* të ishte një nyje e gjindores; ne përkundrazi, thomi *ljulje e dimërit* (lule e dimrit), *shī i dimërit* (shī i dimrit), *tëtim të dimërit* (të ftohtë i dimrit), ku të tri fjalët *e*, *i*, *të* të njëvlershme (ekuivalente)

¹⁷⁵ Po aty.

shënojnë përcaktimin ngushtëzues duke iu përgjigjur *lules së dimrit, shiut të dimrit, të ftohtit të dimrit*; e kështu kemi *një pjes të mëje* (një pjesë të meje; një pjesë prej meje; një pjesë nga unë), *shkretja e mëje* (fatkeqësia e ime). E di se më rëndom (më zakonisht) thuhet *pjes imia* (pjesë imja), *shkretja ime* (fatkeqësia ime), por braktisja e përemrit është ndryshe nga shkatërrimi i tij (nga prishja e tij), sepse *me* nuk është e mundur /si/ përemër i yni, por në vend të tij vihet *meje*, që i afrohet më fort latinishtes.

Ju e pranoni, sepse i afrohet aty “idesë (së tepruar të shprehur prej jush) që ta bësh të quhet shqipen një dialekt i greqishtes”. Unë nuk e quaj gjuhën time, siç pohoni ju, si diçka që qëndron o ka qëndruar më vete. Unë mendoj (besoj) se është zhvilluar në një kohë më të lashtë se greqishtja e latinishtja, dhe si një motër e madhe mes të dyjave; të tillë e quaj nëpërmjet arsyetimeve të ndryshme që bëj, por jo sepse e di nga studimet gjuhësore që kam bërë. Nëse kam ndonjë ide për këtë shkencë, e kam në saje të dy librave që më janë dhuruar me aq fisnikëri nga zotni Komparetti. Por unë që kam studiuar, me kënaqësi, gjashtë vjet shkencat matematike, nuk më është mbushur mendja për një teori të mbështetur mbi hipoteza apriori, nga të cilat me forcë, pastaj, nxirren pasoja (përfundime), që vazhdojnë të jenë të rastit e të kufizuara dhe të kundërshtuara nga të tjera. Unë nuk besoj se gjuha mund të formohet nga përpjekje individuale të bashkëzanuara, as nga përpjekje bashkëkohore të një brezi të vjetër, dhe se ka vajtur gjithnjë e më tepër duke u zhvilluar, ku më fort ku më pak; kështu që gjithë këto gjuhë të përfaqësojnë një shkallë të mbarë të zhvillimit të mëpastajmë. Unë besoj se kjo rrjedh nga svenimi i një gjuhe më të madhe. Por jo gjithnjë është një teori imja kjo, mbasi unë nuk e di dhe e besoj. Dhe nuk e di nëse kjo është teoria që përpiqeni ta kundërshtoni në Shtojcën /e Gramatologjisë/; ku, përkundrazi, shfaqet opinionimi im mbi mbeturinat e gjuhës sonë. Nëse keni gjë për të thënë për këtë opinion, duhet ta shtroni në këtë mënyrë. Gjuha shqipe, siç na është paraqitur nga të huajt që e kanë marrë (e kanë nxjerrë) në Shqipëri, është me shumë gabime, nuk ka ose ka më pak ajo që na është dhënë nga shqiptarë të edukuar (të mësuar, të ditur) e që jetojnë në qytetet e tyre të lindjes. Gjuha shqipe duhet të jetë më pak e prishur në Ngulimet (Kolonitë) e Italisë, të mbajtura të mbyllura ndaj të huajve dhe me

besimet (fetë) e tyre të paprekura, se sa në Shqipërinë e shkelur e të bërë rrafsh nga turqit. Përmendorja e saj më e kulluar është kënga e kohës së Skënderbeut, që edhe sot ekziston. Kundërshtojeni, po të doni, këtë opinion, por mos e falsifikoni. Jo thom veç se, sado fjalë që të harxhoni, nuk do t'i ndërroni faktet, të cilat kanë urdhëruar që, nëse populli ynë do të organizohet (do të ripërbëhet), do të flasë gjuhën e Ngulimeve të Italisë.

Po jua kthej letrën e Tomazeut. Më thoni (më shkruani) nëse do ta keni marrë këtë dhe nëse Princesha Dora d'Istria është gjithnjë në Livorno.

Festa të gëzuara (i gëzofshit festat). Miku juaj
Jeronim De Rada

Vula e nisjes së postës:
Morano, Kalabri, më 22 janar 1866

11. DHIMITËR KAMARDËS¹⁷⁶

(Vula e nisjes së postës: Corigliano Calabro 10 korrik 1866)

I dashur im Kamardë,

E kam marrë kopjen e *Shtojcës /së Gramatologjisël* dhe ju falënderoj së tepërmi. Po si dyshoni se s'do të mirrni prej meje ekzemplar in e *Këngëve kombëtare*? Më vjen keq vetëm se ndërtohen si Sh. Pjetri.

Mendoj se nga *Shtojca* do të dalin më shumë kopje se sa nga *Gramatologjia*; por sot nuk mund të flitet për këtë gjë. Mbas asaj të mëndafshit, ka ardhur zia e grurit: e gjithë krahina e Bossanos, dhe më se gjysma e asaj të Kastrovilarit nuk kanë dhënë më shumë se dy të mbjella. Edhe ullinj të janë vyshkur, sepse nuk po bie shi që nga janari. Dhe njerëzit janë shqetësuar si mos kurrë. Prandaj nuk do t'ia çoj kopjen time, mbasi ta kem lexuar, Stamiles, vendi malor i të cilit është në një gjendje më të mirë.

Kolegjit ia kam dërguar kopjen e *Gramatologjisë* që më kish mbetur, dhe që, mbas dy muajsh, më qe çuar nga Sh. Sofia. E kish kërkuar Ipolit Mashi, një napolitan e gjyqtar; porse nuk e desh, sepse ishte e vështirë për të. Prandaj dërgojani Kolegjit vetëm *Shtojcën*.

Shqetësimet e luftës e të vështirësive të ndryshme (në një vend pa tregëti e pa monedha fare) nuk më lënë të mbaroj së lexuari librin tuaj; megjithëse ai më tërheq nga të gjitha anët.

Për të ju plotësuar dëshirën, në një farë mënyre, dhe, duke lënë diskutimin e filologjisë, për kushtet e përgjithshme të këtyre studimeve

176 Po aty.

në krahinat jugore të Italisë, siç vërejt i ndrituri Kompareti; po ju them pak fjalë mbi këngët e mbi gjuhën.

Poezitë e nxjerra nga Hahni, nga Reinholdi, etj., të vëna pranë këngës sonë kombëtare, e bëjnë të qartë faktin që kjo nuk është një diçka popullore, por vepër e shquar poeti të zgjedhur, emri i të cilit ka humbur. Duken (me përjashtim të këngëve dashurie të fortë mëkatnore të Nezim Beut) një cicërim i popullit e njerëzish të ditur të gjorë, sipas mënyrës së këngëve greke moderne, aty pranë prodhimeve madhështore të artit. Në *Parimet* e mia *estetike* flitet për fjalët italiane që përzihen (përdoren) aty. Janë shumë të pakta; pjesa më e vogël të nxjerra në tokën kalabreze. Po tipari gramatikor i gjuhës, aty, është i pastër dhe shënon shkallët e prishjes së saj, që duket ndër shembujt e tjerë të sjellur aty; po shënoj vetëm këto fjalë: *Kur të ljeu tij mëma / kur të lindi ty nëna/*. *Mëma* është një kompozitë e formuar (e sajuar) prej *ime ëma – im'ëma, m'ëma*, dhe do të thotë *mëma ime* dhe jo *nëna jote*, që në shqipe thuhet *jot'ëmë*; dhe, përveç domethënies së /fjalës/ *ljeu /lindi/*, që nga asnjësi është bërë vepror arbitrarisht.

Së fundi, po ju them, se e bëra unë përmbledhjen e parë të *Këngëve të Ngulimeve larbëreshel*, dhe, duke e mbledhur, provoja t'i imitoja. Provat ia dërgoja Baziles, mikut tim. Dhe këto, në përkthimin e vargjeve të këngëve kombëtare, /duke i përmbledhur/, nga të cilat kam bocat e shtypura, futa, aty brenda, dy a tri nga ato prova të mia. Me letrat e Baziles do t'i vejë Dorsës kënga e shtatë e përmbledhjes suaj, që, tashmë, qëndron në *Milosaun* tim.

Për gjuhën, ndër të tjera, në faqen 139: *Qite kordhen me mua, bënë mizirë lavosmë, se lavoma nënk zë qelbë*, duhet shpjeguar /kështu/: Ngule më pak shpatën, bën një plagosje mizore, se plaga nuk do të nxjerrë qelb (dmth., do të jetë vdekjeprurëse); dhenë faqen 143 duhet lexuar: *Ashti, paljëra, kurmi e shpirti svishet*, etj., ose: *Ashti, palci (palca), trupi e shpirti u shkatërruan*. Mjafton, mendohuni për këtë.

Ju lutem dorëzojani letrën e mbyllur këtu brenda zonjës Princeshë.

Me nderim e miqësi, krejt i Juaji,
Jeronim De Rada

12. DHIMITËR KAMARDËS¹⁷⁷

5 tetor 1866

I dashur im Kamardë

Do të jem shprehur keq, se unë nuk kam menduar kurrë të bëj një shtet të Shqipërisë, po vetëm ta nxjerr (ta çliroj) nga panhelenizmi i zbrazët e i thatë.

Mbas provave tona të zbehta për unitetin e shtetit që kërkohet për çdo racë, mua s'më ka mbetur kurrnjë farë shprese. Po të qëndronte Shqipëria e tërë me Austrinë, siç qëndrojnë Hungaria e Bohemia, kjo për mua më duket se do të ishte një punë mjaft e mirë. Shteti shumë i mirë, pra, duket se do të formohej, kur të gjitha provincat turke europiane në Greqi të formonin një federatë me një drejtësi të barabartë dhe të drejtuar mirë, me Konstandinopolin si kryeqytet, dhe në rast se nuk do të mund të arrihej kjo, të lidhej me Greqinë, kushërirë e saj, duke formuar një unitet, në sajë të të cilit asnjëra të mos përpiquej të gllabëronte tjetrën.

Ju thoni se Greqia ka sot më shumë përfitime; dhe ndonëse edhe unë e pranoj, por këto përfitime parashikoj se do të zhduken brenda një kohe jo të gjatë. Sikur po e ndiej me një farë shqetësimi rrokullisjen e ngjarjeve. Shqipërisë, siç e thoni mjaft mirë, i mungon sot ndjenja kombëtare; i mungon letërsia që ia ndez (ia ngjall) atë; ndoshta i pari libër që nga zemra shqiptare u ka ardhur atyre, është libri i princeshës sonë, i destinuar, ndoshta, për të mbajtur të gjallë lëvizjen e atdheut të vet. Por unë ju thashë se nga Magna Grecia do t'i vijë kultura e vet Shqipërisë; dhe e dija ç'thoja; kurse ju që do ta dini më pak, mund të

¹⁷⁷ Po aty.

më quani, drejtpërdrejt, i zhgënjyer! Le të mjaftojë, që unë të jem i një mendimi me ju, deri këtu; por këtë gjë, ju lutem, ta kërkonte në një tjetër gjë. Nëqoftëse para gjuhës sonë vini gjuhën e lashtë helenike, nuk vlen ta kundërshtojmë, mbasi ajo është një gjuhë pagane, e sosur, tashmë, e vdekur. Nëse preferon greqishten e re, keni arsye, po të mbani për modele tona versionin e Ungjijve e të *Speculum confessionis* (Pasqyrës së të rrëfyerit). Por unë vëreja (dallova) gjëra krejt të ndryshme e, edhe për forcën mendore, si një që njeh shkrime neohelenike, e thom pa ngurrim, lexova pak prej tyre dhe, për nga forma, nuk di shumë; e kam gjykuar panhelenizmin sikur nuk ka ndonjë gjë, përsa i përket qartësisë e fuqisë së konceptit dhe mënyrës së shkëlqyer të diktimit, të mund të barazohet me këngët tona tradicionale të mesjetës dhe me Këngëtoren e Santorit, kështu ne nuk duhet të kënaqemi me rekat e huaja kundrejt helenëve, as ju, besa, nuk duhet të kënaqeni me këto.

Por duhet të hahemi me këdo që vlen më fort në çdo fushë, me helenët, dhe kjo do të jetë nder për ne.

Mësimet që ju u epni shkrimtarëve shqiptarë, janë të mira, por, për mua, vijnë mbasi është thyer shtama. Unë, sot për sot, po pastroj e përkthej atë që kam krijuar, s'bej më tepër; dhe për pesë grosh, nuk mund të shmangem nga zakoni i marrë. Kur zemra më ishte ndezur, gjuha që unë e dija, më tretej në të si afsh i mendimit; dhe kur nuk ndihej ajo gjuhë, aty shkrihej (tretej) ajo fjalë që kisha gati, qoftë greke, qoftë italiane, qoftë frënge, qoftë e krijuar sërishmi.

Unë nuk kisha rregull, por shqipja, në vetvete, është një gjuhë e tillë që pa forcë mund të përdoret për çdo gjë. Kisha përkthyer për një gazetë të sendergjuar (të projektuar) italo-helenike një kapitull të romanit të pabotuar të Santorit; po jua dërgoj copën që më ka mbetur. Lexojeni me durim (e di që ndryshimi i shkronjave /i alfabetit/ ju pengon, ashtu sikurse tuajat më pengojnë mua, dhe, mbasi nuk i kam lexuar ende mirë, nuk dita të ju shpjegoj atë që donit), por përpiquni ta kapërceni (shmangni) mërzitjen, tani e tutje është nevoja të njihemi me njeri-tjetrin, lexojeni me dashuri dhe do të shihni se ku kemi arritur, pavarësisht se helenët kanë sot kush t'i drejtojnë, me forcë mendjeje, përkundrejt këti kallogjeri të gJORë.

Dhe këtu po e lë.

Për të vazhduar rishtas letërkëmbimin dhe për të ndjerë kënaqësi nga gjithë ajo që më propozoni, kur të më shkruani ku gjindet Teofil Stier, ku Hahni, ku Malte-Brun-i, mbasi përmbledhja jonë është gati të dalë në dritë (të botohet). Mirëqofshi deri sa të marrim sërishmi (deri sa të fillojmë përsëri) bashkëbisedimin tonë.

Shumë i dashuri juaj,
Jeronim De Rada

13. ZOTNI BARTOLOMEO ÇEKETIT PËR STUDIMET E TIJ MBI VEPRAT E PRINCESHËS ELENA GJIKA (DORA D'ISTRIA)

Të mërguar, pa Atme,
Kur, mbi varr t'braktisur, i huaji vendoi
Një lule, i përdëllyer,
Ne qanim ngashëryer
Dhe zëmra më s'kërkoi.

Por një ndjenjë e papritur
Na thotë se dhimbja mbaroi tash për ne:
Të kem' besim na bëri
Tingllimi i një zëri
Bujar nga tjetër dhé.
Nga mbretëresha e Adriatikut
E cila ende ngre fisnikun flamur,
Dhe për të humburën perandori
Ëndërron furishëm në mendimet e ti(j),
Ti, o shpirt plot nur.

Mbi shëmbëllesën Tënde
Të mermertë, për Shqipëri nderim,
Kurorës së pashuar,
Në shekuj përjetuar,
Vë lule për amshim.
Dhe thotë profeci e popullit
Nga princërit e të cilit Ajo lindi, oh, jo larg shumë
Se ditën që tek ajo ringrihet,
Dhe drejt Venecies të shtrihet
Ajo dorë mike që i shpunë.

Tani ata shpirtra të lodhur
 Që ndalën të shlodhnin udhëtimin
 Pasi ajo murgeshë dashnore
 Rrethon dhe thur përmendore
 Për mbarë dheun italian, vlerësimin
 Kështu, o njeri fisnik, për shpirtin
 Ne qajmë për kohën që nga ne fluturoi;
 Kur për nga largësia,
 Venecia dhe Shqipëria
 Secila një ditë fitoi.
 Dhe plazhi i bekuar
 Mbulonte Luanin e Venedikut në Europë përgjatë:
 I bekuar! një e shkurtër histori
 Dritë nxirrte prej kësaj
 Të tmerrshmeje shamatë!
 Po Skënderbeu, i vetëm,
 Ordhisë së qenit turk i kalli tmer,
 Kur erdh si egërsirë
 Dhe qiellin duke nxirë
 Shoi gazin ton' me vrer.
 Ne, nga mërgimet tona,
 Blatojmë ato ditë të bardha nga mot
 Dhe Ty, që nder gjithmonë
 I solle Atmes zonjë
 Të përshëndesim sot.

10 shtator 1868

14. GJIMNAZI GAROPOLI NË KORILJANO KALABRO¹⁷⁸

Koriljano Kalabro, më 25 tetor 1868

Qyteti i Koriljanos ka luftuar, vazhdimisht, për të themeluar një gjimnaz për fëmijët e vet dhe për krahinën e afërt; e, mbasi, tekembramja, e pau të hapur, vështirësi të shumta i dualën përpara, aq sa t'i kundërshtonin parimet e gjërave të larta; por të gjitha u tejkaluan dhe u kthyen, pothuajse, në asgjë. Ky qytet nuk ka pushuar së kërkuari me durim, duke vazhduar projektin e vet të shenjtë. E ky durim fisnik na imponon besimin se do t'ia arrijmë qëllimit qoftë edhe përmes gabimesh.

Kur unë qeshë thirrur që të marr në dorë drejtimin e këtij Kolegji, një besim i tillë ka qenë për mua, në të vërtetë, ndihmës për t'ia dalë në krye me faqe të bardhë kësaj detyre. Dhe unë shkoj duke ia kushtuar gjithë veprimtarinë time, gjithë kujdesin tim. Kush më njeh, e din disiplinën rigorozë (të rreptë), me të cilën u rrita unë vetë sidhe përvojën që kam fituar /prej sa vitesh/ në të edukuarit dhe në të dhënë mësim. Kush më njeh së largu, do t'i thom se, si babà familjeje dhe me fëmijët e mi të vetëm, në gjimnazin që po shkoj të drejtoj, nuk do të frymëzohem nga asgjë tjetër, nga asnjë kujdes i jashtëm, por vetëm nga ndjesia e lindur tek secili at, dmth nga ajo që t'i ketë fëmijët e vet të shëndetshëm, të urtë, të zgjuar, të pafajshëm dhe të bashkuar me Zotin. Tashti, ky le të ndjekë propozimet tona të mira! (qëllimet tona fisnike).

¹⁷⁸ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 7.

Konvikti hapet sipas këtyre kushteve:

- 1) Nuk do të pranohen nxënës të rinj më të vegjël se tetë vjeç dhe më të mëdhej se katërmbëdhjetë vjeç.
- 2) Do të kenë një ushqim të mirë dhe të shijshëm: në mëngjez, kafë me zgjedhje; tri pjata në drekë, bukë e fruta; një sallatë e një pjatë të nxehtë (të ngrohtë) për darkë.
- 3) Pensioni (pagesa) për çdo konviktor do të jetë 225 lireta, të cilat do të paguhen 112, 50 kur të hyjë, dhe 112, 50 në prill.
- 4) Pasi të ketë filluar semestri dhe konviktori dëshëron të dalë, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e të hollave që ka dhënë për hesapin tonë.
- 5) Gjumnazi do të rihapet më 20 nëntor dhe do të mbyllet në fund të shtatorit.

Jeronim De Rada

15. NXËNËSVE TË GJIMNAZIT TË KORILJANOS NË HAPJEN E SHKOLLAVE ¹⁷⁹

1 dhjetor 1868

Ju djem, keni lindur në një shekull që konsiderohet me dritë të madhe dhe me dashuri të lira që shpalosen në të gjitha drejtimet, ende të pasigurt për ndalesën.

Kjo është një kohë e dritës, sepse në njohjen e globit tokësor, të bimëve dhe të jetës që ai mban në gji, bashkë me trupin e yjeve të lidhur me Tokën, dhe në fund me atë të gjuhës me të cilën njeriu i bën jehonë Universit në të cilin gjendet, ku gjithnjë e më tepër ligjet dhe çdo shfaqje tjetër e natyrës kuptohet gjithnjë e më shumë duke zbuluar edhe mendjen e cila është baza dhe mbështetja e produkteve të larmishme të natyrës. Por në këtë kohë vihet re ende një rrjedhë e pasioneve të lira pothuajse si valët nga të cilat bregu zgjerohet derisa të humbasin nga sytë. Duke rënë vazhdimisht statutet e vjetra, të cilat tanimë ishin të mira vetëm për disa dhe nga të cilat shumë thuajse u refuzuan nga trashëgimia e të tjerëve; popujt e gjejnë veten tani si në një fushë të hapur, ku atyre u jepet mundësia të marrin çdo drejtim. Dhe rreziku qëndron në atë që, ndër gjërat që një burrë mund t'i japë vetes, zgjedhja e më të përshtatshmes është e vështirë. Dhe pikërisht për këtë, pra, plebenjtë janë më të shumtë në numër si në fuqi, ashtu edhe në vullnet, ato ndërtesa të rena nga vakti që ishin trashëguar vetëm nga pak njerëz, ishin një shenjë për dëshirat ziliqare të turmave dhe kanë për këto sidoqoftë tërheqjen më të fuqishme dhe jeta si e dehur ende nuk e di se ku pushon.

¹⁷⁹ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 7.

Në mes të kësaj lëvizjeje, së cilës i shtohet secila lëvizje e re, dhe ku sot mundet të humbasë, brenda barbarisë që na rrethon, vetë Dritë e sotme, siç u zhduk nën barbarinë e jashtme bota e shndritshme romake. Principatat kombëtare i kanë ngritur shkollat si të jenë pothuajse fenerë të së vërtetës dhe si bastione të së mirës së vërtetë që janë të udhës për njeriun. Meqenëse çrregullimi që kërcënon epokën tonë, qëndron në faktin se Demagogjia e ka lënë pothuajse pas dore pjesën shpirtërore dhe fisnike të jetës dhe ka nxjerrë në pah anën servile të saj - ne vrapojmë, do të thosha, me një mendje të trazuar, pas përfitimeve të trupave, të cilët madje zhbëhen pasi të jenë konsumuar në një shkallë të gjerë – Ndërsa shkolla që ju mirëpret, o ju të rinj, punon për të edukuar shpirtin e pavdekshëm të njeriut dhe për ta bërë atë një imazh të denjë të Zotit dhe, në fund, ta afrojë pranë gjirit të tij, ta bëjë që të thithë jetën e përjetshme. Në shkollë, gërshetohen kështu të dy forcat tokësore, të cilat na janë lënë trashëgim që nga antikiteti, kanë mbështetur më vonë mbretërinë e Zotave kundër dhunës së verbër titanike: virtyti moral i përfaqësuar nga Herkuli dhe Feja që na kujton origjinën e simbolizuar tek Atlasi, kolonë e Olimpiti.

Është e mbushur plot me këtë qëllim të lartë Shkolla italice, që tani vjen në ndihmë të atdheut, i cili nga ana tjetër po lufton me rreziqet e kohës dhe dëshiron që nëpërmjet bashkimit të vet të rifitojë bashkë me madhështinë e tij antike edhe përfitimet më të mëdha. Meqë atyre që e shikojnë nga brenda, Ajo u duket se është rregulluar në mënyrë që të ilustrojë mendjet tuaja me gjuhën e mençur e hyjnore të Italisë dhe të Helenëve, si edhe të mburjë shpirtrat tuaj në shembujt e Athinës, Spartës, Romës, Firences, të Venecias - Ndërsa mendjet dhe shpirtrat tashmë ushqehen nga fjalët dhe imazhet shembullore, ndërsa trupat ushqehen me ushqime materiale. - Dhe dallimi kryesor i atyre qyteteve bujare ishte një ekuilibër i lumtur mes fateve vulgare, një kulti sovran i bukurisë së shpirtrave të rritur tek të Ndershmit dhe shëndetit të trupave të fuqizuar nga ushtrimet. Kështu që për ata të mëdhenjtë që ju propozojmë t'i imitoni, jeta e shkëlqyer njerëzore “qëndronte në të pasurin e sa më shumë të mirave për shpirtin dhe mendjen, përfitime për trupin, ndërsa të mirat e jashtme lipseshin vetëm aq sa të ishin një mbështetje e arsyeshme për jetën”¹⁾. Kështu që ata, të lindur gjithashtu në tokën e lumtur, *Magna Parens*, në të cilën Ju jeni, dhe, pothuajse

duke mos i vënë re të mirat që e mbushin atë, por nga bukuria e saj e pafund (e cila nuk është gjë tjetër veçse një reflektim i të Ndershmëve i përhapur për krijimin material) duke tërhequr mendimet më të larta dhe vazhdimësinë fetare, ata u kthyen në parime midis bashkëkohësve më të mëdhenj që erdhën më pas.

Ju mbetet pra, Ju, bijtë e mi, që nga këta popuj e keni gjakun dhe shpirtrat, ta përhapni atë, dhe të bashkoheni në një racë të guximshme dhe të lirë që, duke ndjekur shembullin e paraardhësve, i reziston botës dhe kurrë mos përplasit për të shtypur dritën dhe jetesën e lartë që i është dhuruar njerëzimit. Kjo është e mira që Atdheu pret nga ju.

Por për vetë Ju, o djelmosha, si shpërblim për përsosmërinë tuaj, ka një të mirë më të lartë, një të mirë të pakrahasueshme, të qenit pjesë e të jetuarit hyjnor si vëllezër të Krishtit, martir deri në kryqin e Virtytit duke besuar tek Ati.

Sepse kjo jetë do të jetë për ju, bijtë e mi, ashtu siç është për të gjithë një ëndërr e shkurtër; ëndërr e dëlirë e cila megjithatë i njeh ngjyrat e zeza, dhe që pastaj nxihet krejt në të ngrysur. E megjithatë ajo është gjithçka që kemi në botë; siç i duket gjithmonë çdokujt që nga ajo po largohet, i cili sheh se si në të mund të shquante Autorin e gjërave të mëdha dhe të mira mes të cilave jetojmë. Ah, kjo njohuri e mangët! që është fryti i shenjtë së njeriut, në mënyrë që shpalosja e saj tek të ndershmit të jetë lulja e saj e vyer.

Unë për dy gjëra mund t'ju siguroj juve, se njohuria dhe, përmes saj, bashkimi me Zotin është i hapur për të krishterët e botës me zemër dhe për këtë fakt dëshmitarë janë historia dhe përmendoret e të gjithë artit të ri. Dhe se përfitim më të madh se sa kjo prehe pranë Zotit nuk i është dhënë askujt. Po, tamam si pishtar që e ndriçojnë këtë bashkim mbinjerëzor, ngrihen nga çdo epokë fëmijë të burrave të shenjtëruar, të cilëve të këqijat u largohen dhe të mirat u kthehen shtëpive midis të cilave ata bashkëjetojnë ose të cilave Ati u dha si krahë dashurinë që, në prani të fqinjëve, u solli atyre trupa të lehtë të ngritur nga toka drejt qiejve të Tij, ose, profecive të cilave u përgjigjeshin vazhdimisht ngjarje, dhe ata që ndihen të mburjtur me virtyt mund të thoshin më shumë se çdo njeri i lumtur: “Kjo është dita e krijuar nga Zoti, le të gëzohemi dhe ngazëllemi me të”.

Ah, fëmijët e mi, sikur të mundja unë ta vija dorën tuaj ende të njomë në atë të Atit që keni në Qiell, në mënyrë që, në presionin e jetës, Atij t'i flisni besimplotë dhe të dëgjonit çka ju përgjigjet; si gjithmonë, të gjithë ata që preken nga sëmundjet dhe nga mundimet e tokës ose të detit, dëshirojnë ta shohin dhe ta dëgjojnë, dhe nuk e dinë në cilën anë do ta gjejnë.

Por nëse vetë Ai do t'ju bëje me dije ju nëse po rriteni në të Vërtetën, në Drejtësinë dhe në Mirësinë që Shkolla pret t'ju edukojë, Ai do t'ju bëje me dije dhe do t'ju bekojë kundër gjërave të mbrapshta, ashtu si unë, edhe prindërit tuaj, jua urojnë me gjithë zemër.

Drejtori
Jeronim De Rada

16. LARTËSISË SË SAJ, PRINCESHËS ELENA GJIKA¹⁸⁰

Ideja e një Gramatike të gjuhës sonë, tashmë, ishte spontane, në kushtet tona: dhe, nëqoftëse, shumë i ri, unë e përvetësova, qe, ndoshta, nga kjo që koha e re buron, në mënyrë të vazhdueshme, prej zemrave djaloshare.

Mbasi që Lartësia Juaj mori dhe lartësoi, rishtas, Flamurin e Shqipërisë; dhe, ndër vëllezër, të ndarë nga vendi e besimi, e shohim, tash, si shenj afrimi shpirtërash dhe shpresash, nga të gjitha anët dhe, thuajse, instinktivisht, u pat kujdes për gjuhën, e cila na mbetet mjet i madh dhe i përbashkët për t'u kuptuar dhe për t'u afruar.

Por kjo, ose e varfëruar nën të këqijat tona, ose e dhunuar në lakimet e veta, duket se nuk e ka më atë që pritet prej saj. Barbarizma që, në mes /njerëzish/ të largët e në mes tyre të panjohur, marrin pamjen e dialektit, na pështjellojnë çdo të kuptuar të drejtë. Aq e ndierë është nevoja për të ngritur rregullat e rrepta, brenda të cilave, edhe me ndryshimet dialektore, përmbahet kjo gjuhë shumë fisnike. Dhe këtë, ndonëse i ri, desha ta bëj, duke patur besim në dobinë se u rrita në Kantonin shqiptar (arbëresh), që e ruan më mirë veten¹, dhe se linda nga një nënë gege dhe një babë toskë, i cili edhe mund, përmbi çdo tjetër (= përmbi të gjitha), të përkrahë punën time (= punimin tim).

Tani, këtë, që unë e desha për ndihmë në bashkimin tonë, e ve me nderim në duart Tuaja, Zonja jonë; duke dëshiruar, dhe tashmë nuk e mohoj, që të më pranoni ndër ushtarët e fatit tonë, nën hijen e Flamurit Tuaj.

I shkëlqesisë Suaj,

shërbëtor i përvujtë
Zef De Rada

¹⁸⁰ *Grammatica della lingua albanese*, Tipografia dell'associazione, Via Valfonda, Nr. 79, Firenze, 1870.

17. GUSTAV MAJERIT¹⁸¹

Sh. Dhimitër Korone, 31 tetor 1883

I nderuar Zotëri,

Letra juaj e papritur që duhet të më bëjë krenar, më ka hutuar krejt prandaj jam i pafuqishëm që t'ju them menjëherë diçka për punën tuaj, si ata që nuk dinë gjermanisht. Por unë kam një mik nga Gjermania e poshtme, profesor muzike në Gjimnazin e Koriljanos, i cili ka aq mirësi për mua sa më përkthen librat gjermanë që më interesojnë; atij ia dërgova me lutje të thellë dhuratën tënde të çmuar.

Ndërkohë, nuk munda të mos i shfletoja faqet duke u përpjekur t'i gjeja kuptimin, dhe mbase e kam rrokur rëndësinë e tij të madhe dhe rrugën kryesore që Ai rreh në të cilën, megjithatë, Ai do të gjejë dy pengesa të cilat nëse lehtësohen, nuk do të mund t'i bëhen pritë.

E para është ndryshimi i alfabeteve, gjithmonë i përdorur gabimisht në shumicën e rasteve për faj të mjeteve tipografike dhe shpesh për faj të tipografëve. Kështu për shembull *k*-në, e cila në përdorimin e zakonshëm ka tingullin *k* të latinishtes, unë e kam përdorur për të dhënë tingullin e ëmbël të *k*-së së greqishtes përpara *e*-së ose *i*-së dhe ky abuzim i imi ju ka shtyrë që në faqen 19 të nxirrni në pah një ndryshim dialektor të pagjasë mes fjalës tonë *avëlkedhe* asaj *avl'ak'e* të Kulluriotit. Nga ana tjetër, meqë doja të mos e shpërndaja ndalimin e zërit në përbërësit e secilës temë, e shënova atë me *ë*-në e shurdhët; sepse sapo t'i ndalësh pothuajse gjithmonë ndjehen fare pak. Kulurioti e ka lënë pas dore këtë gjë, ndërsa unë vetë jo gjithmonë i shkruaj dhe për këtë arsye të huajt gabohen.

E dyta është vullneti që shquhet tek shkrimtarët e gjuhës sonë të konsumuar dhe të shpërndarë për të krijuar lehtësisht fjalët që mungojnë nga analogji gramatikore, në vend që t'i kërkojnë aty ku

¹⁸¹ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

janë lënë pas dore ose të lenë imagjinatën krijuese të shkrihet në nxehtësinë e frymëzimit. Prandaj, ata që nuk janë shqiptarë shpesh hasin në krijime individuale të dhëna si terma popullore. Më shumë se sa tek të tjerët, është mbjellë me risi të nxituara, *Chërsteu i seiteruar* i At Antonio Santorit dhe Kristoforidhit.

Këtij gabimi i shtohet edhe një tjetër, ai i Kamardës, do të thosha, ku në kohën e tij të parë mbizotëroi edhe plani për ta identifikuar ndoshta shqipen me greqishten - e cila përpiqet t'i përshtasë fjalët dhe format gramatikore shqipe siç di vetë. Këtu vlen të sjellim si shembull deformimin e shkaktuar për të në dialektin e Frashinetos, ku jo shumë besnik ndaj përkthimit të Shën Mateut të bërë nga Dorsa, ai e shtrembëroi aty-këtu për ta asimiluar atë me atë që hamendësonte kur fliste për *Piana de' Greci* ose nga ato çka lexonte në libra apo përmbledhje të bëra nga misionarë ose të tjerë, pas gjuhës së prishur të vulgut të Shqipërisë së veriut. Dhe pas tij edhe të tjerët e bënë këtë.

Këto janë dy shkëmbinjtë që hasin ata që lundrojnë në detin tonë, por Ju do të jeni në gjendje t'i shmangni ato, siç duket se e bëni tashmë, për shkak të burimeve të shumta që ju shfrytëzoni.

Në revistën periodike ku unë vura dorë – prej së cilës *Zotëria Juaj* i Nderuar mori dy numrat e parë - është një detyrë e veçantë të përfaqësosh plotësisht tingujt e gjuhës, duke shënuar aty ku është e mundur ndryshimet dialektore. Dhe shpresoj që, kur të fillojë, ndihma që do të marr nga të gjitha anët do të më mbështesë në përmbushjen e qëllimit tim.

Nga librat që nuk shfaqen në katalogun tuaj, unë njoh vetëm *Këngëtoren* dhe të "*Burgosurin*" e Santorit, të rëndësishëm për vlerën e tyre estetike, dhe të *Kishterin* e tij të *shenjtëruar*. Unë botova katër histori në '48, nga të cilat Stier përktheu disa faqe dhe në 43 *Identiteti i kombit shqiptar me Pellazgët*, në të cilin mitologjia pellazge deshifrohet nëpërmjet gjuhës shqipe. U bë një botim i dytë në vitin '62. Nuk kanë mbetur më kopje as të njërit e as të tjetrit.

Dhe në fund, ju lutemi pranoni dhuratën e vogël të një prej botimeve të mia më të fundit, e cila është e huaj për studimet tuaja, por jo për shekullin që po vërshon.

Me mirënjohje e plot respekt e quaj veten time Shërbëtorin Tuaj të Devotshëm.

Jeronim De Rada

18. GUSTAV MAJERIT¹⁸²

1887

I ndrituri dhe fort i nderuari Zotëri,
Fiamuri u ndal pas numrit të shtatë të vitit të tretë dhe kjo më pikëlloi kryesisht për ndërprerjen e botimit të dramës së Kaloxhero Santorit sepse një tjetër dëshmitar i sinqertë dhe i vërtetë i qenies sonë në mërgim të trashëguar mungonte. Por çfarë të bëjmë? Mua më mbeti një kredi e humbur prej më tepër se 2400 lireta përpos abonentëve borxhlinj dhe nuk pata më para të mijat që t'i shtija paradhënie. Dy vjet pasi fondet nuk dhanë fryte, dhe shitja e vogël mbeti e pashitur, kur Qeveria thith dhe Bankat tërheqin kapitalin; këtu e gjithë pasuria u zhduk. Pardje një pronar i 400.000 liritave në fonde nuk kishte as një kambial prej 100 lirash për farën e mëndafshit dhe me vështirësi që në gjendje t'i mblidhte një e nga një në të gjithë Shën Mitrin; çka mbeti, tashmë në gjendje të keqe, u shit për rreth 60 c. libra. Ata dështojnë, shpërthejnë dhe tashmë rrjedha po më përpin edhe mua gjithashtu. I zënë ngushtë nga kreditorët, e shita në një çast të keq tufën e bagëtisë dhe prej tre javësh po përpiqem më kot të shes një fond të parë dhe nuk gjendet kush mes 3600 banorëve që ka të shpenzojë më tepër se 2000 lireta - vlen më tepër. Jam përpjekur të shes pronësinë e *Rapsodive Kombëtare*, por në Itali, përveç disa specialistëve që ia vlejnë, shkrimi është aq i cekët saqë u jep një pretext të mirë fëmijëve të punonësorëve të cilët në vend që t'i shpenzojnë paratë e tyre në lexime t'i shpenzojnë ato për të kënaqur veset e tyre.

¹⁸² Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

Në këto shqetësime të dëshpëruara, nëse letra juaj e ngrohtë nuk do të më kishte diskutuar, unë përsëri nuk do të përmbushja detyrimin që kam ndaj jush. Sepse kisha, përkthyer, një pjesë të mirë të gramatikës suaj dhe që atëherë mbajta disa shënime, të cilat kam nderin t'ju bashkangjis; ajo çfarë ka mbetur nuk e di nëse mund t'ju vlejë; sigurisht sot kujdesi për zemrën time të ngratë (*curae torquentes cor meum*) nuk do të ma lërë kokën të kthehet e vendosur.

Mund ta përmbledh mendimin tim në dy përshtypje. 1. Që ju jeni i pari, dhe me një fuqi të veçantë, tipike e juaja, vëreni, nën të dhënat e veçanta, ligjet universale formologjike dhe sintetike të gjuhës. Ndoshta shumë përjashtime ju rrëshkasin, por me kalimin e kohës shumë degë vërshuan në lumë përpara se ndryshimet në gjuhën shqipe të çrregullojnë çdo përgjithësim absolut. 2. Se jo të gjitha burimet nga të cilat ajo mori janë të papërziera ose të pacënuara.

Unë e marr për të mirëqenë që shqipja e folur në kolonitë e Sicilisë, të Kalabrisë dhe Bazilikatës në veçanti, shërben si gjurma më e pastër e saj ashtu siç të paktën ishte deri në kohën e Skënderbeut. Z. Tier, i cili më do kaq shumë, më kishte bërë të shpresoj se do të kisha nderin të prisja një vizite nga ju. Nëse në të ardhmen kjo do të ndodhë dhe do të më gjesh të gjallë - unë jam 74 vjeç - do ta shohësh vetë se me gjithë ndarjet në pesë kantone, 20 e kusur kilometra larg njëri-tjetrit dhe pa kurrëfarë marrëdhënie mes tyre, ato kanë të njëjtën morfologji dhe sintaksë. Në Sicili do të gjeni gjuhën tonë të sinkopuar. *Arbëri i ri* ndaloi në numrin e tretë. Ju kanë shkruar një profesor dhe një student, që jetonin me pensione në një Palermo mjaft të pasur; atyre iu desh ta preknin me dorë gjykimin e Gëtes se “kushdo që dëshiron të njohë mjerimin le të shkojë në Itali”.

Por rrezikoj që t'ju mërzis dhe me vlerësimin dhe respektin tim më të lartë po ndalem.

Juaji me devotshmëri dhe respekt
Jeronim De Rada

19. GUSTAV MAJERIT¹⁸³**22 maj 1888**

Zotëria im i shquar e fort i nderuar,
E mora dhuratën e çmuar të gramatikës suaj dhe ju jam mirënjohës për dallimin e bërë me të cilin më nderon mua dhe dashamirësinë me të cilën ndihmon kombin tim të mjerë dhe ua kujton atë popujve të Europës. Dje munda t'ia dërgoja kopjen mikut tim gjerman në Kordiljano që të më përktente atë çka më volit më tepër të di se ç'ka brenda. Dhe më pas do të jem i lumtur të diskutoj gjatë me Ju, por me ç'munda të marr me mend Ju keni plotësuar mangësitë e paraardhësve tuaj.

Me respekt të devotshëm e përsëris,

Juaji i devotshëm
J. De Rada

¹⁸³ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

20. GUSTAV MAJERIT¹⁸⁴

I Shquari dhe i nderuari Profesor,
Letra juaj, aq e ngrohtë dhe fisnike, e cila më gjeti në një çast “brenge të madhe” më hodhi në një konfuzion të dhimbshëm dhe unë nuk u përgjigja, përpara se mendja ime, e cila shpejt u bë fajtores, të ishte kthyer mbrapa tek gjërat e kaluara për të kërkuar atë çka nuk e bënte të humbiste plotësisht sipas mendimit tuaj. Dhe ja tek vij me një rrëfim të sinqertë në lidhje me errësimin e shpirtit tim për arsye se hijet sterroseshin nga dobësia e subjektit që godisnin - Shqipërinë e mjeruar dhe zemrën time të rrënuar në përkushtim ndaj saj - dhe për vendin e lartë ku lëviznin.

Tani kini durim të më dëgjoni pak, dhe do ta kuptoni arsyen e shmangies nga tema me të cilën po e nis.

E kam filluar karrierën time poetike gati si lojë dhe pengesa e parë ishte, si te fëmijët, mungesa e fjalëve shqipe që do të ndihnin idetë e mia, por kjo në vend që të më bënte ta lija punën të më binte nga dora, më shkundi në një përpjekje kokëfortë për të ringjallur, do të thoja, gjuhën. Pas më pak se një viti, një pasion rinor më ndihmoi ta përdorja me më zhdërvjellësi, siç mund të shihet ende te *Milosao*. Edhe kur atëherë desha ta ngre në shprehjen e jetesës së lartë dhe megjithëse duke u nisur nga kënga popullore shquajta para vetes temperamentin e mundimshëm dhe të vështirë të epikës, lirikës dhe dramatikës, të përshkruar në embrion në atë këngë; mendja shqetësohej që t'i kompozonte ato në harmoni të qartë, dhe ligështohej vazhdimisht nga instrumenti i mangët që kishte, nuk ndalej në krijimin e një koncepti të dhënë dhe të rëndë që ta vendosja brenda.

¹⁸⁴ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

Kur dhe pas shumë vitesh, m'u duk se kisha arritur një stil, për arsye të jashtme dhe duke marrë parasysh faktet e mia, m'u krijua besimi se kisha një mision që lipste të nisja kultivimin dhe ringjalljen e vendit amë. Kështu, kur më vonë nxorra në dritë librin e *Skënderbeut*, më shumë sesa pjesën e përsosur të tyre ai rrekej të zgjonte tek shqiptarët ndërgjegjësimin për veten. Gjithë kësaj pune të gjatë i kam kushtuar jetën dhe pasurinë time; askush nuk më dha dorën, veç Zoti më mbështeti.

Tani në këtë fazë të fundit, ishte duke u negociuar në Gjermani, botimi i tre ose katër tregimeve të zgjedhura dhe të përfunduara të *Skënderbeut* kur një artikull i Juaji, nuk e di në cilën revistë gjermane shpreheni se nga çdo këndvështrim që t'i shihnit studimet e mia, i gjykonit të zhveshur nga një përmbajtje e arrirë. Botuesi zemërthyer e prishi marrëveshjen dhe u zbraps. Ndjeva dëm edhe dhimbje sepse shpresoja tek një fitim ndërkohë që isha në nevojë dhe po më godiste dora e Zotit. Megjithatë, u qetësova duke ditur që gjërat e mia nuk ishin të përsosura – që tek Revista europiane *de Gubernatis* i kisha gjetur ato të shkëputura dhe të papërunuara - dhe më ngushëllonte ndjenja dhe shpresa që unë ashtu si *Jupanqui* i autores së *Capo Cabana del Calderon*, më në fund e kalova testin.

Por kur, pasi ndërmora botimin e *Fiamurit*, më dërguan të lexoj një disertacion tuajin mbi Shqipërinë, botuar në Antologjinë e Re, ku na quanit një popull të kohëve të fundit, të cilit në thelb i mungonte shpirti poetik ndërkohë që gjatë studimeve tuaja shqiptare nuk njohët asnjë shkrimtar tjetër shqiptar përveç Varibobës; aty u duk qëllimi juaj, nuk e di se nga cila e metë e jona u ngjiz, për të kundërshtuar punën tonë rigjeneruese, dhe . . . shfaqje të tjera që u hasën, nuk e dobësuan, por e konfirmuan këtë errësim të shpirtit tim. Dhe unë për të ngritur shpirtrat kombëtarë dhe për t'ju bindur gjithashtu edhe ju që nëse nuk ishte shfaqur ende në veprim, gjithsesi potencialisht ekzistonte gjenia kombëtare; ekspozova disa piktura të Varibobës dhe më pas Paraskenën e Skënderbeut, duke iu afruar difekteve dhe dramës së Santorit. Ju nuk do t'i mohoni këtyre prodhimeve, pas *Rapsodive Kombëtare*, një epërsi të lindur - ndaj poezisë neohelene. Vetëm se ata nuk kanë një treg kombëtar.

Besomëni, unë ushqeja një nderim të përzemërt për Ju pasi mësova për studimet tuaja shqiptare. Nuk munda të kuptoja veçse atë pak që më shpjegoi me mirësi një miku im i largët; I paditur në filologji, nuk

mund ta gjykoja vetë përmbajtjen e tij, por as nuk mund t'i kundërshtoja rezultatet e doktrinës tuaj, ndaj disa prej të cilave përkulesha, të cilat, do të thoja se qenë jehonë e një të kaluarë shumë të largët, për shembull, fjala *mish* e zakonshme në shqip dhe në sanskritisht, dhe emrin tonë të përgjithshëm *malje* (male) që ka mbetur që nga Imalla e Indisë. Unë vetëm u trishtova nga ajo që besoja, mbase gabimisht, që Ju e lidhnit shqipen, sipas një preference mes familjeve ariane, me gjuhën sllave, për shkak të papërcaktueshmërisë së natyrës së ilirëve nga e cila ajo buron. Për ne asimilimi sllav është më i urryer se edhe ai helen. Larot e Rusisë, Mali i Zi dhe Ristishiçi i çuditshëm - në shqip *rrëshikj* – bashkë me Serbinë e tij *të vjetër* po vdesin ta bëjnë pre emrin tonë dhe kudoqofshin, panrusët janë të lidhur fshehurazi me Eleninë në planin që kanë për të na shkatërruar. Në vetvete gjurmët e gjuhës sonë, gjurmët e origjinës sonë, kult i Natyrës, ekzistojnë që në antikitetin parahistorik përpara, me sa di unë, shfaqjes historike të ilirëve, gjurmë që unë i hasa në 1840, ndërsa u zbuluan më vonë nga Hahn, shërbyen për të na identifikuar, sipas shumë vetave, me pellazgët, pra që na tregonin si antikë për antomazi, *Plaçkë e vjetër*. Në numrin e 7-të të *Fiamurit* – të cilin me ç'duket ju nuk e keni marrë dhe unë po ju dërgoj një kopje tjetër - iu ktheva këtij fakti, tani i pranuar nga më shumë, dhe koha do të zbulojë nëse është me të drejtë.

Sa i përket pranimin të Shqipërisë sot në Austri kjo pengohet nga e gjithë bota dhe gjendja e saj më e sigurt është të qëndrojë me Turqinë; dhe nëse kjo nuk do të promovonte civilizimin dhe prosperitetin, jo me ndrojtje si sot dhe pothuajse me zemërdhemje, të qëndrojë me të përgjithmonë do të që gjëja më e mirë. Por nëse Turqia lë pas dore veten e saj, ose zhduket e konsumuar nën lakminë e popujve evropianë, për Shqipërinë do të që më mirë të shpallej neutrale, gjëja më lehtë, më e sigurt dhe më e dëshirueshme, do të që, ashtu si edhe Bohemia dhe Krakovia, të pranohej në Federatën Austro-Hungareze. A nuk do të dëshironit dhe ju ta shihnit aty? Mjaft: *më ndjeni*, Ju lutem, për mërinë që mund t'ju jetë dukur ndonjëherë se kam pasur. Nëse *Fiamuri* nuk bie nga varfëria, do të pendohem.

Me respekt të devotshëm e përsëris,

Juaji i devotshëm
Jeronim De Rada

21. ÇEZAR KANTUSË¹⁸⁵

I ndritshmi Zotëri i imi,

Meqë e lexova në Opinionin e Firences letrën tuaj drejtuar prof. Billias, vendosa t’ju paraqes çështjen e Shqipërisë së braktisur nga të gjithë; se edhe në historinë e vet ajo qe mohuar dhe dënuar. Tani me letrën tuaj ajo më entuziazmon dhe më shpejton.

Pikë së pari, kombi shqiptar, sido që të jetë i përzier me atë helen, është i huaj dhe i ndryshëm nga ai dhe gjuha e tij, sipas asaj që tashmë dihet, është larg nga helenishtja më tepër se ç’është dhe nga latinishtja, çka tregon se nuk ka pothuajse asnjë ngjashmëri racore mes të dyjave.

Prandaj nuk pati një Federatë ballkanike ku “trashëgimtarët e Botzarit dhe Maurokordatos” (se si Ajo, me mënyrën e vet të shkurtër dhe të skalitur, përcakton Shqiptarët dhe Helenët) të formonin, ashtu si suedezët dhe norvegjezët, një shtet të vetëm; mua më duket se pak pasi të qe formuar do t’i qe nënshtruar sllavëve federalë, ose zotërve të tyre që qëndrojnë pas.

Por këtë bashkim prej të barabartësh Helenët nuk e duan, ato pretendojnë të rivendosin Perandorinë Bizantine e cila për ta tingëllon si Perandoria Greke.

Sa i përket Shqipërisë, ata e kanë paracaktuar që të jetë ajo subjekti i egër me të cilin ato të shartojnë gjuhën dhe sundimin e tyre, dhe kështu të kenë një pozitë mbizotëruese në Lidhje.

Rreth vitit 1883, Mavromati, konsulli grek në Maltë, u përpoq të demonstronte (në shumë numra të gazetës *Akropoli* të Athinës): “Se Shqipëria e Veriut dhe ajo e Mesme, Epiri dhe Maqedonia, nuk kishin as 700. 000 shqiptarë, interpretim që hoqi detyrimin të konsiderohej

¹⁸⁵ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 10, Cosenza, 20 febbraio 1886, p. II-VI.

pothuajse si një komb që gëzonte të drejta”. Dhe disa vjet më parë, kur me nismën e Buskaljonit, një dorë vullnetarësh italianë u ofruan të mbështesin, së bashku me Helenët, Federatën Ballkanike, sapo kolonel Koeli shprehu dëshirën e Buskaljonit dhe të Kancios që Shqipëria të figuronte midis atyre shteteve, Komonduros u turbullua i gjithi dhe hoqi dorë nga bisedimet.

Ndërkohë Shqipëria as nuk ka menduar dhe as mendon për Federata, cilatdo qofshin ato.

Përkundrazi, tashmë shpirtrat e saj tani janë shumë të ndërsyer nga tradhtia arrogante e Helenisë e cila kryeneçësisht punon për ta humbur. Në nr. 3, viti II i “*Fiamurit*” janë të rrjeshtuara fazat e të dy popujve dhe pozicioni i tyre përkatës aktual dhe se si Helenia ka përfituar nga keqkuptimi, se këtu në Europë, besohet se shqiptarët dhe helenët janë popull grek që flasin dialekte të ndryshme. Nëse burrat e mëdhenj të Greqisë antike, ishin të gjithë helenë, apo pjesa më e madhe e tyre ishin pellazgë, koha ende nuk e zbulon, por ajo që dihet mirë është se Rilindja helene zuri fill nga një pellazg, Aliu nga Tepelena dhe se heronjtë më trima të Heladës, Botzari, Zavella, Macry, Odisea, Miauli, Tombasi, Karaiskaki, Kondurioti, Bulgari, Bubulina, etj. ishin pellazgë, por me dashje helenët heshtën për kombësinë e tyre dhe përfituan nga bëmat dhe lavdia e tyre.

Them me dashje sepse që nga viti 1850 një gazetë greke e Vjenës, *Imera*, e përgëzonte faktin se shumë fshatra në Greqi kishin arritur ta ndalnin përdorimin e gjuhës shqipe. Pastaj unë në broshurën: *Lashtësia e Kombit Shqiptar*, (që mundi të botohej vetëm pas vitit 1860) vura në dukje këtë mburrje të pakuptimtë, duke paralajmëruar suksesin e rremë të Panhelenizmit.

Në të vërtetë atyre më pas u shkoi gjithçka mirë: për shkak të neglizhencës së Portës së Lartë dhe dyshimeve që patën Feneriotët në lidhje me Shqipërinë, u hapën si në Epir ashtu edhe në Maqedoni shkolla greke për shqiptarët, me paratë e Zapas dhe Zografit falë zemërgjërësisë së të cilëve nderi i kaloi emrit grek ndërsa ata s’ishin veçse dy shqiptarë naivë. Dhe duke mos reshtur së punuari, me ndihmën e Themeluesve të Klerit Ortodoks dhe të Lozhave Masonike, u arrit të helenizoheshin më shumë vende në ato provinca turke. Ky ishte shkaku i parë i reagimit të ndjenjës kombëtare që u shfaq në zemërimin

e Ibrahim bej Dragrotit në Tepelenë dhe në Komitetin Shqiptar për kultivimin e gjuhës kombëtare, themeluar në Konstandinopojë nën presidencën e Sami bej Frashërit, dhe më vonë në Lidhjen e Prizrenit.

Kjo kishte rrezikuar fatet e thurura nga Mbretëria Greke, kur lëshimi i Ulqinit që e ashpërsoi atë kundër Portës, u dha helenëve mundësinë të bëheshin këshilltari djall dhe nxitësi i kryengritjes së Gjakovës dhe Prizrenit. Se si më pas ato i tradhëtuan dhe ndërsa Krerët e Lidhjes u degdisën në fortesat e Perandorisë, ata fituan pjesën më të madhe të vendeve shqiptare në Thesali dhe Epir, Ju do ta lexoni në broshurën e Z. Kanini që unë po jua përcjell bashkë me këtë letër.

Të inkurajuar nga sukcesi, me t'u shpërndarë Lidhja, Mbretëria greke vazhdoi me zjarr, çka dukej urrejtje ndaj rracës tonë, punën për zhdukjen e gjuhës së saj. Një shqiptar i shquar, shtetas grek, A. Kolorioti, shkoi në Gjirokastër për të përhapur abecedarin e tij të gjuhës shqipe, por Konsulli grek (me emrin Kamaço nëse nuk gaboj) e burgosi dhe e ktheu në Korfuz, mes duartrokitjeve të shtypit helen dhe favorizimeve të qeverisë që e promovuan atë në Konsullatën e Korçës.

Pastaj Shqipëria pati mendimin që të themelonte një gazetë të sajën, duke ma besuar mua drejtimin e saj, shfaqja e të cilës pati një efekt kërcënues në të gjithë komplotin panhelenik. Duke mos mundur edhe pas intrigave të gjata ta ulnin këtë *Flamur të Shqipërisë*, u vu përpara fantazmës së një Lidhjeje Ballkanike, nismë e Trikupit siç thuhej, dhe emisarët që erdhën tek ne nga Korfuzi kërkuan “që të nxisnin një kryengritje në Shqipëri në mënyrë që, kur Turku të mposhtej, ajo të mos aneksohej nga Greqia, por të bënte pjesë, si e barabartë mes të barabartëve, në Federatën Ballkanike”

Morën përgjigjen: - “Çfarë / Nëse Greqia dhe Shtetet e Ballkanit të pavarura do të bashkoheshin, më vonë Shqipëria do ta pleqëronte këtë me veten”

Pak më vonë patëm në shkëmbim numrat e parë të gazetës *Federata Lindore* dhe Leonida Bulgari më deklaroi se ndonëse nuk mund t'i kundërshtonte ambiciet e Greqisë, ai, meqë kishte lindur maqedonas, i kishte fort për zemër sidomos Maqedoninë dhe Shqipërinë. Edhe ky arsyetim i gazetës nuk më bindte, dhe as nuk luajta nga qëndrimi im; kështu u ndërpre çdo marrëdhënie mes nesh.

Prandaj ndodhi që, në funksion të *Flamurit* të ngritur të *Shqipërisë*, në Bukuresh u krijua një Komitet prej 300 bashkatdhetarëve tanë, me qëllimin për të kultivuar dhe ngritur lart gjuhën shqipe. Ky fakt i rëndë i shtangu shpresat e Helenisë dhe ishte ai që e çoi atë të merrte këto vendime të rrezikshme. Më dërguan nga Firence një numër të *Federatës Lindore* në të cilën, pas themelimit të Komitetit, dha thirrjen e alarmit: “Mbaruan, thuhej aty, fatet e larta të helenizmit ku të merrte hov krijimi (fiks kështu!) i një gjuhe shqipe”.

Këtu, nuk qe më vetëm balli i Bullgarit, pa maskë, por fytyra e mbretërisë Greke e zhytur në paudhësi.

E dëshpëruar për ta pasur vasale Shqipërinë për “*dhesmòn Abnicon*”, kurdisi planin e pamëshirshëm, i cili tashmë u shfaq qartë, që të binte në ujdë me fqinjët sllavë për ta copëtuar atë. Apo mos jemi ne që duam gjë prej saj? Jo, por kur ajo deshi dhe thirri të tjerët që të kërkonin kompensim në vendin shqiptar, për të ruajtur ekuilibrin pas zgjerimit, siç thonë ata, të Bullgarisë dhe dëshirat e tyre gjetën përkrahje në atë pjesë të shtypit evropian që “mban temjanicën përpara Bishës”, Shqipëria rroku armët kundër armikut të saj, dhe për sa kohë që kjo luftë nuk pushon, dhe as nuk mendon më për Epirin dhe Maqedoninë, ajo nuk do t’i ulë ato.

Tani Flamuri shqiptar, zotëria im i nderuar, nuk mund të ishte pa të meta dhe pa maturi askund tjetër përveç në fushë shqiptare. Dhe pse duhet ta lërë atë, dhe më kot ta pushojë?

Prej një kohe të gjatë ata e shohin Greqinë si një forcë dhe një civilizim që duhet t’u imponohet fqinjëve: ne që ndiejmë gabimin e këtij mendimi dhe dëmtimin prej tij, themi se në të vërtetë Shqipëria mban në trojet e veta më shumë se dy milion Shqiptarë, dhe (përveç atyre që ende figurojnë gati gjysma e popullsisë së Greqisë) kanë shumë ishuj të Arkipelagut të mbushur plot me shqiptarë, koloni në Azi, Itali dhe gjetkë; se raca shqiptare për nga virtyti i mendjeve dhe trupave, për nga thjeshtësia dhe besnikëria qëndron më lart se ajo helene, e cila flet një gjuhë që i ndrituri Bucholtz e quan të *vyer*, frytet e së cilës, janë pastruar, do të thosha, kohët e fundit, ajo është më shumë se kushdo tjetër në gjendje të gjykojë dhe të krahasohet me ato të nevelenikës. Unë besoj se fati i saj sot është i lidhur me Perandorinë Osmane – që tashmë ka hyrë në orbitën e Fatit të Austrisë dhe të Gjermanisë që

prej shumë kohësh u bënte ballë forcave të tyre, dhe e nevojshme për dinjitetin dhe paqen e Anglisë -: besimplotë se ai Sulltani, ashtu si edhe Fuqitë e tij mike janë të vendosura që t'i rikthejnë prosperitetin dhe virtytin e tij antik këtij bastioni të fuqishëm dhe të *status kuosë* lindore.

Ndërkohë, le të përhapet çiltërsia dhe harmonia jonë në vendin amë nga një vend i lënë jashtë pasioneve, dhe të ndihmojë zhvillimin vendas dhe historik të kulturës së tij.

Ne e dimë që flamuri i atdheut tonë së shpejti do të na bjerë nga duart, por Zoti, i cili e ka mbajtur për këto raste baltën tonë të mjerë, do të jetë Ai që do ta ngrëjë në vendin tonë të tjerë më të lumtur. Dhe i mbetet gjithmonë atij mënyra e veprimit sipas planeve të kota të njerëzve të vdekshëm.

Pas këtyre fakteve të cilat, të bashkërenditura, shpjegojnë njëri-tjetrin, Ju s'do të mund të kini veç mirëkuptim.

Juaji, gjithnjë me nderim e devotshmëri
Jeronim De Rada

22. ZONJË IME SHUMË E MIRË DHE E NDRITUR¹⁸⁶

28 mars 1884

Letër Baroneshës Jozefina (Xhusepina) Fon Knorr

Po përgjigjem me ndonjë ditë vonesë, sepse m'u desh të jepja me shkrim disa ndriçime mbi një çështje time civile, për avokatin në Gjykatën e Madhe të Katancaros, dhe, pastaj, sepse, në këtë ndërkohë, u kthye në shtëpi, nga ushtria, im bir. Mbas pak ditësh, shpresoj të jem më i qetë.

Ju dëshironi të dini idenë themelore të poemës “*Skanderbegu*”? E, pra, ju do të çuditeni për sa do të them; unë ia nisa dhe shkova përpara duke u thurur pa pasur kurrfarë paramendimi, sepse e ndiej në vete atë që qe shkruar “*Poeta nascitur, orator fit*” /= Poeti lind, gojëtari (oratori) bëhet/; dhe vonë “fit-i” filloi të zhvillohet në mendjen time.

Këngët e një pjese të gjatë kohe qenë shprehje të pamposhtura të një ndjenje të tanishme, shumë herë të paraqitura në formën (sipas modelit) e Rapsodive kombëtare, që desha t'i imitoja.

Vetëm kur isha njëzet vjeç, fillova t'i bashkërenditja në një farë mënyre degët (shkrimet, prodhimet, krijimet) e shpërndara, dhe kreu ciklin e idileve të “*Milosaut*”.

Atëhere më lindi si parandjenjë ideja për hartimin e një poeme të gjerë, për të cilën *Milosaoja* do të kishte qenë hyrja (tremja), dhe të *Katër historitë*, të botuara, pastaj, më 1847 – dhe nga të cilat përfitoi Teofil Satiri – do të sajnin mbylljen e saj.

Tani nuk do të shkoj përtej formës që, në botimin e fundit, i kam dhënë *Milosaut*; më vonë do të ju flas për poemën madhore.

¹⁸⁶ Per l'anniversario della morte di Girolamo De Rada, “La nuova Albania”, Anno III, nr. 5, 1 marzo, Napoli, 1904.

Por, që të vëreni çdo të metë e çdo hijeshi të veprës, të cilën e keni aq për zemër, këtu po ju rreshtoj faktet, nga të cilat linden (dolën, gjinekuan).

Dhe këtë, me kënaqësi të plotë të shpirtit tim, që para se të largohet nga kjo botë, do t'ua ketë bërë rrëfimin e vet veshëve të një personi kaq fisnik dhe, për mua, përtej çdo merite time, kaq mik.

Dhe, ndoshta, ju do ta lexoni përligjien e rreptësisë së Zotit mbi jetën time, mbasi më pat nxjerrë (lindur) nga fshati më i përvujtë (i përunjtë), dhe mbasi më pat nxitur nëpërmjet rrugëve të tija, për të zbuluar gjuhën e traditën stërgjyshore të Shqipërisë së gjorë.

Në Gjermani e Austri kanë shumë simpati për kombin tim; dhe, për këtë, Baroneshë e ndritur, u jemi shumë borxhlinj juve; por Franca na njeh, më fort, përmes xhamit të ngjyrosur të helenëve të pabesë.

Prandaj mund ta mirrni me mend pritjen dhe respektin plot meritim timin, nëse, duke treguar, do të paraqitem, tash, si një fëmijë. Le të më falni për rravgimet e tregimit (kallëzimit, narracionit).

Ju puth me respekt dorën,

Shumë i devotshmi dhe i detyrueshmi juaj
Jeronim De Rada

23. BARONESHËS JOZEFINA FON KNOR¹⁸⁷

Baroneshë e ndritur dhe shumë fisnike
Maqë, ditën e Pashkëve të shenjta 1884

Ju uroj pashkë plot kënaqësi, që të ju sjellin ditë të gëzueshme. Shpre-soja të ju dërgoja numrin e *Fiamurit*, por gjithnjë po vonohet nga pasiguria dhe zemërligësia e vogël e pronarit të shtypshkronjës; unë s'kam ç'të bëj, sepse *asnjë gjethe s'bie po s'e tha Zoti*.

Këtu brenda po ju dërgoj tri letrat e rrëfimit tim të përgjithshëm. Do të mund të njihni njeriun dhe shkakun intim (të përbrendshëm) nga format e nga e meta e krijimeve të tija, do të mund të lexoni vargun e sukseseve që e formuan gjatë udhës (krijimit), dhe ta gjykoni ashtu siç është, jashtë botës.

Po ju dërgoj një ekzemplar të *Milosaos*; po të doni ta kundroni në dritën e gjenezës së saj, dhe nëse do të doni t'ua bëni dhuratë të njohurve tuaj, kam në dispozicion endë shumë kopje dhe nuk besoj se mund t'i vë në përdorim më mirë se sa nga dora juaj e dashur dhe e ditur, e shquara Baroneshë.

Më falni për konfidencën e tepruar dhe mos më leni pa lajmet tuaja.

Shumë i devotshmi dhe i detyruari juaj,
Jeronim De Rada

¹⁸⁷ *Per l'anniversario della morte di Girolamo De Rada, La nuova Albania, Anno III, nr. 5, 1 marzo, Napoli, 1904.*

24. SHUMË I NDRITSHMI ZOTNI I IMI, KALORËSI LUIGJ DE SIMONI (L. G. DE SIMONE)¹⁸⁸

Kryetar i Gjykatës Tregtare të qytetit të Barit

Tepër i detyruar jam ndaj Princeshës Dora d’Istria e cila më ka krijuar rastin fatlum të hyj në marrëdhënie me Zotërinë Tuaj shumë të ndritshëm. E kam vonuar përgjegjen deri sa të vija në gjendje të plotësoj, në ndonjë mënyrë, dëshirat tuaja.

Përsa u përket vrojtimeve gjeodezike, absolutisht nuk kam dijeni nëse janë bërë të tilla ndër brigje në brendi të Shqipërisë.

Kam dijeni për një hartë gjeografike, shumë të vlefshme dhe të punuar me kujdes nga Enrico de Gubernatis, konsull italian. Qe botuar në Romë, në Shtypshkronjën Kapaçini e Ripamonti, dhe shitet nga “Libraria qendrore e botimeve Myler”. Aty tregohet relievi i krahinës që shtrihet nga gjiu i Artës e deri në Myzeqë, afër Durrësit. Çdo gjë është paraqitur imtësisht.

Dij, gjithashtu, se bregu i detit të Shqipërisë së Sipërme qe studjuar, me kujdes, nga ana e Shtatmadhorisë austro-hungareze, por më tej nuk di.

Ekziston, gjithashtu, harta e përmendur (e famshme) e të gjithë Shqipërisë e Kiepertit, botuar në Berlin.

Në qoftë se nuk gabohem, qyteti i Barit përpiqet të ringjallë lidhjet e vjetra, që bashkonin Italinë me Shqipërinë, në kohët e bukura të Venedikut. Në lidhje me këtë çështje, mund të ju thom se nga njoftimet e atyre që banuan në vendin e përshkruar nga De Gubernatis, rezulton se përfitime shumë të mëdha mund të vijnë nga një tregëti aktive

¹⁸⁸ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 12.

(e gjallë) në mes të dy popujve të afërm me njeri-tjetrin. Të njëjtat përfitime mendoj se do të vinin, nëqoftëse ky aktivitet (kjo veprimtari) do të shtrihej edhe në Shqipërinë e Sipërme, sipas një promemorie (përkujtese) të shkurtë të Kavalier (Kalorës) Zef Jubanit, që kam nderin të jua paraqes (të jua bashkangjes). Këto marrëdhënie priten shumë mirë përtej detit, dhe ne arbëreshët e Italisë do të ndihmonim, në këtë drejtim, me sa të kishim mundësi.

Unë, në veçanti, kam të abonuar, në të përkohëshmen time *Fiamuri Arbërit*, në Përmet, Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Labovë, Tepelenë, Korçë, Manastir, Shkodër, Orosh, etj. Dhe besoj se i përgjigjem njerëzisë së Zotnisë Suaj, po të thom se, ndoshta, jo veten time që jam në moshë të thyer, porse djalin tim të vetëm e vë në dispozicion të të deleguarve, që tregu i Barit të mund të vendosë, ndonjëherë, të dërgojë për të hapur marrëdhënie miqësore me mëmëdheun e të parëvet tanë /me Shqipërinë/.

Këtë e thom për atë që Zoti do të caktojë për një të ardhme pak ose shumë të largët.

Me konsideratë të plotë dhe të veçantë, kam nderin të quhem,

shumë i devotshmi i Juaj,
Jeronim De Rada

25. DREJTORIT TË GAZETËS “L’ADRIATICO” TË VENEDIKUT¹⁸⁹

12 dhjetor 1885

Duke qenë i bindur se ju me të ndritshmin profesor Kanini jeni të pajisur me të njëjtën drejtësi shpirti, e cila ju shtyni të përkrahni, në gazetën tuaj plot autoritet, të drejtat e Shqipërisë së gjorë, besoj se do të më lejoni që ta bëj të njohur, me anën e saj, luftën e maskuar, me të cilën emri grek, ngado që të jetë, përndjek jetën shqiptare. Pak më përpara, në Bari, një farë Jankopulo, epirotas, kundërshtoi propozimin e fillimit, në Pulje, të tregëtisë me Shqipërinë. Tash, një vëlla i tij, nga fara e Sinonit, lufton mundësinë e paraparë nga mendje të ndritura të një federate të drejtë ballkanike, në të cilën do të kishte një vend edhe Shqipëria. Që të dy, me madhështi dhe me pohime të rreme, do të donin të zhkatërronin atë dashamirësi që shohin tek Italia për kombin shqiptar. Besimet fetare, si Turqia ashtu edhe Greqia, i kanë përdorur si një mjet të rrezikshëm ndaj ndjenjës kombëtare në Shqipëri.

Turqia, duke privilegjuar shqiptarët myslimane duke mëshiruar paudhësitë e tyre, i trajtonte ndryshe nga bashkatdhetarët e tyre katolikë e ortodoksë. Nga ana e tyre, priftërinjtë, mbas parullës që kishin marrë nga Patriku i Stambollit, u tregonin këtyre, si liman shpëtues, vetëm shndërrimin në helenë. Tashti, kjo lojë e ka humbur çdo forcë të veten. Shqiptarët muhamedanë, të ftuar më 1879 nga Porta për të mbrojtur vendin e tyre të kërcënuar nga copëtimi, shprehën në Lidhjen e Prizrendit ndjenjën e përbashkët kombëtare. Kjo është e plagosur, por nuk është shuar nga dështimi që ata i ngarkuan Turqisë; sot

¹⁸⁹ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 53.

jeton e pamposhtur, qoftë edhe mbi gërmadhat e Lidhjes. Nëse Abdyl Frashëri vdiq në burgjet turke, nuk ndodhi *sepse kishte parapëlqyer tiraninë turke kundrejt lirisë helenike*. Ai dhe *buljarët* fisnikë, shokët e tij, përkundrazi, vuajtën drejt shkatërrimit nga pabesia greke. Ja një ngjarje pak e njohur. Greqia /1880-81/ lakmonte Epirin dhe Tesalinë, dhe nuk dinte se si mund t'ia dilte t'i shtinte në dorë; kur mendoi të përfitonte nga mllefi që strukej në zemër të shqiptarëve për shpresat e porealizuara dhe për besën e shkelur mbas lëshimit të Ulqinit, atëhere ajo armatosej dhe kërcënonte t'i vinte zjarrin Gadishullit ballkanik.

Iu afrua, pra, Komitetit shqiptar, duke i propozuar federimin dhe duke i premtuar një veprim të përbashkët, kur shqiptarët të ngrinin krye kundër osmanit besëthyes; kështu i mashtroi krerët shqiptarë myslimanë besnikë. Unë e lajmoja, me anë letrash Abdyl Beun për rrezikun; por ato ose qenë diktuar, ose puna kish kryer (zerja që hedhur). Turqia, e lajmëruar kush e din nga cili dhe e topitun nga humbjet e afërta, dresh forcat e bashkuara të helenëve dhe të shqiptarëve dhe i lëshoi Greqisë tokët e veta. Kjo, e kënaqur, nuk u kujdes më për aleatët e vet, të cilët, të rralluar dhe të topitur, qenë mundur. Dhe Sulltani shfreu mbi këta vasalë mllefin e humbjeve të tija. Cilat janë, tashti, prirjet e shqiptarëve të tradhëtuar kundrejt Greqisë, e tregon ngjarja e sjellur, tash pak kohë, nga gazetatat franceze, se nga ushtria osmane me fushim në Epir, u shkëputën shqiptarët me kompani dhe, duke hyrë në fshatrat greke, plaçkitën, vranë dhe turpëruan gratë. Nga ana tjetër, propaganda helenike, e cila në Toskëri përfitonte nga mungesa e librave dhe e alfabetit shqiptar, po shkon duke u shuar para kulturës së re që lind e rrezaton nga brenda e nga jashtë atdheut. Kjo kulturë është hija e Bankos për panhelenizmin e çmendur. Gënjen ai që pohon se në Greqi nuk janë ndaluar shkollat shqipe; gazetatat greke flasin me inat (dispjek) edhe për ato që po hapen në Turqi.

Kur në Aleksandri të Egjiptit që botuar nga Thimi Mitkoja, shqiptar nga Korça, *Bleta shqiptare*, e cila çekte një revistë shqiptaro-helenike, në Athinë qenë djegur të gjitha kopjet që mundën të shtinin në dorë. Kur në vitin 1879, shqiptari Kullurioti, nënshtetas grek, shkoi në Gjirokastër për të vënë në shitje një abetare të tij shqip, konsulli grek urdhëroi ta arrestonin e ta kthenin në Greqi, dhe gazetatat greke gjithkund brohoritën. Kur, pastaj, doli *Fiamuri Arbërit*, italisht dhe

shqip, i shtypur në Kozencë, e para e përkohshme shqipe e botuar dhe që është redaktuar nga unë, mbas përçapjeve të kota pranë qeverisë italiane për të penguar botimin, grekët besuan se do të nxirrnin lejën nga turku që të ndalonte hyrjen në atdhe, dhe, një ditë prej ditësh, gazetat greke lajmëruan me gëzim se kjo kishte ndodhur. Por kjo nuk ishte aspak e vërtetë. *Fiamuri Arbërit*, i ngritur, diftoi se, tashmë, është e pamundur, si pohon Kanini, burrë me mendje të lartë dhe praktike, që të helenizohen më shqiptarët, të huaj për mbretërinë e Greqisë. Letrat e vazhdueshme që marr prej andej, provojnë këtë largim të Toskërisë dhe të Epirit nga emri grek; e provojnë pëlqimet e zotërinjve të shquar, të krishterë e myslimanë, të viseve më të pasura të Shqipërisë për *Fiamurin* që përfaqëson riintegrimin e autonomisë së Atdheut dhe numëron më se njëqind pajtimtarë në Turqi. Tani, qeveria helenike megjithëse i di të gjitha këto, prapëseprapë beson se ka ardhur çasti që ta bëjë me nënshtetësi greke Epirin. Por kush ia ve veshin? etj.

Jerolim De Rada

26. ANTON DE SOMOGYIT¹⁹⁰

Zotëri i Ndrirshëm,

Nuk mund të qëndroj më në këtë gjendje të rëndë heshtjeje, që, sot ose nesër, mund të më nxjerrë nga zemra e Zotnisë Suaj¹⁹¹, dhe, për këtë, mendoj se opinioni im, megjithëse, ndoshta, i ndryshëm nga Juaji, duke qenë se është i sigurtë, nuk do të Ju fyejë Jú, që ma doni të mirën.

Së pari, nga programi i Radikalëvet të Francës duket se nuk i kushtojnë kujdes faktit se tjetër është rregullimi i qyteteve dhe tjetër rregullimi i gjendjes së familjeve.

Grumbullimi i shumë vetëve në një qytet bëhet se ata kërkojnë paqë dhe shpëtim, mbasi vetëm për këtë të gjithë kanë nevojë. Drejtësia dhe Mirësia, pengesa të përjetshme të paqës dhe të konservimit (të ruajtjes) së përbashkët, janë të nevojshme dhe në ndërgjegjen e secilit. Ligjet e qytetit këto po i mbështesin, mbasi në shoqëri ka të verbët dhe njerëz të këqinj, në të cilët Drejtësia dhe Mirësia janë përdhosur. Dhe princat e kishin zakon t'u lenin në dorë njerit ose disave Drejtësinë që zbatonte ato ligje, duke u siguruar atyre mirëqenien me të ardhurat e pakta të çdo familjeje. Dhe, përtej kësaj pakice, principati, i mbështetur mbi të këqinjët, nuk kishte pse të kërkonte gjë nga ata që e kishin themeluar.

Gjithashtu qytetarët patën, gjithmonë, nevojë, për të shporrur cubat që vinin nga jashtë, që të forconin trupin, guximin e qëndresën dhe të mësonin rreshtimin në çeta, nën komandën e kapitenave të zgjedhur. Në ditët e luftës, ushtrisë dhe prisave të saj, u përgatitej buka nëpër shtëpi. Mbas luftës, prisat që kthenin ndër shtëpi, nuk

¹⁹⁰ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 8, Cosenza, 20 dicembre, 1885, p. I.

¹⁹¹ Ant. de Somogyi ma kishte dërguar programin e fundit të Radikalëvet të Francës, duke kërkuar mendimin tonë. Nuk mundëm t'i përgjigjemi, veçse me vonesë, dhem kur mbërriti letra, e gjet të vdekur. Për të tërhequr vëmendjen, sadopak, mbi një njeri kaq të zgjedhur dhe kaq dashamirës për mua, dhe për përmbajtjen e rëndësishme të saj, vendosa ta botoj.

kishin më ndonjë pushtet. Prandaj Pushteti i përhershëm për zbatimin e ligjeve, dhe i përkohshëm mbi ushtrinë, janë dhe qenë një peshë që e solli e keqja në jetënjëriut.

Prej këtu duhej të ishin nisur ata që pagëzohen “Rimëkëmbës që në themel të qytetit”. Dhe, mbasi Principata është një e keqe e domosdoshme, duhej të ishin përpjekur vetëm si ta zvogëlojnë dhe lehtësojnë këtë të keqe, në mënyrë që qyteti mos të vuante. Ndërsa ai, sot, vazhdimisht, përziën, dhe, duke e mbajtur veten si zot (padron) i të gjithëve, e fut lugën kudo, kurrë nuk të shporret nga sytë dhe gjithnjë merr për vete. Kurrkush nuk deshi t’ia njohë atë çka pretendon si një e drejtë e tija, por pa i thënë kush zuri vendin e atit të familjes, duke e konsideruar qytetin si një shtëpi të madhe fëmijësh të mitur dhe femrash për t’u vënë nën kujdestari. Dhe, sot, ndoshta, ka të drejtë; mbasi atë që të vjetrit e konsideronin (e njehnin) si shërbyes, ne e konsideruam (e njehëm) si një njeri tonin.

Mua më duket se këtyre miqve të qytetarëve, as nuk u shkon ndër mend kujdesi për të lehtësuar peshën e Shtetit, përsakohë që ata, në vend të një Princi të vetëm, caktojnë shumë të tillë në Permanente (ndër Asamblé). Caktojnë, mandej, që fëmijët e paligjshëm të kenë të drejtë në shtëpi njëlloj si ata të ligjshmit; që Shteti të mos pranojë besimin që qyteti ka kundrejt Zotit, që ai që vdes pa lënë mbas vetes fëmijë, pjesa e tij, në vend që t’u kalojë vëllezërvet që kanë lindur dhe kanë jetuar bashkë me të, në shtëpinë atërore, t’i kalojë shetit. Është e qartë se ata nuk e vrasin mendjen për shumicën e popullit, por për forcimin sa më tepër të sundimit dhe për pasurimin sa më të madh të Shtetit që tani është bërë plaçkitës. Kam vërejtur (kam vënë re), tash shumë kohë, se ata që preferojnë t’ia dhurojnë çastet e jetës së vet atyre që janë në hall dhe bërtasin për dashurinë e tyre ndaj Atdheut, në asnjë kohë e në asnjë komb nuk kanë propozuar kufizimin e së drejtës së Shtetit, si gjyqtar, si edhe kufizimin e zyrove, me anën e të cilave Shteti i gërryen, vazhdimisht, të përdëllyerit prej tyre; përkundrazi, sot, ata të gjithë si shokë, shkojnë të uritur në pronën e përbashkët “*rem publicam*” – duke parë se ajo – dhe këtë e kuptojnë – ishte në dorën e Shtetit.

Pesha e rëndë e pushtetit të zotërinjve mbi bashkëkohësit e vet që, gjithëherë, pjesë e trishtueshme e jetës; dhe këtë, ne të krishterët, e kemi të pasqyruar në simbolin e përjetshëm të jetës njerëzore. Le të

shohim si dhe përse një sunduesi i erdhi në mendje t'i nxjerrë njerëzit prej shtëpive të veta për t'i numëruar. Krishti lindi në një stallë, mes dimrit të ftohtë, dhe, fill mbrapa, shohim krijesat e Shtetit, të çmendur nga kryelartësia e fuqishme e Shtetit, ta dëbojnë të pafajshmin me një mospërfillje përbuzëse për jetën, edhe kur stina e zbutur u hapte njerëzve verën plot të mira. Dhe, tash, që dashuria për Atdheun është shndërruar në një lakmi për gjërat që ai ruan në vetvete, Shteti është kthyer në një mjet për t'i tërhequr këto gjëra nga ato që i përkasin, duke u bërë kaq i urrejtsëm, sa nuk ka qenë ndonjë herë.

Nga kjo kuptohet përse ata duan që, së bashku me rregullimin e qytetit, të bëhet edhe përtëritja e fateve të familjes¹⁹².

Zotni shumë i drejtë, në mes gjithë atyre që unë njoh, tash po ju pyes: Si venë ato dorë mbi shtëpiat që janë caktuar një herë? Kush i ka njohur për pronarë të këtyre veprave? Përse nuk e muarën autorizimin nga pronarët e shtëpiave? Mos të vijnë ata që nuk kanë shtëpi, të kërkojnë dhe të duan të hyjnë e të strehohen në shtëpitë e huaja, mbasi e dinë se kjo është vjedhje. Tërhiqen para fajit dhe preferojnë (parapëlqejnë), përkundrazi, të qëndrojnë po në ato kushte, megjithëse e dinë se kanë vetëm tokën e fortë. Në të vërtetë, mbasi kalojnë vuajtjet e përditshme, sëmundjet, dhe, së fundi, edhe vdekjen, që bashkon, në të njëjtën kupë, të pasurit dhe të varfërit, qetësohen me gjendjen e vet. Për këtë arsye, vetëm ata autorët e ditur të socializmit, në të cilin shumë të mirë do të humbnin, kurse shumë të këqinjë do të përfitonin, që nuk përfaqësojnë, sot, kurrkënd, vetëm ata kanë dëshirënvjedhjes, gjarpërinj që mëshehin kokën brenda vrimave të qytetit.

Porse ata bëjnë një punë të kotë.

Familjet që sot janë të pasura, nuk janë ato që ishin dje; nesër, në vend të tyre, do të jenë të tjera, mbasi pasuria është prodhim i punës. Po t'ua heqim atë atyre që e kanë sot, për t'ua shpërndarë atyre që nuk e vunë këtë pasuri brenda vitit (në mes të cilëve në radhë të parë rrinë këshilltarët e shpërndarjes), mbaron si e konsumuar, në pjesën më të madhe, dhe duhet të vihet përsëri në vend nga ata që e konsumuan; dhe, mbasi të gjithë nuk kanë as forcë, as mend, as vullnet të njëjtë, shpejt do të përsëritet, në mes të palëve, shpërpjestimi, për shkak të të cilit u bë ndarja e pasurisë që ishte më parë. Porse thonë: Duhet t'i

¹⁹² Po aty, Anno III, Nr. 11, Cosenza, 20 marzo, 1886, p. I.

jepet Shtetit kamxhiku në dorë për të goditur dembelat (përtacët), që mos të hanë e mos të vishen me mundin e të shkathtëve. Shteti i duhet lënë edhe vlerësimi i aftësisë së secilit, për të nxjerrë nga njeriu çdo gjë që ai mund të japë për ta bërë jetën të lumtur.

Dhe ne, duke lënë më një anë këtë robërim të pashoq në botë, të cilit do t'i nënshtrohej njerëzimi, pyesim vetëm këtë: Po kush është Shteti? Kjo Farë hyjnore, mes shokëve të jetës, që do të marrë përsipër masën e fatit të secilit, duke i dërguar ai vetëm si bari me thupër në kullosë. Dhe ky, që të mendojë se mund të përulë njerëz e kafshë në një fat të përbashkët të robëruar për ta bërë sa më të majme jetën në këtë tokë; e përse vegjelia mos të ketë pjesë në bukurinë e ëmbël të shpirtit të njeriut e në dritën e mendjes, në të cilën reflektohet ati (babai) i gjithësisë (i njerëzimit, i universit), që grumbullon të mira, do të përpiqet, në ditët që jetojmë ne, të paraqesë anën tjetër të mbulesës së jetës, anë në të cilën ne, si fëmijë të vegjël, shihnim gomarin që i rruante mjekrën zotnisë së vet (padronit), ndenjtur në karrige.

Ma fal, o Zotni, hidhërimin e zemrës.

Shtyllat e botës, që mbajnë mbi vete jetën njerëzore, janë krejt të ndryshme nga pasuria, që ndjek amëshimin (të pafundmen, pambarimin) dhe, përmbi të cilën, ka tjetër bukë në vetë qenien e njeriut, afër të cilit oqeani i jetës ose ngre tallaz, ose qetësohet. Kush mund të thotë se është në gjendje të dijë nëse çdo vit ka për t'i sjellë shoqërisë njerëzore kuotën e ushqimit dhe të kulturës, të caktuar për të gjithë; ose, përkundrazi, mund të mbetet e porealizuar ajo që pritet, mbasi vitet herë sjellin bollëk drithi dhe pemësh (begati), herë vere dhe vaji, ndërsa ndonjë vit tjetër, me gjithë punën e bërë, të lënë të uritur dhe me shpresë. Duken si kllapi! Dhe, mbi të gjitha, ndërsa fjala që ushton brenda nesh, që nga lindja, qëndron përjashta këtyre lakmive dhe konsiderohet nder (për zbukurim) për njeriun për të mos u bërë rob i këtyre interesave, që brenda vetëvetes kanë vdekjen. Dhe, nga kjo fjalë, qëndron tek ne bindja e palëkundëshme se as pasuria, as varfëria nuk i heqin gjë vlerës së njeriut. Më e shëndetshme është jetesa me bukë, me qumësht dhe me fruta, duke punuar në ajër të pastërt, dhe çdo shpirt i lartë për këtë nuk trishtohet, se sa me mish dhe me ëmbëlsira brenda në shtëpi.

Prandaj mundimi vetëm për pasurinë do ta lodhte dhe do ta trishtonte jetën tonë njerëzore kaq të lartë në botë. Perëndia i lirisë njerëzore do

t'i lirojë ata nga pesha dhe mundimi i çmendur, mbasi çdo njeriut, për një jetë të shëndetshme, i mjaftojnë të mira materiale të kufizuara që, pak a shumë, koha i sjell pa ndonjë kujdes të madh. Ai që i hapi qefe të guximshme jetës në bisedat me Átin, mallëkoi dëshirën e flakët për bukën e grumbulluar, që na robëron në një robërim të verbët (qorr). Dhe, mbasi gjinia njerëzore nuk i ka vënë vesh, sot jemi të trishtuar, pa ndonjë qëllim të dukshëm.¹⁹³

Dhe ai, i biri i Zotit, nuk bëri t'i bjerë buka prej qiellit, por edhe nuk desh që të vuanin nga uria ata që fati nuk ia sjell (nuk ia bjen) këtë, megjithatë nuk tha që t'ua grabisin të tjerëve nga duart. Për të lehtësuar lodhjen nga mungesat e njerit apo të tjetrit prej shokëve tanë bashkëudhëtarë në këtë jetë, qysh në lindje (që me të lindur) na u ngul në shpirt dhimbsuria, e cila, në të vërtetë, jep të njëjtin fryt sikurse japin ndihmat. Dhe, po të vërejmë rastet që na ndodhin, koprracia dhe ashpërsia me të varfërit dhe nevojtarët ndëshkohen, vazhdimisht, me humbje në pasuri, në sëmundje dhe në vuajtje të tjera me burim të panjohur, mbasi drejtësia njerëzore nuk ka se si ndëshkon kot pa dhimbsuri, ashtu sikur dënon fyerjet kundrejt të tjerëve. Dhe, nga qëndrimi si njerëz të dhimbshëm për të tjerët, ose të ashpër kundrejt të tjerëve, përcaktohen si njerëz të mirë ose të këqinj, dhe në përendimin e jetës secili ka për t'u cilësuar kështu: "Isha i çveshur e nuk më vishte; pata uri e nuk më dha të hajë e të pijë".

*I krishterë dhe me shpirtë nga
"Odî profanum vulgus et arceo".*

këto vjersha që të ngrejnë nga zhurma shurdhuese që sot i mbulon ato, dhe Zotërinë Tuaj që, megjithëse i tërhequr, asgjë nuk të tërheq nga Drejtësia.

Mirënjohës për mirësinë që Zotëria Juaj më nderon, Ju përsëndes me nderime:

Jeronim De Rada

¹⁹³ Në njëqind mënyra na u vu në dukje mbrothësia (lulëzimi) material i Amerikës republikane, si një kufi i jetës universale (të gjithmbarëshme). Ajo, vërtet, që si nxitje nga përfaqësitë, porse deri dje e mori lulëzimin nga mudi i robërve, që u shkrinë (u tretën, u konsumuan) duke punuar për të tjerët, dhe, nëqoftëse një pjesë e qytetarëve jetoj e gëzuar, gëzimi i saj vinte nga vuajtjet e dhimbshme të një klase të lënë mbas dore. Përkundrazi, në vende të tjera, po kjo nxitje, e bërë nga përfaqësitë, në mes të njerëzve të lirë dhe njerëzve të barabartë (të njëjtë), krijoi një popull servil që, vazhdimisht, "mbledh fortunë".

27. ZOTIT MARK ANTON KANINI¹⁹⁴

Më vjen shumë keq që ju të vuani nga kundërshti për shkakun tim dhe jam i detyruar t'i bëj ballë unë zemërimit të hapur të helenëve. Libri i Z. Kapiomont, që u botua në interes të Greqisë dhe për të ndihmuar veprimin diplomatik të Vadigtonit, nuk ka asnjë vlerë, përsa i përket Epirit. Ky, i kthyer aso kohe nga Greqia, ku kishte shkuar, nuk di si antikuar apo si përfaqësues i Francës, i dukej oportuniste si mjet shumë i përshtatshëm për t'i hapur rrugën aleancës me Rusinë, aleancë kjo që e caktonte Shqipërinë e rrejtur si plaçkë tregu për t'u ndarë midis satelitëve të tyre: Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. As më vonë nuk ishte qetësuar, megjithëse kish qëndruar jashtë traktatit të saj të Shën Stefanit; as sot nuk di të thotë se ç'kërkon, e angazhuar, siç është, tash, së fundi. Prandaj, gazetat e saja mallkojnë Bullgarinë që po nxitohej. E. Vadigtoni e braktiste, atëherë, traktatin e Parizit, bënte kërkesa për trashëgimtarët e helenëve; dhe, si mbrojtës i katolicizmit, u caktonte mirditasve një pozitë të ndarë Shqipëri, duke i larguar nga Lidhja / Shqiptare/. Prej këtej del e qartë dhe shpjegohet simpatia që tregon, edhe tash, e përkohshmja “Revue des deux mondes” për Greqinë e përkohshme që është bërë sot mikluese plot pretendime për të.

Ndërsa, nga çdo njeri, qënjuh, pak a shumë, botën e lashtë dihet, fare mirë, se Epiri nuk ishte vend grek, dhe mbreti i tij, Pirroja, për grekët ishte “i huaj”. Më vonë, Princi i kalorësve të kohës së mesme, shqiptari Skënderbé quhej *Epirotarum Rex* (mbret i epirotëve) dhe me këtë titull njihej si nga historianët ashtu edhe nga diplomatët bashkëkohës. Myzeqeja, që ndodhet në Epir dhe prej nga ne jemi shpërngulur, ruan edhe tashti emrin Arbëri, dhe né arbëresh quhemi. Në Vulën Unixheniti të Klementit XII që, më 1735, themeloi Kolegjin

¹⁹⁴ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 5, Cosenza, 15 maggio 1887, p. V.

arbëresh, shqiptarët janë quajtur epirotë (njerëz epirotë, popull epirot). Po ashtu edhe Regjimenti Mbretëror Maqedon, që ishte në shërbim të mbretërisë së Napolit, që në vitin 1820, përbëhej prej shqiptarësh; edhe Marko Boçari bëri pjesë në atë regjiment.

Këto janë fakte të vërteta që i kemi parasysht.

Sa për përhapjen e paktë të “*Fiamurit të Arbërit*” në Shqipëri, kjo nuk rrjedh nga unë. Dhe për këtë s’duhet të shqetësohen. Por ajo që i ka shqetësuar dhe po i shqetëson ata, janë tashmë, efektet me rëndësi që bëri “*Fiamuri Arbërit*”, që sapo është ngritur. Sepse Porta e Lartë ka marrë vendimin e urtë t’u japë shqiptarëve të saj shkolla në gjuhë të tyre; sepse janë ngritur deri brenda, në thellësi të tokës greke, komitete për lëvrimin e kësaj gjuhe, së cilës mbretëria greke nuk do t’u dëgjojë zërin; sepse Epiri, i ftuar që të ngrejë kryet për t’u bashkuar me grekët, i vështroi ata gjithmonë me zemërim dhe s’luajti.

E meqë e ardhmja më e drejtë është në dorë të Zotit, gjithmonë, shpresojmë, do të vijë dita, që kësaj reviste të vetme të popullit pellazg /shqiptar/ dhe të braktisur si ai përballë kaq shumë fletushkave greke, do t’i përshtatet vargu i bukur italian:

“*Horaci i vetëm kundër gjithë Etrurjes!*”.

Miku juaj mirënjohës dhe shumë i devotshëm,
Jeronim De Rada

28. THIMI MITKOS¹⁹⁵

Bashkatdhetar e vëlla, Zoti Mitko

Mos u mërzit për fjalët që i hëngri Abramidhi. Unë atë e kam parandjerë prej shumë kohësh, kur pashë se po shkonin ditët e nuk po ndiqej rruga e drejtë; e parandjeva dhe e thashë.

Kur unë nxora të përkohshmen shqipe /*Fiamuri Arbërit*/, asgjë nuk dihej për Abramidhin; e, megjithatë, një shpresë gëzimi, do të thoshja, e përshkoi gjithë popullin tonë, mbasi e pa të ngritur flamurin e vet. Dhe nuk u gënjem së bashku. Nga ajo e përkohshme Turqia pa qartë se Greqia po i helenizonte shqiptarët, me qëllim që t'i quante, pastaj, të farës së vet /si popull apo gjind të saj/ dhe se i hilej, prandaj, Europës që t'ia hiqte Turqisë dhe t'ia kthente asaj. Prandaj Sulltani urdhëroi, pastaj, që në shkollat e qyteteve tona (shqiptare) të mësohej gjuha e tyre /amtare/. Në atë të përkohshme, bashkëkombësit tanë panë, të shkruar e të bukur, gjuhën e tyre, edhe nëse ndonjë prej tyre i kishte besuar helenëve që çirreshin se s'kish gjuhë shqipe dhe u ofronin të vetën, tashmë, plakë dhe pa gjak. Dhe u ndez dashuria për gjuhën e magjepsur të mëmës sonë. Dhe /nga kjo dashuri/ edhe Abramidhit, pastaj, iu ngjall dëshira që të tregohej bujar (fisnik) ndaj atdheut të vet. Ajo e përkohshme bëri, pastaj, që sytë e Europës drejtoheshin me një interesim më të madh, nga kombi ynë. Për nderin e emrit tonë, thomi për të vetëm këtë: “Ai nga djepi qe çuar në varr”. Dhe sot i drejtojmë sytë e marrim frymë në atë vend, ku është shpalosur edhe sot e kësaj dite *Fiamuri / Arbërit*/, shenjë besimi për ne.

¹⁹⁵ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 5, Cosenza, 15 maggio 1887, p. IV.

Pastaj, ç'do të ishin për Shqipërinë tonë një ose dy mjekë ose edhe një tjetër dijetar, përkundrejtë dritës e dashurisë për atdhe, që një e përkohshme, e frymëzuar nga shpirti i drejtë i Zotit tonë, merr dhe e përhap në jetë, pastaj ndër krahinat tona, ose përkundrejtë shëmbëlltyrave (përfytyrimeve) të një jete fisnike, që e përkohshmja jonë paraqet, me qëllim që të rinjtë, në shtëpitë tona, sot e pastaj duke u asimiluar, të bëhen më të bukur?

Ndoshta qe më mirë kështu. Që kur dolën në skenë këto komitete, Shqipëria duke u besuar sërishmi atyre po e le, si pas dore *Fiamurin / Arbërit/* (ia solli krahët kësaj së përkohshmeje). E, pra, gjithë shpëtimi asaj nuk i vjen nga Rumania o nga të huaj të tjerë, por nga bijtë e vet që ajo ka në Itali, mbi të cilët Helada nuk mund të ndikojë aspak, as ndër shkollat e veta që asaj ia dha Sulltani.

J. De Rada

29. SHKËLQESISË SË SAJ PRINCESHËS ADELE PINJATELI STRONGOLI

ZONJË E OBORRIT TË MADHËRISË SË SAJ, MBRETËRESHËS MARGERITË¹⁹⁶

Është një ditë tepër e lumtur, për mua kjo, kur Ju Zonjë po jepni pëlqimin që unë të Ju kushtoj *Sofonisben*.

Nuk është tronditja që rrjedh nga nderimi që njeriu dëgjon se i bëhet, kur një mendje e kthjelltë dhe e pajisur me kulturën më të zgjedhur, ndalohet dhe merr në konsideratë me dashuri ndonjë vepër të tijën, por është ajo ndjenjë dalldie që më pushton nga besimi që më jepet. Sepse Perendia, Princeshë e përndritshme, ka krijuar me personin Tuaj një mbështetje për shpëtimin e popullit tim.

Ju e keni marrë vesh se unë, me një punë që vazhdon prej më tepër se një gjysmë shekulli, kam rimëkëmbur gjuhën shqipe, me qëllim që të përgatisë ringjalljen e pashmangshme të popullit tim, dhe për ta veçuar (për ta ndarë) këtë nga fqinjët, që me mënyra të djallëzuara kërkonin ta futnin në kurthe duke lakmuar shtëpitë e tyre dhe shpirtrat e tyre, arrita të ngre *Flamurin* e vërtetë dhe të bekuar të saj, por, mbasi ku u godit nga një magji keqbërëse dhe u kundërshtua nga djalli, që e përndjek kombin tonë pellazg /= shqiptar/, e pashë që më ra nga dora.

Zhdukjen e tij e shoqëroi gëzimi i fqinjve të Shqipërisë, sidomos i Heladës (= i Greqisë). Ata ishin bashkuar, në mënyrë të fshehtë, kundër popullit tonë, duke vepruar prej shumë kohe së toku, për ta paraqitur si një popull të egër, mes malesh të pakapërcyeshme, pa gjuhë, që as nuk do të kuptohej se çka kërkohet prej tij, dhe, duke bërë kështu,

¹⁹⁶ *Sofonisba*, A. Bellisario&C-R. Tipografia de Angelis, Portamedina alla Pignasecca, 44, Napoli, 1891.

t'ia paraqesin gënjeshtar botës së krishterë që, në këtë mënyrë, do t'ia dorëzonte, si vend jomikpritës, atij që, duke punuar si njeri, do të siguronte bukën dhe paqen me ndihmën e Zotit. Ata mbetën të prekur, ndër ato tri ose katër vjet, që ajo (Zonjë) foli dhe tregoi arsyet e veta; por, fill mbasi heshti organi, që e mbronte, e quajtën për të humbur. Rifilluan punën dhe, herë mbas here, u përpoqën të luajnë pjesë teatrale, duke pasqyruar atë çka për ta dukej stoli e madhe qytetërimi, dhe e denjë për atë të cilit do t'i lihej në dorë Shqipëria për ta pasur në mbikëqyrje.

Por, atëherë, Perëndia qëndroi pranë Atdheut tonë të pikëlluar, mbasi bijtë e tij, më të mëdhenj, sakrifkuan pozitat e tyre, gjendjen e vendin e tyre të gëzuar e sakrifkuan për birin e tij (Zotit). Vetëm ai – dhe nuk e dimë për cilën arsye – e bëri të fitonte simpatinë aq bujare edhe të çiltër tuajën, që keni lindur nga njerëz shumë të mirë e të nderuar dhe të afërm të frontit të Italisë, që na shpëtoi në të dalurit nga sigurimet dhe që, edhe sot e kësaj dite, na mbron. Përsëri tash, kjo mikpritëse e dashur, me ndërmjetësimin Tuaj, na ka ndihmuar për ruajtjen tonë, dhe i ka hapur gjuhës shqipe, mbrojtëse e vetë ekzistencës sonë dhe kundër së cilës po bëhet një luftë kaq e madhe, një shkollë në Kolegjin që, në gji të Italisë, është një i vetëm për në botë.

Në këtë fatbardhësi që kemi dhe në këtë paqe që na vjen në mënyrë të dukshme nga Qielli, unë mendova, Zonjë, se është koha të paraqesim edhe ne diçka që përkon në mënyrë besnike me jetën tonë. Dhe nëqoftëse kjo shfaqje do t'i vete mbarë të mundet Europa të na krahasojë me ata që preferojnë (pëlqejnë) ato që ne duan të na shohim të shkatërruar “deleti”. Dhe, këtë shfaqje e sprovova unë i pari, duke e shndërruar në një tragjedi njerëzore që e tronditi dhe trondit zemrën e njeriut, me të cilën fiton pjesën më të madhe të lavdisë së vet të pashoqe ai që qe kombi Juaj, o Zonjë shpirtmadhe. Aty brenda kam pasqyruar shpirtin shqiptar të thjeshtë “morata recte” (që paraqet besnikërisht karakteret, tipare – Horaci) dhe e bëra të flasë – e si mund të veproja ndryshe unë? – gjuhën e vërtetë e të qartë shqipe. Dhe e dija se ajo s'do të puthitej me synimet e mia si diçka që tani është e huaj për të gjithë, megjithatë e bëja duke shpresuar se, më vonë, do ta përktheja në gjuhën e njohur italisht, që na flitet për rreth, dhe që në gojën Tuaj, Princeshë shpirtlartë, është si një muzikë që na pushton zemrat.

Në të vërtetë, unë nuk munda, pastaj, ta shndërroj, në melodinë e italishtes, frazën aq të pështjelluar të gjuhës sonë të vjetër dhe të pajisur me përkulshmëri; dhe, pikërisht kjo veçori, shqetësuese si turpi, pasqyron prejardhjen e huaj. Sot vepra është e gatshme (e kryer); dhe, sikur nëna i dorëzon djalit të vet të ri shpatën dhe mburojën për të dalë në mbrojtje të vendit të vet, ashtu edhe unë po i jap udhë, duke pasur besim në drejtësinë, dhe duke uruar që të kem përkrahjen e shpirtit tuaj të lartë, në paraqitjen, para këshillave të Europës, të cilësisë së racës pellazge /= të popullit shqiptar/, dhe edhe sikur të mos jetë mëkat shumë i rëndë që lopët e dobëta, që dolën të fundit nga rrjedha e kohës, të përpijnë ato që i gjejmë duke kullotur të qeta, në vendlindjen e tyre.

Me respektin më të madh kam nderin, Princeshë shumë e mirë, të më quani

Shërbëtor i Juaj shumë i devotshëm dhe shumë i detyruar kundrejt
Jush.

Jeronim De Rada

30. A G. C. BUGLIARIT¹⁹⁷

Letër Xhan Krizostomo Buljarit

Shumë i dashuri im, Xhan Krizostom

4 korrik 1893

Thirrja juaj që i bëni Skënderbeut, është bërë në një italishte të mirë, e pa të meta. Por sot nuk vlen ta përkujtojmë atë: për ta risajuar atdheun, është e nevojshme t'ia vemë në pah vlerën që ka, duke edukuar mendjen e zemrën dhe ta bëjmë të denjë për shoqërinë e kombeve të qytetëruara. Kësaj do t'i arrijë me kulturën (me lëvrimin) e gjuhës së vet, dhe me studimet klasike e kristiane. Përsa u përket turqve, ata sot nuk i shtypin, por i shohin me sy të mirë shqiptarët, tek të cilët mbështeten.

Jeronim De Rada

31. A G. C. BUGLIARIT¹⁹⁸

Letër Xhan Krizostomo Buljarit

Shumë i dashur, Dom Krizostom

7 tetor 1894

Ju falënderoj për fjalët e përzemërta që keni për mua, e shpresoj se nuk do të harroni mendimet (ndjenjat) e mia plot dashuri për atdheun tonë të gjorë dhe plot besim.

Jeronim De Rada

¹⁹⁷ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 53.

¹⁹⁸ Po aty.

32. THIRRJE SHQIPTARËVE-PELLAZGË TË ITALISË DHE JASHTË SAJ

Greçi di Pulia, gusht 1895

Vëllezër, të shpërndarë, të Shqipërisë!

Një popull që nuk shkundet ose që nuk jep shenja jete, të paktën në punët e veta të rëndësishme, është një popull i vdekur! Jo, kjo njollë kaq e vajtueshme dhe e turpshme, më në fund, duhet të shlyhet nga kujtimet tona të atdheut, o /bashkatdhetarë/ bij fatzez të mjerë dhe të mërguar të Epirit!

Po, dhe është pikërisht për këtë arsye, që, për t'i përforcuar disa *fakte* të rëndësishme mbi fatet tona, dhe, kryesisht, mbi lavrimin dhe kombësinë e gjuhës sonë të *hyjnueshme*, nga shumë atdhetarë tanë të Italisë është menduar njëmendjeje, së toku, që të mbahet një Kongres kombëtar, me njerëz tanë të shquar, në tokët e *Vullkanit*, duke pasur si qendër Kalabritë. Dhe, prandaj, me gëzim, më 10 të muajit të ardhshëm /të shtatorit/, në Koriljano Kalabro, vend mikpritës për ne, ju ftojme, me bujari, që të merrni pjesë e të interesoheni për një Kongres, në të cilin, ndoshta, mund të vendosen, në pjesën më të madhe, fatet e atdheut tonë!

Oh! dhe cili jush nuk ka një zemër që të mos rrahë nga dashuria e ngrohtë dhe, njëheri, nga pikëllimi për fatkeqësitë e popullit të vet? Cili nuk ka edhe një ndjenjë mëshire për vëllezërit tanë të mjerë, të shkapërderdhur, të ndarë, ose që fshajnë nën prangat e skllavërisë?

Vëllezër, shqiptarë të gjithë! Guxim, pra, dhe përpara! Zoti i lëviz popujt! Të interesohemi, pra, të paktën për një kauzë të drejtë dhe të shenjtë të një populli përpara Europës së kulturuar dhe të qytetëruar! Dhe, në vetvete, me këtë rast të volitshëm, duke u vëllazëruar së bashku, edhe sikur të jetë nevoja për sakrifica nga ana jonë, në Koriljano Kalabro, me solemnitet shpresojmë të përqafohemi rishtas, duke

zbatuar kështu, edhe qëllimet e Qeverisë, e cila dekretoi themelimin e një Katedre të re të shqipes në Itali. Do të jetë kjo, me siguri, një tjetër faqe e lavdishme për t'iu shtuar historisë sonë, dikur aq e ndriçuar dhe e nderuar nga pellazgët tanë, të vjetër e të rinj!

Ja, në kaq, programi apo rendi i ditës, /që do të diskutohet dhe të miratohet/:

- a) Vendosja e një alfabeti shqip, të vetëm e të njejtë, që mungon.
- b) Hartimi, së bashku, i një fjalori shqip-italisht dhe anasjelltas.
- c) Themelimi i një të përkohshmeje të ré, që të trajtojë /çështje/ të gjuhës dhe të kombit shqiptar, me një pjesëmarrje më të madhe bashkëpunëtorësh.
- ç) Së fundi, të merren masat për të përhapur në mëmëdhe, rezultatet e studimeve tona, me qëllim që të ndiqet një aksion për një qytetërim të përbashkët, me ngulimet e saja të tjera /arbëreshe/ në Itali.

Ata që do të kenë mirësinë të marrin pjesë, janë të lutur që t'u njoftojnë të nënshkruarve.

Për Komitetin:

Prof. Kavalier (Kalorës) Jeronim De Rada

Prof. Luixhi Lauda

33. FJALIM (përrurimtar)

Mbasi mbaruan formalitetet paraprake, kryetari i Kongresit /gjuhësor/, Kavalier (Kalorës) De Rada, në mes duartrokitjesh të përsëritura, mban fjalimin inaugural në gjuhën shqipe. Tregon mënyrën se si do të veprohet në diskutimet nga Kongresi, sipas rendit të ditës, duke shpjeguar dhe duke vënë në dukje rëndësinë shumë të madhe që u duhet dhënë studimeve të gjuhës e të letërsisë shqipe, që është, nënshtresa e parë e çdo kombësie. Thekson, në kalim, nevojën, me të cilën duhet respektuar *status quo*-ja (gjendja e sotme) politike në Shqipëri, si ajo që, ndër kushtet aktuale, jep garancitë më të mira për kombësinë: çdo popull tjetër i huaj do ta mbyste dhe do ta zhdukte.

20 shkurt 1897

34. FJALIM¹⁹⁹

Duke pasur parasysh se mund të shpërthejë lufta në Lindje, shumë sy e kanë sy e kanë drejtuar vështrimin nga ky Kongres shqiptar.

Unë besoj se mund të thom, në emër të ju të gjithëve, që mëmëdheu ynë nuk don gjënë e huaj, don veçse të mos realizohen dëshirat e fqinjëve. Don vetëm që të mos i merren tokat e saja. Dëshëron të ketë paqë e liri të plotë, që të lavrojë gjuhën amtare, të mbajë shkollat shqipe, të ketë libra, tregti të hapët, vende mike, ku të kërkojë përhapjen e mirëqenies së saj. Dhe, në krye të të gjithave, që ajo e don të harmonizuar është ajo që të mund dhe të dijë t'i përdorë për vete e për kamjen e saj. Përsa u takon fateve që na vijnë shpejt, ne kemi besim të plotë se Zoti në qiell do t'i sjellë, si gjithmonë, drejtësinë dhe virtytin.

Jeronim De Rada
21 shkurt 1897

199 Diskutim në Kongresin e Dytë Gjuhësor Arbëresh të Lungros (21 shkurt 1897).

35. ZEF SQUIROIT²⁰⁰

30 korrik 1897

Kur dikush ka përpara shumë gjellë të preferuara, don që atë më të mirën ta ruajë për të fundit. Sipas kësaj mase njerëzore, ju do të merrni, tashti, me vonesë, falënderimet e mia.

Unë e mësova prej jush atë fjalë, që do të mbetet si një shpërblim i jetës sime plot mundime, mbasi që Engjëll Bazile, më 1847, me kushtimin e vet /mbi veprën e tij/ *Ines de Castro*, e gjallëronte këtë që ishte e pasigurtë për vetveten në udhëtimin e tij.

Libri, nga të pakët që njohim në këtë fshat të vogël, më qe marrë, pothuajse, për duarsh; por ky është ai që duhej sot, dhe unë e kam theksuar (rakomanduar) në një artikull mbi të ardhmen tonë, që do të dalë (do të botohet) në numrin 12 të /së përkohshmes/ “Nacione Albaneze” (Kombi shqiptar). Brenda pak kohe, do të bëj që /çështja/ të trajtohet me themel, dhe të caktohet me detyrim blerja nga anëtarët e të dy shoqërive shqiptare, kulturore e politike.

Më lejoni të ju njoftoj se Greqia don ta shpërblejë Turqinë, dhe pjesët e saja t'i ndajnë shtetet e krishtera, duke copëtuar më së pari Shqipërinë.

E, meqenëse Greqia qe mundur prej shqiptarëve, shtypi i shitur e pa Zot, tashti, përdoret, me marifete të këqia, që të bëjë që Shqipëria, të hyjë në vend të Greqisë, në luftën kundër Turqisë, për ta shtënë në dorë të vetë, mbasi të jenë dërmishur mirë.

Mos e hiqni dashurinë prej meje.

Juaji shumë i devoçëm,
Jeronim De Rada

²⁰⁰ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

36. KONTIT ENJËLL DE GUBERNATIS, DREJTOR I REVISTËS “VITA ITALIANA” (“JETA ITALIANE”)²⁰¹

Maqë arbëreshe, 15 gusht 1897

Por, pse Zotëri shumë i mirë dhe mik imi, vazhdohet të caktohen pjesë dhe të copëtohen tokat e Turqisë, ashtu siç veprohej në kohën, kur pritej zhkatërimi i saj?

Ajo doli fituese dhe shëndoshë e mirë, dhe nga lufta, në të cilën e tërhoqën, dolën të qarta edhe dy gjëra, në kundërshtim me dëshirat:

1) Se krahinat e saja i qëndruan besnike, dhe, nëqoftëse do t'i kënaqë, duke u dhënë autonomi brenda një federate të drejtë, do të zërë një vend në mes të fuqive të klasit të parë;

2) Se Shqipëria, që konsiderohej si e përçarë sipas feve dhe fiseve në luftë mes tyre, po përfytohej ëndrra e së ardhmes, shkëputja e saj nga Perandoria dhe ndarja e copave të saj mes fqinjëve të përbetuar të pangopur. Shqipëria, e bashkuar nga ndjesia e ruajtjes së vetvetes, doli një dhe e fuqishme në shpirtin e saj të vetëm kombëtar.

U duk përsëri në të /d.m.th. në Shqipëri/ gjaku i shokëve të Lekës së Madh, dhe u njoh nga kjo gjuha me një shprehje të pakrahasueshme. Lufta që për të një palestër, prej nga ajo doli shumë e dalluar për trimëri ushtarake, dhe e gëzuar, sepse e kuptoi që, brenda një kohe të shkurtë, do të shihet se dhe në prodhimtarinë (krijimtarinë) gjeniale të gjuhës së saj i kapërcen shumë disa cuba harbutë, që e kërcënojnë.

Tash, të gjithë e shohim se kjo forcë e Perandorisë dhe ky gjak i Shqipërisë, nuk janë faktorë që venë në rrezik paqen në Lindje, për të cilën kanë kaq nevojë Fuqitë europiane.

²⁰¹ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

Dhe nuk është e qartë (nuk kuptohet) se ku duan të dalin (ku duan të mërrijnë) ato me këto mbledhje të zgjatura. Sigurisht, është një e drejtë e tyre të kërkojnë mbajtjen e qëndrueshme të *suatu quo*-së, të kërkojnë që Turqia të zbatojë në tokat ku sundon ajo, reformat civile, që premtoi në Berlin, me të cilat Fuqitë e Mëdha duke e shtrënguar siguruan paqën shpëtimtare.

Por që të bëhen helenët (grekët) arbitra mbi shtetet e tjera, këtë të drejtë nuk ia dhanë as Zoti, as njerëzit; këtë ia njohin vetëm disa zhkarravitësa të paguar, që e nxjerrin gjuhën – cilësi tjetër nuk kanë – në mbështetje të tradhtive të fshehta, sepse jo drejtësia do t'i shtynte që të zbulojnë vullnetin e keq të njerëzve të njohur si të këqinj, si p. sh. të Helenisë (Greqisë), që duke u lënë e lirë të jetojë mbas disfatave që i provokoi (i nxiti, i ngacmoi) ajo vetë, i kërkon rishtas mbasi ka humbur Artën, Thesalinë, etj., që po ia rikthejnë Fuqitë e Mëdha, mbasi ato ia kishin dhuruar.

As drejtësia, as kuptimi i drejtë nuk mund t'ua këshillonin atyre një marrëzi të tillë. Ndërsa është, tashmë, e ditur se, duke pasë qenë dorëlëshuar me Heleninë (Greqinë) kryelarte dhe pas asnjë meritë, e bënë që të prishë paqën (turbulluese të qetësisë). Dhe, po të vazhdohet me këto dhurata pedante ose me pasion, do të përjetësohen turbullimet në Lindje, të favorshme për Perandoritë, që kanë humbur fenë e krishterë.

Por, edhe në qoftë se veprohet *sipas qejfit (a libito)*, ne që besojmë në zotin, po ia përsërisim Perandorisë Osmane se është nevojë jetësore për të që të bashkohet në provinca të federuara, që do të ishin të kënaqura në drejtësi dhe në zotërimin e vërtetë të pasurisë së tyre.

Kështu ajo (Perandoria Osmane) do të përfaqësojë vetveten, dhe, atëhere, në kohën e ardhshme, kur shqiptarët mund të jenë për të, siç janë, sot, maxharrët për Austro-Hungarinë, valët e fryra që duke u përplasar për shkëmb, thyhen e bëhen thërmi në ujë.

Më fal, Zotni Kont shumë i shndritshëm, mbasi është dashuria për Atdhe që, ndoshta, vlerësimet e mia i bën të ndryshme nga tuajat.

Me shumë nderime dhe devocion, yti
Jeronim De Rada

37. ANSELM LOREKJOS²⁰²

. . . Vetëm nuhas me kënaqësi që Shqipëria po shkon duke u qetësuar në gji të Perandorisë turke, sipas këshillit të urtë që ju keni bërë të përfitojë.

Që Shqiptarët e mëmëdheut, të të parëvet, Shqipërisë, të munden sot, të konspirojnë për ringritjen e Princit Skanderbeg, ose në një aleancë me Malin e Zi, do të ishte marrëzi për t'u marrë me mend.

Maturia e vendosur shpëtimtare dhe urtësia le të jenë qëllimi i së përkohëshmes suaj të shquar. Deri sa koha të jetë pjekur, letërsia kombëtare e lindur do të pengojë që shqiptari të mos ngatërrohet (ndërlikohet) kurrë me turkun.

Duke qenë e afërt koha që unë të përkulem nga vdekja e birit tim, nuk e di në se do të qëndroj më gjatë. Juve ju uroj jetëgjatësi, lumturi dhe shëndet. Unë kujtoj, gjithmonë, si një bekim të Zotit, ditën që pata nderin të ju njoh dhe të vë shpresat e mia në shtëpinë tuaj fisnike, së cilës i përsëris urimet më të mira.

Jeronim De Rada

²⁰² *La Nazione Albanese*, Anno I, Nr. 1, 15 gennaio, 1898, p. 8.

38. ZEF SQUIROIT²⁰³

Letër Zef Skiroit
15 mars 1898

I ndritur zotni dhe mik

Po ju lutem edhe një herë që të mos më vini faj për mungesën time, që vjen jo për tjetër veçse nga çrregullimi i jetës dhe i fatit tim.

Megjithëse isha mjaft borxhli ndaj jush, ju i shtuat një ngushëllim të ri të shkëlqyer jetës së pakët që më ka mbetur.

Elegjia (vajtimi) juaj, botuar në /të përkohëshmen/ “Nazione Albaneze” (Kombi shqiptar), do të mbetet i vetmi epitaf (mbishkrim) i vërtetë mbi varrin tonë. Verë Baronesha /Jozefina/ Knorr, poeteshë aq gjeniale, ka mbetur e prekur thellë, plot mbresa, përshtypje). Dhe ky është një lavdërim që s’e ka shoqen.

Mbështetemi te zoti dhe tek Atdheu.

Ju lutem të pranoni nderimet e mia më të devotshme,

Miku juaj shumë besnik,
Jeronim De Rada

²⁰³ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

39. I NDERUARI ZOTNI KOMENDATOR R. KAVACCA²⁰⁴

Letër Të ndritshmit Komendator R. Kavacca,
Komisar Mbretëror pranë Institutit Lindor, Napoli

Maqe arbëreshe, 7 nëntor 1900

Nuk di si t'ju falënderoj për kumtimin, me të cilin më keni nderuar. Me themelimin e një katedre të Institutit Lindor në Institutin Mbretëror të Lindjes vërtetohet se ne jemi të dalluar e të ndarë nga çdo tjetër Institut.

Vlerësimi që i bëni ju, gjyqtar i shkëlqyeshëm, që e pranon (njeh) rëndësinë e këtij fakti, qëndron si një bekim për veprimtarinë e zhvilluar gjatë jetës sime, që mund të përmblihet *në lavrimin e gjuhës amtare*.

Unë kam qenë dhe jam i bindur, se ky lavrim i gjuhës shqipe, përveç se mban lart ndjenjat kombëtare, ndoshta ndriçon me historinë e njerëzimit, një vend të braktisur, të vjetër, pellazg. S'ka dyshim se dëshira dhe urimi i ngulimeve tonanë Itali siedhe ato të Kongresit XII Gjuhësor Botëror, drejtuar Italisë, duke kërkuar që të caktojë, ndër disa Universitete të sajat nga një shkollë të gjuhës shqipe, frymëzoheshin nga ky objektiv i dyfishtë.

Ndoshta, vërtet, vazhdojnë të qëndrojnë arsyet, për të cilat bën aluzion Zotëria juaj shumë e shndritshme, lidhur me paaftësinë time për t'iu shmangur detyrimeve të shkollës që, karriera ime e gjatë në vazhdim siedhe opinionin e përgjithshëm, ma kishin besuar dhe Zoti këtë e desh për të mirën time. Kam besim të patundur se ai (zoti) do të bëjë që tek unë të vazhdojë aftësia, sikurse tash gati tri të

²⁰⁴ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

katërtat shekulli, duke i folur kombit tim në gjuhën e vet, të cilit ia kam përtërirë vetëdijen e vet, dhe do të më ndihmojë, duke më dhënë mjetet për botime të tjera *broshurash* të përshtatshme, qofshin këto të vjetra ose të reja, për t'i shërbyer atij.

Dhe tashti po marr, si shpërblim, nga zoti këto marrëdhënie me Ju, që po më çelin dhe po më ngushëllojnë.

Ju lutem pranoni, si shenjë e mirënjohjes sime, një kësombëll (kopje) të tragjedisë sime "*Sofonisba*", të cilën shpresoj ta ribotoj vitin e ardhshëm, duke i vënë në ballë shqipen, prej nga është përkthyer, duke uruar që të jetë shfaqja e parë e teatrit të ardhshëm në Shqipëri.

Pranoni ndjesitë e mia të respektueshme, i devotshmi juaj,
Jeronim De Rada

40. MIKELE MARKIANÒIT²⁰⁵

Letër e Jeronim De Radës dërguar dijetarit arbëresh

Mikele Markianòit, në Paola.

Maqë, më 13 prill 1901

I dashuri dhe shumë i miri kushëriri im

Shpresoj se do të m'i falni të metat e mia, të cilat, në pjesën më të madhe, e kanë burimin në gjendjen time të keqe.

Që atë natë që më vdiq Rodrigoja nga pika s'mbaj mend gjë nga e kaluara, dhe, edhe tash, vazhdimisht, nuk më kujtohet çka ndonjëherë vë o ruaj dhe ku e ve.

Shqetësimi që ndiej kur më vonohen pagesat (rrogat) mujore nuk mbaron kurrë. Për dy gjashtëmujorët, tetor-dhjetor dhe janar-mars, m'u pagua më 2 prill rroga e vitit 1900; për tjetrin as nuk u kujtua kush se kishte skaduar dhe jetoj me vështirësi (me halle e me derte) dhe në mjerim. Shumë nëpunës të Qeverisë nuk më shohin me sy të mirë, edhe pse jam shumë i drejtë dhe shumë i ndershëm; prandaj në periudhën IV të *Autobiologjisë* (fq. 13) sime e pata përcaktuar *Shtetin me përfaqësi si livrizën e vendit, që na është imponuar*.

Ka pastaj, gati, një vit që po merrem, gjithënjë, me ripunimin (përpunimin) e dy këngëve të para të poemës *Serafina Topia*.

Dhe si ta kem mbaruar të parën, uroj që kjo poemë të zërë vendin e parë në mes të veprave të mia. Por, pastaj, trazimet e shumta ma ndërprejnë veprën; për dy muaj, unë nuk munda të sajoj një histori të re në këngën e parë të librit të dytë, derisa, pas kungimit të javës së madhe, krijova, me trup e me shpirt, dy këngët e para. Nuk mund

²⁰⁵ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

të më gjykoni me drejtësi, po nuk e lexuat edhe një herë këtë poemë time të fundit të reformuar (ripunuar). Aty pasqyrohet një faqe e jetës, e ndryshme dhe e vetme, mbas asaj që paraqiti (që na ofroi) Homeri pagan.

Kështu, nuk kam mundësi më të vazhdoj biografinë që do të kishte tri pjesë (anë).

Po ju shënoj vetëm punën, që i kushtova fraksionit (vendit), ku u linda, si këshilltar bashkie (ose këshilltar i komunes):

- 1) Mora përsipër të blej një pjesë të tokës së S. Mauros – 240 tomolate (matje agrare), tokë shumë e mirë, kundrejt Vakkariccos, dhe e shtina në dorë.
- 2) Kërkova që të më ktheheshin si shpagim më tepër se 200 tomolate tokë, grabitur nga Kolegji, dhe fitova kundër D. Antonios.

Bëra një mbrojtje të pashoqe të Makit plot me jetë për të dhe për Shën Dimitri Koronën.

Më dërgoni listën e veprave të mia, që keni ju.

Kushëriri juaj shumë i devoçëm,
Jeronimi

41. ANSELMO LOREKIOS²⁰⁶

Letër e Jeronim De Radës drejtuar Anselm Lorekjos
më 31 janar 1902

Kartë më të denjë për mençurinë tënde, nuk mund të kishte për mua, se sa kartolina që më njofton ringritjen e flamurit tonë nën mbrojtjen e Princit Kastrioti, mbasi vjen pikërisht kur lipset për gjendjen e kolonive tona në Itali.

J. De Rada

²⁰⁶ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

42. ANSELMO LOREKIOS²⁰⁷

Letër drejtuar Anselmo Lorekios

Zotnisë
të ndritshëm dhe bujar,
Kalorësit Anselm Lorekio

Miku im i ndritshëm dhe bujar
Maqë arbëreshe, më 5 prill 1902

Më ka ra në dorë një letër e Çezar Kantu-it, i cili shtron për bisedim gjendjen e Shqipërisë, gjendje edhe atëherë e njëjtë me gjendjen e tanishme. Sikurse sot, edhe në atë kohë unë nuk shihja ndonjë zgjidhje tjetër. Aq më tepër se po i imponohet çdo ditë e më tepër Turqisë, që po zhduket, mbasi e pat tërhequr deri në fenë e saj, dhe u ngjall shpresa batakçinjve të huaj dhe se ata, duke luftuar mes tyre, mund të ruajnë dhe të lenë për vete toka e qytete të lulëzuara që kanë këto vende.

Vërtetë se autoriteti i Kantuit është i madh, porse besoj se gjendja jonë dhe e Europës na këshillojnë sot t'i përmbahemi me këmbëngulje proklamates së thjeshtë të princit A. Kastrioti: "*Jashtë të huajtë!*".

Dhe shpresoj se Epiri dhe Maqedonia, qortimet e Europës së krishterë, dhe vetë nevoja e shpëtimit të saj, tashmë, e këshillojnë Perandorinë Turke të na vendosë në një autonomi të përbashkët, së paku siç e gëzon Hungaria prej Austrisë.

Krejt i devotshmi Juaj
Jeronim De Rada

²⁰⁷ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja Nr. 53.

43. DONATELO NIVES (VIKTOR GASPËR GUALTIERIT) DONATELLO NIVE (VITTORIO GASPARE GUALTIERI)²⁰⁸

Zotërisë së tij

Donatelo Nive /Viktor Gaspër Gualtierit/, përkthyes i “Milosaos”
31 maj 1902

Shumë i njerëzishmi Zotni

E si mund të mos jemi mirënjohës për vëmendjen që po i kushtoni ju veprës sime të parë. Akti juaj përtërinë në mua, tanimë nga perëndimi i jetës, qëllime dhe shpresa, dhe më përforcon idenë se ka qenë misioni im në jetë të përpiqem për ringjalljen e një atdheu të përjetshëm. Këtë e vërteton edhe fakti se fjala ime qëndroi e gjallë dhe asaj i dhanë dinjitet historik Leka i Madh dhe, më tej, në kohëra, Akili, bir i Tetit.

Në atë poezi timen, është njoftuar dhe pikëzuar me thjeshtësi dhe çiltëri përfytyrimi i një jete, gjurmë kjo e poezisë shqiptare, që është një përfytyrim i thjeshtë dhe i pandërgjegjshëm i botës, si një qenie e pakuptueshme para atij që i lind dhe i vdes në zemër. Dhe as mendja që beson se e rrok, nuk mund të gjejë ndonjë fjalë tjetër, përveç kënaqësisë së shijeve të veta dhe të gjërave që adhuron dhe që e bëjnë të lumtur. Dhe mendja që e nxori në pah, nuk mendoi ta stolisë (zbukuronte) me tinguj të tillë të cilët t’i ilustronin ato. Me këtë kotësi ngjarjesh i patën mbushur në fillim me metrikë dhe më pas me rimë dhe pastaj rima epikë italiane, dhe në një kohë më të lashtë atë latine. Poezia shqiptare nuk i kalon kufijt e natyrës, gjë e cila e bën që të pranohet me endje.

Dhe kjo pondodh në një kohë të mbarë. Rikrijimi i Epirit në katër vilajetet e veta autonome, ashtu siç këshillohet dhe dëshirohet prej

²⁰⁸ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 53.

saj. Ky rikrijim qe për Gazetën tuaj, atë të shumë të mirit A. Lorekjos, ku merr pjesë Princi Kombëtar Kastrioti Gjini, që njoftohet si fatlum dhe gati si qendër e stabilitetit të Perandorisë Osmane dhe të paqës në Europë, prelud i asaj përhapjeje të mbretërisë së Zotit mbi tokë, që do të jetë paqa në mes të njerëzve.

Dhe mbas një bashkërendimi kaq të madh ndihmash për të ndryshuar fatet e Atdheut tim të shkretë, e që unë mendoj se i paraqes në përkthimin kaq të dashur të “Milosaos”, jo vetëm ju autorizoj për të por jam shumë borxhli ndaj jush duke iu autorizuar për këtë vepër që m’i përtërin shpresat që nuk janë zhdukur deri tani. Ndoshta ato pak pjesë të botimit, që ju duke përkthyer i pëlqeni më fort, kundrejt varianteve të mëpastajme, përputhen më fort me origjinalin që përgjithësisht u parapëlqye më tepër.

Vazhdoni ta doni, ta doni aq fort sa mua kombin tim, që është drejtuar kahë fate të reja dhe më konsideroni si mikun tuaj të sinqertë.

Miku juaj i sinqertë,
Jeronim De Rada

44. VIKTOR XH. GUALTIERIT²⁰⁹**31 maj 1902**

“... Mbas ndihmës aq të madhe për (fjalë e palexueshme) fatet e atdheut tim të mjerë që unë besoj se shoh në përkthimin aq të dashur (të shtrenjtë) të *Milosaos*, si dhe për autorizimin për vetë atë, që duhet të mbetem shumë borxhli ndaj jush për punën tuaj (në shënim, në fund të faqes: që e përsërit) që keni bërë për të mos shkuar kot shpresat e mia për sa pritja. Dhe, ndoshta, disa janë të botimit të parë që Ju, duke i përkthyer, i preferoni nga variantet e mëpastajmeve, që janë më të përputhshme me origjinalin që pëlqehet në përgjithësi”.

²⁰⁹ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 53.

45. MIKELE MARKIANÒIT²¹⁰

Maqë, 1 nëntor 1902

Shumë i dashur kushëri

Do të mirrni lira 2 e 70, vlerë (çmim) i një kopjeje të librit tuaj të *Shqipërisë*, që ju lutem t'ia dërgoni D. Ruxhero Pankaroit, avokat në Kozencë. Ai e pret prej shumë kohësh; dërgojani shpejt. Libri, përveç (me përjashtim) të smirëzezëve, është pëlqyer mjaft. Po ju sjell gjykimin e baroneshës Knorr nga Viena: “Kam marrë letrën e këndshme tuajën dhe Ju falënderoj nga zemra. Duket gjithnjë e qartë ndaj Jush dora e zotit, që ju ka zgjedhur për gjëra të mëdha. Por jo vetën për t’Ju falënderuar për rreshtat (për fjalët) e dashur tuaj, po Ju shkruaj sot, por dua edhe t’Ju përgëzoj për medaljen që Ju ka dhënë princi i ndritur Aladro Kastrioti dhe për librin shumë të bukur të zotit Markianò, që flet për Ju me patos që të rrëmben, etj., ”. Do të doja ta shtyp (ta botoj) tërë këtë letër.

Më dërgoni, me kartolinë, lajme të reja shumë të freskëta.

Jeronimi, tërësisht i juaji.

²¹⁰ Arkivi i Shtetit, Fondi 24, Dosja 53.

KREU VII

JERONIM DE RADA

VEPRA HISTORIKE DHE FILOLOGJIKE **Teksti në dialektin arbëresh**

Transkriptuar nga JUP KASTRATI

30 dhjetor 1977

1. ZOTNI BARTOLOMEO ÇEKETIT PËR STUDIMET E TIJ **MBI VEPRA TË PRINCESHËS ELENA GJIKA (DORA D'ISTRIA)**

Të shkretë, ndë n'azil, të pā-
Hòr, ndë i mîr i hùaj kuròr
Ljuljesh vëi mbi varrin t'ën,
Na qajim e s'dijim më.
“Po sot, si nkë prisim, shkuan
Të kéqet” – na thot një zë –
Tek të gjålëve edhè, na vjén
Fjalj e hùaj besje të ré.
Zotròte kà hòra e dëtít
Çë vantiljen e ponìme
Ni përngrejti, e mòn e pàr

Do ndë mest léghvëvet,
 Kuròr ljuljesh pà-veshkëta
 I vë ndë bàlt të statit marmur
 Të zonje të Arbërit,
 Si shëjtje çë mundën mòn:
 Hér e agëzòn çë gjindja gjith
 Çë atë e ka tharòs me të
 Te moti të përtërret,
 Venetis t'i zëhet dòres,
 J'e ngrëjtur dica të prëhet
 Me marr frimën e vetëhés;
 Ditur mòtërën ç'e do mìr.
 Të fòrme nka dheu ljëtir.
 Kaqë se na përrjër Zotrote
 Rét te moti i fatit bàrdh
 Kë bashk patëtim na ndë dhé.
 Kùr këtëj matin e të ljùmes
 Euròp, e gjàt' e ljùm
 Nën driten e ré të qiëlvet,
 Rrìdh anishit Venetia.
 Vet' e Iskandri *pà-fàn*
 Mbànej zotë sheshet e lãrg
 Ehj thra forën e hùaj çë frinej
 Bes të hùaja e qiëlën vrënëj.
 E përgjunj kà jemi shprisht
 Lotëmi atë dìt me t'in-zòn;
 Tij e uratëmi kaljòr
 I fatit e i zonjes àn.

10 shtator 1868

2. BULJËRI E VËLEZËRËS T'ARBËRIT

Gjithë zotravet t'arbëresh

Ka ca mot që dërguam, e katundet dhiovastin antirin mber këshilin skalangkùr t'Ellenëvet, më ata marrur e ljidhur perëndis tire Arbërin e poshtëm; pjes e gjëris àn, aqëvet se gòrt e mésëme e atò ndër maljet. In tek ajò emrat e kreravet ai, e vuljèma e juve gjithve; e martiriti malin t'ën për katundin ç'është vetëm ini, e i pà-mè-shqérr vëlezërve e të një gjuhe, për ghìr të ndò-njeriu. Po nd'at' që atèj u ljëfàr e bëna, që bëjn mè e ghejgur, pas dica t'Ellenëvet, që ghitin nd'Arbërit pòshtëm me këshìl t'e mbjedhëjin nën vantiljen e tire e andej prà t'e mbajn të zégheet fàres tire; pra që t'Arbrësht vet i prùartin prap; nka vorèa gòr t'ona të skuljarta ishin të zëna ka më të tjër e shùm. Gjith e dini se t'Arbrësht, po sa mundëtin t'e bëjn ata të ljidhur Perëndis Osmanle, ndènjëtin mb'àn tek amàhi Maljit-Zi me Turqit. Ashtù nkà njij i piku mbë zëmër kùr leghet e Maljit-Zi (që thojn mose se më i ndigur vëlezërvet tire të Bosnies a t'Erzegovinës kishe njëin ljenur shpìt) kur atò u pàn të shprishta fshateshit' arbrësh, e se zëjn një e një atër proit t'Arbërit aljartaz. Ndietëjin ata të sgjèruar t'ushtërës tire pèrtèj vént e ljuftëvet, më ndietën se psora e amàhit i bënej një nevoès të xëjin ato gòr, ata proite, pà fàrè ata hasmì nkamate të dheut gùaj. Po sot, pas fidencit të ljuftàrvet j'u duk po mìr jo vet të dùan véntet që zùn e t'i mbànjën për ta, ma pèrtëndònjën të pèrnènënjën fàrt e arbresha që ateina ishënjin me zotèri mbi vetëjùen; mbi petkun e statin e ciljvet jo kush j'a dhà, jo jat eu kishndò një ljiqe. E dà xùn e dhespozënjën mbi t'Arbresht atej, si ndër légh te ju dhèna; jàpën e marrën, kùr 's vièdhën; e nkà dita mè i rendënjën mbàlj.

Ketà të cenùam të fòrem ndër né prei të gùaj ciljvet nk' i ftéstim shtù paru nd' Arbërit vuljì t'errta e vòl gjaku mek të bunàrënjën ljugàdhin e rì kè t'àrdhurit gàptin ndër né. E nji gòlje tash gjith paru thòn: Ecëna e i ndighemi vèlezërvet' àn, ka gjindt “mè e madhe t'angosur e të shkeljur”. Buljàrt e vlémies t'Arbrësh as dùan mirfil të gapèt ljugàdh e rì ndè dhét t'ën, cilji i xënur ndër dì fàr t'afërme e të ciljavet njèra 's e pat njer sot me jatërën, mund dhezinj pa meta nd' Apoljèt amahe të à zàlje e mbè të qàr. Ata vùn nën sít e gjithve t'afërme e të largh ljiqen t'ën – e ndër gjith është mose e Dreqa – e ljutënjën mosnjë të tundet edhé; se, porsi u sgjidh kà gjendjederlja Arbëri i poshtëm, kàn bés se mosnjë ndè kuvendet t'Europës të llijgërònj për ata që dùan të shqèren gjërìt mè riempier petkun e gjitònvet. Andaj ata ljutënjën ka buljàrtë arbrësh të mbanjën ata lèghet. Pse ljiqa e katundit ni është e vèn ndër dùar të Përendvet t'Europës: e aqë ata, sa Zoti madh Konstantinopul, nënk munde' dhén se ata që u stahjetin ka patèt se të mirrin nka gjitònt që nënk e prisim, nani të mbànjën atè që mùartin margù, e ata të dreqët ç'i mbajtin Përendis tire besën e dhèn, të jén të shqèrr, e pra të xheshur e shkeljur, se qén të mìn. Na 's dùami nkà pètku Ellenëvet jo nkà i të Maljit zì, e aqëvet ata të mos ndenjën dùart te dheu in: Këjo liqa; e atej besa jòn. Ndo se pròhë me gjith se na jemi, të mos i lièmi, mos lièshim edhe kèt jet, dhén t'ën e shpìt t'ona njeriu të gùaj. Arbëri është i t'Arbrëshvet ku dhe shprishur, e kà atire fljieghet.

Pér të Konstantinopulit 18 të mait 1878.

18 maj 1878

3. GJELLA E SKANDERBEKUT ZEMËR MADHE

Janj Kastrioti u përzier me njetër dy përgjipra t'Arbëreshë luftoi kunder Amuratit; po si që i mundur bëri paqë, e se të mbanej pa t'i jip Zotit Madhë katër të bijt' e tij: Riposin, Stanixen, Kostantinin e *Gjergjin*.

Janji kish për grua *Voisaven* të bilen e Përgjipës Maçëdhonies e Bullgaries, Zonjë shumë e urtë ej e bukur, ka cila pat atà katër bil që thamë përsipër, e njetër katër bila: Marien, Gjellën, Ëngjëllinën e Mamizën.

Amurati si vrejti të bilt' e Përgjipës Arbërisë, e i pa kopil të bukur e të shëndoshtë kudhësi se një ditë mund i bëjin Mbëretisë tij e liqëroi të i rritnej si bil; po përdika se ca ishin të mbëdhenj e thomse së mund i prirë t'i qikarnej si doi aì, kudhësi t'i farmëkosnej. Kështù ca më një here, ca më tutjë farmëkosi tre të mbëdhenjtë e mbajti vet *Gjergjin*, ç'ish tetë o nëndë vjetë. Se t'mos kultonej më prindët e dhén e tij i ndërroi ëmrin e ja vu *Skanderbek* që vjen me thënë *Ljisënder Zot*, ndë gjuhë turke.

Skanderbeku rritej i bukur, i shëndoshtë, i fuqimë e zëmer-math, e që kur ish i vogël së bëj më gjë se vej kaluar, dridh shpaten e shkrehnej jatulla e shtiza. Aì së kish jatër shok se mahjerjen; e nga dita buthtohej më e më i fuqime, sa ndë mbëretit të Amuratit s'ish mos një që mund i rrij perpara aq nd'urtëritë sà ndë kaluarit, sa ndë të shkrehurit, sa ndë të luaturit mahjerjen.

Skanderbeku fôrka ndë të luftuarit e ndë shumë tjera shurbise ish edhé shumë i urtë te gjuha turke, te arabia, te greka, te shklovònia, te llatinia e te ljetinia. Amurati si e pà kështù t'urtë e zëmer-math ndër shurbiset e luftës, e bëri krye të njij ushtërije të madhe. Pak mot pas që e kish bënë krye, mberëtia Çilliçies ju rribëlàr zotit mathë, e Sulltani mbjedhur një ushtëri të madhe dërgoi edhé Skanderbekun

bashkë me të tjerët krera, se të luftojn atë mberëti e të e pririn pameta nën vandilet e atij.

Trimi i Arbëreshë u qëll aq mirë e madhisht ndë këtë lufë, sa tjerët krera e akol kur e pruarin i thanë Amuratit: - Mbëretin e Asies që kish përjerrë oplitë (armet) kunder tij, nëng e mundëtin shpatat e ushtërtorvet tanë, po valëma e madhështia e Skanderbekut. Ahër Skanderbeku ish nëndëmbëdhjetë vjet.

Pas që kish mundur Çilliçerat, njeter mberëti e Asjes, që jo shumë mot përpara kish njohur ziguan e Zotit Mathë, ju pruar kundër. Amurati pameta i dhënë Trimit Arbëresh një ushtëri të madhe kalorësh e ushtërtorësh mbë këmbë, e dergoi kundër asaj. Ndë këtë lufë Skanderbeku rriti laftinë (nderën) që kish gavnjier te lugadhi Çiliçjes, se psë mudi Armiqtë e u pruar tek Amurati me shumë barom' e ushtërtorë armiq që zu.

Sulltani si e pa kështë të fuqimë e zëmer-math e bëri krye mbi gjithë krerat e akolët e tij, e kudhësi t'e dërgonej kundër ca mbëretit t'Asjes, që nëng dishtin të njih'jin zotërinë e tij.

Gjergji vate e jo vet mudi ata, kundër cilëve kish qënë i dërguar, ma edhe ndër shumë mberëti të tjera qandoi vandilet më gjymen e hënëzes; sa kur e pruar, Amurati, e mbjedhur me shumë nderë, i dha dhë shumë harome.

GJELLA E SKANDERBEKUT ZEMËR MADHE (vijon)

Një Tàrtar nga Adrianopulli erdh ahier te Kurtja Sulltanit e sfidhoi gjithë Turqit një e një të luftijin kurm me kurm me atë.

Turqit gjithë gjegjtin monomàhjin po mos njeri patë zëmer të i dil përpara; Zoti Math të gjëndej ndonjeri të monomàhjne me atë, se nëmos ish dhunë keq e madhe mberëtisë tij, zù e taksenj harom' e tjera shurbise, po mosnjeri u bë përpara.

Si gjegji Skanderbeku se një Tartar kish marrë aq shpirt, sa mbrënda te Kurtja Zotit Math sfidoi më të fuqimë, ngë mund kish mbajtur më volen, e u hypur te Amurati i lipi falimë të vej të matej me mahjrenen me atë Tartar, çë kish trëmbur gjithë mberëtinë e tij. Amurati si pa Skanderbekun keq ganjùn e se ahier ze e i buthtohej mjekra u trëmb të e lëj e i tha:

- Skanderbeku, biri im, nxìr ka trutë këtë vuli, se psé, ndë të bjerrsha tyj, bìer krahun e djathët timin; po përdika se e doj keq mirë, ndë të prasmën i dha falimë të vej; e ai vet dish të rrij përpara monomahjit, se të shihë djathtimën e Trimit Arbëresh.

Tartari, parë Skanderbekun kështù ganjùn, ture qeshur i tha:

- Trim, psé do të shkretosh tèt atë e tèt ëmë me vdeqen tënde? Ec, ec e u mbjith! së jé njeri ti të presh vollën (*vollin?*) e shpatës time.

Skanderbekut kto fjalë i fryitin zëmëren e e ruatur vrëret i tha:

- Zëmer lèpuri çë më fjet me aq burgàmë, dil përpara e kjò mahjere të mëson kush jam u.

Tàrtari gjithë vllën, helqur mahjeren ju sul ngrah Skanderbekut; po trimi nd'atë çë ja priti, i shpejt e lakosi ndë xerkut e e shtù të vvarë. Zatë e atyrve çë rrijin mbë rieth u ngjitetin ndër qiell, Amurati e mbjedhur gjithë haré i dha shumë harome e tjerë shurbise.

Pas çë kishin qënë kto shurbise Sulltani me Skanderbekun e me më të miret të mbretërisë tij vatë *Burs* o *Prusje*, katund i *Bitinies*,

ku ju fanartin dy trima Persjanë, cilëvet njerit ja e thojin *Jaj* e jetërit Xampës. Këtë sfiduan me të fuqimin ndër turqit të monomahnej me njerin ndër të kaluar e më shtizat. Si e gjegji Skanderbeku këxier mbi kalin i pieti cili doi të masej me ‘të i pari.

Ahier u bë përpara Jaja e i shtunë shtizën, ja e zu te kryezori, e u bë cika. Trimi i holqi të tij; me Jaja u qikartur shpejt e reshti. Ahier holqëtin mahjeret e u sultin si dy lliunra; ma Xampa, dëlguar se Jajai vetëm së mund prit krahun e armikut, u shtua edhë ai. Skanderbeku e parë e dilgoi e ju sulur më shpejt se pika i ndajti stamahjin ej e shtu ka kali, prana u pruar te Jaja e pas pak kollpanesh, çë ndërruan njeri-jetri, i holqi një te mushku ej e ndajti njera mb’ ilë! Ahier u zdripur nga murxhari vate tek Sulltani, çë e mbjodhë pjotë haré, sà ture qjatur i tha:

- Skanderbek, biri im, ti jé ndera e mberëtisë sime e u çë ditën sot të mbanj si bër e kështu të thërrës.

Skanderbeku jo vet ndër momomahjet ish ashtu zëmer-madh e i fuqimë; ma ndër gjithë short lufje. Ai i pari i sulej armiqtvet ndër luftë, e i pari qandoi vandilet mbi muret e atyreve. Ngë qé ndonjë krye çë dish më mirë ushtërtoret se ai, në ushtërtorë çë dojin më mirë kryen e tyre, sà t’atij dojin atë. Ky, kur kish gjë rrigеле ka Sulltani, ja e ndaj gjithë ushtërtorëvet e së mbaj për ‘të farë gjë.

Ndë ktë mot Skanderbekut i erdh një llajm e i tha vëdekjen e të jatit. Dhëmbesià e Skanderbekut së mund rrëfihet; përdika se së mund e buthtonej dhëmbësin’ e vëdekjes të jatit, nëmos, Amurati çë i tha se e doi si bir, e se ai jetër at së kish të njih se atë, mund dhispëlqihej.

T’Arbëreshët kudhësjin se Amurati, drej besën çë i kish dhënë Janjit, i dërgoj Skanderbekun të mbërëtonej te lloku të jatit, ma u gënjyen, përdika se Sulltani ndër gjithë katundet e kastjelet e Shqipërisë dergoi ushtërtor turq. E Vaizavës të katives Janj Kastriotit u shënoi ndë Maçëdhonjet, (ku ajò me njerin nder të bilat u mbjodh) shumë bëgatì.

Amuratit i shkoi për ndë kryet të farmëkosnej edhé Skanderbekun, si kish farmëkosur të vllezërit e tij, ma përdika se ai ish i dashur keq mirë ka gjithë Mberëtia e tij e ka më të mirët bulerë turq, e u trëmb t’e bënej; ej e thërritur vëtem i tha:

- Mos u helmò përdika se së dërgonj te mberëtia prindëvet tënd, se psé u e bënë për bëgatinë e asaj Perëndi, në se të zgjeronj mberëtinë time; ma, përdika se të dua si bër, më dhispëlqén të të kem llargu.

Ca bulëre turq e marrë mbi sy, përdika se Amurati e doj keq mirë, zunë fill të e ngalësjin e zunë e i thanë Amuratit se ai ruanej të bënej mbërëti Turqëvet e të nxirë atë vet, e se andai kish bënë miq gjithë ushtërtorët. Amurati që ahier ish shumë pjak e si nxanxon kish bësë gjithë shorçit, i pati besë, e ligjëronej me vet-henë si kish të i shuanej gjellën. Ma qielli që mose i kish ndihur, e reshti ka kudhëza e Amuratit, si rrëfyemi pas.

Ndë atë mot Përgjipa Servjes ju rribëlâr Amuratit e ky, si së kish ndë njetër krye më të fuqimë e të shpejtë se Skanderbekun kudhesi të ja dërgonej kundër. Skanderbeku me një ushtëri të madhe si erdhi ndë amahj me Përgjipën e Servjes e mundi, e i shprishi ushtërtorët e tij për ndër fushat, e, i marrë shumë katunde e bëgati u pruar te Zoti-madh.

Amurati, që kish kudhesur të vritë Skanderbekun, sa më njëhere mundhnej, trëmbej të e bënej faqe, e se të mos të dëlgonej njeri, zu e dërgonej llaime ndër gjithë katundet e Perëndisë tij me thënë të vejin kush doi të vej ndë Horët të monomahjnej kaluar o mbë këmbë, te karrera e te luti. Amurati bëri këtë përdika se dij se Skanderbeku ish i pari të masej, e kudhesnej se ndër aq që atjè mbjdhëshin kish të gjëndej ndonjë më i fuqimë se ai t'e vrit; ma Skanderbeku i mundi gjithë, ndë gjithë short lufje.

Ndë vitët 1440 (një mil katërqind' e katë dhjetë vjet) Pap Euxheni i Katërt, parë se Turqit zgjerojin keq shumë mberëtinë e tyre, u përzier me Përngjipen e Ungerisë e shumë të tjer të kështë, vate kundër Zotit Madh, me dyzet milë ushtërtorë. Amurati ahier dërgoi Skanderbekun me një zet milë ushtërtorë të përzihej me Pashân e Maçedhonjes e të vej kundër të kërshtervet; ai vet prana marrë nëndedhjetë milë ushtërtorë u nis pas atyreve.

Skanderbeku që kish xënë se Amurati ruanej si më mundnej të e vrit, kundhesi t'iknej e të mbjidhej te Perëndia tij; andaj i shkruati shehur uniadhit, Përngjipës Transillvan'je, si kish të të qellej të lufa se të mundnej Turqit, ej e porsiti mbi gjithë shorçit.

Si njera pjesë e jetra t'armiqvet erdhëtin me duar, Skanderbeku pas që luftuan ca herë, pruari krahët me një zet milët e tij e la vetëm Pashân, cili për një copë herë luftoi me shumë fuqi; ma prana si pa se i Arbëreshi, cili ish më i fuqimi e zëmer madh mbi gjithë krerat kish ikur, pruari edhe ai krahët.

Të kërshitetë ahier u sulur mbi turqit i shkuan gjithë nën mah (jerën). Skanderbeku, parë se Turqit kishin qënë ca të vrarë, ca të shporangjisur, marrë me 'të një kanxhëlier të Zotit Madh u zdryp te lugadhi Uniadit, cili e priti me shumë haré. Atjë me trëmbur kanxhëlierin, bën' e i shkruati një lëpushë Pashaut Krojes me sixhilin e Zotit Madh, cilin kanxhëleret qelljin mose me 'ta, çë i thoi, të lënej mbjatu Krojen Skanderbekut e të mbjidhej Adhrianopull; se përdika se ky pëngjip (*siç*) ish zëmer madhe, e shumë i urtë ndër shurbiset e lufës, kish t'ruanej atë pjesë se të mos hyjin Ungërnjotët ndë Turqitë. Pas çë kanxhelieri bëri lëpushën, Skanderbeku e fëtoi të vej ndë Arbëritë se i jip shumë bëgatë e i bëj nderë: po si ai së dish të vej, bën' e vranë se të mos i rrëfyenej shurbesin Amuratit.

Pas këto shurbise Përngjipa marrë tre qint kalorë çë i kishin mbetur mose rretha për sa mbët te kurtja Amuratit u nis prej Krojen, ku si hiri i dha lëpushen Pashaut çë mbjatu muari udhen e Adrianopullit. Si që mbrënda Kroi, zu mbjatu e nxuar Turqit ka gjithë katundet e mberëtisë tyj, ca i vrau e të tjer çë u pakëzuan i mbajti për ushtërtorë. Harenë çë patëtin t'Arbëreshët kur xunë se u kish mbjedhur Skanderbeku së mund rëfihet. Gjindja, si miza lisi, ka gjithë katundet u mbjoth Kroi se t'e shihëjin. Gjithë prana, shtunë vandiljet e Turkut ka Kastjelet, qanduan fjamurit e kuq të Skanderbekut me akuillen e arët me dy krera.

4. RAPSODI KOMBËTARE

Parathënie

I dëlur monu prei Kollegjit Shën Trianit ndë Lonār të vitit 1833, pata një ljpësh të Rafael Valentinit – cilji shumë piak prà dhespòzi të ngrëiturit e Kalabries te 1848 – mek’ ài më ljpënej këntëkat e katundevet anë. Aghier u vaita Strigār te mëme-màdhia. E atiè një piakarràqe, Torrètòshëlja më thà të pàrat, e ndër atò atè të Dedi Skurës, të Miloshinit e të Radha Vanit.

U ngjita prà Shën Mitër te krushka Orìxie, ngà shpī e Strigàrvet, e motime nënt’ dhièt vietësh e andài garraçeke: cilja më mbësòdi këntëkën “*Rā Turku, po ku rā?*” e të tièra mbë gjims.

Nd’atè vèja tue gjëtur gratè e katundit, kà xùra ndò nj’zét. E prèi atà t’kufamè me vasha e të dëljirit e s’ thënës t’atire kënt’kave u zū storia e prà e rrëfietura, ashtù si është, e pròmes të Milosàut. Të mbjèdhurat dèrgova Kozencè.

Kùr te viti 1845 më gjeti Anàpulj Dhimitër Kamarda, e m’buthtòdi një livrith të shkrùatur me ndònj’pesmbèdhiet kënt’ka, të çuar te Kollegji arbrësh Palèrm, e ciljat ài pak dëljgonej, edhè psè nk’ishnjin te dialeti Siçilies; si i pē, njoga mbiatè glùghen e katundevet’ anë. Ishnjin të sgjèdh’ta e gjith, thòshnje, të ljàra ndè Moretè: “*Dùal e bùkura ndè derè*”; “*Te gorè e Anàpuljit*”; “*Rrëmpep mèrùame*”, etj. Holjqa një të gjarè j’e pèrzieta me të tierat. Vitin pas njòga Herman Kestner kà Hannovèra, çè vijè prèi të vaturit mbjèdhur këntëkat katundàre të ndrìshe boteve, e dèshi edhè ngà t’miat. Afa e àksème e rē e ciljavet j u duk se i ngrènej mbi sà më kish gjégjur; e m’ anangasi t’i ncìria mbè drit se të na i shìghin.

Pes viet më përpara më kish Ligjè Petراسì ngà Qana dèrguar trī, gavnàre abonsina; e te viti pas èrth Anàpulj Èngjel Basili ngà Plàtaçi e

m'sual të tiëra: të Pieter Shtròrit, e t' kreta si nk' i kishnja atò të nusevet e t'besës madhe të Kostantinit parë. I adhiasa poka e pròra ljetisht. Prà èrthëtin psorë të suvālme e m'i mënùan. Ashtù kùr ljë Anàpuljin me zëmren të shqerrë, shqòra no shtùra me t'tiera të shkruarta, pà e vrètur, edhè at liver; e vate u svìs.

U këthitur ndë katùnd, si u adunārta, kèrkòva kartat' ngàha kèshnja adhiasur at liver, po piesa të dritème u kinë bierrur, e një "*Këndova e sgjòva zonë*" nk'ish më. Të k'sài m'sosej spëlja se i kish një shemblemare Kèstner, ciljit ja kèsh u dhënur. U dha aghier se vaíta Shën Sofi, e prèi një piak, ç'e përçëmonjin Xibia, gjégja pes o gjasht të réa si jatër kombe diu nd'i pat kurrë: "*Ngrëitin një shatorë*"; "*Mbre i biri Fighies*", "*Gjith suvāla i nxùar mb'anë*", etc. Prà nj' grua Përçiljote më mbësòi më dreq të hjëshmen aq': "*Kùr ljeve ljevè ti vash*".

Për s'prasmi pata një zèt përtejote t'mbjèdhura prei Frat' Antòn Santori: Po pat' vèja tue goditur me i nxierrë të shtuamet: i ndigur prei të tierë semblemare kë kishnja edhè prei gjëje çë kuljtònja se i këndonej zònja mèmë të mī vèlèzërve te diepi. Ashtù nga plaka kriate, çë nà rriti prà të varfër, mbàja ment "*Ljigjëròi piaku me maljë*".

Tash kanë të jenë të tiëra t'pāgarrùara ndër katùndet t'anë e vet ljutinj ndìghmètartë e ksài ditàrie t'i ngrënjën ngàha do edhè rrinë t'pāvëna rë: se t'gatet puna ime dùarshit tìre; psè është ajò dhiata gadhiare e gjith've nève.

Te viti 1866, adhiasur bashk me Nikol Jenin nga Shën Mitëri atò kë kimë, na gjeti N. Tomasèu kush na i stampàrti Fiorencë. Si të tierë ciljvet athun j u prùartim, ài sè na njigh: po qè Ài me fat se ndë mest àqëve dhe më të nderùar te moti i tij, t'vëij dorë mose me mbàitur shtùara çë dò Italies t'i kish hjë: Sā dùket se vendi aq' i gapt sàve frinjën pegamë mbi bèst e gjëlës, u bë pèstài e ai vèdiq; e foka psè nk' është më kush t'i gèrgàs, një e njater fòren mbì gjāgjënë e vet'jùes. Ài buljār si pā monu afën e rë çë àhjëtenej ngà Rapsodhitë e Shqipërisë i valjandisi te përjerren ljetisht më i bënur udhë të vèjin ku do vendi, si i pati uratur.

Se mirëflë atò sot t'i jenë një shëndetine sandergjisë bënjtare t'Europës; sot çë rë, fanī, te ndieme çiesu, të heljqëra e t'اناتosta kà dò u panë, piksen ndë t'bëna të vèdèkta çë mùartin vendin e ninës të gjëlës: sà sot ljpset gjithpàru njeriù çë dò, fjèt e bën pas vet' jùen, e ndrìshme te ngà një: E atéi i ljpset për çë atò të jenë. Ndrìshe atò

t'ònat. Të përpàrame trimash e grashë që qenë e t'ciljavet i njëgmi zënë buljare te mbarete, të bënat e t'thënat, atò na afëronjën foka vetëtire pse ngà atò t'marmi e t'i gjàsmi. Për andai zëat e atire që i bënë, të ahjëta piot t'ri ndër kanqëlje t'pàvëdëkëm, edhè u rrinë porsì rrempa t'hiëla gjërisë t'Arbrësh. E ngà atà kangjëlje nd'Italiet ku jemi shprisht, kanë gjith të mbëuarit madheshtimë shpitë t'òna të vapëhta e tutiëme prei gjëles së górvet që sot qughen fànmira e buljërështa.

Ngà jëtër anë ato Rapsodhì t'zotrave të ciljvet gòra e ëmri, si të Omerit, as dighen më, dò edhé t'jenë një ftirë tek pasiqìret gjëla e fati inë. E nà mbë t'i dhiovasur shighemi aljà e dùami vet'henë te dhata e Musaqit të Delvinjit, me ciljin na, bilj te trimavet shokt e tij, ndiemi e pò t'thomi:

Por se m'shìgh'ni të shkufëndùames gorë se u prirem, mos thav-mzi; se mosnjèri jùsh t'ljùme të gùaish mberë këto timpa t'ònat dò t'ziljèps'nej; E vet që i liëva Delvinit me jù, psòres s'anë të ljugur gjakut më t'mirë s'i ndaghem për një jet.

Te moti kùr ato patëtìn ljerë që ghëra e madhe e prìndvet anë të përparani savuljënët turke e i shtitur mos t'zënjin e ndërritjin gjith jeten e kërshhtë: e t'kësài inë sitë mose të përjerë nd'Arbërit. E psè atò ahjëtëjin fòren e atìre trìmave nd'amàhj e hjenë e shpivët tek ata kinë ljerë, qenë të hatrùara afër e largë, e nd'Italiet të kondisura bashk me atà kaljorë të ljavosur prei fatit. Te kënkat e sai e t'Ilit-rì ndìghet èdhe sot ehjòa e atire. Po ndë Greçiet, ndò se ajò që mose piòt ndò se umbjùa aghier me t'Arbrësh, këntëkat laosme që Fauriel e të tierë mbjòdhtin një sot, e madhia piès më shpèt se të gjàra u kà ato t'ònat, janë cà t'përrjerra vobeka e peljakane. Andèi edhè duket se patëtìn shkùar te poesia e ùrt e Italies vet, pròmet e kules t'Atlantit, e Mandrikardit i përmbùdhur me Doralicën, e Angjelicës ndë vetëmi me këlògjerin piak: *confr. Ljart te çuka e nji ràhji, Këshnja vënë u postëzën, Gàjin buk si dì vëlzër, Më u nistin nëntë trima.*

Nani une gjith i ndrëqa e i adhiasa ndër tre livra. Veç' e më e pàra, storia e màlit madh, t'arbrësh; ciljit i njëmëndën abonsina ljevdia kë patëtìn prei *Guidhës* të Turinit. Se ndë e rùami si nj' simbol e Gjelës – cilja ljèghet si ljùlja anamesa pëmëve kë çòn, e ture marrur ngà jeta bënet e mbarùar ndë vethë me të njëghta e me dëshire, e ndòse ndër ghëljlme e garë shìghet zonjë; e Ajo vet që pràna prúnjet ndër valjanditë

et' j u ljetvet te shpia, ciljt kanë t'i marrën vendin e aljà marrën dhè më t'rèvet e atire që i rrièdhën – si simbol e k'sai Gjëlë, thomse është, ndër sà u plasmùan një sot, e kret e si me fiàljen. Vèçë storien e fatit të botes s'anë; e atë të ndàitur dishë, si edhè duket e bënë e dī dūarve. Te njëra se fèksën dita e Skënderbekut; te jat'ra zëghet amàhji i ngjatur ndë Moretë, njëra tek të ràrit e Koronit; ngàha Karlo V mbī anitë e tīj mùar e sùal kètèi të prasmit e Arbrësh. Pasandài vë ato këntëka ciljat më dùken t'ljëra vet ndë gjī të Gjëlës; që ndë t'shkùar shègh te Gjithsèna gjë t'qënë mose ej a mbjèdh ndër proberbe ndò ndër simbolj, ciljt shpèit një kombe mèrr gùa kà gjitònia.

20 korrik 1883

5. VREJTJA E MEHMET ALI PASHËS²¹¹

Duami na të zëmi nga vrejta e Mehmet Ali Pashës, pse nga ajo më se nga të goditur të duarve të shehta që gjithsej piljastin e rrëzuan udhës ngaha edhe venë, faneset thiel ndjeta e shkretisë s'anë. Andej pra na zotëritë e Europës u ngurtin zëmrie mbi fatin e Shqipërisë. E ndomos se ajo e keqe, mos ja kishnjin pasur rrëfietur mbë të rrëme doi më shpet me e pasur çeljur ndër ato, të dashurit mirë e thavmasia për atë besë, ciljes ndë Arbëritë, ku do faneset, pjeq e të ri i naforënjën mallin e katundit, gjërinë dhe vetëhenë.

Pse është një storie dëljirë si rapsodi Omeri e tek pasiqiret thielë zëa e arbresh: e shkruatur nga një buljar që ish me shpinë e tij te vlemja e Bri-drenit, je pati pjesë tek ajo shkreti njera që e pa gati për së afëri.

Ish e mërkur; je krent e buljarët e Gjakovës, turq e të kërshtenë, dualtin mbë udhë të Prisërendit që prej Gjakovës është larg gjashtë sahat të ecur; e pritënjin Mehmet Ali Pashën që kish bënun telegram menatet, e vij me ndarë një anë të Shqipërisë e me ja dhënur Maljit zi, si zotënitë e kërshteva vetë e deshtin.

Na vij ashtu animik, i çuar prej animiqëvet. Pritëtin der një sahat prej mbrëmjes, kur erth një zabt e tha: Pasha nëng vjen; se ja vranë Prizërend telegrafistin ndë kafe të Marashit. Gjith u gazuan, ej Hasan Aga i tha të kërshtenvet atje: Ju të kërshtenë rahati. Kishit gëzim, se vij ki, pse është kaurr si ju? U përgjegj zoti Pjetër, prifti të kërshtenvet që ish me ta: Si të vinj, si të mos vinj; mirë o llik që të vjen për ju, vjen edhe për ne; pse juve e e neve shqipëtarë e të nij gjaku, ai vjen i huaj prej të huajsh.

- Po si kujtoni ju (u pruar Hasan Aga) ndo ai, ndo Franca, s'ka më që bënj: se halja jemi të gjallë.

²¹¹ *Uccisione di Mehmet Aly Pascià, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 1, Corigliano Calabro, 20 luglio 1883, p. II.

Bashk gjith u ketshin mbrëmanet ndë sheher. Të shtunën erth Mehmet Aliu Gjakovë me nja pesëdhjetë suari kaljuar; e të dielj mbrëma dërgoi thirtur Patër fra Pjetrin që rrij ndë Zim ndaj Drinit, katër sahat largu Gjakovës ndë udhë të Prezërendit. Me një gjimsë herë natë Patër Pjetri vate Gjakovë ndë shpi të Prek Gulisë, muslim për të kërshenët, e andej me Tonin e Prekës e një husmequr dualtin me vatur ndë shpit të Avdulla Pashës, tek kish heljqur Mehmet Aliu. Udha ish gjith e zënë pushka të Gjakovës e të katundevet, shprishur tuba tuba.

Saraj i Avdulla Pashës ish më katër të stisura, me bari ndë mest, e të rrjedhura gjith njëj muri që i mbulij; e ljumi Përroni, që shkoj për ndë mest Gjakovës ngit të stisurën tek rrijin Pashallarët. Kur ata hitin mbrënda, gjetin ndë kuvend me Pashën, të zotin e shpisë, Kadinë, Koronicën, Bajram Agën, Soliman Agën, Shaqir Agën, Mirtiz Agën, Hasan Agën e të tjerë buljarë; ciljt ishin gjith krent e Vlemjes, e bëjn të arrënjisjin Pashën me u përrerë pa i ftesur Shqipërisë aqë miljetë me Padishanë. Bjerrur po fjaljë athun, të shumët u ngrënë e dualtin. Aher Patër Pjetri qe thirtur mbrënda. Porsa pa thënë dhe ata mirë kush je e si je, u mbjuan shpitë me gjind nga jashti që piejin: “Pse erth ki këtu?”. Po dual Avdulla Pasha e ju tha: Ç’është këtu gjith këjo bërrimë? Ata i thanë: E duam njërinë, e duam që ka ardhur këtu. Avdulla Pasha u përgjegj: Unë për të gjallë tim njërinë nëng e jap, si kujtoni ju; se më njihni mirë se u kush jam.

Bajram Aga, Shaqir Aga e Hasan Aga qetëtin atë gjindë përjashta derës me të mirë. Se dualn e u mbill dera, bënë jasht një vikamë e pas një patare pushkë ndë pexher të odit, tek ish Mehmet Aliu. Të gjith Gjakova zunë e zhgrehëshin pushkë. Atë herë dual Mehmet Aliu prej odit ndë bari, e tha: - Hapëni derën; që duan këta? Se mua nëng më trembënjën me të ljehur udhës. Avdulla Pasha e muar për krahu e i tha: Hajde vemë mbrënda, se ti këta ngë njeh si janë.

I folji dhe burravet: Se ju mos qoft kush këtu mbrënda i vorruar o dekur, të mos ngrëni pushkë.

Masandaj pleqët e shehrit hitin ndë mest e dhanë besën deri kur të dilj dielli.

Pas që u tha te Saraj: Është prifti edhe ati me Tonin e Gulisë.

Pasha me Avdulla Bejn i thanë Patër Pjetrit: Mos u tund.

Po Toni i tha fratit: “Dalim”. Frati i tha: “Jo”; më tha Pasha: Rri këtu me ne.

Toni vate folji me Hasan Agën, çë i bëri:

Më ndjet keq se gjëndet këtu Pater Pjetri, je edhe ti: po më s'mund diljëni. Pra bënë vulji bashkë e i ndërruan të veshten fratit e i dhënur ndë një skamantilj gûnën e tij Maldjurit, një njeri i Hasan Agës, dualn me këtë zabëti, e shkuan për ndë gjindjet asaj dhe sarajt tek ishin Pashallarët.

Si u di e hëna, shehri hiri njetër herë ndë mest e u ngjat besa deri ndë nesërit sahati pesë. Mehmet Aliu dërgoi Hasan Agën Filjiesvish ndë Kosovë, një kë kish sjelj pas vetë, se ki të vëhej tek udha e hekurit më vatur Stambul: me telegrafin pra ljiipi asqerë ndë Prizërend. Hasan Aga u pruar, e si e porsiti zëmra buljare ngë hiri më te saraj Avdulla Pashës në kundër këtë u përzie me shokët e Vlemjes; por holjq ndë shpitë, e atej se dual. Të martën sahatit tre erth Gjakovë një tabor asqerë. Pak pa ardhur, i dualtin dica përpara, se tabori kish dhe shqiptarë, e pietin: Janë edhe shumë çë vinjën? Prejveshtarët u përgjegjën: Ngë ka të tjerë.

- E ju çë do të bëni? - Çë na vëlla me vëlla nëng ljuftomi; pse ki është kaurr. - Erdhëtin ndë kershëll ndë fusht të Bajram Pashës. Nga të Gjakovës e të Rekës, Malsija e pak të Ipesë hitin pas ta e i muartin pushkë, xhepëhënet, e çë pat me vete një tabor. Sa ata u këthien, e u pruartin Prizërend të xheshur.

Avdulla Pasha e Bajram Aga kishin mbjatë dërguar për ndër katunde e ndë për miq, e i ërdhëtin bashkë me myslimanë nja tridhjetë të kërshtenë të Fundës, djelmëtë që qenë më të mirët.

Të martën ndaj mjesditën, Hoshi i Nurit i Novaseljës erth Gjakovë, e shkoi nga saraj Avdulla Bejt. Bajram Aga ish tue ndenjtur te dera e i thirri e i tha: Ku po shkon? - Shkonj te kisha. - Kish nëk ka ehtizanë, po kam unë këtu ehtizanë.

- Bajram Aga, se do të vete te kisha, mos na e vjedhën Maljsia.

Bajram Aga i bëri: Po tutesh, Hosh, ti me ndenjë këtu.

Jo, Bajram Aga, s'u tuta u kurr, si e di ti mirë, se shumë herë qesh me ti. - E ndënji ati.

Pas dica zunë ljuftën e u vranë shtatë o tetë, mbrënda e jashtë. Shehri i thimosur hiri ndë mest e u dha besa deri të ënjten, sahati pesë.

Pëstaj çë gjith të mërkurën dhanë e muartin, e Mehmet Ali Pasha ngë lja ka këshilli mek kish ardhur, jashtë e mbrënda iku shpelja të ngolarshin.

Ahier Mehmet Ali Pasha e Avdulla Bej pajtuan Bajram Agën e Shaqir Agën; e ata di trima të Shqipërisë që s'mund shiheshin fare, u puthtin si vëllezër te hera e zezë.

Kur mbrëmja e të mërkurës u serpos, Hoshi i Nurës u mbjodh e fjeti te Preka, tek shumë e gjith e donjin mirë. Ati i foljtin të mos prirej më, se hapej vrejte ndër vëllezër.

Jo; se u i taksa Bajram Agës që më pati besë e më pret.

- Çë do edhe ai të thetë, ngë është e bënë e dashur prej zotit, të vrash e të jeshë vrrarë, pa ftësë të gjëj.

- Këjo po është ditë e sdredhun prej shqerie. Avdulla Pasha, se ka ndë shpi armikun e do me e vjuar ndënë qeramidhet e tij; nesër thomse të vritet me shokët e gjëritë, si e ljidhi ndera. E të mejeaqvet.

- Po tu bilj të vigjëlj e nusja e re sonte s'dinë gjë; e mbë shpi të janë pa mosnjë.

Hoshi ulji kriet mbë mushaver e më s'folji fare. Para se të dihej, që të shpisë edhe fjenë, u ngre e vate te saraj.

Të ënjten pas sahatit pesë u zu ljufta, e keqe deri sahatit njëmbëdhjetë, cilja vate ndë këntëk ndë për goljë:

*“Krisi pushka te mejtepi,
kah lufton Avdulla Begu,
për një që i dërgoi Davleti,
dy asllana i kish me vete,
si s'i ka Krali, s'i ka mreti,
Shaqir Agë, Bajram Rrustemin,
Aferim prej njaj mileti,
prej miletit t'Fundëzës,
se ata ishin djelmt e nanës,
se ata ishin djelm daji;
lufton Funda për zotëni.*

.....

Avdullah Pasha u kujtua:

- Çë ka Funda, se u shurdhua?

- Se Hoshi i Nurës u vorrua.

Hoshi i Nurës po bërtet:

Bini, shokë, të bajmë gajret,

se na ka ardhë dita me dekë,

për me dekë me pashallarë”.

Mbë sahatit njëmbëdhjetë ata përjashta hitin mbrënda e shtunë zjarmin e vranë Avdulla Pashën; i dogjën gjith sarajet; vetëm ndënji një kullë tri katësh; tek ish Mehmet Ali Pasha, Bajram Aga, Shaqir Aga, i biri i Avdulla Pashës, një djalë shtatëmbëdhjetë vjetësh, e Hoshi i vorruar me ca pak të Fundës e myslimanë. Bënë luftë atë natë gjithë natën. Për menatjet i biri i Avdulla Pashës, i djegur etje e i ljamaksur, se një ditë e një jatë kishin ljuftuar pa ngrënë e pa pirë, u ndë ndë pexherë të shtihej te Përroni sa të frihej uj, po Bajram Aga e kapi për krahu t'e hiljq mos e vrisin e atë herë një ka jashti thërriti:

- “O Bajram Aga, pa prit burra”. E i zhgrehu e i ra ai prapa. U tha, se atë natë Mehmet Ali Pasha i taksij gjashtë milje grosh ciljt t'i sill një kutrove ujë; e mosnjë ja qelli për idhënim, se ai i kumbist te fuqi e atire ngaha vijë e jo te zëmra e vet, pati hitur si gjarpër i zi e tërbuar Shqipërinë.

Rarë Bajram Aga, armiqtë hiptin për mbi të tretin kat e i dhanë zjarmin; mjesditë digjej kulla krejt, e mbë të daljun, ata që inë mbrënda, i prisin e vranë, e ashtu diqëtin me pushkë Shaqir Aga e Hoshi. Vetëm të birin e Avdulla Pashës, e muar një ndë besë, e pështoi. Mehmet Aliut i prenë mbrënda kryet e ja vunë e ljanë ndë një hu te fusha e Bajram Pashës, e kufomën xhikaran ka pexheri e shtunë mbë udhë.

20 korrik 1883

6. VLEM' E MALSORËVET²¹²

Maljsorët e Skutarit u ljdhtin vëlemje; se vetëhenë as duan t'i japën Maljit zi. Turqia, cilja thoshnjnin se ishtinej k'saj vëlemje se t'i mbanej me të, tash dërgon me i vrarë, ata mos ju dhëshin atij marguri që qe ndjeta e gjith të keqjevet saj. E gjaku zu eshprishet ku do vendi. Nani Europa sheh që bëri e tek ljavosi, kurë se t' kastionej dhistiksin, më se jater, e Turkut, dhà se ai t' paguanej, jo me turrës jo me gjë që t'i dhëmb'nej, po me të dhënur mbë t'prishur një gjind të huaj, ndera e të kërshtevet një mot: Ciljen ai pati shkretur përpara, e gjënë që asaj i sosi pati mose, e sot edhe gjelën, trahetisur për dukët e vetëhesë.

20 korrik 1883

²¹² *Vlem' e Maljsórvet* (Lega de' montanari), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 1, Corigliano Calabro, 20 luglio 1883, p. II.

7. LJËPUSH NGA JANINA²¹³

Zotit N. N.

Me shumë gaz shoh punërat që bën zotëria jote për të mir Shqipërisë e të gjuhës s'onë. Zoti të bekoft e i hapt fatin Shqipëries mjerë që ka rënë ndë mes të armiqtëve mëdhenj.

Toskërinë Grekërat e kanë mbuljuar me Propaganda për të prishur mendjen e dielmëvet e vashavet me skola greqishte.

Pas gergariat e Grekëvet (si e mbësontj unë) Dera e ljart ndë Kostantinopol ndali Shoqëries Anglo-amerikane të shtiposurit mbi gjuhë shqipe. As i jep atje ljeë Kristoforidhit të shtiposontj një Fjaljtore shqip, greqisht, italisht edhe turqisht, që e ka që mot gati.

- Ndë Dardanelë gjënden t'arratisur, si ropa, di zotërinj shqipëtarë, Vrioni Mustafà, Pasha Vliori; Avdhul Bey Frashëri gjënet, kà mòt, fialjaqi Prisërèd. Edhè ndë Rodhos di sà të tjerë, që i zù Kurtia tervitinaj ndë për shpit e tire, si kur ata duanjin të ngrëjin krie bashk me Gegërinë.

Ësht keq e gjora Shqipëri; po zoti e shpëtoft!

I faljem zotërisë sate.

30 shtator 1883

²¹³ *Ljèpus nga Jannina* (Lettera da Giannina), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. VI.

8. LAJME TË KOMBES S'ANË²¹⁴

Vëdiq ndë Kair me Kolërën Ljigor Nuçoja, një buljarë nga Korça, horë e dritëm e Shqipërisë poshtëme, e lja te dhiata pesdhjet e di miljë frënge, mek të jetë e ndihur puna e të spudhazurit gëjuhen e arbresh.

Te Mirditja i biri Kapitan Gjonit ç' i qe vëlà Bib Dodës, vrau Dod Gegën që e kish bënë të varfër, e shtunur edhe kish distaksinë jo vetëm Orosh ngaha ish, po edhe ndë gjith Mirë-diten. E kà do e zunë ndë Shqipëri, uratëtin pajolin e aksëm e Zotërije s' tire, një djallë i pesmbëdhjet vjeçë, që bëri të mirë për monë një njeri të ljik. Të ciljit te jàtëra fjet duami të thòmi gjagjë.

Stanislà Marqanò nga Shën Sofia stampàrti Anàpulj, ku kà zotëri te Nikoqirata e qishvet, një livër që shtie drit të ré tek e qëna Se Pëlasje (Plaqë) u thanë një mot ata që sot edhe janë e thuhet t' Arbrësh: Të ciljvet jeshnin dí farët më të mbëdhatë pëstajna, Epirotërat e Maqedhonët”.

Këmi na të gëzonëmi kà të bënat bashk e ndrìshe për dukët e katundit prej këta zotëra të nderëm.

30 shtator 1883

²¹⁴ *Laijme te kombes s'aan* (Notizie patrie), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. VII.

9. ANASTAS KOLURIOTI²¹⁵

Nga *Omonîa*, Efimeridhë eljenë nd' Alesandriet t' Egjiptit kemi:
 “I njohur Athenë si miku i t' Arbreshëvet, ndo më shpet si Apostoli i shëngur i t' Arbreshëvet, Anastas Kolurioti, shkuar nd' Arbërit pòshtëm se të dhezënej atje mallin e gjuhës shkeptare, nj' ënderr e mbrazët çë i shparri trutë, qe zënur prej Proksenitin²⁾ eljenë ç' ë Argjirokastër. Cilji e nxuar ashtu mbë herë duarshit t' Eljenvet të ngrëitur, nga do anë gjenden atje shprisht; e ndë mest sogjivet tijë e dërgoi Korçirë”.

Mbi këtë as duhet jatër fjalë po me i ljëfatur trushit, nd' atë e kà edhe ndo nj' i Arbresh, merën e vlemjes t'ënë me Eljent. Porsa na donjim Europa t'vëj ré kësaj ngërrë të tërbuar t'Eljenëvet me të sgjuarit e zëavet shkeptare ndë gjëritë tire. Cilja i gjet, e më i past fanë! vòlës Judhëravet me besën e ré të Zotit Krisht: kë ata nga do gjendëshin pak o shumë ndë përkatunde të huaj, si e gjegjënjin, t' egërsuar ngrehëshin me e shuatur ndë gjakët të Apostuljvet. Njera çë e Dreqëta e botës njerime e përmishur te zoti më i buti ç' i qe Romës, i pati atire shkeljur margurët ndë gjì mbë të spovisur.

15 dhjetor 1883

²¹⁵ *Anastas Colurioti*, (Anastasios Colurioti) *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883, p. III.

10. PROVERBE T'ARBËRESH²¹⁶

1. Prapa bishtin e kà dardha.
2. Kush kà gjizë e kaciq, vete mbë kurt e i japën ljiq.
3. Dialjit çë ngë qanë sis g' i japën.
4. Lupielji teke delj i vënë ziarrin.
5. Kush bën të keqen e qanë.
6. Dieli kë sheh ngrohën.
7. Marçaruli çë kà shet.
8. Palja e largë qëndron udhës.
9. Ka kriet qelbet pishku.
10. Qeni çë ljuhën ngë zë.
11. Fjalja e mirë çanë një gurë.
12. Gjuha së kà asht e çanë eshtra.
13. Dialthi ngë kà ljesh e shet paljac.
14. Bëhe stierr, uljku të hà.
15. Dhinë e mulinë kush e ruan e hà.
16. Burri me qerren e gruaja me ljugën daljën paru.
17. Bën ljist' era, frinë ljist' era.
18. Tek këcen dhia këcen kaciqi.
19. Më mirë krie miu se bisht liuni²¹⁷.
20. Ë më afër gjitoni se gjëria.
21. Pulja ç' ecën, mbëjidhet me gushën piot.
22. E di qeni ku fië ljepuri.
23. Mos nga qenin ç' ë e fië se ai ngrëhet e të zë

²¹⁶ *Proverbe t'arbëres*, (Proverbi albanesi), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Corigliano Calabro, Anno I, Nr. 3, 15 dicembre, 1883, p. VIII.

²¹⁷ *Po aty*, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. VII. (Viti është 1884 por është shtypur gabimisht, shën. i red.). p. VIII.

24. Vete tue kërkuar kaliz për ndë borë.
25. Kur zëhen mielonlëjt ruaj mielit.
26. Njeriu së kà të hé se kà ne të thetë sa dí.
27. Maljet ngë qasen po njerëzit përpiqen.
28. Nga urë kà kamnoin e tijë.
29. Kandilora si psora, kà i delj dieli i bie bora²¹⁸.
30. Kush e shanë gadhurin e bienë.
31. Misht nga thoi ‘s ndahet.
32. Çë bën gjënë.
33. Njera dorë ljanë jetërën, të dia ljanën faqet.
34. Kush i bën varra shokut bie ai mbrënda.
35. Kush lqipën gjenë kudo.
36. Çë do mizë nuk bën mialjt.
37. Sa lë rralohen presht aq ndrashen.
38. Gjela e njerëzet një qirì.
39. Gjela e njerëzet një qirì, ljoset dritës kë kà ndë gjì.
40. – Ik malj se vien supata. *Malji*: Sa të mos vinjë sfina. . . ²¹⁹
41. ‘Së janë arra gjith ato çë trokulënjen.
42. Kush ljë udhen e vietër për të renë di ciljen lja, as di atë
çë gjenë.
43. Pështima çë pështinë drë-ljart të priret ndë çerët.
44. Vetë di ljugja çë kà poçia mbrënda.

²¹⁸ *Po aty, Proverbi, Nr. 6, 30 Marzo, 1884, p. VIII.*

²¹⁹ *Po aty, Anno II, Nr. 7, Cosenza, 20 Novembre, 1885, p. VIII.*

11. AUSTRIA E SHQIPËRIA²²⁰

Thuhet nga gjith anët se Shqipëria e sipërme do të lidhet ndë një shtat nën hjenë e Austrisë. Na s' dimi çë duan atje mbrënda, e mëngu ndë Shqipëria e poshtëme, e pse do me qëndruar veçë.

Na dojm, ej e thamë, për të mirët e Shqipërisë e ampninë të Europës ajo të mos zgjidhej nga Avleti. Cilji po t'i jip ajo të prëhej ndë vetëjue me zakonet e parë; ljiqen më ja bënur pleqt e saj; e më ja dhënur kurraj më hjarom se atë çë prindët dhanë; e hasmek me të e mbanej, e ai sdëitrej me Kuvendin e Berlinit, tek taksi se i jip lehëvet të përnëna nikoqiratën e vetëhesë.

Thomse Turqit këto i doin e më, parë besën e Shqiptarëvet, e lagur gjakut më të mirë të tire te amahji me Rusien. Po Shqerë u vu ndë mest e i sdrodhi nga s'e pandehëjin. Mali zi, pse kish qenë ndën vandiljen e Ruisë, ljiqi e pati prej kësaj për plaçkë në anë të dheut të Shqipërisë së sipërme; Grekërat përdika se inë të biljt e Ellenëvet ljiptin sheshet e pritë e Arbërit poshtëm; e Françia ja desh, për durtiljë hjesë të prindvet.

Mirëfilli për gjith Turqinë të shqerrit e Shqipërisë qe një ljavomë. Aq sa kur këjo për shëndeten e saj u bë veç e u ljidhur Prisrend me vet të saj i tha gjitonvet: "Po eni e mirni"; këta një zani i thirtin zotënitë të Europës, e ngaljestin Avletin, si atë çë ndë nevojë, e se të mos jip atë gjë çë të munduri i deshtin, ljiqi t' Arbrësht të ndàh'shin "alla sicuna". E Zotënitë andëj qeshin t' hëljqura ndë t' bëme pà-hjë. Pse atò përrtròlënjin e jipin di armiqvet saj, më e grisur, një kombe, më e motimja nd' Europë e çë s' bëij keq, po e ljosur hëljmeshit: e prana me gjith at buljërì çë gjith i dinë. Atò rrëzuan bashk aq' fôren e fuqisë tire ehthra një katundi me pak shpì ndë nj' zalë të hapt.

²²⁰ *Austria e Skjiperia* (L'Austria e l'Albania), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 2, Corigliano Calabro, 30 settembre 1883, p. I.

Andëj Dera eljart a trëmbur kèq u pruari gjith kundër Shqipëisë e i dhà edhè Grekëravet atë çë atëj dònjin.

U thom se s'mundi e ng' qè për më ngaljesur se i ljà; po të përjirë ndër tà armët e saj qe punë mirzitari. Aly Beg i Gusinjit i vù përpara Zotit madh buljërisht të njemendunit e di pjesvet – Deri nani (Ai shkruati) të pata për prind; po pas çë ti më ljerëve e zì; nani s'ual Fati se Ai më m'uari e kà petkat e m'ia; po edhè t' ipërnënem u e shp'ia ime, jo nevoje ndërie, jo gjëla më tatën. Unë bilj s' kam, di i martova: varrin e kam ni hapt përpara, e sosën se të dësh no sëmëndie, no i vorrUAR për ndëren e vetëhesë s'ime. Vet Madheshtia jote njeh se ng' është drëq e mirë husmaqari t'i ordhunonjë të zotit: Ashtu ndë, sot ^ë më lje e nkë m' ké, arsh mé marrur e m' përnënur Maljit-zí, u do t' shihem ndë mest di mirzitarve çë e kanë me mua -. Këjë është ahata e sosme e maljsôrvet çë me gjeltë e tire i ndihënjen Shpisë e petkut tire se të mos i bien ropa ndër d'uar të h'ajve.

U s' kam bës se të dërg'umit ç' ecënjën Shqipërinë janë nga Austr'ia; ciljes nk' pothën sot të mos ketë më Turqinë te kràhu, po t'e shohë ndaj spërvjere të h'aj: në artën të thimosinj andej Zotënì shokë, mek p'arthin u l'jdh për shëndët të madhe. Vetëm çë prana se eljarta Derë buthtòn se harrò të mirtë e Shqipërisë shkrèt; e buljartë ja mbanë ndë hapsane pse bënë vëlëmje se të mos b'jin ndënë zotëra të rì; e nani edhè i përgjakën shpitë: mund jetë se ajò sot o menàt t'i ndënjë d'uart ciljit t'i vinjë ndihmorë. Mundë jetë andaj se nga Shklavunit e Austries i vinjën Shqipërisë g'orë të tàksura e atà të ndërsier mb' Turqinë, çë ka t'e l'javosinj edhe p'ahirë. Ciljt bënënjën t'i presën – e Greçia e l'jënë i vete pas – t'i presën kript f'arvet Shqipërisë, aljà të distaks'ime je të sht'itura veçë ndë am'ahë, se ajò të bjerë, e prasmja kumb' e Turqisë nd' Europtë; e vëndin e kësaj t'e zërë Skavun'ia e sbarrisur për mbi Apoljenë njëra te d'eti Atërisë.

12. DISTAKSITË E EUROPËS²²¹

Kà mot ej Europa rri më u ndajtur di ljuëshesh, ndo se t' përshtuarinj ampninë, ndo se të jetë gati përpara të me ardhuravet. Pse i fanet se mbanjën ampninë, aljur ashtu njera jatëren me fuqitë e vetëjues; pret nganjera pra me fuqinë e saj të dhespozinj fatin, ndë fora e madhe shtitit jatëren t'i suljet me e shqerrë e sosur.

Dihet nani se Gjermania e Austria, e Italia pas, dhanë bes ndër to; e aqëvet se Rusia e Françia kanë bashk një merë. Këtë verë prà u pà Spanja ndaj vandiljen e Gjermanies, e se edhe Turqia do atje të mbljdhjet: Nga jetë anë bënjin Kopenagë kuvend vlemje Rusia me Danimarken; tek desh t' ullej edhe Ingilterra. Mirëfilë, përdika se këjo dual çë kurë, e është edhe e vetëme mb' anë të suvaljurit e Europës; e prana tek ai kuvend as vate Françia cilja mund' thimosënej ata ç' inë jasht: ajo e përbashkëme as fanet edhe si e antirime Vlemjes t' Austries me Gjermanien. Po më shpet duan – si zëmra, e përvënur atje, m' e pandehën, me i daljur përpara ndë t' gaturit adhiasinë e Apoljesë, tek është hora ëma jonë. Pse Austro-Gjermania, se të kenë një dit' për në dit' te krahu Turqinë, hordë edhë e prëhëme, e duan të përshtuatur; e kemi bes mbí të kutënduar çë ajo të kutëndronjë kombet e përnëna; ciljat j u ljidhur të hirme t'e bënjën po të stenëme. Po Rusia e do të shqitur aso kombesh, mek pati stisur perëndinë e saj; ashtu se ajo të bjerë e t'i bjerë piasma nd' Europët. Andej ajo pret të bëgatinj akoljt e saj – e një i rrijë pas me hjoanë e prindëvet buljarë, Greçia, çë trokulën kà ca mot te diert e gjith Zotëniyet huaja – pra të përstisinj state autonom, ciljt o t'i qëndronjën evhjarimë o, si të vigjëlj, pa-fuqí t'e përmbudhënjën. Edhe Gladstoni ndo se bes së mirje te Turqia 's kà

²²¹ *Distaxut e EUropës* (Le divisioni d'Europa), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883, p. III.

më; ndo se atij i duket se nj' eterí të ndrise farvet të sosta te vendi i saj, me Kostantinopulin për to vetëm, do të mos jetë ndihëmëtare të fores të njerit e jatërit; ndo se zëa e kërshé i fjet ndë vtëjue: Ai thomse do Turqinë, e pabes, të rrasbisur nga Europa.

E na dojim ç'edhe Shqipëria të mbjidhej ndë vetéhé e ndënë dorën e t'Inë-Zoti të prît.

15 dhjetor 1883

13. KA PËRRALEZ E SALARDIT²²²

Si m' erth ndër vësh dua t'e vë mbë drit' një cop poezije tek na kemi të përjerrë për mallet e gjërisë s'anë, një të pësua me gadhiare të heljqur nga Realet e Frëncës. Pse asja, ndo te frima shejte e thielë ndo tek të pasiqirturit të dreqëten e besen buljare je t'Inë Zoti të përgjunjëme të zëavet që qenë te këto shpí t'ona, gjë nënk i gjët e të save na ljanë më të ljevduarit bënëjtarë që na qenë ati përpara nd'Italiet – tek dëjirë duket se ajo pati ljerë – . Në kam bës se vet ajo poezia françize e moçëme kà hjoà që te hjea e të ljinët më ljidhën zëmrat. Që katundi qe ndo që moti Aì që e bëri u 's kam nga t'e dij; në po nd' ajo tuke shkuar goljëshit e zëavet të lëhëvet ionashit u pati gëljitur noerije e hjeje. Vetëm se gratë që ishënjín j' e këndonjín m'e thanë t' ardhur kà Shën Sofia; në e dijin të tërë. Po i gjet atireve të Kosta Shalies kà Shën Mitëri.

Dita keq që bënej vap
 tue ljuftuar daljë e vrap,
 mbiakëshuar se fuqinë e bër,
 mieshtri u ljoth ture shërbier:
 maljën e thikës prori mbë trual,
 si edhe mendia j u sual.
 Pse po zënur që menat
 kishnjín ljozur keq gjat.
 Vate trimi e u shtù mbë shtrat,
 mieshtri viði ato shpat,
 prana u ulj e i qëloi.
 Gjegjëni po që i pësoi.

²²² *Ca përralesz e Salardit* (Dalla leggenda di Salardo), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883, p. V.

Fiëj e rrogolisnej shkrèt,
 Trimi 's mund zëi rëçèt.
 Shih se ikënaj herë e gjumit
 në vetëdijë i ljëi të ljumit:
 aq sa shtratin pra ljërëu,
 miëkërën dhaskaljit i prëu.
 Miështrin gjumi si ljëshoi
 ndau miekërën e ng' e çoi;
 muari shpatën mbë t' kjarë
 dreq ka ë trimi u sflarë.
 Ndënë gjumë ai frinej ljé
 ljulje e bardhen nd' ato hjé,
 ehj' e fanëme e kërshaté.
 Dhaskaljit j u shparr këshilli;
 pruari shpatien te mili;
 e lià shpinë i heljmuar,
 vate të jatin me i çuar.
 - Zot, kur t'ët birë më dhé,
 se shkojin ndë vetëmë
 piest e Frëncës ti vo thé.
 Ai ni gjelën, po çë nderen,
 mua më mori; e Frënca e tërë
 pret nga Ljiqua të e vieren;
 mos i nga i rritur pra ndër shpí
 prindëvet t'i bënet stihjí.
 Zoti u err po kish bé
 bënur, rregj e i kërshaté;
 lja të birin dhe buljarë
 lja t'e zëin t'e qelëjin vrarë.
 Nxuar edhe dhikret të rí
 për trí dit të mos shih njerí.
 Porsitëtin ahier suljdèt:
 të rrëzohëshin ljéth e qèt:
 - Ndë Fioravanti ng' është e fjë
 mos i qari mosnjerí;
 kund se i bën një karbaxeu

si mizie ç' ecën për dheu.
 Të ndërlòksurith e çuan,
 holë e ljidhtin j e dërtuan,
 mbë t' shtërnguar prana e sgjuan.
 E j'ëma ndë shpí ng' ë
 nemënkú më dí gjë:
 kish një vut për at' birë;
 at mbrëma vate e nxirë.
 E mb'udhë ushtëres j u fruntarë
 çë dialjin m'i qelëjin varë.
 Tutië i rriedhur gjalmarije:
 vijë i xheshur gjith stoljije;
Rexhina: Keq e madhe është mëkat
 të vëdës kí dialjë sot.
 Po si ajo u aferua
 i përlyotëm ai j u trua.
 - Mos më lieë ti Zonja m'ëmë,
 Zoti tat se më dha nëmë
 të jemë vierrë par se t' serposet,
 sonte e gjë të meje ngë soset".
 Zonja tek të birin pá
 u zalj e ká kalji rá. . .

15 dhjetor 1883

14. ZEF DE RADA (XHUSEP' I RÀDHANJET) (20 DHJETOR 1885)²²³

Diè vëdiqë' pas ljenkim të gjat, kë durò mose shtúara, Xhusep' i Ràdhanjet, i biri Dreqëtàrit *Fiàmurit*: Një trim i piasmes më të hjëshëm shkeptáre, e ndër buljartë anë keq i valjandimë të psòrvet t' Arbërit pá-fanë.

Kish ljerë Maqë, një fshat i vogël, katër kilometra largu prei Shën Mitërit, ndë Ianarë të vitit 1852.

Ndër vietët 1868-69 te Kolehxi Kurljanës, ku ritej ndai t'anë, adhiasi Gramatëkën e arbëresh; çë e nafòrtur Zonjës Ljenë të Gjìkës ç'ish fanare e Shqipërisë sai, qè stampàrtur Fiorencë te viti 1871. E shpèit e xënur nd' Europtë, holjqi retë e më të dritëmëvet për urtëri (Sklavuni Miklosich, Meyer ká Universitata e Gratz e aqë të tierë). E ajò Gramatëk, ndò mos se jo e mbúshur, se ai nk' e fërnò, të fánet si e vetem çë ká të vëna për monë themení t'as-ljuetëshme të gjuhës shkeptáre: andëi me ndiet të madhe Louis Benloew t' Institutit Frënces tek' ajò kumbisi Analisen e tijë mbí gjuhen e Arbërit (Paris 1879). Prána ai ljà të shkrúame të tiëra.

Nká studhet sùal te gjëla e përjashtëme një të Dreqët, e një të Mirë të bardhen je ponime Beses shëite të prindëvet: sá mai nk' u tha se pat' ai ndénjë armik, e sot çë e buartim bën e kuljtomi viershin katundarë:

Kush e do e njòhu e doi mirë,
ljutëtin gjith t'i bëjin hirë.

Te viti 1879 u martúa me një zonjë shpije buljare Strigariote, e motëra e Guljelm Toçit çë qè Deputat te Kuventi Italies.

²²³ *Giuseppe De Rada, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 3, Corigliano Calabro, 15 dicembre 1883.

E pati neà ajo di dièljème, të ciljëvet më i madhi, di ivieç', vëdiqë kët muaj, tet dit më parë se prindi, e pas të e nisi.

Fshati çë e pati birë e qaiti pà ljevrosí. Kolexhi i Arbresh dërgòì për piest e vetëjues di kamerata t'e pasëjin ndë ljipt. Ciljavet ju përbàshkëtin, ndë të shkuar, Zotërat e Qishës të Shën Mitërit. Iater nderë gjaku inë i shprisht nd' Italiet je zënë hëljmevet rì të Shqipërisë, 's pat nká t'i bënej.

Maqë ndë 20 të Shën Mërtirit 1883

15. NIJATA TË GREÇIES²²⁴

Ndë theristí erdh ndër katundet t'anë Prenk Gjoka Mirditiz nga Kauçinari, i dërguar, si thoi, të mbjidh turrës më i bjëtur pushka e pluhur Maljësôrvet Skutarit që ljuftòjin se të mos ishin përnënur Maljit zí. Që i kontìsur e i pritur mirë. Po, i afëruar, tha drej se údha e Shqipërisë i ish e prerë; një vá i sosej, Malji-zí; se vijë i dërguar prej Eterisë Korçirës, e se Athën kish foljur me Trikupin që shumë i taksi për Shqipërinë, e se edhe Rusia i doi mirë.

Dëlguam gjithsej; porsi përdika pak më përpara na kish ardhur ljëpush nga Maljësorët e na ljipëjin ndihmí, e Ai si, i Dërguam, u dha të vei fshat mbë fshat, hapëtim një not nafórësh për ëmen t'ënë: ciljat të jipëshin kurna të gjëndej kush shumë i njohur të taksënej se ato ja shkonej Maljësorëvet, o bjenej për ta që i ljipsej. E se t'i kishin atij bës i vumë ndër duar, t'e buthtonej, ljëpushen e Maljësorëvet.

Gjithparu u shkruatin te ajo not. Po nd' atë që ai shkonej fsàtevet, e që kërkojm kush naforat të hjumpazënej për ata kuj i jipeshin, Maljësorët patëtim të ljejin armët, e të mbjidhëshin mbë shpí. Ljipi ahier Prenk Gjoka turrëst për Kuvendin e Korçirës, që të mbanej atej ziarmin të çeljur ndë Shqipëri. Ma nënk dha mosnjë më se atë që j u desh të vej Rromë.

Atje çoi ato gënjeshtërlja të vjetëra, që më parë tërbuan zaljet e Europes për dukët të pak shëmëtimve; po çënaní qeljben që për së largu: E atej thonë se i pati shkruatur mbëretërit se Shqipëria 's ká jetër projt ampnije se të ljidhet me Greçien: ajo ndër çipet e Turkut 's mund' e thëtë; por Prenk Gjoka, i dërguami i Eterisë t' Eljenvet, e thot për të; e i bënëjen bës ndo nj' Ditare ljëtire, e ato gjith të Greçies.

Poka Shqipëria do me i qënur dhënë Greçies.

²²⁴ *Nijatta të Grecies* (Le insidie della Grecia), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. I. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën i red).

16. NA SHKRUANJËN MBI KËTË KA TOSHKËRIA²²⁵

Pashë ndër Ditaret greqishte te Permendëjen, ciljen Shqiptarë nga Gegëria, nga Maqedhonia edhe nga Çemëria dërguan ndë për rigatat e Europës tuke llijpur bashkim me Elladhen etc. E ndermja Ditare e Triestes, *Imera*, N. 465, 10 të Shën Mërtirit thot “Se këjo e shkruame me vetëm një nënëshkrës nuk’ duket fort e vërtet. Perse s’gëjith Shqiptarët muhamedan edhe katolik janë keq të ndajtur zëmres prej Ellent për fanatism e besës”. E nga të jetër anë, çë të mirë i bënë kurraj Ellent me ljidhur zëmrat e Shqipëtarëvet, ndo më shpët çë të keqe nuk’ i bënë? Vëçë se E. M. Olga mbëretëresh e Eljenvet xú mirë gjuhën shqipe për nderë të Shqiptarvet. Unë donja të pies përsé të mos jetë ndë Elladhet një shkolë edhe për gjuhën shqipe, tek gjënden 4 ndo 500 mijë Shqiptarë të vendit? . . .

Një Shqiptarë ngaj Toshkëria

²²⁵ *Na schruánën mbi chëte câ Toshëria* (Ci scrivono dalla Toscheria), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1884.

17. T'ARËBRËSHT E KALABRIES²²⁶

T' Arëbrësht, si, pas çë Turqit i muartin gòrèt, arrëjin nd' Italië, qenë shprishur ktú kètiè për gjith regjërinë, po më të shumet vanë ndë Sixhiliët e ndër Kalabriet.

Te Kalabria e pá, atà janë të ndarë katër goneshë, të gjitha ndër këmbë të mäljvet çë atë rriëdhën, me Speccanen ndë mest, e Falkunaren e Farneten tutiè mbi di deitet çë i rrinë ndai Petku ndër tà gjith, është i ndaitur ndër shumë duar.

Gjasht katundet të Shën Mitrit, Shën Sofisë, Maqit, Strigarit, Vakkariccit e Mbuzatit, kanë, çë Bezënjänë njera Kurljanë, zalit Agrattit e përpiëljeivet e maljvet çë ngeasen Akren, dhëra ku bëhen kështenjat, ulinjt, vreshtat, mëntgjërshitë, portogaliët, ljen urist e prá më t'ëmbëljit karponjë, me dusqie e ljuhëdhe për dhí e dhën e qé.

Atà gjith kanë thomse të ruamen më të mirë ndër katundet e Kalabries, psè, nestru Shën Sofia çë shëh maljet e voresë e të perendimës, mbëreth përtèi Gratin, stisur mbälj rëhjeve të tieret pes, kanë përpára, me sheshet e maljet ká vorea, dhe détin Ión. Kanë prá ajër e újëra të mirë.

Gjindia është e fuqíme e dëljànë mbiatu gjithsèi, por andai thomse pak logazën. E u duk ndë mot ç'ërdhëtin Françist ndë Kalabrie, kurna këtë katunde rrojín vëlezërish të ljumë, me gjith të mirat, pa frimë të guaj – se njera ahier bijë mbrëmanet kumbora pas Vemaries, e kush di Ljëtí kish t'ish i daljur ká shpitë e tire – po ahier fríma e guaj i sdrodh e ndaiti ndër vreita e shpí të diëgura. E atëina u shkretëtín aq e më se gjith Mbuzatti e Maqi. Andai mund i thuhën edhë viershat çë Enni i tha prindevet tire:

*“Stolidum genus Aeacidarum,
Bellipotentis sunt magi’ quam sapienti potentis”.*

²²⁶ *T'arëbrest e Calabries (Gli Albanesi di Calabria), Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. III. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën i red.).*

Kètà katunde u stistin mbiatu pas ç'iku i biri Skënderbeut ká dheu tijë. Pëstài, shkuar mot, e Grekërat, çë t'Arbreshëvet 'si kishin dhënur dorë te amahji preiveshtarë, bierrur Morenë, ndënj edhe mot për bèsen e kërshhtë atië e Arbrështa Koronë, me Modonen moter, të rriëdta e ndigura anishit të Karlo V. Atië erdhëtin prá ndë ubrìh kaljortë e Rodhit, e bashk gjith ljuftúan kunter të tërë fuqinë e Zotit Madh Sulejmanit, njëra çë të ntretur si ishin pak, ata çë qëntrúan erdhëtin bashk mbí anitë e Spanjës, e vanë prishur te katundet ç'ishin t'Arbërësh te dhéu ljetí. E atei buljarë të mirë u prëitin Shën Mitër, Maq e Strigarë. E perdika se me ta u kinë përzlier edhe Spanjòlj, shumë ëmra ndër né janë Spanjòlj, e astu kemi Liopësërat, Kurtizërat, Pisarrat Ljarà, thomse të Radhnjet e të tierë.

Kurë ërdhëtin ndë Italie, t' Arbërësht e Mbazattit e Vakkariccit, qenë dërgúar te feudi Dukës Kurljanes; atà të Shën Mitrit, të Maqitë e Strëgarit te Badhia Vasilianëravet; Shën Sofia më tutië, qè midheur te feudi Prinçipës Berzënjanes, ku ish Zonjë e bilja e Skënderbekut.

Atà jo vetëm dhera të punòin, po Koronërat ç' erdhëtin pas kishin edhe nka Karl V 70 dukat ndë vit për fëmíljë ka minierat e hëkurit; e bashk gjith, privilexhet çë kinë ata të Liparit, aq çë mund vein me shpaten edhe përpara Rexhit.

Pas çë Kuventi i arbërësh shkoi Shën Miter, kètà katunde dërgoin shumë nká të biljt e tire, pse nkë spëndòin shumë e se ishin afër: e u bë ndër tà drit e madhe; sà motit pas' nká shpí çë pat gjë i qè mose ndër duar Zoti çë díj shumë o pak Latinin e Grekun.

T' Arbrësht ardhur nd' Italie, jo vet se mbàitin gjuhen çë kishin, po mënku zakònet e tire nënk ljerien, e anamesa Ljetinjëve, mbiatu se janë t'ardhur ká njeter dhé shúm ndrishe se ai ku gjënden.

Martesa e vëdëkia ndër t'Arbërësht nkë bëhet si ndër Ljetinjt; të brëdhurit e burravet janë rroljia, liufta, të shkrëgurit te shëngu e të thieturit. Gratë ljuanjën cukulin e brëdhën te cickadhiàrëza, cilja është e bënë me di drunje, më i shkurtur njëri çë hinë ndë dhé, jetri më gjat kumbiset sipr të parit, e silet pas çë i hipënjën siper trí o kater vet; taliuanjën edhe te shehënjën një unazë.

Te martesa prána e ndër garetë e mbëdhá, grá e burra, zënë valen e këntonjën këntkat e motit pár, të ljera ndë dhét tire. Bashk kètà fshate kanë më se 10 mílj vet.

18. LAIJME TË SHQIPËRISË²²⁷

Dhiovasmi ndër Ditare ljetire aqë të rrëfjeta t' antirime ndër to, ciljat ndo nkë janë, ndo mirë nkë dimi se t'i speljirmi.

1. Se te Maljizí janë e adhiasnjën 4000 ushtërtorë me ciljt të marrën Gusinjen.
2. Se Maljizí i jep pushka e baràt Shqiptarvet se të venë t'i marrën e t'i japën Gusinjen.
3. Se di farë t' Arbresha hitin te Maljizí, xheshtin, vranë e dòqëtin.

Na dimi vetëm me gjith, se te Sinodhìa Berlin, i kishnjin, me i benur hirë Rusies, dhënur Malji-zí, bashk me Antivarin e Dulçinjin, Gusinjen, një katund Shklavun ndër maljet. Po Aliu nga Gusinji, çë mündënej keq mbi vlemien e ljidhur Prisërend, me tintibú se Maljizí andej vijë e përhapej mbi Gjakovën, Ipenë, Reken e të tjera horë t' Arbresha, shtiti Shqipërinë e sipërme maumetane me daljur e u vënur përpara katundit taksur. Ahier Avleti me Maljin-e-zí u ngolartin mbë të ndërruamt Gusinjen me horë t' Arbresha të kërshtea nga maljet e Skutarit. Po këto së deshtin të Maljit-zí; e bënë simpjet çë shkoi amahj me Avletin vet.

Duket nani se t' asljuetëshmit e zëmrvet të Maljësorëvet, ndo se te mundur, i pati gavënjër ndieten; e Mbëreteritë e Europes i kanë pasur dhënë ljiq; sa pameta Majli-zí do me u përrjerrë Gusinj. E kí ani, foka e përierra e tij është gjë të mirë çë ai i bën Shqipëtarëvet të kërshaté, dò nga këta të venë me të të marrën Gusinjen. Videvarë se edhe Maljizí çiauvuk pramatisen se të vriten ndër né vëlezër me vëlezër. Po hera shkoi, nd' Inë-Zot dáf.

Nani, ndë ato Ditare të huaja as thonë të rremen, t' Arbresht çë hitin te Malji-zí kanë pasur qënë ata çë me maljësorët e Gjakovës rrodhënjën Gusinjen. Porsa pra çë nkë dimi aljà nga ata vet psorët e rea ku gjënden, mund' edhë të gënjihemi.

²²⁷ Laijme të Skjipëriis (Notizie dell'Albania), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 5, Corigliano Calabro, 30 febbraio 1884, p. I.

19. DOD GEGA²²⁸

Nga Mirditia qe edhë Dod Gega.

Kish ljerë Orosh, e, si më të shumët, gjëllinej ndër petka Beyrash kë m'irr për miet. Ashtu shkoi pra ndë dhët Gjakovës ruajtār ljòpësh, tek u l'jìdh me letër maljësòr, e u njogh i stenëm kurmit e zënë.

Atejna kriet e Zotënisë turke i shtunë sitë siper e m'e korjirtin.

Psoi një dit se ndë Puk, nëntë orë largu ka Skutari, erdh në matëshër Elbasaniot, Braim Zaka, që mbanej kriet mose të bindur posht mbi kufarin. Kurna diljin e bënjin taljim Jusbashi i thoi: Ngrei kriet; e ai 's e bëij. Njera që Jusbashi i vū një picigū nën miekëren e te gropa e fytit, ndë mest të qeshurat e Turqëvet. Po, sosur taljimi, ai vate ndë kaljian e u mbulī mbrënda e j a mbuliti gjithve, e i shkreku atire që qasëshin t'e gapëjin. Shtat vet vrau ndër shokët, sa mos një më guxoi të fanepsej ngaha ai arrënej me sī.

Egjël di dit, tek e treta nat i ndìgur prei shok t' Arbrësh duali; i shpëtoi Orosh nd' ubrigh te shpi e Kapitanet. Pas ca dit, për ordin ç'ertth prei Stambul, Zabiti j a ljipi atire të shpisë o të gjalë o të vëdekur. Ata u përgjë "Se prindët e tire as kin kurrai gënjier të kontisurt e tire, e ata për një jet' mënku të ftesëjin nderën e prindvet". Nododhej aghie i përjerrë Orosh Dod Gega; me ciljin Zabiti bëri pramatī, e i t'aksi se m'e bëij Jusbash.

Ki j u afërua Braim Zakës e foka e magjepsi. E ture i shkuar, miqëvet, dit e jārë, e i buthë-tuar Ai ljëpusha të Zabitit, që i taksëjin ndëljes, një menat e nisi e qeli Skutar, tek e shtunë ndë hapsane. E pasandai e dërguan Podgoric e atie e vranë.

²²⁸ *Dod Gjegga, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 5, Corigliano Calabro, 30 febbraio 1884, p. V.

Dod Gegën e bënë Jusbash. Shpisë Kapitanet i nditi aq keq, sa akolj të sai vanë e atij i vranë as di ndë ljaljën o të vëlanë: Se gjak për gjak, si është zakona.

Mbi atë Avleti dërgoi mbë shpī Bib Dodën, një dialjë nga Kapitanërat që dhiovasënej Stambul, se ai të qelnej Mirditist te amahji me Maljin-e-zī. Atie po u mbjodhtin pieqtë e Fares e bënë vuljī; pra u përgjegjjetin “Se Zotënia kur holjqi ka gjiri Mirdities një senī e m’e vrau, as mbaiti më paitin e Dukagjinit Ljeshëzī; e andei edhe ata inë të sgjidhur nga ai pat, që j bënej një dëtirë t’e perkraghëjin nd’ë amahjë”.

Aghier ushtër Turke nga Skutari u ngjit ndë Mirditie me preiveshtarë Dod Gegën të rriedhur letërish nga maljet e Gjakovës; e të ciljit gjëritë e miqët vejin tue nkaljesur Kapitanet, se të porsitur me Francen bëin të sgjidhëjin Vlemën e Bri-drenit; ese ndo pse e kërshhtë, ndo se gjërī me Vladiken, bëjin t’i jipin katundet e Arbërit Malji-zī. Andei Mirditia u mbī e druetëme; e shumkë nkë piljastin me vantiljet e Kapitanet: ciljt qenë të rrasbisur; e rā ndë ljugadh zoti Gjon. Dod Gega shkoi përpara e i dogji atire pëlasin. Pas këto qe bënëur Baraiktār; e, si gjith paru nga korronxī prei fuqinë e Zotënisë të kui të jetë kriat, dhe Ai muar burgamë pa vujun ka kumbī e Kurties turke: sa një hjë të keqe pati shtunur edhe mbi fanë e maljësorvet Skutarit.

Ndë viesht pra simpietëshkoi i biri Kapitan Gjonit si ghiri ndër pesmbidhiet viet atë përmbudhi ndë tregth t’Oroshit me pushk e i dogj stomahjin.

20. KOLLEGI I ARBRËSH

Kuvendi i arbrësh që sot është te monoshtëri Shën Trianit përtëi Shën Mitërin ka perëndíma, që gapur të pàrën herë te Kolonia e Shën Benëdhítit.

Di Shën Benëdhítitòt vëlizëris ngá shpía buljërësh e Rodhotàravet, te dërgúar mbë skolë Romë, atìe mënúan bashk: psè njëri, Pompili, u rritur shkòì bibliotekár Vatikàn; jàtëri, mose ati nd'aft të krënëvet te Qìshës, múari nd'atë gorë këshyl e besen t'i gapënej një kuvënd t'Arbrëshëvet ljerier, e që kish mot e mot shprisht ndë dhé të gúaj.

Thúhet se kí, I-ljumë èmrit, pàr se t'i përpàranej Papës (Clemente XII) parkalesín përgjëndien e tíj, ngá menàt, te nëntë dit, e vëi, si e kish të shkruame, ndënë kalëçin kúr thòì Mëshen e ja trúanej t'Inë-Zoti. E Papa hatròì atë të bëshme, si ja e nafòrti. E bënë vuljí t'e gapëjin Shën Benëdhít te kë di vëlzërit kishin te stisura përgjëndien, e shpía Korsini, ngáha ish Papa, kish petka me k' e paljtòì. Dësh e Papa edhé më, se të mblidh katúndet e arbrësh ku do vendi nën një Pëshpëkat të tíreve; te gjìri të ciljit të prëjin besen mekë kishin ardhur ndë dhét ljetí. Po Zotënia e Anàpuljit që i kish kontisur si mbë të varèst e i shprishur, nënk dësh; se atà të mos njìghëshin një gjëri.

Aghier ato Zoti t'arbrësh kë bëri Arqepiskop, Papa i ngrëiti mbrënda te Kuvendi ç'ish i qishës thron Zotërije mbí Skòlen, e i vú ndër dúar nikoqiraten e Priftënisë je të Krismes mbàrie grek.

Ashtú te viti 1736 u gap Kollegji, si déra e madhe e dritie te but' e të ré gjithve shpívet t'Arbrësh: të ciljavet atò që mündëtin mbiatë, dërguan të "biljt ndó priftëra ndó buljá" se të m'i prirëshin. Të piljasurit përgjëndien atìe mëft tries e skolë: shòkët kë prít' jeta pagùajin jo më se një zèt dhukat (frënqe 85) ndë vitët; po klerëçit, me binësh e serbeljic mbë qish, të tíerët me te vëshura katundàre, xëjín një skolie, rríjin përzìer ndër kàmarat.

Kuljtima e ëmës s'anë, ljerier të gúajvet çë i mirrin besën ditë pas ditie, shighet e ngrëitur tek e para faqe e Buljës çë kumbisi at Skolë: e ajò kuljtímë humbòì thélé e garémë tek zëmra e dièljmëvet çë atìe u mbjòdhëtin. Andèi u zú ndër tà e u mbush prèi të pàrèt çë atèi dúaltin, këshíli të mbjidhin këntkat çë të sièlja ká dhéu prindëvet edhé kuljtòghëshin: psè ndër to pasiqírej gjéla e hjëshme e arbresh, e rrëfighej diftihíj e trimavet pá fanë, të cilivet atà ishin pajòlj edhè nën dielin; e andèi na múnðetim të i pèrpàrajim papá botes s'anë, si një stem' buljèrìje. E tek vet ai mòt zú e u shkruá gjúga e arbresh; e ndër rrimë të marra gúa u gjèg o më shpet' u pá Psóra hinuès e gheljmóre të Zónjes Shën Merí; ciljen na të nxiérmi shpèit, e të piot spélj se edhè ajò të hatròghet me ghír.

Ish ata të hjaràskuret të rí të ditës s'anë ndó se tutiém.²²⁹

Dí méré kish ajo Skolë:

1. Të xënen e mistírit jetës, cilja j u bë e ré të Kërshtëvet si janë rietin atà të ndìgur të ghéljqën me të pròthème ngà ujana, e mbí atò të ftúar te buka e pishku i shkuar ziàrmit ke i shtròn Gjéla e stoneónme parastème. Teologjia, Liturgjia, Storia e Qishës nën të mbësúamen e Prindvet shëitëra, të Elladhës mbí gìth, qenë andèi të vënura kumbí të fatit mirë.
2. Pas atò i shpighej pèrpàra hjéa e búrrave të dhéut t' Elladhes e të Ljètírit, zòtëraçë ndríshtin jetën me të bëna e të pasura të mbëdhá; i xënur gjúghen, po se nd'ato pasiqíra të i rritej noëra e zëmra e ré diàljmevet.

Këjò e pèrjerrë e révet Gjéles mose te ditët e shkuame, dúket se edhè i sinodhínej gjërisë s'anë, tek e shpríshur zàljeve tek e pèrnënur të gúajve të verbër, e pèr andai me psorë mose vobèk te moti ku ë.

Ljanë shkruár Skolèlj të atíj Kuvendi nd' at motë, se një ndër tà, Xhan Franqisk Avati ngà Maqi pas dí u ndë në vit të xënuri, i qéltur Romë, mé bënur Papën gosnúk i dhiovasi pèrpàra e i prúar talianisht gjë t'Omérit e të Pindarit. E mose prá dúaltin atèi t'úrt tek atò gjúghë, dhe ndën dí të tièret Peshkëpëra çë pastin, të zgjèdhur si i pári, shpísh së míreshi, Nikolë de Markis nga Ungëra e Franqisk Arqòpoli nga Shën Mitëri. Sa vet throne i Qishes Romë, kë harëpsënej aiò e stisur e

²²⁹ *Collegi i Arbres*, (Il Collegio Albanese), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 5, Corigliano Calabro, 30 febbraio 1884, p. II.

karpúamirë, dësh e vuljíti te moti këtire jàter të pròthëm kombes' anë vobèk. Mbretëréa e Anapuljit bëri e mbuliti monoshtirin Baziliàn keq të bégat të Shëites Trinitàt Milèt, po nga petku këlògjervet kë Papa i lja asai ndër duar, qëndruan ndë bes se katër miljë dhukàt nga kamati Mbretëria kish të ja shkonej fshatevet t'Arbrësh, se të gapëjin atà skolë për corrobìljt. Po këjo mënòi të jip, e gënjètare me at kamàt pagúanej krèrat e vargarívet t'arbresha ciljat Anàpulj i mbanjin kághët. Njër çe ndë këmbë t'Arqopolit pati Peshpëkaten e t'Arbrëshvet Franqisk Buljá i ngá Shën Sofia. Aghier u ndodh Ministër i mbretërisë Tanuççi, njerí vuljemiemirë çe u rrèthi buljërije t'urt e të marrë, si vet ai, rëshit çe ngrèghëshin prei gjith anëshit, thòshje, dreq qiel të rí. Kish bërritur edhë se gapënej ljugadh te kë të sgjidh katër dhàskaljëra për katedhra te gjúghie eljene të përshtuarta prei vet; e kish edhe xënur se të zgjèdhur kishnjin qënë katër diàljme të Kuvendit t'Arbrësh, ndër cilit njëri ljëti, Vèteri ngá Kozenca. Andèi u bë gjith i ghírëm vendit t'arëbrësh. Sá Buljári e Paskál Baffa, një ndër katër të zgjèdhurit edhe ai i ljerë Shën Sofi e çe ngá mesi të tièrvet, psè më i aresi-góli kish qënë shkúar Bibliotekár të Bibliotëkes ré t'Anàpuljit – këshiltin e valjandistin me metarosur dhurtíjën e Paps ngá petku Baziliànvet Milèt. Vet se jo per fshatet t'anë, kúja ish, e ljiptin por ja deshtin Kuvendit e Skòlëvet kë ai kish mbrënda e Buljári dhesposnej: e mbase për andàina e patëtín më kolài. Se ndër të rárit e sekulit shtatëmbëdhietëm, i qè ajo durtílj ndërrúar me Badhinë e Shën Triánit; tek Buljári, përzënur këlògjerit, shkòi ngá Shën Benëdhiti dièljmer e shpívet shkeptáre.

Kës i ljevdúar pati qënë Buljári për bégatinë kë i gati Skóles së kombes tíj; po ljevdía ehjóì aq edhe, pse ngá atà çe prisin duk për vetëtà andèi, e ngá etería e révet e viviljèvet e rea, me cilien ai dukej i përbashkur. Porsa nuk qè abonsína shumë e drèqëte ajo e bënë e tire mek vapghëtúan katundet, se të ngosëjin Skolen çe për dukt e katúndevet kish qenë e themeljitur. Nè përdika se qè mose adhèt e ë t'i jipet Nikoqirit përpára ngá buljbërt e gjith nikoqiratie e ndó se prána pak gjë të soset ai çe t'nikoqírinj për të zòtërat e gjësë: vete i shkalljësuar ai peshpëk e ai buljár ngá e as-drèqa.

Nestru se u duk mbë drít shpèit e vonu si “tek kufóma atiè dhe bugjárdet”. Mirë-fíl Bellushi çe perkëmbi Buljárin, mundi pas çe vèdiq të ljei shtat miljë dhukàt ng' ajo bégatí te sènduqí Kuvendit; edhe

për sá rròì pati atei pasur hjaròmt mek jifi skoltë e réa të gápura prei Buljarit: ajò e Filosofisë e Ljiqes katundáre, e Matematëkavet e Fizikës: Porsa i rritur ai Shën Benëdhít mbë fialjtë e plëqëvet, u kish përbënur i zgjidht gjith ngamatije të grismesh e buljarë. Por pasandài u pá më e më se për të shumë krënj të Skolës, diëljmet e Arbëri si të bierë sishit, trapëza e Shën Trianit që diàthi i përràles tek u mbulí miu me merë se andèi të mos e shkúljëjin: e një çë sosi vet korqa e përjashtëme, rarë gjith adhiasía e më tepër të Skolëvet mek Buljári kish mbushur të gëljturit urtërisht e gjindies tíf.

Ká jeter anë mberë të dhurëtiljes, si ajo dúkej, mbretëria çë jip desh e pati të kish prá dòren dhespotime mbrënda te Kuvendi çë më pàr që i t'Arbrëshvet e jo i më njeriu. E sot rri fanést përpara sivet anë si ajo dorë e guaj na e ká pasur svisur. Keq e madhe e mbëkàt që këjò abonësina.

E vet prá dúarshit Buljarit të sgjerúart e dashur aq e 's dínaveu u zgjidh, pár se atà rrekur mbë karpúa. Psë ai me skolen mose i shtërfundur àjërashit përjashtëm; një çë ju shúa dita ndën pushka e thik të margúreve kriët, si thúghëshin, e Zotërisë çë tet viet' prap kish dhënur vierrë Anàpulj Paskál Baffën.²³⁰

Moti çë Pëshpëk Bëljushi ngá Frashënit i që dhespot, shkòì si dita e atij Kuvendi. Thomse gjúga ellene nk' u xú si më parë, po ljëtiria ëgh; dhe ghítin aghier e u dhiovàstin me mál livrat e krënjëvet t'urtërisë taliane. E mbí gjith fora e hjésë vetëjús e dàrqur prei shemblemërashit e Romës ej Elladhes, i dhà gànjunve kuturé të besëme, dàljur atèi, të matëshin ndë shësh të dities, me të biljt e sgjèdhur të kombevet gúaja.

Te viti 1833 vëdiq Pëshpëk Bëljushi. Por adhiasí e të xënit e vënur tek vietët e pàra e dhespothisë Bëljushit prèi dòres hëkuri të Mikelangjol Russanit ngá Fërmòza, rròì te kuvendi më ca mot; e ajò me ziarmin aq të dhëzur të mbories, mbàiti shtuara ndërën e màdhe të Skòles s'anë.

Pëshpëku çë e përkëmbi, Gabriél de Markis, i urtë e shumë i mirë, ish keq pjak; ej e mundi notía e të timi e dìmërave nd'atë monoshtír: sa u pati mbjèdhur Ài ndë shpí, e i ljà déren gapt Mbëretërisë. Sgjàdhi këjò me Papën Ljëtinj bënjapèsëm të Dhespotisë pistepsur. Thomi se këtë kanë qënë të mirë; ma psë ata rrijin lárq, priftërat e arbrësh ciljëvet

²³⁰ *Cuvendi i Arbëres nd'Italiet*, (Collegio Albanese in Italia), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 7, Corigliano Calabro, 30 aprile 1884, p. I.

i patëtin besur nikoqiratën e vendit, as patëtin pëstài jàtër kuidès se t'i goditëjin ghíren e të ja bëjin; tek ata dinjin se kriétët e Mbretërisë, që i rríjin afer, i mbánjin sitë siper. Ashtu Kuvendi inë i bukur, autonòm, sosi një shpí mbí prindët e ciljes zotëronjin te guaj. E kúr si që mose vátër ljeftërije ajò flagu përjashta mbërdhëçëk, e marrur mbí sí j'e pá-ndigur o mbëzìth prèi papës, búari edhè ampninë e përmbrendëme që i ljìpsej. E qendròì aní e pá-udhë e pá-vend-t'umbjëdhuri përpara, e grisur àjërashit e merëngshit ndrìdhëtare.

E këjò shkretí edhé më u përkëq ndë mest përzites t'Italies. Ndë na dúan kèq, o mirë si thonë, e dinë atà; ajò që fanèst na rrí përpara është, se nestra Garibaldit që t'Arbrësht njògu për s'afëri ndë ljugàdh e i dësh mirë, aqë Ministrat e Mbretërisë së ré kush ré s'i vú, kush bëri t'i svisënej.

Te viti 1860 Ministër Skura, një i Arbrësh ká Vakkaricci, dèshi e pati bès se prirë Kuvendin te themeljitë e te mbòria autonome e motit parë. Po si vëdiq ai mbiatë, Mbretëria më s'e ljà t'i dilj dúarshit. Minister Mançini, o se nuk dëljugòì Dekrètin e Garibaldit, o se bëri si kúr s'e dëljugòì, s'e ljà të përkëmbej: ndómòs se antirisënej vuljinë e mbretërisë tek inë aq më të ponimë se Aì, edhè Dekretin e rrëgjìt me të aq dorë-gapt. Kí njerí ca mot më përpàra, kitun diu sá sentencie të thrònit ljiqes, i múar t'Arbrëshvet t'Italies qìshen grek t'Anapuljt e ja dha Ellenevet gúaj. Zotëria e Elladhës i vúar ndë xerkut aghier Krìqin e Zotit Krisht.

Andèi Peshpëkata, ngáha aqë të pritura ndër né, e prunjt atìre zotërave foka as sùali gjë të vetëghesë. E gjithsèi pasandai është atìe pá vetëhé. Simpiet shkoi Minister Ianucci i dërgòì Nikoqiratës Kuvendit parkaljesín e nji Ljetíri: "Se atìe t'i rritëjin të bírin pá pagúar". Peshpëku i pari e te tiertë me të u pëgjëgjëtín. Se Bulja e themeníme të Kuvendit dhespòzi të mos rritëshin atìe mbrënda mëst mënku t'Arbrësht jo të pagëzúar grèk, ljìp ndë Ljëtìnjt; se jìpej, mé i pianepsur priftëra fshàtevet vobèk. Andài ajo Buljë vú edhé se nd'atìe prána t'u kish pasur rritur pá pagúar i Arbrësh që prá u xú se ish pagëzúar ljëtí e 's mund' béghej prift grek, të jìp ai nji ghèrie dètìren e vietëvet që kish ndënjur atìe mbrënda. Nestru këtë se sot për sot Scola monu rrij shtúara, e 's i jìp të gjëlìturit mënku atìre që me ljìq e ljìpënjìn". Ministri me burgàmën e Statit ndër kraghë, ordinarti se Ljetírin t'e mbjìdhin e t'i jìpin.

Janë ëgh edhé të dréqt e të mirë nd'Italiet, e Mbëreti vet as dí, e mose tutiém Ài kësàì vrámie por te nikoqirata e Bënjapsëmëvet despotía ë më spét e kesì njerëzis gjá-gjë. Pár se atà të dì, u désh se Ljëtìnjt të ndájin me t'Arbërësht Kuvendin e këtìre; e prana dhàskaljvet atie mbrënda i ljanë të mos kishin patentë, do me thënë të díjin o të mos díjin, si gjith një. E ljuftúam me tà!

Kètò ku vrëjin mos tek të shúaturit e Skolës, çë kish veç' drìt' për né? Inë-Zòt dí e ká ndë gjít tíj kë do i ndìgu kësai punie kunder mëmës anë nëmur. Njó értth si pandehjej, gherë çe e pá-harom mé shúatur dëtirë të madhe, j'e pá kush t'i jap, pse dóra e gúaj i ndàlj ngaha të ndìghej, (e miq e armiq ni e nëmënjën) ká ndò të shësh të petkut ndó simpìet të mbulìghet.²³¹

231 *Cuvendi i Arbres*, (Il collegio albanese), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 70, Corigliano Calabro, 30 luglio 1884, p. III.

21. KU E SHTINJËN?²³²

Erth ndër né pameta Prenk Gjoka, po jo më pedhot i vuljisë e të mos u ljidhurit Shqipëria me Elladhen. Pas që stampa eljenë tek e psuamia e Kuluriotit sbuljoi dreq, e pa-balë j' e ljene, këshillin të ljidhënej Shqipërinë te qerria e vet, i shuatur të thënen te gjuga e sai, nga i Arbresh do të ndienj edhep t'i ndighnij tek të ndridhurit e kombes tij. Pse njoghëtim ndë një gjelë të gjat e mund e thomi, se ndë vënë dorë së bënje të keqe për botën e tire një i Arbrësh e jatëri, ata nënk e dinë; po të gënjer prei faqie se mirie, kë i buthëtonjën se asai nka ajo e bënë është me e ardhur; j vënë dorë. Pak është ndonjë që për ndieten t'i bënë ghirë ngaha pret buk e të ngordhur, ljavosën ëmën t'ënë aq të ghejmuarën. U dua këtu të zë filë di buljerë ndër të mirët kë na kemi, Kost Zapën e Kristaq Zografine me fialjtë e Kuluriotit tek Anasqeva e vetëjues.

“E me kadarsgji shoghëmi se di zotra aq të dreqt me gjërinë e tire qenë të vënë ndë thest prei ca gjims njerëzish ç'i ljëpinjën taljurtë, e çë aqe fuqi patëtin mbi ta sa me gjë ç' ishtunë sipër farmëkostin mburimen e ëmbëlje e shëndetëme e të bënave tire aqe vuliemie-mirë”.

Pse këta di buljerë t' Arbresh zëmër-mbëdhenj, çë gapëtin shkollë elenishte, si gjetk edhe ndër fshatet e Arbërit, e patën bënur për nderë të tharosit të vjuar pë gjith gjindiet te gjuha e moçëme të Elenëvet; me bes edhe se katundarvet tire noera t'i dritej, e zëa t'i rritej tek ajo pasiqirë gjelie më gadhiare. Po si të shoghën, e shpeit, se Grekërat me ato Shkolë jo bënë të gëljiten Shqëptarët hëshëm te piasma e prindëvet, me u përzietur andei me ta vëlezërisht, po at piazëm se t'i se t'i ljëfarënjën, e nën ta ti prunjtënjën: ndë kanë gjakun e prindëvet ndë zëmër, ata të di do të metanosen keq: si tash gjith katund i arbresh çë vu vetëhenë për dukët t' Eljenëvet. Se sot besa se Shqipëria ej Elladha janë një kòmb, rà gjithparu; e kush e rrëfien kotikun, atij fialja i është ka zën margure, e o mbrazët se dimie.

²³² *Cu e stinën?* (Dove lo spingono?), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 6, Corigliano Calabro, 30 marzo 1884, p. I.

Andai nani Prenk Gjoka ljiipi mirë jatër prei nësh. Laijmi po na t'i ndighëjim Shqipërisë me u ngreitur njize e u ljidhur Eterisë madhe t'Elladhes, Servies, Rumenies, Maljit zi e Bulgarisë, te cilja të jetë ampni esai j'e t'Europës. Se përkëtë Ingilterra e ministra t'Italies duan t'i japin dorë së ngrëiturie e t'i gapënjën udhën.

Këjò emë-qënë duket mirëfie për-së-largu, na u duk edhe neve në mot-proiti t'atire gjindëve e të valjandivet t'Europës. Po kush sot të stisinj at proit, nga të trubuloghet thomse, gjith deti e t'i rrëparet i pari?

Na thomi pak jo shumë: "Se Elladha, Rumenia, Servia, Bulgaria, Malji-zi, çë kanë zotërinë e vetëues e duart të sgjidhura, të ljidhen jndër to. Edhe Ingilterra, e kush do mund i vinjë ndër kraghë ndë Turku e ndo njetër t'i antirisinj. E aghier Shqipëria do t'i provëdhirinj vetëjues pas një të bënë çë ka përpara. Ndrishe donjim sbuljuar gjarpërin e zi çë e porsin ajo të ngrëghet pas nji së mos-te-qënie, te zërë ajo e distaime, pa hjaròm, pa armë, pa adhiasçi ushtërie, j' e pakë duarsh, amahjë me Turqinë çë ka tepër gjithë këto emë ndighëmëtarë të guaj.

Po valjtimi sai mbi vetëjuen kështu hjeshëm, si na thonë, kumbon nd' Arbëni:

Shqipëni një qind viljaete
në fund të dinjajë e humbëte!

Ca rigata pa edhep

i thonë Sultanit ti jep-e.

O sultan mos ep razinë;

mbanjëm vet na Shqipërinë.

Ne së vemi me Malje-zinë,

as me Serp, as me Austrinë,

as me Turk, as me Greqinë;

duam vetëjues autonominë.

Keq turp për Shqipërinë,

të gumbasim një filjinë,

po ndë kët mot ndashtinë,

çë Frëнку bëri Shklerinë,

e harroiti Shqipërinë,

Vetëme çë ka trimëninë.

O Frënk, kuito Perëndinë

se atie do bëjmë gjyqinë.

30 mars 1884

22. PROGRAMI I RADIKALËVE UNGAREZË²³³

Patëtim themen mbi ciljat një Shokëri buljarësh t' Ungerisë – mose ajo mike të Shkeptarvet shkrèt – këshiltin të ndreqënjën gjelën katundare. Ej e kemi për nderë të madhe; edhe përdika se duket andei se livri te kë na vumë dica kufi dëljira mbī¹⁾ Zotëninë e të Bëna-piesmet cilji-mbase të jetë guri i rukulisur mbī këmbët botie të statues të motit t'ënë – se ai livër me retë e themenime të atire zotrave sinodhinë.

Vetëm një hesape po na ndanë.

Pse ata duket se nkë mund' shqiten ndutu prei të qënit kë i bënë gjelës tek jemi, e ngaha ajo të jetë mose e përrjerrë adhiasisë të gores ku u rreparë. Cilja adhiasī do prana të jetë e besur dicave ndë per gjith: e mirëfilë këta dica janë mose gjëmbat e Shokërisë. Ata çë gaptin motin tënë, e deshtin të pasiqirtur te Gjela e Romës ej Elladhes; e së kufitin se këjo, shtunë valjandinë e të rruamit mbi ropet, kish llimontī të prirë retë çiesu; prana, e mbjedhur ndër gorë të vetëme e jo të mbëdhā, ish mose e parasteme Bëna-piesmëvet sai. Po edhë atie të përrjerritë ishin gjith përrjerrë zotërisë të gorës si tharosit gjelës, mbaiti dhistaksimë njera çë u vranë me mizirë: të bëgetët ndo buljertë ciljvet i frinej zënë zotëria e katandia; e vobekt e peljakant ciljt pse ishin më shumë shighin me nkerr se ata ashtu dhespozëjin te gora.

Shëndeta e vetëme cilja nga aq pathima i fleshet sot njerësvet, është tek të sosurit e valjandisë kë një o shumë duan të kenë të gjelvet veçia.

Dhespotisë as ka t'i jipet ngaha të marrë forë e hjaròm. Duarshit bënëtare të shprishta vendeshit i do ljenë fati tire; pse jater më 's varesën se dorë e guaj çë na ndëghet mbī motin t'ën, e na merr nga karpoi e të bënat për vetëhenë. E ka jetër anë pse e ljumia e begatia

²³³ *Programma dei radicali ungheresi*, Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania), Anno I, nr 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. II.

ndë dhë varen themenishit kë njeriu ‘s bën, ato mos-një mund ja stisinj për monë shpisë tijë – se duarshit e atijë që i pati sot sgjidhen e ghinjën ndër dier të guaja menat – na mberë të lavemi si kemë të vaphtomi buljberin e njerit me ja ndaitur save nkë kanë, na dughet të papsëmi më shpet nkamatinë që pasën nj’ ënderr; e t’i ljëmi ljipisisë njerime e vuljisë protopare të mparonjën psorët. Nō që kur u zu piasma, shoghëmi se bënjtartë marrën ata të parët ka gjëa e bënë, i ljënur të zotit gjësë të marrë pak e shumë si pra t’e shës: e bashk gjëlinjën gherë zë-rrëfikst gherë të gaptë ahjëtavet jetës.

Për andaj shokëritë e Sandergjivet të jetnë më të ljiga se të mira. Nestru se të nga njera janë ziljitë kë tha Esiodhi:

“Aidhòs aidhoo fthonëj kjè tictoni tictoon” që do me u ngrëitur këjo hjë e ngjethëme që tërrie mose njerithin mbi leghën? Pra edhe se ato të mos rughëshin shtrëmbur njera jatërën, pse të shprishta ndër fshate tutiemë, atie të sgjedhën e ateina të sgjedhurit të shkonjën te vendi i Vuljisë nga-ditëme: vien se gjith gherie i spavet nkea të bënjën këpuc, të qepënjën tirqë etc., e koljai edhe t’i dheksët prana se i nket të gjëlinjën nga autari ku naforënjën. E këjo një e keqe shumë e madhe.

30 maj 1884

23. LAIJME TË SHQIPËRISË²³⁴

Ditare t'Elladhës shprishtin të dime të keqe se Zot' i madh' së ljë më të ghinjë *Fiàmuri* ndë Shqipërit. Pandehmi nani çë pati ai lqipur parthina Zotërisë t'Italies; e thomi te jeteri nëmër Ai sot çë do.

Ditare t' Anapuljit sualtin se Shqipëria ç' është sot ndënë Turqinë e Maqedhonia bashk janë sa t'i lqipënjën Zotërivet t' Europës t'i japën vend me ato thënur çë adhiasī gorie duan; me kë duan të përzighen. Laijmi i kësai vuljimie së ljëne i pati ardhur atire ka Eteritë.

Shqiptartë nuk sinodhitin edhe nji vuljemie mbi psoren e tire e me dashurën. Po nd' ish këjo ghera e thronit të atire Zotërive mbi fatin e gjith kombëvet e të nga njerës vet ndër to: jo vet aghier Shqipëri e Turqisë po ku e do vendi, se ata gjith çë pa ghirë qenë ljidhur me Elladhen, se Maljin-e-zī e me Servien dojin me qenë pietur, por ndër shpitë e tire të mbrasta të guajish; e atie të pietur veç' e më gjegjur.

²³⁴ *Laijme të Shqipëriis* (Notizie dell' Albania), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. I.

24. LAIJM' I ATI-PARTHINA²³⁵

Athëne 10 të theristiçet

Një ditës te Kuvendi filolog i përcëmuar Parrais, u vū nd' Elladhet Shokëri mb' emërit “*t' Arëbresht vëlezër*”. Të parat themenī te kë buthtoghet gjith e dashura j' ëmë-bëna e sai janë këto:

1. Shokëria k̄a ndë këshilë të përngrenjë e të pastronjë gjughen e arbresh, mē u përgapur nd' adhet të Gjeles s' anë; e bashk at Gjelë të gjëljitinj zëje e noerie t' arbrësh, pa i vënur rē katundit ndo thresqisë kë vendeshi ajo gjeti e muar.
2. Do pra të sbuljonjë ajo vet e të reshtin ka vetējua çë do jater merë ndrishe ciljen n' erri të detë klas te puna e sai.

²³⁵ *Laijm i atti-Parthina*, (Notizia recentissima), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr 8, Corigliano Calabro, 30 maggio 1884, p. VIII.

25. TRÍ FIALJË T'ARBËRESHA AT, ËMË E SIS²³⁶

Rumënt e Italiòtët kanë *tata*, padre kanë prâ Rumënt *sis*a e Italiòtët *cicca*, mammella. Të këtire di fiâljlve e zëna është thielë tek di fiâljlët e arbëresha *at*, padre e *sis*, latte di donna e *mammella* : onde *drosissën*, allattare.

Italiòtët kanë prâna *mamma mia*, madre që u pat bënur prèi fiâljlë s'anë em, âm, madre.

Dúket mbë drit se dí fiâljlët *at* e emë tek e pàra e ciljavet *têja* e stënëme ndai *a-së* t'aksëme, shëngën zotërinë e búrrit, e tek e dîta *emmia* /*m-ëja* – J. K. / e njomë ku *e-ja* e poshtëme kumbiset, ninëzòn të prunjtit e grúas – ato dí fiâljlë, foka të pàrat të gëjuhes njerîme, patëtin, e *sis* me tò, nga Pleqëria jonë shkúar ndër Italiòtët protoparë.

Edhë tek atò trí fiâljlë shihet që-së-pâri themenâ cilja nga njëit prier ndë të shumë mbàse gjith emrat fëmërorë, e të mādhen piës e mashkulôrëvet.

²³⁶ *Trii fjaalj t'abërësa AT, EEM, e SIS (Tre paroli albanesi AT, EEM, SIS), Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 4, Corigliano Calabro, 15 gennaio 1883, p. VII. (Viti është 1884, por është shtypur gabimisht, shën i red.).

26. POKA DUAN TË NA DIEGËN DRITËN E SIVET?²³⁷

Të ndalurit çë ndali Dera Otomane Ditaren shqipe mos ajo të ghinjë ndë Shqipëri, nd' është ki laijm i vërtet, buthton fanest se Turku këtë s'e kã për pies të vetëhesë, por, shkuar katër qind viet, e mbanë edhe si pljaçëke e gavënjier, kë vet të grisinj.

Pse ajo Ditare as shtinë ndë ziarm; as porsiti Shkeptartë t'i ngreghëshin kundër, po ja i deshi miq: e goljë ellene, ciljat nani agëzuan se asai Arbëri j'u mbulī, parthina e nkaljesëjin, se nd'atë fjitë Zotënia turke, me mënuar e svisur ljefterinë e të mirtë e Arbërit te hjea e Elladhes moter. Abonsina na nk' i shighim Arbërit jatër dhës se të njëemen me Turqinë, ciljes fati ja pati ljidhur; e ljutëtim mose të ghëljqëta pameta e të përngjitura kurmit saij ato pies çë i qenë shqitura prei gjitont margurë, e ashtu mbī detin e Atërisë ai të prëghej me shoke e ndër kraghë Zonjën e Ellespondit.

Këjo merë qe edhe fanare e *Fiàmurit* njëra sot.

Mirëfilë i thamë drej Derës Otomane se të mbanej doren e të mos bijë më ndë Shqipëri, të mos ndighij te sqerit e asai aq të dashur ka armiqët e të diave; pse andei këputëj gjaljmëri i besës vleme me k'inë; e ljei të dia veç' e te veta ndër zalje t' irënuar e ndë mest aqëve, çë Turqinë duan svisur e Shqipërinë te prunjt e të ljidhur vetejuve. Të ruanj ajo sot mbë rreth sa pak të kombes sai sosënjen nga ato orteje çë pasëshin si valjat e një ljumi kur zunë Apoljenë; ani paç e ndë mest te kërshteve: E si janë edhe çë asai i thonë: "Shqipëria një gjarpër, kë dieli ndë nkaft shpighet e të zë; shkelje, shkelje ndë qater ni çë e kë". E Shqipëria ka jetër anë. "Shegh si të mbanjën e të përbënjën? Jipu me në; të shkoni na thik t'i shposh gjëlen qenit çë të kã ndër dhëmbë e më s' të ljë". E një na erdhëtim sot tek të kemi bes "Se dhëlpra e rreme aljà heljq pas të ulikun dardàn".

²³⁷ *Pocca duan të na dieschen dritten e civet?* (Voglienci dunque abbacinare?), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania) Anno I, Nr 9, Corigliano Calabro, 30 giugno 1884.

Mund' ajo po të thetë se vet libri kë për së pari i deshtim vëtur ndër duar dialjmevet t' Arbërit, "*Rapsodhitë* e motit që na ishim bashk ndë zalt atërisë", se vet ai liver që rrëfien ljuft e prindëvet tire me Turkun e dhistihjinë, do t'i distaksinj e t'i vërë hjordet ndër duar pameta. Po ato ljuft tutieme; e atie të përparana anamesa aq fanive të tiera të jetës, sosënjen jo më bështra mbi përziten e di kombevet, se nkë qe ca mot prapa storia e Tierryut mbī adhiasinë e Britanies nën zotërat Norman. Na t' Italies që andei buartim që do kimë, nì garruam; e të marrur zësë prei së mirashit e së keqëshit te ku jemi, monu dimi Turqinë, ljiq nd' e nodhimi: Ata që qëndruan me të, të ponisur më se jater e të ljenur vetëhesë tire, me kufà e besë të për-s-afërit e të shumet ndë thresqī e me martesë j u patëtin ljidhur; e pasandai i qenë te kragu e një psorie, njera ati par-ndër baljastritë e maljeve ti Emit.

Ëgħ se ai livër një pasiqirë e thielë e trimave e grave t' abëresha e së hjesë të shpivet kë kinë, me i gjëljitur të biljt e sosëm pas faren e tire, do – e ashtu *Fìàmuri* gjith – të i përtëririnj zësë, të foljurit, e emrit, një gjërije ka do anë. Po këjo që i bën Turqisë? Do të farmëkosinj mbase mbase ndo një Mavràmat o Nikokël të Nikoklesë ciljvet andei dī ç'i bie duarshit, e picàrënjen pështimen me kë stisënjin: po Turqisë kui i ljiqset të prëghet, aqëvet se Austria, mb' adhiasī vëleme të kombevet kë përllidhi – e nga njera kutient së ljuves e të ljiqndi tvetëjues – Turqisë t'i prothinj e t'i bënë nderë.

Pra përjashta, leghëvet që s' mund dinë të dheut t'ënë – e te këta të mbulitur që sot i bënë faneset po ndieta pse më ndër t' egërit e Afrisë, si u tha, është udha e gapt me e vatur e parë e njogur, se ndë Shqipëritë kë Europa ka ndë gjī – përjashta këjo Ditare na buthton si jemi e që kemi. E presmi se andai të na duan mirë, e të mirit të guaj t'i kemi hjë. Ah! patëtin dhe thënë se na ljiqsej golja, e mbuzu doin të na jipin të tieren ca trūcakulje!

Poka ndo se e shtitur ka ata që i duan keq, ndo se vet Turqia bën t'i mbulinjë të zënen njerime e të shpiturit njerimë katundeshi³⁾, Shkëptarvet nëmur, se ata t'i jenë mose qent e verbër kë të ndërsenjë mbī armiqt e sai: sot çon Europen mbë rrëth të veljur mos jater nga ajo mizirë e guaj që i përgjaku skuljtarturie një mot piest e mira t' Apoljesë sai, e ljiqja jonë rrī edhe e tërë, përpara kombevet t'Europës të kërshhtë te dera e kui na ramë mbi t'i dhifënsuar besen kë ajo mbaiti e dhespozën dhenë; e pra mbrenda ndë trimënime zëmrat t'ona e tek këmbtë e t'inë-Zoti, Prind që as vū një vëlā ndënë jatërin.

27. SE EARTH GHERA²³⁸

Se ngreghen rë, se deljudhën shiu, dhe hjidhen borë, Dieli ë prapa; ahjëtes ngroghët agëzomi motin e rī çë afëroghet.

“Kur fiqët nxierën fjetat na thomi se është vera”.

Pas çë ndë zalë të vetëm e të mbulitur përtërirjim këtei gjughën e prindëvet e na piejin-për çë? e ‘s dijim çë të pëgjegjëshim: u gap dita e pamë buljarë të tierë, Kristoforidhi, Mitkoa, Padre Leonardi, Bey Frashëri se bëjin aqvet ndeshi tutiemë. Ish dora e t’inë Zoti, tek’ e keqia e njerësvet përpiqet e çaghet.

E pamë andai një gherie te rehjet e maljevet anë krenjt e Shqipërisë, ndo se me idhenë e t’inë-Zoti ndrishe ndë gji, se t’ ardhur gjith-anëshit, jipin doren vëleme ndë një pat përzititë çë më nkë sgjidhet.

E kur qieli u vrë atei pameta e na i muari sishit; e na thojn: Ku ë besa me kë bëjit? zëmra e asljetëshme na priti. E tash erth çë shuflën këtei nd’airit Fiàmuri i Farës anë: E përtei nd’ Elladhët kumbiset me më forë Fati çë na qe faljur nga inë-Zot.

I varesur niatashit t’Elladhës, çë aharîme as do Shqipërinë me të ma nën të, Anastas Kulurioti j’u pruar, e na s’e dijim, gorvet t’ Arbresha çë janë aq nd’ ato parata, ë i vū përpara shkrëtinë e gjakut tire të shprisht ndë për leghet. E u pā se gjith me të i dojin nderen e të mirët. E u bë një buljërī me kuides e psorëvet të gjërisë tire.

Janë buljerë nga Athena, nga Atidha, nga Idra, nga Suli, nga Specia, nga Çefalonia, nga Argu, nga Idillia, nga Eleusina e Kradinidhiu, e bashk me ta, zotra të Janinës e t’Argjirokastrit.

“Është këjo dita kë na bëri inë-Zot; oreksemi nd’atë e uratëmi Prindin.

²³⁸ *Se erth ghëra* (Perchè l’ora è venuta), Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell’Albania), Anno I, Nr 9, Corigliano Calabro, 30 giugno 1884, p. IV.

28. PARAGJYKIME TË SHQIPËRISË VERIORE²³⁹

- 1) Kanë bes se janë çë dhiovasënjën tek ashti çë kanë puljat ndë stomachjët, gjith atë çë kã të vinjë.
- 2) Ata ndë janë e shgrehënjën e shkon një grua e kanë qëndronjën thonë se ‘s i bien më shkakut pse i preu udhën.
- 3) Ndë janë e venë gjakun e një ljepur o një dheljpër i pret udhën, thonë se ë ljik, e kã t’i vinjë ndonjë e keqe.
- 4) Kur kalji është e gã eljpët te trasta kë kã të ljidhët ndë kriet e uljet me vithet ka grazhdi e me kriet përjerrë ka dera, thonë se vëdes i zoti shpisë.
- 5) Thonë se është ljik edhe kur urën qeni; e nga t’urturit e tijë ndrishe se njoghën ndë kã të vëdes ndonjë i shpisë o njeri të gjithonisë.

²³⁹ *Pregiudizii dell’ Alta Albania, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno I, Nr. 11, Corigliano Calabro, 30 settembre 1884, p. V.

29. LAIJM I LJUMË²⁴⁰

Dual ndo është sa të daljë Kostantinopul jatër Ditare shqipe *Drita*. Këjo e ardhur na aksën të stënëmit te puna e rëndë t'i përjermi të dimen e vetëghesë Katundit t'ënë; ngaha kur prindët' anë ikëtin as ljërien besen, se ata nuk e ljejin për gjith monë, e pra nd' errëbirë mose më e më të keqe.

Pse na ljothi të pakët çë, t'anamesëm, nkë ljë të thënen t'ën (çë do të jetë e mirë për gjith të biljt e Mëmës' anë) nd' ata të gjëveshinj e të kumbonjë. Thonë se i anakatosën të ndrishëmit e të foljit, i anakatosën Alfabeti. Po të foljët si t'e ndërrojnë? Isht i Ndëljehies s'ime, është edhe më pak i grisuri e me fat se nd' atë gjuga e prindëvet të përtëritet. Për gramatitë, ato janë një shengh i përjashtëm i ndinavet të foljit, këtireve po jo të ngjitura, si ato goljes; e pse aq kardasgji? Marmi sot atë çëkemi për ndër duar. Varesën mirë-filë sqepe i gramativet cilji t'errinj ninën e gjelie noreme, kë vëghemi e vrëmi: po të biljvet të Buljarvet t'anë, aqë të shpeit të i japën ashtuthina petkun edhe gjelen ndëries Shqipëtare, i lipënjëm kuides të një javie o dīsh, më shqepur at sqep dialeti e alfabeti; e vera e sgjedhur pra çë t'i çonjën mbrënda maide t'i denjë tharosi shëndetëm nga hjetë e zemravet golje t' Arbresh.

Me ghirë të madhe edhe *Drita* Kostantinopul, na bufton se shpī e Zotit madh nënk është vërteta ajo rë çë t'i mbanjë dielin Shqipërisë, si krietët e sai margurë bënë të duket. Por pse ajo t'ish? Shkeptarët sot, pa mos një mbë rreth tek mund kumbisënjën besën e bardhen të tire, asai Derë mek më të shumë janë një thresqije, i rrinë përjerrë me zëmrat; dhe Ajo kã vet ata ndë kraght çë e duan shtuara e të nderuar. Sot, si shkruan vet ditare e *Eterisë t' Apoljesë*, ateti kombet, u desh,

²⁴⁰ *Laijm i Ljjum*, (Notizia felice), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno I, Nr. 12, Corigliano Calabro, 30 ottobre 1884.

te Kuvendi Skiernevicë, se te rrinë si gjënden; e mbase, për dica viet, që atie u desh edhe të jetë: Poka Shpia e Zotit madh shegh vet se hjea e shendeta e vetëjues rri ndë të qënit ajo dorë-gapt, si qe mose, me akoljt e sai difilj te keto dit' ampnije, dorë-gapt dritie buljërije e begatije. E zëmrat prana t'i prëghet; se sot vet' Elladha ndò kush nkamate si ajo për sëm brasti (se ë kush i frinë e dighet) jo nd' ënderr, po ndë të sguamit bën e prebën, ndër ditaret e sai, dhiaten e Turqisë.

30. LAIJM I RANDË NGA SHQIPËRIA KUMBON ND'EUROPËT. DHIOVASMI TEK L' INTRASIGÉANT DI PARIGI²⁴¹

Këto zëra sot përthughen ndër Ditaret e gjith gjughëvet. Na kishin shkruatur çë ndë dimër se Korça, e diegur pse ndenji aghier veçë, u kish ljidhur edhe ajo te Vlemia e Brîdrenit. Ca mot prap zumë edhe se Brî Dreni ish ndër duar të njij nga shpī e Culopit, kreu i t' Arbëreshvet të Dibrës poshtëme.

Këto gjith na shkoqur trushit, as mundëmi edhe të thomi me të dime ndë te stomachji Shqipërisë u bë ghera të marrën ata hordet ndër duar, o nd' atë hapëtin të ndërisherat e përjashtëme mbë rreth. Dimi krê vet se hordet u holjqëtin për ndiet ljiqes.

- 1) Të mos japën më se atë çë dhanë prindët, e haratëçin t'e ndanjën pieqët e tire për nga shpī, si qe zakonë, kanë ata ljiq.
- 2) Të mbanjë më e më Turku' filjaqishit e ndë nazil buljërinë e Arbërit, ë ftes e madhe me të dimen kë ai e dī, se ata buljarë Ai vet, si i kish pasur ndë ljuft me Rusien, i desh mbë rreth ehthra kombevet ndai, çë dojin t'e xheshëjin. E vet kur ata panë se Ai, ndo se paghirë, i pati dhënë atire kombeve armike pies të gjërisë tire i e qënur aq e besëme, ata j u shqitëtin zëmrie e së bënashi. E t'i mbanjë ajo edhe ndë shkretī s'ësht më për çë.

Të jetë nani ljutëmi këjo hera çë Dera Otomane me aq afër e largë çë i duan keq, e me, ndër të pakt çë nk' ë 'ljërien edhe, t' Arbëresht e mielljë, ata mos të nga mbë gjak; me i dhënur, si taksi Berlin, nikoqairatën e shpivet tire, ata të bënjë gosnuk, e të liëfarinj mahane e guaja ngamate.

²⁴¹ *Notizie gravi dalla Shqipëria echeggiano in Europa, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 1, Corigliano Calabro, 10 aprile 1885, p. I.

31. T'ARBRESHT T'ELLADHES²⁴²

Të prerit e Istmit të Korintit holjqi atie me aq të ndrishe kombeve, edhe t'Arbëresh të katundevet t'anë, kush për të rëmuar, kush për të stisur, kush me mbiuar vagonjet a bënur gjë të jater. Dica shkuan vendi mbë vend, e panë; po çë gjith pra nkë vanë Athenë. Prei ata çë u pruartin na zumë se nd' Atikët fjitet arbrisht; se tek e shuma e Elladhes ndër fshatet e vigjelj janë t' Arbëresh – e Hahn, ndo se e kish parë ndo se gjegjur, e kish ljenur thënë – ndër goret prana gjith janë Ellenëra.

Prefistin edhe at çë mënuan Korçirë, se di brinjat e përroit çë sosen te mati ku është e stisur gora, njera ë piot Ellen jetëra kã t'Arbrësh.

Këta të gjërisë s'anë çë mbanjën aq vend t' Elladhes s'u patëtin mirfilë derdhur ateina, kurna, rarë Iskandri, aq buljërī e Arbresh iku zaljeve të larguar Turqisë, pse Elladha aghier ish vet ajo nën Turkun, e marrur ka Maumeti më parë, te muajit çë Skanderbeku ndënji nd' Itali. Në prana storiët e motit përmesëm kanë kuljtimë t'u sbarrisuri e fares s'anë drëpòsht nd' Elladhet e njera Ider e Specie. Por tash te moti Skanderbekut, gorët e Koronit e Modhonit e t' Anapuljit ndë Morë, ishënjin t' arëbresha; e martirinjën Rapsodhitë çë u bënë atie, e ato shpī t' Arbëresha çë, t' ardhura atei, janë ndë mest neve.

Këjo përzit kë gjetëtin nani njerëz të vatur këeti, ish çë te ditët e Platonit, cilj e zū filë. E duket nani thielë se është kī stati çë sosi atie pas t'ardhurit e t'Ellenëvet e zënur vendin kondisur ka Pelasjet çë protoparë, të ciljes së qënie fjasën edhe gurët t'atijë moti. E pse shkruet nkë naliartin farët greke pas këto dī gjëri ndrishe, kemi, me skuturë të madhe të truvet, jo më se emra të farëve çë përzighëshin dhistaksime a prëghëshin ndë sinodhī; e jo kurrai ndieten ethelë e dhistaksisë e sinodhisë, ç'ish drita me-rarë mbi ato gherë, Ndieta pati qënë gjëria ndrishe: ejona e shtruamia më parë (si pandehu Benloeë) edhe ndër izulat e detit Gjerë, e te mati Azisë.

²⁴² *T'arbrësh t' Eladhes, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 1, Corigliano Calabro, 10 aprile 1885, p. III.

32. PO RANË SQEPET²⁴³

La Confédération Orientale ditare çë delj Athënë siel ndë 21 të Janarit: “Gjegjëtim, e na rā foka skuturë, se Bukuresh u gap një kuvend (Sillogji) i valjandimë të gjughës shkeptare, me këshilë t’i gjënjë mburimat, e t’e gatinj të kuluame ndë vetëjue.

“Këjo e bënë na buthton me çë aresī të holë e tutiepame Shkruest e Hores kanë pasur përvuiar ndieten e Elenismit. Këta miq këta ndighmëtarë galjtan çë shkruanjën Horen, shoghën, pa medruetur, më atei se na: e andai se të ndajin pë gjith monë prei Elladhes Shqipërinë, deshtin se të hiljqej te gjela një gjughë e arberesh. Pse t’u ljërit e kësai gjughë as do të thetë jatër se t’u ndarit e t’u përveçurit e t’Arëbreshvet prei nësh”.

Pëstai, pas kuljtuar ajo Ditare t’ardhurat e vitit 1877, te cilji thot se Ellent ‘s ditin të rrëmpijin heren, po ljanë t’ Arbëresht të vetëm ndë dhistihjī, shkon ndër këto fialjë: Ne ata miliune të marrë gua, nè se armonismi ushtëri e anī, nè të gapurit t’anangast e udhësh hekurime i prothën gjë psorëvet të mbëdhā t’ Ellenismit, ashtu plagur, si bën, gjërinë Shkeptare. Cilja vien të ndaghet prei nësh gjith udhëshit; e më se gjith t’Arbresht ortodhoksëra, ndë kī këshilë të bënënjë një gjughë për ta mo vēft rrënjë”.

Për së pari thomi se nk është abonësinëmia ajo se Elladha as diti të rrëmpin heren: e se t’ mos e mpiomi turp rrimi qet.

Piemi por Bulgarin, njerinë e ljinde, çë do ai të ketë me bënëur Elladha se t’ angosinj te diepi gjuhën e arbëresh? Pse na duket, se i sosen vetëm të marrë ajo sishit sa të t’anëvet Vet ajo kā ndë gji, sa mbjedh ndë të Shqipëria, e pas të tutiemit t’ Italies, të Mizirit, të Rumenies, e paru të

²⁴³ *Po raan skjëepet* (Ma son caduti i veli), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 2, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885, p. I.

Turqisë njera nd' Asī; t'i marrë sishit e t'i qetrarinj te vetëhen Afen me Fialjën çë i dhezet ka Fialja e gjërisë pas çëi ljeghen.

Po i marmi skamalinë e jo më; skamalinë, një dritë, tek Shqipëria të shoghë tri të qëna nd' Elladhë:

- 1) Se eteri e kombevet t'Emit i rri asai mbë zëmër jo se kã malë e së Mirës të të guajvet, por se pret, atë shtunur si një sqep mbalj sitë e Shqipërisë, këtë të heljq rope; e të fuqimie andei, ajo eteri t'i bëghet qerre, ku t'uljet perëndesh.
- 2) Se Ajo të detë prana ndai, Shqipërinë, këjo kã të bierë ndëljehien e vetëjues me fialjen t'i spovisur ndë gjī; e të qëndronjë, më se rope, kavsha e sai.
- 3) Se pra vetëm Elladha nuk dī edhe se gjuga e Shqipërisë as pritët të ljëghet; pse ajo është e çë protoparë:

“e ni e tagjisur, ej e potisur”¹⁾

ndë dhët sai e ndër të guaj sot,

“Ajo u rrit e u bë kopilje”.

Po Elladha me vërtet këtë dī, e më të jetër; pse atë gjughë ajo vet e gjegjën, e i kumbon ndë gjī nga do anë. Nkë dī edhe thomse se sot menat të thënavet t' asai gjughë, Ajo të mos die çë t'i përparanith ka të sait sot e t'i këtë hjë.

33. NA SHKRUANJËN KA DIRAHJI²⁴⁴

Prenk Gjoka i shkrët qe rriedhur e zënur ndë një shpī te grika e Buenës. Pati ai mot mbrënda të svisënej ndë kish gjë kart nkaljesore, pse si thonë, jatër nënk i gjeitin se një flet të *Fiàmurit* ç’ecën ndë Shqipëri, e vetëjuen. Jo pse e kishin mbi sī atë e dhanë ndër duar të Turqëvet, se ai ‘si mbanej dielin ndonjeriu; ma pse u duk se vinej pedot i Trikupit një çuletëk Panelen. E qelëtin Stambul për dheu, druetur se nd’ atë vëjin ndë vapūr – çë nkasën proitet e Elladhes – mund atie Ellent të ja e mirrin duarshit.

E, si rop i Panellenëvet, përpoqi ndë psorë edhe më të keqe Naredin Begu nga Matia. Një njeri i ljik kī, cilji, vranë mbë të pa dimë të kushëririn Rizanë, një zot i dritëm, atë e gjith shpinë e tij, kish ikur nd’ Elladhë. Atie gjeti kush i korjiri margurtë, ej e sgjodhi akolj t’Ellenismit *fatëbardhë*. E pas mot atei u pruar, te kupra njeri nuk gënjeu, se edhe nd’Elladhet pak i fjitë ndonjë i Arbëresh. Ashtu e vënur një mbrëma ndë mest, e vranë mb’ udhë.

²⁴⁴ *Ci scrivono da Durazzo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 2, Corigliano Calabro, 20 maggio 1885, p. III.

34. DRITA²⁴⁵

Patëtim ka Kostantinopuli tre nëmra të *Dritës*, e i agëzomi ditë të bukur e të gjat me monë. Ato çë dihen sot ndë për kombet e shklieme, Ajo do, e shumë mirë, të ja mësonjë dieljmevet të Shqipërisë shkrët, për kūr këjo të ketë skolët e sai. Tek ajo edhe na me ghirë gjëmi aq fialjë, ciljat ndë këtë të veçëmit t'ënë patëtin garruar, e kuljtomi si mot prap zotërat çë shkruanjën *Dritën* na kishin thënë të kijin bes se gjuga, si na vet, rronej pies këtu pies atie e shprisht, e një gherë mbjidhej. Po si, i garruam, na ljipset neve t'i kishim të përjerra ndo françis, ndo ellenisht. I parkaljesmi pra të mos marrën, të mos dredhën keq me miencet e gjuhëvet guaja, fialjë kë na s' kemi; se e thëna e ljutur sumbulën ajo vet e me ghekurin e shpisë, te moti sai, nga kroi Gjelës.

Mbi alfabetin na të thomi prana; te ghera çë afëronte, kur zotërat e *Dritës*, Buljartë e Sillojit Bukuresh, e Na bashk të sinodhimi mbë gramati çët'ehjonjën ndinavet gjith të goljës, e çë të jenë edhe më e njogura kolai.

²⁴⁵ *Dritta* (La Luce), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 3, Corigliano Calabro, 20 giugno 1885, p. I.

35. EKSTRAKT NGA LIBRI I JUL VARIBOBËS

“Gjela e Shën Mërisë Virgjër”²⁴⁶

Zoti Guljelm Toçi nga Strëgari çë kish të na shkonej të përjerrë ljetisht *Gjelën e Shën Mërisë* të Varibobës e bashk zëren e të psuamevet të tij ngaha ajo e rrëfieme ndritet; edhe ‘s mbushi të bënë e tij; i anakatosur si mose është punashi çë të ljevrosënë leghët e anëvet t’ona të vaphëtuaara.

Porsa, pse një njeri shumë i urt e i nderuam Gustavo Meyer, çelji male të njoghën at Gjelë pra çë e shengu për të bënen e sgjedhur e Gjughes t’arëbresh; na duam përparanur gjagjë t’asai, e vet t’e përjermi. Mirsilë një nga Shkruest t’anë, kë gjith dinë, na pati porsitur të ljetim at Gjelë me afën e prunjët e të rruami vobek e foka pa-katund, zotit çë Shqipëria, nikoqire e të vetësajet, të detë ndë ljimonti u fisur tek e gjara e dëlji të statit nëmur e shpivet më murga t’Arbëresha ndë dhetë të guaj. Abonësina – nestru nd’at stat, shoghëm Gjëat Shëite kë na ponismi, të venura si ndë përsihjenarë – fare ajo Gjelë i pròthen ndo malit ndo nevoesës të ditës sot. Arbërit i ljpiset sot mose përpara, si kã te paseqira e Rrapsodhivet, zëra e të bënavet gavzare të prindëvet nën në vantilje bashk ndote shkretisë ku i shtu të shparrurit; e Variboba, si ai çë ‘s diti, së ndieti at buljarë at shkretë: i ljpiset të buthtomi të foljët kë Gjëria jonë as pret ka gola e mëmasve të guaja, po pati ka ëma e sai ndë të protoparat e piames: e Ai u ngigh mose, si rop, ka gjuga ljetire.

E ndorrina na edhe tekëjo fjet te sbuljomi një pies t’asai hjroã, mos duket ngaha i pati hjesur aq atij Zoti të ponimi; ndë e Vërteta e të fleskurit e përmbrendëm e një botie çë rroi, të fleshur ashtu si sot e duan më j u dhifisur mbë të përtuar, o ndë jatër ‘s dimi çë, eljidhi.

²⁴⁶ Estratto dal libro di *Giulio Variboba, La vita della Vergine Maria, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’ Albania), Anno II, Nr. 3, Corigliano Calabro, 20 giugno 1885, p. II.

36. U LJËFARTIN RETË ?²⁴⁷

Qemë përrëzë ditie ç'ish sa t'i gapënej ljugadh të keq Anglies e Rusies: E ndë qoft se njera e jatera të këtireve, keq forë-mbëdhā, andei të reshtet me zëmren ljavost, ajo çë duket ampni do të spavet njize. Se jo abonsina ndë ngamatī antirime të një gjëi ato sot përpiqen; e ashtu si pas të zënuar fialjësh, të ketë vola me j u pasur tuke shkuar dit.

Keq një tramaksī mbase shkundi ështëërat e Europës. Njō Anglia kā mot çë merr e ljë nd' Egjitë, e do me të shoke: Françia, sa u ntrashtin zatë e dī piesvet, bëri ajo paq me Kinen ndomos se e rrangur; e pas atie mbanë ushërën edhe, foka të gatur për gjë çë kā të vinjë. Kā jetr anë Gjermania, pse nestra Frëncën çë e kā mbi si, Zotërī e Anglies kā herë çë mose e antirisen – as desh t'i mbulinej dhenë e sai të pështuarvet ngaha patëtin tërbuar katunde, e parthina Ajo rrëfieti t'e xëjin, diçë porsima dī-faqe çë Bismarku i kidh dhënur – Gjermania agëzonej, si jo me të vietët e tiera, ditën çë kī Zot i ljeu, thoshëje se t'i jip zëmër, thoshëje se evhjarime me të për përziten e tre Imperaturvet.

Ndë çë, te Kuveni tire, këta u ljidhëtin e 's deshtin Italian martiri? Mosnjë e tha: Vet se pas atë, Rusia i shtū guantin Anglies ç' edhe 's embjodhi.

Mirëfilë dizet viet prap Rusia as doi të përparanej me aq burgamë Anglien e Palmerstonit. Qe mot ai që mali i gjith kombevet ish drëi të ljevrosurit e vetëgheve e të petëkut ka vuljitë e dhespotia e mbretërivet; e vantiljia e atij mali pa-zalje, ish aghier ai Ministër e Anglia e tij. E kush mund' e përmbudhënej? I erth pësati nijj botie e jatërës ata të ljevrosur; po gjith ndë shesht ljeftër as patëtin më se të sgjidhëjin ndë një dit të shënuame jo të dërguam te gjegjëm, por dica bënjapiesëm

²⁴⁷ U liëfartin reet? (*Si son dileguate le nubi?*), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 4, Corigliano Calabro, 20 agosto 1885, p. III.

të vetëjues. E shpeit u spav e ljumia, e dukur për së largu të stati tek nga një prit' të dhespozënej shpinë e tij. Shpitë shkuan ndër duar të Bënjapiesmevet, e ata, si vien ndë dhë mose e gjithparu, svistin, pra që nk' ish e tiria, gjënë ç'i erth ndër duār: e të zotërat e shpivet grisura ditëshit që pasen, varen si rope dinë-ata që baljt mbëretërash, ciljëvet i dhanë nikoqiratën e petkut e të vetëjuve.

E s'është ndë këtë gjith shkretia: Ata Bënja-piesën zot menat venë ture u parë rrethur leghëshit mose më e më të shuma, që pianepsënjën at nikoqirât e shpive të guaja. E bashk kui do kâ, e përçë do-kâ, fëmijë, hjë ndë gorë hjarom i rrī zëmra e pisëruame e si e pandehjëme së keqie. Ashtu te dora e Anglies e Frënçës vantilja e gavnisë të Bënjapiesmevet e rragur njërash të përmbrendëm e ka jashti; e për andai, edhe së kuxonjën, as kuturisënjën.

Ashtu thelë ndë fundët ujanës, te ku suvaljët e marrën ej e ljenë sivet, rrī kreu i Medusës, e afraintën Europën.

37. THIMI MITKO²⁴⁸

Jater ‘s mundëmi për Abramidin e buljërinë katundare që e rrethën, se kët prej, t’i vëmi mbase përpara evhjarinë e gjith kombes tire, ciljes i ehjon ki imnë i fiuturuar nga zëmra e Toshkërisë.

38. KĀ JANINA 16 TË KORRIKUT 1885²⁴⁹

Të shkruajta se Abdul Begu i Frasharit vëdiq në fuljaqī. Se desh mirë Shqypërinë psoi të keqe; e këtei gjith, që e dinë, janë heljmuar.

Për Komitatin e Korqires beso se ai i shërbeu Elladhës e Shqypërinë e gënjeu. Sa për Shqypetarë kanë mbledhur dica vvarëz, të papunëshëmë, të pa-bukëshëmë që të quhet shqypë; e është e rreme. Gjith mendimi tire është të mundin të ndajënë Shqypëtarët myslimanë e të kërshterë, Gegë e Tosqë.

Prap më shkruanjën kĀ Toskëria se ‘s kanë marrë fare *Flāmburin*. Gjegjesh se i presën udhën Korqirë a Janinë, me mendim se ata të mos paguanjën e Zotrote të ljotheshë.

Shkruanjën pa meta nga Atena.

Ljēpusha jote e sotëme më bëri edhe kët heljm. Nuk dijë që jē kaq plak: nuk jemi na edhë të mbëkëmburë në paçëmuar. Por mbau fort e me gjëlim të madh sa të mundësh, njerë sa të lleshë të jetër ndë këmbë t’ënde. Se të jap unë sot një lajlm shumë të mirë: Dera e Ljart i dha faljimë katundevet shkeptarë të hapënjën në gjithë tire Skolë të glughës Shqipërisë.

Quod erat in votis.

²⁴⁸ *Inno ad Abramidhi, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 4, Corigliano Calabro, 20 agosto 1885, p. I.

²⁴⁹ CĀ Jannina 16 të Corricut 1885 (Da Giannina al 16 Giugno 1885), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 4, Corigliano Calabro, 20 agosto 1885, p. I.

39. RËNJA E MBRETËRISË SË SHQIPËRISË

Parathënie

Mberë Varibobës ndighëmëtarë të *Fiàmurit* donjin të bëin të pasënej *Milosàu*, aq i ëndëm për Gjëlën e ré çë pasiqirën. As dësh po i Zoti; e ljusti vënd për armoni trëmnòre, kë thot se ai mundi të hiljq me kòrdat ndò se të këputura të gjúghes anë. E i shkoi Komitatit piesën e parë, a më shpet dérën e madhe e “*Skandërbekut pa-fanë*”; te cilji ai shëngu hjoã gjëlie me madheshti zëmrash, e ghëljme të thielë. Po përdika se atà një të mitosur kéq gjër, sà nj’anë e jàtëra t’ikënej sishit: që pasandài prerë; e veçe pes tilje mbjèdhën ndë gji të tërë at gjelë gavnàre kë Zonjë, emadhia jonë, agëzòdi për të haràksurit e dites Shqipërisë. Kà edhë ajò Gjelë ndë ghëkurit diu çë të ndrishëm kà poesi e guaj: pràna çë tek ajò, si te *Rapsodhitë katundàre*, tek rrëfighet tek fiasen vet njerëzit e përparanur; e sinodhia e hjèa e Jetes gjarë të mérr malit.

Të kësai piesie së parë të Skandërbekut vet i Zoti thot se e gati ashtú si dësh; e më nk’ i priret siper, si jo më *Milosàut*; porsi ndien se atireve t’i jip të jatër nënk stënej. E na kuxòmi se pas ljevdiñe e madhe çë tàsh pasi at dushk ljuste e karpúa-mirë të gjúghës shkeptàre, nga dita “i shpitur ljart ndër qiel”: se nani, e vretur, thòmi, të kaladhësput, do të mbànjën frimen edhé atà çë prisin se gjëria jonë, si lià të fjinin për të mose t’ardhurit, të mos kish për së pràsmi ajo goljë ndë t’e angosurit, si këta vuljitëtin, për monë.

20 gusht 1885

40. PELASGË DHE HELENË²⁵⁰

Të gjughës t'Elladhes kemi piasma e të shkruame një trī miljë vjetësh prap: të ciljat gjith na rrī përpara egjëljitur, e si ehjo ehjeshëme të gjërije gadhiare nd'adhiasī katundi t'urta.

Të gjughës t'arbëresh mirfilë sithona më e moçëme kë dimi, na erdh katër qind viet prap me Rapsodhitë e me fëmiljët, çë të shkuara Italie – pse me të guajt njerë dië 'su përzielin – ku do vendi vanë shprishur e mbaitin me mbaret e njëa: ciljat sot na vinjën të gjegjura, pak o fare të ndrishta, prei të qëndruarit te dheu çë qe ini. Porsi, ndë të gjitht e gjughës t'arbëresh dī u çë ndighet si nga viet më para se të shkruamet e Elladhës, e çë shkoi nde për këto. Janë emëra të gjëave: *borë, dét, dhé, nëmë, dilë, ilë, shī*; janë emëra të vendeve: *Pelja, Hjima, Atë-ljash, Shkëmbi, Timpë, Te-zali, Afër-zali, Grami*; janë emërat e idhuljvet të thrisqisë t'Ellenëvet: *Zëa, Hera, Athëna, Idhesti, Dhemetëra, Ha-biri, Afërdita, Deti, Vrënia, Ujana*, etj³⁾; emra këta të gjalë ndër né, e duan me thënë fuqitë e Jetës kë ata idhulj ninëzojin; se Elladha dij po ata emëra t'ardhur asai kā të guaj, e ndë mot tutiemë o 's dëljgoi o hjarroi.

Këto fialjë shkuan kā kombe protoparë te gjugha e Elladhës, e s'qenë të sait; ato po sot t'arbëresha zgjlidhen ndë të foljtë e shpivet t'ona.

Erodhoti, një më i moçëmi te shkruet ellén, lja thënur se ndër ditët e tij Greçia, tek nani ato janë, ish aqëvet e kontisur di kombesh: njëra atie emotime *Pëlasga* = Plaka; jatëra *Eljëna* çë atie sdrepi pas, e shtiti drei voresë ata të vendit çë nuk j'u dhanë duarljidhur: Se disa çë qëndruan, kësai ndo i mbetëtin ndai, ndo j u përzielin te ku inë: Se fjsin ndrishe kā Eljent, si vet i gjegji; e rrëfien se grā eljëna athëniote të viedhura prei Pëlasjit e Lemnit i mbësuan pra të biljëvet gjughën e tire me i antirisur të shoqëravet". Ato forëmëdhā, pse të dalja gjërije më bagjane, e cilja ndë katund ish zonjë e Pëlasjet.

²⁵⁰ *Pelasgi ed Elleni, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno II, Nr. 5, Cosenza, 20 settembre 1885, p. III.

Thot edhe se Zotërat e Olimpfit t' Elladhes, menu Posidhona e që dī u jater, ishin të marrur kā thresqī e Pëlasjet. Poka (u thash mbë të dhiovasur këtë) t' Arbëresht janë Pëlasjet e Greçies, e ndër Ta fleshet andei, se qe më dëlji rë ponia protoparë e botës njerime, evharistare t' Afes Jetës ndër të bënate e Sai.

Sot edhe këto dī gjind, si patëtin pasur përzit e guatur ndër to ata emëra e dī sa të tierë, gjënden vendeshi afer, vendeshi ndai mefshate veçë: E ndo mos gjuga e njerës është, nga e ndëljehia, ndrishe ka e së jatëres.

Sot dhistaksī e emravet "Epirotë, Maqedhonë, Arbëresh, Shekptarë" etc., janë mirmanga ciljat nga frimë shqier. Pëlasjë as qe emër kombie; po shëngu ata ç'inë te vendi par se t' arrëjin Eljent. Pse nga farë e kombie, njera që më e fuqimia ndër to s' i mbjodhi një dorie, pati mose e vet emërin e sai. Sot thughet Arbëri gjith diepi Ujzës njer tek mbase një mot Epiri = Arbëri ljidhej me Ilirinë grek; e na ç'ikëtim andei mbaitim emërin "t' Abëresh = Apiresi": ashtu Shekptarë edhe qughen ata kë Eljent e Ljëtinjat përcëmojn qeravni.

Gurtavo Meyer shkruati kā pak mot se t' Arbëresht janë një degë e Iliriut. Po të këtire nd' Italet as gjënden varre më posht se te rehjet euganë. E nga prana ai piljasën të vërë t' Iliri te piasma e Pëlasjet? Çë kemi të gjuhës atire me e afëruar t' Arbëreshes e nxierrë për ndë mest atë të Pelasjet të cilies kemi po piasma, e ciljen Erodoti gjeti edhe nd' Italet poshtëm?

E fialjët kë çomi sot t' arbëresha edhe te thrisqia e Ljëtinjëvet me domethënënen kë kanë ndër në, bënëjen e logazëmi se te Italia poshtëm si ndë Greçiet inë prindët anë. E sa prana me t' Italiotëravet nkë sinodhinë Gramatëka jonë? Mirë dimi se Ljëtinjat hitin zotëra nd' Iliritë grek e tek Epiri, e fialjë të tire edhe kumbonjën atei; po me thrisqinë e tire të motime atie erdhëtin. Mundën po të thetë njeri se *Vesta, Iljigu, Diana, Pana, Angerona, Dhia, Larët* me domethënënen e tire janë ndër Shklavunit?

Por sosmi fialjë që janë mose ajër; e me kë bierëmi mot përdika se prindët t' anë nuk ljanë piazëm e gjuhës kë fjisin. Po si ata mund' e ljëjin pëstai që protoparë një na rromi pa katund? Lega Eljene më gadhiare atie pas dobinë, j'e dhënë hjevet të gjelës, vet ajo u duk buljëresh; e bota e vendit që me të 's u bë një, ma veç te një katund e zonjë ajo e shpivet ku ehjonej gjuga e sai, i rrj te kragu ndër të bënate e ndër psorët, ej e ljëi të dukej Ajo vet.

Erdh pra mot mirflë që një farë e Pelasjet e pistepsur ndë jirtë voreme t' Elladhes, fara Maqedhone nën Filipin e të birin përgapi mejdanë e me

psorë të ljume kundër mundësorët e prindvet. Po kī dialjë, ç'ish e ndighej zot i njerëzvet, i marrur resë të dhesponëzej Dhenë, gjithëseje i garruar, zū amahjin me Asinë. Mbaiti e për ndër duar gjughën e Eljenëvet – se te skola e atire u kish mësuar – edhe i dish shok me të te ku do vate. E ndo-mos, pse këtireve j'u duk se atei patëtin pasur Maqedhont si rope, i qëndroi nghërrë e zezë ndë zëmër; e pas çë ajo drit' e pa-shoke u shua, i ndighëtin dhistaksisë të buljarevet Maqedhon; e për së prasëmi patëtin shtitur katundin e atire të larghë, ej e parë ndër këmbët të Ljëtinjëvet.

Por këta në psorë i bënë prana e jo të lëndë dī kombevet bashk: tek cilja dalj ka daljë ato garruan e u papstin gjith ziljie kë siel mose e ljumia. Bashk i thoshënjin Grekëra, pëstaina këta Romëra, ata Maqedhonë e t'Arbërësh.

Njera çë të guaj të tierë diu saje largë i erdhëtin marrur me petëkun best e prindvet; e shkretia i pati rrusur një vuljemie, tek edhe të foljë të njëra xū të jatëres. Ashtu t' arrënuara Elladha e Arbëri ndër ditët t'ona i pamë të ngrëitura bashk me këshilë të njëj përzitje, tek throne i dritëm i Greçies moçeme të përkumbisej mbi fuqinë e di kombevet. Vet po Europa mbase i përveçi. Se kur vonu i ndëiti dorën, sual për ndiet se kish at' dëtitë me Elladhën ngaha i kish ardhur gjith drit norë; e prerë përjashta Arbërin, ka zëmra e kui u kish çeljur e mbaitur dhezur ziarmi, stisi Elladhen e rë ndër kufine kë dij aghier se ajo kish pasur. E atei nkalosi mbë ftës zëa e Elladhës, cilja u pā e vetëme ndë prej. E bëri vulji ndë të, t'ellenixarënej t'Arbërësht, e më të përjashtëmit; se pra kur të mund' i buthtonej si pies të vetëjues, ata Europes të ja llijpënej si të sait.

Pas margurët e asai bashk të Maljit-zī, Serviant, Bulgarët, të kumbist botes sklavune, me gatur për dukt e vetëhesë këshilin përsentuz t' Ellenëvet, njota duan nga gorët e Shqipërisë gjorë, e nafortur Të qeta. E stistin Skolen çë kā t'i porsinjë se janë gjëri, andai të mos përtonjën t'i ghinjën rope ndë për shpitë.

Por Inë-Zot çëka vëdekia gheljqë gjelen gapënej ani motin e sai ndër ditët e jetës. Ka do ish e shprisht, ajo si e shkuar njëj hërie njëj porsimie, zū at pune të gjughes tek ë Gjela e përmbrendëme e nga gjërije. As visoi, thoshënje, neve ndë nazilë të gjat për kët herë, e i dha gjindies Omanle çë u duk se pati svisur tharosin t'ënë, të na aksënej gjërinë e pas çë ndo Ljisëndri ndo Skënderbeku as i patëtin kuides.

Evharimi Prindin ndër qiel; e mos na reshteshin ftesa të rea ka drita e mënuar çë na fleshet, ndo se anamesa reshë.

41. PULJET DHE SHQIPËRIA²⁵¹

Nënk dī të thom me fialjë evharinë e zëmres t’ime – e të gjith t’ Arbreshëvet kur t’e xënë – ciljen po i kemi Zotit Kaljör de Simone, President i Tribunalit Tregëtisë Bār, e bashk kësai gorë të bëgat, per vuljinë madheshtime të ljidhënjën pameta tregëtije me Arbërin afër Puljet çë të më e shuma një mot i fjsin gjughën e të një gjaku edhe janë. Kā mot çë ndër ditare dhiovasia me malë të thëna të dreqëta e norë t’ atij buljari; e ‘së pandeha kurrai se një dit ai kish t’i ngrëghej Arbërit t’ënë shtëmëngun ampnije mbi gjith.

Pse prei gjith anësgit Vet ài (si laijm i rī na siel) bën të mbushinj fatin e mirë të mëmë s’anë me jater të përparane të bukur. Presëmi nga zaljet e kësai të na ehonjë dëshira gosnuke me ata u ndëitur, gjith vendeshit, as thom të shituri e të bieturi, po foka njij të guaturi njera jatërës me ghirë, si zakonet shpive motëra.

Gjegjëni laijmin e rī kā *Risorgimenti* Puljes të shtat të Vieshtes.

“Pas ato ke shtipostim parthina, na erth jatër ljëpush e t’urtit Kaljör de Simone, i pa-ljodhësi te puna e psomevet mira t’Italies, me te përparane ciljen as druetëmi se e ponimia Kamer e tregëtisë e i shkliemi Zot i Skoles Regjëresh s’anë *con Banco Modello*, mbë të ndërruarit këtë shpeit “in Istituto Superiore Universitario” i japën kurm: një e përparane ajo e thavmasme të njij katedrie të Gjughës t’arbëresh. Pa na shoshur duktë e të xënit gjughën e Arabisë, po uratur me zëmër një nikoqirë të marrur vende ndër zaljet e Afrisë: mbi gjith sei na duket së mirie, të njighemi me t’Arbëresht afër, e të japëmi me ta duart vëlezërisht”.

²⁵¹ *Le Puglie e l’Albania, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 5, Cosenza, 20 settembre 1885, p. I.

42. TË FEDERUARIT E BALKANIT²⁵²

Sot parastemi gjëje të ré ndë dhé. Te ku një Stat me përzita t'afërish bënet më i madh, jatëri që i rri ndai, se të mos qëndronjë më i vogël do e këshilën ka mundën të rrëmpenjë. Nesër pra një shpi, cilja të shoghë te gora se gjitonia, a me të bietura a me jater pune, u bëgat mbi të: të ndëghet e të marrë ku munden; pse ajo ka ljiq të mos qëndronjë prap. E Ditare që thërriten dorë-gapta – mirëfilë ngaha e të tiervet – i japën ljiq. Se sod qent që rrethënjën trapezën e nëmur të katundeve nëmur, i ljuhënjën mose Hënës bukur as-ljuetëshëme, mbaljë kë që e prëitur gjela njerime. Po ku vemi pra bashk, i dhëtur që t'i dhëshim ljiq të viedhurit ç'i ndighën njij më mos qëndruar ai prapa jatërit?

Ësht, po ata thonë, këjo një varat e veçëme: Abonsina kur u mbiodh Italia e u bë e madhe, as qe kështu; se mos një desh a ljiqi aqëvet. Sot jemi ndë varat që Turqia e guaj vien që të daljë nga Europa; e kombet kë ajo mbaiti nën, do t'i marrën pa-meta vendin e jo të-jeter.

E na i piemi: Por ciljin vend? Ajo erdhi nga Asia, e vendet mbi kë dhespozi janë ata të shpivët kë ajo gjeti. Se ajo tashti nuk shkreti dhenë tek u prë, po e ardhur ndë di o tre qind miljë ushtërtorë, sgjodhi ndër dherat kë mundi e ndënji zonjë e dimbëdhiet a trembëdhiet miliunëve burra, grā, pleq e corrobilj. Ajo vet 'kā vend të sai.

Mbi kë poka ndëgheh duart ndë penisul t'Emit? Elladha e para do Arbërin, Tezalien e nga Emathia; Malji-Zi do Gegërinë t'afërme zalit; vende këta gjith, ku ehjon e vetëme gjuga e Shqipërisë; përveç se këtu këtie Shpia e Zapënjet ka Lebovi – gadhure kotikunej ej e mbjedht te hathet e Elladhes – bëri ej ehjon ka ndo një skolë gjuga ellene, ndose e guaj ëmavet e atëravet sai: Servia pra do Servien e vietër, cilën

²⁵² *I federati de'Balcani, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 6, Cosenza, 20 ottobre 1885, p. I.

Ljiqia e Romës, si ajo që ‘s pā që ‘s dī, marrur prej ditare të shitura, ngjatën njëra Gjakovë, njëra Rëk, edhe Mirditen këlet mbrënda; Po Servia e vietër më edhe se Emadhia sot, është e mbiuar t’ Arëbrësh. Pse ish ajo protoparë e kombes s’anë’ Serviant erthëtin ej e zunë ndë mest motëravet; po të shitur prap njize, ja patëtin ljenur kuja ish: sod prana, me ljiqen mek gjëritë e Longobardhevet i ljiqëjin Italis Lombardinë, duan t’e marrën si pies e shqerrë e kombes tire.

Një mbë të rarë atie po dieli na shoghëmi: Goret që u zgjidhëtin parthina prej Derës Otomane, ngrëghën jo se t’i ndenjën dorën Shqipërisë me u ngrëitor edhe ajo moter “po se t’e bënë copa, e t’ndanjën ndër to komben gjorë që e prasëmia qe mundur prej Turqit, e ciljen besa e arbëresh nën të edhe mbanë”. Për to, këjo ë gjith “la Questione orientale”. E ndò se atire që së duan të shoghën, ni ato duken të antirime mbi piesën që i dughet nga-njerës, piest ato i ndaitin më parë tek e sheghëta e së “Ljidhëmes Balkanvet”.

E nani që vet u sbuljuan, Arnaut e Gjakovës, e Ljumies, e Divrës etc., mbiatë ato hjordë që kishin rrëmbier me difënsuar thëmenitë e shpivët tire, e ndo se ehthra Zotit madh, ja naforetin vëlezërisht Haezel pashaut, i arbëresh edhe ai; t’i qelinj, kundër armiqtë e Gjelës shkeptare. E këjo e suvaljur ndër fusha e malje pret t’i jipen armët trimënisë sai ku do vendi: E pie ata marguar nënk artënjën njeri pas jatërin të vinjën vet ndë mejdan me Arbërin, kī, njera që Zoti madh, i pa-druetëm, ata t’i pres bashk, nën vantiljen e tij agëzon hernë amahjit. Send’ është pra te fati t’Inë-Zoti, se Turqia, e shtitur posht ka fuqī të guaja të tieria, të bired zëmrie: vet ai t’gapin udhen vetëhesë, me u rrëpartur ndë shokëri e dreqët ndë vetëtë, e cilja t’e mbjedhë të tierë, e i patur besën, kë i vetëm ai mbanë edhe, Deres otomane ndo se një mot me të aq e këqī.

Dimi se këto atie shkonjën sot ndë për zëmra të kershtea e muskumënte, pa taraksī.

43. NGUSHËLLIME NË MUNDIMET E TASHME²⁵³

Sot ziarmi malit i hjesë të gjughes s'anë u çelj ndë Pëlasjitë, e prei gjith vendeshit né të faljënjen e *Fiàmurin* uratënjen.

Patëtim tek e prasmia javë të Lonarit kët ljëpush ka Maçedhonia:

“Ka shumë kohë që kur dishëruar të kësh fletën tuaj “*Fiàmuri Arbërit*”, po për fat të keq s’ju kam gjetur udhën. Para 18 muaj dhiovasa fletën që i dërgonësh Kristoforidhit ndë Stambul, edhe shumë më ka pëlqier. Tashti u lutem tregoni me ku të paguanj 6 1/2 frangat, edhe të m’vinjë fleta.

Të falura me shëndet gjith punëtarëvet të kësai pune të shëitëruar.
Manastir 23 të korrikut 1885.

Vëllai juaj i dashëm

Gj. D. Qirias”.

Njatër ljëpush na ërth pra nga Siçilia, cilja nestru se na siel emërin kë një dialjë spelie-të-sgjedhur i jep *Fiàmurit*, është ajo vet një buthtimë e dritëm aq e mendies nikoqire sa e të foljit bukur e gjith aneshit të mbushur, e zonjavet’ ona. Duam me e përpanur kët ljljje e gjughës Shqipërisë:

“I dritëmi Zot,

Bërë zëmbër nga e Mira e Zotërisë sate, kuxonj t’i shkruanj pameta, e besëme se do më ndieshëne kuturenë p’ait glughës sanë për ciljen vinj t’i jap përtës.

Një kushëri jimi, Sep’i Sqironjëvet, dialë çë ndodhet të spudhazënjë Palerm, shërben sa t’i japënjë glughës shqipe të viëtërin deljëm. Më bëë të dhiovasia dica shërbise të tijat (vale, kangjelje e të tierë viershe)

²⁵³ *Conforti nei presenti travagli, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 6, Cosenza, 20 ottobre 1885, p. IV.

çë mua per sa mund gjikonj më duken të mira. I dërgonj gjagjë, sa zotëria jote, çë mbi këto shërbise ndëljgjonet më se gjith tëjerët, të m'thetë si i duken; pse një fialjë e Zotërisë sate rrinjë tek ai, zëmbren e vuljemën t'ecinj te dhromi i marrë. Ki dialjë, me gjith se shumë i ri (nkë kã edhë një zet viet) kã shtiposur për një Ditare çë do këntëka italishte çë kanë pëlqier.

Pata të katërtin livër të Skënderbekut ej e haristis shumë. Sglodha vaitimin mbi të ndjëmìn t'ët birë e nkë gjënj fialë sa t'i thom si më shqori zëmbren. Për këto lojë lavomesh nënk është shërim. E u e di keq edhë! pse kur kishënja monu pesmbëdhiet vieçë bora mëmën e me atë nka të mirë. Perëndia, çë këto urdhëron nkë dimë për çë, na dhëft fuqinë sa të durojëmë me paq. Ditë pastë Zotëria jote edhe familja e Zotërisë s'ate”.

Të poesivet dërguara bashk me kët ljëpush – e nkaha na pandehëmi maide! se mund' i thomi: “*Vos exemplaria graeca nocturna versate manu versate diurna*” – pse keq pak vend kemi, keq pak mund buthtomi. Edhe se sosën ata të pak te ku shkepten dica të ri, ninëz e zëje norë për së ljeri, e nkaha gjëria jonë e gëzuame t'i thetë me bes: “*Macte virtute puer, etc.*”.

44. SHQIPËRIA E DITARET E LJËTIRE²⁵⁴

Pas çë përzierin piest e Italies, te pasiqira e ditareve të lojesë çë rrëmpeu ndër duar frentë e së Përbashkëmes, u verbërua e verbëroghet mose një dëshirë si e tutieme të kenë ndopak te zalit të Shqipërisë, e një dré e afër mos Austria të ndëghet nd' ata zalje t'i mbanjë dielin.

Mos nj' udhë të dreqt po ato i buthtuan kurrai Zotravet tire, ngaha ndër Shqipëritë t'inë të pohjtisur si miq e gjëri – se gjëri qenë – : jo të hapur trahetije mek të ndighëjin njera të ljumtë e jatëres; jo ndonjë kuides e nevoes dritie e të diljirturi çë atie është keq, - e sosënej për këte t'i jip Italia doren të gjëljiturit e gjughës t'asai ndër koloniet aq kë ajo kã ndë gjë. E ajo dī shërbiset mund' gatënej, vet me të ngrëitur Skolë t' asai gjughë te Kuvendi arbresh, kë kanë ato Kolonie te gapët edhe Ljëtinjëvet: të ngrëitur tek ajo s' kish të vëij më se një fialjë.

Mberë ato Ditare as patëtin goljë o vet për gjë të korjirtur emërin t'ënë këtei, ma edhe kur Ministria krie-famaz at Kuvend, ç' është ini, e patëtin dhënë, me svisur, si një cop buk për hirë të tundabishtëmet çë rrethënjën Zotërinë, ato, se e gjegjëtin, fare nkë pipëtin. Ka jeter anë çë do herë j u patë dukur kamnua i zi çë ngrëghej nd' apoljë: ato ni goljie agëzojin fat të mirë për Elladhen, Servien e Maljë-e-zinë çë ljipëjin, e kanesëshin mbë shokëri, të shqirin Arbërin e t'e ndajin pies: Thoshënje “Italia është me ato një vuljije, ndo se i taksëtin edhe asai, nga Shqipëria gjorë; ndo se prei aso vlemie e Balkanëvet, i faneset e mbulitur Austries udha e detit Atërisë”.

Por si bënë e ajo duket hatërimet punes e të kui do të stisin fanë e vetëjues mbi të rartë e t'afërmit; si sot fleshet fati i së mieljes vlemie të Balkanëvet: qëndron, pa edhe bënëur gjë, shëng h i nodhisë keqe kë

²⁵⁴ *Shqipëria e dittaret ljëtire* (L'Albania e i giornali italiani), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 7, Cosenza, 20 novembre 1885, p. I.

sot Shqipëria, mbi kë stiset si in *corpore vili*, ka me Elladhen te trutë e rreme e ciljes biu së pari këshili i Vlemies Balkanëvet, e kë ato Ditare po çës' thonë se Italia përkraghën.

Keq edhe zëmrat tona do t'ishënjn andei ljavosura, mos shighim se Mëreti Italies ka sot me të buljarë të dreqt e së mirish; ciljt u mundëtin sgjidhur prei frimëshit verbëra çë errënjën airin; e pasënjën shëndeten te besa e patevet. E pra – si të mos dëljonet? – Turqia e mbaitur shtuara e me gjith fuqinë çë mund' ketë, papsën vet' ajo druetit e Italies; rreth se i hekurimë për ciljin të jetë i mpodhepsur nga një ngamun çë do të shkonjë përpara. Fuqia priret prei kumbisë e Zotërivet t'Europes pas patet e marrë, e prei të ljidhurit çë t'i ljidhen Fatit sai kombet kë dhespozën nd'Eurōp. Ciljavet pasur, si ajo taksi Berlin, nikoqiraten e shpivet e gorëvet tire, s'i ljpset më të ruanjën shokërinë çë aq ndrisha kombevet, nd' Austriet, i bën ato të mira.

Mose pra Shqipëria e prëitur ndë vetëhé e u mbjedhur fjetashit shprishta ndë butësitë gjërije, ë vet shkëmbi ku të çaghen suvaljat shklovune, ciljat Austrien sot thimosënjën ej e mbanjën valjandime të shtëmënguni ku do t'i fleshet.

45. INAGURIMI I PUNISHTES SË VAJIT NË SHËN MITËR²⁵⁵

Ndë dhë të Shën Mitërit te ku Bekanielji e ljumi Math përzighen nën Maqin, qe stisur e gatur ndë kët verë një trapit për valjt e golë, e sot çë shkruami biuan me psorë të mirë. Pse sot është thomse i sgledhuri ndër pak trapitet kësish çë njera nani u gaptin ndë Kalabriet parë; e përdika se i vënur ndë mest gjashtë fshatet e Arbrësh t’afër mbë rreth, ciljt të kenë pasandai rritur të njëj të katërti kamaten e ulinjëvet: kur ndë një zet e di të Shën Mertirit ai u rrëzua, qe si një e kremte e arbëresh, ndë buljëritë atie e ftuar. Atë e gatëtin bashk gjasht Zotëra shok: Di vëlezër Korradi nga Shën Remi ndë dhetë Genues, Udhis Pankari Bënapiesëm Shën Mitër e Trapëzës madhe të Kozencës; Albert i Marqanonjet ka Shën Mitëri, Mikanton Palaci ka Strëgari, e nga Maqi Rodrigu i Radhanjet i biri i Dreturit Fiàmurit: Ujët e siel; e biuan ndër tri fishkī.

Pas çë i agëzuan të piljasurit, u vū tries gareme buljërisë ftuar e shatervet sai. Tek ajo tries bashk me Guljejm Toçin nga Strëgari, Deputet i Provinçies, e me Marçeljë e Ljopsatëvet Sindëk i Shën Mitërit, desh vend i nderëmi Dretūr i Bankës madhe, Xhuzep Forliu, ardhur andai ka Kozenca se të parasetenej të zepsurit e një stabilimenti i fatur të ketë rritinj bëgatinë e shumë katundeve; ciljit me ghirë i kish dhënur dhe dorë.

²⁵⁵ *Inaugurazione dell’opeficio oleario in S. Demetrio, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 7, Cosenza, 20 novembre 1885, p. III.

46. DITË E SHËNÚAM²⁵⁶

Dié kjé në ditt' e shënúam për *Fiàmurin*. Mëma jòn pèrtèi détin ç'i oréxsej ej e passënej me maal të kjettëm, diè e agëzòì e i ndèiti dòren me të bìr e sàì të sgjèdhurin Prenk Bib Doden, Përñqipa i Mirditës, i ponimi i gjith vëlezërìs e Kërshtë ej Muhamedàn; çë i dërgoi këto pak fiàlj e të mira:

16 shkurt 1886

“Prenk Pasha, Princ i Mirditasve, e lut shumë të nderuarin zotni De Radën të pranojë 40 frangat, që ai ia dërgon me nderimet e veta të sinqerta, e të besojë se do ta ndihmojë, me sa do të jetë e mundur, në detyrën e tij të vështirë e atdhetare, që ka marrë përsipër”.

²⁵⁶ *Giorno segnato di bianca pietra, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno II, Nr. 8, Cosenza, 20 dicembre 1885, p. I.

47. PROGRAMI I RADIKALËVE TË FRANCËS LETËR ANT. DE SOMOGYI-T

I dritëmi Zot,

As mund rri nën të rëndurit e qetëmis çë sot menat të më shqínj prei zëmres të Zotëris sate¹⁾; edhè psè kam bés se hesapa ime, ndòmòs se ndrishe thomse ká e Zotëris sate, pse e dreq't, të mos i dúket ftes asai çë më do mír.

E për së pàri nká Programi i Radikaljëvet Francës, fleshet si nkë vén më ré, se jatër është adhiasí e Gores e jatër është të pàkrúart e psorëvet të shpívet.

Të mbjedhurit ndë një gòr bënèt për ampnín e shëndeten e gjithëve: se këjò vet i ljpiset. E Dreqëta ej e Mira, gjerdhe të shëndetës e të ampnís, jàn tek nevoesa e tek e dimia e nkànjij. Themenít e katúndit këto kumbisënjën; pse jàn tek e përbashkëmia e të verbër e të ljjig çë të Dreqëtën e të Mirën çartënjën. E qé çë protopàr zakòn t'i besëjin njij a më dicave Ljiqen pas ato themení; e atíreve t'i bëjin nghën më pak të gjës së nka shpije. Nestrú këta pak, Zotëria e ngrëitur mbi margúrt, as kish ka të doi prei leghes çë e kumbisënej.

U ljpis edhé se katundart, më rështur të gúajt mirzitàr, patëtín më rritur kurmet e zëat ndë aksi e fuqí; e xënur t'aràdhëshin ndër vargarì ndën kréra të sgjédhur. Te ditët e amahjit, ushtërës e kreravet sai i bëghje buka ndër shpít: e atà krenj pas amahjit, mbidhëshin ndër të turet, jo zotëra më. Po ka Zotënia e nka-ditëme e Ljiqes e ajo gonovàre e ushtërës jàn e qén një nevojë e së keqes ndë gjelet.

Kètèi vidir të kishin piljasur ata çë thughen se dúan stisënjën mbi të zënen e gores; e prà çë Zotëria është një nevojë e së keqes të kishin kërkuàr vet një, si t'e ljésojin njër çë gòra më të mos e varësënej: Poka ajò sot mose trazon, e dhespote, si i duket se ë, e gjithëve, kà

ljugen gjithparu, e ‘s na rështet sishit te ndò një ghér; e mose ture màrr për të. Mosnjeri desh t’i jip fòren kë merr, vet nkà vetëghéa múar vendin e Prindit, e Gora do t’i jét një shpì viete-vigjëljish o gràsh më valjandisur. E kà thomse ljiq; pse u tha Bëna-piesmia jòn, ajo kë piéqt sgjidhëjin për kriate.

Mua duket se kujdesa e të ljesúarit rëndësìn e Statit ‘s i shkon për trú këtire miqëve të léghëvet, kur te vendi nji kreu të vetëmì dúan një lojë “*La Permanente*”. Tek ajo prà këshilënjën, se mushqit të kén aq sà të biljt e shpìs, se Stati të mos i ehthisinj thrisqis kë katundi kà për t’Ínzòn; se ai, ndë vedèkt njerì pà bilj, t’i màrr shpìs, e të vëlèzërvet atiè u rritur me të, se ish e të jatit, e të mbànj për të: mundën të thúash se jo për leghet ata jàn të valjandim, por si Statit t’i japën më buljber e fòr.²⁵⁷

Vúra ré çë kà mot, se ata çë dúan japën hért e tire të ljevrosurit hjeshëm e korronxezëvet prei kardasgjit e gjéles, ata çë burrithënjën për màlin e katundit, jo te ndònjë ghér jo te ndo një kombe vún përpara të pistepsurist e Statit te Ljiqa e të pakësuarit e atireve nkaha ë dèthimkeqt të botes shkrét ciljes i ljipisënjën të rrëfksurit: më shpet ata sot vén t’usëm e mbë légh drét gjën e gjithëve “*rem publicam*” të vënur çë të ja pashim vén ndër duart Statit.

Mose piés e shkretìs gjéles qé të rendurit e zotènìs të njerësve mbi shokët e motit tire: e kètè na të kërshité e kemi të pasiqirtur te simboli hinués i Gjéles këtu-postème: Te ku, pse i dhéksej meretit të ljënej gjindia shpìt ai t’i nëmëronej, Zoti Krisht u pati ljer te një hàthe ndë grikt dimërit: e pameta kriet’ të Statit, të ngòrdhur fòres të atij e nxúartin pàftés e mbë të kitan kà Gjéla; kur moti i butësuar i hapënej njerësvet veren karpúa-mìr. E ndò sot çë màli gores u ndërrúa ndë màl të gjagjës kë ajo kà, Stati cilji këta gjagjë kà t’i shkuljinj dúarshit çë e kàn, do të bënet më i mbisishim se ‘s kjé mai.

Dëljugòhet kètèi psé ata dúan të ndrequrit e psórëvet të shpivet përzìer me adhiasìn e gòrëvet.

Zpt, keq i dreqt ndë mest save u njoga, piemi për së pari: Si vënë ata dorë te shpitë të ndodhura sot? Io njeri i bëri zotëra të kësai pune? pse at faljimë ata nkë patëtìn prei atjire të kui shpitë janë. E njo ‘s vinjën ata çë nënk kanë, të ljipënjën se duan të ghinjën ndër të stisurat

²⁵⁷ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno II, Nr. 8, Corigliano Calabro, 20 dicembre 1885, p. I.

mb' ubrigh; pse dinë se ish një të viedhur, e i reksën ftesa: I reksën ftesa, e mbaghen më shpet te fati i ngurët, ciljin i thonë se ndë dhë kanë vet ata. Mirflë, se si i parastenjën të farmëkosurit nga-ditëshëm sëmundeve, e vetëdekies për së prasëmi, kë ndë një qeljq të vetëm pinë të nëmur e të bëget: ata prëghen te dhata e vetëjues. Poka ata buljarë të përzites, tek të mirë bierën e të ljiq gadhënjën, bënjapiesëmit e mosnjij, janë ata vet me malë të viedhuri, gjarpëra çë fsheghënjën kriet ndë për govertë e gores.

Por ata edhe shtielen një punë t'athun.

Shpitë çë janë sot të bëgata as janë ato çë qenë die; e menat te vendi këtireve ampnisen të tiera: pse bëgatia është karpoi i së bënes. Ej e marrur ajo kuja sot ë, me ja ndaitur atire çë 's bëne (ndër ciljt parastenjën ata Buljarë të Përzitës), ajo me vitin soset e shuma, e do me përbënur prei asi të gjith çë e gristin: e pse gjith nkë janë njij fuqije, njij aresije, njij vuljemie, përbëhet shpeit ndër piest e ndrishëmia çë qe ndieta e të ndarit e bëgatosë çuame. Po thonë: Ma i do vënur Statit drupe ndër duar me kë të rraghë ljimontiertë, mos ata të ganë e të veshen nga puna e t'aksëmëvet: i do dhënur edhe Statit metëra e të vëljiemit të nga njij, për çë Ai të heljq ka bota njerime çë do më mund ap ajo më i ëndur gjelen vetëvehet”.

E na, përrjerrë sitë ka zeghbëtia e pashoke ku shtijin boten, i piejim vetëm: Po kush ë Stati, ki fitua hinues ndër shokët e Gjëlës, çë do të ketë metërën e Fatit të nga njij e vet deljemierë me drupe t'i qelinj të kulotënjën? E cilji, pse mund' bindinj njerëz e skatanse ndë një fat bashk të zeghbet ushqiemit gjeles gonovare; a pse peljakan pies nënk kā te hjea e ëmbëlj të zësë njerime e te drita e noerës tek pasiqiret Prindi nga e mira e Gjithësësë: kā, ndër gherët çëna rroni, të përjerë paljacën e Gjeles; tek cilja e përrjerrë shighim na të vigjëlj gadhurin ç'i bënej miekërën të zotit t'uljët ndë thron?”.

Ndëliém, Zot, të thartit e zëmrës.

Kumbitë e Jetës çë mbanjën piasmen, ndrisha keq, e të tiera se Bëgata pazalje; mbi ciljen është jatër Buk ndë vetëhetë njerime, pas kë deti gjeles sëvaljën e ampniset. Kush di pra se nga Vit pas zëi e i sil shokërisë njerime at buljber çë sosënej për piest e gjithëve, a mos e pritura i spatarej; pra çë vet ai kur siel pulandi grurërash e pemësh, kur verie e valji, e kur ljë edhe egjel punën e speljën? Duken si ëndërra:

E më pse fialja çë me piasmen na kumboi ndë për vetëtona, rri nestru ka këto nkamati; e i është hjë njerësvet të sgjidhurt prei gjëlimavet, buk vedekore e tireve. Andei na rri e dime as ljuetësheme se as begatia i jep, as vaphëtia i merr të vëljiem njeriut. Edhe shëndeta na vëghet më ka të rruamit me buk kjumësht e pemë për ndër pune – e gjith zëmër e sgjedht’ së meroghet asosh – se nga mishëra e t’ëmbëlia mbë t’u prëitur shpive.

Pse e bëna bëgatije pasinuarë ljodhënej e gundonej gjeltë e fanëme t’ona ndë dhë, Zoti i ljeferisë njerime, se andei ato të ljevrosënej, at pune nëmi. Se pak ka të prothemet i ljpset nganjij për shëndeten, e at pak dita i siel mbase pak valjandije: ai çë na gapi tharosin e gjelës ndë kufatë më Prindin, nëmi nkamatinë e bukës sarua, çë na zëgbëtonë punës verbore. E pse bota ‘si gjegji, jemi sot ndë kardasgji të keqe së pa-zalje.

Në ai birë i t’Inë-Zoti tas hjiodhi buken ka qiel; e mënku desh t’usëm ta kui dita nk’ i mburoi, ndomos se nk’ i dha t’e rrëmpijin por duarshit tek e shighin. Me papsur ljamaksinë e kardasgjinë e njerit e jatërit mek’ ecëmi bashk, na qe te piazëma vënur ndë vetëhetë Ljipisia; cilja mirfilë nuk siel jetër karpua. E ndë vëmi ré te psorët çë na psohen, të ngurtit nxinirk me vobekët a ndrishe të nevojëm, na është mose rragur me të bierra, me ljëngime e heljme mburimie pa parë; pëstai çë ljiqa e njerësvet ‘s kã ngaha të rraghë ata të ngurët, ashtu si rregh ftesat. E andei thughen të Mirë a të Ljiq; e i bëghet fati i stoneonem. “Jesh u gjikaran e së më veshtit, pata ue e ‘së më dhatë të gaja”.

I Kërshtë, e të zëje me kë

“*Odî profanum vulgus et arceo*” (“*E urrej turmën e paditur dhe i shmangem asaj*). (Shën. i përkth.).

këto të vërteta ngrënjë ndë për nënë gjalmarinë e skotist çë sot i vëghet sipër; e Zotërisë sate, çë aqëvet i reshtur prëghe te besa e prindëvet ponimë, e t’asëljuetëshrni tek e dreqa, i vë përpara”.

I thavmasur nderes ej evhjarimë të mirit të Zotërisë sate, të faljin.²⁵⁸

Girolamo De Rada

²⁵⁸ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Nr. 11, Cosenza, 20 marzo 1886, p. I.

48. E RREMJA Ë ÇALJOGE²⁵⁹

Monostrofi nga apoljën, si duket, u ljëfarë pa ljenur ruce. Te Maljizi ghinjën ndër vëret me ljemsh besie të largë; vet Elladha as mund ampniset ndë vetëjue. Ata ç'i qëndruan miq i thonë mbë rreth: “Pa lje të thuash se do të sgjerohesh nga petëku guaj; kështu i ftesën ljiqes, e mosnjeri të ndighën”. – “Po maide! (pergjegjet ajo) se na nkë duami të të tiervet; na rrempiem Hjordet se të ljevrosëmi vëlezërit. Duami na të kemi pameta dhenë gjith kë patëtin një mot prindët t'anë: se sot njerëzit e motit ri thonë gjith se këjo është liqe”.

Shkomi përpara mbi hesapen e njerësvet të motit ri, cilja ndë béghej metëra e të më pasuravet sot, Elladha vet me gjimsen e Europës kish t'i përnënej më shpet fares Ljëtire.

I piemi vetëm të na thenë dëljië atë kë duam të gjegjëmi, e mbiatë nëngjin janë e me pasur sgjidhur.

- Ju doni jatër pies t'Epirit e nga Maçedhonia, e për çë? Se janë ato petk i gjërisë sai; a pse gjiri tuaja i janë të mbjedhëta ndër gorë, e kanë atie pet'k?

Se ato janë pet'k i gjërisë sai është një e rreme e purpunirtur nga të pa-balë; e tashti e qëna e spavi – tri pjes atie janë Shkeptarë me ndo pak Shklavun, të katërtën niata kë anakatostit, bënë e duket Eljene. E rreme babalare prana është e thirtura mbi triesat tuaja se t'e gjegjëjien: Se Shqipëria është një degë e Elladhes; vet çë per gëjughen, çë j u ndrìdh e do përjerrë te piasma e parë, hekuri eljen ni monu i njighet”. Sot kët gënjeshtër spavi gjith një diel, e pra të pasurit çë ato kighen e u patëtin mose mbi si njera jatëren.

²⁵⁹ *E rrëmia ee cialjògche (La bugia è storpia), Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 9, Cosenza, 20 gennaio 1886.*

Sosën poka ajo ç'është e bonsinëme, se ndër ata vilajete shumë katunde me petëkun e tire janë të gjërije eljene.

Porsa ndër përandai Elladha pas urtërinë e atire ç'e porsinjën do me i mbjedhur nën vantiljen e sai, e ka ljiq: Ajo të vërë re nga jetër anë, mos detë edhe Shqipëria, e sot Turqia për atë, të mbjedhë ndër gjithë sai Shkeptartë aq, kë Greqia ka ndër të, avtoktoni ata të dheut kë e ardhur Elladha zu, e të ciljit një të tretën të madhe ata mbaitin e kanë edhe.

Dimi se ata përgjegjen: T'Arbëresht e Elladhes janë të dashur, e duan të rrinë me të; po ndrishe Grekërat ndënë Turqinë.

Na duam të shoghëmi pas, mos edhe këjo një e rreme mbi të tierat.

49. LAIJM I PRITUR²⁶⁰

Një grua Vakariciote që u mbjodh nga Vëljora, rrëfeti se Omer Bey Vriones u kish mbjedhur ndë shpitë, i ljëshuar me Zotërat e tierë të Shqipërisë ç’ishin të mbaitur ndë kultë e Dardaneljit.

Pra javën që shkoi na erdh ka Miziri jatër e zënë që na mboi gare.

- Die pata lëpush ngaj Bukureshi, tek më shkruanjën se Abdul Bey Frashëri rron; e Sultani e falji, edhe e ftoi ndë Stambul. Ki nishan është i mirë e i mbarë për Shqipërinë, e jam fort gëzuar. Shko kët laijm të bukur ndë *Flamburt*.

Ditaret e Ellenëvet e shkroitin rreshim aq gherë “se Abdul Bey vëdiq”. Ashtu ndë Mars 1885, Ditarëja “La Confederatione d’Orient” tha se Shqipërinë që Gjirokastër e njera ndër maljet lart Serbia, piesën njera te ljumi Strimon, Salonikun edhe ljunin Aliaschmon Austria, Elladha pra do të mirr Epirin poshtëm pas Gjirokastrin: se këjo u kish ljidhur ndë Skernevics”. Gjith panë sot që njeri i vërtet është kush e shkruai. Të rrejtur e të tërpruar qofshin ata gjith monë! *Beni – Suef* 16 të Shkurtit 1886.

- Zumë edhe me ghirë te ki muaj, se ajo zonjë e Arbëresh nga Siçilia aq norë-hjeshëm e që aq gadhiarë e bukur ka të foljtë shkeptarë, Kristina Xhentilia, ish vaiz e bardhën, e ndër 14 të Fievarit u martua me Gjergj Madaloin, një dialjë i shpije të madhe të Qanes Grekëravet.

²⁶⁰ *Laijm i pritur* (Notizia Aspettata), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 9, Cosenza, 20 gennaio 1886, p. III.

50. KUVENDI I ARBËRESH SHËN TRIANË²⁶¹

Nd' atë çë Shkera as pati ngaha të shtinej m'ëmen t'ënë ziljitur, ndë ljugadh tek ljenur të biljt ciljt vrarë ciljt të ljavosur, ajo pra t'i jip gjithonëvet duart me ja ljidhur jatër e ljume na fleshet nd'Italiet tek na "të daljë prej shkretije të madhe" patëtim ubrigh. Se nkë fjit Ajo, kombet afërme patëtim bés teh të qetëmit mose t'asai; ej Elladha, pse gjëndëshin aq vendeshi bashk, zu par herë punën të ndalënej skoltë kë t'kijh për të, e t'e mbjidh e t'i jip të foljtë e vetëjues; se prana ajo t'i rrijë mbrone e kriate. Për andai na holqëtim ndë drit një Ditare t'Arbëresh. E ndo, parthina buljarë të guaj edhe të sgjedhur, na gërganë pse ndajim psorën e Shqipërisë nga t'Elladhës e të dia i ljëshojim kuspuljuara. Ata nkë dinë se sot të veçëmit na bën pra të jemi, e përzita na bën të mos jemi: e se ashtu ata na ljpëjin të rrusëjim *Fiàmurin e Arbërit*, e shtunur mbë trual për monë.

Mundëshim por këto nani t'i ljëmi si të shkuara! Se retë t'ona sot janë përjerra këtei, te Skola ç'është jona e mbi ciljen no Turqia no Elladha s'kanë dorë, e cilja është me na u përsëritur. Ministrat çë panë se ndera e Italies do se ajo të shtuarat me hjenë e madhe kë pati nën Zotërinë e Anapuljit, sgjodhëtin e dërguan bënjapiesëm e të dashurit tire një Zot, nestru se i ljerë së mirësh, të dëljugam, e të çeljur malit urtërisë e buljërisë.

U duk mbiatë, e presëmi të jetë, këjo hera e të mbushurit e vuljemes mek u stis ajo Skolë, t'ish, duam thomi, fanare dritie per Koloniet; e andei me u verbëruar mbi Shqipërinë. Ashtu ka gjith anët përdhezet dëshira, nd' atë Skolë të kemi pa-meta qishen e thrisqisë të prindëvet, e një ubrih, çë sot i ljpiset gjughës plakë kë na fjasëmi. Ashtu Ungëra,

²⁶¹ *Cuventi Arbëresh Shen Triaan* (Collegio albanese in S. Adriano), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 10, Cosenza, 20 febbraio 1886, p. I.

Kolonie buljërësh e më e madhia ndë Kalavritë, e para ajo – e shpeit të tiera të pasënjën – t’Ardhurit-mirë këto dëshira i vu përpara, e ljuti. Se ngaha Kolegji i kumbiset Nikoqiratës të qishvet mos, jo nga thrisqi e prindëvet të ciljes Kolegjit i qe besur valjandia? Ka jetër anë, nestru se Kolegji i arbëresh te ku gjuga e arbëresh nukë mbësoghet, është gjë të mbrazët: sot dera çë na u gap e dheut ku ljamë shpitë, siel nevoesën e të mbësuarit atë; e pra nderë e madhe e vet e sai është për Italian të jap ajo andei kliche e të dhiovasuri te jeta protoparë, ciljen gjith anëshit sot duan e bënë me e gapur. E kur ajo të jetë, na dimi se Shkeptarë përtei detin janë se të dërgonjën atie dieljme të mbësohen. Aghier të ve tuke u ljëfatur të ndrishëmit e dialetevet, e me të të mpodhepsurit kufanë ndë për ne; e Shqipëria të i ljidhet mali evhjarimë e mbuljkash ditë për ditie dheut Ljëti, edhe se kondisi neve ndë shkretitë e veshi e darqi si të sait. Qe mot çë nga Arbëria Andromaka, shtuara te zali detit e piono ljot, shigh gjëritë e sai me Paladhin e gjithve, të rrëzuara mbi deit me ardhur këteina, e i agëzonej Fatie të bardhë, e ljutënej se ata t’ishin një i të di piesvet.

51. LETËR NGA PALERMI²⁶²

Na shkruanjën nga Palermi:

“Qe këtu sgjedhur bënjapiesmë i gores, të dielj çë shkoi, Pietër Kiara, një buljār nga Palac-Adriani. Mirë e njohën, e të kenë haré ata çë shkruanjën *Fiàmurin*. Pes katundet t’anë, Pëlàs Adriani, Kiana, S. Kristina, Mexxojuzi e Kontesha qenë gjith për të, si i pati hjé”.

52. NGA BUKURESHTI

Ka qe shkruatur nga Bukureshi:

“Do të bëjënë ndihma për *Flamburin*. Mbë të mitë, mbrënda ndë salon tel silogu kishujin kuvent, Nikolë Naçua, një shkeptār, holjqirevolverin përmbi Nën-kreun, Konstantin Butinin, po nuk e vrau; do t’a shpëtonjë Inë-Zot. Tustai ljavozu me thik Thanas Mborien po pak e pa dëm. Nani e kanë ndë burg Nikolë Naçin”.

Këjo ë zënë na zëroi, e më se nkë dimi ndietën e dhistakësisë; mos ajo që pse kush shumë e kush malë pak kã të gjërisë varfër.

Se qenë nga Eliadha të ljerë shpive arbëresha çë at sillog ljuatin t’a svisëjin. Ashtu zumë se Puskidha, një i Arbëresh kashtie, si monu zunë e lundëshin fjetat e Balkanet, nga Athëna shkoi Bukuresh: e hesapëtin se ata ç’e nderonjin triesës tire, e patëtin dërguar andai.

Pra dojim të dijim ndë kī është Nikol Naçi, i mbaitur mirë simpiet çë shkoi, nën nkaljesmenë se ai kish shtitur të nipin të tërpruar prei Konsulit t’Elladhës Ngasurah, t’e prit ndë treg e t’e vrit; si ai dialjë bëri.

(Shih *Fiàmurin*, viti I, num. 6).

20 mars 1886

²⁶² *Lettera da Palermo, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 11, Cosenza, 20 marzo 1886, p. I.

53. GJON ARAGONA²⁶³

Prèi aq ànëshi të dhët sitë u prúartin mbi Pasteur Parigjë, të ciljit u thà se gjéti jatrinë e àjit të qënit tërbúar. Po vinjën lajme se nk' i shëròn gjith.

Ndë Kalabriet dighet, çë kã mot, se Karpancàn, një buljãr, Xhovanni d'Aragona, shëròn kë dò i qëlënjën pas aji të qëni të tërbúam. E vet u i jam martirì.

Te viti 1881 u tërbúa Shën Mitër, një qen i Dhon Marçëlj Ljopsit. Iku e shkòdi Maqë; atíe u súlj e zū di corrobìlj çë brìdhn mb' udhë: njërit ja thonë Zep Bëljúshi, tetë viètësh aghier, jàtërit Ligjë Frontéra i gjasht-viètësh. Të thirrmët e atire e të gràvet diershit, qëni pështòi brinjës nga Apoljéa, çë sosën te ljúmi Math; e kush u gjënt ndë katúnd e pàstin ndrìshe údhëvet t'asai brinjë. E shighin se rrëvúar te ljúmi – kish një metër új a pak më – ngàu zàlit ljàrt një cik, prana u prúar prap brinjës përpièlj: Tek, nd'udhë çë qelë Strëgãr, ju përpoq të miërit t'im biri ç'i shkregu; e rã mbë vënd pa çinkërtur fàre.

Prindët qëltn di dièljmet Karpancàn; ndënjtin dicà dit e vet jatrítë pagúatin: Fuqi e ciljavet te e pàra javë bëri e të sëmúrmit përmúartin gjak. Të di sot janë të gjalë.

Na 's dimi si edhé, pas çë janë e bëghen aq fialjë mbi kët nevòje, mos-një i thòt Prefetit Kozencë të rëxétës kë dihet se kanë Karpancàn.

²⁶³ *Jatriti I àjit të kjenit tërbuar* (Rimedio al morso di cane rabbioso), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 12, Cosenza, 20 aprile 1886, p. II.

54. VAITIME²⁶⁴

Ndë ampnitë e kuidesës të psorëve kë na gatënjin pa-ghirve, duam të priremi me u ljevrosur ndër provë të rea, (çë na vinjën) e të gjëljiturit gjughës t'ënë, aq e hjeshme. E ciljat, ndrushi dialetesh, na rrinë fanare e vendevet, ngaha ikëtin këjo e ajo përzit' e gjërisë s'anë.

Njera është e të ponimit Billòt nga Frashënita, mose i valjandimë i nderes Shkeptare; je është një vaj mbi vëdeken e Akil Parapunjës nga Përçili. Një vlastarë ki i zëmres Shqipërisë, diu çë shkretije e fatur te Dhiata e Jetës.

Jatëra është e njëj ganjuni çë për së pari ghinë te ljugadhi i trimavet Shqipërisë /Françesk Krispi nga Glaviano/. Të fali ai bukur *Flamurin* e kombes tij: Po retë çë na u pruartin mbë gheljm bënëjen e pasëmi, me të, më shpët varën e Zotit Gabriell Darë, katundarit tij, e ditrën e ciljt gjëria jonë vobeke buari njize. Si Billota edhe ki dialjë thot pas të ndiemet e të dîmen, e jo se të duket gjë: u mbaitur kështu ata bashk hekurit t'arbëresh.

²⁶⁴ *Vaitime* (Nenie), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 12, Cosenza, 20 aprile 1886, p. II.

55. KEMI KËT LJËPUSH NGA MIZIRI²⁶⁵

“Për Kolerë as fjasën gjë ngaj Shqipëria. Po Brindis, e ndë për gjith zaljet e Italies mbaljë detin e Atërisë, janë të sëmurëm; e t’ardhurit atei nuk i duan ndër shpitë t’ona. Edhe ndë Shqipëri, si nani, janë shumë kusarë; e unë i them Zotërisë s’ate: Mos e dërgò tashi birin t’ënd tek janë kaq ushtëri Turqish andej, e ata kusarënjën më keq. Edhe Shqiptarët gati e të dhezur të ljuftoin me Elladhën, gjënden edhe posi pa krie. Rrëmpienë kaq katunde të kërshterësh, Janin, Permet, Koljonjë edhe Korçë, tek ishin tuke ndënjur nd’ampni.

E ndorrina presëmi të mbushënjësh mendirin të dërgojësh birin t’ënd e dashur për këteina. Këjo udhë e birit t’ënd do t’i siellë të madh fitim Shqipërisë, tek gjith diert do t’i àpen me ghirë. Se politikia e *Flamburit* na pëlqen: “Përkraghësi me Sultanin kundër të huajvet”: e ato sa shkruan janë të dreita. Shqipëria e tërë janë me Sultanin kundërë Eljenëvet. Ndo pak ndë për të kërshterët e Epirit kanë zëmbren me Elladhen; po ‘s kuxonjën. Maometant e Shqipërisë janë më të mirët patriotë”.

Beni-Suef, 3 korrikut 1886
Eutim Mitkoa

²⁶⁵ *Chemi chët ljëpush nea Mizhiri* (Abbiamo questa lettera dall’ Egitto), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 12, Cosenza, 20 aprile 1886.

56. RETË E APOLJESË²⁶⁶

T'ardhurat e prasëme nd'Apoljetë sbuljuan pse mpothimat e ampnisë, kë asai pies t'Europës i ljutënjën se të papsej, as dukëshin as thughëshin; e pse Europa as kã udhë të prënjë vetëhenë prei valjandishit, te ku të suvaljurit e asai anë e anakatosën. U pã mbë drit se është ajo Rusia çë 's do të ljerë plaçen kë pati marrur mbi Turqinë, e cilja i që prei këtë ljerier ndër dhëmbë Shën Stefan; po kë Europa u vënur anamesa i kish shkullur. E një ajo 's rrī, ne ljë të prëitur mos e rrëmpeft pameta ka duar e kësai; e sot kã, si duket, ù edhe për më. *Moskoëskya Èedemosti* te e treta e Viështës e tha drëq: "Përnqipa Ljisëndë kã të mbanjë fialjën kë dha. Ai kã t'i përjerë ndër duar, si taksi kur e pati, kurorën e Bulgarisë Zotit madh të Rusies ka e pati".

Për gherën e të përjerrit Rusia se të bënej një të shqerrë më të madhe Turqisë e jet t'i vinej më e shumë: dha ajo dorë fshëght, e Bulgarisë ju ngjit Rumelia. Vet se dī provinçiet te fora e përzites këshiletin e deshtin, si ndë Rusiet nën pritej, Zotëninë e vetëghesë. Ftës për ciljen na parthina pamë mëretin e tire të ljidhur e "buthëtuar si ndë markat".

Europa, si lojë zògj e taraksur, jater si kã një nani, se zae mb'air.

Turqia, ljerier vet me vetëghenë, rrī si e mposimarme.

Austria druetën mos te hera e nevojës të i llijpset pra te kragu Gjermania.

E vet këjò gjëndet e vënur mbë staçë. Françia çë armatoset e gatet për mejdanin, i siel ndë buzë një fialjë çë më se jatër i tharton griken: Se të Balkant ajo 's kã kuides". I ljë poka Rusies gjith foren e sai, mos ajo e zekëthur të shkonjë me Françën, maha është e pianepsur – e pati andei si thamë, e mudi vet të sfarënej kuvendin e pas amahjet e

²⁶⁶ *Reet e Apoljees* (Le nubi dell' Oriente), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell' Albania), Anno III, Nr. I, Cosenza, 15 ottobre 1886, p. II.

Krimesë, e nani pret e di se andei kanë të bien patet e Berlinit. – E dieli Gjermanies fanet i gunduar – afër asai ciljen thomse se mose korjirti, sot e motanosën.

Aqëvet më duket se u gënjie ajo mbë t’i vënur, me ghirë të Rusies, këmben te xerku anës të Polonies që i toku, pse ngordhi Zotëninë e Rusies mbi piesën e madhe t’asai kombe të dhistihjime, e i lja Françës speljën se një ditë këtë te këtë te kragu nd’ amahjët kë ‘s bier sishit. E ndo sot e mosnjë ljutën psorë të përbashkëme me të Françës e ndë Posen si Krakovia të ahjtënej ajërin kë atie fritin prindët: Polonia jeter i sosënej Rusies “si arnëri i ri te e veshur e vietër”.

Sosën Ingilterra, cilja nd’edhe buljartë e sai inë ndër vërteret e katundit e të psorës tire, doin ata vet të risetarëjin trubulinë e Europes që denë më e më trutë e leghëvet; edhe gjindia e kërshte përbesë si një mot te Fati mirë i Ljiqes. Por nd’Ingilterrët ata që, edhe pa gjë, taksënjën gjetëk gjith të mirat gjërisë që t’i sgjedhë Bënjapsëm të vetëjues, edhe nd’Ingilterrët venë ture patur statin ndë duar; e pse janë jo më se vulji a nkamati ka pasën: atie, si gjith paru, Zotënia është mose e ljuetëshme. E ndo se sot këjo duket e kumbist bujarve me zënë e Anglies piak ciljes nk’ i çajin patet ndër duar: Gjermania mba se s’artën të i beset. E ndë t’anakatosurit e Zotënivët gjitha, këjo, kutient thomse të drites që rā mbi kush janë që së ljenë Europën të prëghet ndë kuides të vetëghesë; e për ciljt e mielljë një te gjaku se te gjëlinjë dialjmet e sai nd’ushtëri, “ushtëri e filjaqi”, rri mose me héljm: sot këjo i naforën, thomi, te Ljigut Jetës murgun Ljisender.

57. HYJNIZIME ETNOGRAFIKE²⁶⁷

Te viti 1829 erdh nga Shqipëria ndër Koloniet t'ona një burrë që kish qënur akollj të Aliut nga Tepeleni; e ljodi te shpia jonë të ljodurt e Palikarënjet; ç'ish më se jatër një të këcier. Ata të ljodur vet e keshia parë më se një gherë ndër burra t'anë të motimë – mbase je kanë t'e kultonjën të tierë pieq të të tierve fshate t'anë për këtei – e ish mbë meter të koreut: Këmbe e diatht kur mbë trual kumbisej rëndë, dora e diatht ngjatej posht ndai shaljën si ajo që edhe ostenë kumbisënej mbë trual; mb'atë që dora e mençer ngrënej bërruljë përpara balit, foka me e pushtruar me petën.

Ish këta te moti protopatë te ljodurit ljerë nd' Arbëri, që muar emrin ka Burri, e u tha të ljodur Burrërisht? Të ljodurit e Salinjet Romë, që atie qëndroi ka shokët e Enesë Frigjë e ciljt të parët ljodëtën nd'Italiet (si shkruati Palemoni) τὴν ορχησιν ενοπλεον, të ljodurit e Salënjet ish gjith një me të ljodurit burrërisht? Piazem këjo e ljé po e qenëme e të njëit thomse të atire farave të marra psorëshi tutieme.

E shkomi përpara: Salitë e Romes as qelëjin te bërrulji *ançilin* e gores, ma peten e Thraçies mbë rreth. Kush qenë Thraqët? se mos njera ndër kombet e Balkanëvet dinë gjë të pasur ndër to e që mund i ljidhet piazëmie të asai farë. Ajo mba se nkë lja piazëm si ajo që'së qe. Por mos nijj farie, pas ç'erdhi Zoti Krisht, kuljtoghet se me svisur e gjavuan atie si e të frushkuljve: pati ajo poka pasur qënur gjëri e të tierave farë e nijj kombi që edhe fjet gjughen e ljasht. Ndë Shklavunit e Balkanëvet as kanë ngaha t'i zëghen, rri e dime e thielë se Elladha i ish Thraçies e guaj. E na duam pasëmi tek të ljodurit burrërisht e armatost t'Arbërisë e te shokëvet t'Enesë me peltën e Thraqënjet, një

²⁶⁷ *Divinazioni etnografiche, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 1, Cosenza, 15 ottobre 1886, p. IV.

pë, të golë si të duash, na çës u këput e ljidhën një gjërije Trojant, Thraqët, e t'Abëresht ciljt gjetk muartin ashtu emra të tierë, ndë Maqedonie, te Zali, nd' Arbëri, ndë Thesprozie e tek Iliri.

Pse *pelta* do të jetë mirëfilë *peta* kë na edhe kemi. Janë gati katër qind viet çë rā skudhi ka ushtëritë; te nazili inë më nënk dighet, qëndroi po një emër. Te martesë e trimi me vash, t' enjëten parna të dielën e gjurdhekut, te shpi e atij gëshenjën me miel zagat e vé petën më mbare të rrethi; e trash më se dhiet çentimetra, e gjërë sa mos një shòsh, e sipër e tërjortur me aq të dukura të Gjelës: e mbi ciljën shempletirë dimi prei Omerit se i terjoristin peten e Aqeljesë Pelasg, jati Burrit. E na bëghet andei drit, se te shpi e dhëndërrit “qiparizi kui dhria i vei me kumbisur” adhiasei te java, *pelta* thraqie simbol e ubrigut kë ajo kish me gjëitur atie.

E më këtei te Resi mëret i Thraqies ç'i erdh ndigur Trojës, na fjet gjëria e asai me shokët e Enesë; e te kueljt aq të sgjedhurit e tij, kuljtomi atë çë qe e është ljevdi e Arbërisë ndër gjith farët e sai; se tagjisore e valjandime ajo të kueljëve pa shok.

II.

Nk' është me thavmasur se përzëtur faten e leghëve të vatura me motin – e si t'i gjegjëmi më fialjën? – kemi na të pasëmi, njeri po thoi, fjturaka.

Po qëndroi një fialjë e Pirrit, zilja, flagë e dhezur, dritën mbi të foljtë e atij mëreti, të foljë arbëresh.

Ndër gjëat çë sosënjën t'Enit kemi se ai mëret i dërgoi thënë Romanëvet:

*Ferro vitam cernamus utrique,
Vos ne velit an me regnare Hera; quidve ferat Sors
Virtute experiamur . . .*

Qe kush pruar të ditin viersh: “Ndë juve zotëninë a mua më dhëft Junona”. Po ljk i thanë se pruar, pse Junona as e ljufës as e di kombevet ljuftore, ish perëndesh. T'e ndreqëjin, pse Hera për ta mose fialj ljtire, e ljidhëtin jatëres Sors, foka Zonja Psorë; vet se andei vëi bierrur e qëna e hjea e dive idé veçë.

Gjithsei ljëfaret njogur te *Hera* fialjen e Arbëresh, të mbaitur ndë mest të guajavet. Hera për né është e bështëra fani e motit, e ashtu e kemi mose edhe për ndë goljë. E ai viersh vete përjerrë: Ndë se juve Zotëninë, ndë se mua dhëft Hera”.

Se Eni at fialjë pati mbaitur bashk me aq foren e zësë t’arëbresh, e për nderë të shkliemit Burrë, si edhe i thërret te gjuga e atij e ndrishe se Ljëtinjt, je pse Hera e arbëresh kā më se tempus i Ljëtinjvet t’aksëmit ç’ish, thua, te gjaku i atij bënjtari i ljerë ndër koloniet e Kalabries.

58. DY FJALË MBI KOMITETET ANTIKLERIKALE²⁶⁸

Nga i pati rarë si një skuturë atire aqëve çë a patëtin, a kanë, a presën të kenë prei Zotërisë çë mbjodhi ndë një anët e Italies, e kush andëi më të thërrës “se Ai është me Çesarin e jo me t’inë Zonë?”. Këjo mba se dighej: ‘së dighet vet çë sual vërtet Hera, e shtū gjith kët tërbim.

Ashtu gorët i gjegjënjen të mbosimarta. Vet se andei (e po çë pëstai mbë rreth rrodhen me vandilje të gapta *Trimat e Mentanes t’u Mbjedhurit* nga amahjet e katundit, e të tierë kësish (gjith thomse për më gjë) leghet meroghenj dëljudhit “tempore cujus omnia trunza natant” cilji ‘s rraloghet, ‘së ljë më Italien zeshk.

²⁶⁸ *Due parole su i Comitati anticlericali, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. IV.

59. FRINË AJËR I MIRË²⁶⁹

Kollegji i arbëresh Shën Mitër u gap i përndrequr ndë Gjinas e Liçë: presëmi të vinjë edhe jatër, pas çë kamata e petkavet, jo më e sdredhur udhëshit, t'i kulonjë mbrënda.

Nani buljartë e Shqipërisë, e ndër ta, të parët çë e zënë, ndighmë tartë e *Fiàmurit*, ndë kanë dieljëme me mbësuar, t'i dërgonjën ndë katund të gjakut tire, më shpet se ndër Skolët ré-guaja t'Elladhes e të Françës. Tek e pushtruamia e Ditares mundë dhiavasënë programin e çë doi atie zëghet e me çë të ljamun; e si të pagëzuarit grek do të jenë të gjëlitur me jo më se sa paguanjën biljt anë.

Shëndeten pra të ajërit e ujit, vetëminë e ëndëme të vendit e pulandinë e aqëve të mirash kë dheu këtei kã, e mbi gjith hjenë e zakonevet shkeptare, mundën një buljër e njeter, par se të dërgonjën të biljt, të vinjën te viti ri t'i shoghën me sitë vet.

*

* *

Kemi pësati ndër duar, martirī të nevojës e të malit nani i gjithparëm e te me gjëljiturit gjuhen e me të hjenë e gjërisë, një ljëpush e të nderëmi beyu nga Korça, ciljen i shkruati të shkliemit Eutim Mitkos ndë Mizirë.

“Sa do çë nuk u njohim’ njeri jatërin me të parë, po me të deshuar vehten mose deshonj për Zotërinë tënde, çë ke qenë, edhe jé, mirë-bënjës i madh i kombit t’ënë. Me gaz¹⁾ të madh mora nga kushëri

²⁶⁹ *Frin ajer i mir*, (Spira buon vento), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. V.

jyt, Zoti Ligor Mitkua, sa i kishënje atij shkruar për mua, si kundër edhe unë kam malë të madh që të shkëmbejëm kartëra “për punën të gjughës t’onë”.

Ne heljm të madh mësuam ngjarjen e Zotit Anastas Avranidhit²⁾, prei Iskariotit Nikola Naços: po Zoti Jetës e shpëtoi për të mirtë e gjith kombit: Ati që nat e dit i ljetet Zotit t’i ngjatinj jeten për atë që nisi përsëljindien e Shqipërisë.

Ndofta edhe Zotrote i shkrove ato që ljipsen ndë kët punë për t’e shpërehëruar³⁾; të mos ljerë prapa punën që kã nisur.

Të përqaftinj me malë: *Vëlai yt Orhan Çerçis*
Korçë, 2 të vieshtës 1886

60. UDHA E MADHE E GAPT TURQISË

Duam' i thomi kët herë pak ma të dreqëta Turqisë e të shëndetëme. Pse ajo rri mose si e marrë noerishit je pandehjëme di u çë fati, edhe pas çë Berlin i taksëtin se nënk ljëin t'i mirrin më nga ato çë i qëndruan?

Pse i rri tek e dimia se kush atie taksi pararenej jo dukt e asai po të vetëjues; e të ndigurit çë u desh qe për heren kur ndonjera nd' ato zotëri të ndëghej mbi atë të mirr, me u gatur atei madheshtije e fuqie per mbi shoket. Tashti kanë ardhur edhe këso heresh; e ato Zotëri, për ndiet t'ampnisë ç'i ljipsej më shpet, as muartin andei nkë thom pune po valjandi.

Ato pra gjë 's taksëtin per heren çë një o më provincie të vetëesai bëjin prei atë të ndaghëshin e të shtuarshin Zonja vetë. Se ajo i do pasur ljidhur me fuqitë e sai. Punë këjo e vështirë, ndë mest kui as kanë jatër vuljemë se me piest e Turqisë guaj të rriten e të ngordhen; e frinjën gjith anëshit nd'ato provincie, se t'i sgjidhen e t'i jipen atire. Gjith dinë si këta margurë u hie e shtual çë aghiera mbiatu; pse u bë e bëgghet mbë drit pa-balë. Për andai qenë tek ai Kuvend çë e deshtin mirë; e i bënë foka një borte e të prëiturit ato provincie te gjela e prindëvet, me themeni edhe vrëtare, ciljat t'i viojin nga njeriu nd' ubrigh Besën, petkun, e gjërinë prei të fodhult e nkamatinë e krenjëvet, bënjapiesëm atie të Zotit madh mose i paftes. Dera e madhe mosnji farie kë pati ljidhur psores vet, i deshi kurrai sfartur gëjughën a hjenë e gjelës; e mund hesapej se sa t'i prirë ampninë e bëgatinë, ato i mbaghëshin t'asëljiuetëshme. Po t'afërmit një sot nk' e ljanë atire të ja e përjir.

Dhata poka tek gjëndet, e porsin t'i ljinj shëndetën vetëgghesë, marrur zëmer nga aq të mirat kë ajo kã.

Keq tutië nga na t'i thomi se e mira e gorvet, të kenë bënapiesem, si mbase gjith Europa sot, ciljt të bëjin për ato. Se ata bënjën, të shumë, mose për ta, e me buljbert e kui i sgjodh: e u ndã lega e kërshtë, e një pies e madhe gã nga kamat e jatërës e 's bën, jatëra bën e jep. Keq turp keq fles e madhe të duan njerëzit "Ca çë të jenë vetëggha e gjithëve".

Duami atë çë do nga Farë, të veçëmit çë, si shpitë fëmijet, të mbjedhë gjërinë; e valjandinë e petkut sai e të harates; e mbi të bënat e të dhënat katundeshit ljiqa të jetë e sai, pas themeni të dreqëta e

të kumbista Zotit Madh. Nga njëra me Fiamurin e sai ndë ljugadh, me buljërinë e me gjughën e sai nestru se te pramatitë me Derën ëm. Pak krenjë të guaj t'i dërgonen, pak t'i jenë të katundit; se të mos rëndënjën ndonjë short udhie; je rëndë të muntoniset ndër ta gjith ftes e së Dreqies ç'i qe besur.

Po të thonë: Këta të gapt-dorie i shqitën më shpet ato ka Mbretëria, ciljes duket se duami t'i përjermi fuqinë. Oghe se i shqitën; po vet dimi se fuqia Zotërisë 's'i vien nga të ngjiturit që ato t'i jenë, po nga ubrigu kë andei të kenë, je nga të dashurit që mirë t'i duan. Ata kë një Zot mundën, se i do ljidhur te qerre tij është se ata t'i ndënjënjen foren, jo se t'i japën fuqi. E Roma të nga kombi kë mundënej, hiljq ftiren, ti thoshënje, ndër këmbtë e shpivet saj t'i frinej gavninë; atë vet pra ljëij ndë petkut e me vethenë e sai; me të po ai t'ish një ndër nevoesat. E mirë i mbajin besen; e porsi ljumë i madh mose i rritur rrekashi që ja rrënjën udhës, u duk pra si e vetëme ndë dhé. Ki po është dhësi tek Zotëritë më t'aresime t'Europes, Elvecia, Svecia, Austria, Gjermania, Ingilterra u preitin a binden për ampni; e këto vleme buthtuan parthina se gjë nënk i taraksën. Nd'atë, ajo gjegjen e jo die a një ditëz, se duan rrëparen Statet e Balkanëvet; e Hera nk' i vien, pse varen prei të guaj më të mbëdhenj; dhe i ljpset unaza e namesme e përzites: Nganjë as do as është e ljenur të detë se këjo e ajo shoke të hipinj mbi vërteren e qerres.

Poka ampnia, te kë na shoghëmi se edhe Dera e madhe mund' ampniset, është tek të mbaiturit më daljë frenët e gjërivet që e ponisënjen; unazë qendruar e zonjë vet ajo e të përndënavet evhjarime. E jatër vëleme më e fanëme prana se e sai të mos jetë gjikun; e njigherie të ljëfaret gjith patolëka mbi nevoesat e Apoljeesë.²⁷⁰

Një qe (pas t'i marrurit leghëvet kë ni dhespozën dukt e petëkut tire) ftesa e madhe e Deres Otomane, e desh t'i jip gjithëve besen kë ajo kish e ngaha e kish te inë Zot.

Këtë s'mundi abonësina të gatënesj më se mbë gjims; e moti vate ture i papsur foren e vuljinë e kësai pune. J' edhe këto janë di të ljume e gheres sodëme.

Pse Vlemia nën Zotërinë e sai, përdika se tek ajo mbase aq janë të Kërshterë se Maometan, do të ampniset mbi at gjë, cilja e gërvisht më egerson boten njerime, duam thomi thrisqinë mek t'inë Zoti nga prindëri i ljidhën të ljerit. E pra nevoesa e parë e asai Zotërije, të rughet nga puna te i ndërronjë fuqime ndëljehien me të dimen kë kanë të Perëndisë, leghët që asai i besëtin vetëhenë.

²⁷⁰ *Udha e madhe e gapt e Turkjiis* (La via regia aperta alla Turchia), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 2, Cosenza, 15 novembre 1886, p. I.

Se ljiqia çë nha njerës t'i vloghet këtei e t'e ampnisinj, ndalën ata të guaj çë e rriedhën, mos marrën ndiet nga dhistihjia e e ndo neres, no se gjeri no se njëj thrisqije, t'i vinjën ndigur e t'e marrën nën ta. – E Dera e Madhe vet, ljë e bie druetima çë do t'e mbe sot të meruame, se thomse te një dit'e pa-pritur gjimsa e të përndënëvet sai, sot ndrisha besie me të, t'i shqitet e t'ubrightet ndë gjinde të Kërshtë cilja me atë të zërë amahjinë.

Këjo poka të jetë qerria e qielit sai, ngaha sitë as kanë t'i sdridhen se të mos bierë udhën.

E prëitur te këjo e Dreçie-prindi, Vlemia e Gorëvet sot të ljidhura Fatit të Zotërisë turke, të rrëzohet ndë jetët me di të ljume pa-shoke. Pse gjëritë kë ajo mbjith, janë të vogëlja si kërthi çë sosënjën të horëve të dritëme një pas njëi zonjë e ponime të vendit – e rarë prana se t'i ljëi ditën t'afërmes – e andai ndë nevoes me monë të preghen ndë fuqitë vëlame te hjea e dushkut Otoman. Pse nga njera çë të doi, u ndaitur, të veçej, sosej e vetëme, pljaçe e paratur nga marguri të forem. E këjo për të stisurit asëljuetëm të statit Vlemies re kë na ljutëmi. Ka jatër anë i vënur rë si të gjëndiet ajo e uljt mbë rreth detit çë nga Tripoli nd' Afritë për Mizirin gapet zaljevet më të shëndetëm të Azisë njera Kostantinopul, e për këtei matevet Traçies, Maçedhonies, Arbë-risë njera Antivār, e me izulat e bukura e dheut: thomi se mbi gjith Zotëritë ajo pati pulandi grurësh, dushqesh, kavshash, anamesa ljume e proite sielë-të mira, e mb'ajër të shëndetëm nën diel të bukur. Duket edhe nani si nd'atë gji rri alja piasma te Parraisit dheut parë. E mbi këto gjith atie pra i fanëm dushku njerimë. Atie u ljenë Moiseu, Davidhi, Akilli, Ljisëndri, Sesostri, Nabukodonosor, Çiri, Burri, Maumeta, Iskandri, Maumeti ditë, Mehemet Aliu, atie Salamoni, Omeri, Pitagora, Aristotili; e atie për di miljë viet Gorët, e Dhinastitë më gavnare, bënë gjith storien e dheut.

Ai të marrë zëmër Zoti madh, e t'i ndighinj atire farëve çë edhe janë, të përçeljen ndë vetëhe me të njogurat e të pasurat kë i patëtin prindët. Nganjera prana, e përbesur tek të sait, ciljt të ketë jo bënja-piesëm por të Dërguam ndë buljëritë Divanit; e tek armët çë t'i jipen e kui t'i zakonënjën ushtërtorë të sgjedhur ndër kombët e shkliem: të heljq mbi atë simpatinë e së dimes Europë; e t'i jetë ndë ljugadh, ndai shoket, “hordë e ehjëme e prehëme” ajo Deres madhe ehthra kui do marguri.²⁷¹

²⁷¹ *La via regia aperta alla Turchia, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 3, Cosenza, 15 marzo 1887, p. II.

61. LAIJME KËSO-DITËSHIM²⁷²

Na shkruanjën nga Athena: Vëdiq Kulurioti cilji shumë shkruati te gjughes t'Arberesh; e malin e kësai të çeljënej ndër aq katundet t'anë ç' edhe sosënjën nd' Elladhët, bëri sa mundi. Kish pasur dashur të ljidhënej vëlezërisht, si protoparë, ndë një Greçie të përtëritur Ellent e Shqiptartë; po ata këshili-të-ljik shpeit angostin "*tin Fonin tis Alvanias*" e atë vet reshtin ndë nj'anë.

- Ljëpush pra gëzore na erth prei Manastirit ndë Maqedhonie: "Turqia të pestaimen dha ljë shenërisht ndë për Skolat e Shqipërisë të këlitet pa hirë gluga shqipe edhe turqishte, jo ellenishte. Mirvuljosi edhe livrat çë u shtiposënë Bukuresh, të ciljtë dërguan ndë Shqipëri. Klisha ellene ndë Kostantinopoj po shërben e përpiqet sa të mos marrë udhë ki urdhër: porsì atie janë edhe shimë Shkeptarë të munçimë: E më duket se me hirë të Zotit na u shpërbëljiën mëndimet, e arriti dit e bardhë për gjughën t'ënë.

"Anastas Avramidhi Corciari, dërgòj dhiatë nga Bukureshi ndë Korçë se falji njëzetepesmi një Napuliune për gjughën t'ënë, edhe për të tjera punëra të njerëzish: E Despoti Eljën (*i ljen*) me dica Korçarë të ljiq e tradhitorë të vlezërvet, u përgjegjënë se nuk e duan gjughën shqipe, pse Krishti kã thënë ellenishten".

- Pameta ka i shkliemi Zot Eutim Mitkoa ndë Mizirë na qe shkruatur:

"Tashi çë qesh Alesandri e Kair mbetësh mposazi di a tri dit më tepër, folja me dica myslimanë e të kërshterë për të bërë edhe këtu, si Bukuresh, një vëlezëri për gjughën e prindet, e m'u përgjegjëtìn fort mirë, pas çë u dha pra urdhëri i Derës Ljartër. Por Shkeptartë e këtushim gjënden, Vëlã, keq të shprisht; e hargji për të rëndur pas tire është më i madh mbase se atë çë njeri mundë' marrë mbi vet. E ndo mos kam shpëres të bëghet gjë të mirë edhe këtu.

²⁷² *Laijme cheso –dittëshim (Notizie recenti), Fiamuri Arbërit (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 3, Cosenza, 15 marzo 1887, p. VI.*

62. KARDASGJI E SAVE JEMI SOT²⁷³

Rrinë me dorë te hordët, e presën cilja të suljet e para se t'ë thonë ftës të vrëites ku të jenë andei te heljqura gjithë. E u thom me Frënçën se ajo 's do të zëghet nani; thom se Gjermanies gjë nk' i ljipset kë se të marrë ajo armatoset; e mba se Rusia qe ftesur prei Kriati sai, e ki sa t'i priret i ponimë, më ajo s'ë kâ me mosnjeri: Poka ngaha fiton teramonî e sosëm? Fajiljë e parë qe të nxierit jasht çë Rusia nxuar Përnqipen Ljisëndër nga Bulgaria, kur ajo pas Patin e Berlinit 's kish gjë ljiqie më atie. E ndë zâ e gjithave çë njëmendëtin at pat, i kish aghier gërgarë forën me kë e pa-bindur mirr ajo nga e të gjithave: maide! se ziarmi u pati kish shuatur ndë t'u çeljur.

Mundij abonësina Ajo të thoi: "Po ju si ljatë dië kët Buljâr e Bulgarinë me të se, kitun at pat, të hiljqin e t'i ljidhëjin vetëjues Rumelinë?". Ma të kësai ndietie aghier mos një u kuljtua. Vet se mbi burgamën e Rusies ato u gjëitin dhistaksime. E se Gjermania desh miqërinë e Rusies e ampninë më se të pasënej, si tha, të dheksurat e Bulgarisë: pas një ditë e jatëren janë ato të dia e ljëfarën përpara.

E dejim sot ajo të vëi ré, se jo Bulgaria por të kitunit e Besës të Patevet, kumbi e vlemes njerime, ljughet te këjo punë: edhe aghier shigh me gjith ngaha më ljiqë po të sgjidhet anakatosi e sosëme.

Pse nd ajo i mbanej kraghët për ljiqien Austries, Ingilterres e Turqisë, ciljat dëmton mbjatu te shqerrit e patevet çë Rusia tundën: Këjo o prirej prap e papsej, e gjith paru prirëshin e frijin mbë të shpitur; o zëi amàhjin e atie doi t'ish e vetëme. Se ndë pra Françia ghinej ndë mejdan po asai i ndigur, e Ajo fanesëj bes-gënjeshter bashk, e se jo vërteta 'së doi guerrë, ma prit herën. Embi tu bënurit e drites, të shkeptënej pra vulji e t'inë-Zoti.

²⁷³ *Cardasgji e sàve jemi sot* (La cura trista di quanti or siamo), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 3, Cosenza, 15 marzo 1887, p. I.

63. PSÚAME SHQIPE²⁷⁴

Pas dhistaksinë çë shqiti dī pièsësh Shkeptartë Bukurësh, na rā ndër dúar një ljëpúsh e Nikolë Naçit, për ndiët të ciljit u tha se u mbúsh ajo psúame e kèqe. E andèi pamë, se gjith thomse atà çë atiè ishin, dònjin bashk të mirën e katúndit; po dī u çë Shkerë, cilja kà aq mòt çë trivulisèn të nëmurèn m'ëmèn t'ënë, bèn punë edhè të mbrazinj vuljëmèn e mirë të Prìndit, tek ajo beset. Nd'atë ljëpúsh pasiqiret àq thielë zëa e Arbërësh, e rrièdhur nevoèsash çë e hëljqën gjith ànëshit, sà na duket, e dúam të buthtòmi ndō pak, si merku i Hëres tekë shkòmi.

“. . . Po mësoni (*italo-albanese* mbësòni) edhè për të ngjarat e këtúome të Shokërisë. Me shumë zamèt çalestisa gjerë (*italo-albanese* njerë) sà të siel më (*italo-albanese* të silia mbë) udhë të mbārë çë të kupëtòin nevojën e kombit t'ënë, edhè u mbjúadh (për *mbjúadhëtin*) më të shumë: po filat greka na vunë intrika për të prishur, se e dinë se gjúga jonë është vèdèkia e tire. . .

“Greku e shëkòn (*italo-albanese* e shégħ) se çë Shkeptartë të sgjòhen e të shkrúanjën gjūghën e tire, filat t'ona ndër tà dò të sgjohen prèi gjūmit: e më të shumë janë; më trima kanë; topotët në dorët të Shqiptarve gjënden, edhè duféqet. Sot e çúan mbëretërinë Greqī, neser t'e çònjën Shqipëri: kush mund' i mbanjë? Andài ata kanë kuvendúar me Serbiàn, me Maljin-e-zī etj. : Kètà të marrën Pizëdrënin, Karadakun, Skodrën, Zoti Grekë Jāninën. Kī është hesàpi, kètò nevoja; e bèn Greçia udhën të tièrëvet. E kështú gjith bënjën azèrgj të na hanë néve. E unë ljutem Zotit të mos bëhet ljuft për dī vièt sà të ngjālemi edhe ne (*italo-albanese* nà); se ndë u bëft amahjë nani, jëmi të húmbur neve (*italo-albanese* nà) e Turqia: po sà të bëmi gjūhen të shkrúar, e në Fillat të dërgòim pak kàrtëra në për Skolë!

²⁷⁴ *Psuame Shkijpe* (Fortune albanesi), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 4, Cosenza, 15 aprile 1887, p. VI.

“... Te Shokëria intrikat qenë të dhespòzjin pak njërez; e prāna, se gjë ‘s gatej shpëit, dúkej se doin të ljëin punen prapa, gjër sã të vijë Greku. Po unë më mirë të vëdës se sã të shò kombin të ndarë e të húmbur. Një shkúan dī vièt e gjìms, e një Fletòre nuk vate në të mièrën m’ëmën zésk, çë ngà kējò prit gjith të mirat edhè èmrin. E ngaij sé? Ngai se jémi të verbër, e verbëria na suali ndàrien; e ndària u dha koralj maçeve t’ljdhen aslanit ta hānë: Kush janë maçe? Vet ngai çë pāsh se atìe gënjighej Shqipëria, u zushë me tà, gjër sã vaish haps.

“Nani unë me ca shòk bëra një Komitāt të rī më 9 Kalendarit 1887, edhè vúra njërez të mëdhénj; edhé me èmrin të zotit dò të vèmi përpara, e shpëit të vete me fletòre shqip, çë t’e sapòsen me dushmanet e kombit t’ënë. Një të Presidhentet, V. A. Urequa ç’është Senatòr, e çë ngjāli gjūghen vlāshe në Maçedhonī, më thot çë të sièlëm djéme edhé çupa shqiptare çetë mësòin shqip e vlash, çë të vènë dhàskai në Shqipëri.

“Më herë dërgòni këtú një njerī, çë të shohë edhé púnërat të dreqëta”.

II.

Nd’atë çë ndë Shqipëri dúan e ‘s çonjën udhen, ngā të biljt e shprisht zaljeshit, vete tue ju bënur asai shëndeta. Njeter Fletore, motër e kësài të Kalavrisë, kã sod gjuga e Arbërësh ndë Siçiliet. Kūr atìe pamë të rrëfietur me goljen dëljiirë kē kã vet’ ajo, vasha zonjë Kristinë e Maddalòit, njërën ngā përralezit t’òna, kuiuítuam ljevdiinē çë na dha një Zot Poloniz ngā Universitata e Vienës, Jānj Hanúszi: “Te përralezit e arbrështa gjënden çiathò net kē çòni gjètk, po të kulúame nji piasmie çë nket zëmërën ngā vet”. Kī “*Arbëri rī*” na gëzòi vèrtèt. Atà çë thúghen se gjètk kanë hjaròm, për të ljevrosurit e Gjërisë, si nënk bienjën nga këtò Fletore me i shprishur atìe, e àksur Zëmrat e noérët? Për ndièt alfabetit? Po ish për më qëshur, tek na gjith shërbinemi, njerë ndë u kuvendúar bashk, gramatishi të përdúarshme si të véshurie e hjoarës parastème.

“I thòmi pra di Zotrave të Ditaires: Ljik bëni, të ndrìshëni dialetet e tjerë e t’i bëni një me t’ëjin, si tek të shkrúamet e Serembit e të Kjinigòit. Kështú bëij Kamarda, po me çë trū? Se ndë kët zakonë ju mbàishi ékë me gjughën e Varibobës kush mund’ ndëljenjë sakriligjen quk?

64. Ç'I LJIPSET SHQIPËRISË?

E para nevoés e sai është Ajò e thronit ljiqes. Atiè sod dërgonjën Kadira të guaj, nkamàtëra si gjith gjindia e përdorëshme, e ciljëvet e ljumia a shkreti e katundevet është për fare; e çë mose e mbanjën me farët çë atiè mundënjën, e ngaha kanë hjaròm e të tiera ghirë. Andèi edhe shpi së Mirësh janë të hëljqura të vrasën edhe të marrën nga e të tieravet, ato abonsina gavnare më se nkamata. Të ftestat prana, pa shperë të ubrigu te throni Ljiqes, i ljiqënjën gagje trëmavet kë kanë ndë gjì: e andèi u bë zakoni i motim të duan gjak për gjak, petk për petk. Sã edhe të lãrghëvet vendi i faneset si i ëgër me ndër piljat aslane të këqi.

Thonë se është sot adhët i Gjëles shkeptäre, të bënë atiè nga një ljiqien e vetëjues. Jo abonsina, por i është nevojë e të ljiqsurit çë i ljiqsen ljiqjëtartë. Tek ata múaj çë Vlëme Brídrënit móri ndër dúar psòret e gjërivet, vierrë ajò katër o pes kusarë o ndrìshe të ljiq, Arbëri inë u pã një shësh ampniye për ndo një vit. T'i priret adhà gjërivet ljiqia ndër të gjakut tire; piëq të daljë shkúrçëzish e të vëndit ku që ftesa, t'e bënë përpara leghës katundare; ata vet prana të kumbìst së dreqëtes e vuljemes mirë të Zotit-madh. Psé ndë gjithë e botës njërime e dimia e së Vërtetës e së Ljiqies rrì pã t'angosëm kurrài; e, më se gjètq, ndë Shqipëritë të ngordhurit e margurtë e rremë rëndën mbi frimët e mbanë gjëlën kardasgjime. Pra gjith, pas themeni ciljat të vràrat e të viëdhurat fuqimë j'edhë të rrembòsht e Ljiqjëtãrvet t'i pistëpsënjën me të biërrën a të pètqut a së vetëhesë.

Po se lëga t'i ljiqghet e skuljtãrtur njij së bënë burrash si këjò, do të jetë gjith të dimen e zotërinë e vetëσαι ndë mest frimës e Vëlëmie të gjerë. Këjò u dësh Brídrën; po dregëzi e gúaj e mënòi.

Na thòmi se Arbëri do të jetë i përmbiëdhur zãljeshit kë pati mose, ndë nj' Pashalàt çë të nxënë Shqipërinë, Epirin e Maçedhòniën tek

bota a shumë ë nga gjaku inë e me gjūghën t'ënë. Ndënë një Beljerbèi, kë Zotimàdh dërgòn po kë të detë, krënjet e sgjèdhur e të triave ato provinçie të jenë t'Arbërësh; nd' ubriğh të ciljvet ljiqia e katúndit të frinjë e ampnime. Pse éρθ hëra çë Avleti ndò atò të bierë, i përpitura t'afërmit margurë; ndò për shëndët të beset, si Austria Ungerisë, te bésa e arbërësh: si vet këjò, jàtër proit shëndetie, nestru se tek ai, gjikún 's kã. Buljarë të dërgúam atèi, aqë të kërshhtë sã maometàn – e ndò pak edhé katúndeshit gúaj çë atìe gjenden – të kenë piès te vuljì e Avlètit. Haràtshi, si gjëndet sot, këtú të bëghet pies; të mbjedhur andài, t'e ndánjën gòrëshit, e gòrèt ndë për shpitë, pas njij métërie të dréqt e të dhënur kã Buljéria. Adhiasi e haràtshit prãna, themenì e parë e Shokërisë. Haràtsh i rì të mos mund' vëghet më mos i ëghthisur prèi dīsh mbi trī piès të piëqëvet kombit. Se shpèit ndër Statet merë begatije çë të véshinj ndrìshe gjëlen, a ndërìe çë të kombonjë largë pas ciljì çiauvúke, shpìghen si ëndërria të sëmürmi: e sot Europa krie-famàc, për këtë t'i vënë ndër dúar dica vëntuliërve buljbert e sai, një dërgjet hëljmít e vaptisë. Prã me çë të ndiét? 'S ë krèu shpisë çë bën e jép ngã e tija, po me gjënë e të tièrëvet psodhepsënjën si i dhékset. Kì ë mërku i abonësinëm e zeghëtisë.²⁷⁵

Psé 's kémi bés se rrī gjë të mirë tek të Bënjapiesmit; psé thòmi të njëmëndëm më shpét Shqipërisë t'i jetë ngã farë nd' ubriğh të njij zoti ngã të sàit, mberë se gjith faret të dhespozinj një vet edhé i sgjedhur mesit tìre: dua të ligjërònj me pak fialjë.

Për të pàrën, tashti nga Zotëri Regji a Buljarësh, mos ata dhespozënjën kë múndëtin me armët, qenë mose e janë Bënjapiesëm, të sgjèdhur protoparë, e gòrëvet, për ljiqien kë andèi presën. Ndrìshe është vetëm se Bënja-pièsmit e sodëm mund mos jenë atà çë qenë diè; aqëvèt sì shòghëmi të shkúamit e krietëvet të njij Zoti a të njij Buljerie. Po këjò çë prothën? Edhè se qenë të ljiq, t'i nxièrrurit mb'anë nën shëròn shkretitë kë múndëtin pasur bënë; ndò se bota njerime frinë e ljevrosur gágjes e ziljisë, si po i shègh të shtunur ashtu si rrëfërèt pa më kòqe.

Abonsina ndrìshen ndë këtë. Se ndë Bënjapièsmi është një i vetëm. Ai 's mund marrë mose forë o nkerrë me të shùmët kë 's njëgh: krietët e tij, e më atà çë më i rështen sishit, àq herë me burgamë o nkamati

²⁷⁵ *C'i ljiqset Shqipëriis?*(*Di che è bisogno all' Albania?*), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 4, Cosenza, 15 aprile 1887, p. I.

trivulisënjën dhistihjimtë ciljvet i dërgònen afër; ndë vetëjue Ai këtë së dò e nënk e di. Ajò që mund' e bënë te kéq është drëa; e aqvét ajo, si ai shìghet i vetëm, mund' e mbanjë te dhata. Ndë prà e zònja është një Buljëri, për së pàri ajò korjirën hjenë e vetëjues; ej e rëksën të prúnjtít mek njeriu vàret kà vërijli gúaj; ashtu pak dò, ndò as dò kà e të të peljakànëvet. Rëndën po ajò kèq, ndë të kitunit gavnarë, mbi boten që i ljisën arròtula, e mbë t'i dhënur forë sàve at gavni të i gatënjën rope. Ma lojëa e Bënjapiesëmëvet' anë, gjith kà atà dhifiete e u 's di ndë gjë të mirë. E të shumëvet ndër tà, psè të pà-vëljien e ndë nevòje, kuidesa e parë me kë piljasënjën, të përtròlënjën më të mirtë e të ponimtë kui i patëtin ljerë afer, e nkomatia mek t'ushqinjën Statin, tharose i tire, e te cilji prà të bënëjën ndaka, si frashèrit ndë mot të jap mënën. E pràna gjith paru e Rrëmia, mek ndighen mos ata të biërën vëndin te prapëza.

E këtë sosën për të Bënjapiésmít.

Të jenë prà fàrët Shkeptàre të ljidhura ndër tò njëj gjaku e njëj gjùghie mek inë Zot i përbàshku, e jo fuqie zotërime të katundàri a të gò: është nevoés kë psòrèt i bënë. Ndë gjithë m'ëmës' anë gavnìa e zëmrvet as dò një shpì të vetëme mbi të tièrat¹⁾; e thrisqia ndrìshe as ljëi të papsej i Kërshtëu nën perënd maumetàn, në Maumetàn i përnënëshin Zoti të kërshtë, kùr njëri a jatëri të mos jenë të dërgúar përdorëshim prèi Zotit madh kë bàshk ponisënjën. Ngà farë poka atiè të rrie si është e prèitur nën buljarë të sai, të gjëgjëm piëqëvet. Përzita e Shqipërisë e Arbërit ej e Maqedhonies, keq i ngrënej frënet vlëmies s'anë. E si është e pà-dime ndë shësh të gapt e vet, dòi të gjëgjënej porsima gjàrpërash ajò të ndàghej kà Déra Otomane që sod i stenën ndëljèhien; e Turqia pràna e druetëme të gjejë antirime e me-pritur, nënk ampnisej te besa e sai, nënk i ntòqej e mirë si sod i buthòghej e është.

Kètò vënur pëpara, jàter nevoés e màdhe i është Shqipërisë të shtierë këtiétèi, tek e kà, privilegjin i të mos i jetë e më marrur trimënia ej e mbësúar ndë të maniúarit armët; po të jetë e zonja ajo vet të ja dërgonjë Avletit kùr i ljijsët, e per kaq múaj bashi-buzukëra. Psé për andàina ajò qëndròn mose me ti bìljt e sai porsì me aslàne frimie e fuqije, ciljt po ljavosën për së largu e vret birë i ljeqòst i grúaje. Kush i dësh, te Pati Berlinit, përtërirtur at privilegjë, bëri t'i prit krìpt, se më të mos àksëj ngà adhiasia; cilja nën Ljisëndrin e Skanderbekun i dha të vetëmie e të pakëmie zotëni mbi sà i èrthëtin nën horden.

Mbi kë gjith, prā i ljiptet urtērià, çē dit pas dītē t' e shkatērljiksinj dūarshit gúaja.²⁷⁶

Psé patētēin adhetur pēr mōt e monē gjúghēn e gúaj ndē tē shkruāmet, na's patētēim dhīat urtērije e vuljēmie tē prindēsh; e u patētēim ndietur mose rope e tē tjerēvet çē na dhanē gjūhen mē shkruātur: E pēr katēr qind viēt, pār se t'ardhurit e Túrçēvet tē mbjidhshpitē nd'atē vēleme çē thavmāzi dhenē njij hērie tē shpēt, prindēt t'anē, akòlj tē Ljētinjve nga Anāpulji, t' Ellenēve nga Fanari, edhé tē Françisve fatē-bierrē, pērgjākēshin, vabēhtōnēshin e qēndrōjinmose tē zeghbēt psōres gúaj. Sōt çē atā ghēljme dhiovasmi te storie Tajanit çēi hòljqi mbē drit: zēmra na shpōghet kundrēlja atā tē kērkúar mose gadhitē kē kinē tē gúajt, j' edhé t'i stisējin, po jo pēr vetējūen. I ljiptēj gjāljmēri çē qē dhēnē pēr tē ljūmen, fārvet uzi i gōljēs tire, si gjērivet zakōna e tē dashēmes.

Mē tē fanēm jēmi nà sot nēn tē garāksurit e mālīt e tē mē-gjēljiturit, me hjenē çē i viēn ka ndēljēghia e vetēsài, tē thēnen e gōljēs s'anē. Ndē Stambul kēmi tipografī ngaha dāljen dītē pēr dītē zēra ndē gjughēt shqipepēr Skòlet e pritura e dieljmevet t'anē. Ndē gjithē Shqipērisē ngrēghet mē e mē valjē e antirīme punēs gúaj, çē e ljōdhi mbi tē ndrīshurit çē dō t'e ndrīshinj se t'i gjās vetasài. Ajo kā buljerē ndē Rumeniet, e, gjēgjētēim, edhé Athēnē, çē u ljīdhētēin vlēmie mē pērtēritur e adhetur gjughen e vet. Nd'Itāliet rek rrēpārī aq zotērī e Arbērēsh pas çē Nēnkēmundia i ljosi hordet ndër dūar, se ngāha 's dimi atīe ahjētur, e vetēme, ehjōi pēr sē pari e thēna jonē; e nani e shōghēmi si tē dhēzurit golē e ziārmi tē madh. U gjēitēin atīe, mbiatu pas, kēntēka tē ljēra ndē gjithē te m'ēmēs anē te moti çē atjē imē gjithē bashk; te ciljat pasiqiret gavnia e gjēlēs gadhiāre çē dōin tē na shúajin. E piōt àfē katundāre shpiti atīe gjēthet njē poesī ngāha Europa e hēljqur, u prúar e i vē ré gjērisē çē kā atē gōljē, e ciljēs moti 's i grīsi hjetē e hērēvet ljume. Sot atīe kēmi njē Ditare me uratēn e t'inē Zoti e me tē dimen se i ēsht Fiāmur i pàftēs e Shkeptārvet ku do vendi. Ashtú njēra ndē Mizir, ngāha i gjēvēshi Shqipērisē e pāra borī çē therrit' biljt e sai tē ngrēghēshin pēr ndērtē s'Emēs, asài Ditārie i rrinē ndighmētārē.

Por pēr mbī gjithē kētō psorē tē réa, erdhi kuidesa e Avletit; cilji se tē veçēnej Shkeptartē çē me tē kumbonjēn njij zēmrie, kā armīqt e tij

²⁷⁶ Po aty, Nr. 6, 15 Agosto, 1887, p. II.

çë ja e réthënjën, i déshi të shpitur vetëjéun pas ndeljiën e tire, e te gjúga e tire; e dhespòzi skolë të kësài, ndër gjith gortë e tire.

Sosën poka të sithònen këtò të bëna e këtò fuqī e vuljemë ashtú çë të ndighen ndër tò, e të gatënjën autonominë e ljutur e së noërës e së gjëlës të gjërisë s'anë.

Kësài pune se të zëghet, i ljiipset pāmeta të dashurit mirë e Zotit madh, çë të jà bënëjè dëtirë katúndevet abërësh të mbësuarit e gjúghës tire; edhé i dhurtíljur, te ku gjénden Skolë ellene, me haròmt e këtire. Ç' ë këtà të fodul t'Elladhes t'i zënë t'Abëresht gjúghen e sai kë mosnjë dò të die!

Por mos gjë antirisën këtà të sithònur e fuqishë të shprishta, sà tutièmit edhé pa udhë përzitie, e t'u gjëturit anamesa Ellént, një kura-stà margurë çë bën të na ndanjë edhé më, e po sà të mos (e na çë kémi dëtín ndë mest më se gjith) të mos shighemi njëri jàterin. I ljiipsen dhàskaljëra katúndevet Shqipërisë, e ndò pak mund i vèjin këtèina, po 's dinë sà kamàt i jìpin, çë gjëjin, e vāren ta druetëm. Múnd edhé të vijin të Kollegji inë këtú afër; po gjithsèi piljaset me të druetëm këshili, e më psé héra ngjatet çë atié janë dhèspina vuljemë të gúaja. Mo qèva edhé fëtúar të shkoja vét, e të shìghia e të njìghia çë Kostantinopul njera Skutar; por pleqëria e të mos diturit si të jësh i pritur, më mēnúan. Ishin mbase këtà dicà gjàljmëra çë dī ú ndī ljìdhëshin e kūr.²⁷⁷

(vazhdon)

²⁷⁷ Po aty, Nr. 7, 15 Novembre, 1887, p. I.

65. LETËR EFTIM MITKOS²⁷⁸

Katundâr e Vëlâ Zoti Mitkúa,

Mos u mërò nga të mbàra-pràpt e Abramidhit. Vet e pandèha çë kà shumë, si pë se shkònjin ditët e ‘s mirrej ùdha mbàru; e pandèha ej e thàsh.

Kur u gapa Ditàren e Arbërèsh, gjë ‘së dighej t’ Abramidhit, e ndò mòs një speljë e garème foka shkòi gjith gjërinë t’ënë, si pà të ngrëitur vandiljen e sai. E ‘s u patëtim gënjër. Ngà ajò ditare Turqia njogu drëq se Elladha ellenixarënej t’Arbërësht me merë ajò të thòì prana se ata ishin të fàres sai, e t’i trughej Euròpes se të ja mìrr Turqisë e të ja prirë asai. Për andàina Avleti urdënòì se ndër Skolët e shpìvet t’arbrëshha të mësòghet gjùga e tire. Ngà ajò Ditare atà të kombit t’ënë, panë të shërúar e të bukur gjughen e tire, ndë i kish ndonjerì patur bes Elladhes çë burrithënej se ‘s ish ndò një gjughë e arbërèsh; e i tàksij të tìren piàk e pà-më gjak: E u çëlj mālì gjughës fànem të mëmës s’anë. J’ edhë Abramidhit andèi j u dhéks të dúkej buljâr i shpìvet. Ajo ditare qè pràna ndieta, e sitë t’Europës u prúartin me më rë mbi kombën t’ënë. Për nderen e émrit t’ënë, thòmi ni vetëm: “Ai kà diépi qé shkúar te varri”; e përrjèrmi sitë e frimi ndër të gjaltë, tek i përgapt është *Fiàmuri* edhé, shëngu i besëvet t’ona.

Pràna çë i ish Arbërit t’ënë një jatrúa e i diti o jàtër ndrìshe i úrt, mberë driten e mālìn e gjërisë kë një Ditàre e fritur ngà frima e drëhjët e t’inë-Zoti ahjëtën te gjieat e zàljevët t’anë, a mberë shempletirat e të rrúamit buljarë kë Ditària jonë përpàranith, se diàljëmët e shpìvet t’ona sot e për monë mbë t’i gjarë të rriten hjëshëm?

Thòmse më mirë qé kështú. Çë kùr u zunë filë kètà Komitate, Shqipëria me bés të madhe atèi, foka i prúar kraghët Ditares: ndorrina se gjith shendeta e sai është jo te Rumenia no te jatër e guaj sà tek të biljt kë ajo kà nd’Italië, mbì cìlit Elladha së mundën, e tek Skolët e ljusta kë asài i dhà Avleti vet.

J. De Rada

²⁷⁸ *Ad Eutimio Mitko, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 5, Cosenza, 15 maggio 1887, p. IV.

66. MBETURINA TË SELIVE TONA TË LASHTA QË VAZHDOJNË TË QËNDROJNË ENDE MIDIS NESH²⁷⁹

E kështu mose bëgheet drit më e më mbi atë çë ‘s dijim. “Çë zali na erdhëtim? Ku ljenë Rapsodhitë? Ciljt jemi nga leghët e moçëme?”.

I. Edhë gjëmi ndë Shqipëri të poshtëme, me të tjera, se këndòghet e dita rapsodhi e të parit livër të të Bënavet e trimavet:

*S’ëmës vanë e më i thanë:
 “Të zū gjarpëri t’ët bijë.
 - Nd’ e zū gjarpëri u shëròft;
 ndë e zū trimi u trashigòft”.*

E te këntëka e *Bëljetës shkeptāre*, mbi fjiët 58, n. II për ehonet Rapsodhia jonë “Viën Marsi mirë se viën”.

II. Kūr këtëi erdhëtim tashti dighet: kūr patëtim zënur ata zàlje ngaha èrdhëtim, fialjë e mòçëme a piàzëm jàtër mbase nënk shënghën dëjirë njerë sod. Vet mund kumbisemi te besa e aresime se çë dò atië është sod, që çë protoparë. E mirëfilë, si ata zàlje ishënjin të zënë ndër ditët e Strabonit, janë edhé sod.

“Këtà janë (Aì ljà thënë tek i shtati livër i Gjiografisë) poka kombët të vënë anamesa Istrin, maljet sklavune e gjindien Thraqe. Qëndròn àna e këtëre màljeveçë rúan miesditen, e dhërat çë përgàpen apòstaz njer te dëti; tek është prà Ellenia e atà të Guaj ç’i rrinë ndài. Ekatèu ngà Mileti shkrúati se ndë Peloponèst parë se Ellent kinë shpī atà të guaj, e po se gjith Greçia qé protoparë e zënë ngà ata të guaj. Ndër të tiëra, Atika qe mbàitur prei Thràqeve t’ardhur me Eumolpin. Tashti njer sot Thraqt, Shklàvunit e t’Arëbrësht janë arrotula Greçies, e t’asai kanë edhé ndò pak. Tesprotët, Kasiopetë, Anfilòkerat, Molosërat, Atamànt, farë t’Arbërit kanë, për mbī Akarnanien ej Etolien.

²⁷⁹ *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’ Albania), Anno III, Nr. 5, Cosenza, 15 maggio 1887, p. I. Nr. 7.

“Faret e Arbërit, si rrëfen Teopompi, janë katërmbëdhiet; e ndër të më të fanësta Karnjet, e Molosërat që nga shpia e Eaqënjet e për ndiet t’Orakulit të Dodhônës. Tuçidhidhi lja thënur se u përrjerrë Anfiloku ka Troja, pse Árgj e múartin mbi sî, pati ikur tek i vëlàu Alkmeòni nd’Akarnànie; te ku qëndròi edhe mërèt pas të vëlàut, e stisi Anfilokien.

“Anfiloqist ni janë t’Arbërësh; e me të gjith atà që rrinë sipër, mëljeshtij njer tek ngjiten me Shklavunit; Molosëra, Atamàn, Eting, Tinfera, Orestie, Parorë, Atintàn. Me këtë janë të përzier katunde shklavune ciljt shkúan nd’anë të mëljevet që ruan miesditen. Se mëlji pòstëm që Diràhjë e Ljonë njera te mëljet Shkeptarë, janë të mbàitur prei Viljiònt, Taulantët të Bardhënit e Frigjet.

“Kush nisen nga Ljònia e nga Diràhji vinjën njij ghèrie e përpiqen nd’udhtë Enjatie, kë gapëtin Romàn. Kējò udhë merr te piesa e parë emër ka Kandàvia, malj i Shklavunet e shkòn andei anamesa Piljònes, ku údha ndanë dhenë Shklàvun prèi Maqedònes, e vete përpara Eraklë, Edhesë, Peljë njera Salonik. Ani atij që ngèt kësai udhë e udhë, i rrinë ka e mënçera mëljet e Shklàvunit, i rrinë ka e diàthta kombet e Arbërit njer te gjiri dëtit Artës, gorë e arbërësh, shumë e dritëm te moti sai kùr atie kish Burri shpinë e Zotërisë: Përtëi, mbë të diàthëten e të kui ghinë nd’at gjì dëti, janë dica fshate Ellén t’ Akarnanies.

“Shkúar Artën, dhèu anamesëm së diàthëtës Enjaties e të mënçurit të Peloponèsit, kà ndë të, farët e Maqedhonies e të Peonies njera te Strimoni: përtëi ljúmin njer tek Emi e te grika e dëtit madh gapet Thraqi. Vet zàlit e zàlit dëtit janë gorë elléne.

“Fúshat e piljat e Ljingjistisë e Palagonisë, e Orestiadhes ej Emies i kanë edhe thënë Maqedhonie sipërm: e janë që gjithëve atire paràtave njer Korçirë i japën émërin Maqedònie; per ndiet se “gjith bashk fjasën një gjúghë, veshen qethënjën ljësht një mbàrie, e ndër zakònet gjithë si njij gjërije”.

Këtò lja të shkruata Straboni. E gjë ‘së faneset të ndërruar të atij stàti. Vendi, sî te moti atij, është i mbjúar me t’Arëbrësh; këtë kanë Atikën e as mundëtin të kinë qenë shkúljur nga Greçia kë prà zunë Ellént; e të Peloponesit edhe mbànjën gjìmsën. Një është gjúga e gjithëve atire bashk; e po të nësh që andei ikëtum janë katër qind viét, e të sàve mbetëtin ndë mést Ellenëvet; këtë po kanë më dicà fialjë ellene, na përkëtëi, ljetire; se pas psorëvet.

Por të kësai të ndrishëmie e t’Arbërit nga Elladha, kémi martiri Virgjilin (Enei. lib. III): Psè Enea arrënur Leukadhin thòt: *Hunc petimus fessi et parvae succedimus urbi . . . Actiaca*²⁸⁰

²⁸⁰ Po aty, Nr. 7, 15 novembre, 1887, p. V.

*Iliacis celebramus litora ludis.
 . . . juvat evasisse tot urbes
 Argolicas, mediosque fugam tenuisse per hostes.*

Porsa thonë: “Pa nkë nxënë Shqipëria te vëndi që zë Avlonë e qëndrën Art: psë që Avlonë gâpet kà jëter anë, drëi voresë, njëer te Mâlji zî. Te këjò paràt ish Illiri; e psë është një gjughë ajò që fjitet që ngà Malji-zî njëer Art e më tutië, bota e Illirit është ajò që u pati përgâpur njëra ndë kufint Elladhes, e këjò është Shqipëria që na rrî sot përpara”. G. Meyer kumbisën kët hesâpe te fialjët ljetire te shprishta pârue te gjúga e arbërësh, ciljat ai thot se qëndruân së pârri ngà Ljëtinjti mek Roma mbàiti mot e mot të zeghbëtúar Illirin. Po këjò estisur ‘s kâ kumbî më të pàht se fialja, se atà janë gjërî me Albanesërat e Kaukasit për atë se kanë nj’ émër të di. Pse vet Straboni as çioi jàter se tre kombe: Çeltërat, Shklàvunit e Thràqët. Illiritë as inë ndò një komb’ i rî, ma farë asosh, e përcëmúar ngà vendi o ndrîshe. Nënk i zë Ai filë kà gjúga, ngaha ndâlën boten e Epirit aish e rriëdhur, e ndrîshe gjúghie edhë kà Ellént. Dìghej vetëm se vëndi ljart ish i mbàitur nga Shklàvunit, i pòstëmi ngà lëghët që atië edhé janë, e shtònëshin me Ellént nd’Akarnaniet, e thughej Illiri-grek. Prà që, si e vû mbë drit Benloeë, Ellent e Pleqt e vendit kè ati çúan këtà e mek ménúan përzier, u thanë pràna bashk Grekëra; e këjò e psúame edhë na pështiel, ndò se àq të gúaj njertë jëtërvet.

Kètò mund antirisen per ghirë jo me ndiët: Se ashtú janë si thúghen.

Pìghet vetëm: Kúsh e ku qenë te moti protoparë atà që inë të guaj Sklávunit e Ellenit, të ciljëvet Straboni diti àq fàret, ndrîshe të përcëmúame, e pràna émërin e vendit ku rrijin, e jo më? Se prana njëer dië mos nj’émër i qé gjith gjërisë tìre.

Per múa është një bes e as-ljuetëshëme. “Se gjeria Pelasje ish e motímia tek ata zàlje tek prà u vunë Ellént të gúaj; se me emër të gjughes tìre “plake” qenë thënë Pëlasje aq tek fitoi tìre, sà tek ndénjëtìn të veçieur ndër tà prèi të gúajëshì anamesëm. Pas që dhiovasa tek Erodhoti se Zotërat e Olimpít Ellén e patëtìn piassen te gjindia pelasje, kè Aì njògu e gjeti ndër paràtët ku ndë mot Strabonit rrijin t’Arëbrësht si pamë; e émërat e atìre Zotërave ishënjìn fialjë t’Arëbrështa mek përcëmònjëmi edhé sot gjëat mbi ciljat atà kinë zotëri: njoga dëljir se atà Pelasje të vendit, jëmi nà mberë të gúajvet që pasandai shkúan nder në.

(ndòqet edhé)

67. MURGU PANHELEN I KORÇËS²⁸¹

Na shkúanjën kà Berati

Vate i dhúnur émri Abramidhit, e mos gjëtitit kī kush në pìs e dasht afër. Këlògjerin çë i shtúni kalamiten, e njòha une; psè këtú ndòdhi peshpël parë se atiè të shkojë. Nuk është thomse jater njerī më antipatik e disapit aq sà qé kī shëmtim. Fanatik rop të margúrit t'Ellenëvet kish për të sdrèdhurit Abramidhin e t'i shúatur ndèrën, Aì pasur të vierrë te xerku Kriqen e Shelbuesit shëit. E Kī i këputi údhen, se të mos ish préj i të Ljigut. Pse i Ljigu e pati pianepsur e helqur kà dhata, te ku kish gjith të mbaij vëlezër të mbledhurt te qisha e tij; sà vëi ndër ta cicàniën; e prúari kontrë j'ëmën shkrét të tire dicà të pà-nderë, cìljt ju ljenë tradhitorë, të bléitur me parà të qivernisë ellène. E pati aì fatin kë bëri vet. Psè mos është e rrème ajò çë rrëfighet, e këtëi e gjegjinj ku do vendi, aì pse jo shùm mot çë i ftesi Zotit Krisht e Shqipërisë, qé i zënur ka kusarë, cìljt e gjikaraniàrtin pèrpàra, pèstài e vranë e prenë thélja.

J. DE RADA

²⁸¹ Il *monaco panelleno di Corcia, Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania), Anno III, Nr. 6, Cosenza, 15 agosto 1887, p. VII.

68. NA SHKÚANJËN²⁸²

ndë 20 të korrikut 1887

“Bukurësh u përsërit me të mādhe ziljī Sillogu i Shkeptārëvet me émër të rī “Ditura”. Naçúa mbeti jasht, pā shok. Ashtú edhe Abramidhi as dò të gjégjet. Kī është njeri i pā-spudhàzur e i tràsh, sã nuk njëh të mirët të “Flàmburit”. Pā atë, Skōla Korçë u hap. Nanì dúan të marrën ndë dorë edhe petëkun e Skolës mādhe ç’është atië; e për këtë vajtin e trúhen Kostantinopol; tek po gjikòhen. Ndë vúntëshin ndë dorë Skolën e mādhe, at herë gjúga jon zë këtëi vënd.

“U hapëtin Skolë edhe Okridh, e ndë Starovë, e në Rresh; një sod të gjitha gjàsht. Psé nukë vién edhe ndò një miështër ngà túajt të ngrëhinj Skolë si-do-zòt ndë Beràt, Kavajë afër Dirahjit? Po ljé të kemi durim dorë për dorë.

J. DE RADA

²⁸² *Na sheruanjën ndë në oo të Corricut 87* (Ci scrivono a 20 di luglio 87), *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’Albania), Anno III, Nr. 6, Cosenza, 15 agosto 1887, p. I.

~~Shprehjet me mendime~~
~~konkrete? I përshkruar~~
~~(Halla) Veprimet e fjalës~~
~~madhe krahasuar.~~ J. J. J.

Vezrat e De Radës sipas rendit kronologjik

~~nga J. J. J.~~

I/OIS BIBLIOGRAFI E JERONIM DE RADE'S
(1831/32 - 1909)

[Drejtuesi: pabotues]

Shkruar

BIBLIOGRAFI E JERONIM DE RADËS

(1831/32-1909)

Shkodër

69. LUDVIG PODHORSKY²⁸³

Na u vuljtit te Ditaria “Revue de l’Orient” që dëlj një zërë e Ludvig Podhorskyt, cilji me dritën që na jep e të mirët që na dò aq, na ndigu e ndighën hërëshit ljekosisë s’anë; e na hjé t’i thomi Shqipërisë ndòpàk t’asai zërie, se t’e die evhjarime. Thot ajò Ditare:

“Gjith gjúghët e Apoljesë! Po të jetë njeri që i pati ato xënë gjith, a mbà se gjith? Çë mund logazinj mbi fiàljët e adhasinë e gjúghëvet më të shklieme e t’Asies e t’Europës pse i njëgh nga gjith ànët?

“Oghë. Kì njeri është e rròn. Na e njëghëtim Parigjë. Atië e pamë si të mbitur ndër aqët e të shënuamevet e gjughëve pà-të zënë, gjughë e Indàsvet, e Anamitëvet, e Malësëvet, e Javanasëvetj’ e Mizirit motim, pà thënur gjúghët e përduarshëme si araben, persianen, basken, indúen, t’arbëreshën, finesën, bretonen, thom të përduarshëme psë i gjëgjëtiti të zëna filë. Ndë hode përpara të dúkura të pà zalje te moti e të egapta-gjërë, i zoti shpisë, Podhorsky një i Akademies e të dimavet, t’Ungërisë, ndë një kohë, aili! e futurm, bëri e paratat më të lãrga, e motet më tutiemë, te ku u veçëtin fàrët, e gjúghët e tire u shpìtin, na shkúan përpara. Me të foljë të dritëm Ai tuke buthtúar të gjërimtë e atire gjughëve, na pati përpàranur të u pasurit që kà një vend te jetëri u pàs bota njerime që më se kàtër miljë viët prap, e t’u nkàtërljiksurit e fàrëvet sai.

“Një psorë eljume më súal laijm se i dëshuri Zot i bierrë sishit kà dī u sà, kish ardhur, më e ljevrosur punëvet noré, nd’Ungëritë tij; e se mbë zakonë ish i kondisur Zob te villa e Lutcenbaher. . .

“Kish, kur na vamë e gjëtur, pasur Ai ljëpúsh ka *Arçidúk Josifi* që e pienej mbi dicà të druetëme të gjughës Cingaravet, ciljen Zotëri e tij pasën réshit që ka met.

(ka më)

²⁸³ *Fiamuri Arbërit* (La Bandiera dell’ Albania), Anno III, Nr. 7, Cosenza, 15 novembre 1885, p. VIII.

" ~~VEPRAT E DE RADES SIMBAS RENDIT KRONOLOGJIK~~

1/ 1831/32 : "Odisen".

(De Rada: Autobiologia, I, 21; Gualtieri: L'Opera; op.cit. 59; Marchiand: L'Albania; op.cit. 56).

2/ 1833 : "I dbeumi i Krujës"

(De Rada: Canti di Milosao, 1836, fq. VI).

3/ 1836 : "Poesia albanesi del secolo XV, Canti di Milosao, figlio del Despota di Scutari" - Napoli, Da' Tipi del Guttemberg, 1836, fq. 96, dim. cm. 11,5 x 17; in 16°.

(Biblioteka/Kastrati).

Të gjitha këto, që u thuhet këtu, qenë të domosdoshme të thoheshin para se të arrihej të përcaktohej pë fundimi. Mbase i vrotovet, me ato vëzhgimet të shpjegues më parë, 32 punimet e mësipërme gjubësore e pjesisht hisitorike të shkruara italisht nga De Rada e duke u lidhur përkthimin e tyre shqip të J. Kasstratit dhe mbasi u këshillova pastaj me përkthyesin rreth diçka gjërave për t'u rregulluar më mirë, po shpreh këto mendime. Përkthimin shqip të J. Kasstratit e kreu për 32 punimet e nëntëmbësuarë gjubësore e hi stordike të hartuara në gjuhën italishte nga De Rada, e mirëtojmë për këto arsye. J. Kasstrati bëri që të

arrihet përkthimi në gjuhën shqipe i atyre punimeve, ku Rada shkruan italisht për gjuhën shqipe e për diçka shpje gjme historike. Ndërkaq ky përkthim shqip privret drejt rrugës së përkthimit sa më besnik me origjinalin italisht e cila rrugë ndiqet me plot durim, veçse është më e sigurtë; këtu pra përkthyesit në një anë ia ruan De Radës kuptimin e frësës italishte e në anën tjetër ia ruan veqori të dallnese të shprehurisë, shprehjen sintetike. Por përkthimi në një anë tjetër synon ta lehtësojë mënyrën sintetike të De Radës: bile De Rada e shkruan italisht me të shprehur mjafet sintetik, e bile prolixe, tepër të zgjatur, kurse J. Kasstrati në përkthim i përgjegjës përlozizimi të De Radës me një sintaks shqip të rregullit, ku lot rol për një lexim të kujdesshëm edhe vendosja e drejt e shenjave të pikëzimit e ndryshme nga ajo e De Radës; in

anën tjetër në përkthim bëhet më e çelhtë shprehja sintetik e De Rada's sepse përkthyesi në frazën shqipe ka fjalisë e ndërtime të tyre në fjali, që përputhen me natyrën e gjuhës sonë. J. Kastrati, duke vënë pranë njeri tjetrit tekstin e përkthyer shqip edhe tekstin origjinal italisht të shkruar nga De Rada, i jep mundësinë lexuesit o studjuesit që të dyja tekstet t'i krahasojë për nga kuptimi e për nga shprehja. Këto pra janë arsye, sipas të cilave e miratojmë punën plotësisht të J. Kastratit në përkthimin shqip të atyre 32 punimeve të shkruara nga De Rada me një italisht të vështirë për lexuesit.

Mbasi nuk kam gjë tjetër të them e të shkruaj, veçse të përsëris çka shkrova, po i jap fund, për sa kam mundur, punës sime.

Me nderime :

(Kole Ashta)

Kole Ashta

Shkodër, më 29 shtator 1979

- 7) A Saverio Frato (2 giugno 1848).
- 8) Ad Antonio Santori (3 aprile 1865).
- 9) A Giovanni Stabile (25 gennaio 1865).
- 10) A Demetrio Camarda (21 giugno 1865).
- 11) A Demetrio Camarda (25 giugno 1865).
- 12) A Demetrio Camarda (22 gennaio 1866).
- 13) A Demetrio Camarda (10 luglio 1865).
- 14) A Demetrio Camarda (5 ottobre 1865).
- 15) A Bartolomeo Cecchetti (10 settembre 1868).
- 16) Il Ginnasio Garopoli in Corigliano Calabro (25 ottobre 1868).
- 17) A Giuseppe Jubani (12 luglio 1870).
- 18) Agli alunni del Ginnasio di Corigliano (1 dicembre 1868).
- 19) A Sua Altezza la Principessa Elena Ghica (1870).
- 20) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (28 marzo 1864).
- 21) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (il giorno della Pasqua 1864).
- 22) A Gustav Meyer (31 ottobre 1863).
- 23) A Gustav Meyer (gennaio 1868 ?).
- 24) A Gustav Meyer (22 maggio 1868).
- 25) A Gustav Meyer (dicembre 1867 ?).
- 26) A Cesare Centi (19 marzo 1866).
- 27) Al Cav. L. De Simone (20 settembre 1865).
- 28) Al Rettore dell' Abruzzo di Venezia (12 dicembre 1865).
- 29) Ad Antonio de Somogyi (20 dicembre 1865; 20 marzo 1866).
- 30) Ad Antonio Genini (20 dicembre 1865).
- 31) Ad Estimio Mikko (15 maggio 1867).
- 32) A Sua Eccellenza la Principessa Adele Pignatelli Strongoli (1891).
- 33) A Gian Crisostomo Bugliari (4 luglio 1893).
- 34) A Gian Crisostomo Bugliari (7 ottobre 1894).

7) A Saverio Frato (2 giugno 1848).

8) Ad Antonio Santori (3 aprile 1865).

9) A Giovanni Stabile (25 gennaio 1865).

10) A Demetrio Camarda (21 giugno 1865).

11) A Demetrio Camarda (25 giugno 1865).

12) A Demetrio Camarda (22 gennaio 1866).

13) A Demetrio Camarda (10 luglio 1865).

14) A Demetrio Camarda (5 ottobre 1865).

15) A Bartolomeo Cecchetti (10 settembre 1868).

16) Il Ginnasio Garopoli in Corigliano Calabro (25 ottobre 1868).

17) A Giuseppe Jubani (12 luglio 1870).

18) Agli alunni del Ginnasio di Corigliano (1 dicembre 1868).

19) A Sua Altezza la Principessa Elena Ghica (1870).

20) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (28 marzo 1864).

21) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (il giorno della Pasqua 1864).

22) A Gustav Meyer (31 ottobre 1863).

23) A Gustav Meyer (gennaio 1868 ?).

24) A Gustav Meyer (22 maggio 1868).

25) A Gustav Meyer (dicembre 1867 ?).

26) A Cesare Centi (19 marzo 1866).

27) Al Cav. L. De Simone (20 settembre 1865).

28) Al Rettore dell' Abruzzo di Venezia (12 dicembre 1865).

29) Ad Antonio de Somogyi (20 dicembre 1865; 20 marzo 1866).

30) Ad Antonio Genini (20 dicembre 1865).

31) Ad Estimio Mikko (15 maggio 1867).

32) A Sua Eccellenza la Principessa Adele Pignatelli Strongoli (1891).

33) A Gian Crisostomo Bugliari (4 luglio 1893).

34) A Gian Crisostomo Bugliari (7 ottobre 1894).

7) A Saverio Frato (2 giugno 1848).

8) Ad Antonio Santori (3 aprile 1865).

9) A Giovanni Stabile (25 gennaio 1865).

10) A Demetrio Camarda (21 giugno 1865).

11) A Demetrio Camarda (25 giugno 1865).

12) A Demetrio Camarda (22 gennaio 1866).

13) A Demetrio Camarda (10 luglio 1865).

14) A Demetrio Camarda (5 ottobre 1865).

15) A Bartolomeo Cecchetti (10 settembre 1868).

16) Il Ginnasio Garopoli in Corigliano Calabro (25 ottobre 1868).

17) A Giuseppe Jubani (12 luglio 1870).

18) Agli alunni del Ginnasio di Corigliano (1 dicembre 1868).

19) A Sua Altezza la Principessa Elena Ghica (1870).

20) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (28 marzo 1864).

21) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (il giorno della Pasqua 1864).

22) A Gustav Meyer (31 ottobre 1863).

23) A Gustav Meyer (gennaio 1868 ?).

24) A Gustav Meyer (22 maggio 1868).

25) A Gustav Meyer (dicembre 1867 ?).

26) A Cesare Centi (19 marzo 1866).

27) Al Cav. L. De Simone (20 settembre 1865).

28) Al Rettore dell' Abruzzo di Venezia (12 dicembre 1865).

29) Ad Antonio de Somogyi (20 dicembre 1865; 20 marzo 1866).

30) Ad Antonio Genini (20 dicembre 1865).

31) Ad Estimio Mikko (15 maggio 1867).

32) A Sua Eccellenza la Principessa Adele Pignatelli Strongoli (1891).

33) A Gian Crisostomo Bugliari (4 luglio 1893).

34) A Gian Crisostomo Bugliari (7 ottobre 1894).

7) A Saverio Frato (2 giugno 1848).

8) Ad Antonio Santori (3 aprile 1865).

9) A Giovanni Stabile (25 gennaio 1865).

10) A Demetrio Camarda (21 giugno 1865).

11) A Demetrio Camarda (25 giugno 1865).

12) A Demetrio Camarda (22 gennaio 1866).

13) A Demetrio Camarda (10 luglio 1865).

14) A Demetrio Camarda (5 ottobre 1865).

15) A Bartolomeo Cecchetti (10 settembre 1868).

16) Il Ginnasio Garopoli in Corigliano Calabro (25 ottobre 1868).

17) A Giuseppe Jubani (12 luglio 1870).

18) Agli alunni del Ginnasio di Corigliano (1 dicembre 1868).

19) A Sua Altezza la Principessa Elena Ghica (1870).

20) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (28 marzo 1864).

21) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (il giorno della Pasqua 1864).

22) A Gustav Meyer (31 ottobre 1863).

23) A Gustav Meyer (gennaio 1868 ?).

24) A Gustav Meyer (22 maggio 1868).

25) A Gustav Meyer (dicembre 1867 ?).

26) A Cesare Centi (19 marzo 1866).

27) Al Cav. L. De Simone (20 settembre 1865).

28) Al Rettore dell' Abruzzo di Venezia (12 dicembre 1865).

29) Ad Antonio de Somogyi (20 dicembre 1865; 20 marzo 1866).

30) Ad Antonio Genini (20 dicembre 1865).

31) Ad Estimio Mikko (15 maggio 1867).

32) A Sua Eccellenza la Principessa Adele Pignatelli Strongoli (1891).

33) A Gian Crisostomo Bugliari (4 luglio 1893).

34) A Gian Crisostomo Bugliari (7 ottobre 1894).

- 33) Invito al di sopra di Abasco. Fejasedi d' Italia e fuori (agosto 1895).
 - 34) Discorso inaugurale (20 febbraio 1897).
 - 35) Discorso (21 febbraio 1897).
 - 36) A Giuseppe Schirò (30 luglio 1897).
 - 37) Al Conte Magalo De Gubernatis (15 agosto 1897).
 - 38) Ad Anselmo Lorecchio (15 gennaio 1898).
 - 39) A Giuseppe Schirò (15 marzo 1898).
 - 40) Al Comm. R. Gervasa (30 novembre 1900).
 - 41) A Michele Marchisio (13 aprile 1901).
 - 42) Ad Anselmo Lorecchio (31 gennaio 1902).
 - 43) Ad Anselmo Lorecchio (5 aprile 1902).
 - 44) A Donatello Miye (Vittorio Giuseppe Guattieri) (31 maggio 1902).
 - 45) A Donatello Miye (Vittorio Giuseppe Guattieri) (31 maggio 1902).
 - 46) A Michele Marchisio (1 novembre 1902).
- Capitolo VI.
- Palatulor (1834-1902). Mja Letrat e bofuara.
dirizuar ose drejtuar :
- 1) Rafael Nagarens (20 tetor 1834).
 - 2) Mikal De Radis (20 shtator 1839).
 - 3) SH Bekurars Vaxhiresheh si Paparayer (8 dhjetor 1840).
 - 4) Vinçenc Dorris (1847).
 - 5) Saverio Frutos (2 qershor 1848).
 - 6) Anton Santori (3 prill 1855).
 - 7) Gjon Semilles (25 janar 1855).
 - 8) Daimitër Komardis (21 qershor 1855).
 - 9) Daimitër Komardis (25 qershor 1855).
 - 10) Daimitër Komardis (22 janar 1856).
 - 11) Daimitër Komardis (10 korrik 1856).
 - 12) Daimitër Komardis (5 tetor 1856).

- 13) Bartolomé Geketi (10 shtator 1868).
- 14) Gjilmanzi Gropoli ne Koriljano Kalabro (25 tetor 1868).
- 15) Zef Jubani (12 korrik 1870).
- 16) Kriusave ts Gjilmanzi ts Koriljano (1 dhjetor 1868).
- 17) Elena Gjikes (1870).
- 18) Josefina Korrit (28 mars 1884).
- 19) Josefina Korrit (1884).
- 20) Gustav Meyerit (31 tetor 1883).
- 21) Gustav Meyerit (janar 1888 ?).
- 22) Gustav Meyerit (22 maj 1888).
- 23) Gustav Meyerit (dhjetor 1887 ?).
- 24) Geras Kantuit (19 mars 1886).
- 25) L. G. De Simonit (korrik 1885).
- 26) Drejtori ts Geras ts Adriano ts Veneditut (12 dhjetor 1885).
- 27) Anton De Sonogjit (20 dhjetor 1885; 20 mars 1886).
- 28) Anton Keminis (20 dhjetor 1885).
- 29) Tind Mitkos (15 maj 1887).
- 30) Adele Finjetele Strongoliti (1891).
- 31) Ihan Krisostom Buljardit (4 korrik 1893).
- 32) Ihan Krisostom Buljardit (7 tetor 1894).
- 33) Proklamati. Mirrije shqiptare ts supërdarë ts Igerië dhe jashtë (shtet 1895).
- 34) Pjallim përurimtar (20 shkurt 1897).
- 35) Pjallim (21 shkurt 1897).
- 36) Zef Sqirëti (30 korrik 1897).
- 37) Mëgjill De Gubernatis (15 shtet 1897).
- 38) Anselm Lorekjos (15 janar 1898).
- 39) Zef Sqirëti (15 mars 1898).
- 40) R. Kavess (7 shtator 1900).
- 41) Mikale Marchisio (13 prill 1901).
- 42) Anselm Lorekjos (31 janar 1902).
- 43) Anselm Lorekjos (5 prill 1902).

44) Viktor Gualtieri (31 maj 1902). errata, dirre, siatitche (per le quali si ripetono in proposizioni, le stesse parole, meglio che analiticamente) si mescolano e ridanno in una prosa, che ha dello stile latino e albanese e che si svolge in una forma qua e là infastile e punto proprio dall'interpunzione e ortografia spesso errata, dall'andatura cascate, ove neppure le maducole sono usate correttamente" (M. Marchisani). "Edhe përkitim që bën në italisht, nuk është njëfjalësh, se edhe italishten De Rada nuk e përdorte njëfjalësh, vetë thotë në një vend këto fjala: "Questa medesima [la lingua italiana] non era a me nativa, ed ove non seppi tutta la sua potenza né sia escusazione l'averla dovuta apprendere su i libri, al modo che la latina, al modo che la greca" (Luigi Guaraldi). "Veramente io non potei poscia risolvere nella melodi tanto dell'italiano, la frase spesso disvolta della lingua nostra, antica e dovuta di flessioni: pure questa improntata, imbarazzante come il pudore, ne riflette la provenienza forestiera" (G. De Rada).

Të gjitha këto vëzhgime janë kapërcyer me sukses nga doçent ipp Kastrioti. Përkitim prej italishtes në shqip është bërë me kujdes të veçantë dhe me përhimëri. Shqipërim është i saktë dhe i qartë, gjatë kohës e punuar, stili i rrjeshtë. Përkryesi i ka qëndruar besnik origjinalit italisht.

Me nderime,
 (Fadil Përgjica)
 Tash Përgjica

Shtator, më 25 tetor 1979

44) Viktor Gualtieri (31 maj 1902). errata, dirre, siatitche (per le quali si ripetono in proposizioni, le stesse parole, meglio che analiticamente) si mescolano e ridanno in una prosa, che ha dello stile latino e albanese e che si svolge in una forma qua e là infastile e punto proprio dall'interpunzione e ortografia spesso errata, dall'andatura cascate, ove neppure le maducole sono usate correttamente" (M. Marchisani). "Edhe përkitim që bën në italisht, nuk është njëfjalësh, se edhe italishten De Rada nuk e përdorte njëfjalësh, vetë thotë në një vend këto fjala: "Questa medesima [la lingua italiana] non era a me nativa, ed ove non seppi tutta la sua potenza né sia escusazione l'averla dovuta apprendere su i libri, al modo che la latina, al modo che la greca" (Luigi Guaraldi). "Veramente io non potei poscia risolvere nella melodi tanto dell'italiano, la frase spesso disvolta della lingua nostra, antica e dovuta di flessioni: pure questa improntata, imbarazzante come il pudore, ne riflette la provenienza forestiera" (G. De Rada).

Të gjitha këto vëzhgime janë kapërcyer me sukses nga doçent ipp Kastrioti. Përkitim prej italishtes në shqip është bërë me kujdes të veçantë dhe me përhimëri. Shqipërim është i saktë dhe i qartë, gjatë kohës e punuar, stili i rrjeshtë. Përkryesi i ka qëndruar besnik origjinalit italisht.

Me nderime,
 (Fadil Përgjica)
 Tash Përgjica

Shtator, më 25 tetor 1979

Prof.

ALEXS BUDA

Kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH

T i r a n ë

zoj Veprat historike
-1903), të cilat i
mën, përkrahjen dhe
a, i lashë të sekre=
daktilografuara, të
l në italisht, 645 f.
lektin arbëresh, i

transkriptuar, 140 f. (vëllimi 8); e) Teksti i shqipëruar ose
i përshtatur në gjuhën e sotme, 645 f. (vëllim. 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15).
Deri më 15 prill 1978,
Ju dërgoj studimin introduktiv (20 f.) sëdhe aparatit
shkencor (150 f.).

Vili Kamsi më tha se do të vini në Shkodër nga
fundi i kësaj jave. Më vjen keq që s'takohemi dot, sepse unë
jam me shërbim në Peshkopë, për konsultime dhe provime të
stazhierëve dhe të studentëve me korrespondencë, në ditët 22,
23, 24, 25, 26 mars 1978.

Veprat historike dhe filologjike të De Radës ia
tregova shokut Foto Çami, i cili më nderoi së tepërmi duke më
pritur në zyrën e tij, me një konsideratë të veçantë. Ai më
përgëzoi me gjithë zemër për këtë veper të madhe. "Ta kam
zili" - më tha me ngrohësi dhe dashamirësi. M'u kujtua ^{shpreh}
~~ja~~ e De Radës, kur shkruan: "Më tha fjala që do të ngjallnin
një ndajnjë krenarie në zemrën e cilitdo".

Çështjen e shkëmjes sime ndër arbëreshët e
Italisë e kam ngritur përshri, aty ku është vendi. Ju lutem
shumë, kur të vini në Shkodër, bisedoni o me shokun Foto
Çami, o me shokun Adem Tullja, o me të dy bashkë, këtë çështje.
Organizata-bazë e Partisë e Institutit të Partë Pedagogjik
sëdhe sekretari i saj Ing. Fadil Kraja janë plotësisht

dakord që unë të shkoj për qëllime shkencore ndër arshvrahët e Italisë. Ata kanë folur edhe me organet kompetente. Drëndaj, po ta shihni të arsyeshme, përshirte kërkesh zyrtare. Vajtja ime atje do të jetë me dobi të madhe si për interpretimin sa më të mirë të Skauderbekut të pafundë, që kam në dorë, ashtu edhe për kultivimin tonë kombëtar, sepse do të sillja materiale arkivale të punjohura ndër në.

Po ju bashkohes një karakteristike të tims, që ka bërë Institutin tu. Luftë Redogogjike, dy muaj në parë. *Shkolla munda* të të shkollës ndërime të thallë.

(Jep Lastrat)
J. Shkollë

Firma, 20 Mars 1978

I dashur Profesor,

Edhe nga Shkolla të ju dorëzoi Veprat Historike dhe Filologjike të Jeronim De Radës (1832-1903), të cilat i përvuara dhe i përfundura nën nxitjen, ndihmën, përkrahjen dhe dashamirësinë tuaj. Në qershor nuk ju gjeta, i lashë të sekrete të J. De Radës. Jam gjithashtu 1500 f. q. të daktilogruara, të ndara në katër mënyra: a) teksti origjinal në italisht, 645 f. (vëllim 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7); b) teksti në dilelatin arshvrah, i transkriptuar, 140 f. (vëllim 8); c) teksti i shqiptarëve ose i përshkruar në gjuhën e sotme, 693 f. (vëllim 9) deri më 25 prill 1978, ju dërgoj studimin introduktiv (20 f.) si dhe aparatin shkencor (150 f.).

Vili kamsi më tha se do të vini në Shkodër nga fundi i kësaj jave. Më vjen keq që s'takova më dot, sepse unë jam me shërbim në Feshkopë, për konsultime dhe provime të stabilizimit dhe të studimit me korrespondencë, më ditët 22, 23, 24, 25, 26 mars 1978.

Veprat historike dhe filologjike të De Radës is tërëqë shohet Foto Pamë, i cili më nderoi në tëpërm duke më pritur në zyrën e tij, me një konsideratë të veçantë. Më përgjigod me gjithë zemër për këtë vepër të madhe. Më kam zili" - më tha me ngrohësi dhe dashamirësi. M'u kujtesh të të të De Radës, kur shkruantë më tha fjale që do të ngjallnin një ndjenjë krenarie në zemrën e çilitdo.

Shërbimet e shkencës sime ndër arshvrahët e Italisë e kam ngritur përshirte, ku kanë vend. Ju lutem shprehni, kur të vini në Shkodër, bindësia o me shokun Foto Pamë, o me shokun Adem Tullio, o me të dy bashkë, kështu që shërbimet. Organizata-Buzë e Partisë e Institutit të Artit Redogogjik si dhe sekretori i saj Ing. Fudil Kraja janë plotësisht

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I LARTË PEDAGOGJIK

Drejtoria

Nr. ____

Shkodër, më 20 qershor 1979

Lënda: *Përgatitja për botim e Veprave historike, filologjike dhe publicistike të Jeronim De Radës nga Jup Kastrati*

Prof. Aleks Buda

Kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH

Tiranë

Sipas porosisë Suaj, *Veprat historike, filologjike dhe publicistike të Jeronim De Radës*, 1800 faqe të daktilografuara, punuar nga Jup Kastrati, në tri versione (italisht, në dialektin arbëresh dhe në shqipen e sotme letrare) ua kemi shpërndarë me kohë pedagogëve Kolë Ashta, Fadil Podgorica dhe Luigj Franja. I thirrëm në drejtori, më 5 prill 1979, dhe iu lutëm që të marrin përsipër kontrollin dhe verifikimin e saktësisë së përkthimit të tekstit nga italishtja në shqip. Megjithëse ishin të zënë me punimet e tyre shkencore, e mirëpritën një gjë të tillë dhe filluan nga puna. Duke marrë parasysh moshën e tyre të thyer, shëndetin e dobët si dhe vëllimin e gjerë të veprës, shqyrtimi i tyre do të vazhdojë gjatë majit dhe qershorit. Në fund, secili do të dorëzojë nga një recension të shkruar. Të tri recensionet, së bashku edhe me një tjetër të prof. Vehbi Balës për shqipërimin e *Autobiologjisë* (I, II, III, IV) të De Radës nga J. Kastrati, do të Jua dërgojmë në rrugë zyrtare. Në muajin korrik, autori do të reflektojë vërejtjet eventuale, që mund të kenë kolegët. Ndërkohë, J. Kastrati po punon parathënien, studimin hyrës, aparatit shkencor dhe seleksionimin e Veprës nga ndonjë gjë e panevojshme. Një kopje, të redaktuar përfundimisht, do të Jua dorëzojmë në Akademi më 30 gusht 1979. Një kopje tjetër, do ta mbajë vetë autori. Kontrolli paraprak i tre pedagogëve të lartpërmendur, në Shkodër, do ta ndihmojë redaksinë e botimit të kësaj vepre, duke u fituar shokëve të komisionit shqyrtues të Tiranës një kohë të mirë, që do t'u duhej për këtë verifikim.

Katedra e gjuhës shqipe dhe e letërsisë e ILPSH na vë në dijeni, se lënda e *Veprave historike, filologjike dhe publicistike të J. De Radës* ka këtë vëllim:

- a) Treguesi i lëndës, parathënia, kriteret 25 f.
- b) Studimi hyrës: Mendimi politik, patriotik, shkencor dhe estetik i J. De Radës ... 80 f.
- c) Teksti original italisht ... 650 f.
- ç) Teksti original në dialektin arbëresh ... 135 f.
- d) Teksti në gjuhën e sotme letrare shqipe ... 650 f.
- dh) Aparati shkencor ... 250 f.
- Gjithësejt 1800 f.

Veprat historike, filologjike dhe publicistike të J. De Radës janë klasifikuar sipas kësaj renditjeje:

Kapitulli I: Vepra historiko-gjuhësore (1834-1902).

Kapitulli II: Vepra historiko-letrare (1836-1900).

Kapitulli III: Profile historiko-letrare (1833-1896).

Kapitulli IV: Vepra historiko-publicistike-politike për çështjen shqiptare (1873-1898).

Kapitulli V: Vepra historiko-autobiografike (1885-1902).

Kapitulli VI: Letra të Jeronim De Radës, dërguar disa autoriteteve letrare dhe personaliteteve politike dhe shkencore të kohës së vet, botuar në vise të ndryshme, gjatë viteve 1834-1903.

Për redaktimin e kësaj Vepre, J. Kastrati ka pasur dy leje krijuese:

- a) Leja e parë i është dhënë për periudhën 1 tetor 1975, 31 mars 1976, d.m.th. gjashtë muaj (me shkresën e Akademisë së Shkencave, nr. 755/1, dt. 23.9.1975).
- b) Leja e dytë i është dhënë për periudhën 1 shtator 1976 – 30 qershor 1977, d.m.th. dhjetë muaj (me shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, nr. 2387, dt. 6.7.1976).

Në bazë të shkresave nr. 755, dt. 1.8.1975 dhe nr. 755/1, dt.23.9.1975, J. Kastrati është ngarkuar nga Akademia e Shkencave me hartimin e dy vëllimeve të shkrimeve filologjike-historike të J. De Radës, për serinë që po përgatit ajo Akademi në korpusin “Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar. Monumente të gjuhës shqipe dhe vepra të gjuhësisë shqiptare”. Gjatë tre muajve të parë (tetor, nëntor, dhjetor 1975), ai ka punuar *Veprat gramatikore të J. De Radës*, sepse ashtu ishte projektuar, që vëllimi i parë të përfshinte studimet e De Radës, botuar prej tij, për strukturën gramatikore të shqipes. Në janar të vitit 1976, është porositur nga Ju që të lërë vëllimin e *Veprave gramatikore* dhe të punojë vëllimin e *Veprave historike, filologjike dhe publicistike*, sepse këto kishin karakter të theksuar politik, patriotik dhe kombëtar, dhe shkonin më shumë me atmosferën e jubileut të 100-vjetorit të

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Për këtë arsye, më 12 dhjetor 1975, J. Kastrati, sipas porosisë Suaj, i ka dorëzuar Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Sektori i gramatikës), Tiranë, një informacion shkencor për punën e bërë lidhur me përkthimin nga italishtja dhe me transkriptimin e transliterimin e dy veprave gramatikore të De Radës: *Grammatica della lingua albanese* (1870) dhe *Caratteri e Grammatica della lingua albanese* (1894).

Për kriteret dhe dimensionet e botimit të *Veprave të plota historike, filologjike dhe publicistike të J. De Radës*, J. Kastrati ka paraqitur katër projekte, që tregojnë e dëshmojnë jo vetëm gjenezën, por edhe zhvillimin e mëtejshëm apo evolucionin e planit botues.

- a) Projekti i parë, më 12 prill 1975 (4 f. të daktilografuara)
- b) Projekti i dytë, më 19 janar 1976 (diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e redaksisë së botimit, më 19 janar 1976, në Akademi, në prani të Dh. S. Shuteriqit, A. Uçit, K. Kodrës, A. Xhikut. E. Çabej mungoi atë ditë. Një kopje ia ka dorëzuar Dh. S. Shuteriqit, më 20 shkurt 1976) (7 faqe të daktilografuara).
- c) Projekti i tretë, më 25 dhjetor 1976 (5 f. të daktilografuara).
- ç) Projekti i katërt, më 15 qershor 1976 (një kopje e ka dorëzuar në Ministri të Arsimit dhe të Kulturës, në degën e Arsimit të Lartë; një kopje tjetër Jua ka dorëzuar Juve) (6 f. të daktilografuara).

Fillimisht, vëllimi: *Veprat historike, filologjike dhe publicistike të J. De Radës*, është parashikuar të ketë 800 faqe të daktilografuara; por, gjatë punës së përditshme, u rrit në 1.800 faqe të daktilografuara, d.m.th. shkoi duke u shtuar, pasuruar e zgjeruar, deri sa arriti të dyfishohet, në krahasim me parashikimin. Më 14 prill 1977, autori Ju ka dorëzuar përmbajtjen sistematike të lëndës, sipas kërkesës Suaj.

Vepra që ka përgatitur për botim J. Kastrati, është rezultat i një pune kërkimore disavjeçare, e jo vetëm i lejes së tij krijuese. Për të ai ka punuar, me ditë të tëra, në kryeqytet dhe në disa qytete të tjera të vendit tonë, duke shfrytëzuar fondet e Bibliotekës Kombëtare, të bibliotekës së Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, të Arkivit të Shtetit, të bibliotekës së shtetit: Shkodër, Durrës, Elbasan, Berat, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Fier, Kukës, Peshkopi. I gjithë ky hulumtim i ka ngrënë tre muaj kohë. Ai ka punuar gjatë pushimeve verore, në ditë festash dhe të dielash, intensivisht, pa e dëmtuar fare as procesin mësimor në Institut, as punën shtetërore; madje, edhe gjatë kohës së lejes së tij krijuese, ai është marrë edhe me redaktimin e “Buletinit shkencor” të ILPSH (dy vëllime në vit), edhe me botimet e posaçme të Pashko Vasës, Luigj Gurakuqit (1976) dhe 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1978), edhe me botimin jubilar të 20-vjetorit të ILPSH (1977),

edhe me organizimin e një vargu sesionesh shkencore të ILPSH dhe të rrethit, edhe me kumtesën e tij për Konferencën Kombëtare të Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (Tiranë, qershor 1978), edhe me komisionin e rrethit të këtij jubileu etj., pa numëruar këtu punët e shumta dhe aktivitetet shoqërore, të cilave as nuk u është shmangur kurrë, as nuk u shmanget. Gjatë muajve nëntor-dhjetor 1978, është marrë me hartimin e Bibliografisë së veprave të Prof. E. Çabejt, sipas porosisë Suaj.

Vetëm daktilografimi i materialit, të cilin e ka bërë vetë J. Kastrati dy herë, sepse tekstet origjinale të dialektit arbëresh dhe italisht nuk mund t'i daktilografonte tjetërkush për arsye saktësie, i ka kushtuar një vit kohë (1800 faqe: 10 faqe në ditë = 180 ditë : 30 ditë = 6 muaj. Daktilografuar dy herë fillim e mbarim: 6 muaj x 2 = 12 muaj). Pra: 3 muajt e parë i shkuan bosh, sepse punoi për dy gramatikat e De Radës ose për *Veprat gramatikore* të tij, për arsye se ashtu ishte planifikuar; 3 muaj për gjurmime në biblioteka dhe arkiva; 12 muaj për daktilografim; pra 18 muaj. Leje krijuese ka pasur gjithsejt 16 muaj. Siç shihet, e gjithë leja krijuese u shpenzua vetëm për këto anë. Nuk kemi llogaritur këtu kohën për shqipërim, transliterim, transkribim, interpretim, koment, variante pune, limë në dorë, përkthime të teksteve jo vetëm nga italishtja, por edhe nga frëngjishtja, latinishtja, greqishtja e vjetër, gjermanishtja etj. Nuk i thomi këto për të justifikuar vonesën gjashtëmujore të një vepre të tillë të rëndësishme, por për të treguar vështirësitë objektive dhe subjektive, vështirësi të paparashikuara, pengesa të pallogaritura më parë.

Katedra e gjuhës shqipe dhe e letërsisë e ILPSH ka dalë me mendimin se J. Kastrati ka bërë një punë shumë të mirë, të saktë, të kujdesshme. Ai ka punuar me zell, me pasion dhe në mënyrë sistematike. Atij i është dashur të përballojë dhe të kapërcejë një varg vështirësish të karakterit objektiv dhe subjektiv.

- Duke qenë se *informacioni bibliografik* i veprave të J. De Radës, që gjinden apo ruhen në vendin tonë, mungon edhe sot e kësaj dite, autorit i është dashur ta përpilojë dhe ta hartojë vetë një bibliografi të tillë, duke e filluar nga alfa. Mund të merret me mend sa kohë materiale i është dashur për një punë të tillë, pa të cilën nuk ecet përpara në asnjë studim, po sidomos në vepra madhore të kësaj fare. Por, tashti, ai ka në dorë të skeduar, sipas kërkesave të shkencës bibliografike, gjithë literaturën deradiane, të hartuar ose të botuar prej shkrimtarit të madh arbëresh si dhe bibliografinë e shkruar për të gjatë 145 vjetëve (1834-1979). Kur të botohet kjo bibliografi kronologjike dhe tematike, alfabetike dhe sistematike, do të jetë një ndihmesë e madhe për studiuesit e ardhshëm të arbëreshit të madh. Të paktën këtë kohë që harxhoi autori ynë i sotëm, nuk do ta shpenzojnë të tjerët studiues që do të merren me De Radën, sepse regjestin do ta gjejnë të gatshëm.

- Gjithë *materialet e gjetura*, nëpër arkivat dhe bibliotekat tona të qendrës dhe të rretheve, ai i ka *kopjuar me dorë*, sepse tek né, nga ana e këtyre institucioneve, mungon shërbimi i kualifikuar me kseroks, fotokopjim dhe mikrofilmim për punonjësit shkencorë. Edhe nëse ka filluar, kjo është një praktikë e kohëve të fundit. Mund të merret me mend, pra, sa kohë e humbur ka qenë kjo punë materiale për këtë deradian; por ai e ka kapërcyer këtë vështirësi jo të vogël me dashurinë për temën, me zell e me pasion, me këmbëngulje e me durim, duke e çuar deri në fund.

- Vështirësi jo e pakët ka qenë edhe çështja e një *interpretimi* sa më të drejtë *fonetik* të fonemave në veprat e arbëreshit të madh, sepse - siç dihet - sistemi i tij alfabetik, gjatë shtatëdhjetë vjetësh të krijimtarisë së tij letrare dhe të veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore (1834-1903), ka ndryshuar shtatë herë! Po, meqenëse J. Kastrati është marrë me De Radën që nga viti 1952, pra që prej njëzeteshtatëvjetësh, dhe ka qenë i familjarizuar me alfabetet e arbëreshit të madh, ai e ka kapërcyer me sukses një gje të tillë.

- Ajo që vlen për *transkribimin* e veprave të De Radës, vlen, përgjithësisht, edhe për tekstet shqip të arbëreshëve të Italisë. Transkribimi i këtyre nuk është një punë e lehtë; përkundrazi, ai kërkon një njohje të mirë të fonetikës së këtyre dialekteve, të mënyrës se si e shqiptojnë këto shqipen. Ky shqiptim, në shuymë pika, ndahet nga shqiptimi i gjuhës në të folët me Shqipërisë. Pesë shekuj zhvillimi të pavarur kanë përfutur, këtu dhe atje, sisteme fonetike mjaft të dalluara. Një transkribim i mirë do të synojë një besnikëri fonetike sa më të madhe. Pyetja parimisht më me rëndësi është se a do të bëhet një transliterim apo një transkribim. Ndërsa e para konsiston në një riprodhim të shkronjës, pa marrë parasysh tingullin që ajo përfaqëson, kjo e dyta synon në një riprodhim të shqiptimit, të tingullit që përmbahet në shkronjën përkatëse. Në tekste relativisht të reja, siç janë shkrimet e De Radës, ku shqiptimi, në më të shumtat e rasavet, dihet, transkribimi do preferuar patjetër përpara transliterimit. Përveç së tjerash, kjo ka dhe këtë dobi që gjithë riprodhimi i tekstit është më konsekuent, se evitohen shumë inkoherenca e keqkuptime. Veçse do përpjekur që të arrihet një besnikëri fonetike sa më e madhe, një afrim sa më i madh i shqiptimit të dialektit të poetit. Pikësëpari, në të folët e kolonive arbëreshe ruhet mirë, edhe sot e kësaj dite, kuantiteti i rrokjeve të theksuara. Zanoret e gjata shënon te De Rada, siç dihet, me zanore të dyfishuara, po ashtu si te të gjithë shkrimtarët e vjetër, të Shqipërisë e të kolonive. Theksi hundor, nga fjalët ku përdoret, shënon një gjatësi pak më të vogël se zanorja dyfishe. Në asnjë mënyrë nuk është lënë në transkribim ky theks, sepse do të merrej si një shenjë e nazalitetit, kurse ndër ato dialekte arbëreshe nazalitet nuk ka. Në transkribim të veprave të De Radës janë pasur parasysh toni, kuantiteti, akcenti, arsi, mōra, tëzi.

- Botimi i Veprave të plota të De Radës i është nënshtruar një *kriteri paraprak*. Dihet se arbëreshi i madh ka vepra letrare, poetike, dramaturgjike, folklorike, historike, gjuhësore, shkollore, politike, publicistike, estetike, sociologjike, filozofike, autobiografike, të shkruara në shqip dhe në italisht. Është menduar që këto të botohen në *edicion kritik, diplomatik*, duke i përmbledhur në një kolanë: botimet italisht të përkthyer në shqip, kurse botimet e shkruara në dialektin arbëresh - të *përshtatura* në gjuhën e sotme letrare. Nuk është e drejtë që vepra e tij shqip (arbërisht të përkthehet nga italishtja, siç është vepruar, fatkeqësisht, nga një deradian në Tiranë. Të folmet e arbëreshëve të Italisë i përkasin dialektit të toskërishtes dhe nuk përbëjnë një dialekt të tretë të shqipes. Prandaj, tekstet e shkruara në dialektin arbëresh J. Kastrati i ka përshtatur në gjuhën e sotme edhe në atë rasë kur ato kanë pasur përbri përkthimin italisht. Ky kriter e ka ruajtur fizionominë e sintaksës së shqipes së De Radës, duke përjashtuar elementet arkaike. Është pasur parasysh, gjithashtu, që përshtatja të ruajë sa më besnikërisht frymën e poetit të madh dhe ritmin e brendshëm të prozës së tij. Ku qe e mundur, u ruajt edhe elipsi, pse - siç thekson me të drejtë Tomazeu - kjo figurë sintaktike është e nevojshme. Po kështu, në pjesën më të madhe, u ruajt edhe stili konciz, lakonik, si dhe leksiku deradian. Dialekti arbëresh, për ata që s'janë marrë me të, është i vështirë. Në anë tjetër, fragmentariteti - karakteristikë e De Radës, mungesa e lidhjes organike në një vepër apo në një tjetër, koncizioni i stilit, proza e dendur, lakoniciteti i shprehjes, shkurtësia e mendimit, errësia e autorit me vetëdashje (it. *volutamente oscuro*), fluturimet pindarike, fjalitë eliptike, e bëjnë edhe më të vështirë të shijuarit e veprës së tij. Por, kur i hyn veprës së tij, kur e zbërthen atë, atëherë të del përpara një margaritar i vërtetë.

Përkundrazi, kur tekstet e De Radës kanë qenë vetëm italisht, pa pjesën në dialektin arbëresh, - e raporti i gjithmbarshëm është 1 me 5, - vetëm atëherë janë shqipëruar, por duke zhdukur format latinizuese dhe duke ruajtur stilin e tij në përshtatmëri me gjuhën e sotme letrare shqipe të njësuar.

- Ndër rastet kur në një vepër të tij ka mendime dhe *shprehje me përmbajtje fetare* ose me filozofime të kota, të padobishme për lexuesit dhe studiuesit tanë të sotëm, këto janë harrur, krehur dhe krasitur, pa e dëmtuar fare brendinë e gjithmbarshme të tekstit të De Radës. Në botëkuptimin e tij, - siç dihet - De Rada ka qenë idealist objektiv dhe iluminist. Ai i ruajti përherë bindjet e tij fetare, por pa qenë një besimtar i flaktë. Në këtë vështrim, veprat e tij botohen të plota, por edhe të zgjedhura, të seleksionuara, lidhur me ato pjesë që, për né, sot, nuk sjellin gjë me vlerë. Në këtë mënyrë, botohen ato që meritojnë dhe që vlejné për të përfaqësuar si duhet veprimtarinë përparimtare të De Radës shkrimtar, filolog dhe publicist.

- *Mbledhja dhe përmbledhja e veprave* të shpërndara të një mendimtari, dijetari dhe shkrimtari aq prodhimtar, siç qe De Rada, është një problem me shumë rëndësi dhe me disa aspekte.

Këtu duhen pasur parasysh disa lloje botimesh. *Botime të bëra për së gjalli*, d.m.th. të bëra nga vetë autori. Por këto mund të jenë botime, ribotime, rishtypje, dorë e parë, e dytë, e tretë e, kështu, me radhë. Në këtë rasë, ne do të pranojmë botimin e fundit të autorit, por duke e krahasuar me botimet e mëparshme, për të parë ngritjen e hartuesit, ecjen e tij përpara, evoluimin e tij, por ky kriter mund të mos jetë gjithëherë i drejtë, sepse një ribotim i katërt i një veprë, bërë me gjallje të shkrimtarit, mund të jetë më i dobët se botimi i tij i parë. Kjo rrethanë e disfavorëshme për filologun arbëresh është pasur parasysh nga deradiani i sotëm.

Një pjesë e mirë e veprave të De Radës shkrimtar, dijetar dhe publicist janë botuar e ribotuar për gjallje të tij, por janë të shpëndara ndër organe të ndryshme të shtypit periodik shqiptar dhe të huaj të shekullit XIX. *Të gjitha këto botime e ribotime nuk gjenden në Shqipëri*. Ato janë bërë raritete bibliografike, që në kohën e De Radës, pse ishin botuar në tirazhe tepër të pakta dhe të kufizuara. Le të përmendim, sa për konkretizim, disa syresh: “Omnibus” (1836), “Viaggiatore” (1840), “Divinazioni pelasghe” (1840), “Lucifero” (1843), “Passeggiate intorno Napoli” (1844) ose “Passeggiate per Napoli e contorni” (1844), “Disertatie archeologica” (1844), “Athinà” (Minerva, 1845), “Curieru român” (1846), “L’Albanese d’Italia” (1848), “Il Vero” (1878), “L’Avvenire” (Reggio Calabria, 1880), “L’Albania in faccia all’Europa” (1880), “Das Deutschland” (Wien), “L’Adriatico” (1885), “Pelasgi e Albanesi” (1890), “Lezioni di lingua albanese” (1891), “Sulla venuta di Albanesi in Italia” (1893), “Abecedario della lingua albanese” (1896) etj. Këto botime dhe ribotime të De Radës dhe të tjera të tij duhet të mblidhen dhe të sillen të kseroksuara në Shqipëri; por, përpara se të bëhej kjo punë, ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme të gjindeshin burimet, të hartohet bibliografia përkatëse e të gjithë artikujve, studimeve, përkthimeve në greqisht, rumanisht, frëngjisht, hungarisht, latinisht, gjermanisht etj., të shkruar nga De Rada, si dhe të bashkëpunimeve të tij ndër organet e ndryshme të Evropës. Padyshim, kjo ka qenë një punë mjaft e vështirë, sepse burimet, nganjëherë, janë të tërthorta, jo të drejtpërdrejta, dhe jo të sakta. Ato duhen verifikuar në vend, në fondet ku ruhen materialet e sipërsënuara. Duhet gjurmuar e hetuar, në të ardhmen, ndër arkivat e huaja dhe ndër disa biblioteka të dijetarëve, me të cilët pati letërkëmbim De Rada; kuptohet, kur ka sinjalizime ose hipoteza ose kur kemi të dhëna burimore të sigurta, si, p.sh., në Kozenca, Palermo, Napoli, Firenze, Roma, Venedik, Livorno, Grac, Hamburg, Paris, Bukuresht, Budapest, Stamboll, Athinë etj. Kjo çështje i përket së ardhmes. Po kështu duhen bërë

sondazhe ndër bibliotekat e dijetarëve e shkrimtarëve europianë, me të cilët pati letërkëmbim të gjatë, afro 75 vjet. Le të përmendim këtu vetëm disa personalitete politike, letrare e shkencore, p.sh.....

Një problem tjetër ka qenë ai i *veprave të botuara pas vdekjes së De Radës* nga një tjetër, qoftë ky kritik letrar, publicist apo historian i letërsisë. Duke u ribotuar sot, ndjehet nevoja të vendosen mbi kritere të tjera shkencore, mbasi vuajnë në këtë drejtim. Diku është respektuar gjuha e autorit; diku jo; diku është ndërhyrë nga mbledhësi a redaktori, duke u bërë, madje, edhe veprime arbitrare, si kontaminacione etj. Ato duhen shikuar me sy kritik, në një ribotim kritik dhe shkencor, dhe të mos mbështetemi tek ato botime që janë bërë nga të tjerët, për arsye se këta kanë pasur qëllime të tjera, kërkesa të tjera, pikësnyime të tjera, kritere të tjera.

Një çështje tjetër me rëndësi është ajo e *dorëshkrimeve* që ruhen në arkivat e shtetit, në institucione shkencore dhe në trashëgimtarët e shkrimtarit, mendimtarit, dijetarit dhe publicistit përparimtar De Radë. Ndjehet e nevojshme të hartohet një regjest i tyre. Të dhënat burimore bibliografike si edhe epistulati i De Radës na çojnë në mjaft vise të Italisë dhe të Evropës; por kjo punë i takon së ardhmes. Ato gjenden të ruajtura edhe sot e kësaj dite në Austri, Gjermani, Greqi, Egjipt, Turqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Francë etj.

Botimi i veprave të figurave të shquara politike dhe letrare të së kaluarës paraqet një varg *problemesh redaktoriale*. Këto janë të ndryshme dhe varen sipas autorit, sipas veprës, sipas gjuhës së shkruar dhe sipas kohës, në të cilën u hartuan, mbetën dorëshkrim apo u botuan. Për shkrimtarët arbëreshë të Italisë, si De Rada, duhen bërë transliterimi, transkribimi, përshtatja në gjuhën e sotme letrare, shqipërimi dhe fototipia ose riprodhimi fotomekanik. Në këtë mënyrë, do të kishim botime shkencore në lartësinë e kërkesave të kohës. Për veprat e tyre shqip - në dialektin arbëresh, mund të ndiqet kriteri që faqja *recto* të ketë dy shtylla (kolona) me transliterim dhe transkribim të tekstit origjinal, kurse faqja *verso* të ketë përshtatjen në gjuhën e sotme. Do të ishte e volitshme që versioni i ri të ndiqte në mënyrë juxtalineare origjinalin, duke pasur në njërën faqe fotokopjen, kurse në faqen tjetër përbri kthimin në shqipen e sotme. Veprat e shkruara në italisht, mund të botohen në origjinal (me fotokopje në të majtë) dhe me shqipërimin (në të djathtë). Këto ribotime me fototipi dhe me përkthimin përbri do të zëvendësonin botimet origjinale të De Radës, që sot nuk gjenden, po që janë të domosdoshme të jenë në duart e punonjësve tanë shkencorë dhe të pedagogëve e të profesorëve të instituteve tona të larta pedagogjike dhe të universitetit. Nga ana tjetër, një veprim i tillë flet edhe për saktësi shkencore të përkthyesit. Po një botim i tillë shkencor ka vështirësi të mëdha tipografike dhe, he për he, nuk ka mundësi të realizohet. Atëherë rruga më praktike për botimin e *Veprave historike, filologjike dhe publicistike*

të *De Radës* mund të ishte kjo: Parathënia dhe studimi hyrës të botoheshin me shkronja kursive, teksti shqip në gjuhën e sotme letrare të njësuar - me shkronja të karakterit dhjetësh, teksti origjinal në të folmen arbëreshe me shkronja 9^e, teksti origjinal italisht me shkronja 8^e, aparati shkencor me shkronja 7^e ose 6^e. Në këtë mënyrë, të 1800 faqet e daktilografuara mund të përmblihdeshin në një vëllim me rreth 1000 faqe shtyp të rrastë, me dimension 17 cm x 24 cm. Kështu del një volum dinjitoz dhe hap serinë e veprave të plota të *De Radës*, i cili mund të pasohet me vepra të tjera me vlerë të këtij njeriu të madh. Po mund të ndiqet edhe një rrugë tjetër: të 1800 faqet e daktilografuara të *Veprave historike, filologjike dhe publicistike të De Radës* mund të ndaheshin në dy vëllime. Në njërin vëllim të botohej teksti në gjuhën e sotme letrare së bashku me parathënien dhe studimin hyrës; kurse në vëllimin tjetër të botoheshin teksti origjinal në dialektin arbëresh dhe në italisht së bashku me aparatën shkencor.

Shqipërimi i veprave të arbëreshit të madh nga italishtja është një çështje me rëndësi të veçantë dhe paraqet një tok vështirësish. De Rada, duke shkruar italisht, përkthente nga gjuha e vet amtare, nga shqipja: Ai mendonte dhe fliste në dialektin arbëresh, i cili, sidomos në veprat e tij, është shumë i errët. Italishten nuk e përdorte mirë, sepse - siç thotë vetë - “ajo nuk qe për mua gjuha e nënës; atë m’u desh ta nxë (ta mësoj) ndër libra, sikurse latinishten dhe greqishten”. Nga ana tjetër, ai shkruante pa kujdes, madje edhe pa shenjat e duhura të pikësimit, pa një drejtshkrim të përpikët, koherent, të njësuar, me shumë të meta të tjera, me inkonsequenca ortografike, me një gjuhë, shpeshherë, të pakuptueshme, të pakapshme, me konstrukte që s’janë të italishtes letrare të shekullit XXI, me latinizma, provincializma, inversione, metateza, anakolute, arkaizma, amnezi sintaktike, me fjali të varura, të ndërshtëna a të ndër kallura, pa kriter. Një varg studiuesish e kanë vënë re prej kohësh një të metë të tillë të arbëreshit të madh.

Ja, ndonjë, sa për konkretizim: “Il De Rada scrivendo in italiano traduceva: egli pensava e parlava in albanese” (G. Schirò Junior). “... la lingua italiana, in cui è scritta questa grammatica, senza neppure punteggiatura ed ortografia esatta, latineggia, contorcendosi in volute rudi e tormentose” (M. Marchianò). “Questo autografo, non so come, manca quasi affatto dell’energia incisiva del suo stile e ribocca di ogni sorta di errori. Latinismi, provincialismi, inversioni contorte, voci poetiche, bisticci, metatesi strane, arcaismi, amnesie, vorrei dire, sintattiche (per le quali si ripetono in proposizioni, le stesse parole, peggio che anacoluticamente) si mescolano e ridanno in una prosa, che ha dello stile latino e albanese e che si svolge in una forma qua e là infantile e punto perspicua, dall’interpunzione e ortografia spesso errata, dall’andatura cascante, ove neppure le maiuscole sono usate correttamente” (M. Marchianò).

“Edhe përkthimi që bani n’italisht nuk është mjaft i lehtë, se edhe italishten De Rada nuk e përdorte mirë, e ai vetë thotë në një vend këto fjalë: “Queste medesima / la lingua italiana / non era a me nativa, ed ove non seppi tutta la sua potenza mi sia accusazione l’averla dovuta apprendere su i libri, al modo che la latina, al modo che la greca” (Luigj Gurakuqi). “Veramente io non potei poscia risolvere nella melodia tanto dell’italiano, la frase spesso discolta della lingua nostra, antica e dotata di flessioni: pure questa impronta, imbarazzante come il pudore, ne riflette la provenienza forestiera” (G. De Rada).

Për *redaktimin gjuhësor* të Veprave të arbëreshit të madh, J. Kastrati është orientuar nga Kriteret e përgjithshme të botimit të Trashëgimit kulturor të popullit shqiptar (Akademia e Shkencave, Seksioni i Shkencave shoqërore, Tiranë, 1975, f. 11-14). Është pasur parasysh që *Veprat historike, filologjike dhe publicistike të De Radës* janë botime kritike shkencore, që u drejtohen studiuesve të shkencave të ndryshme albanologjike, pedagogëve të shkollave tona të larta, mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë dhe të gjithë punonjësve që merren me studimin e historisë së gjuhës amtare, të letërsisë dhe të folklorit shqiptar. Duke qenë se Veprat e De Radës botohen për nevoja shkencore dhe të shkollës sonë të lartë, në gjuhën e shkrimtarit të madh arbëresh nuk është vënë dorë fare ose është vënë dorë fare pak, sa me thanë. Duke ndryshuar drejtshkrimin e vjetër, nuk duhet ndryshuar gjuha. Modernizimi i gjuhës, në botime të kësaj fare, është i palejueshëm dhe antihistorik. Kur drejtshkrimi i një fjale nuk ka qenë i lidhur me pasqyrimin e veçorive fonetike, por ka qenë grafi e thjeshtë ose ka pasur karakter konvencional, ajo nuk është ruajtur. Në punën redaktuese është bërë dallimi midis sistemit ortografik të shkrimtarit, nga njëra anë, dhe paraqitjes grafike të një vepre ose dorëshkrimi, nga ana tjetër. Ndonjëherë, si rezultat i gabimeve që mund t’i kenë shpëtuar arbëreshit të madh gjatë punës mbi veprën, si përfundim i gabimeve që mund të kenë bërë tipografët ose i ndryshimeve që mund të kenë sjellë në tekst redaktorët, sistemi ortografik i De Radës nuk përputhet me drejtshkrimin e një vepre. Prandaj, në botimin kritik shkencor të J. Kastratit nuk është riprodhuar mekanikisht origjinali, por është dhënë drejtshkrimi i origjinalit, duke e pasë nxjerrë atë nga studimi kritik i të gjitha veprave të tij. Në këtë rrugë është zbuluar sistemi ortografik i shkrimtarit të madh arbëresh dhe, në bazë të tij, është bërë gati botimi i Veprës. Një çështje e tillë del lidhur me botimin e De Radës, veprat e të cilit kanë gabime të ndryshme, që ia kanë prishur ortografinë unike, edhe për shkak se tipografët ishin italianë ose sepse dorëshkrimet poeti ynë i dorëzonte me dorë, me një grafi që nuk deshifrohej lehtë, ose edhe për faktin tjetër, se në shtypshkronjën e vet, për aq kohë sa e mbajti, kishte radhitës arbëreshë pa përvojë, ose, së fundi, pse vetë poeti ynë nuk bënte një korigjim të bocave me skrupolozitet, për vetë natyrën e tij prej poeti. Arsyeja e kërkonte, pra, që sot të bëhej çmos që vepra, para se të botohej, të çlirohej nga gabimet dhe shtrembërimet e ndryshme tipografike.

Kur brenda për brenda këtij shkrimtari të madh ose të një vepre të tij ose të disa veprave të tij janë vënë re luhatje në shikimin e një trajte drejtshkrimore, atëherë është marrë për bazë forma mbizotëruese. Ndërhyrja në drejtshkrimin e origjinalit është bërë e domosdoshme vetëm në atë rast kur kemi pasur të bëjmë me një drejtshkrim të pa ngulitur mirë. Duke qenë se në letërsinë arbëreshe të Rilindjes sonë Kombëtare, ashtu edhe më parë, në çështjet e pikësimit nuk ka pasur rregulla unike dhe çdo shkrimtar i vinte shenjat e pikësimit sipas mendjes së vet, në botimet e Veprave të De Radës janë zbatuar rregullat e pikësimit që janë sot në fuqi.

Këto ishin disa nga kriteret e përgjithshme të punës për gjuhën e Veprave të De Radës. Padyshim, ato nuk pasqyrojnë të gjitha problemet gjuhësore e tekstologjike. Gjatë punës, autorit të sotëm i kanë dalë edhe një tok çështjesh të tjera, të cilat janë studiuar duke u nisur nga veçoritë individuale të veprës dhe të gjuhës së De Radës. Në këtë mënyrë, është arritur një unitet relativisht i mirë në përgatitjen për botim të *Veprave të tij historike, filologjike dhe publicistike*.

Veprat e De Radës do të botohen nga Akademia e Shkencave e RPSSH, në korpusin “Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar”, në serinë e parë “Monumente të gjuhës shqipe dhe vepra të gjuhësisë shqiptare”. Është projektuar që të hidhen në shtyp dy vëllime. Vëllimi i parë: *Veprat historike, filologjike dhe publicistike* (1800 f. të daktilografuara, në vitin 1979). Vëllimi i dytë: *Veprat gramatikore* (600 f. të daktilografuara, në vitin 1980). Veprat e De Radës botohen me qëllim që trashëgimi kulturor i së kaluarës të bëhet pronë e masave popullore e të vihet në shërbim të ndërtimit të kulturës socialiste. Në këto botime përfshihen monumente gjuhësore, vepra letrare, visare të folklorit, shkrime dhe materiale që lidhen me zhvillimin e mendimit politiko-shoqëror të Rilindjes.

Botimi, njohja dhe përhapja e traditës deradiane bëhet duke u nisur nga vlera aktuale e veprave të tija si dhe nga kërkesat më të ngutshme të zhvillimit kulturor. Iu dha preçedencë De Radës, sepse njihet si një nga autorët tanë të së kaluarës, që shquhet për prirje të spikatura përparimtare, demokratike dhe revolucionare. Ai hyn në radhën e personaliteteve shqiptare, veprimtaria letrare e shkencore e të cilit ka karakter kompleks. *Vepra* që botohet sot, ka interes shkencor; prandaj *është caktuar*, në radhë të parë, për specialistët e shkencave të ndryshme albanologjike. Po, përveç punonjësve shkencorë, për karakterin përparimtar të saj të theksuar, ajo i drejtohet edhe një publiku më të gjerë, siç janë pedagogët, mësuesit dhe studentët e shkollave tona të larta.

Veprat filologjike të De Radës janë *botime tekstologjike*, d.m.th. në to përfaqësohen, në mënyrë të gjerë, jo vetëm tekstet e veprave historike, gjuhësore, publicistike, por edhe variantet e tyre. Përveç veprave letrare të mirëfillta, në këto botime përfshihen edhe dokumente të tjerë, si letra të panjohura, shkrime autobiografike etj. Botimi shkencor i Veprave të De Radës bëhet sipas Kritereve të përgjithshme të botimit të Trashëgimit kulturor të popullit shqiptar, përcaktuar

nga Akademia e Shkencave. Vëllimi i parë akademik i De Radës bën pjesë në llojin e veprave të plota ose sa më të plota dhe shoqërohet nga një studim hyrës mbi autorin dhe veprën e tij, nga një parathënie me një tok problemesh: mbi kriteret e ndjekura nga studiuesi i sotëm për botimin e veprave historike dhe gjuhësore të arbëreshit të madh, mbi problemet e veçanta të trajtuara nga De Rada, mbi kontributin e tij në fushën e gjuhësisë shqiptare, mbi të mirat dhe të metat e tij, mbi tezat dhe idetë e tij, mbi metodën e ndjekur prej tij, mbi jehonën e mendimeve të tij, mbi ndikimet e ushtruara, mbi gjendjen e studimeve albanistike në kohën e tij etj. Vëllimi shoqërohet, gjithashtu, nga komente tekstologjike dhe bibliografike, nga komente historiko-letrare, nga komente gjuhësore dhe nga komente “reale” ose historike. Në studimin introduktiv është dhënë një vlerësim kritik mbi veprën e shkrimtarit dhe të dijetarit arbëresh. Aty janë pasqyruar rezultatet e fundit të arritura në hulumtimin e autorit dhe janë paraqitur pikëpamjet që janë pranuar dhe kanë hyrë në literaturën shkencore. Në komentin tekstologjik është dhënë historia e krijimit të veprës dhe të tekstit të saj. Kur ka pasur variante dhe redaktime të ndryshme, është përshkruar, me sa ka pasur mundësi, historia e hartimit të tekstit, duke sjellë informata, në të njëjtën kohë, për dorëshkrimet e autorit arbëresh dhe për botimet që kanë shërbyer si burim bazë mbi fatin e veprës së botuar, si u prit ajo nga bashkëkohësit dhe si ka reaguar autori ndaj jehonës që i bëri publiku. Kjo ka dalë përmes vlerësimeve të kritikës, të kujtimeve të njerëzve që e kanë njohur shkrimtarin dhe të korrespondencës së tij e të bashkëkohësve të tij. Komenti gjuhësor ka si synim ta bëjë tekstin të qartë, prandaj në të janë shpjeguar fjalët e pakuptueshme, si fjalët e huaja dhe fjalët që kanë dalë nga përdorimi. Në komentet “reale” ose historike janë dhënë informata të shkurtra dhe shpjegime për ngjarjet dhe personat, për të cilat bëhet fjalë në vepër, të cilat, ndoshta, lexuesi i sotëm nuk i njeh, por diheshin dhe njiheshin në kohën e De Radës. Aparati shkencor është relativisht i plotë, por ai nuk e ka rënduar tekstin jashtë mase.

Si vëllimi i parë ashtu edhe i dyti do të pasurohen me *fotografi të frontespiceve* të veprave origjinale të De Radës ose me faksimile fragmentesh të ndryshme, sidomos nga parathëniet dhe pasthëniet e veprave të tij si dhe nga disa artikuj të tij.

Vëllimi *Veprat historike, filologjike dhe publicistike të De Radës* bën pjesë në aksionin pesëmbëdhjetëvjeçar (1976-1990) të Akademisë së Shkencave, e cila, me porosinë e Partisë dhe të Qeverisë, merr përsipër botimin kritik-shkencor të monumenteve të Trashëgimit kulturor të popullit shqiptar. Ky botim-bazë, me tekste shkencërisht të përcaktuara e të pajisura me aparatit shkencor përkatës, përfaqëson me dinjitet një pjesë të traditës dhe filologjisë vendase. Ai përbën një bazë shkencore, që ka munguar deri më sot, për studimet e mëtejshme deradiane dhe për ribotimet e ndryshme për masat e gjera. Botimi i De Radës përfshihet në serinë e parë të korpusit Trashëgimi kulturor i popullit

shqiptar. Monumente të gjuhës shqipe dhe vepra të gjuhësisë shqiptare. Në të hyjnë vepra që kanë interes kryesisht gjuhësor, si studime, monografi etj., të De Radës, të cilat kanë luajtur një rol të shquar në shkencën e gjuhësisë shqiptare, sidomos të diasporës së arbëreshëve të Italisë. Të gjitha materialet e këtij vëllimi përmbledhen dhe botohen për herë të parë, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në mjedisin arbëresh.

Shoku Jup Kastrati është shumë i preokupuar që Vepra në fjalë u vonua gjashtë muaj përtej afatit të dorëzimit (dhjetor 1978). Ai e ndjen thellë një gjë të tillë, sepse Ju ka vënë në pozitë të vështirë, mbasi e kishin në plan për ta çuar në shtyp. Nuk është në natyrën e tij të neglizhojë, sepse ndjenjen e punës dhe të përgjegjësisë e ka në gjak; por janë rrethanat e sipërshënuara që e kanë vonuar pa e paraqitur, pa e dorëzuar në kohën e caktuar. Në kaq, Vepra ka fituar shumë, sepse është pasuruar, plotësuar, redaktuar. Këtu duhet pasur parasysh edhe një rrethanë tjetër: Pozita e tij shtetërore dhe shoqërore, sidomos në lëvizjen mendore, shkencore e kulturore të rrethit të Shkodrës, qenia e tij përgjegjës katedre, titullar lënde, në grupe pune, në redaksi, në komisione nga më të ndryshmet. Të gjitha këto e kanë penguar që ta dorëzojë në afatin e duhur. Nuk po shënojmë këtu, që ai vuan edhe nga zemra, po ai nuk e ka përfillë një gjë të tillë. Edhe ne, si drejtori e Institutit, ndjejmë një përgjegjësi jo të vogël që, edhe sot e kësaj dite, ende s'i kemi dhënë kohën e duhur për ta përfunduar këtë vepër. Ju kini të drejtë, Profesor, kur më thonit në letrën Tuaj të datës 21.8.1978, “se është edhe për nderin e Institutit që libri të dalë sa më parë”. Por gjashtë muajt e humbur, besojmë t'i kompensojë grupi redaktorial i Shkodrës, megjithëqë shoku Fadil Podgorica prej një muaji është i sëmurë në shtëpi e spital. Kjo kohë do t'i ishte dashur redaksisë Suaj të qendrës për kontroll. Tash, komisioni Juaj mund të merret me probleme të tjera të Veprës, por jo me atë të verifikimit të saktësisë së përkthimit.

Sot, De Rada është gati të futet në korpusin “Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar. Monumente të gjuhës shqipe dhe vepra të gjuhësisë shqiptare”. Duke pasur parasysh se 1979-a është viti jubilat i 35-vjetorit të Çlirimit, mund të shfrytëzohet fare mirë botimi i De Radës në këtë kuadër, duke qenë, njëkohësisht, edhe brenda periudhës 100-vjeçare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1978-1981). Meqenëse botimi i Trashëgimit kulturor të popullit shqiptar do të kryhet në disa faza, me plane konkrete për secilën fazë, në etapën e parë (1976-1980) do të botohen një varg veprash që lidhen, kryesisht, me 100-vjetorin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kësaj periudhe i takojnë edhe *Veprat historike, filologjike dhe publicistike të De Radës*.

Konceptuar dhe daktilografuar
nga Jup Kastrati

Drejtori
(Dhora Lloja)

Drejtorisë së Institutit të Lartë Pedagogjik
Shkodër

Në mbledhjen që u bë më 5 prill 1979 në Drejtorinë e Institutit të Lartë Pedagogjik, pranova të shqyrtojshëm përkthimin nga italishtja në gjuhën shqipe të një pjesë të *Veprave historike e filologjike të Jeronim de Radës*, të cilin, për Akademinë e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e ka bërë pedagogu i atij Instituti të Lartë Pedagogjik docent Jup Kastrati.

Pas pranimit tim që ta bëja shqyrtimin, m'u dorëzua pa vonesë lënda italisht dhe përkthimi i saj në shqip, të lidhur secili veç e veç. Gjithashtu m'u tha edhe cilat pjesë të kreut të tretë nuk do të shqyrtoja, sepse nuk ishte nevoja.

Sadoqë e fillova me të parën punën për shqyrtimin e saktësisë së përkthimit të bërë nga italishtja në gjuhën shqipe të kaptinës III që është titulluar *Profile historike-letrare* (1833-1896), nuk mujta ta ktheja në kohën e duhur lëndën që m'u dha për shqyrtim, sepse puna nuk qe e lehtë dhe *dolën vështirësi të paparashikuara*. Pasi dorëzova kapitullin e tretë të shqyrtuar, m'u dha kreu V me titull: *Vepra historike-autobiografike* (1885-1902).

Në kaptinën III janë 61 shkrime të Jeronim De Radës dhe pikërisht këto:

Capitolo III.

Profili storico-letterari (1833-1896)

- 1) Domenico Bellusci (1833 / 1838).
- 2) Giulio Variboba (1838).
- 3) Francesco Avati (1838).
- 4) Francesco Bugliari (1838).
- 5) Pasquale Baffi (1838).
- 6) Angelo Masci (1838).
- 7) Agostino Tocci e Guglielmo Tocci (1866).
- 8) Milo Shini (1866).
- 9) Costantino e Garentina (1866).
- 10) Giuseppe De Rada (1883).
- 11) Anastasio Colurioti (1883).
- 12) Dod Gjegga (1884).
- 12/1) Dora d'Istria (1884).
- 13) Leonardo De Martino (1884).
- 14) Giovanni Emanuele Bidhera (1884).
- 15) Peti Mitko I (1884).
- 16) Peti Mitko II (1884).
- 17) Vincenzo Dorsa (1884).
- 18) Primo Dochi (1884).

- 19) Costa Bellucci (1884).
- 20) Louis Podhorszky (1885).
- 21) Giuseppina Di Knorr (1885).
- 22) Giuseppe Bennici (1885).
- 23) Giuseppe Musacchia (1885).
- 23/1) F. A. Stier (1885).
- 24) Giulio Variboba I (1885).
- 25) Giulio Variboba II (1885).
- 26) Eutimio Mitko (1885).
- 27) Filip Shiroka (1885).
- 28) Primo Dochi (1885).
- 29) Vincenzo Dorsa (1885).
- 30) Gabriele Dara (1885).
- 31) Antonio De Somogyi I (1885).
- 32) Antonio De Somogyi II (1885).
- 33) Michelangelo Billia I (1886).
- 34) Domenico Mauro (1886).
- 35) Michelangelo Billia II (1886).
- 36) Pashko Vasa, Angelo De Cubernatis, Marc Antonio Canini (1886).
- 37) Francesco Baffa, Carmine Dramis, Achille Parapugna, Giuseppe De Rada (1886).
- 38) Giovanni D'Aragona (1886).
- 39) Bernardo Bilotta. Francesco Crispi Di Glaviano (1886).
- 40) Teodoro Cedrero (1886).
- 41) Michele Calvosa (1886).
- 42) Giuseppe Skjirò (1886).
- 43) Hermann Buccholtz (1887).
- 43/1) Nicola Nacio (1887).
- 44) Francesco Tajani I (1887).
- 45) Francesco Tajani II (1887).
- 46) Ludvig Podhorsky (1887).
- 47) Giulio Variboba (1896).
- 48) Luigi Lorecchio (1896).
- 49) Costantino l'Adolescente (1896).
- 50) Giuseppina Di Knorr I (1896).
- 50/1) Giuseppina Di Knorr II (1896).
- 51) Bernardo Bilotta (1896).
- 52) Antonio Argondizza (1896).
- 53) Toni Gulia (1896).
- 54) Alfonso Kjinigò (1896).

- 55) Nicola Nacci (1896).
- 56) Cristina Gentile Mandalà (1896).
- 57) Antonio Santori (1896).
- 58) Eutimio Mitko (1896).
- 59) Leonardo De Martino (1896).
- 60) Rodrigo De Rada (1896).
- 61) Giuseppe De Rada (1896).

Kapitulli III

Profile historiko-letrare (1833-1896)

- 1) Domenik Belushi (1833/1838).
- 2) Jul Variboba (1833/1938).
- 3) Françesk Avati (1833/1938).
- 4) Françesk Bugliari (1838).
- 5) Paskal Bafi (1833/1938).
- 6) Engjëll Mashi (1833/1938).
- 7) Agostin Toçi dhe Guljelm Toçi (1866).
- 8) Milo Shini (1866).
- 9) Kostandini e Garentina (1866).
- 10) Zef De Rada (1883).
- 11) Anastas Kullurioti (1883).
- 12) Dodë Gega (1884).
- 12/I) Dora D'Istria (1884).
- 13) Leonard De Martino (1884).
- 14) Gjon Emanuel Bidera (1884).
- 15) Peti Mitko I (1884).
- 16) Peti Mitko II (1884).
- 17) Vinçenc Dorsa (1884).
- 18) Prenkë Doçi (1884).
- 19) Kostë Beluçi-Shala (1884).
- 20) Luigi Podhorszky (1885).
- 21) Jozefina Knorr (1885).
- 22) Zef Beniçi (1885).
- 23) Zef Muzaka (1885).
- 23/I) F. A. Stier (1885).
- 24) Jul Variboba I (1885).
- 25) Jul Variboba II (1885).
- 26) Thimi Mitko (1885).
- 27) Filip Shiroka (1885).

- 28) Prenkë Doçi (1885).
- 29) Vinçenc Dorsa (1885).
- 30) Gavril Dara (1885).
- 31) Anton De Somogyi I (1885).
- 32) Anton De Somogyi II (1885).
- 33) Mikelangjelo Bilja I (1886).
- 34) Domenik Mauro (1886).
- 35) Mikelangjelo Bilja II (1886).
- 36) Pashko Vasa, Engjëll De Gubernatis, Mark Anton Kanini (1886).
- 37) Françesk Baffa, Karmin Dhërmiu, Akil Parapunja, Zef De Rada (1886).
- 38) Gjon Aragona (1886).
- 39) Bernard Bilota dhe Françesk Krispi Glaviano (1886).
- 40) Teodor Çedrarò (1886).
- 41) Mikel Kalvoza (1886).
- 42) Zef Squirò (1886).
- 43) Herman Buholc (1887).
- 43/I) Nikollë Naço (1887).
- 44) Françesk Tajani I (1887).
- 45) Françesk Tajani II (1887).
- 46) Luigj Podhorszky (1887).
- 47) Jul Variboba (1896).
- 48) Luigj Lorekjo (1896).
- 49) Kostandini i vogël (1896).
- 50) Jozefina Knorr I (1896).
- 51/I) Jozefina Knorr II (1896).
- 52) Bernard Bilota (1896).
- 53) Toni Gulia (1896).
- 54) Alfons Kjinigò (1896).
- 55) Nikollë Naço (1896).
- 56) Kristina Gjentile Mandalà (1896).
- 57) Anton Santori (1896).
- 58) Thimi Mitko (1896).
- 59) Leonard De Martino (1896).
- 60) Rodrigo De Rada (1896).
- 61) Zef De Rada (1896).

Në kapitullin V të *Veprave historike dhe filologjike të Jeronim De Radës* janë tri shkrime:

Capitolo V.

Opere storico-autobiografiche (1885-1902)

- 1) Autografo (1885).
- 2) Autobiologia I, II, III, IV (1898, 1899).
- 3) Il testamento politico (1902).

Kapitulli V

Vepra historike-autobiografike (1885-1902):

- 1) Autograf (1895).
- 2) Autobiologji I, II, III, IV (1898, 1899).
- 3) Testamenti politik (1902).

Nga vëllimi *Veprat historike dhe filologjike të Jeronim De Radës*, që përfshin 1800 faqe të daktilografuara, unë kam shqyrtuar gjithësejt 414 faqe të daktilografuara.

Shumica e shkrimeve janë italisht e të përkthyer shqip, por ka edhe përshtatje nga dialekti arbëresh i Jeronim De Radës në shqipen letrare. Këto të fundit nuk qe nevoja të shqyrtoheshin. Lëndën e shqyrtuar të kreut V e dorëzova brenda kohës që m'u kërkua (më 30 gusht 1979).

Përkthimi i bërë nga docent Jup Kastrati u shqyrtua i tëri për sa i përket saktësisë duke krahasuar fjalë për fjalë tekstin italisht me përkthimin e bërë në gjuhën shqipe, sepse vetëm kështu mund të bëhej siç duhet puna e kërkuar.

Gjatë shqyrtimit të përkthimit të bërë dolën vështirësi që nuk qenë të pakta as të vogla, sepse italishtja që ka përdorë J. De Rada është e vështirë për t'u kuptuar në disa vende. Ai italishten nuk e ka përdorë mirë, prandaj është i errtë. Parregullsia në lidhjen e fjalive, proliksiteti, shprehjet e mbyllta e të tjera gjëra e bëjnë të vështirë, për të mos thënë të pamundur, në disa vende përkthimin. Vështirësitë që ka ndeshur përkthyesi m'u shfaqën në disa vende gjatë shqyrtimit që bëra; kështuqë, për të bërë saktësimin e përkthimit, lindi nevoja e domosdoshme e bashkëbisedimit dhe e këshillimit tim me përkthyesin. Ky bashkëpunim - mendoj unë - ka qenë i frutshëm, për pjesët e vështira, përkthimin e të cilave e kemi bërë bashkë, duke e zgjidhur në mënyrën më të drejtë për mendimin tonë.

Në përkthimin e bërë docent Jup Kastrati, me sa ka pasur mundësi - i ka qëndruar besnik origjinalit italisht nga ana kuptimore, duke bërë të qartë mendimet që Jeronim De Rada i ka shprehur errtë italisht në disa vende.

Puna që ka bërë përkthyesi, ka qenë e mundshme, por ai ka punuar me

zell e me dashuri të madhe, duke çarë i pari rrugën e përkthimit të vështirë të shkrimeve të De Radës në gjuhën italishte. Ai e ka detyruar italishten e Jeronim De Radës t'i bindet gjuhës letrare shqipe. Fjalët e fjalitë janë përkthyer shqip me saktësi pas kuptimit të thellë të tekstit italisht. Mendoj se përkthimi në shqip, në përgjithësi, ka dalë i qartë, po ta krahasojmë me tekstin italisht, që është i vështirë për t'u kuptuar në disa vende edhe nga vetë italianët. Përkthyesi çdo fjalë italiane ka kërkuar ta përkthejë me atë fjalë shqipe, që i përgjegj asaj më me përpikëmeri, por njëherit ka kërkuar edhe që mendimet e autorit t'i përkthejë shqip me ngjyrat e tyre. Këtë gjë ai e ka bërë me aftësi, siç e vërteton krahasimi i dy teksteve italisht e shqip.

Disa ndryshime në përkthimin e bërë në gjuhën shqipe nuk mund të shmangeshin nga përkthyesi dhe ishin të domosdoshme për ta bërë sa më të qartë shqip mendimin e shprehur errtë italisht nga Jeronim De Rada.

Përkthyesi ka bërë një punë serioze edhe për përkthimin e pjesëve që dëshmojnë për botëkuptimin idealist e fetar të Jeronim De Radës. Ato pjesë paraqitnin vende-vende vështirësi për t'i përkthyer shqip, duke i bërë sa më të kuptueshme për lexuesit.

Shkrimet italisht të Jeronim De Radës, të përkthyer në gjuhën shqipe, - për mendimin tim - duhen plotësuar me shënime që do të gjykohen të nevojshme.

Me nderime,
(Luigj Franja)

Shkodër, më 8 tetor 1979

Drejtorisë
së Institutit të Lartë Pedagogjik
Shkodër

Mora njoftim për kërkesën që unë të shqyrtoja saktësinë e përkthimit duke bërë krahasimin nga italishtja në shqipen të një pjese prej vëllimit, i cili titullohet “*Veprat historike e filologjike të Jeronim De Radës*”, të punuara (në 1800 faqe) nga docent Jup Kastrati, pedagog i këtij Instituti, për Akademinë e Shkencave. Prej këtij punimi të J. Kastratit, i cili përveç parathënies dhe studimit, përfshin edhe gjashtë pjesë apo kapituj për botimin e veprave të De Radës, u caktua që të merrja vetëm shkrimet gjuhësore të kapitullit të parë, ku gjindeshin edhe shkrime historike, i cili kapitull arrin në 216 faqe të daktilografuara dhe pra të krahasoja saktësinë e përkthimit për aq faqe italishte me aq të tjera shqipe.

Kapitulli, ai i pari marrë për krahasim, i lidhur veças në njërin e veças në tjetrën gjuhë, përmban 32 punime italishte të De Radës e të përkthyer shqip nga J. Kastrati, porse prej atyre nuk janë përkthim shtatë punime, janë të përshtatura nga shqipja e De Radës (dialekti arbëresh) në shqipen e sotme e po i dallojmë me një shenjë përkatëse (x). Këtu poshtë për të gjitha punimet e kapitullit të parë po rendisim titujt e tyre:

Opere storiche e linguistiche (1834-1902)

- 1) Avvertimento (1934).
- 2) Schiarimenti (1843).
- 3) Identità de' Pelasgi e degli Albanesi (1946).
- 4) Dalla Grammatica albanese di Camillo De Rada (1847).
- 5) Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli Elleni e i Latini (1864).
- 6) L'afflitto nostro venire nell' Italia (1866).
- 7) Alfabeto albanese (1866).
- 8) Osservazioni grammaticali (1866).
- 9) L'Albania in faccia all' Europa (1880).
- 10) Alfabeto nazionale (1883).
- 11) Note grammaticali (1883).
- 12) Gli Albanesi di Calabria (1884).
- 13) Il Collegio Albanese I (1884). Collegio Albanese in Italia II (1884).
Il Collegio Albanese III (1884).
- 14) Note grammaticali (1884).
- 15) Tre parole albanesi (1884).
- 16) Lexicon delle Rapsodie: Prefazione (1884).

- 17) Osservazioni linguistiche (1885).
- 18) Gli Albanesi della Grecia (1885).
- 19) Pelasgi ed Elleni (1885).
- 20) Rilievi grammaticali della lingua albanese (1885).
- 21) Collegio Albanese in S. Adriano (1886).
- 22) Divinazioni etnografiche (1886).
- 23) Progressi nella classificazione della lingua albanese (1886).
- 24) Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora (1887).
- 25) Il Collegio di S. Adriano (1887).
- 26) Lezioni di lingua albanese (1891).
- 27) La Cattedra di albanese in S. Demetrio Corone (1892).
- 28) Conferenze su l'antichità della lingua albanese (1893).
- 29) Alfabeto nazionale (1897).
- 30) Ma uopo è di largo concorso alla ristaurazione nazionale (1898).
- 31) Caratteri della lingua albanese e suoi monumenti nell'età preistorica (1899).
- 32) Prolusione all'apertura della Scuola albanese nel Collegio di Sant' Adriano (1902).

Vepra historike dhe gjuhësore (1834-1902)

- 1) Shënim (1834).
- 2) Sqarime (1843).
- 3) Identiteti i pellazgëve me shqiptarët (1846).
- 4) Nga Gramatika shqipe e Kamil De Radës (1847).
- 5) Lashtësi e kombit shqiptar dhe afëri e tij me helenët dhe latinët (1864).
- 6) Ardhja jonë e shkretë në Itali [Emigrimi i shqiptarëve në Itali] (1866).
- 7) Alfabet shqip (1866).
- 8) Vërejtje gramatikore (1866).
- 9) Shqipëria përballë Evropës (1880).
- 10) Alfabet kombëtar (1883).
- 11) Shënime gramatikore (1883).
- x 12) Arbëreshët e Kalabrisë (1884).
- x 13) Kolegji arbëresh I (1884). Kolegji arbëresh në Itali II (1884).
Kolegji arbëresh III (1884).
- 14) Shënime gramatikore (1884).
- 15) Tri fjalë shqipe (1884).
- 16) Fjalor i Rapsodive: Parathënie (1884).
- 17) Vërejtje gjuhësore (1885).

- x 18) Arbëreshët e Greqisë (1885).
- x19) Pellazgë dhe helenë (1885).
- 20) Dukuri gramatikore të gjuhës shqipe (1885).
- x 21) Kolegji arbëresh në Shën Adrian (1886).
- x 22) Hyjnizime etnografike (1886).
- 23) Përparime në klasifikimin e gjuhës shqipe (1886).
- x 24) Gjurma të vendbanimeve tona të lashta që qëndrojnë ende midis nesh (1887).
- 25) Kolegji i Shën Adrianit (1887).
- 26) Mësime për gjuhë shqipe (1891).
- 27) Katedra e shqipes në Shën Mitër Koronë (1892).
- 28) Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe (1893).
- 29) Alfabet kombëtar (1897).
- 30) Por është e nevojshme një pjesëmarrje e gjerë në rimëkëmbjen kombëtare (1898).
- 31) Tipare të gjuhës shqipe dhe përmendore të saja në periudhën parahistorike (1899).
- 32) Ligjëratë [e mbajtur me rastin] e hapjes së shkollës shqipe në Kolegjin e Shën Adrianit (1902).

Për t'ia arritur krahasimit të caktuar, do vendosur mënyra e qëllimi i veprimit. Do vepruar në atë mënyrë që ato 32 punime gjuhësore e pjesërisht historike të shkruara italisht nga De Rada të krahasohen me ato të përkthyer shqip nga J. Kastrati; mirëpo ky veprim nuk mund të kryhet duke lexuar vetëm përkthimin shqip as duke i ballafaquar aty këtu, pak këtu e pak aty tekste e të dyja gjuhëve, por duke u bërë krahasimi rresht pas rreshti nga i pari deri tek i fundit. Do bërë ky veprim kaq i gjerë për të plotësuar qëllimin që është formulimi i mendimit përfundimtar se si qëndron në atë tërësi prej 216 faqesh përkthimi ndaj origjinalit.

Por në këtë shqyrtim krahasues dalin të forta vështirësi. Duke qenë se do kuptuar së pari fraza italishte për të ditur se si është sjellë shqip ajo e duke qenë për më tepër se De Rada e shkruan italishten në mënyrë sa që nuk mund të kuptohet menjëherë prej lexuesit, hasen vështirësi për t'i përkthyer shqip këto shkrime italishte të De Radës ose për të ditur se si janë përkthyer. Kështu lind nevoja që fraza italishte e tija të studjohet e të lexohet sintaksisht për të ia nxjerrë domethënien e për të marrë vesh pastaj se si është bërë përkthimi i saj. Ndër ato 32 punime italishte të De Radës ka prej atyre, që ai i ka shkruar me një penë më të lehtë, por këtu çështja qëndron tek të vështirat. Mënyra e të shkruarit të italishtes prej tij është shumë sintetike sa atij i lypet që tubën e fjalive të varura ta ndajë me pikëpresje duke vazhduar

prap me një tubë tjetër këso fjalish për të arritur më në fund te fjalia kryesore e parë edhe kjo nga të varura tjera; në këto mënyrë De Rada shkruan italisht, po thuat se gjithkund, ndër ato 32 punime. Por ajo që në këtë kontekst bie në sy më fort është se De Rada e përdor të shkruarit sintetik herë këtu e herë aty në mënyrë prolixse, tepër të zgjatur (*stylus prolixus*). Ndërkaq gjindemi edhe ndër shprehje të mbyllta o kapërcyese o me përemra lidhorë, që i referohen emrit në largësi. Për disa nga këto vështirësi të tekstit italisht, në të cilin ka shprehje të De Radës që me gjithë përpjekjen time nuk po arrij t'i marr vesh, jemi këshilluar me përkthyesin për t'i zgjidhur.

Prandaj do të kemi parasysh ato vështirësi, që ka përballuar J. Kastrati në përkthim të atyre punimeve të sipërshënuara të De Radës e që i kemi ndërë gjatë krahasimit italisht-shqip. Po të flitet mbi përkthime nga ana teorike, njihen këto lloje: përkthim besnik sa të jetë i mundshëm, i lirë, i përshtatur, i përmbledhur. Ai përkthim, që brenda mundësive synon t'i rrijë afër origjinalit, është më i pëlqyer por më i vështirë dhe ai kërkohet të përkthehet sa më besnikisht fraza si kuptim, por edhe të ruhen format artistike, elementat e shprehurisë (ekspresivitet) nga gjuha e origjinalit në gjuhën e punuar të përkthimit. Këtë rrugë të një përkthimi sa më i përputhur me origjinalin ka ndjekur J. Kastrati. Po të dojë lexuesi të shikojë në këtë drejtim, ndihmohet nga kjo se J. Kastrati ka dhënë tekstin origjinal pranë tekstit të përkthyer. Në qoftë se përkthimi i duket lexuesit aty për aty si i vështirë, në të vërtetë është vetë mënyra e të shkruarit sintetik të De Radës, e cila është ruajtur në një masë të duhur edhe në përkthimin shqip të J. Kastratit ndër ato faqe.

Të gjitha këto, që u thanë këtu, qenë të domosdoshme të thoheshin para se të arrihej të përcaktohej përfundimi. Mbasi i vrojtova, me ato vështirësi të shpjeguara më parë, 32 punimet e mësipërme gjuhësore e pjesërisht historike të shkruara italisht nga De Rada e duke u lidhur përkthimin e tyre shqip të J. Kastratit dhe mbasi u këshillova pastaj me përkthyesin rreth disa gjërave për t'u siguruar më mirë, po shpreh këtë mendim. Përkthimin shqip që J. Kastrati e kreu për 32 punimet e naltshënuara gjuhësore e historike të hartuara në gjuhën italishte nga De Rada, e miratojmë për këto arsye. J. Kastrati bëri që të arrihet përkthimi në gjuhën shqipe i atyre punimeve, ku De Rada shkruan italisht për gjuhën shqipe e për disa shpjegime historike. Ndërkaq ky përkthim shqip priret drejt rrugës së përkthimit sa më besnik me origjinalin italisht, e cila rrugë ndiqet me plot durim, veçse është më e sigurtë; kështu pra përkthyesi në një anë ia ruan De Radës kuptimin e frazës italishte e në anën tjetër ia ruan veçoritë dalluese të shprehurisë, shprehjen sintetike. Por përkthimi në një anë tjetër synon ta lehtësojë mënyrën sintetike të De Radës: bile De Rada e shkruan italishten me të shprehur mjaft sintetik, e bile

proliks, tepër të zgjatur, kurse J. Kastrati në përkthim i përgjegj periodizimit të De Radës me një sintaks shqip të rregullt, ku lot rol për një lexim të kujdesshëm edhe vendosja e drejtë e shenjave të pikëzimit e ndryshme nga ajo e De Radës; në anën tjetër në përkthim bëhet më e çeltë shprehja sintetike e De Radës sepse përkthyesi në frazën shqipe ka fjalë e ndërtime të tyre në fjali, që përputhen me natyrën e gjuhës sonë. J. Kastrati, duke vënë pranë njëri tjetrit tekstin e përkthyer shqip edhe tekstin origjinal italisht të shkruar nga De Rada, i jep mundësinë lexuesit o studjuesit që të dyja tekstet t'i krahasojë për nga kuptimi e për nga shprehja. Këto pra janë arsytet, sipas të cilave e miratojmë punën plot durim të J. Kastratit në përkthimin shqip të atyre 32 punimeve të shkruara nga De Rada me një italishte të vështirë për lexuesit.

Mbasi nuk kam gjë tjetër të them e të shkruaj, veçse të përsëris çka shkrova, po i jap fund, për sa kam mundur, punës sime.

Me nderime:

(Kolë Ashta)

Shkodër, më 29 shtator 1979

Drejtorisë së Institutit të Lartë Pedagogjik

Shkodër

Më 5 prill 1979, në mbledhjen që u bë në drejtorinë e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, sipas kërkesës Suaj, mora përsipër të shqyrtoja përkthimin nga gjuha italiane në shqip të kapitullit të gjashtë të vëllimit: *Veprat historike e filologjike të Jeronim De Radës*, punuar nga docent Jup Kastrati për Akademinë e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Megjithëse kam qenë i sëmurë në spital dhe në shtëpi, verifikimin, përjasjen dhe krahasimin në mes të dy gjuhëve e kam kryer brenda kohës që më është ngarkuar.

Nga vëllimi: *Veprat historike dhe filologjike të Jeronim De Radës*, që ngërthen 1800 faqe të daktilografuara, unë kam shqyrtuar gjithësejt 224 faqe të daktilografuara. Kapitulli i gjashtë i këtij vëllimi përmban 46 letra të Jeronim De Radës, dërguar dijetarëve dhe shkrimtarëve të kohës.

Ja konkretisht letrat që kam kontrolluar e verifikuar saktësinë e përkthimit nga italishtja në shqip:

Capitolo VI.

Epistolario (1834-1902). Dalle Lettere:

- 1) A Raffaele Zagarese (20 ottobre 1834).
- 2) A Michele De Rada (20 settembre 1839).
- 3) Alla SS. Vergine Immacolata (8 dicembre 1840).
- 4) A Vincenzo Dorza (1847)
- 5) A Saverio Prato (2 giugno 1848).
- 6) Ad Antonio Santori (3 aprile 1865).
- 7) A Giovanni Stamile (25 gennaio 1865).
- 8) A Demetrio Camarda (21 giugno 1865).
- 9) A Demetrio Camarda (25 giugno 1865).
- 10) A Demetrio Camarda (22 gennaio 1866).
- 11) A Demetrio Camarda (10 luglio 1866).
- 12) A Demetrio Camarda (5 ottobre 1866).
- 13) A Bartolomeo Cecchetti (10 settembre 1868).
- 14) Il Ginnasio Garopoli in Corigliano Calabro (25 ottobre 1868).
- 15) A Giuseppe Jubani (12 luglio 1870).
- 16) Agli alunni del Ginassio di Corigliano (1 dicembre 1868).
- 17) A Sua Altezza la Principessa Elena Ghica (1870).
- 18) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (28 marzo 1884).
- 19) Alla Baronessa Giuseppina von Knorr (il giorno della Pascua 1884).
- 20) A Gustav Meyer (31 ottobre 1883).

- 21) A Gustav Meyer (gennaio 1888 ?).
- 22) A Gustav Meyer (22 maggio 1888).
- 23) A Gustav Meyer (dicembre 1887 ?).
- 24) A Cesare Cantú (19 marzo 1886).
- 25) Al Cav. L. De Simone (20 settembre 1885).
- 26) Al Direttore dell' *Adriatico* di Venezia (12 dicembre 1885).
- 27) Ad Antonio de Somogyi (20 dicembre 1885; 20 marzo 1886).
- 28) Ad Antonio Canini (20 dicembre 1885).
- 29) Ad Eutimio Mitko (15 maggio 1887).
- 30) A sua Eccellenza la Principessa Adele Pignatelli Strongoli (1891).
- 31) A Gian Crisostomo Bugliari (4 luglio 1893).
- 32) A Gian Crisostomo Bugliari (7 ottobre 1894).
- 33) Invito ai dispersi Albanesi-Pelasgi d'Italia e fuori (agosto 1895).
- 34) Discorso inaugurale (20 febbraio 1897).
- 35) Discorso (21 febbraio 1897).
- 36) A Giuseppe Schirò (30 luglio 1897).
- 37) Al Conte Angelo De Gubernatis (15 agosto 1897).
- 38) Ad Anselmo Lorecchio (15 gennaio 1898).
- 39) A Giuseppe Schirò (15 marzo 1898).
- 40) Al Comm. R. Cavazza (30 novembre 1900).
- 41) A Michele Marchianò (13 aprile 1901).
- 42) Ad Anselmo Lorecchio (31 gennaio 1902).
- 43) Ad Anselmo Lorecchio (5 aprile 1902).
- 44) A Donatello Nive (Vittorio Gaspare Gualtieri) (31 maggio 1902).
- 45) A Donatello Nive (Vittorio Gaspare Gualtieri) (31 maggio 1902).
- 46) A Michele Marchianò (1 novembre 1902).

Kapitulli VI

Epistular (1834-1902). Nga Letrat e botuara, dërguar ose drejtuar:

- 1) Rafael Xagarezes (20 tetor 1834).
- 2) Mikel De Radës (20 shtator 1839).
- 3) Së Bekuarës Virgjëreshës së Papërlyer (8 dhjetor 1840).
- 4) Vinçenc Dorsës (1847).
- 5) Saverio Pratos (2 qershor 1848).
- 6) Anton Santorit (3 prill 1865).
- 7) Gjon Stamiles (25 janar 1865).
- 8) Dhimitër Kamardës (21 qershor 1865)
- 9) Dhimitër Kamardës (25 qershor 1865)
- 10) Dhimitër Kamardës (22 janar 1866)

- 11) Dhimitër Kamardës (10 korrik 1866)
- 12) Dhimitër Kamardës (5 tetor 1866).
- 13) Bartolomé Çeketit (10 shtator 1868).
- 14) Gjinnazi Garopoli në Koriljano Kalabro (25 tetor 1868).
- 15) Zef Jubanit (12 korrik 1870).
- 16) Nxënësve të Gjinnazit të Koriljanos (1 dhjetor 1868).
- 17) Elena Gjikkës (1870).
- 18) Jozefina Knorrit (28 mars 1884).
- 19) Jozefina Knorrit (1884).
- 20) Gustav Meyerit (31 tetor 1883).
- 21) Gustav Meyerit (janar 1888?).
- 22) Gustav Meyerit (22 maj 1888).
- 23) Gustav Meyerit (dhjetor 1887?).
- 24) Çezar Kantuit (19 mars 1886).
- 25) L. G. De Simonit (korrik 1885).
- 26) Drejtorit të gazetës *Adriatico* të Venedikut (12 dhjetor 1885).
- 27) Anton De Somogyit (20 dhjetor 1885; 20 mars 1886).
- 28) Anton Kaninit (20 dhjetor 1885).
- 29) Thimi Mitkos (15 maj 1887).
- 30) Adele Pinjatele Strongolit (1891).
- 31) Xhan Krizostom Buljarit (4 korrik 1893).
- 32) Xhan Krizostom Buljarit (7 tetor 1894).
- 33) Proklamatë. Thirrje shqiptarëve të shpërndarë të Italisë dhe jashtë (gusht 1895).
- 34) Fjalim përurimtar (20 shkurt 1897).
- 35) Fjalim (21 shkurt 1897).
- 36) Zef Sqiròit (30 korrik 1897).
- 37) Engjëll De Gubernatis (15 gusht 1897).
- 38) Anselm Lorekjos (15 janar 1898).
- 39) Zef Sqiròit (15 mars 1898).
- 40) R. Kavacas (7 nëntor 1900).
- 41) Mikel Markianòit (13 prill 1901).
- 42) Anselm Lorekjos (31 janar 1902).
- 43) Anselm Lorekjos (5 prill 1902).
- 44) Viktor Gualtierit (31 maj 1902).
- 45) Viktor Gualtierit (31 maj 1902).
- 46) Mikel Markianòit (1 nëntor 1902).

Nga këto 46 letra të Jeronim De Radës, dy janë në dialektin arbëresh (letra e dërguar Anton De Somogyit, nr. 27; dhe ajo e dërguar Thimi Mitkos, nr. 29); kurse 44 të tjerat janë në italisht.

Shqipërimi i veprave të arbëreshit të madh nga italishtja është një çështje me rëndësi të veçantë dhe paraqet një tok vështirësish. De Rada, duke shkruar italisht, përkthente nga gjuha e vet amtare, nga shqipja: Ai mendonte dhe fliste në dialektin arbëresh, i cili, sidomos në veprat e tij është shumë i errët. Italishten nuk e përdorte mirë, sepse - siç thotë vetë - “ajo nuk qe për mua gjuha e nënës; atë m’u desh ta nxë (ta mësoj) ndër libra ashtu sikurse latinishten e greqishten”. Nga ana tjetër, ai shkruante pa kujdes, madje edhe pa shenjat e duhura të pikësismit, pa asnjë drejtshkrim të përpikët, koherent, të njësuar, me shumë të meta të tjera, me inkonsequenca ortografike, me një gjuhë, shpeshherë, të pakuptueshme, të pakapshme, me konstrakte që s’janë të italishtes letrare të shekullit XIX, me latinizma, provincializma, inversione, metateza, anakolote, arkaizma, me amnezi sintaktike, me fjali të varura, të ndërshtëna a të ndërkallura, pa kriter. Një varg studiuesish e kanë vënë ré prej kohësh një të metë të tilla të arbëreshit të madh. Ja, ndonjë, sa për konkretizim: “Il De Rada scrivendo in italiano traduceva: egli pensava e parlava in albanese” (G. Schirò Junior). “... la lingua italiana, in cui è scritta questa grammatica, contorcendosi in volute rudi e tormentose” (M. Marchianò). “Questo autografo, non so come, manca quasi affatto dell’energia e incisiva del suo stile e ribocca di ogni sorta di errori. Latinismi, provincialismi, inversioni contorte, voci poetiche, bisticci, metatezi strane, arcaismi, amnesie, vorrei dire, sintattiche (per le quali si ripetono in proposizioni, le stesse parole, peggio che anacoluticamente) si mescolano e ridanno in una prosa, che ha dello stile latino e albanese e che si svolge in una forma qua e là infantile a punto perspicuo dall’interpunzione e ortografia spesso errata, dall’andatura cascante, ove neppure le maiuscole sono usate correttamente” (M. Marchianò). “Edhe përkthimi që bani n’italisht, nuk është mjaft i lehtë, se edhe italishten De Rada nuk e përdorte mirë, e ai vetë thotë në një vend këto fjalë: “Questa medesima [la lingua italiana] nuk era a me nativa, ed ove non seppi tutta la sua potenza mi sia escusazione l’averla dovuta apprendere su i libri, al modo che la latina, al modo che la greca” (Luigj Gurakuqi). “Veramente io non potei poscia risolvere nella melodia tanta dell’italiano, la frase spesso disvolta della lingua nostra, antica e dotata di flessioni: pure questa impronta, imbarazzante come il pudore, ne riflette la provenienza forestiera” (G. De Rada).

Të gjitha këto vështirësi janë kapërcyer me sukses nga docent Jup Kastrati. Përkthimi prej italishtes në shqip është bërë me kujdes të veçantë dhe me përpikmëri. Shqipërimi është i saktë dhe i qartë, gjuha është e punuar, stili i rrjedhshëm. Përkthyesi i ka qëndruar besnik origjinalit italisht.

Me nderime,
(Fadil Podgorica)
Shkodër, më 25 tetor 1979.

Prof. ALEKS BUDA

Kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH

Tiranë

I dashur Profesor,

Erdha nga Shkodra të Ju dorëzoj *Veprat historike dhe filologjike të Jeronim De Radës* (1832-1903), të cilat i punova dhe i përfundova nën nxitjen, ndihmën, përkrahjen dhe dashamirësinë Tuaj. Meqenëse nuk Ju gjeta, i lashë te sekretarja Juaj. Janë gjithësejt 1600 faqe të daktilografuara, të ndara në këtë mënyrë: a) Teksti origjinal në italisht, 645 f. (vëllimi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7); b) Teksti në dialektin arbëresh, i transkriptuar, 140 f. (vëllimi 8); c) Teksti i shqipëruar ose i përshtatur në gjuhën e sotme, 645 f. (vëllimi 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15). Deri më 15 prill 1978, Ju dërgoj studimin introduktiv (20 f.) si edhe aparatën shkencor (150 f.).

Vili Kamsi më tha se do të vini në Shkodër nga fundi i kësaj jave. Më vjen keq që s'takohemi dot, sepse unë jam me shërbim në Peshkopi, për konsultime dhe provime të stazhierëve dhe të studentëve me korrespondencë, në ditët 22, 23, 24, 25, 26 mars 1978.

Veprat historike dhe filologjike të De Radës ia tregova shokut Foto Çami, i cili më nderoi së tepërmi duke më pritur në zyrën e tij, me një konsideratë të veçantë. Ai më përgëzoi me gjithë zemër për këtë vepër të madhe. "Ta kam zili" - më tha me ngrohtësi dhe dashamirësi. M'u kujtua shprehja e De Radës, kur shkruan: "Më tha fjalë që do të ngjallnin një ndjenjë krenarie në zemrën e cilitdo".

Çështjen e shkumjes sime ndër arbëreshët e Italisë e kam ngritur përsëri, aty ku është vendi. Ju lutem shumë, kur të vini në Shkodër, bisedonie o me shokun Foto Çami, o me shokun Adem Tukja, o me të dy bashkë, këtë çështje. Organizata-bazë e Partisë e Institutit të Lartë Pedagogjik si edhe sekretari i saj Ing. Fadil Kraja janë plotësisht dakord që unë të shkoj për gjurmime shkencore ndër arbëreshët e Italisë. Ata kanë folur edhe me organet kompetente. Prandaj po ta shihni të arsyeshme, përsëritnie kërkesën zyrtare. Vajtja ime atje do të jetë me dobi të madhe si për interpretimin sa më të mirë të *Skanderbekut të pafanë*, që kam në dorë, ashtu edhe për kulturën tonë kombëtare, sepse do të sillja materiale arkivale të panjohura ndër në.

Po Ju bashkangjes një karakteristikë time, që ka bërë Instituti i Lartë Pedagogjik, dy muaj më parë. Ndoshta mund të Ju shërbejë.

Me nderime të thella,

(Jup Kastrati)

Tiranë, 20 mars 1978

DOKUMENT ANEKS 4



E pritëm me interes letrën tuaj, ku na njoftoni për punën e madhe që keni bërë për veprën poetike të Jeronim De Radës.

Lidhur me mundësitë dhe masat konkrete që duhen ndërmarrë për botimin e kësaj vepre, si dhe për disa probleme që kanë të bëjnë me botimin e veprave historiko-filologjike-publistike të De Radës, për të cilat me kohë jeni në dijeni, mendojmë se do të ishte mirë që të vini për një takim pune në Akademi, në një kohë të shpejtë, brenda mundësive. Nëse ju jeni dakord, ky takim mund të bëhet në 10-ditorin e parë të muajit korrik. Për datën e saktë kur mund të vini, mundësisht na njoftoni paraprakisht.



KRYETARI

(Aleks Buda)

Aleks Buda



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISE
AKADEMIA E SHKENCAVE

Kryesia

Nr. 850/1 Prot.

Tiranë, më 28.6.1986

Sh. JUP KASTRATI

INSTITUTI I LARTË PEDAGOGJIK

SHKODËR

E pritëm me interes letrën tuaj, ku na njoftoniit për punën e madhe që keni bërë për veprën poetike të Jeronim De Radës.

Lidhur me mundësitë dhe masat konkrete që duhen ndër-marrë për botimin e kësaj vepre, si dhe për disa probleme që kanë të bëjnë me botimin e veprave historiko-filologjike-publistike të De Radës, për të cilat me kohë jeni në dijeni, mendojmë se do të ishte mirë që të vinit për një takim pune në Akademi, në një kohë të shpejtë, brenda mundësive. Në se ju jeni dakord, ky takim mund të bëhej në 10-ditorin e parë të muajit korrik. Për datën e saktë kur mund të vini, mundësisht na njoftoni paraprakisht.



KRYETARI

(Aleks Buda)

Aleks Buda

Nr. 170



Tiranë, më 21.3.1986

Sh. Jup Kustaku
Instituti i Lartë Pedagogjik
Shkollës

KODËR

it, shtëpia botuese

"N. Frashëri", do të botojë veprat e traditës të autorëve arbëresh
vetëm në gjuhën e sotme. Botimet në dy gjuhë (në të vjetrën dhe atë
të sotmen) do t'i bëjë Akademia e Shkencave. Kështu që veprën
"Skënderbeu i pafan" që keni përshtetur ju, nuk mund të botojmë në
dy variante.

DREJTORI

(Thanas Leq)





REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHqipëRISE

SHTËPIA BOTUESE "NAIM FRASHËRI"

Tiranë, më 23.3.1986

Nr. 150 Prot.

Sh. Jup Kastrioti
Instituti i Lartë Pedagogjik

SHKODËR

Shoku Jup,

Sipas kritereve të miratuara kohët e fundit, shtëpia botuese "N. Frashëri", do të botojë veprat e traditës të autorëve arbëresh vetëm në gjuhën e sotme. Botimet në dy gjuhë (në të vjetërn dhe atë të sotmen) do t'i bëjë Akademia e Shkencave. Kështu që veprën "Skënderbeu i paan" që keni përshtatur ju, nuk mund të botojmë në dy variante.

DREJTORI

(Thanas Lëo)



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

De Rada, Jeronim

Vepra historike dhe filologjike / Jeronim De Rada;
përkth. prej ital., studim hyrës, pajisi me shënime e komente Jup
Kastrati; red. përkth. Elda Katorri; rec. Emil Lafe, Klara Kodra;
red. shkenc. Bashkim Gjergji, Vilma Proko, Manjola Tërshana.
– Tiranë: Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, 2020

905 f. ; 24 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4664-0-2

1. Letërsia arbëreshe 2. Autorë arbëreshë 3. De Rada, Jeronim
4. Kritika, interpretimi 5. Shkrime, korrespondenca për shtypin 6. Itali

821.18'282.4(450).09

929(=18:450) [De Rada, Jeronim]